



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë /Akademija Pravde /Academy of Justice

E DREJTA CIVILE, ADMINISTRATIVE DHE EKONOMIKE

Prishtinë, tetor 2017

Publikuar nga Akademia e Drejtësisë

© AD 2017, Të gjitha të drejtat e rezervuara

Përmbajtja e këtij materiali nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohët pa miratimin me shkrim të Akademisë së Drejtësisë (AD).

MOHIMI I PËREGJEGJËSISË

Pikëpamjet e autorëve nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Akademisë së Drejtësisë.

Tabela e përmbajtjes së modulit

I. E Drejta civile.....	5
II. Procedura kontestimore – pjesa e parë	49
III. Procedura kontestimore – pjesa e dytë	163
IV. Procedura jokontestimore	213
V. Procedura përmbartimore.....	239
V. Marrja dhe administrimi i provave në procedurën civile.....	275
VI. E drejta familjare.....	327
VII. E drejta trashëgimisë.....	375
VIII. Mbrojtja gjyqësore në konteste nga marrëdhënia e punës.....	409
IX. E drejta e detyrimeve.....	447
X. E drejta administrative.....	491
XI. E drejta ekonomike	533
XII. E drejta e pronësisë dhe të drejtat dhe të drejtat e tjera të përafërta.....	617

I. E drejta civile

Shukri Sylejmani
Gjyqtarë në Gjykatën Supreme

Tabela e përmbajtjes “ E drejta civile “

Hyrje.....	8
Objektivat e modulit	9
Metodat e të shpjeguarit.....	9
Pritjet nga pjesëmarrësit	10
Mjetet e nevojshme.....	10
Ushtrim praktik.....	10
Burimet.....	10
Përmbledhje	11
1.1 Hyrje	12
1.2 Objektivat trajnuese	12
1.4 Objekti i së drejtës civile-sendet dhe të drejtat.....	13
1.5 Ushtrime	14
1.6 Përmbledhje.....	14
2. Krijimi dhe mbarimi i raporteve juridike ndarja e fakteve juridike- dhe modifikimi i punëve juridike-kushti dhe afati	16
2.1 Hyrje	16
2.2 Objektivat trajnues	16
2.3 Krijimi dhe mbarimi i raporteve juridike.....	17
2.5 Ushtrime	21
2.6 Përmbledhje.....	21
3. Posedimi, llojet, mbrojtja dhe shuarja e tij	22
3.1 Hyrje	22
3.2. Objektivat trajnues	22
3.3 Posedimi dhe llojet e posedimit	22
3.4 Mbrojtja e posedimit dhe shuarja e tij	24
3.5 Ushtrime	25
3.6 Përmbledhje.....	25
4. Të drejtat absolute dhe relative, përfaqësimi me prokurë (autorizimi)	26
4.1 Hyrje	26
4.2 Objektivat trajnues	26
4.3 Të drejtat absolute dhe relative	26
4.4 Përfaqësimi - përfaqësimi me prokurë (prokurë).....	29
4.5 Ushtrime	30
4.6 Përmbledhje.....	30
5. Punët juridike të njëanshme /negotia unilateralia/, punët juridike të dyanshme/ negotia bilateralia/, dhe punët juridike të pa vlefshme-nule	31
5.1 Hyrje	31
5.2. Objektivat trajnues	31
5.3 Punët juridike të njëanshme dhe të dyanshme	31
5.4 Ushtrime	42
5.5 Përmbledhje.....	42
6. Veprimet e palejueshme (deliktet) - pasurimi i pabazë - Mbrojtja e të drejtave .	43

6.1 Hyrje	43
6.2. Objektivat e trajnimit	43
6.3 Veprimet e palejueshme (deliktet) - pasurimi i pabazë	43
6.4 Mbrojtja e të drejtave	45
6.5 Ushtrime	48
6.6 Përmbledhje.....	48

Hyrje

E Drejta Civile si degë pozitive e së drejtës në sistemin juridik të çdo shteti, me normat juridike të saj, paraqet një rregullator juridik të marrëdhënieve shoqërore me karakter pasuror respektivisht të marrëdhënieve juridiko-civile (marrëdhënieve juridiko-sendore, marrëdhënieve juridiko-detyrimore, dhe marrëdhënieve juridiko-trashëgimore).

Andaj si e tillë, e drejta civile si degë pozitive e sistemit juridik është e pranishme në përditshmërinë e jetës së njeriut, më shumë se çdo degë tjetër e së drejtës. Njeriu nga lindja deri në vdekje, fiton të drejta dhe detyrime që burojnë nga normat e së drejtës civile, madje në disa raste këto norma juridike veprojnë edhe para lindjes së njeriut si dhe mortis causa (në rast të vdekjes së tij).

Pyetjes se, ç'është e drejta civile, nuk mund t'i përgjigjemi menjëherë, sepse, megjithëse shkencë mbi të drejtën civile hynë në shkencat më të vjetra dhe më të zhvilluara të drejtësisë, shkencëtarët ende nuk pajtohen rreth çështjes se çka studion e drejta civile, çka është objekt i saj. Por, e drejta civile nuk është vetëm shkencë, nuk është vetëm teori. Ajo ekziston në praktikë, në jetë dhe çdo ditë hasim në te e nuk jemi të vetëdijshëm për te, prandaj është me rëndësi që të mësohet për teorinë, praktikën dhe teknikën civile juridike, sepse, para se gjithash, shkencë e së drejtës civile, domethënë, teoria e së drejtës civile nënkuptohet nga fjala e drejta civile si dhe nga fjala e drejta. Por, si theksuam më lartë, e drejta civile ekziston në praktikë, në jetën e përditshme . Çdo marrëdhënie civile juridike, është raport konkret, i caktuar jetësor , më saktësisht raport shoqëror. Ndërsa, teknika juridike është mjeshtri, mënyrë e arsyeshme dhe efikase e zbatimit të drejtë të rregullave të përgjithshme, abstrakte në rastet konkrete (me teknikën juridike disa nënkuptojnë përcaktimin e parimeve juridike në sistemin e kuptimeve dhe të dispozitave. Ndërkaq, kjo është punë e shkencës juridike).

E drejta civile rregullon marrëdhëniet shoqërore duke caktuar norma, pra, kemi të bëjmë me normat e të drejtës civile.

Marrëdhëniet shoqërore që i rregullon e drejta civile janë drejtpërdrejtë marrëdhëniet ekonomike, madje një rreth i marrëdhënieve ekonomike, pra e drejta dhe ekonomia. Në këtë kontekst, duhet të thellojmë mësimin mbi lidhjen e ekonomisë dhe të drejtës si bazë e superstrukturës. Tërësia e këtyre marrëdhënieve të prodhimtarisë përbënë strukturën ekonomike të shoqërisë; bazën reale, në të cilën ngrihet superstruktura juridike , politike dhe të cilës i përgjigjen format përkatëse të vetëdijes shoqërore.

Lidhur me këtë, e drejta civile është e kushtëzuar nga ekonomia, madje me formacion të caktuar ekonomik – ekonominë e mallrave. Prandaj, kemi të bëjmë me veprimin reciprok të bazës dhe superstrukturës juridike. Kushtëzimi i ekonomisë dhe të drejtës ka të bëjë me faktin se ligjdhënësi me rastin e nxjerrjes së dispozitave është i lidhur me ekonominë e shoqërisë përkatëse. Dhe, nga kjo rezulton se historia e së drejtës civile është histori e raporteve të mallrave. Edhe formacionet e vjetra historike shoqërore me pronësi kolektive kanë pasur edhe sisteme gjegjëse normative. Ky proces, mund të përcillet në mënyrë veçanërisht të mirë në zhvillimin e së drejtës romake, i cili më pastaj me shkatërrimin e Romës dhe krijimin e rendit të rinj shoqëror- feudalizmit, e drejta civile shtyhet përsëri në planë të dytë. Mirëpo, studimi shkencor i së drejtës civile është më i vjetri midis disiplinave shkencore juridike.

Objektivat e modulit

Pas përfundimit të këtij moduli trajnues, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Dallojnë burimet materiale dhe formale të së drejtës civile. Të fitojnë njohuri dhe dijeni për të zbatuar praktikën gjyqësore në punën e tyre si gjyqtar të ardhshëm.
- Njohin rëndësinë e praktikës gjyqësore në sigurinë juridike të qytetarëve, si dhe kush merret apo e redakton praktikën gjyqësore.
- Zgjerojnë njohuritë e tyre për objektet e së drejtës civile dhe për llojet e objekteve të së drejtës civile.
- Thellojnë njohuritë për sendet si objekt më i rëndësishëm i të drejtës civile, përkatësisht njohurit se e drejta sendore (pronësia) si pjesë e së drejtës civile përfshinë tërësinë e normave juridike – civile, përkatësisht të normave juridiko-sendore me të cilat rregullohen marrëdhëniet juridike – civile, të subjekteve lidhur me sendet.
- Dallojnë rëndësinë e sendeve në qarkullim dhe sendeve jashtë qarkullimit që do t'i hasin shumë shpesh në praktikën gjyqësore të ardhme të tyre.
- Kuptojnë rëndësinë e krijimit dhe mbarimit të raporteve juridike.
- Njohja me faktet juridike dhe ndarja e fakteve juridike si dhe rëndësia e ndarjes së tyre për raportet juridike.
- Bëjnë ndarjen e fakteve juridike si dhe ato t'i zbatojnë në punën e tyre si gjyqtar të ardhshëm dhe rëndësinë e deklaramit të vullnetit si fakt juridik në raportet juridike – civile që krijon ai.
- Dallojnë llojet e deklaramit të vullnetit në bazë të së cilave krijohen punët e vlefshme juridike dhe punët jo të vlefshme juridike
- Thellojnë njohuritë dhe t'i kuptojnë punët juridike të modifikuara, rëndësinë e veprimit të punës juridike në modifikimet lidhur me kushtin dhe afatin.
- Njohin kur puna e nulshme juridike ekziston me kusht .
- Zbatojnë drejtë afatet në të cilat mund të paraqitet kërkesa për rrëzueshmërinë e punës etj
- Avancojnë njohurit lidhur me posedimin dhe mbrojtjen e posedimit – paditë posesore dhe llojet e tyre.
- Dallojnë posedimin nga pronësia që shpeshherë ngatërrohen njëra me tjetrën.

Metodat e të shpjeguarit

Prezantimi fillohet me parashtrimin e një apo më shumë pyetjeve ,me ç' rast pjesëmarrësve do tu ndihmojnë të kuptojnë dhe mendojnë për ligjëratën, pastaj vazhdohet me paraqitjen e problemit dhe me marrjen e disa përgjigjeve apo zgjidhjeve nga pjesëmarrësit e cila pastaj mund të vazhdoj duke shqyrtuar dhe ndërtuar sugjerimet që dalin nga pjesa e diskutimeve.

Të kërkohet që ata t'i sfidojnë idetë e trajnuesit.

Në pyetjet e pjesëmarrësve, në vend të përgjigjes të trajnuesit të kërkohet përgjigje nga pjesëmarrësit tjerë. Pyetjet dhe përgjigjet duhet t'i dëgjojnë dhe kuptojnë të gjithë pjesëmarrësit. Të shtrohet pyetje gjatë prezantimit të cilat janë më shumë sugjестive nëse nuk kërkoni një përgjigje të saktë, por gjithsesi duke u parashtruar pyetje më frytdhënëse të cilat nxisin mendimin e tyre për përgjigje të saktë. Kur të arrihet një pikë e rëndësishme, sipas nevojës pauzohet në ligjëratë. Nëse është caktuar detyra, ajo duhet t'i referohet qëllimit të qartë duke kërkuar përgjigje të saktë, të cilën do ta aprovojnë edhe pjesëmarrësit. Përdorimi i slideve – fotografive të prezantimeve apo materialeve fillohet me pyetje se, çfarë shohim në te para se të vazhdohet me prezantim, dhe këto mjete dhe metoda përdoren për t'i ndihmuar pjesëmarrësit që të mendojnë për një problem për gjatë kohës së prezantimit. Për demonstrimin e çështjeve, kryesisht do të përdoret forma e diskutimit – bashkëbisedimit.

Me këtë arrihet që të gjithë pjesëmarrësit të jenë aktiv gjatë gjithë kohës duke e dhënë kontributin e tyre në diskutime – bashkëbisedime , me ç'rast bashkarisht ndihmohet arritja e qëllimeve të këtij programi.

Pritjet nga pjesëmarrësit

Nga pjesëmarrësit pritet që të jenë të përgatitur me dije dhe shkathtësi fillestare nga e Drejta Civile, për të pas qasje më aktive gjatë ligjërimit, bashkëbisedimit dhe punës praktike individuale dhe grupe në mënyrë që pjesëmarrësit të përfitojnë dije dhe shkathtësi në pajtim me qëllimet-objektivat e këtij cikli mësimor.

Posaçërisht, nga pjesëmarrësit pritet që të jenë aktiv gjatë çdo shqyrtimi duke dhënë kontributin e tyre me pyetje, përgjigjeje, diskutime dhe angazhim në punë praktike gjatë tërë kohës së zgjatjes të këtij cikli mësimor.

Mjetet e nevojshme

Slaidet me Power Point. Do të shfrytëzohen si shtesë e mësimin klinik, analizimi apo zbërthimi i informatave, me grafite dhe ilustrime të cilat i shikojnë të gjithë pjesëmarrësit gjatë prezantimit dhe diskutimeve – bashkëbisedimit.

Përparësitë dhe mangësitë qëndrojnë në atë se, pjesëmarrësit gjatë prezantimit i përcjellin ilustrimet duke u thelluar në prezantim , çka përfitojnë nga prezantimi. Ndërsa mund të ndodhë që disa nga pjesëmarrësit të koncentrohen më tepër në grafitet – ilustrimet duke mos përcjellë prezantimin e trajnuesit.

Ushtrim praktik

Përshkrimi dhe rëndësia e problemit (çështjes) ,zgjdhja alternative e cila do të ishte më e mira. Nëse ajo nuk funksion, të provohet deri sa të gjendet zgjidhja e problemit – çështjes. Gjithashtu do të bëhet studimi i rasteve në rast të ndonjë konflikti apo dileme, si është vendosur për rastin dhe pse ashtu?

Burimet

Si burime juridike pjesëmarrësit e këtij cikli mësimor mund ti shfrytëzojnë përveç ligjëratave nga trajnuesi, edhe literaturën juridike nga lëmia e së Drejtës së Procedurës Civile, ligjet e cituara më lartë, konventat ndërkombëtare, praktikën gjyqësore me komente të ndryshme si dhe burime tjera juridike.

- E drejta sendore (pronësia) Prof Dr. A. Aliu.
- Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike –Pronësore.
- Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.
- Ligji për Familjen i Kosovës.
- Ligji për Trashëgiminë e Kosovës.

- Ligji për Marrëdhëniet Banesore.
- Ligji mbi Qarkullimin e Pasurisë së Paluajtshme.
- Ligji mbi Bashkëpronësinë.
- Ligji për Procedurën Kontestimore, etj.

Përmbledhje

Në këtë modul do të prezantohet, diskutohet – bashkëbisedohet për objektivat mësimore, pasqyrimin e prezantimit, renditjen e aktiviteteve dhe përputhjen e përmbajtjes, ushtrimin praktik të aktiviteteve, (ushtrime, raste studimi etj) si dhe për burimet e nevojshme (transparenca, dorëzimi i materialeve, flip – chart shënime etj)

Tu jepen pjesëmarrësve, qartësimet e nevojshme në pyetjet e tyre eventuale. Të pranohen sugjerimet dhe vlerësimet e pjesëmarrësve lidhur me trajnimin dhe propozimet dhe sugjerimet e tyre të qëlluara të përfshihen në modulet e ardhshme të trajnimit.

1. Objekti i së drejtës civile- sendet dhe të drejtat - Burimet e së drejtës civile – praktika gjyqësore

1.1 Hyrje

Në këtë sesion do të ligjërohet – bashkëbisedohet për konceptin dhe rëndësinë e burimeve të së drejtës civile dhe zbatimi i tyre në praktikën gjyqësore me theks të veçantë praktika gjyqësore si burim i të drejtës civile, aftësia e tyre në zbatimin e praktikës gjyqësore në punën e ardhshme në gjykata.

Në këtë sesion do të ligjërohet – bashkëbisedohet edhe për konceptim dhe rëndësinë e objekteve të së drejtës civile, si dhe për përkufizimin e nocionit të sendit, me theks të veçantë, për sendet në qarkullim dhe jashtë qarkullimit, të cilat gjykatësit dhe prokurorët e ardhshëm shpesh do t'i hasin në praktikën e tyre gjyqësore. Të zbatojnë ligjet në aplikim lidhur me sendet në qarkullim dhe sendet jashtë qarkullimit duke shpjeguar dallimet e sendeve në qarkullim dhe atyre jashtë qarkullimit si dhe përkufizimet ligjore lidhur me sendet në qarkullim dhe ato jashtë qarkullimit.

1.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij sesioni, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Dallojnë burimet materiale dhe formale të së drejtës civile;
- Zbatojnë drejtë praktikën gjyqësore në punën e tyre si gjyqtar të ardhshëm;
- Njohin rëndësinë e praktikës gjyqësore, në sigurinë juridike të qytetarëve si dhe kush merret apo e sajon praktikën gjyqësore;
- Zgjerojnë njohuritë e tyre për objektet e së drejtës civile për llojet e objekteve të së drejtës civile;
- Thellojnë njohuritë për sendet si objekt më i rëndësishëm i të drejtës civile, përkatësisht njohurit se e drejta sendore (pronësia) si pjesë e së drejtës civile përfshinë tërësinë e normave juridike – civile, përkatësisht të normave juridiko-sendore me të cilat rregullohen marrëdhëniet juridike – civile, të subjekteve lidhur me sendet;
- Dallojnë rëndësinë e sendeve në qarkullim dhe sendeve jashtë qarkullimit që do ti hasin shumë shpesh në praktikën gjyqësore.

1.3 Burimet e së drejtës civile – praktika gjyqësore

Burimet e së drejtës civile nuk nënkupton procesin shoqëror që krijon marrëdhëniet civile – juridike, përkatësisht marrëdhëniet ekonomike. Sepse, burim i së drejtës në terminologjinë e gjertanishme ka kuptim të caktuar dhe donë të thotë burim i normave juridike. Si zakonisht, këto ndahen në burim material dhe formal. Burim material është fuqia shoqërore që i përcakton normat, përkatësisht ajo është vullnet i klasës sunduese në secilin shtet. Ndërsa, burim formal është ajo trajtë, formë, në të cilën ky vullnet manifestohet (më gjerësisht do të vazhdohet me bashkëbiseduesit).

Ndër burimet formale të së drejtës konsiderohet edhe praktika gjyqësore. Interpretimin e ligjit që e bën gjyqtari duke kryer detyrën e vet, nuk është qëllim për vetveten, por bëhet për arsye të zbatimit të së drejtës, dhe pikërisht ky zbatim i së drejtës quhet praktikë gjyqësore.

Vendimi gjyqësor i formës së prerë sipas rregullit ka fuqi obliguese vetëm për palët dhe me arsye konsiderohet (ligj) për palët. (Bashkëbisedim rreth një vendimi të formës së prerë të gjykatës).

Praktikën gjyqësore të sajone Gjykata Supreme e cila drejtpërdrejtë ndikon në vendimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta. Në formë indirekte, në praktikën e gjykatave më të ulëta mund të ndikojnë qëndrimet nga mbledhjet sesionit gjyqësor si p.sh. Seksioni civil i Gjykatës Supreme. Botëkuptimet juridike të aprovuara në mbledhjet e seksionit gjyqësor janë të obligueshme për të gjitha seksionet e kolegjit përkatës, mandej qëndrimet nga Mbledhja e përgjithshme e zgjeruar e Gjykatës Supreme (rasti i ish RSFJ). Mirëpo, ata si gjyqtar të ardhshëm duhet ditur se vendimet e gjyqëve më të larta si dhe botëkuptimet e paraqitura në këto vendime nuk janë të obligueshme për gjykatat më të ulëta, gjykatat më të ulëta shpesh i konsiderojnë vendimet e gjykatave më të larta si orientim dhe i zbatojnë me vendim të njëjtë, sikurse të ishin të obligueshme dhe në këtë mënyrë botëkuptimet juridike të paraqitura në ato vendime, bëhen burim i së drejtës, të paktën për një kohë të caktuar.

Tek uzansat e përgjithshme kjo është edhe më e qartë sepse këto janë në esencë burim i së drejtës, pa marrë parasysh natyrën e tyre konstitucionale. (Më tutje këto çështje do të komentohen - bashkëbisedohet me pjesëmarrësit).

1.4 Objekti i së drejtës civile-sendet dhe të drejtat

Nocioni i sendit

Si është theksuar në pjesën hyrëse për të drejtën civile, se ende ka shumë çështje në të drejtën civile që janë kontestuese. Një përkufizim të objektit të së drejtës civile mund ta marrim se, objektet e të drejtës civile janë raportet e mallrave. E drejta civile e rregullon raportet e mallrave. Lidhur me këtë rezulton edhe rëndësia e objekteve të së drejtës civile.

Lidhur me nocionin e sendit ka interpretime të ndryshme. Mirëpo, në të shumtën e rasteve ky caktohet me ligj dhe ndër nocionet tjera mund të përkufizohet në kuptimin civil – juridik, send (res) është pjesa materiale e natyrës, që gjendet nën pushtetin e njeriut dhe mbi të cilin ekziston e drejta e pronësisë ose ndonjë e drejtë tjetër sendore ose sende me kuptimin juridik, mund të jenë jo vetëm trupat e ngurtë, por edhe lëngjet dhe gazrat, me kusht që ato të vihen nën sundimin e njeriut dhe të përdorën prej tij për dobi ekonomike. Apo nocioni tjetër se, send është pjesa materiale e natyrës që e plotëson kushtin fizik dhe kushtin shoqërorë. (Në vazhdim komentim me bashkëbisedim me pjesëmarrësit).

E drejta sendore (pronësia) si pjesë e së drejtës civile përfshinë tërësinë e normave juridike – civile, përkatësisht të normave juridiko-sendore me të cilat rregullohen marrëdhëniet juridike – civile, të subjekteve lidhur me sendet. Të drejtat sendore jo vetëm që paraqesin kategori të veçantë të të drejtave subjektive – civile, krahas me të drejtat detyrimore dhe trashëgimore, por ato kanë një rëndësi të veçantë në çdo sistemi juridik.

Të jesh pronarë mbi një send, do të thotë të kesh të drejtën absolute më të fortë, pushtetin faktik dhe juridik mbi sendet, qofshin ato të luajtshme apo të paluajtshme. Pra, pronari është titullarë me autorizime të veçanta, sepse ka të drejtën e përdorimit, shfrytëzimit dhe të disponimit mbi sendin e caktuar. (Komentim dhe bashkëbisedim i dispozitës së nenit 3 të LMTHJP).

Sendi duhet të jetë objekt i pronësisë apo i ndonjë të drejte tjetër sendore. Që nënkupton se sendi i tillë është i bartshim nga një titullarë në tjetrin. Andaj, akti i bartjes nga një titullarë në tjetrin, e

kushtëzon ndarjen e sendeve në ato në qarkullim dhe ato jashtë qarkullimit. Pra, kjo ndarje e sendeve është hasur edhe në të drejtën romake dhe ky dallim ekziston edhe në të drejtën sendore bashkëkohore. Aftësia e sendeve që të paraqiten si objekte të drejtave subjektive dhe si objekte të punëve juridike është aftësia qarkulluese e sendeve.

Sendet të cilat nuk mund të jenë në qarkullim juridik, konsiderohen si të mirat e përgjithshme dhe këto nuk mund të jenë objekt i ndonjë të drejte sendore, sepse janë në funksion të plotësisimit të nevojave të përbashkëta të të gjithë njerëzve (ajri, ajri i lirë me atmosferë, deti i hapur, lumenjtë, rrugët, hekurudhat etj).

Ndarja e sendeve:

Sendet e luajtshme dhe të pa luajtshme,
Sendet në qarkullim dhe jashtë qarkullimit,
Sendet në qarkullim të kufizuar
Sendet e konsumueshme dhe të pa konsumueshme,
Sendet e individualizuara dhe sendet e shquara sipas gjinisë /gjenerike/
Sendet e zëvendësueshme dhe sendet e pa zëvendësueshme,
Sendet e pjesëtueshme dhe të pa pjesëtueshme,
Sendet e thjeshta dhe sendet e përbëra,
Sendet kryesore dhe sendet aksesore,
Sendet tube/universitatis rerum/
Sendet trupore dhe jo trupore,
Frutat,
Sendi i përbërë sipas destinimit ekonomik,
Paraja dhe letrat me vlerë si send.

1.5 Ushtrime

Gjatë këtij sesioni trajnues do të bëhet ushtrim praktik lidhur me një vendim gjyqësor të formës së prerë, rreth faktit se për kënd ka fuqi obliguese ai vendim, si dhe ndonjë ushtrim të ndonjë qëndrimi nga praktika gjyqësore, duke kërkuar edhe nga pjesëmarrësit që të tregojnë ndonjë rast të ndonjë vendimi gjyqësor të formës së prerë nga jeta e tyre.

Po ashtu do të bëhet ushtrim praktik për ndonjë send në qarkullim dhe send jashtë qarkullimi, duke i ndarë pjesëmarrësit së paku tri grupe punuese, duke e diskutuar edhe bashkëbiseduar lidhur me atë send në qarkullim dhe për sendin jashtë qarkullimi, duke pasur rëndësi në ndarjen dhe dallimet në mes të këtyre sendeve, duke pranuar gjithashtu edhe propozimet e pjesëmarrësve lidhur me ndonjë shembull praktik që u intereson nga ky modul.

1.6 Përmbledhje

Në pjesën e parë të këtij sesioni janë theksuar burimet themelore të së drejtës civile, me theks të veçantë të praktikës gjyqësore si dhe zbatimit të sajë në praktikën gjyqësore. Sidomos është bashkëbiseduar për rolin aktiv dhe krijues të gjyqtarit në interpretimin e ligjit.

Ndërsa, lidhur me çështjen e ligjëruar do të shfrytëzohen vendimet e formës së prerë të gjykatave dhe qëndrimet juridike nga praktika gjyqësore.

Në pjesën e dytë të këtij sesioni janë theksuar vetëm temat – çështjet kryesore të objekteve të së drejtës civile, të nocionit të sendit dhe ndarjes së tyre, me theks të veçantë në sendet në qarkullim dhe sendet jashtë qarkullimit, duke mos lënë anash edhe ndarjen e sendeve të tjera sipas interesimit të pjesëmarrësve në kuadër të kohës së programuar.

Që në fillim të këtij moduli është dhënë literatura për konsultim si dhe ligjet në aplikim lidhur me çështjet e përfshira në këtë modul e të cilat do të interpretohen dhe komentohen së bashku me pjesëmarrësit si gjyqtarët e ardhshëm të kësaj lëmie juridike.

Nga secila temë e prezantuar, pjesëmarrësve si gjyqtarë dhe prokurorë të ardhshëm, do tu jepet mundësia që të shprehin një mendim apo qëndrim gjyqësor lidhur me zbatimin e ligjeve në aplikim për çështjet – temat e ligjëruara.

2. Krijimi dhe mbarimi i raporteve juridike ndarja e fakteve juridike- dhe modifikimi i punëve juridike-kushti dhe afati

2.1 Hyrje

Në pjesën e parë të këtij sesioni do të bashkëbisedohet për konceptin dhe rëndësinë e krijimit dhe mbarimit të raporteve juridike, njohjen me faktet juridike dhe dallimin e ndarjes së fakteve juridike, për rëndësinë dhe kuptimin e vullnetit si fakt juridik dhe raportet juridike që krijon ai në marrëdhëniet juridiko – civile, me theks të veçantë për llojet e deklaramit të vullnetit. Është karakteristikë se të gjitha deklaramet e vullnetit , kanë si pasojë, krijimin, ndërprerjen ose ndryshimin e një raporti juridik: të statusit (ndërrimi i emrit), real – juridik (dereliksioni), obligativ – juridik (opsioni, shkëputja, reklamacioni) dhe trashëguese – juridike (heqja dorë nga trashëgimia) Të gjitha këto deklaramet të vullnetit për këtë arsye janë fakte juridike, sepse me to krijohet, ndryshohet ose merr fund një numër i madh i raporteve juridike dhe ato përbëjnë atë grupin më të rëndësishëm të fakteve juridike të cilat i quajmë veprime juridike.

Në pjesën e dytë të këtij sesioni do të bashkëbisedohet për kuptimin dhe rëndësinë e modifikimit të punëve juridike si dhe rëndësinë e kushtit dhe afatit në modifikimin e punëve juridike. Kur puna e nulshme juridike ekziston me kusht, cilat janë afatet në të cilat mund të paraqitet kërkesa për rrëzueshmërinë e punës, ç'është konvalidacioni dhe disa shembuj të konvalidacionit nga e drejta e jonë pozitive, ç'është konversioni dhe shembuj të konversionit nga e drejta e jonë pozitive, ç'është restitucioni dhe mënyra e kthimit në gjendje të mëparshme, a mund të dëmtohen personat e tretë koshient nga nulshmëria e punës juridike dhe cila palë ka për detyrë të kompensoj dëmin e shkaktuar nga pavlefshmëria e punës juridike etj.

2.2 Objektivat trajnues

Pas përfundimit të këtij sesioni, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Thellojnë njohuri lidhur me rëndësinë e krijimit dhe mbarimit të raporteve juridike;
- Njohja me faktet juridike dhe ndarja e fakteve juridike si dhe rëndësia e ndarjes së tyre për raportet juridike;
- Bëjnë ndarjen e fakteve juridike si dhe i zbatimi në punën e tyre si gjyqtar të ardhshëm;
- Njohin rëndësinë e deklaramit të vullnetit si fakt juridik në raportet juridike – civile që krijon ail;
- Dallojnë llojet e deklaramit të vullnetit në bazë të së cilave krijohen punët e vlefshme juridike dhe punët jo të vlefshme juridike;
- Thellojnë njohuritë rreth punëve juridike të modifikuara dhe rëndësisë së veprimit të punës juridike në modifikimet lidhur me kushtin dhe afatin.
- Dallojnë kur puna e nulshme juridike ekziston me kusht .
- Zbatojnë afatet në të cilat mund të paraqitet kërkesa për rrëzueshmërinë e punës etj.

2.3 Krijimi dhe mbarimi i raporteve juridike

Nocioni i fakteve juridike

Marrëdhëniet juridike civile, lindin ndryshohen dhe shuhet në bazë të fakteve juridike. Andaj fakti juridik është rrethana që mund të ndikoj në krijimin, ndryshimin dhe shuarjen e marrëdhënies juridike civile respektivisht të drejtës subjektive civile për arsye se vetëm një normë juridike nuk është e aftë që të bëjë krijimin, ndryshimin apo shuarjen e të drejtës subjektive, por kërkohet fakti juridik apo tuba e fakteve juridike që të lind, të ndryshohet apo të shuhet një e drejtë subjektive, respektivisht një marrëdhënie juridiko civile.

Fakt juridik është rrethana që ka fuqi të pranuar nga ligji që të krijojë, ndryshojë, apo shuaj ndonjë të drejtë subjektive, respektivisht edhe të vet marrëdhënies juridiko civile. Marrëdhënia jetësore respektivisht shoqërore përbëhet prej disa rrethanave, fakteve që janë reciprokisht të lidhura. Rrethanat që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në krijimin e marrëdhënies juridike civile apo fitimin e të drejtës subjektive civile, konsiderohen fakte juridike.

Nga kjo rezulton se nuk janë, pra të gjitha ngjarjet fakte juridike, por vetëm ato për të cilat e drejta objektive lidhë ndonjë veprim juridik. Pra, në vazhdim do të shtjellojmë faktet të cilat shkaktojnë veprim juridik, përkatësisht krijojnë raporte juridike si dhe ndarjen e tyre tradicionale.

Tuba e fakteve juridike

Të gjitha faktet që duhet të mblidhen për krijimin ndryshimin ose shuarjen e ndonjë të drejte subjektive civile përbëjnë tubën e fakteve juridike. Kjo është kështu, nga se shumë shpesh nuk mjafton vetëm një fakt për krijimin, ndryshimin apo shuarjen e një të drejte subjektive respektivisht marrëdhënie juridiko civile. P.sh, për të lindur e drejt a subjektiv e pronësisë në bazë të trashëgimisë me testament, nevojitet ndodhja e vdekjes së trashëgimlënësit, që është një fakt juridik, një ngjarje natyrore, por njëkohësisht duhet të konstatohet edhe ekzistenca e testamentit që është punë juridike e njëanshme e trashëgimlënësit. Lidhur me trashëgiminë mund të numërojmë disa rrethana si fakte juridike, dhe atë, vdekja e trashëgimlënësit, pasuria e trashëgimlënësit, trashëgimtarët e gjallë në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit, aftësia e trashëgimtarëve për të trashëguar, dhe në fund duhet të ekzistojë edhe testamenti.

Ndarja e fakteve juridike

Faktet juridike ndahen në *-ngjarje ose fakte natyrore, dhe*
- veprimet e njerëzve.

Ngjarjet si fakte juridike mund të jenë të ndryshme, si lindja, vdekja, kalimi i kohës, fatkeqësitë elementare, sëmundja psikike, shkatërrimi i sendeve etj.

Veprimet e njerëzve si fakte juridike janë shumë më të rëndësishme.

Veprimet e njerëzve ndahen në: 1. në veprime të lejuara dhe
2.veprime të palejuara.

Veprimet e lejuara njerëzore i ndajmë në:

- 1.veprimet në pajtim me drejtësinë dhe*
- 2. veprimet e vullnetit.*

Të parat janë veprime njerëzore që nuk janë të ndaluara por nga drejtësia janë të lejuara, por nuk janë ndërmarrë me qëllim që të krijohet, ndërrohet apo suprimohet ndonjë e drejtë (të merren shembujt edhe nga pjesëmarrësit – bashkëbisedim). *P.sh. gjetja e sendit të huaj, ose përpunimi (me mirëbesim nuk kalon në delikt) dmth. përpunimi ose bashkimi i sendit të vet me të huajin pa dije se është i huaj, shkatërrimi i sendit të huaj mbi vlerën më të vogël se sendit të tij me vlerë më të madhe.*

Ndërsa, të dytat, veprimet e vullnetit janë ato që ndërmerren pikërisht me qëllim që të prodhohet ndonjë efekt objektiv juridik, i lejuar nga drejtësia. Veprimet e vullnetit janë në të vërtetë deklarim i vullnetit.

Veprimet e palejuara quhen edhe delikte, (e drejta penale i klasifikon si të ndaluara, të palejuara duke paraparë sanksione penale) dhe ato krijojnë obligim që të kompensohet dëmi i shkaktuar (komentim dhe bashkëbisedim të dispozitave ligjore të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, lidhur me kompensimin e dëmit).

Te gjitha faktet që duhet të mblidhen për krijimin, mbarimin ose ndërrimin e të drejtës përbëjnë tubin e fakteve. Si p.sh. në të drejtën e detyrimeve fakt më i rëndësishëm juridik është deklarimi i vullnetit (bashkëbisedim lidhur me deklarimin e vullnetit dhe pasojat në raportet e ardhshme juridike).

Të bashkëbisedohet për faktin plotësues juridik që është me rëndësi që një gjendje juridike të shndërrohet në të drejtë subjektive (komentim- bashkëbisedim).

Me rëndësi janë edhe supozimet/ prezumimet/ dhe fiksionet. Supozimi është fakt i tillë juridik, që konsiderohet e provuar derisa nuk vërtetohet e kundërta. Pra disa fakte supozohen, d.m.th në qoftë se ekzistojnë fakte përkatëse merren sikur ekzistojnë edhe disa të tjera, pra ato “merren” që të mos vërtetohen, argumentohen, pra nga faktet e ditura konkludohet ekzistimi i të panjohurës p.sh. mirëbesimi i poseduesit të posedimit supozohet, deri sa të mos argumentohet e kundërta. Ka raste kur nuk lejohet të vërtetohet e kundërta e supozimit, dhe në këtë rast bëhet fjalë për supozimin e pa rrëxueshëm. Për këtë thuhet se supozimi i pa rrëxueshëm do të thotë, sipas ligjit konsiderohet ndonjë rrethanë e provuar, ndërsa kundër të provuarit nuk lejohet., si bie fjala Ligji për familje i Kosovës, neni 99 par.1, ku thuhet” atë i fëmijës së lindur në martesë do të konsiderohet burri i nënës së fëmijës nëse fëmija është lindur gjatë martesës ose brenda afatit prej 300 ditësh pas mbarimit të martesës”. Ky supozim për fëmijën është gjithë gjithë jetën i rrëxueshëm, pra lejohet që fëmija ta vërtetojë edhe të kundërtën, këtë e parasheh LFK, neni 115 par 3, ku thuhet “ e drejta e padisë së fëmijës nuk parashkruhet”, kurse babai i fëmijës këtë të drejtë e ka vetëm brenda një kohe, LFK, neni 113 par. 2 “ padia për kundërshtimin e atësisë mund të paraqitet brenda afatit prej 6 muajësh nga dita e marrjes në dijeni të faktit që vë në dyshim atësinë e tij. Kërkesa nuk mund të dërgohet më vonë se afati prej 10 vitesh nga lindja e fëmijës.”

Fiksionet dallohen në ato se merret se ekziston një fakt juridik që në të vërtetë nuk ekziston. P.sh fëmija i pa lindur konsiderohet se është i lindur kur mbrohet interesi i tij trashëgimor, që ndryshe quhet nasciturus pro jam nato habetur, në këtë rast trashëgimia ndahet midis trashëgimtarëve të gjallë si dhe atij i cili është ende i pa lindur por konsiderohet se është i lindur. Fiksioni ekziston edhe te regjistrimi i tokave në librat e tokave ku merret se është pronar ai i cili është i regjistruar respektivisht në rastet kur nuk lejohet të vërtetohet e kundërta e faktit të regjistruar, parimi i njohur me emrin fiksioni i saktësisë absolute.

Vullneti si fakt juridik dhe raportet juridike që krijon ai – llojet e deklarimit të vullnetit

Llojet e deklarimit të vullnetit

Veprim juridik është ajo deklaratë e vullnetit të cilën palët e ndërmarrin me qëllim, për arsye të krijimit të ndonjë raporti juridik, është e vërtetë se vullneti është fakt më i rëndësishëm dhe më i shpeshtë juridik i cili prodhon numrin më të madh të raporteve civile-juridike.

Në qarkullimin juridik shihet se pjesa më e madhe e raporteve civile juridike krijohen pikërisht për arsye se këtë e dëshirojnë vetë pjesëmarrësit në raportin juridik. Por, vullnetin si fakt juridik nuk duhet nënkuptuar, sepse vullneti i deklaruar duhet të jetë serioz i drejtuar kah diçka në pikëpamje fizike dhe juridike është e mundshme, pra vullneti duhet të jetë i drejtuar kah ajo që është e zakonshme, për gjërat në shoqëri e sidomos në qarkullim ekonomik. Postulati i “mundësisë juridike” do të thotë se vullneti i deklaruar është i kufizuar me disa kujdes dhe qëllime që i paraqesin rendi juridik dhe botëkuptimet morale të shoqërisë.

Deklarimi i vullnetit, në të drejtën civile që të mund prodhojë veprim, që të ketë si pasojë ndonjë raport, që të ketë ndonjë raport juridik, duhet të jetë i lirë dhe i deklaruar qartë (bashkëbisedim lidhur me vullnetin e deklaruar) duke komentuar edhe dispozitat ligjore në aplikim.

***Deklarata mund të jepet verbalisht, gojarisht,
me shkrim,
me shenja ose
përgjithësisht me sjellje.***

Shenja ose sjellja me të cilën deklarohet vullneti quhet veprim konkludent,(bashkëbisedim lidhur me shembujt konkludent).

Sipas rregullit vullneti mund të deklarohet pa kurrfarë forme, vetëm në rastet e jashtëzakonshme kur kërkohet që vullneti të deklarohet në mënyrë të veçantë, në formë të veçantë.

Rëndësia e aktit administrativ qëndron në atë se, akti administrativ nuk është fakt juridik, por ai shpesh i prinë raportit civilo – juridik dhe për këtë arsye është supozim i këtyre raporteve, apo përcakton kufijtë e tyre. Dhe lidhur me këtë ai ndaj raportit civilo juridik mund të jetë i nevojshëm; raporti civilo juridik mund të jetë i nënshtruar aktit administrativ dhe mund të ekzistojë krahas aktin administrativ dhe pavarësisht nga raporti administrativ.

Deklarimet e vullnetit në të drejtën civile mund të jenë të ndryshme dhe mund të kenë veprime të ndryshme, si p.sh. Deklarata për hartimin e testamentit, kërkesa për ndërrimin e emrit, deklarimi i vullnetit në të cilin çdo kush heqë dorë nga pronësia dereliksioni ose siguron pronësinë në sendin e braktisur (okupimi) etj.

Është karakteristike se të gjitha deklarimet e vullnetit, kanë si pasojë krijimin, ndërprerjen ose ndryshimin e një raporti juridik: të statusit (ndërrimi i emrit), real – juridik (dereliksioni), obligativ – juridik (opsioni, shkëputja, reklamacioni) dhe trashëguese – juridike (heqja dorë nga trashëgimia). Të gjitha këto deklarime të vullnetit për këtë arsye janë fakte juridike, sepse me to krijohet, ndryshohet ose merr fund një numër i madh i raporteve juridike dhe ato përbëjnë atë grupin më të rëndësishëm të fakteve juridike të cilat i quajmë veprime juridike.

Këto janë deklarime të vullnetit me të cilat jo vetëm që krijohet ose ndryshohet ndonjë raport juridik, por me të cilat bartet ndonjë send apo ndonjë vlerë tjetër pasurore prej një pasurie në

tjetrën, këto janë deklarata kauzave të vullnetit. Me to pasqyrohet rëndësia e kauzës si efekt ekonomik që dëshirohet të arrihet në qarkullimin juridik.

Me to arrihen punë juridike të cilat, janë instrument i qarkullimit juridik, pra me to bëhet qarkullimi juridik. Deklarimet e këtilla të vullnetit quhen edhe punë juridike.

2.4 Modifikimi i punëve juridike-kushti dhe afati

Në pikëpamje të paraqitjes së veprimit të punës juridike mund të bëhet modifikimi lidhur me kushtin dhe afatin.

Paraprakisht, duhet ditur definicionin dhe ndarjen, në atë, se kushti është rrethanë e ardhshme e pasigurt nga paraqitja ose mos paraqitja e të cilës varet krijimi ose ndërprerja e ndonjë të drejte.

Kushti është pra, një fakt juridik i cili duhet ti bashkohet tubimit ekzistues të fakteve dhe deri sa të mos paraqitet kushti e drejta nuk ekziston, ekziston vetëm gjendja juridike. Për kuptimin e kushtit është esenciale se ai është rrethanë e ardhshme që nuk është paraqitur akoma dhe se është e pasigurt paraqitja e saj.

Në qoftë se rrethana tani më është paraqitur, por nuk u është e njohur bashkë kontraktuesve, nuk është fjala me të vërtetë për kushtin, por përgjithësisht për pasigurinë e ekzistimit të punës juridike. Kjo rrethanë mund të jetë e varur nga vullneti i një pale, e atëherë quhet potestativ, e mund të mos varet nga mos vullneti i palëve dhe atëherë kushti quhet kauzal, por gjithashtu mund të varet edhe nga rasti atëherë kushti është i përzier (shembujt lidhur me të tri kushtet do të komentohen, bashkë bisedohen me pjesëmarrësit).

Vlen të theksohet se vullneti i palës tjetër; si kusht potestativ ekziston vetëm atëherë kur ajo palë duhet të deklarohet në afatin e caktuar.

Kushti mund të jetë pozitiv dhe negativ, varësisht nga jo se a varet krijimi i të drejtave nga paraqitja apo mosparaqitja e rrethanave.

Kushti mund të jetë pastaj i shtyeshëm, (suspensiv) dhe i shkëputshëm (rezolutiv).

Kushti i shtyeshëm ekziston atëherë kur e drejta krijohet vetëm pas paraqitjes ose mos paraqitjes së rrethanave, kurse ai rezolutiv kur e drejta ndërpritet me paraqitjen e kushteve.

Në praktikë, kushti i shtyeshëm është më i shpeshtë se ai shkëputës, (disa shembujt do të bashkë bisedohen me pjesëmarrësit).

Kushtet jo morale dhe të pamundshme bëjnë tërë punën juridike të pavlefshme. Për kusht të pamundshëm shkëputës, konsiderohet se kushti as nuk është paraparë. Pamundësia nuk është vetëm fizike (p.sh. që të udhëtohet në hënë) por, edhe juridike (p.sh. njeriu i martuar të martohet përsëri).

Veprimi i paraqitjes së kushtit qëndron në atë se konsiderohet se e drejta krijohet definitivisht prej momentit të paraqitjes së kushtit.

Nganjëherë, konsiderohet se e drejta ekziston jo prej momentit të paraqitjes së kushtit, por prej momentit të mëparshëm, e nga njëherë prej momentit të lidhjes së punës juridike. (disa shembujt lidhur me këtë do të bashkë bisedohen me pjesëmarrësit).

Për punë fiktive ose të stimuluar juridike pala e cila nuk ka ditur e as sipas rrethanave ka mundur të dijë se është fjala për punë të nulshme juridike, për te ajo punë juridike vlen.

Ajo palë që ka shkaktuar pavlefshmërinë e punëve juridike duhet të ja kompensoj dëmin përveç restitucionit, palës tjetër të pafajshme. Pra, jo vetëm ai person që është fajtor për nulshmërinë e punës juridike që ka bërë dhunën, mashtrimin, shantazhin, kanosjen, por edhe personit që ka qenë në lajthim, madje edhe sikur të mos jetë fajtor për lajthimin e vet (sepse ai nuk është paraqitur për shkak të mos kujdesit të tij) duhet ti kompensoj palës tjetër dëmin që pëson ajo për shkak të shpalljes së punës juridike si të pavlefshme.

(Në vazhdim me pjesëmarrësit të bashkëbisedohet për kompensimin e dëmit real dhe fitimin e humbur).

2.5 Ushtrime

Gjatë këtij sesioni trajnues do të bëhet ushtrim praktik lidhur me kushtin si rrethanë e ardhshme për krijimin ose ndërprerjen e ndonjë të drejtë. Llojet e kushteve dhe secili nga pjesëmarrësit të thotë nga një shembull të llojeve të kushteve. (Të bashkëbisedohet për rastet kur rëndësia e kushtit i afrohet afatit etj).

Poashtu gjatë këtij sesioni do të bëhet ushtrim praktik lidhur me deklarimin e vullnetit të secilit pjesëmarrës për një çështje juridike. Komentimet dhe bashkëbisedimet do të bëhen bashkërisht për disa nga deklarimet e vullnetit të pjesëmarrësve.

2.6 Përmbledhje

Në këtë cikël janë bërë shqyrtime teorike dhe praktike për faktet juridike dhe rëndësinë e ndarjes së tyre me theks të veçantë në zbatimin e tyre nga ana e pjesëmarrësve, si gjykatës dhe prokurorë të ardhshëm. Po ashtu edhe për llojet e deklarimit të vullnetit në bazë të së cilave krijohen punët e vlershme juridike dhe punët jo të vlefshme juridike. Në këtë cikël janë bërë shqyrtime praktike edhe për kuptimin dhe rëndësinë e modifikimit të punëve juridike si dhe rëndësinë e kushtit dhe afatit në modifikimin e punëve juridike. Lidhur me këtë cikël do të interpretohen dhe komentohen dispozitat ligjore në aplikim nga kjo lëmi.

3. Posedimi, llojet, mbrojtja dhe shuarja e tij

3.1 Hyrje

Edhe për nocionin e posedimit, si institut juridik ka formulime të ndryshme. Duke filluar nga ai se, posedimi nuk konsiderohet e drejtë sendore por vetëm pushtet faktik, (ekonomik mbi sendin), se posedimi nuk është asgjë tjetër përveç se pushtet faktik ndaj sendit dhe ky përkufizim i posedimit është i përbashkët pothuajse në të gjitha legjislacionet, e deri te kuptimi tradicional romak, se për posedim nuk mjafton vetëm pushteti faktik mbi sendin, por duhet haptas të manifestohet edhe vullneti se sendin që është objekt i posedimit e mbanë (konsideron) si të vetin, e deri te kuptimi modern i posedimit që kërkon vetëm pushtetin faktik mbi sendin dhe në këtë rast nuk kërkohet të manifestohet dëshira që sendin ta mbanë si të vetin.

Rëndësia e posedimit për të drejtën civile në përgjithësi dhe për të drejtën sendore në veçanti është shumë e madhe me dallimin e posedimit nga pronësia që nuk është vetëm çështje e rëndësisë teorike (shkencës juridike) por edhe me rëndësi praktike.

3.2. Objektivat trajnues

Pas përfundimit të këtij sesioni, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Thellojnë njohurit rreth nocionit të posedimit;
- Dallojnë llojet e posedimit, po ashtu edhe posedimin nga pronësia që shpeshherë ngatërrohen njëra me tjetrën;
- Thellojnë njohurit për mbrojtjen e posedimit – paditë posesore dhe llojet e tyre;
- Njohin rëndësinë dhe pasojat e shuarjes së posedimit.

3.3 Posedimi dhe llojet e posedimit

- **Nocioni i posedimit**

Posedimi si institut juridik paraqet një gjendje faktike të mbrojtur nga e drejta pozitive. Me LPDTS të Kosovës, posedimi rregullohet me nenet 103-114. Posedimi nuk konsiderohet e drejtë sendore por vetëm pushtet faktik (ekonomik) mbi sendin. Posedimi nuk regjistrohet në librat publik edhe pse gëzon mbrojtje juridike, për shkak se posedimi nuk konsiderohet e drejtë sendore. Edhe mbajtësi i sendit të gjetur, të vjedhur, apo të blerë nga jo pronari edhe pse sillet si pronar i sendit, ai është vetëm një posedues i thjeshtë, ai ka vetëm pushtet faktik mbi sendin dhe jo pushtet juridik mbi të. Pushteti juridik mbi sendin i takon vetëm pronarit të vërtetë. E drejta ia njeh pronësinë vetëm pronarit e jo çdo mbajtësi të sendit. Posedimi është pushtet faktik mbi sendin pa marrë parasysh se ky pushtet ushtrohet në bazë të së drejtës subjektive, apo ushtrohet pa bazë juridike, pavarësisht nga ajo se poseduesi beson se është i autorizuar që ta ushtrojë atë pushtet faktik

Është me rëndësi të theksohet se posedimi nuk është e drejtë sendore, por megjithatë gëzon mbrojtje juridike dhe duke u nisur nga parimi i përgjithshëm juridik edhe në degë tjera të drejtësisë është se një gjendje ekzistuese faktike duhet të mbrohet, sepse askush nuk mund të cenoj pushtetin faktik në mënyrë arbitrare, por vetëm me ndihmën e organeve kompetente.

- **Rëndësia e posedimit**

Rëndësia e posedimit për të drejtën civile në përgjithësi dhe për të drejtën sendore në veçanti është shumë e madhe. Të dallosh posedimin nga pronësia nuk është vetëm çështje e rëndësisë teorike, por edhe me rëndësi praktike. Poseduesi i sendit supozohet se është pronar ose titullar i ndonjë të drejte tjetër sendore. Poseduesi i sendit ose i të drejtës edhe pse ka vetëm pushtetin faktik ai në një mënyrë gëzon edhe mbrojtje juridike. pastaj posedimi, ai me mirëbesim dhe i ligjshëm paraqet fakt juridik që ka ndikim në fitimin e të drejtës së pronësisë me parashkrim fitues, ose shuarjen e ndonjë të drejte tjetër respektivisht mund të shkaktojë shuarjen e ndonjë të drejte tjetër sendore të titullarëve të tjerë. Në këto raste shuhet mundësia e realizimit të ndonjë të drejte në mënyrë të dhunshme nga ish pronari . Në disa legjislacione konsiderohet se shuhet vet e drejta e pronësisë. Poseduesi që nuk është pronar përgjigjet në bazë të përgjegjësisë objektive për dëmin e shkaktuar duke ushtruar pushtetin faktik faktik mbi sendin.

- **Objekti i posedimit**

Objekt i posedimit mund të jenë sendet e luajshme dhe të pa luajshme, si dhe të drejtat e caktuar. Sendet në përdorim të përgjithshëm nuk mund të jenë objekt i posedimit. P.sh. rrugët parqet publike etj. Posedimi i të drejtës mund të jetë posedimi i të drejtës së servitutit, e drejta në barrën reale, e drejta e obligacionit, që është rrezultat i ndonjë pune juridike etj. Komento nenin 259 të LPDTS.

- **Fitimi i posedimit**

Posedimi fitohet me punë juridike, siç e rregullon neni 104 LPDTS, ku parashihet që posedimi në një send fitohet me krijimin e pushtetit faktik mbi sendin. Marrëveshja e poseduesit të mëparshëm dhe e fituesit të posedimit është e mjaftueshme për fitimin e posedimit nëse fituesi është në gjendje që të ushtrorë pushtetin mbi sendin në momentin e marrëveshjes. Nëse një person e ushtron pushtetin faktik mbi një send për ndonjë person tjetër ose për biznesin e ndonjë personi tjetër apo në ndonjë raport të ngjashëm, në kuadër të cilave personi duhet ti përgjigjet udhëzimeve të tjetrit rreth sendit, atëherë ai nuk është posedues /detentori i posedimit neni 105 LPDTS/. Posedimi fitohet edhe me trashëgimi/neni 106 i LPDTS/. Posedimi është fituar kur poseduesi krijon pushtetin faktik mbi sendin, qoftë duke e themeluar me veprimin e një anshëm, pa vullnetin e poseduesit apo kundër vullnetit të poseduesit të gjerë tanishëm (fitimi origjiner), me marrjen e sendit, me fillimin e shfrytëzimit të sendit të pa luajshëm etj, ose i bartur për mes ndonjë pune juridike (fitimi derivativ), me vullnetin e poseduesit.

- **Bashkëposedimi dhe posedimi i përbashkët**

Bashkëposedimi parashihet në nenin 108 të LPDTS, ku parashihet që nëse disa persona e kanë bashkëposedimin në një send . e drejta e një personi për përdorimin e sendit në raport me të tjerët dhe mbrojtja individuale e poseduesit për posedimin e tij është e kufizuar me të drejtën e personave të tjerë për përdorimin e sendit . Ajo qka mund të thuhet për bashkëpronësi dhe pronësi të përbashkët, analogjikisht mund të thuhet edhe për bashkëposedimin dhe posedimin e përbashkët.

- **Llojet e posedimit**

Posedimi, ndahet në disa lloje, dhe atë varësishtnga mënyra e krijimit, mënyra e ushtrimit dhe pasojave juridike që dalin nga posedimi.

Llojet e posedimit janë:

1. Posedimi i drejtpërdrejtë dhe posedimi i tërthortë/indirekt/ neni 109 i LPDTS/
2. Posedimi i ligjshëm dhe posedimi jo i ligjshëm
3. Posedimi i vërtetë dhe posedimi jo i vërtetë,
4. Posedimi me mirëbesim dhe posedimi me keqbesim, dhe
5. posedimi pronësor/ neni 110 i LPDTS/.

Mandej kemi posedim të kualifikuar, dhe posedim tabular.

Janë me rëndësi të dihen edhe efektet juridike të posedimit me mirëbesim dhe keq besim, dhe efektet juridike të posedimit lidhur me frutat, shpenzimet të cilat i bën poseduesi lidhur me sendin, shpenzimet e nevojshme (të domosdoshme).

3.4 Mbrojtja e posedimit dhe shuarja e tij

- **Mbrojtja e posedimit**

Vetëndihma- vjen në shprehje vetëm për mbrojtjen e pushtetit faktik dhe atë vetëm nën kushtet e parapara me ligj. Vetëndihma është e sanksionuar me nenin 112 të LPDTS, për më tutje shpjegimit, referoju kësaj dispozite ligjore.

Për mbrojtjen e posedimit ekzistojnë dy padi, padia për pengimin e posedimit dhe padia e kthimin e posedimit. Me padi për pengim posedimi kërkohet, ndërprerja e pengimit dhe kthimi i posedimit.

Gjykata siguron mbrojtjen sipas gjendjes së fundit të posedimit dhe pengimit të bërë, me ç'rast nuk ka ndikim e drejta për posedimin, baza juridike e posedimit dhe mirë besueshmëria e mbajtësit / neni 480 LPK/ Përfundohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike , ndërgjegjshmërinë ose pandërgjegjshmërinë e posedimit. Përfundohet mundësia që në kontestet për pengim posedimi të paraqitet kërkesa për shpërbllimin e dëmit të shkaktuar me anë të veprimeve me të cilat është bërë pengimi në posedim.

Padia poseduese qoftë për pengim, qoftë për kthim duhet të paraqitet në afatin prej 30 ditësh, nga dita e njoftimit për pengimin dhe kryesin, e më së largu brenda afatit prej 1 viti nga dita e pengimit të bërë (kontesti për shkak të pengimit të posedimit)/ neni 114 i LPDTS/

Mbrohet çdo posedim, qoftë ai i tërthortë, ose i drejtpërdrejtë, me mirëbesim ose keqbesim, i ligjshëm apo jo i ligjshëm. Mbrojtja gjyqësore nga trazimi, respektivisht marrja e posedimit është përcaktuar me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPDTS.

- **Shuarja e posedimit**

Më lartë, përkufizuar nocionin se posedimi është pushtet faktik mbi sendin. Ndërsa **me humbjen e pushtetit faktik** mbi sendin humbë edhe posedimi. Zhveshja nga pushteti faktik duhet të jetë kundër vullnetit të poseduesit. Nëse poseduesi e kalon pushtetin faktik tek një person tjetër, ky edhe më tutje konsiderohet posedues.

Posedimi shuhet **me shkatërrimin e sendit** që është objekt i posedimit, pastaj **me bartjen e sendit në personin tjetër, si dhe më shitje, me dhuratë etj.**

Humbjet e posedimit kemi edhe atëherë kur sendi i kthehet poseduesit respektivisht pronarit në bazë të padisë për kthimin e sendit në posedim/ actio reivindicatio/ ose në bazë të padisë për mbrojtjen e pronësisë padisë publiciane , kur këto padi përfundojnë me sukses.

3.5 Ushtrime

Gjatë këtij sesioni do të bëhet ushtrim praktik me ndarjen e grupeve të pjesëmarrësve që secili prej tyre të hartoj një padi për pengim posedimi duke nxjerr një aktvendim të shkurt me arsyetim, duke marr si shembull një prej tyre për bashkëbisedim.

3.6 Përmbledhje

Në këtë sesion janë theksuar nocioni dhe llojet e posedimit. Rëndësia e mbrojtjes së posedimit si dhe kuptimi i pasojave të shuarjes së posedimit. Lidhur me këtë sesion do të interpretohen dhe komentohen dispozitat ligjore në aplikim nga kjo lëmi.

4. Të drejtat absolute dhe relative, përfaqësimi me prokurë (autorizimi)

4.1 Hyrje

Rëndësia dhe kuptimi i ndarjes të drejtave në absolute dhe relative, me theks të veçantë të drejtat relative (obligative, përkatësisht detyimore sipas Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve dhe në vazhdim të këtij teksti do të theksohet detyrimore).

Në këtë modul do të ligjërohet – bashkëbisedohet për rëndësinë e ndarjes të drejtave në absolute dhe relative me theks të veçantë, në të drejtat relative (detyrimore)

Duke bërë ndarjen e të drejtave në absolute dhe relative, do të bashkëbisedohet cilat janë të drejtat absolute, ndërsa të drejtat relative (detyrimore) për personat në raportin e detyrimit, përmbajtja dhe lënda e detyrimeve, llojet e detyrimeve, burimet e detyrimeve etj.

Rëndësia dhe kuptimi i përfaqësimit ligjor dhe kontraktues, me theks të veçantë të përfaqësimit me prokurë(autorizim), sipas LPK-së.

Në këtë modul do të ligjërohet – bashkëbisedohet për rëndësinë e përfaqësimit ligjor dhe kontraktues, e posaçërisht përfaqësimit me prokurë (autorizim).

4.2 Objektivat trajnues

Pas përfundimit të këtij prezantimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Zgjerojnë njohurit lidhur me ndarjen e të drejtave civile në ato absolute dhe relative, duke kuptuar rëndësinë e tyre në raportin civilo- juridik.
- Zbatojnë drejtë ndarjen e të drejtave absolute dhe relative, konform dispozitave ligjore në aplikim.
- Thellojnë njohuritë për kuptimin, rëndësinë dhe efektet e përfaqësimit ligjor dhe kontraktues, e sidomos të përfaqësimit me prokurë, i cili çdo ditë haset në praktikën e gjykatave

4.3 Të drejtat absolute dhe relative

Para se të bëhet ndarja e të drejtave civile duhet ditur se, subjekti në raportin civil-juridik që disponon me të drejtën quhet titullar ose bartës i të drejtave, apo person i autorizuar, ndërsa subjekti në anën e të cilit është detyrimi quhet person i detyruar. Siç vërehet nga titulli i këtij prezantimi, të drejtat subjektive civile që u takojnë subjekteve të së drejtës ndahen, para së gjithash, në absolute dhe relative. Ndarje tjetër e të drejtave subjektive civile kemi në të bartshme dhe të pa bartshme. Pastaj të drejtat subjektive civile ndahen edhe në të drejta subjektive kryesore dhe të drejta subjektive aksesore.

- **Të drejtat absolute**

Të drejtat absolute janë ato të drejta subjektive civile të karakterit absolut, janë të drejta subjektive të rregulluara kryesisht me norma imperative të cilat përcaktojnë nocionin dhe përmbajtjen e këtyre të drejtave. Të drejtat absolute për shkak të rëndësisë që kanë në rendin

juridik të shtetit ato përcaktohen me ligj dhe i nënshtrohen parimit të numërimit taksativ. Të drejtat absolute janë të drejta më të forta në krahasim me të drejtat relative, sepse përmbajtjen e tyre nuk mund ta ndryshojnë palët me deklarinimin e vullnetit të tyre.

-ato të drejta të cilat, të drejtës së personit të autorizuar i përgjigjet detyrimi i të gjithë personave të tjerë, pra vepron ndaj të gjithëve (erga-omnes),

-numri i këtyre personave të detyruar nuk është i caktuar,

-detyrimi i tyre është negativ, të mos pengohet në ushtrimin e autorizimeve të tij të cilat bëjnë përmbajtjen e të drejtave të tij.

-ky raport i titullarit ndaj të gjithë personave tjerë nuk është konkretizuar, pra më parë nuk është caktuar në mënyrë të veçantë, detyrimi i përgjigjet të drejtave subjektive, e jo autorizimit nga e drejta subjektive, detyrimi nuk përbëhet nga dhënia, efekti pasuror, ekonomik.

Të drejtat absolute nuk parashkruhen (edhe pse ka mendime të kundërta).

Te të drejtat absolute ekziston e ashtu quajtura “e drejtë e racionit” p.sh. (sendi i vjedhur), autorizimet e titullarit, pronarit që të kërkoj kthimin e sendit prej çdo kujt te i cili gjendet ai send.

Nga kjo arsye të drejtat absolute prodhojnë të ashtuquajturat padi reale, që nënkupton mundësinë e parashtrimit të padisë (në kuptimin material) ndaj çdo kujt, ndaj personit më parë të caktuar që e shkelë këtë të drejtë.

Të drejtat absolute janë :

- të drejtat / sendore/ reale dhe,
- të drejtat personale.

Të drejta reale/sendore/ të numëruara taksativisht në LPDTS janë: e drejta e pronësisë, e drejta e servitutit, e drejta e pengut, barrët sendore dhe e drejta e ndërtimit.

Të drejtat reale janë ato të drejta absolute të cilat si objekt të vetin të drejtë për drejtë kanë sendet. Kryesore është e drejta reale e pronësisë.

Të drejtat personale

Të drejtat personale janë ato të drejta që janë të lidhura ngushtë për personin dhe si të drejta personale konsiderohen 1) të drejtat e personalitetit, dhe 2) e drejta e autorit (të drejtat nga pronësia intelektuale) ku objekt i së cilës është produkti që paraqet krijimtari në fushën e letërsisë, artit dhe të shkencës. Të drejtat e personalitetit janë të drejta që konsiderohen jo pasurore por të cilat në instancë të fundit mund të marrin karakterin pasuror.

Të drejtat e personalitetit

Këto të drejta janë të lidhura ngusht për subjektin e caktuar, dhe si të tilla janë të karakterit absolut. Këto të drejta u takojnë si personave fizik ashtu edhe personave juridikë. Si të drejta të personalitetit numërohen:

- e drejta e integritetit fizik,
- e drejta e integritetit moral,
- e drejta e respektimit të jetës private,
- e drejta e respektimit të nderit,

- e drejta e emrit, etj.

Të drejtat e personalitetit edhe pse janë të drejta jo pasurore ato në rast se cenohen mund të kërkohej shpërblim në para, që është një shpërblim i dëmit jo material. Të drejtat e personalitetit gëzojnë mbrojtje juridike sepse ato janë si të drejta themelore të njeriut dhe në disa raste gëzojnë mbrojtje si në nivelin nacional ashtu edhe në nivelin ndërkombëtar.

Të drejtat e autorit

E drejta e autorit është një e drejtë e karakterit absolut e titullarit mbi një krijimtari intelektuale në fushën e letërsisë, artit dhe shkencës. E drejta e autorit është e drejtë personale sepse është e lidhur për personin e caktuar, dhe autor mund të jetë vetëm personi fizikë. Në Kosovë kjo e drejtë është e rregulluar me Ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, në të cilin parashihet se çka më konkretisht rregullon ky ligj në lidhje me këto të drejta, mandej, përmbajtjen e kësaj të drejte, çka konsiderohet vepër e autorit, dhe mbrojtja e saj. Po ashtu në këtë ligj janë paraparë edhe të drejtat pasurore të autorit, të drejtat morale të tij, natyra juridike e të drejtës së autorit, dhe kohëzgjatja e të drejtës së autorit.

Edhe pak fjalë për pronësinë industriale, e cila buron nga krijimtaria intelektuale e autorit. Në Kosovë lidhur me pronësinë industriale janë nxjerrë ligje të veçanta që mbrojnë objektin e pronësisë industriale: Ligji nr. 04/L-029 për patenta, GZ zyrtare nr.12 datë 29 gusht 2011, Ligji nr.04/L-026 për markat tregtare GZ.nr.10 datë 24 gusht 2011, Ligji nr.04/028 për dizajnin industrial GZ.nr.9, datë 22 gusht 2011.

- **Të drejtat relative**

Të drejtat relative janë të drejta që gëzojnë mbrojtje juridike por jo në dimensionin e të drejtave absolute për shkak se këto të drejta me mos ushtrim ose me kalimin e kohës mund të parashkruhen . Këto të drejta gëzojnë mbrojtje juridike me kërkesë të subjekteve të tyre, e cila duhet të bëhet në gjykatën kompetente kur ajo nuk realizohet vullnetarisht brenda afatit të caktuar. Të gjitha të drejtat që dalin nga marrëdhëniet detyimore janë të karakterit relativ.

Është me rëndësi të dihet se sistemi i të drejtave relative apo e drejta detyimore, si degë e së drejtës civile, përbënë degën më të gjerë dhe më së shumti të përpunuar të së drejtës civile, pasurore.

Nga ky shkak, kjo edhe quhet e drejtë e detyrimeve. Për arsye se çdo të drejtë relative i përgjigjet një detyrim, përkatësisht detyrimi i palës tjetër. Në të drejtat e detyrimeve gjithmonë ekzistojnë dy palë, pala e autorizuar e cila quhet kreditor dhe pala e obliguar e cila quhet debitor.

Detyrimi i debitorit shikuar nga ana e kreditorit quhet kërkesë, pra, detyrimi dhe borxhi janë kuptime korelative, ajo që për debitorin është detyrim, për kreditorin është borxh. Ky detyrim është konkretisht i caktuar dhe është gjithmonë pasurorë.

Lidhur me këtë, është me rëndësi që të ligjërohet, bashkëbisedohet për subjektet e marrëdhënies detyimore, lëndën e detyrimeve: dhënie/dare/, bërje/facere/, mosbërje /nonfacere/,durim/pati/, burimet e detyrimeve: kontrata, shkaktimi i dëmit, pasurimi pa bazë juridike, kryerja e punëve të huaja pa porosi, si dhe për premtimin publik të shpërblimit etj.

Të drejtat e detyrimeve krijojnë kërkesën, e madje edhe padinë “në kuptimin material” vetëm ndaj personit qysh më parë të caktuar – borxhliut. Pra thënë shkurt të drejtat relative veprojnë vetëm inter partes, në mes palëve të caktuara.

4.4 Përfaqësimi - përfaqësimi me prokurë (prokurë)

Paraprakisht, duhet ditur kuptimin se, përfaqësimi është kryerje e veprimit juridik në emër të tjetërkujt dhe për llogari të tjetër kujt dhe për të dy këto kuptime do të bashkëbisedohet me pjesëmarrësit, secili me nga një shembull.

Personi që kryen veprimin juridik quhet përfaqësues, ndërsa personi në emër dhe për llogarinë të së cilit kryen veprimin, quhet i përfaqësuar.

Është me rëndësi që te përfaqësimi të bëhet përkufizimi i materies, sepse përfaqësim nuk mund të ketë në secilin raport civil – juridik, por vetëm te veprimet juridike; kur deklarohet vullneti me qëllim të krijimit, ndryshimit ose suprimimit të ndonjë raporti juridik, p.sh. te lidhja e punës juridike (shkëputja e kontratës, dorëzimi i sendit në pronësi etj).

Por çdo veprim nuk mund të kryhet nëpërmes përfaqësuesit p.sh. testamenti nuk mund të bëhet nëpërmes përfaqësuesit. Nuk mund të gjendet sendi ose të bëhet delikti, veprimi i palejuar nëpërmjet përfaqësuesit. Komentim të disa shembujve me pjesëmarrësit.

Ndërmjetësi gjithashtu nuk është përfaqësues.

Në praktikë ka raste të shpeshta, e që në tregti këto raste janë legalizuar, përfaqësimi indirekt – komisioni, kur dikush paraqitet në kryerjen e veprimit juridik në emër të vet, por për llogari të tjetrit.

Ka dy lloje të përfaqësimit. Ai ligjor dhe kontraktues.

Kontraktimi ligjor ekziston për personat që janë të paaftë për punë apo për shkak të mungesës janë të penguar të ndërmarrin vet veprime juridike. Prindi është përfaqësues ligjor i fëmijëve të mitur etj.

Përfaqësimi kontraktues është ai që në bazë të kontratës paraqitet midis përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit.

Te përfaqësimi me prokurë(autorizimi) përfaqësuesit që të mund të përfaqësojë të përfaqësuarin, i nevojitet autorizimi.

Te përfaqësimi ligjor autorizimin e jep vet ligji, kurse te ai kontraktues i përfaqësuar.

Te autorizimi në kuptimin e gjerë duhet pasur parasysh tri gjëra të ndryshme; fuqinë juridike të përfaqësuarit që të bartë mbi përfaqësuesin mundësinë që në emër të tij dhe për llogaritë të tij të lidhë punë juridike, rrethin e punëve që përfaqësuesi mund t'i kryejë në emër dhe për llogari të përfaqësuarit dhe deklaratën e një anshme, fuqinë juridike të të përfaqësuarit me të cilën u drejtohet personave të tretë dhe informon për rrethin e punëve që përfaqësuesi mund t'i kryej për te.

Autorizimi mund të jepet verbalist dhe me shkrim. Me shkrim, kur ligji e parasheh në mënyrë ekskluzive. P.sh. autorizimi mbi përfaqësimin e palës para gjyqit.

Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm (gjeneral) dhe i veçantë(special).

Rëndësia e tejkalimit të autorizimit, kush mund të jetë përfaqësues. Autorizimi ndërpritet për shkak të kalimit të afatit për të cilin ka qenë i dhënë, dhe për shkak të revokimit.

Natyra juridike e përfaqësimit është ajo se përfaqësimi është fikcion në të cilin konsiderohet se përfaqësuesi transmeton vullnetin e të përfaqësuarit kontraktues. Ka edhe fiksione tjera, do të bashkëbisedohet me pjesëmarrësit.

4.5 Ushtrime

Gjatë këtij sesioni do të bëhet ushtrim praktik lidhur me dy palët e detyrimeve, disa në rolin e palës së autorizuar, kreditorit apo huadhënësit dhe disa në rolin e palës së detyruar, debitorit apo huamarrësit. Gjithashtu gjatë këtij sesioni do të bëhet ushtrim në ndarjen e pjesëmarrësve në grupe më të vogla, duke luajtur rolin e përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit.

4.6 Përmbledhje

Në këtë modul janë theksuar rëndësia dhe kuptimi i ndarjes të drejtave në absolute dhe relative me theks të veçantë të drejtat relative (detyrimore).

Lidhur me këtë modul do të interpretohen dhe komentohen dispozitat ligjore në aplikim nga kjo lëmi me theks të veçantë ato nga Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Në këtë modul janë theksuar rëndësia dhe kuptimi i përfaqësimit, me theks të veçantë, përfaqësimi me prokurë (autorizim).

Lidhur me këtë modul do të interpretohen dhe komentohen dispozitat ligjore në aplikim nga kjo lëmi nga nenit 85 deri 95 të LPK-së, (komentim me pjesëmarrësit - bashkëbisedim).

5. Punët juridike të njëanshme /negotia unilateralia/, punët juridike të dyanshme/ negotia bilateralia/, dhe punët juridike të pa vlefshme-nule

5.1 Hyrje

Në këtë sesion do të ligjërohet – bashkëbisedohet për rëndësinë e punëve juridike të njëanshme dhe të dyanshme, e posaçërisht, cilat janë punët juridike të njëanshme dhe të dyanshme si dhe për punët juridike të pavlefshme, e posaçërisht punët e nulshme juridike, shkaqet për pa vlefshmërinë absolute dhe shkaqet për pa vlefshmërinë relative , si dhe pasojat juridike të pa vlefshmërisë absolute dhe relative të punëve juridike.

5.2. Objektivat trajnues

Pas përfundimit të këtij prezantimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Thellojnë njohurit për kuptimin, rëndësinë dhe efektet e punëve juridike të njëanshme dhe të dyanshme, të cilat çdo ditë do t'i hasen në praktikën e gjykatave;
- Thellojnë njohuritë për kuptimin, rëndësinë dhe efektet e punëve juridike me pavlefshmëri absolute dhe punëve juridike me pa vlefshmëri relative si dhe lidhur me shkaqet për pa vlefshmërinë e punëve juridike, të cilat çdo ditë hasen në praktikën e gjykatave.

5.3 Punët juridike të njëanshme dhe të dyanshme

Me deklarin e lirë të vullnetit, personat fizikë apo juridikë, lidhin punët juridike që paraqesin mjetin juridik për qarkullimin e të drejtave subjektive civile , nga një subjekt në subjektin tjetër. Me punët juridike nuk mund të barten vetëm të drejtat e personalitetit sepse ato janë të lidhura ngushtë për personin, subjektin e atyre të drejtave. Pra puna juridike në fakt paraqet deklaratën e vullnetit të lirë të personit fizik apo juridik i cili ka zotësinë juridike të plotë ose të pjesërishme për të vepruar, që mundëson krijimin ndryshimin apo shuarjen apo bartjen e të drejtës subjektive civile.

Autonomia e vullnetit është bazë për krijimin e punëve juridike nga e cila lindin apo shuhen të drejta subjektive civile./ neni 2 par.1 dhe 2 LMD./ komento këtë dispozitë ligjore.

Punët juridike janë kontratat, testamenti, letrat me vlerë, premtimi publik i shpërblimit, etj. Objekti i punës juridike duhet të jetë pa të meta fizike dhe juridike.

Deklarimi i vullnetit që të krijoj të drejta apo detyrime duhet të shprehet, të bëhet botërisht i njohur për palën apo për palët. Në LMD të Kosovës, neni 30 par 1, përcakton se heshtja e të ofertuarit nuk do të thotë pranim i kontratës. Mirëpo një përjashtim del nga vet përmbajtja e këtij rregulli ligjor në par.3 të këtij neni ku thuhet se megjithatë kur i ofertuari ndodhet në lidhje të vazhdueshme afariste me ofertuesin, lidhur me mallin e caktuar , konsiderohet se e ka pranuar ofertën që ka të bëjë me mallin e tillë , në qoftëse nuk e ka refuzuar menjëherë ose brenda afatit që i është lënë. Pra deklarimi i vullnetit mund të bëhet verbalisht, me shkrim apo edhe në mënyrë konkludente, me shenja, gjeste, luajtja e kokës se e pranon kontratatën etj.

Paraprakisht, duhet ditur për ndarjen e punëve juridike: në punët juridike formale dhe jo formale, punët juridike midis të gjallëve/inter vivos/ dhe në rast të vdekjes/ mortis causa/, punët

juridike kauzale dhe abstrakte, punët juridike komutative dhe aleatore, punët juridike fiduciare, punët juridike të simuluar, punët juridike fiktive, punët juridike barrësore dhe bamirëse, dhe ndarjen kryesore të këtyre punëve, në punët juridike të njëanshme dhe të dyanshme, duke u përqendruar në këto të fundit, ku do të bashkëbisedohet me pjesëmarrësit, secili me nga një shembull.

- **Punët juridike të njëanshme**

Punët juridike të njëanshme janë ato punë juridike të cilat mjafton deklarimi i vetëm një vullneti që të krijohet raporti juridik, pra për këto punë juridike është esenciale që detyrimi të krijohet me deklaratën e një anshme të një personi, më saktësisht të një pale në raportin e detyrimit.

Punët juridike të dy anshme janë ato punë juridike në të cilat nevojitet deklarata e dy apo më shumë vullneteve, si dhe pëlqimi i tyre, që të mund të krijohet raporti i detyrimit. Punët e dy anshme juridike quhen edhe kontrata.

Kontratat janë rregull në të drejtën civile dhe ato përbëjnë pjesën më të madhe të marrëdhënieve civile - juridike, përkatësisht janë mjet më i rëndësishëm i qarkullimit civil – juridik.

Punët e një anshme juridike janë testamenti, premtimi publik i shpërblimit dhe dhënia e letrave me vlerë. Në literaturën juridike shkencore, si punë të një anshme juridike konsiderohen edhe heqja dorë nga trashëgimia, heqja dorë nga e drejta e parablerjes, revokimi i prokurës, dhe kryerja e punëve të huaja pa porosi.

Testamenti është punë juridike e një anshme sepse lind me deklarin e vullnetit vetëm të testatorit në bazë të cilit vullnet bëhet kalimi i pasurisë së trashëgimlënësit te trashëgimtarët të përfshirë në testament. Ky kalim i pasurisë së lënë trashëgimi me testament bëhet vetëm pas vdekjes së trashëgimlënësit. Testamenti paraqet deklarin e vullnetit të fundit të trashëgimlënësit lidhur me disponimin e pasurisë së tij në rast vdekjeje dhe për këtë arsye testamenti është edhe punë juridike formale, punë juridike personale, sepse testamenti mund të bëhet vetëm me deklarin e drejtpërdrejtë të vullnetit të testatorit , pa përfaqësim, dhe është punë juridike mortis causa/ neni 69 par.1 Ligji për trashëgiminë./

Premtimi publik i shpërblimit / neni 212 i LMD/ ekziston atëherë kur ndokush i premtton një vlerë të caktuar pasurore, më së shpeshti para, atij që realizon kushte të dhëna me premtim, tani është aktuale tenderimi, ku në të parashihen kushtet për pjesëmarrësit, si për të drejtat po ashtu edhe për detyrimet. Konsiderohet si punë e një anshme juridike sepse krijohet dhe prodhon efekte juridike me deklarin e vullnetit vetëm të njëjës palë të marrëdhënies juridike. psh, kush e gjen sendin e humbur do të ketë shpërblimin e caktuar etj. Premtimi publik i shpërblimit më detalisht mësohet në të drejtën e detyrimeve.

Letrat me vlerë / neni 217 i LMD/ janë dokumente me shkrim me të cilat emetuesi (lëshuesi i tyre) detyrohet se do ta përmbush detyrimin e shkruar në këto dokumente ndaj poseduesit të tyre të ligjshëm. Letrat me vlerë janë shkresa që nga një anë janë send në qarkullim dhe barten me punë juridike, ashtu si edhe sendet tjera, e nga ana tjetër përmbajnë në vete disa të drejta (reale ose të detyrimit) të cilat mund t'i realizojë vetëm pronari ose mbajtësi i tyre, p.sh. pronari i lotarisë, kambiali (bashkëbisedim me pjesëmarrësit lidhur me kambialin).

- ***Punët juridike të dyanshme***

Punët juridike të dy anshme janë ato punë juridike të cilat krijohen me deklarinimin e vullnetit të së paku dy palëve në anë të ndryshme, psh.kontratave. LMD nuk e përkufizon se çka nënkuptojmë me punët juridike të dy anshme, mirëpo, në nenin 15 të LMD parashihet” kontrata është e lidhur kur palët kontraktuese janë marrë vesh për elementet thelbësore të kontratës”. Nga kjo dispozitë në mënyrë të tërthortë edhe del përkufizimi i këtyre punëve juridike. Pra, kontratat lindin vetëm me pajtimin e vullnetit të palëve dhe janë objekt i të drejtës detyruese, por nuk përjashtohet mundësia që kontratat të ekzistojnë edhe në lamitë tjera juridike si në të drejtën familjare, trashëgimore, , në të drejtën e punës etj. Në të drejtën familjare, neni 53 i LFK,” bashkëshortët në çdo kohë mund të pjesëtojnë pasurinë e tyre të përbashkët me marrëveshje”. Në të drejtën e punës, neni 1.pika 11 “ kontrata e punës është akt individual e cila lidhet midis punëdhënësit dhe të punësuarit, me të cilën rregullohen të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga marrëdhënia e punës në pajtim me këtë ligj, kontratën kolektive dhe me aktin e brendshëm të punëdhënësit”. Në të drejtën trashëgimore, neni 141 i LT,”2 çdo trashëgimtar para ndarjes mund të cedojë pjesën e vet trashëgimore në tërësi ose pjesërisht vetëm tek bashkëtrashëgimtarë. Ky ceditim duhet të bëhet vetëm me anë të kontratës e cila duhet të vërtetohet në gjykatë”

Kontratave, si është theksuar më lartë, janë mjeti më i rëndësishëm i qarkullimit civil – juridik. Prandaj, të njëjtat, duhet të shqyrtohen në detale duke filluar nga:

- lidhja e kontratave,
- pjesët e kontratës,
- ndarja e kontratave,
- liria e kontraktimit,
- detyrimi kontraktues,
- forcimi dhe sigurimi i kontratës,
- kontrata në favor të personave të tretë,
- pasojat e mos plotësimit të kontratës,
- veprimi i kontratës midis palëve,
- plotësimi (zbatimi i kontratës)
- ndërtrimet e subjektit në kontratë,
- ndërprerja e detyrimit,
- parashkrimi
- si dhe kontratat e ndryshme.

Me pjesëmarrësit do të bashkëbisedohet dhe komentohen dispozitat ligjore të Ligjit mbi Marrëdhëniet e detyrimeve për secilin kontratë që u intereson atyre.

Te ndarja e kontratave do të ligjërojmë, bashkëbisedojmë për kontratat komutative dhe aleatore.

Komutative janë ato kontrata të cilat kauzat reciproke, efektet (qëllimet) reciproke ekonomike, janë caktuar qysh më parë. Ndërkaq, aleatore janë ato kontrata të cilat këto efekte nuk janë caktuar qysh më parë, por varen prej një rrethane të ardhshme dhe ndryshe quhen kontrata me fat ose kontrata krenare, psh. kontrata mbi lojën me fat, lotaria, kontratat mbi sigurimin, kontratat mbi bastin etj.

Kontratave komutative janë rregull,ndërsa ato aleatore janë përjashtim dhe janë shpesh të ndaluara si p.sh. kontrata mbi lojën hazarde (bixhozi)

- **Punët juridike të pa vlefshme - nule**

Punët juridike krijohen nga ana e subjekteve të së drejtës me qëllim që të prodhojnë efekte juridike të parapara , të lejuara me ligj.

Puna juridike prodhon efekte juridike vetëm në rastet kur ajo është në pajtim me rendin juridik, respektivisht kur puna juridike përmban të gjitha elementet që kërkohen nga e drejta pozitive që puna juridike të jetë e vlefshme.

Mirëpo, mund të ndodh të konsiderohet e pa vlefshme për shkak se nuk është në pajtim me të drejtën pozitive respektivisht te puna juridike ekzistojnë shkeljet e tilla të ndaluara nga ligji dhe kjo shkakton pavlefshmërinë e punës juridike. Punët juridike për kah intensiteti i pa vlefshmërisë mund të jenë , **punë juridike absolutisht të pa vlefshme, që ndryshe quhen edhe punët juridike nule**, dhe ***punët juridike relativisht të pa vlefshme që ndryshe quhen punë juridike të rrëzueshme.***

- **Punët juridike absolutisht të pa vlefshme**

Nëse me punën juridike të krijuar nga subjektet e së drejtës cenohet interesi i shtetit ajo punë gjithmonë konsiderohet absolutisht e pa vlefshme. Punët juridike absolutisht të pa vlefshme konsiderohen se as që janë lidhë kur ato të shpallen si të pa vlefshme. Pa vlefshmëria e punës juridike në fakt është sanksion ndaj punës së tillë juridike dhe për pa vlefshmërinë absolute gjykata kujdeset ex officio. Padi për vërtetimin e pa vlefshmërisë absolute mund të paraqet çdo person i interesuar, e jo vetëm personi që ka interes juridik, këtu përfshihet edhe prokurori dhe gjykata në mënyrë ex officio. Gjyqtari dhe personat tjerë në çdo kohë kur të konstatojë ekzistimin e punës juridike nule kanë të drejtë që të kërkojnë shpalljen e asaj pune juridike të pa vlefshme.

- **Shkaqet për pa vlefshmërinë absolute të punëve juridike**

Në nenin 89 par.1 të LMD parashihet “ Kontrata që është në kundërshtim me rendin publik, dispozitat urdhëruese, ose moralin e shoqërisë, është nule, në qoftëse qëllimi i rregullës së cenuar nuk udhëzon në ndonjë sanksion tjetër apo në qoftë se ligji në rastin e caktuar nuk parashikon diçka tjetër”.

Kjo dmth se çdo herë kur puna juridike është në kundërshtim me rendin juridik që do të thotë me parimet kushtetuese, të Republikës së Kosovës, puna juridike do të jetë gjithnjë absolutisht nule, respektivisht e pa vlefshme. Është e pa vlefshme edhe atëherë kur ajo punë juridike është në kundërshtim me një normë imperative të cilën palët nuk mund ta ndryshojnë me vullnetin e tyre, por vetëm si të tillë duhet ta respektojnë dhe zbatojnë në raportet e tyre civile juridike . psh. Në të drejtën penale, familjare, trashëgimore, detyrimore , të drejtën e punës etj. Puna juridike absolutisht e pa vlefshme gjithmonë mbetet e pa vlefshme, dhe pa vlefshmëria lind nga momenti i lidhjes së punës juridike, pra veprimi i pa vlefshmërisë është ex tunc.

Shkaqet që drejtpërsëdrejti shkaktojnë pa vlefshmërinë absolute të punëve juridike, edhe në Kosovë janë:

- 1) pa aftësia për të vepruar e palëve,
- 2) lënda/objekti/ e punës juridike e cila është e ndaluar, e pamundshme, e pa caktuar ose e pa përcaktueshme,
- 3) baza (kauza) e ndaluar, dhe
- 4) punët juridike të simuluar.

1) *Paafhtësia për të vepruar e palëve.*

Personat që nuk kanë fare zotësi veprimi janë personat deri në moshën 14 vjeç si dhe personat të cilëve u është hequr zotësia për të vepruar, të cilët janë të barazuar me personat me moshë deri në 14 vjet. Punët juridike të tyre janë absolutisht të pa vlefshme, nga se ligji këta persona i përjashton nga mundësia e lidhjes së punëve juridike.

Personat fizik që kanë mbushur moshën 14-18 vjeçare, ose u është hequr zotësia e plotë për të vepruar dhe janë barazuar me personat e moshës 14-18 vjeçare, kanë zotësinë e kufizuar për të vepruar, kanë të drejtë të lidhin vetëm ato punë juridike të cilat mund të jenë të vlefshme. Psh. Personat që kanë krijuar marrëdhënie pune të cilën të drejtë e fitojnë nga mosha 15 vjeçare, mund të krijojnë punë juridike të cilat janë të vlefshme pa pëlqimin e prindit apo të organit të kujdestarisë. Mandej, neni 70 par.1 i LT, 2 testament mund të bëjë çdo person i cili ka zotësi për të vepruar dhe i cili ka mbushur moshën 18 vjeçare.” Respektivisht, në moshën 16 vjeçare ka zotësinë e veprimit, të fituar me vendim gjykatë, është martuar me leje të gjykatës, kjo parashihet në paragrafin 2 të nenit 70 të LT “ Testament mund të bëjë edhe personi që ka zotësi për të vepruar e i ka mbushur 16 vjet dhe është i martuar”. Ndërsa me LMD të R.Kosovës, neni 41 par.1 parasheh” për lidhjen e kontratës së vlefshme nevojitet që kontraktuesi të ketë zotësinë për të vepruar që kërkohet për lidhjen e kësaj kontrate. Paragrafi 2 parasheh” personi me zotësi të kufizuar për të vepruar mundet pa lejen e përfaqësuesit të vet ligjor të lidh vetëm ato kontrata, lidhja e të cilave i lejohet me ligj2, dhe paragrafi 3 parasheh” kontratat tjera të këtyre personave janë të rrëzueshme nëse janë lidhur pa lejen e përfaqësuesit ligjor, por mund të fuqizohen me aprovimin e më vonshëm të të njëjtave”.

2) Lënda / objekti / i punës juridike

Neni 35 i LMD të Kosovës parasheh” kur objekti i detyrimit është i pa mundur, i pa lejueshëm, i pa caktuar, ose i cili nuk mund të caktohet, kontrata është absolutisht e pa vlefshme” Ndërsa neni 34 i LMD parasheh2 se detyrimi kontraktues mund të bëhet nga dhënia, veprimi ose mosveprimi ose durimi, dhe par.2, parasheh se detyrimi duhet të jetë i mundshëm, i lejueshëm, i caktuar përkatësisht i caktueshëm.

Në kuptim të nenit 37 të LMD objekti i detyrimit është i pa lejueshëm nëse është në kundërshtim me dispozitat e rendit publik, dispozitat tjera urdhëruese dhe moralin e shoqërisë. Në këto raste puna juridike është absolutisht e pa vlefshme. Këto janë punët juridike të ndaluara, punët juridike imorale, dhe punët juridike të fajdexhillëkut.

Psh, neni 444 par2 LMD “ nule është kontrata në mes avokatit ose urdhërmarrësi tjetër do ta blejë të drejtën kontestuese realizimi i së cilës i është besuar atij, ose do ta kontraktonte për vete pjesëmarrjen në ndarjen e shumës së caktuar me vendim gjyqësor urdhër dhënësit të tij.

Kontratat me fajde po ashtu janë nule, neni 123 par.1 LMD.

Objekti është i pa caktuar ose i pa caktueshëm. Në nenin 38 par.1 të LMD, parashihet “ Objekti i detyrimit është i caktueshëm nëse kontrata përmban të dhënat me ndihmën e të cilave mund të caktohet objekti, apo nëse palët ia kanë lënë personit të tretë që të caktojë objektin”, ndërsa paragrafi 2 parasheh “ nëse ky person i tretë nuk dëshiron apo nuk mund të caktojë objektin e detyrimit, kontrata është absolutisht e pa vlefshme”. Pra LMD kërkon që lënda të jetë e caktuar ose e caktueshme në të kundërtën puna juridike konsiderohet e pa vlefshme absolutisht, mirëpo, LMD, në nenin 445 paragrafi 2 parasheh përjashtimin kur nuk e shpall punën juridike të pa vlefshme kur detyrimi kontraktues është në para. Komento këtë dispozitë!

3) *Baza e pa lejueshme*

Në literaturën juridike baza definohet si qëllim juridik të cilëin e pretendojnë palët dhe i cili është i njëjti të lloji i njëjtë i kontratave psh të kontrata e shitblerjes, ku qëllimi i punës juridike është fitimi i pronësisë mbi sendin e marrë. Neni 39.par 4 i LMD shprehimisht parasheh” në rast se nuk ka bazë ose baza është e pa lejueshme, kontrata është nulë dhe absolutisht e pa vlefshme”. Pra edhe për bazën kërkohet që ajo të e lejueshme, në pajtim me dispozitat e rendit publik, dispozitat tjera urdhëruese, dhe moralin e shoqërisë./ neni 39 par2 i LMD, në të kundërtën baza do të ishte e pa lejueshme.

4) *Punët juridike të simuluar*

Këto punë janë ato të cilat palët i prezantojnë krejt ndryshe nga puna juridike e cila është e vërtetë. Edhe këto punë juridike janë absolutisht të pavlefshme. Puna e simuluar është ajo punë të cilën palët e lidhin edhe pse nuk e dëshirojnë si të tillë por këtë e bëjnë me qëllim që të fshehin punën tjetër juridike veprimin e se cilës e dëshirojnë që të realizohet. Në këtë rast kemi dy punë juridike, njëra e vërtetë dhe tjetra e simuluar. Në momentin kur ajo e simuluar shpallet absolutisht e pa vlefshme, ajo e vërtetë vjen në shprehje dhe ajo është e vlefshme. Psh. Palët kontraktuese me qëllim të fshehjes së tatimit, prezantojnë kontratën e dhurimit, e në fakt në mes tyre për të njëjtin objekt është e lidhur kontrata e shitblerjes. Kur kontrata e dhurimit shpallet absolutisht e pa vlefshme, kontrata e shitblerjes mbetet e vlefshme, nga se ajo është e vërtetë.

Motivi i pa lejueshëm si shkak për pa lejueshmërinë e punëve juridike, vlen vetëm te kontratat me shpërblim, që dmth se te kontratat pa shpërblim motivi nuk ka kurrfarë ndikimi. Përndryshe në nenin 40.paragrafi 2 të LMD përcakton “megjithatë, nëse motivi i pa lejueshëm ka ndikuar esencialisht që një nga kontraktuesit të vendos lidhjen e kkontratës dhe në qoftëse këtë gjë kontraktuesi tjetër e ka ditur ose është dashur ta dinte, kontrata do të jetë pa efekt”.

Mosrespektimi i formës si shkak për pa vlefshmërinë e punëve juridike, në raste të veçanta mund të shkaktojë pa vlefshmërinë absolute të punës juridike, psh. Testamenti konsiderohet punë juridike rigorozisht formale, dhe mos respektimi i formës së testamentit shkakton pa vlefshmërinë absolute të testamentit. / neni 85.1 LT komento ! / mandej, neni 55 par.1 i LMD, mos lidhja e kontratës në formën e parashikuar me ligj, komento !, neni 36 par.2 i LPDTS kontrata për bartjen e pa luajtshmërisë , duhet të lidhet me shkrim dhe në prezencë të dy palëve në një zyrë kompetente, komento ! /

Pavlefshmëria absolute e pjesërishme e punëve juridike, komento nenin 91 par.1 të LMD. Nuliteti i ndonjë dispozite të kontratës nuk mund të ketë si pasojë nulitetin edhe të vet kontratës , në qoftë se ajo mund të qëndrojë pa dispozitën nule, dhe në qoftë se ajo nuk ka qenë kusht apo motiv vendimtar për lidhjen e saj. Dhe paragrafi 2, megjithatë , kontrata do të jetë e vlefshme edhe atëherë kur dispozita nuk ka qenë kusht ose motiv vendimtar i kontratës në rastin kur nuliteti është konstatuar pikërisht që kontrata të lirohej prej kësaj dispozite dhe të vlejë pa të.

Pasojat juridike të punëve absolutisht të pa vlefshme. Punët juridike absolutisht të pa vlefshme kur të vërtetohet pavlefshmëria e tyre , nuk prodhojnë efekte juridike nga momenti i lidhjes së tyre. Konstatimi i punës juridike absolutisht të pa vlefshme , si pasojë mund të ketë detyrimin e kthimit të asaj që është marrë nga ana e palëve kontraktuese, pastaj marrjen e dhënieve të palëve kontraktuese në favor të organit shtetëror dhe përgjegjësia për dëmin e shkaktuar palës tjetër kontraktuese nga puna juridike absolutisht e pa vlefshme.

LMD i Kosovës shprehimisht rregullon pasojat e nulitetit të kontratës , respektivisht të punës juridike. Në nenin 90 paragrafi 1, parashihet “Në rastin e nulitetit të kontratës secila palë kontraktuese ka për detyrë t’ia kthej palës atë që ka marrë në bazë të kontratës së tillë, e në rast se kjo është e pamundshme apo nëse kthimi parandalohet nga natyra e asaj që është plotësuar, duhet të bëhet kompensimi përkatës në të holla sipas çmimeve në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligj.” Ndërsa në paragrafin 2 parashihet” Në rast se kontrata është nul për shkak se sipas përmbajtjes ose qëllimit të vet është në kundërshtim me parimet themelore morale, gjykata mund të refuzojë tërësisht ose pjesërisht kërkesën e palës së pandërgjegjshme për kthimin e asaj që i ka dhënë palës tjetër; në marrjen e vendimit, gjykata do të ketë parasysh shkallën e veprimtimit në mirëbesim të njëjës ose të dy palëve dhe rëndësinë e interesave që cenohen. “

Në qoftë se dhëniet e bëra midis palëve në bazë të kontratës absolutisht të pa vlefshme është e pamundur të kthehen atëherë do të bëhet shpërblimi përkatës në të holla. Ndërsa në rastet kur kontrata absolutisht e pa vlefshme vjen ndesh me parimet themelore morale, gjykata mund ta refuzojë tërësisht ose pjesërisht kërkesën e palës së pa ndërgjegjshme për kthimin e asaj që ka dhënë palës tjetër.

Pasojë tjetër e pavlefshmërisë absolute të punës juridike është përgjegjësia për dëmin e shkaktuar për shkak të lidhjes së punës juridike absolutisht të pa vlefshme. Pala e ndërgjegjshme nëse pëson dëm nga pa vlefshmëria e kësaj pune juridike ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit. LMD i Kosovës , përgjegjësinë e personit fajtor për nulitetin e kontratës e rregullon me nenin 94, ku thuhet “ kontraktuesi që është fajtor për lidhjen e kontratës nule i përgjigjet bashkë kontraktuesit të tij për dëmin që pëson për shkak të nulitetit të kontratës, në qoftë se ky nuk ishte në dijeni apo sipas rrethanave nuk do duhej të ishte në dijeni për ekzistimin e shkakut të nulitetit” për përgjegjësinë për shpërblimin e dëmit do zbatohen dispozitat e LMD për shkaktimin e dëmit. Restitucioni bëhet për arsye se është pa bazë juridike, nga se puna juridike është shpallur absolutisht e pa vlefshme.

Kërkimi i nulitetit. Neni 95 i LMD parasheh” Për nulitetin gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe në atë mund të thirret çdo person i interesuar”. Pra nuk lidhet me atë se personi i interesuar ka apo nuk ka interes juridik, sepse punët juridike absolutisht të pa vlefshme *ex lege* konsiderohen punë juridike nule. Edhe prokurori mund ta paraqes këtë padi për anulim. Në nenin 96 të LMD parashihet “E drejta e paraqitjes së kërkesës të nulitetit nuk shuhet” Kjo nënkupton se nuk ekziston parashkrimi i kërkesës për shpalljen e punëve juridike absolutisht të pa vlefshme.

- **Punët juridike relativisht të pavlefshme / të rrëzueshme/**

Nëse me punën juridike cenohet interesi i palëve kontraktuese e jo interesi i shtetit atëherë puna juridike konsiderohet punë juridike relativisht e pa vlefshme apo punë juridike e rrëzueshme. Ato punë juridike përmbajnë të meta në deklarinimin e vullnetit.

Punët juridike të vlejshme gjersa pala e interesuar ose organi tjetër i autorizuar të mos paraqet arsyen për pavlefshmërinë e tyre, andaj ato kanë efekte deri në momentin e anulimit të tyre. Mirëpo, nëse anulohet puna juridike relativisht e pa vlefshme atëherë ajo punë juridike konsiderohet si e pa vlefshme jo nga momenti i anulimit por nga momenti i lidhjes së asaj pune juridike.. Pala mund ta bëjë këtë vetëm brenda afatit të caktuar. Kur paraqitet arsyeja për pavlefshmërinë e punës juridike, edhe për punët juridike të rrëzueshme sipas rregullit,

konsiderohet sikur nuk janë lidhur. Ka komentime të ndryshme rreth punëve juridike të nulshme dhe të rrëzueshme, të cilat do të komentohen me pjesëmarrësit.

Anulimi i punëve juridike të rrëzueshme ka fuqi prapa vepruese, dmth me anulimin e kontratës kthehen dhëniet që kanë qenë objekt i kontratës. Mirëpo këto punë mund të bëhen të vlefshme me kalimin e kohës së paraparë për anulimin e tyre ose me pranimin e mëvonshëm nga pala e dëmtuar nga puna juridike relativisht e pa vlefshme. LMD i R.Kosovës, përmban dispozita nga neni 97-102, me të cilat rregullon kontratat e rrëzueshme . Sipas nenit 98 të LMD, anulimin e punës relativisht të rrëzueshme mund ta kërkoj vetëm personi të cilit me këtë punë juridike i është cenuar interesi juridik. Në këtë dispozitë parashihet “ pala kontraktuese në interesin e së cilës vërtetuar rrëzueshmëria, mund të kërkoj që kontrata të shpallet e pa vlefshme”.

Sipas nenit 97 të LMD, kontrata është e rrëzueshme kur e ka lidh pala me aftësi të kufizuar të veprimit, kur gjatë lidhjes së saj ka pasur të meta në pikëpamje të vullnetit të palëve, si dhe kur kjo gjë është caktuar me këtë ligj apo me ndonjë dispozitë të veçantë.

Në nenin 102 të LMD parashihet që e drejta e personit të interesuar që të kërkojë rrëzimin e punës juridike relativisht të pa vlefshme parashkruhet brenda afatit subjektiv prej një viti nga dita kur merret në dijeni shkaku i rrëzueshmërisë së punës juridike, por më së voni në afatin prej tre viteve nga dita e lidhjes së kontratës. Ky afat është prekluziv.

Shkaqet për pavlefshmërinë relative (të rrëzueshme) të punëve juridike. Këto shkaqe janë numruar taksativisht në nenin 97 të LMD, ku parashihet që kontrata është e rrëzueshme kur e ka lidh pala me aftësi të kufizuar të veprimit, kur gjatë lidhjes së saj ka pasur të meta në pikëpamje të vullnetit të palëve, si dhe kur kjo gjë është caktuar me këtë ligj apo me ndonjë dispozitë të veçantë.

1. Aftësia e kufizuar për të vepruar e palëve. Këtë aftësi e kanë personat e moshës 14-18 vjeçare, dhe personat të cilëve u është hequr zotësia e plotë e veprimit por iu është lënë zotësia e kufizuar e veprimit me vendim të gjykatës. Nëse këta persona lidhin punë juridike pa pëlqimin e prindërve apo të organit të kujdestarisë , këto punë juridike të tyre do të konsiderohen punë juridike të rrëzueshme. Çështja e këtij pëlqimi është e rregulluar edhe me nenin 19 par.1 të LMD ku parashihet “ Kur për lidhjen e ndonjë kontrate nevojitet aprovimi i personit të tretë, ky pëlqim mund të jepet para lidhjes së kontratës, si leje, apo pas lidhjes së kontratës, si aprovim, po qe se me ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”, dhe leja respektivisht aprovimi duhet të bëhet në të njëjtën formë që kërkohet për kontratën e cila lidhet me pëlqimin e përfaqësuesit ligjor. Këta persona kanë të drejtë të lidhin disa punë juridike për të cilat nuk kërkohet pëlqimi prej përfaqësuesit ligjor respektivisht nga organi i kujdestarisë, dhe ato punë konsiderohen si plotësisht të vlefshme. Psh. kontratën për disponimin me pasurinë që vet e kanë fituar nga marrëdhënia e punës, mandej të lidhin kontratë mbi dhurimin për pjesën që vet e kanë fituar nga marrëdhënia e punës por jo edhe të asaj pjese të fituar me trashëgimi. Ai mund të lidh kontratë mbi shitblerjen për sendet që vet i ka fituar. Neni 7 i Ligjit të Punës në Kosovë, parasheh “ marrëdhënia e punës mund të themelohet edhe me personat në mes të moshës 15-18 vjeç të cilët mund të punësohen për punë të lehta që nuk paraqesin rrezik për shëndetin e tyre ose për zhvillimin e tyre dhe nëse ajo punë nuk është e ndaluar me ndonjë ligj ose me ndonjë akt nënligjor.” Për lidhjen e kësaj kontrate nuk kërkohet pëlqimi i përfaqësuesit të tij ligjor nga se ky person e ka zotësinë e kufizuar të veprimit. Ndërsa punët tjera të lidhura pa këtë pëlqim konsiderohen si të rrëzueshme. Këta persona nuk mund të bëjnë testament, kontrata të dy anshme detyruese pa pëlqim, nuk mund të bëjnë premtimin publik të shpërblimit, nëse dhënia e shpërblimit nuk është nga pasuria e fituar nga puna e tij.Këto punë juridike mund të konvalidohen jo vetëm me pëlqimin ose aprovimin e lartë theksuar por edhe nëse në afatin prej 3 muajësh nga dita e fitimit të zotësisë së plotë të veprimit nuk paraqet padi për anulimin e tyre / neni 44 i LMD “.

2. Deklarimi i vullnetit me të meta. LMD në nenin 18 par.2 parasheh” shprehja e vullnetit duhet të bëhet lirisht dhe seriozisht” Pra deklarimi i vullnetit nën ndikimin e kanosjes, lajthimit ose mashtrimit. LMD i Kosovës nuk e përmend dhunën, mirëpo ajo nënkuptohet, nga se përdorimi i dhunës për lidhjen e punës juridike mund të kualifikohet edhe se veprim juridik që është në kundërshtim me rendin publik të paraparë në nenin 89 të LMD. Mirëpo këto punë të lidhura me këto të meta mund të mbesin të plotfuqishme nëse ai më vonë këto i pranon ose nuk i kundërshton brenda afatit ligjor.

- **Kanosja.** Kanosja është të shkaktuarit e dhimbjes psiçike te pala tjetër, frikës se do ti shkaktohet një e keqe atij ose anëtarëve të familjes së tij nëse nuk pranon lidhjen e kontratës respektivisht hartimin e testamentit, ose ndonjë pune tjetër juridike.

Në nenin 45 të LMD parashihet” Në qoftë se pala kontraktuese ose ndonjë i tretë me kanosje të palejueshme ka shkaktuar frikësim të bazuar te pala tjetër, kështu që kjo për këtë arsye e ka lidhur kontratën, pala tjetër mund të kërkojë që kontrata të anulohet. Frika konsiderohet e bazuar në qoftë se nga rrethanat shihet se nga rreziku serioz është cenuar jeta trupi ose ndonjë e mirë tjetër e rëndësishme e palës kontraktuese ose e personit të tretë. Edhe kjo punë mund të konvalidohet nëse i kanosuri brenda afatit ligjor nuk paraqet padi për anulimin e saj.

-**Lajthimi.** Lajthimi gjithashtu mund të ndikojë në deklarimin e vullnetit me të meta për shkak se pala deklaron diçka që përndryshe nuk do ta kishte deklaruar po të mos ishte në lajthim. Lajthimi është bindje e gabuar për ndonjë element thelbësor juridik të punës juridike e cila ka pasur ndikim te pala kontraktuese që ai të deklaron vullnetin i cili konsiderohet se nuk është i lirë. LMD me nenin 46-48 rregullon lajthimin.

Neni 46 Lajthimi thelbësor

1. Lajthimi është thelbësor, në qoftë se ka të bëjë me elementet thelbësore të objektit, me personin me të cilin lidhet kontrata, në qoftë se lidhet duke marrë parasysh këtë person, si dhe me rrethanat të cilat sipas dokeve që praktikohen ose sipas qëllimit të palëve, konsiderohen vendimtare, ndërsa pala që është në lajthim nuk do ta lidhte përndryshe kontratën me përmbajtje të tillë.

2. Pala e cila është në lajthim mund të kërkojë të shpallet e pavlefshme kontrata për shkak të lajthimit thelbësor, përveç nëse gjatë lidhjes së kontratës nuk ka vepruar me kujdesin që kërkohet në qarkullim.

3. Nëse kontrata shpallet e pavlefshme për shkak të lajthimit, pala tjetër me mirëbesim ka të drejtë të kërkojë shpërblim për dëmin e pësuar.

4. Pala e cila është në lajthim nuk mund t'i referohet lajthimit, në qoftë se pala tjetër është e gatshme ta përmbushë kontratën sikur lajthimi të mos kishte ekzistuar fare.

Neni 47 Lajthimi për motivin te kontrata pa shpërblim Te kontrata pa shpërblim lajthim thelbësor konsiderohet edhe lajthimi për motivin që ka qenë vendimtar për marrjen përsipër të detyrimit.

Neni 48 Deklarata e tërthortë. Lajthimi i personit me anë të cilit pala ka shprehur vullnetin e saj konsiderohet se është njësoj si dhe lajthimi në shfaqjen e vullnetit vetjak.

-**Mashtrimi.** Mashtrimi është të shkaktuarit e lajthimit me vetëdije te pala tjetër me qëllim që të lidhet puna juridike. Pra personi i cili e përdor mashtrimin, e vë në lajthim ose krijon parafytyrim të gabuara me qëllim që të lidh punën juridike. Mashtrimi mund të bëhet si nga personi i cili lidh punën juridike ashtu edhe nga personi i tretë i cili i shkakton lajthim palës tjetër me qëllim të lidhjes së punës juridike. Mashtrimi paraqet një arsye më të fortë për rrezimin e punës juridike se sa lajthimi, nga se mashtrimin e bën pala tjetër, ndërsa lajthimi shkaktohet nga vet pala e cila thirret në lajthim. Kemi mashtrim aktiv dhe pasiv. Aktiv është kur pala e bind

palën tjetër për cilësinë e sendit në mënyrë shprehimore, kurse është pasiv kur me heshtje lejon që personi të bie në lajthim.

Neni 49 Mashtrimi

1. Në qoftë se njëra palë shkakton lajthim te pala tjetër, ose mban në lajthim me qëllim që me këtë ta shtyj për lidhjen e kontratës, pala tjetër mund të kërkojë të shpallet e pavlefshme kontrata edhe atëherë kur lajthimi nuk është thelbësor.
2. Pala që ka lidhur kontratë duke qenë e mashtruar, ka të drejtë që të kërkojë shpërblim për dëmin e pësuar.
3. Në qoftë se mashtrimin e ka bërë personi i tretë, mashtrimi ndikon në vetë kontratën në qoftë se pala tjetër kontraktuese në kohën e lidhjes së kontratës ishte në dijeni ose është dashur të dinte për mashtrimin.
4. Kontrata pa shpërblim mund të shpallet e pavlefshme edhe kur mashtrimin e ka bërë personi i tretë, pavarësisht nëse pala tjetër kontraktuese në kohën e lidhjes së kontratës e ka ditur ose është dashur të dinte për mashtrimin.

- Dëmtimi përtej mase / laesio enormis

Në të drejtën pozitive, rrëzueshmëri të punës juridike të dyanshme detyruese kemi edhe në rastet kur shkaktohet dëmtimi mbi gjysmën respektivisht dëmtimi i pa masë nga puna juridike. Në këtë rast për shkak të mos respektimit të parimit të ekuivalencës së vlerave që këmbehen midis palëve kontraktuese apo palëve të punës juridike, e njëjta punë juridike është e rrëzueshme. Lidhur me dëmtimin për tej mase LMD i Kosovës parasheh në nenin 122 par.1 se,

1. Në qoftë se midis detyrimeve të palëve kontraktuese në kontratën e dyanshme detyruese ekziston në kohën e lidhjes së kontratës disproporcion i hapur pala e dëmtuar mund të kërkojë edhe anulimin e kontratës, në qoftë se për vlerën e saktë atëherë nuk ka ditur dhe as që është dashur të dinte.
2. E drejta për të kërkuar anulimin e kontratës pushon me skadimin e një (1) viti nga lidhja e kontratës.
3. Heqja dorë që me parë nga kjo e drejtë nuk ka efekt juridik.
4. Kontrata do të mbetet në fuqi në qoftë se pala tjetër ofron plotësimin e dhënies deri në vlerën e plotë.
5. Për shkak të këtij disproporcioni nuk mund të kërkojë anulimi i kontratës aleatore të shitjes në ankandin publik, si dhe atëherë kur për sendin është dhënë çmimi i lartë për shkak të afinitetit të posaçëm. Komento këto dispozita!

• Anulimi i punëve juridike relativisht të pavlefshme

Anulimin e punëve juridike të rrëzueshme mund ta kërkojë vetëm pala kontraktuese në interesin e së cilës është vërtetuar rrëzueshmëria, nga shkaqet të cilat shkaktojnë pavlefshmërinë relative të punës juridike.

Te punët juridike relativisht të pavlefshme, cenohet interesi i palës kontraktuese e jo interesi i përgjithshëm, andaj të drejtën e kërkesës për anulimin e këtyre punëve juridike e ka vetëm personi i dëmtuar, si palë në këtë punë juridike e jo organi shtetëror, respektivisht gjykata nuk mund të kujdeset ex officio për punët juridike relativisht të rrëzueshme.

Neni 44 i LMD parasheh “Kur kontraktuesi e fiton zotësinë për të vepruar pas lidhjes së kontratës. Personi i aftë për të vepruar mund të kërkojë që të anulohet kontrata të cilën, pa autorizimin e nevojshëm, e ka lidhur gjatë kohëzgjatjes së zotësisë së kufizuar për të vepruar,

vetëm në qoftë se padinë e ka paraqitur brenda tre (3) muajsh nga data e fitimit të zotësisë së plotë për të vepruar.”

Anulimi i punëve juridike relativisht të pa vlefshme, qoftë të atyre të lidhura me mungesa vullneti, ose midis personit që nuk ka zotësi të plotë të veprimit, ose të punëve juridike të dëmtimi pa masë, mund të bëhet vetëm në afatin e paraparë ligjor. Afati për paraqitjen e padisë për anulimin e punës juridike është afat prekluziv që dmth nuk ka as pezullim e as ngecje të afatit për paraqitje të padisë. *Afati subjektiv* për anulimin e këtyre punëve juridike është 1 (një) vit i cili afat fillon të rrjedh nga dita kur kemi kuptuar për shkakun e rrzueshmërisë së punës juridike, prej pushimit të dhunës, respektivisht 3 (tre) muaj, nga dita e fitimit të zotësisë së plotë për të vepruar kur punët juridike janë lidhur nga personat me zotësi të kufizuar veprimi. Ndërsa *afati objektiv* për paraqitjen e padisë për anulimin e punës juridike relativisht të pa vlefshme është afat i cili fillon të rrjedh nga dita e lidhjes së punës juridike, dhe kjo parashihet edhe në LMD të Kosovës, në nenin 102 paragrafi 2, ku thuhet “ Kjo e drejtë në çdo rast shuhet me skadimin e afatit prej 3 (tre) vitesh, nga dita e lidhjes së kontratës.”

- ***Pasojat e anulimit të punëve juridike të rrzueshme***

Punët juridike të rrzueshme, nëse anulohen, krijojnë pasoja juridike. Mirëpo, ato kur anulohen, atëherë edhe pavlefshmëria e tyre vlen nga momenti i krijimit të saj. Pra këtu kemi veprim retroaktiv të efekteve juridike.

Puna juridike e rrzueshme konsiderohet e pa vlefshme nga momenti i lidhjes së saj, sepse anulimi në bazë të vendimit gjyqësor prodhon efekte juridike jo nga momenti i marrjes së vendimit por nga momenti i lidhjes së punës juridike relativisht të rrzueshme. Kërkohet që të korrigjohen efektet e krijuara të punës juridike të rrzueshme të anuluar.

LMD i Kosovës kur flet për pasojat e anulimit të kontratave të rrzueshme, në nenin 99 paragrafi 1 parasheh ” *Pasojat e anulimit* 1. Në rast se në bazë të kontratës se rrzueshme që është anuluar është përmbushur diçka, duhet të bëhet kthimi; në rast se kjo është e pamundshme apo në rast se kthimi ndalohet nga natyra e asaj që është përmbushur, duhet të bëhet kompensimi përkatës në të holla. 2. Kompensimi në të holla jepet sipas çmimeve në kohën e kthimit ose në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor.

Në raste të caktuara si pasojë e anulimit të punëve juridike të rrzueshme kemi edhe përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar me rastin e anulimit të kontratës. Kjo përgjegjësi rregullohet me LMD, në nenin 100, ku thuhet “ Përgjegjësia për anulimin e kontratës Kontraktuesi, në anën e të cilit është shkak i rrzueshmërisë, i përgjigjet bashkë kontraktuesit për dëmin që pëson për shkak të anulimit të kontratës, nëse ky nuk ishte në dijeni dhe as që duhej të ishte në dijeni për ekzistimin e shkakut të rrzueshmërisë së kontratës.”

Me rastin e anulimit të punës juridike të rrzueshme, edhe personat me aftësi të kufizuar për të vepruar do të përgjigjen për dëmin të cilin ia kanë shkaktuar tjetrit duke përdorur dinakëri, për të bindur bashkë kontraktuesin e tij, se është i aftë për të vepruar. Pra këtu kërkohet veprimi dinak i personit me aftësi të kufizuar veprimi, i përdorur te pala tjetër, që ta bind për lidhjen e punës juridike.

Neni 101 i LMD parasheh “Përgjegjësia e personit me aftësi të kufizuar për të vepruar Personi me aftësi të kufizuar për të vepruar përgjigjet për dëmin e shkaktuar me anulimin e kontratës, në qoftë se me dinakëri e ka bindur bashkë kontraktuesin e tij se është i aftë për të vepruar.”

5.4 Ushtrime

Gjatë këtij sesioni do të bëhet ushtrim në ndarjen e pjesëmarrësve në grupe më të vogla, duke luajtur rolin e palëve kontraktuese në ndonjë nga kontratat që atyre u interesojnë. Po ashtu gjatë këtij sesioni do të bëhet ushtrim në ndarjen e pjesëmarrësve në grupe më të vogla, duke luajtur rolin e palëve kontraktuese në ndonjë nga punët e nulshme juridike.

5.5 Përmbledhje

Lidhur me këtë modul do të interpretohen dhe komentohen dispozitat ligjore në aplikim nga Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, (komentim me pjesëmarrësit - bashkëbisedim) përkitazi me çështjet e lartë përmendura, ku krejt në fund, besoj se me shpjegimet praktike të këtyre çështjeve do të arrihet qëllimi i këtij sesioni.

6. Veprimet e palejueshme (deliktet) - pasurimi i pabazë - Mbrojtja e të drejtave

6.1 Hyrje

Në këtë sesion, në pjesën e parë do të ligjërohet – bashkëbisedohet për rëndësinë e veprimeve të palejueshme (delikteve), e posaçërisht për pasurimin e pabazë. Cilat janë ato veprime të palejueshme të cilat paraqesin delikte dhe detyrimet për kompensimin e dëmit. Kur veprimi është i palejueshëm. Çka është dëmi, inkriminimi i veprimit të palejuar, përgjegjësitë objektive dhe subjektive etj. si dhe rastet e pasurimit të pabazë. Gjithashtu do të diskutohet për rëndësinë dhe kuptimin e mbrojtjes së të drejtave në organet shtetërore, me theks të veçantë në gjykatat të cilat mbrojnë të drejtat civile të palëve, kuptimin e parimit të dispozicionit të palëve, padinë dhe llojet e padive, ndarjen e padive, çka është argumentimi dhe cilat janë mjetet e argumentimit, çka është procedura kontestimore dhe jashtë kontestimore, aktgjykimi i formës së prerë dhe procedura ekzekutive për një aktgjykim të tillë, të cilin debitori – i padituri nuk duan ta përmbushin detyrimin e vet, përkatësisht të plotësojë kërkesëpadinë e padisë.

6.2. Objektivat e trajnimit

Pas përfundimit të këtij prezantimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Thellojnë njohurit për kuptimin, rëndësinë dhe efektet e veprimeve të palejueshme (delikteve), me theks të veçantë pasurimit të pabazë, të cilat çdo ditë hasen në praktikën e gjykatave,
- Avancojnë njohurit për kuptimin dhe rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave në organet shtetërore me theks të veçantë në gjykata të cilat mbrojnë të drejtat civile të palëve.
- Thellojnë njohuritë për kuptimin e parimit të dispozicionit të palëve, argumentimin dhe mjetet e argumentimit.
- Thellojnë njohuritë për procedurën kontestimore dhe jashtë kontestimore.
- Zgjerojnë njohurit për aktgjykimin e formës së prerë dhe procedurën ekzekutive për një aktgjykim të tillë, të cilin debitori – i padituri nuk do ta përmbushë detyrimin e vet, përkatësisht të plotësojë kërkesëpadinë.

6.3 Veprimet e palejueshme (deliktet) - pasurimi i pabazë

Paraprakisht, duhet ditur cilat veprime të palejueshme paraqesin delikte. Detyrimet që krijohen nga ai fakt juridik i quajmë veprime të palejueshme. Ky fakt juridik krijon detyrimin që të kompensohet dëmi.

Kemi dy lloj burimesh të krijimit të detyrimit për kompensimin e dëmit: kontratat dhe shkaktimi i dëmit. Për kontratat si punë juridike është folur në sesionet e më parme, kurse tani do të flasim për veprimet e palejueshme (deliktet) me të cilat tjetrit i shkaktohet dëmi. Kur dëmi i shkaktohet të dëmtuarit, krijohet përgjegjësia respektivisht detyrimi për shpërblimin e atij dëmi. Përgjegjësia për dëmshpërblim quhet edhe përgjegjësi deliktore-civile. Veprimi anti juridik, në kuptimin e gjërë quhet delikt, ndërsa në kuptimin e ngushtë ky veprim anti juridik mund të jetë vepër penale, apo kundravajtje, por nuk dmth pa tjetër. Pra delikti civil është çdo veprim i kundërligjshëm me të cilin është shkakuar dëmi që krijon detyrimin që dëmi i shkakuar të shpërblehet. (Bashkëbisedim me pjesëmarrësit lidhur me këto detyrime).

Që të krijohet detyrimi nga delikti respektivisht veprimi i kundërligjshëm nevojiten këto rrethana: *veprimi i palejueshëm, dëmi i shkaktuar me atë veprim, inkriminimi i veprimit të palejueshëm ose faji dhe lidhja shkaktuese midis veprimit të palejueshëm dhe dëmit.*

Veprimi është i palejueshëm në qoftë se është i ndaluar me dispozitë ligjore. Veprimi i kundërligjshëm mund të shkaktohet me veprim aktiv të dëmtuesit, ose me mos veprim aktiv të dëmtuesit/ me veprim pasiv/. Shpesh herë ndodh që edhe pse dëmi i është shkaktuar subjektit tjetër, mirëpo veprimi i shkaktimit të dëmit nuk ka karakter kundërligjor, pra dëmtuesi nuk përgjigjet. Këto janë pra rastet e përjashtimit të kundërligjshmërisë së veprimit me të cilin është shkaktuar dëm personit tjetër: dëmi i shkaktuar duke kryer të drejtën, dëmi i shkaktuar me pranimin e të dëmtuarit, dëmi i shkaktuar në mbrojtje të nevojshme, dëmi i shkaktuar në nevojë ekstreme, dëmi i shkaktuar duke kryer detyrën zyrtare, dhe dëmi i shkaktuar në vetë ndihmën e lejuar . rastet e përmendura që përjashtojnë veprimin e kundërligjshëm duhet të jenë reale, objektive dhe të vërtetuara.

*Dëmi është humbje në masën pasurore të dëmtuarit. Në qoftë se është shkaktuar pakësimi i masës ekzistuese të pasurisë, kjo quhet *dëm real*. Në qoftë se nuk është shkaktuar shtimi i masës së pasurisë për shkak të veprimit të dëmtuesit, dëmi quhet *fitim i humbur*. Për veç dëmit pasuror kemi edhe *dëmin moral*, i cili përbëhet nga lëndimi i të drejtës personale që nuk mund të shprehet në mënyrë pasurore. Lidhur me këtë bëhet kompensimi i dëmit moral. Te vendimet gjyqësore ky kompensim realizohet në qoftë se dëmtuesi ka shkaktuar me qëllim apo nga pakujdesia. Bashkëbisedim për dëmin real dhe moral.*

Inkriminimi i veprimit të palejuar do të thotë regjistrim i tij në fajin e bërësit . Faji është fenomen psikik, është raport subjektiv. Inkriminimi mund të jetë qëllim i keq (dolus) apo pakujdesi (negligentia) pa dashje. Dashja / dolus/ mund të jetë e drejtpërdrejtë, dhe dashje eventuale. Edhe pakujdesia mund të jetë e rëndë dhe e rëndomtë.

*Te faji duhet të kihet parasysh rasti (kasusfortuitus) forca madhore (vis major). Cilat do të ishin karakteristikat e fuqisë madhore?- ngjarja e pa paraparë, e pa shmangshme, e pa pengueshme, dhe e jashtme. *Rasti*. Kur ndodh rasti, nuk ka faj dëmtuesi. Psh kur shkaktohet dëmi nga pëlçitja e gomës së mjetit motorik. Këtu nuk ka faj dëmtues. Ekzistimin e rastit duhet ta provoj dëmtuesi në qoftë se provon të lirohet nga përgjegjësia. Edhe dëmi i shkaktuar nga personi i tretë, nuk e obligon për kompensim personin përgjegjës. Psh person i tretë konsiderohet bashkë udhëtari i cili hedh cigaren në rrugë dhe shkakton zjarrin. Edhe në këtë rast personi përgjegjës duhet të provojë se se dëmi është shkaktuar me veprimin e fshehur të personit të tretë dhe se ai nuk përgjigjet për dëmin e shkaktuar.*

Lidhja kauzale. Midis veprimit të palejuar dhe dëmit të shkaktuar duhet të ekzistojë lidhja kauzale. Kompensimi i dëmit mund të rezultojë nga përgjegjësia objektive, përgjegjësia për sendet e rrezikshme, përgjegjësia për personat e tretë, dhe përgjegjësia objektive nga konsiderata e drejtëshmërisë,

- ***Pasurimi pa bazë juridike***

Kur masa pasurore e një personi shtohet pa bazë juridike, ndërsa e personit tjetër njëkohësisht pakësohet , bëhet fjalë për pasurimin e pabazë të atij, masa pasurore e të cilit është shtuar në dëm të masës pasurore të personit tjetër, p.sh. primusi i paguan gabimisht sekunduesit, duke menduar se prej tij ka blerë sendin, atëherë nuk ka bazë dhe sekunduesi është pasuruar pa bazë.

Ka lloje të ndryshme të pasurimit të pabazë:

Pagimi i asaj që nuk është borxh (conditio indebiti) - në qoftë se ndokush nga lajthimi paguan atë që nuk ka pasur borxh, mund të kërkoj kthimin por nëse e paguan me vetëdije, nuk mund të kërkoj kthimin (ajo do të jetë dhuratë në qoftë se personi të cilit i paguhet pranon pagimin, apo ndonjë punë tjetër sipas rrethanave të rastit). Gjithashtu nuk është pagim i asaj që nuk është borxh në qoftë se realizohet detyrimi i natyrshëm (kërkesa e parashkruar, borxhi nga bixhozi i lejuar etj.), apo pagimi i borxhit akoma të pa arritur për pagesë.

Pagimi sipas bazës që nuk është realizuar- kur kryhet / ekzekutohet/ prestimi i caktuar, duke pritur që baza e caktuar do të realizohet, e në realitet nuk realizohet. Kur paguan borxhin e ardhshëm, ndërsa ky nuk krijohet psh paguan qiranë edhe për periodën kur nuk e ka sendin me qira, etj.

Pagimi sipas bazës që ka dështuar më vonë.

Pasurimi pa bazë me veprimin e subjektit të pasuruar,

Pasurimi pa bazë me veprimin e personit të tretë, etj

Baza ka ekzistuar , por ka rënë poshtë (condictio causa data causa non secuta i condictio ob causam finitam).

Në qoftë se ndokush ka realizuar detyrimin nga puna juridike, por puna juridike është shkëputur, personi që ka paguar kërkon kthimin e pagesës, sepse ai e mbanë pa bazë, p.sh. blerësi ka paguar çmimin, por sendi i shitur para shitjes rastësisht është shkatërruar, apo puna e rrëzueshme juridike është shpallur e pavlefshme, pra palët mbajnë pa bazë atë që njëra tjetrës i kanë dhënë: martesa anulohet apo bëhet shkurorëzimi, ose marrësi i dhuratës është treguar jo mirënjohës, prandaj kthehen dhuratat.

Baza është e ndaluar ose imorale (te condictio ob turpem vel injustam causam). Në qoftë se puna është e nulshme palët mbajnë pa bazë atë që kanë dhënë me qëllim të realizimit të punës së nulshme juridike. Për këtë arsye palët kthejnë atë që e kanë marrë.

Shembujt janë marr më parë për restitutionin, kur kemi folur për pasojat e pavlefshmërisë të punëve juridike.

Rastet tjera të pasurimit të pabazë (conditio sine causa, në kuptimin e ngushtë) këto janë raste tjera si në tri grupet e mësipërme p.sh. Përpunimi i sendit të huaj në të rinj, pasurimi nga kryerja jo kompetente të punëve të huaja, realizimi i përbashkët i vlerave të personave që nuk janë në marrëdhënie kontraktuese (p.sh. Një person punon në familjen e tjetrit pa kontratën mbi punën, personat në raporte jashtë martese fitojnë në bashkësi sende që i përvetësojnë njëri prej tyre).

Personi që është pasuruar pa bazë duhet të kthej sendin me të cilin është pasuruar ose vlerën e tij.

6.4 Mbrojtja e të drejtave

Kushtetuta e Kosovës në nenin 46 parasheh “ E drejta e pronës është e garantuar”. Edhe në nenin 54, Kushtetuta garanton të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me kushtetutë, ose me ligj dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konsiderohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Paraprakisht, duhet ditur se mbrojtjen e të drejtave e ushtrojnë organet shtetërore dhe se realizimi arbitrar i të drejtave, e edhe të drejtave civile është i ndaluar.

Në të drejtën tonë pozitive lejohet edhe *gjendja e domosdoshmërisë / sakrifikimi i sendit të huaj/* që të eliminohet rreziku prej vetes ose prej tjetrit, apo përgjithësisht të mbrohet e drejta e vet, që është objekt i cili vlen shumë më tepër se sendi i sakrifikuar. Kur ndodh kjo situatë, shpërblimi duhet ti jepet personit sendi i të cilit është sakrifikuar.

Me nenin 20 të LPDTS parashihet “ *Mbrojtja e nevojshme* **1.** Asnjë person nuk vepron në kundërshtim me ligjin nëse ai e dëmton ose e shkatërron pasurinë e luajtshme që i takon ndonjë personi tjetër me qëllim të largimit nga vetvetja ose nga personi i tretë rrezikun e pritshëm të rrjedhur nga kjo pasuri e luajtshme, përderisa dëmtimi ose shkatërrimi i kësaj pasurie të luajtshme ishte e domosdoshme për largimin e rrezikut. Nëse rreziku ishte shkaktuar nga personi që e dëmton ose shkatërron pasurinë e luajtshme ose nëse ky person ka mundur të shmangë rrezikun e pritshëm por nuk ka vepruar me qëllim ose nga neglizhenca, ky person është përgjegjës për kompensimin e pronarit të pasurisë së luajtshme për dëmin e shkaktuar. **2.** Pronari i një sendi të luajtshëm ose i një paluajtshmërie nuk ka të drejtë të ndalojë të tjerët për ushtrimin e ndikimeve mbi këtë pronë nëse kjo është e domosdoshme për shmangien e rrezikut të pritshëm, përderisa rreziku është proporcionalisht më i madh në krahasim me dëmin që i shkaktohet pronarit. Pronari mund të kërkojë kompensim për çdo dëm të shkaktuar.

Vetëmbrojtja pra mund të përdoret në kushtet ku në përgjithësi është e lejuar vetë ndihma.

Padia

Të drejtat subjektive civile, mbrohen me padi, e cila i drejtohet gjykatës kompetente, për mbrojtje e tyre.

Organet shtetërore që i mbrojnë të drejtat civile janë gjykatat.

Parimi i dispozicionit të palëve

Gjykata nuk mbron të drejtat civile sipas detyrës zyrtare , si në të drejtën penale, por sipas iniciativës së palëve. Ky quhet parim i dispozicionit të palëve dhe është i lidhur ngushtë me vet veçoritë themelore të metodës civile – juridike dhe me dispozitivitetin e normave civile juridike. Titullari i së drejtës, në rast, se debitori vet nuk dëshiron të përmbushë vullnetarisht detyrimin e vet, nuk është i detyruar për të realizuar të drejtën e vet në mënyrë të dhunshme.

Për mbrojtjen e të drejtës së vet gjykatës i drejtohet me parashtrimin e padisë. Të drejtuarit e titullarit të së drejtës , gjykatës quhet padi. / neni 252 i LPK/.

Padia në kuptimin material rrjedh nga vet e drejta subjektive, ajo rrjedh nga kërkesa si element përbërës i të drejtës subjektive, ajo është në të vërtetë kërkesë e paraqitur në procedurën e realizimit të dhunshëm të së drejtës.

Padia në kuptimin formal paraqet shkresën me anë të së cilës paditësi i drejtohet gjykatës për mbrojtjen e të drejtës së tij subjektive civile.

E drejta që të jesh paditës (actor) në drejtësi quhet aktorat.

Titullari i së drejtës ose personi tjetër që ka aktorat, kur i drejtohet gjykatës për mbrojtjen e të drejtës së vet, quhet paditës, ndërsa personi i detyruar kundër të cilit është drejtuar padia quhet i paditur.

I padituri mund ta kundërshtoj padinë e paditësit apo mund të paraqet kundërpadi në kuptimin materialo – juridik.

Llojet e padive

Në pajtim me ndarjen themelore të së drejtës civile në absolute dhe relative, edhe paditë në kuptimin material ndahen në reale juridike dhe personale.

Padit reale / sendore/ juridike mund të paraqiten kundër kujt do që cenon ndonjë të drejtë reale, absolute. Ato janë pasojë e të “drejtës së racionit” në të drejta subjektive reale.

Kështu qëndron edhe te cenimi i së drejtës tjetër absolute psh. Të drejtës në emrin e autorit, p.sh. mund të padisë këndo, te i cili gjendet sendi i tij, apo i cili mban sendin në të cilin ka të drejtën e pengut.

Paditë sendore janë,

-padia e reivindikimit (actio reivindicatio), -pronari posedues kundër poseduesit jo pronësor kërkon kthimin e sendit në posedim,

-padia publiciane (actio publiciana) – poseduesi i mëparshëm kërkon nga poseduesi aktual kthimin e sendit,

-padia negatore (actio negatoria) – kërkohet mbrojtja nga shqetësimet që nuk kanë të bëjnë me marrjen e sendit, pra mbrohet pronësia e sendit të cilin e ka në posedim.

-padia konfessore (actio confesoria), - e paraqet personi i cili e ka të drejtën e servitutit ndaj çdo personi të tretë si dhe ndaj pronarit të paluajtshmërisë shërbyese.

Padia personale është e drejtuar kundër personit qysh më parë të caktuar me të cilin qëndron në raport përkatës detyrimor – juridik. Diferenca më kryesore qëndron në atë se kërkesat tek të dy paditë në esencë janë të ndryshme. Te ajo reale – juridike (dhe përgjithësisht te paditë absolute) qëllimi është ai, që të vendoset, krijohet gjendja që titullari të mund të ushtroj të drejtat e veta. Ndërsa, te ajo personale që i padituri të realizojë ndaj titullarit detyrimin e vet, p.sh. pronari kërkon që t’i kthehet sendi që të mund, ashtu si më parë të ushtrojë të drejtën e vet të pronësisë.

Ky detyrim – juridik në esencë është bartje e ndonjë vlere të re pasurore në titullarin (paditësin). Ndërsa, te padia reale juridike nuk bartet vlere e re, por objekti i mëparshëm kthehet në masën e pasurisë.

Paditë ndahen në ekzekutive (kondemnatore), konstatuese (deklarative) dhe konstitutive.

Te paditë ekzekutive kërkohet realizimi i dhunshëm i ndonjë detyrimi p.sh, pagimi i borxhit etj. Kërkesa realizohet gjithmonë me padi ekzekutive.

Te paditë konstatuese (deklarative) me vendimin e gjykatës konstatohet se ndonjë e drejtë ekziston apo nuk ekziston.

Kurse, te paditë konstitutive me aktgjykim shqiptohet ekzistimi i së drejtës së re, p.sh. padia për ndarjen e sendeve etj. Lidhur me paditë dhe llojet e tyre do të bashkëbisedohet me pjesëmarrësit.

Argumentimi është veprimi më i rëndësishëm i procesit gjyqësor dhe gjykata njeh atë të drejtë që është argumentuar, që do të thotë, të vërtetën e ndonjë rrethane. Pala që pohon diçka në padinë e tij ose në procesverbal, mbi të bie e ashtuquajtura barrë e argumentimit (actori incumbit probatio). Mirëpo, ligji shpesh supozon se ndonjë fakt ose rrethanë ekziston deri sa mos të argumentohet e kundërta. Mjetet e argumentimit janë: dokumentet, dëshmitarët, ekspertët dhe prova me anë të dëgjimit të palëve. Lidhur me këtë do të lexohen dhe komentohen me pjesëmarrësit dispozitat ligjore të LPK-së, që kanë të bëjnë me provat, dëshmitarët, ekspertët, palët etj.

Gjykata lidhur me kërkesëpadinë e padisë vendos me vendim gjyqësor dhe atë: me aktvendim për çështjet procedurale dhe masat e sigurimit, ndërsa në mënyrë meritore për kërkesëpadi për pengim të posedimit, sipas kërkesës për urdhër mbrojtje dhe me urdhërpagesë (Gjykata do ta urdhëroj të paditurin që të përmbush kërkesëpadinë e cila ka të bëjë me kërkesën në të holla që është bërë e realizueshme e që provohet me dokument të besueshëm). Ndërsa, për të gjitha çështjet tjera me aktgjykim, me të cilin e aprovon në tërësi apo pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit apo e refuzon në tërësi apo pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit.

Aktgjykimi është i formës së prerë kur nuk mund të sulmohet më me mjete të rregullta juridike – ankesë të paraqitur në gjykatën më të lartë dhe ai është ekzekutiv, pra mund të realizohet me dhunë.

Do të bashkëbisedohet me pjesëmarrësit për ndonjë nga aktgjykimet e formës së prerë të gjykatave me mjete të rregullta juridike apo me mjete të jashtëzakonshme juridike.

Konflikti midis paditësit dhe të paditurit është kontesti. Mirëpo, në gjykata kemi edhe procedurën jashtë kontestimore si: shpallja e personit të zhdukur si të vdekur dhe provimi i vdekjes, zgjatja, heqja dhe kthimi i së drejtës prindërore, dhënia e lejes për lidhjen e martesës, shqyrtimi i pasurisë trashëgimore etj.

Në qoftë se ekziston aktgjykimi i formës së prerë, e nganjëherë madje edhe para formës së prerë, kur ai është ekzekutiv dhe debitori – i padituri përsëri nuk donë të përmbushë detyrimin e vet, d.m.th. të plotësojë kërkesëpadinë e paditësit, mund të kërkohet zbatimi i dhunshëm i aktgjykimit. Ky zbatim i dhunshëm zhvillohet sipas procedurës së veçantë, procedurës së përbarimit - ekzekutimit, në të cilën gjithashtu parashihen edhe të ashtu quajturat masat e sigurimit, të gjitha me qëllim të përbarimit-ekzekutimit të aktgjykimit të formës së prerë.

6.5 Ushtrime

Gjatë këtij moduli do të bëhet ushtrim në ndarjen e pjesëmarrësve në grupe më të vogla, duke luajtur rolet e paditësit dhe të paditurit në konteste gjyqësore, ndërsa të propozuesve në procedurë jashtë kontestimore.

6.6 Përmbledhje

Lidhur me këtë modul do të interpretohen dhe komentohen dispozitat ligjore të LPK-së dhe të LPP-së (komentim me pjesëmarrësit - bashkëbisedim). E po ashtu edhe dispozitat ligjore nga neni 136 deri 202 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, (komentim me pjesëmarrësit - bashkëbisedim) që kanë të bëjnë me çështjet si temë e trajnimit gjatë këtij sesi.

II. Procedura kontestimore – pjesa e parë

Albert Zogaj
Gjyqtarë në Gjykatën e Apelit

Tabela e përmbajtës “ Procedura kontestimore – pjesa e parë’

Hyrje.....	55
Objektivat e modulit	55
Metodat e të shpjeguarit.....	55
Pritjet nga pjesëmarrësit.....	56
Mjetet e nevojshme.....	56
Burimet 56	
AKTE, KODE, LIGJE, RREGULLORE DHE RAPORTE.....	57
Përmbledhje	58
1. Parimet e procedurës kontestimore	59
1.1 Hyrje	59
1.2 Objektivat trajnuese	59
1.3 Parimet themelore të procedurës kontestimore.....	59
1.4 Parimi i kushtetutshmërisë.....	60
1.5 Parimi i ligjshmërisë.....	61
1.6 Parimi i disponibilitetit	61
1.7 Parimi i dëgjimit të palëve	61
1.8 Parimi i publicitetit	62
1.9 Parimi i shqyrtimit dhe i hetimit.....	63
1.10 Parimi i së vërtetës materiale	64
1.11 Parimi i vlerësimit lirisht të provave	64
1.12 Parimi i pandërmjetësisë.....	65
1.13 Parimi i shfrytëzimit me mirëbesim i të drejtave procedurale.....	65
1.14 Parimi i oralitetit	66
1.15 Parimi i dhënies së ndihmës juridike palës së paudhëzuar	66
1.16 Parimi i ekonomisë së gjyqimit	66
1.17 Gjuha në procedurën kontestimore	67
1.18 Përmbledhje.....	67
2. Shqyrtime të përgjithshme lidhur me kompetencën.....	68
2.1 Hyrje	68
2.2 Objektivat trajnues	68
2.3 Shqyrtime të përgjithshme lidhur me kompetencën	68
2.4 Kompetenca e Gjykatave Themelore	68
2.5 Kompetenca Lëndore	69
2.5.1 Kur dhe si duhet ta vlerësoj kompetencën gjyqtari i çështjes?.....	69
2.5.2 Kriteret që e rregullojnë kompetencën lëndore	69
2.5.3 Në çfarë mënyrë mund të paraqitet jokompetenca lëndore e gjykatës	70
2.5.4 Jo kompetenca lëndore në raport me gjykatën tjetër.....	70
2.5.5 Jo kompetenca lëndore në raport me organin administrativ.....	70
2.5.6 Jo kompetenca e gjykatës së vendit.....	70
2.5.7 Jo kompetenca lëndore kur palët kanë kontraktuar arbitrazhin	71
2.5.8 Jo kompetenca në rastet e procedurave jokontestimore.....	71
2.6 Kompetenca Territoriale	71
2.6.1 Kompetenca e përgjithshme territorial.....	71
2.6.2 Roli i gjyqtarit në vlerësimin e kompetencës së përgjithshme territoriale	72
2.6.3 Kompetenca e veçantë territoriale	72
2.6.3.1 Kompetenca territoriale ekskluzive	73
2.6.3.2 Kompetenca territoriale e zgjedhur.....	73

a) Kompetenca territoriale e zgjedhur në kontestet martesore	74
b) Kompetenca në kontestet për vërtetimin apo kundërshtimin e atësisë apo amësisë	74
c) Kompetenca në kontestet për ushqimin ligjor	74
d) Kompetenca në kontestet për shpërblimin e dëmit	74
e) Kompetenca në kontestet për mbrojtjen e së drejtës në bazë të garancisë së prodhuesit	75
f) Kompetenca në kontestet nga marrëdhënia e punës	75
g) Kompetenca sipas vendit të pagesës	76
h) Kompetenca sipas vendit ku ndodhet njësia e personit juridik	76
i) Kompetenca në konteste për shkak të pengim-posedimit mbi sendin e luajtshëm	76
j) Kompetenca në konteste nga marrëdhëniet kontraktuese	76
k) Kompetenca në konteste nga marrëdhëniet trashëgimore - juridike	77
2.6.4 Kompetenca territoriale ndihmëse.....	77
- Në cilat raste vjen në shprehje kompetenca territoriale ndihmëse?.....	78
a) kompetenca territoriale ndihmëse për bashkë-ndërgjyqësit.....	78
b) kompetenca territoriale ndihmëse në kontestet martesore.....	78
2.6.5 Kaktimi i kompetencës territoriale nga gjykata e lartë	79
2.6.6 Marrëveshja mbi kompetencën territoriale	81
2.6.7 Konflikti në lidhje me kompetencën.....	81
2.7 Përmbledhje.....	83
3. Përbërja e rregullt e gjykatës dhe përjashtimi i gjyqtarit.....	84
3.1 Hyrje	84
3.2. Objektivat trajnues	84
3.3 Përbërja e rregullt e gjykatës (kompetenca funksionale).....	84
3.4 Përjashtimi dhe rekuizimi i gjyqtarit nga gjykimi.....	85
3.4.1 Rrethanat të cilat qojnë deri të përjashtimi i gjyqtarit nga gjykimi	85
3.4.2 Rrethanat të cilat qojnë deri të rekuizimi i gjyqtarit nga gjykimi	86
3.4.3 Procedura	87
3.4.4 Autoriteti kompetent për të vendosur lidhur me kërkesën për përjashtimin dhe rekuizimin e gjyqtarit	
88	
3.4.5 Kërkesat e palejuara	88
3.5 Përmbledhje.....	88
4. Palët në procedurën kontestimore	90
4.1 Hyrje	90
4.2. Objektivat trajnues	90
4.3 Prezumimet procedurale lidhur me palët.....	90
4.4 Kuptimi i palëve në procedurën kontestimore	90
4.5 Kush mund të jetë palë në procedurën kontestimore?	91
4.6 Zotësia procedurale e palëve.....	91
4.7 Përfaqësimi ligjor i rregullt në rast të mungesës së zotësisë procedurale.....	92
4.7.1 Përfaqësuesi ligjor	93
4.7.2 Përfaqësuesi i përkohshëm	93
4.7.3 Përfaqësimi i rregullt i personit juridik	94
4.7.4 Përfaqësuesit e autorizuar të palëve (me prokurë)	94
4.7.5 Mos përfaqësimi i duhur i palës nga ana e avokatit apo personit tjetër	95
4.7.6 Mënyrat e dhënies së autorizimit	95
4.7.7 E drejta e ndjekjes së çështjes në gjykatë (legetimatio ad processum).....	97
4.8 Përmbledhje.....	98
5. Parashtrat dhe dërgimi i shkresave	99
5.1 Hyrje	99

5.2	Objektivat trajnues	99
5.3	Parashtresat	99
5.3.1	Veprimi i gjykatës në rastet kur parashtresa nuk është e kuptueshme dhe e plotë	100
5.3.2	Pasojat e mos plotësimi - korrigjimit të parashtresës	100
5.4	Dërgimi i shkresave	100
5.4.1	Problemet që mund të paraqiten lidhur me komunikimin e shkresave	101
5.4.1.1	Rastet kur adresati është person juridik	101
5.4.1.2	Komunikimi i shkresave personave të privuar nga liria	101
5.4.1.3	Rastet kur pala vepron në gjykim nëpërmjet përfaqësuesit	102
5.4.1.4	Si do të veprohet në rastet kur palës i dërgohet shkresa edhe pse është e përfaqësuar qoftë nga përfaqësuesi ligjor ose me prokurë si dhe në rastet kur ka më tepër përfaqësues ligjorë dhe me prokurë?	102
5.4.1.5	Komunikimi personalisht adresatit	102
5.4.1.6	Si do të veprohet në rastet kur personi të cilit duhet dorëzuar personalisht shkresa nuk gjendet atje ku duhet bërë dorëzimi	102
5.4.1.7	Çka duhet të përmbajë njoftimi?	103
5.4.1.8	Komunikimi i zakonshëm	103
5.4.1.9	Dërgimi i shkresave nga vet palët	104
5.4.1.10	Refuzimi i pranimi të shkresës dhe veprimi në rastet e tilla	104
5.4.2	Problemet që mund të paraqiten në dërgimin e shkresave në rast të ndërrimit të adresës ..	104
5.5	Përmbledhje	105
6.	Seancat, afatet dhe kthimi në gjendjen e mëparshme	106
6.1	Hyrje	106
6.2	Objektivat trajnues	106
6.3	Seancat	106
6.3.1	Mënyra e caktimit të seancës gjyqësore	106
6.3.2	Vendi i mbajtjes së seancës	107
6.4	Afatet	107
6.4.1	Llogaritja e afatit	107
6.5	Kthimi në gjendjen e mëparshme	108
6.5.1	Afati për paraqitjen e propozimit për kthim në gjendjen emëparshme	108
6.5.2	A lejohet ankesa kundër aktvendimit me të cilin vendoset për propozimin për kthim në gjendjen e mëparshme?	109
6.6	Përmbledhje	110
7.	Përfundimi i procedurës me vendim të gjykatës	111
7.1	Hyrje	111
7.2	Objektivat trajnues	111
7.3	Aktgjykimi	111
7.4	Përmbajta e aktgjykimit	112
7.5	Dhënia, hartimi me shkrim dhe dërgimi i aktgjykimit	117
7.6	Korrigjimi i aktgjykimit	118
7.8	Forma e prerë e aktgjykimit	119
7.9	Llojet e Aktgjykimeve	119
7.9.1	Aktgjykimi detyrues (dënues, kondemnator)	120
7.9.2	Aktgjykimi vërtetues (deklarativ)	120
7.9.3	Aktgjykimi transformues (konstitutiv, ndryshues)	120
7.10	Përmbledhje	120
8.	Llojet e aktgjykimeve sipas LPK-së	121
8.1	Hyrje	121
8.2	Objektivat trajnues	121
8.3	Aktgjykimi i pjesshëm	121

8.4 Aktgjykimi në bazë të pohimit	122
8.5 Aktgjykimi në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia.....	123
8.6 Aktgjykimi për shkak të padëgjueshmërisë	125
8.7 Aktgjykimi për shkak të mungesës.....	126
8.9 Aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes	127
8.10 Nxjerrja e aktgjykimit pa caktuar seancë gjyqësore sipas dispozitës së nenit 398 të LPK-së	128
8.11 Nxjerrja e aktgjykimit pa caktuar seancë gjyqësore sipas dispozitave nga neni 399 i LPK-së.	129
8.12 Përmbledhje.....	130
9. Mjetet e rregullta të goditjes	131
9.1 Hyrje	131
9.2 Objektivat trajnues	131
9.3 Mjetet e rregullta të goditjes	131
9.4 Ankesa kundër aktgjykimit.....	132
9.4.1 Interesi juridik për goditjen e vendimit.....	132
9.4.2 Efektet e ankesës	134
9.4.3 Afati për paraqitjen e ankesës	134
9.4.4 Përmbajtja e ankesës.....	134
9.4.5 Shkaqet nga të cilat mund të goditet aktgjykimi	135
9.4.6 Shkelja e dispozitave të procedurës kontestimore.....	136
9.4.6.1 Vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike	140
9.4.6.2 Zbatimi i gabueshëm i të drejtës materiale	140
9.5 Procedura sipas ankesës.....	141
9.5.1 Veprimi i gjykatës së shkallës së parë kur ankesa është e rregullt	144
9.5.4 Kufijtë e ekzaminimit të aktgjykimit të shkallës së parë.....	145
9.6 Mënyrat e vendosjes sipas ankesës.....	146
9.6.1 Hedhja poshtë e ankesës si e vonuar, jo e plotë apo e palejueshme	147
9.6.2 Prishja e aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe hedhja poshtë e padisë	147
9.6.3 Prishja e aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe kthimi i çështjes në rigjykim	147
9.6.4 Refuzimi i ankesës dhe vërtetimi i aktgjykimit të shkallës së parë.....	149
9.6.5 Ndryshimi i aktgjykimit të Gjykatës Themelore.....	149
9.7 Organizimi i një aktgjykimi të Gjykatës së Apelit	149
9.8 Ankesa kundër aktvendimit.....	150
9.9 Efektet e ankesës	150
9.10 Mënyra e vendosjes nga gjykata e shkallës së dytë për ankesat kundër aktvendimeve	150
9.11 Përmbledhje.....	150
10. Mjetet e jashtëzakonshme të goditjes.....	152
10.1 Hyrje.....	152
10.2 Objektivat trajnues	152
10.3 Mjetet e jashtëzakonshme	152
10.4.1 Në cilat raste lejohet revizioni	153
10.4.2 Shkaqet për paraqitjen e revizionit	153
10.4.3 Procedura sipas revizionit	155
10.4.4 Vendosja sipas revizionit në Gjykatën Supreme të Kosovës.....	155
10.5 Përsëritja e Procedurës	156
10.5.1 Shkaqet për paraqitjen e propozimit për përsëritje të procedurës	156
10.5.2 Afati për paraqitjen e propozimit për përsëritjen e procedurës.....	157
10.5.3 Procedura e paraqitjes së propozimit për përsëritjen e procedurës	158
10.5.4 Vendosja sipas propozimit për përsëritje të procedurës	159
10.6 Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë	160
10.6.1 Kompetenca për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.....	160

10.6.2 Shkaqet e goditjes për goditjen e vendimit më kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.....	160
10.6.3 Vendimet të cilat mund të goditën me kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.....	161
10.6.4. Afati për ngritjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë	161
10.7 Përmbledhje.....	161

Hyrje

Moduli “Procedura Kontestimore – pjesa e parë ” paraqet një kornizë të koncepteve themelore të procedurës kontestimore i mbështetur kryesisht në temat që trajtohen në pjesë e parë të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Në këtë modul janë trajtuar tema të rëndësishme dhe të domosdoshëm për zhvillimin e veprimtarisë së funksionit të gjyqtarit. Temat e trajtuara janë: parimet e procedurës, përbërja e gjykatës, palët, parashtrirat, seancat, afatet, vendimet gjyqësore, mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme, etj, dhe si të tilla përbejnë fundamendin e procedurës kontestimore dhe rrjedhimisht edhe detyrimin që secili gjyqtar të zhvilloj shkathtësitë e zhvillimit të procedurës dhe vendosjes, krejt në funksion të zbatimit të drejtësisë së besueshme.

Gjatë zhvillimit të këtij moduli gjyqtarët do të njoftohen edhe me standardet e praktikës gjyqësore lidhur me sfidat e zbatimit të procedurës në mënyrë të unifikuar dhe duke i garantuar secilit të drejtën për një proces gjyqësor të drejtë dhe të ligjshëm.

Për secilin sesion do të ofrohen shembuj të shumtë nga praktikatat e gjykatave tonë në mënyrë që gjyqtarët të jenë në gjendje që në mënyrë të pavarur të shqyrtojnë dhe vendosin për rastet me të cilat ngarkohen.

Si qëllim final përmes këtij moduli synohet që gjyqtarët e sapoemëruar njohurit e tyre akademike (teorike) dhe njohurit që do të përfitojnë në Programin Fillestarë të jenë në gjendjen që ti materializojnë në praktikë.

Objektivat e modulit

Pas përfundimit të këtij moduli trajnues, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Kuptojnë pjesën e parë të së drejtës pozitive procedurale e zbatueshme nga ana e gjykatave në çështje civile;
- Zhvillojnë shkathtësi të interpretimit të dispozitave procedurale dhe zbatimit të tyre në praktikë varësisht nga specifikat dhe situatat me të cilat do të përballën;
- Zhvillojnë shkathtësitë e zhvillimit të procedurës me efikasitet dhe duke garantuar standardet e gjyqimit të drejtë dhe të ligjshëm;
- Zbatojnë drejtë të gjitha veprimet procedurale në të gjitha fazat e procedurës varësisht nga situatat me të cilat paraqitet çështja në gjykatë;
- Përpilojnë vendimet gjyqësore procedurale dhe meritore duke zbatuara me korrektësi dispozita ligjore si për strukturën e vendimit gjyqësor ashtu edhe për përmbajtjen.

Metodat e të shpjeguarit

Trajtimi teorik i temave nga pjesa e parë e Ligjit të Procedurës Kontestimore si: parimet e procedurës, përbërja e gjykatës, palët, parashtrirat, seancat, afatet, vendimet gjyqësore, mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme, etj.

Diskutim teorik lidhur me dispozitat ligjore të pjesës së parë të procedurës sipas Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Demonstrim praktik përmes shembjeve, rasteve dhe simulimeve të ndryshme për nivelin e shkathtësive të kërkuara për secilin gjyqtar qoftë për shqyrtime paraprakë, qoftë për shqyrtime gjyqësorë, qoftë për vendosje meritore apo edhe çështje që lidhen me mjete e goditjes etj. Një rëndësi të veçantë në organizimin dhe ndërtimin e këtij trajnimi do të kenë ushtrimet praktike për të nxitur pjesëmarrjen aktive të kandidatëve.

Për demonstrimin e çështjeve kryesisht përdoret forma e diskutimit- bashkëbisedimit me qëllim që të arrihet që të gjithë pjesëmarrësit të jenë aktiv gjatë gjithë kohës duke dhënë kontributin e tyre më parashtrimin e pyetjeve, ofrimin e zgjidhjeve dhe me sugjerimet e tyre. Pjesëmarrësit përveç kontributit të tyre në diskutime sfidojnë edhe idetë e trajnuesit lidhur me shtruarjen dhe zgjidhjen e shumë çështjeve alternative apo edhe problematike.

Pritjet nga pjesëmarrësit

Në fund të këtij moduli synohet të arrihen këto rezultate:

Gjyqtar e sapoemëruar të njohin dhe zbatojnë parimet dhe rregullat tjera të procedurës kontestimore:

Të zhvillojnë shkathëtuesit për shqyrtime paraprake, mbajtje të gjykimit dhe vende të rasteve sipas kërkesave që arrijnë në gjykata.

Të njohin dhe të zbatojnë standardet e praktikës gjyqësore sidomos lidhur me përpjekjet e gjykatave për zbatim unike të procedurave.

Të njohin dhe zbatojnë në praktik edhe standardet ndërkombëtare që i referohen gjykimit të drejtë, veçanërisht nenin 6 i Konventës Evropiane.

Mjetet e nevojshme

Për të arritur efektin më të madh, mjetet mbizotëruese të mësimdhënies në këtë trajnim do të jenë me karakter të nxitjes së dialogut/debatit. Prezantimet në Poëer Point dhe ilustrimet tjera të shembujve të ndryshëm lidhur me temat e trajtuara në këtë modul do të paraqitën përmes materialeve ekzemplarë. Sa i përket ushtrimeve praktike, trajnuesi do të shfrytëzojnë modelet hipotetike por edhe të anonimizuara (p.sh. të vendimeve të ndryshme, dispozitave përkatëse kushtetuese, ligjore, rregullative, etj, ose raste të simuluar gjyqësore (*pjesë të caktuara të shqyrtimit/diskutimit*) për qëllime të demonstrimeve në klasë të shkathtësive të interpretimit, zbatimit dhe vendosjes.

Burimet

1. Faik Brestovci, Iset Morina & Rustem Qehaja, E Drejta Procedurale Civile-Procedura Kontestimore, Prishtinë 2017.
2. Faik Brestovci, E Drejta Procedurale Civile I dhe II, Prishtinë 2006.
3. Faik Brestovci, E Drejta Procedurale Civile Ndërkombëtare, Prishtinë 2000.
4. Faik Brestovci, Doracaku për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, Prishtinë, 2004.
5. Arsen Janevski & Tatjana Zoroska-Kamilovska, e Drejta Procedurale Civile-E Drejta Kontestimore, Shkup 2009.
6. Flutra Kolaj-Tafaj & Asim Vokshi, Procedurë Civile, Pjesa I, Tiranë 2003.
7. Iset Morina & Selim Nikçi “Komentar” Ligji për Procedurën Kontestimore, Prishtinë 2012.
8. Steven J. Burton, Hyrje në të Drejtën dhe Arsytimin Ligjor, Tiranë 2000.

9. Enver Hasani & Ivan Cukalovic, "Komentar" Kushtetuta e Republikës së Kosovës, botimi I, Prishtinë 2013.
10. Muahrrem Shala, Albert Zogaj, Valon Totaj & Zenel Leku, Doracaku i Gjyqtarëve për Procedurën Kontestimore, Prishtinë 2015.
11. Enver Hasani, Ne Bis In Idem në Procedurën Kontestimore, Prishtinë, 2009
12. Hajredin Kuçi & Asllan Bilalli, E Drejta Ndërkombëtare Private, Prishtinë 2008.
13. Hajredin Kuçi & Asllan Bilalli, Zanafilla, Zhvillimi Historik dhe Burimet e së Drejtës Ndërkombëtare Private, Prishtinë 2006.
14. Petraq Çuri, E Drejta Procedurale Civile & Noteria, Tiranë 2008.
15. Jani Vasili, Procedura Civile, Tiranë 2010.
16. Ardian Kalia, E Drejta Ndërkombëtare Private, Tiranë 2010.
17. Marek Antonio Noëicki, Rreth Konventës Evropiane, Tiranë 2003.
18. Michael A Cunniff & Albert Zogaj, Moduli-Shkathësitë e Arsytimit dhe Shkrimit Ligjor për Gjyqtarë, IGJ Prishtinë 2013.
19. Gjykata Supreme e Kosovës, Buletini i Praktikës Gjyqësore, Prishtinë, 2011, vëllimi 1.
20. Gjykata e Apelet, Buletin i Praktikës Gjyqësore 1, Prishtinë 2015.
21. Gjykata e Apelit, Buletin i Praktikës Gjyqësore 2, Prishtinë 2016.
22. Gjykatat e Qarkut Kosovë, Buletini i Praktikës Gjyqësore, Prishtinë, 2011, vëllimi 2.
23. Gjykata Supreme e Kosovës, Përmbledhje e Vendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës në Rastet Pronësore, Prishtinë, 2011.

AKTE, KODE, LIGJE, RREGULLORE DHE RAPORTE

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
2. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut, 1950.
3. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës- OKB, 20 nëntor 1989
4. Ligji për Gjykatat nr. 03/L-199, shpallur me datën 09.08.2010, GZ.79/24.08.2010, që ka hy në fuqi me 01.01.2013.
5. Ligji për Procedurën Kontestimore
6. Ligji për Procedurën Përmbartimore
7. Ligji për procedurën Jokontestimore
8. Ligji për Zgjidhjen e Kolizionit të Ligjeve me dispozita e shteteve tjera në marrëdhëniet e caktuara- Gazeta Zyrtare të RSFJ nr.43/82 dhe me përmirësimin në nr.72/82.
9. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve
10. Ligji për Familjen i Kosovës.
11. Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve
12. Ligji nr.04/L-157 për Avokaturën Shtetërore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.8, e datës 08.04.2013.
13. Ligjin për Noterinë
14. Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale
15. Ligji për Ndërmjetësimin
16. Kodi i Etikes Profesionale për Gjyqtarë, 2016
17. Rregullorja, 04/2016 Për Përcaktimin e Sjelljeve të Pahijshme
18. Ligji për Procedurën Kontestimore, (i vjetri)
19. Ligji për Procedurën Përmbartimore, (i vjetri)
20. Ligji për Procedurën Jokontestimore, (i vjetri)
21. Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës nr.217/13, të datës 25.03.2013
22. Ligji për Avokaturën Publike (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.9/83).
23. Ligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Procedurën Kontestimore nr.04L-118.

Përmbledhje

Ky modul përfshin çështje më të rëndësishme nga Procedura Kontestimore të cilat në kuptimin e njohjes dhe zbatimit janë të domosdoshme për secilin gjyqtarë sepse nuk mund të vendoset një çështje e paraqitur në gjykatë pa zhvilluar në procedurë. Përmes këtij moduli gjyqtarët do të materializojnë njohurit e tyre akademike dhe ato të fituara në Programin Fillestarë, duke qenë në gjendjes që në mënyrë të pavarur, të besueshëm dhe të sigurt të ushtrojnë funksionin e tyre të gjykatësit për aq sa i takon procedurës.

Secili gjyqtarë, qysh ditën e parë të punës do të përballët me nevojën e njohjes, interpretimit dhe zbatimit të procedurës, prandaj ky modul synon që atyre t'ju ofroj mbështetjen e duhur.

1. Parimet e procedurës kontestimore

1.1 Hyrje

Në këtë sesion janë paraqitur parimet kryesore të Procedurës Kontestimore, me shpjegime përkatëse për impaktin që tërheq secili parim në shqyrtimin, zhvillimin dhe vendosjen e një çështje. Synohet që të paraqitën për diskutim raste të shumta nga praktika gjyqësore për të cilat mungojnë dispozitat specifike dhe rrjedhimisht të paraqitën format e veprimit të gjykatës duke zbatuar parimet procedurës.

1.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij moduli pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të :

- Njohin parimet kryesore të procedurës kontestimore;
- Kuptojnë impaktin që ka secili parim i procedurës për të garantuar gjykimin efikas, të besueshëm, objektiv dhe ligjor;
- Zbatojnë të gjitha parimet e procedurës kontestimore në çdo situatë kur zgjidhja varët nga zbatimi i parimeve të procedurës.

1.3 Parimet themelore të procedurës kontestimore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës me dispozitën e nenit 31 paragrafi 1, përcakton se: “Çdo kujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike” ndërsa me dispozitën e nenit 54 parasheh Mbrojtjen Gjyqësore të të Drejtave, duke përcaktuar se: “ Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar më këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.

Një garanci e rëndësishme kushtetuese që mbron lirinë individuale të individëve që kanë të bëjnë me të drejtë për gjykim të drejtë janë dispozitat e cituara. Edhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, në nenin 6 i garanton secilit të drejtën për t’i parashtruar gjykatës për gjykim çfarëdo pretendimi, që u referohet “të drejtave dhe detyrimeve me karakter civil”.

Koncepti i “të drejtave dhe detyrimeve” me karakter civil është koncept autonom, i cili duhet interpretuar pavarësisht nga e drejta e brendshme e shteteve të Konventës, por duke marrë parasysh parimet e saj të përgjithshme.

E drejta e individit për një proces gjyqësor të rregullt dhe publik, e cila zë vend në një shoqëri demokratike, në kuptimin e Konventës, ka rëndësi tepër të madhe për funksionimin e duhur të mekanizimit të demokracisë dhe si rezultat i kësaj, nuk mund të bëhet një interpretim i ngushtë i saj. Në rast të paqartësive, nëse neni 6 duhet të gjejë zbatim, gjithmonë, atje ku kjo është e mundur-përgjigja duhet të jetë pozitive.

Në vendimin “*Delcourt kundër Belgjikës*” Gjykata theksoi se “Në shoqëritë demokratike, në kuptimin e Konventës, e drejta për një proces të rregullt gjyqësor zë një vend kaq të rëndësishëm, sa që, çfarëdo interpretimi i ngushtë i nenit 6 paragrafi 1, nuk do të përgjigjet as qëllimit dhe as karakterit të këtij neni”. Në çështjen “*Sunday Times (nr.1) kundër Britanisë së Madhe*” Gjykata

tërhoqi vëmendjen se neni 6, është pasqyrim i një parimi të rëndësishëm, që shtrihet në themelet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe përkatësisht, parimit të rendit ligjor. Kushtetua e Republikës së Kosovës në mënyrë primare e garanton mbrojtjen në gjykatë, si formën më të rëndësishme të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në të drejtën e brendshme.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Konventa Evropiane garantojnë të drejtën e secilit për mbrojtje gjyqësore, në këtë rast në nivel kushtetuese, ndërsa në mënyrë specifike procedurën për mbrojtje gjyqësore e rregullon ligji përkatës-Ligji për Procedurën Kontestimore-(LPK).

Me dispozitën e nenit 1, të LPK-së, përcaktohet se: *“Me ligjin për procedurën kontestimore caktohen rregullat procedurale në bazë të të cilave gjykata i shqyrton dhe i zgjidhë kontestet nga marrëdhëniet juridiko-civile të personave fizik dhe juridik, po që se me ligj të posaçëm nuk është përcaktuar ndryshe”*.

Procedura kontestimore mbi disa parime bazë që garantojnë ligjshmërinë dhe objektivitetin e zhvillimit të procedurës.

Gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore gjykata duhet të kujdeset për zbatimin e parimeve të procedurës. Procedurat civile në vendet bashkëkohore kanë tendencë që të rregullohen në mënyrë sa ma parimore duke shmangur kështu fondin e madh të dispozitave për çështje specifike sepse sa më specifikisht që të rregullohen procedurat civile/kontestimore mundësitë e kolizionit të dispozitave apo të dykuptimisë janë më të mëdha, prandaj edhe ne duhet tu kushtojmë një vëmendje të veçantë parimeve të procedurës kontestimore të cilat gjejnë zbatim parimisht nga fillimi i procedurës kontestimore e deri në përfundim të procedurës kontestimore.

Në procedurën kontestimore me këtë term quhen rregullat themelore, të cilat përshkojnë aktivitetin që kryejnë subjektet e procesit me qëllim që të arrihet mbrojtja juridike e së drejtës subjektive apo me qëllim që të konstatohet se për një gjë të tillë nuk ka vend. Parimet e kësaj procedure i caktojnë metodat e veprimit që kryhet gjatë shqyrtimit të çështjes juridike dhe vendosjes mbi të.

1.4 Parimi i kushtetutshmërisë

Kushtetuta e Republikës së Kosovës me dispozitën e nenit 102 paragrafi 1, përcakton se: *“Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga gjykata”*, me paragrafin 2, përcaktohet se: *“Pushteti gjyqësor është unik, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata”*, ndërsa në paragrafin 3, përcaktohet se: *“Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit”*.

Kufizimi i gjykatave që të mund të kenë pushtet jashtë kufijve të vendosur nga Kushtetuta dhe ligjet është standard i mbrojtjes nga arbitrariteti i pushtetit gjyqësor, në njërën anë, dhe në anën tjetër, standard themelor i demokracisë i shprehur si kushtetutshmëria dhe ligjshmëria.

Në praktikë, ky paragraf i Kushtetutës i detyron gjykatat që pushteti i tyre të burojë vetëm nga kushtetuta dhe ligjet.

Përveç dispozitave të cituar e të cilat ndërlidhen me parimin e kushtetutshmërisë në procedurën kontestimore, ekziston edhe dispozita e nenit 16 paragrafi 1, në Kushtetutë e cila përcakton se: *“Kushtetuta është akti më i lartë juridik në Republikën e Kosovës, Ligjet dhe aktet tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë”*.

Parimi i kushtetutshmërisë kërkon që normat e sistemit të caktuar juridik të jenë në pajtim me Kushtetutën si dokument juridik kryesor. Ata që kanë për detyrë zbatimin e normave juridike

gjatë punës së tyre duhet t'i kenë parasysh rregullat kushtetuese dhe ligjore si dhe ato të akteve të përgjithshme të cilat fuqinë e tyre e nxjerrin nga rregullat kushtetuese dhe ligjore.

1.5 Parimi i ligjshmërisë

Parimi i ligjshmërisë përcakton detyrimin e gjykatës që zhvillimi i shqyrtimit gjyqësor por edhe vendimi meritor të jetë i ndërlidhur me normën juridike. Gjykata është e detyrueshme që kontestin ta zgjidhë ashtu siç e parasheh norma me të cilën është rregulluar raporti materialo-juridik nga i cili ka lindur kontesti.

Parimi i ligjshmërisë në procedurën kontestimore vlen edhe për normat e natyrës materialo-juridike nga të cilat gjykata nxjerrë përfundimin për themelësinë e kërkesëpadiisë e po ashtu edhe për normat procedurale mbi bazën e të cilave gjykata e udhëheqë procedurën për vendosjen e çështjes kontestuese.

1.6 Parimi i disponibilitetit

Esenca e këtij parimi është shprehur me maksimumin latine *“nemo iudex sine actore”*. Kjo do të thotë se nuk ka proces kontestimor pa kërkesën e personit të autorizuar që gjykata të vendosë mbi kërkesën e caktuar të mbrojtur juridikisht. Në bazë të këtij parimi, paditësit i njihet e drejta që procedurën e inicuar me padi ta përfundojë me veprimin procedural të tërheqjes së padisë (*dispozita e nenit 261 paragrafi 1, i LPK-së*) apo me atë të heqjes dorë nga kërkesëpadiia (*dispozita e nenit 149 paragrafi 1, i LPK-së*). Procesi përfundon me veprimet disponibile të palëve edhe atëherë kur ato lidhin pajtim gjyqësor për objektin e kontestit të përcaktuar me padi (*dispozita nga neni 412-419 të LPK-së*). Procedura instancionale gjithashtu mund të përfundojë me anë të veprimit disponibil të tërheqjes së mjetit të goditjes së vendimit (*dispozitat e nenit 177 të LPK-së*).

1.7 Parimi i dëgjimit të palëve

Me dispozitën e nenit 5 paragrafi 1, të LPK-së, përcaktohet se: *“Gjykata do t'i jep mundësi secilës palë që të deklarohej rreth kërkesave dhe thënieve të palës kundërshtare”*, ndërsa në paragrafin 2, të nenit të njëjtë përcaktohet që:

“Vetëm në rastet e përcaktuara me këtë ligj gjykata ka të drejtë që të vendosë mbi kërkesën, për të cilën palës kundërshtare nuk i është dhënë mundësia që të deklarohej”.

Sipas këtij parimi, gjykata ka për detyrë që, para se ta japë vendimin meritor, çdonjëres nga palët t'ia japë mundësinë për të paraqitur mendimin lidhur me çështjen mbi të cilën duhet vendosur, si dhe për t'u deklaruar lidhur me thëniet dhe pretendimet e palës kundërshtare. Ky parim, i cili ndryshe quhet parim i kontradiktorialitetit. Me rregullat mbi këtë parim sigurohet barazia e palëve para gjykatës dhe mbledhja e fakteve relevante për vendosje meritorë, por edhe konstatimi se çka është kontestuese e çka jokontestuese midis palëve. Barazia e dy palëve me interesa të kundërta ndikon që secilës nga to t'i njihet e drejta që të shprehet në lidhje me veprimet procedurale, të cilat i kryen kundërshtari i saj. Duke i vënë në pozita të barabarta, ligji njëkohësisht krijon parakusht për gjykim objektiv. Sepse, gjykata është e detyruar që edhe njëres e edhe palës tjetër në mënyrë të njëjtë t'ia mundësojë marrjen e qëndrimit në lidhje me veprimin procedural të kundërshtarit, dhe është e detyruar të marrë parasysh gjithë atë që kanë paraqitur të dy palët.

Shkelja e parimit të kontradiktorialitetit, është paraparë si shkelje esenciale e dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak të shkeljes së tillë, gjykata e shkallës së dytë e prishë vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe lëndën e kthen në rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë.

Sipas interpretimit të Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut e drejta e dëgjimit publik është e garantuara, megjithatë shtypi dhe publiku “mund të përjashtohen nga të gjitha apo nga një pjesë e ‘një gjykimi për disa arsye specifike të caktuara, respektivisht, për interes të moralit, rregullit publik apo sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, në interes të jetës private të palëve, apo kur përndryshe këtë e kërkon interesi i drejtësisë”. Konventa Evropiane kësaj i shton edhe “interesin e të miturve” si një arsye për të mbajtur procesin gjyqësor nën kamerë. Sipas konventës Evropiane, procedurat duhet, në përjashtim të asaj të cekur më lartë, të mbahen në publik. Sidoqoftë, zbatimi i kësaj dispozite “në procedurat para gjykatave të apelit, varet nga mënyrat speciale të procedurave të përfshira “ dhe “duhet të kihet parasysh procedurat në përgjithësi të rregullit ligjor vendor dhe roli i gjykatave të apelit në to. Kështu gjykata si vazhdimësi ka theksuar se: “*nëse ka ekzistuar një dëgjim publik në instancën e parë, mungesa e ‘dëgjimit publik’ në instancën e dytë ose të tretë mund të arsyetohet me paraqitjen speciale të procedurave për çështjen në fjalë. Kështu, procedurat për lënje të ankesës apo procedurave që përfshijnë vetëm çështje të ligjit, si kundërshtim i çështjes së faktit, mund të jenë në pajtim me kërkesat e nenit 6, madje edhe nëse ankuesit nuk i është dhënë një mundësi që të dëgjohet personalisht nga gjykata e apelit apo kasacionit”.*

Nga praktika gjyqësore: Sipas dispozitës së nenit 182 paragrafi 2, i LPK-së, përcaktohet se: “Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë: pika i) nëse ndonjëherë nga palët me veprimin e paligjshëm, e sidomos me mosdhënien e mundësisë për shqyrtimin e çështjes në gjykatë”.

Me dispozitën e nenit 197 të LPK-së, përcaktohet se: “Gjykata e shkallës së dytë në seancën e kolegjit, apo në bazë të shqyrtimit të çështjes, me aktvendim e prishë aktgjykimin e shkallës së parë dhe çështjen ia kthen për rigjykim të njëjtës gjykatë të shkallës së parë, nëse konstaton se ekziston njëri ndër këto shkaqe të përmendura në ankesë: pika) Nëse ndonjëherë nga palët me veprim të kundërligjshëm, e sidomos për shkak të mos thirrjes në mënyrë të rregullt, nuk i është dhënë mundësia që të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes, kurse veprimi i tillë ka pasur ndikim në dhënien e vendimit të ligjshëm dhe të drejtë”.

Nga dispozitat e cituara shihet vlera e parimit të kontradiktorialitetit në procedurën kontestimore, prandaj me të drejtë gjykata e shkallës së dytë mbanë qëndrim rigoroz gjatë ekzaminimit të vendimeve të gjykatës së shkallës së parë, përkritazi me zbatimin e këtij parimi.

Parimi i procesit të rregullt gjyqësor ka si element të vetin edhe të drejtën e secilës palë për të qenë e pranishme në seancë gjyqësore. Praktika e Gjykatës Evropiane, ka përcaktuar standarde edhe për pjesëmarrjen në gjykim me qëllim që t’i krijohen mundësit secilës palë për tu mbrojtur efektivisht në të drejtën që pretendohet si e shkelur. Gjykata Evropiane, në një çështje të saj shprehet se: “*prania e palëve në procedurë civile është karakteristikë e rëndësishme e garancive të parashikuara në nenin 6 të Konventës. Në lidhje me çështjet civile, gjykata ka vendosur se kjo është veçanërisht e rëndësishme kur probleme të natyrës faktike ose personale janë në lojë...”.*

1.8 Parimi i publicitetit

Ky parim është shprehur në nenin 4 të LPK-ës, sipas të cilit gjykata për kërkesëpadinë zakonisht vendosë në bazë të shqyrtimit të zhvilluar në seanca gjyqësore me dyer të hapura. Është

parashikuar mundësia që në rastet në të cilat, me qëllim të ruajtjes së fshehtësisë, moralit, interesit të palës së mitur apo të ndonjë interesi tjetër të posaçëm, të përjashtohet publiciteti. Një gjë e këtillë bëhet me vendim të gjykatës. Mirëpo, në kontestet martesore, si dhe në ato në lidhje me atësinë apo amësinë publiciteti është përjashtuar ex lege.

Nga praktika gjyqësore: Parimi i publicitetit paraqet njërin ndër parimet me fundamentale në procedurë, zbatimin e të cilit shikohet zyrtarisht nga gjykata e shkallës së dytë me rastin e vendosjes sipas ankesave të palëve kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Detyrimi që gjykata e shkallës së dytë zyrtarisht të shikojë nëse është cenuar parimi i publicitetit përcaktohet me dispozitën e nenit 194 të LPK-së.

Rëndësia praktike e këtij parimi qëndron në atë se përmes publicitetit nxitet besimi i opinionit në gjykata e rrjedhimisht publiku shërben në njëfarë mënyre si monitorues i pavarësisë, paanësisë, objektivitetit dhe ligjshmërisë, përkitazi me vendosjen nga ana e gjykatës.

Karakteri publik i procesit ka rëndësi shumë të madhe, ai i mbron palët nga sistemi i drejtësisë, i zhvilluar në fshehtësi, pa kontrollin publik. Është, gjithashtu, një nga format e ruajtjes së besimit tek qytetarët, duke bërë që sistemi i drejtësisë të jetë i hapur dhe të synojë drejtë arritjes së qëllimit të nenit 6 paragrafi 1, të Konventës Evropiane, për besueshmërinë e procesit, garancitë e të cilit janë një nga parimet themelore të çdo shoqërie demokratike.

Me qëllim që të nxitet besimi ndaj administratës së gjyqësisë dhe të sigurohet dëgjimi i drejtë i palëve, procedurat duhet të jenë të hapura për publikun e gjerë. Sipas maksimës së njohur e cila thotë se drejtësia jo vetëm që duhet të bëhet, por edhe duhet të shihet se si bëhet, publiku ka të drejtë të dijë se si bëhet drejtësia dhe çfarë vendimesh merren. Dëgjimi publik, nënkupton dëgjimin e prezantimeve gojore për bazat e rastit, të cilat duhet të jenë publike dhe të cilat mund të përcjellë publiku dhe shtypi (sipas procedurës). Për këtë arsye, gjykatat duhet të bëjnë publike kohën dhe vendin e dëgjimit të prezantimeve gojore. Parimi i publicitetit duhet të respektohet në tërësi, përveç nëse ekziston ndonjë arsye që lejon përjashtimin e publikut.

Siç është vërejtur nga Gjykata Evropiane, objekt i nenit 6 (1) në lidhje me publikimin e vendimeve gjyqësore është “ të siguroj shqyrtim të gjyqësorit nga ana e publikut me qëllim të garantimit të të drejtës për gjykim të drejtë”. Gjykata nuk ka adaptuar një interpretim literal të fjalës “gjykimin duhet të shpallët publikisht”, por në vend të kësaj në praktikën e saj gjyqësore ka marrë parasysh “traditën e saj jetëgjatë” të shumë shteteve të Këshillit të Evropës gjatë bërjes publike të vendimeve të disa apo të të gjitha gjykatave të tyre; për këtë arsye një traditë e tillë nuk do të thotë domosdoshmërisht lexim me zë të gjykimit në fjalë, por nënkupton ruajtjen e këtyre vendimeve në një regjistër që është i hapur për publikun.

Parimi i publicitetit është duke u zgjeruar në kuptimin që publiku i gjerë të ketë mundësi të shohë drejtësinë se si është duke u bërë. Në këtë kuptim gjyqësori në Kosovë ka filluar me publikimin e vendimeve gjyqësore përfshirë edhe vendimet për çështje civile. Besoj që kjo është një mundësi e mirë e kontrollit nga publiku i gjerë për punën e gjykatave.

1.9 Parimi i shqyrtimit dhe i hetimit

Me rregullat procedurale më këto dy parime caktohet çështja e iniciativës lidhur me grumbullimin e materialit procedural në bazë të të cilit gjykata e nxjerrë vendimin meritator për kërkesëpadinë. Materialin procedural e përbëjnë: materiali faktik, materiali provues dhe rregullat juridike. Në praktikën gjyqësore në vendin tonë nuk ka qëndrim unik sa i përket parimit të

hetimit, përkatësisht rolit aktiv apo pasiv që duhet të ketë gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes kontestuese.

Sipas dispozitës së nenit 7 paragrafi 1, i LPK-së, përcaktohet se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, ndërsa me dispozitën e nenit 319 paragrafi 1, i LPK-së, përcaktohet se: *“Palët ndërgjyqëse kanë për detyrë të provojnë faktet mbi të cilat i bazojnë kërkesat dhe pretendimet e tyre”*.

Nga dispozitat e sipërcituara rrjedh se gjykata e shqyrtton çështjen duke e hetuar në masën që e propozojnë palët ndërgjyqësore, gjithmonë duke vlerësuar se cilat prova do të merren për të provuar faktet vendimtare, natyrisht nëse janë propozuar provat. Ka përjashtime nga ky rregull, sepse gjykata merrë prova edhe zyrtarisht kur bëhen përpjekje nga palët për të disponuar me kërkesa që nuk mund të disponojnë.

Me Ligjin nr.04/L-118, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-006, për Procedurën Kontestimore është ndryshuar dispozita e nenit 356 duke i dhënë mundësi gjykatës që zyrtarisht të bëjë të provuarit me anë të ekspertizës. Ky ndryshim është në kundërtënie të plotë me frymën e Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe në tërësi në kundërshtim me parimin e shqyrtimit dhe hetimit sepse bënë përjashtim vetëm për të provuarit me anë të ekspertizës. Ky ndryshim është i palogjikshëm sepse të gjitha mjetet provuese i shërbejnë qëllimit të njëjtë, vërtetimit të gjendjes faktike në çështjen kontestuese, prandaj është e paarsyeshme që të bëhet përjashtim për marrjen e provës me ekspertizë, megjithatë tani gjykata ka mundësi që zyrtarisht të bëjë marrjen e provës me ekspertizë.

1.10 Parimi i së vërtetës materiale

Me nenin 7 të LPK-ës nga gjykata kërkohet që para se të jepet vendimi për kërkesëpadinë, të vërtetohet plotësisht dhe saktësisht gjendja faktike, mbi të cilën mbështetet kërkesëpadia. Cilësia e njohurive për gjendjen faktike relevante varet nga mënyra e hulumtimit dhe e vlerësimit të materialit faktik të grumbulluar nga gjykata në një proces kontestimor. Ekzistojnë dy sisteme, me të cilat zgjidhet çështja e zgjedhjes, ekzaminimit dhe e fuqisë provuese të mjeteve provuese. I pari quhet sistem i vlerësimit lirisht të provave (i kërkimit të së vërtetës materiale), kurse i dyti sistem i vlerësimit ligjor (legal) të provave (sistem i kërkimit të së vërtetës formale).

Me dispozitën e nenit 8 paragrafi 1, të LPK-së, përcaktohet se: *“Se cilat fakte do t’i konsiderojë të provuara e cilat jo, vendosë vetë gjykata në bazë të çmuarjes me ndërgjegje e të kujdesshme të provave, por edhe në bazë të rezultatit të gjithë procedimit”*, ndërsa në paragrafin 2, përcaktohet se: *“Gjykata me ndërgjegje dhe me kujdes e çmon çdo provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku”*.

Nga dispozita e sipërcituar rrjedh së në sistemin tonë është vlerësim i lirë i gjykatës për të vendosur se cilat fakte do ti konsiderojë të provuara e cilat jo, pastaj çmuarjen e provave veç e veç e të gjitha së bashku, e në këtë mënyrë të arrijë në përfundimin e duhur ligjor.

1.11 Parimi i vlerësimit lirisht të provave

Në sistemin e vlerësimit lirisht të provave nuk parashikohen rregulla procedurale për zgjedhjen, shfrytëzimin dhe fuqinë provuese të mjeteve provuese. Gjykata, sipas këtij sistemi, nuk është e lidhur e as e kufizuar me rregulla të posaçme formale për të provuarit. Pretendimin e caktuar

gjykata e merr si të provuar vetëm pasi të jetë bindur në saktësinë e tij (në bazë të provave të shfrytëzuara dhe të vlerësuara).

Gjykata është e lirë të vlerësojë rezultatin e hetimit gjyqësor dhe të vendos për themelin e çështjes. Vlerësimi i lirë i provave nga gjykata, kërkon një kujdes të veçantë në respektimin e rregullave dhe kufijve të caktuar për këtë qëllim, si dhe përdorimi me efektivitet i eksperiencës. Gjykatësi duhet të ruhet nga ajo që quhet interpretim personal i tij, në drejtim të vlerësimit subjektiv e të njëanshëm të provave dhe të pranimit të konkluzioneve të nxjerra nën influencën e të dhënave të marra privatisht prej tij ose të ofruara nga palët, e që nuk i janë nënshtruar debatit gjyqësor. Del e domosdoshme formimi i një disipline të fortë juridike në vlerësimin e provave, ku si çështje bazë duhet të jetë formimi dhe konsolidimi i provës në procesin e përpjekjes së dy të kundërtave. Çdo cenim i këtyre rregullave të shpie në varfërimin e vlerës ligjore të gjykimit.

Sipas Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut, vlerësimi i provave u takon, në parim gjykatave vendore. Organet e Konventës mund ta kontrollojnë vetëm mënyrën e administrimit të provave dhe jo vlerësimin e tyre nga gjykata, me përjashtim të rasteve, kur bëhet fjalë për parregullsitë apo për arbitraritet.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut, nuk i përmban parimet e pranimit të provave, duke e lënë këtë ekskluzivisht në dorën e ligjeve vendore. Gjykata ka për detyrim shqyrtimin e kujdesshëm të provave dhe të kërkesave të palëve për paraqitjen e provave, si dhe vlerësimin e rëndësisë së tyre për zgjidhjen e çështjes. Lënia palëve njëfarë iniciative në fushën e provave nuk e liron gjykatën nga detyrimi i respektimit të nenit 6 të Konventës në këtë fushë. E drejta e palëve për të paraqitur argumente sigurohet vetëm në rastin kur ato dëgjohen realisht, pra, kur shqyrtohen nga gjykata në mënyrën e duhur. Nuk mund të thuhet se kjo është bërë në qoftë së është nënvlerësuar një provë më rëndësi esenciale.

1.12 Parimi i pandërmjetësisë

Sipas këtij parimi, gjykata, me anë të shqisave personale, njihet me natyrën dhe përmbajtjen e mjeteve provuese dhe pa ndërmjetësimin e tjetërkujt, vendos për vlerën provuese të tyre, si dhe merr vendim meritor të bazuar në materialin që ka grumbulluar vetë. Parimi i pandërmjetësisë ka të bëjë me faktin, se gjykata në gjykimin e çështjes civile duhet të jetë prezentë në dëgjimin e palëve, në marrjen e provave, si dëgjimi i dëshmitarëve, provave shkresore, etj.

Ky parim është shprehur në nenin 4 të LPK-ës, sipas të cilit gjykata vendosë për kërkesëpadinë zakonisht në bazë të shqyrtimit të drejtpërdrejtë të çështjes juridike të zhvilluar publikisht dhe gojarisht. Ky parim nuk zbatohet në procedurat instancionale, sepse në to vendoset në bazë të shkresave.

1.13 Parimi i shfrytëzimit me mirëbesim i të drejtave procedurale

Një prej standardeve kryesore në të drejtën bashkëkohore është ai se titullari i një të drejte nuk bënë ta keqpërdorë atë. Atij i njihet një e drejtë me qëllim që të shfrytëzohet për atë që është dedikuar jo për qëllime të tjera. Me LPK (neni 10) kërkohet nga palët që me ndërgjegje t'i shfrytëzojnë të drejtat procedurale, të cilat ua njeh ligji, kurse nga gjykata që ta pamundësojë keqpërdorimin e tyre. Kemi keqpërdorim të autorizimeve procedurale, p.sh., kur një person ngre padi, duke menduar se debitori nuk do të mund ta bindë gjykatën se e ka shlyer borxhin, pasi nuk ka kurrfarë provash për një gjë të tillë.

Suksesi personal, të cilin pala e ka parasysh gjatë aktivitetit të saj procedural, nuk guxon të jetë në kundërshtim me qëllimin objektiv të gjykimit.

Gjykata mund ta dënojë me të holla palën, përfaqësuesin e saj dhe ndërhyrësin, nëse me veprimet procedurale e kanë keqpërdorur rëndë ndonjë të drejtë që u njihet me LPK.

1.14 Parimi i oralitetit

Për komunikimin dhe këmbimin e mendimeve midis njerëzve si dhe midis palëve dhe gjykatës ekzistojnë dy forma: forma gojore, kur gjykata palëve dhe palët gjykatës mendimet ia shprehin gojarisht drejtpërdrejt, dhe forma e shkruar, kur palët kërkesat, propozimet dhe informatat e tjera i përpilojnë me shkrim dhe shkresat ia dorëzojnë gjykatës. Sipas LPK-ës, veprimet procedurale kryhen me shkrim jashtë seancave dhe gojarisht në seanca. Gjykata e krijon bindjen e saj nëpërmjet dëgjimit të vetë palëve, por në procesin gjyqësor civil shërbejnë edhe materialet e shkruara, të cilat shërbejnë si provë për zgjidhjen e çështjes, por gjithmonë ato lexohen e administrohen drejtpërdrejtë në gjykimin civil. Gjykimi oral, nga një anë ndihmon në zbulimin e së vërtetës dhe nga ana tjetër, kontribuon tek shtetasit pjesëmarrës si dëgjues në gjykim, që të marrin dijeni vetë nga zhvillimi i gjyqit dhe nga mënyra e zgjidhjes së konfliktit në gjykatë.

Në fazën përgatitore dhe në atë sipas mjeteve të goditjes së vendimeve, dominon forma e shkruar.

1.15 Parimi i dhënies së ndihmës juridike palës së paudhëzuar

Me qëllim të evitimit të pabarazisë faktike dhe dëmit eventual që mund ta pësojë pala e pa udhëzuar në punët juridike, është parashikuar detyra e gjykatës që atë ta udhëzojë se cilat veprime procedurale duhet t'i kryejë, por edhe ta njohë me pasojat e moskryerjes së veprimeve procedurale. Mirëpo, kjo detyrë e gjykatës ka të bëjë vetëm me udhëzimin për të drejtat procedurale e jo edhe me të drejtat e natyrës materialo-juridike. Gjykata mbetet brenda suazave të detyrës së përmendur, nëse, p.sh., palës ia shpjegon domethënien e instituteve procedurale: ndërprerje e procedurës, pezullim, tërheqje e padisë, heqje dorë nga kërkesëpadija, ndryshimi i padisë etj. Në të kundërtën do të shkelej parimi i paanësisë së gjykimit.

Për disa raste parashihet posaçërisht detyra e gjykatës që palët dhe personat tjerë t'i udhëzojë në lidhje me të drejtat e tyre ose t'i njoftojë me pasojat e mosveprimit të tyre. Kështu, p.sh., pala duhet njoftuar me dëmin që mund t'i shkaktohet për shkak të mosparaqitjes në gjykim. Gjykata është e detyruar që palën ta udhëzojë edhe mbi mënyrën e përmirësimit të gabimeve në aktin e saj të shkruar.

1.16 Parimi i ekonomisë së gjykimit

Sikurse edhe çdo aktivitet tjetër, edhe aktiviteti procedural duhet të kryhet në kohë sa më të shkurtër, me punë sa më të pakët dhe me shpenzime sa më të vogla. Për këtë qëllim është parashikuar, p.sh., marrja e provave nëpërmjet gjykatës së porositur, bashkimi i dy gjykimeve, mos caktimi i seancës përgatitore, bashkimi i kërkesëpadive, përfshirja e dy të paditurve me një padi të vetme etj.

Shembuj tjerë: Palëve prezent gjykata gojarisht ua komunikon vendin dhe kohën e mbajtjes së seancës së ardhshme; Ekspertët gjykata i detyron që ta paraqesin mendimin e tyre me shkrim para së të filloj seanca e shqyrtimi kryesor i çështjes, më qëllim që palët të përgatitën për të.

1.17 Gjuha në procedurën kontestimore

Bazuar në nenin 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë:

- a) gjuha shqipe, dhe
- b) gjuha serbe,

Gjuha turke, boshnjake dhe ajo rome, kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komunal ose do të mund të jenë në përdorim zyrtar në cilin do nivel në pajtim me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.

Ligji për Procedurën Kontestimore (LPK) përcakton se pala dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë kanë të drejtë që të përdorin gjuhën e vet apo gjuhën të cilën e kuptojnë.

Nëse procedura nuk zhvillohet në gjuhën e palës, respektivisht të pjesëmarrësit tjetër në procedurë, do të sigurohet sipas kërkesës së tyre përkthimi gojarisht në gjuhën e tyre apo në gjuhën që ata e kuptojnë, i të gjitha parashtrësive dhe provave shkresore si dhe i asaj që parashtrëhet në seancë.

Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë do të njoftohen me të drejtën që procedurën verbale ta ndjekin në gjuhën e tyre me anë të përkthyesit. Ata mund të heqin dorë nga e drejta e përkthimit, nëse deklarojnë se e njohin gjuhën në të cilën zhvillohet procedura. Në procesverbal do të shënohet se atyre u është dhënë udhëzimi për të drejtën e përdorimit të gjuhës së tyre, si dhe deklarata e palëve dhe e pjesëmarrësve të tjerë në procedurë lidhur me udhëzimin e dhënë nga gjykata.

Përkthimin e bëjnë përkthyesit, ndërsa shpenzimet e përkthimit mbeten në ngarkim të buxhetit të gjykatës.

Shkelja e rregullave të përdorimit të gjuhës në procedurën kontestimore, paraqet shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika (j) të LPK-së, për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare, ndërsa vendimi i cili bazohet në këto shkelje, duhet të priset.

Parimet themelore të procedurës kontestimore

1.18 Përmbledhje

Në këtë sesion trajnimi janë paraqitur parimet e procedurës kontestimore si rregullat bazë për zhvillimin e procesit gjyqësor. Parimet kanë rëndësi të pazëvendësueshme në procedurën kontestimore edhe për faktin së tendencat bashkëkohore në legjislacionet pozitive për procedurat janë të orientuara ma tepër ka formulimet e dispozitave në cilësinë e parimeve (*të përgjithshme*) në mënyrë që procedurat të kenë një lloj fleksibiliteti pa cenuar ligjshmërinë e procesit gjyqësor. Është bërë përpjekje që në mënyrë specifike të trajtohen pesha dhe hapësira që zë secili parim i procedurës dhe rrjedhimisht edhe pasojat që shfaqën në rast të mos zbatimit të parimeve të procedurës kontestimore.

2. Shqyrtime të përgjithshme lidhur me kompetencën

2.1 Hyrje

Në këtë sesion është trajtuar kompetenca e gjykatave si kushti i parë nga i cili varët nëse një procedurë e iniciuar para një gjykate do të jetë e lejueshme për tu shqyrtuara dhe vendosur. Në këtë kontekst rezulton së kompetenca përfaqëson detyrimin që secili gjyqtarë të ketë njohuri mbi kompetencë, llojet e kompetencës, rolin që ka gjykata në vlerësimin e kompetencës gjatë shqyrtimit paraprak të padisë dhe në fazat tjera të shqyrtimit gjyqësor dhe pasojat që krijohen në rast së gjykata nuk ka kompetencë.

2.2 Objektivat trajnuës

Pas përfundimit të këtij moduli pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të :

- Vlerësojnë prezumimet procedurale që lidhen me gjykatën në fazën e shqyrtimit paraprak të padisë;
- Vendosin varësisht nga fakti së gjykata ka, apo, nuk ka kompetencë dhe varësisht nga prapësimi mbi kompetencën;

2.3 Shqyrtime të përgjithshme lidhur me kompetencën

Kuptimi i kompetencës. Me termin kompetencë në pikëpamje objektive kuptojmë rrethin e punëve të një organi. Në pikëpamje subjektive kompetenca është e drejtë dhe detyre e organit që të vepron në çështjen e caktuar juridike.

2.4 Kompetenca e Gjykatave Themelore

Gjykata Themelore u krijua me Ligjin për Gjykatat- Ligji nr.03/2-19, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.04/L-171 dhe me Ligjin nr.05/L-032, ku sipas nenit 9 të tij, kjo gjykatë është gjykatë e shkallës së parë.

Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe.

Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore gjykon në shkallë të parë të gjitha çështjet, përveç nëse kjo është kompetencë e një departamenti tjetër të Gjykatës Themelore.

Me dispozitat e nenit 11 të Ligjit për Gjykatat, përcaktohet juridiksioni i Gjykatës Themelore sipas lëndës. Në paragrafin 1 (një) të nenit 11 (njëmbëdhjete) përcaktohet se: “ *Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe*”, ndërsa në paragrafi 2 (dy) të nenit të njëjtë përcaktohet së:” *Gjykatat themelore janë kompetente për të dhënë ndihmë juridike ndërkombëtare dhe për të vendosur për pranimin e vendimeve të gjykatave të huaja*”.

Nga dispozitat e sipërcituara kuptohet së në juridiksionin e Gjykatës Themelore-Departamenti i Përgjithshëm, përfshihen të gjitha çështjet përveç nëse me ligj përcaktohet ndryshe. Në fakt në juridiksionin e Departamentit të Përgjithshëm, siç vërehet nga dispozita e cituara nuk janë të

numëruara çështjet sipas lëndës në mënyrë taksative, por nga juridiksionet e departamenteve tjera kuptohet se cilat çështje nuk janë kompetencë e Departamentit të Përgjithshëm.

Në një përpjekje teorike për të identifikuar çështjet që potencialisht mund të trajtohen në Gjykatën Themelore-Departamentin e Përgjithshëm, mund të themi se juridiksioni i Departamentit të Përgjithshëm, i referohet çështjeve civile sipas padive civile, familjare dhe të Punës (*ky identifikim është sipas padive në pikëpamje të së drejtës materiale*).

2.5 Kompetenca Lëndore

Kompetenca lëndore është ajo në bazë të së cilës gjykatat e një kategorie kanë të drejtë dhe detyrë të gjykojnë disa çështje juridike për shkak të llojit, natyrës dhe vlerës së objektit të kontestit.

2.5.1 Kur dhe si duhet ta vlerësoj kompetencën gjyqtari i çështjes?

Edhe në rastet kur çështja e kompetencës nuk është ngritur nga palët, gjyqtari i çështjes duhet që menjëherë pas marrjes së padisë dhe gjatë gjithë procedurës, ta shikoj dhe të kujdeset se zgjidhja e kontestit hyn apo jo në kompetencën lëndore të gjykatës në të cilën është paraqitur.

Përcaktimi i kompetencës lëndore është kusht i domosdoshëm, ngase nga kjo varet lejueshmëria e procesit gjyqësor, që do të thotë se në rast se gjykata për çështjen e shtruar para saj nuk është kompetente, atëherë nuk mund të kryejë asnjë veprim procedural rreth asaj çështje.

Detyrimi i gjykatës që ta vlerësoj zyrtarisht kompetencën menjëherë pas marrjes së padisë dhe gjatë gjithë procesit gjyqësor përcaktohet me dispozitat nga neni 17.1, 18.1 dhe 19, 20.1 dhe 21.1 të LPK-së.

Gjykatësi e vlerëson kompetencën lëndore duke u bazuar në thëniet e paditësit dhe në bazë të fakteve që i ka të njohura vet gjykatësi.

Në të gjitha rastet e jo kompetencës lëndore, gjyqtari i çështjes duhet të vendosë me aktvendim. Ky lloj vendimi gjyqësor parashihet me dispozitën e nenit 387 par 1, pika u) të LPK-së.

2.5.2 Kriteret që e rregullojnë kompetencën lëndore

Për caktimin e kompetencës lëndore janë të njohura dy kriteret:

- Objekti i kontestit dhe
- Vlera e Objektit të Kontestit (vetëm për përdorim të mjetit të jashtëzakonshëm-revizioni).

Këto kriteret konsiderohen në bazë të përmbajtjes së padisë. Kompetenca e gjykatës paraqet prezumim procedural ngase në mungesë të këtij kushti gjykata nuk mund të lëshohet në themelësinë e kërkesëpadisë.

2.5.3 Në çfarë mënyrë mund të paraqitet jokompetenca lëndore e gjykatës

Jo kompetenca lëndore e gjykatave mund të paraqitet:

- a) në raport me jo kompetencën e ndonjë gjykate tjetër
- b) në raport me organin administrativ
- c) në raport me jo kompetencën e gjykatës së vendit
- d) në raport me jokompetencën kur palët kanë kontraktuar arbitrazhin
- e) në raport me procedurën jokontestimore kur çështja është inicuar si kontestimore.

2.5.4 Jo kompetenca lëndore në raport me gjykatën tjetër

Ky rast praktikisht ndodhë kur çështja është shtruar para Gjykatës Themelore-Departamentit të Përgjithshëm ndërsa kompetent mund të jetë Departamenti për Çështje Administrative, Departamenti për Çështje Ekonomike apo Dhoma e Veçante e Gjykatës Supreme të Kosovës.

Gjyqtari i çështjes ka kompetencë që menjëherë pas marrjes së padisë dhe gjatë zhvillimit të procedurës ta shikojë kompetencën lëndore dhe në rast se vlerëson se çështja e shtruar nuk është në kompetencë të gjykatës para të cilës është shtruar, por e ndonjë gjykate tjetër, atëherë me aktvendim e shpallë gjykatën jo kompetente dhe lëndën ja dërgon gjykatës për të cilën mendon se është kompetente për gjykimin e çështjes së ngritur me padi.

2.5.5 Jo kompetenca lëndore në raport me organin administrativ

Në praktikë mund të ndodhë që pranë gjykatës të paraqiten çështje për të cilat nuk është kompetente gjykata por ndonjë organ administrativ.

Nëse pas shqyrtimit paraprak të padisë dhe gjatë gjithë zhvillimit të procedurës gjyqtari arrin në vlerësimin se çështja e ngritur me padi nuk hynë në kompetencë gjyqësore por është çështje për të cilën kompetent është organi administrativ, atëherë nxjerr aktvendim për inkompetencë dhe padinë e hedhë si të palejueshme.

Në qoftë së gjykata është lëshuar në shqyrtim dhe ka ndërmarrë veprime procedurale, atëherë nxjerrë aktvendim për inkompetencë, i anulon veprimet e ndërmarra dhe padinë e hedhë si të palejueshme.

Në këto raste lënda nuk i dërgohet organit administrativ për të vendosur lidhur me çështjen e shtruar në padinë e paraqitur në gjykatë.

2.5.6 Jo kompetenca e gjykatës së vendit

Në praktikë ndodhë që para gjykatës të shtrohen çështje me element të huaj, ku vlerësimi i kompetencës lëndore ka të bëjë me atë që zgjidhjen e çështjes duhet ta ndërmerr gjykata e vendit apo ndonjë gjykatë e vendit të huaj.

Nëse gjyqtari konstaton se për zgjidhjen e kontestit kompetente është ndonjë gjykatë e ndonjë vendi tjetër e jo gjykata vendore, atëherë gjyqtari me aktvendim e shpallë gjykatën vendore inkompetente, anulon veprimet procedurale të kryera deri në atë fazë dhe padinë e hedhë poshtë. Gjykatësi nuk do të veprojë kështu në rastet kur i padituri jep pëlqimin që gjykata vendore mund të shqyrtojë dhe të vendosë në lidhje me çështjen.

2.5.7 Jo kompetenca lëndore kur palët kanë kontraktuar arbitrazhin

Gjykatat mund të përballen me situata ku palët për zgjidhjen e një kontesti të caktuar e kanë kontraktuar arbitrazhin. Gjykata, të cilës i është paraqitur padia për të njëjtin kontest midis palëve të njëjta, sipas kundërshtimit të palës së paditur për kompetencën do të shpallet inkompetente, do t'i anulojë veprimet e kryera në procedurë dhe do ta hedhë poshtë padinë.

Gjykata nuk vepron kështu vetëm po që se konstaton se kontrata mbi arbitrazhin nuk është e vlefshme, se ka pushuar vlefshmëria e saj apo se nuk mund të realizohet.

2.5.8 Jo kompetenca në rastet e procedurave jokontestimore

Në këto raste, gjykata gjatë zhvillimit të procedurës konstaton se procedura do të duhej të zhvillohej sipas rregullave të procedurës jokontestimore.

Nëse gjyqtari gjatë shqyrtimit të lëndës mbi çështjen kryesore konstaton se procedura do të duhej të zhvillohej sipas rregullave të procedurës jokontestimore, me anë të aktvendimit për inkompetencë do të përfundojë procedurën kontestimore. Në këto raste gjyqtari nuk e hedhë poshtë padinë por çështjen e dërgon tek gjykata kompetente për zhvillimin e procedurës jokontestimore. Duhet të kihet parasysh se veprimet e kryera nga gjykata gjatë procedurës kontestimore (këqyrja direkte, ekspertiza, dëgjimet e dëshmitarëve etj.), si dhe vendimet e marra nga kjo gjykatë nuk shpallen të pavlefshme dhe nuk do të kryhen rishtas.

2.6 Kompetenca Territoriale

Kompetenca territoriale përcakton së cila gjykatë e kompetencës lëndore brenda ndonjë territori të caktuar do të vendos lidhur më një rast konkret. Kompetenca territoriale mund të jetë si kompetencë e përgjithshme e gjykatës dhe kompetencë e veçantë.

2.6.1 Kompetenca e përgjithshme territorial

Edhe në të drejtën tonë procedurale për kompetencën tokësore të përgjithshme është pranuar rregulli *actor sequitur forum rei*. Sipas këtij rregulli për gjykimin e një çështjeje juridike e kompetencës së përgjithshme tokësore është gjykata e cila për palën e paditur është e kompetencës së përgjithshme tokësore.

- *Si e përcakton LPK-ja, kuptimin e kompetencës së përgjithshme territoriale?*

Sipas dispozitës së nenit 37 paragraf 1, të LPK-së, përcaktohet se: “Në qoftë se me ligj nuk është caktuar kompetenca ekskluzive territoriale e ndonjë gjykate tjetër, për procedimin e çështjes është kompetente gjykata e kompetencës së përgjithshme territoriale”.

- *Si e përcakton LPK-ja, përjashtimin e kompetencës së përgjithshme?*

Sipas dispozitës së nenit 37 paragraf 2, të LPK-së, përcaktohet se: “Në rastet e përcaktuara me këtë ligj, për procedimin e çështjes është kompetente, përpos gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale edhe gjykata tjetër e caktuar”.

- *Çfarë kriteri përcakton LPK-ja, për përcaktimin e kompetencës së përgjithshme territoriale?*

Sipas dispozitës së nenit 38 paragraf 1, të LPK-së, përcaktohet se: “Për procedimin e çështjes juridike është e kompetencës së përgjithshme territoriale gjykata në territorin e të cilës i padituri e ka vendbanimin”, ndërsa në paragrafin 2 të nenit të njëjtë përcaktohet se: “Në qoftë se i padituri nuk ka vendbanim, e kompetencës së përgjithshme territoriale është gjykata në territorin e të cilës i padituri e ka vendbanimin”.

2.6.2 Roli i gjyqtarit në vlerësimin e kompetencës së përgjithshme territoriale

Gjyqtari më rastin e marrjes në shqyrtim të rastit e vlerëson kompetencën e përgjithshme territoriale të gjykatës duke marrë për bazë vendbanimin apo vendqëndrimin e palës së paditur, ndërsa kur bëhet fjalë për personat juridik kompetenca e përgjithshme territoriale përcaktohet në bazë të territorit të selisë së personit juridik.

Kur para gjykatës jo kompetente paraqitet për objekt shqyrtimi ndonjë çështje e kompetencës së përgjithshme territoriale, atëherë gjyqtari i çështjes mund të marrë aktvendim me të cilin gjykatën e shpallë jo kompetente vetëm pas prapësimit të palës së paditur dhe atë më së voni deri në seancën përgatitore e në rast se nuk mbahet seanca përgatitore deri në seancën e shqyrtimit kryesor. Nëse tërhiqet propozimi konsiderohet se nuk është paraqitur fare.

Në rastet e përcaktuara me Ligjin për Procedurën Kontestimore, për procedimin e çështjes është kompetente, përpos gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale edhe gjykata tjetër e caktuar, e cila ndërlidhet më kriteret për caktimin e kompetencës së veçantë.

2.6.3 Kompetenca e veçantë territoriale

Për gjykimin e disa kontesteve të caktuara LPK-ja, e përjashton kompetencën e përgjithshme territoriale, sipas vendbanimi apo vendqëndrimit (*përkatësish selisë së personit juridik*) të t’paditurit, duke përcaktuar si kompetente gjykatë tjetër.

- *E çfarë llojit mund të jetë kompetenca e veçantë territoriale?*

Kompetenca e veçantë territoriale mund të jetë:

- territoriale ekskluzive,

- territoriale e zgjedhur dhe
- territoriale ndihmëse

2.6.3.1 Kompetenca territoriale ekskluzive

Kompetenca territoriale ekskluzive e përjashton kompetencën e përgjithshme territoriale dhe asnjë gjykatë tjetër nuk mund të gjykojë në kontestet e tilla.

- *Në cilat raste vjen në shprehje kompetenca territoriale ekskluzive?*

a) Kompetenca në kontestet lidhur me sendet e paluajtshme;

- Kontestet lidhur me pronësinë dhe të drejtat sendore mbi sendet e paluajtshme,
- Kontestet për shkak të pengim posedimit mbi sendet e paluajtshme, dhe
- Kontestet nga raportet e qiradhënies së paluajtshmërisë, ose nga kontratat për shfrytëzimin e banesave apo të lokaleve të punës.

b) Kompetenca në kontestet lidhur me mjete e fluturimit,

- Kontestet lidhur me të drejtën e pronësisë apo të drejtave sendore të tjera mbi mjetin e fluturimit,
- Kontestet nga raporti i qiradhënies së mjetit të fluturimit.

c) Kompetenca për kontestet në procedurën përmbarese dhe të falimentimit;

- Kontestet që lidin gjatë dhe lidhur me procedurën e përmbarimit gjyqësor dhe administrativ, gjegjësisht gjatë dhe lidhur me procedurën e falimentimit, në pikëpamje territoriale është ekskluzivisht kompetente vetëm gjykata në territorin e së cilës ndodhet gjykata, e cila është duke e zhvilluar procedurën përmbarese apo të falimentimit, gjegjësisht gjykata në territorin e së cilës është duke e kryer përmbarimin administrativ.

Rastet kur vjen në shprehje kompetenca territoriale ekskluzive e gjykatës janë përcaktuar me nenin 41, 42 dhe 43 të LPK-së:

Nëse ndonjëri prej këtyre rasteve paraqitet si objekt shqyrtimi para gjykatës e cila nuk ka kompetencë territoriale ekskluzive, atëherë gjyqtari i çështjes sipas detyrës zyrtare pa prapësimin e palës merr aktvendim me të cilin gjykatën e shpallë jo kompetente dhe lëndën ja dërgon gjykatës për të cilën mendon së është kompetente.

2.6.3.2 Kompetenca territoriale e zgjedhur

Në rastet e kompetencës territoriale të zgjedhur, pala paditëse mund të zgjedh se ku dëshiron të paraqes padinë dhe atë në gjykatën e kompetencës së përgjithshme tokësore ose ndonjë gjykatë tjetër që mund të jetë kompetente sipas kompetencës tokësore të zgjedhur.

-*Në cilat raste vjen në shprehje kompetenca territoriale e zgjedhur?*

a) Kompetenca territoriale e zgjedhur në kontestet martesore

- konstatimi i ekzistimit dhe mosekzistimit të martesës,
- anulimi i martesës dhe zgjidhja e martesës,

Në këto dy raste pala paditëse ka të drejtë të zgjedhë se a do ta paraqes[padinë në gjykatën e cila është e kompetencës së përgjithshme territoriale apo në gjykatën ku palët kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët.

b) Kompetenca në kontestet për vërtetimin apo kundërshtimin e atësisë apo amësisë

Në kontestet e tilla kur palë paditëse është fëmija, atëherë fëmija ka të drejtë që të paraqesë padi ose në gjykatën e kompetencës së përgjithshme ose në gjykatën, në territorin e së cilës paditësi e ka vendbanimin ose vendqëndrimin.

Ky rregull për kompetencën e zgjedhur vlen vetëm në qoftë së fëmija është palë paditëse, ndërsa në qoftë se palë paditëse është i ati ose e ëma atëherë vlejné rregullat e kompetencës së përgjithshme.

c) Kompetenca në kontestet për ushqimin ligjor

Në kontestet e tilla paditësi që kërkon alimentacion ka të drejtë që padinë ta paraqesë përveç në gjykatën e kompetencës së përgjithshme edhe në gjykatën ku paditësi e ka vendbanimin gjegjësisht vendqëndrimin.

d) Kompetenca në kontestet për shpërblimin e dëmit

Edhe te ky rast i kompetencës pala paditëse ka mundësi që ta zgjedhë kompetencën tokësore duke ju drejtuar gjykatës së kompetencës së përgjithshme apo gjykatës tjetër kompetente.

Lidhur me këtë kompetencë paraqiten dy situata:

Situata e parë: i referohet kontesteve lidhur me përgjegjësinë jokontraktuale për dëmin nga e cila rrjedh se përveç gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale, kompetente është edhe gjykata në territorin e së cilës është kryer veprimi dëmtues apo gjykata në territorin e së cilës ka lindur pasoja e dëmit.

Situata e dytë: i referohet kontesteve kur dëmi është shkaktuar për shkak të vdekjes apo lëndimit të rëndë trupor nga e cila rrjedh se përveç kompetencës si në situatën e parë kompetente është edhe gjykata në territorin e së cilës paditësi ka vendbanimin respektivisht vendqëndrimin.

Këto rregulla vlejné për rastet e auto-përgjegjësisë:

Përshkrimi praktik i situatës së parë:

Subjekti X me vendbanim nga Prishtina përderisa lëvizë me veturën e tij në qytetin e Pejës, rruga "Haxhi Zeka", për shkak të pakujdesisë del nga rruga duke u përplasur në murin e jashtëm të shtëpisë së subjektit Y, me ç'rast subjektit Y i shkaktohet dëm material.

Në këtë rast subjekti Y, në cilësinë e paditësit, ka mundësi që të zgjedhë nëse padinë do ta paraqesë para gjykatës së kompetencës së përgjithshme në Prishtinë (sipas vendbanimit të të paditurit) apo para gjykatës së zgjedhur në Pejë (sipas vendit ku është kryer veprimi dëmtues).

Përshkrimi praktik i situatës së dytë:

Subjekti X, me vendbanim në Prishtinë, përderisa lëvizë me veturën e tij në qytetin e Prizrenit, rruga “Lidhja e Prizrenit”, për shkak të shpejtësisë së madhe humb kontrollin mbi veturë dhe përplasët me një shtyllë elektrike ku si pasojë e përplasjes vije deri të lëndimi i rëndë i bashkudhëtarit Y i cili është me vendbanim nga Gjilani.

Në këtë rast subjekti Y, në cilësinë e paditësit, ka mundësi që të zgjedhë nëse padinë do ta paraqesë para gjykatës së kompetencës së përgjithshme në Prishtinë (sipas vendbanimit të të paditurit), para gjykatës së zgjedhur në Prizren (sipas vendit ku është kryer veprimi dëmtues), apo para gjykatës tjetër të zgjedhur në Gjilan (sipas vendbanimit të palës paditëse).

e) Kompetenca në kontestet për mbrojtjen e së drejtës në bazë të garancisë së prodhuesit

Për gjykim në konteste të tilla përveç gjykatës së kompetencës së përgjithshme (selia e të paditurit) është kompetente edhe gjykata me kompetencë territoriale për shitësin (vendi ku është shitur sendi), kur rasti ka të bëjë me garancinë shkresore.

Rast praktik i situatës që ka të bëjë me këtë kompetencë:

Subjekti X, me seli në Gjilan merret me prodhimin e radiatorëve të cilët kanë garancion pesë vjeçar. Radiatorët e prodhuar në Gjilan janë shitur nga kompania Y, në Gjakovë e të cilët i ka blerë kompania Z sipas garancionit të prodhuesit X. Pas vendosjes së radiatorëve në punë ka rezultuar se të njëjtit kanë të meta pasi që e rrjedhin ujin.

Në këtë rast subjekti Z (blerësi), në cilësinë e paditësit, ka mundësi që të zgjedhë nëse padinë do ta paraqesë para gjykatës së kompetencës së përgjithshme në Gjilan (sipas selisë së të paditurit) apo para gjykatës së zgjedhur në Gjakovë (sipas vendit ku është shitur sendi).

f) Kompetenca në kontestet nga marrëdhënia e punës

Për gjykim në kontestet e tilla kur paditës është punëtori, përpos gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale për të paditurin, kompetente është edhe gjykata në territorin e së cilës kryhet puna ose është kryer, respektivisht gjykata në territorin e së cilës puna është dashur të kryhet, si dhe gjykata në territorin e së cilës është themeluar marrëdhënia e punës.

Rast praktik i situatës që ka të bëjë me këtë kompetencë:

Subjekti X nga Peja, është punësuar në ndërmarrjen publike KEK-Prishtinë, mirëpo marrëdhënien e punës e ka themeluar në distriktin e Pejës të kësaj ndërmarrje, ndërsa detyrat e punës si instalues i njehsorëve elektrikë i kryen në territorin e Komunës së Klinës. Subjektit X i është ndërprerë marrëdhënia e punës nga punëdhënësi për shkak të përformancës së dobët.

Në këtë rast subjekti X për mbrojtjen e të drejtave të tij nga marrëdhënia e punës në cilësinë e paditësit, ka mundësi që të zgjedhë nëse padinë do ta paraqesë para gjykatës së kompetencës së përgjithshme në Prishtinë, (sipas selisë së të paditurës), para gjykatës së zgjedhur në Pejë (sipas vendit ku ka themeluar marrëdhënien e punës) apo në Klinë (sipas vendit ku ka kryer punët).

g) Kompetenca sipas vendit të pagesës

Paditësi si posedues i kambialit ose çekut mund të vendos nëse dëshiron që për konteste lidhur me kambialin ose çekun të paraqes padi në gjykatën e kompetencës së përgjithshme tokësore për nënshkruesin ose në gjykatën në territorin e së cilës duhet të bëhet pagesa nga kambiali dhe çeku.

Rast praktik i situatës që ka të bëjë me këtë kompetencë:

Subjekti X, është posedues i kambialit apo çekut të lëshuar nga subjekti Y me seli në Prishtinë, si nënshkrues i kambialit apo çekut, ndërsa në kambial apo çek është shënuar vendi i pagesës Gjilan. Nëse vije deri të mos realizimi i pagesës, në këtë rast subjekti X si posedues i kambialit apo çekut, ka të drejtë të paraqes padinë kundër nënshkruesit të kambialit apo çekut-subjektit Y dhe atë në gjykatën e kompetencës së përgjithshme në Prishtinë, (selia e të paditurit) apo në gjykatën e zgjedhur në Gjilan (vendi i pagesës).

h) Kompetenca sipas vendit ku ndodhet njësia e personit juridik

Në kontestet kundër personit juridik paditësi ka të drejtën e paraqitjes së padisë në gjykatën e kompetencës së përgjithshme tokësore ose në gjykatën, në territorin e secilës ndodhet njësia e personit juridik.

Rast praktik i situatës që ka të bëjë me këtë kompetencë:

Subjekti X, nga Mitrovica, ka lidhur kontratë me Postën dhe Telekomin e Kosovës Prishtinë- (PTK), njësia në Mitrovicë që PTK të shpërndajë rrjetin kabllor në objektin e subjektit X i cili gjendet në Mitrovicë, ku sipas kontratës parashihet se shpërndarja e rrjetit kabllor për internet duhet të përfundojë brenda një muaji nga dita e nënshkrimit të kontratës, në të kundërtën për çdo ditë vonese është kontraktuar kushti penal 0.001 % të vlerës së kontratës. PTK është vonuar pa fajin e subjekti X, në kohëzgjatje prej 10 ditësh. Në këtë rast subjekti X ka të drejtë të paraqesë padinë kundër PTK-së, në gjykatën e kompetencës së përgjithshme në Prishtinë, (selia e të paditurës) apo në gjykatën e zgjedhur në Mitrovicë (vendi ku gjendet njësia e të paditurës).

i) Kompetenca në konteste për shkak të pengim-posedimit mbi sendin e luajtshëm

Në këtë rast paditësi si person i penguar në posedimin e fundit të sendit të luajtshëm, mund të zgjedhë që padinë ta paraqes në gjykatën e kompetencës tokësore të përgjithshme ose në gjykatën, në territorin e së cilës është bërë pengimi.

Rast praktik i situatës që ka të bëjë me këtë kompetencë:

Subjekti X, nga Prishtina, në territorin e komunës së Gjilanit, subjektit Y ja ka marrë automjetin e markës Audi, tipi 80, të cilin e ka pasur në posedim deri në atë kohë. Në këtë rast subjekti Y ka drejtë të paraqesë padinë kundër X, në gjykatën e kompetencës së përgjithshme në Prishtinë, (vendbanimi apo vendqëndrimi i të paditurit) apo në gjykatën e zgjedhur në Gjilan (vendi ku ka ndodhur pengimi i posedimit).

j) Kompetenca në konteste nga marrëdhëniet kontraktuese

Në kontestet lidhur me:

- ekzistimin ose mosekzistimin e kontratës;
- me përmbushjen ose zgjidhjen e kontratës;
- lidhur me zhdëmtimet e shkaktuara nga mos përmbushja e kontratës.

Në raste të tilla paditësi mundë të zgjedhë që padinë ta paraqesë në gjykatën e kompetencës së përgjithshme tokësore apo në gjykatën në territorin e të cilës pala e paditur ka marrë për obligim që ta përmbush prestimin në bazë të kontratës.

Rast praktik i situatës që ka të bëjë me këtë kompetencë:

Subjekti X, nga Prishtina ka lidhur kontratë me subjektin Y nga Prishtina, sipas të cilës subjekti Y për llogari të subjektit X do të bëjë çmontimin e pajisjeve për përpunimin e zhavorrit nga lokacioni i njohur me emrin “Kulla në Ferizaj” dhe të njëjtat pajisje duhet t’i montojë në lokacionin tjetër të njohur me emrin “Kodra” në Ferizaj.

Subjekti Y ka dështuar në përmbushjen e kontratës.

Në këtë rast subjekti X ka të drejtë që për përmbushjen e kontratës të paraqesë padi në gjykatën e kompetencës së përgjithshme në Prishtinë, (vendbanimi apo vendqëndrimi i të paditurit) apo në gjykatën e zgjedhur në Ferizaj (vendi i përmbushjes së kontratës).

k) Kompetenca në konteste nga marrëdhëniet trashëgimore - juridike

Në konteste të tilla paditësi ka të drejtë të paraqesë padinë përveç gjykatës së kompetencës së përgjithshme tokësore edhe në territorin e gjykatës që zbaton procedurën trashëgimore.

Në rastet e tilla padia rëndom do duhej të paraqitet para gjykatës e cila është me kompetencë të përgjithshme territoriale, mirëpo dispozita e nenit 54 të LPK-së, lejon mundësinë që padia të paraqitet edhe në territorin e gjykatës e cila zbaton procedurën trashëgimore. Janë të mundshme situatat kur kontesti mund të iniciohet edhe para gjykatës e cila nuk është e kompetencës së përgjithshme territoriale por është gjykatë e zgjedhur pasi që sipas dispozitës së nenit 128.2 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore (LPJK) parashihet mundësia që në rastin kur trashëgimlënësi në momentin e vdekjes nuk ka pasur vendbanim e as vendqëndrim të territorin e Kosovës, si kompetente territoriale për shqyrtimin e trashëgimisë të jetë gjykata ku gjendet pasuria trashëgimore e tij.

Rast praktik i situatës që ka të bëjë me këtë kompetencë:

Në qoftë se subjekti X ka vdekur në Francë dhe i njëjti ka masë trashëgimore në Kosovë por nuk ka vendbanim e as vendqëndrim në Kosovë, atëherë procedura e shqyrtimit të trashëgimisë mund të fillojë në territorin e gjykatës ku gjendet masa trashëgimore. Deri sa nuk përfundon me vendim të formës së prerë procedura e trashëgimisë e iniciuar para gjykatës ku gjendet masa trashëgimore, për gjykim në konteste nga marrëdhënia trashëgimore si dhe në kontestet lidhur me kërkesat e kreditorëve ndaj trashëgimlënësve përpos gjykatës me kompetencë të përgjithshme (vendbanimi apo vendqëndrimi i trashëgimlënësit - Francë) është kompetente edhe gjykata në territorin e së cilës ndodhet gjykata që zbaton procedurën trashëgimore-Kosovë.

2.6.4 Kompetenca territoriale ndihmëse

Nëse lidhur me çështjen që do të paraqitet para gjykatës nuk gjejmë zgjidhje se cila gjykatë do të jetë kompetente sipas dispozitave që rregullojnë kompetencën tokësore të përgjithshme, ekskluzive dhe të zgjedhur atëherë vijnë në shprehje dispozitat që kanë të bëjnë me kompetencën

territoriale ndihmëse që i mundësojnë palës paditëse realizimin e të drejtës në mënyrë më të lehtë.

- Në cilat raste vjen në shprehje kompetenca territoriale ndihmëse?

a) kompetenca territoriale ndihmëse për bashkë-ndërgjyqësit

Në rastet kur në cilësinë e palës së paditur paraqitën disa bashkë-ndërgjyqës, kompetenca tokësore e lidhur më njërën palë të paditur vlen për të gjitha palët tjera të paditura, që paraqitën në cilësinë e bashkë-ndërgjyqësve.

Rregullat e kësaj kompetence gjejnë zbatim vetëm për bashkë-ndërgjyqësit pasiv, kur paraqiten si të paditur.

Rast praktik i situatës që ka të bëjë me këtë kompetencë:

Subjekti X ka një ordinancë stomatologjike në Prishtinë dhe nga puna e stomatologut ka realizuar të hyra mujore në shumë prej 5000 Euro. Subjektet Y dhe Z me veprimet e tyre të përbashkëta kanë përhapur të dhëna të rrejshme për veprimtarinë e subjektit X gjoja se i njëjti nuk është i kualifikuar për punën që bënë dhe për shkak të këtyre të dhënave të rrejshme, subjektit X i është zvogëluar puna, ashtu që tani realizon vetëm 1000 Euro të hyra mujore. Subjekti Y e ka vendbanimin në Ferizaj ndërsa subjekti Z e ka vendbanimin në Gjilan. Në këtë rast për shkak të cilësisë së bashkë ndërgjyqësve pasiv që kanë të paditurit, subjekti Y dhe Z, atëherë paditësi, subjekti X mundet që padinë ta paraqes qoftë në gjykatën Themelore në Ferizaj ose në gjykatën Themelore në Gjilan.

b) kompetenca territoriale ndihmëse në kontestet martesore

Në këto konteste kompetenca ndihmëse vjen në shprehje ngase përveç kompetencës së përgjithshme territoriale (ku i padituri e ka vendbanimin përkatësisht vendqëndrimin në Kosovë), kompetencës së zgjedhur (ku palët e kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët përkatësisht vendqëndrimin në Kosovë), vjen në shprehje kompetenca ndihmëse e cila përcakton mundësinë që pala paditëse ta paraqesë padinë në vendin ku e njëjta e ka vendbanimin.

c) kompetenca territoriale ndihmëse në kontestet e raporteve pasurore-juridike të bashkëshortëve

Në konteste të natyrës së tillë kompetenca tokësore ndihmëse vjen në shprehje pasi që padia mund të paraqitet në territorin e Kosovës përkatësisht në gjykatën në territorin e së cilës pala paditëse e ka vendbanimin ose vendqëndrimin në kohën e paraqitjes së padisë edhe nga shkakut së pasuria e bashkëshortëve ndodhet në Kosovë.

d) kompetenca territoriale ndihmëse në kontestet për vërtetimin apo kundërshtimin e amësisë apo atësisë

Kjo kompetencë i referohet kontesteve me element të huaj por që kompetente është gjykata e vendit tonë, për shkak se pala paditëse e ka vendbanimin ose vendqëndrimin në Kosovë në momentin e ngritjes së padisë, ndërsa kompetenca brenda vendit tonë përcaktohet sipas kriterit se ku paditësi e ka vendbanimin (në territorin e cilës gjykatë brenda Kosovës).

e) kompetenca territoriale ndihmëse në kontestet për ushqim ligjor

Kjo kompetencë i referohet kontesteve me element të huaj por që kompetente është gjykata e vendit tonë, për shkak se pala paditëse e ka vendbanimin ose vendqëndrimin në Kosovë në momentin e ngritjes së padisë, ndërsa kompetenca brenda vendit tonë përcaktohet sipas kriterit se ku paditësi e ka vendbanimin (në territorin e cilës gjykatë brenda Kosovës).

Po që se kjo kompetencë është e gjykatës së vendit tonë nga shkak se i padituri e ka pasurinë në Kosovë, nga e cila mund të realizohet ushqimi ligjor, atëherë kompetenca brenda vendit tonë përcaktohet sipas kriterit se ku ndodhet pasuria e të paditurit nga e cila mund të realizohet ushqimi ligjor.

f) kompetenca territoriale ndihmëse për personat për të cilët në Kosovë nuk ekziston gjykata e kompetencës territoriale

Në qoftë se kjo kompetencë i referohet kërkesave pasurore juridike kundër personit, për të cilin nuk mund të përcaktohet kompetenca ndërkombëtare e vendit tonë, kompetente është gjykata në territorin e së cilës ndodhet çfarëdo pasurie e palës së paditur apo sendi që kërkohet me padi.

Në qoftë se kjo kompetencë i referohet shkakut se detyrimi është krijuar gjatë qëndrimit të palës së paditur në Kosovë, atëherë është kompetente gjykata në territorin e së cilës është krijuar detyrimi.

Në qoftë se kjo kompetencë i referohet vendit të përmbushjes, atëherë kompetente do të jetë gjykata në territorin e së cilës detyrimi do të përmbushet.

g) kompetenca territoriale ndihmëse sipas vendit ku ndodhet përfaqësia e personit juridik

Për të vendosur lidhur me kontestet kundër personave fizikë apo edhe juridik, të cilët e kanë vendbanimin respektivisht selinë jashtë territorit të Republikës së Kosovës, por detyrimet janë krijuar apo duhet të përmbushen në Kosovë, atëherë kompetente do të jetë gjykata në territorin e së cilës ndodhet përfaqësia e këtij personi të huaj juridik apo qendra e ndonjë organi të këtij personi juridik, organ të cilit i është besuar kryerja e punëve të tij.

Kjo kompetencë përveç se është ndihmëse, është e karakterit subsidiar që do të thotë se mund të aplikohet vetëm në qoftë se për subjektin e cekur më lartë nuk mund të themelohet kompetenca sipas cilësdo kompetencë të veçantë.

2.6.5 Caktimi i kompetencës territoriale nga gjykata e lartë

Caktimi i kompetencës të një gjykate nga ana e një gjykate më të lartë ose nga ana e gjykatës supreme realizohet përmes institucioni të delegimit dhe ordinimit.

- **Delegimi i domosdoshëm i kompetencës**

Në praktikë mund të paraqiten raste kur gjykata kompetente për shkak të përjashtimit të gjyqtarëve apo për shkaqe tjera nuk mund të procedoj me çështjen. Në këto raste gjykata e cila nuk mund të procedojë me çështjen duhet ta njoftojë gjykatën e shkallës më të lartë me qëllim që

e njëjta të caktojë gjykatë tjetër nga territori i vet, por që është e kompetencës lëndore për çështjen konkrete.

Rastet më të shpeshta praktike të delegimit të domosdoshëm të kompetencës:

- a) kur kryetari i gjykatës apo ndonjë gjyqtar është palë në procedurë,
- b) kur ndonjë punëtorë i gjykatës është palë në procedurë,
- c) kur gjyqtarët për shkak të përfshirjes në procedura tjera nuk u lejohet të marrin pjesë në gjykimin e çështjes, (gjyqtari që ka marrë pjesë në pajtimin gjyqësor me të cilin ka përfunduar procedura, nuk mund të vendos sipas padisë për anulimin e pajtimit gjyqësor dhe nëse nuk ka gjyqtar tjerë atëherë lënda dërgohet për delegim) etj.

Në këto raste por edhe në raste tjera të mundshme gjyqtari i çështjes duhet që përmes kryetarit të gjykatës të kërkojë nga gjykata më e lartë delegimin e lëndës.

Pasi që lënda t'i dërgohet gjykatës më të lartë për delegim, kryetari i gjykatës me të lartë (për gjykatat themelore vendos Gjykata e Apelit – Kryetari i Gjykatës së Apelit) me aktvendim vendos për delegimin e lëndës tek gjykata tjetër kompetente.

• **Delegimi i arsyeshëm**

Përveç rasteve të cekura te delegimi i domosdoshëm mund të paraqiten rrethana të cilat bëjnë që shqyrtimi i çështjes nga një gjykatë tjetër të ishte shumë më i lehtë dhe më efikas.

Si rrethana të cilat e bëjnë një gjykatë tjetër më efikase për shqyrtimin e çështjes mund të jenë: kur provat ose shumica e provave gjenden në territorin e gjykatës ku delegohet çështja, p.sh. këqyrja e drejtpërdrejtë e objektit nga gjykata të cilës i është deleguar çështja.

Kur paraqiten arsyet apo rrethanat për delegim të arsyeshëm, propozimin për delegim të arsyeshëm mund ta paraqet pala apo gjykata kompetente. Për të vendosur sipas propozimit të palës apo edhe të vet gjykatës kompetente, kompetente është vetëm Gjykata Supreme e Kosovës.

Delegimi i një çështje juridike prej një gjykate kompetente në ndonjë gjykatë tjetër mund të bëhet vetëm në pikëpamje të kompetencës tokësore dhe jo në aspektin lëndorë. Sipas kësaj nuk mund të bëhet bartja e lëndës nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin për Çështje Administrative apo në atë për Çështje Ekonomike.

• **Ordinimi**

Koncepti i ordinimit vjen në shprehje dhe është i lejueshëm vetëm në rastet kur dihet me saktësi se gjykata e vendit tonë është kompetente në pikëpamje lëndore por nuk dihet se cila gjykatë është kompetente në pikëpamje tokësore.

Procedura për ordinimin vihet në lëvizje në bazë të kërkesës së palës paditëse. Kompetent për të paraqitur këtë kërkesë është vetëm pala paditëse, që mund të jetë edhe prokurori i shtetit.

Gjykata Supreme pasi që t'i vlerësoj rrethanat e paraqitura në kërkesën për ordinim dhe ato sipas detyrës zyrtare, me anë të aktvendimit vendos që ta caktojë gjykatën kompetente në pikëpamje territoriale për të vendosur.

2.6.6 Marrëveshja mbi kompetencën territoriale

Palët mund të merren vesh që çështjen e tyre juridike ta gjykojë gjykata, e cila sipas rregullave ligjore për kompetencën tokësore nuk do të ishte kompetente për një gjë të tillë. Palët mund të merren vesh vetëm për kompetencën territoriale të gjykatës dhe asnjëherë për kompetencën lëndore të gjykatës.

Rastet kur palët mund ta kontraktjnë kompetencën

- a) kompetenca mund të kontraktohet vetëm në pikëpamje territoriale,
- b) për çështjet që nuk janë kompetencë ekskluzive e një gjykate tjetër,
- c) për çështjet që kompetente janë dy gjykata territoriale të vendit tonë.
- d) gjykata për të cilën kontraktohet kompetenca duhet të jetë kompetente lëndore.

Kushtet për kontraktim të kompetencës

- a) marrëveshja e vlefshme e palëve
- b) marrëveshja t'i bashkëngjitet padisë

2.6.7 Konflikti në lidhje me kompetencën

Paraqitet në rastet kur gjykata së cilës i është dërguar lënda për vendosje konsideron se nuk është kompetente për të vepruar sipas saj, por që është kompetente për të vepruar gjykata e cila ja ka dërguar lëndën ose ndonjë gjykatë tjetër.

Në këtë rast gjykata të cilës i është dërguar lënda, pa dhënë aktvendim për in-kompetencën e saj, nxjerr aktvendim me të cilin e hap konfliktin e kompetencës, dhe në afatin brenda tri ditësh ja dërgon lëndën gjykatës më të lartë në mënyrë që ajo të vendosë lidhur me konfliktin e kompetencës.

Nga praktika:

Në qoftë së konflikti i kompetencës ka lindur në mes të dy gjykatave themelore apo degëve të këtyre gjykatave, atëherë lënda i dërgohet gjykatës së Apelit si gjykata me e lartë për të dy gjykata, ndërsa në qoftë së konflikti është hapur në mes të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit, atëherë lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës si gjykata me e lartë për të dy gjykatat. Në praktik shumë rrallë mund të ndodhë që të hapët konflikti i kompetencës në mes të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë pasi që me riorganizimin e sistemit gjyqësor është e qartë së gjykatat e shkallës së parë i shqyrtojnë të gjitha çështjet në shkallë të parë ndërsa në gjykata e Apelit, çështjet dërgohen sipas mjeteve të goditjes.

- **Mundësia e gjykatës që të mos kërkojë që të vendoset lidhur me konfliktin e kompetencës**

Në rastin kur ka ndodhë ndonjë gabim i hapur nga gjykata e parë për kompetencën (kjo vjen në shprehje të rastet e kompetencës territoriale ekskluzive), ku qartazi shihet se kompetente do të ishte ndonjë gjykatë tjetër.

Në vazhdim do të paraqitet një rast praktik kur gjykata ka mundësi që ta rikthejë lëndën te gjykata e shkallës së parë apo te gjykata tjetër pa hapur konflikt për kompetencë.

Rast praktik i një situatë të tillë:

Nëse Gjykata Themelore në Prishtinë ja ka dërguar lëndën Gjykatës Themelore në Pejë, edhe pse kompetente do të ishte Gjykata Themelore në Prizren, për shkak se kontesti ka të bëjë me paluajtshmërinë që gjendet në territorin e kësaj gjykate, atëherë Gjykata Themelore e Pejës, mundet lëndën t'ia kthejë Gjykatës Themelore në Prishtinë, pa hapur konflikt të kompetencës pasi që ta vërejë se Gjykata Themelore e Prishtinës, gabimisht e ka dërguar lëndën në Gjykatën Themelore në Pejë.

- **Veprimi obligativ i vendimit të gjykatës së shkallës së dytë lidhur me kompetencën**

Nëse pala ka bërë ankesë kundër aktvendimit të gjykatës e cila është shpallë jo-kompetente në pikëpamje tokësore dhe lëndën ja ka dërguar gjykatës kompetente dhe nëse ky vendim bëhet i formës së prerë për shkak se është vërtetuar me vendimin e shkallës më të lartë, atëherë vendimi i gjykatës së shkallës së lartë e obligon edhe gjykatën e dytë të e cila është dërguar lënda nga gjykata e parë.

Kur gjykata nxjerr vendim lidhur me inkompetencën lëndore dhe pala ka bërë ankesë kundër atij vendimi, nëse gjykata kompetente lidhur me konfliktin e kompetencës e refuzon ankesën e palës dhe e vërteton aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, atëherë ky aktvendim i gjykatës së shkallës së parë lidhur me konfliktin për kompetencën i obligon të gjitha gjykatat.

- **Zgjidhja e konfliktit për kompetencën**

Në praktikë ndodhë që konflikti për kompetencën të lindë në atë mënyrë kur dy gjykata pretendojnë se janë kompetente lidhur me shqyrtimin e një çështje kryesore (ky konflikt në shkencën juridike njihet si konflikti pozitiv) ose nëse gjykatat pretendojnë se nuk janë kompetente për zgjidhjen e një çështje konkrete (si konflikti negativ).

- a. Lindja e konfliktit të kompetencës në mes të gjykatave të llojit të njëjtë

Në rast se lindë konflikti lidhur me kompetencën në mes të gjykatave të llojit të njëjtë atëherë kompetente për të vendosur lidhur me këtë është gjykata më e lartë dhe e përbashkët për gjykatat në konflikt.

Nga praktika:

Në mes të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës Themelore në Ferizaj, atëherë për konfliktin e kompetencës do të vendos Gjykata e Apelit si gjykatë më e lartë për të dy gjykatat.

Në rast të lindjes së konfliktit lidhur me kompetencën në mes të gjykatave themelore, kompetent për të vendosur lidhur me këtë do të jetë Gjykata e Apelit. Në të njëjtën mënyrë do të veprohet edhe në rastet e konfliktit të kompetencës në mes të departamenteve të të njëjtës Gjykatë.

b. Lindja e konfliktit të kompetencës në mes të gjykatave të llojit të ndryshëm

Nëse konflikti i kompetencës lindë në mes të gjykatave të llojit të ndryshëm, kompetent për të vendosur lidhur me zgjidhjen e këtij konflikti është Gjykata Supreme e Kosovës.

Një situatë e tillë do të vije në shprehje nëse lindë konflikti për kompetencën në mes të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore.

Duhet të kihet parasysh se deri sa është i hapur konflikti lidhur me kompetencën, gjykata e cila e ka pranuar lëndën nga gjykata e parë duhet të ndërmer veprimet e duhura procedurale, nëse ato janë të ngutshme dhe nëse në rast të mosndërmarrjes së këtyre veprimeve procedurale do të shkaktoheshin dëme të pa riparueshme për palët. Një rast i tillë mund të vije në shprehje të çështja e sigurimit të provës, nga e cila provë varet zgjidhja e kontestit ose sqarimi i tij, kur ka rrezik që të zhduket ose të vështirësohet marrja e saj.

Gjykata kompetente për të vendosur lidhur me konfliktin për kompetencën ka mundësi që të vendos pa shqyrtim gojor të çështjes, pra mund të vendos për konfliktin e kompetencës edhe nëse palët fare nuk janë deklaruar lidhur me kompetencën.

Kundër aktvendimit me të cilin vendoset për konfliktin për kompetencën nuk lejohet përdorimi i mjeteve juridike të rregullta apo të jashtëzakonshme.

2.7 Përmbledhje

Në këtë sesion është elaboruar korniza e përgjithshme ligjore që i referohet të gjitha llojeve të kompetencës dhe janë paraqitur në mënyrë specifike secili lloj i kompetencës. Përveç kësaj janë dhen shpjegime se si duhet të vlerësohet dhe veprohet nga ana e gjykatës. Në këtë sesion janë paraqitur shembuj të shumet përmes të cilëve është synuar që të materializohen njohurit teorike më pjesën praktike.

3. Përbërja e rregullt e gjykatës dhe përjashtimi i gjyqtarit

3.1 Hyrje

Në këtë sesion janë prezantuar rregullat mbi përbërjen e gjykatës dhe pasojat në rast të mos përbërje së rregullt të gjykatës. Gjithashtu është trajtuara edhe pjesa e procedurës lidhur me përjashtimin e gjyqtarit duke përfshirë shkaqet për përjashtimin e gjyqtarit, procedurën për përjashtimin e gjyqtarit dhe pasojat në rast të mos përjashtimit kur kanë ekzistuar rrethanat për përjashtim. Ky sesion trajton çështje mjaft të rëndësishëm sepse përjashtimi i gjyqtarit nga gjykimi përfaqëson garancionin e ruajtjes së paanësisë.

3.2. Objektivat trajnues

Pas përfundimit të këtij moduli pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbatojnë rregullat për përbërjen e rregullt të gjykatës;
- Njohin shkaqet për përjashtimin e gjyqtarit;
- Njohin procedurën dhe veprimet që duhet të ndërmerren nëse paraqitet situata kur gjyqtari duhet të përjashtohet;
- Ruajnë paanësinë në çdo çështje për të cilën mund të krijohet perceptimi i anshmërisë së gjykatës duke u përjashtuar nga rasti.

3.3 Përbërja e rregullt e gjykatës (kompetenca funksionale)

Më përbërje të gjykatës kuptojmë përbërjen në të cilën ajo gjykon, që domethënë vendos për themelin e kërkesëpadisë, apo për mjetin e goditjes së vendimit gjyqësor.

Përbërjen e gjykatës shkallë së parë, të dytë dhe të tretë, për çështje civile përcaktohet me dispozita e Ligjit për Gjykata, Ligjit për Procedurën Kontestimore, Ligjit për Përmbartimore dhe Ligjit për Familjen.

Përbërja e gjykatës në shkallë të parë:

Në procedurën e shkallës së parë dhe në procedurën sipas propozimit për përsëritjen e procedurës, vendos gjyqtari individual (i vetëm).

Në procedurën e shkallës së në kontesteve martesore dhe në konteste e ushqimisë e zhvillon dhe i merr vendimit kolegji i përbërë prej një gjyqtari dhe dy gjyqtarëve porotë, kurse në shkallë e dytë kolegji prej tre gjyqtarëve.

Përbërja e gjykatës në shkallë të dytë:

Në procedurën e shkallë së dytë dhe procedurën sipas revizionit vepron trupi gjykues prej tre gjykatësve.

Përbërja e gjykatës në shkallë të tretë:

Gjykata Supreme shqyrton dhe gjykon lëndët në kolegji me nga tre (3) gjyqtar profesionist, me përjashtim kur me ligj parashihet një numër me i madh i gjyqtarëve.

3.4 Përjashtimi dhe rekuizimi i gjyqtarit nga gjykimi

Me dispozitën e 7 paragrafi 1, i Ligjit për Gjykata parashihte se: “Gjykata trajtojnë të gjithë personat në mënyrë të barabartë, askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal”. Megjithatë, pavarësisht këtij detyrimi të gjykatës, eksitojnë situata praktike kur mund të vije në pikëpyetje pavarësisë, paanësia, objektiviteti dhe besimi i publikut në gjykatë, për shkak të rrethanave që mund ta ndikojnë gjyqtarin apo që mund të krijojnë përshtypjen së gjyqtari është i ndikuar apo i njëanshme.

Më qëllim që të sigurohet sidomos paanësia e gjykatës LPK ka rregulluar çështjen e përjashtimit të gjyqtarit apo të rekuizimit të gjyqtarit nga gjykimi.

Përveç dispozitave të LPK-së, për përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi, një rendësi jashtëzakonisht të madhe për sigurimin e paanësisë së gjykatës e ka edhe Kodi i Etikës Profesionale për Gjyqtar dhe Rregullorja për Përcaktimin e Sjelljeve të Pahijshme.

Kodi i Etikës Profesionale për Gjyqtar, me dispozitën e nenit 2, përcakton se: “Gjyqtari gjatë ushtrimit të funksionit të tij i trajton të gjitha palët në procedurë në mënyrë të barabartë pa favorizime, anime dhe paragjykime. Gjatë gjithë kohës gjyqtari duhet të jetë dhe duhet të duke i paanshëm. Paanshmëria ka të bëjë jo vetëm më vendimin, por edhe në procedurën e marrjes së vendimit”. Ndërsa me dispozitën e nenit 2.5 përcaktohet se: “Gjyqtari do të kërkojë përjashtimin e tij nëse të publiku mund të krijojë përshtypjen, ose kur e vlerëson vetë, se nuk është në gjendje të vendos në lidhje me lëndën në mënyrë të paanshme”. Përveç që përcaktohet detyrimi i gjyqtari për të kërkuar përjashtimin e tij, në rast së gjyqtari nuk e kërkon përjashtimin parashihet edhe sanksione disiplinore ndaj tij/saj.

Me dispozita e nenit 5 të Rregullores për Përcaktimin e Sjelljeve të Pahijshme përcaktohen shkeljet e rënda, ndërsa në mënyrë specifike me dispozitën e nenit 5.1.9 përcaktohet si shkelje e rëndë e gjyqtarit : “Nëse nuk kërkon që të përjashtohet nga lëndët në të cilat ekzistojnë arsyet që vënë në dyshim mundësin e vendimeve të anshme gjyqësore që nënkuptojnë lidhjet familjare, miqësore, afariste, sociale dhe lidhjet tjera me palët dhe përfaqësuesit e tyre”.

Qëllimi i përcaktimit si shkelje e rëndë nga ana e gjyqtarit në rast së nuk kërkon përjashtimin e tij, nën kondita e përcaktuara me dispozitë e sipër cituar, është që gjyqtarët që kenë kujdesin e duhur në ruajtjen e paanësisë. Paanësia e gjykatës është mekanizimi kryesor i nxitjes së besimit të publikut në sistemin gjyqësor.

3.4.1 Rrethanat të cilat qojnë deri të përjashtimi i gjyqtarit nga gjykimi

LPK-ja, i ka numëruar në mënyrë taksative rrethanat që përbejnë shkak që gjyqtari të përjashtohet domosdoshmërishtë. Rrethanat të cilat qojnë deri të përjashtimi i gjyqtarit nga gjykimi janë përcaktuar me nenin 67 të LPK-së.

Gjyqtari nuk mund ta procedojë çështjen juridike:

- a) *nëse është vetë palë, përfaqësues ligjor apo me prokurë i palës, apo nëse me palën është bashkëkreditor apo bashkëdebitor ose i obliguar për regresim, apo nëse në të njëjtën çështje është dëgjuar si dëshmitar ose si ekspert;*

- b) nëse pala ose përfaqësuesi ligjor apo me prokurë i saj është kushëri gjaku në vijën vertikale deri në cilëndo shkallë, kurse në vijën horizontale deri në shkallë të katërt, apo nëse është bashkëshort, apo gjini e krushqisë deri në shkallë të dytë, pavarësisht nëse martesë ka pushuar ose jo;
- c) nëse është kujdestar, adoptues ose i adoptuar i palës, i përfaqësuesit të saj ligjor ose me prokurë;
- d) nëse në të njëjtën çështje ka marrë pjese në dhënien e vendimit të gjykatës më të ulët, ose të organit tjetër, ose në procedurën e ndërmjetësimit;
- e) në qoftë se ka vepruar në çështjen në të cilën është bërë ujdia gjyqësore, e me padinë e ngritur kërkohet anulimi i ujdisë së këtillë;
- f) nëse është aksionar apo anëtar i shoqërisë tregtare që është palë në procedurën e iniciuar me padi;
- g) Nëse ekzistojnë rrethana të tjera që e vejnë në dyshim paanësinë e tij.

Këto janë rrethana të cilat sipas dispozitës ligjore të lartshënuar janë numëruar shprehimisht dhe taksativisht e që duhen të merren për bazë me rastin e përjashtimit të një gjyqtari nga një rast konkret. Për këto rrethana pika a)-f), është detyrë e gjyqtarit të çështjes që t'i paraqesë me kërkesë për përjashtimin e tij nga gjykimi para kryetarit të gjykatës.

Rrethanat nga neni 67 pika g), i referohen rrethanave që nuk janë të numëruara por që në procedurë mund të paraqitën në forma të ndryshme, andaj ndryshe njihen si rrethana që qojnë deri të rekuizimi i gjyqtarit.

Përveç këtyre rasteve të numëruara në mënyrë taksative kur gjyqtari duhet përjashtuar nga gjykimi, me dispozitave të LPK-së, ekziston edhe një situatë kur parashihet përjashtimi gjyqtarit në mënyrë taksative, e që i referohet rastit kur lejohet përsëritja e procedurës. Sipas dispozitës së nenit 241 paragrafi 1, i LPK-së, përcaktohet se: “Në procedurën e përsëritur në gjykatën e shkallë së parë nuk mund të veprojnë gjyqtari që ka dhen vendimin në procedurën e me parashmë”.

Rast praktik i një shtate të tillë:

Në qoftë se në gjykatën e shkallë së parë gjyqtari “ X”, e ka shqyrtuar dhe e ka vendosur në mënyrë meritore një çështje juridike kontestuese me palë paditëse subjektin “AA” dhe të paditur subjektin “BB”, nën supozimin se vendimi ka marrë formën e prerë dhe ndaj të njëjtit gjykata e shkallë së dytë e ka lejuar përsëritjen e procedurës sipas kërkesës së njëres prej palëve ndërgjyqësore, atëherë në rishqyrtim në shkallë të parë këtë çështje nuk mund ta vendos gjyqtari” “X (që ka vendos më herët).

3.4.2 Rrethanat të cilat qojnë deri të rekuizimi i gjyqtarit nga gjykimi

Paragrafi g) i nenit 67 të LPK, nuk ka rregulluar as shprehimisht as taksativisht rastet e rekuizimit të gjyqtarit, por vetëm ka përmendur faktin nëse ekzistojnë rrethana të tjera që e vënë në dyshim paanësinë e gjyqtarit në vendosjen e çështjes të shtruar para tij.

Mund të ekzistojnë rrethana të tjera të cilat nuk klasifikohen si shkaqe që në mënyrë automatike gjyqtari të përjashtohet nga gjykimi (rrethanat e parapara nga paragrafi a) deri te paragrafi f), të nenit 67 të LPK) por janë rrethana të tilla që mund të sjellin në dyshim paanësinë dhe jo objektivitetin e tij në proces gjyqësor. Në këto raste, nëse gjyqtari i çështjes vlerëson se janë paraqitur rrethana për të cilat duhet të përjashtohet gjyqtari, gjithmonë duke e pasur në vëmendje edhe standardin e kodit të etikës, përmes kërkesës së arsyetuar duhet të kërkojë nga Kryetari i Gjykatës përjashtimin e vet nga gjykimi.

Nga praktika gjyqësore:

Për rrethanat që njihen si rrethana për rekuizim të gjyqtarit, në praktikën gjyqësore ka një standard sipas të cilit në mënyrë parimore dihet se kur do të përjashtohet një gjyqtar nga gjykimi dhe kur nuk do të përjashtohet. Në këtë kuptim gjyqtarët asnjëherë nuk guxojnë ta përdorin mundësinë e përjashtimit të gjyqtarit nga gjykimi më qëllim që tu shmangën dosjeve komplekse, por mundësia e përjashtimit të gjyqtarit gjithmonë duhet të vije në shprehje në rastet kur ekzistojnë arsye të vërteta që e sjellin në dyshim paanësinë dhe objektivitetin e gjykatës.

Si rrethana të cilat mund të vlerësohen si të mjaftueshme për rekuizimin e gjyqtarit nga një proces, mund të jenë:

- Fakti së kryetari i asaj gjykate ka një çështje në gjykatë;
- Fakti së një gjyqtar i asaj gjykate ka rastin e tij në gjykatë;
- Fakti që gjyqtari qëndron në miqësi apo armiqësi me palën;
- Fakti që gjyqtari ka shprehur mendimin e tij se si do të përfundoj procesi para gjykatës (këtu duhet të përfshihet edhe mendimi i dhënë në ambientet private);
- Fakti që gjyqtari më herët ka marrë pjesë në negociim në mes të palëve, lidhur me të njëjtën çështje që është objekt shqyrtimi në procesin konkret;
- Shoqëria shumë e ngushtë në mes të gjyqtarit dhe personit, i cili ka vendosur lidhur me të njëjtën çështje juridike.

Këto janë disa nga rrethanat të cilat me ligj nuk janë paraparë shprehimisht dhe taksativisht por si të tilla u japin mundësi palëve në procedurë që të kërkojnë rekuizimin e gjyqtarit nga procesi gjyqësor.

3.4.3 Procedura

Pala duke nënkuptuar edhe secilin bashkë-ndërgjyqës dhe vet-ndërhyrësin ka të drejtë të paraqes kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit kur ka mësuar se ekziston ndonjëri nga shkaqet për përjashtim. Këtë të drejtë pala mund ta shfrytëzoj deri në përfundim të shqyrtimit kryesor apo deri në nxjerrjen e vendimit meritor. Pala mundet që edhe në mjetin e goditjes së vendimit përfundimtar por edhe në përgjigje të mjetit të goditjes t'i theksojë rrethanat që kanë të bëjnë me përjashtimin e gjyqtarit nga një proces gjyqësor.

Edhe vet gjyqtari ka për detyrë që të vlerësoj ex officio se a ekzistojnë shkaqe për përjashtimin e tij nga një proces konkret.

Kur janë në pyetje rrethanat për përjashtimin e gjyqtarit sipas pikës a), deri te pika f), të nenit 67 të LPK, mjafton vetëm paraqitja e të dhënave që dëshmojnë ekzistimin e raportit që është paraparë në ligj. Ndërsa kur janë në pyetje rrethanat nga pika g), i këtij neni, që ka të bëjë me

arsyet për rekuizimin e gjyqtarit, nga pala që kërkon rekuizimin e gjyqtarit duhet që të paraqes fakte të ndryshme dhe prova për ta dëshmuar se ekziston baza për rekuizimin e gjyqtarit.

Gjyqtari ka për obligim që ta ndërpres çdo veprim procedural posa ta kuptoj se është shtruar kërkesa rrethanë për përjashtimin e tij (kjo ka të bëjë vetëm me rrethanat nga pika a) deri te pika f) e nenit 67 të LPK) dhe për këtë ta njoftoj Kryetarin e Gjykatës.

Kur kërkohet përjashtimi i gjyqtarit për rrethanat e parapara në nenin 67 pika g), që kanë të bëjnë me rekuizimin e gjyqtarit, gjyqtari i çështjes për këtë e njofton kryetarin e gjykatës por ka mundësi që të ndërmarr veprime të caktuara, nëse ndërmarrja e atyre veprimeve nuk mund të shtyhet.

3.4.4 Autoriteti kompetent për të vendosur lidhur me kërkesën për përjashtimin dhe rekuizimin e gjyqtarit

Autoriteti kompetent që vendos për përjashtimin e gjyqtarit nga një proces nuk duhet të pranojë shumë lehtë kërkesa për përjashtim, përndryshe palët do të kenë sukses për të ndikuar në mënyrë efektive në zgjedhjen e gjyqtarit në rastin e tyre.

Para se të vendoset lidhur me kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit, merret deklarata e gjyqtarit me qëllim të vërtetimit të rrethanave sipas rregullit të të provuarit, rezultati i të cilit e bën të besueshëm ekzistimin e shkakut për përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi konkret. Lidhur me kërkesën për përjashtimin dhe rekuizimin e gjyqtarit vendos kryetari i gjykatës pranë së cilës gjykatë është shtruar çështja. Nëse kërkohet përjashtimi apo rekuizimi i kryetarit të gjykatës për këtë vendos kryetari i gjykatës më të lartë. P.sh. nëse kërkohet përjashtimi ose rekuizimi i Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë për këtë vendos Kryetari i Gjykatës së Apelit. Ndërsa lidhur me kërkesën për përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës së Apelit vendos Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, ndërsa për kërkesën për përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës Supreme vendos Seanca e Përgjithshme e Gjyqtarëve të Gjykatës Supreme. Kundër aktvendimit me të cilin aprovohet apo refuzohet kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit nuk lejohet ankesa.

3.4.5 Kërkesat e palejuara

Në praktikë ndodh që palët me qëllim të zvarritjes së procesit dhe ndërprerjes së punës së gjykatës të bëjnë kërkesa të ndryshme për përjashtim dhe rekuizim të gjyqtarit, dhe atë:

- kërkojnë përjashtimin e të gjithë gjyqtarëve të gjykatës së caktuar që të gjykojnë në një kontest të caktuar;
- kërkesën për të cilën është vendosur njëherë, si dhe
- kërkesa që nuk përmbajnë arsyetim lidhur me kërkesën për përjashtimin ose rekuizimin e gjyqtarit.

Lidhur me këto kërkesa të palejuara kompetent për të vendosur është gjyqtari që është duke e proceduar çështjen. Gjyqtari bie aktvendim të veçantë me të cilin e hudh kërkesën për përjashtim, kundër të cilit vendim nuk lejohet ankesë e veçantë.

3.5 Përmbledhje

Në këtë sesion është prezantuar korniza ligjore që i referohet përbërjes së rregullt të gjykatës dhe përjashtimit të gjyqtarit nga gjykimit. Gjatë trajtimit të kësaj teme do të prezantohen shembuj nga praktika gjyqësore si për përbërjen e gjykatës, pasojat në rast të përbërjes së

parregullt, gjithashtu edhe për situata e shumta që kanë të bëjnë me nevojën e përjashtimit të gjyqtarit. Ky sesion do të zhvillohet në një mjedis ku do të nxitën diskutime sidomos për pjesën që ka të bëjë me përjashtimin e gjyqtarit.

4. Palët në procedurën kontestimore

4.1 Hyrje

Në këtë sesion janë trajtuara çështje që i referohen prezumimëve procedurale lidhur me palët, si kuptimi i palëve në procedurën kontestimore, zotësia procedurale e palëve, përfaqësimi etj. Në këtë sesion do të paraqite dhe elaborohen edhe detyrimet që ka gjykata në procedurën kontestimore për tu kujdesur zyrtarisht për disa çështje që ndërlidhën me cilësinë e palëve dhe përfaqësimin e tyre.

4.2. Objektivat trajnues

Pas përfundimit të këtij moduli pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Vlerësojnë prezumimet procedurale lidhur me palët;
- Ndërmarrin veprimet e duhura procedurale për të evituar të meta që kanë të bëjnë me cilësinë e palëve dhe përfaqësimin;

4.3 Prezumimet procedurale lidhur me palët

Prezumimet procedurale lidhur me palët i gjejmë në ato dispozita të LPK-së, që i referohen:

- ekzistimit të palës,
- zotësisë për të qenë palë ndërgjyqëse,
- zotësisë procedurale të palëve,
- përfaqësimi ligjor i rregullt në rast të mungesës së zotësisë procedurale,
- përfaqësimi i rregullt i personit juridik dhe ekzistimi i prokurës së rregullt,
- autorizimi procedural për ndjekjen e çështjes në gjykatë.

4.4 Kuptimi i palëve në procedurën kontestimore

Procedura kontestimore është procedurë dypalëshe. Asaj i paraprinë kontesti në mes të palëve lidhur me të drejtat dhe obligimet e tyre nga marrëdhënia e caktuar juridike. Në fakt, Ligji për Procedurën Kontestimore (LPK), nuk e përkufizon në mënyrë të qartë termin palë, por për të kuptuar këtë term mund të merret ajo se:

- a) Paditësi, është ai i cili nga gjykata kërkon mbrojtjen e të drejtës së tij subjektive, ndërsa
- b) I padituri, është ai ndaj të cilit kjo mbrojtje realizohet.

Në procedurën kontestimore vlen rregulli se palë e paditur është ajo e cila është e cekur në padi, e jo ajo të cilën ka pasur për qëllim paditësi. Kësisoj, një palë nuk e merr cilësinë e të paditurit për shkak se të njëjtës i është dorëzuar gabimisht padia, por për shkak se ajo si e tillë është e shënuar në padi.

Edhe me nenin 2 të Ligjit për Procedurën Përmbare, është e paraparë se shprehja palë nënkupton kreditorin apo debitorin në procedurën përmbare.

4.5 Kush mund të jetë palë në procedurën kontestimore?

Secili person fizik dhe juridik mund të jetë palë në procedurën kontestimore. Kjo është ajo që njihet si aftësia juridike e cila tek personat fizik arrihet me lindje (bile edhe para lindjes të marrëdhëniet juridike – trashëgimore nëse fëmija lind i gjallë), ndërsa tek personat juridik kjo aftësi fitohet në bazë të rregullave të veçanta materiale juridike, përkatësisht me regjistrimin e personit juridik pranë organit kompetent.

Personat juridik duhet të kenë pasurinë e tyre e cila është e përshtatshme për përmbarrim gjyqësor, si dhe që përmes akteve të përgjithshme, këtij personi juridik, t'i jetë pranuar cilësia e tillë e personit juridik si bartës i pavarur i të drejtave dhe obligimeve në qarkullimin juridik. Cilësinë e personit juridik e kanë edhe komunat si njësi administrativo–territoriale, përmes të cilave realizohet vetëqeverisja lokale, ndërmarrjet publike, si dhe entitetet e tjera, përkatësisht bashkësitë e tjera të personave të cilat në bazë të ligjit mund të jenë palë në procedurë, apo ato forma të bashkimit të cilave gjykata ua njeh cilësinë e palëve, me kusht që ato forma të bashkimit t'i përmbushin kushtet e nevojshme që të jenë bartës të pavarur të drejtave dhe obligimeve në marrëdhëniet juridiko-civile dhe që të disponojnë me pasuri e cila mund të jetë e përmbarrueshme.

Sipas mendimit juridik të Seancës së Përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, pranë Departamentit për Çështje Ekonomike të Gjykatës Themelore në Prishtinë, përkatësisht Departamentit për Çështje Ekonomike pranë Gjykatës së Apelit, si palë mund të paraqiten edhe:

- a) biznesi individual;
- b) ortakët e shoqërisë së ortakërisë, ortakët e përgjithshëm dhe të kufizuar të shoqërisë komandite;
- c) shoqëria me përgjegjësi të kufizuar;
- d) shoqëria aksionare;
- e) drejtori apo drejtorët menaxhues të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, dhe
- f) bordi i drejtorëve të shoqërisë aksionare.

Gjykata është e obliguar që gjatë të gjithë procedurës, sipas detyrës zyrtare, të kujdeset në lidhje me zotësinë juridike të palëve respektive. Nëse palët nuk e kanë këtë zotësi, atëherë procedura nuk mund zhvillohet më tutje dhe nëse edhe përkundër ftesës së gjykatës, kjo mangësi nuk evitohet, padia do të hidhet poshtë, ndërsa veprimet e ndërmarra më parë, do të abrogohen.

Shpjegim praktik:

Konsiderohet si e parregullt padia me të cilën paditësi i'a le në vendosje gjykatës, që mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar në procedurë, ta përcaktoj të paditurin kryesor, përkatësisht personin i cili më së shumti i ka dhënë shkas ngritjes së padisë. Në këtë rast gjykata do ta ftoj paditësin që brenda afatit ligjor ta rregulloj padinë, e në rast se padia përsëri nuk rregullohet, e njëjta nga ana e gjykatës do të hidhet poshtë si e palejuar.

Shembull praktik: Nuk është i mundur kontesti në mes të dy njërive të ndërmarrjes së njëjtë, sepse ato konsiderohen si pjesë të personit të njëjtë juridik. E njëjta gjë vlen edhe për organet shtetërore, përkatësisht ministrinë.

4.6 Zotësia procedurale e palëve

Përveç zotësisë juridike, si parakusht procedural për zhvillimin e procesit kontestimor, paraqitet edhe zotësia për të vepruar, përmes të cilës pala mundet që vetë dhe në mënyrë të pavarur të

ndërmerr veprime në procedurën kontestimore (e cila ndryshe njihet edhe si zotësia procedurale). Zotësia për të vepruar tek personat fizik përputhet në tërësi me zotësinë e plotë punuese e cila rregullohet me dispozitat materialo-juridike.

Personi fizik zotësinë për të vepruar dhe zotësinë e plotë punuese e arrin në moshën 18 vjeçare, apo para kësaj, nëse në bazë të lejes së gjykatës kompetente që të lidhë martesë.

Sipas dispozitës së nenit 74 paragraf 1, të LPK-së, përcaktohet së:” *pala që është plotësisht e aftë për të vepruar mund të kryej vetë veprimet në procedurë (zotësia procedurale)*”.

Zotësia procedurale është cilësi e palës ndërgjyqësore që personalisht dhe vleftësisht të kryej veprimet procedurale në procesin kontestimor. Zotësia postulative është zotësia e palës që e ka zotësinë procedurale, që personalisht (pa përfaqësues) të kryej veprime procedurale. Thuhet së nuk ka zotësinë postulative pala, nëse ajo, sipas dispozitave procedurale, veprimet procedurale mund t’i kryejë vetëm nëpërmjet përfaqësuesit që i ka kualifikimet e duhura. Në të drejtën tonë procedurale përkatësisht sipas dispozitave të LPK-së, rrjedh se zotësia procedurale është e barabartë me zotësinë postulative, që nënkupton se çdo person që ka zotësinë e veprimit ka edhe zotësinë procedurale përkatësisht zotësinë postulative. Në këtë kontekst duhet kuptuar se për personat që kanë zotësi procedurale përfaqësimi me përfaqësues me prokurorë është veç një e drejte e tyre.

LPK parasheh se i mituri i cili nuk e ka fituar plotësisht zotësinë për të vepruar, ka zotësi procedurale brenda kufijve në të cilët i njihet zotësia për të vepruar. Deri në moshën 14 vjeçare, personi fizik nuk e ka zotësinë punuese (nuk e ka zotësinë procedurale), e pasi që të mbushë 14 deri 18 vite, ai është pjesërisht i aftë. Me arritjen e moshës 15 vjeçare, i mituri mund të themelojë marrëdhënie pune, të disponojë me të ardhurat, si dhe mundet që para gjykatës të paraqitet si palë, apo të përpiloj testament.

Kur personi madhor privohet në tërësi nga zotësia e tij për të vepruar, ai më nuk e ka as zotësinë procedurale dhe i njëjti barazohet me personin e mitur nën 14 vjet. Por personi madhor të cilit i është kufizuar pjesërisht zotësia për të vepruar, e ka zotësinë procedurale në kufijtë e zotësisë së tij për të vepruar (neni 74.2 i LPK). Në këto raste, organi i kujdestarisë i cakton punët juridike të cilat ky person mund t’i ndërmerr në mënyrë të pavarur, si dhe përcakton se për cilat veprime ai e posedon zotësinë procedurale.

4.7 Përfaqësimi ligjor i rregullt në rast të mungesës së zotësisë procedurale.

Palën e cila nuk e ka zotësinë procedurale, e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor. Ai përcaktohet me ligj apo me aktin e organit shtetëror kompetent të marrë në bazë të ligjit. Pala e cila e ka zotësinë procedurale, veprimet në procedurë mund t’i ndërmerr personalisht apo nëpërmes të personit të cilin e autorizon (i autorizuari).

Personat juridik nuk e kanë zotësinë procedurale. Ata në procedurë i përfaqësojnë përfaqësuesit e tyre të cilët caktohen në bazë të ligjit dhe rregullave të tjera. Komunitat i përfaqësojnë Avokatët Publikë, si përfaqësues ligjorë në bazë të Ligjit mbi Avokaturën Publike Komunale, ndërsa organet qendrore shtetërore, divizioni për përfaqësimi i Ministrisë së Drejtësisë. Pas aprovimit të Ligjit nr.04/L-157 për Avokaturën Shtetërore, i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës nr.8, të datës 08.04.2013, autoritetet publike të Republikës së Kosovës, pranë organeve gjyqësore, të arbitrazhit apo ato administrative, i përfaqëson Avokati i Përgjithshëm Shtetëror, avokati shtetëror, apo personi i autorizuar i punësuar pranë Avokaturës Shtetërore apo pranë organit tjetër të administratës shtetërore, e i cili e ka të dhënë provimin e jurisprudencës.

Personat fizikë madhor të cilët në tërësi janë të privuar nga zotësia për të vepruar, i përfaqësojnë kujdestarët të caktuar nga ana e organeve të kujdestarisë, kurse kujdestari mund të caktohet edhe për personat të cilët pjesërisht janë të privuar nga zotësia për të vepruar, varësisht nga lloji i kontestit i cili mund të zhvillohet para gjykatës. Personat e mitur, në rastet kur ata janë plotësisht të paafte në aspektin e veprimit (u mungon zotësia procedurale), apo kur kjo është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të tyre, sipas ligjit i përfaqësojnë prindërit e tyre.

4.7.1 Përfaqësuesi ligjor

Sipas rregullit, përfaqësuesi ligjor i ka të gjitha autorizimet dhe detyrimet e palës në procedurën kontestimore. Por në rastet e caktuara, me rregulla të veçanta mund të parashihet që përfaqësuesi ligjor duhet të ketë autorizim të veçantë për ndërmarrjen e veprimeve individuale kontestimore, të cilat kanë ndikim esencial në rrjedhën dhe fatin e procedurës.

Rastet e tilla janë p.sh. në:

- a. parashtrimin apo tërheqjen e padisë;
- b. pranimin apo heqjen dorë nga kërkesëpadia;
- c. lidhjen e ujdisë dhe të tjera, kur përfaqësuesi ligjor për ndërmarrjen e këtyre veprimeve duhet të ketë autorizim të posaçëm.

Gjykata është e detyruar që gjatë gjithë procedurës të kujdeset sipas detyrës zyrtare se a janë përmbushur prezumimet procedurale në raport me zotësinë juridike dhe atë të veprimit (zotësinë procedurale) të palës në procedurë, në rregullsinë e përfaqësimit të palës e cila nuk e ka zotësinë e veprimit nga ana e përfaqësuesit ligjor, në rregullsinë e autorizimit të tij të veçantë në rastet kur ky autorizim është i nevojshëm dhe të ndërmerr masat e nevojshme që këto mangësi të mënjanohen. Procedura nuk mund të vazhdojë deri sa këto mangësi nuk eliminohen sepse çfarëdo vendimi gjyqësor i cili do të përmbante këto mangësi, do të prishej nga ana e gjykatës së shkallës së dytë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë të parapara me nenin 182 par.2 pika (k) të LPK-së. Për këtë arsye në këto raste gjykata do të duhej t'i abrogonte veprimet e ndërmarra deri atëherë dhe ta hedhë padinë.

4.7.2 Përfaqësuesi i përkohshëm

Nëse procedura rreth caktimit të përfaqësuesit ligjor për personin (të paditurin) me pazotësi të veprimit (pazotësi procedurale) nga ana e organit të kujdestarisë do të zgjaste shumë dhe do të mund të prodhonte pasoja të dëmshme për cilëndo palë, LPK ka paraparë mundësinë që gjykata e shkallës së parë t'ia caktojë atij (të paditurit pra) përfaqësuesin e përkohshëm.

Përfaqësuesi i përkohshëm në procedurë i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përfaqësuesit ligjor dhe këto të drejta dhe detyrime i ushtron derisa i padituri apo i autorizuari i tij nuk paraqiten në gjykatë, respektivisht deri sa organi i kujdestarisë nuk e informon gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Gjykata do t'ia caktojë të paditurit përfaqësuesin e përkohshëm në rastet të cilat janë të saktësuar me ligj dhe për këtë do ta njoftojë menjëherë organin kompetentë të kujdestarisë si dhe palët kur një gjë e tillë është e mundshme.

Nëse të paditurit i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm nga arsyeja se vendbanimin e ka të panjohur, kurse nuk ka të autorizuar, si dhe nëse ai dhe përfaqësuesi i tij ligjor gjenden në botën e jashtme kurse nuk kanë të autorizuar në territorin e Republikës së Kosovës, si dhe nëse dorëzimi nuk ka mundur të kryhet, gjykata brenda afatit prej shtatë (7) ditësh do të jap shpallje e cila do të botohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, ndërsa që shpallja do të afishohet edhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës së çështjes, e sipas nevojës edhe në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme. Në këtë rast procedura do ta vazhdoj deri sa i padituri nuk lajmërohet në gjykatë respektivisht deri sa organi i kujdestarisë nuk e informon gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Gjykata e cakton përfaqësuesin e përkohshëm nga radha e avokatëve.

Shpenzimet e shpalljes për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm në rastet e parapara sikurse në nenin 79.3 të LPK-së, (shpenzimet e botimit të shpalljes në ndonjë gazetë), duhet t'i deponojë paditësi. Në këtë rast, paditësi duhet t'i deponoj edhe shpenzimet për pagesën e përfaqësuesit të përkohshëm për pjesëmarrje në seancat gjyqësore, të llogaritura sipas tarifës zyrtare të Odës së Avokatëve të Kosovës, për shpërblimet dhe kompensimin e shpenzimeve për punën e avokatëve, përkatësisht nr. tarifor 7, të ekstraktit të bashkëngjitur kësaj tarife.

4.7.3 Përfaqësimi i rregullt i personit juridik

Personat juridik marrin pjesë në qarkullimin juridik me anë të personave fizik, të cilët kryejnë veprime relevante. Personat fizikë, që veprojnë në emër të personave juridike, janë zakonisht organe të tyre, të caktuara me anë të statutit.

LPK-ja, me dispozitën e nenit 75 paragrafi 3, përcakton së: “*Përfaqësuesi i personit juridik caktohet me ligj apo me aktin e përgjithshëm të personit juridik*”. Përfaqësuesi i personit juridik ose i etnitetit tjetër autorizimin e nxjerr nga akti, me të cilin rregullohet konstituimi dhe qarkullimi juridik i personit juridik apo i etnitetit tjetër.

Raste nga praktika:

Përfaqësuesi i personit juridik i caktuar nga ligji është për shembull përfaqësimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, nga Ministria e Drejtësisë.

Përfaqësuesi i personit juridik i caktuar me aktin e themelimit/organizmit të personit juridik, për shembull përfaqësuesi i një banke, përfaqësuesi i një Kompanie të Sigurimeve, etj.

4.7.4 Përfaqësuesit e autorizuar të palëve (me prokurë)

Në të drejtën tonë nuk është i paraparë detyrimi i palëve që të drejtat e tyre medoemos duhet t'i realizojnë përmes të autorizuarve, të cilët janë persona me kualifikime profesionale – avokatët. Ata mundën që vetë ta udhëheqin kontestin, respektivisht në rastet kur janë të paditur, mbrojtjen dhe kundërshtimet t'i paraqesin personalisht apo nëpërmes të të autorizuarve.

Duhet cekur se për të pasur cilësinë e të autorizuarit të palës në procedurë, vendimtare është ndërmarrja e veprimeve për palën, e jo ekzistimi i autorizimit.

Shpjegim praktik:

Kështu edhe përfaqësuesi i pa autorizuar mund ta ketë pozitën e përfaqësuesit, sepse autorizimi duhet të ekzistoj që përfaqësimi të jetë i vlefshëm dhe mungesa e autorizimit i bënë të pavlefshme

dhe të paefektshme të gjitha veprimet procedurale të ndërmarra në emër të palës. Por këto veprime mund edhe të fuqizohen dhe të merren si të mirëqena, po qesë pala më vonë i aprovon ato.

Aktgjykimi nuk i drejtohet të autorizuarit të palës, e as që ka kurrfarë efekti ndaj tij.

Pasi që përfaqësuesi vepron në interes të palës të cilën e përfaqëson, nuk është e lejuar që i njëjti person të jetë përfaqësues i të dy palëve (paditësit dhe të paditurit) në një procedurë gjyqësore.

Të autorizuar të palëve mund të jenë të gjithë personat madhor dhe personat me aftësi të veprimit (procedurale) të cilët nuk merren me pseudo shkresari.

4.7.5 Mos përfaqësimi i duhur i palës nga ana e avokatit apo personit tjetër

Ekziston detyrimi i gjykatës që ta informoj palën me pasojat e dëmshme të cilat mundë të lindin për të, në rastet kur atë e përfaqëson në mënyrë jo të duhur i autorizuari i cili nuk është avokat.

Por edhe në rastet kur gjykata konstaton se përfaqësuesi i palës i cili është avokat, nuk e kryen detyrën në pajtim me Ligjin mbi Avokaturën, mbi të rëndon detyrimi që për një gjë të tillë ta njoftojë Odën e Avokatëve.

4.7.6 Mënyrat e dhënies së autorizimit

Pavarësisht faktit se kënd e autorizon, pala mund ta jep autorizimin në dy mënyra:

- a. me shkrim, apo
- b. me gojë në procesverbal para gjykatës.

Pala e cila nuk di shkrim/lexim ose e cila nuk është në gjendje të nënshkruhet, do të vejë në autorizimin e shkruar shenjën e gishtit tregues. Nëse një autorizim i këtillë i jepet personit i cili nuk është avokat, është e nevojshme që të jenë prezentë dy dëshmitarë të cilët do të nënshkruhen në autorizim. Në rastet kur dyshohet në vërtetësinë e autorizimit, gjykata me aktvendim kundër të cilit nuk lejohet ankesa, do të urdhërojë që të parashtrahet autorizim i verifikuar. Kur pala ka të autorizuar, gjykata është e detyruar që dorëzimin t'ia bëjë të autorizuarit.

Pala mund të ketë më shumë përfaqësues të autorizuar, të cilët janë të autorizuar që në mënyrë të pavarur t'i ndërmarrin veprimet kontestimore, e të cilat veprime nuk mund të jenë në kundërshtim me veprimet e të autorizuarve të tjerë. Në këto raste dorëzimi i shkresave mjafton që t'i bëhet vetëm njërit nga të autorizuarit.

Te rastet e administrimit të provave edhe përmes dëgjimit të palëve, dorëzimi i ftesës për këtë seancë duhet t'i bëhet personalisht palëve.

Veprimet kontestimore në procedurë për palën i ndërmerr i autorizuari i tij, por gjykata mundë ta ftojë palën që të deklarohej personalisht lidhur me faktet të cilat duhet të vërtetohen. Është e drejtë e palës që të kërkoj nga gjykata që t'i mundësoj dhënien e deklaratave lidhur me lëndën e kontestit edhe pranë deklaratës së dhënë nga i autorizuari i tij.

Revokimi i deklaratës së të autorizuarit nga ana e vetë palës

Pala mundet që deklaratën e të autorizuarit të saj të dhënë në seancë:

- a) ta ndryshoj, apo
- b) ta revokoj.

Mund të ndodhë që i autorizuari në seancë e ka pranuar ndonjë fakt, të cili pala nuk ka qenë prezentë apo e ka pranuar në parashtrësë, e pas kësaj pala këtë pranim ta ndryshojë apo revokojë. Në këtë rast gjykata sipas vlerësimit të lirë, e duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, do të vendos se cilës deklaratë do t'ia fal besimin, e cilës jo.

Vëllimi dhe përmbajtja e autorizimit

Se cilat veprime do të jetë i autorizuar t'i ndërmerë përfaqësuesi i autorizuari i palës, varet nga vëllimi i autorizimit të cilin e cakton pala si autorizim dhënës.

Autorizimi mund të jetë:

- a) i përgjithshëm (gjeneral), apo
- b) i veçantë.

Në rastet kur bëhet fjalë për autorizimin e përgjithshëm, autorizimet e të autorizuarit sipas përmbajtjes janë të ndryshme, varësisht nga fakti se a është personi i autorizuar avokat, apo jo.

I autorizuari i cili është avokat dhe i autorizuar me autorizim të përgjithshëm, ka të drejtë t'i kryej të gjitha veprimet në procedurë, e sidomos:

- a) ta parashtrorë dhe ta tërheqë padinë;
- b) të parashtrorë përgjigjen në padi;
- c) që të pohojë kërkesëpadinë apo të heqë dorë nga ajo;
- d) që të lidhë pajtim gjyqësor;
- e) që të parashtrorë mjetin e goditjes së vendimit si dhe të heqë dorë nga kjo e drejtë, apo ta tërheqë mjetin e parashtruar;
- f) të propozoj caktimin e masave të përkohshme të sigurimit të kërkesave;
- g) të parashtrorë kërkesën për ekzekutimin ose sigurimin dhe të kryej veprime të nevojshme lidhur me kërkesat e tilla;
- h) që nga pala kundërshtarë t'i pranoj shpenzimet procedurale të caktuara nga gjykata,
- i) të autorizojë avokatin tjetër me shkrim që të kryej disa veprime të caktuara procedurale, por jo edhe që të veprojë në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes.

Për paraqitjen e propozimit për përsëritjen e procedurës, avokatit i nevojitet autorizim i veçantë, vetëm nëse nga koha kur vendimi është bërë i formës së prerë kanë kaluar më shumë se gjashtë muaj.

Avokatin mund ta zëvendësoj praktikanti që është duke punuar tek ai, por vetëm para gjykatës së shkallës së parë. Por nëse i autorizuari i palës nuk është avokat, ndërsa që pala në autorizim nuk ia ka caktuar atij më hollësisht autorizimet, i autorizuari në këtë rast mund t'i kryejë të gjitha veprimet procedurale, por gjithmonë i nevojitet autorizim shprehimor për:

- a) tërheqjen e padisë;
- b) për pohimin apo heqjen dorë nga kërkesëpadia;
- c) për lidhjen e pajtimit gjyqësor;
- d) për heqje dorë nga e drejta e paraqitjes së mjetit të goditjes së vendimit,
- e) apo për tërheqjen e tij dhe për kalimin e autorizimit një personi tjetër, si dhe parashtrimin e mjeteve të jashtëzakonshme të goditjes së vendimeve.

Përfaqësues i autorizuar i palës mund të jetë çdo person që ka zotësi të plotë për të vepruar (zotësi procedurale).

Parashtrimi i autorizimit

I autorizuari i palës është i detyruar që me rastin e kryerjes së veprimit të parë në procedurë, ta paraqesë autorizimin (me rastin e parashtrimit të padisë, përgjigjes në padi etj.). Gjykata mund t'ia lejoj personit të tillë përfaqësimin e palës edhe pa parashtrimin e autorizimit, mirëpo do t'ia caktojë atij një afat të caktuar që ta parashtrroj autorizimin.

Nëse ky person nuk vepron sipas urdhrit të gjykatës, procedura do të vazhdoj sikurse ai fare të mos ishte paraqitur para gjykatës në cilësinë e të autorizuarit të palës dhe pa i marrë në konsideratë veprimet e kryera nga ai.

Veprimet të cilat i ka ndërmarr ky person në procedurë gjykata do t'i anulojë, me përjashtim të atyre për të cilat pala më vonë e jep pëlqimin.

Shkelja e këtyre rregullave paraqet shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika k të LPK, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe si pasojë e të cilave shkelje do të duhet që të priset vendimi i gjykatës së shkallë së parë. Po ashtu për shkak të kësaj shkelje mund të paraqitet edhe mjeti i jashtëzakonshëm juridik – revizioni.

Revokimi dhe denoncimi i autorizimit

Pala mund të revokojë autorizimin kurse i autorizuari të denoncojë atë në çdo kohë. Revokimi dhe denoncimi i autorizimit bëhet në mënyrë të shkruar apo gojarisht në procesverbal para gjykatës pranë së cilës zhvillohet procedura, kurse prodhon efekt juridik kundrejt palës së kundërt, nga koha kur asaj i është komunikuar. Megjithatë, i autorizuari i palës, është i detyruar që edhe për 15 ditë të kryejë veprime procedurale për palën që e ka autorizuar atë, po që se është nevoja që të evitohet ndonjë dëm që mund t'i shkaktohet palës brenda kësaj kohe.

Me vdekjen e personit fizik, gjegjësisht me shuarjen e personit juridik shuhet edhe autorizimi të cilën ai e ka dhënë.

Në rastin e falimentimit, autorizimi i dhënë nga debitori në falimentim shuhet në momentin në të cilin sipas dispozitave në fuqi shkaktohen pasojat juridike të hapjes së procedurës për falimentim.

4.7.7 E drejta e ndjekjes së çështjes në gjykatë (legetimatio ad processum)

Legjitimi procedural në radhë të parë u takon subjekteve të cilët janë pjesëmarrës të raportit materialo-juridik kontestuese dhe kreditor, përkatësisht debitor të së drejtës të përfshirë me anë të kërkesëpadisë. Zakonisht autorizimin e tillë e kanë pjesëmarrësit e raportit të kontestuar materialo- juridik. Thënë thjeshtë, e drejta e ndjekjes së çështjes në gjyq u takon subjekteve të cilat në procesin kontestimor janë të legjitimuar realisht. Legjitimi real mund të jete legjitimim real aktiv dhe legjitim real pasiv.

Nga praktika:

Legjitimiteti aktiv-, padia për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar mund të paraqitet vetëm prej ati që i përket e drejta e shkelur, ose e mohuar prej një tjetri. Rast praktik i legjitimit pasiv, P.sh., padia mund të paraqitet vetëm kundër atij që me qëndrimin ose veprimin e tij shkel ose mohon të drejtën subjektive të paditësit. P.sh., kreditori si paditëse e ka legjitimitetin aktiv për të paraqit paditë kundër personit, i cili nuk e përmbush ose e mohon detyrimin ndaj paditësit/kreditorit. Ky i fundit e ka legjitimitetin pasiv.

Në disa raste e drejta e ndjekje së çështjes në gjyq është e ndarë nga titullari i së drejtës subjektive dhe kalon në një person të tretë. Në këto raste personi i tretë paraqitet në gjykim si palë dhe vepron në emër të vet, por për të mbrojtur të drejtën subjektive të huaj.

Kur dikush kontraktin në emër të tij ndonjë kërkesë në dobi të personit të tretë, atëherë personi i tretë fiton të drejtën vetjake dhe të drejtpërdrejtë ndaj debitorit, në qoftë se nuk është kontraktuar diç tjetër ose nuk del nga rrethanat e punës.

Përjashtim nga rregulla se kontrata ka efekt juridik vetëm ndaj palëve kontraktuese përbën edhe kontrata e lidhur në dobi të personit të tretë.

Rast nga praktika:

Si rast i një situate të tillë kur personi i trete firon të drejtën vetjake dhe të drejtpërdrejtë është kontrata e sigurimit të jetës në dobi të personit të tretë.

4.8 Përmbledhje

Në këtë sesion janë trajtuar palët si subjekt i procedurës kontestimore, cilësia e palëve dhe përfaqësimi i tyre. Palët në procedurën kontestimore përfaqësojnë njërin prej subjekteve të domosdoshëm për cilësitë e të cilave gjykata duhet të kujdeset zyrtarisht. Në këtë kontekst janë trajtuar të gjitha prezumimet procedurale që lidhen me palët e për të cilat kujdeset gjykata.

5. Parashtrësirat dhe dërgimi i shkresave

5.1 Hyrje

Në këtë sesion është trajtuar komunikimi i palëve me gjykatën përmes parashtrësirave. Parashtrësirat përfaqëson një rreth prej formave të komunikimit të palëve me gjykatën, por të cilat gjithsesi i nënshtrohen disa rregullave formale për formën dhe përmbajtjen, por njëkohësisht ekzistojnë edhe detyrime të gjykatës që të kujdeset nëse parashtrësirat janë sa i përket formës dhe përmbajtjes në harmoni me ligjin. Në këtë sesion një hapësirë e rëndësishme i kushtohet veprimeve të gjykatës nëse palët dështojnë që parashtrësira e tyre të jetë sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuara. Përveç kësaj është trajtuara edhe dërgimi i shkresave, po ashtu çështje me rëndësi për shkak të specifikave që ekzistojnë për mënyrën e dërgimit të shkresave dhe për mënyrë e pranimit për tu konsideruara të rregullta.

5.2 Objektivat trajnues

Pas përfundimit të këtij moduli pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Vlerësoj nëse parashtrësirat janë të rregullta në kuptimin formal dhe përmbajtësore;
- Ndërmarrin veprime për kthimin e parashtrësirave në plotësim-korrigjim;
- Vendosin nëse palët dështojnë të plotësojnë-korrigjoj parashtrësirave;
- Vlerësojnë nëse dërgimi dhe pranimi i shkresave është bërë në mënyrë të rregullt, dhe
- Ndërmarrin veprime ligjore për dorëzimin e shkresave në mënyrë të rregullt.

5.3 Parashtrësirat

Parashtrësira nënkupton veprimin procedural me shkrim të palës drejtuar gjykatës me qëllim që të vihet në lëvizje procesi civil. Këto veprime procedurale kryhen jashtë seancave me shkrim dhe në seancë me gojë.

Parashtrësirat janë:

- Padi
- Përgjigjja në padi
- Mjetet e goditjes së vendimit dhe deklaratat tjera
- Propozimet dhe njoftimet (që bëhen jashtë seancave gjyqësore)

Për të vepruar gjykata sipas parashtrësirave ato duhet të jenë të kuptueshëm dhe sidomos të përmbajnë:

- Emrin e gjykatës,
- Emrin dhe mbiemrin e palës (emërtimin e personit juridik),
- Vendbanimin apo vendqëndrimin (selinë e personit juridik) të palëve,
- Emrin dhe mbiemrin si dhe vendbanimin apo vendqëndrimin e përfaqësuesve të palëve,
- Objektin e kontestit,
- Përmbajtjen e deklaratës dhe
- Firmën e parashtrësirës (nënshkrimin).

Në qoftë së parashtrës drejtuar gjykatës përmban ndonjë deklaratë si kërkesë, atëherë parashtruesi duhet që në parashtrësë t'i tregoi faktet në mënyrë të qartë dhe të thuktë dhe të ofrojë provat në lidhje me to.

5.3.1 Veprimi i gjykatës në rastet kur parashtrës nuk është e kuptueshme dhe e plotë

Gjatë shqyrtimit të parashtrës nëse gjykata vlerëson se nuk i përmban elementet e kërkuara me nenin 99 par 2 të LPK-së, atëherë gjykata me aktvendim të veçantë do ta thërras personin që e dërgon që ta korrigjojë ose ta plotësojë parashtrësën.

Në raste të tilla gjykata e udhëzon palën që brenda tri ditësh ta evitojë të metën e parashtrësës duke e udhëzuar për korrigjimin dhe plotësimin.

Shembuj të rasteve kur gjykata e udhëzon palën për plotësimin-korrigjimin e parashtrësë

- Plotësimi i parashtrësë lidhur me të dhënat e palëve
- Kur përmbajtja e deklaratës është e paqartë
- Kur në parashtrësë ka kërkesë por nuk janë treguar faktet
- Kur fakte nuk mbështeten në prova
- Kur parashtrës nuk përmban firmën (nënshkrimin) e palës
- Kur parashtrës nuk përmban numrin e mjaftueshëm të ekzemplarëve

5.3.2 Pasojat e mos plotësimit - korrigjimit të parashtrësës

Në qoftë së pala nuk e plotëson-korrigjon parashtrësën varësisht nga të metat për të cilën është kthyer në plotësim dhe atë brenda afatit të caktuar (tre ditor) përkundër njoftimit të gjykatës për pasojën juridike, do të konsiderohet se parashtrës është tërhequr. Në raste të tilla gjyqtari merr aktvendim të veçantë me të cilin konsideron së është tërheq parashtrës.

Në rastet kur parashtrës i kthehet gjykatës pa u plotësuar-korrigjuar si dhe në rastin kur parashtrës apo dokumentet që i bashkëngjiten parashtrësës nuk i janë dorëzuar gjykatës në numër të mjaftueshëm ekzemplarësh, atëherë gjyqtari merr aktvendim me të cilin parashtrësën do ta hedh poshtë.

5.4 Dërgimi i shkresave

Komunikimi i shkresave ka karakter të veprimit procedural, të cilin sipas detyrës zyrtare është e detyruar ta kryejë gjykata.

Gjykata shkresat ua dërgon palëve dhe pjesëmarrësve në procedurë përmes postës. Këto shkresa mund të jenë të zakonshme, rekomande dhe shkresa për fahun postar. Dërgimi i shkresave mund të bëhet edhe përmes personit të cilin e autorizon gjykata për dërgimin e shkresave palëve dhe pjesëmarrësve në procedurë. Një gjë të tillë mund të bëhet edhe përmes shërbimit kompetent të Kuvendit Komunal. Dërgimi i shkresave mund të bëhet edhe përmes personit juridik të regjistruar dhe të autorizuar për kryerjen e punëve të komunikimit. Sipas kësaj, që ndodh edhe në praktikë, gjykatat kanë mundësinë që përveç komunikimit me postë, dërgimin e shkresave të

ndryshme ta bëjnë edhe përmes personave juridik të cilët ofrojnë shërbime të tilla postare. Dërgimi i shkresave mund të bëhet drejtpërsëdrejti edhe në gjykatë.

Kjo do të thotë se nëse pala ose pjesëmarrësi në procedurë gjendet në gjykatë, ndërsa shkresa ka të bëjë me të, nuk ka pengesë që aty të bëhet dorëzimi i shkresës. Këto mënyra të dërgimit të shkresave janë rregulluar me nenin 103.1 të LPK-së.

5.4.1 Problemet që mund të paraqiten lidhur me komunikimin e shkresave

Në disa raste personi që i adresohet shkresa dhe marrësi i shkresës nuk është i njëjtë. Kjo praktikisht ndodhë në rastet kur adresati është person juridik dhe kur pala vepron në gjykim nëpërmjet përfaqësuesit.

5.4.1.1 Rastet kur adresati është person juridik

Në rastet kur shkresa i adresohet organeve shtetërore dhe personave juridik, komunikimi me këta persona bëhet në atë mënyrë që shkresa i dorëzohet personit të autorizuar për pranimin e shkresave ose punëtorit në ambientet e personit juridik ose të organit shtetëror (neni 103.1).

Është paraparë edhe mundësia që komunikimi me personin juridik të bëhet edhe nëpërmjet njësisë së tij, vetëm atëherë kur kjo njësi është përfshirë në proces direkt ose indirekt. Sipas kësaj komunikimi konsiderohet i rregullt në momentin e dërgimit të shkresës në këtë njësi (neni 104).

Në rastet e tilla të komunikimit me organe shtetërore dhe persona juridik nuk vlejnë rregullat për shkresat që duhet dorëzuar personalisht adresatit nga neni 110 të LPK-së, ngase komunikimi konsiderohet se është kryer në rregull në rast se shkresat i janë dorëzuar personave në kuptim të nenit 104.1 të LPK.

Në rastet kur ka ndonjë letërthirrje për seancë nga ana e gjykatës dhe adresati është ushtarak, punonjës i policisë, punonjës në institucione të komunikacionit ajror ose tokësorë, atëherë komunikimi konsiderohet se është në rregull nëse shkresa e tillë i dorëzohet komandës apo eprorit direkt të këtyre personave. Në rastet kurë pjesëmarrja e këtyre personave në këto institucione është e vazhdueshme dhe me prezencë të vazhdueshme dhe të pandërprerë, përveç letërthirrjes për seancë gjyqësore sipas nevojës në këtë mënyrë tu dërgohen edhe shkresat tjera (neni 104.4).

5.4.1.2 Komunikimi i shkresave personave të privuar nga liria

Komunikimi i shkresave me persona të tillë bëhet përmes drejtorisë së burgut apo drejtorisë së institucioneve për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe për kundërvajtje (neni 106). Kjo dispozitë gjen zbatim në praktikë edhe në rastet e personave që gjenden në paraburgim ose edhe janë në vuajtje të dënimit me heqje lirie. Kjo dispozitë vlen edhe për personat që gjenden në ndonjë institucion shëndetësorë apo korrektues e që janë të varur nga urdhrat e ndonjë eprori.

5.4.1.3 Rastet kur pala vepron në gjykim nëpërmjet përfaqësuesit

Ne rastet kur pala vepron në gjykim nëpërmjet përfaqësuesit ligjor apo me prokurë, shkresa nuk i dërgohet palës, edhe pse ajo është adresat, por përfaqësuesit të saj ligjor dhe me prokurë.

5.4.1.4 Si do të veprohet në rastet kur palës i dërgohet shkresa edhe pse është e përfaqësuar qoftë nga përfaqësuesi ligjor ose me prokurë si dhe në rastet kur ka më tepër përfaqësues ligjorë dhe me prokurë?

Në rastet të tilla vetëm dërgimi i shkresës te pala e përfaqësuar edhe pse pala përfaqësohet nga përfaqësuesi ligjor respektivisht me prokurë nuk prodhon kurrfarë efekti juridik. Dorëzimi konsiderohet se është kryer me rregull vetëm atëherë kur shkresa i është dërguar përfaqësuesit ligjor, respektivisht përfaqësuesit me prokurë.

Edhe në rastet kur pala ka më tepër përfaqësues ligjor ose me prokurë, komunikimi i shkresës vetëm palës së përfaqësuar është i pavlefshëm dhe se komunikimi i shkresave konsiderohet se është kryer në rregull nëse shkresa i është dërguar njërit prej tyre.

Kur përfaqësuesi i palës është avokat, komunikimi konsiderohet i rregullt kur shkresa i dorëzohet atij personalisht ashtu edhe kur i dorëzohet të punësuarit në zyrën e tij (neni 108.1 i LPK-së).

5.4.1.5 Komunikimi personalisht adresatit

Për shkresat që kanë rëndësi më të madhe për procedurën kontestimore është paraparë komunikimi personalisht adresatit. Sipas nenit 110 të LPK, është paraparë që padia, përgjigja në padi, letërthirrja për në seancë, urdhërpagesa, aktgjykimi dhe aktvendimi, kundër të cilit lejohet ankimi i veçantë, mjeti i goditjes së vendimit, i dorëzohet personalisht palës, përkatësisht përfaqësuesit ligjor ose me prokurë.

Sipas kësaj dispozite ligjore komunikuesi ka për detyrë që të bëjë edhe një tentim që shkresën t'ia dorëzojë personalisht adresatit, para se t'ia dorëzojë atë personit tjetër.

5.4.1.6 Si do të veprohet në rastet kur personi të cilit duhet dorëzuar personalisht shkresa nuk gjendet atje ku duhet bërë dorëzimi

Në raste të tilla komunikuesi ka për obligim që me anë të një shkrese-njoftim, të cilin ja len ndonjë personi të paraparë për komunikim sipas nenit 111 të LPK, ta njofton atë se në cilën periudhë kohore dhe ditë duhet të ndodhet në banesë apo në vendin e punës me qëllim që shkresa t'ia dorëzohet personalisht.

Në rast se as herën e dytë komunikuesi nuk e gjen adresatin në kohën dhe vendin e përcaktuar me njoftim, atëherë edhe për shkresat që duhet dërguar personalisht do të veprohet në atë mënyrë që ato të dërgohen në mënyrë të zakonshme, duke ua dorëzuar shkresat personave të cilët janë të autorizuar për komunikim të zakonshëm sipas nenit 111 të LPK.

Nëse komunikimi i shkresës është bërë nëpërmjet gjykatës atëherë depozitimi i shkresës bëhet në gjykatë. E nëse komunikimi i shkresës është bërë nëpërmjet postës, atëherë depozitimi i shkresës bëhet në postën e vendbanimit ose vendqëndrimit të palës.

Depozitimi i shkresës sipas nenit 115 të LPK vjen në shprehje vetëm në ato raste kur komunikimi i shkresës nuk mund t'i bëhet personalisht adresatit sipas nenit 110 të LPK dhe as personave të tjerë konform nenit 111 dhe 113 të LPK.

Kur plotësohen kushtet për depozitimin e shkresës, atëherë komunikuesi e lë njoftimin në derë, përkatësisht në arkën postare të adresës së adresatit.

5.4.1.7 Çka duhet të përmbajë njoftimi?

Njoftimi duhet të përmbajë të dhëna se ku depozitohet shkresa, se shkresa mund të merret brenda afatit prej 15 ditësh, nënshkrimin e komunikuesit si dhe të dhëna se pse depozitohet shkresa dhe data e lënies së njoftimit.

Do të konsiderohet se shkresa është dorëzuar në ditën kurë është lënë shkresa, nëse shkresa nuk merret në vendin e depozituar brenda afatit prej 15 ditësh. Për këtë mënyrë të komunikimit duhet të njoftohet gjykata që e ka urdhëruar dërgimin e shkresës.

5.4.1.8 Komunikimi i zakonshëm

Me qëllim që mos të vije deri te zvarritja e procedurës, me ligj është paraparë se shkresa, për të cilën nuk parashihet komunikimi personal, mund t'i dorëzohet personit tjetër, apo mund të lihet në vendin e caktuar me efekt sikur ajo t'i ishte dorëzuar adresatit.

Në rastet kur personi të cilit duhet dërguar shkresa nuk gjendet në banesën e tij, komunikimi konsiderohet i rregullt nëse shkresa i dorëzohet ndonjë anëtar të familjes së tij që është i moshës madhore. Nëse në banesën e adresatit nuk gjendet asnjë person i tillë, atëherë komunikimi konsiderohet në rregull nëse shkresa i dërgohet fqinjtit që jeton afër me adresatin, por vetëm nëse pajtohet për një gjë të tillë.

Në rastet kur komunikimi bëhet në vendin e punës, e adresati nuk gjendet aty, komunikimi konsiderohet i rregullt nëse shkresa i dorëzohet punëtorit i cili punon bashkë me adresatin, me kusht që punëtori ta japë pëlqimin për pranimin e shkresës.

Nuk lejohet një zëvendësim i komunikimit si në rastet e përmendura në rast se personi të cilit duhet dërguar shkresa në procesin kontestimor e ka rolin e kundërshtarit të adresatit. Kundërshtari i adresatit në proces është secili person, kundër të cilit person adresati ka paraqitur ndonjë pretendim në proces dhe secili person, i cili ka paraqitur ndonjë pretendim në proces kundër adresatit. Shembull, nëse adresati është paditësi atëherë kundërshtar në këtë kuptim është pala e paditur ose secili bashkë ndërgjyqës në anën e palës së paditur si dhe ndërhyrësi në anën e palës kundërshtare.

5.4.1.9 Dërgimi i shkresave nga vet palët

Komunikimi i shkresave parimisht dhe zakonisht bëhet ekskluzivisht nëpërmjet gjykatës, mirëpo përjashtimisht lejohet komunikimi i shkresave direkt nga pala tek pala tjetër.

Një mënyrë e tillë e komunikimit të shkresave është e lejuar vetëm nëse kemi të bëjmë me shkresa, të cilat nuk duhen të dorëzohen personalisht.

Në praktikë një mënyrë e tillë e komunikimit ndodhë kur gjykata shprehimisht jep pëlqim se e lejon komunikimin direkt të shkresave dhe në këtë mënyrë pala një ekzemplar do t'ia dërgojë palës kundërshtare ndërsa ekzemplarin tjetër gjykatës që i shërben si njoftim se palës tjetër i është bërë dërgimi që më parë.

5.4.1.10 Refuzimi i pranimit të shkresës dhe veprimi në rastet e tilla

Me nenin 112 të LPK është paraparë rasti kur personi të cilit i është dërguar shkresa, përkatësisht anëtari i rritur i familjes së tij, përkatësisht personi i autorizuar ose i punësuar në organin shtetëror apo në personin juridik, pa ndonjë arsye të ligjshme refuzon ta marrë në dorëzim shkresën, dorëzuesi do t'ia lë në banesë ose në lokalet në të cilat punon personi i tillë apo do t'ia bashkëngjis shkresën në derën e banesës apo lokalit të punës. Në fletë dërgesë do të shënohet dita, ora dhe shkaku i refuzimit të marrjes si dhe vendi ku është lënë shkresa.

Në raste të tilla komunikuesi, shkresën e lenë në banesën apo lokalin në të cilin punon personi që e refuzon pranimin e shkresës, ose e afishon atë në derën e banesës apo lokalit të punës. Komunikuesi në fletë dërgesë e komunikimit shënon orën, ditën dhe shkahun e refuzimit të pranimit, si dhe vendin në të cilin është lenë shkresa dhe kështu konsiderohet se është kryer komunikimi në mënyrë të ligjshme.

Në rastet kur dërguesi i shkresës merr ndonjë informatë nga anëtarët e familjes apo të afërmit se adresati është i paarritshëm dhe se personat e përmendur në nenin 111 paragrafi 1 dhe 2 nuk do kenë mundësi që shkresën t'ia dërgojnë me kohë, atëherë komunikuesi do ta kthejë shkresën në gjykatë. Raste të tilla kemi kur adresati është i paarritshëm për shkak se ka emigruar nga vendi dhe supozohet se për një kohë relativisht të gjatë nuk do të jetë i arritshëm në këtë adresë (neni 113 LPK). Kjo dispozitë ligjore e përjashton zbatimin e dispozitave të neneve 110, 111 dhe 112 të LPK.

5.4.2 Problemet që mund të paraqiten në dërgimin e shkresave në rast të ndërrimit të adresës

Është detyrim i palës, përfaqësuesit të palës, por edhe i pjesëmarrësve të tjerë në një proces kontestimor, siç janë secili bashkë-ndërgjyqës ose edhe secili ndërhyrës, që në rast të ndërrimit të adresës në të cilën bëhet dorëzimi i shkresave që për këtë ta njoftojnë menjëherë gjykatën.

Në rastet kur pala nuk vepron në këtë mënyrë, e komunikuesi nuk ka dijeni për adresë të re të palës, gjykata do të urdhërojë që në të ardhmen palës së tillë komunikimi i shkresave t'i bëhet duke u afishuar ato në tabelën e shpalljeve të gjykatës. Në raste të tilla gjykata merr aktvendim me të cilin urdhëron që komunikimi me palën të bëhet duke u afishuar shkresat në tabelë të shpalljes së gjykatës dhe duke e caktuar njëherit edhe afatin. Sipas kësaj konsiderohet se komunikimi është kryer në mënyrë të rregullt pas kalimit të afatit prej shtatë ditëve pas afishimit

të shkresave në tabelën e shpalljeve të gjykatës (neni 116 LPK). Lidhur me këtë shih rastin praktik.

5.4.3 Rasti kur subjektit të regjistruar në regjistrin publik nuk mund t'i bëhet dorëzimi i shkresës në adresën e treguar në regjistër

Në rastet kur adresati nuk është person fizik por ndonjë subjekt që në mënyrë të veçantë është evidentuar në regjistër publik, atëherë komunikimi i shkresave bëhet në atë mënyrë që shkresa i dorëzohet në adresën e treguar në regjistër dhe nëse dorëzimi i shkresës nuk mund t'i bëhet në adresën e tij, atëherë komunikuesi e kthen shkresën në gjykatë duke shënuar në fletë dërgesë arsyet e kthimit të shkresës në gjykatë. Pasi që gjykata ta vërtetojë se vërtetë adresati ka deklaruar atë adresë, atëherë gjykata me aktvendim do ta afishoj këtë shkresë në tabelë të shpalljes së gjykatës.

Sipas kësaj konsiderohet se komunikimi është kryer në mënyrë të rregullte pas kalimit të afatit prej shtatë ditëve pas afishimit të shkresave në tabelën e shpalljeve të gjykatës (neni 114 LPK). Lidhur me këtë shih rastin praktik.

5.5 Përmbledhje

Në këtë sesion janë përmbledhur çështje të rëndësishme për rregullësin formale të parashtrësive dhe veprimet që ndërmerren nga gjykata për kthimin në plotësim-korrigjim të parashtrësive kur e njëjta nuk është e rregullt. Janë trajtuar edhe pasojat që krijohen nëse palët dështojnë të veprojnë sipas vendimit për plotësim-korrigjim. Temë po ashtu me rëndësi në këtë sesion është edhe dorëzimi i shkresave në mënyrë të rregullt.

6. Seancat, afatet dhe kthimi në gjendjen e mëparshme

6.1 Hyrje

Në këtë sesion janë trajtuar nocionet për seancën gjyqësore, afatet dhe kthimi në gjendjen e mëparshme. Përmes këtij sesiioni synohet që gjyqtarët të njohin specifikat dhe që lidhen me konceptin e seancës gjyqësore, llogaritjen e afateve dhe kthimin në gjendjen e mëparshme. Rendësi e vençant i kushtohet kthimit në gjendjen e mëparshme për shkak të specifikat dhe për shkak të rolit që ka gjykata e shkallës së parë për kthimin në gjendjen e mëparshme.

6.2 Objektivat trajnuës

Pas përfundimit të këtij moduli pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Njohin dhe specifikat e përlllogaritjes së afateve në procedurën kontestimore; dhe
- Zbatojnë dispozita e procedurës kontestimore për kthimin në gjendjen e mëparshme.

6.3 Seancat

Seanca është një termin i caktuar nga ana e gjykatës që i shërben takimit të përbashkët të gjykatës me palët dhe subjektet tjerë për ndërmarrjen e veprimeve procedurale.

Varësisht nga ajo se çfarë aktiviteti është dashur të kryhet në seancë, dallojmë:

- Seancën përgatitore;
- Seancën për shqyrtim kryesor;
- Seancën për shqyrtimin e propozimit për kthimin në gjendjen e mëparshme;
- Seancën për marrjen e provës;

6.3.1 Mënyra e caktimit të seancës gjyqësore

Gjykata me aktvendim konkludent (të nënkuptueshëm – jo formal) e cakton seancën sa herë që një gjë e tillë parashihet me ligj ose kur e kërkojnë nevojat e procedurës.

Gjykata për seancën i njofton palët dhe pjesëmarrësit tjerë me anë të letërthirrjes duke i njoftuar për pasojat ligjore në rast të mos ardhjes në seancë.

Në rastet kur palës bashkë me letërthirrje i dërgohet edhe parashtresa që i ka dhënë shkas caktimit të seancës, në letërthirrje tregohet vendi, lokali dhe koha e mbajtjes së seancës.

Ndërsa në rastet kur palës nuk i dërgohet së bashku me letërthirrje edhe parashtresa, atëherë në letërthirrje do të tregohen palët ndërgjyqëse, objekti i kontestit si dhe aktivitetet që do të zhvillohen në seanca.

Në rastet kur pala paraqitet në seancë pas fillimit të seancës nuk mund të kërkojë përsëritjen e veprimeve procedurale të kryera në mungesë të saj.

6.3.2 Vendi i mbajtjes së seancës

Seanca zakonisht mbahet në ndërtesën e gjykatës por ekzistojnë raste kur gjykata vendos që seanca të mbahet në një vend tjetër, jo në ndërtesën e gjykatës, nëse gjykata e vlerëson si të nevojshme, e që lehtëson qasjen për cilën do palë ose kursen kohën, përpjekjet dhe shpenzimet procedurale.

Nëse gjykata e sheh të arsyeshme mund të mbaj seancën edhe në një vend tjetër jashtë ndërtesës së gjykatës:

P.sh., nëse Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Istog, ka një çështje ku të gjithë paditësit dhe të paditurit janë duke vuajtur një dënim me burg, në burgun e Dubravës Istog, gjykata mund të vendos që seancën ta mbaj në ndërtesën e burgut pasi që shumë më ekonomike do të jetë mbajtja e seancës në ndërtesën e burgut se sa dërgimi i të gjithë palëve në ndërtesën e gjykatës kur dihet së të burgosurit duhet të bartën nën masa të larta të sigurisë.

Shembull tjetër mund të jetë nëse Gjykata Themelore në Prishtinë ka vendosur të dëgjojë në cilësinë e dëshmitarëve tre persona, të cilët gjenden në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës Prishtinë, për shkak të frakturave të shumta të gjymtyrëve. Në këtë rast gjykata mund ta bëjë dëgjimin e tyre në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës Prishtinë, pasi që bartja e këtyre personave deri në ndërtesën e gjykatës mund të jetë e vështirësuar

Për mbajtjen e seancës jashtë ndërtesës së gjykatës vendoset me anë të aktvendimit ndaj të cilit nuk lejohet ankesë.

6.4 Afatet

Afatet janë distanca kohore brenda së cilës duhet të kryhet apo mund të kryhet veprimi procedural i caktuar.

Afatet janë të caktuara me ligj mirëpo varësisht nga rrethanat e rastit konkret mund të caktohen edhe nga gjykata.

Afatet ligjore nuk mund të zgjaten nga ana e gjykatës, ndërsa afatet gjyqësore mund të zgjaten me propozimin e personit të interesuar.

Kundër aktvendimit me të cilin pranohet apo refuzohet propozimi për zgjatjen e afatit gjyqësor nuk lejohet ankesë e veçantë.

6.4.1 Llogaritja e afatit

Afatet llogariten në ditë, muaj dhe vite.

Në qoftë se afati është caktuar me ditë, atëherë nga llogaritja përjashtohet dita, në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme.

Afati që është caktuar në muaj ose në vite mbaron me kalimin e asaj dite të muajit të fundit që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës që ka filluar afati.

Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji.

Kur dita e fundit e një afati bie në ditë feste shtetërore apo ditën e diel ose në ndonjë ditë tjetër kur nuk punon gjykata, afati mbaron në ditën e punës, që vjen pas asaj të pushimit.

6.5 Kthimi në gjendjen e mëparshme

Në rastet kur pala nuk shkon në seancë fare apo e humb afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural dhe për këtë shkak e humb të drejtën që më vonë të kryejë veprimin procedural të lidhur me afat, gjykata do t'i lejojë kësaj pale, me propozimin e saj, ta kryejë më vonë këtë veprim, nëse e konstaton se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen.

Propozimi për kthimin në gjendje të mëparshme i paraqitet gjykatës, në të cilën është dashur të kryhet veprimi procedural i pakryer.

6.5.1 Afati për paraqitjen e propozimit për kthim në gjendjen mëparshme

Propozimi duhet të paraqitet brenda afatit shtatë (7) ditor nga dita kur ka pushuar shkak i mosveprimit, e nëse pala më vonë ka mësuar për mosveprimin, atëherë afati llogaritet nga dita kur ka mësuar për mosveprimin, ndërsa pas kalimit të afati prej 60 ditësh nga dita e mos veprimit nuk mund të kërkohet më kthimi në gjendjen e mëparshme.

Në rastet kur kthimi në gjendjen e mëparshme kërkohet për shkak të mos ruajtjes së afatit për kryerjen e veprimit procedural, propozuesi ka për detyrë që propozimit t'i bashkëngjisë veprimin e shkruar.

Rast nga praktika,

P.sh., nëse pala e pa kënaqur me aktgjykimin apo aktvendimin e gjykatës ndaj të cilit lejohet ankesa, e ka humbur afatin për ankesë, atëherë pala se bashku me kërkesën për kthim në gjendjen e mëparshme duhet që ta dorëzoj edhe ankesën andaj vendimit të gjykatës me të cilin është e pakënaqur. Pra në këtë rast nëse gjykata ja lejon kthimin në gjendjen e mëparshme ankesa e paraqitur se bashku me kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme (në fakt e paraqitur pas afatit të rregullt) konsiderohet si e afatshme dhe lënda i dërgohet gjykatës se shkallës së dytë për shqyrtim të se njëjtës.

Në rast se gjykata e refuzon kërkesën për kthim në gjendjen e mëparshme e cila ishte paraqitur në gjykatë se bashku me ankesën, atëherë duhet që edhe ankesën të hedh si të pasafatshme por kuptohet ndaj aktvendimit me të cilin hedhe ankesa si e paafatshme lejohet ankesë e veçantë.

Gjykata nuk do të lejojë kthimin në gjendjen e mëparshme nëse propozuesi nuk e ka paraqitur brenda afatit propozimin për kthim në gjendjen e mëparshme si dhe në rastin kur nuk ka ardhur në seancën e caktuar për shqyrtimin e propozimit për kthimin në gjendjen e mëparshme.

Propozimin e paraqitur pas afatit, apo propozimin e palejueshëm për kthimin në gjendjen e mëparshme gjykata e hedhë poshtë me anë të aktvendimit.

Nga praktika gjyqësore,

Kur gjykata e hedh poshtë si të pasafatshëm propozimin për kthim në gjendjen e mëparshme, atëherë ndaj aktvendimit me të cilin hedhet poshtë propozimi për kthim në gjendjen e mëparshme lejohet e drejta e ankesës së veçantë.

Për të vendosur lidhur me propozimin për kthimin në gjendjen e mëparshme gjykata cakton seancë vetëm kur një gjë të tillë e propozon pala shprehimisht. Mirëpo përkundër propozimit të palës gjykata nuk do të caktojë seancë për të vendosur lidhur me propozimin nëse faktet në të cilat mbështetet propozimi janë të ditura botërisht (notore) gjykata nuk cakton seancë në asnjë rast. Po në këtë mënyrë gjykata vepron edhe kur faktet, në të cilat mbështetet propozimi janë qartë të pajustificueshme, por edhe kur gjykata ka prova të mjaftueshme në dosjen e lëndës për dhënien e vendimit sipas propozimit për kthimin në gjendjen e mëparshme.

Kur gjykata e aprovon propozimin për kthim në gjendjen e mëparshme procesi kontestimor kthehet në atë gjendje në të cilën ndodhej para mosveprimit dhe prishen të gjitha vendimet që i ka dhënë gjykata për shkak të mosveprimit.

Raste nga praktika,

Psh., nëse gjykata ka marrë aktgjykim në mungesë të t 'paditurit dhe sipas propozimit të t 'paditurit për kthim në gjendjen e mëparshme gjykata vendos që ta lejoj propozimin, atëherë gjykata do të prish aktgjykimin në mungesë dhe do ta kthej procesin në gjendjen në të cilën ka qenë para se të merrej aktgjykimi në mungesë. Pra në këtë rast do të priset aktgjykimin në mungesë dhe gjykata do ta caktoj serish seancën në të cilën do të ftohen në mënyrë të rregullt palët ndërgjyqësore.

Psh., nëse paditësi ka pranuar aktvendimin e gjykatës për plotësimin e padisë me detyrim që brenda 3 (tri) ditësh ta nënshkruaj padinë e panënshkruar, po i njëjti nuk arrin që ta dorëzoj parashtrësën për plotësimin e padisë brenda afati 3 (tre) ditor, ashtu që në ditën e 5 (pestë) dorëzon propozimin për kthim në gjendjen e mëparshme se bashku me parashtrësën për plotësimin e padisë, atëherë gjykata nëse e lejon kthimin në gjendjen e mëparshme do ta konsideroj plotësimin e padisë si të afatshme.

Në qoftë se nuk plotësohen kushtet për kthimin në gjendjen e mëparshme gjykata me aktvendim e refuzon propozimin për kthim në gjendjen e mëparshme.

Kundër aktvendimit me të cilin aprovohet apo refuzohet propozimi për kthim në gjendjen e mëparshme nuk lejohet ankimi i veçantë.

6.5.2 A lejohet ankesa kundër aktvendimit me të cilin vendoset për propozimin për kthim në gjendjen e mëparshme?

Lejohet ankesa vetëm në rastin kur gjykata refuzon propozimin për kthim në gjendjen e mëparshme nga shkak i dhënies së aktgjykimit për shkak të mungesës së palës së paditur nga seanca gjyqësore.

Nga praktika,

Në praktikën gjyqësore nuk ka një "listë" të shkaqeve apo rrethanave që parimisht justifikojnë kthimin në gjendjen e mëparshme, por shkaqet/rrethanat vlerësohen specifikisht për çdo rast nga gjyqtari i çështjes. Megjithatë praktika gjyqësore ka të ndërtuar një standard të nënkuptueshëm të shkaqeve/rrethanave që justifikojnë lejimin e kthimit në gjendjen e mëparshme e në lidhshmëri me këtë edhe të shkaqeve/rrethanave që nuk e justifikojnë lejimin e kthimit në gjendjen mëparshme.

Psh., nëse njëra nga palët ndërgjyqësore nisët që të shkoj në gjykatë sepse ka një seancë gjyqësore, mirëpo gjatë rrugës pëson aksident komunikacioni dhe për pasoj nuk arrin në seancë gjyqësore. Nën supozimin se kjo palë paraqet propozim për kthim në gjendjen e mëparshme me provat përkatëse (si raporti i aksidentit, etj) sigurisht që gjykata do ta vlersoj këtë propozim dhe arsyet e paraqitur do të justifikojnë kthimin në gjendjen e mëparshme.

P.sh., nëse njëra nga palët ka dështuar të marr pjesë në seancë gjyqësore apo të kryej një veprim që lidhet me afta (psh, të plotësoj padinë, të paraqes ankesë, etj.) sepse ditën e fundit të aftit ligjore është sëmurë dhe është dërguar për tretman shëndetësor në spital, sigurisht që propozimit për kthim në gjendjen e mëparshme nëse i bashkëngjitën provat që dëshmojnë se pala është penguar për arsye shëndetësore të ndërmarr një veprim të caktuar do të pranohet nga gjykata dhe do të lejohet kthimi në gjendjen e mëparshme.

6.6 Përmbledhje

Në këtë sesion janë dhen shpjegime dhe janë paraqitur raste e shembuj nga praktika gjyqësore në përpjekje që diskutimet teorike të materializohen me shembujt dhe raste nga praktika gjyqësore. Lidhur me kthimin në gjendjen e mëparshme janë paraqitur edhe disa rrethana që në praktikën gjyqësore shfaqen me së shumti si shkak për kthimin në gjendjen e mëparshme.

7. Përfundimi i procedurës me vendim të gjykatës

7.1 Hyrje

Në këtë sesion është trajtuar një prej çështjeve me të rëndësishme në kuadër të procedurës kontestimore “*përfundimi i procedurës me vendime të gjykatës*”. Ky sesion është jashtëzakonisht i rëndësishme sepse i referohet vendimeve gjyqësore që nxjerrin gjykata në procedurat kontestimore për përfundimin e procedurës. Në këtë sesion janë elaboruar me detaje struktura dhe përmbajta e aktgjykimi.

7.2. Objektivat trajnues

Pas përfundimit të këtij moduli pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Njohin strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimit;
- Zbatojnë dispozitat për nxjerrjen e aktgjykimit;
- Zbatojnë dispozitat për nxjerrjen e aktgjykimit plotësues dhe të dispozitat për korrigjimin e aktgjykimit.

7.3 Aktgjykimi

Funksioni gjyqësor qëndron në rendë të parë në zbatimin e normave juridike në situatën konkrete në të cilën ndodhet marrëdhënia shqoqërore konkrete. Me vendimin e gjykatës nuk krijohen raporte të reja materialo-juridike në mes të palëve ndërgjyqësore, e as nuk ndryshohen raportet e krijuara më parë në mes të palëve ndërgjyqësore. Në procedurën kontestimore gjykata nuk krijon të drejtat subjektive e as që i ndryshon apo i ndërpretë të drejtat e tilla ekzistuese. Ajo vetëm bënë konkretizimin e së drejtës objektive duke e zbatuar normën juridike abstrakte për ngjarjen ose gjendjen faktike të vërtetuar në procesin kontestimor.

Procesi i krijimit të vendimit kalon nëpër disa hapa të cilët ndiqen njëri pas tjetrit. Së pari, konstatohet gjendja faktike, mandej duhet gjetur rregullën juridike me të cilën është rregulluar marrëdhënia juridike konkrete në lidhje me të cilën ka lindur kontesti, pas kësaj gjendja faktike e konstatuar i nënvihet rregullës juridike dhe së fundi evidentohen pasojat juridike të cilat norma juridike i lidhë për faktet e konstatuara.

Vendimi i gjykatës për themelësinë apo pathemelësinë e kërkesëpadisë manifestohet si përfundim (conclusio) i silogjizmit logjik (gjyqësor) në të cilin premisën e sipërme ose të madhe (praemisa maior) e përbënë normën juridike abstrakte, kurse premisën e poshtme ose të vogël (praemisa minor) gjendja faktike e konstatuar nga gjykata gjatë gjykimit.

Themeli faktik i vendimit gjyqësor- themelin faktik (premisën e poshtme) të vendimit gjyqësor e përbëjnë faktet të cilat gjykata i konstaton gjatë gjykimit dhe për të cilat mendon se janë të rëndësishme për zbatimin e normës me qëllim të dhënies së vendimit.

Cilat fakte do të konsiderojë relevante gjykata për të vendosur për themelësinë e kërkesëpadisë do të varet vlerësimi që ka gjykata për kualifikimin e fakteve në raport me normën materialo-juridike. Pavarësisht se baza juridike si element i padisë është element fakultativ për të cilin nuk

është e lidhur gjykata, gjithsesi baza e paraqitur nga pala që kërkon mbrojtje gjyqësore apo mundësia që natyra e kërkesës sipas fakteve të paraqitura të kualifikohet në raport me normën apo normat e caktuara materialo-juridike i jep mundësinë gjykatës që të konstatojë se cilat fakte janë relevante.

Në sistemin tonë të procedurës kontestimore barra e të provuarit parimisht u takon palëve. Pra palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë provat me të cilat konstatohen faktet e tilla. Është detyrë e gjykatës që të vendosë se cilat prova do të merren me qëllim të vërtetimit të fakteve vendimtare.

Fondi i fakteve të cilat i merrë në vlerësim gjykata me rastin e vendosjes meritore përbëhet nga faktet jokontestuese të paraqitura nga palët, faktet kontestuese por të cilat janë provuara në procedurën e të provuarit, faktet e ditura botërisht (të cilat nuk ka nevojë të provohen) dhe faktet e prezumuara nga ligji, e të cilat provohen vetëm nëse kontestohen.

Faktet vendimtare përbëjnë gjendjen e çështjes dhe gjykata vendimin e saj e mbështet në gjendjen faktike që ekziston në momentin e përfundimit të seancës së fundit të shqyrtimit kryesor.

Themeli juridik i vendimit gjyqësor- themelin juridik të vendimit gjyqësor e përbënë norma juridike e cila duhet të zbatohet, në rastin konkret, për gjendjen faktike të konstatuar gjatë gjykimit.

Është detyrë e gjyqtarit që të konstatojë ekzistimin e normës materialo-juridike që përputhet me gjendjen e çështjes dhe pasi të konstatojë ekzistimin e normës të bëjnë kualifikimin e gjendjes së çështjes në përputhje me normën duke dhënë edhe vlerësimet dhe arsyetimin se si gjykata ka ardhur në përfundimin e tillë. Gjyqtari duhet të thellohet në esencën e raportit kontestues sespe norma juridike me të cilën parashihet se si duhet të sillen subjektet e së drejtës e ka parasysh gjithmonë gjendjen faktike abstrakte dhe hipotetike. Gjyqtari e krahason gjendjen faktike të konstatuar nga gjatë gjykimit me gjendjen faktike hipotetike të normës juridike dhe si përfundim i nxjerrë pasojat juridike për rastin konkret.

Me aktgjykim gjykata vendosë për themelësinë e kërkesëpadisë e cila është objekt i gjykimit. Aktgjykimi është lloji i vendimit gjyqësor me anë të të cilit vendoset për bazën e kërkesëpadisë. Në teorinë procedurale aktgjykimi definohet si akt i gjykatës me të cilin, sipas rregullës, pas përfundimit të shqyrtimit vendoset për çështjen kryesore dhe për kërkesat dytësore. Aktgjykimi është vendim përfundimtar, me të cilin, sipas rregullës, përfundon procedura kontestimore e shkallës së parë. Aktgjykimi është vendim meritore sepse me anë të aktgjykimit vendoset se a e meriton pala mbrojtjen juridike që e kërkon nga gjykata. Aktgjykimi është akt individual me të cilin zgjidhet kontesti në atë mënyrë që bëhet konkretizimi i normës juridike abstrakte mbi gjendjen faktike individuale të vërtetuar në procedurën kontestimore. Me rastin e vendosjes për çështjen kryesore gjykata është e lidhur me kërkesën e palëve. Ajo nuk mund të vendosë për asgjë tjetër, përveç për atë që ka kërkuar pala. Gjikata me rastin e vendosjes meritore ka për detyrë që të vendosë për të gjitha kërkesat në mënyrë të plotë.

7.4 Përmbajta e aktgjykimit

Aktgjykimi duhet të përmbajë pjesën formale dhe materiale. Përmbajtjen formale e përbëjnë pjesët e aktgjykimit, ndërsa përmbajtjen materiale e përbën PËRMBAJTJA e vendimit me të cilin pranohet apo refuzohet aktgjykimi.

Përmbajtja formale e aktgjykimit

Pjesa Hyrëse

Sipas nenit 160.2 të LPK-së, pjesa hyrëse e aktgjykimit përmban këto informacione:

- emrin e gjykatës,
- emrin dhe mbiemrin e gjyqtarit,
- emrin dhe mbiemrin, vendbanimin, gjegjësisht vendqëndrimin e palëve,
- identifikimin e përfaqësuesve ligjorë dhe me prokurë të palëve,
- përshkrimin e shkurtër të objektit të kontestit dhe vlerën e tij,
- ditën e përfundimit të shqyrtimit kryesor,
- përshkrimin e versionit të palëve lidhur me kontestin dhe të përfaqësuesve të tyre ligjorë dhe me prokurë që kanë qenë të pranishëm në seancën për shqyrtim,
- ditën kur është dhënë aktgjykimi.

Dispozitivi

Sipas nenit 160.3 të LPK-së, dispozitivi i aktgjykimit përmbanë:

- vendimin me të cilin aprovohen apo refuzohen kërkesat e veçanta që kanë të bëjnë me çështjen kryesore dhe kërkesat aksesore,
- vendimin për ekzistimin apo mosekzistimin e kërkesës së parashtruar me qëllim kompensimi të saj me kërkesëpadinë,
- vendimin mbi shpenzimet procedurale.

Pjesa e arsytimit

Në pajtim me nenin 160.4 dhe 5 të LPK-së, në pjesën e arsytimit të aktgjykimit, gjykata duhet të përfshijë rezultatet e veprimeve të mëposhtme:

- Kërkesat e palëve;
- Faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar palët;
- Specifikimi se cilat nga faktet e tilla janë vërtetuar, dhe arsyet përse janë vërtetuar ato fakte;
- Përshkrimin se si janë vërtetuar ato fakte, nëse faktet janë vërtetuar me anë të provave, duhet të saktësohet se cilat prova i ka shfrytëzuar gjykata dhe si i ka vlerësuar ato;
- Dispozitat e së drejtës materiale të cilat janë zbatuar në nxjerrjen e aktgjykimit;
- Deklarimi për pretendimet e palëve lidhur me bazën juridike të kontestit, si dhe propozimet dhe kundërshtimet e tyre për të cilat gjykata nuk ka arsyetuar vendimet e nxjerra më parë në procedurë.

Udhëzimi mbi të drejtën në ankesë

Sipas nenit 160.1 të LPK-së, aktgjykimi duhet të përmbajë udhëzimin mbi të drejtën në ankesë.

Nënshkrimi

Neni 159 i Ligjit për Procedurën Kontestimore përcakton që aktgjykimin burimor e nënshkruan gjyqtari.

Përmbajtja materiale e aktgjykimit (përmbajtja e vendimit)

Përmbajtjen materiale e përbëjnë pjesët përbërëse të aktgjykimit të përpiluar me shkrim. Përmbajtjen materiale e përmban përmbajtja e vendimit me të cilin pranohet apo refuzohet kërkesëpadia.

- Udhëzime për Shkrimin dhe Arsyetimin e Aktgjykimit Sipas Strukturës Formale të Aktgjykimit

Pjesa hyrëse

Në pjesën hyrëse të aktgjykimit nuk ka hapësirë për shfaqje kreative të gjykatës/gjyqtarit, përveç se duhet të ndiqen me korrektësi kërkesat për të dhënat e nevojshme sipas dispozitës së nenit 160.2 të LPK-së.

Numri i lëndës: [...]
Gjykata Themelore e [...] [Emri / mbiemri i gjyqtarit]
[Emri / mbiemri i palëve dhe vendbanimi apo vendqëndrimi i palëve]
[Emri / Mbiemri i përfaqësuesve ligjorë dhe të autorizuar të palëve që janë të pranishëm në shqyrtim gjyqësor]
[Përshkrimi i objektit të kontestit dhe vlerës së kërkesës]
[Dita e shqyrtimit kryesor]
[Përshkrimin e versionit të palëve lidhur me kontestin dhe të përfaqësuesve të tyre ligjorë dhe me prokurë që kanë qenë të pranishëm në seancën për shqyrtim]
[Kohën dhe datën kur është dhënë aktgjykimi]

Dispozitivi i aktgjykimit

Sipas nenit 160.3 të LPK-së, dispozitivi i aktgjykimit përmban:

- vendimin me të cilin aprovohen apo refuzohen kërkesat e veçanta që kanë të bëjnë me çështjen kryesore dhe kërkesat aksesore,
- vendimin për ekzistimin apo mosekzistimin e kërkesës së parashtruar me qëllim kompensimi të saj me kërkesëpadinë,
- vendimin mbi shpenzimet procedurale.

Dispozitivi i aktgjykimit është pjesa qendrore dhe kryesore e secilit aktgjykim. Dispozitivi i aktgjykimit përmban vendimin meritore lidhur me kërkesat kryesore dhe aksesore. Dispozita e nenit 160 paragrafi 3, e LPK-së, përcakton me saktësi se gjykata në dispozitivin e aktgjykimit duhet të vendosë për aprovimin apo refuzimin e kërkesave kryesore dhe aksesore, pastaj për kërkesën e parashtruar me qëllim të kompensimit të saj nëse ekziston dhe në fund pjesë e dispozitivit të aktgjykimit është edhe vendimi mbi shpenzimet.

Vlen që të theksohet se dispozitivi i aktgjykimit është përfundimi që ka arritur gjykata sipas vlerësimit të saj mbi themelësinë apo pathemelësinë e kërkesëpadisë. Në fakt dispozitivi i aktgjykimit edhe kur gjykata vendosë për aprovimin apo refuzimin e kërkesave qoftë kryesore apo aksesore është analoge me kërkesëpadinë (petitumin) sipas të cilit është propozuar përmbajtja e mbrojtjes gjyqësore që e kërkon paditësi në gjykatë.

Në çdo rast gjykata gjatë shqyrtimit përgaditor të padisë duhet të sigurohet nëse kërkesëpadia është e artikuluar në formën që sipas saj do të jetë i lejueshëm zhvillimi i shqyrtimit kryesor. Në rast se kërkesëpadia nuk është artikuluar në formë të tillë që procesin gjyqësor do ta bënte të lejueshëm, atëherë gjykata duhet të marrë masa për evitimin e të metave për shkak të t'cilave nuk

mund të zhvillohet gjykimi. Në këtë rast kërkesëpada sidomos ajo detyruese duhet ta saktësoj subjektin e detyruar, për çka detyrohet (me saktësi detyrimi duhet të shënohet sepse në të kundërt do të paraqesë vendim të pa përmbarueshëm) dhe subjektin me cilësi të kreditorit. Nëse procesi gjyqësor është zhvilluar sipas një kërkesë e cila nuk ka saktësuar siç kërkohet për cilin do element që e bënë të pa përmbarueshëm vendimin e gjykatës atëherë në procedurën e ankesës një vendim i tillë do të kualifikohet si vendim i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për shkak të të cilave çështja do të kthehet në rishqyrtim.

Kështu edhe praktika gjyqësore konsideron: (Gjykata e Apelit e Kosovës, me AC.nr.1764/13, përcakton se:

“ Aktgjykimi është i përfshirë edhe në shkelje nga neni 182 paragrafi 1 e lidhur me nenin 102 paragrafi 1, 99 paragrafi 2 dhe 253 paragrafi 1, pika (a) të LPK-së, sepse në çdo rast kur gjykata konstaton se një parashtrësë nuk është e plotë përkatësisht nuk i përmban të dhënat e kërkuara siç përcaktohet me dispozitën e neni 99 paragrafi 2, i LPK-së, të njëjtën duhet të kthejë në plotësim. Në çdo rast elementet përbërëse të parashtrësës sipas neni 99 paragrafi 2, janë objekt i kontestit dhe përmbajtja e deklaratës, të cilat elemente për padinë si parashtrësë janë ekuivalent me kërkesën e caktuar në pikëpamje të çështjes kryesore dhe kërkesave aksesore, për të cilat elemente nëse mungojnë padia duhet të kthehet në plotësim. Pra në këtë rast kur para gjykatës së shkallës së parë është paraqitur padia pa e specifikuar me saktësi kërkesën, gjykata është detyruar ta kërkojë plotësimin”.

Kuptohet që gjykata dispozitivin e aktgjykimit mund ta strukturojë ndryshe nga petitumi-kërkesëpadia, sepse dispozitivi duhet të jetë i kuptueshëm, i qartë dhe i përmbarueshëm, prandaj gjykata për ta ruajtur harmoninë e dispozitivit në shumë raste përdorë pika, paragraf brenda dispozitivit me të cilat vendos për aprovimin e kërkesave specifike apo refuzimin e tyre. Prandaj kemi theksuar që qysh në fillim të shqyrtimit paraprak të padisë gjykata duhet të kujdeset për rregullsinë formale të padisë veçanërisht të kërkesës-petitumit sepse në mungesë të një kërkesë/ave të qartë do të kemi pastaj edhe një dispozitiv të parregullt.

Dispozitivi duhet të formulohet në formën e një norme juridike por i kufizuar në rastin individual sipas specifikave individuale.

Në rastet kur gjykata vendosë për pranimin e padisë detyruese duhet të shënojë në pjesën urdhëruese në mënyrë të qartë e të saktë, pa lënë shteg për asnjë dyshim se kush detyrohet, për çka detyrohet dhe në dobi të cilit detyrohet. Nëse bëhet fjalë për kërkesë/a të cilat refuzohen tërësisht apo pjesërisht gjykata duhet të shënojë me saktësi pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë në mënyrë që pasi aktgjykimi të bëhet i formës së prerë të kemi mundësi për të identifikuar se çka në fakt përbën çështjen e gjykuar. Gjithmonë edhe kur refuzohet kërkesëpadia apo një pjesë e saj duhet të shënohet se është refuzuar në tërësi duke përshkruar përmbajtjen e kërkesës së refuzuar, apo kur refuzohet pjesërisht të shënohet se është refuzuar pjesërisht duhet e përshkruar edhe përmbajtjen e pjesës së përshkruar.

Në pjesën e dispozitivit të aktgjykimit kur vendoset për shpenzimet e procedurës në fakt pjesa e aktgjykimit që ka të bëjë me shpenzimet të procedurës është aktvendim sipas dispozitës së neni 142 paragrafi 6 i LPK-së.

Përveç aktvendimit mbi shpenzimet e procedurës praktika gjyqësore ka lejuar mundësinë që dispozitivi i aktgjykimit të përmbajë edhe ndonjë aktvendim tjetër, për shembull aktvendimin për masat e sigurimit të kërkesëpadisë apo të ndonjë veprimi procedural i cili është marrë nga gjykata në përfundim të shqyrtimit kryesor.

Arsyetimi i aktgjykimit

Çdo gjykatës duhet të ketë pikësynim që me rastin e vendosjes në një çështje juridike civile përveç se të vendos drejtë dhe ligjshëm vendimi i gjykatës të jetë edhe bindës. Komponent e padiskutueshme për të krijuar besueshmëri në objektivitetin e gjykatës dhe ligjshmërinë e vendimeve të gjykatës është arsyetimi i aktgjykimit. Përmes arsyetimit të aktgjykimit duhet të prezantohet në mënyrë të besueshme një pamje e gjithë procesit gjyqësor duke përfshirë edhe konkludimet e gjykatës.

LPK, me dispozitën e nenit 160 paragrafi 4, përcakton se: *“Arsyetimi i aktgjykimit përmban: kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato”*, ndërsa në paragrafin 5 të nenit të njëjtë përcaktohet se: *“Gjykata posaçërisht tregon se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve. Kur është nevoja gjykata deklarohet edhe lidhur me qëndrimet e palëve për bazën juridike të kontestit, si dhe për propozimet dhe prapësimet e tyre, për të cilat gjykata nuk ka bërë arsyetime të vendimeve që i ka dhënë më herët gjatë procesit gjyqësor”*.

Referuar dispozitës së cituar për arsyetimin e aktgjykimit mund të konkludojmë se ligjdhënësi përveç strukturës së aktgjykimit apo pjesës formale ka përcaktuar edhe kornizat e përmbajtjes së aktgjykimit veçanërisht të arsyetimit të aktgjykimit. Përmes përmbajtjes së përcaktuar janë saktësuar hapa që duhet të ndjekë gjykata gjatë arsyetimit të aktgjykimit në mënyrë që të sigurohemi se përmes aktgjykimit përveç se do të vendoset drejtë dhe ligjshëm një çështje kontestuese të sigurohet edhe besimi se gjykata ka vendosur drejtë dhe ligjshëm.

Hapat që duhet ndjekur gjatë arsyetimit të aktgjykimit janë të renditura sipas një kronologjije logjike dhe juridike në mënyrë që përmes arsyetimit të prezantohet figura e plotë e çështjes kontestuese dhe vlerësimet respektivisht përfundimi i gjykatës.

Praktika gjyqësore është e prerë sa i përket arsyetimit të aktgjykimit respektivisht përmbajtjes që duhet të ketë arsyetimi i aktgjykimit sipas dispozitave të cituara nga neni 160 paragrafi 4 dhe 5 i LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës dhe rrjedhimisht edhe Gjykata Supreme e Kosovës, gjatë vendosjes në procedurën sipas mjeteve të goditjes të rregullta dhe të jashtëzakonshme, duke i ekzaminuar vendimet e gjykatave të instancës më të ulët lidhur me arsyetimin e aktgjykimit sipas pretendimeve ankimore ka raste kur kanë konstatuar shkelje për shkak se arsyetimi i aktgjykimit nuk është në përputhje me dispozitat e LPK-së, për përmbajtjen e arsyetimit. Prandaj për të kaluar testin e vlerësimit nga gjykata e shkallës së dytë dhe gjykata e shkallës së tretë aktgjykimi duhet të jetë i arsyetuar sipas kërkesave të LPK-së.

7.4. Aktgjykimi plotësues

Nëse gjykata me vendim meritator nuk ka vendosur për ndonjë kërkesë të palës, atëherë ajo mund të kërkojë që gjykata të vendos lidhur me këtë kërkesë.

LPK sa i përket kërkesës nuk bën dallim në mes të kërkesave kryesore dhe atyre aksesore. Me dispozitën e nenit 162.1 të LPK-së, është përcaktuar se: *“Po që se gjykata nuk ka vendosur mbi të gjitha kërkesat që është dashur të përfshihen në aktgjykim, ose kur vetëm një pjesë e kërkesës ka mbetur pa u përfshirë me të, pala mundet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur i është dorëzuar aktgjykimi t’i propozojë gjykatës që të bëjë plotësimin e tij”*. Po që se pala nuk paraqet propozimin brenda afatit do të konsiderohet se është tërhequr padia në pjesën që

nuk është përfshirë në aktgjykimin e dhënë. Propozimi i vonuar për plotësimin e aktgjykimit hidhet poshtë nga ana e gjykatës ndërsa propozimi i pathemeltë refuzohet nga gjykata pa u caktuar seanca gjyqësore.

Nga të cekurat rrjedh se gjykata do ta plotësojë aktgjykimin nëse plotësohen disa kushte në mënyrë kumulative:

- Nëse nuk është vendosur për të gjitha kërkesat apo për një pjesë të kërkesës,
- nëse paraqitet propozimi për plotësim nga pala dhe
- nëse propozimi për plotësim të aktgjykimit është i afatshëm.

Vlerësojmë se gjykata nuk mundet ex officio të bëjë plotësimin e aktgjykimit pa pasur propozim nga pala.

Konsiderohet se është kërkesë për plotësim edhe ankesa e cila mbështetet vetëm në shkakun se gjykata nuk ka vendosur për tërë kërkesëpadinë, pra në këtë rast gjykata ankesën duhet ta trajtoj si kërkesë për plotësimin e aktgjykimit.

Paditësi i cili nuk e ka parashtruar kërkesën për plotësimin e aktgjykimit nuk e humb të drejtën që për pjesën e pavendosur të paraqesë padi të re.

Në qoftë se propozimi për plotësimin e aktgjykimit i referohet vetëm kërkesës për shpenzime atëherë gjykata nuk vendos me aktgjykim por me aktvendim.

Kundër aktgjykimit plotësues lejohet ankesë e veçantë.

7.5 Dhënia, hartimi me shkrim dhe dërgimi i aktgjykimit

Parimisht, aktgjykimi duhet dhënë menjëherë pas përfundimit të shqyrtimit kryesor. Gjithashtu, menjëherë pas dhënies aktgjykimi duhet shpallur në seancë.

Sipas dispozitës së nenit 153.1 të LPK-së, gjykata e jep aktgjykimin më së voni brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e përfundimit të shqyrtimit kryesor. Koha në të cilën jepet aktgjykimi quhet dita në të cilën ai hartohet me shkrim.

Në qoftë se gjyqtari e kalon afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh për dhënien e aktgjykimit ai ka për detyrë ta njoftojë kryetarin e gjykatës për shkaqet e tejkalimit të tij.

Mos përmbajtja ndaj afatit për dhënien e aktgjykimit nuk ka kurrfarë pasojash procedurale-juridike për palët, ndërsa për gjyqtarin mos përmbajtja e afatit mund të ketë pasoja administrative të natyrës disiplinore.

Shpallja e aktgjykimit- pas përfundimit të shqyrtimit kryesor gjykata i njofton palët e pranishme për ditën e dhënies së aktgjykimit, e në qoftë se ndonjëra nga palët nuk merr pjesë në seancë atëherë gjykata duhet që ta njoftojë me shkrim.

Duhet theksuar se në praktikën gjyqësore në vendin tonë nuk respektohet detyrimi i shpalljes së aktgjykimit përveç në një numër të vogël kontestesh, pasi që në praktikën gjyqësore respektohet detyrimi i gjykatës që palës t'i dërgojë aktgjykimin me shkrim siç parasheh dispozita e nenit 155.2 e LPK-së.

Mos shpallja e aktgjykimit nga gjykatat tona është edhe pasoja e procedurës shumë formale që parasheh dispozitat e nenit 154 paragrafi 1 e LPK-së, me të cilën përcaktohet detyrimi i gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit kryesor t’i njoftojë palët e pranishme për ditën e dhënies së aktgjykimit (mendohet për shpalljen e aktgjykimit), e rrjedhimisht në qoftë se ndonjëra nga palët nuk ka marrë pjesë në seancën për shqyrtim kryesor, gjykata më shkrim ta njoftojë të njëjtën për ditën e dhënies së aktgjykimit. Vlerësojmë se kjo është një procedurë shumë formale që është në kundërshtim me parimin e ekonomizimit të procedurës, prandaj ne insistojmë që të respektohet afati për hartimin me shkrim brenda 15 ditësh, ndërsa për detyrimin e shpalljes së aktgjykimit gjithsesi mendojmë se është një detyrim ligjor që duhet respektuar, por rrethanat praktike sigurisht që do të ndikojnë që ky detyrim që mos jetë i zbatuar. Në këtë aspekt paraqitet edhe një problematikë që lidhet më afatin e ankimit pasi që sipas dispozitës së nenit 154.2 të LPK-së, parashihet se në qoftë se palët janë njoftuar rregullisht për ditën e dhënies së aktgjykimit, afati për ankim kundër aktgjykimit fillon të ecë ditën e nesërme pas dorëzimit të aktgjykimit. Në këtë kontekst shtrohet pyetja çka nëse palët nuk janë njoftuar rregullisht për ditën e dhënies së aktgjykimit sidomos kur njëra palë nuk ka marrë pjesë në seancën, çka ndodh me afatin nëse njëra palë ka qenë e njoftuar rregullisht dhe nuk ka marrë pjesë.

Mendojmë se dispozitat ligjore janë të paqarta, e për rrjedhojë ka ndikuar edhe në krijimin e praktikës që palëve t’ju dërgohet aktgjykimi me shkrim pa e shpallur paraprakisht gjykata të njëjtin.

Aktgjykimi burimor - aktgjykimin burimor e nënshkruan gjyqtari. Nga kjo rrjedhë se gjyqtari e nënshkruan vetëm një dokument origjinal (aktgjykimin burimor). Sipas kuptimit të dispozitës së nenit 159 rrjedhë se palëve të kontestit duhet tu dërgohet kopja e legalizuar e aktgjykimit, ndërsa aktgjykimi burimor duhet të ruhet së bashku me shkresat e lëndës në gjykatë. Praktika gjyqësore është e ndryshme pasi që gjykatat tona palëve u dërgojnë nga një kopje të aktgjykimit të cilat janë të nënshkruara nga gjyqtari, ndërsa praktika tregon se në gjykatën e shkallës së dytë dhe të tretë respektohet kuptimi i kësaj dispozite.

Momenti i komunikimit të aktgjykimit në aspektin procedural është i rëndësishëm sepse nga ky moment fillon të ecë afati partitiv (afati i përmbushjes vullnetare të detyrimit) e gjithashtu fillon të ecë edhe afati për të drejtën e ankesës. Këtu bëhet fjalë për dorëzimin e aktgjykimit palëve e jo shpalljen e tij.

7.6 Korrigjimi i aktgjykimit

Korrigjimi i aktgjykimit i referohet vetëm mungesave që kanë të bëjnë me gabimet e bëra në shkrim ose llogari, si dhe pasaktësitë e dukshme të vendimit. Të kësaj natyre janë edhe gabimet në lidhje me formën e aktgjykimit si dhe mospajtimi midis kopjes dhe origjinalit të aktgjykimit. LPK-ja me dispozitën e nenit 165 i referohet korrigjimit të aktgjykimit.

Sipas dispozitës së nenit 165.1 përcaktohet se: *“gabimet në emra dhe numra, si dhe gabimet tjera në shkrim dhe llogaritje, mungesat në aspektin e formës së aktgjykimit dhe mospajtimi midis kopjes me origjinalin e aktgjykimit, e korrigjon gjykata në çdo kohë”*.

Gjykata për korrigjimin e gabimeve nxjerrë aktvendim të posaçëm dhe një kopje e këtij aktvendimi u dërgohet palëve.

Në qoftë se midis origjinalit dhe kopjes së aktgjykimit ka mospajtime atëherë palëve u dërgohet nga një kopje e korrigjuar e aktgjykimit, duke u treguar se më këtë kopje të aktgjykimit

zëvendësohet kopja e mëparshme e aktgjykimit. Në këtë rast afati për ankim kundër pjesës së korrigjuar fillon të ecë nga dita e pranimit të kopjes së korrigjuar nga palët.

Për korrigjimin e aktgjykimit gjykata vendos pa dëgjimin e palëve. Kundër aktvendimit me të cilin bëhet korrigjimi i aktgjykimit lejohet ankesë e veçantë.

Gabimet përkatësisht mungesat në aktgjykim të cilat janë bazë e korrigjimit të aktgjykimit nuk guxojnë të jenë rezultat i formulimit të gabuar të vullnetit të gjykatës në kohën e dhënies së vendimit, sepse me anë të korrigjimit nuk mund të ndryshohet vullneti i gjykatës i formuar me rastin e dhënies së vendimit, pasi që gjykata është e lidhur me të nga momenti i shpalljes së aktgjykimit.

7.8 Forma e prerë e aktgjykimit

Marrëdhëniet e ndryshme juridike të palëve në kontest caktohen në mënyrë përfundimtare, atëherë kur vendimi i gjykatës merrë formën e prerë.

Pas marrjes së formës së prerë, vendimi fiton fuqinë e “*gjësë së gjykuar*” që do të thotë se pala që ka fituar gjyqin mund të vërë vendimin në përmbarrim të detyrueshëm në qoftë se ai nuk ekzekutohet vullnetarisht nga subjekti që ka humbur gjykimin (debitori).

Sipas dispozitës së nenit 166.1 të LPK-së, parashihet se “*aktgjykimi i cili nuk mund të goditet me anë të ankesës bëhet i formës së prerë për aq sa është vendosur me të mbi kërkesëpadinë apo të kundërpadisë*”.

Është detyrë e gjykatës që ex-officio gjatë tërë procedurës të kujdeset nëse çështja objekt i shqyrtimit është gjithë e gjykuar. Nëse konstatohet se kemi të bëjmë me çështje të gjykuar padia hedhet poshtë si e palejueshme.

Aktgjykimi mund të bëhet i formës së prerë:

- nëse palët kanë hequr dorë nga e drejta për të parashtruar ankesë,
- nëse palët i kanë tërhequr ankesat e paraqitura,
- nëse ka kaluar afati për paraqitjen e ankesës dhe
- nëse ka vendosur gjykata e shkallës së dytë duke e refuzuar ankesën dhe duke e vërtetuar vendimin e shkallës së parë.

Sipas LPK-së, kundër të gjitha aktgjykimeve lejohet e drejta e ankesës, prandaj në asnjë rast aktgjykimi nuk mund të bëhet i formës së prerë në mënyra tjera përveç mënyrave të cekura.

Aktgjykimi i formës së prerë prodhon efekt juridik vetëm ndërmjet palëve ndërgjyqëse, përveç kur nga shkak i natyrës së raportit kontestues apo, sipas urdhrit të ligjit, prodhon efekt kundër personave të tretë.

7.9 Llojet e Aktgjykimeve

Ndarja e aktgjykimeve mund të bëhet në bazë të disa kriterëve. Më i rëndësishme është kriteri sipas përmbajtës së mbrojtjes juridike që jepet me aktgjykim. Sipas këtij kriteri klasifikimi bëhet sipas llojeve të padive respektivisht qëllimit që dëshiron të arrijë paditësi në procedurë gjyqësore. Llojet e aktgjykimit sipas këtij kriteri janë: aktgjykimi detyrues (dënues, kondemnator), aktgjykimi vërtetues (deklarativ) dhe aktgjykimi transformues (konstituiv).

Aktgjykimet mund të klasifikohen edhe sipas vëllimit të mbrojtjes juridike që jepet me aktgjykim. Sipas këtij kriteri bëhet dallim në mes të aktgjykimit të pjesshëm dhe aktgjykimit plotësues.

Aktgjykimet mund të klasifikohen edhe sipas sjelljes së palës së paditur në gjykim. Sipas këtij kriteri aktgjykimi mund të jetë kontradiktor dhe jo kontradiktor.

Për shkak të specifikave që përmban arsyetimi i secilit lloj të aktgjykimit në këtë pjesë do të trajtohen specifikisht llojet e aktgjykimit sipas përmbajtjes së mbrojtjes juridike që jipet me aktgjykim dhe sipas klasifikimit që parashohin dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Llojet e aktgjykimit sipas mbrojtjes juridike që jepet:

7.9.1 Aktgjykimi detyrues (dënues, kondemnator)

Me këtë aktgjykim gjykata e pranon si të themeltë kërkesëpdinë dhe e urdhëron të paditurin që në dobi të paditësit të jep diçka, të bëjë diçka, të duroj ose pësoj.

7.9.2 Aktgjykimi vërtetues (deklarativ)

Me këtë aktgjykim deklarator jepet mbrojtje juridike deklaratore në atë mënyrë që vërtetohet ekzistimi, mosekzistimi i ndonjë të drejte ose marrëdhënie juridike, ose vërtetohet vërtetësia respektivisht mos vërtetësia e ndonjë dokumenti.

7.9.3 Aktgjykimi transformues (konstitutiv, ndryshues)

Me aktgjykime të tilla gjykata e ndryshon ose e anulon raportin juridik nga i cili për palët dalin të drejta dhe detyrime.

Në arsyetimin e aktgjykimit me të cilin pranohet si e themeltë kërkesëpadia, gjykata duhet ti paraqes rrethanat nga të cilat shihet se ekziston raporti juridik dhe autorizimi i paditësit që nga ajo të kërkojë ndryshimin e përmbajtjes së raportit të tillë. Pra, edhe mbrojtjes juridike konstitutive i paraprinë vërtetimi i përmbajtjes së raportit juridik midis palëve.

7.10 Përmbledhje

Në këtë sesion janë trajtuar dispozitat që i referohen përmbajtjes formale dhe materiale të aktgjykimi dhe rrjedhimisht edhe dispozitat për nxjerrjen e aktgjykimit. Përveç kësaj janë trajtuar edhe lloje e aktgjykimit sipas qëllimi natyrës së detyrimit.

8. Llojët e aktgjykimeve sipas LPK-së

8.1 Hyrje

Në këtë sesion janë trajtuar të gjitha llojet e aktgjykimeve sipas dispozitave të Logjit për procedurën Kontestimore. Janë elaboruar edhe kushte specifike për secilin lloj të aktgjykimit të mund të nxjerrët sipas dispozitave të LPK-së.

8.2. Objektivat trajnues

Pas përfundimit të këtij moduli pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Njohin llojet e aktgjykimeve sipas dispozitave të LPK-së;
- Njohin kushte specifike për secilin lloje të aktgjykimit;
- Zbatojnë dispozitat për nxjerrjen e secilit lloj të aktgjykimit varësisht nga rrethanat.

8.3 Aktgjykimi i pjesshëm

Aktgjykim i pjesshëm quhet ai aktgjykim me të cilin gjykata vendos vetëm për një pjesë të kërkesëpadisë, apo për njërën nga disa kërkesat që janë objekt gjykimi. Gjykata e jep këtë aktgjykim kur pjesa e objektit të gjykimit, për shkak të pohimit ose në bazë të shqyrtimit të mjaftueshëm, njëra ose disa sosh, janë pjekur për vendim definitiv dhe meritore, gjykata mundet, në pikëpamje të kërkesave të përgatitura, përkatësisht të pjesës së kërkesës së përgatitur, ta përfundojë shqyrtimin dhe të jep aktgjykim të pjesshëm. Nga kjo, del qartë se nëse disa nga kërkesat e paraqitura të një pjesë të kërkesës, është shqyrtuar në masën që është e mjaftueshëm për sjelljen e vendimit përfundimtar në bazë të shqyrtimit, gjykata ka mundësi, por edhe është e obliguar që të sjellë aktgjykim të pjesshëm.

Rast praktik i një shtate të tillë: Në qoftë se paditësi ka paraqitur disa kërkesa kundër të paditurit, si p.sh., dorëzimin e sendit, kompensimin e dëmit dhe kompensimin për pasurim pa bazë, nën supozimin se është përgatitur për vendosje pjesa e kërkesëpadisë që ka të bëjë me dorëzimin e sendit por jo edhe për kompensimin e dëmit dhe pasurimit pa bazë, atëherë gjykata mund të marrë aktgjykim të pjesshëm me të cilin vendos për dorëzimin e sendit tek paditësi e pastaj të vendos edhe për dy kërkesat tjera. Kjo mund të ndodh për arsye se në këtë rast kërkesa për kompensim dëmi dhe pasurim pa bazë mund të zgjasë për shkak të procesit kompleks të të provuarit të dëmit dhe kompensimit për pasurim pa bazë, pasi që gjykata sigurisht sipas propozimeve të palëve do të nxjerrë ekspertizat përkatëse dhe provat tjera materiale për të provuar faktet e çështjes dhe vlerën e kompensimit.

Gjykata mundet të jep aktgjykim të pjesshëm edhe kur objekt i gjykimit është edhe kundërpadia, por që për vendim është përgatitur vetëm kërkesa e padisë apo e kundërpadisë.

Nuk do të lejohet aktgjykimi i pjesshëm në qoftë se në padi apo kundërpadi janë përfshirë me tepër kërkesa vendosja e të cilave nuk mund të bëhet ndaras për shkak të natyrës së raportit kontestues për themelësinë e kërkesave të tilla.

Gjykata e jep ex-officio këtë aktgjykim në qoftë se një gjë të tillë e çmon si të arsyeshme. Gjykata duhet të marrë parasysh me rastin e vendosjes së pjesshme të kërkesëpadisë madhësinë e kërkesës e cila është përgatitë për vendosje por edhe qëllimet tjera procedurale realizimin e të cilave e mundëson aktgjykimi i pjesshëm.

Gjykata është e obliguar që pa vonesë të sjellë aktgjykim të pjesshëm nëse nga me tepër kërkesa të paraqitura, në bazë të pranimit ose të heqjes dorë vetëm disa janë shqyrtuar në masën që është e mjaftueshme për vendim përfundimtar ose nëse vetëm një pjesë e kërkesës është shqyrtuar në masën që është e mjaftueshme për vendim përfundimtar. Gjithashtu, nëse kërkesëpadia e cila ka të bëjë me më tepër bashkëndërgjyqës të thjeshtë është shqyrtuar në masën që është e mjaftueshme për vendim përfundimtar në bazë të pohimit ose të heqjes dorë nga kërkesëpadia vetëm sa i përket ndonjërit nga bashkëndërgjyqësit, ose ndonjëra nga me tepër kërkesëpaditë që ka të bëjë me bashkëndërgjyqës të ndryshëm është shqyrtuar në masë që është mjaftueshme për vendim përfundimtar në bazë të pohimit apo heqjes dorë nga kërkesëpadia, gjykata është e obliguar të sjellë aktgjykim të pjesshëm vetëm ndaj bashkëndërgjyqësit të cilit i përket.

Aktgjykimi i pjesshëm është aktgjykim i pavarur nga aktgjykimi definitiv për pjesën tjetër të kërkesëpadisë si në pikëpamje të mjeteve të goditjes ashtu edhe sa i përket përmbartimit të aktgjykimit.

8.4 Aktgjykimi në bazë të pohimit

Aktgjykimi në bazë të pohimit është vendimi meritor të cilin e jep gjykata në bazë të deklaratës së shprehur të palës së paditur. Me pohimin e kërkesëpadisë, si veprim procedural i njëanshëm i palës së paditur, bëhet i panevojshëm zhvillimi i mëtutjeshëm i procesit kontestimor.

LPK përcakton se në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo në tërësi, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimi në bazë të pohimit).

Përcaktimi ligjor se i padituri mund të pohojë kërkesëpadinë deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor nënkupton se i padituri mund ta pohojë kërkesëpadinë jashtë seancës gjyqësore por edhe në seancë gjyqësore, (shembull mund ta pohojë kërkesëpadinë me përgjigje në padi apo edhe me parashtrësë gjatë zhvillimit të shqyrtimit përgatitor dhe atij kryesor e gjithashtu edhe me pohim të drejtpërdrejtë në seancën përgatitore apo të shqyrtimit kryesor).

Zakonisht posa të kryhet veprimi procedural me të cilin pohohet kërkesëpadia, gjykata menjëherë pa e pritur propozimin e palës paditëse e jep aktgjykimin në bazë të pohimit me të cilin e pranon kërkesëpadinë si të themeltë. Pavarësisht se gjykata në rrethana normale duhet që menjëherë posa të pohohet kërkesëpadia të jep aktgjykimin në bazë të pohimit, në qoftë se kërkesa e padisë ka të bëjë me kërkesa me të cilat palët nuk mund të disponojnë lirisht (par.3 i nenit 3 të LPK-së), pavarësisht se plotësohen kushtet që gjykata të jep aktgjykim në bazë të pohimit, të njëjtin nuk do ta jap.

Gjykata nuk do të jep aktgjykim në bazë të pohimit sa herë që konstaton se kërkesa e padisë është kërkesë me të cilën palët nuk mund të disponojnë lirisht e gjithashtu nuk do të jep aktgjykim në baza të pohimit as në konteste martesore.

Shtyrja e dhënies së aktgjykimit në bazë të pohimit - dhënia e aktgjykimit në bazë të pohimit mund të shtyhet për më vonë në qoftë se është e nevojshme që të merren njoftimet e duhura nëse kërkesa e padisë është kërkesë më të cilën palët mund të disponojnë lirisht apo jo.

Shembull i një shtate praktike mund të jetë: Subjekti X e ka paditur subjektin Y për vërtetim të së drejtës së pronësisë lidhur me pronën NN dhe gjatë seancës përgatitore nga ana e subjektit të paditur para gjykatës jepet deklarata e pohimit të kërkesëpadisë. Në qoftë se gjykata nuk ka

dëshmi të mjaftueshme mbi bazën e të cilave mund të konstatojë rrethanën se a është kërkesë e disponueshme për të paditurit objekti i kërkesëpadisë, mund ta shtyjë dhënien e aktgjykimit në bazë të pohimit dhe të ndërmerë verimet e duhura me të cilat do të konstatoj nëse kërkesa e padisë është e disponueshme ose jo për të paditurin. Në këtë mënyrë ex-officio mund t'i drejtohet organit kompetente në kuptim të dispozitës së nenit 7.2 të LPK-së, me kërkesë që organi përkatës t'i dorëzojë gjykatës në afat të caktuar (afat gjyqësor) certifikatën e pronës dhe informata tjera për historiatin e pronës etj. Pas marrjes së këtyre informatave gjykata do të vendos që të pranohet apo të refuzohet deklarata e pohimit të kërkesëpadisë.

Revokimi i deklaratës mbi pohimin e kërkesëpadisë - I padituri i cili e ka dhënë deklaratën mbi pohimin e kërkesëpadisë ka mundësi që ta revokojë deklaratën mbi pohimin e kërkesëpadisë. LPK me dispozitën e nenit 148.4 e ka paraparë mundësinë që i padituri ta revokojë deklaratën me të cilën e ka pohuar kërkesën e padisë por vetëm deri në momentin e dhënies së aktgjykimit në bazë të pohimit nga ana e gjykatës.

Për kryerjen e veprimit procedural me të cilin revokohet deklarata për pohimin e kërkesëpadisë nuk nevojitet pëlqimi i palës së paditur. I padituri nuk ka nevojë që gjykatës t'i paraqes kurrfarë arsytimi për revokimin e deklaratës me të cilën është pohuar kërkesa e padisë, por mjafton vetëm deklarimi se e revokon deklaratën për pohimin e kërkesëpadisë por me kusht që të mos jetë dhënë aktgjykimi.

Posa të revokohet deklarata për pohimin e kërkesëpadisë gjykata duhet të vazhdojë procedurën, një gjë të tillë gjykata do ta bëjë edhe nëse konstaton se kërkesa e padisë nuk është e disponueshme për palët.

Edhe pas revokimit të deklaratës për pohimin e kërkesëpadisë i padituri ka mundësi që ta ripohojë kërkesën e padisë dhe natyrisht kjo deklaratë e ka efektin e plotë në bazë të së cilës gjykata do të jep aktgjykimin në bazë të pohimit nëse konstaton se kërkesa e padisë është e disponueshme për palët.

Nëse nxjerrët aktgjykimi në bazë të pohimit i njëjti duhet të përmbajë këtë emërtim *“aktgjykim në bazë të pohimit”*.

Arsyetimi i aktgjykimit në bazë të pohimit– arsyetimi i aktgjykimit në bazë të pohimit dallon prej arsytimit të aktgjykimit të zakonshëm sepse tek ky arsyetim gjykata do të kufizohet në dhënien e arsyeve sa i përket vërtetimit të gjendjes së fakteve, analizës së provave dhe aplikueshmërisë së të drejtës materiale. Esenciale është përshkrimi i kërkesëpadisë, përshkrimi i deklaratës së pohimit të kërkesëpadisë, konstatimi se kërkesa është e disponueshme për palët dhe referenca në dispozitat e LPK-së, pjesa e aktgjykimit në bazë të pohimit.

Shkaqet e ankimit kundër aktgjykimit në bazë të pohimit- LPK, me dispozitën e nenit 181.2 ka përcaktuar se *“aktgjykimi në bazë të pohimit mund të goditet për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, apo nga shkakun se deklarata e pohimit, është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit”*.

8.5 Aktgjykimi në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia

Me dispozitat e nenit 149 të LPK-së është paraparë mundësia e përfundimit të procesit gjyqësor me anë të veprimeve disponibile të palëve. Për derisa me dispozitat e nenit 148 të LPK-së është paraparë mundësia e përfundimit të procesit gjyqësor me pohimin e kërkesëpadisë, me dispozitat e nenit 149 të LPK-së procesi gjyqësor mund të përfundojë me heqjen dorë nga kërkesa e

padisë. Në qoftëse paditësi deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes heq dorë nga një pjesë e kërkesëpadisë apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi.

Edhe në këtë rast kemi të bëjmë me një veprim procedural të palës paditëse i cili i nënshtrohet rregullave të LPK-së përkatësisht dispozitës nga neni 149 të LPK-së.

Për heqjen dorë nga kërkesa e padisë palës paditëse nuk i nevojitet pëlqimi i palës së paditur.

Në praktikën gjyqësore gjykatat duhet të qartësojnë situatat kur kemi të bëjmë me tërheqje të padisë me deklarinim të palës paditëse dhe heqje dorë nga kërkesa e padisë.

Qartësimi i këtyre situatave më së lehti bëhet duke i identifikuar dallimet në mes të tërheqjes së padisë dhe heqjes dorë nga kërkesa e padisë.

Dallimet në mes të tërheqjes së padisë dhe heqjes dorë nga kërkesëpadia janë:

- Paditësi mund të heqë dorë nga kërkesëpadia pa pëlqimin e të paditurit deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, ndërsa paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi.
- Në qoftë se paditësi heqë dorë nga kërkesa e padisë atëherë gjykata do të nxjerrë aktgjykim në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia, ndërsa në qoftë se paditësi e tërheqë padinë gjykata do të marrë aktvendim me të cilin do ta konsiderojë të tërhequr padinë.
- Kundër aktgjykimit në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia në çdo rast mund të paraqitet ankesë drejtuar gjykatës së shkallës së dytë, ndërsa kundër aktvendimit me të cilin konstatohet e tërhequr padia e paditësit nuk lejohet fare ankesë.
- Procesi gjyqësor i përfunduar me aktgjykim të heqjes dorë nga kërkesëpadia konsiderohet çështje e përfunduar me vendim meritore dhe nënkupton pamundësinë që paditësi për çështjen e njëjtë të paraqes përsëri padi pasi që nëse do të paraqiste përsëri padi do të konsiderohej si çështje e gjykuar, ndërsa në qoftë se procesi gjyqësor ka përfunduar me aktvendim me të cilin është konstatuar e tërhequr padia e paditësit i njëjti mund ta përsërisë prapë padinë e tij.

Refuzimi i dhënies së aktgjykimit në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia – Gjykata nuk do të jep aktgjykim në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia edhe pse janë plotësuar kushtet e nevojshme për një gjë të tillë po që se konstaton se është fjala për kërkesën me të cilën palët nuk kanë të dejtë të disponojnë lirisht.

Gjykata nuk do të jep aktgjykim në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia sa herë që të konstaton se palët nuk mund të disponojnë lirisht me kërkesëpadinë e gjithashtu nuk do të jep aktgjykim në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia as në kontestet martesore.

Shtyrja e dhënies së aktgjykimit në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia - dhënia e aktgjykimit në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia mund të shtyhet për më vonë në qoftë se është e nevojshme që të merren njoftimet e duhura, nëse kërkesa e padisë është kërkesë në të cilën palët mund të disponojnë lirisht (paragrafi 3 i neni 3 të LPK-së).

Shembulli në situatën praktike: *Në qoftë se subjekti X e ka paditur subjektin Y për vërtetimin e të drejtës së pronësisë lidhur me pronën N.N. Supozojmë se në rastin konkret paditësi nuk ka legjitimitet aktiv në këtë çështje juridike - kontestuese për shkak të mungesës së raportit juridik - civil me palën e paditur dhe nën supozimin se i njëjti e deklaroi heqjen dorë nga kërkesëpadija, gjykata mund ta shtyjë për më vonë dhënien e aktgjykimit deri sa të sigurojë dëshmi të mjaftueshme në bazë të cilave mund të konstatojë rrethanën se a është kërkesa e disponueshme për palët në këtë rast për paditësin. Në këtë mënyrë gjykata ex officio në kuptim të nenit 7.2 të LPK-së mund të mbledhë të gjitha informacionet e nevojshme për të nxjerrë përfundimin nëse kërkesa është e disponueshme apo jo.*

Revokimi i deklaratës mbi heqjen dorë nga kërkesëpadija – Paditësi i cili e ka dhënë deklaratën mbi heqjen dorë nga kërkesëpadija gojarisht në seancë gjyqësore ose me anë të parashtrësës jashtë seancës gjyqësore, mund ta revokojë të njëjtën pa pëlqimin e palës së paditur deri në momentin e dhënies së aktgjykimit.

8.6 Aktgjykimi për shkak të padëgjueshmërisë

Aktgjykimi për shkak të padëgjueshmërisë është risi të cilën e ka sjellë LPK-ja aktual. Aktgjykimi për shkak të padëgjueshmërisë është në funksion të efikasitetit të procedurave gjyqësore dhe shtimit të masave në funksion të parimit të ekonomizimit. LPK me dispozitën e nenit 150 në mënyrë specifike e ka rregulluar mundësinë e marrjes së këtij aktgjykimi.

Është me rëndësi të theksohet për praktiken gjyqësore se ky lloj i aktgjykimit mund të merret vetëm jashtë seancës gjyqësore dhe asnjëherë në seancë gjyqësore.

Sipas dispozitës së nenit 150.1 të LKP-së përcaktohet se: *“në qoftë se i padituri, brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj nuk paraqet në gjykatë përgjigje në padi, gjykata jep aktgjykim për shkak të padëgjueshmërisë me të cilin aprovon kërkesëpadinë”.*

Aktgjykimin për shkak të padëgjueshmërisë do të mund ta nxjerrë gjykata në qoftë se plotësohen disa kushte kumulative:

- Po që se të paditurit i është dorëzuar rregullisht padija dhe thirrja për dhënien e përgjigjes në padi,
- Po që se themelësia e kërkesëpadijes del nga faktet e treguara në padi,
- Po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadija nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht.

Kushtet e lartë cituara nga ana e gjykatës duhet të vlerësohen në mënyrë kumulative dhe në mënyrë që e njëjta mund të nxjerrë vendim për shkak të padëgjueshmërisë dhe atë jashtë seancës dhe pa propozimin e palës paditëse. Nga kjo rrjedhë se gjykata kryesisht vlerëson nëse plotësohen kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë. Është me rëndësi të theksohet se gjykata përveç kushtit që ndërlidhet me përgjigjen në padi duhet të bëjë një vlerësim objektiv të themelësisë së kërkesëpadijes e cila gjithsesi duhet të rezultojë si e bazuar duke u mbështetur në faktet e treguara në padi të cilat duhet të jenë të provuara me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Kur analizohen me kujdes kushtet kumulative që duhet të plotësohen për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë rezulton se praktika gjyqësore do të jetë e kufizuar në shumë raste për nxjerrjen e këtij aktgjykimi pasi që në të gjitha rastet nga të cilat rrjedh se faktet do të provohen me prova të cilat nuk mund të deponohen së bashku me padinë me rastin e punimit të padisë në gjykatë, ky aktgjykim do të jetë i pamundur të nxirret. Për shembull në qoftë se një fakt

do të provohet me dëgjimin e dëshmitarëve, ky aktgjykim nuk mund të nxirret, pastaj në qoftë se një fakt do të provohet me nxjerrjen e ekspertizës ky aktgjykim gjithashtu nuk mund të nxirret etj.

Mosdhënia e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë - Gjykata nuk do të nxjerrë aktgjykimin për shkak të mosbindjes pavarësisht se plotësohen kushtet, nëse gjykata konstaton se është fjala për kërkesën në të cilën palët nuk kanë të drejtë të disponojnë lirisht.

Kjo situatë është identike me të gjitha rastet në të cilat gjykata do të veprojë kryesisht kur konstaton se palët kanë pretendime të disponojnë me kërkesa që nuk mund të disponojnë (neni 3.3 i LPK).

Shtyrja e dhënies së aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë – Gjykata mund të shtyjë dhënien e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë në qoftë se ka nevojë të merrë njoftimet e duhura lidhur me rrethanën nëse kërkesa e palëve është kërkesë e disponueshme për palët. Gjithmonë kjo shtyrje duhet të ndodhë në periudhën deri sa gjykata nuk u ka dërguar palëve ftesat për seancën përgatitore apo të shqyrtimit kryesor në qoftë se nuk cakton seancë përgatitore. Kjo për arsye se siç u theksua gjykata mund të jep këtë aktgjykim vetëm jashtë seancës.

Në çdo rast kur i padituri nuk ka dhënë përgjigje në padi por që nga faktet e treguar në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, gjykata cakton seancën përgatitore dhe po që se në seancën e këtillë paditësi nuk e ndryshon padinë, jep aktgjykim me të cilin e refuzon kërkesëpadinë. Kjo situatë ka nevojë të sqarohet për praktiken gjyqësore pasi që në seancën e shqyrtimit kryesor gjykata do të nxjerrë edhe prova tjera me të cilat provohen faktet e padisë e të cilat nuk i ka pasur në disponim gjykata me rastin e vlerësimit të kushteve për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë. Pra në shqyrtim gjyqësor kërkesëpadija nga provat e administruara mund të del si e bazuar.

Kundër aktvendimit të gjykatës me të cilin refuzohet propozimi i paditësit që t'i jepet aktgjykimin për shkak të padëgjueshmërisë nuk lejohet ankimi. Ky përcaktim ligjor mund të krijojë hamendje në praktiken gjyqësore pasi që mund të interpretohet se është kusht propozimi i palës paditëse për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë. Vlerësojmë se nuk është kusht propozimi i palës paditëse për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë.

8.7 Aktgjykimin për shkak të mungesës

Me aktgjykimin për shkak të mungesës kuptojmë atë aktgjykim me të cilin pranohet si e themeltë kërkesëpadija e përmbajtur në padinë e ngritur kundër të paditurit i cili nuk mbrohet nga ajo, nuk e kundërshton kërkesëpadinë me veprim të shkruar dhe mungon në seancën përgatitore, apo në qoftë se nuk është mbajtur kjo, nga seanca e parë për shqyrtim kryesor, e paditësi i pranishëm e propozon dhënien e tij apo gjykata sipas detyrës zyrtare e jep këtë aktgjykim. Aktgjykimin për shkak të mungesës është paraparë me dispozitat e nenit 151 të LPK-së. Në qoftë se krahasohen kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mungesës dhe aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë do të vërehen se ekzistojnë disa ngjashmëri por edhe disa dallime esenciale.

Kështu gjykata do të nxjerrë aktgjykimin për shkak të mungesës kur të paditurit nuk i është dërguar padija për përgjigje, por vetëm bashkë me letërthirrje për seancë përgatitore apo në seancën e parë të shqyrtimit kryesor në qoftë se seanca përgatitore nuk është caktuar fare, ndërsa i padituri nuk vjen deri në përfundimin e seancës, atëherë gjykata me propozimin e paditësit apo sipas detyrës zyrtare e jep aktgjykimin me të cilin e aprovon kërkesëpadinë po që se plotësohen edhe këto kushte:

- nëse i padituri është thirrur rregullisht në seancë:
- nëse i padituri nuk e ka kontestuar kërkesëpadinë me anë të parashtrësës,
- nëse themelësia e kërkesëpadi së del nga faktet e treguara në padi,
- nëse faktet në të cilat bazohet kërkesëpadi nuk janë në kundërshtim me provat e paraqitura nga vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht,
- nëse nuk ekzistojnë rrethana notore nga të cilat del përfundimi se e kanë penguar të paditurin shkaqe të arsyeshme që të vijë në seancë.

Kushtet për dhënien e aktgjykimit për shkak të mungesës duhet të kuptohen si prezumime procedurale dhe materiale që duhet të plotësohen përveç prezumimeve që duhet të plotësohen për çdo aktgjykim.

Është me rëndësi të theksohet se gjykata duhet tu kushtojë vëmendjen e duhur plotësimit të kushteve siç kërkohen e veçanërisht gjykata duhet të bëjë një vlerësim objektiv të themelësisë së kërkesëpadi së e cila gjithsesi duhet të rezultojë si e bazuar duke u mbështetur në faktet e treguara në padi të cilat duhet të jenë të provuara me provat që gjenden në shkresat e lëndës. Në këtë pikë vërehen zakonisht dobësitë e vendimeve të cilat merren për shkak të mungesës.

Mosdhënia e aktgjykimit për shkak të mungesës - Gjykata nuk do të nxjerrë aktgjykimin për shkak të mungesës pavarësisht se plotësohen kushtet, nëse konstatohet se është fjala për kërkesën në të cilën palët nuk kanë të drejtë të disponojnë lirisht. Kjo situatë është identike me të gjitha rastet në të cilat gjykata do të veprojë kryesisht kur konstaton se palët kanë pretendime të disponojnë me kërkesa që nuk mund të disponojnë.

Shtyrja e dhënies së aktgjykimit për shkak të mungesës – Gjykata mund të shtyjë dhënien e aktgjykimit për shkak të mungesës në qoftë se ka nevojë të merrë njoftimet e duhura lidhur me rrethanën nëse kërkesa e palëve është kërkesë e disponueshme për palët.

Gjykata me aktvendim e refuzon propozimin e palës për dhënien e aktgjykimit për shkak të mungesës, kundër të cilit nuk lejohet ankesë.

Duhet theksuar se dispozita e nenit 151 të LPK-së, të cilat parashohin mundësinë e marrjes së aktgjykimit për shkak të mungesës, nuk janë duke gjetur zbatimin e duhur pasi që njëri ndër kushtet për dhënien e këtij aktgjykimi është që gjykata fare mos t'i ketë dërguar të paditurit aktvendim për përgjigje në padi, ndërsa LPK-ja, në ana tjetër parashih detyrimin e gjykatës që palës së paditur t'i dërgoj aktvendimin për përgjigje në padi. LPK-ja nuk ka dispozita me të cilat e qartëson saktësisht se në cilat raste gjykata mundet fare mos t'i dërgojë palës së paditur aktvendimin për përgjigje në padi.

Vlerësojmë se aktgjykimi për shkak të mungesës më së shumti mund të gjej zbatim të kontestet me vlerë të vogël.

8.9 Aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes

Aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes nuk ka qenë i paraparë më LPK-në e vjetër. Me dispozitën e nenit 152 të LPK-së, është paraparë mundësia e nxjerrjes së aktgjykimit pa shqyrtim kryesor të çështjes. Më këtë dispozitë synohet efikasiteti i procesit gjyqësor civil.

Sipas kësaj dispozite gjykata do të nxjerrë aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seancë gjyqësore, të nxjerrë aktgjykim (neni 143 dhe 147 i LPK-së), nëse nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e tij.

Duhet theksuar se dispozita e nenit 152 ka ngjashmëri substanciale me dispozitën e nenit 398 të LPK-së.

Kusht esencial për nxjerrjen e aktgjykimit sipas dispozitës së nenit 152 të LPK-së, është që pala e paditur të ketë dhënë përgjigje në padi dhe më përgjigje në padi t'i ketë pohuar faktet e prezumuara nga ana e palës së paditur. Në këtë rast për nxjerrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor të çështjes duhet të plotësohen në mënyrë kumulative kushtet që pala e paditur të ketë dhënë përgjigje në padi dhe gjithashtu t'i ketë pohuar faktet e çështjes të prezumuara nga paditësi.

Në çdo rast për praktikën gjyqësore duhet të jetë e qartë se aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes mund të nxirret vetëm jashtë seancës gjyqësore, çka do të thotë se për nxjerrjen e këtij aktgjykimi nuk do të caktohet as seancë përgatitore dhe as e shqyrtimit kryesor.

Në çdo rast nëse gjykata vlerëson se plotësohen kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor të çështjes atëherë mundet vetëm ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit por jo edhe ta refuzojë. Kjo nënkupton se nëse është dhënë përgjigje në padi, janë pohuar edhe faktet e prezumuara nga paditësi, por megjithatë pavarësisht së janë pohuar fakte nuk del themelësia e kërkesëpadisë apo nëse kemi të bëjmë me kërkesë me të cilën palët nuk mund të disponojnë lirisht atëherë gjykata nuk e nxjerrë aktgjykimin pa shqyrtim kryesor të çështjes por e cakton seancën përgatitore apo të shqyrtimit kryesor.

8.10 Nxjerrja e aktgjykimit pa caktuar seancë gjyqësore sipas dispozitës së nenit 398 të LPK-së

Dispozita e nenit 398 e LPK-së, ka ngjashmëri substanciale me dispozitën e nenit 152 të LPK-së, pasi që në të dy rastet gjykata pasi t'i arrijë përgjigja në padi pa shqyrtim kryesor do të nxjerr aktgjykim me të cilin do ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar.

Me dispozitën e nenit 398 parashihet se: *“kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, dhe konstaton së ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të jep aktgjykim me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Edhe sipas kësaj dispozite rrjedhë se njëri ndër kushtet substanciale për dhënien e këtij aktgjykimi është dhënia e përgjigjes në padi nga ana e të paditurit. Kusht tjetër esencial është edhe vlerësimi i gjykatës përkatësisht konstatimi i gjykatës se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor. Dhënia e përgjigjes në padi është me rëndësi edhe te ky aktgjykim pasi që gjykata nga padia dhe përgjigja në padi do të mund të konstatojë, se cilat fakte në mes të palëve janë kontestuese e cilat jo dhe në bazë të kësaj të vendos për veprimet e mëtutjeshme.

Dallimet në mes të aktgjykimit pa shqyrtim kryesor të çështjes (neni 152) dhe aktgjykimit sipas dispozitës së nenit 398 janë:

- aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes do të emërtohet “aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes, ndërsa aktgjykimi sipas dispozitës së nenit 398 vetëm “aktgjykim” por në hyrje të aktgjykimit do të shënohet data e nxjerrjes dhe konstatimi se është vendosur jashtë seancës.
- te aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes (neni 152), domosdoshmërisht duhet të ketë pohim të fakteve të çështjes nga ana e të paditurit, ndërsa te aktgjykimi sipas dispozitës së nenit 398 nuk është e domosdoshme të ketë pohim të fakteve të prezumuara nga paditësi, por vlerësimi se gjendja faktike nuk është kontestuese në mes të palëve duhet të jetë vlerësim i gjykatës.
- te aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes (neni 152), arsyetimi i aktgjykimit sa i përket analizës dhe përfundimit për gjendjen e fakteve në të cilat mbështetet kërkesëpadia është fare i shkurtër, ndërsa te aktgjykimi sipas dispozitës së nenit 398 arsyetimi i aktgjykimit për faktet e çështjes dhe përfundimi i gjykatës lidhur me konstatimin se nuk është kontestuese gjendja faktike në mes të palëve duhet të jetë analizë e mirëfilltë, vlerësim logjik e objektiv se si gjykata ka konstatuar se nuk është kontestuese gjendja e fakteve.

8.11 Nxjerrja e aktgjykimit pa caktuar seancë gjyqësore sipas dispozitave nga neni 399 i LPK-së.

Dispozita e nenit 399 janë risi në LPK-në aktual, pasi që LPK-ja e vjetër nuk i ka përmbajtur këto dispozita.

Qëllimi i këtyre dispozitave është në funksion të parimit të ekonomizimit dhe efikasitetit të procesit gjyqësor.

Sipas dispozitës së nenit 399.1 është përcaktuar se: *“kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendim meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*.

Sipas dispozitës nga paragrafi 2 i nenit 399 parashihet se: *“kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të nenit 399, po që se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi, apo po që se faktet mbi të cilat mbështet kërkesëpadia qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Për dallim nga dispozitat e nenit 152 dhe 398 me të cilat është paraparë mundësia që gjykata të bie aktgjykim pa shqyrtim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë, me dispozitën e nenit 399 është parë mundësia e nxjerrjes së aktgjykimit pa shqyrtim por për refuzimin e kërkesëpadiës.

Gjykata do të vlerësojë se kërkesëpadia është e pathemeltë në qoftë se ajo qartazi është në kundërshtim me faktet të cilat paditësi i ka theksuar në padi, në qoftë se faktet të cilat i ka prezantuar janë në kundërshtim me provat të cilat i ka propozuar paditësi për vërtetimin e fakteve, apo nëse kërkesëpadia është në kundërshtim me faktet e ditura botërisht.

Kërkesëpadia do të jetë në kundërshtim me faktet në qoftë se sipas të drejtës materiale nga faktet e treguara nuk del themelësia e kërkesëpadiës, faktet do të jenë në kundërshtim me provat në qoftë se me provat e propozuara do të vërtetohen fakte tjera nga ato të prezantuara nga paditësi e gjithashtu në qoftë se faktet e prezantuara nga paditësi do të jenë në kundërshtim me faktet e ditura botërisht e të cilat nuk ka nevojë të provohen.

8.12 Përmbledhje

Në këtë sesion janë përmbledhur dhe elaboruar të gjitha llojet e aktgjytimeve sipas dispozitave të LPK-së, duke përfshirë kushtet për nxjerrjen, procedurën dhe arsyetimin që duhet të përmbaj secili lloj i aktgjykimit varësisht nga specifikat.

9. Mjetet e rregullta të goditjes

9.1 Hyrje

Në këtë sesion janë trajtuar mjetet e rregullta të goditjes duke filluar nga e drejta e ankesës si e drejtë kushtetuese, bazat për paraqitjen e ankesës, proceduar dhe mënyrat e vendosjes. Do të diskutohen edhe detyrimet e gjykatës së shkallës së parë në procedurën e ankesës. Për procedurën e ankesës do të paraqitën shembuj dhe raste nga praktika gjyqësore.

9.2 Objektivat trajnues

Pas përfundimit të këtij moduli pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Vlerësojnë të drejtën dhe lejueshmërinë anekses;
- Njohin bazat për paraqitjen e ankesës;
- Ndërmarrin veprimet e duhura në procedurën e ankesës;
- Vendosin varësisht nga vlerësimet që do të kenë për lejueshmërinë e mjeteve të rregullta.

9.3 Mjetet e rregullta të goditjes

Mjet goditjeje quajmë mjetin procedural me të cilin pala apo personi tjetër i autorizuar nga gjykata kërkon që ta prishë (anulojë) apo ndryshojë vendimin për të cilin pretendon të vërtetohet se është i pavolitshëm, i padrejtë dhe i kundërligjshëm. Mjeti i goditjes është shprehje e pakënaqësisë së palës me vendimin e dhënë në çështjen e saj dhe njëherazi kërkesë që ai të zëvendësohet me vendimin e ligjshëm dhe të drejtë.

E drejta e goditjes së vendimeve është një e drejtë elementare e cila garantohet edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës por edhe me Ligjin për Procedurën Kontestimore.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 32 të saj garanton të drejtën për mjetin juridik duke përcaktuar se: “*Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtë ose interesat e saj/tij në mënyrë e përcaktuar me ligj*”, (në këtë rast është Ligji për Procedurën Kontestimore që rregullon mënyrë se si mund të përdoret mjeti i goditjes kundër vendimeve gjyqësore).

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përveç kësaj dispozite për të drejtën e përdorimit të mjetit juridik me dispozitën e nenit 54 parasheh Mbrojtjen Gjyqësore të të Drejtave, duke përcaktuar se: “*Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar më këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur*”, ndërsa me dispozitën e nenit 102 paragrafi 5, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcaktohet se: “*Garantohet e drejta për ankesë ndaj një vendimi gjyqësor, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe. E drejta e përdorimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, rregullohet me ligj. Me ligj mund të lejohet e drejta për të referuar një rast në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, dhe për të tilla raste nuk ka të drejtë ankese*”.

Me këto 3 (tri) dispozita bazë Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton një të drejtë fundamentale të njeriut duke e trajtuar këtë të drejtë (*e drejta e përdorimit të mjeteve juridike*) si kategori kushtetuese.

E drejta në ankesë ndaj një vendimi gjyqësor është standard i së drejtës ndërkombëtare të drejtave të njeriut, jo thjeshtë një e drejtë që buron nga e drejta e brendshme e një shteti. E drejta në ankesë, në kuptimin e gjerë, nënkupton të drejtën e një subjekti që ka qenë palë në një procedurë gjyqësore, dhe mbi të cilin vepron një vendim gjyqësor i shkallës së parë, që të ketë mundësi të ankohet tek një gjykatë më e lartë për vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Me Ligjin për Gjykatat është themeluar Gjykatat e Apelit e cila ka juridiksion të vendosë:

- *Të gjitha ankesat e ushtruara kundër vendimeve të Gjykatave Themelore,*
- *Të vendos për konfliktin e juridiksionit ndërmjet Gjykatave Themelore, dhe*
- *Çështje tjera të parapara me ligj.*

Në këtë mënyrë është garantuar zbatimi i parimit që çdo çështje të shqyrtohet të paktën në dy instanca gjyqësore dhe shqyrtimi në instancën e shkallës së dytë bëhet përmes ushtrimit të mjetit të goditjes-ankesës.

Sa i përket gjerësisë së rishikimit që duhet të bëhet nga gjykata më e lartë, është standard themelor që rishikimi gjyqësor nga një gjykatë më e lartë të përfshijë si kontrollin e të drejtave procedurale ashtu edhe kontrollin e meritës së rastit, duke mundësuar që një gjykatë më e lartë të bëjë rishikimin si formal ashtu edhe substancial të rastit të gjykuar në shkallë të parë.

9.4 Ankesa kundër aktgjykimit

Ankesa është mjet i rregullt i goditjes së aktgjykimit të shkallës së parë. Ankesa është e lejuar kundër çdo aktgjykimi të shkallës së parë pa përjashtim.

Për ankesën kundër aktgjykimit thuhet se është mjet universal i goditjes, sepse me të pala ka të drejtë që ta atakoj çdo aktivitet të gjykatës, procedurën që e ka zhvilluar, gjendjen faktike të konstatuar dhe vlerësimin juridik të çështjes që ka pasur për pasojë zbatimin e normës materialo-juridike të caktuar.

LPK me dispozitën e nenit 176 paragrafi 1, përcakton se: *“Kundër aktgjykimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë palët mund të bëjnë ankim brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, po që se me këtë ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër. Në kontestet nga raportet në të cilat është dhënë aktgjykimi në bazë të kambialit apo çekut, afati për ankim është shtatë (7)ditor”.*

9.4.1 Interesi juridik për goditjen e vendimit

Sikurse për çdo veprim procedural, ashtu edhe për mjetin e goditjes është paraparë se pala mund ta përdorë vetëm në qoftë se për një gjë të tillë ka interes juridik. Për paraqitjen e mjetit të goditjes pala ka interes juridik në qoftë se shpreson se në lidhje me të gjykata kompetente do të jep vendim më të volitshëm se ai të cilin e ka goditur.

Praktikisht është e thjeshtë të kuptohet se cili nga palët ka interes juridik për paraqitjen e ankesës sepse pala me interes juridik për paraqitjen e ankesës është ajo palë e cila është e pakënaqur me vendimin e gjykatës.

LPK me dispozitën e nenit 186 paragrafi 3, përcakton se: *“Ankesa është e palejueshme po që se e ka paraqitur personi që nuk është i autorizuar për paraqitjen e saj, apo personi që ka hequr dorë*

nga e drejta e ankimit apo që e ka tërhequr ankesën e paraqitur, apo në qoftë se personi që e ka paraqitur ankesën nuk ka interes juridik për paraqitjen e ankesës”.

Sipas kësaj dispozitë rrjedh së është e palejueshme ankesa në qoftë se personi që e ka paraqitur ankesën nuk ka interes juridik për paraqitjen e ankesës. Në rast së gjykata konstaton se ankesën e ka paraqitur personi që nuk ka interes për paraqitjen e saj atëherë të njëjtën e hedhë si të palejuar.

Rast nga praktika

Nëse ankesën ka paraqitur pala e cila e ka fituar kontestin me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë me të cilin gjykata ka vendosur për të gjitha kërkesat e saj.

Kur gjykata e ka aprovuar vetëm pjesërisht kërkesëpadinë apo kur e refuzon vetëm pjesërisht nëse ankesën e paraqet i padituri, atëherë interesi juridik i ankuesve që të godasin vendimin e gjykatës i referohet vetëm pjesës me të cilën ankuesit janë të pakënaqur.

Raste nga praktika

Në qoftë se paditësi me kërkesëpadi ka kërkuar kompensimin e dëmit jo material për dhimbje fizike, për frikë, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë dhe për dhimbje shpirtërore për shkak të shëmtimit në shumë të përgjithshme prej 20 000 Euro, por gjykata i ka aprovuar për të gjitha kategoritë e dëmit shumën e përgjithshme prej 10 000 Euro, në këtë rast interesi i tij juridik i referohet vetëm pjesës në të cilën është refuzuar kërkesëpadi. Për të paditurin në rastin e njëjtë interesi juridik është i kundërt me të paditësit dhe që i referohet pjesës së aprovuar të kërkesëpadisë.

Me dispozitës e nenit 178 pika b) e LPK-së, kërkohet nga ankuesi që të deklarohet se aktgjykimin e kundërshton në tërësi ose në pjesë të caktuar, por në praktikën juridike në shumë raste ankuesit nuk deklarohen me saktësi se aktgjykimin e godasin në tërësi apo në pjesë të caktuara. Në rastet kur ankuesi nuk është deklaruar se e godet aktgjykimin në tërësi apo në pjesë të caktuara, është interesi juridik për paraqitjen e ankesës që shërben si mekanizëm për të saktësuar se ankuesi e ka goditur në tërësi aktgjykimin apo në pjesë të caktuara.

Në praktikën gjyqësore kur ankuesi nuk është deklaruar se e godet aktgjykimin në tërësi apo në pjesë të caktuara, të njëjtit nuk i kthehet ankesa në plotësim pavarësisht se sipas dispozitës së lartë cituar kërkohet që i njëjti të deklarohet por në bazë të interesit juridik që ka ankuesi për ankesë përcaktohet se ankesa i referohet në tërësi aktgjykimit apo vetëm pjesëve të caktuara.

Raste nga praktika

Në qoftë se në një rast gjykata duke vendosur për kërkesëpadinë e paditësit ka marrë aktgjykim me të cilin në pikën një të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit dhe e ka detyruar të paditurin që paditësit ti paguaj borxhin në lartësi prej 5000 Euro, ndërsa në pikën dy të dispozitivit të aktgjykimit e ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë për borxh në lartësi prej 5000 Euro. Në ankesën e paraqitur nga paditësi, kundër këtij aktgjykimi nëse i njëjti nuk ka saktësuar së në cilën pjesë e godet aktgjykimin atëherë gjykata në bazë të interesit juridik që ka paditësi për ankesë e ekzaminon aktgjykimin në pjesën që është refuzuar pjesërisht kërkesëpadi e paditësit, pra pika dy e dispozitivit të aktgjykimit.

Nëse ankesën do ta paraqiste i padituri pa e saktësuar se në cilën pjesë e godet aktgjykimin atëherë gjykata prapë në bazë të interesit juridik që ka i padituri për ankesë e ekzaminon aktgjykimin në pikën një të dispozitivit.

Duhet theksuar se LPK me dispozitën e nenit 195 paragrafi 2, ka përcaktuar se: “Gjykata e shkallës së dytë nuk është e lidhur për propozimin e parashtruar në ankesë”, pavarësisht se shqyrtimi në gjykatën e shkallës së dytë bëhet vetëm pasi që njëra nga palët e kontestit shprehë

pakënaqësinë e saj ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ky përcaktim ligjor që përjashton detyrimin e gjykatës që të lidhet për propozimin e ankuesit të shprehur në ankesë në radhë të parë i referohet rrethanave të cilat mund ti marrë në vlerësim gjykata e shkallë së dytë edhe ex-officio e të cilat mund të diktojnë përfundim të kundërt me atë të propozuar në ankesë.

9.4.2 Efektet e ankesës

Ankesa është mjet me efekt suspenziv, sepse me paraqitjen e saj pengohet marrja e formës së prerë të aktgjykimit, në tërësi apo në pjesën e goditur.

Ankesa është mjet devolutiv, sepse me paraqitjen e saj themelohet kompetenca e gjykatës së shkallës më të lartë që të shqyrtojë vendimin e goditur. Përveç kësaj ankesa është mjet i pavarur, sepse për të vendoset pavarësisht mjeteve tjera të goditjes.

9.4.3 Afati për paraqitjen e ankesës

Afati për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit të dhënë në gjykatën e shkallës së parë është 15 ditë nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, po që se me Ligjin për Procedurën Kontestimore nuk parashihet ndonjë afat tjetër, (nenin 176 paragrafi 1, i LPK-së). Përjashtim bëjnë procedurat e posaçme kontestimore ku përcaktohen afate më të shkurtra.

Afati për ankesë në procedurat e posaçme kontestimore është më i shkurtër së 15 ditë, kështu në procedurat e kontesteve nga marrëdhënia e punës, afati për ankesë është 7 ditë (neni 477 i LPK-së), në procedurën nga kontestet për shkak të pengimit të posedimit, afati për ankesë kundër aktvendimit është 7 ditë (neni 482 paragrafi 2 i LPK-së), në konteste më vlerë të vogël afati për ankesë kundër aktgjykimit është 7 ditë (neni 491 paragrafi 3 i LPK-së), në kontestet-procedurën e dhënies së urdhërpagesës afati për prapësim është 7 ditë kur vendoset lidhur me kambialin dhe 3 ditë kur vendoset lidhur me çekun (neni 495 paragrafi 2 i LPK-së) dhe në kontestet tregtare afati për ankesë është 7 ditë (nenin 509 pika c) i LPK-së).

9.4.4 Përmbajtja e ankesës

Sipas dispozitës së nenit 99 paragrafi 1 i LPK-së, edhe ankesa si mjet i goditjes është parashtrësë por me dispozitat e nenit 178 përcaktohet se ankesa duhet të përmbajë:

- Aktgjykimin kundër të cilit paraqitet ankimi;
- Deklaratën se aktgjykimi kundërshtohet në tërësi ose në pjesën e caktuar;
- Shkaqet e ankimit me arsyetim;
- Nënshkrimin e paraqitësit të ankimit;

Nëse ankesa nuk i përmban elementet e paraqitura si më lartë, atëherë gjykata e shkallës së parë duhet të marrë aktvendim me të cilin e thërret ankuesin që brenda afatit prej 7 ditësh ta plotësojë ankesën. Kundër aktvendimit për plotësimin e ankesës nuk lejohet ankesë (neni 179 paragrafi 1 i LPK-së).

Një shembull i një aktvendimi me të cilin thirret ankuesi për plotësimin e ankesës është paraqitur përmes një formulari sipas numrit të përshkruar në fusnotë.

Po që se ankuesi brenda afatit prej 7 ditësh nuk vepron sipas kërkesës së gjykatës, gjykata me aktvendim e hedhë poshtë ankesën si jo të plotë (neni 179 paragrafi 2 i LPK-së).

Nëse gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar sipas dispozitës së nenit 178 paragrafi 1 i LPK-së, kur ankesa nuk i përmban të dhënat sipas dispozitave nga neni 178 i LPK-së, por ankesën e përcjellë për vendosje në gjykatën e shkallës së dytë për vendosje, atëherë në këtë rast gjykata e shkallës së dytë nuk mund të veproj sipas ankesë. Gjykata e shkallës së dytë në pamundësi që të veproj sipas një ankesë që nuk i përmban elementet e duhura të paracaktuara nga LPK-ja, detyrohet që më akt t'ia kthej shkresat e lëndës gjykatës së shkallës së parë që e njëjta ti ndërmerr veprimet e duhura siç parashihet me dispozitën e nenit 179 paragrafi 1 i LPK-së.

Për një veprim të tillë gjykata e shkallës së dytë i referohet dispozitës së nenit 189 paragrafi 2 të LPK-së.

Raste nga praktika

Nëse gjykatës së shkallës së dytë i është dërguar për shqyrtim ankesa e cila nuk është e nënshkruar nga paraqitësi i ankesës. Në këtë rast gjykata e shkallës së dytë nuk ka mundësi ta hedhë ankesën si jo të plotë sepse paraprakisht duhet që gjykata e shkallës së parë ta thërras ankuesin për plotësimin e ankesës dhe nëse i njëjti nuk e plotëson ankesën, atëherë vet gjykata e shkallës së parë e hedhë ankesën si jo të plotë. Pra në këtë rast gjykata e shkallës së dytë me akt do ti kthejë shkresat e lëndës në gjykatën e shkallës së parë me udhëzime që gjykata e shkallës së parë ti ndërmerr veprimet e duhura për shkak se ankesa nuk i përmban elementet e duhura.

Në mënyrë të njëjtë do të veprohet për të gjitha elementet që duhet ti përmbaj ankesa edhe pse në praktikën gjyqësore ka tolerime për ndonjë element të ankesës. Për shembull në praktikën gjyqësore shumë rrallë mund të ndodhë që ankesa të kthehet në plotësim për deklaratën e ankuesit se aktgjykimi goditet në tërësi apo në pjesë të caktuar. Siç e diskutuam te pjesa “interesi juridik për paraqitjen e ankesës” ndihmon gjykatën për të saktësuar së në cilën pjesë është goditur aktgjykimi.

Nga praktika gjyqësore

Praktika gjyqësore është tolerante edhe sa i përket arsytimit të shkaqeve ankimore sepse në fund të fundit vëllimi i arsytimit është çështje relative shumë e diskutueshme, prandaj nga kjo rrjedhë se gjykata do ta shqyrtoj një ankesë edhe nëse arsytimi për shkaqet ankimore është relativisht i shkurtër. Kjo mënyrë e veprimit në praktikën gjyqësore ka kuptim sidomos për një kategori shkeljesh, për shembull “zbatimi i gabuar i të drejtës materiale” është bazë ankimore që vlerësohet ex-officio, ose disa shkelje absolute të procedurës kontestimore që shikohen ex-officio, për shembull “publiciteti” ose “gjuha në procedurë” etj.

Në praktikë gjyqësore pranohet si ankesë e arsyetuar edhe ankesa që ka saktësuar bazat ankimore por që për arsytim ka përdorë vetëm referencë në shkelje të dispozitave përkatëse. Për shembull referenca në dispozitën që përbënë shkelje absolute për shkak se përbërja e gjykatës nuk është në pajtim me ligjin. Pra nëse ankuesit do ti referohej në ankesë dispozitës së nenit 182 paragrafi 2, pika a) e LPK-së, pa e arsyetuar këtë shkak për ankesë, gjykata e shkallës së dytë do ta pranonte ankesën dhe do ta ekzaminonte aktgjykimin e shkallës së parë pikërisht mbi këtë bazë/shkak ankimore sepse janë të dhënat në shkresat e lëndës që e konfirmojnë ose jo pretendimin e ankuesit.

9.4.5 Shkaqet nga të cilat mund të goditet aktgjykimi

Me shkaqe të ankimit kundër aktgjykimit kuptojmë të gjitha shkaqet për të cilat, sipas LPK-së, pala mund ta godasë atë me ankesë. Shkaqet e ankimit ligji i lidhë për tri lloje aktivitete të cilat

gjkata i kryen me qëllim të dhënies së aktgjykimit me të cilin pranohet apo refuzohet kërkesëpadia në tërësi apo pjesërisht. Të tilla janë aktivitetet që kanë të bëjnë me:

- a) zbatimin e rregullave procedurale,
- b) me konstatimin e gjendjes faktike dhe
- c) me zbatimin e normës materialo-juridike mbi gjendjen faktike të konstatuar në gjykim.

Aktgjykimi mund të goditet (neni 181 paragrafi 1, i LPK-së):

- Për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore,
- Për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike,
- Për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Aktgjykimi në bazë të pohimit dhe aktgjykimi në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia mund të goditen për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, apo nga shkakut se deklarata e pohimit, gjegjësisht e heqjes dorë nga kërkesëpadia, është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit (neni 181.2 i LPK-së).

9.4.6 Shkelja e dispozitave të procedurës kontestimore

Sipas dispozitës së nenit 182 paragrafi 1, i LPK-së, përcaktohet se: “*Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston në qoftë se gjykata gjatë procedurës nuk e ka zbatuar apo ka zbatuar në mënyrë jo të drejtë ndonjë dispozitë të këtij ligji, kurse kjo ka pasur apo ka mund të ketë ndikim në nxjerrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë*”.

Me dispozitat e nenit 182.2 të LPK-së, janë numëruar në mënyrë taksative shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore.

Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë:

- a) *në qoftë se gjykata është përbërë jo sipas dispozitave ose në qoftë se në nxjerrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari që nuk ka marrë pjesë në seancën kryesore;*
- b) *në qoftë se është vendosur për kërkesën e cila nuk bënë pjesë në juridiksionin gjyqësor;*
- c) *në qoftë se në nxjerrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili sipas ligjit duhet të përjashtohet, respektivisht me vendim të gjykatës ka qenë i përjashtuar ose me rastin e dhënies së vendimit ka marrë pjesë personi i cili nuk e ka cilësinë e gjyqtarit;*
- d) *në qoftë se gjykata sipas prapsmit të palëve gabimisht ka vendosur se është e kompetencës lëndore;*
- e) *në qoftë se është vendosur për kërkesën sipas padisë të ngritur pas afatit të përcaktuar me ligj;*
- f) *në qoftë se gjykata ka vendosur për kërkesëpadinë për të cilën është me kompetencë lëndore gjykata më e lartë e llojit të njëjtë, gjykata e llojit tjetër;*
- g) *në qoftë se në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata e ka bazuar vendimin e vetë në disponimin e palejueshëm të palëve, (neni 3 paragrafi 3 i këtij ligji);*

- h) në qoftë se në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata ka nxjerrë aktgjykim për shkak të pohimit, mosbindjes, mungesës, heqjes dorë nga kërkesëpadia, ose pa mbajtjen e shqyrtimit kryesor;
- i) në qoftë se ndonjëri nga palët me veprimin e paligjshëm, e sidomos me mosdhënien e mundësisë për shqyrtimin e çështjes në gjykatë;
- j) në qoftë se në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata e ka refuzuar kërkesën e palës, që në procedurë të përdorë gjuhën dhe shkrimin e vet e të ndjekë procesin në gjuhën e vet, kurse për këtë arsye ankohet;
- k) në qoftë se në procedurë si paditës, ose i paditur, ka marrë pjesë personi që nuk mund të jetë palë në procedurë, apo në qoftë se palën që është person juridik nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar, ose në qoftë se palën me pazotësi procedurale nuk e ka përfaqësuar përfaqësuesi ligjor ose në qoftë se përfaqësuesi ligjor, respektivisht përfaqësuesi me prokurë i palës nuk ka pasur autorizim të nevojshëm për zhvillimin e procedurës apo për kryerjen e ndonjë veprimi në procedurë, në qoftë se zhvillimi i procedurës, respektivisht ushtrimi i veprimeve të veçanta në procedurë nuk është lejuar më vonë;
- l) në qoftë se është vendosur për kërkesën për të cilën vazhdon procedura apo për të cilën më parë është nxjerrë aktgjykim i formës së prerë, ose prej të cilit paditësi njëherë ka hequr dorë ose për të cilin është lidhur pajtimi gjyqësor;
- m) në qoftë se, në kundërshtim me ligjin është përjashtuar publiku në seancën kryesore;
- n) në qoftë se aktgjykim i ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykim i nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vetë atyre dokumenteve ose të procesverbalit;
- o) në qoftë se me aktgjykim është tejkaluar kërkesëpadia.

Në vështrim të dispozitave të sipërcituar rrjedh se jo çdo shkelje e dispozitave të procedurës kontestimore klasifikohet në grupin e shkeljeve thelbësore.

Në praktikën gjyqësore është e lehtë të bëhet ekzaminimi i aktgjykimit/aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë sipas pretendimeve të ngritura në kuptim të dispozitave nga neni 182 paragrafi 2, pikat prej a-o, por është mjaft sfiduese për ti kualifikuar veprimet tjera të gjykatës në shkelje thelbësore ose jo të dispozitave të procedurës kontestimore.

Gjykata ka për detyrë që t'i zbatoj drejtë të gjitha rregullat procedurale të parapara me ligj. Veprimi procedural i cili nuk është kryer në pajtim me dispozitat e procedurës kontestimore është jo i rregullt në pikëpamje procedurale. Nuk është me rendësi a është bërë shkelja e ligjit me qëllim apo nga padijenja. Mirëpo nuk janë të rëndësishme së njëjtë të gjitha shkeljet e dispozitave procedurale. Disa nga shkeljet e procedurës kontestimore janë paraparë si shkelje për ankim e disa nuk janë paraparë si shkelje për ankim.

Praktikisht mund të thuhet se përveç shkeljeve thelbësore të përcaktuara me dispozitat e nenit 182 paragrafi 2, pika prej a-o, të LPK-së, ekzistojnë edhe shkelje tjera thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat duhet të kualifikohen në kuptim të dispozitës së nenit 182 paragrafi 1, të LPK-së. Dallimi i shkeljeve thelbësore në kuptim të dispozitave nga neni 182 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të LPK-së, qëndron në atë se shkeljet thelbësore në paragrafin 2, janë të numëruara, ndërsa në paragrafin 1, shkeljet thelbësore nuk janë të numëruara por i mbetet praktikës gjyqësore që të vlerësojë se cilat nga shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore që nuk janë të përfshira në nenin 182 paragrafi 2, duhet të kualifikohen në grupin e shkeljeve thelbësore.

Si shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në kuptim të nenit 182, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, të LPK-së, mund të konsiderohen të gjitha ato shkelje të cilat kanë penguar vlerësimin bazik dhe të tërësishëm të çështjes kontestuese. Në rrjedhën e kësaj logjike mund të thuhet se në grupin e shkeljeve jo thelbësore përfshihen të gjitha ato shkelje të procedurës por të cilat vlerësohen se nuk e kanë pasur peshën e tillë që të ndikojnë në marrjen e vendimit të drejtë dhe të ligjshëm.

LPK nuk ka bërë klasifikime tjera për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore, çka do të thotë se nëse kufizohemi brenda terminologjisë së përdorur në LPK do të konkludonim se shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore mund të jenë thelbësore dhe jo thelbësore. Megjithatë nëse nisemi nga sanksioni procedural që vije në shprehje për shkak të shkeljes së caktuar atëherë duhet bërë edhe dallime tjera. Në këtë kontekst shkelje thelbësore do të klasifikohen në shkelje thelbësore absolute dhe shkelje thelbësore relative.

Ka një mendim unik sa i përket kuptimit të shkeljeve absolute si në praktikën gjyqësore ashtu edhe në teorinë juridike. Sipas këtij mendimi në shkelje thelbësore absolute përfshihen të gjitha ato shkelje pasojë e të cilave vendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet anuluar, ndërsa në grupin e shkeljeve thelbësore relative bëjnë pjesë të gjitha ato shkelje të cilat kanë ndikuar apo kanë mundur të ndikojnë në dhënien e vendimit të ligjshëm, (në aspektin e konstatimit të gjendjes faktike dhe në aspektin e zbatimit të së drejtës materiale).

Përtej kësaj logjike apo koncepti të klasifikimit të shkeljeve duket se në teorinë juridike dhe në praktikën gjyqësore sa i përket shkeljeve absolute dhe relative ka disa dallime. Në pikëpamje teorike pothuajse të gjithë autorët pajtohen në një pikë, se shkeljet thelbësore absolute janë shkeljet të cilat janë paraparë me dispozitat e nenit 182 paragrafi 2, pikat prej a-o, e LPK-së. Çështja është se nëse merret për bazë kriteri i lart cituar se shkeljet absolute janë të gjitha shkeljet thelbësore për të cilat duhet të anulohet vendimi i gjykatës së shkallës së parë, atëherë në vështrim të dispozitave të LPK-së, paraqiten disa kundërthënie. Kundërthëniet qëndrojnë në atë se ka raste që në mënyrë taksative me dispozitat e LPK-së, përcaktohet se për shkak të shkeljes së caktuar vendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet anuluar, pavarësisht se shkelja e tillë nuk përfshihet në grupin e shkeljeve të numëruara taksativisht me dispozitat e nenit 182 paragrafi 2, pika prej a-o, e po ashtu për disa shkelje të përcaktuara në dispozitat e nenit 182 paragrafi 2, pika prej a-o, vendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk anulohet por ndryshohet.

Rastet:

Rasti a)

Rasti kur shkelja nuk parashihet në dispozitat e nenit 182 paragrafi 2, pika prej a-o, të LPK-së, por vendimi i gjykatës së shkallës së parë prishet.

Me dispozitën e nenit 197 parashihet se: "Gjykata e shkallës së dytë në seancën e kolegjit, apo në bazë të shqyrtimit të çështjes, me aktvendim e prishë aktgjykimin e shkallës së parë dhe

çështjen ia kthen për rigjykim të njëjtës gjykatë të shkallës së parë, nëse konstaton se ekziston njëri ndër këto shkaqe të përmendura në ankesë:

Pika c)- “Po që se gjykata e ka dhënë aktgjykimin pa e bërë shqyrtimin kryesor të çështjes juridike”.

Siç shihet nga kjo dispozitë në mënyrë shprehimore përcaktohet detyrimi i gjykatës së shkallës së dytë që ta prishë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe çështjen ta kthejë në rigjykim nëse gjykata e shkallës së dytë gjen se gjykatë e shkallës së parë e ka dhënë aktgjykimin pa e bërë shqyrtimin kryesor të çështjes juridike. Sigurisht këtu nuk bëhet fjalë për aktgjykimin që në kushte të caktuara procedurale edhe mund të merren pa shqyrtim kryesor, si për shembull aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes (neni 152 i LPK-së).

Në këtë rast nxjerrja e aktgjyimit pa e bërë shqyrtimin kryesor si shkelje/rrethanë procedurale nuk parashihet si shkelje nga grupin e shkeljeve të numëruara në mënyrë taksative me dispozita e nenit 182 paragrafi 2 pika prej a-o, të LPK-së.

Nëse do të merrej për bazë se shkeljet absolute janë shkelje për të cilat parashihet anulimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë, do të konkludonim se në këtë rast nxjerrja e aktgjyimit pa e bërë shqyrtimin kryesor përfshihet në kategorinë e shkeljeve absolute.

Rasti b)

Rasti kur shkelja parashihet me dispozitat e nenit 182, paragrafi 2, pika prej a-o, të LPK-së, por vendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk priset.

Sipas dispozitës së nenit 182 paragrafi 2, shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekzistojnë gjithmonë:

Pika o)- “Në qoftë se me aktgjykim është tejkualuar kërkesëpadi”.

Pavarësisht se tejkualimi i kërkesëpadisë si shkelje është listuar në grupin e shkeljeve thelbësore të parapara në nenin 182, paragrafi 2, nëse bëhet fjala për tejkualim të kërkesëpadisë në atë mënyrë që gjykata ka pranuar më tepër se që është kërkuar me padi, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk priset por ndryshohet.

Këtë përjashtim e parasheh dispozita e nenit 201 e cila përcakton se: “Gjykata e shkallës së dytë në seancën e kolegjit, apo në bazë të shqyrtimit të çështjes kryesore drejtpërsëdrejti, me aktgjykim e ndryshon aktgjykimin e shkallës së parë, Nëse konstaton se ekziston ndonjëri nga këto shkaqe të treguara në ankesë:

Pika e) – “Nëse ka konstatuar se me aktgjykimin e shkallës së parë është tejkualuar kërkesëpadi ashtu që me të është pranuar më tepër se që është kërkuar me padi”.

Në bazë të këtyre dy shembujve mund të themi se nuk mund të shërbej si kriteri i vetëm dhe unik për të përcaktuar shkeljet thelbësore të natyrës absolute fakti se shkelja duhet të jetë e listuar taksativisht dhe për të njëjtën vendimi duhet të anulohet.

Në praktikën gjyqësore ekzistojnë mjaft raste kur gjykata e pranon ankesën dhe pretendimet ankimore duke e anuluar aktgjykimin për shkak se i njëjti është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat gjykata i kualifikon në kuptim të dispozitës së nenit 182 paragrafi 1, lidhur me dispozitën përkatëse, të cilën pala ankuuese e pretendon si shkelje dhe gjykata e pranon si të tillë.

Rast praktik

Nëse gjykata pa arsytim përkatës dhe në kundërshtim me dispozitat e LPK-së, pranon që shkakun për mos dhënien e dëshmisë nga ana e dëshmitarëve.

Nëse përfaqësuesi i palës që nuk është avokat, nuk është i zoti ta kryej këtë detyrë, gjykata duhet ta njoftoj palën me pasojat e dëmshme që mund të lindin për shkak të përfaqësimit të këfillë. Por nëse gjykata nuk ka vepruar në këtë mënyrë atëherë kjo përbën shkelje.

9.4.6.1 Vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike

Ekziston vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike kur gjykata gabimisht e ka vërtetuar ndonjë fakt vendimtar, përkatësisht kur faktin e tillë nuk e ka vërtetuar fare (neni 183 paragrafi 1 i LPK-së). Ekziston konstatimi jo i plotë i gjendjes faktike edhe kur për këtë flasin faktet e reja apo provat e reja (neni 183 paragrafi 2 i LPK-së).

Konstatimi i gabuar i gjendjes faktike - Kur e parashtron këtë shkak, ankuesi pretendon të vërtetojë se shqyrtimi i çështjes është bërë në mënyrë të plotë, por me gabime. Fakti konstatohet gabimisht në qoftë se gjykata, nga provat e marra, është bindur se ai ekziston, edhe pse në të vërtetë ai nuk ekziston si dhe anasjelltas fakti konstatohet gabimisht në qoftë se gjykata, nga provat e marra, ka nxjerrë përfundim se nuk ekziston edhe pse në të vërtetë ai ekziston.

Raste praktike

Shembull: Në qoftë se gjykata nga provat që ka administruar ka vërtetuar faktin se paditësi ka qenë në posedim dhe shfrytëzim të pronës kontestuese, ndërsa në të vërtetë në posedim të pronës nuk ka qenë paditësi.

Shembull: Në qoftë se gjykata nga provat që ka administruar ka vërtetuar faktin se paditësi nuk është penguar në posedimin e pronës nga i padituri, ndërsa në të vërtetë ai është penguar nga i padituri.

E meta e tillë e vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike zakonisht është pasojë e çmuarjes së gabuar të provave të shfrytëzuara. Përveç kësaj konstatimi i gabuar i gjendjes faktike mund të jetë edhe pasojë e provave të pamjaftueshme apo e zgjedhjes së gabueshme të tyre me qëllim të vërtetimit të ndonjë fakti, mandej e përpunimit të gabuar në baza të faktit ekzistues (inicionit) se ekziston fakti tjetër, si dhe pasojë e qëndrimit të gabuar se është pohuar ndonjë fakt edhe pse në të vërtetë nuk është bërë një gjë e tillë ose qëndrimit të gabuar se një fakt është i ditur botërisht.

Konstatimi jo i plotë i gjendjes faktike - Deri të një situatë e tillë mund të vihet në rastet kur gjykata e ka përfunduar gjykimin para se të jetë përgatitur plotësisht çështja juridike për vendosje përkatësisht pa u vërtetuar një fakt vendimtar apo disa sosh. Me rëndësi është që ankuesi, në ankesën e tij të tregojë saktësisht përse mendon se gjendja faktike nuk është konstatuar plotësisht. Me këtë qëllim ai duhet ti përmend faktet për të cilat mendon se nuk janë konstatuar dhe të tregoj pse janë ato, sipas mendimit të tij, me rëndësi për dhënien e mendimit të drejtë.

Raste nga praktika

Shembull: Në qoftë se çështjen në të cilën paditësi e pretendon të drejtën e pronësisë sipas bazës së mbajtjes (mirëbesimit- me parashkrim fitues) ndërsa gjykata se vërteton fare faktin se kush është në posedim të pronës kontestuese.

9.4.6.2 Zbatimi i gabueshëm i të drejtës materiale

Sipas nenit 184 të LPK-së zbatimi i gabueshëm i së drejtës materiale ekziston kur gjykata nuk e ka zbatuar dispozitën e së drejtës materiale që është dashur ta zbatojë, apo kur dispozitën e tillë nuk e ka zbatuar në mënyrë të drejtë.

Kjo shkelje kuptohet si moszbatim nga gjykata i një ligji të së drejtës materiale që duhej zbatuar, zbatimi i një ligji që nuk duhej zbatuar, si dhe interpretimi jo i drejtë i ligjit që bie në kundërshtim me kuptimin e tij të saktë ose me frymën e tij të përgjithshme. Një rast i tillë mund të vijë në shprehje kur pavarësisht se gjykata zbaton me korrektësi dispozitat e procedurës

kontestimore dhe vërteton drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, por zbaton gabimisht normën materiale mbi bazën e të cilës ka vlerësuar themelësinë e kërkesëpadisë, aktgjykimi do të jetë i kundërligjshëm.

Raste nga praktika

Shembull: Në qoftë se gjykata e ka zbatuar ligjin material i cili nuk ka qenë në fuqi në kohën kur është kërkuar mbrojtja juridike gjyqësore për një të drejtë të pretenduar subjektive.

Shembull: Në qoftë se gjykata ka zbatuar gabimisht normat e përcaktimit të afateve të parashkrimit.

Shembull: Në qoftë se gjykata i ka zbatuar dispozitat të cilat një kantatë e bëjnë relativisht nule e është dashur të zbatojë dispozitat të cilat kontratën e bëjnë absolutisht nule.

9.5 Procedura sipas ankesës

Në procedurën e vënë në veprim me anë të ankesës kundër aktgjykimit vepron sikurse gjykata e shkallës së parë e cila e ka dhënë aktgjykimin e goditur, ashtu edhe gjykata e shkallës së dytë, kompetente për vendosjen meritorë për ankesën.

Ankesa i paraqitet gjykatës e cila e ka dhënë aktgjykimin e shkallës së parë, në një numër të mjaftueshëm ekzemplarësh për gjykatën dhe palën kundërshtare (neni 185 i LPK-së).

Veprimet që duhet të ndërmarrë gjykata e shkallës së parë në rast të paraqitjes së ankesës jashtë afatit, jo të plotë apo të palejueshme janë të përcaktuara në nenin 186.1 të LPK-së, me të cilën përcaktohet se: *“Ankesën e paraqitur jashtë afatit të parashikuar me ligj, apo jo të plotë, apo të palejueshme, gjykata e shkallës së parë e hedhë me aktvendim pa caktuar fare seancë gjyqësore”*.

Është detyrë e gjykatës së shkallës së parë që në çdo rast kur gjen se ankesa është e pa afatshme, jo e plotë, apo e palejueshme ta hedhë poshtë me aktvendim ndaj të cilit lejohet ankesa pa caktuar fare seancë gjyqësore.

Duhet sqaruar se ankesën jo të plotë gjykata e shkallës së parë mund ta hedhë poshtë si jo të plotë, pasi që paraprakisht ta ketë konsumuar procedurën e kthimit të ankesës në plotësinë (nenin 179 paragrafi 1, i LPK-së), dhe nën supozimin e ankuesi nuk e plotëson ankesën atëherë duhet të hedhë poshtë.

Ankesa është e pa afatshme po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e saj, (neni 186 paragrafi 2, i LPK-së).

Sipas dispozitës së nenit 186 paragrafi 3, i LPK-së, përcaktohet se: *“Ankesa është e palejueshme nëse e ka paraqitur personi që nuk është i autorizuar për paraqitjen e saj, apo personi që ka hequr dorë nga e drejta e ankimit apo që e ka tërhequr ankesën e paraqitur, apo nëse personi që e ka paraqitur ankesën nuk ka interes juridik për paraqitjen e ankesës”*.

Në praktikën gjyqësore nuk paraqitet ndonjë sfidë për rastet kur kemi të bëjmë me ankesën e paraqitur nga personi që ka heqë dorë nga e drejta e ankimit, apo personi që e ka tërhequr ankesën, apo kur personi që e ka paraqitur ankesën nuk ka interes juridik për paraqitjen e ankesës, por ka një mënyrë veprimi jo unike sa i përket ankesës së paraqitur nga personi i paautorizuar.

Në praktikën gjyqësore shfaqen disa situata kur ankesën e paraqet personi i paautorizuar por që dallon situata/rasti nga situata/rasti. LPK-ja, është mjaftueshëm i qartë për zgjidhjen juridike që duhet të bëjë gjykata për ankesën e paraqitur nga personi i paautorizuar duke saktësuar se ankesa është e palejuar, por në jetën praktike krijohen disa situata qoftë edhe me gabimet e gjykatës së shkallës së parë të cilat krijojnë dilemë se si të veprohet.

LPK-ja, saktëson se ankesa e paraqitur nga personi i paautorizuar është e palejueshme, por nuk jep zgjidhje në pyetjet:

Raste nga praktika:

a). Nëse ankesën e ka paraqitur personi që nuk ka prezantuar autorizim, a duhet paraprakisht gjykatës t'ia kërkojë autorizimin apo menjëherë ta hedhë ankesën si të palejuar?

b). Si të konsiderohet ankesa e lejueshme apo jo, në rast së gjatë shqyrtimit kryesor në seancë ka prezantuar edhe pala edhe përfaqësuesi i palës por që nuk ka dorëzuar fare autorizim në shkresat e lëndës dhe ankesën e nënshkruan pikërisht përfaqësuesi që nuk ka autorizim në shkresat e lëndës?

c). Si të veprohet nëse padinë e ka nënshkruar përfaqësuesi i palës, në shqyrtim përgatitor dhe kryesor ka marrë pjesë përfaqësuesi i palës dhe i pakënaqur me vendimin e gjykatës së shkallës së parë ankesën e ka paraqitur pikërisht përfaqësuesi, por i njëjti nuk ka prezantuar asnjëherë autorizim në shkresat e lëndës dhe gjykata e pakujdesshme e ka toleruar një rast të tillë?

Në vazhdim do bëhet përpjekje për t'u dhënë përgjigje pyetjeve të ngritura.

Përgjigje në pyetjen e parë:

Për pyetjen e parë praktikisht mund të na paraqiten dy situata të ndryshme.

Situata e parë kur ankesën e ka paraqitur personi i paautorizuar dhe i njëjti nuk pretendon se paraqitet në cilësinë e përfaqësuesit të palës ankuese. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë duhet që ta hedhë ankesën si të palejuar sepse e njëjta është paraqitë nga personi i paautorizuar.

Situata e dytë kur ankesën e paraqet personi i paautorizuar dhe i njëjti pretendon se e ka cilësinë e përfaqësuesit të palës. Në këtë rast gjykata duhet ti kërkojë personit që e ka paraqitur ankesën në cilësinë e përfaqësuesit që i njëjti të paraqesë në gjykatë autorizimin/prokurën. Gjykata duhet t'ia kërkojë autorizimin/prokurën me aktvendim të veçantë, ndaj të cilit nuk lejohet e drejta e ankesës dhe me të cilin njoftohet se në rast të mos prezantimit të autorizimit/prokurës cila është pasoja juridike.

Në lidhje me afatin që duhet t'ia jap gjykata për dorëzimin e autorizimit/prokurës nuk ka një dispozitë specifike që rregullon këtë situatë. Në analogji mund të merret afati për plotësimin e ankesës afati 7 (shtatë) ditor, por në parim një afat i tillë për dorëzimin e autorizimit/prokurës është afat gjyqësor. Edhe në rastin kur përfaqësuesi në shqyrtim gjyqësor nuk prezanton autorizim/prokurë gjykata e urdhëron të njëjtin që ta dorëzojë autorizimin/prokurë brenda një afati të caktuar nga gjykata (afat gjyqësor).

Në përcaktimin e afatit gjyqësor në çdo rast gjykatë duhet të veprojë pa e prejudikuar pamundësinë që pala të ndërmarrë veprimin e caktuar. Pra duhet të jepet afati i mjaftueshëm gjyqësor brenda të cilit normalisht pala ose përfaqësuesi mund të kryejnë veprimin e kërkuar.

Nën supozimin se edhe pas kërimit të prokurës, gjykatës nuk i është dorëzuar autorizimi/prokura, atëherë gjykata duhet ta hedhë poshtë si të palejuar ankesën.

Përgjigje në pyetjen e dytë:

Cilësia e përfaqësuesit në gjykim konfirmohet në dy mënyra formale përmes dorëzimit të autorizimit/prokurës dhe përmes konfirmimit të autorizimit/prokurës nga vetë pala për përfaqësuesin në shqyrtim përgatitor/kryesor duke e konstatuar gjykata në procesverbal autorizimin dhe vëllimin e autorizimit. Në të kundërtën fakti së përfaqësuesi i palës, i cili nuk ka prezantuar autorizim/prokurë pasi që me të njëjtin në shqyrtim ka prezantuar edhe pala, në asnjë mënyrë nuk e konsumon nevojën për prezantimin e autorizimit/prokurës. Në këtë kontekst ankesa e paraqitur nga ky person në cilësinë e përfaqësuesit të palës është e paraqitur nga personi i paautorizuar, por gjykata nuk do të duhet ta hedhë ankesën si të palejuar pa i kërkuar paraprakisht përfaqësuesit autorizimin/prokurë.

Përgjigje në pyetjen e tretë:

Përgjigja që i korrespondon pyetjes së tretë në praktikën gjyqësore paraqitet me shumë dilema dhe rrjedhimisht edhe veprimet jo unike të gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së shkallës së dytë. Duhet qartësuar një gjë, se e vërtetë është se në gjykatat tona na paraqiten raste të tilla kur padinë e ka nënshkruar përfaqësuesi, në gjykim ka marrë pjesë përfaqësuesi dhe ankesën e paraqet përfaqësuesi, i cili në fakt asnjëherë nuk ka prezantuar autorizim/prokurë. Në pyetjen logjike se a do të duhej të ndodhte një situatë e tillë? Përgjigja është prapë logjike, JO, nuk do të duhej të ndodhë. Në pyetjen vijues pse ndodhë një situatë e tillë? Përgjigja është prapë logjike dhe e thjeshtë, sepse gjykatat në disa raste janë të pakujdesshme.

Në këtë rast paraqiten dilemat dhe mënyrat e veprimit jo unike ndoshta edhe në gjykatën e shkallës së dytë sepse nuk është një situatë e zakonshme, por është një situatë e jashtëzakonshme.

Nga këndvështrimi i gjykatës së shkallës së dytë, ideja apo vlerësimi fillestar do të ishte se ankesa është e palejuar sepse është paraqitë nga personi i paautorizuar. Kësaj ideje apo vlerësimi fillestar i kundërvihet pasoja jologjore dhe jo logjike që do të krijohet nëse ankesa hedhet si e palejuar për shkak se është paraqitë nga personi i paautorizuar. Pasoja jo logjike është se në momentin që hedhet ankesa bëhet e formës së prerë vendimi i gjykatës së shkallës së parë, për palën e cila në fakt asnjëherë nuk ka paraqitë kërkesë në gjykatë.

Nëse përjashtojmë këtë mundësi të hedhjes së ankesës për shkak të pasojës që krijon atëherë duhet shikuar zgjidhja tjetër si alternative e të parës e që do të ishte prani e ankesës dhe anulimi/prishja e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me udhëzim që gjykata në riprocedurë ti evitohet të metat që lidhen me përfaqësimin. Por edhe qasja mënyrë apo alternative të trajtimit të ankesës i kundërvihet faktit se gjykatat do të pranojnë një ankesë të palejuar për të evituar një ankesë të palejuar.

Do të ishte e thjeshtë për gjykatën e shkallës së dytë nëse ankesa do ta paraqiste pala tjetër sepse zgjidhjen për këtë rast e ofron dispozita e nenit 198 paragrafi 2, që përcakton mundësinë që gjykata e shkallës së dytë ta pranojë ankesën, ta prishë aktgjykimin e goditur dhe lëndën t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim, apo ta pranojë ankesën, ta prishë aktgjykimin e goditur dhe ta hedhë poshtë padinë.

Sipas dispozitës së nenit 182, paragrafi 2, pika k), e LPK-së, gjykata kujdeset ex-officio për shkeljet në procedurë që i referohen palës dhe përfaqësimit të palës, por të vlerësuar ex-officio gjykata këtë shkak ankimor duhet të ketë ankesë të lejueshme, megjithatë praktika gjyqësore e gjendur në këtë situatë të pakuptimte ligjore duke se ka bërë një zgjidhje që është me ma pak pasoja ligjore për palët. Kështu në praktikë gjyqësore dominon mendimi se duhet anuluar vendimi i gjykatës së shkallës së parë sipas ankesës që në fakt është e paraqitur nga personi i

paautorizuar. Kjo mënyrë e veprimit nga gjykata e shkallës së dytë duket se është analogjike me mënyrën e veprimit të gjykatës së shkallës së parë kur lejon përfaqësuesin e palës ti kryejë disa veprime pa e prezantuar paraprakisht autorizimin/prokurën, natyrisht me urdhër që të njëjtën ta paraqesë, por në rast se përfaqësuesi dështon të prezantoj brenda afatit autorizimin/prokurën atëherë gjykata i anulon të gjitha veprimet që ka ndërmarrë përfaqësuesi pa prokurë.

Ju sugjerohet gjykatave të shkallës së parë që të kenë kujdesin e duhur në lidhje përfaqësuesit e palëve sepse nga mos kujdesi i gjykatave mund të krijohen pasoja juridike për vetë palët. Është e njohur se në disa raste kur autorizimi/prokura i është bashkangjitur padisë, gjykata e shkallës së parë nga moskujdesi, gabimisht kopjen e padisë që është për gjykatën, e ku është e bashkangjitur autorizimi/prokura i'a dërgon palës së paditur duke mbetur kështu shkresat e lëndës pa autorizim/prokurën e përfaqësuesit edhe pse përfaqësuesi e ka dorëzuar në mënyrë të rregullt.

9.5.1 Veprimi i gjykatës së shkallës së parë kur ankesa është e rregullt

Në qoftë se ankesa është paraqitur me kohë, është e lejueshme dhe e plotë, atëherë gjykata e shkallës së parë ia dërgon palës kundërshtare, e cila ka të drejtë që në afat prej shtatë (7) ditësh të paraqesë përgjigje në ankesë. Në qoftë se pala e kundërt e shfrytëzon mundësinë që i ka dhënë ligji dhe paraqet përgjigje në ankesë atëherë gjykata e shkallës së parë ia dërgon ankuesit menjëherë përgjigjen ose më së voni brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e arritjes së përgjigjes në gjykatë.

Pas pranimit të përgjigjes në ankesë, apo pas skadimit të afatit për përgjigje në ankesë, gjykata e shkallës së parë ankesën dhe përgjigjen në ankesë me të gjitha shkresat e lëndës ia dërgon gjykatës së shkallës së dytë në afat prej shtatë (7) ditësh më së shumti.

9.5.2 Procedura sipas ankesës në gjykatën e shkallës së dytë

Para se të vendoset për ankesën gjykata e shkallës së dytë e përgatitë çështjen. Gjyqtari relator e përgatitë raportin me qëllim të shqyrtimit të lëndës në gjykatën e ankimit, e cila gjykon në trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë.

Gjyqtari relator, po qe nevoja mundet që nga gjykata e shkallës së parë të kërkojë raport për shkeljet e dispozitave të procedurës dhe mungesat tjera të përmendura në ankesë si dhe të kërkojë që me qëllim të konstatimit të shkeljeve, përkatësisht mungesave të tilla, të bëhen hetimet e duhura (nenin 189 paragrafi 2, i LPK-së).

Për çfarë do mungesë gjyqtari relator mund të kërkojë nga gjykata e shkallës së parë të bëhen hetimet e duhura apo të ndërmerren veprime të caktuara. Është praktikë e gjykatës së shkallës së dytë që këtë veprim e ndërmerr vetë gjyqtari relator i cili e përgatitë çështjen për shqyrtim në kolegji, por për çështje specifike edhe mund të diskutojë me kolegjin, megjithatë aktin me të cilin kërkohen veprime të caktuara nga gjykata e shkallës së parë e paraqet vet gjyqtari relator.

Detyrë e gjyqtarit relator pra është që të studiojë lëndën dhe në lidhje me të, të paraqesë raportin në seancë të mbyllur apo të hapur varësisht se si është caktuar.

Shqyrtimi i çështjes para gjykatës së shkallës së dytë fillon me shpjegime të thukëta të relatorit lidhur me çështjen, por pa e shprehur mendimin e tij rreth themelësisë së ankesës. Pastaj lexohet aktgjykimi, apo pjesa e tij e goditur me ankesë, e nëse është nevoja edhe procesverbali mbi shqyrtimin kryesor para gjykatës së shkallës së parë.

9.5.3 Caktimi i seancës nga gjykata e shkallës së dytë

Gjykata e shkallës së dytë parimisht vendosë për ankesën në seancë të mbyllur, por mund ta caktojë shqyrtimin e çështjes në rastet:

- Kur në procedurën sipas ankesës, para gjykatës së shkallës së dytë ofrohen fakte të reja dhe prova në lidhje me këto fakte. Faktet dhe provat e reja palët mund ti paraqesin në pajtim me nenin 180 të LPK-së.
- Gjykata e shkallës së dytë duhet ta caktojë shqyrtimin e drejtpërdrejtë të çështjes edhe po që se aktgjykimi i shkallës së parë është anuluar dy herë dhe kur ankesa është paraqitë për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale dhe për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ndërsa në seancën e kolegjit vlerësohet se aktgjykimi i ankimuar është bazuar në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore apo në gjendje faktike të konstatuar gabimisht apo në mënyrë jo të plotë.
- Gjykata e shkallës së dytë mund ta caktojë shqyrtimin e drejtpërdrejtë edhe kur vlerëson se me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet përsëri të merren të gjitha ose disa nga provat e administruara në gjykatën e shkallës së parë. Për kjo situatë mbetet në vlerësimin e gjykatës së shkallës së dytë se kur do të hap shqyrtimin dhe kur do të vendosë pa hapur shqyrtim. Në praktikën gjyqësore ka fare pak raste kur gjykata e shkallës së dytë për këtë situatë ka hapur shqyrtim.

Është me rëndësi të theksohet se caktimi i seancën në gjykatën e shkallës së dytë nuk mund të bëhet nga gjyqtari relator, por duhet që paraprakisht në seancë të mbyllur kolegji të konstatojë nevojën apo mundësinë e caktimit të seancës në gjykatën e shkallës së dytë e pastaj të thirret seanca.

Nëse kolegji ka konstatuar se duhet të caktohet seanca në gjykatën e shkallës së dytë atëherë është kryetari i kolegjit i cili me rastin e hapjes së seancës duhet të bëjë konstatimet përkatëse për arsyen e caktimit të seancës e pastaj të vazhdojë me rrjedhën e procedurës sikurse në çdo rast kur është konvokuar seanca gjyqësore.

Edhe në rastet kur është caktuar seanca në gjykatën e shkallës së dytë, mënyra e vendosjes janë të njëjta sikur kur gjykata e shkallës së dytë në seancë të mbyllur.

9.5.4 Kufijtë e ekzaminimit të aktgjykimit të shkallës së parë

Me dispozitën e nenit 194 të LPK-së, përcaktohet se: *“Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të këtij ligji”.*

Përveç që gjykata e shkallës së dytë do të kujdes ex-officio për zbatimin e të drejtës materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë, ajo kujdeset ex-officio edhe për disa shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore.

Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kujdeset ex-officio gjykata e shkallës së dytë janë:

- *Në qoftë se është vendosur për kërkesën e cila nuk bënë pjesë në juridiksionin gjyqësorë,*
- *Në qoftë se në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata e ka bazuar vendimin e vetë në disponimin e palejueshëm të palëve, (neni 3 paragrafi 3 i këtij ligji),*
- *Në qoftë se në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata e ka refuzuar kërkesën e palës, që në procedurë të përdorë gjuhën dhe shkrimin e vet e të ndjekë procesin në gjuhën e vet, kurse për këtë arsye ankohet,*
- *Në qoftë se në procedurë si paditës, ose i paditur, ka marrë pjesë personi që nuk mund të jetë palë në procedurë, apo në qoftë se palën që është person juridik nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar, ose në qoftë se palën me pazotësi procedurale nuk e ka përfaqësuar përfaqësuesi ligjor ose në qoftë se përfaqësuesi ligjor, respektivisht përfaqësuesi me prokurë i palës nuk ka pasur autorizim të nevojshëm për zhvillimin e procedurës apo për kryerjen e ndonjë veprimi në procedurë, në qoftë se zhvillimi i procedurës, respektivisht ushtrimi i veprimeve të veçanta në procedurë nuk është lejuar më vonë, dhe*
- *Në qoftë se, në kundërshtim me ligjin është përjashtuar publiku në seancën kryesore.*

Mjafton që të ketë ankesë kundër një vendimi të gjykatës së shkallë së parë dhe gjykata e shkallës së dytë do të kujdeset ex-officio nëse vendimi i atakuar është i përfshirë në këto shkelje. Arsye pse ligdhënësi ka përcaktuar se gjykata e shkallës së dytë duhet të kujdeset ex-officio për zbatimin e të drejtës materiale dhe për pesë shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore duket se qëndron në atë se e drejta materiale-ndryshe e drejta objektive apo vetë ligji, përcakton nevojën e shoqërisë që e drejta subjektive e secilit subjekt të jetë brenda asaj çka është formësuar si vullneti i shoqërisë në të drejtën objektive, ndërsa shkeljet thelbësore që shikohen ex-officio duket se tejkalojnë interesin e palës në procedurë.

Shembuj:

Nuk është shumë me rëndësi publiciteti në procedurë sepse palës i intereson interesi individual, por publiciteti është në interes të shoqërisë, sepse përmes publicitetit nxitet besimi i publikut në gjykatë.

Është në interesin e shoqërisë për shkak të sigurisë juridike që gjykata mos të lejoj asnjë palë të disponojë me diçka që nuk mund të disponojë.

Është në interesin e shoqërisë që të veprohet brenda juridiksioneve të institucioneve sepse kjo krijon sigurinë juridike dhe garanton funksionimin e rendit juridik, etj..

9.6 Mënyrat e vendosjes sipas ankesës

LPK-ja, me dispozita e nenit 195 paragrafi1, parasheh se Gjykata e Ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejtë para saj, do të vendosë për ankesën në njërin nga mënyrat si në vijim:

- *ta hedhë poshtë ankesën si të vonuar, jo të plotë apo të palejueshme;*
- *ta prishë aktgjykimin e goditur dhe ta hedhë poshtë padinë;*
- *ta prishë aktgjykimin e goditur dhe ta kthej çështjen në rigjykim në Gjykatën Themelore;*
- *ta refuzoj ankesën si të pathemeltë dhe ta vërtetoj aktgjykimin e goditur;*
- *ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë.*

9.6.1 Hedhja poshtë e ankesës si e vonuar, jo e plotë apo e palejueshme

Sipas dispozitës së nenit 196 të LPK-së parashihet se: Ankesën e vonuar, jo të plotë, apo jo të lejueshme, e hedhë poshtë gjykata e shkallës së dytë me aktvendim, po që se nuk e ka bërë një gjë të tillë gjykata e shkallës së parë siç është parashikuar në (nenin 186).

Gjykata e shkallës së dytë nuk do të veprojë sipas dispozitës së nenit 196 të LPK-së, në situatën si në vijim: Në qoftë se gjykatës së shkallës së dytë i është dërguar lënda sipas ankesës e cila është jo e plotë, ndërsa gjykata e shkallës së parë nuk i ka ndërmarrë paraprakisht veprimet nga neni 179 paragrafi 1 i LPK-së, atëherë gjykata e shkallës së dytë nuk mundet që ta hedhë poshtë ankesën si jo të plotë por duhet që lëndën t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë me udhëzim që gjykata e shkallës së parë të veprojë në kuptim të dispozitës së nenit 179 par 1 i LPK-së, duke e thirrur ankuesin që ta plotësoi ankesën.

9.6.2 Prishja e aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe hedhja poshtë e padisë

Gjykata e Apelit nxjerrë aktvendim për prishjen e aktgjykimit të Gjykatës Themelore, dhe e hedhë poshtë padinë, nëse janë plotësuar rrethanat sipas nenit 198 të LPK-së, të cilat parashohin si në vijim:

- *Nëse kërkesa për të cilën është vendosur bënë pjesë në kompetencën gjyqësor;*
- *Nëse ekziston gjyqëvarësia;*
- *Nëse çështja është e gjykuar, (ekzistimi i aktgjykimit të formës së prerë);*
- *Nëse paditësi ka heqë dorë nga kërkesëpapia (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpapia);*
- *Nëse ekziston pajtimi gjyqësor për çështjen.*

Këto situata i referohen rasteve kur gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar prezumimet procedurale që kanë të bëjnë me kompetencën dhe objektin e kontestit.

Gjykata e Apelit e hedhë padinë edhe në këto raste:

- *Në qoftë se në procedurën e shkallës së parë ka vepruar, si paditës apo i paditur, personi që nuk mund të jetë palë ndërgjyqëse,*
- *Nëse palën që është person juridik nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar, apo nëse palën me pazotësi procedurale nuk e ka përfaqësuar përfaqësuesi ligjor,*
- *Nëse përfaqësuesi ligjor, ose ai me prokurë, nuk i ka pasur autorizimet e duhura për ndjekjen e çështjes në gjyq, apo për kryerjen e veprimeve procedurale të veçanta, gjegjësisht nëse veprimet e caktuara të kryera në procedurë më vonë nuk i ka aprovuar vetë pala.*

Këto situata i referohen rasteve kur gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar prezumimet procedurale që kanë të bëjnë me palët.

9.6.3 Prishja e aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe kthimi i çështjes në rigjykim

Sipas nenit 197 të LPK-së, Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, apo në bazë të shqyrtimit të bërë të çështjes, me aktvendim e prishë aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe çështjen ia kthen për rigjykim, në qoftë se konstaton se ekziston njëra ndër këto shkaqe të përmendura në ankesë:

- *po që se në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji gjykata e ka dhënë aktgjykimin në bazë të pohimit, apo aktgjykimin në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia;*
- *po që se ndonjë nga palët me veprim të kundërligjshëm, e sidomos për shkak të mos thirrjes në mënyrë të rregullt, nuk i është dhënë mundësia që të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes, kurse veprimi i tillë ka pasur ndikim në dhënien e vendimit të ligjshëm dhe të drejtë;*
- *po që se gjykata e ka dhënë aktgjykimin pa e bërë shqyrtimin kryesor të çështjes juridike;*
- *po që se në dhënien e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili sipas vet ligjit duhet të përjashtohet nga gjykimi.*

Përveç rasteve të cekura Gjykata e Apelit do ta prishë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë edhe nëse në seancën e kolegjit konstaton se:

- me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë është tejkaluar kërkesëpadia, ashtu që me të është vendosur për ndonjë çështje tjetër e jo për atë të ngritur me padi, atëherë ajo me aktvendim e prishë aktgjykimin e shkallës së parë dhe e kthen çështjen për procedim të serishëm, (neni 202 i LPK-së).

Është me rëndësi të theksohet se këto raste të sipër theksuara për të cilat priset aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe lënda kthehet në rishqyrtim të serishëm i referon vetëm shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat janë të parapara me dispozitat e nenit 182 paragrafi 2, i LPK-së, prandaj duhet kuptuar se Gjykata e Apelit do ta prishë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe do ta kthejë çështjen në rishqyrtim edhe të në gjitha rastet që gjen se aktgjykimi është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat mund të kualifikohen në kuptim të dispozitave së nenit 182 paragrafi 1, lidhur me shkeljen përkatëse të dispozitës së caktuar (të pretenduar më ankesë).

Për shkeljet që nuk shikohen ex-officio pavarësisht se mund të jenë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, Gjykata e Apelit do ti vlerësojë vetëm nëse janë paraqitë si shkelje të pretenduara me ankesë, në të kundërtën nuk do të vlerësohen fare nga gjykata e shkallës së dytë.

Fakti së gjykata e shkallës së dytë e ekzaminon aktgjykimin brenda kufijve të ankesës përveç atyre shkeljeve që shikohen ex-officio ka ndikuar që në disa raste të mendohet se gjykata e shkallës së dytë nuk vepron në mënyrë unike përkatësisht të harmonizuar sepse për çështje të përafërta është vendosur në mënyra të ndryshme. Kjo mund të ndodhë për arsyen e thjeshtë së në njërin rast ankuesi i ka pretenduar shkeljet të cilat nuk vlerësohen ex-officio dhe gjykata ka konstatuar se aktgjykimi është i përfshirë në shkeljet e tilla të cilat kanë ndikuar që vendimi gjyqësor të priset dhe çështja të kthehet në rishqyrtim, ndërsa në rastin tjetër ankuesi nuk i ka pretenduar shkeljet që nuk vlerësohen ex-officio dhe gjykata është kufizuar brenda kufijve të ankesës duke gjetur se aktgjykimi ankesa nuk është e themeltë.

Për më tepër kur gjykata e shkallës së dytë e prishë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe çështjen ia kthen të njëjtës gjykatë për rigjykim, ajo mund të urdhërojë që rishqyrtimi i çështjes të bëhet nga gjyqtari tjetër.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë është e detyruar që pasi që ta pranojë aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë në aftë prej 30 ta caktojë seancën (përgatitore apo për shqyrtim kryesor), ti kryej gjitha veprimet procedurale dhe ti shqyrtojë të gjitha çështjet kontestuese që i ka ofruar gjykata e shkallës së dytë me vendimin e saj.

Procedura e zhvilluar në rishqyrtim përbënë tërësi unike më atë në të cilën është dhënë aktgjykimi i anuluar. Në të palët mund ti kryejnë të gjitha veprimet procedurale, duke përfshirë edhe ato disponibile, të cilat kanë pasur të drejtë ti kryejnë në procedurën e parë.

9.6.4 Refuzimi i ankesës dhe vërtetimi i aktgjykit të shkallës së parë

Gjykata e shkallës së dytë me aktgjykim e refuzon ankesën si të pathemeltë dhe e vërteton aktgjykimin e shkallës së parë nëse konstaton se nuk ekzistojnë shkaqet nga të cilat është goditur aktgjykimi, e as shkaqet për të cilat ajo kujdeset sipas detyrës zyrtare, (neni 200 i LPK-së).

Në rastet, kur gjykata e shkallës së dytë konstaton se ankesa është e pathemeltë, ajo njëkohësisht e vërteton vendimin (aktgjykimin ose aktvendimin) e gjykatës së shkallës së parë.

9.6.5 Ndryshimi i aktgjykit të Gjykatës Themelore

Me dispozitën e nenit 201 të LPK-së, Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, apo në bazë të shqyrtimit të çështjes kryesore drejtpërsëdrejti, me aktgjykim e ndryshon aktgjykimin, po që se konstaton se ekziston ndonjëri nga këto shkaqe të treguara në ankesë:

- *nëse ka konstatuar se ekziston shkelja e dispozitave të procedurës kontestimore, përpos atyre të përmendura në nenin 197 të këtij ligji;*
- *nëse në seancën e kolegjit, me anë të vlerësimit ndryshe të shkresave dhe provave të marra në mënyrë indirekte, ka konstatuar gjendje tjetër faktike nga ajo e përmbajtur në aktgjykimin e shkallës së parë;*
- *nëse pas shqyrtimit direkt të çështjes, në bazë të provave të reja, apo në bazë të marrjes rishtas të provave të administruara nga Gjykata Themelore, ka konstatuar gjendje tjetër faktike nga ajo e përmbajtur në aktgjykimin e shkallës së parë;*
- *nëse konsideron se gjendja faktike e përmbajtur në aktgjykimin e shkallës së parë është konstatuar drejtë, por e drejta materiale është zbatuar gabimisht nga Gjykata Themelore;*
- *nëse ka konstatuar se me aktgjykimin e shkallës së parë është tejkualuar kërkesëpadija ashtu që me të është pranuar me tepër se që është kërkuar me padi.*

Sipas nenit 203 të LPK-së, “Gjykata e Apelit nuk mund ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë në dëm të palës ankuese, po që se vetëm ajo ka bërë ankim, e jo edhe pala kundërshtare”.

Në të gjitha rastet e ndryshimit të aktgjykit të shkallës së parë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë duhet të jetë tjetër dhe i ndryshëm nga ai i pari. Me anë të aktgjykit ndryshues të gjykatës së shkallës së dytë evitohen parregullsitë që kanë të bëjnë me vendosjen meritore e jo me procedurën, përjashtim nga ky rregull bënë rasti i tejkalimit të kërkesëpadiisë ku gjykata e shkallës së dytë në të vërtet e ndryshon aktgjykimin për shkak të gabimeve të procedurës.

9.7 Organizimi i një aktgjykimi të Gjykatës së Apelit

Neni 204 i LPK-së parasheh që: “Në arsyetimin e aktgjykit, gjegjësisht të aktvendimit, Gjykata e Apelit duhet t’i vlerësojë thëniet në ankesë që kanë qenë të rëndësisë vendimtare për dhënien e vendimit të saj”.

Të gjitha rregullat që vlejnjë për vendimin e gjykatës së shkallës së parë parimisht vlejnjë edhe për vendimin e gjykatës së shkallës së dytë, por me disa specifika. Në hyrje të vendimit duhet të tregohet përmbajtja e ankesës në pika të shkurtra, në dispozitiv tregohet mënyra e vendosjes

ndërsa në pjesën arsyetuese bëhet vlerësimi i thënieve të ankuesit dhe tregohen shkaqet për mënyrën e vendosjes nga gjykata e shkallës së dytë.

9.8 Ankesa kundër aktvendimit

Baza për ankesë

Neni 206 paragrafi 1 i LPK-së parasheh që kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë lejohet ankimi, në qoftë se në këtë ligj nuk është përcaktuar që ankimi nuk lejohet, kurse (neni 206 paragrafi 2). Po që se me këtë ligj parashihet shprehimisht se ankimi i veçantë nuk lejohet, aktvendimi i shkallës së parë mund të goditet vetëm me anë të ankesës që paraqitet kundër vendimit me të cilin përfundon procedimi i çështjes në gjykatën e shkallës së parë.

9.9 Efektet e ankesës

Ankesa e paraqitur brenda afatit ligjor e pengon përmbarimin e aktvendimit, në qoftë se me këtë ligj nuk është parashikuar ndryshe, (neni 207.1).

9.10 Mënyra e vendosjes nga gjykata e shkallës së dytë për ankesat kundër aktvendimeve

Neni 209 i LPK-së i parasheh dispozitat në vijim për vendosjen mbi ankesat kundër aktvendimeve të Gjykatës Themelore.

Gjykata e Apelit mund ta zgjidhë ankesën në këto baza:

- *të hedhë poshtë ankesën si të pa afatshme,*
- *ta hedhë poshtë si jo të lejueshme;*
- *të refuzoj ankesën si të pa themeltë dhe të vërteton aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë;*
- *të aprovon ankesën dhe të ndryshon aktvendimin e goditur;*
- *të prishë aktvendimin e goditur, e kur është nevoja ta kthejë çështjen në Gjykatën Themelore.*

Në procedurën sipas ankesës së veçantë, të paraqitur kundër aktvendimit, në mënyrë adekuate do të zbatohen dispozitat e këtij ligji që vlejné për ankesën kundër aktgjykimit, përveç dispozitave me të cilat parashihet mundësia e shqyrtimit të çështjes drejtpërsëdrejti nga gjykata e shkallës së dytë, (neni 208 i LPK-së).

9.11 Përmbledhje

Në këtë sesion janë elaboruar mjetet e rregullta të goditjes, bazat për paraqitjen e mjeteve të goditjes, proceduar dhe mënyrat e vendosjes. Është përfshirë me detaje edhe aktiviteti i gjykatës në faze të shqyrtimit të lejueshmërisë së mjeteve të goditjes.

10. Mjetet e jashtëzakonshme të goditjes

10.1 Hyrje

Në këtë sesion janë shtjelluar mjete e jashtëzakonshme të goditjes se vendime të formës së prerë. Janë elaboruar llojet e mjeteve të jashtëzakonshme, kushtet për paraqitjen e tyre, vlerësimet që bën sa i përket lejueshmërisë gjykata e shkallë së parë dhe mënyrat e vendosjes sipas mjeteve të jashtëzakonshme.

10.2 Objektivat trajnues

Pas përfundimit të këtij moduli pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të :

- Vlerësojnë lejueshmërinë e secilit mjet të jashtëzakonshme;
- Vendosin varësisht nga vlerësimet që do të kenë për lejueshmërinë e mjeteve të jashtëzakonshme;
- Njohin kushte edhe shkaqet sipas të cilave mund të paraqiten mjetet e jashtëzakonshme.

10.3 Mjetet e jashtëzakonshme

LPK i njih tri lloje të mjeteve të jashtëzakonshme juridike të cilat mund të paraqiten kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë, dhe ato janë: Revizioni (neni 211); Përsëritja e Procedurës (neni 232) dhe Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë (neni 245).

10.4 Revizioni

Revizioni është mjet i goditjes së jashtëzakonshme me të cilin pala e godet për shkak të shkeljes së ligjit aktgjykimit të formës së prerë të gjykatës së shkallës së dytë të dhënë sipas ankesës kundër aktgjykimit të shkallës së parë.

Revizioni nuk duhet parë vetëm si garanci më tepër se kontesti midis palëve do të zgjidhet drejtë, por rëndësia e këtij mjeti qëndron edhe në faktin se ai është mjet për njëjtësimin e praktikës gjyqësore, pasi që duke marrë qëndrime në lidhje me një çështje Gjykata Supreme e Kosovës, ndihmon me vendimin e saj gjykatat më të ulëta, sepse ato zakonisht i respektojnë qëndrimet e saj.

Revizioni si mjet i jashtëzakonshëm është i kufizuar sepse mund të goditen vetëm vendimet e caktuara dhe për shkaqet e caktuara.

Sipas dispozitës së nenit 211 paragrafi 1, i LPK-së, parashihet se: *“Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, palët mund të paraqesin revizion brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën iu është dorëzuar aktgjykimi”*.

10.4.1 Në cilat raste lejohet revizioni

Sipas dispozitës së nenit 211 paragrafi 2, i LPK-së, përcaktohet se: *“Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit, ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk kalon 3000 Euro”*, ndërsa në dispozitën e paragrafit 3 të nenit 211, të LPK-së, parashihet se: *“ Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia nuk ka të bëjë me kërkesat në para, me dorëzimin e sendit apo me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit e treguar në padinë e paditësit nuk kalon shumë prej 3000 Euro”*.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave rrjedh se është kusht formal për lejimin e revizionit që kontesti të ketë vlerë 3000 Euro, e më shumë. Nga ky kusht formal nga i cili varet lejueshmëria e revizionit ka përjashtime të cilat parashihen me dispozitat e nenit 211 paragrafi 4, i LPK-së.

Sipas dispozitës së nenit 211 paragrafi 4, i LPK-së, përcaktohet se: *“Përjashtimisht edhe kur është fjala për kërkesëpadinë nga paragrafi 2 dhe 3 të këtij neni, revizioni gjithmonë është i lejuar:*

- a). në kontestet për ushqim;*
- b). në kontestet për shpërblimin e dëmit për ushqimin e humbur, për shkak të vdekjes së dhënësit të ushqimit;*
- c). në kontestet nga marrëdhëniet e punës të cilat i fillon i punësuari kundër vendimit për shuarjen e marrëdhënies së punës”*.

Përjashtim nga kushti formal që objekti i kontestit të ketë vlerë 3000 Euro, bëhet edhe në procedurën e kontesteve tregtare ku me dispozitën e nenit 508 të LPK-së, përcaktohet se: *“Revizioni në kontestet tregtare nuk lejohet në qoftë se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit të formës së prerë nuk i kalon 10.000 Euro”*.

Sigurisht në të ardhmen do të ishte me interes për procedurën kontestimore që vlera e objektit të kontestit të rritet si kusht formal nga i cili varet lejueshmëria e revizionit.

10.4.2 Shkaqet për paraqitjen e revizionit

Shkaqet për paraqitjen e revizionit përcaktohen me dispozitat e nenit 214 të LPK-së, të ndryshuar dhe plotësuar me dispozita e Ligjit Nr.04/L-118.

Sipas dispozitave nga neni 214 të LPK-së, revizioni mund të paraqitet:

- a). për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, me përjashtim të shkeljeve të parapara në nenin 182 paragrafi 2 pikat (f, h, i dhe m).
- b). për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1, të këtij ligji që është bërë në procedurën e shkallës së dytë.
- c). për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
- d). për shkak të tejkalimit të kërkesëpadisë, në qoftë se kjo shkelje është bërë në procedurën para gjykatës së shkallës së dytë.

Nga dispozitat e sipërcituara mund të konkludohet së fundi i shkeljeve thelbësore për të cilat mund të paraqitet revizioni në raport me ankesën është më i vogël, pasi që për paraqitjen e revizionit si shkaqe nga neni 182 paragrafi 2, mund të përdoren vetëm 4 shkaqe dhe atë:

- në qoftë se gjykata ka vendosur për kërkesëpadinë për të cilën është me kompetencë lëndore gjykata më e lartë e llojit të njëjtë, gjykata e llojit tjetër;
- në qoftë se në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata ka nxjerrë aktgjykim për shkak të pohimit, mosbindjes, mungesës, heqjes dorë nga kërkesëpadia, ose pa mbajtjen e shqyrtimit kryesor;
- në qoftë se ndonjëherë nga palët me veprimin e paligjshëm, e sidomos me mosdhënien e mundësisë për shqyrtimin e çështjes në gjykatë;
- në qoftë se, në kundërshtim me ligjin është përjashtuar publiku në seancën kryesore.

Përveç këtyre shkeljeve nga neni 182, paragrafi 2, për paraqitjen e revizionin si shkak mund të përdoret edhe tejkalimi i kërkesëpadisë por me kusht që tejkalimi i kërkesëpadisë të ketë ndodhur në gjykatën e shkallës së dytë.

Sa i përket shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të kualifikuar në kuptim të nenit 182, paragrafi 1 të LPK-së, si bazë për revizionin mund të përdoren vetëm për procedurën në gjykatën e shkallës së dytë.

Në kuptim të t'cekurave mund të konkludohet se revizioni si mjet i jashtëzakonshëm i goditjes së vendimit të formës së prerë është mjaft i kufizuar në kuptimin e pretendimeve që mundë të paraqesin palët përmes revizionit sa i përket shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore.

Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike.

Revizioni kundër aktgjykimit të dhënë në procedurën e shkallës së dytë, me të cilin vërtetohet aktgjykimi në bazë të pohimit, mund të paraqitet vetëm për shkak të:

- a). për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, me përjashtim të shkeljeve të parapara në nenin 182 paragrafi 2 pikat (f, h, i dhe m).
- b). për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1, të këtij ligji që është bërë në procedurën e shkallës së dytë.
- d). për shkak të tejkalimit të kërkesëpadisë, në qoftë se kjo shkelje është bërë në procedurën para gjykatës së shkallës së dytë.

Në këtë rast nuk mund të paraqitet edhe pretendimi për zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Kundër aktgjykimit të shkallës së dytë me të cilin vërtetohet aktgjykimi i shkallës së parë, revizioni nuk lejohet për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore nga paragrafi 1 pika a) e këtij neni (*për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pikat (f, h, i dhe m)*), po që se ekzistimi i tyre nuk është përmendur fare në ankesë, përveç se kur është fjala për shkeljet për të cilat kujdeset sipas detyrës zyrtare vet Gjykata e Apelit dhe ajo e revizionit (neni 214.4).

Kur revizioni paraqitet për shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të bërë në gjykatën e shkallës së dytë, palët mund të paraqesin fakte dhe prova të reja nëse pa fajin e tyre nuk kanë mundur ti paraqesin më herët.

10.4.3 Procedura sipas revizionit

Revizioni i dorëzohet gjykatës së shkallës së parë e cila e ka dhënë aktgjykimin e shkallës së parë, në numër të mjaftueshëm për gjykatën dhe palën kundërshtare.

Revizionin e paraqitur pas kohe, të palejueshëm apo jo të plotë, e hedhë poshtë me aktvendim gjykata e shkallës së parë pa mbajtur fare seancë gjyqësore. Ndaj aktvendimit me të cilin hedhet revizioni lejohet ankesa për gjykatën e shkallës së dytë.

Sipas dispozitave të LPK-së, nga neni 218 paragrafi 2, revizioni është i palejueshëm nëse:

- a) e ka paraqitur personi i cili nuk është i autorizuar për paraqitjen e revizionit;
- b) revizionin e ka paraqitur personi i cili e ka tërhequr revizionin;
- c) nëse personi i cili e ka paraqitur revizionin nuk ka interes juridik për paraqitjen e tij; dhe
- d) është paraqitur revizioni kundër aktgjykimit kundër të cilit sipas ligjit nuk mund të paraqitet.

Nëse revizioni i paraqitur është paraqitur brenda afatit, është i plotë dhe i lejueshëm, atëherë gjykata e shkallës së parë një kopje të revizionit ia dërgon palës kundërshtare brenda shtatë (7) ditësh. Pala kundërshtare ka të drejtë që brenda afatit prej shtatë ditësh të paraqes përgjigje në revizion.

Pasi të jepet përgjigja në revizion apo pasi që të kalojë afati për paraqitjen e revizionit gjykata e shkallës së parë brenda afatit prej shtatë ditësh ia dërgon revizionin bashkë me shkresat e lëndës Gjykatës Supreme të Kosovës që e njëjta të vendosë për revizionin.

10.4.4 Vendosja sipas revizionit në Gjykatën Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme vendosë mbi revizionin, vetëm në bazë të shkresave të lëndës, në seancë të trupit gjykues, (nenin 220 i LPK-së).

Gjykata e revizionit e shqyrton aktgjykimin e goditur vetëm në pjesën e tij të goditur me anë të revizionit dhe vetëm brenda kufijve të shkaqeve të treguara në revizion, por duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale dhe për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore që kanë të bëjnë me zotësinë për të qenë palë dhe përfaqësimin e rregullt, (neni 215 i LPK-së).

Mënyrat e vendosjes sipas revizionit nga Gjykata Supreme e Kosovës;

- Revizionin e vonuar, jo të plotë dhe të palejueshëm me aktvendim e hedhë poshtë gjykata e revizionit, po që se një gjë të tillë nuk e ka bërë gjykata e shkallës së parë brenda kufijve të autorizimeve të saja (neni 221 i këtij ligji).
- Gjykata Supreme e refuzon revizionin si të pathemeltë, me anë të aktgjykimit, po që se konstaton se nuk ekzistojnë shkaqet e cekura në revizion.
- Në qoftë se gjykata e revizionit konstaton se ekziston shkelja e dispozitave të procedurës kontestimore për shkak të të cilave mund të paraqitet revizioni, përpos (shkeljeve), atëherë ajo, duke marrë parasysh natyrën e shkeljes, me aktvendim e anulon pjesërisht apo plotësisht aktgjykimin e shkallës së dytë dhe të parë, apo vetëm aktgjykimin e shkallës së dytë dhe ia kthen çështjen për rigjykim gjyqtarit tjetër apo

të njëjtë të gjykatës së shkallës së parë, gjegjësisht kolegjit tjetër apo të njëjtë të gjykatës së shkallës së dytë, ose gjykatës tjetër kompetente.

- Në qoftë se gjykata e revizionit konstaton se e drejta materiale është zbatuar gabimisht, me aktgjykim e aprovon revizionin e paraqitur dhe e ndryshon aktgjykimin e goditur.
- Po që se gjykata e revizionit konstaton se për shkak të zbatimit të gabueshëm të së drejtës materiale, apo për shkak të shkeljeve të rregullave procedurale, gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk ekzistojnë kushtet për ndryshimin e aktgjykimit të goditur, atëherë ajo me aktvendim e aprovon revizionin dhe e anulon pjesërisht apo tërësisht aktgjykimin e shkallës së parë dhe të dytë, apo vetëm aktgjykimin e shkallës së dytë, dhe çështjen ia dërgon për rigjykim gjyqtarëve të njëjtë apo të tjerë të gjykatës të shkallës së parë apo të dytë.
- Po që se konstaton se me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës së shkallës së dytë është tejkalluar kërkesëpapia, gjykata e revizionit me aktgjykimin e saj e aprovon revizionin e palës dhe e ndryshon aktgjykimin e goditur.

Vendimi i gjykatës së revizionit u dërgohet palëve nëpërmjet gjykatës së shkallës së dytë brenda afatit tridhjetë (30) ditor, (neni 226 i LPK-së). Duhet sqaruar se gjykata e shkallës së dytë pasi që ti pranon shkresat e lëndës së revizionit nga Gjykata Supreme, e njëjta lëndën e dërgon në gjykatën e shkallës së parë, përveç në rastet kur gjykata e revizionit e ka kthyer lëndën për shqyrtim në gjykatën e shkallës së dytë.

Po që se me dispozitat e neneve të këtij kreu nuk parashikohet ndonjë gjë tjetër, në procedurën sipas revizionit, në mënyrë adekuate zbatohen dispozitat e këtij ligji mbi ankesën kundër aktgjykimit, përveç dispozitave me të cilat parashihet mundësia e mbajtjes së shqyrtimit të çështjes kryesore në gjykatën e ankimit, (neni 227 i LPK-së).

10.5 Përsëritja e Procedurës

Propozimi për përsëritjen e procedurës është mjet i jashtëzakonshëm i goditjes, i kufizuar, jo suspenziv, i dyanshëm dhe në disa raste remonstrativ. E drejta për të kërkuar përsëritjen e procedurës është e kufizuar në aspektin e vendimeve që mund të goditen më këtë mjet goditjeje, në aspektin e shkaqeve për të cilat mund të bëhet goditja e vendimeve, si dhe në aspektin e afatit brenda të cilit mund të ngritët ai.

Me anë të propozimit për përsëritjen e procedurës mund të kërkohet përsëritja e procedurave të përfunduara me vendim të formës së prerë. Procedura mund të përfundojë me anë të aktgjykimit, me anë të aktvendimit me të cilin padia hedhet poshtë apo me anë të aktvendimit me të cilin konstatohet se ka përfund procedura me anë të veprimeve disponibile të palëve.

10.5.1 Shkaqet për paraqitjen e propozimit për përsëritje të procedurës

Shkaqet për përsëritjen e procedurës - Neni 232 i LPK-së parasheh që procedura e përfunduar me aktgjykim dhe aktvendim të formës së prerë të gjykatës mund të përsëritet sipas propozimit të palës.

Në dispozitat e nenit 232 parashihen shkaqet për përsëritjen e procedurës të numëruar në mënyrë taksative, por të cilat mund të klasifikohen në tri grupe:

Shkelja e dispozitive procedurale:

- në qoftë se palës me veprim të kundërligjshëm, e sidomos në rast të mos thirrjes për në seancë nuk i jepet mundësia që të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes kryesore;
- në qoftë se në procedurën e përfunduar ka marrë pjesë si paditës ose si i paditur personi që nuk mund të jetë palë ndërgjyqëse, apo në qoftë se palën që është person juridik nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar, ose po që se palën me pazotësi procedurale nuk e ka përfaqësuar përfaqësuesi ligjor i saj, ose në qoftë se përfaqësuesi ligjor, respektivisht përfaqësuesi me prokurë i palës, nuk ka pasur autorizim të duhur për ndjekjen e çështjes në gjyq apo për kryerjen e veprimeve procedurale të caktuara, po që se ndjekja e çështjes në gjyq apo kryerja e veprimeve procedurale të caktuara nuk është lejuar me vonë nga pala;

Vepra penale:

- në qoftë se vendimi përfundimtar i gjykatës është bazuar në deklarata të rreme të dëshmitarëve apo të ekspertëve ose në dokumentin që është falsifikuar apo në të cilin është verifikuar përmbajtja e pasaktë;
- në qoftë se vendimi përfundimtar i formës së prerë është pasojë e veprës penale të gjyqtarit, të përfaqësuesit ligjor apo me prokurë të palës, kundërshtare apo të personit të tretë;

Fakte të reja dhe provat e reja:

- në qoftë se pala fiton mundësinë ta përdorë vendimin e formës së prerë të gjykatës, i cili më parë, është dhënë në procedurën e zhvilluar midis palëve të njëjta për të njëjtën kërkesëpadi;
- në qoftë se vendimi përfundimtar i formës së prerë është bazuar në një vendim tjetër gjyqësor, ose në vendimin e ndonjë organi tjetër, kurse ky vendim është ndryshuar, prishur apo anuluar në mënyrë të prerë;
- në qoftë se pala merr dijeni për fakte të reja ose gjen prova të reja, ose e fiton mundësinë që t'i përdorë ato, në bazë të të cilave për palën do të mund të merrej vendim përfundimtar më i favorshëm, sikur faktet dhe provat e tilla të ishin përdorur në procedurën e mëparshme.

10.5.2 Afati për paraqitjen e propozimit për përsëritjen e procedurës

Sipas dispozitës së nenit 234 paragrafi 1 të LPK-së, propozimi për përsëritje mund të paraqitet brenda afati prej 30 ditësh, dhe atë:

- në rastin nga neni 232, pika a) e këtij ligji, që nga dita kur palës i është dorëzuar vendimi i formës së prerë;
- në rastin nga neni 232, pika b) e këtij ligji në qoftë se në procedurë si paditës apo si i paditur ka vepruar personi që nuk mund të jetë palë ndërgjyqëse nga dita në të cilën vendimi i është dorëzuar personit të tillë;

- në qoftë se palën që është person juridik nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar, apo në qoftë se palën me pazotësi procedurale nuk e ka përfaqësuar përfaqësuesi ligjor i saj nga dita në të cilën vendimi i është dorëzuar palës, gjegjësisht përfaqësuesit ligjor të saj, e po që se përfaqësuesi ligjor, gjegjësisht me prokurë i palës, nuk ka pasur autorizim të duhur për ndjekjen e çështjes në gjyq, apo për kryerjen e veprimeve procedurale të caktuara, nga dita kur pala ka marrë dijeni për këtë shkak;
- në rastin nga neni 232, pika c) e këtij ligji – nga dita në të cilën pala ka marrë dijeni për aktgjykimin penal të formës së prerë;
- në rastin nga neni 232, pika d) e këtij ligji – nga dita në të cilën pala ka marrë dijeni për vendimin penal të formës së prerë, e nëse procedura penale nuk mund të zhvillohet, atëherë nga dita kur ka marrë dijeni për pezullimin e procedurës penale, apo për rrethanat për shkak të të cilave nuk mund të iniciohet procedura penale;
- në rastet nga neni 232, pika e) dhe f) të këtij ligji – nga dita në të cilën pala ka mundur ta përdorë vendimin e formës së prerë që është shkak për përsëritjes së procedurës;
- në rastin nga neni 232, pika g) të këtij ligji – nga dita në të cilën pala ka mundur t'i parashtojë në gjykatë faktet e reja, gjegjësisht mjetet provuese të reja.

Po që se afati i caktuar në paragrafin 1 të këtij neni (*afatet e sipër cekuar*) do të fillonte të rrjedhë para së vendimi të ketë marrë formë të prerë, ky afat do të llogaritet nga momenti në të cilin vendimi bëhet i formës së prerë, në qoftë se kundër tij nuk është paraqitur ankesa, gjegjësisht nga dita e dorëzimit të vendimit të formës së prerë të gjykatës së lartë të dhënë në shkallë të fundit.

Pas kalimit të afatit prej pesë vjetësh nga dita kur vendimi bëhet i formës së prerë, propozimi për përsëritjen e procedurës nuk mund të paraqitet, përveçse kur përsëritja kërkohet nga shkaqet e përmendura në nenin 232, pika a) dhe b) të këtij ligji e që i referohet rasteve:

- në qoftë se palës me veprim të kundërligjshëm, e sidomos në rast të mos thirrjes për në seancë nuk i jepet mundësia që të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes kryesore;
- në qoftë se në procedurën e përfunduar ka marrë pjesë si paditës ose si i paditur personi që nuk mund të jetë palë ndërgjyqëse, apo në qoftë se palën që është person juridik nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar, ose po që se palën me pazotësi procedurale nuk e ka përfaqësuar përfaqësuesi ligjor i saj, ose në qoftë se përfaqësuesi ligjor, respektivisht përfaqësuesi me prokurë i palës, nuk ka pasur autorizim të duhur për ndjekjen e çështjes në gjyq apo për kryerjen e veprimeve procedurale të caktuara, po që se ndjekja e çështjes në gjyq apo kryerja e veprimeve procedurale të caktuara nuk është lejuar me vonë nga pala.

10.5.3 Procedura e paraqitjes së propozimit për përsëritjen e procedurës

Propozimi për përsëritjen e procedurës duhet ti paraqitet gjykatës së shkallës së parë e cila e ka dhënë vendimin e shkallës së parë.

Në propozimin për përsëritjen e procedurës duhet të tregohet baza ligjore për përsëritjen e procedurës, rrethanat me të cilat provohet se propozimi është i afatshëm dhe mjet provues me të cilat provohen thëniet në propozim.

Gjykata e shkallës së parë është e detyruar që të shikojë nëse propozimi për përsëritjen e procedurës është i afatshëm, i plotë dhe i lejueshëm. Nëse gjen se propozimi për përsëritjen e procedurës është i pa afatshëm, jo i plotë apo i palejueshëm, të njëjtin duhet ta hedhë me aktvendim ndaj të cili lejohet e drejta e ankesës.

Nëse gjykata e shkallës së parë konstaton se propozimi nuk duhet të hedhet atëherë të njëjtin ia dërgon palës kundërshtare e cila ka të drejtë që brenda 15 ditësh të paraqet përgjigje lidhur me propozimin.

Pasi që të arrij përgjigja e palës kundërshtare apo pasi të kalojë afati për përgjigje, gjykata e shkallës së parë duhet të ia dërgojë shkresat e lëndës sipas propozimit për përsëritje të procedurës gjykatës së shkallës së dytë në afat prej tetë (8) ditësh.

10.5.4 Vendosja sipas propozimit për përsëritje të procedurës

Me dispozitën e nenit 235 të LPK-së, përcaktohet se: *“Mbi propozimin për përsëritjen e procedurës vendosë gjykata e shkallës së dytë, dhe atë gjyqtari individual i cili nuk ka marrë pjesë në dhënien e vendimit të shkallës së dytë në procedurën e mëparshme”*, megjithatë në praktikën gjyqësore ka përjashtim nga ky rregull bazë.

Rast i përjashtimit nga rregulli bazë.

P.sh., Nëse paraqitet propozimi për përsëritjen e procedurës me të cilën kërkohet lejimi i përsëritjes së procedurës në të cilat paraprakisht sipas mjeteve tjera të jashtëzakonshme (revizionit dhe kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) ka vendosur Gjykata Supreme e Kosovës, atëherë për propozimin për përsëritje të procedurës nuk vendosë gjykata e shkallës së dytë por gjykata e shkallës së tretë.

Shpjegimi logjik pse në praktikë gjyqësore veprohet në këtë mënyrë qëndron në atë se nëse do ta lejon përsëritjen e procedurës, gjykata e shkallës së dytë, do të duhet të anulohet edhe vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës që është instanca e fundit e vendosjes gjyqësore. Prandaj për të shmangur situatën kur një gjykatë e rangut me të ultë do të anulonte vendimin e një instance me të lartë, në praktikë veprohet në atë mënyrë që në disa raste vendos gjykata e shkallës së dytë e në disa raste gjykata e shkallës së tretë.

Me dispozitën e nenit 239 paragrafi 2, të LPK-së, përcaktohet se: *“Gjykata e shkallës së dytë vendosë mbi propozimin për përsëritjen e procedurës zakonisht jashtë seance për shqyrtim kryesor”* por në disa raste mund të veprojë edhe në kuptim të dispozitës së nenit 239 paragrafi 2, të LPK-së, me të cilën dispozitë përcaktohet se: *“Po që se gjykata vjen në përfundim se është i domosdoshëm shqyrtimi i tillë, ajo do të veprojë në pajtim me dispozitat e neneve 191 dhe 193 të këtij ligji”*.

Nëse gjykata e shkallës së dytë e lejon përsëritjen e procedurës, me aktvendimin me të cilin lejohet përsëritja e procedurës anulohet vendimi i dhënë në procedurën e mëparshme.

Kundër aktvendimit me të cilin lejohet përsëritja e procedurës nuk lejohet ankesa, ndërsa kundër aktvendimit me të cilin refuzohet propozimi për përsëritjen e procedurës lejohet ankesa e veçantë.

Ankesa kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë me të cilin refuzohet propozimi për përsëritjen e procedurës i paraqitet të njëjtës gjykatë, e cila sipas ankesës vendosë në trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtar, (neni 240 paragrafi 1, i LPK-së).

Në procedurën e përsëritur në gjykatën e shkallës së parë nuk mund të veprojë gjyqtari që e ka dhënë vendimin në procedurën e mëparshme.

Gjykata e shkallës së parë është e obliguar që të caktojë seancën përgatitore menjëherë pasi që t'i ketë pranuar shkresat e lëndës nga gjykata e shkallës së dytë e më së largu brenda afatit prej tetë (8) ditësh.

10.6 Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë

E gjithë veprimtaria e gjykatës në procedurën kontestimore nuk është asgjë tjetër veçse zbatim i pandërprerë i ligjit procedural dhe material. Përkundrejt të gjitha garancive për rregullsinë e punës së gjykatës, nuk përjashtohet mundësia që gjykata ta cenoj ligjin, dhe kështu vendimi që duhet të jetë ligj për palët është i kundërligjshëm. Me vendimin e formës së prerë por të kundërligjshëm cenohet jo vetëm interesi i palëve por edhe ai publik, sepse kundërligjshmëria e vendimit gjyqësor është shenje e funksionimit jo të rregullt të gjyqësisë si shërbim publik. Nga kjo arsye ligjdhënësi e ka paraparë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si mjete të goditjes së jashtëzakonshëm të vendimeve të formës së prerë, me qëllim që puna e organeve gjyqësore të dakordohet me ligjin.

10.6.1 Kompetenca për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë

Sipas nenit 246 të LPK-së, kompetent për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë është prokurori i shtetit. Megjithatë iniciativën për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë mund ta marrë edhe nga palët, të cilët në pamundësi të ushtrimit të këtij mjeti i propozojnë prokurorit që ta bëjë një gjë të tillë.

Në praktikën gjyqësore rëndom kështu edhe ndodh që kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë e ushtron prokurori pasi që të jete marrë iniciativa nga palët.

10.6.2 Shkaqet e goditjes për goditjen e vendimit më kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet:

- për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, në qoftë se shkelja ka të bëjë me kompetencën territoriale, po që se gjykata e shkallës së parë e ka nxjerrë aktgjykimin pa seancë kryesore, kurse e ka pasur detyrë ta mbajë seancën kryesore, po që se është vendosur për kërkesën, rreth së cilës kontestimi është në vazhdim, apo në qoftë se në kundërshtim me ligjin, është përjashtuar publiku në seancën kryesore;
- për shkak të aplikimit të gabueshëm të së drejtës materiale.

Prokurori publik nuk mund të ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të kapërcimit të kërkesë-padisë dhe as për shkak të vërtetimit të gabueshëm apo jo të plotë të gjendjes faktike.

10.6.3 Vendimet të cilat mund të goditën me kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të ushtrohet ndaj:

- vendimit të marrë në shkallë të parë, kundër të cilit nuk është bërë ankim prej ditës kur ky vendim nuk ka mundur më të kundërshtohet me ankim;
- vendimit të marrë në shkallë të dytë, kundër të cilit nuk është deklaruar revizioni prej ditës kur ky vendim i është dërguar asaj pale së cilës i është dërguar më së voni.

10.6.4. Afati për ngritjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë

Kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë prokurori i shtetit mund të ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë brenda tre muajsh. Afati për ngritjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë llogaritet:

- Kundër vendimit, të nxjerrë në shkallë të dytë, kundër të cilit palët kanë deklaruar revizion, prokurori publik mund të ngrejë kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë vetëm brenda tridhjetë (30) ditësh nga data kur i është dërguar revizioni i asaj pale, revizioni i së cilës i është dërguar më herët.
- Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk lejohet kundër vendimit që me rastin e revizionit ose të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë e ka marrë Gjykata Supreme (neni 245 paragrafi 3 LPK, i ndryshuar me nenin 12 të Ligjit nr.04/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e LPK).

Procedura sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë - për kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë vendos Gjykata Supreme e Kosovës. Aktgjykimi apo aktvendimi i goditur ekzaminohet vetëm në pjesën e goditur më kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe gjykata i merr parasysh vetëm shkaqet e treguar në këtë mjet të goditjes. Për seancën në të cilën shqyrtohet dhe vendoset për kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë gjykata e lajmëron prokuronin e shtetit që e ka paraqitur atë. Autorizimet e gjykatës supreme me rastin e vendosjes për kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë janë të njëjta me ato që i ka kur vendos për revizionin. Në qoftë se kundër të njëjti vendimi janë paraqitur si revizion ashtu edhe kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, gjykata kompetentet do të vendos për mjetet juridike me një vendim.

10.7 Përmbledhje

Në këtë sesion janë elaboruar mjetet e jashtëzakonshme, kushte për paraqitjen e mjeteve të jashtëzakonshme, procedura dhe mënyrat e vendosjes sipas mjeteve të jashtëzakonshme.

Ky sesion do tu mundësoj gjyqtarëve të ngritin njohuritë tyre për veprimet që duhet të ndërmerren sidomos në procedurën e vlerësimit të lejueshmërisë së mjeteve të jashtëzakonshme.

III. Procedura kontestimore – pjesa e dytë

Hasan Shala
Kryetarë në Gjykatën e Apelit

Tabela e përmbajtjes – Procedura kontestimore – pjesa e dytë

Hyrje.....	166
Metoda e shpjegimit.....	167
Pritjet nga pjesëmarrësit	168
Burimet	168
Përmbledhje	169
1. Paraqitja e padisë në gjykatën e shkallës së parë.....	170
1.1 Hyrje	170
1.2 Objektivat trajnuese	170
1.3 Paraqitja e padisë në gjykatë	170
1.4 Kërkesëpadia (Petitum)	172
1.5 Llojet e padive.....	172
1.6 Bashkimi i kërkesëpadive.....	173
1.7.1 Mënyra e paraqitjes së padisë në gjykatë	173
1.7.2 Pasojat proceduralo-juridike të paraqitjes së padisë	174
1.7.3 Pasojat juridiko-civile të paraqitjes së padisë	174
1.8 Mbrojtja e të paditurit nga padia	174
1.9 Kundërpadia.....	175
1.10 Ushtrime.....	175
1.11 Përmbledhje.....	175
2. Shqyrtimi paraprak i padisë dhe përgjigja në padi.....	176
2.1 Hyrje	176
2.2 Objektivat trajnuese	176
2.3 Shqyrtimi paraprak i padisë	176
2.4 Dërgimi i padisë palës së paditur	177
2.5 Përgjigja në padi.....	178
2.6 Ushtrim	179
2.7 Përmbledhje.....	179
3.1 Hyrje	180
3.4 Ndërmjetësimi dhe pajtimi gjyqësor	182
3.5 Ushtrim	182
3.6 Përmbledhje.....	182
4. Përgatitja e seancës për shqyrtim kryesor dhe seanca për shqyrtim kryesor	183
4.1 Hyrje	183
4.2 Objektivat trajnuese	183
4.3 Përgatitja e seancës për shqyrtim kryesor.....	183
4.4 Hapja e seancës së shqyrtimit kryesor.....	184
4.5 Mbajtja e rendit në seanën për shqyrtimin kryesor.....	184
4.6 Seanca për shqyrtim kryesor.....	185
4.6.1 Hapja e seancës së shqyrtimit kryesor.....	185
4.6.2 Mbajtja e rendit në seanën për shqyrtimin kryesor.....	185
4.6.3 Marrja e vendimit përfundimtar	186
4.7 Ushtrim	186
4.8 Përmbledhje.....	186

5. Mjetet provuese dhe marrja e provës.....	187
5.1 Hyrje	187
5.2 Objektivat trajnuese	187
5.3 Barra e provës	188
5.4 Faktet që nuk kanë nevojë të provohen	189
5.5 Mjetet provuese dhe marrja e provave	190
5.5.1 Dëshmitari.....	190
5.5.2 Eksperti.....	190
5.5.3 Këqyrja në vend	191
5.5.4 Shkresa-dokumenti.....	191
5.5.5 Dëgjimi i palëve	192
5.6 Ushtrimi	192
5.7 Përmbledhje.....	192
6.1 Hyrje	193
6.2 Objektivat trajnuese	193
6.3 Kuptimi i gjyqvarësisë - litispedencës	194
6.4 Bashkëndërgjyqësia	195
6.5 Pjesëmarrja e personit të tretë në procedurën kontestimore	196
6.5.1 Bashkëndërgjyqësit unik:	197
6.5.2 Ndërhyrësi sui generis:	197
6.5.3 Ndërhyrja e organit të kujdestarisë:.....	197
6.5.4 Emërtimi i paraardhësit	197
6.5.5 Njoftimi i personit të tretë për procedurën kontestimore	198
6.6 Ushtrime	198
6.7 Përmbledhje.....	198
7. Sigurimi i kërkesëpadisë	199
7.1 Hyrje	199
7.2 Objektivat trajnuese	199
7.3 Sigurimi i kërkesëpadisë.....	199
7.4 Ushtrimi	204
7.5 Përmbledhje.....	204
8. Ndërprerja dhe pushimi i procedurës kontestimore	205
8.1 Hyrje	205
8.2 Objektivat trajnuese	205
8.3 Ndërprerja e procedurës-gjykimit	205
8.4 Pushimi i procedurës kontestimore.....	206
8.5 Ushtrime	207
8.6 Përmbledhje.....	207
10.1 Hyrje.....	210
10.2 Objektivat trajnuese.....	210
10.3 Shpenzimet e procedurës kontestimore	210
10.4 Lirimi nga pagimi i shpenzimeve të procedurës kontestimore.....	211
10.5 Ushtrim	211
10.6 Përmbledhje.....	211

Hyrje

Me Ligjin e Procedurës Kontestimore të miratuar nga Parlamenti i Kosovës me nr.03/L-006 i cili ligj ka burimet nga legjislacioni austriak mbi procedurën kontestimore. Karakteristikat më të rëndësishme lidhur me procedurën civile janë: Kompetenca e gjyqtarit lidhur me menagjimin e çështjeve, i cili sipas detyrës zyrtare garantion kushtet për kryerjen e hapave të ndryshme procedural dhe i cili ka kompetenca të rëndësishme në fushën e hetimit në faktet e rastit.

Ndarjen e procedurës në fazën përgatitore dhe në fazën kryesore, mund të zhvillohet në një seancë gjyqësore. Veprimet e veçanta procedurale nuk mund të merren, pasi të ketë skaduar periudha e caktuar kohore si dhe njoftimi sipas detyrës zyrtare e palëve lidhur me parashtrirat e ndryshme procedural që janë paraqitur në gjykatë.

Në procedurën kontestimore ekzistojnë tri subjekte kryesore të cilat janë: Padiësi, i padituri dhe gjykata. Padiësi është ai i cili parashtron kërkesën pranë gjykatës për t'i dhënë mbrojtje juridike, kurse ndaj të paditurit kërkohet kjo mbrojtje. Subjekti i tretë është gjykata, e cila duhet të vendosë nëse kërkesa për mbrojtje juridike është e themeltë ose e pa themeltë, dhe varsisht nga rezultatet e shqyrtimit me aktgjykim vërteton se a ka vend për dhënie të mbrojtjes juridike për themelësinë e kërkesëpadiësë apo jo themelësinë e kërkesëpadiësë.

Procedura kontestimore ndahet në procedurën e përgjithshme kontestimore, procedurën e posaçme dhe procedurën e veçantë.

Procedura e përgjithshme kontestimore ndahet në procedurën kontestimore – pjesa e parë, e cila përmban dispozita të përgjithshme që rregullojnë çështjet e zbatimit të parimeve themelore në procesin kontestimor-gjyqësor, kompetencën gjyqësore, përjashtimin e gjykatësit nga gjykimi, palët dhe përfaqësuesit e tyre, gjuhën në procedurë, parashtrirat dhe procedura e dërgimit të shkresave nga gjykata, seancat dhe afatet, procesverbalet, vendimet gjyqësore dhe mjetet juridike të rregullta dhe jo të rregullta.

Procedura kontestimore-pjesa e dytë, përmban dispozita ligjore që rregullojnë çështjet e rrjedhës së procedurës në gjykatën e shkallës së parë dhe at: duke filluar prej paraqitjes së padiësë në gjykatë, bashkëndërgjyqësisë, pjesëmarrja e personit të tretë në kontest-procedurë, ndërprerja dhe pushimi i procedurës kontestimore, ndihma juridike, mosrespektimi i gjykatës, sigurimi i kërkesëpadiësë, mjetet provuese dhe marrja e provave, përgatitja e shqyrtimit kryesor, ndërmjetësimi dhe pajtimi gjyqësor, shqyrtimi kryesor dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Procedura kontestimore e posaçme përmban dispozita të posaçme që rregullojnë rrjedhën e procedurës në kontestet nga marrëdhënia e punës, procedurës në kontestet për shkak të pengimit në posedim, procedurën e kontesteve të vlerës së vogël, procedurën e dhënies së urdhërpagesës, procedurën në kontestet tregtare dhe procedurën e arbitrazhit.

Procedura e veçantë kontestimore përmban dispozita të veçanta që rregullon procedurën në konteste familjare, procedurën në konteste të pronësisë intelektuale, procedurën në konteste të pronësisë industriale e tjera.

Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij cikli mësimor-trajnuese, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Kuptimin e plotë të Procedurës Civile me tri tërësitë e saj dhe atë procedurën kontestimore, jo kontestimore dhe përmbartimore;
- Zgjerojnë njohurit për rrjedhën e mirëfillt të procedurës kontestimore në gjykatën e shkallës së parë në pajtueshmëri me risit e Ligjit për Procedurën Kontestimore të Republikës së Kosovës;
- Fitojnë shkathtësit praktike për udhëheqjen e drejtë dhe të shpejtë të procedurës kontestimore lidhur me një çështje kontestuese, duke filluar prej paraqitjes së padisë në gjykatën e shkallës së parë e deri te marrja e vendimit gjyqësor;
- Fitojnë shkathtësi praktike për drejtimin e procedurës kontestimore gjatë shqyrtimit paraprak të padisë;
- Zgjerojnë njohurit për përgjigjen në padi, përmbajtjen e saj dhe marrjen e aktvendimit për dërgimin e padisë së të paditurit për të paraqitur përgjigjen në padi;
- Fitojnë shkathtësi praktike për përgatitjen e seancës për shqyrtim përgatitor dhe seancën për shqyrtim kryesor;
- Njohin me hollësishtë ekzistimin e gjyqëvarsisë – litispedencës dhe bashkndërgjyqësisë si dhe pjesëmarrjen e personit të tretë në procedurën kontestimore;
- Fitojnë shkathtësi praktike kur plotësohen kushtet ligjore për ndërprerjen dhe pushimin e procedurës kontestimore;
- Zbatojnë drejtë procedurën në rast të mosrespektimit të gjykatës nga palët dhe pjesëmarrësit tjerë si dhe shqiptimin e dënimeve.
- Avancojnë njohurit për ndihmën juridike, ndërmjetësimin dhe sigurimin e kërkesëpadisë si dhe marrjen e vendimit gjyqësor;
- Zbatojnë drejtë procedurën për marrjen e provës me dëgjimin e dëshmitarit, këqyrjes në vend, ekspertizës, leximit të dokumentit dhe me dëgjimin e palës;
- Mësojnë për shpenzimet e procedurës kontestimore dhe gjykimin e tyre lidhur me një çështje kontestimore;
- Fitojnë shkathtësi për nxjerrjen e aktvendimit për drejtimin e procedurës në seancën përgatitore dhe seancën për shqyrtim kryesor;
- Fitojnë shkathtësi praktike për përmbajtjen e procesverbalit të seancës përgatitore, seancës për shqyrtim kryesor dhe përpilim i tyre lidhur me një rast praktik.

Metoda e shpjegimit

Për shqyrtim më praktik dhe përmbajtësor të çështjeve të cilat e përbëjnë këtë cikël mësimor do të përdoren metodat e kombinuara dhe atë me shqyrtime të përgjithshme teorike - ligjërime i shkurtë teorik nga trajnuesi, bashkëbisedim me pjesëmarrësit ku pjesëmarrësit do të marrin pjesë në shqyrtim në formë të pyetjeve dhe përgjigjeve, diskutimit të përbashkët me trajnuesin dhe çdo shqyrtim i temës do të përfundojë me përfundim të përbashkët të trajnuesit dhe pjesëmarrësve.

Pjesëmarrësit për të qenë më aktiv për fitim më të mirë të aftësive profesionale dhe praktike për drejtimin e mirëfillt të procedurës kontestimore do të kenë qasje me shembuj praktik, duke punuar secili pjesëmarrës veç e veç dhe në grupe.

Përveç, angazhimeve gjatë orarit mësimor, pjesëmarrësit do të angazhohen edhe duke punuar në shtëpi çështje-detyra praktike të cilat do të propozohen nga trajnuesit

Pritjet nga pjesëmarrësit

Nga pjesëmarrësit pritet që të jenë të përgatitur me dije dhe shkathtësi fillestare nga procedura kontestimore, për të pas qasje më aktive gjatë ligjërimit, bashkëbisedimit dhe punës praktike individuale dhe grupore në mënyrë që pjesëmarrësit të përfitojnë dije dhe shkathtësi në pajtim me qëllimet-objektivat e këtij cikli mësimor.

Posaçërisht, nga pjesëmarrësit pritet që të jenë aktiv gjatë çdo shqyrtimi duke dhënë kontributin e tyre me pyetje, përgjigjeje, diskutime dhe angazhim në punë praktike gjatë tërë kohës së zgjatjes të këtij cikli mësimor.

Burimet

Si burime juridike pjesëmarrësit e këtij cikli mësimor mund ti shfrytëzojnë përveç ligjëratave nga trajnuesi, literaturën juridike nga lëmia e së Drejtës së Procedurës Civile, ligjet e cituara më lartë, konventat ndërkombëtare, praktikën gjyqësore me komente të ndryshme si dhe burime tjera juridike.

- Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
- Ligji për Procedurën Kontestimore.
- Ligji për Procedurën Jokontestimore.
- Ligji për Procedurën Përmbartimore.
- Ligji për Gjykatat e Rregullta të Kosovës.
- Ligji për Familjen i Kosovës.
- Ligji për Marrëdhëniet Pronësoro Juridike Bazë.
- Ligji për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat Tjera Autoriale.
- Ligji për Pronësinë Industriale.
- Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë.
- Ligji për Zgjidhjen e Konflikteve të Ligjeve.
- Ligji për Ndërmjetësim.
- Ligji për Ndhmën Juridike.
- Ligji për Avokaturën dhe Ndhmën Tjetër Juridike.
- Rregulli për Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave.
- Tarifa e avokatëve të Kosovës.
- Prof. Dr.Faik Brestovci “E Drejta Procedurale Civile” – Prishtinë 2002.
- Lamani “Procedura Civile” e RPSH-1962.
- Dr.Borivoje Pozniq “Gradjansko Procesno Pravo” 1986.
- Triva, Beljajec, Dika “Gradjansko Parnicno Procesno Pravo” Zagreb 1986.
- Prof. Dr. Faik Brestovci “ E drejta Procedurale Civile Ndërkombëtare” Prishtinë 2000.
- Komentari I Ligjit për Procedurën Kontestimore botimi i I-rë autor Prof. Dr. jur. Iset Morina, Avokat Selim Nikçi, viti 2012.
- Prof. Dr. Faik Brestovci, Prof. asoc. Dr. Iset Morina, Prof. Ass. Dr. Rustem Qehaja, “E Drejta Procedurale Civile Procedura Kontestimore” Botimi i pestë Prishtinë, 2017.
- Konventa për Procedurën Civile Gjyqësore.
- Konventa për Procedurën Civile.
- Konventa për Përmbartimin e Vendimeve të Arbitrazhit të Huaj.
- Konventa për Njohjen dhe Përmbartimin e Aktgjykimeve.
- Konventa Evropiane për Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar.
- Konventa për Zgjidhjen e Gjykatës.
- Konventa për Falimentimin, Ujdinë dhe Procedurat e Ngjashme.

Përmbledhje

Në këtë cikël mësimor, është bërë shqyrtimi i çështjeve në pajtim me qëllimin – objektivat mësimore për aftësimin profesional të gjykatësve të ri në Gjyqësorin e Republikës së Kosovës.

Me shfrytëzimin e metodës së kombinuar me ligjërime, bashkëbisedime dhe punë praktike e duke i shfrytëzuar edhe burimet tjera juridike pjesëmarrësit do të përfitojnë njohuri dhe shkathtësi profesionale për zbatimin praktik të Ligjit të Procedurës Kontestimore – Pjesa e dytë.

Pjesëmarrja aktive e pjesëmarrësve do jetë një kontribut i veçantë për jetësimin e këtij programi mësimor i cili është bazë për aftësimin profesional të gjykatësve të rinj në gjyqësorin e Republikës së Kosovës.

Së fundi, ky punim është vepër e autorit-trajnesit, i cili i destinohet IGJK-së, ndërsa do t'iu shërbejë edhe personave tjerë që kanë nevojë për përfitimin e shkathtësive profesionale dhe praktike nga procedura kontestimore.

Vërejtjet, sugjerimet e mirëfillta profesionale dhe miqësore nga profesionistët do të jenë të mirëpritura nga autori.

1. Paraqitja e padisë në gjykatën e shkallës së parë

1.1 Hyrje

Në këtë cikël do të shqyrtohet padia në kuptimin formal dhe material, duke dhënë shpjegime praktike për secilin elementet veç e veç të padisë, llojet e padive, paraqitjen e një kërkesë apo shumë kërkesëpadive në një padi. Veprimet e gjykatës për përmirësimin apo plotësimin e padisë jo të rregullt. Ndryshimin e padisë në kuptimin objektiv dhe subjektiv.

Gjatë këtij cikli pjesëmarrësit do të përfitojnë shkathtësi profesionale dhe praktike për të vlerësuar se padia e paraqitur nga ana e paditësit a i përmban të gjitha elementet e parapara me dispozitat e nenit 253 të LPK-së. Përveç, kësaj pjesëmarrësit do të përfitojnë shkathtësi edhe për veprimet e gjykatës të cilat janë të detyrueshme për eliminimin e parregullsisë së padisë.

Shpjegimet teorike dhe praktike do të bëhen në pajtueshmëri me risit e Ligjit të Procedurës Kontestimore të Republikës së Kosovës. Pjesëmarrësit për herë të parë do të kuptojnë përmbajtjen ndryshimeve të reja të cilat paraqesin një fillim të një praktike të re gjyqësore në procedurën kontestimore.

1.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij prezantimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zgjerojnë njohurit lidhur me përmbajtjen e padisë;
- Fitojnë shkathtësi për vlerësimin e padive jo të rregullta;
- Fitojnë shkathtësi për rregulluesin e padisë jo të rregullt;
- Vlerësojnë përmbajtjen e padisë detyruese, vërtetuese dhe ndryshuese;
- Thellojnë njohurit lidhur me ndryshimin e padisë;
- Përpilojnë një padi.

1.3 Paraqitja e padisë në gjykatë

Padia në kuptimin formal është një shkresë – parashtresë e formës së shkruar e paditësit, e cila paraqitet në gjykatën e shkallës së parë. Ndërsa padia në kuptimin material është një ngjarje jetësore - kërkesë e paditësit e cila është rrjedhojë e një marrëdhënie juridike me të cilën paditësi nga gjykata kërkon mbrojtje gjyqësore përmes vendimit gjyqësor.

Ligji i Procedurës Kontestimore në nenin 99 al.1 padinë e cilëson si parashtresë e cila në pajtim me al.2 të njëjtit nen duhet të jetë e kuptueshme dhe të përmbaj çdo gjë që nevojitet dhe e mundëson veprimin sipas saj.

Me paraqitjen e padisë në gjykatë fillon procedura kontestimore lidhur me një çështje kontestuese.

Padia duhet t'i përmban të gjitha elementet e parapara me dispozitat e nenit 253 al.1 të LPK-së, përcaktohet mënyra ligjore se çka duhet të përmbajë padia, pa marrë parasysh llojin e padisë. Me

këto dispozita parashihet shprehimisht përmbajtja e padisë por jo edhe forma e sajë. Andaj, padia duhet të përmbajë:

Kërkesën e caktuar në pikëpamje të çështjes kryesore dhe aksesore;

- Faktet mbi të cilat paditësi e bazon kërkesën;
- Provat me të cilat vërtetohen faktet e tilla;
- Vlerën e kontestit;

Bazën juridike dhe të dhënat e tjera që duhet t'i ketë çdo parashtrësë konform nenit 99 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se parashtrësit: Padia, përgjigja në padi, mjetet e goditjes së vendimit dhe deklaratat e tjera, propozimet dhe njoftimet, që bëhen jashtë seancave gjyqësore, paraqiten me shkrim. Kushtin e formës së shkruar e përmbushin edhe parashtrësit e dërguara me anë të telegrafit, telefaksit apo postës elektronike. Parashtrësit e këtilla quhen të firmosura, po që se në to është treguar dërguesi.

Parashtrësit duhet të jenë të kuptueshme dhe të përmbajnë çdo gjë që nevojitet dhe e mundëson veprimin sipas tyre. Ato duhet të përmbajnë: Emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin (emërtimin e personit juridik) vendbanimin apo vendqëndrimin (selinë e personit juridik) e palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjor apo me prokurë, po që se i kanë objektin e kontestit, përmbajtjen e deklaratës dhe firmën e parashtrësit. Në qoftëse deklarata përmban ndonjë kërkesë, pala duhet me parashtrësë t'i tregoj faktet mbi të cilat e bazon kërkesën si dhe provat kur është nevoja për një gjë të tillë. Parashtrësit që dërgohen me anë të postës elektronike duhet të verifikohen me anë të firmës së kualifikuar elektronike.

Procedura civile iniciohet përmes veprimeve procedurale, që i ndërmerren pala në bazë të parimit fundamental që do të thotë në bazë të parimit të disponibilitetit.

Gjithashtu, paditësi në gjykatë mund të paraqes padi e cila nuk e përmban kërkesëpadinë dhe gjykimi sipas kësaj padie nuk mund të bëhet, mirëpo gjykata nuk mund ta hedh këtë padi jo të rregullt, këtë sepse gjykata para se t'ia dërgoi të paditurit një kopje të kësaj padie jo të rregullt për të dhënë përgjigjeje në padi do ta fton paditësin që ta bëjë rregullsinë e saj dhe pastaj një kopje të padisë së korrigjuar do t'ia dorëzojë të paditurit për të dhënë përgjigjen në padi dhe për këtë arsye ne mendojmë se kjo dispozitë ligjore duhet të ndryshohet në pajtim me at e cila u paraqit më lartë.

Gjatë procedurës, paditësi mund ta bëjë ndryshimin e padisë në kuptimin objektiv dhe subjektiv. Ndryshimi i padisë në kuptimin objektiv shprehet duke bërë ndryshimin e njëjtësisë së kërkesëpadisë, rritjen apo zmadhimin e kërkesëpadisë apo paraqitjen edhe të ndonjë kërkesë tjetër krahas asaj ekzistuese. Padia nuk mund të konsiderohet si e ndryshuar po qe se paditësi e ka ndryshuar bazën juridike të padisë, po qe se e ka zvogëluar kërkesëpadinë ose po qe se i ka ndryshuar, plotësuar apo përmirësuar thëniet e caktuara në padi. Ndryshimin e padisë paditësi mund ta bëjë më së voni deri në përfundimin e seancës për shqyrtim përgatitor apo deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor. Në situatën e tillë gjykata të paditurit duhet t'i jep kohë të nevojshme që i padituri të përgatitet për shqyrtim të padisë së ndryshuar. Pas përfundimit të seancës përgatitore e deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor, gjykata mund ta lejoj ndryshimin e padisë vetëm po qe se konstaton se ndryshimi nuk ka për qëllim zvarritjen e gjykimit dhe po qe se i padituri pajtohet me ndryshimin e padisë. Konsiderohet se ekziston pëlqimi i të paditurit për ndryshimin e padisë po qe se i padituri lëshohet në shqyrtimin e çështjes pa e kundërshtuar më parë ndryshimin. Në qoftë se, padia është ndryshuar në seancën në të cilin i padituri nuk ka qenë i pranishëm, gjykata e shtyn seancën dhe të paditurit ia dërgon kopjen e

procesverbalit nga kjo seancë. Gjykata vendosë me aktvendim për ndryshimin e padisë kundër të cilit nuk lejohet ankesa e veçantë.

Ndryshimi subjektiv i padisë shprehet në atë mënyrë që në vend të paditurit të mëparshëm paditet një person tjetër. Për këtë ndryshim nevojitet pëlqimi i personit i cili paditet në vend të paditurit të mëparshëm, e po qe se i padituri ka filluar të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes kryesore nevojitet edhe pëlqimi i tij. Personi i cili hyn në gjykim në vend të palës së paditur e pranon rrjedhën e procedurës e cila është zhvilluar deri në momentin kur ka pranuar cilësinë e të paditurit.

Për të fituar njohuri më të thella profesionale lidhur me këto çështje të cilat u shqyrtuan më lartë, pjesëmarrësit mund të shfrytëzojnë Ligjin, literaturën profesionale dhe praktikën gjyqësore me sa vijon:

- Ligji i Procedurës Kontestimore, i publikuar në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës” nr.30/2008.
- Ligji i Procedurës Përmbartimore, i publikuar në “(Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës” nr.33/2008)
- Ligji i Procedurës Jokontestimore, i publikuar në (“Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr._____2008).
- Prof.Dr. Faik Brestovci “ E drejta procedurale Civile I dhe II.
- Prof. Dr. Faik Brestovci, Prof. Asoc. Dr. Iset Morina, Prof. Ass. Dr. Rustem Qehaja, “E Drejta Procedurale Civile Procedura Kontestimore” Botimi i pestë Prishtinë, 2017.

1.4 Kërkesëpapia (Petitum)

Kërkesëpapia është kërkesë e natyrës proceduralo-juridike. Këtë kërkesë paditësi e mbështetë në pretendimin se i takon autorizimi. Papia duhet të përmbajë gjithmonë kërkesën e përcaktuar lidhur me çështjen kryesore dhe kërkesën aksesore. Kërkesëpapia është pjesa kryesore e padisë dhe gjithë veprimtaria procedurale zhvillohet në lidhje me të, sepse me dispozitivin e aktgjykimit gjykata duhet të përgjigjet pikërisht në pyetjen se a është e themeltë apo e pathemeltë kërkesëpapia. Gjykata është e obliguar të vendosë lidhur me kërkesëpadinë e paditësit, që do të thotë se gjykata nuk mund të vendos për diçka tjetër apo më tepër se që është kërkuar me padi. Me kërkesëpadi pala paditëse përcakton: në pikëpamje objektive, përkatësisht objektin e kontestit, gjersa në pikëpamje subjektive pala duhet të përcaktojë se kush është palë në procedurë.

Objekti i kontestit në kërkesëpadi është çështja në lidhje me të cilën ekziston kontesti midis paditësit dhe të paditurit. Objektin e kontestit e përbënë kërkesa materialo-juridike, sidomos në rastet kur kemi të bëjmë me padinë me të cilën nga gjykata kërkohet që i padituri të detyrohet me prestimin apo përmbushjen e kërkesës materialo-juridike të paditësit.

1.5 Llojet e padive

Paditë ndahen ose klasifikohen në lloje të ndryshme dhe kriterëve që ndiqen: materialo-juridike ose proceduralo-juridike. Në pikëpamjen e së drejtës materiale i ndajmë paditë: civile, familjare dhe të punës. Paditë që rrjedhin nga marrëdhëniet juridiko-civile dallojnë me padi për çështje pronësore, posedimore, kompensim dëmi, trashëgimore. Gjersa, duke marr parasysh natyrën e objektit të padisë i ndajmë në padi reale, kur nëpërmjet këtyre padive synohet kërkimi i një sendi, dhe në padi personale, kur synohet shlyerja e një detyrimi.

Në pikëpamjen e së drejtës procedurale paditë ndahen në disa lloje varësisht nga fakti se qfar vendimi kërkon pala paditëse që gjykata të merr vendim. Sipas qëllimit të paditësit, paditë ndahen në: Padi detyrimi (Kondemnatore), në padi njohje (Vërtetimi, deklarative) dhe në padi ndryshimi (Transformimi konstituive).

1.6 Bashkimi i kërkesëpadive

Paditësi me padi mund të paraqes kundër të paditurit një padi të vetme apo disa. Kërkesëpadia e përfshirë me një padi mund të jetë e thjeshtë, që do të thotë se pala paditëse do të kërkon nga gjykata me një padi të vendos me aktgjykim për një çështje juridike, apo pala paditëse kërkon nga gjykata që të vendos mbi dy apo më shumë çështje juridike të pavarura. Këtë çështje e ka rregulluar neni 255 i LPK-së, ku thuhet se një një padi paditësi mund të përfshijë disa kërkesa kundër të njejtës palë të paditur po që se ato të gjitha janë të lidhura me të njejtën bazë faktike dhe juridike. Në qotë se kërkesat nuk janë të lidhura me të nejtën bazë faktike dhe juridike, ato mund të përfshihen në një padi kundër të njejtës palë të paditur vetëm po që se e njëjta gjykatë është e kompetencës lëndorë për secilën nga këto kërkesa dhe kur për të gjitha kërkesat është e përcaktuar i njëjti lloj i procedurës, e gjykata vjen në përfundim se përfshirja e kërkesëpadive të tilla në një padi i kontribuon ekonomisë së procedimit (bashkimi kumulativ i kërkesëpadive). Po që se një gjë e tillë nuk i kontribuon ekonomisë së procedimit, gjykata, më së voni në seancën përgatitore, sjellë aktvendim për ndarjen e procedurës. Paditësi mundet në një padi t'i përfshijë dy apo më tepër kërkesëpadi që janë të ndërlidhura midis tyre, dhe të kërkojë që gjykata ta aprovojë të dytën me radhë vetëm po që se e para refuzohet (bashkimi eventual i kërkesëpadive). Bashkimi i kërkesëpadive mund të bëhet sipas paragrafit 3 të këtij neni vetëm po që se gjykata është e kompetencës lëndore për çdonjërin nga kërkesat e përfshira në një padi, dhe nëse për të gjitha kërkesat është përcaktuar i njëjti lloj i procedurës. Me aktgjykimin me të cilin aprovohet kërkesëpadia nën një shuhet gjyqëvarësia e krijuar lidhur me kërksëpadinë në numrin 2.

1.7 Vënia në veprim e procedurës kontestimore me rastin e parashtrimit të padisë në gjykatë

Inicimi i procedurës në gjykaatë me rastin e ushtrimit të padisë është veprim procedural me të cilin vihet në veprim procedura kontestimore siq ka përcaktuar neni 252 të LPK-së, ku thuhet se gjykimi i një çështje në gjykatë fillon me paraqitjen e kërkesëpadiisë me shkrim. Nga momenti i ushtrimit të padisë procesi kontestimor zhvillohet nëpër katër faza dhe ato: I. Procedura përgatitore, e cila fillon pas ushtrimit të padisë në gjykatë dhe përfundon me caktimin e seancës së shqyrtimit kryesor. II. Faza e dytë është shqyrtimi kryesor i çështjes juridike, që mban pjesën kryesore të procedurës kontestimore e cila procedurë zhvillohet në një apo me disa seanca. Faza e tretë përmbëhet nga veprimet e dhënies së vendimit meritior dhe procedimi i vendimit meritior palëve ndërgjyqëse. Faza e katërt përbënë shqyrtimin e vendimit meritior sipas ankesës.

1.7.1 Mënyra e paraqitjes së padisë në gjykatë

Një nga mënyrat e ushtrimit të padisë është dorëzimi i padisë drejtpërdrejtë në gjykatë. Me dorëzimin e padisë në zyrën e pranimit në gjykatë, personi zyrtar duhet të ndërmerr veprimet duke konstatuar pranimin e padisë, duke shënuar datën në vetë shkresën e padisë. Ky veprim është akt i administratës gjyqësore e jo veprim procedural. Akt tjetër i administratës gjyqësore

është regjistrimi i padisë në librat e regjistrimit dhe dorëzimi i saj tek gjyqtari apo kryetari i gjykatës i cili bënë ndarjen e lëndëve të regjistruara tek gjyqtarët. Mënyrë tjetër e dorëzimit të padisë është dërgimi i padisë nëpërmjet postës. Kur ajo dërgohet me letër rekomande apo telegrafisht, dita e dorëzimit në postë konsiderohet si ditë e dorëzimit në gjykatë. Kur dorëzimi i padisë bëhet me letër të zakonshme, padia konsiderohet e paraqitur në ditën në të cilën letra arrinë në gjykatë. Mënyra e tretë e paraqitjes së padisë është parashtrimi gojarisht i kërkesëpadisë. Në rastin konkret padia konsiderohet e ushtruar në momentin kur paditësi e nënshkruan procesverbalin i cili proces e zëvendëson shkresën e padisë. Konstatimi i momentit të paraqitjes së padisë është shumë me rëndësi, ngase me rastin e ushtrimit të padisë lidhen edhe pasojat apo efektet e caktuara proceduralo-juridike dhe juridiko-civile.

1.7.2 Pasojat proceduralo-juridike të paraqitjes së padisë

Me rastin e ushtrimit të padisë vihet në veprim procedura kontestimore, që do të thotë se krijohen raportet procedurale midis paditësit dhe gjykatës:

- Vlerësimi i kompetencës lëndore dhe tokësore nga ana e gjykatës;
- Marrëveshja e palëve mbi kompetencën;
- Zgjedhja e kompetencës;
- Lejueshmëria e padisë në aspektin e prozumimeve procedurale.

1.7.3 Pasojat juridiko-civile të paraqitjes së padisë

Ushtrimi i padisë në gjykatë i përbënë disa efekte të natyrës juridiko-civile siç janë:

- Me ushtrimin e padisë ndërpritet parashkrimi;
- Nëse e drejta e ushtrimit të padisë është e kufizuar me afat prekluziv, atëherë afati prekluziv nuk shkaktohet nëse është ushtruar padia në afat të caktuar;
- Kur e drejta e zgjedhjes midis dy prestimeve në rast të detyrimeve alternative i takon kreditorit, atëherë e drejta e zgjedhjes konsumohet në momentin e ngritjes së padisë.

E drejta e cila është e lidhur rreptësisht për personin e caktuar, ajo e drejtë e cila nuk mund të trashëgohet, e drejta e cila mund të trashëgohet tek trashëgimtarët.

Për kamatën që nuk është paguar me kohë mundë të kërkohet kamatëvonesa, që nga dita kur është ushtruar padia për pagimin e kamatës.

Kamatëvonesa në kërkesat në të holla, që janë bërë të kërkueshme, mund të kërkohen dhe të llogariten nga dita e paraqitjes së padisë për realizimin e tyre.

Detyrimi për dhënien e ushqimit ligjor mund të caktohet me vendimin e gjykatës nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë.

Në rastet në të cilat nuk është caktuar afati për përmbushjen e detyrimit, debitori bie me vonesë që nga momenti i paraqitjes së padisë në gjykatë.

1.8 Mbrojtja e të paditurit nga padia

Mbrojtja është e drejtë e jo detyrë e të paditurit. Mbrojtjen nga padia i padituri mund ta bëjë me veprim procedural juridik apo me veprim materialo-juridik ose në të dy veprimet përnjëherë.

Qëllimi i mbrojtjes me veprime procedurale është që gjykata ta hedhë poshtë padinë për shkaqe procedurale, pa u deklaruar lidhur me themelësinë apo pathemelësinë e kërkesëpadisë. Kurse qëllimi i mbrojtjes me veprim materialo-juridike është që gjykata me vendim merititor ta refuzoj kërkesëpadinë si të pabazë.

Mbrojtja me anë të veprimeve proceduralo-juridike:

I padituri mbrohet duke parashtruar fakte për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, që përbënë pengesë për zhvillimin e mëtejshëm të gjykimit, parashtrimi i parashtrimeve procedurale dhe kërkesa për sigurimin e shpenzimeve procedurale.

Mbrojtja me anë të mjeteve materialo-juridike:

I padituri mbrohet me këto mjete:

- I konteston faktet në të cilat bazohet kërkesëpadia;
- E konteston bazën juridike të kërkesëpadisë;
- I parashtron prapësimet materialo-juridike dhe
- Parashtron kundërkërkesat.

1.9 Kundërpadia

Kundërpadia është padi e të paditurit kundër paditësit e parashtruar në procesin të cilin i dyti e ka vënë në veprim kundër të parit. Me anë të kundërpadisë i padituri në të njëjtën gjykatë dhe në të njëjtin gjykim e parashtron kërkesëpadinë e tij të veçantë. Me kundërpadi themelohet edhe një raport proceduralo-juridik me role të kundërta të palëve. Kundërpadia është paraparë si e drejtë e të paditurit e jo edhe si detyrë procedurale e tij. Kundërpadia shërben si mjet i mbrojtjes, sidomos kur mbështetet në faktet të cilat i padituri mund t'i përdor për të propozuar aktgjykimin me të cilin refuzohet kërkesëpadia e paditësit.

1.10 Ushtrime

Gjatë këtij sesioni pjesëmarrësve do t'iu prezantohet një rast praktik për të përpiluar një padi të rregullt. Pjesëmarrësit do të punojnë në grupe dhe pastaj do të bashkëbisedohet me secilin grup veç e veç për të gjitha çështjet të cilat janë më rëndësi për të vlerësuar drejtë dhe shpejt rregullsinë e padisë.

1.11 Përmbledhje

Në këtë cikël janë bërë shqyrtime praktike lidhur me paraqitjen e padisë në gjykatë dhe rrjedhën e shpejt të procedurës kontestimore lidhur me një çështje kontestuese në gjykatën e shkallës së parë.

Çështjet e paraqitura në këtë cikël janë shqyrtuar në aspektin praktik në pajtim me risit e LPK-së, me qëllim që pjesëmarrësit gjatë punës së tyre profesionale të kenë qasje më të mirëfillta për zbatimin praktik të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat kanë të bëjnë me rrjedhën e procedurës kontestimore në gjykatën e shkallës së parë.

2. Shqyrtimi paraprak i padisë dhe përgjigja në padi

2.1 Hyrje

Shqyrtimi paraprak i padisë është një nënë fazë e rëndësishme për përgatitjen e seancës për shqyrtim për kryesor.

Çështjet të cilat shqyrtohen gjatë shqyrtimit paraprak të padisë janë në kompetencë të gjykatësit të vetëm.

Gjykatësi i vetëm ka autorizim që nga momenti i dorëzimit të dosjes së lëndës – çështjes në punë t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për shqyrtimin paraprak të padisë

2.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij prezantimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbaton drejtë masat të cilat i ndërmer gjykatësi gjatë shqyrtimit paraprak të padisë;
- Thellojnë njohurit mësojnë për përgjigjen në padi;
- Fitojnë njohuri për pasojat procedurale që rrjedhin për shkak të mos rregullsisë së padisë dhe përgjigjes në padi;
- Mësojnë për vendimet gjyqësore të cilat gjatë shqyrtimit paraprak të padisë.

2.3 Shqyrtimi paraprak i padisë

Shqyrtimi paraprak i padisë është veprim procedural i detyrueshëm për përgatitjen e shqyrtimit kryesor për një çështje juridiko-civile. Për ta zhvilluar këtë veprim juridik të shqyrtimit paraprak të padisë është i autorizuar kryetari i trupit gjykues apo gjyqtari i çështjes. Me rastin e shqyrtimit paraprak të padisë nga ana e gjyqtarit, fillimisht bëhet verifikimi se a janë përmbushur prezumimet procedurale nëse ato mund të vërtetohen me leximin e padisë. Këtë konstatim gjyqtari e bënë në bazë të dhënave që i përmban padia dhe shkresat tjera të cilat i janë bashkangjitur padisë.

Në bazë të padisë dhe shresave të lëndës gjyqtari mund të vërtetoj se a ka juridiksion gjykata në këtë çështje juridike që është parashtruar me padi:

- A është gjykata kompetente në pikëpamje lëndore dhe territoriale;
- A ekzistojnë shkaqet për përjashtimin e gjyqtarit ;
- A kanë palët zotësi për të qenë palë dhe zotësinë procedural si dhe a janë të përfaqësuar rregullisht;
- A është paraqitur padia me kohë, nëse me dispozitë të veçantë është caktuar afati i parashtrimit të padisë.

Nga e tërë kjo rezulton se kur padia është përpiluar në mënyrë të kuptueshme dhe të plotë, gjyqtari mund të vërtetojë të gjitha shkaqet juridike të cekura më lartë.

Gjatë shqyrtimit paraprak të padisë gjykatësi mund ti marrë aktvendime me të cilin paditësin e detyron që ta bëjë rregullsinë e padisë, nëse sipas saj nuk mund të gjykohej. Padia e paraqitur në

gjykatë mund të mos jetë e rregullt, këtë sepse i mungon ndonjë element i cili është parapa me dispozitat e nenit 99 të LPK-së.

Gjithashtu padia mundë të jetë edhe e pakuptueshme sepse nuk i përmban elementet e parapara me dispozitat e nenit 253 të LPK-së.

Kur padia nuk është e plotë dhe nuk i përmban të gjitha elementet për të gjykuar lidhur me at, gjykatësi i çështjes në pajtim me dispozitat e nenit 102 të LPK-së me aktvendimi ia kthen në plotësim ose përmirësim padinë e parregullt paditësit. Padiësi është i detyruar që brenda afatit prej 3 ditësh t'ia kthej gjykatës padinë. Ky afat për dallim nga ligji i mëparshëm tash është ligjor.

Përveç kësaj, gjykatësi gjatë procedurës së shqyrtimit paraprak merr edhe këto lloje të aktgjykimit: aktgjykimin në bazë të pohimit, aktgjykimin në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia, aktgjykimin për shkak të mosbindjes, aktgjykimin mungesor dhe të miratoi pajtimin gjyqësor.

Këto autorizime janë parapa me dispozitat e nenit 388 të LPK-së. Në këtë fazë të përgatitjes së seancës për shqyrtim kryesor në pajtim me dispozitat e nenit 390 të LPK-së mundë të ndërmerr edhe këto masa duke ftuar paditësin që ta bëjë: rregullsinë e padisë nëse është e pakuptueshme apo jo e plotë, për ti eliminuar mungesat që kanë të bëjnë me zotësinë e palëve ndërgjyqësore për të qenë palë në procedurë apo mungesat që kanë të bëjnë me përfaqësuesin ligjor të palëve ndërgjyqësore apo mungesa që kanë të bëjnë me autorizimin e autorizuesit për fillimin e procedurës kontestimore, kur autorizimi i tillë kërkohet me ligj.

Gjykata me qëllim të eliminimit të këtyre pengesave ndërmerr masa brenda autorizimeve të parapara me dispozitat e nenit 79 dhe 102 të LPK-së.

Gjithashtu, pas shqyrtimit paraprak gjykatësi i çështjes me aktvendim mundë ta hedhë padinë e paditësit nëse vlerëson se: çështja kontestimore nuk hynë në kompetencën gjyqësore, kur palët kanë lidhur kontratë për zgjidhjen e çështjes nga arbitrazhi, kur ekziston gjyqëvarsia, kur çështja është e gjykuar në formë të prerë, kur është lidhur pajtimi gjyqësor, nëse paditësi ka hequr dorë nga kërkesëpadia, kur nuk ekziston interesi juridik i paditësit për padi vërtetimi, kur padia është paraqit pas afatit, po që se me dispozita të posaçme është parapa afati për paraqitjen e padisë.

Përpos kësaj gjykatësi i çështjes gjatë shqyrtimit paraprak të padisë mund të marr aktvendim për jokompetencë dhe çështjen t'ia dërgoi gjykatës për të cilën vlerëson se është kompetente po që se konstaton se: nuk është jokompetente territoriale për gjykimin çështjes kontestimore dhe kur çështja nuk bie në kompetencë lëndore të gjykatës.

2.4 Dërgimi i padisë palës së paditur

Gjyqtari i çështjes pas shqyrtimit paraprak të padisë vërteton se nuk ka pengesa procedurale për zhvillimin e tutjeshëm të procedurës. Gjyqtari duhet t'ia dërgoj padinë palës së paditur, brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita kur padia është paraqitur e rregullt në gjykatë, konform nenit 394 të LPK-së. Me dërgimin e padisë të paditurit, nga ana e gjykatës i ipet rasti të paditurit që të njoftohet me pretendimet e paditësit, që të deklarohet lidhur me këto pretendime, duke i pohuar apo kontestuar ato pretendime. Bashkë me padinë gjykata të paditurit ia dërgon palës së paditur edhe udhëzimin për përgjigje në padi, dhe për pasojë procedurale në rastë se pala e paditur nuk përgjigjet në padi konform nenit 395 par 2 i LPK-së.

2.5 Përgjigja në padi

Pas dorëzimit të padisë të paditurit nga ana e gjykatës, i padituri ka të drejtë që të përgjigjet me shkrim lidhur me padinë e paditësit. Në bazë të nenit 395.1 të LPK-së, të paditurit pasi t' i dërgohet padia me shkresa të bashkangjitura, eventualisht, ka për detyrë që brenda afatit prej 15 ditësh, të përgjigjet me shkrim në padi. Me rastin e dërgimit të padisë gjykata do ta udhëzojë të paditurin për detyrimin nga paragrafi 1 i këtij neni për përmbajtjen që duhet ta ketë përgjigja në padi si dhe për pasojat procedurale në rastë se përgjigjen në padi nuk e paraqetë në gjykatë brenda afatit të duhur. Nga kjo rezulton se pasi i padituri të ketë marr aktvendimin për dhënien e përgjigjes në padi së bashku me padinë dhe të gjitha shkresat e lëndës, i padituri ka për detyrë që brenda afatit prej 15 ditësh, të jap përgjigje me shkrim në padi. Dhënia e përgjigjes me shkrim në padi e ndihmon në përgatitjen e rrjedhjes së mëtejme të procedurës.

Në qoftë se në përgjigjen në padi janë theksuar kundërshtime lidhur me prezumimet procedurale dhe nëse gjykata konstaton se ato kundërshtime janë të bazuara, do të merr vendim për hedhjen e padisë para caktimit të seancës përgatitore, p.sh. (për shkak të ekzistimit të kontestit, për shkak të çështjes së gjykuar, të ekzistimit të pajtimit gjyqësor, të heqjes dorë nga kërkesëpadia e njëjtë), për çka do të arrihet kursim i rëndësishëm në kohë dhe shpenzime të procedurës.

Në pajtim me dispozitat e nenit 99 al.2 dhe 3 të LPK-së, përgjigja në padi ngjashëm sikurse padia duhet të jetë e kuptueshme dhe të përmbaj çdo gjë që nevojitet dhe e bënë të mundur veprimin-gjykimin sipas saj.

Me dispozitat e nenit 397 të LPK-së, është parapa se gjykata do të veproj në pajtim me dispozitat e nenit 102 të LPK-së, po qe se konstaton se përgjigja në padi është e pakuptueshme apo jo e plotë, me qëllim të heqjes së mungesave.

Duke marrë për bazë faktin se mosparaqitja e përgjigjes në padi shkakton pasoja procedurale për të cilat në vazhdim do të bëjmë fjalë, jam i mendimit se kur të paditurit i kthehet në përmirësim apo plotësim përgjigja në padi dhe ai nuk e bënë përmirësimin apo plotësimin e saj brenda afatit të caktuar kjo nuk mund të konsiderohet si e tërhequr e as të hedhet poshtë.

Ky mendim bazohet në arsyetimin se tërheqja konsiderohet sikurse i padituri të mos ketë paraqitur përgjigje në padi, ndërsa hedhja poshtë e pengon zhvillimin e procedurës kontestimore në gjykatën e shkallës së parë, sepse gjykata nuk lëshohet fare në shqyrtim dhe me këtë veprim të paditurit ia bënë të pamundur realizimin e të drejtës së përgjigjes në padi.

Nga kjo që u paraqit më lartë rrjedhë përfundimi se në situatën e tillë juridike nuk mund të zbatohet dispozitat e nenit 102 al.3 dhe 4 të LPK-së, por gjykata do të veproj në pajtim me dispozitat e nenit 400 al.1 dhe 2 të LPK-së dhe do ta cakton seancën përgatitore.

Kjo seancë si rregull mbahet më së voni brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita kur gjykatës i ka arritur përgjigja në padi. Ne mendojmë se në rast kur i padituri nuk e ka paraqit brenda afatit të caktuar përgjigjen në padi e cila i është kthyer të paditurit me aktvendim për përmirësim dhe plotësim, afati për caktimin e seancës përgatitore prej 30 dite do të llogaritet nga dita kur i padituri ka qenë i detyruar që t'ia paraqes gjykatës përgjigjen në padi të përmirësuar dhe të plotësuar.

Mosparaqitja e përgjigjes në padi ka për pasojë nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë – mosbindjes në qoftë se plotësohen kushtet e parapara me dispozitat e nenit 150 al.1 pika a, b, c, të LPK-së. Ndërsa, po qe se i padituri me përgjigjeje në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundër kontestimit të kërkesëpadiës, gjykata në pajtim me dispozitat e

nenit 152 lidhur me nenin 143 dhe 147 të LPK-së, pa caktuar seancë gjyqësore mund të nxjerrë aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes.

2.6 Ushtrim

Gjatë këtij sesion trajnues pjesëmarrësit do të marrin raste nga praktika ku secilit veç e veç do vlerësojnë situatat kur mund të merret aktvendimi për kthimin e padisë në plotësim dhe përmirësim dhe llojet tjera të aktvendimit të cilët merren gjatë shqyrtimit paraprak të padisë. Gjithashtu, pjesëmarrësit do të marrin një detyrë nga praktika gjyqësore për të marr aktvendim me të cilin të paditurit do ti dërgohet padia për të paraqit përgjigja në padi.

2.7 Përmbledhje

Në këtë sesion pjesëmarrësit janë aftësuar për marrjen e masave të nevojshme për shqyrtimin paraprak të padisë dhe përgjigjes në padi. Posaçërisht përgjigja në padi është sqaruar më në detaje sepse përfaqëson një veprim procedural të formës së shkruar të paditurit i cili me ligj merr një përmbajtje tjetër e cila në rast të mos paraqitjes shkakton pasoja të rënda procedurale-ligjore.

3. Seanca përgatitore

3.1 Hyrje

Pasi që të arrij përgjigja në padi, gjyqtari i çështjes e cakton seancën përgatitore, meqë seanca përgatitore është nënfaza e fundit e fazës së përgatitjes të shqyrtimit kryesor, në të cilën bëhet sqarimi i çështjeve kontestuese dhe eliminohen pengesat procedurale që kanë të bëjnë me rrjedhën e mëtejme të procedurës. Në seancën përgatitore gjykata vërteton se cilat fakte janë kontestuese midis palëve dhe cilat janë relevante për dhënien e vendimit lidhur me kërkesëpadinë, si dhe cilat prova do të merren për përvetimin e tyre fakteve në shqyrtimin kryesor. Me qëllim që seanca e shqyrtimit kryesor të përfundoj vetëm me një seancë, gjë që është edhe intenca e ligjdhënësit që seanca përgatitore duhet të jetë e përgatitur në atë mënyrë që në të zgjidhen të gjitha çështjet procedurale. Në seancën përgatitore, palët duhet t'i definojnë qartë kërkesat e tyre dhe aty duhet të rregullohet i tërë materiali lidhur me çështjet kontestuese.

Seanca përgatitore në bazë të nenit 401 të LPK-së, seanca përgatitore është e detyrueshme, përveç se në rastet në të cilat gjykata pasi ti ketë arritur përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk ka fakte kontestuese apo nga shkaku i pandërlikueshmërisë së kontestit, vjen në përfundim se nuk ka nevojë të konvokohet seanca përgatitore.

Në bazë të nenit 402 të LPK-së, gjykata fton ndërgjyqësit me letërthirrje për seancën përgatitore, e njëjta i njofton palët për pasojat e mosardhjes në seancë si dhe për detyrën që më së voni në seancën përgatitore duhet t'i parashtrijë të gjitha faktet në të cilat mbështesin kërkesat e tyre, si dhe t'i propozojnë të gjitha provat që dëshirojnë të merren gjatë procedurës, por edhe që në seancë t'i sjellin të gjitha shkresat dhe sendet që dëshirojnë t'i përdorin si mjete provuese. Letërthirrja për në seancë përgatitore, si rregull, u dërgohet palëve së paku shtatë (7) ditë para ditës në të cilën mbahet ajo.

3.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij sesiioni pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Aftësohen për përgatitjen dhe udhëheqjen e seancës përgatitore;
- Aftësohen për marrjen e vendimeve gjyqësore gjatë seancës përgatitore;
- Përpilojnë procesverbalë të seancës përgatitore;
- Përpilojnë procesverbalë për pajtimin gjyqësor.

3.3 Seanca përgatitore

Nga prezantimi i nëntë në nëntitullin, përgjigja në padi janë paraqit efektet pozitive dhe negative procedurale të përgjigjes në padi. Përveç atyre efekteve juridiko procedurale, përgjigja në padi paraqet edhe një prezumim me rëndësi vendimtare për caktimin e seancës përgatitore.

Me dispozitat e nenit 400 të LPK-së është paraparë se pasi të arrij përgjigja në padi, gjykata e cakton seancën përgatitore.

Praktika gjyqësore do të përballet edhe me situata kur të paditurit i është kthyer përgjigja në padi për ta plotësuar apo përmirësuar dhe i padituri brenda afatit prej 3 dite nuk e ka plotësuar

përkatësisht përmirësuar ose kur përgjigjen në padi e ka kthyer pa plotësuar ose të pa përmirësuar.

Në këto situata gjykata do ta cakton seancën përgatitore ku i padituri do të ftohet që të metat e tilla ti eliminon në këtë seancë.

Po që se, nuk është paraqit përgjigja në padi nga ana e të paditurit dhe kur nuk plotësohen kushtet ligjore të parapara me dispozitat e nenit 150 al.1 pika a, b dhe c. e LPK-së për marrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, gjykata do ta cakton seancën për shqyrtim përgatitor pas kalimit të afatit ligjor prej 15 dite për paraqitjen e përgjigjes në padi nga i padituri.

Seanca përgatitore si rregull caktohet më së voni brenda afatit prej 30 dite nga dita kur gjykatës i ka arritur përgjigja në padi e të paditurit. Ditën e mbajtjes së seancës përgatitore, gjykata do ta cakton kur ajo vlerëson se janë plotësuar kushtet për mbajtjen e suksesshme dhe at pasi që të konsultohet me palët ndërgjyqësore.

Ne mendojmë se lidhur me konsultimin e palëve ndërgjyqësore, gjykata do të mban shënim zyrtar në të cilin do të konstatohet se palët ndërgjyqësore janë konsultuar për mbajtjen e seancës për shqyrtim përgatitor dhe menjëherë do ti njoftoi palët për ditën e mbajtjes së seancës përgatitore me paralajmërim për pasoja procedurale në rast të mosparaqitjes.

Kur gjykata vlerëson se seanca përgatitore nuk është e domosdoshme të caktohet nga se çështja e cila është lëndë gjykimi është e natyrës së lehtë gjykata e cakton menjëherë seancën për shqyrtim kryesor, ndërsa kur faktet e paraqitura në padi nuk janë kontestuese edhe përkundër kontestimit të kërkesëpadsisë, gjykata nuk e cakton seancën për shqyrtim përgatitor as at kryesor dhe pa seancë të shqyrtimit kryesor merr aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes.

Seanca përgatitore fillon me paraqitjen e paditësit i cili do të paraqet deklaratën e shkurt dhe sqaruese lidhur me përmbajtjen e padsisë së paraqitur. Pastaj ftohet i padituri që të paraqes po ashtu deklaratë sqaruese lidhur me përmbajtjen e përgjigjes në padi. Sa herë që gjykata vlerëson se ndonjë fakt i paraqitur nga palët duhet të sqarohet ajo një gjë të tillë e bënë duke bërë dëgjimin e palëve. Pas kësaj gjykata kalon në shqyrtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me pengesat për rrjedhën e procedurës.

Lidhur me eliminimin e këtyre pengesave gjykata është e autorizuar të merr prova nëse është e nevojshme për një gjë të tillë. Gjatë seancës për shqyrtim përgatitor gjykata do të vendos për të gjitha prapësimet tjera të parapara me dispozitat e nenit 390 të LPK-së.

Gjatë seancës përgatitore shqyrtohen edhe propozimet e palëve dhe faktet mbi të cilat bazohen propozimet e paraqitura. Në seancën për shqyrtim kryesor gjykatësi vendos se cilat prova do të shqyrtohen në seancën për shqyrtim kryesor.

Për të gjitha këto veprime procedurale gjykata mban procesverbal për seancën e shqyrtimit përgatitor të cilin e nënshkruajnë palët, sekretarja juridike dhe në fund gjykatësi.

Mos ardhja e paditësit në seancën për shqyrtim përgatitor ka për pasojë marrjen e aktvendimit me të cilën padia konsiderohet si e tërhequr- neni 409 al.1 të LPK-së, në qoftë se i padituri nuk kërkon që seanca të mbahet në mungesë të paditësit.

Po që se i padituri nuk paraqitet në këtë seancë edhe pse është ftuar rregullisht seanca mbahet vetëm me paditësin i cili është i pranishëm. Gjatë seancës për shqyrtim përgatitor gjykatësi i ka të gjitha autorizimet që i ka në seancën për shqyrtim kryesor.

3.4 Ndërmjetësimi dhe pajtimi gjyqësor

Procedura kontestimore mund të përfundoj me ndërmjetësim dhe pajtim gjyqësor. Zgjidhja e çështjes kontestimore me ndërmjetëson është një risi e LPK-së e cila më parë nuk ka ekzistuar.

LPK-ja me dispozitat e nenit 411 ka parapa mundësinë që gjykata ti propozon palëve ndërgjyqësore për të zgjidhur kontestin në procedurën e ndërmjetësimit e cila është e rregulluar me ligj të veçantë.

Zgjidhjen e kontestit me ndërmjetësim mund ta propozojnë edhe vet palët me marrëveshjen e tyre. Propozimin e këtyre palët mund ta bëjnë deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes.

Palët ndërgjyqësore gjatë gjithë procedurës së zhvilluar kontestimore mund të bëjnë zgjidhjen e kontestit me pajtim gjyqësor. Gjykata brenda autorizimeve ligjore mund të kontribuoj te palët ndërgjyqësore që çështjen kontestimore ta zgjidhin me pajtim gjyqësor.

Me anë të pajtimit gjyqësor mund të zgjidhet çështja kontestimore për të gjitha kërkesëpaditë e paraqitura dhe për një ose dy kërkesa të paraqitura në padi. Gjykata me aktvendim e miraton pajtimin gjyqësor. Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Ndërsa kur pajtimi i propozuar nga palët ndërgjyqësore nuk lejohet, gjykata me aktvendim e refuzon propozimin e paraqitur dhe kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa.

Në qoftë se gjykata e merr një aktvendim të tillë, atëherë e ndërprejnë procedurën kontestimore për deri sa të bëhet i formës së prerë aktvendimi.

Pajtimi i arritur gjyqësor konstatohet në procesverbal i cili i dorëzohet palëve ndërgjyqësore dhe si i tillë ka fuqinë e dokumentit përbarimor-titullit ekzekutues. Pajtimi gjyqësor mund të goditet vetëm me anë të padisë.

3.5 Ushtrim

Gjatë këtij sesioni pjesëmarrësit do të marrin një rast nga praktika gjyqësore dhe në grupe të ndara do të ndërmarrin veprime procedurale të cilat kanë të bëjnë me udhëheqjen e seancës përgatitore, gjithashtu, pjesëmarrësit do të kenë qasje në marrjen e aktvendimeve gjatë seancës përgatitore. Secili pjesëmarrës do të përpiloj një procesverbal të seancës përgatitore.

3.6 Përmbledhje

Në këtë sesion, janë shqyrtuar çështjet të cilat janë vendimtare për rrjedhën e shpejtë dhe të drejtë të procedurës kontestimore në seancën përgatitore. Pjesëmarrësit janë njoftuar me risitë e LPK-së dhe zbatimin praktik të këtyre risive.

4. Përgatitja e seancës për shqyrtim kryesor dhe seanca për shqyrtim kryesor

4.1 Hyrje

Shqyrtimit kryesor është faza kryesore e procedurës kontestimore. Seancën e shqyrtimit kryesor e përbëjnë veprimet procedurale të gjykatës dhe të palëve, të kryera në një apo më tepër seanca, me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike, nga të cilat m'varet themelësia e kërkesëpadisë

Në këtë sesion trajnimi do të shqyrtohen autorizimet e gjykatësit për përgatitjen e seancës kryesor në pajtim me risit e LPK-së. Dija profesionale dhe shkathtësitë praktike të gjykatësit janë me ndikim shumë të madh në përgatitjen e mirëfilltë të seancës për shqyrtimin kryesor. Përgatitjen e seancës kryesore tash e udhëheq gjykatësi i vetëm pa marrë parasysh ndërlikshmërinë e çështjes kontestimore. Përgatitja e seancës për shqyrtim kryesor sipas ligjit fillon nga momenti kur gjykatës i paraqitet padia. Praktikisht përgatitja e seancës për shqyrtim kryesor fillon prej momentit kur dosja e shkresave të lëndës i dorëzohet në punë gjykatësit të çështjes sipas orarit vjetor të punës. Përgatitja e mirëfilltë e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes ndikon në rrjedhën e shpejt dhe të drejtë të procedurës, i cili është synim i palëve ndërgjyqësore dhe i gjykatës dhe i shoqërisë në përgjithësi.

Gjithashtu në këtë sesion do të shqyrtohen edhe risitë e LPK-së lidhur me autorizimet e gjykatësit të çështjes për caktimin e seancës për shqyrtim kryesor, të cilat kanë të bëjnë me çështjet e zhvillimit të seancës për shqyrtim kryesor, publicitetit të seancës për shqyrtim kryesor, udhëheqjes – menaxhimit të seancës për shqyrtim kryesor nga gjykatësi i çështjes dhe mbajtjes së rendit publik në seancën për shqyrtim kryesor. LPK-ja rrjedhën e procedurës në seancën për shqyrtim kryesor e rregullon me dispozitat e nenit 423 deri në nenin 448.

4.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij sesioni, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zgjerojnë njohurit për autorizimet e gjykatësit për përgatitjen e seancës për shqyrtim kryesor;
- Hartojnë vendimet gjyqësore gjatë përgatitjes së seancës për shqyrtim kryesor;
- Hartojnë aktvendime gjatë përgatitjes së seancës për shqyrtim kryesor;
- Thellojnë njohurit për aktgjykimit gjatë përgatitjes së seancës për shqyrtim kryesor dhe për përgjigjen në padi;
- Fitojnë njohuri lidhur me përgatitjet për caktimin e seancës kryesore dhe marrjen e vendimeve gjyqësore dhe për zhvillimin e seancës për shqyrtim kryesor;
- Hartojnë procesverbalin për seancën e shqyrtimit kryesor;
- Mësojnë për publikimin e aktvendimit gjatë seancës dhe publikimin e aktgjykimit pas përfundimit të seancës për shqyrtim kryesor.

4.3 Përgatitja e seancës për shqyrtim kryesor

Pasi që të përfundon seanca përgatitore, gjyqtari kur ka mundësi në atë seancë ju komunikon palëve të pranishëm ditën dhe orën si dhe vendin e mbajtjes së seancës për shqyrtimin kryesor. Në qoftë se gjyqtari nuk e bënë këtë, palët thirren në bazë të letërthirrjes për në seancën e shqyrtimit kryesor. Palës së paditur duhet t'i lihet një kohë e mjaftueshme nga dita e thirrjes për seancën e shqyrtimit kryesor së paku 8 ditë, e cila kohë shërben që i padituri të përgatitet për

seancën e shqyrtimit kryesor. Përveç palëve gjykata fton edhe dëshmitarët, ekspertët, për të cilët gjyqtari ka vendosur në bazë të shqyrtimit në seancën përgatitore, ose në bazë të propozimit në padi apo në përgjigjen në padi. Seanca e shqyrtimit kryesor caktohet me aktvendim i cili bënë pjesë në kategorinë e veprimeve drejtuese, për çka kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa siq e ka përcaktuar dispozita e nenit 123.2 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

Gjyqtari i çështjes e analizon materialin procedural për ta përmbajtur në veprimet procedurale të shkruara dhe të parashtruara gojarisht në seancën përgatitore. Gjyqtari i çështjes e bënë planin e shqyrtimit të çështjes dhe merr masa për mbledhjen e materialit tjetër të nevojshëm. Këto përgatitje duhet të bëhen me qëllim që seanca e shqyrtimit kryesor lidhur me çështjen të përfundoj, sipas mundësisë në një seancë të vetme ndonse procedura e shkallës së parë, si rregull, përbëhet prej dy seancave gjyqësore: Seanca përgatitore dhe seanca për shqyrtimin kryesor.

4.4 Hapja e seancës së shqyrtimit kryesor

Gjyqtari me rastin e hapjes së seancës së shqyrtimit kryesor, pas verifikimit të ftuarve përkatësisht ndërgjyqësve dhe përfaqësuesve të tyre, heton shkaqet e mosparaqitjes në seancë si dhe rregullsinë e thirrjeve të atyre që kanë munguar. Kur gjyqtari konstaton se disa të ftuar nuk marrin pjesë, gjyqtari duhet të verifikojë se ata persona apo palë janë ftuar në mënyrë të rregullt apo jo, apo palët të cilët mungojnë e kanë arsyetuar mungesën. Nëse gjykata vërteton se pala e cila ka munguar nuk ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt, seanca e shqyrtimit kryesor shtyhet për një ditë tjetër, për kur pala do të ftohet në mënyrë të rregullt.

Po që se pala paditëse edhe pse e ftuar në mënyrë të rregullt mungesën nuk e ka arsyetuar, konsiderohet se e ka tërhequr padinë, përveç se kur i padituri deklaron se kërkon që të zhvillohet shqyrtimi kryesor i çështjes në mungesë të paditësit. Po që se në seancën për shqyrtimin kryesor nuk vjen i padituri që është thirrur rregullisht atëherë seanca e shqyrtimit kryesor mbahet pa praninë e të paditurit.

Gjykata ka për detyrë që edhe para seancës së shqyrtimit kryesor të kujdeset nëse ekzistojnë prezumimet procedurale për mbajtjen e seancës së shqyrtimit kryesor, kështu sipas dispozitës së nenit 437 të LPK-së, gjykata mund ta shtyj seancën e caktuar për shqyrtimin kryesor para se të filloj ajo, po që se konstaton se nuk janë plotësuar prezumimet ligjore për mbajtjen e saj, apo se provat e caktuara për marrje nuk do të mund të bëhen të pranishme deri në fillimin e seancës. Gjykata ka për detyrë që më së voni 7 ditë para fillimit të seancës, ta bëjë verifikimin nëse janë plotësuar kushtet për mbajtjen e seancës së shqyrtimit kryesor. Kur seanca e shqyrtimit kryesor shtyhet gjykata ka për obligim që t'i ftoj ndërgjyqësit dhe personat e thirrur më parë, për kohën e mbajtjes së seancës së shtyer.

4.5 Mbajtja e rendit në seancën për shqyrtimin kryesor

Gjyqtari i çështjes është i obliguar që të përkujdeset lidhur me mbajtjen e rendit dhe të qetësisë në sallën e gjykimit, si dhe të kujdeset për ruajtjen e autoritetit të gjykatës, në qoftë se, ndonjëri nga personat e pranishëm në sallën e gjykimit e prish rendin dhe qetësinë në sallë. Gjyqtari i çështjes personit i cili e prish rendin dhe qetësinë i bënë vërejtje. Në qoftë se personi i qortuar e përsëritë gabimin, gjyqtari personin e qoftuar do ta largon nga salla ose mund ta dënojë me dënim me gjobë prej 100 deri në 500 euro, siç e ka përcaktuar dispozita e nenit 289 të LPK-së. Në qoftë se pala apo përfaqësuesi me prokurë largohet nga seanca, seanca do të mbahet pa praninë e tij. Po që se përfaqësuesi me prokurë i palës edhe gjatë zhvillimit të seancës së shqyrtimit kryesor bënë veprime të përcaktuara si më lartë, gjykata mund t'ia ndaloj

përfaqësimin e mëtutjeshëm të palës. Kur gjykata dënon me gjobë ose e largon nga seanca e shqyrtimit kryesor avokatin apo praktikantin e avokatit, si përfaqësues me prokurë, do ta njoftoj për këtë Odën e Avokatëve. Me rastin e përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor kontesti kalon nga faza e shqyrtimit në fazën e vendosjes. Pas këtij momenti palët nuk mund të parashtrojnë kërkesa të reja e as të përdorin mjete të mbrojtjes apo të sulmit.

4.6 Seanca për shqyrtim kryesor

4.6.1 Hapja e seancës së shqyrtimit kryesor

Gjyqtari me rastin e hapjes së seancës së shqyrtimit kryesor, pas verifikimit të ftuarve përkatësisht ndërgjyqësve dhe përfaqësuesve të tyre, heton shkaqet e mosparaqitjes në seancë si dhe rregullsinë e thirrjeve të atyre që kanë munguar. Kur gjyqtari konstaton se disa të ftuar nuk marrin pjesë, gjyqtari duhet të verifikojë se ata persona apo palë janë ftuar në mënyrë të rregullt apo jo, apo palët të cilët mungojnë e kanë arsyetuar mungesën. Nëse gjykata vërteton se pala e cila ka munguar nuk ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt, seanca e shqyrtimit kryesor shtyhet për një ditë tjetër, për kur pala do të ftohet në mënyrë të rregullt.

Po që se pala paditëse edhe pse e ftuar në mënyrë të rregullt mungesën nuk e ka arsyetuar, konsiderohet se e ka tërhequr padinë, përveç se kur i padituri deklaron se kërkon që të zhvillohet shqyrtimi kryesor i çështjes në mungesë të paditësit. Po që se në seancën për shqyrtimin kryesor nuk vjen i padituri që është thirrur rregullisht atëherë seanca e shqyrtimit kryesor mbahet pa praninë e të paditurit.

Gjykata ka për detyrë që edhe para seancës së shqyrtimit kryesor të kujdeset nëse ekzistojnë prezumimet procedurale për mbajtjen e seancës së shqyrtimit kryesor, kështu sipas dispozitës së nenit 437 të LPK-së, gjykata mund ta shtyj seancën e caktuar për shqyrtimin kryesor para se të filloj ajo, po që se konstaton se nuk janë plotësuar prezumimet ligjore për mbajtjen e saj, apo se provat e caktuara për marrje nuk do të mund të bëhen të pranishme deri në fillimin e seancës. Gjykata ka për detyrë që më së voni 7 ditë para fillimit të seancës, ta bëjë verifikimin nëse janë plotësuar kushtet për mbajtjen e seancës së shqyrtimit kryesor. Kur seanca e shqyrtimit kryesor shtyhet gjykata ka për obligim që t'i ftoj ndërgjyqësit dhe personat e thirrur më parë, për kohën e mbajtjes së seancës së shtyer.

4.6.2 Mbajtja e rendit në seanën për shqyrtimin kryesor

Gjyqtari i çështjes është i obliguar që të përkujdeset lidhur me mbajtjen e rendit dhe të qetësisë në sallën e gjyqimit, si dhe të kujdeset për ruajtjen e autoritetit të gjykatës, në qoftë se, ndonjëri nga personat e pranishëm në sallën e gjyqimit e prish rendin dhe qetësinë në sallë. Gjyqtari i çështjes personit i cili e prish rendin dhe qetësinë i bënë vërejtje. Në qoftë se personi i qortuar e përsëritë gabimin, gjyqtari personin e qortuar do ta largon nga salla ose mund ta dënojë me dënim me gjobë prej 100 deri në 500 euro, siç e ka përcaktuar dispozita e nenit 289 të LPK-së. Në qoftë se pala apo përfaqësuesi me prokurë largohet nga seanca, seanca do të mbahet pa praninë e tij. Po që se përfaqësuesi me prokurë i palës edhe gjatë zhvillimit të seancës së shqyrtimit kryesor bënë veprime të përcaktuara si më lartë, gjykata mund t'ia ndaloj përfaqësimin e mëtutjeshëm të palës. Kur gjykata dënon me gjobë ose e largon nga seanca e shqyrtimit kryesor avokatin apo praktikantin e avokatit, si përfaqësues me prokurë, do ta njoftoj për këtë Odën e Avokatëve. Me rastin e përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor kontesti kalon nga faza e shqyrtimit në fazën e vendosjes. Pas këtij momenti palët nuk mund të parashtrojnë kërkesa të reja e as të përdorin mjete të mbrojtjes apo të sulmit.

4.6.3 Marrja e vendimit përfundimtar

Pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor gjyqtari menjëherë tërhiqet për të marr vendimin në bazë të nxjerrjes së provave dhe vërtetimit të gjendjes faktike. Vendimi mund të jetë i natyrës procedurale si: Hidhet poshtë padia si e pa lejueshme, apo të natyrës materiale kur me vendim pranohet apo refuzohet kërkesëpafia. Kur gjykata jep aktgjykimin atë e shpallë menjëherë. Seanca në të cilën shpallet aktgjykimi nuk është pjesë përbërëse e shqyrtimit kryesor. Andaj, aktgjykimi mund të shpallet kur nuk janë të pranishëm palët. Nëse gjyqtari nuk mund ta shpallë aktgjykimin nëse çështja është e komplikuar, gjyqtari mund ta shtyj shpalljen e aktgjykimit për 8 ditë, nga dita e përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor, në rast të tillë aktgjykimi nuk shpallet por palëve do t'iu ekspedohet nga një kopje e aktgjykimit.

4.7 Ushtrim

Gjatë këtij sesioni pjesëmarrësit do të marrin detyra konkrete nga praktika gjyqësore dhe secili veç e veç do ndërmarrin veprime të caktuara procedurale për të ndërmarr masa lidhur me drejtimin e mirëfilltë të procedurës dhe përgatitjen e seancës për shqyrtim kryesor. Përveç kësaj pjesëmarrësit do t'i vlerësojnë situata konkrete kur do të merret aktvendimi i cili ka për qëllim drejtimin e procedurës, kundër të cilit lejohet ankesa, aktvendimi kundër të cilit nuk lejohet ankesa si dhe aktgjykimit.

Poashtu gjatë këtij sesioni, pjesëmarrësit në bashkëpunim me trajnuesin do të organizojnë një seancë për shqyrtim kryesor duke bërë simulimin e një gjykimi lidhur me një çështje kontestimore-pronësore, pengim në posedim, servitut ose shpërblim dëmi. Çdo pjesëmarrës do të hartojë procesverbalin e seancës për shqyrtim kryesor dhe pastaj do të publikojë dispozitivin e aktgjykimit me gjyqësor me arsyetimin e shkurt gojor.

4.8 Përmbledhje

Gjatë këtij sesioni janë shqyrtuar çështjet të cilat janë me rëndësi vendimtare për përgatitjen e seancës për shqyrtim kryesor. Gjykatësi i çështjes kur posedon aftësi profesionale dhe shkathtësi praktike do të jetë në gjendje për t'i ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme të cilat ndikojnë në rrjedhën e mirëfilltë të procedurës kontestimore.

Në këtë sesion trajnues pjesëmarrësit janë njoftuar me risitë e LPK-së lidhur me zhvillimin e seancës për shqyrtim kryesor. Shqyrtimi i këtyre risive është bërë në pajtueshmëri me përmbajtjen dhe qëllimin e tyre që për synim të fundit kanë rrjedhën e shpejtë dhe të drejtë të procedurës kontestimore.

5. Mjetet provuese dhe marrja e provës

5.1 Hyrje

Veprimet kryesore të cilat i kryen gjykata gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, kanë për qëllim vërtetimin e së vërtetës rreth çështjes që është objekt shqyrtimi i kërkesëpadisë. Zbatimi i dispozitave ligjore siç janë ato materialo-juridike apo proceduralo-juridike, mund të bëhet në mënyrë të drejtë vetëm në qoftëse konstatohet saktësisht dhe plotësisht gjendja faktike në të cilën palët i bazojnë kërkesat e tyre. Në sistemin tonë procedural sikurse vërtetimi igjendjes faktike ashtu edhe të provuarit është detyrë e përbashkët e gjykatës dhe e palëve ndërgjyqëse. Me anë të provuarit pala mund ta bindë gjykatën në saktësinë e fakteve për të cilat e mbështetë kërkesëpadinë, kurse gjykata verifikon saktësinë e tyre, por edhe të fakteve që duhet t'i konstatoj sipas detyrës zyrtare. Gjykata duhet të provoj vetëm faktet relevante, ekzistimin e tyre apo edhe mosekzistimin e tyre. Të provuarit e përbëjnë veprimet procedurale të subjekteve kryesore me të cilat bëhet propozimi, zgjedhja, mbledhja, ekzaminimi dhe qmuarja e mjeteve provuese me qëllim të vërtetimit të fakteve relevante në të cilat mbështetet kërkesa e palëve.

Faktet që kanë qenë objekt i të provuarit gjykata i merr për themel të vendimit të saj vetëm në qoftë se janë paraqitur të sakta. Për tu bërë i besueshëm një fakt lejohet vetëm marrja e provave që janë likuide, që do me thënë provat që mund të merren menjëherë shpejtë dhe në mënyrë të përshtatshme. Për një gjë të tillë janë të përshtatshme në rend të parë dokumentet shkresore, por vinë në konsiderim edhe dëshmitarët që janë të pranishëm apo që mund të vijnë shpejtë në gjykatë nëse thirren. Marrja e provave është me rëndësi për rrjedhën e mirëfilltë të procedurës kontestimore. Vlerësimi i drejtë i provave të propozuara nga palët ndërgjyqësore dhe ato që i merr gjykata kryesisht ndikojnë në gjykimin e drejtë të çështjes kontestuese.

Sipas parimit të së vërtetës materiale gjykata është e detyruar që drejtë dhe plotësisht ti vërtetoi faktet kontestuese. Faktet të cilat nuk janë kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqësore nuk vërtetohen. Gjykata nuk mund ti pranoi si të pohuara faktet kur kemi të bëjmë me çështjet kontestuese që palët nuk mund të disponojnë lirisht.

Ligji i Procedurës Kontestimore mjetet provuese dhe marrjen e provave e ka rregulluar me dispozitat e nenit 319 deri në nenin 378 ndërsa procedurën e sigurimit të provave me dispozitat e nenit 379 deri në nenin 385.

5.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij sesiioni, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zgjerojnë njohurit për marrjen e provës me dëgjimin e dëshmitarit, për marrjen e provës me këqyrjen në vend, me ekspertizë, me leximin e shkresës-dokumentit, dhe me dëgjimin e palëve;
- Përpilojnë një procesverbal për marrjen e provës me këqyrje në vend.

5.3 Barra e provës

Në bazë të nenit 7 të LPK-së, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Gjykata është e autorizuar t'i vërtetoj edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur si dhe të marr edhe provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin e kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht. Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vetë në faktet dhe provat lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarohen. Kjo dispozitë përcakton parimet fundamentale në procedurën civile dhe parimin e shqyrtimit dhe hetimit. Këto dy parime janë në kundërshtim njëra me tjetrën të vazhdueshëm. Deri sa parimi i shqyrtimit është parim fundamental dhe vlenë si rregull në procedurën civile, rol dominant në procedurë penale e ka parimi hetues, sipas të cilit gjykata vepron sipas detyrës zyrtare. Në procesin gjyqësor civil paditësi në padinë e tij duhet me hollësi të parashtrijë kërkesën se si duhet të jetë dispozitivi i aktgjykimit të gjykas. Pala paditëse duhet të parashtrijë faktet, në të cilat mbështetë kërkesën e vetë. Faktet që paditësi mbështetë përbëhet nga ato fakte që paditësi pretendon që shkaktojnë në zbatimin e një rregulli apo rregulla. Eseanca e parimit të shqyrtimit qëndron në atë se gjykata do të merr parasysh vetëm ato fakte të cilat janë paraqitur dhe shtjelluar nga ana e palës. Informatat tjera, që do të kenë mundësi të arrijnë te gjykata, nuk mund të merren parasysh edhe pse ato informata i përgjigjen të vërtetës dhe në raste konkrete do të kishin ndikim në vendimmarrje.

Nga kjo rezulton se barra kryesore për paraqitjen e fakteve dhe provave në procedurën kontestimore në gjykatë i takon palëve. Vetëm në raste të veçanta vlen parimi i hetimit, sipas të cilës gjykata ka të drejtë edhe detyrim që të ofroj fakte ose të merr prova që nuk i kanë paraqitur palët, nëse kemi të bëjmë me rastet e veprimeve që palët nuk mundën të disponojnë vetë lirisht.

Me këtë tentohet që gjykata të ket rol më aktiv. Sipas nenit 84 par.2 i Ligjit për Familjen të Kosovës, vlen parimi i hetimit, gjykata është e obliguar të provoj fakte vetëm në rastet kur kemi të bëjmë me ruajtjen dhe edukimin e fëmijëve, pavarësisht nga ajo nëse prindërit kanë paraqitur prova ose jo, i njëjti obligim vlen edhe në rastet kur gjykata vendos lidhur me procedurën e shkurorëzimit.

Objekti i provës:

Objekt i të provuarit janë pretendimet e palëve për ekzistimin apo mosekzistimin e fakteve juridike nga të cilat m'varet zbatimi i të drejtës materiale në procedurën kontestimore. Me dispozitat e nenit 319 të LPK-së, rregullohen tri çështje themelore të cilat kanë të bëjnë me të provuarit:

Barra e të provuarit

- Rrethi i fakteve të cilat duhet provuar,
- Vendosja për rrethin e provave për vërtetimin e fakteve vendimtare.

Sipas dispozitave të këtij neni barra e të provuarit i takon domenit të detyrimit të palëve, ashtu që është paraparë se secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoj faktet mbi të cilat i bazon kërkesat dhe pretendimet e veta. Që do të thotë se është obligim i secilës palë sigurimi dhe

mblledhja e lëndës procedurale që nënkupton theksimin e fakteve poashtu edhe propozimin dhe sigurimin e provave. Objekt i të provuarit janë të gjitha faktet të cilat janë të rëndësishme për dhënien e vendimit. Gjykata duhet të kujdeset që rrethin e fakteve të cilat duhen të provohen, ta sjellë vetëm në ato fakte të cilat janë element i vetë kërkesës ose në të cilat ndërtohen kundërshtimet kundër saj. Kjo do të thotë se është detyrë e gjyqtarit që nga një numër i madh i fakteve, të cilat i kanë theksuar palët, t'i ndaj ato të cilat janë të rëndësishmet për vendosjen e çështjes juridiko-kontestimore, përkatësisht për bazueshmërinë apo pabazueshmërinë e kërkesëpadisë. Mirëpo, që të arrihet kjo gjyqtari duhet të posedoj njohuri solide të dispozitave të instituteve të së drejtës procedurale dhe të së drejtës materiale të praktikës gjyqësore.

5.4 Faktet që nuk kanë nevojë të provohen

Faktet të cilat nuk kanë nevojë të provohen edhe pse e përbëjnë thelbin e padisë apo të kundërpadisë, janë:

- Faktet e ditura botërisht;
- Faktet e prezumuara nga ligji dhe
- Faktet e pranuar.

Faktet e ditura botërisht nuk kanë nevojë të provohen e as faktet që i ka vërtetuar gjykata në gjykimet e mëhershme, këtë e ka potencua dispozita e nenit 321 e LPK-së: Nuk ka nevojë të provohen faktet e ditura botërisht e as faktet që i ka vërtetuar gjykata në gjykimet e mëhershme. Nuk ka nevojë të provohen faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor. Gjykata ka të drejtë të vlerësojë, duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, se a do ta merr si të pohuar apo si të kontestuar faktin të cilin pala e njëherë e ka pohuar e pastaj tërësisht apo pjesërisht e ka kontestuar, apo e ka kufizuar prohimin duke paraqitur fakte tjera. Faktet, ekzistimin e të cilave e presupozon ligji, nuk duhet provuar, por mund të provohet mosekzistimi i tyre, po që se me ligj nuk është përcaktuar diç tjetër.

Faktet e prezumuara nga ligji:

Objekt i të provuarit nuk mund të jetë as fakti, ekzistimin e të cilit ligji e prezumon. Në vend të tij provohet baza e tijë në rastë se kundërshtohet.

Faktet e pranuar:

Parimi i fakteve është veprim procedural i njëanshëm me të cilin pala deklaron se janë të vërteta në të cilat kundërshtari i saj e bazon kërkesën e tij. Faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor nuk ka nevojë të provohen. Pranim të fakteve në kuptimin e plotë procedural, kemi vetëm kur pranohen faktet e disfavorshme dhe vetëm kur ai bëhet gjatë zhvillimit të procesit kontestimor para gjykatës së çështjes.

5.5 Mjetet provuese dhe marrja e provave

Për të gjykuar drejtë lidhur me një çështje kontestuese, gjykata e bënë marrjen e provave duke e bërë dëgjimin e dëshmitarit, ekspertit, këqyrjen në vend, leximin e shkresës - dokumentit dhe dëgjimin e palëve.

5.5.1 Dëshmitari

Dëshmitar i çështjes mund të jetë çdo person i cili është i aftë të paraqes dëshmi të sakta lidhur me një fakt i cili duhet të vërtetohet. Secili person i cili ftohet nga gjykata si dëshmitar është i detyruar që ti përgjigjet ftesës së gjykatës dhe të dëshmoi, nëse nuk është parapa diçka tjetër me ligj. Nuk mundet të dëgjohet si dëshmitar personi i cili me dëshminë e paraqitur do ti ekspozohet turpit personal apo personave të afërt. Si dëshmitar mund të dëgjohet edhe personi i mitur nën moshën 14 vjeçare, por vetëm atëherë kur dëshmia e tij është e domosdoshme për vërtetimin e fakteve kontestuese.

Se a është e nevojshme të bëhet marrja e provës me dëgjimin e dëshmitarit apo jo vendos gjykata me aktvendim. Nëse vlerëson se dëshmia e dëshmitarit është me rëndësi për gjykimin e drejtë të çështjes ajo me aktvendim e miraton propozimin e palës dhe e bënë marrjen e provës me dëgjimin e dëshmitarit.

Në qoftë se, gjykata vlerëson se dëshmia e dëshmitarit nuk është me rëndësi për gjykimin e drejtë të çështjes ajo po ashtu me aktvendim e refuzon propozimin si të pabazuar.

Kundër aktvendimit për miratimin e propozimit gjegjësisht refuzimin e propozimit për marrjen e provës me dëgjimin e dëshmitarit nuk lejohet ankesa e veçantë.

Duhet theksuar se gjykata gjatë procedurës nuk është e lidhur për këtë aktvendim, këtë sepse ajo në çdo fazë të zhvillimit të procedurës mund ta tërheq – revokoi aktvendimin e vet për mos dëgjimin e dëshmitarit.

5.5.2 Eksperti

Gjykata e bënë marrjen e provës me ekspertizë kur për vërtetimin ose sqarimin e një fakti është e nevojshme dija profesionale me të cilën gjykata nuk disponon. Kur gjykata vlerëson se një fakt kontestues duhet të vërtetohet me ekspertizë ajo me aktvendim e cakton ekspertin për të bërë ekspertizën profesionale. Ekspertin mund ta propozoi pala dhe në rast se pala tjetër pajtohet atëherë gjykata me aktvendim kundër të cilit nuk lejohet ankesa e veçantë e cakton marrjen e provës me ekspertin e propozuar. Në qoftë se, pala kundërshtare nuk pajtohet atëherë gjykata me aktvendim do ta caktoi një ekspert tjetër.

Ekspertiza mund të bëhet nga një ekspert, shumë ekspertë dhe nga ndonjë institucion i specializuar për ekspertiza gjyqësore apo organ, ent ose organizatë tjetër.

Ekspertiza duhet të jetë e kuptueshme dhe të përmbaj arsye profesionale për të gjitha faktet të cilat duhet të vërtetohen drejtë dhe plotësisht. Kur lidhur me një çështje kanë ekspertuar dy ekspert dhe ekspertizat e tyre nuk janë në pajtueshmëri njëra me tjetrën atëherë gjykata i fton ata që ta bëjnë pajtueshmërinë lidhur me ekspertizat e paraqitura. Në qoftë se, ekspertët nuk arrijnë që ta bëjnë pajtueshmërinë atëherë gjykata do ta caktoi marrjen e provave me superekspertizë dhe në këtë mënyrë e bënë vërtetimin e plotë të një fakti me rëndësi për gjykimin e drejtë të një

çështje kontestuese. Eksperti i caktuar ekspertizën e paraqet me shkrim apo me gojë. Ekspertiza e paraqitur me shkrim i dërgohet palëve ndërgjyqësore. Në qoftë se, eksperti e ka paraqitur ekspertizën pa praninë e palës së paditur, gjykata do ta shtyn seancën dhe një kopje të procesverbalit me pjesën e ekspertizës së ekspertit do t'ia dërgoj të paditurit.

5.5.3 Këqyrja në vend

Marrja e provës me këqyrje në vend bëhet sa herë që gjykata vlerëson se një fakt i cili është me rëndësi të vërtetohet drejtë është e domosdoshme që të këqyret drejtpërdrejt nga gjykata dhe eksperti i lëmis përkatëse.

Për marrjen e provës me këqyrje në vend gjykata vendos me aktvendim. Në qoftë se gjykata vlerëson si të nevojshëm këqyrjen e drejtpërdrejtë ajo me aktvendim kundër të cilit nuk lejohet ankesa e veçantë e cakton seancën për marrjen e provës me këqyrjen në vend në bashkëpunim me ekspertin dhe njëkohësisht i njofton palët ndërgjyqësore për këtë seancë.

Gjatë marrjes së provës me këqyrje në vend gjykata e përpilon procesverbalin. Në procesverbal konstatohen vetëm faktet e këqyra në vend nga gjykata dhe eksperti. Përmbajtja e këtij procesverbali dallon nga ai i seancës për shqyrtim përgatitor dhe seancës për shqyrtim kryesor.

5.5.4 Shkresa-dokumenti

Çdo shkresë – dokument i cili ka përmbajtje të kuptueshme për të vërtetuar një fakt kontestues i lëshuar nga ndonjë organ shtetëror apo organizatë tjetër – person juridik që ushtron autorizime publike apo edhe nga një person tjetër brenda autorizimeve ligjore paraqet mjet provues.

Shkresat mundë të jenë publike dhe jo publike

Shkresat publike e kanë formën dhe përmbajtja e cila është parapa me ligje të veçantë, ndërsa ato jopublike lëshohen nga persona fizik apo juridik.

Në situata kur shkresa është e dyshimtë atëherë gjykata mund ta vërtetoi autenticitetin e saj duke kërkuar informacion nga subjekti i cili e lëshon.

Gjatë procedurës ndodh që pala gjykatës t'i paraqes si provë një shkresë të dyshimtë ose të falsifikuar.

Në këto situata gjykata e ndërprente gjykimin për deri sa të vërtetohet autenticiteti apo vërtetësia e shkresës.

5.5.5 Dëgjimi i palëve

Marrja e provës me dëgjimin e palës bëhet vetëm atëherë kur një fakt kontestues me rëndësi për gjykimin e drejtë të çështjes kontestuese nuk ka mundur të vërtetohet.

Marrjen e kësaj prove gjykata e bënë me propozimin e palëve ndërgjyqësore apo kryesisht.

Në qoftë se gjykata vendos për marrjen e kësaj prove, atëherë palët i fton me ftesë të veçantë për dëgjimin e palës dhe në udhëzim i paralajmëron për pasojat gjyqësore në rast të mos paraqitjes së paarsyeshme.

Nëse njëra nga palët e ftuara rregullisht nuk paraqitet në gjykata dhe kur plotësohen kushtet ligjore për mbajtjen e seancës në mungesë të palës, atëherë gjykata do të merr aktvendim dhe do ta bëjë vetëm dëgjimin e palës e cila është e pranishme në gjykatë.

5.6 Ushtrimi

Gjatë këtij sesioni pjesëmarrësve do t'iu paraqitet një rast praktik dhe do të punohet në grupe. Njeri grup do të bëjë marrjen e provës me dëgjimin e dëshmitarit, leximin e shkresës- dokumentit dhe dëgjimin e ekspertit. Tjetri grup do të bëjë marrjen e provës me këqyrjen e gjykatës në vend me ekspert gjyqësor dhe do të përpiloj procesverbalin në seancës së këqyrjes në vend. Grupi tjetër do të bijë marrjen e provës me dëgjimin e palëve.

5.7 Përmbledhje

Në këtë sesion pjesëmarrësit janë trajnuar për njërën nga fazat më të rëndësishme të procedurën kontestimore-procedura e provave. Pjesëmarrësve ju është shpjeguar procedura e marrjes së provës me dëgjimin e dëshmitarit, ekspertit, leximin e shkresës, këqyrjes në vend dhe dëgjimin e palës.

6. Gjqvarësia, bashkëndërgjyqësia dhe pjesëmarrja e personit të tretë në procedurën kontestimore

6.1 Hyrje

Gjqvarësia-litispedenca dhe bashkëndërgjyqësia përfaqësojnë institucione procedurale me rëndësi për rrjedhën e shpejt dhe të drejtë të procedurës kontestimore lidhur me një çështje kontestuese. Çështja e gjyqvarësisë rregullohet me dispozitat e nenit 262 dhe 263, ndërsa bashkëndërgjyqësia me dispozitat e nenit 264 deri në nenin 270 të LPK-së. Pjesëmarrja e personave të tretë në procedurën kontestimore është përcaktuar me nenin 271 të LPK-së, ku thuhet:

Kushdo mund të ndërhyjë në një proces kontestimor që zhvillohet ndërmjet personave të tjerë, kur ka interes juridik për të mbështetur njërën ose tjetrën palë ndërgjyqëse, me të cilën bashkohet në gjykim për ta ndihmuar atë. Ndërhyrësi mund të hyjë në procesin gjyqësor gjatë gjithë procedurës që përfundon me marrjen e formës së prerë të vendimit mbi kërkesëpadinë, si dhe gjatë procedurës që inicohet me mjete goditje të jashtëzakonshme. Deklaratën për hyrjen në procesin kontestimor, ndërhyrësi mund ta bëjë me shkrim jashtë seance apo verbalisht në seancë gjyqësore. Parashtrësia e ndërhyrësit i dërgohet të dy palëve ndërgjyqëse, e kur deklarata e ndërhyrësit është dhënë në seancë gjyqësore, atëherë pjesa përkatëse e procesverbalit i dërgohet vetëm palës që nuk ka qenë e pranishme në seancë.

Si rregull në procedurën kontestimore marrin pjesë palët ndërgjyqësore dhe gjykata. Kurse si përjashtim në procedurën kontestimore marrin pjesë edhe personat e tretë në cilësinë e ndërhyrësit anësor, kryesor, emërtimi i paraardhësit juridik dhe njoftimi i personit të tretë për procedurën kontestimore. LPK-ja sjellë risi për sa i përket pjesëmarrjes së personave të tretë në procedurën kontestimore, këtë sepse numri i subjekteve të cilët mund të fitojnë cilësinë e pjesëmarrësve në procedurën kontestimore është më i kufizuar në krahasim me LPK-në e mëparshme. Sipas LPK-së cilësinë e pjesëmarrësve në procedurën kontestimore mund ta kenë: ndërhyrësi, emërimi i paraardhësit dhe njoftimi i personit të tretë për procesin kontestimor. LPK-ja nuk e ka parapa mundësinë që prokurori publik apo avokati publik të paraqiten në procedurën kontestimore në cilësinë e pjesëmarrësit ndërhyrësit në procedurën kontestimore.

6.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij prezantimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zgjerojnë njohurit lidhur me gjyqvarësinë;
- Njohin pasojat procedurale të gjyqvarësisë;
- Fitojnë shkathtësi profesionale për vlerësimin e drejtë të gjyqvarësisë;
- Bëjnë dallimin në mes të fillimit të procedurës kontestimore dhe gjyqvarësisë;
- Thellojnë njohurit për bashkëndërgjyqësinë, materiale, formale, solidare dhe unike;
- Bëjnë dallimin ndërmjet bashkëndërgjyqësisë materiale, formale, eventuale, solidare, dhe unike;
- Thellojnë njohurit për pjesëmarrjen e ndërhyrësit anësor dhe kryesor në procedurën kontestimore, për pjesëmarrjen e paraardhësit juridik dhe njoftimin e personit të tretë për procedurën kontestimore;
- Përpilojnë një propozim për pjesëmarrjen e personit të tretë në procedurën kontestimore në cilësinë e ndërhyrësit kryesor;
- Përpilojnë një aktvendim për pranimin dhe refuzimin e propozimit për pjesëmarrjen e personit të tretë në procedurën kontestimore.

6.3 Kuptimi i gjyqvarësisë - litispedencës

Gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore ekzistojnë dy momente të rëndësishme. Momenti i parë është ushtrimi i padisë në gjykatë konform dispozitës së nenit 252 të LPK-së, dhe momenti i dytë është kur t'i dorëzohet padia palës së paditur dhe këtë e përcakton dispozita e nenit 262 të LPK-së, dhe se këtë moment ligji e emërton gjyqvarësi (litispedencia). Gjyqvarësia krijohet që në momenti në të cilin të paditurit i dorëzohet padia. Sa i përket kërkesës të cilën pala e ka parashtruar gjatë zhvillimit të procedurës, gjyqvarësisë krijohet në momentin në të cilin është njoftuar pala kundërshtarë për kërkesën e tillë. Gjatë kohës së ekzistimit të gjyqvarësisë për të njëjtën kërkesëpadi nuk mund të iniciohet gjykimi i ri midis palëve të njejtja, po që se, prap se prap bëhet një gjë e tillë gjykata e hedhë poshtë padinë. Gjykata gjatë gjithë procedurës sipas detyrës zyrtare kujdeset nëse është në zhvillim e sipër gjykimi tjetër për të njëjtën kërkesëpadi midis palëve të njejtja.

Me dorëzimin e padisë palës së paditur krijohet një raport i trefishtë në mes të gjykatës, palës paditëse dhe palës së paditur. Momenti i krijimit të gjyqvarësisë do të duhej të kishte efekt juridik edhe në rastin e ndryshimit të padisë. Kjo për faktin se pas këtij momenti, padia do të mund të ndryshohej vetëm me pëlqimin e palës së paditur. Sipas nenit 262 par.3 të LPK-së, që nga momenti i krijimit të gjyqvarësisë nuk mund të iniciohet dhe as të zhvillohet proces gjyqësor tjetër për të njëjtën çështje.

Gjyqvarësia lidhur me një çështje kontestimore ekziston nga momenti kur të paditurit i dorëzohet një kopje e padisë. Në pajtim me dispozitat e nenit 394 të LPK-së, gjykata bashkë me provat tjera ia dërgon të paditurit një kopje të padisë për përgjigjeje në padi brenda afatit prej 15 dite. Gjykata në pajtim me dispozitat e nenit 387 al.1 pika a) të LPK-së, me aktvendim kundër të cilit nuk lejohet ankesa ia dorëzon të paditurit padinë për të paraqit përgjigjeje në padi.

Në pajtueshmëri me këto risi të LPK-së, rrjedhë përfundimi se gjyqvarësia ekziston në momentin kur të paditurit i është dorëzuar padia e cila i është bashkangjitur aktvendimit për përgjigjeje në padi. Prandaj, ekzistimi i gjyqvarësisë vlerësohet nga dita e dorëzimit të aktvendimit për përgjigjeje në padi, e jo nga dita kur ka kaluar afati i të paditurit për dhënien e përgjigjes në padi apo nga arritja e përgjigjes në padi në gjykatë.

Në qoftë se, paditësi ka paraqit kërkesë tjetër në padi gjatë rrjedhës së procedurës kontestimore lidhur me një çështje kontestuese, ekzistimi i gjyqvarësisë vlerësohet nga momenti kur i paditurit është njoftuar lidhur me këtë kërkesë apo është lëshuar në shqyrtim.

Vlerësimi i drejtë i ekzistimit të gjyqvarësisë është me rëndësi sepse prej momentit kur të paditurit i dorëzohet padia, ndërmjet palëve të njejtja ndërgjyqësore nuk mund të paraqitet padi tjetër për të njëjtën çështje kontestimore edhe atëherë kur palët i ndërrojnë pozitat e tyre ndërgjyqësore, për të cilën gjykata është e detyruar që të kujdeset kryesisht. Kur gjykata vlerëson se ekziston gjyqvarësia, atëherë në pajtim me dispozitat e nenit 391 gjatë shqyrtimit paraprak të padisë me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme. Një gjë e tillë është parapa me dispozitat e nenit 262 al.3 të LPK-së.

Në qoftë se, gjykata nuk e vlerëson gjyqvarësinë në pajtim me dispozitat e cituara dhe vendos lidhur me kërkesëpadinë e paditësit, atëherë bën shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 al.2 pika 1) të LPK-së, ku vendimi gjyqësor i gjykatës së shkallës së parë në procedurë ankimore në pajtim me dispozitat e nenit 198 me aktvendim do të prishet dhe padia e paditësit do të hedhet poshtë si e palejueshme.

Pas fillimit të rrjedhës së procedurës kontestimore, paditësi nuk mund ta bëjë ndryshimin e padisë pa pëlqimin e të paditurit, ndërsa tërheqjen e padisë pa pëlqimin e të paditurit mund ta bëjë deri në momentin në të cilin i padituri i paraqet në gjykatë përgjigjen në padi. Paditësi mund ta tërheq padinë edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në çoftë se i padituri e jep pëlqimin. Po që se i padituri në afat prej 7 dite nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet, do të konsiderohet se ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë. Padia e tërhequr konsiderohet se nuk është paraqitur asnjëherë dhe mund të paraqitet në gjykatë përsëri. Lidhur me të mund të përfundojmë se në qoftë se paditësi ka bërë tërheqjen e padisë dhe më vonë paraqet padi kundër të paditurit të njëjtë dhe për të njëjtën çështje kontestimore, konsiderohet se gjyqvarësia nuk ekziston dhe në këtë situatë juridike gjykata do të gjykoj meritorisht.

6.4 Bashkëndërgjyqësia

Padia mund të paraqitet nga shumë paditës dhe kundër shumë të paditurve. Kur padia paraqitet nga shumë paditës themi se ekziston bashkëndërgjyqësia subjektive, aktive, ndërsa kur padia është paraqitur kundër shumë të paditurve themi se ekziston bashkëndërgjyqësia subjektive, pasive.

Bashkëndërgjyqësia në kuptimin objektiv- materiale ekziston atëherë kur të drejtat apo detyrimet e palëve ndërgjyqësore rrjedhin nga e njëjta bazë faktike apo juridike. P.sh. në qoftë se, një person përjeton lëndime trupore në aksident trafiku dhe si rrjedhojë e lëndimeve trupore i dëmtuari ka përjetuar dhimbje fizike, frikë, shëmtim etj, në këtë situatë i dëmtuari me një padi ka të drejtë që ti përfshijë shumë kërkesa duke kërkuar shpërblimin e dëmit për të gjitha format e dëmit të shkaktuar jo material që u theksuan më lart në pajtim me dispozitat e nenit 200 të LMD-së.

Kur në një çështje kontestuese ekzistojnë shumë paditës dhe shumë të paditur në këtë situatë ekziston bashkëndërgjyqësia e shumanshme.

Bashkëndërgjyqësia e paraparë me dispozitat e nenit 264 al 1 pika b) është bashkëndërgjyqësi formale. Ekzistimi i kësaj bashkëndërgjyqësie kushtëzohet nga shkak i ekonomizimit të procedurës, p.sh. paditësi nga i padituri i parë mbi bazën e kontratës së shitblerjes e ka blerë një paluajtshmëri të caktuar dhe të identifikuar me të gjitha të dhënat gjeodezike. Gjithashtu, në bazë të një kontrate tjetër ka blerë një paluajtshmëri nga i padituri i dytë. Në këtë situatë paditësi me një padi mund ti paditë të dy shitësit-të paditurit për të cilin gjykata do ti gjykon me aktgjykim të përbashkët.

Paditësi me padi mund të përfshijë dy ose më shumë të paditur dhe të kërkoj që kërkesëpadia të miratohet ndaj të paditurit të dytë po që se refuzohet si e pabazuar ndaj të paditurit të parë në këtë rast ekziston ndërgjyqësia eventuale.

Debitori kryesor dhe dorëzani mund të paditen bashkërisht, në qoftë se kjo nuk është në kundërshtim me përmbajtjen e kontratës për dorëzaninë. Në këtë situatë kemi të bëjmë me bashkëndërgjyqësi solidarë. Në pajtim me dispozitat e nenit 1004 të LMD-së në rastin e bashkëndërgjyqësisë nga dorëzani mund të kërkohej përmbushja e detyrimit vetëm atëherë kur debitori kryesor nuk e përmbush. Megjithatë, kur ekziston dorëzania solidarë, përmbushja e detyrimit munde të kërkohej qoftë nga debitori kryesorë ose nga dorëzani apo nga te dytë solidarisht në të njëjtën kohë. Në rast të ekzistimit të shumë dorëzanëve ata të gjithë përgjigjen solidarisht, përveç kur është caktuar ndryshe me dispozitat e nenit 1005 të LMD-së.

Në çoftë se sipas ligjit ose për shkak të natyrës së marrëdhënies juridike kontesti mund të zgjidhet vetëm në mënyrë të njëjtë ndaj të gjithë bashkëndërgjyqësve (bashkëndërgjyqësia unike)

atëherë ata të gjithë konsiderohen si një palë ndërgjyqëse e vetme, kështu që në rastin kur ndonjëri nga bashkëndërgjyqësit nuk e kryen ndonjë veprim procedural efektiv i veprimeve procedurale të kryera nga bashkëndërgjyqësi tjetër shtrihet dhe në ata që nuk i kanë kryer veprimet e veta.

Për dallim nga bashkëndërgjyqësia e thjeshtë-formale bashkëndërgjyqësit unik konsiderohen si një palë në procedurë ashtu që sikurse u tha më lartë veprimi procedural i njërit nga ata do të shfrytëzohet nga të gjithë të cilët nuk e kanë kryer veprimin e tillë. Në këtë kuptim kundërshtimi ose mjeti juridik i paraqitur nga njëri prej bashkëndërgjyqësve vepron edhe ndaj të tjerëve.

Palë aktive të bashkëndërgjyqësia unike mund të paraqiten p.sh. bashkëpronarët etj. Palë pasive të bashkëndërgjyqësia unike mund të paraqiten përsëri bashkëpronarët. Gjithashtu edhe në marrëdhëniet trashëgimore kontestuese si palë aktive mund të paraqiten të gjithë trashëgimtarët dhe palë pasive po ashtu trashëgimtarë.

6.5 Pjesëmarrja e personit të tretë në procedurën kontestimore

Ndërhyrësi është person i tretë i cili për shkak të interesit të tij juridik, gjykatës i paraqet propozim me shkrim – parashtrësë apo me gojë në seancë gjyqësore për pjesëmarrje në procedurën kontestimore e cila zhvillohet ndërmjet palëve ndërgjyqësore.

Ndërhyrësi vetëm e ndihmon palën paditëse apo të paditur, kurse ai nuk e ka cilësinë e palës e as bashkëndërgjyqësit. Personi i tretë në propozim do të paraqes arsye të cilat e arsyetojnë interesin e tij juridik për të marr pjesë në kontest.

Gjykata në pajtim me dispozitat e nenit 387 al.1 pika f) të LPK-së, me aktvendim vendos lidhur me propozimin e ndërhyrësit. Në qoftë se, propozimi është i bazuar atëherë gjykata ia pranon ndërhyrjen personit të tretë dhe ndërhyrësi e ndihmon palën për të cilën i është pranuar ndërhyrja duke i përkrahur veprimet e ndërmarra nga pala dhe duke ndërmarr veprime procedurale të veta të cilat do ta ndihmojnë palën që të ketë sukses në kontest por vetëm kur janë në pajtueshmëri me veprimet e palës.

Kundër aktvendimit me të cilin pranohet propozimi për ndërhyrje nuk lejohet ankesa. Ndërsa, kundër aktvendimit me të cilin refuzohet propozimi për ndërhyrje lejohet ankesa. Për deri sa të merr formën e prerë aktvendimi me të cilin i është refuzuar propozimi, gjykata ia lejon pjesëmarrjen personit të tretë në kontest.

Personi i tretë i cili ka interes të ketë cilësinë e ndërhyrësit mund të paraqes propozim për ndërhyrje gjatë tërë procedurës kontestimore dhe në procedurën sipas mjeteve të rregullta dhe jo të rregullta juridike.

Në kontestin e huaj, ndërhyrësi paraqitet në emër të vet për të mbrojtur interesin e vet juridik dhe me këtë dallohet nga përfaqësuesi apo i autorizuari i palës, sepse këta veprojnë në emër dhe interes të palës.

Llojet e ndërhyrësit konditat e ndryshme nën të cilat mund të ndërhyhet në gjykimin e huaj, si dhe pozita procedurale që mund ta ketë ndërhyrësi, shkaktojnë dallimin midis tri llojeve të ndërhyrësve:

Ndërhyrësit të zakonshëm,

Ndërhyrësi me pozitën, bashkëndërgjysit unik dhe avokati publik, prokurori publik dhe organit të kujdestarisë si ndërhyrës sui generis.

Ndërhyrësi i zakonshëm (invervenientë) është person i tretë i cili ndërhyrë në procesin kontestimor që është në zhvillim e sipër midis palëve të caktuara, duke iu bashkuar njëres nga ato me qëllim që ta ndihmojë dhe ta kontrollë mënyrën në të cilën ajo e ndjek çështjen në gjyq. Ndërhyrësi ka interes juridik që pala së cilës i bashkohet ta fitoj gjykimin. Pra, ndërhyrësi i zakonshëm është personi i tretë që nuk është as paditës as i paditur, por i bashkangjitet njëres nga palët me qëllim që njëres palë t'i ndihmoj në kontest.

6.5.1 Bashkëndërgjyqësit unik:

Personi i tretë që ndërhyr në gjykimin e huaj e fiton pozitën e ndërhyrësit të bashkëndërgjyqësit unik, në qoftë se aktgjykimi prodhon efekt juridik sikurse ndaj palës ashtu edhe ndaj ndërhyrësit.

6.5.2 Ndërhyrësi sui generis:

Me qëllim që gjykata të mos i miratoj veprimet disponibile të palëve që janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të detyrueshme dhe në moralin publik me ligj është paraparë e drejta e prokurorit publik që të ndërhyjë në proceset kontestimore në të cilat janë duke u zgjidhur kontestet e lindura nga raportet juridiko-civile me rëndësi të madhe shoqërore. Duke u bazuar në nenin 3 paragrafi 3 i LPK-së, prokurori i shtetit mund të ndërhyjë nëse konstaton veprimet e palës, të cilat palët nuk mujnë të disponojnë lirisht. Nga dispozita e nenit 67 të Ligjit për Familjen të Kosovës, prokurori i shtetit mund të ndërhyjë në procedurën për anulimin e martesës.

6.5.3 Ndërhyrja e organit të kujdestarisë:

Sipas nenit 342 të Ligjit për Familjen të Kosovës, organi i kujdestarisë ka të drejtë të marr pjesë në gjykimin në të cilin duhet të zgjidhet kontesti nga marrëdhënia familjare ndërmjet prindërve dhe fëmijëve të mitur.

6.5.4 Emërtimi i paraardhësit

Personi i cili është i paditur si posedues i një sendi apo shfrytëzues i ndonjë të drejte, nëse vërteton se sendin e posedon ose të drejtën e shfrytëzon në emër të personit të tretë mundet që në seancën përgatitore ose seancën për shqyrtim kryesor, nëpërmjet gjykatës ta thërras personin e tertë (paraardhësin juridik) që në vend të ti të hyj në kontest si palë e paditur.

Pëlqimi i paditësit, që në vend të palës së paditur të hyj paraardhësi - personi i tretë, nevojitet vetëm atëherë kur paditësi kundër të paditurit paraqet aso kërkesë e cila nuk varet nga ajo se i padituri sendin e posedon apo të drejtën e shfrytëzon në emër të paraardhësit.

6.5.5 Njoftimi i personit të tretë për procedurën kontestimore

Në qoftë se, paditësi apo i padituri e kanë të përbashkët çështjen me personin e tretë, ose kur nga çështja e cila është lëndë gjykimi rrjedhë ndonjë garanci apo shpërblim mund ta thirrin në gjykatë personin e tretë për të marrë pjesë në procedurën kontestimore.

Personi i tretë thirret me parashtrësën e palës e cila mund të paraqitet deri në përfundimin e procedurës në formë të prerë. Parashtrësja duhet të përmbajë arsye për shkakun e thirrjes së personit të tretë dhe njoftimin për rrjedhën e procedurës kontestimore.

6.6 Ushtrime

Gjatë këtij sesioni trajnues, pjesëmarrësve do të ju prezantohen raste praktike të cilët do të jenë në gjendje të kuptojnë dhe vlerësojnë ekzistimin e gjyqvarësisë dhe bashkëndërgjyqësisë në mënyrën sikurse paraqit më lart. Ushtrimet praktike do të bëhen në grupe ku pastaj çdo grup do të japë veç e veç komentet e veta.

Gjatë ushtrimeve lidhur me këtë sesion pjesëmarrësit do të njoftohen lidhur me një rast praktik të pjesëmarrjes së ndërhyrësit, paraardhësit dhe njoftimit të personit të terë në procedurën kontestimore. Ushtrimi do të organizohet në grupe dhe secili grup do ta zgjidhë detyrën konkrete në formë të shkruar. Puna e grupeve do të komentohet nga pjesëmarrësit

6.7 Përmbledhje

Në këtë sesion janë trajtuar çështjet teorike dhe praktike për vlerësimin e gjyqvarësisë dhe ekzistimin e bashkëndërgjyqësisë. Gjithashtu janë bërë përpjekje që pjesëmarrësve të ju ofrohen njohuri më praktike për të vepruar me shkathtësi profesionale lidhur me situatat kur ekziston gjyqëvarësia dhe bashkëndërgjyqësia qoftë ajo subjektive apo objektive.

Në këtë sesion trajnues janë shqyrtuar çështjet të cilat kanë të bëjnë me ndërhyrësin anësor, paraardhësin dhe njoftimin e personit të tretë në procedurë kontestimore. Pjesëmarrja e këtyre personave në procedurë kontestimore është me interes për palët dhe vet pjesëmarrësit e paraqitur në procedurë. Pjesëmarrësit në bazë të këtij shqyrtimi dhe përmes ushtrimeve praktike do të jenë në gjendje që në të ardhmen e tyre profesionale dhe punën e tyre praktike ti zgjidhin këto çështje drejtë dhe shpejt.

7. Sigurimi i kërkesëpadisë

7.1 Hyrje

Sigurimi i kërkesëpadisë është përcaktuar me kreun e XXI-të duke filluar nga neni 296 deri në nenin 318 të LPK-së. Sigurimi i kërkesëpadisë realizohet në procedura të veçanta të cialt janë në parim procedura të shpejta. Në procedura të tilla të sigurimit të kërkesave vendoset përkohësisht për ndërmarrjen për një apo disa masave. Këto masa e kanë karakterin e masave të përkohshme, të cilat vlejné në parim deri në realizimin faktik të kërkesave. LPK-ja e rregullon institutin e sigurimit të kërkesëpadisë, për dallim nga institutet tjera të procedurës civile, sipas legjislacionit aktual krijohet në procedurë kontestimore, me qëllim të realizimit të efektit të tij në procedurë tjetër e që është procedura përmbarimore.

Për vendosjen mbi propozimin për sigurim të kërkesëpadisë të paraqitur para se të jetë ngritur padia për fillimin e procedurës kontestimore si dhe gjatë procedurës së tillë është kompetente gjykata që vepron sipas padisë. Vendimi mbi masën e sigurimit e jep gjykata që vepron në shkallë të parë, kurse gjykata më e lartë atëherë kur propozimi për marrjen e saj është paraqitur pas dërgimit të dosjes së lëndës sipas ankesës në gjykatë. Pasi të jetë bërë i formës së prerë aktgjykimi mbi kërkesëpadinë, për propozimin e sigurimit vendos gjykata që do të ishte kompetente për vendosje mbi kërkesëpadi në shkallë të parë.

Shqyrtimet tona lidhur me masat e sigurimit të kërkesëpadisë do të jenë praktike dhe në vazhdim do të bëhet fjalë për fillimin e procedurës për caktimin e masës siguroese, llojet e masave siguroese, vendimi gjyqësor dhe ankesa kundër aktvendimit për masën siguroese.

7.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij prezantimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Fitojnë njohuri për fillimin e procedurës për caktimin e masave për sigurimin e kërkesëpadisë;
- Fitojnë njohuri për llojet e masave siguroese;
- Mësojnë për marrjen e vendimit gjyqësor-aktvendimit për marrjen e masës siguroese;
- Mësojnë për mjetet juridike kundër aktvendimit për marrjen e masës siguroese.

7.3 Sigurimi i kërkesëpadisë

Procedura për caktimin e masave për sigurimin e kërkesëpadisë fillon me paraqitjen e propozimit në formë të shkruar – parashtresë dhe në formë gojore gjatë rrjedhës së procedurës - në seancë gjyqësore.

Propozimi i paraqitur në formë të shkruar dhe gojore gjatë seancës gjyqësore duhet t'i përmbaj të gjitha elementet e parapara me dispozitat e nenit 304 al.3 të LPK-së.

Propozimi për sigurimin e kërkesëpadisë mund të paraqitet:

- para fillimit të procedurës kontestimore.
- gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore.

- gjatë procedurës ankimore – kur shkresat e lëndës i dërgohen gjykatës së shkallës së dytë.
- pas përfundimit të procedurës kontestimore deri sa të zbatohet përmbarimi.

Për të gjykuar lidhur me propozimin për sigurimin e kërkesëpadisë para fillimit të procedurës kontestimore dhe gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore është kompetente për të gjykuar, gjykata e shkallës së parë e cila gjykon lidhur me padinë.

Lidhur me propozimin për sigurimin e kërkesëpadisë gjykon gjykata më e lartë kur shkresat e lëndës i dërgohen për të vendosur lidhur me mjetin e rregullt juridik-ankesën. Ndërsa, për të vendosur lidhur me propozimin për caktimin e masës siguroese pas përfundimit të procedurës kontestimore deri sa të zbatohet përmbarimi gjykon gjykata e shkallës së parë e cila është kompetente që të gjykoj lidhur me kërkesëpadinë.

Në bazë të nenit 297 të LPK-së, rregullohen kushtet se kur mund të caktohen masat e sigurisë, kështu që masat e sigurisë mund të caktohen:

Në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij, dhe

Në qoftëse ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund të pamundësonte apo vështirsonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vetë, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

Po që se nuk është përcaktuar ndryshe me ligj gjykata e cakton masën e sigurimit vetëm nën kushtet që propozuesi i sigurimit, brenda afatit të caktuar nga gjykata, ashtu siç parashihet me Ligjin e Procedurës Përmbarimore, jep garanci në masën dhe llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t'i shkaktohet palës kundërshtare me caktimin dhe ekzekutimin e masës së sigurimit.

Po që se propozuesi nuk jep garanci Brenda afatit të caktuar gjykata refuzon propozimin për caktimin e masës së sigurimit. Me kërkesën e propozuesit gjykata mund ta lirojë atë nga detyrimi i dhënies së garancisë, po që se konstatohet se nuk ka mundësi financiare për një gjë të tillë.

Bashkësitë e pushtetit lokal janë të përjashtuara nga detyrimi për pagesën e garancionit.

Sipas Ligjit të Procedurës Kontestimore është paraparë përgjithësisht që masat siguroese mund të caktohen kur të përmbushen dy kritere apo prezumime:

Në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij, që nënkupton se para së gjithash propozuesi i sigurimit mund të dëshmojë këtë përmes ndonjë titulli juridik si, vendim të mëhershëm qoftë të gjykatës apo të ndonjë organi administrative, kontratë, testament apo të ndonjë mjeti tjetër ekzekutiv: Kriteri i dytë është atëherë kur ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund të gjendej në pozitën e atillë që do të pamundësohej apo vështirësohej dukshëm realizimi i kërkesës së propozuesit të sigurimit. Situata e tillë do të mund të krijohet sidomos kur ekziston rreziku që pala kundërshtare të bëjë tjetërsimin e pasurisë së vet, të fsheh atë, ta vë nën ngarkim qoftë në

peng apo hipotekë apo me ndonjë mënyrë tjetër. Të gjitha këto situara rrezikojnë që me ose pa qëllim të ndryshohet gjendja ekzistuese materiale e palës kundërshtare, dhe kështu në një mënyrë ose tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

Përveç këtyre dy kritereve të përcaktuara me nenin 297 par.1 pika a) dhe b) i LPK-së, është paraparë sigurimi i një detyrimi si kusht i cili duhet të realizohet para se gjykata të vendosë lidhur me masën e sigurimit, sipas këtij paragrafi nëse nuk është përcaktuar ndryshe me ligj, gjykata e cakton masën e sigurimit vetëm me kusht që propozuesi i sigurimit të jap një garanci për masën dhe llojin e sigurimit. Afatin brenda të cilit gjykata e cakton dhënien e garancisë është afat gjyqësor, sepse këtë e cakton gjykata varësisht nga rrethanat. Qëllimi i këtij garancioni është që edhe palës kundërshtare t'i garantohet për një siguri për ndonjë dëm eventual që mund t'i shkaktohen me caktimin dhe ekzekutimin e masës së sigurimit. Lidhur me mënyrën e dhënies së garancisë ligji referon tek dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Përmbarrimore, sipas këtij ligji në rastet në të cilat parashihet dhënia e garancionit, atëherë ajo jepet në para të gatshme. Gjkata mund ta lejoj dhënien e garancionit në formë të garancisë bankare, letra me vlerë si dhe sende të qmueshme, vlera e të cilave lehtë caktohet në treg dhe që mund të shëndrrohet shpejtë në të holla. Në garancionin e deponuar në këtë mënyrë, pala kundërshtare e fiton të drejtën e pengut ligjor.

Për sigurimin e kërkesës në të holla mund të caktohen këto masa të sigurimit:

- Ndalimi kundërshtarit të sigurimit që ta tjetërsojë, fshehë, ngarkojë ose disponojë me pasurinë e caktuar me vlerë të mjaftueshme për sigurimin e kërkesës së propozuesit të sigurimit. Ky ndalim do të regjistrohet në regjistrin publik përkatës;
- Ruajtja e pasurisë me të cilën ka të bëjë ndalimi nga pika e sipërme nga gjykata në depozitën e saj kur ka mundësi për një gjë të tillë, apo duke iu dhënë në posedim propozuesit të sigurimit apo personit të tretë;
- Ndalimi debitorit të kundërshtarit të sigurimit që këtij të fundit t'i përmbushet kërkesa apo dorëzohet sendi, si dhe ndalimi kundërshtarit të të sigurimit që ta pranojë sendin, ta realizojë kërkesën apo të disponojë me të;

Parashkrimi i së drejtës së pengut mbi sendin e paluajtshëm të kundërshtarit të sigurimit, apo mbi të drejtën e regjistruar në sendin e paluajtshëm, gjerë në vleftën e kërkesës kryesore, me kamata dhe shpenzime procedural, për të cilën është dhënë aktgjykimi i cili ende nuk është bërë i ekzekutueshëm.

Aktvendimi me të cilin caktohet masa e sigurimit i dërgohet kundërshtarit të sigurimit, debitorit të kundërshtarit të sigurimit, e kur është rasti edhe regjistrin publik përkatës.

Masa e sigurimit konsiderohet e zbatuar në momentin kur aktvendimi i dorëzohet kundërshtarit të sigurimit apo debitorit të tij, po që se i është dorëzuar këtij të fundit, apo regjistrin është më e hershme në pikëpamje kohore.

Në rajonet në të cilat nuk ekzistojnë librat publike, masat e sigurimit nga ky nen do të zbatohen duke u zbatuar rregullat procedurale adekuate të procedurës përmbarrimore.

Për sigurimin e kërkesës së drejtuar kah sendi i caktuar apo kah një pjesë e tij mund të caktohen këto masa sigurimi:

- Ndalimi kundërshtarit të sigurimit që ta tjetërsojë, fshehë, ngarkojë apo disponojë me pasurinë kah e cila është drejtuar kërkesa. Ky ndalim do të evidentohet në regjistrin publik përkatës;
- Ruajtja e pasurisë të cilës i përket ndalimi nga pika a) e këtij paragrafi dhe atë duke u depozituar në gjykatë, nëse kjo është e mundshme, apo duke iu dorëzuar në posedim propozuesit të sigurimit apo personit të tretë;
- Ndalimi kundërshtarit të sigurimit që të kryej veprime me të cilat mund të dëmtohet pjesa e pasurisë kah e cila është drejtuar kërkesa, apo urdhri kundërshtarit të sigurimit që t'i kryejë veprimet e caktuara të nevojshme për tu ruajtur pasuria apo për tu ruajtur gjendja ekzistuese e rrethanave;

Dispozitat e paragrafit 2 dhe 3 të nenit 299 të këtij ligji zbatohen edhe në rastin e sigurimit të kërkesës së drejtuar kah sendi i caktuar apo kah një pjesë e tij.

Masat e sigurimit nga ky nen nuk guxojnë në tërësi ta përfshijnë kërkesën që sigurohet me anë të tyre.

Ndalimi i kundërshtarit të sigurimit që ta tjetërsojë, fshehë, ngarkojë ose disponojë me pasurinë e caktuar me vlerë të mjaftueshme për sigurimin e kërkesës së propozuesit të sigurimit. Ky ndalim do të regjistrohet në regjistrin publik përkatës:

Ruajtja e pasurisë me të cilën ka të bëjë ndalimi nga pika e sipërme nga gjykata në depozitën e saj, ku ka mundësi për një gjë të tillë, apo duke iu dhënë në posedim propozuesit të sigurimit apo personit të tretë:

Ndalimi i debitorit të kundërshtarit të sigurimit që këtij të fundit t'i përmbushet kërkesa apo dorëzohet sendi, si dhe ndalimi kundërshtarit të sigurimit që ta pranojë sendin, ta realizojë kërkesën apo të disponojë me të:

Parashënimi i së drejtës së pengut mbi sendin e paluajtshëm, gjer në vleftën e kërkesës kryesore, me kamata dhe shpenzime procedurale për të cilën është dhënë aktgjykimi i cili ende nuk është bërë i ekzekutueshëm:

Aktvendimi me të cilin caktohet masa e sigurimit i dërgohet kundërshtarit të sigurimit, debitorit të kundërshtarit të sigurimit, e kur është rasti edhe regjistrin publik përkatës. Masa e sigurimit konsiderohet e zbatuar në momentin kur aktvendimi i dorëzohet kundërshtarit të sigurimit apo debitorit të tij, po që se i është dorëzuar këtij të fundit, apo regjistrin publik përkatës, m'varësisht nga ajo se cila nga këto tri data të dorëzimit është më e hershme në pikëpamje kohore;

Në rajonet në të cilat nuk ekzistojnë librat publike, masat e sigurimit nga ky nen do të zbatohen duke u zbatuar rregullat procedurale adekuate të procedurës përmbartimore.

Për sigurimin e kërkesës së drejtuar kah sendi i caktuar apo kah një pjesë e tij mund të caktohen këto masa të sigurimit:

Ndalimi i kundërshtarit të sigurimit që ta tjetërsoj, fsheh, ngarkoj apo disponoj me pasurinë e cila është drejtuar kërkesa. Ky ndalim do të evidentohet në regjistrin publik përkatës. Ruajtja e pasurisë të cilës i përket ndalimi dhe atë duke e depozituar në gjykatë, nëse kjo është e mundshme, apo duke iu dorëzuar në posedim propozimit të sigurimit apo personit të tretë. Ndalimi i kundërshtarit të sigurimit që të kryej veprime me të cilat mund të dëmtohet pjesa e pasurisë nga e cila është drejtuar kërkesa, apo urdhëri i kundërshtarit të sigurimit që të kryej veprimet e caktuara të nevojshme për tu ruajtur pasuria.

Propozimin për caktimin e masës së sigurimit gjykata, bashkë me provat tjera të cilat i janë bashkangjitur, ia dërgon kundërshtarit të sigurimit me njoftim se mund të paraqes përgjigjeje në afat prej 7 ditë nga dita e dorëzimit. Në të njëjtën mënyrë do të vepron kur propozimi është paraqit gojarisht në seancë kur kundërshtari i sigurimit nuk është i pranishëm në seancë përgatitore apo për shqyrtim kryesor. Në këtë situatë gjykata do t'ia dërgoj një kopje të procesverbalit kundërshtarit të sigurimit për të dhënë përgjigjeje në propozim brenda afatit të cekur më lartë.

Kur propozimi është paraqit në seancë në prani të kundërshtarit të sigurimit dhe ai lëshohet në shqyrtim, gjykata do ta mban seancën e shqyrtimit, e kur kundërshtari kërkon që seanca të shtyhet, atëherë gjykata e shtyn seancën dhe kundërshtarin e sigurimit e detyron që brenda afatit prej 3 dite të paraqes përgjigjeje në propozim dhe njëkohësisht e cakton seancën e shqyrtimit.

Përveç procedurës për caktimin e masës së sigurimit të kërkesëpadsisë, LPK-ja me dispozitat e nenit 306 ka parapa edhe mundësinë që gjykata në bazë të propozimit të propozuesit për caktimin e masës së sigurimit të kërkesëpadsisë të propozoi edhe caktimin e masës së përkohshme të sigurimit pa njoftim dhe dëgjim paraprak të kundërshtarit të sigurimit, po qe se propozuesi i sigurimit i bënë të besueshme faktet e propozuara me propozim se siguri është i bazuar dhe urgjente dhe se me veprim të kundërt do të humb qëllimi i masës së sigurimit. Vendimin lidhur me këtë masë të sigurimit të përkohshëm gjykata ia dërgon kundërshtarit të sigurimit menjëherë.

Kundërshtari i sigurimit brenda afatit prej 3 ditësh mund të paraqes përgjigjen e tij me të cilën i kundërshton shkaqet për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit dhe pas kësaj gjykata duhet të caktoj seancë në tri ditët e ardhshme. Përgjigja e kundërshtarit të sigurimit duhet të përmbaj pjesën arsyetuese.

Pas mbajtjes së seancës gjykata me aktvendim të veçantë e shfuqizon aktvendimin me të cilin e ka caktuar masën e përkohshme ose e zëvendëson me një tjetër aktvendim për caktimin e masës së sigurimit në pajtim me dispozitat e nenit 307 të LPK-së.

Kundër aktvendimit të ri për caktimin e masës së sigurimit lejohet ankesa. Kur jemi të lejueshmëria e ankesës kundër aktvendimit për masën siguroese edhe dispozita e nenit 310 al.1 e LPK-së e lejon ankesën në afat prej 7 dite nga dorëzimi i aktvendimit, ndërsa al.5 e të njëjtit nen është parapa se kundër aktvendimit për masën e përkohshme nuk lejohet ankesa.

Ne mendojmë se dispozitat e nenit 306 al.3, nenit 310 al.1 dhe 5 janë kundërthënëse. Me këtë rast ne mund të konstatojmë se al.5 e nenit të cituar ndoshta ka të bëjë me jo lejueshmërinë e ankimit kundër aktvendimit për caktimin e masës të sigurimit nga gjykata e lartë kur i dërgohen shkresat e lëndës për të vendos lidhur me ankesën kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë sepse një gjë e tillë nuk është rregulluar me ligj në ndonjë vend tjetër.

Me dispozitat e nenit 299 të LPK-së janë parapa kushtet për caktimin e masës siguroese në kërkesa në të holla, ndërsa me dispozitat e nenit 300 në send dhe nenin 301 në të drejta tjera.

7.4 Ushtrimi

Gjatë këtij sesioni pjesëmarrësit do të ndahen në grupe punuese dhe at njëri grup do të përpiloj një propozim për caktimin e masës për sigurimin e kërkesëpadisë në pasuri të paluajtshme, ndërsa tjetri grup do të përpiloj një propozim për caktimin e masës së përkohshme për sigurim të kërkesëpadisë. Gjithashtu, të gjithë pjesëmarrësit bashkërisht me trajnuesin do ta përpilojnë një aktvendim për caktimin e masës për sigurimin e kërkesëpadisë.

7.5 Përmbledhje

Në këtë sesion pjesëmarrësit janë trajnuar për zbatimin praktik të dispozitave të LPK-së gjatë procedurës së caktimit të masës për sigurimin e kërkesëpadisë. Posaçërisht i është kushtuar kujdes përmbajtjes së propozimit për caktimin e masës për sigurimin e kërkesëpadisë dhe vendimin gjyqësor.

8. Ndërprerja dhe pushimi i procedurës kontestimore

8.1 Hyrje

Ligji i Procedurës Kontestimore në kreun e XVIII-të me dispozitat e neneve 277 deri në 282 i ka përcaktuar saktë rregullat procedurale lidhur me ndërprerjen dhe pushimin e procedurës kontestimore, meqë ekzistojnë situata në të cilat veprimtaria procedurale domosdo duhet të ndalet edhe pse ende nuk janë krijuar kushtet për vendosje të çështjes kryesore që është qëllimi kryesor i çdo procesi kontestimor. Rastet e tilla të krijuara, me vullnetin e subjekteve kryesor, por edhe pa vullnetin e tyre, e vonojnë dhënien e vendimit të çështjes kryesore. Rrethanat që shkaktojnë, zakonisht vetëm ndaljen e përkohshme të aktivitetit procedural.

Rrjedha e shpejt dhe e drejtë e procedurës është synim i palëve dhe i gjykatës edhe pse i padituri shpeshherë në praktik me veprimet e ti e pengon rrjedhën e shpejt të procedurës.

Në disa situata konkrete, rrjedha e shpejt e procedurës kontestimore përballet me pengesa ligjore ose shkaqe tjera të cilat për një kohë të caktuar e pengojnë rrjedhën e procesit kontestimor, me arsyetim se janë plotësuar kushtet ligjore për ndërprerje apo pushimin e procedurës, për deri sa të pushojnë së ekzistuari shkaqet të cilat i kanë shkaktuar këto pengesa procedurale.

Shqyrtimi i këtyre çështjeve është parapa si nevojë për pjesëmarrësit, me arsyetim të përfitimit të njohurive profesionale dhe shkathtësive praktike për zbatimin e drejtë të dispozitave të LPK-së, i cili lidhur me këto institucione procedurale ka sjellë risi.

8.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij moduli, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Familjarizohen me situatat konkrete për ndërprerjen e procedurës;
- Fitojnë aftësi për marrjen e aktvendimit për ndërprerjen e procedurës;
- Fitojnë aftësi për marrjen e aktvendimit për pushimin e procedurës;
- Njohin pasojat juridike të shkaktuara nga ndërprerja dhe pushimi i procedurës.

8.3 Ndërprerja e procedurës-gjykimit

Ndërprerja e gjykimit nënkupton ndaljen e përkohshme të veprimeve procedurale në një çështje juridiko-civile për shkak të rrethanave që pengojnë vazhdimin e shqyrtimit dhe zgjidhjen e çështjes. Nga kjo rezulton se ndërprerja nuk është shtyrje e gjykimit për një ditë tjetër, por ndalja e zhvillimit të tij për një kohë të pacaktuar. Që do të thotë se në rastet të cilat procesi gjyqësor duhet të ndalet përkohësisht për shkak të pamundësisë faktike të njërës nga subjektet kryesor që të kryej aktivitetin procedural.

Gjykata e bënë ndërprerjen e procedurës: kur vdes pala ndërgjyëse apo e humb aftësinë e veprimtari e nuk ka përfaqësues me prokurë në gjykim. Me dispozitat e nenit 95 al.1 të LPK-së është parapa se me vdekjen e personit fizik, gjegjësisht me shuarjen e personit juridik shuhet edhe prokura të cilën ai e ka dhënë. Kjo dispozitë është kundërthënëse me dispozitën e nenit 277 al.1 pika a) të LPK-së. Në qoftë se, zbatohet dispozita e nenit 95 al.1 të LPK-së, atëherë procedura kontestimore ndërpritet menjëherë, sepse me vdekjen e personit fizik, gjegjësisht

shuarjen e personit juridik shuhet edhe prokura. Ndërsa, po që se zbatohet dispozita e nenit 277 al.1 pika a) e LPK-së, procedura kontestimore mund të ndërpritet vetëm nëse personi fizik i vdekur nuk ka caktuar me autorizim përfaqësues. Pra nëse pala e vdekur ka të autorizuar gjykata e vazhdon procedurën kontestimore, në qoftë se, trashëgimtarët nuk e kundërshtojnë paraqitjen e të autorizuarit.

Nëse plotësohen kushtet ligjore të parapara me dispozitat e nenit 277 të LPK-së, gjykata është e detyruar që me aktvendim ta bëjë ndërprerjen e procedurës kontestimore. Ndërprerja e procedurës bëhet sipas fuqisë së ligjit. Gjykata në këtë situatë me aktvendim vetëm e vërteton ndërprerjen e procedurës. Këtë aktvendim gjykatësi i çështjes ka autorizim që ta marr gjatë përgatitjes së seancës përgatitore në pajtim me dispozitat e nenit 378 al.1 pika e) e LPK-së e deri në seancën për shqyrtim kryesor. Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, e cila nuk e shtyn përmbarimin e aktvendimit.

Përveç rasteve të parapara me ligj, gjykata e cakton ndërprerjen e procedurës edhe kur ka vendosur që çështjen paraprake mos ta zgjidh vet (neni 13 i LPK-së) dhe po që se pala e cila ndodhet në zonën e cila për shkak të ngjarjeve të jashtëzakonshme (vërshimit, tërmetit) i bëhet i pamundësuar paraqitja në gjykatë.

Gjykata mund ta caktoj ndërprerjen e procedurës kontestimore në qoftë se vendimi gjyqësor lidhur me kërkesëpadinë e paditësit varet nga fakti i vërtetimit të deliktit ekonomik apo veprës penale e cila ndiqet kryesisht, e sidomos kur paraqitet dyshimi se dëshmitari ose ekspertit ka dhënë dëshmi përkatësisht ekspertizë të rrejshme apo dokumenti i përdorur si mjet provues është i rremë.

Procedura e ndërprerë vazhdohet nëse plotësohen kushtet ligjore të parapara me dispozitat e nenit 280 të LPK-së.

Pasojat procedurale të ndërprerjes së procedurës janë gjithmonë të njëjta, pa marr parasysh a është fjala për ndërprerjen e procedurës sipas fuqisë ligjore apo ndërprerje me vendim të gjykatës.

Si rezultat e ndërprerjes së gjykimit, afati për zhvillimin e veprimeve procedurale, poashtu ndërpritet. Gjatë kohës sa zgjat ndërprerja e gjykimit gjykata nuk mund të kryej kurfar veprimesh procedurale, por po që se ndërprerja është shkaktuar pas përfundimit të seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes gjykata mund të jap vendimin meritore në bazë të materialit procedural nga shqyrtimi i bërë. Veprimet procedurale të kryera nga njëra palë gjatë kohës sa zgjat ndërprerja e gjykimit nuk prodhojnë kurfar efekti juridik ndaj palës kundërshtare. Efekti i tyre fillon vetëm pasi të vazhdoj procesi gjyqësor i ndërprerë.

Vazhdimi i procedurës së ndërprerë, kur pushojnë shkaqet e ndërprerjes, procedura mund të vazhdoj. Për vazhdimin e procedurës së ndërprerë gjithmonë gjykata duhet të bie vendim për shkak se duhet fiksuar ditën nga e cila fillojnë të ecin afatin dhe të kryhen veprimet procedurale. Vendimi për vazhdimin e procedurës m'varsisht nga shkakut që e ka ndërprerë atë gjykata, mund të jepet sipas propozimit të palës ose sipas detyrës zyrtare. Kur pala propozon që procedura të vazhdohet, në parastresën për vazhdimin e procedurës pala ka për detyrë që t'i tregoj provat nga të cilat shihet se ka pushuar shkakut i ndërprerjes.

8.4 Pushimi i procedurës kontestimore

Pushimi i gjykimit bëhet në ato raste kur është përcaktuar me nenin 282 dhe atë kur vdes pala, apo kur mbaron së ekzistuari, po që se objekt kontesti janë të drejtat që nuk mund të kalojnë në

trashëgimtarët e palës, përkatësisht në pasardhësin juridik të saj. Me rastin e pushimit gjykata bjen aktvendim dhe të njëjtin ja procedon palës kundërshtare, trashëgimtarëve, përkatësisht pasardhësit juridik të palës, pasi të jetën caktuar ata. Trashëgimtarëve të palës së vdekur sipas propozimit të palës kundërshtare apo sipas detyrës zyrtare, gjykata ua cakton përfaqësuesin e përkohshëm të cilit ia dërgon aktvendimin mbi pushimin e gjykimit, po që se konstaton se procedura trashëgimore, mund të zgjas shumë kohë. Aktvendimi mbi pushimin e gjykimit i dhënë nga shkaku i mbarimit të personit juridik i dërgohet palës kundërshtare dhe pasardhësit juridik të personit juridik, po që se ky i fundit ekziston. Deri sa të bëhet i formës së prerë aktvendimi mbi pushimin e gjykimit, lidhur me afatet për kryerjen e veprimeve juridike, me të drejtat e palëve dhe veprimet e gjykatës në mënyrë adekuate zbatohen dispozitat mbi ndërprerjen e gjykimit.

Pushimi i procedurës shkaktohet kur vdes pala apo kur shuhet personi juridik, po që se çështja kontestuese e cila është lëndë gjykimi nuk mund të trashëgohet nga trashëgimtarët e personit fizik apo ati juridik.

Në qoftë se gjykata e pushon procedurën për këtë shkak atëherë aktvendimin për pushimin e procedurës me udhëzim për mjetin juridik ia dërgon palës kundërshtare apo trashëgimtarëve të palës pasi të jenë caktuar ata.

Trashëgimtarëve të palës së vdekur, me propozimin e palës kundërshtare apo kryesisht gjykata ua cakton përfaqësuesin e përkohshëm për dërgimin e aktvendimit për pushimin e procedurës, po që se konstaton se procedura trashëgimore do të zgjas shumë.

Aktvendimi për pushimin e procedurës nga shkaku i shuarjes së personit juridik i dërgohet palës kundërshtare dhe trashëgimtarit të personit juridik po që se ky i fundit ekziston.

8.5 Ushtrime

Gjatë këtij sesioni pjesëmarrësit do të kenë qasje praktike ku do të vlerësojnë situatat konkrete të cilat i arsyetojnë shkaqet për ndërprerjen dhe pushimin e procedurës kontestimore. Pastaj, pjesëmarrësve të organizuar në grupe do t'iu jepen detyra dhe secili grup veç e veç do ta bëjë zgjidhjen e detyrës duke i bërë të mundur bashkëbisedimin me trajnuesin.

8.6 Përmbledhje

Në këtë sesion janë shqyrtuar çështjet më të rëndësishme të cilat kanë të bëjnë me ndërprerjen dhe pushimin e procedurës në pajtim me risitë e LPK-së. Pjesëmarrësit në bazë të këtyre shqyrtimeve dhe punës praktike do të aftësohen për zbatim të mirëfilltë të LPK-së.

9. Mosrespektimi i gjykatës

9.1 Hyrje

Në kreun e XX-të LPK-së, janë sanksionuar dhe specifikuar lidhur me gjobat në rast të cilat janë theksuar në LPK. Në këtë kapitull janë rregulluar rastet të cilat në një mënyrë ose tjetër shprehin mosrespekt ndaj gjykatës. Përmes dispozitës së nenit 288 ka pasur për qëllim që palët në këtë proces të rezervohen jo vetëm nga qfarëdo veprimi i cili paraqet keqpërdorim të të drejtave, por edhe të evitojnë qfardo shprehje e cila do të përbënte fyerje për gjykatën dhe palët tjera në procedurë. Nga kjo dispozitë konkretisht është rregulluar situata kur gjykata mund të shqiptoj ndëshkimet me gjobë ndaj palëve të cilat gjatë zhvillimit të procedurës, keqpërdorin rëndë të drejtat që u janë njohur e dispozitat e LPK-së.

Respektimi i gjykatës nga palët dhe pjesëmarrësit tjerë në procedurë është një faktor i rëndësishëm për rrjedhën autoritare të procedurës, andaj për të kultivuar kulturë të tillë ligjdhënësi ka paraparë dënime me gjobë.

9.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij prezantimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Mësojnë për mbajtjen e rendit dhe qetësisë publike në seancën përgatitore dhe kryesore.
- Mësojnë për rastet kur gjykatësi i çështjes i shqipton masën e largimit nga seanca gjyqësore palës dhe pjesëmarrësit tjetër në procedurë.
- Mësojnë për shqiptimin e dënimit me gjobë palës apo pjesëmarrësit tjetër në procedurë.
- Fitojnë shkathtësi për marrjen e një aktvendimi me të cilin shqiptohet dënimi me gjobë.

9.3 Mosrespektimi i gjykatës

Në qoftë se gjatë rrjedhës së procedurës kontestimore duke filluar prej dërgimit të padisë të paditurit për të dhënë përgjigjen në padi e deri në marrjen e vendimit gjyqësor nga palët ndërgjyqësore dhe pjesëmarrësit tjerë në procedurë me veprimet e tyre i keqpërdorin rëndë të drejtat që i janë njohur me LPK-në, atëherë gjykata në pajtim me dispozitat e nenit 288, shqipton dënim me gjobë në shumë prej 500 €. Përveç kësaj në al. 2 të njëjtit nen është parapa edhe mundësia se gjykata nëse vlerëson se me veprimin e palës apo pjesëmarrësit tjetër në procedurë ndonjërit nga palët apo pjesëmarrësi tjetër në procedurë i është shkaktuar dëm i natyrës juridiko civile, atëherë me kërkesën e të dëmtuarit gjykata do të vendos për shpërblimin e dëmit bashkë me çështjen kontestimore.

Të gjitha dënimet e parapara me dispozitat e nenit të lartëcituar dhe ato të cilat janë parapa me dispozitat e nenit 289 deri në nenin 293 të LPK-së, gjykata i shqipton me aktvendim. Kundër aktvendimit i cili është marrë në pajtim me dispozitat e nenit 288, 289, 290 al.1, 292 al.1 dhe neni 293 al.1 të LPK-së është e lejuar ankesa e cila nuk e shtyn përmbarimin e aktvendimit. Dënimi i shqiptuar me gjobë nëse nuk përmbarohet atëherë si i tillë mund të zëvendësohet me dënim me burg ashtu siç është parapa me Kodin e Procedures Penale.

9.4 Ushtrim

Gjatë këtij cikli pjesëmarrësit do të marrin një aktvendim me të cilin ndonjë pjesëmarrësi në procedurë do të shqiptojnë dënim me gjobë.

9.5 Përmbledhje

Në këtë cikël pjesëmarrësit janë trajnuar për marrjen e masave të cilat kanë për qëllim mbajtjen e rendit dhe qetësisë publike si dhe situata kur dënimi i shqiptuar mund të zëvendësohet me burg.

Pjesëmarrësit gjatë këtij cikli do të përfitojnë aftësi praktike për mbajtjen e rendit dhe qetësisë publike gjatë rrjedhës së procedurës kontestimore në pajtim me risit e LPK-së.

10. Shpenzimet e procedurës kontestimore

10.1 Hyrje

Shpenzimet e procedurës kontestimore ndahen në shpenzime gjyqësore dhe procedural. Me rastin e inicimit të procedurës në gjykatë nga ana e palës paditëse me qëllim që ti mbrohet e drejta subjektive, apo kur pala kërkon mbrojtje nga pretendimet e kundërshtarit ka për detyrë që ta bëjë pagesën për shërbimet të cilat i jep gjykata. Pagesa për shërbimet gjyqësore bartet në buxhetin e shtetit dhe në kushtet e caktuara me ligj, pagesa bëhet duke marrë parasysh vlerën e objektit të kontestit që do të thotë shprehja në të holla e interesit pasuror të paditësit.

Rrjedha e procedurës kontestimore lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore është rregulluar me dispozitat e nenit 449 deri në nenin 473 të LPK-së.

10.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij prezantimi pjesëmarrësit do jenë në gjendje që të:

- Thellojnë njohurit për gjykimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore;
- Dallojnë se cilat nga shpenzimet e palëve ndërgjyqësore dhe pjesëmarrësit tjerë në procedurë i përbëjnë shpenzimet procedurale;
- Thellojnë njohurit se cilat shpenzime procedurale bien në barrë të palës që humb gjyqin dhe palës e cila i ka dhënë shkas shpenzimeve të shkaktuara;
- Përpilojnë aktvendim lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore.

10.3 Shpenzimet e procedurës kontestimore

Sipas definicionit ligjor shpenzimet e procedurës kontestimore konsiderohen të gjitha shpenzimet e shkaktuara gjatë ose lidhur me procedurën kontestimore. Shpenzimet e procedurës i përbënë edhe shpërblimi i avokatit dhe personave të tjerë i cili ka të drejtë në shpërblim.

Shpenzimet procedurale gjatë procedurës kontestimore janë: shpenzimet për taksa gjyqësore për padi apo parashtrësë, për marrjen e provës, shpërblimi për avokat, ekspert, përkthyes, shpenzimet për paraqitjen e palëve, të autorizuarve ose përfaqësuesve të palëve në gjykatë etj. Shpenzime të procedurës shkaktohen edhe para fillimit të procedurës kontestimore dhe at: shpenzimet e procedurës gjatë sigurimit të provave-paraprovës, shpenzimet e procedurës paraprake si kusht për paraqitjen e padisë, shpenzimet për tentimin e arritjes së pajtimit gjyqësor ose ndërmjetësimit etj.

Secila palë paraprakisht i bartë shpenzimet të cilat i ka shkaktuar me veprimet e veta. Paditësi në momentin e paraqitjes së padisë në gjykatë është i detyruar që ta paguaj taksën gjyqësore në lartësinë e vërtetuar nga gjykata. Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore brenda afatit të caktuar, atëherë padia e paditësit konsiderohet si e tërhequr. Paditësi është i detyruar që gjatë seancës ti paguan shpenzimet të cilat do të shkaktohen gjatë procedurës po që se është e nevojshme që në bazë të propozimit të tij të merret prova me ekspert gjyqësor etj. Gjatë procedurës i padituri po ashtu mund të detyrohet që ta bëjë pagimin e shpenzimeve për marrjen e provës së propozuar. Për të gjitha shpenzimet e shkaktuara gjatë procedurës kontestimore gjykata vendos me aktvendim. Shpenzimet e procedurës i kompenson pala e cila e ka humb kontestin. Me rastin e vlerësimit se cilat shpenzime do ti shpërblehen palës, gjykata do ti merr parasysh

vetëm ato shpenzime të cilat kanë qenë të nevojshme për gjykimin e drejtë dhe meritor të çështjes kontestuese.

Shpenzimet për shpërblimin e avokatit do të caktohen në bazë të tarifës për avokat të Odës së Avokatëve të Kosovës. Për pagimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore gjykata vendos vetëm në bazë të kërkesës së specifikuar të palës pa seancë të shqyrtimit. Pala është e detyruar që në kërkesën e saj ti specifikoi saktësisht shpenzimet dhe lidhur me lartësinë e tyre të paraqes prova nëse nuk gjenden në shkresa të lëndës. Pala kërkesën për kompensimin e shpenzimeve duhet ta paraqet më së voni deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor. Lidhur me kërkesën e palës për kompensimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendos me aktgjykim ose aktvendim me të cilin përfundon procedura kontestimore.

Gjatë zhvillimit të procedurës gjykata vendos me aktvendim të veçantë për pagimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore vetëm atëherë kur e drejta e shpërblimit nuk varet nga vendimi mbi çështjen kryesore. Vendimi për shpenzimet e procedurës i përmbajtur në aktgjykim ose aktvendim mund të goditet vetëm me ankesën kundër aktvendimit, po që se njëkohësisht nuk goditet edhe vendimi mbi çështjen kryesore. Po që se goditet aktgjykimi ose aktvendimi vetëm në pikëpamje të shpenzimeve procedurale gjykata do ta shqyrtoi vendimin gjyqësor vetëm lidhur me shpenzimet e procedurës. Kur njëra palë e ka goditur vendimin gjyqësor lidhur me çështjen kryesore, ndërsa tjetra vetëm për shpenzimet e procedurës, atëherë gjykata e shkallës së dytë do të gjykojë me një vendim të përbashkët.

10.4 Lirimi nga pagimi i shpenzimeve të procedurës kontestimore

Pala e cila vërteton faktin se është e varfër apo ushqehet nga personi i tretë, jeton me ndihma sociale dhe është në pamundësi që ti bartë shpenzimet e procedurës kontestimore pa e rrezikuar ekzistencën e saj ka mundësi që gjykatës ti paraqes kërkesë për lirim nga pagimi i shpenzimeve të procedurës kontestimore.

Vendimin për lirim nga pagimi i shpenzimeve të procedurës kontestimore gjykata e jep brenda afatit prej 7 ditë nga dita e paraqitjes së padisë. Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

10.5 Ushtrim

Gjatë këtij cikli mësimor pjesëmarrësit do të marrin një rast nga praktika dhe do ti vlerësojnë se cilat shpenzime do të llogariten në shpenzime procedurale. Përveç kësaj një grup i pjesëmarrësve do të hartojnë një kërkesë për kompensimin e shpenzimeve të specifikuar dhe një vendim gjyqësor bashkë me të cilin do ti gjykojnë edhe shpenzimet e procedurës kontestimore, ndërsa grupi tjetër do të hartojnë një aktvendim me të cilin pala do të lirohet nga pagimi i shpenzimeve të procedurës kontestimore.

10.6 Përmbledhje

Në këtë cikël mësimor pjesëmarrësit kanë shqyrtuar shpenzimet e procedurës kontestimore, përbërja e tyre. Pastaj pjesëmarrësit janë njoftuar me procedurën e paraqitjes së kërkesës për shpenzimet e procedurës kontestimore dhe vendimet gjyqësore.

IV – Procedura jokontestimore

Drita Rexhaj
Gjyqtare në Gjykatën Themelore – Prishtinë

Tabela e përmbajtjes – “Procedura jokontestimore”

Hyrje	216
Objektivat trajnuese	216
Metodat e të shpjeguarit	216
Pritjet nga pjesëmarrësit	216
Burimet dhe literatura	216
Përmbledhje	217
1. Dispozitat e përgjithshme të Ligjit të procedurës jokontestimore	218
1.1 Hyrje.....	218
1.2 Objektivat trajnuese	218
1.3 Dispozitat e përgjithshme të Ligjit të Procedurës Jokontestimore	218
1.3.1 Nocioni.....	218
1.3.2 Fillimi i procedurës jokontestimore.....	218
1.3.3 Pjesëmarrësit në procedurë.....	219
1.3.4 Personat që gëzojnë mbrojtje të posaçme.....	219
1.3.5 Kryerja e veprimeve nga personi pa zotësi procedurale	220
1.3.6 Parimi i Publicitetit.....	220
1.3.7 Tërheqja e propozimit	220
1.4. Kompetenca territoriale	220
1.5 Forma e vendimeve	221
1.6 Mjetet e rregullta juridike (Ankesa).....	222
1.7 Mjetet e jashtëzakonshme të goditjes.....	223
1.7.1 Revizioni	223
1.7.2 Përsëritja e procedurës.....	223
1.8 Faktet kontestuese lidhur me çështjen paraprake	223
1.8.1 Zgjidhja e çështjes paraprake	223
1.9 Shpenzimet e procedurës	224
1.10 Ushtrime.....	224
1.11 Përmbledhje.....	224
2. Shpallja e zhdukjes së një personi, Shpallja e vdekjes së një personi dhe Procedura e të provuarit të vdekjes	225
2.1 Hyrja	225
2.2 Objektivat trajnuese	225
2.3 Metodat e të shpjeguarit.....	225
2.4 Shpallja e zhdukjes së një personi	225
2.5 Shpallja e vdekjes së një personi	227
2.6 Procedura e të provuarit të vdekjes.....	230
2.7 Ushtrime	231
2.8 Përmbledhje.....	231
3. Caktimi i lartësisë së kompensimit për paluajtshmërinë e eksproprijuar, rregullimi i megjës (sinorëve) dhe ndarja fizike	232
3.1 Hyrje	232
3.2 Objektivat e trajnimit	232
3.3 Metodat e të shpjeguarit.....	232
3.4 Caktimi i lartësisë së kompensimit për paluajtshmërinë e eksproprijuar.....	232
3.5 Rregullimi i megjës (sinorëve).....	234

3.5.1 Procedura për rregullimin e megjës.....	234
3.6. Ndarja fizike - e sendeve	236
3.6.1 Ndarja e sendeve dhe palujtshmërive në bashkëpronësi	236
3.7 Ushtrime	237
3.8 Përmbledhje.....	237

Hyrje

Procedura Jokontestimore është procedurë specifike e paraparë me Ligjin e Procedurës Jokontestimore (LPJK). Procedura jokontestimore nuk është tërësi unike sepse përbëhet nga rregulla procedurale të diferencuara, me të cilat rregullohet dhënja e mbrojtjes juridike në qështjet e caktuara juridiko – civile, të cilat nuk zgjidhen sipas rregullave të procedurës kontestimore.

Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij moduli trajnues, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Identifikojnë se kush dhe me qka mund të inciohet procedura jokontestimore
- Zgjerojnë njohurit lidhur me personat që gëzojnë mbrojtje të posaçëme;
- Njohin përjashtimet në parimin e publicitetit;
- Zbatojnë parimin e disponibilitetit të palëve në procedurën jokontestimore;
- Njohin kompetencën territoriale;
- Dallojnë format e vendimeve;
- Zbërthejnë dhe njohin mjetet e rregullta dhe mjetet e jashtëzakonshme juridike;
- Identifikojnë dallimet dhe ngjashmëritë e procedurës kontestimore me procedurën jo kontestimore.

Metodat e të shpjeguarit

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metodat e shpjegimit, duke u bazuar në raste, duke përdorur shembuj konkret praktik (raste praktike të zgjedhura në Gjykatë). Kjo metodologji përdor ushtrime, diskutime. Materiali i këtij trajnimi do t'iu shpërndahet pjesëmarrësve, i cili material përmban komente, shënime, shembuj praktik mbi parimet dhe rregullat kryesore të Ligjit për Procedurën Jokontestimore (LPJK), në dispozitat që rregullojnë juridikisht temën e përmendur. Në këtë mënyrë secili nga pjesëmarrësit do të jetë aktiv gjatë gjithë kohës, duke marr pjesë në diskutime me pjesëmarrësit tjerë dhe me vetë prezantuesin pas çdo prezantimi dhe ushtrimi.

Pritjet nga pjesëmarrësit

Nga pjesëmarrësit pritët që të jenë aktiv gjatë gjithë kohës, të japin kontributin e tyre në diskutime ashtu që me pjesëmarrjen e tyre të ndihmojnë në arritjen e qëllimeve të këtij programi. Gjithashtu nga pjesëmarrësit pritët që të parashtrajnë pyetje, të ofrojnë zgjidhje dhe sugjerime gjatë gjithë kohës sa zgjatë programi.

Burimet dhe literatura

Pjesëmarrësit e programit mund të shfrytëzojnë si burime për të mësuar përveç materialit të prezantuar nga Ligjëruesi edhe nga:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës,

- Ligjin e Procedurës Jokontestimore,
- Ligji i Procedurës Kontestimore,
- Komentari i Ligjit të Procedurës Kontestimore,
- Deklarata e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut dhe protokollet e saj, etj.
- Prof. Dr. Faik Brestovci: E Drejta Procedurale Civile II. Prishtinë 1977.

Përmbledhje

Në këtë modul diskutimi qendror bëhet rreth qëllimit të modulit, objektivat trajnuese, metodat e të shpjeguarit, pritjet nga pjesëmarrësit si dhe për burimet nga të cilat mund të mësohet.

1. Dispozitat e përgjithshme të Ligjit të procedurës jokontestimore

1.1 Hyrje

Procedura Jokontestimore është procedurë specifike e paraparë me Ligjin e Procedurës Jokontestimore (LPJK), mirëpo me që për trajtimin e kësaj procedure koha është e kufizuar për trajnim, gjatë trajnimit do të synojë që pjesëmarrësit të njoftohen, me specifikat kryesore të kësaj procedure, strukturën e procedurës jokontestimore, pozitën dhe rolin e subjektëve në procedurë, aktivitetet procedurale të tyre si dhe raportet reciproke në mesë palëve.

1.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij moduli trajnuese, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Zbatojnë drejtë dispozitat e përgjithshme të ligjit të procedurës jokontestimore;
- Zgjerojnë njohurit lidhur me personat që gëzojnë mbrojtje të posaçëme;
- Njohin përjashtimet në parimin e publicitetit;
- Zbatojnë parimin e disponibilitetit të palëve në procedurën jokontestimore;
- Analizojnë kompetencën territoriale;
- Dallojnë format e vendimeve;
- Zbërthejnë dhe njohin mjetet e rregullta dhe mjetet e jashtëzakonshme juridike;
- Identifikojnë dallimet dhe ngjashmëritë e procedurës kontestimore me procedurën jokontestimore.

1.3 Dispozitat e përgjithshme të Ligjit të Procedurës Jokontestimore

1.3.1 Nocioni

Rregullat sipas të cilave Gjykatat veprojnë dhe vendosin mbi të drejtat dhe interesat personale, familjare dhe pasurore dhe që zgjidhen në procedurë civile jokontestimore janë të përmbledhura në dispozitat ligjore të Ligjit të Procedurës Jokontestimore të Republikës së Kosovës – Ligj nr. 03/L-007, datë 30.06.2008.

Dispozitat e Ligjit të Procedurës Jokontestimore, zbatohen edhe në çështje tjera juridike, për të cilat nuk është paraparë që të zgjidhen sipas rregullave të procedurës kontestimore.

Dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore, zbatohen përshtatshëmish në procedurën jokontestimore, po që se në LPJK-së, nuk janë paraparë ndryshe (neni 3 i LPJK – së).

1.3.2 Fillimi i procedurës jokontestimore

Procedura jokontestimore iniciohet me Propozim. Propozimin për iniciimin e procedurës jokontestimore mund të paraqitet nga:

- Personat fizik;
- Personat juridik;
- Organi shtetërorë sipas kushteve të parapara me këtë Ligj.

Procedurën jokontestimore mund ta iniciojë gjykata sipas detyrës zyrtare, vetëm për rastet dhe nën kushtet e përcaktuara me këtë Ligj apo me ndonjë ligj tjetër.

1.3.3 Pjesëmarrësit në procedurë

Pjesëmarrës në procedurë jokontestimore janë:

- Propozuesi – Personi, përkatësisht organi, me propozimin e të cilit iniciohet procedura.
- Kundër propozuesi – Kundërshtari i propozuesit, personi ndaj të cilit realizohet e drejta subjektive apo interesi juridik i propozuesit.
- Organi shtetëror – i cili merr pjesë në procedurë sipas autorizimeve që i ka dhënë ligji, edhe në rastet kur procedurën jokontestimore e ka iniciuar personi tjetër i autorizuar, i cili njoftohet nga Gjykata dhe vendos të marr pjesë në procedurë (Organi i Kujdestarisë, i cili vepron në kuadër të Qendrës për Punë Sociale, gjithmonë njoftohet nga Gjykata kur kemi të bëjmë me personat që gëzojnë mbrojtje të posaçme).

1.3.4 Personat që gëzojnë mbrojtje të posaçme

Me Ligjin e Procedurës Jokontestimore, personat që gëzojnë mbrojtje të posaçme dhe për të cilët Gjykata sipas detyrës zyrtare ndërmerr masa për mbrojtjen e të drejtave subjektive dhe interesave juridike janë:

- të miturit pa kujdes prindor. (psh. fëmijët e braktisur, fëmijët prindi ose prindërit e tij, ose ndonjë përkujdesës tjetër, për shkak të mënyrës së jetesës, paaftësisë ose sëmundjes fizike ose mendore, problemeve psiko-sociale, varësisë ose arsyeve të tjera, kanë vështirësi në ofrimin e nivelit adekuat të përkujdesjes dhe mbikëqyrjes për të).
- personat që nuk janë në gjendje të kujdesen vet për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre(personat me aftësi të kufizuara).

Kur procedura jokontestimore iniciohet lidhur me shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjeve të personave nën mbrojtje të posaçme, Gjykata menjëherë e njofton Organin e Kujdestarisë për procedurën e filluar, do ta njoftoi për pjesëmarrje në secilën seancë gjyqësore, do t'ia dërgojë të gjitha parashtrësit dhe vendimet kundër të cilave lejohet mjeti juridik i goditjes, pa marrë parasysh se a e ka iniciuar procedurën Organi i Kujdestarisë dhe a ka marr pjesë në procedurë edhe pasi është njoftuar nga Gjykata, për iniciimin e procedurës nga personi apo organi tjetër.

Në procedurën jokontestimore, Organi i Kujdestarisë edhe në rastet kur nuk ka të drejtë ta inicio procedurën jokontestimore, kur është në pyetje mbrojtja e të drejtave dhe interesave juridike të miturve dhe personave nën mbrojtje të posaçme, mund ti kryej të gjitha veprimet procedurale:

- të paraqes fakte relevante të cilat nuk i kanë paraqitur pjesëmarrësit tjerë në procedurës,
- të propozojë marrjen e provave dhe të paraqes mjetet e goditjes së aktvendimeve.

1.3.5 Kryerja e veprimeve nga personi pa zotësi procedurale

Personi i cili është në gjendje të kuptojë domethëniet e veprimeve dhe pasojat e atij veprimi, Gjykata mund të ia lejoj pjesëmarrjen në procedurë edhe kur nuk e ka zotësinë për të vepruar, e krejt kjo me qëllim të realizimit të drejtave dhe interesave që i takojnë. (psh. deklarata trashëgimore).

1.3.6 Parimi i Publicitetit

Është rregull që procedurat gjyqësore, duke përfshirë edhe procedurën jokontestimore të jenë PUBLIKE, mirëpo në procedurë jokontestimore ku vendoset lidhur me çështjet personale ose familjare përjashtohet publiku (psh. në rastet kur vendoset për heqjen dhe kthimin e zotësisë për të vepruar, vazhdimi dhe pushimi i të drejtës prindore, dhënia e lejes për lidhjen e martesës, vendosja edhe mbajtja e të sëmurit psikik në institucionin shëndetësor, adaptimi adoptimi, publiciteti nuk përjashtohet kur zhvillohet procedura për shpalljen për të vdekur ose për vdekjen e personit fizik. Përjashtimi i publikut në këto raste është në funksion të kërkesave që dalin nga Ligji për Familjen të Kosovës, sepse duhet ruajtur konfidencialiteti i informatave dhe të dhënave personale gjatë procedurës. psh. tek adaptimi adoptim, prania e publikut mund të zbuloi informatat që prekin çështjet private.

1.3.7 Tërheqja e propozimit

Propozimi me të cilin është inicuar procedura mundë të tërhiqet deri sa të jepet aktvendimi i shkallës së parë për zgjedhjen e çështjes Në rastet kur është marrë aktvendimi në shkallë të parë, tërheqja e propozimit mund të bëhet, vetëm nëse nuk cenohen të drejtat e pjesëmarrësve të tjerë në procedurë, në këtë raste gjykata gjithmonë kërkon pëlqimin për tërheqjen e propozimit pjesëmarrësve të tjerë në procedurë. Kur kërkohet tërheqja e propozimit në këtë fazë të procedurës, gjykata e shkallës së parë e prish aktvendimin dhe e përfundon procedurën.

Konsiderohet se propozuesi e ka tërhequr propozimin po që se nuk vjen në seancën e parë për të cilën është ftuar në mënyrë të rregullt, ndërsa mungesën nuk e ka arsyetuar verbalisht ose me shkrim. Kjo rregull përjashtohet në çoftë se ekzistojnë shkaqe të ditura botërisht e të cilat e kanë penguar propozuesin që të vijë në seancë. Përcaktimi i ligdhënësit për një zgjedhje të tillë, qëndron në faktin se procedura civile përshirë edhe procedurën jokontestimore, inicohet me vullnetin ekskluziv të palës propozuese, prandaj vazhdimi i procedurës pa pjesëmarrjen e propozuesit, nuk do të kishte kurrfarë kuptimi. Në interes të propozuesit është që të përfundojë procedura në afat sa me të shkurtër, andaj mungesa e propozuesit në seancën për të cilën ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt është tregues i mjaftueshëm se propozuesi e ka humb interesin për vazhdimin e mëtejshëm të çështjes, edhe njëherit tregon se propozuesi dëshiron që ta tërheq propozimin.

1.4. Kompetenca territoriale

Me LPJK-ë, është paraparë që kur vendoset lidhur me sendet e paluajtshme e kompetencës territoriale ekskluzive është gjykata në territorin e së cilit ndodhet palujtshmëria. Në rastet kur palujtshmëria shtrihet në territorin e disa gjykatave, atëherë kompetente është secila nga to. Në këto raste nuk mund të shpallet më vonë jokompetente.

Në rastet kur me Ligji është paraparë kompetenca ekskluzive, atëherë përjashtohet kompetenca e përgjithshme tokësore dhe asnjë gjykatë tjetër nuk ka të drejtë të gjykojë një çështje të tillë.

Arsye kryesore për caktimin e kompetencës tokësore është e natyrës praktike, sepse në këtë mënyrë sigurohet më së lehti dhe më së miri këqyrja në vend apo edhe marrja e provës në vend nga gjykata e çështjes. Në rastet kur është paraparë kompetenca tokësore ekskluzive e ndonjë gjykate, palët nuk mund të merren vesh për ndonjë kompetencë tokësore me marrëveshje.

Ndërsa, në procedurën në të cilën vendoset mbi çështjet personale dhe familjare e kompetencës territoriale është gjykata në territorin e të cilës e ka vendbanimin personi në interesin e të cilit zhvillohet procedura, nëse nuk ka vendbanim e kompetencës territoriale është gjykata e të cilës e ka vendqëndrimin po që se me ligj nuk është paraparë ndryshe. Në qeshje tjera jokontestimore e kompetencës territoriale për të gjykuar është gjykata në territorin e të cilës propozuesi e ka vendbanimin apo vendqëndrimin, respektivisht selinë, nëse me ligj nuk është parapara ndryshe.

Në parim gjykata në procedurë jokontestimore, sipas detyrës zyrtare mund të shpallet territorialisht jo kompetente, jo më vonë se në seancën e parë, apo jashtë seancës, në momentin e kryerjes së veprimit të parë procedurat nga pjesëmarrësi i procedurës i cili është ftuar nga gjykata. Gjukata mund të shpallet territorialisht jokompetente, në qoftë se gjatë zhvillimit të procedurës ndryshojnë rrethanat mbi të cilat është mbështetur kompetencën e gjykatës dhe mund t'ia dërgojë lëndën gjykatës e cila sipas rrethanave të ndryshuara është bërë e kompetencës territoriale, po që se duket qartë se para kësaj gjykate procedura do të zhvillohet më lehtë, ose kur kjo shkon në interes të personave nën mbrojtje të veçantë.

Kur duhet shpallur jo kompetente territoriale e që kemi të bëjmë në interesat e personave nën mbrojtje të veçantë, gjykata e cila e ka filluar procedurën paraprakisht do ta ftojë Organin e Kujdestarisë që brenda afatit të caktuar të jep mendimin për arsyeshmërinë e dërgimit. Nëse Organi i Kujdestarisë brenda afatit që i është caktuar nga gjykata nuk e dërgon mendimin e vet, gjykata do të veprojë sipas rrethanave të rastit, gjithmonë duke pasur kujdes për interesat ineresin më të mirë të e-personit nën mbrojtje të veçanta. (p.sh. ndaj një të moshuari QPS-ë në Ferizaj, ka iniciuar procedurën në Gjykatën Themelore në Ferizaj, për heqjen e pjesshme të zotësisë për të vepruar, për faktin se i njëjti e ka pas vendbanimin në Ferizaj, mirëpo ndërkohë pasi është përpiluar anamneza dhe është mbajtur një seancë kundërpropozuesi- personi ndaj të cilit kërkohet heqja e pjesshme e zotësisë për të vepruar është vendosur në Shtëpinë e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Prishtinë.

Gjukata në këtë rast shpallet jokompetente territoriale dhe lëndën i dërgon në vendosje Gjykatës Themelore në Prishtinë, sepse interesi i të moshuarit, personit nën mbrojtje të veçantë është që të zhvillohet procedura në gjykatën me të afërt dhe më të arritshme për te.

Në rastet kur gjykata gjatë zhvillimit të procedurës jokontestimore vlerëson se procedura duhet zhvillohet sipas rregullave të procedurës kontestimore, atëherë me aktvendim e pezullon procedurën jokontestimore dhe pasi aktvendimi të marr formë të prerë, procedura e mëtejme vazhdon sipas rregullave të procedurës kontestimore në gjykatën kompetente.

1.5 Forma e vendimeve

Sipas LPJK-ë, në procedurë jokontestimore vendimet merren në formë të AKTVENDIMIT.

Në procedurën jokontestimore merren dy lloje të Aktvendimeve:

- Aktvendimet kur vendoset në mënyrë meritore i cili duhet të përmbaj: hyrjen, dispozitivin, arsyetimin dhe këshillën juridike, ndaj të cilëve pjesëmarrësi në procedurë

mund të bëjë ankim të veçantë (psh. Aktvendimi mbi rregullimin e megjës, aktvendimi mbi heqjen apo kthimin e kujdesit prindor etj).

- Aktvendimet procedurale siç janë: aktvendimi mbi pezullimin e procedurës, mbi caktimin e seancës etj.

1.6 Mjetet e rregullta juridike (Ankesa)

E Drejta e ankimit është e drejtë fundamentale e njeriut dhe njëherit kategori kushtetuese e paraparë me nenin 6 të KEDNJ dhe nenit 32, 54 dhe 102 par. 5 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës. Me këtë mjet juridik synohet mbrojtja efektive e të drejtave të njeriut, me që ekziston mundësia që vendimi i gjykatës të jetë i gabuar për shkaqe të ndryshme.

Në kuptim të LPJK-ë, mjet i rregullt juridik është ANKESA kundër aktvendimit të shkallës së parë.

Ankesa në parim mund të ushtrohet brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e dorëzimit të aktvendimit, po që se me Ligj nuk është paraparë ndryshe, LPJK-ë, parasheh rastet kur afati për paraqitjen e ankesës është më i shkurtër se 15 ditë. Këtë e përcakton shprehimisht dispozita e nenit 46 e të LPJK-ë. Sipas nenit 46 të LPJK-së. Kundër aktvendimit me të cilin hiqet ose kthehet zotësia për të vepruar kanë të drejtë ankimi personat që kanë marrë pjesë në procedurë brenda 3 ditësh, nga dita në të cilën iu është dorëzuar aktvendimi. Është paraparë shprehimisht me ligj, rasti kur afati i paraqitjes së ankesës është më i shkurtër se 15 ditë.

Ankesa duhet të përmbajë:

- Aktvendimin kundër të cilit paraqitet ankimi;
- Deklaratën se aktvendimi kundërshtohet në tërësi apo në pjesë të caktuara;
- Shkaqet e ankimit me arsyetim;
- Nënshkrimi i paraqitësit të ankesës.

Ankesa është mjet i rregullt i goditjes së aktvendimit dhe si i tillë ka efekt suspensiv (shtyrës). Paraqitja e ankesës shtynë ekzekutimin e aktvendimit dhe njëherit ndalon që aktvendimi të bëhet i formës së prerë.

Në procedurë kontestimore ankesa gjithmonë ka veprim devolotiv (vendos gjykata më e lartë), për derisa në procedurë jokontestimore, konform dispozitës së nenit 20 të LPJ-ë, Gjykata e shkallës së parë lidhur me ankesën e paraqitur me kohë mund të ndryshojë apo ta prishë aktvendimin e goditur. Këtë gjykata mund ta bëjë vetëm po që se ankesa është e bazuar dhe vetëm kur me një gjë të tillë nuk cenohen të drejtat e pjesëmarrësve të tjerë të përmbajtura në aktvendimin e goditur.

Në çoftë se gjykata e shkallës së parë nuk e ndryshon apo prish aktvendimin e saj të goditur me ankim, atëherë ankesën bashkë me dosjen e lëndës, ia dërgon gjykatës së shkallës së dytë për vendosje pa marrë parasysh ankimi a është bërë brenda afatit ligjor apo pas skadimit të tij. Me ç'rast gjykata e shkallës së dytë, mund ta aprovojë ankesën e jashtë afatshme, po që se në një gjë të tillë nuk cenohen të drejtat e pjesëmarrësve të bërë në procedurë të bazuar në aktvendimin e goditur.

1.7 Mjetet e jashtëzakonshme të goditjes

1.7.1 Revizioni

Në sistemin tonë juridik revizioni konsiderohet si mjet i jashtëzakonshëm juridik, për shkak se paraqitja e këtij mjeti kufizohet në shumë aspekte dhe se ky mjet mund të paraqitet kundër vendimeve të shkallës së dytë, vendime të cilat janë të formës së prerë. Revizioni konsiderohet si mjet i jashtëzakonshëm juridik edhe për shkak të faktit sepse ky mjet nuk ka efekt pezullues dhe se paraqitjen e tij nuk e pengon përmbartimin e vendimit. Revizioni mund të paraqitet vetëm kundër aktvendimit të shkallës së dytë, me të cilin është vendosur lidhur me ankesën e paraqitur kundër aktvendimit të shkallës së parë, që do të thotë se parakusht elementar është paraqitja e ankesës kundër aktvendimit të shkallës së parë, pra vetëm kundër këtij aktvendimi që është vendosur lidhur me ankesën mund të paraqitet revizioni.

Në procedurën jokontestimore (neni 27 i LPJK-ë) lejohet paraqitja e revizionit kur vendoset kompensimin për palujtshmërinë e eksproprijuar, Në procedurën jokontestimore Revizioni lejohet në kushtet e parapara me nenin 211 deri te neni 231 të LPK-ë.

1.7.2 Përsëritja e procedurës

Për tu ruajtur siguria juridike e cila është kusht elementar për punët juridike, vendimi i formës së prerë në parim është i pacenueshëm. Parime të cilat janë të mbrojtura në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Për kundër këtij fakti Ligji parashih mundësinë që edhe një vendim i formës së prerë të goditet me mjet të jashtëzakonshëm juridik, propozim për përsëritje të procedurës i cili lejohet vetëm për rrethanat veçanërisht të caktuara të shkeljeve të rënda të dispozitave procedurale dhe si pasojë e këtyre shkeljeve është nxjerrë vendim jo i drejtë.

Sipas LPJK-ë (neni 28) kundër aktvendimit meritor të formës së prerë nuk mund të paraqitet propozim për përsëritjen e procedurës, po që se pjesëmarrësit të procedurës jokontestimore me këtë ligj apo me ndonjë ligj tjetër i është njohur e drejta që kërkesën e tij për të cilën është vendosur me aktvendim të realizojë në procedurë kontestimore apo në procesin para organit administrativ. Në qoftë se janë plotësuar kushtet e nenit 20 të LPJK-ë, gjykata do të veprojë sipas propozimit për përsëritjen e procedurës sikur të ishte fjala për ankesën e paraqitur pas skadimit të afatit ligjor për ankim. Ndërsa, po qese gjykata e shkallës së dytë konstaton se nuk janë plotësuar kushtet e parapara nenin 20 të LPJK-ë, atëherë lëndën e kthen gjykatës se shkallës së parë për veprim të mëtejme sipas propozimit për përsëritje të procedurës. Pajtimi gjyqësor nuk mund të goditet me propozim për përsëritje të procedurës, për shkak se pajtimi gjyqësor nuk është vendim i gjykatës, por është veprim disponibil i palëve. Pajtimi gjyqësor konform dispozitës së nenit 418 të LPK-ë, mund të goditet me padi për anulimin e pajtimit gjyqësor.

1.8 Faktet kontestuese lidhur me çështjen paraprake

1.8.1 Zgjidhja e çështjes paraprake

Në Ligjin e Procedurës Jokontestimore në nenin 22 shprehimisht është e paraparë se në qoftë se ndërmjet pjesëmarrësve të procedurës jokontestimore janë kontestuese faktit lidhur me zgjidhjen e çështjes paraprake, Gjukata do ti udhëzojë që brenda afatit të caktuar ta iniciojë procedurën

kontestimore apo procesin para organit administrativ, me qëllim të zgjidhjes me të drejtë apo marrëdhënies kontestuese.

Gjykata e udhëzon për ngritje të padisë në procedurën kontestimore, respektivisht për ta iniciuar procedurën para organit administrativ atë pjesëmarrës të drejtën e të cilit e konsideron më pak të besueshme, po qese me Ligj nuk është paraparë ndryshe. Nëse procedura kontestimore, respektivisht procedura administrative është iniciuar me kohë (në afat jo me te gjatë se 30 ditë) nga pjesëmarrësi i procedurës jokontestimore. Gjykata jokontestimore e ndërpret procedurën deri sa procedura të përfundojë me vendim të plotfuqishëm mbi zgjedhjen e çështjes paraprake në procedurë kontestimore, respektivisht administrative.

Procedura kontestimore, respektivisht administrative me qëllim të zgjidhjes së çështjes paraprake, mund ta iniciojë edhe pjesëmarrësi i procedurës jokontestimore të cilin gjykata nuk e ka udhëzuar për një gjë të tillë. Në qoftë se asnjëri nga pjesëmarrësit në procedurë jokontestimore nuk e iniciojnë procedurën kontestimore apo atë administrative deri në përfundimin e procedurës jokontestimore, Gjykata do ta përfundojë procedurën pa i marrë në konsideratë kërkesat lidhur me të cilat pjesëmarrësi i procedurës jokontestimore është udhëzuar që ta iniciojë procedurën kontestimore respektivisht administrative.

1.9 Shpenzimet e procedurës

Shpenzimet procedurale përbëhen nga hargjimet e bëra gjatë dhe lidhur me procesin gjyqësor dhe shpenzimet procedurale që përfshijnë edhe shpërblimet për punën e avokatit e të personave tjerë të cilave ligji ju jep të drejtën e shpërblimit (shpenzimet për dëshmitarë, ekspert etj).

Në procedurën jokontestimore kur vendoset për çështjet që kanë të bëjnë me gjendjen personale ose familjare të pjesëmarrësit, për shpenzimet procedurale gjykata vendose sipas vlerësimit të lirë duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit dhe rezultatin e procedurës.

Në çështjet juridike që kanë të bëjnë me të drejtat pasurore të pjesëmarrësve, shpenzimet procedurale u mbeten në pjesë të barabarta pjesëmarrësve. Gjykata mund të vendos që shpenzimet procedurale të paguaj personi në interes të së cilit nuk vendos, respektivisht pjesëmarrësi që ekskluzivisht me sjelljet e tij i ka dhënë shkas fillimit të procedurës.

1.10 Ushtrime

Gjatë këtij moduli pjesëmarrësve ju ofrohen shembuj – detyra praktike, të cilët pas punës në grupe do të japin prezantime lidhur me punën e bërë, ndërsa diskutimet do të fokusohen në veprimet procedurale, propozime dhe aktvendime.

1.11 Përmbledhje

Në këtë modul trajnuet pjesëmarrësit do të kenë mundësin që të njoftohen, me specifikat kryesore të procedurës jokontestimore, me dallimet dhe ngjashmëritë e procedurës kontestimore me procedurën jo kontestimore, strukturën e procedurës jokontestimore, pozitën dhe rolin e subjekteve në procedurë, aktivitetet procedurale të tyre si dhe raportet reciproke në mesë palëve.

2. Shpallja e zhdukjes së një personi, Shpallja e vdekjes së një personi dhe Procedura e të provuarit të vdekjes

2.1 Hyrja

Vdekja dhe lindja e një personi janë procese të natyrës, por me të njëjtën kohë janë edhe fakte juridike. Me lindje krijohet një subjektivitet juridik, ndërsa me vdekje shuhet. Kur për faktin e vdekjes të një personi nuk ka prova apo dokumente të parapara me Ligj. Ligji i Procedurës Jokontestimore ka paraparë procedurën e shpalljes së zhdukjes së një personi ose vdekjes së një personi dhe të provuarit e vdekjes.

2.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbatojnë drejtë procedurën e shpalljes së zhdukjes ose vdekjes së një personi;
- Zgjerojnë njohurit lidhur me kompetencën e Gjykatës;
- Identifikojnë kush është kompetent për fillimin e procedurës;
- Analizojnë aktin me të cilin fillohet procedura (propozimi);
- Vlerësojnë kushtet për shpalljen e personit të zhdukur si i vdekur;
- Zbatojnë drejtë afatet në procedurën e shpalljes të personit të zhdukur si i vdekur dhe të provuarit e vdekjes të një personi. (konstatimi i kohës së vdekjes të një personi);
- Hartojnë aktvendimin pas përfundimit të procedurës.

2.3 Metodat e të shpjeguarit

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metodat e shpjegimit, duke u bazuar në raste, duke përdorur shembuj konkret praktik, ushtrime dhe diskutime. Materiali i këtij trajnimi do t'iu shpërndahet pjesëmarrësve, i cili material përmban komente, shënime, shembuj praktik mbi parimet dhe rregullat kryesore të Ligjit për Procedurën Jokontestimore (LPJK-së), në dispozitat që rregullojnë juridikisht modulën përkatës. Në këtë mënyrë secili nga pjesëmarrësit do të jetë aktiv gjatë gjithë kohës, duke marr pjesë në diskutime me pjesëmarrësit tjerë dhe me vetë prezantuesin pas çdo prezantimi dhe ushtrimi.

2.4 Shpallja e zhdukjes së një personi

Me dispozitën e nenin 49 par. 1 të LPJK-së, është paraparë që personi që mungon nga vendbanimi apo vendqëndrimi i tij i fundit dhe për të cilin nuk ka informata më shumë se (2) dy vite, me kërkesën e secilit person fizik ose juridik që për një gjë të tillë ka interes juridik, mund të shpallet i zhdukur me vendim të gjykatës kompetente (në këtë dispozitë parashihen kushtet për shpalljen e zhdukjes së një personi dhe subjektet që kanë të drejtë ta kërkojnë një gjë të tillë.

Ndërsa, në dispozitën e nenin 49 par. 2 të këtij Ligji janë paraparë afatet kur mund të kërkohet shpallja e zhdukjes së një personi, ashtu që në këtë dispozitë është paraparë që kur dita e informatës së fundit nuk mund të caktohet, afati prej (2) dy viteve, i paraparë në dispozitën e lartpërmendur fillon nga dita e parë e muajit pasardhës në të cilin janë marrë informatat e fundit, llogaritje kjo e afatit e cila vlen atëherë kur dita e informatës së fundit nuk mund të caktohet. Kur muaji nuk mund të caktohet afati fillon nga 1 janari i vitit paraprak.

Konform dispozitës së nenit 50 të LPJK-ë, për shpalljen e zhdukjes së një personi, e kompetencës lëndore është Gjykata Komunale (tash Themelore) në territorin e së cilës personi i zhdukur e ka pasur vendbanimin e fundit, ndërsa nëse nuk ka pasur vendbanim, atëherë gjykata në territorin e së cilës ai e ka pasur vendqëndrimin e fundit. Me këtë ligj shprehimisht është paraparë edhe përbërja e gjykatës në këtë procedurë, duke përcaktuar se këtë procedurë e zhvillon gjyqtari i vetëm.

Procedura për shpalljen e personit të zhdukur fillon me propozim i cili duhet të përmbajë të gjitha elementet e parapara shprehimisht në dispozitën e nenit 51 të LPJK – së, (emri i gjykatës, emri e mbiemri i personit që propozohet të shpallet i zhdukur, dita e lindjes dhe vendbanimi apo vendqëndrimi i fundit i këtij personi, faktet në të cilat mbështetet propozimi, provat me të cilat konstatohen këto fakte, interesin juridik të propozuesit për paraqitjen e propozimit, emrin e mbiemrin e propozuesit dhe adresën e tij, certifikatën nga libri amë i të lindurve e cila duhet bashkangjitur këtij propozimi dhe numrin personal për personin me të cilin ka të bëjë propozimi, personit që kërkohet të shpallet i zhdukur).

Pasi Gjykata ta marrë propozimin pa vonesë duhet të verifikojë: se propozimi a përmban elementet e lartpërmendura si dhe a plotësohen në përgjithësi kushtet themelore për fillimin e kësaj procedure dhe nëse konstaton se nuk janë plotësuar kushtet për fillimin e kësaj procedure, ajo me aktvendim e hedh poshtë propozimin. Në të kundërtën gjykata sipas nevojës do të dëgjojë propozuesin dhe dëshmitarët dhe do ti mbledhë të dhënat e duhura e pastaj do të kërkojë nga Organi i Kujdestarisë që personit që ka të bëjë me propozimin t'ia emërojë kujdestarin.

Gjykata pasi ti kryej veprimet procedurale të lartpërmendura, nëse vërteton se janë plotësuar kushtet për fillimin e procedurës, boton shpalljen për fillimin e procedurës për shpalljen e zhdukjes së personit me të cilin ka të bëjë propozimi, në Gazetën Zyrtare të Kosovës, në të cilën konstaton:

- se ka filluar kjo procedurë,
- konstaton rrethanat qenësore mbi të cilat mbështetet propozimi,
- bëhet ftesa që ai të lajmërohet dhe ftohen edhe personat tjerë që kanë informata për te, që gjykatës brenda afatit (3) tre mujorë nga dita e shpalljes t'ia paraqesin ato informata.

Kjo shpallje do të publikohet edhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës, si dhe në vendin në të cilin personi me të cilin ka të bëjë ky propozim ka pasur vendbanimin, respektivisht vendqëndrimin e fundit (në vende publik ku është i frekuentuar më shumë).

Pas skadimit të afatit prej (3) tre muaj, gjykata do të caktojë seancën për nxjerrjen e provave, duke dëgjuar kujdestarin e personit me të cilin ka të bëjë propozimi e sipas nevojës edhe propozuesin, dhe pasi të nxjerrë edhe provat tjera, do të vendosë me aktvendim lidhur me propozimin në fjalë, me të cilin do të shpallë të zhdukur personin në fjalë ose në të kundërtën do të refuzojë si të pa themeltë propozimin për shpalljen e tij si të zhdukur. Ndaj këtij aktvendimi, ankesë mund të paraqet: kujdestari i personit të zhdukur dhe propozuesi.

Me LPKJ-ë, është paraparë se aktvendimi mbi shpalljen e personit të zhdukur, duhet të botohet në Gazetën Zyrtare ose të paktën në një gazetë ditore si dhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës. Aktvendimi mbi shpalljen e një personi të zhdukur, pasi të bëhet i formës së prerë i dërgohet për regjistrim Zyrrës së Gjendjes Civile në të cilën ai ka qenë i regjistruar.

Nëse paraqitet personi që me aktvendim është shpallur i zhdukur, Gjykata do ta anuloj aktvendimin, në të njëjtën procedurë, me të cilin është shpallur personi i zhdukur.

2.5 Shpallja e vdekjes së një personi

Për shpalljen e personit të zhdukur si të vdekur është kompetente Gjykata Komunale (tash Themelore) në rajonin e të cilës personi i zhdukur e ka pasur vendbanimin e përhershëm të fundit por nëse nuk ka pasur vendbanim të përhershëm, kompetente është gjykata në rajonin e të cilës personi i zhdukur ka pasur vendqëndrimin e fundit edhe në këtë procedurë gjykon gjyqtari i vetëm.

Procedurën për shpalljen e personit të zhdukur si të vdekur mund ta iniciojnë:

- çdo person fizik dhe juridik, qe për këtë ka interes juridik dhe
- organi i kujdestarisë.

Procedura për shpalljen e personit të zhdukur si i vdekur, fillohet me PROPOZIM, i cili paraqitet në gjykatën kompetente dhe nga personi kompetent.

Propozimi duhet te përmbaj sidomos:

- emrin e gjykatës,
- emrin dhe mbiemrin e personit për të cilin propozohet të shpallet i vdekur,
- ditën e lindjes dhe vendbanimin e fundit të përhershëm ose të përkohshëm të atij personi,
- faktet në të cilat mbështetet propozimi,
- interesi juridik i propozuesit,
- provat me të cilat konstatohen këto fakte,
- emrin dhe mbiemrin e propozuesit dhe adresën e tij.

Propozimit duhet ti bashkëngjitet, ekstrakti nga libri amzë i të lindurve për personin me të cilin ka të bëjë propozimi.

Me dispozitën nenit 59 par. 1 është paraparë që personi që është shpallur i zhdukur me vendim gjyqësor, me kërkesën e çdo personi të interesuar mund të shpallet i vdekur me vendim të gjykatës, kur kanë kaluar pa pasur informata 3(tre) vjet, nga dita që është shpallur i zhdukur.

Dispozita e nenit 59 par. 2 të LPJK-ë, parasheh se në cilat kushte, me vendim gjyqësor, mund të shpallet një person si i vdekur. Këto kushte janë te natyrës materiale – juridike, (specifik e LPJK –së, si ligj procedural) e të cilat janë:

I vdekur mund të shpallet me vendim gjyqësor personi:

- për jetën e të cilit 5 (pesë) vitet e fundit (para fillimit te procedurës), nuk ka pasur kurrfarë informatash, kurse nga lindja e tij kanë kaluar 65 vite. (I përket kategorisë së personave të moshuar)
- për jetën e të cilit gjatë 5(pesë) viteve të fundit (para fillimit të procedurës) nuk ka pasur kurrfarë informatash, ndërsa rrethanat në të cilat është zhdukur bëjnë të besohet se nuk është i gjallë p.sh. ka qenë në gjendje të rëndë shëndetësore kur është lajmëruar për herë të fundit).
- personi që ka humbur gjatë luftës, lidhur me veprimet luftarake dhe kjo vërtetohet nga organet kompetente ushtarake, për jetën e të cilit nuk ka pasur kurrfarë informatash për 1 (një) vit, nga dita që ka hyrë në fuqi marrëveshja e paqes, ose 2(dy) vite nga mbarimi i veprimeve luftarake.

- personi që është zhdukur me rastin e fatkeqësisë – thyerjes së anies, fatkeqësisë në komunikacion, fatkeqësive si: zjarr, përmytje, tërmet ose ndonjë rrezik tjetër të drejtpërdrejtë, ndërsa për jetën e tij personi nuk ka pasur kurrfarë informatash 6 (gjashtë) muaj pas përfundimit, respektivisht heqjes së rrezikut.

Nga të elaboruarat më lartë, vemi në konkludim se i vdekur konsiderohet personi i zhdukuri:

- i cili ka munguar nga vendi ku ka jetuar për një kohë të caktuar;
- kur për të njëjtin nuk ka kurrfarë informatash se ku ndodhet dhe
- kur është e pasigurt se ai person është gjallë apo i vdekur.

Këto prezumime procedurale, duhet të ekzistojnë komulativisht në kohën kur inicohet procedura gjyqësore.

Afatet e parapara në nenin 59 pika a) dhe b), konform dispozitës së nenit 60 të LPJK –së, fillojnë të llogariten, duke filluar prej ditës kur sipas informatave të fundit, personi i zhdukur pa dyshim ka qenë në jetë. Nëse kjo ditë nuk mund të konstatohet me saktësi, afati llogaritet me mbarimin e muajit përkatësisht te vitit në të cilin personi i zhdukur sipas informatave të fundit pa dyshim ka qenë i gjallë.

Gjykata pasi ta merr propozimin, në mënyrë të përshtatshme do të vërteton:

- se a janë plotësuar parakushtet (prezumimet) për fillimin e procedurës përkatësisht do të vërteton kompetencën e gjykatës,
- rregulluesin e propozimit,
- ekzistimin e interesit juridik të propozuesit dhe
- identitetin e personit të zhdukur i cili kërkohet të shpallët i vdekur.

Nëse në bazë të dhënave nga propozimi ose pas vërtetimit të bërë, vlerësohet se janë plotësuar prezumimet procedurale, atëherë personit të zhdukur i cili kërkohet të shpallët i vdekur, do ti caktohet kujdestari dhe për këtë do të njoftohet Organi i Kujdestarisë ose gjykata do të thërret organin e kujdestarisë që brenda afatit të caktuar te emëroj kujdestarin për përfaqësim në procedurë.

Kujdestari ka për detyrë të mbledhë të dhëna për zhdukjen ose për jetën e personit të zhdukur i cili kërkohet të shpallët i vdekur dhe ato do ti prezantojë gjykatës p.sh. merr shënime për personin e zhdukur në lokacionin ku ai person së fundi ka jetuar etj.

Gjykata ka kompetencë edhe sipas detyrës zyrtare të sigurojë dhe të nxjerr prova për të konstatuar faktet se a ka vdekur personi i zhdukur, kur ka vdekur apo është në jetë.

Kur Gjykata konstaton se nuk janë plotësuar prezumimet e sipër cekura procedurale, propozimin do ta hedhë.

Ndërsa, nëse gjykata vërteton se janë përmbushur prezumimet e lartëcekura procedurale dhe nëse vërteton se janë plotësuar kushtet për fillimin e procedurës, boton shpalljen për fillimin e procedurës për shpalljen e personit të zhdukur si të vdekur me të cilin ka të bëjë propozimi, në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës,

Shpallja publike përmban:

- rrethanat qenësore te rastit,

- thirret personi i zhdukur dhe çdo person që din diçka për jetën e personit të zhdukur dhe për personin e zhdukur, te njoftojë gjykatën menjëherë dhe
- Gjykata do të bënë të ditur, se me kalimin e afatit prej 3 (tre) muaj, duke filluar prej ditës së publikimit të shpalljes në Gazetën Zyrtare, do të vendosë për propozimin.

Shpallja publikohet në:

- Gazetën Zyrtare,
- në tabelën e shpalljeve të gjykatës,
- si dhe në vendin ku personi i zhdukur ka pasur vendbanimin përkatësisht vendqëndrimin.

Gjykata do të cakton seancën pasi të vërteton se nga publikimi i shpalljes kanë kaluar 3(tre) muaj, dhe nuk është paraqitur personi i zhdukur, nuk ka gjurmë apo informata se është i gjallë.

Në seancë gjykata do të thërras propozuesin dhe kujdestarin e personit të zhdukur dhe do të nxjerre provat e nevojshme. Gjykata nëse konstaton se është plotësuar ndonjë nga kushtet e parapara në nenin 59 të LPJK-ë, ndërsa edhe rezultatet e procedurës se tërësishme vijnë në dukje, në mënyrë të sigurt se personi i zhdukur nuk është i gjallë, do të pranon propozimin dhe merr aktvendim me të cilin personin e zhdukur do ta shpallë si të vdekur.

Nga të lartcekurat dhe konform dispozitës së nenit 63 të LPJK-ë, rezulton se shpalljet, seancat gjyqësore dhe afatet në procedurën e shpalljes së vdekjes së një personi, në mënyrë të përshtatshme zbatohen dispozitat për shpalljen e zhdukjes së një personi.

Aktvendimi me të cilin pranohet propozimi dhe personi i zhdukur shpallet si i vdekur, duhet të përmbajë:

- emrin dhe mbiemrin,
- vendbanimin e përhershëm ose të përkohshëm të fundit të personit të zhdukur,
- emrin dhe mbiemrin e prindërve të tij,
- ditën muajin dhe vitin e lindjes,
- do të konstatohet dita muaji dhe viti brenda mundësive edhe ora që konsiderohet kohë e vdekjes të personit të zhdukur.

Si kohë e vdekjes do të konsiderohet, dita e cila në bazë të provave të nxjerra konstatohet se personi i zhdukur ka vdekur, përkatësisht dita kur personi i zhdukur me siguri nuk ka mbet gjallë.

Nëse kjo ditë nuk mund të vërtetohet, do të konsiderohet se vdekja ka ndodhur ditën e parë pas kalimit të afateve të parapara në dispozitën e nenit 59 të LPJK-ë.

Me nenin 66 të LPJK –së, është paraparë, që aktvendimi i formës së prerë në të cilin shpallet personi i zhdukur si i vdekur ti dërgohet:

- nëpunësit të gjendjes civile;
- gjykatës kompetente komunale (Themelore);
- organit të kujdestarisë;
- shërbimit të kadastrit.

Në qoftë se pas dhënies së vendimit për shpalljen e vdekjes së personit të zhdukur, personalisht paraqitet në gjykatë personi i zhdukur i shpallur si i vdekur, gjykata sipas detyrës zyrtare pa zhvilluar procedurë bënë abrogimin e aktvendimit dhe pezullon procedurën. Po ashtu, nëse Gjykata, në çfarëdo mënyre informohet se personi i zhdukur është i gjallë, sipas detyrës zyrtare

do të fillojë procedurën për abrogimin e aktvendimit. Procedurën për abrogimin e aktvendimit gjykata do filloi edhe sipas propozimit të personave të tjerë që kanë ndonjë interes juridik.

Në rast kur pas marrjes së aktvendimit për shpalljen e personit të zhdukur për të vdekur, kuptohet, se ai person ka vdekur një ditë tjetër e jo në ditën si është konstatuar në aktvendim, atëherë gjykata me propozim të personit të interesuar i cili ka interes juridik do të zhvillojë procedurën dhe sa i përket ditës së vdekjes, do të e ndryshojë aktvendimin. Për fillimin e procedurës për abrogimin apo ndryshimin e aktvendimit, gjykata ka detyrim të njoftojë: Organin e Kujdestarisë dhe Gjykatën trashëgimore para të cilës është në zhvillim procedura e shqyrtimit të trashëgimisë të këtij personi, dhe procedura trashëgimore në procedim e sipër do të ndërpritet.

Në rast se me aktvendimin e plotfuqishëm të gjykatës është shqyrtuar pasuria trashëgimore e personit të zhdukur të shpallur të vdekur, ku është përfshirë edhe pasuria e paluajtshme, gjykata do të urdhërojë të bëhet shënim në librin e tokave - kadastrë, për procedurën e filluar për ndryshimin – abrogimin e aktvendimit.

Gjykata edhe kur refuzon propozimin për ndryshim – abrogim të aktvendimit, ka për detyrë të njoftojë organin kompetent të kujdestarisë, gjykatën trashëgimore ku shqyrtohet pasuria e personit të zhdukur të shpallur të vdekur dhe shërbimin e kadastrit për të bërë fshirjen e shënimit të bërë lidhur me procedurën e zhvilluar.

2.6 Procedura e të provuarit të vdekjes

Nëse vdekja faktike e një personi nuk mund të provohet me anë të dokumentit të paraparë me ligj, përkatësisht ekstraktit nga libri amze i të vdekurve, çdo person i cili ka interes juridik, mund të paraqesin propozimin që me aktvendim të konstatojë vdekjen e atij personi.

Në këtë procedurë, në mënyrë të përshtatshme zbatohen dispozitat e procedurës për shpalljen e personit të zhdukur si i vdekur. Megjithatë në këtë procedurë për dallim nga procedura për shpalljen e personit të zhdukur si i vdekur, specifike është shpallja publike e cila në këtë procedurë jepet, në afat jo më të shkurte se 15 e as më të gjatë se 30 ditë, të cilin afat gjykata e cakton varësisht nga rasti konkret.

Njëherit specifike është edhe fakti se në këtë procedurë, propozimi për provimin e vdekjes, mund të parashtrohet në gjykatë, menjëherë pas vdekjes së personit vdekja e të cilit provohet. Në aktvendimin e gjykatës me të cilin pranohet propozimi, tregohet dita në të cilën personi sipas provave të administruara ka vdekur. Në qoftë se nuk mund të konstatohet pa dyshim dita e vdekjes, si ditë e vdekjes konsiderohet, dita për të cilin është konstatuar se i vdekuri nuk e ka përjetuar.

Në procedurën shpalljes së zhdukjes së një personi, shpalljes së vdekjes dhe të provuarit e vdekjes, bëhet harmonizimi i gjendjes faktike me atë juridike. Aktvendimi i lëshuar sipas procedurave të lartcekura ka efekt të njëjtë juridik, si vdekje natyrore e një personi. Kjo realizohet me regjistrimin në librin amzë të vdekurve. Me vdekjen e një personi pushon edhe subjektiviteti juridik i atij personi dhe në këtë drejtim paraqiten edhe efektet juridike si p.sh. hapet çështja e trashëgimisë, bëhet shuarja e martesës, pushojnë autorizimet të cilat ai person i ka dhënë personave të tjerë që të hapet çështja e drejtave nga baza e sigurimeve, kompensimit të dëmit etj.

Në këtë drejtim është me rëndësi të veçantë që në aktvendim të precizohet dita, përkatësisht ora e saktë e vdekjes të atij personi. Në të gjitha rastet e sipërpërmendura propozuesi ka të drejtë që në

afat prej 15 ditësh, pas marrjes së aktvendimit të paraqesë ankesë. Gjykata e shkallës së parë sipas ankesës aktvendimin vete mund ta abrogojë ose ndryshojë. Nëse gjykata e shkallës së parë, aktvendimin e vet nuk e abrogon ose nuk e ndryshon, atëherë ankesën me të gjitha shkresat e lëndës ia dërgon gjykatës së shkallës së dytë, pavarësisht në afatshmërinë e ankesës. Gjykata e shkallës së dytë për arsye të rëndësishme, mund të vendos edhe lidhur me jo afatshmërinë e ankesës, nëse nuk do të cenohen të drejtat e personave tjerë.

2.7 Ushtrime

Gjatë këtij moduli pjesëmarrësve ju ofrohen shembuj, raste të ndryshme nga praktika – detyra praktike, të cilët pas punës në grupe do të japin prezantime lidhur me punën e bërë, ndërsa diskutimet do të fokusohen në propozime dhe aktvendime.

2.8 Përmbledhje

Në këtë modul trajnues pjesëmarrësit do të kenë mundësin që të njoftohen, me procedurat e shpalljes së zhdukjes së një personi, shpalljes së vdekjes dhe të provuarit e vdekjes, ngjashmëritë dhe dallimet në mes tyre.

3. Caktimi i lartësisë së kompensimit për paluajtshmërinë e eksproprijuar, rregullimi i megjës (sinorëve) dhe ndarja fizike

3.1 Hyrje

Pjesëmarrësit gjatë trajnimit do të njoftohen me procedurën e gjykatës në caktimin e lartësisë së kompensimit për patundshmërinë e shpronësuar, vendimet dhe procedurën e ankimit. Do të jepen shpjegime lidhur me të kuptuarit e rregullimit të kufijëve (megjave) ndërmjet kufirit fqinjë të paluajtshmërive, kur shenjat e megjave janë asgjësuar, dëmtuar ose lëvizur, dhe të njihen me ndarjen e sendeve dhe paluajtshmërive në bashkëpronësi. Gjithashtu në këtë modul do të jepen shpjegime lidhur me ndarjen e sendeve dhe paluajtshmërive në bashkëpronësi.

3.2 Objektivat e trajnimit

Pas përfundimit të këtij moduli trajnues, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbatojnë drjtë procedurën e gjykatës në caktimin e lartësisë së kompensimit për patundshmërinë e shpronësuar;
- Zgjerojnë njohurit lidhur me hartimin e vendimeve dhe procedurën e ankimit;
- Njoftohen me propozimin për rregullimin e megjës, ecurinë e seancës gjyqësore, sidomos procesverbalin e këqyrjes në vend, të njoftohen me aktvendimin dhe përmbajtjen e tij;
- Kuptojnë përmbajtjen e propozimit për ndarje fizike, ecurinë e procedurës, kompetencat dhe të njoftohen me aktvendimin mbi ndarjen e sendeve dhe përmbajtjen e tij;

3.3 Metodat e të shpjeguarit

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metodat e shpjegimit, duke u bazuar në raste, duke përdorur shembuj konkret praktik. Kjo metodologji përdor ushtrime, diskutime. Materiali i këtij trajnimi do t'iu shpërndahet pjesëmarrësve, i cili material përmban komente, shënime, shembuj praktik mbi parimet dhe rregullat kryesore të Ligjit për Procedurën Jokontestimore (LPJK), në dispozitat që rregullojnë juridikisht temën e përmendur. Në këtë mënyrë secili nga pjesëmarrësit do të jetë aktiv gjatë gjithë kohës, duke marr pjesë në diskutime me pjesëmarrësit tjerë dhe me vetë prezantuesin pas çdo prezantimi dhe ushtrimi.

3.4 Caktimi i lartësisë së kompensimit për paluajtshmërinë e eksproprijuar

Prona private është kategori e garantuar dhe e mbrojtur me akte ndërkombëtare, të cilat garantojnë se pronat private është e pacenueshme dhe mund të kufizohet vetëm për interes publik dhe nën kushtet e përcaktuara me Ligj. (Deklarata e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet e saj. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokollet e saj). Pronësia private në Republikën e Kosovës është e mbrojtur me aktin më të lartë juridik, Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Me nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është garantuar mbrojtja e pronës nga çdo ndërhyrje arbitrare. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga pronat. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës, mund ta bëjë eksproprijimin e pronës, nëse ky eksproprijim është i autorizuar me Ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit. publik dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin apo për personat pronarë e të cilëve u është eksproprijuar”.

Shpronësimi i pronës së paluajtshme në mënyrë specifike është i rregulluar me Ligjin nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, i miratuar nga Kuvendi i Republikë së Kosovës me dt. 26.03.2009, i shpallur më 23.04. 2009, i cili Ligj ka ç ‘fuqizuar Ligjin për Eksproprijimin e vitit 1979 (GZ e KSAK 21/78). Me këtë Ligj është përcaktuar përveç tjerash edhe procedura e caktimit të lartësisë së kompensimit për patundshmërinë e shpronësuar para organit shpronësues dhe ankesat mbi shumën e kompensimit para Gjykatës. Në këtë modul do të shqyrtohet dhe diskutohet lidhur me caktimin e kompensimit për palujtshmërisë së eksproprijuar, kur pronari i mëparshëm apo zotëruesit e interesit në pronë, është i pa kënaqur me shumën e kompensimit të caktuar në vendim përfundimtar.

Konform LPJK-ë, në procedurën për caktimin e lartësisë së kompensimit për paluajtshmërinë e eksproprijuar gjykata e cakton lartësinë e shpërblimit për paluajtshmërinë e eksproprijuar kur shfrytëzuesi eksproprijimit dhe pronari i mëparshëm para organit kompetent të administratës nuk kanë arritur marrëveshje për kompensim për paluajtshmërinë e eksproprijuar.

Siq u cekë më lartë me Ligjin nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, është përcaktuar përveç tjerash edhe procedura e caktimit të lartësisë së kompensimit për patundshmërinë e shpronësuar para organit shpronësues dhe ankesat mbi shumën e kompensimit para Gjykatës.

Kur organi shpronësues nxjerr vendim përfundimtar, çdo pronar ose zotërues i interesit në pronën ose të drejtat të cilat janë objekt i vendimit mundë të paraqes ankesë pranë gjykatës kompetente për kundërshtimin e shumës së kompensimit dhe dëmeve të cilat janë përcaktuar në vendim se do ti paguhet atij pronari dhe zotëruesit të interesit. Nëse organi shpronësues është komuna, ankesa i paraqitet gjykatës përkatëse komunale.

Ndërsa kur organ shpronësues është Qeveria, ankesa i paraqitet Gjykatës Supreme të Kosovës. (Gjykata Supreme e Kosovës në mbledhjen e përgjithshme të mbajtur më datë 15.01.2013 ka dhënë mendimin juridik se ”Të gjitha lëndët që konform nenit 36 të Ligjit për Shpronësimin i janë adresuar Gjykatës Supreme të Kosovës dhe në këtë Gjykatë ishin regjistruar si konflikte administrative, duhet t’u dërgohen gjykatave themelore – Departamentit të përgjithshëm, në territorin në të cilën ndodhet paluajtshmëria që është objekt shpronësimi, me qëllim të caktimit të kompensimit të drejt, konform nenit 216 të Ligjit të Procedurës Jokontestimore.).

Nga i cili mendim juridik rezulton, se të gjitha lëndët në të cilat vendoset për ankesat lidhur me shumën e kompensimit të caktuar në vendim përfundimtar, vendos Gjykata Themelore – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil në procedurë jokontestimore, në territorin në të cilën ndodhet paluajtshmëria që është objekt shpronësim.

Ankesa paraqitet brenda afatit prej 30 ditëve pas hyrjes në fuqi të vendimit përfundimtar, ndërsa parashtruesi i ankesës duhet t’i dorëzoj 5 kopje të ankesës fizikisht në Zyrën Ligjore të organit përkatës shpronësues.

Nëse parashtruesi nuk vepron në këtë mënyrë gjykata e refuzon ankesën.

Organi shpronësues ka në dispozicion 30 ditë që të dorëzoj përgjigjen në gjykatë. Nëse ankesa dorëzohet në pajtim me dispozitat e këtij ligji gjykata është e autorizuar të bëjë ri llogaritjen e shumës së kompensimit ose dëmeve të përcaktuara në vendimin e organit shpronësues. Gjykata konform dispozitës së nenit 218 par. 2 të LPJK-ë, në seancë gjyqësore do të administroi provat e propozuara nga pjesëmarrësit e procedurës, nëse konstaton se ato janë të rëndësishme për caktimin e kompensimit, e sipas nevojës mund të caktohet edhe marrja e provës me anë të ekspertizës.

Nëse gjykata konstaton se shuma e kompensimit dhe dëmeve e përcaktuar në vendimin e organit shpronësues është më e ulët ose më e lartë se shuma e cila kërkohet sipas këtij ligji, gjykata nxjerr aktgjykim (në procedurë jokontestimore vendoset me aktvendim) me të cilin e ndryshon vendimin përfundimtar të organit shpronësues dhe e rregullon shumën e kompensimit për shpronësim dhe dëmeve. Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afat prej 15 ditësh. Paraqitja e ankesës ndaj vendimit të organit të shpronësimit dhe paraqitja e ankesës ndaj aktgjykimit të gjykatës mbi atë ankesë nuk ndikon në vendimin përkatës ose të drejtën e organit shpronësues që të vazhdoj zbatimin e vendimit përkatës. Shuma e kompensimit dhe dëmeve të përcaktuara në vendim paguhet në pajtim me kushtet e përcaktuara me këtë ligj, megjithatë pagimi i kompensimit dhe i dëmeve nuk e cenon kompetencat gjykatës konform paragrafit 6 të nenit 36 të Ligjin nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, për ndryshimin shumës së kompensimit të dëmeve. Nëse gjykata e ngrit shumën e kompensimit organi shpronësues duhet ta paguaj shumën e rritur.

Në rastet kur gjykata e zvogëlon shumën e kompensimit dhe dëmeve, personat të cilët kanë pranuar kompensimin e tepërt urdhërohen që ti ja kthejnë shumën e tepërt palës të cilën e ka paguar atë.

Shpenzimet e procedurës për caktimin e kompensimit për palujtshmërinë e eksproprijuar konform dispozitës së nenit 222 të LPJK–ë, i bart shfrytëzuesi i eksproprijimit, përveç shpenzimeve të shkaktuara me veprime të paligjshme të pronarit të mëparshëm të palujtshmërisë.

Kundër aktvendimit të formës së prerë të marrë në procedurë jokontestimore në të cilat vendoset për çështjet juridike – pasurore është i lejuar Revizioni nën kushtet e paraparë sipas LPK, neni 228, 211 dhe 214 zbatimin e të cilave dispozitave e lejon neni 27 LPJK. Në procedurën jokontestimore në të cilën vendoset mbi çështjet statusore, banesore dhe lidhur me kompensimin për palujtshmërinë e eksproprijuar, mund të paraqitet revizioni kundër aktvendimit të shkallës së dytë që ka marrë formë të prere.

3.5 Rregullimi i megjës (sinorëve)

3.5.1 Procedura për rregullimin e megjës

Me Ligjin e Procedurës Jokontestimore është paraparë procedura e rregullimit të megjave (kufijve) ku si gjykatë kompetente për rregullimin e megjave – kufijve, ndërmjet palujtshmërie fqinje kur shenjat e megjave janë asgjësuar, dëmtuar apo lëvizur është gjykata themelore në procedurë jokontestimore, me kompetencë territoriale ekskluzive, gjykata në territorin e së cilës ndodhet palujtshmëria.

Propozimin për rregullimin e megjave ndërmjet ngastrave fqinje, ka të drejtë ta paraqetë secili nga pronarët, përkatësisht poseduesit e parcelave të tilla. Propozimin për rregullimin e megjave mund të paraqes edhe organi i autorizuar, kur me ligj është paraparë një gjë e tillë.

Propozimi duhet të përmbajë:

- Të dhënat për pronarët, përkatësisht poseduesit e ngastrave fqinje;
- Të dhënat për ngastrat e tokave ndërmjet të cilave duhet të rregullohet megja (shenjat e ngastrave nga librat e tokave dhe librave kadastrale – fletat poseduese);
- Shkaqet për të cilat inicohet procedura (shkaqet të cilat tregojnë se a është asgjësuar, dëmtuar apo lëvizur megja;

- Vlerën e sipërfaqes kontestuese kufitare.

Pasi të marrë propozimin për rregullimin e megjave, gjykata mbanë seancën në gjykatën në të cilën do të thërrasë palët në procedurë me qëllim të tentimit të rregullimit të megjës me marrëveshje. Po që se palët nuk arrijnë marrëveshje, gjykata do të caktojë seancën në vendshiqim, në të cilën do të ftojë: palët në procedurë, ekspertin e lëmisë përkatëse – gjeometrin, sipas nevojës edhe dëshmitaret. Në letërthirrjen për seancë gjyqësore, pjesëmarrësit e procedurës gjykata i udhëzon që ti sjellin të gjitha provat me rëndësi për rregullimin e megjës (dokumenta, skica etj.)

Në letërthirrje palëve u tërhiqet vëmendja për pasojat procedurale të mosardhjes në seancën e caktuar. Në çoftë se propozuesi nuk prezanton në seancën për rregullimin e megjës i cili ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, ndërsa mungesën nuk e ka arsytuar as verbalisht e as me shkrim, Gjukata do ta konsiderojë se propozuesi është tërhequr, kjo rregull ka përjashtim vetëm në çoftë se kundërpropozuesi i propozon gjykatës që seanca të mbahet përkundër mungesës së propozuesit të ftuar në mënyrë të rregullt.

Në seancën për rregullimin e megjave (kufive), Gjukata në vendshiqim (vendngjarje) do ta caktojë megjën ndërmjet ngastrave fqinje, të palëve në procedurë, do të vi kufirin e dukshëm me shenja të qëndrueshme si gurë apo shufra hekuri

Gjukata në seancën për rregullimin e megjave, përpilon procesverbal në të cilin duhet të shënojë përshkrimin e gjendjes së gjetur (gjendjes faktike) deklaratat e pjesëmarrësve në procedurë, dëshmitarëve dhe ekspertit.

Procesverbalit gjithmonë–e i bashkangjitet skica e gjendjes së gjetur dhe skica e gjendjes së krijuar me rregullimin e megjës.

Pasi eksperti (gjeometri) të përcaktojë vinë e megjës sipas shënimeve nga evidencat kadastrale, palët çështjen e rregullimit të megjës mund ta zgjidhin me marrëveshje, e cila marrëveshje nuk mund të jetë në kundërshtim me ligjin.

Në çoftë se ndërmjet palëve në procedurë lind kontesti lidhur me sipërfaqen kufitare, vlera e të cilit nuk kalon vlerën e kontestit të vlerës së vogël, Gjukata jokontestimore do të caktojë megjën në mbështetje të së drejtës më të fortë, e nëse kjo nuk është e mundshme, atëherë në mbështetje të gjendjes së posedimit të fundit të qetë. Ndërsa, nëse kontesti nuk mund të zgjidhet në asnjërën nga mënyrat e lartpërmendura, gjykata sipërfaqen kontestuese kufitare do ta pjesëtoj sipas parimit të drejtshmërisë.

Në rastet kur palët në procedurë merren vesh paraprakisht, gjykata mund ta rregullojë megjën në mbështetje të planeve kadastrale, në fuqi me marrëveshje gjyqësore.

Ndërsa, në rastet kur ndërmjet palëve në procedurë ekziston kontesti për sipërfaqen kufitare vlera e të cilës e kalon vlerën e kontestit të vlerës së vogël në procedurë kontestimore e nuk arrijnë marrëveshje. Gjukata e përfundon procedurën jokontestimore pa vendim meritor, ndërsa e udhëzon propozuesin që me padi të iniciojë procedurën kontestimore me qëllim të zgjedhjes së kontestit.

Në dispozitën e aktvendimit për rregullimin e megjës gjykata përshkruan megjën ndërmjet parcelave të tokës së pjesëmarrësve, duke u mbështetur në skicën e gjendjes së krijuar e cila konsiderohet pjesë e aktvendimit.

Ujdia për rregullimin e megjës e arrinë në seancë gjyqësore, mund të goditet në padi vetëm nëse është lidhur në lajthim, nën ndikimin e dhunës apo të mashtrimit të cilit do nga pjesëmarrësit e procedurës. Gjykata nuk do ta rregulloje megjën në tokën ndërtimore, në të cilën nuk ekziston e drejta e pronësisë, përveç rasteve kur nuk është bërë parcelimi i tokës, sipas dispozitave të ligjit me të cilin është rregulluar rregullim hapsinorë (që do të thotë se gjykata nuk e rregullon megjën e poseduesit të tokës ndërtimore pa qenë pronarë juridik).

3.6. Ndarja fizike - e sendeve

3.6.1 Ndarja e sendeve dhe palujtshmërive në bashkëpronësi

Gjykata në procedurën jokontestimore vendose për ndarjen dhe mënyrën e ndarjes së sendeve dhe palujtshmërive në bashkëpronësi.

Procedura iniciohet me propozim i cili duhet të përfshijë:

- të gjithë bashkëpronarët, adresat e tyre,
- të dhënat për objektin e ndarjes,
- të dhënat për madhësinë e pjesëve,
- të dhënat për të drejtat tjera sendore të secilit bashkëpronar.

Për palujtshmritë duhet ceken të dhënat kadastrale dhe ato nga libri i palujtshmërive.

Propozimit duhet ti bashkëngjiten provat të cilat argumentojnë legjitimitetin aktiv dhe pasiv të palëve në procedurë (si prova mbi të drejtën e pronës, të drejtën e servitutit, posedimit e palujtshmërisë dhe të drejtat e tjera sendore). Propozimin mund ta paraqes në gjykatë secili bashkëpronarë, pavarësisht nga madhësia e pjesës së tij në atë palujtshmëri.

E kompetencës ekskluzive territoriale për të vendosur lidhur me propozimin për ndarjen e sendeve në bashkëpronësi është Gjykata në territorin e së cilës ndodhet sendi, po qese ai shtrihet në territorin e disa gjykatave, atëherë secila nga gjykatat e tilla.

Në çoftë se gjykata jokontestimore në procedurë e sipër, konstaton se ndërmjet bashkëpronarëve kontestuese është e drejta mbi sendet që janë objekt ndarjeje apo madhësia e sendit – pasurisë së përbashkët ose kur është kontestuese rrethana, se cilat sende, respektivisht të drejtat, bëjnë pjesë në pasurinë e përbashkët e ndërprejnë procedurën dhe e udhëzon propozuesin, që brenda afatit prej 15 ditësh, me padi ta inicioi procedurën kontestimore. Nëse nuk paraqitet padia brenda afatit të dhënë nga gjykata, do të konsiderohet se propozuesi e ka tërhequr propozimin.

Gjykata pasi të arrijë propozimi e cakton seancën në të cilën i thërret të gjithë bashkëpronarët dhe personat që mbi objektin e pjesëtimit kanë ndonjë të drejtë sendore, të cilët gjatë procedimit të çështjes mund të arrijnë ujdi lidhur me kushtet dhe mënyrën e pjesëtimit, gjykata këtë ujdi e konstaton në procesverbal si ujdi gjyqësore.

Gjykata kompetente me aktvendim bënë ndarjen e palujtshmërisë në bashkëpronësi. Në çoftë se bëhet me ndarje fizike të palujtshmërisë në dispozitiv të aktvendimit duhet të përcaktohen saktë pjesët fizike të palujtshmërisë që do t'iu takojnë bashkëpronarëve dhe gjithë ata që duhet të ndërmarrë secili bashkëpronar me qëllim të realizimit të ndarjes së palujtshmërisë (p.sh. realizimin e servitutit në pjesën e palujtshmërisë të ndarë fizikisht).

Ndërsa, nëse pjesëmarrësit në këtë procedurë nuk arrijnë ujdi gjyqësore, lidhur me kushtet dhe mënyrën e pjesëtimit, gjykata do ta dëgjojë pjesëmarrësit në procedurë, e sipas nevojës do të

caktojë edhe ekspert të lëmisë përkatëse për të dhënë mendimin e tij profesional (p.sh. kur kemi të bëjmë me ndarjen e objektit ndërtimor, për pronësi të përbashkët, atëherë gjykata do ti ndihmojë shumë mendimi profesional i ekspertit të ndërtimtarisë, për ndarjen e objektit në mënyrë sa më të mirë të shfrytëzueshme për të gjithë bashkëpronarët), do të administrojë edhe prova të tjera dhe në bazë të rezultatit të shqyrtimit të tërësishëm të çështjes, konform edhe dispozitave materialo-juridike, do të nxjerrë aktvendim për pjesëtimin e sendeve ose palujtshmërive në bashkëpronësi.

Kur Gjykata vendos së cilit person duhet ti takojë sendi i caktuar, duhet të ketë parasysh nevojat e posaçme të bashkëpronarit konkret që mund të jenë shkak që sendi ti takojë bashkëpronarit përkatës.

Nëse gjykata konstaton se ndarja fizike e palujtshmërisë që është në bashkëpronësi është e pamundur (psh. nëse objekti i banimit me ndarjen fizike e humbë destinacionin për të cilin është ndërtuar) atëherë gjykata nxjerr aktvendim të cilin konstaton se ndarja fizike është e pamundur, dhe vendos që ndarja e palujtshmërisë të bëhet me anë të shitjes, atëherë shitja do të bëhet sipas dispozitave të Ligjit së Procedurës Përmbare.

3.7 Ushtrime

Gjatë këtij moduli pjesëmarrësve do ju ofrohet shembuj, raste nga praktika – detyra praktike, të cilët pas punës në grupe do të japin prezantime lidhur me punën e bërë, ndërsa diskutimet do të fokusohen në zhvillimin e procedurës, propozime dhe aktvendime.

3.8 Përmbledhje

Në këtë modul diskutimi qendror bëhet rreth qëllimit të modulit, objektivat trajnuese, metodat e të shpjeguarit, pritjet nga pjesëmarrësit si dhe për burimet nga të cilat mund të mësohet.

V. Procedura përmbarimore

Isa Shala
Gjyqtar në Gjykatën e Apelit

Tabela e përmbajtjes “ Procedura përmbaremore”

Hyrje.....	242
Objektivat trajnuese	243
Metodat e të shpjeguarit.....	243
Pritjet nga pjesëmarrësit	243
Mjetet e nevojshme.....	243
Burimet dhe literatura	244
Përmbledhje	244
1. Propozimi përmbaremore dhe vendimet e organit përmbaremore lidhur me lejimin, pezullimin dhe përfundimin e procedurës.....	245
1.1 Hyrje	245
1.2 Objektivat mësimore.....	245
1.3 Shqyrtimi i propozimit përmbaremore dhe vendimet e organit përmbaremore.....	245
1.3.1 Fillimi i procedurës përmbaremore.....	246
1.3.2 Propozimi për përmbaremore	247
1.3.3 Aktvendimi për përmbaremore dhe urdhri për përmbaremore	247
1.3.4 Shtyrja e përmbaremore.....	248
1.3.5 Pezullimi i përmbaremore.....	248
1.3.6 Përfundimi i procedurës përmbaremore	249
1.4 Ushtrime	249
1.5 Përmbledhje.....	249
2. Titujt ekzekutiv dhe përmbaremore përmes xhironlogarive bankare	250
2.1 Hyrje	250
2.2 Objektivat mësimore.....	250
2.3.1 Dokumentet e besueshme	251
2.3.2 Përmbaremore përmes xhironlogarive bankare	252
2.3.3 Detyrimet e bankave.....	252
2.3.4 Ushtrime	253
2.3.5 Përmbledhje.....	253
3. Përmbaremore në sendet e luajtshme dhe të paluajtshme	254
3.1 Hyrje	254
3.2 Objektivat trajnuese	254
3.3 Përmbaremore në sendet e luajtshme dhe të paluajtshme.....	254
3.3.1 Përjashtimi nga përmbaremore	254
3.3.2 Veprimet përmbaremore	255
3.3.3 Fitimi i të drejtës së pengut	256
3.3.4 Shitja e sendeve të sekuestruara.....	258
3.3.5 Seanca e shitjes publike	259
3.3.6 E drejta e pengut.....	259
3.3.7 Regjistrimi i të drejtave të pengut pa posedim	261
3.3.8 Ekzekutimi gjyqësor i kërkesës për posedim	262
3.3.9 Shitja e paluajtshmeve.....	263
3.3.10 Ankandet	264
3.3.11 Shitja me marrëveshje	265
3.3.13 Hipoteka si rast special i pasurisë së paluajtshme të regjistruar	266
3.4 Ushtrime	269

3.5 Përmbledhje.....	269
4. Mjetet juridike në procedurën përmbartimore dhe kthimi i punëtorit në punë	270
4.1 Hyrje	270
4.2 Objektivat trajnuese	270
4.3 Mjetet juridike nocioni dhe qëllimi.....	270
4.3.1 Mjetet juridike kundër urdhrit për përmbartim.....	271
4.3.2 Garancitë për ankesa lidhur me prapësimin kundër aktvendimit përmbartimor	272
4.3.3 Përmbartimi i vendimit për kthimin e punëtorit në punë	273
4.3.4 Ushtrime	274
4.3.5 Përmbledhje.....	274

Hyrje

Ligji i ri për procedure përbarimore nr. 04/L-139 rregullon procedurën përmes së cilës gjykatat dhe përbaruesit privat përcaktojnë dhe zbatojnë përbarimin në bazë të dokumenteve përbaruese dhe dokumenteve të besueshme, përveç nëse me ligj të veçantë parashihet ndryshe. Nga kjo rrjedh se nga 1 janari 2014 përveç gjykatave kompetent për përbarim janë edhe përbaruesit privat (neni 1 i këtij ligji). Kosova gjatë reformimit të sistemit të drejtësisë ka bërë harmonizimin e ligjeve me ato të BE-së dhe në kuadër të kësaj në Ligjin për procedurën përbarimore 2012-04-L-139 ka marrë për bazë rekomandimet e Këshillit të Evropës për përbarimin.

Rekomandimi (dhe udhëzimet) bazohet në efikasitet, transparencë dhe kuptim të lehtë të tij. Por ai nuk përshkruan sistemin ideal. Nuk ekziston sistemi ideal për përbarim. Por ajo çka është e mundshme, është parashikimi i bazës dhe parimeve të përbarimit. Si të tilla, këto rekomandime dhe udhëzime mund të shfrytëzohen për të vlerësuar procedurat dhe praktikat e përbarimit. Sistemet kombëtare janë aq te ndryshme sa që është shumë vështirë për të krijuar një sistem ideal përbarimor apo zyrtar ideal përbarimor.

Por çfarë është sistemi adekuat i përbarimit? Si funksionon ai? A kemi sistemi ideal? A ekziston sistemi ideal për përbarim? Nuk ka ende përgjigje. Kjo është utopi. Megjithatë, përmes rekomandimeve dhe udhëzimeve, mund të jetë e mundshme që të zbatohen bazat dhe parimet e caktuara në një sistem.

Vendi ynë nen moton e Deklaratës së Mijëvjeçarit të OKB-së “ne nuk duhet të kursejmë asnjë përpjekje për të forcuar Sundimin e Ligjit” i ka hyre një reforme të thelle të sistemit të përbarimit duke parapare ndryshime organizative, duke ofruar mekanizma me efikas të përbarimit, zhvillim gradual të infrastrukturës ligjore dhe logjistike, duke besuar se standardet e llogaridhënës, vlerësimit dhe performancës janë të një rëndësie jetike për një sistem efikas të përbarimit. Proceset e drejta dhe të frytshme të përbarimit janë kyçe për ndërtimin e sundimit të ligjit për të krijuar një mjedis të qete për rritje ekonomike dhe zhvillim shoqëror. Sistem përmes agjentëve privat të përbarimit mendohet se do të ofron zgjidhje për të gjitha problemet tashme që ekzistojnë në Kosovë. Agjentët privat të përbarimit kanë tendencë të jenë tejet të motivuar dhe profesionist në punën e tyre, dhe ofrojnë nivel të lartë të shërbimeve për të siguruar suksesin e tyre konkurrues. Ata kanë kontroll të drejtpërdrejtë në menaxhimin e zyrave që i udhëheqin dhe përfitojnë personalisht nga përformanca e tyre, duke sjelle një nivel të lartë të përgjegjësisë për çështjet siç janë angazhimi dhe largimi, buxhetimi, sistemet e teknologjisë informative për të mbështetur punën e tyre dhe menaxhimin e zyrës.

Përveç kësaj, për shkak se procesi i përbarimit behet biznes privat në vend të funksionit publik, shpenzimet e furnizimit dhe mirëmbajtjes së zyrave të përbarimit dhe të trajnimeve të agjenteve dhe punonjësve të tyre janë hequr krejtësisht nga buxheti i shtetit dhe pse shteti mbanë shumicën prej shpenzimeve të monitorimit të agjenteve të përbarimit për të siguruar ligjshmërinë e funksionimeve të tyre, dhe disponimin e tyre atëherë kur kërkohet.

Sistemi privat i përbarimit ka gjithashtu përparësinë e heqjes së përgjegjësisë së menaxhimit të procesit të përbarimit nga gjyqtaret dhe zyrtaret përbarues të gjykatave. Këto përgjegjësi i kalojnë agjenteve privat.

Roli i gjykatave mbetet mjaftë i rëndësishëm sepse çështjet me të ndjeshme si janë çështjet familjare mbesin kompetence ekskluzive të gjykatave, po ashtu mjetet juridike mbesin në vendosje të gjykatave si dhe funksion tjetër i rëndësishëm është mbikëqyrja sepse palët të cilët mendojnë se agjenti privat ka shkelur ndonjë të drejtë të tyre mund të drejtohen gjykatës.

Megjithatë përfshirja e përditshme e drejtpërdrejtë e gjyqtarëve në procesin e përmbarimit mbaron duke i lënë gjyqtarët me përgjegjësi se tyre themelore të gjykimit të konteksteve gjyqësore mes palëve dhe duke ua hequr atyre barrën e disa përgjegjësive menaxhuese që shpesh marrin një pjesë të rëndësishme të kohës së tyre. Sistemet e përmbarimit të bazuar rreth agjenteve privat të përmbarimit janë bërë standarde në pjesën më të madhe të Evropës Perëndimore dhe në shtete ish socialiste dhe në Evropën Qendrore. Përmbaruesi privat në Kosovë nuk guxon që të refuzoi kërkesat për përmbarim, vetëm nëse plotësohen kriteret për përjashtim e që zbatohen përshtatshëmish dispozitat që vlejné edhe për përjashtimin e gjyqtarëve.

Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij moduli pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Aplikojné njohuritë e fituara për procedurën përmbarimore;
- Krijojné ide të qarta për sistemin adekuat të përmbarimit;
- Analizojné drejtë procedurën përmes së cilës gjykatat dhe përmbaruesit privat përcaktojnë dhe zbatojné përmbarimin në bazë të dokumenteve përmbaruese dhe dokumenteve të besueshme;

Metodat e të shpjeguarit

Gjatë këtij programi do të përdoren metoda të shpjegimit duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike të përcjella me shembuj praktik, në mënyrë që secili nga pjesëmarrësit të jetë aktiv gjatë gjithë kohës, duke marrë pjesë në diskutime me pjesëmarrësit tjerë dhe me prezantuesin pas çdo prezantimi dhe ushtrimi.

Pritjet nga pjesëmarrësit

Nga ju pritjet të kontribuoni në diskutimet grupore. Angazhimi i juaj do të ndihmojë në arritjen e objektivave të këtij trajnimit. Gjithashtu ju inkurajojmë të bëni pyetje të ofroni zgjidhje dhe të jepni rekomandime gjatë tërë zhvillimit të trajnimit. Ky Modul ka për qëllim që tu ofroj profesionisteve ligjore njohuri të specializuara për procedurën përmbarimore. Moduli është dizajnuar posaçërisht për gjyqtarët e sapo emëruar për gjyqtar, ku njohuritë do të ju shërbejnë për të ardhmen në praktikën e tyre profesionale.

Mjetet e nevojshme

Për realizimin e këtij moduli nevojitet të paktën një lap top, projektor me pajisjet për prezantim përmes slideve me power point, letër për hartimin e shkresave (detyrave), mikrofon etj.

Burimet dhe literatura

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- Ligjin e Procedurës Përmbareme 1978;
- Ligjin e Procedurës Përmbareme të Republikës së Kosovës 2008;
- Ligjin e Procedurës Përmbareme të Republikës së Kosovës 2012;
- Ligjin për Procedurën Kontestimore të Republikës së Kosovës 2008;
- Ligji mbi Martesën dhe Marrëdhënien Familjare LMMF;
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut;
- Ligji mbi Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore;
- Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve;
- Doracak për Zbatimin në Praktike të Procedurës Përmbareme;
- Rekomandimet e Këshillit të Evropës për përmbaremin.
- Ligji Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit të procedurës përmbareme nr. 04/L-139

Përmbledhje

Në këtë modul janë dhënë shpjegime lidhur me kompetencën e organit përmbareme, se çka duhet të përmbaje propozimi për përmbaremin, procedurën e shqyrtimit të propozimit, procedurën e caktimit të përmbaremit, përmbajtjen e aktvendimit për përmbaremin dhe urdhrin për përmbaremin, llojet e dokumenteve përmbareme, përmbaremin në sendet e luajtshme, si në rastet kur duhet të kryhet përmbaremi lidhur me pengun gjyqësor po ashtu edhe pengun kontraktual, si dhe përmbaremi në sendet e paluajtshme.

Po ashtu në modul janë dhënë shpjegime lidhur me mjetet juridike në procedurën përmbareme, se cilat janë këto mjete të rregullta, kush vendos për prapësimin e kush vendos lidhur me ankesën, cili është afati për të vendosur për prapësimin sipas dokumentit përmbareme si dhe procedurën e kthimit të punëtorit në punë.

1. Propozimi përmbartimor dhe vendimet e organit përmbartues lidhur me lejimin, pezullimin dhe përfundimin e procedurës

1.1 Hyrje

Ky sesion trajnimi në fokus të veçantë ka procedurën e shqyrtimit të propozimit përmbartimor dhe lejimit të përmbartimit si dhe vendimet që merren në faza tjera të procedurës siç janë vendimet lidhur me pezullimin dhe përfundimin e procedurës.

1.2 Objektivat mësimore

Pas përfundimit të këtij sesioni pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- *Kuptojnë përmbajtjen e propozimit përmbartimor;*
- *Zbatojnë procedurën e shqyrtimit të propozimit përmbartimor;*
- *Bëjnë dallimin në mes të aktvendimit për përmbartim dhe urdhrit për përmbartim;*
- *Aplikojnë drejtë dispozitat mbi pezullimin dhe përfundimin e përmbartimit.*

1.3 Shqyrtimi i propozimit përmbartimor dhe vendimet e organit përmbartues

Sa i përket kompetencës ka interpretime të ndryshme se me hyrjen në fuqi të këtij ligji kreditorët a kanë të drejtë që për të gjitha çështjet prapë ti drejtohen gjykatës. Në nenin 5 paragraf. 2 të këtij ligji citohet “Gjykata kompetente ka kompetencë lëndore për të urdhëruar dhe për të kryer përmbartimin si dhe për të vendosur për çështjet gjatë procedurës në pajtim me dispozitat e këtij Ligji përveç nëse gjykatat dhe autoritetet tjera përmbartuese kanë juridiksionin për të urdhëruar dhe për të kryer përmbartimin si dhe për të vendosur për çështjet gjatë procedurës.

Ndërsa në nenin 5 paragraf. 6 citohet “Gjykata është kompetente të vendos në procedurën e përmbartimit dhe të zbatojë përmbartimin e vendimeve gjyqësore lidhur me:

- të gjitha çështjet nga e drejta familjare;
- kthimin e punëtorëve dhe shërbyesve civil në punë dhe kompensimet tjera.

Kjo dispozitë është dispozite përjashtuese që gjykata të vendos në çështje tjera përveç nëse është paraparë që me ligj të vendose për çështje si p.sh. që kanë të bëjnë me çdo prapësim, ankese, parregullsi në procedurën përmbartuese sipas nenit 52 dhe 67 të këtij ligji, ose çfarëdo lloj procedure kundër veprimeve të ndërmarr nga përmbartuesi privat. Risi sipas këtij ligji është se organi përmbartues mund të konkludojë se natyra e kredisë kërkon trajtim të përsheptuar të rastit nëse ka rrezik legjitim që pasuritë e debitorit në atë rast të mos jenë në dispozicion për konfiskim apo do t'i bie vlera shumë në rast të vonesës. Gjyqtari mund të pranojë ekzistimin e rrethanave të veçanta, dhe të veprojë shpejt, në rastet që kanë të bëjnë me punësimin, çështjet familjare, alimentacionin apo pagesat për fëmijë nëse interesat e palës mund të ndikohen negativisht si rezultat i vonesës. Gjatë zbatimit të procedurës së përmbartimit, duhet kushtuar vëmendje mbrojtjes së dinjitetit të debitorit përmbartues, dhe përmbartimi të jetë sa më pak i dëmshëm që është e mundur për debitorët.

Dispozita ligjore të përcaktimi i mjeteve dhe objekteve të përmbartimit risi parasheh që kreditori mund të kërkojë nga autoriteti përmbartues që të ndihmojë në identifikimin e pasurisë siç është paraparë në këtë ligj.

Në qoftë se janë propozuar më shumë mjete apo objekte përbarimi sesa që nevojiten për të plotësuar vendimin, organi përbarues mund ta kufizojë përbarimin, sipas propozimit të debitorit, të kufizojë përbarimin vetëm në disa nga mjetet dhe objektet e tilla, po qe se ato mjaftojnë për realizimin e kredisë.

Debitori mund t'i propozojë organit përbarues pasuritë që ai preferon të përbarojë, dhe jep arsyet për kufizim të përbarimit.

Debitori i bashka ngjet propozimit dëshmitë e shkruara, siç janë deklaratat bankare, duke dëshmuar se ato mjete dhe objekte mjaftojnë për të mbuluar kredinë. Debitori gjithashtu do të ofrojë informata të sakta organi përbarues se ku gjenden ato mjete apo objekte dhe si ato të sekuestrohen.

Propozimi i debitorit, si dhe të gjitha informatat shoqëruese, i jepen kreditorit, dhe kreditori i përgjigjet propozimit brenda pesë ditëve nga pranimi i propozimit.

Nëse kreditori nuk pranon propozimin, autoriteti përbarues sigurohet nga dëshmitë e siguruara se pasuritë e dhëna në listë mjaftojnë për të mbuluar kredinë para se të vendosë në favor të propozimit të debitorit. Nëse autoriteti përbarues nuk arrin që të sigurohet, në bazë të dëshmimeve të ofruara, se pasuritë e dhëna në listë mjaftojnë për të mbuluar kredinë, autoriteti përbarues refuzon propozimin.

Kur debitori nuk përmbushë brenda afatit të caktuar çfarë do obligimi monetar apo jo monetar të përcaktuar nga dokumenti përbarues, sipas detyrës zyrtare, apo me propozim të kreditorit, gjykata, do të përcaktojë një datë jo më pak se tri ditë pas datës kur është caktuar data, me të cilën fillon llogaritja e gjobës nëse pagesa nuk është realizuar gjër në datën e caktuar. Gjobat për çdo ditë të vonesës do të jenë mbi 5 euro por jo më lartë se 50 euro për personat fizik, dhe mbi 50 euro por jo më tepër se 500 euro për personat juridik. Gjobat do të shtohen për çdo ditë apo periudhë tjetër të vonesës, në pajtim me rregullat e Ligjit për Detyrimet, që nga dita e skadimit të afatit për përmbushjen e obligimeve e gjër sa të arrihet kjo përmbushje.

1.3.1 Fillimi i procedurës përbarimore

Procedura përbarimore fillohet me propozimin e kreditorit si dhe sipas detyrës zyrtare kur me ligj parashihet një gjë e tillë, konform dispozitës së nenit 4 të LPP – Ligji i Procedurës Përbarimore. Në rastet më të shpeshta propozimi për përbarim paraqitet nga personat fizik ose juridik që do të thotë se edhe në procedurën përbarimore vlen parimi i disponimit të palës, që është një nder parimet themelore të procedurës kontestimore, pra inicimi i kësaj procedure varet nga dëshira e kreditorit, po ashtu edhe zhvillimi i mëtejme i kësaj procedure varet nga vullneti i kreditorit sepse kreditori pa pëlqimin e debitorit gjatë zhvillimit të procedurës mund të tërhiqet nga propozimi përbarimor në tërësi apo pjesërisht dhe të përfundohet procedura dhe se propozimi pas tërheqjes mund të paraqitet prapë në gjykatë. (Neni 42 i LPP-se.) Kërkesa duhet të jetë provuar në atë mënyrë që të evitohet mundësia e evitimit të dyshimit të ekzistimit të saj që do të thotë të jetë e besueshme.

1.3.2 Propozimi për përmbarim

Aktualisht kreditorët në Kosovë deri me datë 30 qershor 2014 kanë mundur të drejtohen si Gjykatave po ashtu edhe përmbaruesve privat për realizimin e të drejtave të fituara ose të njohura në bazë të vendimeve të formës së prerë. Pas kësaj date kreditorët mund të drejtohen gjykatave vetëm për çështjet që janë kompetente të kryejnë gjykatat ndërsa për çështje tjera duhet të drejtohen përmbaruesve privat. Procedura përmbarimore fillohet me propozimin e kreditorit si dhe sipas detyrës zyrtare kur me ligj parashihet një gjë e tillë. Në rastet më të shpeshta propozimi për përmbarim paraqitet nga personat fizik ose juridik që do të thotë se edhe në procedurën përmbarimore vlen parimi i disponimit të palës, që është një nder parimet themelore të procedurës kontestimore, pra inicimi i kësaj procedure varet nga dëshira e kreditorit, po ashtu edhe zhvillimi i mëtejme i kësaj procedure varet nga vullneti i kreditorit sepse kreditori pa pëlqimin e debitorit gjatë zhvillimit të procedurës mund të tërhiqet nga propozimi përmbarimor në tërësi apo pjesërisht dhe të përfundohet procedura dhe se propozimi pas tërheqjes mund të paraqitet prapë në gjykatë. Kreditori është personi të cilit debitori duhet t'i paguajë një shumë të hollave ose të bëjë ose mos të bëjë një veprim siç parashihet në dokumentin përmbarimor.

Kërkesa duhet të jetë provuar në atë mënyrë që të evitohet mundësia e evitimit të dyshimit të ekzistimit të saj që do të thotë të jetë e besueshme. Nga ana formale LPP nuk parasheh ndonjë formë të veçante për propozimin për përmbarim. Bazuar në nenin 38 të LPP-së, propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, kërkuesi i përmbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit. Në rast se propozimi për përmbarim nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore. Po që se bashkë me propozimin për përmbarim është bërë edhe kërkesa për konstatimin e pasurisë së debitorit, për rezultatin e konstatimit të tillë gjykata do të njoftojë propozuesin e përmbarimit duke i lënë afat që ta rregullojë propozimin e paraqitur, respektivisht që ta ndryshojë apo plotësojë atë.

1.3.3 Aktvendimi për përmbarim dhe urdhri për përmbarim

Nga 1 janari 2014 vendimet në procedurën e përmbarimit organi përmbarues i nxjerrë në formë të aktvendimit ose urdhrit për përmbarim. Ligji këtu ka bere një dallim në terminologjinë e vendimeve duke përcaktuar se si titullohet vendimi i gjykatës dhe si ai i përmbaruesit privat por në esence ka dhënë sqarime të mjaftueshme se çka kuptohet me këto vendime dhe çka duhet të përmbajnë këto vendime. Urdhri për përmbarim është vendimi i përmbaruesit privat me të cilin pranohet plotësisht apo pjesërisht propozimi për kryerjen e përmbarimit. Aktvendimi për përmbarim është vendimi i Gjykatës përmes së cilit propozimi për përmbarim pranohet plotësisht apo pjesërisht apo përmbarimi urdhërohet sipas detyrës zyrtare.

Përmbaruesi i Gjykatës është i punësuar në sistemin gjyqësor i cili drejtpërdrejt kryen veprime përmbaruese të caktuara, ndërsa Përmbaruesi privat është personi fizik i emëruar nga Ministri i Drejtësisë në pajtim me dispozitat e këtij ligji, i cili në kryerjen e autorizimeve publike të besuara sipas këtij ligji, vendos për veprimet nga kompetenca e tij në zbatimin e përmbarimit të lejuar dhe ndërmerr veprime për përmbarim.

Procedurën e përmbarimit në shkallë të parë e udhëheq dhe për të vendosë përmbaruesi privat, ndërsa përjashtimisht gjyqtari individual kur me këtë ligj është caktuar se përmbarimin e cakton dhe zbaton Gjykata (organi i shkallës së parë). Organi përmbarues vendos për propozimin e përmbarimit brenda afatit prej shtatë (7) ditëve pas pranimit të propozimit. Gjykata kompetente ka kompetencë lëndore për të urdhëruar dhe për të kryer përmbarimin si dhe për të vendosur për çështjet gjatë procedurës në pajtim me dispozitat e këtij ligji përveç nëse Gjykatat dhe autoritetet tjera përmbaruese kanë juridiksionin për të urdhëruar dhe për të kryer përmbarimin si dhe për të vendosur për çështjet gjatë procedurës.

Përmbaruesi privat nxjerr urdhër në bazë të propozimit për kryerje të përmbarimit dhe kryen përmbarimin me qëllim të plotësimit të kërkesës së debitorit në bazë të dokumentit përmbarues, përveç nëse ndryshe parashikohet me ligj që urdhëron që përmbarimi dhe kryerja e përmbarimit të bëhet brenda juridiksionit të Gjykatës. Si urdhri për përmbarim po ashtu edhe aktvendimi duhet të kenë përmbajtje të njëjta. Në aktvendimin për përmbarimin dhe urdhrin për përmbarim në bazë të titullit përmbarues duhet të tregohet dokumenti përmbarues, kreditori dhe debitori i përmbarimit, kredia që duhet të realizohet, mjeti dhe objekti i përmbarimit, si dhe të dhënat tjera të nevojshme për zbatimin e përmbarimit.

Në aktvendimin për përmbarim dhe urdhrin për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm, duhet të tregohet dokumenti i besueshëm në bazë të së cilit urdhërohet përmbarimi, kreditori dhe debitori, kredia që duhet të realizohet, mjeti dhe objekti i përmbarimit, urdhri për debitorin për të zgjidhur kredinë dhe kostot tjera brenda afatit shtatë (7) ditor dhe në kontestet në lidhje me kambialin apo çekun, brenda afatit tre (3) ditor, dhe të dhënat tjera të nevojshme për zbatimin e përmbarimit.

Aktvendimi për përmbarimin apo urdhri për përmbarim nuk duhet ta ketë domosdo pjesën arsyetuese. Ky aktvendim apo urdhër mund të nxjerrët edhe duke u vënë vula katrore në propozimin për përmbarim. Nga kjo shihet që kreditorët janë të obliguar të parashtrajnë propozim për përmbarim e jo si në disa shtete ku kreditorët përmbaruesit privat mjafton ti dorëzojnë dokumentin përmbarues. Aktvendimi për përmbarimin apo urdhri për përmbarim duhet ta përmbajë udhëzimin për mjetin e goditjes të cilin palët kanë të drejtë ta përdorin kundër tij. Aktvendimi me të cilin propozimi për përmbarim tërësisht ose pjesërisht refuzohet apo hedhet poshtë, domosdo duhet ta ketë arsyetimin.

1.3.4 Shtyrja e përmbarimit

Ligji i procedurës përmbarimore 2008 ka parapare shtyrjen e përmbarimit vetëm në baze të kërkesës së kreditorit ndërsa ligji i ri parashihet shtyrjen e përmbarimit edhe sipas kërkesës së debitorit në qoftë se debitori argumenton se zbatimi do t'i shkaktojë atij dëm të riparueshëm. Organi përmbarues plotësisht ose pjesërisht do të shtyjë përmbarimin edhe në raste tjera të parapara sipas dispozitave të neneve 61, 62, 63 dhe 64.

1.3.5 Pezullimi i përmbarimit

Në nenin 65 të ligjit parashihet pezullimi i procedurës së përmbarimit ku përmbarimi pezullohet sipas detyrës zyrtare në këto rrethana:

- kur debitori apo pasuritë e tij nuk mund të gjenden për qëllime të njoftimit dhe sekuestrimit të pasurisë brenda tre (3) muajve nga fillimi i rastit të përmbarimit, përkundër faktit se janë

bërë së paku dy (2) tentime nga organin përbarues që të gjej atë person për qëllime të njoftimit apo sekuestrimit të pasurisë;

- kur është tentuar nga organi përbarues që të zbatohet përbarimi i vendimit së paku dy (2) herë pa arritur asnjë rezultat të synuar nga këto veprime;
- kur adresa e debitorit e dhënë në propozimin për përbarim vërtetohet se është e pasaktë ndërsa kreditori nuk mund të argumentojë para organit përbarues saktësinë e adresës;
- Procedura e pezulluar me konkluzion sipas këtij neni mund të vazhdojë nëse kreditori në afatin prej gjashtë (6) muajsh paraqet informata të reja lidhur me çështjen e pezulluar, në të kundërtën procedura konsiderohet e përfunduar.

1.3.6 Përfundimi i procedurës përbarimore

Sipas nenit 66 te LPP-së, përbarimi do të përfundojë sipas detyrës zyrtare në qoftë se dokumenti përbarimor është anuluar, ndryshuar, shfuqizuar, apo në ndonjë mënyrë tjetër është bërë i pa efekt, apo në qoftë se vërtetimi për përbarueshmërin e tij anulohet me vendim të formës së prerë. Përbarimi do të mbarojë gjithashtu sipas detyrës zyrtare nëse një rast është pezulluar dy (2) herë dhe për herë i plotëson kriteret për pezullim siç përcaktohet në paragrafin 1. neni 65. të këtij ligji.

Përbarimi do të përfundohet sipas detyrës zyrtare edhe kur në pajtim me dispozitat ligjore me të cilat rregullohen marrëdhëniet detyimore, personi i tretë e përmbushë obligimin në dobi të kreditorit në vend të debitorit. Përbarimi do të përfundohet edhe kur ai është bërë i pamundshëm apo kur nga shkaqe të tjera nuk mund të zbatohet, si dhe pas kalimit të afatit absolut të parashkrimit për përbarim. Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përbarimore.

1.4 Ushtrime

Gjatë këtij prezantimi do të prezantohet nga një shembull praktik i cili do t'iu shpërndahet pjesëmarrësve të cilët pas punës në grupe, njeri grup do të prezantojë se si përpilohet aktvendimi për përbarim, ndërsa grupi tjetër do të merr vendim lidhur me përfundimin e procedurës përbarimore.

1.5 Përmbledhje

Në këtë sesion trajnues janë dhënë shpjegime lidhur me kompetencën e organit përbarues, se çka duhet të përmbajë propozimi për përbarim, procedurën e shqyrtimit të propozimit, procedurën e caktimit të përbarimit si dhe për përmbajtjen e aktvendimit për përbarim dhe urdhrin për përbarim.

2. Titujt ekzekutiv dhe përmbartimi përmes xhivollogarive bankare

2.1 Hyrje

Në këtë sesion trajnimi do të shpjegohen dokumentet përmbartimore dhe të besueshëm, llojet dhe kuptimi i tyre si dhe përmbartimi përmes xhivollogarive bankare.

2.2 Objektivat mësimore

Pas përfundimit të këtij sesioni trajnues pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Njohin cilat janë dokumentet përmbartimore;
- Zbatojnë procedurën e përmbartimit përmes llogarive bankare;
- Zgjerohin njohurit rreth detyrimeve të bankave.

2.3 Titujt ekzekutiv

Nuk ka sistem efikas të përmbartimit nëse nuk ka kornize të qartë ku janë të definuar titujt ekzekutiv. Kemi pasur paqartësi në disa raste në interpretimin e dispozitave ligjore duke sjellë në situatë ku është kërkuar nga Gjykata Supreme e Kosovës që të sjell qëndrime juridike. Dilemat më të mëdha kanë qenë sa i përket vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës sa i përket kthimit të shërbyesve civil në punë si dhe vendimeve mbi regjistrimin e hipotekave se a paraqesin titull përmbartimor.

Sipas legjislacionit të mëhershëm (ligji 2008) titujt ekzekutiv konsideroheshin:

- Vendimi ekzekutiv i gjykatës dhe ujdia gjyqësore ekzekutive;
- Vendimi ekzekutiv i dhënë në procedurë administrative dhe ujdia administrative po që se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po që se me ligj nuk është parapa diçka tjetër;
- Dokumenti noterial ekzekutiv e cila është shtuar si titull ekzekutiv në ligjin e ri përmbartimor;
- Dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument ekzekutiv (shembull pajtimi i arritur në procedurën e ndërmjetësimit kur është aprovuar nga gjykata apo vërtetuar nga organi kompetent – Ligji i ri për procedurën e ndërmjetësimit neni 14.4).

Sipas ligjit në fuqi dhe ndryshimeve të fundit të ligjit lista e titujve ekzekutiv (përmbartues) është zgjeruar siç vijon:

- vendimi përmbartues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbartuese;
- vendimi përmbartues i dhënë në procedurë administrative dhe aktapajtimi;
- dokumenti noterial i pambartueshëm në pajtim me ligjin për noterinë;
- marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit në pajtim me Ligjin mbi ndërmjetësimin pas aprovimit të Gjykatës;
- aktvendimet, aktet dhe memorandumet për ujdite gjyqësore të Gjykatave të huaja si dhe vendimet e Gjykatave të huaja të arbitrazhit dhe ujdite e arritura para Gjykatave të tilla në raste të arbitrazhit, të cilat janë pranuar për përmbartim brenda territorit të Republikës së Kosovës;
- vendimet dhe marrëveshjet përmbartuese të arbitrazhit në Republikën e Kosovës të shpallura të ekzekutueshme nga Gjykata;

- kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit;
- vendimi gjyqësor i vërtetuar si urdhër përmbarues evropian;
- dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument përmbarues.

Sipas nenit 5 të Ligji Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit të procedurës përmbarimore nr. 04/L-139 Neni 22 i ligjit bazik paragrafi 1. nën-paragrafi 1.4. pas fjalës“ ndërmjetësimin” fshihen fjalët “pas aprovimit të Gjykatës” si dhe i njëjti nen i ligjit bazik, paragrafi 1., pas nën-paragrafit 1.7.,shtohet nën-paragraf i ri 1.7a. me tekstin si në vijim. 1.7a. kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut, qe do te thotë se kësaj liste i shtohet edhe një dokument përmbarimor.

Harmonizimi i ligjeve me ato të BE vërehet te titujt ekzekutiv që parasheh legjislacioni ynë e që në mase të madhe përmbush kriteret e udhëzimit për zbatim me të mire të rekomandimeve ekzistuese të këshillit mbi përmbarimin të Komisionit evropian për efikasitet të drejtësisë (CEPEJ) ku të Dokumenti i pambarueshëm lidhur me përkufizimin dhe formën e dokumentit citohet: “Korniza legjislative shtetërore duhet të përmbajë përkufizim të qartë të asaj se çka konsiderohet dokument i pambarueshëm dhe kushtet e përmbarimit të tij. Dokumentet e përmbarimit duhet të hartohen në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duke mos lënë hapësirë për keqinterpretim”. Në praktikë vërehen vështirësi në përmbarim sa i përket dokumentit noterial për shkak se nuk përpilohen nga noterët në pajtim me nenin 3 dhe 32 të Ligjit mbi Noterinë.

Risi sipas ligjit të ri është se dokument përmbarimor parashihet vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi, a do të thotë kjo se mund të përmbarohet secili vendim i dhënë ne procedure administrative edhe pse kjo është ne kolizion me dispozitën e nenit 1 te këtij ligji ku citohet “Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për përmbarimin e vendimit të marrë në procedurën administrative dhe për kundërvajtje me të cilin është caktuar detyrimi në të holla, përveçse kur për përmbarimin e tillë është paraparë me ligj kompetenca e organit tjetër”.

2.3.1 Dokumentet e besueshme

Sipas ligjit 2008 të LPP-së, dokumente të besueshëm konsideroheshin:

- fatura;
- kambiali dhe çeku, me po test dhe faturë kthyese po që se nevojitet për themelimin e kredisë;
- dokumenti publik;
- ekstrakti nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të ujit, energjisë elektrike dhe hedhurinave;
- dokumenti privat i verifikuar sipas ligjit.

Sipas ligjit në fuqi, dokument të besueshme janë:

- kambialet dhe çeket me po test dhe faturë kthyese, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës;
- ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave;
- faturat;
- dokumentet që sipas dispozitave ligjore të posaçme kanë rëndësinë e dokumenteve publike.

Llogaritja e kamatës konsiderohet si pjesë e dokumentit të besueshëm. Diskutim i hapur rreth titujve ekzekutiv. Risitë sa i për ketë deklaramit të pasurisë dhe përmbajtjes se deklaramit të pasurisë janë parapare në nenet 45 dhe 46 te këtij ligji.

2.3.2 Përmbartimi përmes xhirollogarive bankare

Bazuar në ligjet e mëhershme gjykatat është dashur që të gjitha vendimet ti dërgojnë në selinë e Bankave Komerciale në Prishtinë për përmbartim e jo në degët e tyre duke sjell vështirësi dhe humbje kohë të panevojshme.

Kjo është rregulluar me ligjin nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, në dispozitat e nenit 153 të këtij ligji theksohet “Kërkesa për përmbartim në para të gatshme në xhirollogarinë e debitorit futet në juridiksion të Gjykatës ku gjendet selia e bankës apo në territorin ku gjendet njësia organizative e bankës në të cilën debitori mban xhirollogarinë e tij”. Në praktikat e deri tanishme të gjykatave në Kosovë dorëzimi i vendimeve gjyqësore për përmbartim në xhirollogaritë bankare është bërë përmes dorëzuesve gjyqësor ose dorëzuesve të postës e që nuk ka qenë fare efikase.

2.3.3 Detyrimet e bankave

Sipas nenit 19 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit të procedurës përmbartimore nr. 04/L-139 Neni 155 i ligjit bazik ndryshohet ku parashihet Sekuestrimi dhe përmbartimi në llogarinë bankare përmes Regjistrimit të llogarive bankare .

- Organi përmbartues përmes sistemit elektronik të Regjistrimit të Llogarive Bankare ia dorëzon bankave komerciale aktvendimin apo urdhrin për përmbartim në llogari bankare.

- Bankat komerciale obligohen të bëjnë bllokimin e llogarive bankare të debitorit brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) minutash prej momentit të pranimit të aktvendimit apo urdhrin për përmbartim. Banka komerciale brenda afatit prej njëqind e 6 njëzet (120) minutash e njofton organin përmbartues për bllokimin e llogarisë bankare sipas aktvendimit apo urdhrin për përmbartim.

- Organi përmbartues dërgon urdhrin për transfer të mjeteve brenda njëzet e katër (24) orësh, pas pranimit të njoftimit nga bankat për bllokimin e llogarisë. Nëse debitori ka fonde të mjaftueshme në llogarinë bankare, banka obligohet që të bëjë transferin e fondeve të debitorit brenda njëqind e tetëdhjetë (180) minutash, pas pranimit të aktvendimit apo urdhrin të organit përmbartues, si dhe brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) minutash, pas kryerjes së transferit të fondeve e informon organin përmbartues se transferimi i fondeve është kryer duke shënuar kohën e marrjes së vendimit të organit përmbartues, shumën e kredisë së transferuar, numrin ose numrat e llogarive nga të cilat janë tërhequr fondet, emrin e palës, numrin e llogarisë dhe bankën ku transferi është kryer. Afati kohor i lartpërmendur llogaritet, dhe bankat janë të obliguara të veprojnë në përputhje me të, vetëm gjatë orarit të rregullt të punës së bankave, duke nënkuptuar se, nëse afati i lartpërmendur, i paraparë për transfer, nga koha e pranimit të urdhrin, e kalon orarin e rregullt të punës së bankave, atëherë llogaritja e afatit për transfer ndërpritet në kohën e përfundimit të rregullt të orarit të punës së bankave dhe afati i mbetur vazhdon të rrjedhë në ditën e ardhshme të punës së bankave.

- Në rastet kur banka bën bllokimin e llogarisë bankare të debitorit, me këtë parandalon çdo tërheqje të fondeve, për çfarëdo qëllimi apo në çfarëdo forme, përveç rasteve kur banka e ka radhën e përparësisë ndaj fondeve në llogari, derisa banka të ketë përmbushur shumën e cekur në vendimin e organit përmbarues ose derisa të tërhiqet urdhri i organit përmbarues. Ky bllokim i llogarive nuk do të parandalojë deponimin e fondeve në llogari. Pas marrjes së urdhrin për përmbarim, debitori i përmendur në urdhër nuk do të lejohet të hap llogaritë tjera në bankë derisa të jetë përmbushur urdhri, ose derisa të hiqen urdhrat e organit përmbarues për bllokimin e llogarisë. Banka nuk mund të përmbush asnjë urdhër të debitorit derisa ai t'ia ketë paguar organit përmbarues shumën e plotë të kredisë ose derisa të informohet nga organi përmbarues se është tërhequr urdhri.

- Organi përmbarues përmes njoftimit të sistemit elektronik të Regjistrin të llogarive bankare e njofton bankën për lirimin e llogarive të debitorit pas pagesës së plotë të kredisë ose pas përfundimit të procesit të përmbarimit, brenda afatit prej njëqind e njëzet (120) minutash prej momentit kur njoftohet se është bërë pagesa e kredisë.

- Banka obligohet që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) minutash të lirojë llogaritë e bllokuara të debitorit pas marrjes së njoftimit sipas paragrafit 5. të këtij neni.

- Më kërkesën e organit përmbarues, banka është e obliguar që të ofrojë sqarime dhe dokumente që dëshmojnë se ajo ka respektuar vendimin për transfer dhe të gjitha vendimet e tjera të organit përmbarues.

- Nëse ekzistojnë rrethanat që e bëjnë të pamundur dërgimin e urdhrin për përmbarim apo njoftimeve përmes sistemit elektronik të Regjistrin të llogarive bankare tek banka, atëherë organi përmbarues mund të dërgojë urdhrin për përmbarim apo njoftimet sipas formave tjera që e bëjnë të mundur dërgimin e tyre.

2.3.4 Ushtrime

Gjatë këtij sesioni do të prezantohet një shembull praktik i cili do t'iu shpërndalet pjesëmarrësve të cilët pas punës në grupe do të prezantojnë se si hartohet aktvendimi për përmbarim i cili dërgohet ne banke për përmbarim dhe ne rastin tjetër do te verifikojnë se a është dokumenti i përshtatshëm për përmbarim.

2.3.5 Përmbledhje

Ne këtë sesion janë dhëne shpjegime për dokumentin përmbarimor, llojet e dokumenteve përmbarimore si dhe procedurën e përmbarimit përmes xhirollogarive bankare.

3. Përmbartimi ne sendet e luajtshme dhe te paluajtshme

3.1 Hyrje

Gjatë këtij sesiioni trajnuet në fokus të veçantë do të jetë praktika gjyqësore lidhur me përmbartimin ne sendet e luajtshme, si ne rastet kur duhet te kryhet përmbartimi lidhur me pengun gjyqësor po ashtu edhe pengun kontraktual, si dhe përmbartimi ne sendet e paluajtshme.

3.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij sesiioni pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Identifikojnë se cilat sende janë të përjashtuara nga përmbartimi;
- Bëjnë dallimet në mes të pengut gjyqësor dhe pengut të kontraktuar;
- Zbatojnë procedurën e shitjes lidhur me sendet e luajtshme dhe të paluajtshme.

3.3 Përmbartimi në sendet e luajtshme dhe të paluajtshme

Për të vendosur mbi propozimin për përmbartim për sendet e luajtshme, si dhe për zbatimin e përmbartimit të tillë, kompetente në pikëpamje territoriale është Gjykata në territorin e së cilës ndodhen ato sende sipas të dhënave te shkruara në propozimin për përmbartim. (neni 82 i LPP)

Kreditori mund të kërkojë që organi përmbartimor të nxjerrë aktvendimin për përmbartimin për sendet e luajtshme, duke mos e përmendur vendin e ndodhjes së tyre.

Lidhur me propozimin për përmbartim në sendet e luajtshme e kompetencës territoriale është Gjykata në territorin e së cilës ndodhet vendbanimi i debitorit, e nëse nuk ka vendbanim në Kosovë, atëherë në territorin e së cilës ndodhet vendqëndrimi i tij, kur kemi të bëjmë me personin fizik.

Kur debitori është person juridik e kompetencës territoriale është Gjykata në territorin e së cilës ai e ka selinë e tij.

Kreditori i përmbartimit aktvendimin për përmbartim mund t'ia parashtrojë secilës Gjykatë me kompetencë lëndore në territorin e së cilës ndodhen sendet e luajtshme të debitorit, me propozim që kjo Gjykatë ta zbatojë përmbartimin.

Në qoftë se Gjykata e ka caktuar përmbartimin për sendet e luajtshme që ndodhen në territorin e saj dhe të Gjykatës tjetër, atëherë pas kryerjes së përmbartimit për sendet e luajtshme në territorin e saj, aktvendimin për përmbartimin do t'ia dërgojë Gjykatës tjetër për përmbartim të mëtejme deri në realizimin e plotë të kredisë së kreditorit të përmbartimit.(neni 84 i LPP)

Gjykata nga e cila është larguar rasti, me përfundimin e largimit, nuk ka më kompetencë në lidhje me rastin.

3.3.1 Përjashtimi nga përmbartimi

Në praktikën gjyqësore ky institut ka paraqitur shumë dilema edhe pse *ligjdhënësi* decidivisht është munduar të paraqes se cilat sende të luajtshme përjashtohen nga përmbartimi.

Bazuar në nenin 85 të LPP-së përjashtohen nga përbarimi sendet si në vijim:

- veshjet, këpucët, ndërresat dhe gjësendet tjera personale, çarçafët, veglat e kuzhinës, orenditë, stufa, frigoriferi dhe objektet tjera me vlerë të zakonshme që shërbejnë për përmbushjen e nevojave themelore të familjes, nëse janë të nevojshme nga debitori dhe familjarët e tij;
- furnizimi me ushqim për tre (3) muaj dhe materialet për nxehe që shfrytëzohen nga debitori dhe familjarët e tij;
- kafshët e punës dhe mbarështimit, pajisjet bujqësore dhe mjetet tjera, farërat, ushqimi për kafshë, mjetet, makinat dhe objektet tjera që i duhen debitorit, bujkut apo zanatliut për vazhdimin e punës në bujqësi, respektivisht në kryerjen e aktivitetit të zanatit, të nevojshme për të fituar të ardhurat minimale të nevojshme për të mbajtur veten dhe familjarët e tij;
- librat dhe objektet tjera që janë të nevojshme nga debitori që në mënyrë të pavarur dhe me punë personale të kryej një aktivitet shkencor, artistik apo aktivitet tjetër profesional;
- të hollat e gatshme të debitorit i cili ka të hyra mujore të përhershme deri në shumën mujore që sipas ligjit përjashtohet nga përbarimi e proporcionalisht me afatin kohor deri në pagesën e ardhshme;
- dekorimet, medaljet, certifikatat ushtarake të nderit apo dekoratat tjera të debitorit për vlerësimin e nderit, unazën e martesës, letrat personale, manuskriptet apo dokumentet tjera personale që i përkasin debitorit si dhe fotografit e familjes; dhe
- mjetet mjekësore që i jepen personave me aftësi të kufizuara apo personave tjerë me paaftësi fizike në pajtim me rregulloret, apo që ai ka përvetësuar personalisht dhe që janë të domosdoshme për kryerjen e funksioneve jetësore.

Dispozitat nga nënparagrafi 1.3. paragrafi 1. te nenit 85 te LPP nuk vlejné për përbarim të realizimit të kërkesave monetare të bankave, në bazë të huave specifike për qëllime të zhvillimit të bujqësisë, respektivisht zanatit, me kusht që ky qëllim është deklaruar në mënyrë të veçantë në kontratën për hua.

Pakot postare apo transferimet monetare përmes postës që i janë adresuar debitorit nuk mund të jenë objekt i përbarimit para se t'i dërgohen debitorit.

Me ndryshimet e reja të LPP-së përjashtohen nga përbarimi edhe të ardhurat në bazë të ndihmës sociale.

3.3.2 Veprimet përbarimore

Përbarimi për sendet e luajtshme zbatohet me anë të regjistrimit, dhe vlerësimit të tyre, sekuestrimit, shitjes së sendeve dhe përmbushjen e kredisë së kreditorit nga shuma e fituar nga shitja e atyre sendeve. (neni 86 i LPP)

Organi përbarues në parim para se të filloj sekuestrimin, debitorit ia dorëzon aktvendimin për përbarimin dhe e urdhëron që ta paguaj menjëherë shumën e të hollave bashkë me kamatat dhe shpenzimet procedurale, për të cilën është lejuar përbarimi.

Nëse është e pamundshme që t'i dorëzohet debitorit aktvendimi apo urdhri përbarimor në rastin e sekuestrimit, atëherë lejohet kryerja e njoftimit duke vendosur një njoftim për datën e

sekuestrimit në tabelën e shpalljeve të organit përbarimor dhe të lihet një kopje e vendimit përbarues në lokalet ku bëhet sekuestrimi.

Për kohën dhe vendin e sekuestrimit të sendeve të luajtshme, kreditori do të njoftohet nga organi përbarimor.

Mos prania e palëve nuk e pengon kryerjen e sekuestrimit. Për sekuestrimin e kryer njoftohet pala e cila nuk ka qenë e pranishme në vendin e sekuestrimit të kryer.

Sekuestrimi bëhet me anë të përpilimit të regjistrit të inventarizimit ne sendet e luajtshme që ndodhen në posedim të debitorit, si dhe sendet e debitorit që ndodhen në posedim të kreditorit. (neni 88 i LPP-es)

Në qoftë se personat e tretë nuk e njoftojnë organin përbarimor për të drejtat e tyre për sendet në posedim të debitorit, e as nuk i provojnë të drejtat e tyre për to në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga data e njoftimit dhe më së voni tre (3) muaj nga data e sekuestrimit, merret se të drejtat e tilla të personave të tretë nuk ekzistojnë dhe se debitori është pronar i sendeve që ndodhen në posedimin e tij.

Supozohet se bashkëshortët martesor dhe jashtëmartesor janë bashkëpronar në pjesë të barabarta të gjitha sendeve të luajtshme që gjenden në shtëpinë, banesën ose lokalin afarist të tyre. Sendet e debitorit që ndodhen në posedim të personit të tretë mund të inventarizohen vetëm me pëlqimin e këtij të fundit.

Në qoftë se personi i tretë nuk e jep pëlqimin për inventarizim, organi përbarues me propozimin e kreditorit, këtij të fundit ia kalon të drejtën e debitorit që t'i dorëzohen sendet nga i tretë.

Me anë të inventarizimit sekuestrues përfshihen aq sende të luajtshme, sa mjaftojnë për përmbushjen e kredisë në të holla të kreditorit të përbarimit dhe për pagimin e shpenzimeve procedurale.

Së pari inventarizohen sendet për të cilat nuk ka vërejtje lidhur me ekzistimin e të drejtës që do ta pengonin përbarimin dhe sendet që mund të shiten më lehtë.

Sendet e inventarizuara organi përbarues ia lenë për ruajtje debitorit. Me propozimin e kreditorit organi përbarues mund të vendosë që ato t'i dorëzohen për ruajtje atij.(neni 90 i LPP) Rrezikun e asgjësimit apo të dëmtimit të sendeve të inventarizuara të dhëna për ruajtje kreditorit e bartë ky i fundit, përveçse kur asgjësimi ose dëmtimi është pasojë e fuqisë madhore. Secili person që i posedon apo mbikëqyrë sendet e inventarizuara, i ndalohet që të disponojë me sendet e tilla pa urdhrin e organit përbarues. (91 i LPP)

3.3.3 Fitimi i të drejtës së pengut

Kreditori e fiton të drejtën e pengut për sendet e luajtshme të inventarizuara.(neni 92 i LPP-es) Në qoftë se inventarizimi është bërë në dobi të më tepër kreditorëve, radha e përparësisë së të drejtës së pengut e fituar me anë të inventarizimit apo shënimit në regjistrin e inventarizimit sekuestrues, caktohet sipas ditës në të cilën ka arritur tek organi përbarues propozimi për përbarim. Po qe se propozimet e tilla kanë arritur tek organi përbarues në të njëjtën ditë, atëherë të drejtat e pengut konsiderohen se janë të radhës së njëjtë.

Propozimi për përmbardim i dërguar tek organi përmbardues me anë të letrës rekomande, konsiderohet se është dorëzuar tek organi përmbardues në ditën kur ajo i është dorëzuar postës. Propozimi për përmbardim i dorëzuar organi përmbardues përmes komunikimit elektronik, nëse lejohet nga organi përmbardues, konsiderohet se i është dorëzuar organi përmbardues në datën kur është dërguar komunikimi elektronik, në pajtim me ligjin për procedurën kontestimore.

Po që se me rastin e sekuestrimit në pasurinë e debitorit nuk gjenden sende të luajtshme që mund të bëhen objekt përmbardimi, organi përmbardues për një gjë të tillë do ta njoftoj kërkuesin e përmbardimit nëse nuk ka qenë i pranishëm gjatë sekuestrimit.

Me kërkesën e kreditorit i cili përcakton mundësinë se debitori dinë se ku mund të gjenden pasuritë e padeklaruara të luajtshme, organi përmbardues urdhëron debitorin që në afat prej tre (3) ditësh nga dita e dorëzimit të jep informatat për vendndodhjen e pasurive të luajtshme.

Nëse debitori nuk respekton këtë detyrim aplikohen dispozitat e neneve 15 dhe 16 të këtij ligji. Kërkuesi i sekuestrimit, brenda afatit prej tre (3) muajsh nga dita në të cilën i është dërguar njoftimi, respektivisht nga dita e tentimit të sekuestrimit me rastin e të cilit ka qenë i pranishëm, mund të propozoj që sekuestrimi përsëri të kryhet.

Nëse kërkuesi i përmbardimit brenda këtij afati nuk e propozon kryerjen e serishme të sekuestrimit, apo nëse as me rastin e sekuestrimit të serishëm nuk gjenden sende që mund të bëhen objekt përmbardimi, autoriteti përmbardues do ta pezulloj procedurën e përmbardimit. Në rastin e sekuestrimit të sendeve, organi përmbardues e bënë edhe vlerësimin e vlerës së sendeve të luajtshme.

Vlerësimin e bënë organi përmbardues, po që se Gjykata nuk e ka caktuar për një gjë të tillë vlerësuesin gjyqësor apo ekspertin e posaçëm, ose përmbarduesi privat ka caktuar një ekspert të posaçëm.

Pala mund të propozojë që vlerësimin ta bëjë eksperti edhe kur një gjë të tillë nuk e ka paraparë organi përmbardues. Nëse organi përmbardues e miraton propozimin e tillë, shpenzimet e ekspertimit është i detyruar ti parapaguaj propozuesi brenda afatit të caktuar nga organi përmbardues. Nëse parapagimi nuk bëhet brenda afatit të caktuar, nga organi përmbardues, konsiderohet se propozuesi ka hequr dorë nga propozimi i tij.

Për propozimin për caktimin e ekspertit organi përmbardues vendosë me anë të vendimit që ka formë të konkluzionit.

Secila palë ka të drejtë që brenda afatit prej tre (3) ditësh, nga dita e vlerësimit të bërë të sendeve të sekuestruara, që t'i propozojë organi përmbardues caktim të vlerës më të vogël apo më të madhe të sendeve të sekuestruara nga ajo e caktuar më parë, apo caktim të vlerësimit të ri. Një gjë e tillë nuk lejohet po që se vlerësimin e parë e ka bërë eksperti. Lidhur me këtë propozim organi përmbardues vendosë me anë të konkluzionit.

Për regjistrimin dhe vlerësimin sekuestrues Gjykata përpilon procesverbal. Në procesverbal veç e veç tregohen sendet e sekuestruara dhe vlera e tyre e caktuar, si dhe shënohen deklaratat e palëve dhe të pjesëmarrësve të tjerë të procedurës, e edhe ato të personave të tretë për ekzistimin eventual të të drejtave të tyre që mund ta pengojnë përmbardimin për sendet e sekuestruara. neni 96 i LPP.

Në sendet e sekuestruara vihet shenja e caktuar nga e cila shihet se janë të sekuestruara. Kreditori ka të drejtë që në procesverbalin e organit përmbardues të përpiluar me rastin e sekuestrimit të

sendeve të debitorit ta publikojë në mjetet e informimit publik.

3.3.4 Shitja e sendeve të sekuestruara

Në praktikën gjyqësore organizimi i ankandeve mbetet sfide për shkak të mungesës së hapësirave ku gjykatat do ti vendosnin sendet e sekuestruara si dhe krijimit të mendimit se sendet në ankande publike nuk duhet blere.

Shitja e sendeve të sekuestruara kryhet jo më herët se pesëmbëdhjetë (15) ditë dhe jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e sekuestrimit.

Shitja mund të bëhet edhe para skadimit të afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga po që se debitori propozon, apo pajtohet me propozimin e kreditorit që shitja e sendeve të sekuestruara të bëhet më herët.

Shitja e sendeve të sekuestruara mund të bëhet para skadimit të afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, po që se sendet e këtilla prishen shpejtë, apo kur ekziston mundësia që të bie dukshëm çmimi i tyre pas një kohe të shkurtër.

Në qoftë se kreditori jep garancinë për dëmin eventual që do të duhej kompensuar debitorit në rast të anulimit të vendimit për përmbarimin, shitja e sendeve të sekuestruara mund të bëhet edhe para skadimit të afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh.

Shitja e sendeve të sekuestruara bëhet me anë të ankandit verbal publik ose me ujdinë e drejtpërdrejtë midis blerësit, nga njëra anë dhe organi përmbarues, apo subjektit tjetër të autorizuar, nga ana tjetër.

Mënyra e shitjes së sendeve caktohet me anë të konkluzionit të organit përmbarues, duke pasur parasysh faktin që të arrihet çmimi më i volitshëm për debitorin.

Ankandin publik të shitjes e administron organi përmbarues, apo personi tjetër i caktuar nga organi përmbarues.

Shitja me anë të ujdisë së drejtpërdrejtë bëhet midis blerësit, nga njëra anë dhe organit përmbarues, apo personit që kryen veprime komisioni, nga ana tjetër. Organi përmbarues sendet e sekuestruara i shet në emër dhe llogari të debitorit, kurse personi që merret me veprime komisioni, në emër të vet, por për llogari të debitorit.

Shitja me anë të ankandit do të caktohet në qoftë se është fjala për sendet e sekuestruara që kanë vlerë të madhe, ndërkaq mund të pritet se ato do të shiten sipas çmimit më të lartë nga sa është shuma e vlerësuar.

Shitja e sendeve do të publikohet në tabelën e shpalljeve të organit përmbarues së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para se të mbahet seanca për shitjen e tyre. Publikimi i shitjes mund të bëhet edhe në mënyrën e paraparë për publikimin e shitjes së sendeve të paluajtshme. Pala mund të përcaktojë se, përveç këtyre mjeteve të shpalljes së shitjes publike, mund të përdoren mjetet tjera të shpalljes, në shpenzim të asaj pale, dhe organi përmbarues do të ndihmojnë që shpallja të bëhet edhe me këto mjete shtesë.

Kreditori dhe debitori do të informohen për vendin, ditën dhe orën e shitjes së sendeve të sekuestruara. Neni 99 i LPP-së.

3.3.5 Seanca e shitjes publike

Neni 15 i ligjit për ndryshime dhe plotësime parashikon që të mbahet vetëm një seance e ankandit të shitjes. Sendet e sekuestruara mund të shiten në seancën e shitjes publike me çmim më të vogël se ai i caktuar, por jo me çmimin më të vogël së pesëdhjetë përqind (50 %) e vlerës së caktuar me rastin e regjistrimit dhe vlerësimit të sendeve të luajtshme të debitorit, respektivisht në afatin që e ka caktuar organi përmbarues për shitjen e tyre me anë të ujdisë së drejtpërdrejtë.

Seanca e shitjes publike mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e sekuestrimit. Nëse sendet e sekuestruara nuk shiten në seancën e shitjes, atëherë kreditori mund të kërkojë transferimin e sendeve në pronësi të tij, për mbulim të pjesshëm apo të plotë të kredisë në çmim të vlerësuar të atyre sendeve, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e mbajtjes së seancës së shitjes publike.

Organi përmbarues e pezullon përmbarimin, nëse nuk ka asnjë ofertues apo nëse nuk ka propozim për shitjen me anë të ujdisë së drejtpërdrejt brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve apo nëse kreditori nuk paraqet propozim për transferim të sendeve në pronësi të kreditorit sipas paragrafit 3. të nenit 100 të ligjit.

3.3.6 E drejta e pengut

Përkufizimin e pengut e rregullon Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Pronësore ku në nenin 133 citohet “E drejta e pengut”(pengu) do të thotë krijimi i ndonjë interesi mbi pasurinë e luajtshme ose mbi ndonjë të drejtë me anë të marrëveshjes ose me anë të ligjit, i cili i jep pengmarrësit të drejtën për ta marrë në posedim atë pasuri ose për ta shfrytëzuar atë të drejtë me qëllim të përmbushjes së ndonjë obligimi ekzistues dhe të identifikueshëm që është siguruar me anë të pengut.

Kontrata e pengut mund t’i shmanget dispozitave të këtij ligji. Në raste të veçanta ajo mund të parasheh që pengu të sigurojë ndonjë obligim i cili ka efekt vetëm pas lidhjes së kontratës së pengut.

- **Llojet e të drejtës së pengut**

Nëse pengdhënësi dhe pengmarrësi nuk janë marrë vesh në kontratën për pengun që pengu të jetë posedimor, pengdhënësi e ruan të drejtën për ta poseduar, përdorur dhe për t’i gëzuar të gjitha të drejtat në sendin e lënë peng, përveç nëse me këtë ligj parashihet ndryshe. (neni 134 i LPDS)

Pengu posedimor ka efekt ndaj personave të tretë vetëm atëherë kur të nënshkruhet kontrata për pengun dhe kur sendi i lënë peng të ketë kaluar në posedim të pengmarrësit ose të agjentit të caktuar nga pengmarrësi.

Pengu pa posedim ka efekt ndaj palëve të treta vetëm atëherë kur të parashtrohet deklarata për njoftim në përputhje me këtë Ligj. (Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Pronësore)
Krijimi i të drejtë së pengut mbi ndonjë të drejtë kërkon regjistrimin e pengut në regjistrin e pengut.

Pengu ligjor themelohet në baze të vet ligjit pra në momentin kur plotësohet faktet e parashikuara në dispozitat ligjore. Nëse kjo e drejtë nuk është i nevojshëm deklarimi i vullnetit të palëve kontraktuese. Një lloj të pengut ligjor kemi në rastin e vendosjes në hotel, kur të gjitha

sendet e luajtshme të cilat i ka personi i vendosur, deri në përmbushjen e detyrimit ndaj hotelit, konsiderohen peng në baze të ligjit.

Bazuar në dispozitat e Ligjit për Pronësinë dhe të drejtat tjera Sendore e drejta e pengut ligjor ka efekt ndaj palëve të treta vetëm atëherë kur të parashtrahet deklarata për njoftim në përputhje me ligjin. Përveç në rastet kur palët pajtohen ndryshe, e drejta e pengut ligjor të qiradhënësit ka efekt vetëm atëherë kur sendi i lënë peng të ketë kaluar në posedim të qiradhënësit.

Pengu gjyqësor mund të themelohet me vendim të organit gjyqësor. Në këto raste vendimi i gjykatës paraqet titullin juridik për fitimin e së drejtës së pengut. Konstituimi i kësaj të drejte behet në kundërshtim me vullnetin e debitorit. Megjithatë ka raste kur edhe në procedurën përbarimore themelohet peng gjyqësor me marrëveshjen e kreditorit dhe debitorit.

- **Dallimet në mes të pengut gjyqësor dhe pengut të kontraktuar**

Pengu gjyqësor krijohet me rastin e inventarizimit dhe regjistrimit të sendeve të debitorit nga ana e organit përbarues pavarësisht se debitorit shpreh vullnet për regjistrimin e sendeve dhe me pas shitjen e tyre në ankand publik.

Pengu i kontraktuar krijohet me marrëveshje të palëve rreth të drejtave dhe detyrimeve të tyre reciproke, përderisa në rast të veçantë nuk bien ndesh me rregullat imperative të këtij ligji. Kontrata mundet në çdo kohë të plotësohet, të ndryshohet apo të shuhet.

Organi përbarues ka për obligim që pas krijimit të pengut gjyqësor të vazhdojë me procedurën përbarimore të organizoi ankandet publike për shitjen e sendeve me qëllim të realizimit të kërkesës së kreditorit.

Me rastin e përbarimit të pengut të kontraktuar organi përbarues ka për detyrë që në baze të kërkesës së kreditorit të marrë sendet e lëna peng dhe të dorëzojë kreditorit ku me pas kreditori organizon shitjen sipas dispozitave ligjore.

- **Autorizimi për shitjen e sendit të lënë peng**

Pengdhënësi duhet të jetë pronar i sendit të lënë peng në kohën e lënies së pengut. Nëse pengdhënësi nuk është pronar i sendit të lënë peng, ai duhet të ketë autorizimin ligjor për vënien e të drejtës së pengut.

Pasuria e një bashkëpronësie ose të një pronësie të përbashkët mund të lihet peng vetëm nëse të gjithë bashkëpronarët ose pronarët e përbashkët e japin pëlqimin për pengun.

Ndonjë person i cili është pronar i një interesi të pjesshëm në pasurinë e luajtshme mund ta lë peng atë interes pa pëlqimin e pronarëve tjerë të interesit të pjesshëm.

Një e drejtë e pengut mund të krijohet në një depo mallrash me përmbajtje të ndryshueshme nëse vendndodhja dhe përmbajtja e depon janë të përshkruara mjaft qartë në kontratën e pengut.

Secili mall që shtohet në depo në të cilën është krijuar e drejta e pengut i nënshtrohet të drejtës së pengut prej momentit kur ai mall i shtohet depon.

Një e drejtë e pengut e siguron tërë shumën e kërkesës, duke përfshirë kapitalin dhe kamatën e papaguar, dënimet kontraktuese, shpenzimet e zbatimit, të mirëmbajtjes dhe shitjes së objekti të pengut.

Pas krijimit të së drejtës së pengut, pengdhënësi dhe pengmarrësi mund të pajtohen që ta rrisin

kërkesën e siguruar ose ta rrisin objektin e pengut. Për çdo rritje e cila nuk është e bashkëngjitur apo e lidhur me objektin e pengut, duhet të trajtohet si krijim i një të drejte të re të pengut.

- **E drejta e pengut ndaj palëve te treta**

Kjo e drejtë është e parapare ne nenin 149 te Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore(ne vazhdim LPDS) ku citohet "Nëse një kërkesë për pagesë në të holla është lënë peng, atëherë debitori i kësaj kërkesë ("debitori i tretë") mund ta përmbushë detyrimin në përputhje me kontratën me pengdhënësin."

Nëse pengdhënësi ose pengmarrësi e ka njoftuar debitorin e tretë lidhur me lënien peng, debitori i tretë duhet t'ia bëjë pagesën pengmarrësit pasi të ketë ardhur koha për pagesën e kërkesës së lënë peng.

Njoftimi për debitorin e tretë duhet të bëhet me shkrim, të përfshijë emrat e pengdhënësit dhe pengmarrësit, të identifikojë kërkesën e siguruar me anë të pengut dhe të përmbajë udhëzime të sakta rreth mënyrës së pagesës për pengmarrësin.

Bazuar ne nenin 150 debitori i tretë ka të drejtë të bëjë kundërshtimet e njëjta lidhur me kërkesën për pagesë nga pengmarrësi, të cilat ai i ka kundër pengdhënësit si kreditori paraprak i kërkesës së lënë peng.

Në qoftë se nuk është arritur marrëveshje tjetër, një pengdhënës mund të lë peng disa sende pasurore ose të drejtën e njëjtë.

- **Fitimi i sendit të lënë peng nga pala e tretë**

Në bazë të dispozitave të Ligjit për pronësinë dhe te drejtat tjera sendore, sendi i lënë peng mund të ngarkohet apo të fitohet nga pala e tretë vetëm në bazë të ndonjë të drejte ekzistuese të pengut. Sendi i lënë peng fitohet i pangarkuar, nëse:

- sendi i lënë peng është shitur në qarkullimin afarist të zakonshëm të pengdhënësit;
- sendi i lënë peng është shitur me pëlqimin e dhënë me shkrim nga të gjithë pengmarrësit të cilët kanë ndonjë të drejtë të pengut në atë send;
- sendi i lënë peng është ndonjë aksion, borxh ose ndonjë instrument sigurie i ofruar në ndonjë treg të pranuar, ndonjë instrument negociimi apo dokument pronësie, ose para të gatshme; ose
- blerësi mund të supozojë me mirëbesim në kohën e blerjes se ndaj sendit të lënë peng nuk ekziston ndonjë e drejtë tjetër.

Mallrat nga ndonjë depo, të shitura në qarkullimin afarist të zakonshëm të pengdhënësit, mund të fitohen të pangarkuara edhe nëse blerësi ka pas njohuri për të drejtën e pengut.

Bartja e kërkesës të siguruar nga pengmarrësi konsiderohet bartje e të drejtës së pengut që e siguron këtë kërkesë. Pengmarrësi e njofton pengdhënësin lidhur me bartjen.

3.3.7 Regjistrimi i të drejtave të pengut pa posedim

Sipas nenit 162 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore regjistrimi i të drejtës së pengut pa posedim në regjistrin e pengut prodhon efekt me regjistrimin e njoftimit të pengut në zyrën për regjistrimin e pengut. Njoftimi i pengut përfshin:

- identitetin e qartë të pengdhënësit, personit i cili duhet ta paguajë kërkesën e siguruar nëse nuk

është pengdhënësi) dhe të pengmarrësit;

- përcaktimin e veçantë apo të përgjithshëm të natyrës së detyrimit të siguruar;
- vlerën maksimale të detyrimit të siguruar të shprehur në para;
- përcaktimin e veçantë apo të përgjithshëm të sendit të lënë peng;
- nënshkrimin nga pengdhënësi ose në emër të tij dhe
- datën e kontratës së pengut.

Një peng konsiderohet të jetë i regjistruar në regjistrin e pengut, atëherë kur njoftimi i pengut të ketë arritur në zyrën për regjistrimin e pengut në formën e parashikuar dhe duke e paguar taksën e parashikuar.

Regjistrimi në regjistrin e pengut është i vlefshëm për tri (3) vjet nga koha e regjistrimit. Me kalimin e afatit tri (3) vjeçar, e drejta e pengut pa posedim e humb efektin e saj ndaj personave të tretë, përveç kur vazhdohet regjistrimi ose kur pengut pa posedim shndërrohet në peng posedimor.

- **Shlyerja e regjistrimit**

Nëse e drejta e pengut shuhet, pengmarrësi duhet që brenda një muaji ta regjistrojë këtë shuarje në regjistrin e pengut duke e paraqitur njoftimin për shlyerje në zyrën për regjistrimin e pengut.

Njoftimi për shlyerje përfshin nënshkrimin e pengmarrësit dhe njoftimin se pengmarrësi nuk kërkon më ndonjë të drejtë pengut mbi një send apo të drejtë siç është theksuar në njoftimin e pengut, i cili duhet të identifikohet me anë të numrit të dokumentimit të tij. Para se të regjistrohet njoftimi për shlyerje, i cili është nënshkruar nga ndonjë person që nuk është pengmarrës atij duhet bashkëngjitur autorizimin me shkrim të dhënë nga pengmarrësi.

Pengmarrësi, i cili nuk e regjistron ose nuk e regjistron brenda kohës së parashikuar njoftimin për shlyerje, i përgjigjet pengdhënësit për dëmet e shkaktuara nga vonesa ose mos regjistrimi i njoftimit për shlyerje.

- **Ekzekutimi i së drejtës së pengut**

Bazuar në nenin 166 Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore nëse pengdhënësi ose debitori i detyrimit të siguruar, nëse ky nuk është njëkohësisht pengdhënës, nuk e përmbush detyrimin e siguruar ose kontratën e pengut, pengmarrësi i pengut pa posedim mund të kërkojë nga pengdhënësi që t'ia dorëzojë sendin e lënë peng.

Nëse pengdhënësi i pengut pa posedim nuk e dorëzon sendin e lënë peng, pengmarrësi mund ta marrë në posedim sendin e lënë peng me ndihmën e gjykatës kompetente.

3.3.8 Ekzekutimi gjyqësor i kërkesës për posedim

Pengmarrësi i pengut pa posedim mund të paraqesë një kërkesë në gjykatën kompetente, që pa pjesëmarrjen dhe dëgjimin e pengdhënësit apo personave të tjerë atë ta autorizojë që sendin e lënë peng ta sekuestrojë dhe t'ia dorëzojë pengmarrësit. Rreth kësaj kërkesë gjykata duhet të vendosë më së voni pesë (5) ditë pune pas datës së paraqitjes së kërkesës.

Pengdhënësi ose debitori i kërkesës së siguar, nëse ky nuk është njëkohësisht pengdhënës, mund të paraqesë kërkesë në gjykatën kompetente që të konstatohet se, e drejta e pengut është e pavlefshme tërësisht apo pjesërisht.

- **Shitja e sendit të lënë peng**

Në rast të vonesës, pengmarrësi mund ta shesë, ta huazojë apo të disponojë në ndonjë mënyrë tjetër me sendin e lënë peng. Shitja e sendit të lënë peng mund të bëhet përmes ankandit publik apo në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme. Pengmarrësi duhet të përpiqet që ta arrijë vlerën e duhur të tregut gjatë shitjes së sendit të lënë peng.

Pengmarrësi duhet ta njoftojë pengdhënësin së paku katërbëdhjetë (14) ditë para shitjes për kohën dhe vendin e shitjes. Ky njoftim duhet t'i dërgohet edhe debitorit të detyrimit të siguar, nëse ky nuk është njëkohësisht pengdhënës, si edhe titullarëve të tjerë të së drejtës së pengut për të njëjtin send të lënë peng.

Pengdhënësi mbetet përgjegjës në rast se shuma e fituar me anë të shitjes së sendit të lënë peng është më e vogël se detyrimi i siguar.

- **Kufizimet për fitimin e sendit të lënë peng**

Pengmarrësi mund ta blejë sendin e lënë peng vetëm në ankand publik ose shitje private po që se sendi i lënë peng shitet në një treg të njohur apo në rastet ku për sendin e lënë peng ekzistojnë çmime standarde gjerësisht të ditura.

Pengmarrësi mund t'i ofrojë pengdhënësit që ta pranojë sendin e lënë peng në përmbushje të plotë ose të pjesshme të detyrimit të siguar. Oferta bëhet e detyrueshme nëse pengdhënësi shpreh pëlqimin me shkrim dhe debitori i detyrimit të siguar, nëse ky nuk është njëkohësisht pengdhënës, apo ndonjë palë tjetër me interes ligjor për ta përmbushur detyrimin e siguar nuk kundërshton me shkrim brenda katërbëdhjetë (14) ditëve pas marrjes së ofertës.

3.3.9 Shitja e paluajtshmërive

Përmbartimi në sendet e paluajtshme rregullohet sipas dispozitave nga neni 190 deri në nenin 271 të LPP-së si dhe sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit të procedurës përmbartimore nr. 04/L-139.

Në rastet kur përmbartimi kërkohet me shitjen e paluajtshmërive si atyre që nuk janë vënë nën hipoteke po ashtu edhe të atyre të vena në hipoteke paraqesin mënyrën më të vështirë të realizimit të kërkesës së kreditorit për arsye se kostoja e procedurës është e lartë duke pasur parasysh faktin se duhet të ndërmerren shume veprime të cilat shkaktojnë vonesa të mëdha.

Kur si objekt ekzekutimi mund të jetë paluajtshmeria e cila nuk është vënë nën hipotekë me marrëveshjen e palëve veprimet ekzekutive të gjykatës duhet kalonin nëpër disa faza:

- Shënimi i paluajtshmërisë në librat publike,
- Përcaktimi i vlerës së paluajtshmërisë,
- Shitja e paluajtshmërisë, dhe
- Pagimi i kreditorëve nga shitja e paluajtshmërisë.

Paluajtshmëria si objekt ekzekutimi mund të bëhet si tersi e caktuar me anë të dispozitave që rregullon pronësinë, si dhe bashkëpronësia mund të jetë objekt ekzekutimi.

3.3.10 Ankandet

Qëllimi i ankandit publik është të fitohet çmimi më i lartë i mundur për paluajtshmërinë duke inkurajuar për pjesëmarrje numër të madh të ofertuesve. Në rast se vetëm një ofertues është prezent, ligji lejon që procedura të vazhdojë. Kjo parashihet njësoj në ligjin e vjetër ashtu edhe në të riun.

Afatet në mes të ankandeve janë më të gjatë nga afatet e ankandeve për sendet e luajtshme duke pas për qëllim të tërheqjen e ofertuesve të rinj.

Shitjet me ankand janë duke u përcjellë me probleme të mëdha në praktike ne Kosove Sfida kryesore është interesimi i vogël i palëve për të blerë këto paluajtshmëri i gërshetuar me mendimin e krijuar se sendet e vena në hipotekë pas blerjes mund të përcillen me probleme. Ky mendim duhet harruar sa me pare dhe duhet kuptuar se edhe ky është një proces ligjor që duhet realizuar. Kjo situatë shihet se është duke u përmirësuar por me hapa shumë të ngadalshëm.

Konform dispozitave ligjore gjyqtari ka për detyrë që të verifikojë se:

- Paluajtshmëria është pronë e debitorit;
- Vendimi mbi përmbarrimin është regjistruar në librin publik të paluajtshmërive;
- Njoftimi mbi ankandin është publikuar së paku 30 ditë para ankandit; si dhe
- Të udhëheqë ankandin publik, përfshirë përfundimin e ankandit 5 minuta pas ofertës më të mirë.

Ligji Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit të procedurës përmbarrimore nr. 04/L-139 parasheh vetëm dy ankande të shitjes se palutshmërive. Në seancën e parë të shitjes publike, paluajtshmëria nuk mund të shitet me çmimin që është më i ulët se pesëdhjetë përqind (50%) e vlerës së përcaktuar me vlerësimin e paluajtshmërisë. Ofertat fillestare në seancën e parë të shitjes publike, të cilat janë më të vogla se pesëdhjetë përqind (50%) e vlerës së përcaktuar, nuk do të shqyrtohen.

Në qoftë se paluajtshmëria nuk ka mundur të shitet në seancën e parë të shitjes publike, organi përmbarrues e cakton seancën e dytë të shitjes publike, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) deri në tridhjetë (30) ditë. Në këtë seancë, paluajtshmëria nuk mund të shitet me çmim më të vogël se një e treta (1/3) e vlerës së përcaktuar të paluajtshmërisë”.

Në qoftë se paluajtshmëria nuk ka mundur të shitet as në ankandin e dytë, atëherë me propozim të kreditorit, organi përmbarrues merr vendim që paluajtshmëria t’i dorëzohet kreditorit duke

kaluar në pronësi të tij, me ç'rast edhe kërkesa ndaj debitorit konsiderohet si e përmbushur në tërësi.

Po që se nuk ekzistojnë persona me të drejtë parablerjeje ligjore, apo kontraktuale, atëherë personi i cili sipas këtij ligji e ka të drejtën e realizimit me prioritet të kredisë së tij nga çmimi i shitjes, e fiton të drejtën e parablerjes së palujatshmërisë me çmimin e arritur në seancën e dytë.

Po ashtu është ndryshuar edhe neni 220 i ligjit bazik, pas paragrafit 1., shtohet paragraf i ri 1a., me tekstin si vijon: 1a. Në rast të kontestimit të vlerës së palujatshmërisë, të arritur nga palët para procedurës përbarimore, organi përbarues me propozim të palëve mund të caktoj ekspertin përkatës për caktimin e vlerës së palujatshmërisë”.

3.3.11 Shitja me marrëveshje

Nëse palët dhe kreditorët e hipotekës arrijnë marrëveshje për shitjen e pronës pa ankand, do të bëhet shitja me marrëveshje të drejtpërdrejtë. Shitja e drejtpërdrejtë duhet të shënohet në kontratë me shkrim .

Në praktikë, kjo mënyrë e shitjes shpesh ka qenë e duhur për shkak të problemeve me shitjen në ankand. Në çdo kohë, palët dhe kreditorët e pengut mund të pajtohen të kalojnë nga procedura e ankandit në marrëveshje. Vendimi i tyre duhet të shënohet në procesverbalin e procedurës së përbarimit.

3.3.12 Shitja përmes gjykatës

Në Ligjin nr.2002/4 për hipotekat lidhur me shitjen e palujtshmërive ne nenin 9 citohet se procedura zhvillohet sipas ligjit në fuqi mbi procedurën e ekzekutimit. Në nenin 294 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore citohet “Për hipotekat, të cilat sipas Ligjit 2002/21 të datës 20.12.2002 janë të vlefshme, zbatohen edhe më tutje dispozitat e këtij Ligji, nëse nuk është paraparë ndryshe me këtë ligj. Për hipotekat, të cilat para hyrjes në fuqi së këtij ligjit duhet të jenë në përputhshmëri me kushtet e aplikueshme të regjistrimit të themeluara me këtë ligj”(s qarim rregullorja është nr.2002/21 ndërsa Ligji për hipotekat është nr.2002/4).

Ndërsa Ligji Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore ne kapitullin III të këtij ligji ka rregulluar hipotekat ne nenin 199 të këtij ligji parashihet përmbushja e kërkesës së kreditorit hipotekues përmes përbarimit të detyrueshëm.

Në rast të vonesës ose të një shkelje tjetër të kontratës nga debitori, kreditori hipotekues mund të fitojë të drejtën përmes padisë gjyqësore që palujtshmërinë e ngarkuar ta shesë dhe kërkesën e siguruar ta përmbush në radhë të parë nga shuma rezultuese (e fituar nga shitja).

Kushtet dhe procedura mbështeten në dispozitat e përmbarimit të detyrueshëm.

Në praktikë kjo ka sjell dilema të mëdha sepse ekspertet kanë qenë të ndarë në interpretimin e shprehjeve propozim dhe padë. Aktualisht një qëndrim i Gjykatës Supreme ka hequr këto dilema.

Sipas këtij qëndrimi parimor të Gjykatës Supreme Agj.nr.K584/2012 të dt.11.12.2012, vendimi i Këshillit të pavarur Mbikëqyrës të Kosovës që ka të bëjë me kthimin e punëtorit në vendin e punës paraqet titull përmbarues për gjykatën.

3.3.13 Hipoteka si rast special i pasurisë së paluajtshme të regjistruar

Hipoteka në Kosove është rregulluar me Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore nr. 03/L-154, si dhe me Ligjin për hipotekat nr. 2002/4.

“Hipoteka” do të thotë krijimi i interesit në pasurinë e paluajtshme me anë të marrëveshjes apo ligjit, që kreditorit të hipotekës (pengmbajtësit) i jep të drejtën të iniciojë procedurën për heqjen e të drejtës mbi pronën e vënë në hipotekë për pasurinë e tillë të paluajtshme, me qëllim të përmbushjes së një detyrimi që është siguruar me hipotekë dhe që duhet të paguhet.

Hipoteka krijohet përmes një kontrate ndërmjet pronarit të paluajtshmërisë së ngarkuar dhe kreditorit hipotekues si dhe përmes regjistrimit në Regjistrin e të drejtave për paluajtshmëritë neni 173 i Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore.

Kontrata e hipotekës

Kontrata e hipotekës duhet të lidhet në formën me shkrim. Nënshkrimet e pronarit të paluajtshmërisë dhe kreditorit hipotekues duhet të vërtetohen sipas të njëjtave rregulla sikurse punët e tjera juridike rreth paluajtshmërisë.

Kontrata e hipotekës duhet të përmbajë së paku këto të dhëna:

Emrat dhe adresat e pronarit të paluajtshmerisë dhe të kreditorit hipotekues si dhe të debitorit të kërkesës së siguruar, në rast se ky nuk është njëkohësisht pronar i paluajtshmerisë së ngarkuar;

Përshkrimin e saktë të paluajtshmerisë së ngarkuar sipas vendit, rrugës dhe numrit të shtëpisë ose të dhëna të tjera të sakta rreth pozitës si dhe numrin kadastral;

Një fletë poseduese dhe vërtetimet rreth përdorimit të paluajtshmerisë, nëse është e nevojshme; Shumën e kërkesës së siguruar përmes hipotekës, duke përfshirë edhe kamatën;

Eventualisht jepet shuma maksimale e kontraktuar;

Një paralajmërim në shkrim me shkronja të mëdha të theksuara, se në rast të vonesës së pagesës ose paraqitjes (arritjes) së kushteve të tjera të kontraktuara kreditori hipotekues do të nisë procedurën e përmbarimit, e cila mund të shpie tek humbja e pronësisë në paluajtshmerinë e ngarkuar dhe braktisjen e shtëpisë dhe paluajtshmerisë;

Palët mund të bëjnë marrëveshje të tjera, nëse këtë e kërkon ky ligj apo ligje të tjera, përderisa këtë e lejojnë rregullat imperative;

Datën e nënshkrimit të kontratës;

Nënshkrimet e vërtetuara të pronarit të paluajtshmerisë së ngarkuar dhe të kreditorit hipotekues.

Hipoteka shtrihet mbi të gjitha pjesët e paluajtshmerisë së ngarkuar, duke përfshirë edhe ndërtesat që aty qëndrojnë apo janë të lidhura në mënyrë të pandashme me tokën.

Përrjashtimisht nga paragrafi 1 i nenit 176 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore mund të krijohet një hipotekë e pavarur, e cila nuk shtrihet mbipjesët e tjera të paluajtshmerisë në një ndërtesë ose në një banesë, të cilat i plotësojnë kushtet e nenit 10 paragrafi 2 nën-paragrafët 2.1. dhe 2.2. të këtij ligji.

Hipoteka përfshin edhe të gjitha pjesët tjera dhe frutat natyrore të paluajtshmerisë, përderisa këto nuk janë të ndara nga sendi kryesor.

Nëse paluajtshmeria është dhënë me qira, hipoteka shtrihet edhe në kërkesat nga qiraja të pronarit të paluajtshmerisë.

Paluajtshmëria me shumë pronarë

Në një pjesë të bashkëpronësisë ose të pronësisë së përbashkët nuk mund të vihet hipoteka pa pëlqimin e bashkëpronarëve të tjerë ose të pronarëve të përbashkët (neni 179 i Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore).

Hipoteka e përbashkët

Një hipotekë mund të vihet për të njëjtën kërkesë në disa paluajtshmeri të të njëjtit pronar ose të pronarëve të ndryshëm (hipoteka e përbashkët). Secila paluajtshmeri përgjigjet për tërë kërkesën e siguruar.

Kërkesa e siguruar

Hipoteka siguron tërë shumën e kërkesës duke përfshire kapitalin dhe kamatën papaguar, dënimet kontraktuese, shpenzimet e zbatimit të mirëmbajtjes dhe shitjes.

Pronari i paluajtshmerisë së ngarkuar administron dhe mirëmban me kujdes këtë, duke përfshirë edhe ndërtimet e krijuara mbi to si dhe sendet aksesore, sa është e nevojshme për përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e zakonshme. Pronari i paluajtshmerisë i lejon kreditorit hipotekues apo një të treti të autorizuar nga ky, këqyrjen e paluajtshmerisë së ngarkuar, nëse për këtë paralajmërohet me kohë para kohës së caktuar.

Evitimi i rrezikut përmes gjykatës

Në qoftë se për shkak të veprimeve apo mosveprimeve të pronarit të paluajtshmerisë së siguruar ose të një personi të tretë është paraqitur apo rrezikon të paraqitet zvogëlimi i vlerës së paluajtshmerisë, kreditori hipotekues mund të paditë për përmbajtjet nga sjelljet e tilla.

Në rast të veprimeve ose mosveprimeve të pronarit të paluajtshmerisë së ngarkuar, të cilat sjellin në të ardhmen një zvogëlim të vlerës së paluajtshmerisë, me kërkesë të kreditorit hipotekues, gjykata mund të urdhërojë masa për evitimin e rrezikimit.

Kundërshtimet në lidhje me kërkesën e siguruar

Pronarit të paluajtshmerisë i takojnë të gjitha kundërshtimet kundër kreditorit hipotekues, të cilat i takojnë debitorit për shkak të kërkesës së siguruar ndaj kreditorit. Pronarit të paluajtshmerisë i takojnë përveç kësaj edhe kundërshtimet të cilat mund t'i bëjë të vlefshme një garantues ndaj kreditorit të detyrimit të siguruar. Në qoftë se pronari i paluajtshmerisë nuk është debitori i kërkesës së siguruar, ai mund të referohet në një kundërshtim të debitorit edhe atëherë, kur debitori ka hequr dorë nga ato.

Hipoteka siguron kërkesën e siguruar deri në shlyerjen saj të plotë. Një pagesë e pjesshme nuk cenon përmbajtjen e tërësishme të hipotekës.

Pronari i paluajtshmerisë ka të drejtë që ta përmbushë detyrimin ndaj kreditorit, nëse afati për përmbushje të kërkesës ka arritur ose nëse debitori personal ka të drejtë për prestim.

Shuarja e hipotekës

Hipoteka shuhet përmes shlyerjes së regjistrimit në Regjistrin për të drejtat në paluajtshmeritë.

Shuarja e hipotekës mund të kërkohet, nëse:

Debitori i kërkesës së siguruar ka përmbushur kërkesën përmes pagesës ose në ndonjë mënyrë tjetër;

Kërkesa e siguruar shuhet për arsye të tjera;

Kreditori hipotekues heq dorë nga hipoteka në formën me shkrim dhe duke vërtetuar nënshkrimin e tij;

Kreditori hipotekues dhe pronari i paluajtshmerisë së ngarkuar janë ose bëhen i njëjti person;

Paluajtshmeria e ngarkuar shitet për të përmbushur kërkesën e siguruar.

Vlefshmëria e hipotekës

Hipoteka për të qenë e vlefshme duhet të regjistrohet në Regjistrin për të drejtat në paluajtshmeritë. Procedura dhe efektet e regjistrimit orientohen sipas ligjit për themelimin e një Regjistri për të drejtat në pronën e paluajtshme.

Renditja e disa hipotekave bazohet sipas kohës së regjistrimit të tyre në Regjistrin për të drejtat në paluajtshmeritë nëse nuk është parapare ndryshe me ligj. Nëse është bere bartja i paluajtshmerisë së ngarkuar hipoteka është e vlefshme edhe kundrejt një fituesi të paluajtshmerisë së ngarkuar. Nëse është bere bartja e kërkesës së siguruar atëherë bartët edhe hipoteka tek kreditori i ri, nëse ky efekt nuk është përjashtuar nga palët.

Përmbushja e kërkesës së kreditorit hipotekues përmes përmbarrimit të detyrueshëm

Në rast të vonesës ose të një shkelje tjetër të kontratës nga debitori, kreditori hipotekues mund të fitojë të drejtën përmes padisë gjyqësore që paluajtshmerinë e ngarkuar ta shesë dhe kërkesën e siguruar ta përmbush në radhë të parë nga shuma rezultuese (e fituar nga shitja). Kushtet dhe procedura mbështeten në dispozitat e përmbarrimit të detyrueshëm.

3.4 Ushtrime

Gjatë këtij sesiioni do të prezantohet një shembull praktik i cili do t'iu shpërndalet pjesëmarrësve të cilët pas punës në grupe do të prezantojnë se si hartohet konkluzioni i shitjes dhe ne rastin tjetër do te hartojnë aktvendimin e shitjes se palujtshmerise.

3.5 Përmbledhje

Në këtë sesiion trajnues janë dhënë shpjegime lidhur me përmbarrimin ne sendet e luajtshme, si ne rastet kur duhet te kryhet përmbarrimi lidhur me pengun gjyqësor po ashtu edhe pengun kontraktual, si dhe përmbarrimi ne sendet e paluajtshme

4. Mjetet juridike në procedurën përmbarimore dhe kthimi i punëtorit në punë

4.1 Hyrje

Në këtë sesion trajnuës do të shpjegohet për mjetet juridike në procedurën e përmbarimit dhe mekanizmat detyruese në dispozicion të gjykatës për të disiplinuar procesin përkatësisht situatat kur munde të ushtrohet prapësimi, si të veprohet kur paraqitet prapësimi kundër aktvendimit në bazë të dokumentit të besueshëm, në cilat raste ushtrohet kundërshtimi i personit të tretë si dhe procedurën e kthimit të punëtorit në punë.

4.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij sesioni trajnuës pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Avancojnë njohurit rreth mjeteve juridike në procedurën përmbarimore;
- Identifikojnë se në cilat raste ushtrohet prapësimi i personit të tretë dhe si zhvillohet procedura e mëtejshme nga gjykata përmbarimore;
- Aplikojnë drejte dispozitat ligjore lidhur me kthimin e punëtorit në punë.

4.3 Mjetet juridike nocioni dhe qëllimi

Mjetet juridike janë veprime procedurale me të cilat palët dhe personat tjerë të autorizuar e atakojnë vendimin në procedurën përmbarimore të cilin e konsiderojnë jo të bazuar në ligj, me anë të të cilave sigurohet realizimi i garancioneve kushtetuese për ligjshmërinë e procedurës gjyqësore lidhur me vendimet që mirën në këtë procedurë.

Qëllimi i mjeteve juridike është të mbrojnë debitorin ndaj veprimeve jo proporcionale apo të tepruara, duke mos pasur për qëllim të shtyjnë në pafundësi zbatimin e përmbarimit apo që të ofrojnë një mundësi për një gjykim të dytë. Termi “mjet juridik” nënkupton çdo veprim procedural i drejtuar kah evitimi i parregullsive (shkeljeve ligjore-procedurale) që janë ndërmarrë në procedurë.

Interes i përgjithshëm e shoqërisë është që vendimet në procedurën përmbarimore si në çdo procedurë tjetër të jenë të ligjshme dhe të mirën brenda afateve ligjore. Për ndryshim nga procedurat tjera në këtë procedurë ka një specifikë të veçantë sa i përket përdorimit të mjeteve juridike sepse këtu në një pjesë të rasteve kemi të bëjmë me përmbarimin e vendimeve që janë të gjykuara dhe të plotfuqishme.

Në procedurën përmbarimore, mjetet e rregullta të goditjes janë:

- Prapësimi dhe
- Ankesa.

Prapësimi mund të paraqitet vetëm kundër vendimeve të organit përmbarues me të cilin përmbarimi është i lejuar. Prapësimi duhet të paraqitet me shkrim, në Gjykatën themelore e cila ka lëshuar vendimin përmbarues kundër të cilit prapësimi është paraqitur kur organi përmbarues është Gjykata. Prapësimi duhet të paraqitet me shkrim në Gjykatën themelore, siç është përcaktuar me paragrafin 5. të nenit 5 të këtij ligji kur organi përmbarues është përmbaruesi

privat. Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet.

Vendimi me të cilin refuzohet propozimi për përmbarrim mund të goditet vetëm me ankesë të kreditorit të përmbarrimit. Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përbashimisht Gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimin. Gjykata do të njoftojë të gjitha palët për dëgjimin publik. Nëse Gjykata vendos të mbajë seancë dëgjimore publike, seanca dëgjimore do të mbahet brenda pesë (5) ditëve, kur kërkohet që përgjigjet ndaj prapësimin të pranohet nga Gjykata. Me këtë ligj janë rregulluar deri në një mase kufizimi i paraqitjes së ankesës vetëm në çështje të caktuara që ka ndikuar që procedura të jetë me e shpejte dhe efikase, por në mënyrë strikte nuk është rregulluar kufizimi i paraqitjes së ankesës vetëm në çështje të caktuara ndërsa është parapare:

- Përcaktimi i afatit kohor për shqyrtimin e ankesës;
- garancitë me rastin e parashtrimit të ankesës të cilat nuk kanë qenë me herët.

Prapësimi kundër aktvendimit përmbarrimor të lejuar në baze të dokumentit të besueshëm deri me tani është konsideruar padi dhe procedura e mëtejme është zhvilluar sipas dispozitave të Procedurës Kontestimore, ku procedurat gjyqësore janë zgjatur me vite, por këtë çështje ligji nuk e ka parapare. Edhe sipas ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore palët kanë të drejtë ankesë kundër vendimit mbi prapësimin. Ankesa kundër vendimit mbi prapësimin duhet të parashtrohet përmes gjykatës së shkallës së parë për gjykatën e shkallës së dytë, në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit.

Një kopje e ankesës i dorëzohet palës kundërshtarë dhe pjesëmarrësve tjerë të cilët mund të paraqesin përgjigje në ankesë në afat prej 3 ditëve. Ky ligj do të sjell siguri dhe efikasitet pasi që ka parapare afate për ndërmarrjen e veprimeve si për Gjykatën e Shkallës së parë po ashtu edhe për gjykatën e Apelit e që me herët nuk kanë qenë të parapara.

Pas pranimit të përgjigjes në ankesë ose pas kalimit të afatit për përgjigje, lënda së bashku me të gjitha shkresat tjera i dërgohet gjykatës së shkallës së dytë në afat prej 3 ditësh. Lidhur me ankesën, gjykata e shkallës së dytë do të vendosë në afat prej 15 ditëve, pra është vendosur një afat lidhur me vendosjen e ankesës i parapare në procedurën përmbarrimore. Mirëpo nuk është parapare që pasi gjykata e shkallës së dytë të vendos lidhur me ankesë lënda duhet të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në një afat të caktuar. Risi në të ardhmen është Ankesa kundër vendimit nuk e ndalon procedurën përmbarrimore përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën e plotë të kredisë. Në rast së debitorit si palë ankuese është i suksesshëm në ankesën e tij dhe nëse pasuria e tij është përmbarruar në pajtim me vendimin përmbarrimorë, ai mund të kërkojë kundër përmbarrim.

4.3.1 Mjetet juridike kundër urdhrit për përmbarrim

Për të vendosur çështjet që kanë të bëjnë me çdo prapësim, ankesë, parregullsi në procedure përmbarruese, ose çfarëdo lloj procedure kundër veprimeve të ndërmarrja nga Përmbarruesi privat, kompetencë ka Gjykata kompetente në territorin e së cilës debitorit ka vendbanimin apo nëse nuk ka vendbanim në Kosovë, atëherë në territorin në të cilin ka vendqëndrimin nëse është person fizik. Nëse debitorit është person juridik, kompetencë territoriale ka Gjykata kompetente ku gjendet selia e debitorit. Nëse debitorit nuk ka vendbanim të përkohshëm ose seli në Kosovë, kompetencë ka Gjykata kompetente në territorin e së cilës gjinden sendet e luajtshme dhe të paluajtshme e të cilat janë objekt përmbarrimi. Risi tjetër kemi edhe sa i përket çështjes se

vendosjes ku në procedurën e përmbarimit në shkallë të parë e udhëheqë dhe për të vendosë përmbaruesi privat, ndërsa përjashtimisht gjyqtari individual (i vetëm) kur me këtë Ligj është caktuar se përmbarimin e cakton dhe zbaton gjykata (organi i shkallës së parë). Me këtë ligj është përcaktuar edhe një afat ku organi përmbarues vendosë për propozimin e përmbarimit brenda afatit prej 7 ditëve pas pranimit të propozimit. Në nenin 3 par.2 të këtij ligji është parapare që “në shkallën e dytë vendimet i nxjerrë gjyqtari individual”, që nuk ka qene praktike e deri tashme kur dihet se në shkallën e dytë vendos kolegji për shqyrtimin e ankesës.

Ligji Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit të procedurës përmbarimore nr. 04/L-139 përcakton se Prapësimi duhet të paraqitet me shkrim organit përmbarues i cili e ka lejuar përmbarimin. Kur prapësimi i paraqitet përmbaruesit privat, përmbaruesi privat obligohet që në afat prej tre (3) ditësh pas pranimit të përgjigjes në prapësim ose kalimit të afatit për përgjigje, ta dërgojë lëndën në gjykatën kompetente. Organi përmbarues ua dërgon prapësimin dhe provat mbështetëse palës kundërshtare dhe të gjitha palëve tjera në procedurën e përmbarimit në afat prej tre (3) ditëve, nga dita e pranimit të prapësimi. Gjykata vendos për prapësimin në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të prapësimi

4.3.2 Garancitë për ankesa lidhur me prapësimin kundër aktvendimit përmbarimor

Disa legjislacione të disa vendeve me qëndrueshmëri dhe stabilitet politik dhe ekonomik siç është Gjermania parashohin garancitë lidhur me parashtrimin e ankesës të cilat sjellin efikasitet, siguri dhe realizim me të shpejt të kërkesës së kreditorit në procedurën përmbarimore.

Në rastet kur debitori dëshiron të parashtrijë ankesë kundër aktvendimit me të cilin është refuzuar prapësimi i tij në lidhje me propozimin për përmbarim në baze të dokumentit të besueshëm, gjykata urdhëron palën ankuese që të paguajnë garancinë në të holla, si parakusht për parashtrimin e ankesës, përveç nëse pagesa e garancisë i shkakton dem të pariparueshëm palës ankuese dhe nëse dem-i është i ndryshëm ose nuk është i lidhur me humbjen që do të shkaktohej me rastin e pagesës së kredisë.

Gjykata cakton shumën e pagesës së garancisë duke marrë parasysh interesin e të dyja palëve në lidhje me çështjen. Gjykata urdhëron pagesën e garancisë në shumën e plotë të kredisë në çdo ankesë në të cilën titulli ekzekutiv bazohet në dokumentin e besueshëm, përveç nëse pala ankuese pretendon se ka të drejtën për trajtim social ose që pagesa e garancisë asaj i shkakton dëme të pariparueshme që janë të ndryshme dhe nuk kanë lidhje me pagesën e kredisë.

Nëse pala ankuese dëshmon se nuk mund ta paguajë shumën e garancisë të caktuar nga gjykata, gjendja financiare e palës ankuese përcaktohet në pajtim me procedurat e përmendurat ligjore të deklarimit të pasurisë, ku kreditori i përmbarimit në propozimin e tij mund të kërkojë nga gjykata që të urdhërojë debitorin dhe çdo person tjetër të rëndësishëm për procesin e përmbarimit të përmendur në propozim, përfshirë organet apo shërbimet administrative, apo institucionet tjera që të sigurojnë të dhëna rreth pasurisë apo të ardhurave të debitorit, kërkesa mund të parashtrijë në çdo kohë gjatë tërë përmbarimit gjer në përfundimin e tij.

Posedimi i pasurisë së pambarueshme në të holla që tejkalon shumën e garancisë do të konsiderohen si disponueshmeri e pasurisë për të plotësuar shumën e garancisë.

Kur gjykata konstaton se pala ankuese nuk mund të paguajë shumën e plote të garancisë, mund të cakton një shumë me të vogël.

Nëse pala ankuese dështon të paguaje shumën e garancisë të caktuar nga gjykata, ankesa konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

Ankesa në gjykatën e shkallës së dytë mund të shqyrtohet pasi që të paguhet shumën e garancisë në gjykatën e shkallës së parë.

Fondet e garancisë vendosen në një llogari të veçante të gjykatës.

Si veprohet në rastet kur gjykata e apelit vendos që çështjet e ngritura në ankese duhet të rishqyrtohen serish nga gjykata e shkallës së parë, atëherë fondet e garancisë duhet të qëndrojnë në llogarinë e posaçme deri sa të merret vendimi i formës së prerë për atë rast, përveç rasteve kur gjykata vendos ndryshe.

Nëse ankesa pranohet dhe debitori fiton çështjen, gjykata ia kthen garancinë palës ankuese dhe e ndërpret përmbarimin. Nëse refuzohet ankesa, vendimi i gjykatës se apelit konsiderohet titull ekzekutiv fondet e garancisë sekuestrohen për të mbuluar shpenzimet procedurale të ankesës dhe kërkesën e kreditorit sipas propozimit për përmbarimin. Shumat që duhet të paguheshin por që nuk mund të mbulohen me fondet e sekuestruara, duke përfshirë shpenzimet procedurale të ankesës, përbejnë kredi që duhet të mbledhet nga kreditori gjatë një procedure përmbarimore pasuese.

4.3.3 Përmbarimi i vendimit për kthimin e punëtorit në punë

Procedura e përmbarimit të vendimit mbi kthimin e punëtorit në punë fillon (iniciohet) me propozimin e punëtorit. Së bashku me propozimin për përmbarim duhet patjetër të paraqitet në origjinal ose të vërtetuar në përkrahje, edhe vendimi me klauzolën e përmbarueshmërisë. Bazuar në dispozitën e nenit 313 të ligjit për Procedurën Përmbarimore propozimi për përmbarim mund të paraqitet brenda afatit prej 90 ditëve, ndërsa lidhur me afatin për paraqitjen e propozimit, gjykata vendos sipas detyrës zyrtare, prandaj propozimet e paraqitura pas afatit do të hedhen. Zbatimi i përmbarimit për kthimin e punëtorit në punë nënkupton angazhimin e vërtetë të tij në procesin e punës. Sipas dispozitave të ligjit të ri për procedurën përmbarimore lidhur me zbatimin e kthimit të punëtorit në punë është paraparë dënimi me të holla dhe shpërblimi i të ardhurave personale.

Sipas dispozitës së nenit 314 të LPP-së përmbarimi në bazë të dokumentit ekzekutiv sipas të cilit punëdhënësi është i detyruar që punëtorin ta kthejë në punë, apo që ta sistemojë në vendin përkatës të punës, zbatohet me shqiptimin e dënimit me të holla kundër punëdhënësit dhe personit përgjegjës duke aplikuar dispozitat e nenit 15 dhe 16 të këtij ligji. Shpërblimi i të ardhurave personale është paraparë në dispozitën e nenit 315 të LPP-së.

Propozuesi i përmbarimit që e ka parashtruar propozimin për kthim në punë, ka të drejtë të kërkojë që gjykata të nxjerr aktvendim me të cilin do të caktoj se debitori ka për detyrë që atij t'ia paguaj në emër të pagës shumën mujore që janë bërë të kërkueshme, nga dita në të cilën ka marrë formë të prerë vendimi e deri në ditën e rikthimit në punë. Me të njëjtin aktvendim, gjykata e cakton përmbarimin për realizimin e shumave mujore të caktuara, ndërsa shpërblimi i të ardhurave personale mujore caktohet në shumën që do të realizonte punëtori po të ishte në punë për periudhën prej plotfuqishmërisë së vendimit deri në kthimin e punëtorit në punë. Propozuesi i përmbarimit të drejtën e tij që të paguheshin pagat mujore mund ta realizojë në procedure të posaçme kontestimore bazuar në nenin 317 të LPP-së.

4.3.4 Ushtrime

Gjatë këtij sesioni trajnues do të prezantohet një shembull praktik i cili do t'iu shpërndalet pjesëmarrësve, të cilët pas punës në grupe do të përpilojnë një aktvendim lidhur me kthimin e punëtorit në punë dhe grupi tjetër do të vendosë lidhur me prapësimin e ushtruar ndaj vendimit lidhur me lejimin e përmbarimit.

4.3.5 Përmbledhje

Në këtë sesion janë dhënë shpjegime lidhur me mjetet juridike në procedurën përmbarimore. Kandidatet kanë mundur të mësojnë se cilat janë këto mjete të rregullta, kush vendos për prapësimin e kush vendos lidhur me ankesën, cili është afati për të vendosur për prapësimin sipas dokumentit përmbarues si dhe procedurën e kthimit të punëtorit në punë.

VI. Marrja dhe administrimi i provave në procedurën civile

Ahmet Idrizaj
Gjyqtar në Gjykatën Themelore – Gjakovë

Tabela e përmbajtjes – Marrja dhe administrimi i provave në procedurën penale”

Hyrje.....	278
Objektivat e modulit	278
Metodat e të shpjeguarit.....	278
Pritjet nga pjesëmarrësit	279
Burimet.....	279
Përmbledhje	279
1. Mjetet provuese dhe objekti i të provuarit	280
1.1 Hyrje	280
1.2 Objektivat trajnuese	280
1.3 Të provuarit	280
1.4 Barra e të provuarit	281
1.5 Objekti i të provuarit.....	283
1.6 Faktet që nuk kanë nevojë të provohen	284
1.6.1 Faktet e ditura botërisht dhe ato të vërtetuara nga gjykata në gjykimin e mëhershëm	285
1.6.2 Faktet e pranuar (pohuara)	285
1.6.3 Faktet e prezumuara me ligj	286
1.7 Ushtrime	287
1.8 Përmbledhje.....	287
2. Marrja e provës, sigurimi i provës, mjete provuese dhe këqyrja në vend... 288	
2.1 Hyrje	288
2.2. Objektivat trajnues	288
2.3 Marrja e provave	288
2.4 Sigurimi i provës- paraprova	290
2.5 Mjetet provuese	294
2.6 Këqyrja në vend	294
2.7 Ushtrime	295
2.8 Përmbledhje.....	296
3. Shkresat dhe fuqia provuese e tyre..... 297	
3.1. Hyrje	297
3.2. Objektivat trajnues	297
3.3 Shkresat – Llojet e shkresave dhe fuqia provuese e tyre.....	297
3.3.1 Dokumenti publik	297
3.3.2 Dokumenti jo publik (privat)	298
3.3.3 Dokumentet dispozitive	299
3.3.4 Dokumentet dokumentuese	299
3.3.4 Dokumenti i huaj.....	300
3.4 Sigurimi i dokumenteve nga gjykata	301
3.5 Paraqitja e dokumenteve	304
3.6 Ushtrime	305
3.7 Përmbledhje.....	305
4. Dëshmitarët	306
4.1 Hyrje	306
4.2. Objektivat trajnues	306
4.3 Dëshmitarët - Zotësia për të qenë dëshmitar	306

4.4 Detyra për të dhënë dëshmi.....	307
4.5 Cilët persona nuk mund të procedohen si dëshmitar?	309
4.6 E drejta e dëshmitarit për të refuzuar të dëshmoj	309
4.7 E drejta e dëshmitarit për mos dhënien e përgjigjes në pyetjen konkrete.....	310
Kur nuk mund të refuzoj dëshmitari të jep dëshminë e tij?	311
4.8 Thirrja e dëshmitarit	312
4.9 Pyetja e dëshmitarit.....	312
2.8 Mënyra e marrjes në pyetje të dëshmitarit	313
4.9 Kur bëhet ballafaqimi i dëshmitarëve	314
4.10 Revokimi i vendimit për procedimin e dëshmitarit	315
4.11 Heqja dorë nga procedimi i dëshmitarit.....	315
4.12 Kompensimi i shpenzimeve dëshmitarit	316
4.13 Ushtrime.....	316
4.14 Përmbledhje.....	317
5. Ekspertët	318
5.1 Hyrje	318
5.2. Objektivat trajnues	318
5.3 Ekspertët - Caktimi i ekspertëve exofficio	318
5.3.1 Caktimi i ekspertëve me propozimin e palëve.....	319
5.4 Detyrimet e ekspertit dhe sanksionet kundër tij.....	320
5.5 Lirimi i ekspertit nga detyra e ekspertimit	320
5.6 Përjashtimi i ekspertit nga detyra e ekspertimit	321
5.7 Ekspertimi	322
5.8 Vlerësimi i provës – ekspertizës.....	323
5.9 Palët si mjet provues	323
5.10 Marrja e provës me procedimin e palëve.....	323
5.11 Ushtrime.....	325
5.12 Përmbledhje.....	325

Hyrje

Procedura e provave është një nga gur themelet e procesit gjyqësor. Pa dëshmi të mjaftueshme, provuese për çështjet kontestuese në një rast, gjyqtari nuk do të jetë në gjendje të bëjë gjetjen e fakteve që duhet të mbështesin një aktgjykim të arsyetuar qartë dhe me kujdes. Të provuarit e përbëjnë veprimet procedurale të subjekteve kryesore me të cilat bëhet propozimi, zgjedhja, mbledhja, ekzaminimi dhe çmuarja e mjeteve provuese me qëllim të vërtetimit të fakteve relevante në të cilat mbështeten kërkesat e palëve. Në praktikë ka vështirësi lidhur me atë se si duhet të zhvillohet procedura e të provuarit dhe kur gjykata është e autorizuar që t'i marr edhe provat që nuk i kanë propozuar palët, po që se konstaton se palët tentojnë të disponojnë me kërkesa me të cilat nuk kanë të drejtë të disponojnë.

Sipas parimit të së vërtetës materiale gjykata është e detyruar që drejtë dhe plotësisht të i vërtetojë faktet kontestuese. Faktet të cilat nuk janë kontestuese ndërmjet palëve në procedurë nuk vërtetohen.

Ligji i Procedurës Kontestimore mjetet provuese dhe marrjen e provave e ka rregulluar me dispozitat e nenit 319 deri në nenin 378, ndërsa procedurën e sigurimit të provave me dispozitat e nenit 379 deri në nenin 385.

Në kuadër të këtij moduli do të trajtohen mjetet provuese dhe objekti i të provuarit, faktet që nuk kanë nevojë të provohen, marrja e provave, sigurimi provës (paraprova), llojet e mjeteve provuese siç janë: këqyrja e vendit, shkresat, dëshmitarët, ekspertët dhe procedimi palëve.

Objektivat e modulit

Pas përfundimit të këtij moduli trajnues, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Njohin rëndësinë e mjetit provues;
- Dallojnë llojet e mjeteve provuese;
- Zbatojnë në praktikë detyrimin e barrës së të provuarit sipas dispozitave të LPK-së;
- Zgjerojnë njohurit për marrjen e provës me këqyrjen në vend, me leximin e shkresës-dokumentit, me procedimin e dëshmitarit, me ekspertizë dhe për marrjen e provës me procedimin e palëve
- Aftësohen që të përpilojnë një procesverbal për marrjen e provës me këqyrjen në vend.

Metodat e të shpjeguarit

Gjatë këtij trajnimit do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike të përcjella me shembuj praktikë, në mënyrë që secili nga pjesëmarrësit të jetë aktiv gjatë gjithë kohës, së trajnimit me qëllim që të arrihen në tërësi objektivat e këtij trajnimit.

Pritjet nga pjesëmarrësit

Nga pjesëmarrësit pritën që të jenë aktiv gjatë gjithë trajnimit, përmes parashtrimit të pyetjeve, pjesëmarrjes në diskutime etj, në mënyrë që të sqarohen të gjitha çështjet kryesore të këtij moduli, si dhe t'i thellojnë njohuritë e tyre dhe shkathtësitë praktike për të gjitha elementet përmbajtësore të çështjeve që do të diskutohen, si dhe në të njëjtën kohë të jenë në gjendje që këtë njohuri t'i zbatojnë me sukses gjatë punës së tyre në praktikë.

Burimet

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Ligji për procedurën kontestimore nr.03/L-006
- Ligji për procedurën jokontestimore nr.03/L-007
- Ligji për familjen e Kosovës nr.2004/32
- Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore nr.04/L-154 dhe
- E drejta procedurale civile, Faik Brestovci, botim i vitit 1986.

Përmbledhje

Në këtë modul pjesëmarrësit janë trajnuar për njërin nga fazat më të rëndësishme të procedurës kontestimore-procedura e provave. Pjesëmarrësve iu është shpjeguar në mënyrë detale procedura e marrjes së provave me këqyrjen në vend, leximin e shkresave, procedimin e dëshmitarit, ekspertimin dhe procedimin e palëve.

1. Mjetet provuese dhe objekti i të provuarit

1.1 Hyrje

Gjatë këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të vërtetojnë se cilat janë mjetet provuese nga të cilat vërtetohet ekzistimi apo mos ekzistimi i një fakti dhe sipas të cilave gjykata mund të vendosë në mënyrë meritore lidhur me çështjen kontestuese. Përveç kësaj pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të vërtetojnë fuqinë provuese të mjeteve provuese, rezultatin e të provuarit, vlerësimin e provave dhe cilës nga palët në procedurë i takon barra e të provuarit si dhe në cilat raste gjykata kujdeset kryesisht për marrjen e provave. Pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të vijnë deri te përfundimi se rrethanat jo kontestuese në procedurë nuk ka nevojë që të provohen dhe të zbatohen prova materiale për të njëjtat. Në fund pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që t'i identifikojnë faktet që nuk kanë nevojë që të provohen, faktet e ditura botërisht dhe ato të vërtetuara nga gjykata në gjykimin e mëhershëm, faktet e provuara (pohuara) faktet e prezumuara me ligj dhe raste nga praktika gjyqësore.

1.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij moduli trajnues, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Njohin rëndësinë e mjetit provues;
- Dallojnë llojet e mjeteve provuese;
- Zbatojnë në praktikë detyrimin e barrës së të provuarit sipas dispozitave të LPK-së dhe të kuptojnë se në cilat raste gjykata është e detyruar që kryesisht të zbatojë prova materiale lidhur në një rast konkret etj.

1.3 Të provuarit

Veprimet kryesore të cilat i kryen gjykata kanë për qëllim zbulimin e së vërtetës rreth çështjes në kontest, dhe çdo gjykim për zbulimin e kësaj të vërtete nuk është gjë tjetër veç së një proces njohje.

Të provuarit e përbëjnë veprimet procedurale të subjekteve kryesore me të cilat bëhet propozimi, zgjedhja, mbledhja, ekzaminimi dhe çmuarja e mjeteve provuese me qëllim të vërtetimit të fakteve relevante në të cilat mbështetet kërkesa e palëve. Gjithashtu të provuarit është metodë me ndihmën e se cilës gjykata e hulumton dhe e konstaton të vërtetën. Bindja e gjykatës se a ekziston apo nuk ekziston një fakt formohet në bazë të çmuarjes me ndërjegje e të kujdesshme të provave dhe në bazë të rezultatit të përgjithshëm të procedimit (neni 8 i LPK-së).

Në procedurën kontestimore sikundër edhe në procedurat tjera roli i provave është jashtëzakonisht i madh prandaj procedura e provave është një nga gurë-themelet e procesit gjyqësor. Pa dëshmi të mjaftueshme, provuese për çështjet kontestuese në një rast, gjyqtari nuk do të jetë në gjendje të bëjë gjetjen e fakteve që duhet të mbështesin një aktgjykim të arsyetuar qartë dhe me kujdes.

Me mjete provuese nënkuptojnë burimet e njohurive për ekzistimin apo mos ekzistimin e fakteve, vërtetimi i të cilave është me rëndësi për vendosjen e çështjeve juridike e cila është objekt i kontestit. Ligji për procedurën kontestimore i njuh këto mjete provuese: objektin e këqyrjes, dokumentet, dëshmitarët, ekspertët dhe palët.

Fuqia provuese e mjetit provues përfaqëson aftësinë argumentuese të tij, e cila është me ndikim në formimin e bindjes së gjykatës dhe në përfundimin e saj për ekzistimin e faktit i cili është objekt i të provuarit. Sa më i drejtë për drejtë të jetë raporti në mes mjetit provues dhe objektit të provuarit aq më e fortë është fuqia argumentuese e mjetit provues, si për shembull: deklarata e dëshmitarit okular është më e sigurt se deklarata e dëshmitarit sipas dëgjimit, dokumenti burimor është më i sigurt se përshkrimi apo fotokopja e tij.

Rezultati i të provuarit është ajo që gjykata e arrin nga tërësia e bazave provuese dhe në bazë të cilave pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku dhe në bazë të rezultatit të procedurës (neni 7 i LPK-së) e krijon bindjen e vet për ekzistimin apo mos ekzistimin e fakteve të cilat kanë të bëjnë në vendimin e gjykatës.

Te vlerësimi i provave gjykata nuk është e lidhur me kurrfarë rregullash formale sipas të cilave një fakt do ta konsideron të provuar. Të gjitha provat vlerësohen në mënyrë të gjithanshme dhe të kujdesshme me qëllim që të arrihet deri te përfundimi për ekzistimin apo mos ekzistimin e faktit konkret. Për të formuar bindjen e saj gjykata duhet të marrë parasysh si argumentet që flasin për ekzistencën e një fakti ashtu edhe argumentet që flasin të kundërtën. Procesi i njohjes gjyqësore realizohet me anë të tre elementëve përbërës: objektit të provës, provave gjyqësore dhe procesit të vërtetimit gjyqësor.

Objekt i provës janë ato fakte juridike vërtetësinë e të cilave duhet ta zgjidh gjykata, si kusht për dhënien e një vendimi të drejtë.

Provat gjyqësore janë mjetet e parashikuara në ligj për konstatimin e të dhënave faktike dhe përcaktimin e vërtetësisë së fakteve juridike që përbejnë objektin e provës.

Procesi i vërtetimit gjyqësor është konstatimi i vërtetësisë së marrëdhënies juridike me anë të provave gjyqësore.

1.4 Barra e të provuarit

Barra e provës ose barra e të provuarit (onus probandi) është përcaktimi i subjektit (palës) në procesin gjyqësor civil që duhet të provojë faktin (faktet) e pretenduar. Secila palë ndërgjyqësore ka për detyrë të provoj faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Ky rregull zbatohet si për kërkesë padinë e paditësit, ashtu edhe për prapësimet e të paditurit. Kjo do të thotë se pala që pretendon ekzistencën e një të drejte, e ka barrën e provës së atyre fakteve që parashikon e drejta materiale si prezumim i ekzistencës së saj dhe e kundërta, pala që mohon ekzistencën e një të drejte ka barrën e provës së fakteve që pengojnë atë ose se ajo është shuar.

Shembull; Paditësi me ushtrimin e padisë për dorëzimin e sendit, nga baza e të drejtës së pronësisë, ka për detyrë të provoj se është pronar i atij sendi, dhe se sendi gjendet në posedim të paditurit.

I padituri ke kundërshtimi i padisë lidhur me të drejtën e pronësisë ose dorëzimin e sendit, zakonisht thirret në faktin se sendin të cilin e kërkon paditësi, i padituri e ka në posedim nga ndonjë bazë të vlershme juridike.

Ndryshe nga ligji i mëparshëm i procedurës kontestimore, sipas LPK-së në fuqi barra e të provuarit është **detyrë ekskluzive e palëve në procedurë**, ndërsa në raport me gjykatën barra e të

provuarit vjen në shprehje vetëm **përbashimisht** kur ngarkohet me detyrën që saktësisht ta vërtetoj gjendjen faktike po që nevoja edhe duke marrë prova të cilat nuk i kanë propozuar palët. Një detyrë e tillë e gjykatës mund të vijë në shprehje vetëm në rastet kur nga rezultati i shqyrtimit del përfundimi se palët kanë për qëllim të disponojnë me kërkesa me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht.

Një autorizim i tillë për gjykatën buron nga nenit 7.2 të LPK-së, që është parapa se: “Gjykata është e autorizuar t’i vërtetojë edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur si dhe t’i marrë edhe provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuar në nenin 3 paragrafi 3 të këtij ligji), në qoftë se me ligj nuk është përcaktuar ndryshe”. Kurse me dispozitën e nenit 320 parashihet së: “Gjykata është e autorizuar që t’i marrë edhe provat që nuk i kanë propozuar palët, po që se konstaton se ato tentojnë të disponojnë me kërkesat me të cilat nuk kanë të drejtë të disponojnë (neni 3 paragrafi 3 i këtij ligji)”.

Andaj, sipas kësaj dispozite (neni 3 parag.3 i LPK) në mënyrë të qartë rezulton se; “Gjykata nuk mund t’i miratoj kërkesat e palëve, që janë në kundërshtim me; a) rendit juridik b)dispozita ligjore dhe c) rregullat e moralit publik”.

Nga këto dispozita ligjore rezulton se në disa situata gjykata (vetëm përbashimisht ex officio) ka të drejtë dhe detyrim që të ofroj fakte ose të merr prova, që nuk i kanë paraqitur palët, nëse kemi të bëjmë me veprimet që i referohen kërkesave me të cilat palët nuk kanë të drejtë të disponojnë lirisht.

*Gjykata gjithashtu është e autorizuar që sipas detyrës zyrtare të nxjerr prova me të cilat do të vërtetohen faktet të cilat palët nuk i kanë propozuar edhe në **kontestet familjare**.*

Ky autorizim rezulton nga dispozita e nenit 84.2 të Ligjit për Familjen i Kosovës, me të cilën dispozitë është paraparë se;

“Gjykata mund të hetoj fakte dhe të zbatoj procedurën e provave rreth pjesës së propozimit që ka të bëjë me ruajtjen, edukimin dhe mbajtjen e fëmijëve, nëse bindet se propozimet e prindërve lidhur me këto çështje nuk ofrojnë garanci të mjaftueshme se interesat e fëmijëve të tyre të mitur ose të pa aftë me këtë marrëveshje do të mbrohen në masë të duhur”.

Me qëllim të mbrojtjes së interesave të fëmijëve Gjykata sa herë që e vlerëson të arsyeshme, është e autorizuar që t’i vërtetoj edhe faktet të cilat midis palëve nuk janë kontestuese.

Është parim juridik: “*ma jep faktin, ta jap të drejtën*”(da mihi factum, dabo tibi juris). Kështu që nëse me gjithë provat e paraqitura nga paditësi, si dhe me provat e marrura nga Gjykata “ex officio” nuk vërtetohet themelësia e kërkesë-padisë, atëherë e njëjta refuzohet si e pathemeltë.

Kjo na dërgon në përfundimin e qartë se rregullat e barrës së provës janë të natyrës materialo-juridike.

Nga praktika gjyqësore:

1. “Në qoftë se Gjykata në bazë të provave të nxjerra nuk mund me siguri të vërtetoj ndonjë fakt, për ekzistimin apo mosekzistimin e atij fakti, do të konkludoj me aplikimin e rregullave mbi barrën e të provuarit”(neni 322 i LPK).

2. “Paditësi duhet t’i provoj faktet të cilat janë bazë reale e padisë. Nëse ai nuk e bënë këtë aplikimi i rregullave mbi barrën e të provuarit e arsyeve vlerësimin e gjykatës se ato fakte nuk janë provuar”.

3. “Kur i padituri thirret në faktin kontestues se kërkesa e paditësit ka pushuar me kompensimin e kërkesave, atëherë barra e të provuarit për kompensimin e kryer bie mbi të paditurin”

4. “Që Gjykata për ekzistimin e fakteve të mund të konkludoj mbi aplikimin e rregullave mbi barrën e të provuarit, duhet të jenë të plotësuara dy prezumime;

a) që Gjykata të ketë nxjerr provat e propozuara dhe

b) që në bazë të provave të nxjerra nuk mundet me siguri të vërtetoj ndonjë fakt vendimtar”.

5. “Rregullat mbi barrën e të provuarit e obligojnë gjykatën që ta merr si të provuar at fakt për vërtetësinë e të cilit pala e cila thirret në te, nuk i ka propozuar gjykatës mjete të mjaftueshme adekuate provuese”.

Për të dalluar se cilës palë i takon barra e provës, përkatësisht cila palë duhet të provoj një fakt, në teori është bërë ndarja e fakteve në: fakte formuese, fakte penguese dhe fakte shuese.

Fakte formuese: janë ato që sjellin me vete lindjen e një të drejte. P.sh. e drejta për të marrë çmimin nga shitja e një sendi, nga dhënia e një huaje etj. Këto fakte duhet të provohen nga pala që i pretendon – paditësi.

Fakte penguese: Janë ato fakte që pengojnë lindjen e një të drejte. P.sh. kryerja e një veprimi juridik me mashtrim ose me kanosje, keqbesimi në posedimin e sendit. Zakonisht këto fakte pretendohen nga i padituri, por mund të pretendohen edhe nga paditësi.

Fakte shuese: Janë ato fakte që sjellin me vete shuarjen e një të drejte. P.sh. pagimi i çmimit për sendin e blerë, pagimi ose falja e një borxhi. Këto fakte zakonisht i pretendon i padituri, prandaj atij i takon edhe barra e provës.

1.5 Objekti i të provuarit

Objekt i të provuarit mund të jetë një fakt ose tërësia e fakteve juridike që janë vendimtare për pranimin e padisë, të prapësimeve ose të kundërpadiës dhe për zgjidhjen e çështjes nga gjykata. Objekti i të provuarit nuk është çdo fakt që pretendohet nga palët, por vetëm ato fakte juridike që janë të rëndësishme për zgjidhjen e çështjes nga gjykata. Sipas dispozitës së nenit 319.2 të LPK, duhet të provohen të gjitha faktet të cilat janë të rëndësishme për dhënien e vendimit.

Është detyrë e gjyqtarit apo e trupit gjykues që nga një numër i madh i fakteve, të cilat i kanë theksuar palët, t’i ndaj ato të cilat janë të rëndësishme për të vendosur lidhur me çështjen juridike kontestimore. Nga faktet relevante, për të cilat ligji e lidhë pasojën juridike, objekt i të provuarit bëhen vetëm ato që janë kontestuese midis palëve. Andaj, gjykata nuk ka nevojë që të administroj prova të cilat nuk janë kontestuese në mes të palëve.

Gjykata është ajo që vendos se cilat fakte duhet provuar dhe cilat prova do merren për vërtetimin e tyre.

Për shembull: të kontestet e pengim posedimit vërtetohen: **a)** gjendja e fundit e posedimit dhe **b)** pengimi i bërë, ndërsa nëse paraqiten propozime për vërtetimin e së drejtës së pronësisë ose

kompensimi i dëmit, propozimet e këtilla refuzohen, meqë konsiderohen irelevante në këtë çështje.

Pra, gjyqtari i çështjes sipas bindjes së lirë dhe aftësisë profesionale e cakton rrethin e fakteve juridike të cilat i konsideron të rëndësishme për marrjen e vendimit dhe përqendrohet në administrimin e provave relevante.

Është në interes të palës që t'i provoj faktet në të cilat ajo i bazon kërkesat dhe pretendimet e veta, në të kundërtën nëse pala nuk i provon faktet e tilla, do ta humb kontestin.

Në kontestin për kompensimin e dëmit, paditësi ka për detyrë që të provoj se i padituri e ka shkaktuar dëmin me fajin e tij dhe të provoj lartësinë e dëmit, ndërsa i padituri duhet të provoj ekzistimin e fakteve në të cilat e mbështetë kundërshtimin e tij, psh: paditësi është vet fajtor për ekzistimin e dëmit ose se dëmin e ka shkaktuar personi i tretë si dhe faktin se dëmi ka ndodhur rastësisht etj.

Në kontestin për vërtetimin e të drejtës së pronësisë në sendin e caktuar, paditësi duhet të provoj ekzistimin e fakteve të cilat e përbëjnë bazën juridike në bazë të së cilës është fituar kjo e drejtë (kalimi i kohës dhe ekzistimi i mirëbesimit për fitimin e të drejtës së pronësisë me parashkrim fitues, ekzistimi i shitblerjes, krijimi i sendit, ndërtimi në tokën e huaj etj), kurse i padituri duhet të provoj ekzistimin e fakteve në të cilat e mbështet kërkesën e vet (p.sh: se paditësi sendin e mban në bazë të kontratës mbi qiranë, se sendi është krijuar me materialin e të paditurit dhe sipas porosisë së tij, se paditësi ka ndërtuar në tokën e të paditurit pa pëlqimin e tij, se nuk janë plotësuar afatet kohore dhe paditësi është posedues me keqbesim etj).

Në sferën e të provuarit **gjykata nuk e ka me rolin aktiv** të cilin e kishte sipas dispozitave të mëparshme ligjore. Pra tani më gjykata nuk mundet të provoj fakte të cilat nuk i kanë propozuar palët, *përrjashtim bëjnë kontestet familjare* dhe kur kemi të bëjmë me kërkesat e palëve me të cilat kërkesa palët nuk mund të disponojnë. Kërkesat e këtilla i referohen *nenit 3 par.3 të LPK-së*, e të cilat kërkesa janë në kundërshtim me rendin juridik, me dispozitat ligjore dhe me rregullat e moralit publik. Nga kjo rezulton se është detyrë e gjykatës që të mos i lejoj palët me keqpërdorimin e të drejtës së disponibilitetit në procedurë, të realizojnë kërkesat e kundërligjshme dhe në kundërshtim me moralin publik.

Ekzistojnë raste kur objekt i të provuarit nuk janë drejtpërdrejtë faktet, por janë pretendimet e palëve për ekzistimin apo mosekzistimin e fakteve juridike, nga të cilat varet zbatimi i normave të së drejtës materiale në procesin kontestimor gjyqësor. Ky është quajtur fakt negativ. Vërtetimi i vërtetësisë së pretendimit mohues negativ, mund të bëhet vetëm në mënyrë të tërthortë, me anë të konstatimit të ekzistimit të faktit që e përjashton ekzistimin e përnjëhershëm të faktit të kontestuar.

1.6 Faktet që nuk kanë nevojë të provohen

Edhe pse në disa raste e përbëjnë thelbin e padisë, të kundërpadisë apo të prapësimeve, disa fakte nuk ka nevojë të provohen, dhe atë:

- a) faktet e ditura botërisht dhe ato të vërtetuara nga gjykata në gjykimin e mëhershëm
- b) faktet e pranuar (pohuara), dhe
- c) faktet e prezumuara me ligj.

1.6.1 Faktet e ditura botërisht dhe ato të vërtetuara nga gjykata në gjykimin e mëhershëm

Faktet e njohura botërisht nuk kanë nevojë të provohen, për shkak se ato njihen prej një rrethi të gjerë personash. Nga shkalla e rëndësisë së tyre varet edhe madhësia e rrethit të personave që janë të njohur me to. Kështu 17 Shkurti si datë e shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës, njihet nga pjesa dërmuese e shqiptarëve në trojet amtare dhe në botë. Por ka fakte të tjera që njihen nga një rreth më i ngushtë personash, p.sh. njihet vetëm nga qytetarët e një qyteti ose rrethi, banorët e një fshati, si tërmeti, përmbytje e madhe, ndodhja e zjarreve masive, ndodhja e demonstratave studentore, apo e punëtoreve, etj.

Për t'u quajtur fakt i njohur botërisht kërkohet që të njihet si i tillë edhe nga gjykata. Ajo e çmon a është i njohur botërisht një fakt konkret, e që si rrjedhojë nuk ka nevojë të provohet.

Fakte të vërtetuara nga gjykata në gjykimin e mëhershëm konsiderohen ato të cilat gjykata i ka vërtetuar në ndonjë procedurë të mëhershme gjyqësore e cila ka përfunduar më aktgjykim të formës së prerë, të cilat për nga karakteri përfaqësojnë çështje të gjykuar.

Nuk duhet të vërtetohet fakti se paditësi sendin e mban me ndonjë bazë të vlefshme juridike nëse me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor është vërtetuar se ai është pronar i atij sendi; apo faktet e vërtetuara në procedurë penale me aktgjykim të formës së prerë, ngase gjykata në procedurë kontestimore në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të kryesit është e lidhur me atë aktgjykim (neni 14 i LPK- së).

1.6.2 Faktet e pranuar (pohuara)

Pohimi i fakteve është veprim procedural i njëanshëm me të cilin pala deklaron se janë të vërteta disa apo tërë faktet në të cilat kundërshtari i saj e bazon kërkesën e tij.

Sipas nenit 321 par. 2 të LPK-së nuk duhet të provohen faktet të cilat i ka pranuar pala para gjykatës gjatë procesit gjyqësor. Rëndësia juridike e pranimit të fakteve para gjykatës gjatë procedurës është shprehje e parimit të disponibilitetit të palëve përkitazi me kërkesat materialo – juridike.

Motivi i pranimit të fakteve zakonisht është relevant dhe gjykata nuk është e detyruar ta vërtetoj saktësinë e atij fakti, përveç në rastet kur bindet se pranimi i fakteve bëhet me qëllim të disponimit të palejueshëm (neni 3. parag.3 i LPK-së). Në këtë rast gjykata vërtetësinë e tyre e bën me mjetet provuese që i ka në dispozicion.

Pranimi i fakteve mund të bëhet shprehimisht, në mënyrë të heshtur dhe me veprime konkludente, p.sh., nëse pala ka kundërshtuar disa fakte e për të tjerat s'është deklaruar, do të konsiderohet se pala ka pranuar faktet për të cilat nuk është deklaruar.

Deklarata për pranimin e fakteve bëhet gojarisht, në seancë, apo me shkrim. P.sh., me përgjigje në padi, me parashtrësën e paditësit pas marrjes së përgjigjes në padi etj.

Deklaratën për pranimin e fakteve pala ka të drejtë që ta revokojë, mirëpo me ligj nuk është caktuar se deri në cilën fazë të procedurës mund ta bëjë këtë. Në ndërlidhje me dispozitat tjera të LPK-së, rrjedhën e procedurës dhe parimin e ekonomicitetit do të ishte e arsyeshme që kjo të bëhet deri në seancën përgatitore, pasi që në këtë seancë debatohet dhe shtjellohen faktet në të cilat palët i bazojnë kërkesat e veta. Në rast të revokimit, gjykata ka mundësi që lirisht ta çmojë, duke marrë për bazë të gjitha rrethanat e rastit konkret, se a do ta konsiderojë të pohuar apo të kundërshtuar faktin njëherë të pohuar, por më vonë të mohuar (neni 321 parag. 3 LPK-së).

Pohimin e fakteve mund ta bëjë edhe paditësi edhe i padituri, kurse pohimin e kërkesë-padisë mund ta bëjë vetëm i padituri.

Nga pranimi i fakteve duhet të dallojmë pranimin e kërkesë – padisë. Dallimi qëndron në atë se pranimi i fakteve është deklaratë e palës me të cilën ajo e shpreh qëndrimin e vet përkitazi me bindjen që e ka për faktin vendimtar, kurse pranimi i kërkesë – padisë është veprim dispozitiv procedural. Në rastin e parë sigurohet baza faktike për vendimin, kurse në rastin e dytë gjykata pa procedim të mëtejshëm e merr aktgjykimin me të cilin e miraton kërkesë – padinë. (neni 148 i LPK-së).

1.6.3 Faktet e prezumuara me ligj

Objekt i të provuarit nuk mund të jetë as fakti, ekzistimin e të cilit ligji e prezumon. Prezumimi ligjor i fakteve përfaqëson rregullin sipas të cilit gjykata është e detyruar që ta merr si ekzistues një fakt (fakt i prezumuar) nëse vërtetohet se ekziston një fakt tjetër i përcaktuar nga ligji (baza e prezumimit).

Ekzistojnë ligje përkatëse që përmbajnë dispozita për faktet e prezumuara. P.sh., Ligji për familjen (neni 99) prezumon se at i fëmijës është personi i cili është në martesë me nënën e fëmijës 300 ditë para lindjes së fëmijës.

Ky është një prezumim ligjor i kundërshtueshëm (relativ), për arsye se ati i prezumuar ka të drejtë të provojë të kundërtën, se ai nuk është atë i fëmijës, me padi në gjykatë për kundërshtim atësie.

Ligji mbi marrëdhëniet detyrimore prezumon se pronari ose poseduesi i sendit të rrezikshëm është fajtor për dëmin e shkaktuar me përdorimin e tij.

Rregullat mbi të drejtat pronësore prezumojnë se ai që e ka pushtetin faktik mbi sendin është pronar i tij etj. Në përgjithësi rregullat mbi prezumimin ligjor e lehtësojnë të provuarit, ngase pala e cila është thirrë në ndonjë fakt juridik relevant, provimi i të cilit do të ishte i vështirë, pretendimin e vet për ekzistimin apo mos ekzistimin e faktit e provon duke u bazuar në rregullat e prezumimit ligjor.

Si rregull prezumimet ligjore janë **të rrëzueshme**, prandaj ato mund të kundërshtohen edhe nëse është vërtetuar ekzistimi i bazës së prezumuar. Në këto raste barra e të provuarit bie në palën e cila e konteston ekzistimin e fakteve të tilla.

Nga praktika gjyqësore:

“Pranimi i padisë do të thotë vetëm pranim i fakteve të theksuara në padi, prandaj pa pranimin e kërkesë – padisë në mënyrë shprehimore gjykata nuk është e autorizuar që ta pranojë kërkesë – padinë me aktgjykim në bazë të pohimit”

“Që një rrethanë të jetë e njohur përgjithësisht, nuk ka nevojë të jetë e njohur të gjithëve, por mjafton që ajo të jetë e njohur një rrethi të gjerë të njerëzve. Mjafton që të jetë e njohur në mjedisin në të cilin zhvillohet gjykimi”.

1.7 Ushtrime

Gjatë këtij sesiioni pjesëmarrësve do tu prezantohet nga një shembull praktik, i cili ndërlihet me temat e shtjelluara më lartë. Ata do të ndahen në grupe të vogla dhe nga ana e secilit grup (përfaqësuesi i grupit) do ta prezantojnë mendimin e tyre, në lidhje me rastin praktik.

1.8 Përmbledhje

Gjatë këtij sesiioni pjesëmarrësit janë trajnuar lidhur me mjetet provuese, fuqinë provuese të provave, vlerësimin e provave, cilës nga palët ju takon barra e të provuarit, në cilat raste gjykata kujdeset kryesisht për barrën e të provuarit, të bëjnë vlerësimin e fakteve juridike relevante të çështjeve konkrete kontestuese, dhe fakteve të cilat nuk kanë nevojë të provohen.

2. Marrja e provës, sigurimi i provës, mjete provuese dhe këqyrja në vend

2.1 Hyrje

Gjatë këtij sesioni pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të kuptojnë faktin se marrja e provës është procedurë urgjente dhe po që se nuk zbatohet në këtë mënyrë, atëherë do të humb vlera e të njëjtës dhe do të jetë shumë e vështirë që në fazat e mëvonshme të procedurës të vërtetohet ekzistenca apo mos ekzistenca e një fakti relevant e një çështje konkrete. Pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të e përvetësojnë mënyrën e përpilimit të kërkesës për sigurimin e provës, përkatësisht që të e hartojnë procesverbalin lidhur me marrjen e provës e i cili procesverbal gjatë shqyrtimit kryesor do të zbatohet dhe lexohet në cilësi të provës. Pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të kuptojnë faktin se procedura e sigurimit të provës zbatohet gjithnjë me propozimin e palëve, si dhe do të kuptojnë edhe rastet specifike kur e njëjta zbatohet kryesisht nga ana e gjykatës. Do të kuptojnë fazat e procedurës kur mund të bëhet sigurimi i provës dhe kompetencën e gjykatës për sigurimin e provës. Do të njihen më saktësisht me llojet e mjeteve provuese, me zbatimin të cilave gjyqtari i një çështje konkrete mund të vendosë meritosisht në një rast konkret.

2.2. Objektivat trajnues

Pas përfundimit të këtij moduli trajnues, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Njohin rëndësinë e mjetit provues;
- Fitojnë njohuri për marrjen e provës me këqyrjen në vend;
- Thellojnë njohurit rreth procedurës së marrjes së provës para gjykatës së porositur;
- Zbatojnë drejtë fazat procedurale në të cilat duhet të bëhet sigurimi i provës (paraprova) etj.

2.3 Marrja e provave

Marrja e provave është veprim procedural i gjykatës me anë e të cilit ajo merr dijeni për bazat e të provuarit nga mjete provuese. Me anë të aktvendimit për marrjen e provave, i cili është pjesë e procesverbalit të shqyrtimit kryesor, gjykata cakton rrethin e fakteve që duhet të provohen, lloji i provave që do të lejohen për vërtetimin e tyre, caktohet mënyra, koha dhe vendi i marrjes së provave.

Është rregull që provat të merren në seancë për shqyrtim kryesor të çështjes. Kjo është shprehje e parimit të drejtpërdrejtshmërisë dhe kontradiktoritetit të cilat parime obligojnë që provat të nxjerrën para gjykatës e cila do të merr vendim për objektin e kontestit. Mirëpo në interes të ekonomizimit të procesit, të efikasitetit në vendosje, ligji bënë përjashtim nga ky rregull duke përcaktuar mundësin që gjykata të vendos që prova e caktuar të merret para ndonjë gjykatë tjetër (gjykata e porositur).

Kur gjykata vendosë që një provë të merret përpara **gjykatës së porositur**, kërkesën e bën me anë të lutjes në formë të shkruar në të cilën përshkruhet gjendja e çështjes sipas të dhënave nga shkresat e lëndës dhe posaçërisht do të theksohet se cilat rrethana duhet të kihen posaçërisht parasysh me rastin e marrjes së provës, varësisht nga shkaqet të cilat e imponojnë ose e arsyetojnë marrjen e provës së tillë. Shkaqet e tilla mund të jenë: a) të natyrës ligjore dhe b) të natyrës objektive. Shkaqet e natyrës ligjore janë ato shkaqe që ja pamundësojnë gjykatës marrjen

e provave jashtë territorit të saj. Ndërsa shkaqet e natyrës objektive janë ato të cilat kanë të bëjnë me shpenzimet e mëdha dhe me humbje të gjatë të kohës të cilat do të bëheshin nëse gjykata e çështjes do t'i nxirrte vetë provat e caktuara.

Zakonisht gjykatës së porositur i besohet nxjerrja e provave vetëm për shkaqe të rëndësishme: me dëgjimin e dëshmitarëve, sjellja e të cilëve në gjykatën e çështjes është e pamundur apo është e vështirësuar, në rast të sëmundjes së dëshmitarit, më këqyrjen në vend (kur sendi i cili duhet të këqyret-shikohet, gjendet në territorin e gjykatës së porositur), me ekspertim të lëmisë së caktuar profesionale. Ndërsa, provën me dëgjimin e palëve vetëm nëse pala për shkak të pengesave të paevitueshme nuk mundet personalisht të paraqitet në gjykatë, apo nëse ardhja e të njëjtit do të shkaktonte shpenzime jo proporcionale.

Veprimet e kryera nga gjykata e porositur për marrjen e provës pasqyrohen në procesverbal, i cili duhet t'i përmbaj të gjitha elementet që i përmban procesverbali nga seanca për shqyrtim kryesor e i cili lexohet në seancë për shqyrtim kryesor të çështjes, lidhur me të cilin palët ndërgjyqëse kanë të drejtë të deklarohen. Në këtë mënyrë procesverbali i përpiluar nga gjykata e porositur bëhet pjesë e lëndës provuese të çështjes e cila është objekt i kontestit dhe i njëjti bashkë me provat tjera i shërben gjykatës për krijimin e bindjes së vet lidhur me ekzistimin apo mos ekzistimin e fakteve relevante dhe për vendosjen e çështjes.

Gjykata e porositur me rastin e marrjes së provës, i ka të gjitha autorizimet të cilat i ka gjykata e çështjes me rastin e marrjes së provës në seancën për shqyrtimin kryesor. Kështu që në qoftë se prova është paraparë të merret me dëgjimin e dëshmitarit, gjyqtari i çështjes së porositur ka të drejtë ta thërrasë dëshmitarin për të dëshmuar që ta merr deklaratën e dëshmitarit, që ta dënojë dëshmitarin, nëse refuzon që të dëshmojë ose që të mos përgjigjet në pyetjet e shtruara pa arsye, që të urdhërojë sjelljen e tij me forcë në gjykatë etj.

Aktvendimi me të cilën marrja e provës i është besuar gjykatës së porositur e ka karakterin e veprimit procedural andaj kundër të njëjtit nuk është e lejuar ankesa e veçantë (neni 387 par.2 të LPK-së).

Po që se sipas rrethanave të rastit mund të supozohet se një provë nuk mund të merret brenda një afati të arsyeshëm apo në qoftë se prova duhet të merret jashtë shtetit, gjykata me aktvendim mbi marrjen e provave do të caktojë një afat deri në të cilin do të pritet që prova të merret, pas kalimit të afatit të tillë shqyrtimi i çështjes do të vazhdojë, pavarësisht se prova e tillë nuk është marrë (neni 325 i LPK-së). Pra, këtu është paraparë edhe zgjatja e afatit për marrjen e ndonjë prove, si dhe shkaqet të cilat e detyrojnë gjykatën në marrjen e vendimit të tillë. Andaj, kohëzgjatja e afatit për marrjen e provës varet nga rrethanat e rastit, mirëpo gjykata duhet të ketë parasysh që ato afate të jenë sa më të shkurtra për hirë të efikasitetit dhe parimit të ekonomizimit të procedurës. Ky afat është zakonisht 30 ditë, nga dita e mbajtës së seancës përgatitore (neni 420 par.2 i LPK-së). Mirëpo, gjykata është e autorizuar që në rastet kur një provë e propozuar nga Gjykata dhe e pranuar nga e njëjta, për shkak të rrethanave nuk mund të merret në afatin e caktuar, të caktojë afat të veçantë gjyqësor, **kur prova duhet të merret jashtë shtetit**. Në raste të këtilla gjykata e ndalë procedurën deri me kalimin e atij afati. Mirëpo, nëse afati i veçantë për marrjen e provës kalon pa sukses, gjykata do të vazhdojë me shqyrtimin e çështjes, të përfundojë dhe të marrë vendimin për çështjen kontestuese pavarësisht nëse prova e tillë nuk është marrë.

2.4 Sigurimi i provës- parapropa

Si rregull provat merren gjatë zhvillimit të procedurës dhe kryesisht në seancën për shqyrtimin kryesor. Mirëpo në praktikë shpeshherë paraqiten situata të cilat kërkojnë që provat të merren sa më shpejtë për shkak se marrja e tyre më vonë do të jetë e vështirësuar ose krejtësisht e pamundur, me çka do të vihej në pyetje ofrimi i mbrojtjes së të drejtave subjektive të mohuara apo të cenuara, përkatësisht do të vihej në pyetje interesi ligjor i palës. Për këtë arsye ligjvënësi në dispozitën e nenit 379 të LPK-ës ka paraparë se, nëse rrethanat tregojnë se një provë ***nuk do të mund të merret në seancën për shqyrtimin kryesor*** ose marrja e saj do të jetë e vështirësuar, me propozimin e palës gjykata mund të urdhërojë ***marrjen e provës më herët, gjatë zhvillimit të procedurës ose para fillimit të saj.***

Sigurimi i provës në mënyrën e paraparë më këtë dispozitë ligjore përfaqëson shmangien nga parimi i drejtëpërdrejtshmërisë, si dhe nga parimi i ekonomizimit. Kjo për arsye se një njëerë anë prova nuk do të merret në seancën e shqyrtimit kryesor, kur merren edhe prova tjera, por në seancë lexohet procesverbali për sigurimin e provës së tillë, dhe në anën tjetër për arsye se në fazën kur bëhet sigurimi i provës, gjykata nuk ka mundësi që të vlerësojë nevojën e marrjes së saj për çka ekziston rreziku që ajo provë më vonë të tregohet e panevojshme. Mirëpo, duke pas parasysh faktin se funksioni themelor i procedurës kontestimore është mbrojtja gjyqësore e të drejtave subjektive të cenuara apo të mohuara, sigurimi i provës në pajtim me këtë dispozitë ligjore përfaqëson kompromis midis parimeve të drejtëpërdrejtshmërisë dhe ekonomizimit nga njëra anë, dhe të ofrimit të mbrojtjes gjyqësore të drejtave subjektive të mohuara apo të cenuara nga ana tjetër, gjë që konsiderohet e arsyeshme.

Në procedurën për sigurimin e provave gjykata e vlerëson vetëm arsyen apo shkakun për nevojën e sigurimit të provës para kohës, përkatësisht faktin se nëse ekziston dyshimi se ndonjë provë fare nuk do të mund të merret ose marrja e saj do të vështirësohej.

Procedura për sigurimin e provës gjithnjë zbatohet me propozimin e palëve. Përjashtim nga ky rregull mund të behët vetëm në rastet kur duhet të vërtetohen faktet që kanë të bëjnë me situatën në të cilën sipas vlerësimit të gjykatës duhet të pengohet dispozicioni i palëve, siç parasheh **neni 3 par.3 i LPK-së**. Pra gjykata **nuk do të miratojë disponimet e palëve** që janë në kundërshtim me: rendin juridik, dispozitat ligjore dhe rregullat e moralit publik. Në raste të tilla gjykata mund të urdhërojë sigurimin e provës edhe nëse palët nuk e kanë propozuar një provë të këtillë. Për dallim nga ligji i mëparshëm (neni 272 i LPK-ës) sipas të cilës dispozitë ka qenë e përjashtuar mundësia e marrjes së provës më dëgjimin e palëve, sipas kësaj dispozite në propozimin për sigurimin e provës mund të përfshihen të gjitha mjetet provuese, pra edhe dëgjimi i palëve të cilin mjet provues tani ligji i ri i LPK-ës në nenin 373, në tërësi e ka barazuar me mjetet e tjera provuese dhe si i tillë mund të përdoret edhe në procedurën e sigurimit të provës .

Shkaqet për sigurimin e provës përcaktohen edhe nga vetë lloji i mjetit provues, i cili duhet të përdoret për sigurimin e provës. Rast konkret mund të jetë nëse një dokument është në gjendje të atillë, që më kalimin e kohës mund të shkatërrohet ose mund të bartet në vendin e huaj, nga i cili nuk do të mund të merrej më. Përveç kësaj, shkak tjetër për sigurimin e provës është edhe rasti kur gjurmët në vendin e ngjarjes duhen shikuar shpejtë që të mos shkatërrohen, kur dëshmitari i cili duhet të procedohet është i sëmurë dhe ekziston rreziku që të vdesë, kur pala dëmin i cili i është shkaktuar dëshiron vetë ta eliminojë, sepse ngelja e tij në gjendjen ekzistuese e rrezikon shkatërrimin e sendit etj. psh. *(rastet kur pala ka pësuar aksident komunikacioni dhe automjeti i tij i është dëmtuar rëndë, andaj para se i njëjti të e riparojë te automekaniku përkatës dhe para së të parashtrijë padi për kompensim dëmi, kërkon nga gjykata sigurimin e një provë të këtillë në prezencën edhe të ekspertit nga lëmia përkatëse).*

Pra, palët propozimin për sigurimin e provës mund ta bëjnë para inicimit të procedurës dhe gjatë zhvillimit të njëjtës. Propozimi për sigurimin e provës pas seancës përgatitore mund të bëhet vetëm lidhur me provën, nxjerrja e të cilës është caktuar në seancën përgatitore, përkatësisht të provës të cilën pala pa fajin e saj nuk ka mundur që ta propozojë në seancën përgatitore.

Sipas nenit 379 par.2 të LPK-së propozimi për sigurimin e provës përveç rasteve që e njëjta mund të parashtrohet para fillimit të procedurës dhe gjatë zhvillimit të saj, mund të parashtrohet edhe në procedurën **sipas propozimit për përsëritjen e procedurës**. Rast konkret mund të jetë kur objekt shqyrtimi ka qenë send i paluajtshëm, kurse i njëjti mund të humb ose të asgjësohet dhe në këtë kontekst pamundësohet marrja e provës e cila do të ishte relevante për marrjen e vendimit në këtë fazë të procedurës, këtë nga fakti se vendimi i formës së prerë- mund të zbatohet para marrjes së vendimit sipas propozimit për përsëritjen e procedurës.

Sigurimi i provës mund të kërkohet edhe gjatë **procedurës së revizionit** (edhe pse ligji shprehimisht nuk e parasheh). Kjo në qoftë se në procedurën e revizionit konstatohen shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës apo të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë jo të plotë, gjykata do të pranojë revizionin dhe do të i anulojë pjesërisht apo tërësisht aktgjykimet e instancave më të ulëta, apo vetëm aktgjykimin e shkallës së dytë dhe çështjen do ta kthejë për rigjykim në gjykatat e instancave më të ulëta (neni 224 par.2 i LPK-së) andaj në këto situata është e mundur që të merren provat të cilat nuk janë marrë më parë, e si rrjedhojë mund të jetë e domosdoshme që të bëhet sigurimi i provës.

Shpenzimet e procedurës për sigurimin e provës i bartë propozuesi, mirëpo i njëjti këto shpenzime mund të i kërkojë si pjesë të shpenzimeve të procedurës në të cilën është përdorur prova e nxjerrë në procedurën e sigurimit të provës (neni 452 par.1 i LPK-së).

Sipas dispozitës 380 të LPK-së është paraparë **kompetenca** e gjykatës për procedim sipas kërkesës për sigurimin e provës. Si rregull, kompetente për marrjen e provave gjate procedurës gjyqësore është gjykata para së cilës zhvillohet procesi. Pra, në rastet e këtylla kompetente për sigurimin e provave është gjykata në të cilën është dorëzuar padia. Ky rregull vlen edhe për propozimet për sigurimin e provave të parashtruar lidhur me kërkesën për përsëritjen e procedurës, andaj edhe në këto raste propozimi parashtrohet në gjykatën në të cilën zhvillohet kjo procedurë.

Me qëllim që procedura për sigurimin e provës të bëhet me sa më pak shpenzime dhe në afat sa më të shkurtër (parimi i ekonomizimit dhe i efikasitetit) në rastet kur është ngritur padia dhe kur marrja e provës është propozuar të bëhet me dëgjimin e dëshmitarit ose me këqyrjen e sendit propozimi për sigurimin e provës i parashtrohet gjykatës në territorin e së cilës dëshmitari duhet të procedohet, përkatësisht në territorin e së cilës ndodhet sendi i cili duhet të këqyret).

Në qoftë se kemi të bëjmë me raste **urgjente** kur shtyrja rrezikon që marrja e provës të vështirësohet apo të pamundësohet (*ps*. “*për shkak se ekziston rreziku që sendi i cili duhet të këqyret do të shkatërrohet shpejtë nga të reshurat atmosferike ose nga pronari apo poseduesi i tij, ose kur sipas konstatimit të mjekut rezulton se dëshmitari i cili duhet të procedohet mund të jetojë edhe vetëm pak kohë*”), ligji e ka paraparë mundësinë që kërkesa për sigurimin e provës t i paraqitet gjykatës në territorin e së cilës dëshmitari i cili duhet të procedohet e ka vendbanimin, gjegjësisht ku ndodhet sendi që duhet të këqyret edhe nëse është ngritë padi në gjykatën tjetër. Në këto raste kërkesa për sigurimin e provës i paraqitet gjykatës së shkallës së parë, ndërsa gjykatës së shkallës së dytë kërkesa për sigurimin e provës i paraqitet vetëm kur është në rrjedhë procedura sipas propozimit për përsëritjen e procedurës.

Sipas dispozitës së nenit 381 të LPK-së në mënyrë decidive është paraparë se :“Në kërkesën për sigurimin e provës duhet të tregohen provat që duhet të merren, rrethanat dhe faktet për

vërtetimin e të cilave shërben ajo provë dhe arsyet që e justifikojnë marrjen e saj, përpara se të vijë koha normale për marrjen e provave. Në kërkesë duhet të tregohet emri dhe mbiemri i palës kundërshtare, përveç kur ajo është e panjohur”. Pra sipas kësaj dispozite parashihet përmbajtja e propozimit. Pala në propozim ka për detyrë të theksojë provat që duhet të merren faktet për vërtetimin e të cilave shërbejnë provat e propozuara si dhe shkaqet për të cilat konsiderohet se më vonë ajo nuk do të mund të merret, ose marrja e saj do të jetë e vështirësuar. Rëndësia e këtyre të dhënave qëndron në faktin se, në bazë të tyre gjykata do të vlerësojë arsyeshmërinë e kërkesës për sigurimin e provës. Po ashtu në propozim pala ka për detyrë që ta theksojë edhe emrin e palës kundërshtare, përveç kur ajo është e panjohur. Në qoftë se provat kërkohen të sigurohen para ushtrimit të padisë në gjykatë, në disa raste të caktuara nuk do të jetë e mundur që të dihet emri i palës tjetër (psh. : “në rastet kur kemi të bëjmë më sëmë të cilin e ka shkaktuar personi i panjohur” etj) propozimi për sigurimin e provës mund të paraqitet edhe pa emrin e palës së kundërt, mirëpo në atë rast propozuesi duhet të potencojë faktet të cilat palën kundërshtare e bëjnë të panjohur. Në raste të këtyra palës së panjohur do t’i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm në kuptim të nenit 383 par.2 të LPK-së.

Me dispozitën ligjore të nenit 382 të LPK-së, është paraparë procedura e cila duhet të zbatohet lidhur me propozimin për sigurimin e provës. Si rregull gjykata propozimin për sigurimin e provës do t’ia dërgojë palës kundërshtare, nëse ajo është e njohur, me qëllim që asaj palë t’i mundësohet që të deklarojë lidhur me propozimin e palës tjetër, edhe pse shprehimisht ligji nuk e parasheh këtë, atëherë gjykata për shkak të natyrës **urgjente** të kësaj procedure, palës kundërshtare do t’ia caktojë afatin për t’u deklaruar në propozimin e palës tjetër, i cili do të caktohet varësisht nga të gjitha rrethanat e rastit, e sidomos nga nevoja për procedim urgjent lidhur me sigurimin e provës së propozuar.

Në qoftë se pala kundërshtare është e panjohur si dhe në rastet kur sigurimi i provës nuk duron shtyrje, gjykata do të jap vendimin sipas propozimit për sigurimin e provës edhe pa deklarimin e palës kundërshtare. Rastet e këtyra janë kur pala kundërshtare vije në dijeni të ekzistimit të propozimit dhe kalimi i kohës do të shkojë në dem të rezultatit të provuarit, atëherë i njëjti do të pengojë sigurimin e provës, duke e eliminuar sendin i cili ndodhet tek ai (pala kundërshtare), e nëse kundërshtari i cili duhet të pyetet është në çastet e fundit të jetës së tij. Në këto raste, si dhe në çdo situatë tjetër të ngjashme e cila nuk duron shtyrje, gjykata duhet të veprojë me shpejtësi dhe në mënyrë operative.

Lidhur me propozimin për sigurimin e provës gjykata vendos me aktvendim. Në qoftë se gjykata e miraton kërkesën për sigurimin e provës, me të njëjtën Aktvendim do të theksojë provën e cila duhet të merret, mënyrën e marrjes së saj dhe faktet të cilat duhet të provohen me ato prova.

Aktvendimi me të cilin është miratuar kërkesa për sigurimin e provës i dërgohet palës kundërshtare. Palës të cilës nuk i është dorëzuar propozimi për sigurimin e provës, në pajtim me nenin 382 par. 1 të LPK-së, propozimi do t’i dërgohet së bashku me aktvendimin me të cilin është pranuar kërkesa për sigurimin e provës dhe është caktuar seanca për sigurimin e saj.

Në qoftë se pala kundërshtare është e panjohur ose nëse vendbanimi i saj nuk dihet, gjykata mund t’ia caktojë përfaqësuesin e përkohshëm në pajtim me nenin 79 të LPK-së, e këtë me qëllim të pjesëmarrjes në seancën për sigurimin e provës. Për shkak të natyrës urgjente të çështjes aktvendimi për emërimin e përfaqësuesit të përkohshëm për pjesëmarrje në shqyrtimin për sigurimin e provës nuk duhet të bëhet shpallje publike siç parasheh neni 83 i LPK-së, për raste tjera.

Si rregull, para dorëzimit të aktvendimit për miratimin e propozimit për sigurimin e provës gjykata nuk mund të fillojë marrjen e provës, mirëpo në raste të ngutshme gjykata mund t’i qaset marrjes së provës edhe para dorëzimit të aktvendimit palës kundërshtare. Në raste të këtyra pala

kundërshtare do të njoftohet për sigurimin e provës në momentin kur prova e tillë do të administrohet, atëherë e njëjta ka të drejtë në të gjitha kundërshtimet, si dhe në propozimin që marrja e provës, sigurimi i të cilës është bërë të përsëritet, nëse kjo edhe më tej është e mundur.

Kundër aktvendimit të gjykatës në të cilën pranohet propozimi për sigurimin e provës, si dhe kundër aktvendimit me të cilën vendosët marrja e provës, para se aktvendimi t'i dërgohet palës kundërshtare, nuk lejohet ankimimi (neni 383 par.4 i LPK-së). Pra, kjo dispozitë ligjore bën përjashtim nga parimi i drejtpërdrejtëshmërisë, për arsye se lejon mundësinë e marrjes së provës para se t'i dërgohet aktvendimi palës kundërshtare. Mirëpo, ky përjashtim mund të arsyetohet si me urgjente i procedurës për sigurimin e provës, ashtu si edhe me faktin që palës kundërshtare gjithsesi do t'i mundësohet që lidhur me provën e siguruar dhe me fuqinë provuese të saj të deklarohet në seancën për shqyrtimin kryesor në të cilën do të përdoret prova e tillë.

Në rast se gjykata me aktvendim e refuzon propozimin për sigurimin e provës, atëherë kundër atij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës.

Gjykata ka për detyrë që t'i thërrasë të dyja palët në shqyrtimin e caktuar për sigurimin e provës. Mirëpo, për derisa mos përgjigja e palës kundërshtare në thirrjen e gjykatës ka për pasojë mbajtjen e shqyrtimit në mungesë të saj, ndërsa nëse në shqyrtimin për sigurimin e provës nuk prezanton pala e cila e ka propozuar sigurimin e provës dhe nuk e ka justifikuar mos prezencën atëherë gjykata do ta refuzojë propozimin e tillë (neni 384 par. 1 i LPK-së).

Pala kundërshtare mund të ketë interes, që prova e propozuar nga propozuesi të sigurohet prandaj në qoftë se ajo propozon që prova e propozuar megjithatë të sigurohet, gjykata mund të vendosë që prova e tillë të sigurohet edhe nëse pala e cila e ka propozuar sigurimin e saj nuk merr pjesë në seancën e caktuar për këtë qëllim.

Mënyra e marrjes së provës në procedurën e sigurimit të saj kryesisht varet nga ajo se me cilin mjet provues propozohet që ajo të sigurohet, me dëshmitarë me anë të dokumentit, me këqyrjen e objektit, me procedimin e palëve etj, andaj si rrjedhojë edhe të sigurimit të provës lidhur me mënyrën e marrjes së saj, në mënyrë të përshtatshme ("mutatis mutandis") zbatohen dispozitat e këtij ligji që vlejné për marrjen e provave në procedurën e rregullt gjyqësore. Fuqia provuese e provës varet nga argumentimi që ajo ofron për vërtetimin e faktit të caktuar, prandaj kjo vlen edhe për provat, marrja e të cilave bëhet në procedurën e sigurimit të provës.

Sikurse me veprime të tjera procedurale edhe lidhur me procedurën e sigurimit të provës gjykata harton procesverbalin. Në qoftë se procedura për sigurimin e provës është zhvilluar para se të ngritet padia, **procesverbali i përpiluar** lidhur me këtë rast ruhet në gjykatë, e cila ka bërë sigurimin e provës (385 par.1 i LPK-së). Palëve mund t'u jepet kopja e procesverbalit i cili është hartuar në procedurën e marrjës të provës, kurse në rast se sigurimi i provës është bërë me ekspertim atëherë atyre u dorëzohet kopja e mendimit dhe e konstatimit të ekspertit.

Në qoftë se procedura është në zhvillim e sipër, kurse për shkak të urgjencës, sigurimin e provës nuk e ka bërë gjykata e çështjes, procesverbali për sigurimin e provës do t'i dorëzohet gjykatës të e cila është duke u zhvilluar procedura. Si rregull procesverbali për sigurimin e provës përpilohet para ngritjes së padisë, me propozimin e palëve, ai do të lexohet si provë në kontestin i cili është iniciuar pas sigurimit të provës. Mirëpo, gjykata mund të vendosë që mos ta lexojë procesverbalin për sigurimin e provës, përkatësisht provën e siguruar mos ta marrë, nëse konstaton se fakti i cili provohet me të nuk është relevant, ose se i njëjti nuk është kontestues midis palëve.

Gjykata gjatë procedurës mund ta plotësojë provën e siguruar me procedimin e serishëm të dëshmitarit apo të ekspertit, apo me këqyrjen e serishme të sendit, nëse vlerëson se kjo është e nevojshme për sqarim më të mirë të çështjes dhe nëse ekzistojnë kushtet për një veprim të tillë.

Nga praktika gjyqësore:

1. *“Në procedurën për sigurimin e provës nuk është i lejuar shqyrtimi lidhur me bazën juridike midis palëve, përkatësisht nëse propozuesi ka të drejtë dhe çfarë është ajo e drejtë në raport me palën kundërshtare”*
2. *“Procedura e sigurimit të provës përfundon me paraqitjen e procesverbalit mbi këqyrjen e sigurimit të provës për gjykatën kontestimore dhe kundër tij nuk është i lejuar ankesa, kurse prova e siguruar do të jetë objekt i analizës dhe vlerësimit në procedurën në të cilën prova e tillë do të përdoret”.*

2.5 Mjetet provuese

Mjete provuese (provë) quhet çdo burim nga i cili me anë të organeve të shqisave nxjerrim njohuri për vërtetësinë e thënies se ekziston apo nuk ekziston një fakt për të cilin lidhet pasoja e caktuar juridike (qoftë ajo e natyrës procedurale, qoftë e natyrës materiale).

Në rastin e parë gjyqtari i çështjes personalisht me vrojtim të drejtë për drejtë e vërteton ekzistimin apo mos ekzistimin e ndonjë fakti relevant kontestues psh: me shqisa të pamurit e vërteton ekzistimin e sendit, cilësitë e tij, apo gjendjen në të cilën gjendet sendi, me shqisa të dëgjuarit e vërteton ekzistimin e zhurmës nga gjeneratori i fqinjtit, me shqisën e të nuhaturit e vërteton ekzistimin e erës, e cila kundërmon nga mbeturinat e fqinjtit, me shqisa të shijuarit e vërteton shijen e ushqimit në restorantin e studentëve etj.

Në rastin e dytë (kur duhet të sqarohet ndonjë rrethanë), gjykata këtë veprim procedural e ndërmerr me qëllim të sqarimit të ndonjë rrethane e cila në mënyrë indirekte e shpjegon ekzistimin apo mos ekzistimin e ndonjë fakti psh: verifikimin e thënieve të dëshmitarit nëse e ka parë ngjarjen e caktuar për të cilën ka dëshmuar, nëse pozita e rrugës në të cilën ka ndodhur aksidenti i trafikut ka mundur shikimin në largësi të caktuar këmbësorit.

Mjetet provuese janë të parashikuara në dispozita të veçanta të LPK-ës sipas llojit të tyre. Këto mjete janë: **këqyrja në vend, shkresat, dëshmitarët, ekspertët dhe dëgjimi i palëve**. Siç shihet lloji i provave varet nga lloji i burimit të parashikuar në ligj.

2.6 Këqyrja në vend

Këqyrja në vend është një nga llojet e mjeteve provuese që shërben për ta venë gjykatën në mundësi që të marr dijëni vet për gjendjen dhe cilësitë e personave dhe sendeve. Dijënia e fituar në këtë mënyrë gjykatës i shërben për vërtetimin e vërtetësisë së thënieve që janë objekt i të provuarit.

Gjykata sipas propozimit të palëve e cakton marrjen e kësaj prove dhe atë:

- në raste kur është e nevojshme të vërtetohet ekzistimi ose mosekzistimi i ndonjë fakti kontestues dhe
- kur duhet të sqarohet ndonjë rrethanë.

Ky mjet provues i jep mundësi gjykatës të marrë dijëni vetë pa ndërmjetësimin e të tjerëve për gjendjen e veçoritë kryesore të personave dhe sendeve të luajtshme e të paluajtshme. Ky mjet provues i shërben gjykatës për të verifikuar vërtetësinë e thënieve të dëshmitarëve, të pretendimeve të palëve, madje disa herë edhe konkluzionet e ekspertëve, duke përfutur kështu edhe një provë të re.

Përmes këqyrjes se personave, këqyrjen e sendeve dhe këqyrjen në vend si veprim procedural, krahas verifikimit të fakteve të kontestueshme mund të zbulohen edhe ekzistimi i fakteve të tjera të rëndësishme.

Ne qoftë se për nxjerrjen e provës me këqyrjen në vend nevojitet njohuri profesionale të cilën gjykata nuk e ka, gjykata mundet që këqyrjen ta realizoj me pjesëmarrjen dhe ndihmën e ekspertit të lëmisë përkatëse, p.sh me ndihmën e gjeodetit, ndërtimtarit, arkitektit, agronomit etj. Në këto raste eksperti i ndihmon gjyqtarit dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë me këshilla, sugjerime dhe ekspertizë në mënyrë që të kuptohet më mirë fakti i cili provohet në këtë mënyrë.

Këqyrja në vend mund të bëhet në gjykatë dhe jashtë gjykatës. Jashtë gjykatës mund të bëhet në rastet kur sendi i cili është objekt i këqyrjes nuk mund të silllet në gjykatë, ose kur sjellja e objektit të këqyrjes do të shkaktonte shpenzime të jashtëzakonshme. Zakonisht këqyrja jashtë gjykatës bëhet kur objekt shqyrtimi i një çështje kontestuese janë paluajtshmëritë (psh: konstatimin e gjendjes së ndërtesës pas plasaritjes të mureve si pasojë e dëmtimit të statikës, gjendja e tokës bujqësore pas hedhjes së gurëve nga gurëthyesi në të, gjendja e pyllit pas prerjes së drunjëve nga fqinji etj.) si dhe për sendet e luajtshme sjellja e të cilave në hapësirat e gjykatës është e pamundur ose do të mund të bëhej në vështirësi të mëdha (orenditë shtëpiake të dëmtuara nga uji, nga tymi etj.).

Këqyrja në vend zakonisht realizohet nga gjykata e çështjes, mirëpo në rastet kur këqyrja duhet të realizohet në territorin e gjykatës tjetër, ajo mund të bëhet edhe nga gjykata e porositur.

Me rastin e këqyrjes në vend gjykata harton *procesverbal*, i cili duhet të përmbajë kohën kur është realizuar shikimi në vend, prezencën e palëve ndërgjyqëse (dhe të autorizuarve të tyre nëse kanë), si dhe eventualisht prezencën e ekspertit të profilit përkatës. Në procesverbal përshkruhet me saktësi objekti i këqyrjes, gjendja e tij dhe të dhënat e tjera të cilat kanë qënë qëllimi i këqyrjes. Procesverbali i tillë do të administrohet në cilësi të provës para gjykatës së çështjes.

Nga praktika gjyqësore:

“Gjykata ka për detyrë që palët ndërgjyqëse t’i njoftoj për vendin dhe datën kur do të mbahet kryerja në vend, në të kundërtën vjen deri të shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore

2.7 Ushtrime

Gjatë këtij sesioni pjesëmarrësve do tu prezantohet nga një shembull praktik, i cili ndërlidhet me temat e shtjelluara më lartë. Ata do të ndahen në grupe të vogla dhe nga ana e secilit grup (përfaqësuesi i grupit) do ta prezantojnë mendimin e tyre se si përpilohet procesverbali me rastin e shikimit në vend në lidhje me rastin praktik.

2.8 Përmbledhje

Gjatë këtij sesi pjesëmarrësit janë trajnuar lidhur me procedurën e marrjes së provave, e cila procedurë është urgjente. Për veç kësaj pjesëmarrësit e kanë përvetësuar mënyrën e përpilimit të kërkesës për sigurimin e provës për para gjykatës së porositur, e në rastet e caktuara edhe jashtë shtetit, si dhe në cilat faza të procedurës mund të parashtrahet propozimi për sigurimin e provave. Po ashtu pjesëmarrësit i kanë përvetësuar edhe llojet e mjeteve provuese sipas vlerësimit të cilave vendoset një çështje konkrete në mënyrë meritore duke u bazuar në dispozitat ligjore të aplikueshme.

3. Shkresat dhe fuqia provuese e tyre

3.1. Hyrje

Gjatë këtij sesi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të kuptojnë përmbajtjen e shkresave, llojet e tyre, fuqinë provuese të tyre, llojet e dokumenteve: publike, jo publike (private), dokumentet dispozitive, dokumentet dokumentuese, dokumentet e huaja dhe kushtet të cilat këto dokumente duhet plotësuar që të kenë fuqi argumentuese sikurse dokumentet vendore dhe se në cilat raste duhet bëhet sigurimi i dokumenteve kryesisht nga gjykata.

3.2. Objektivat trajnues

Pas përfundimit të këtij moduli trajnues, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Fitojnë njohuri për marrjen e provës me leximin e shkresës-dokumentit,
- Bëjnë identifikimin dhe llojet e dokumenteve.;
- Thellojnë njohurit rreth rasteve për të cilat gjykata me propozimin e palëve, do të bëjë marrjen e shkresave kryesisht etj.

3.3 Shkresat – Llojet e shkresave dhe fuqia provuese e tyre

Çdo shkresë-dokument i cili ka përmbajtje të kuptueshme për të vërtetuar një fakt kontestues lëshuar nga ndonjë organ shtetëror apo organizatë tjetër-person juridik që ushtron autorizime publike apo edhe nga një person tjetër brenda autorizimeve ligjore paraqet mjet provues.

Rëndësia e dokumentit si mjet provues në procedurën kontestimore, ashtu si kundër edhe në procedurat e tjera është jashtëzakonisht e madhe. Kjo për faktin se dokumenti si objekt shkresor ruan në vete gjurmë për kohëra shumë të gjata të ngjarjeve në të kaluarën, të cilën fakt nuk e ofrojnë mjetet tjera provuese.

Varësisht se cili kriter merret për bazë provat shkresore në përgjithësi ndahen në dokumente publike dhe jopublike (private), në dokumente vendore dhe të huaja dhe sipas teorisë ndahen edhe në dispozitive dhe dokumentuese.

3.3.1 Dokumenti publik

Dokument publik apo zyrtar konsiderohet ai dokument shkresor i cili sipas nenit 329.1 të LPK-së, është hartuar nga organi shtetëror, në formën e caktuar, brenda kufijve të kompetencës së vet si dhe shkresa të cilën e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike.

Për të qenë dokumenti publik duhet që të plotësohen këto kushte: të jetë lëshuar nga organi kompetent; të jetë lëshuar në formën e paraparë dhe të jetë lëshuar brenda kufijve të kompetencës së organit që e ka lëshuar.

Fuqinë provuese të dokumentit publik e kanë edhe shkresat tjera të cilat me dispozita të veçanta janë barazuar me dokumentet publike, p.sh. dokumentet e lëshuara nga *noteri* etj.

Dokument publik konsiderohet ai dokument shkresor i cili i plotëson kushtet si në vijim

-që të jetë dhënë nga organi shtetëror, nga ndërmarrja apo organizata tjetër,-që të jetë dhënë në kuadër të autorizimeve të tyre dhe

-që të jetë dhënë në formën e paraparë.

Prezumimi ligjor për fuqinë provuese të dokumentit publik para se gjithash mbështetet në domosdoshmërinë për besimin në autoritet dhënësin e dokumentit.

Kjo nga shkakut se organet shtetërore dhe subjektet tjera juridike të cilave u është besuar ushtrimi i autorizimeve publike, përfaqësojnë instrumente unike në qarkullimin juridik, prandaj secilit prej tyre duhet të i falet besimi. Në të kundërtën, mungesa e besimit ndaj këtyre subjekteve do të shpie deri te pasiguria në qarkullimin juridik të vendit. Gjykata për këtë arsye është e kufizuar që t'i provoj faktet të cilat përmbahen në dokumentet publike.

Fuqinë provuese të dokumentit publik mund ta kenë edhe dokumentet tjera të cilat me dispozitat e veçanta janë barazuar me dokumentet publike, p.sh dokumentet e lëshuara nga noteri etj.

Dokumente publike konsiderohen edhe dokumentet të cilat i lëshojnë *përfaqësitë tona diplomatike- konsullore* në kuadër të autorizimeve të tyre, si dhe dokumentet e lëshuara nga institucionet e shteteve tjera në kuadër të kompetencave të tyre.

Sipas nenit 329 paragrafi 1 i LPK-së, gjykata ka për detyrë që ta marr si të saktë atë që është vërtetuar apo përcaktuar me anë të dokumenti publik. Ky është prezumim ligjor për fuqinë provuese të dokumentit publik, duke e marrë parasysh autoritetin dhënës të dokumentit. Në rast të kontestimit të vërtetësisë të dokumentit publik, baza e të provuarit bie mbi palën e cila e ka theksuar kontestimin.

Gjykata është e autorizuar që nga organi, i cili figuron si përpilues i dokumentit, të kërkoj sqarime nëse dyshon në autenticitetin e tij (neni 329 paragrafi 4 i LPK-së). Gjykata do të veprojë njësoj edhe me dokumentin e huaj, mirëpo kërkesa për deklarin e organit i cili duhet të ketë hartuar dokumentin, dërgohet nëpërmes të përfaqësisë diplomatike të Republikës së Kosovës në atë vend, apo nëpërmes të përfaqësisë të atij shteti në Kosovë.

3.3.2 Dokumenti jo publik (privat)

Dokument jopublik është çdo shkrësë tjetër e cila nuk mund të përfshihet me definicionin e dokumenti publik siç parasheh dispozita e nenit 329.1 e LPK-së. Krahas akteve të mësipërme personat zyrtarë mund të nxjerrin shkresa jashtë kufijve të kompetencës së tyre ose jo në formën e kërkuar. Këto akte kanë fuqinë provuese të shkresës së thjeshtë nëse janë nënshkruar nga palët. Pra, vlera provuese e shkresës së thjeshtë varet vetëm nga nënshkrimi i personit në emrin e të cilit është përpiluar.

Dokumentet private nuk e vërtetojnë paraprakisht saktësinë e asaj që përmbahet në to, prandaj, gjykata ka për detyrë që të provojë saktësinë e tyre, çdo herë kur ato kontestohen nga palët ndërgjyqëse. Në këto raste gjykata fillimisht e vërteton *autenticitetin* e nënshkrimeve të palëve e pastaj përmbajtjen e dokumentit si dhe rëndësinë e tij. Mirëpo, nga rezultati i të provuarit, dokumenti privat asnjëherë nuk mund të fitojë cilësinë e dokumentit publik.

Nëse gjykata dyshon se dokumenti privat, i cili është hartuar në formën e paraparë dhe është vërtetuar nga organi përkatës, përmban fakte të pavërteta (është fiktiv apo simulativ), apo nëse objekti i dokumentit, përkatësisht baza e raportit të paraparë në të, është në kundërshtim me

dispozitat imperative ligjore, ka për detyrë që të merr prova me të cilat do t'i vërtetojë faktet e tilla.

3.3.3 Dokumentet dispozitive

Dokumente dispozitive janë ato dokumente në të cilat drejtë për drejtë bazohet krijimi, ndryshimi apo pushimi i ndonjë raporti juridik. Të tilla mund të jenë si dokumentet publike po ashtu ato private. Dokumente dispozitive publike janë *aktgjykimet dhe aktvendimet gjyqësore* të cilat e kanë marrë formën e prerë, vendimet e organeve shtetërore apo të ndërmarrjeve të tjera të marra në pajtim me autorizimet e tyre ligjore, kurse dokumente dispozitive private janë deklaratat e shkruara, kontratat, vërtetimet etj.

3.3.4 Dokumentet dokumentuese

Dokumentet dokumentuese janë ato dokumente shkresore me të cilat nuk krijohen, nuk ndryshohet e as nuk shuhet ndonjë marrëdhënie juridike, por ato shërbejnë si provë për përmbajtjen e ndonjë raporti juridik, të ndonjë të drejte apo detyrimi, të cilat ekzistojnë pavarësisht nga ai dokument. Dokumente të tilla *publike* janë *ekstraktet nga librat amzë të lindurve, të kurorëzuarve, të vdekurve*, kurse dokumente **private** të tilla janë **vërtetimet për ekzistimin e borxhit, për kryerjen e ndonjë shërbimi etj.**

Meqenëse prezumimet për vërtetësinë e përmbajtjes dhe autenticitetit të dokumentit publik, janë *prezumime ligjore të rrëzueshme*, ligji e ka lejuar mundësinë për provimin e të kundërtës. Në veçanti është e lejuar provimi se në dokumentin publik faktet janë konstatuar në mënyrë jo të saktë apo se dokumenti është hartuar në mënyrë jo të rregullt. Provimi i këtyre fakteve në dokumentin publik zakonisht lejohet në rastin kur ato kontestohen nga palët në procedurë dhe kur argumentet e kontestimit e vejnë në dyshim saktësinë e dokumentit.

Në rast të kontestimit të vërtetësisë së dokumentit publik, barra e të provuarit bie në palën e cila e ka theksuar kontestimin. Në rastet kur kemi të bëjmë me autenticitetin e dokumentit publik, rregulli mbi barrën e të provuarit aplikohet nëse dokumenti nuk ka mangësi të jashtme të cilat shkaktojnë dyshim në autenticitetin e tij, barra e të provuarit bie në palën e cila thirret në atë dokument e cila thirret si dokument publik.

Në procedurën kontestimore nuk mund të provohet përmbajtja, përkatësisht saktësia e aktgjykimeve dhe e aktvendimeve të plotfuqishme gjyqësore si dhe vendimeve të organit shtetëror, të ndërmarrjes apo të organizatës tjetër të marra në procedurën administrative, në kuadër të kompetencave të tyre. Këto vendime mund të goditen vetëm me mjete të jashtëzakonshme juridike në procedurën e paraparë me ligj.

Në rastet kur gjykata dyshon në autenticitetin e dokumentit publik, ngase konsideron se është i falsifikuar, mund të kërkojë që lidhur me këtë fakt të deklarohet organi i cili duhet ta ketë hartuar dokumentin.

Gjykata do të veprojë njësoj edhe me dokumentin e huaj, mirëpo kërkesa për deklarimin e organit i cili e ka hartuar dokumentin dërgohet nëpërmes të përfaqësisë diplomatike të Republikës së Kosovës në atë vend, apo nëpërmjet përfaqësisë së atij vendi në Kosovë.

Nga praktika gjyqësore:

“ Për faktet e theksuara në fletë dorëzim vlenë prezumcioni i vërtetësisë deri sa nuk provohet e kundërta”.

“Procesverbali të cilin e ka hartuar regjistruesi publik e ka cilësinë e dokumentit publik, prandaj si rrjedhje e provon vërtetësinë e asaj që caktohet në të. Në procedurën e regjistrimit në regjistër nuk është e lejuar që të provohet se në procesverbalin e tillë faktet janë vërtetuar në mënyrë jo të saktë, por mund të bëhet në procedurën e veçantë kontestimore”.

“Në qoftë se ekziston dyshimi se ankuesi vendimin e goditur e ka pranuar me datën e cila me shkronja është shënuar në fletë dorëzim ose me datën e theksuar në vulën e postës, gjykata është e detyruar që datën e pranimit ta vërtetojë me anë të postës. Nëse në këtë mënyrë nuk është e mundur që të vërtetohet data e pranimit të vendimit gjyqësorë e cila goditet me ankesë, gjykata si datë të pranimit duhet ta marrë datën e mëvonshme”.

3.3.4 Dokumenti i huaj

Neni 330 i LPK-ës në mënyrë shprehimore ka paraparë se: “Po që se me kontratë ndërkombëtare nuk është përcaktuar ndryshe shkresat publike të huaja të legalizuara sipas ligjit, kanë me kusht reciprociteti, të njëjtën fuqi provuese sikurse shkresa publike e vendit”. Pra, dokumentet e huaja publike në parim e kanë fuqinë e njëjtë provuese sikurse edhe dokumentet publike vendore. Mirëpo, që ato dokumente të konsiderohen me fuqi të njëjtë provuese sikurse dokumentet publike vendore, duhet plotësuar kushtet si në vijim:

- që dokumenti i huaj të jetë i legalizuar sipas ligjit;
- që të ekzistojë reciprociteti për njohjen e dokumenteve publike në mes të shtetit të Kosovës dhe shtetit të huaj, organi i të cilit e ka lëshuar dhe
- që dokumenti i huaj të jetë lëshuar nga organi kompetent.

Çështja e vlerëshmërisë së dokumentit të huaj publik në vendin tonë, mund të rregullohet në ndonjë mënyrë tjetër me kontratë ndërkombëtare bilaterale apo multilaterale. Në rastet e tilla me dokumentet e huaja publike do të veprohet në pajtim me dispozitat e asaj kontrate.

Çdo palë ndërgjyqëse detyrohet kryesisht të paraqet shkresat që ka përdorur për të provuar thëniet e veta dhe së bashku me shkresën e hartuar në gjuhë të huaj paraqitet edhe *përkthimi i legalizuar* nga ana e përkthyesit gjyqësor të përhershëm.

Në qoftë se pala në padi, në përgjigje në padi, në parashtrësë apo verbalisht gjatë shqyrtimit kryesor thirret në dokumentin publik si mjet për vërtetimin e fakteve, ka për detyrë që gjykatës të ia dorëzojë atë dokument. Si rregull pala dokumentin duhet ta dorëzojë në *versionin origjinal*, mirëpo nëse ajo e dorëzon kopjen apo përkthimin e dokumentit, gjykata me kërkesën e palës kundërshtare do ta ftojë parashtruesin që ta dorëzojë dokumentin origjinal (neni 101 par.3 i LPK-ës).

Lidhur me ftesën për dorëzimin e dokumentit gjykata vendos me aktvendim me të cilin e cakton edhe afatin brenda të cilit pala duhet ta prezantojë dokumentin si dhe afatin brenda të cilit do të bëhet shikimi i dokumentit në shqyrtimin kryesor, kur bëhet edhe zbatimi i të gjitha provave lidhur me një çështje konkrete. Zakonisht afati për dorëzimin e dokumentit duhet të caktohet disa ditë para datës së mbajtjes së shqyrtimit kryesor, e kjo me qëllim që të iu mundësohet palëve në procedurë që në shqyrtimin kryesor të deklarohen lidhur me dokumentin në fjalë. Kjo do të eliminonte nevojën për shtyrjen e seancës për shkak të mos posedimit me kohë të dokumentit si

provë dhe një mënyrë e tillë e veprimit bëhet edhe për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Nëse gjykata e merr në shikim dokumentin në versionin original, e njëjta këtë fakt do ta shënojë në procesverbal, me të cilin rast shënohen edhe **karakteristikat e dokumentit** të cilat janë me rëndësi për vërtetimin e fakteve lidhur me të cilat është bërë shikimi, si dhe faktit nëse përshkrimi apo fotokopja e cila ndodhet në shkresat e lëndës është **identik** me origjinalin. Nëse dokumenti në origjinal ka rëndësi për palën dhe i nevojitet asaj, gjykata pas shikimit do t'ia kthejë atë palës, i cili fakt gjithashtu shënohet në procesverbal.

3.4 Sigurimi i dokumenteve nga gjykata

Gjykata në bazë të propozimit të palës do ta marrë sipas detyrës zyrtare dokumentin po që se dokumenti ndodhet tek organi shtetëror, ose personi juridik, të cilit i është besuar ushtrimi i autorizimeve publike, ndërsa vetë pala nuk është në gjendje ta dorëzojë apo tregojë atë.

Kur dokumenti ka rëndësi për të provuar pretendimet e një pale, por ndodhet në dorën e palës kundërshtare, gjykata me kërkesën e palës së interesuar, kur e gjen me vend kërkimin, me aktvendim urdhëron paraqitje e këtij dokumenti.

Në tre raste ligji neni 334 i LPK-së, e detyron palën që ta dorëzojë dokumentin gjithsesi:

- Në qoftë se pala vet e ka përmend dokumentin me qëllim të provimit të ndonjë pretendim të saj,
- Në qoftë se është fjala për dokumentin, të cilin ajo sipas ligjit është e detyruar ta dorëzojë apo ta tregojë, (p.sh: dokumenti i cili i është besuar për ruajtje ose që është në bashkëpronësinë e të dy palëve), dhe
- Në qoftë se dokumenti, për shkak të përmbajtjes së tij konsiderohet si i përbashkët për të dy palët, (për shembull: kontrata, testamenti etj).

Pala dhe personi i tretë mund të refuzojnë paraqitjen e dokumentit të kërkuar vetëm për arsyet e përcaktuara me dispozitën e nenit 342 dhe 343 të LPK-së. Kjo në mënyrë analoge zbatohet sikurse të rastet kur ekzistojnë shkaqet për të cilat dëshmitari ka të drejtë të refuzoj të jap deklaratën apo të përgjigjet në pyetjet e caktuara.

Dokumentin të cilin njëra palë dëshiron të përdor për provimin e ndonjë pretendimi, mund të ndodhet në duart e personit të tretë - që nuk është palë në gjykim. Sipas propozimit të palës gjykata mund të urdhëroj me vendim që ta dorëzojë apo tregojë dokumentin e tillë.

Gjykata është e autorizuar që **edhe sipas detyrës zyrtare** të kërkojë nga pala dorëzimin e provave shkresore, të cilat ajo i ka theksuar si mjet për provimin e fakteve kontestuese, e në të cilat i mbështet kërkesat apo kundërshtimet e veta (neni 402 par.1 i LPK-ës).

Në qoftë se pala refuzon që ta dorëzojë në gjykatë origjinalin e dokumentit, i cili ndodhet ke ajo, përshkrimin e të cilës e ka dorëzuar, gjykata këtë sjellje të palës do ta vlerësojë sipas nenit 336 të këtij ligji.

Në qoftë se pala thirret në **dokumentin e huaj** publik i cili është i hartuar në **gjuhë të huaj** ka për detyrë që së bashku me atë dokument ta dorëzojë edhe **përkthimin e tij**, në gjuhën e cila është në

përdorim zyrtar në gjykatë, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët. Dokumenti i huaj duhet të jetë i legalizuar nga ana e përkthyesit gjyqësor

Nga praktika gjyqësore:

“Gjykata nuk i cenon dispozitat e procedurës kontestimore nëse duke vendosur mbi kërkesë padinë nuk e merr parasysh dokumentin e hartuar në gjuhën e huaj të cilit pala nuk ia ka bashkangjitur përkthimin e vërtetuar”.

Neni 332 i LPK-ës, në mënyrë shprehimore parasheh se : “ Po që se dokumenti ndodhet te organi shtetëror, ose personi juridik, të cilit i është besuar ushtrimi i autorizimeve publike, kurse vetë pala nuk është në gjendje ta dorëzojë apo tregojë atë, atëherë gjykata sipas propozimit të palës, do ta marrë sipas detyrës zyrtare këtë dokument”.

Pra, me këtë dispozitë ligjore janë paraparë rastet dhe kushtet në të cilat gjykata, sipas detyrës zyrtare, do ta sigurojë dokumentin i cili është propozuar të merret si provë për vërtetimin e ndonjë fakti. Rastet e tilla kanë të bëjnë kur dokumenti i tillë ndodhet tek organi shtetëror apo subjekti tjetër juridik të cilit i është besuar ushtrimi i autorizimeve publike, kurse pala nuk mundet vetë që të sigurojë atë dokument, atëherë e njëjta mund të kërkojë nga gjykata që ta detyrojë organin shtetëror apo subjektin tjetër juridik, që ta dorëzojë dokumentin, ose që gjykatës t’ia jep në shikim. Mirëpo, gjykata do të veprojë në këtë mënyrë vetëm në qoftë se pala e bënë të besueshme se ka bërë përpjekje për sigurimin e dokumentit, e të cilat përpjekje kanë rezultuar pa sukses në këtë drejtim.

Në qoftë se dokumenti nuk mund të silllet në gjykatë për shkak të **madhësisë** së tij, **të rrezikut** për dëmtim, ose për shkak se atij në mënyrë të përhershme i nevojitet organit kompetent shtetëror apo subjektit tjetër juridik, gjykata me propozimin e palës do ta detyrojë organin shtetëror apo subjektin juridik që t’i dorëzojë raportet apo informatat zyrtare nga dokumenti, **përshkrimin** e pjesëve të dokumentit, ekstraktet ose fotokopjet të tij, (*p.sh: nga subjekti juridik të kërkojë të dhëna nga regjistri i pagave të të punësuarve për lartësinë e pagës së prindit të fëmijës së mitur për caktimin e lartësisë së kontributit për ushqimin e fëmijës; nga shërbimi për regjistrimin e dokumenteve të kërkojë të dhëna për numrin dhe datën e regjistrimit të dokumentit të caktuar në librin përkatës ose fotokopjen e pjesës të librit për regjistrim etj*). Dokumenti i siguruar në këtë mënyrë i cili i përmban informacionet e kërkuara, shërben për qëllim të provuarit, si dhe çdo dokument tjetër publik.

Në qoftë se pala pohon se dokumenti në të cilin është thirrur si mjet për provimin e fakteve kontestuese, **ndodhet te pala tjetër**, ajo mund të kërkojë nga gjykata që ta sigurojë atë dokument. Në këtë rast gjykata fillimisht vlerëson nëse dokumenti i theksuar mund të shërbejë si provë për vërtetimin e fakteve relevante dhe nëse konstaton se ai është i tillë, **me aktvendim** do ta thërrasë palën të e cila ndodhet dokumenti që ta dorëzojë të njëjtin dhe do të ia caktojë afatin për dorëzim.

Aktvendimi për dorëzimin e dokumentit zakonisht merret në seancën përgatitore me qëllim që i njëjti të mund të merret si provë në seancën për shqyrtimin kryesor. Aktvendimi me të cilën është caktuar dorëzimi i dokumentit e ka karakterin e vendimit procedural, prandaj kundër tij nuk është i lejuar ankimi i veçantë (neni 387 parag.2 i LPK-ës).

Nëse pala vetë është thirrur në dokument si mjet për provimin e fakteve kontestuese, ajo **nuk mund të refuzojë dorëzimin** e tij. Po ashtu, pala nuk mund të refuzojë dorëzimin e dokumentit të cilin sipas ligjit material është i detyruar që ta dorëzojë ose ta tregojë, p.sh kur pala dokumentin e ka marrë në ruajtje, në përdorim etj. Pala nuk mund të refuzojë dorëzimin e dokumentit, i cili për shkak të përmbajtjes konsiderohet i përbashkët për të dy palët, p.sh kontrata për shitblerjen e paluejtshmërisë e lidhur në mes të palëve, kontrata për qiranë e lokalit afarist, kontrata për faljen, testamentin kur të dy palët janë trashëgimtarë të testamentlënësit etj.

Pala mund të refuzojë që ta dorëzojë dokumentin e caktuar nëse ekzistojnë shkaqet për të cilat dëshmitari ka të drejtë të refuzojë të jap deklaratën apo të përgjigjet në pyetjet e shtruara (nenet 342 dhe 343 të LPK-ës). Gjykata e vlerëson nëse janë plotësuar kushtet e parapara ligjore që pala të refuzojë dorëzimin apo vënien në shikim të dokumentit. Nëse gjykata konstaton se nuk janë plotësuar kushtet e tilla, do të kërkojë nga pala që ta dorëzojë dokumentin apo që të njëjtin ta vejë në shikim.

Në qoftë se pala nga e cila është kërkuar dorëzimi i dokumentit mohon faktin se dokumenti ndodhet te ajo, gjykata është e autorizuar **që të nxjerrë prova** me të cilat do të vërtetojë nëse dokumenti vërtet ndodhet te ajo palë ose jo. Në këtë rast barra e të provuarit bie në palën e cila është thirrur në dokumentin për të cilën bëhet fjalë. Nëse gjykata me nxjerrjen e provave konstaton se dokumenti nuk ndodhet te pala kundërshtare do ta abrogojë aktvendimin me të cilën e ka thirr atë si palë që ta dorëzojë dokumentin dhe njëkohësisht do të thërrasë personin te i cili ndodhet dokumenti, që ta dorëzojë dokumentin nëse ai person dihet.

Për shkak të pozitës dhe rolit që ka pala në procedurën kontestimore , ndaj saj nuk mund të ndërmerren **veprime të dhunshme** nëse ajo nuk është e gatshme që ta dorëzojë dokumentin, respektivisht që të veprojë sipas aktvendimit të gjykatës për dorëzimin e dokumentit. Mirëpo, gjykata në rastin e marrjes së vendimit lidhur me çështjen e cila është objekt i kontestit, **do të vlerësojë se çfarë rëndësie ka fakti** pse pala nuk ka qenë e gatshme që ta dorëzojë dokumentin i cili ndodhet tek ajo, respektivisht që të veprojë sipas aktvendimit të gjykatës për dorëzimin e tij. Vlerësimi i gjykatës duhet t'i merr parasysh të gjitha rrethanat e rastit, e sidomos gjendjen faktike të vërtetuar në bazë të provave .

Pala e cila pohon se dokumenti në të cilin thirret për provimin e fakteve kontestuese ndodhet te **personi i tretë**, ka të drejtë që t'i propozojë gjykatës që të kërkojë dokumentin nga ai person. Në qoftë se vlerëson se dokumenti, dorëzimi i të cilëve kërkohet nga personi i tretë, mund të shërbejë si provë për vërtetimin e faktit të caktuar, do ta urdhërojë atë person që ta dorëzojë dokumentin dhe do t' ia caktojë edhe afatin për dorëzim.

Person i tretë konsiderohen personat të cilët nuk janë palë në procedurë, si p.sh ndërhyrësi, i autorizuari i palës, përfaqësuesi ligjor, përfaqësuesi i përkohshëm, dëshmitari etj. Në parim personi i tretë mund të refuzojë dorëzimin e dokumentit i cili ndodhet te ai dhe i cili shërben si provë për vërtetimin e ndonjë fakti vendimtar. Para se të merr vendim me të cilin do ta urdhërojë personin e tretë që ta dorëzojë dokumentin, gjykata do ta thërrasë atë person dhe do të kërkojë nga ai që të deklarohe lidhur me dokumentin i cili kërkohet.

Në qoftë se personi i tretë nuk e mohon faktin se dokumenti ndodhet tek ai, por e konteston detyrimin për dorëzimin e tij, gjykata do të vendos nëse personi i tretë ka për detyrë që ta dorëzojë dokumentin. Pra, ligji udhëzon që gjykata në këto raste të veprojë *ex officio* sipas vlerësimit të saj. Kështu nëse gjykata gjen se ekzistojnë shkaqet e parapara me nenin 337 par.2 të LPK-ës, për refuzimin e dokumentit, nuk do të kërkojë nga personi i tretë që ta dorëzojë dokumentin, por nëse ekzistojnë shkaqe të tilla atëherë do ta detyrojë atë person që ta dorëzojë dokumentin i cili ndodhet tek ai.

Në qoftë se personi i tretë mohon se dokumenti gjendet tek ai, atëherë nëse gjykata dyshon në vërtetësinë e këtij pretendimi, mund të *nxjerrë prova* lidhur me këtë rrethanë. Mirëpo, meqenëse gjykata provat nuk i nxjerrë kryesisht rezulton se lidhur me vërtetimin e këtij pretendimi të personit të tretë provat nxjerrën me propozimin e palëve.

Personi i tretë ka të drejtë në ankim të veçantë kundër aktvendimit me të cilën është detyruar që ta dorëzojë dokumentin e caktuar. Mirëpo, në qoftë se aktvendimi i tillë e merr formën e prerë, i njëjti mund të përmbarohet nëpërmjet gjykatës kompetente sipas rregullave të procedurës përmbarimore. Nga kjo rezulton se në këto raste nga personi i tretë dokumenti i kërkuar mund të merret në mënyrë të dhunshme.

Nëse personi i tretë ka pasur shpenzime lidhur me dorëzimin e dokumentit në gjykatë (*p.sh shpenzimet e udhëtimit, shpenzimet e postës etj.*), ai ka të drejtë të kërkojë kompensimin e tyre. Në këtë rast në mënyrë të përshtatshme aplikohen dispozitat e nenit 355 të LPK-ës- të cilat dispozita bëjnë fjalë lidhur me shpenzimet e dëshmitarit kur i njëjti ftohet në gjykatë për t'u proceduar.

Dokumente ose provat shkresore që parashikohen si një nga llojet e mjeteve provuese janë mjete me anë të cilave nëpërmjet shenjave shprehen mendime që përmbajnë të dhëna për faktet, të cilat kanë rëndësi për zgjidhjen e një kontesti.

Në proceset gjyqësore bashkëkohor shkresat janë me rëndësi të madhe dhe kanë përdorim më të shpeshtë si mjet provues. Dokumentet ose shkresat zakonisht kanë këto cilësi: kanë një përmbajtje të kuptueshme lidhur me një fakt, rrethanë apo ngjarje, që kanë rëndësi për procesin gjyqësor; kanë shenjat e shkrimit nëpërmjet të cilave është shprehur mendimi dhe, objektin mbi të cilin janë fiksuar shenjat e shkrimit që shprehin mendimin për faktin, rrethanën apo ngjarjen. Kryesorja është përmbajtja e mendimit nga i cili gjykata mund të nxjerrë përfundimin për ekzistimin apo mosekzistimin e fakteve, rrethanave ose ngjarjeve.

3.5 Paraqitja e dokumenteve

Në qoftë së pala në padi, përgjigje në padi, në parashtresë apo verbalisht gjatë seancës gjyqësore thirret në dokument publik si mjet për provimin e fakteve, ka për detyrë që gjykatës t'ia dorëzojë atë dokument.

Dispozita e nenit 101 par. 1 të LPK-së, i jep mundësi palës që dokumentin e bashkangjitur ta paraqes në mënyrë alternative ose në origjinal, ose të përshkruar apo fotokopje. Në rast se pala e dorëzon kopjen apo përshkrimin e dokumentit, me kërkesën e palës kundërshtare, gjykata vendos me aktvendim me të cilin e fton palën që ta paraqes dokumentin në origjinal ndërsa palës kundërshtare që ta këqyr atë.

Nëse dokumenti në të cilin thirret pala është në gjuhën e huaj, ajo ka për detyrë që në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën ta dorëzojë përkthimin e tij në gjuhën zyrtare që përdoret në gjykatë ku është paraqit. Dokumenti i huaj duhet të legalizohet nga përkthyesi gjyqësor.

Nëse pala që e parqet dokumentin e huaj se përfillë këtë rregull, gjykata mund të vendos lidhur me çështjen kontestuese pa e marrë për bazë dokumentin e hartuar në gjuhën e huaj.

3.6 Ushtrime

Gjatë këtij sesiioni pjesëmarrësve do tu prezantohet nga një shembull praktik-hipotetik, i cili ndërlihet me temat e shtjelluara më lartë. Ata do të ndahen në grupe të vogla dhe nga ana e secilit grup (përfaqësuesi i grupit) do ta prezantojnë mendimin e tyre lidhur me dokumentin e prezantuar dhe ne cilin lloje të dokumenteve bënë pjesë i njëjti.

3.7 Përmbledhje

Gjatë këtij sesiioni pjesëmarrësit janë trajnuar lidhur me shkresat, llojet e shkresave dhe fuqinë provuese të tyre, llojet e dokumenteve, fuqia provuese e dokumentit të huaj dhe kushtet të cilat duhet plotësuar ai dokument që të jetë i barasvlershëm me dokumentin vendor. Përveç kësaj pjesëmarrësit kanë mësuar se në cilat raste gjykata mund të e kërkojë sigurimin e dokumenteve kryesisht dhe cilat kushte duhet plotësuar për sigurimin e një kërkesë të tillë.

4. Dëshmitarët

4.1 Hyrje

Gjatë këtij sesi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të kuptojnë rolin e procedimit të dëshmitarit që e ka me rastin e marrjes së provës në një çështje konkrete, do të kuptojnë zotësinë e personave të cilët duhet të dëshmojnë me qëllim të vërtetimit të fakteve relevante në një çështje kontestuese, do të kuptojnë detyrat për tu proceduar në këtë cilësi si dhe pasojat juridike nëse dëshmitari refuzon pa arsye dhe dallimet që ekzistojnë në mes të dëshmitarit dhe palëve që të refuzojnë për të u proceduar, sa i përket sanksionimit. Pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të kuptojnë formën, përmbajtjen e ftesës së dëshmitarit dhe faktin se procedimi i dëshmitarëve bëhet një nga një pa prezencën e dëshmitarëve tjerë. Krejt në fund pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të kuptojnë rastet kur bëhet ballafaqimi i dëshmitarëve, heqja dorë nga procedimi i dëshmitarit dhe mënyrën e kompensimit për pjesëmarrjen e tij për procedim.

4.2. Objektivat trajnues

Pas përfundimit të këtij moduli trajnues, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Fitojnë njohuri për marrjen e provës me procedimin e dëshmitarit;
- Vlerësojnë kushtet që duhet të plotësohen për procedimin e dëshmitarët;
- Thellojnë njohurit për detyrën e dëshmitarit për tu proceduar në këtë cilësi;
- Njohin se cilat persona nuk mund të procedohen si dëshmitarë,
- Njohin të drejtën e dëshmitarit për të refuzuar që të procedohet,
- Njohin të drejtën e dëshmitarit për mos dhënien e përgjigjes në pyetjet konkrete etj.

4.3 Dëshmitarët - Zotësia për të qenë dëshmitar

Një ndër mjetet provuese me të cilën palët janë të lira për të provuar pretendimet e tyre mbi ekzistencën ose jo të fakteve juridike dhe mbi të cilën ato i mbështesin kërkesat e tyre janë thëniet e dëshmitarëve, të cilët kanë dijeni mbi rrethanat e faktit ose e shprehur në terma ligjorë, thëniet e dëshmitarëve. Në kohën kur mungonin dokumentet e shkruara e për më tepër nuk ekzistonte koncepti i dokumentit zyrtar dhe as që mund të bëhej fjalë për provat shkencore, prova me dëshmitarë zinte vendin qendror në procesin e të provuarit.

Dëshmitarët janë persona të cilët i japin gjykatës informatat lidhur me faktet kontestuese në të kaluarën. Dëshmitari në deklaratën e tij të cilën e jep në këtë cilësi duhet të kufizohet vetëm në perceptimin e tij shqisor, duke mos e dhënë mendimin e tij për faktin e perceptuar.

Në sistemin tonë procedural nuk është e kufizuar çështja e nxjerrjes së provës me dëshmitarë, pra atë e lejon në të gjitha rastet, duke përfshirë edhe ato kur ligji kërkon shkresën si mjet provues për vërtetimin e vlefshmërisë së veprimit juridik.

Rëndësia e provës me dëshmitarë nuk është thjesht historike por edhe aktuale. Në zgjidhjen e një mosmarrëveshje juridiko- civile, nga pikëpamja ligjore, vlera e provës me dëshmitarë qëndron në të njëjtin raport me provat e tjera, ngase vlera provuese e saj vlerësohet nga gjykata, duke shqyrtuar në tërësi rrethanat e çështjes dhe duke e analizuar në raport me provat e tjera.

Dëshmitar mund të jetë cilido person që ka dijeni për disa fakte të cilat kanë të bëjnë me çështjen në procesin gjyqësor. Si dëshmitar mund të pyeten vetëm personat që kanë aftësi të japin informata mbi faktet që duhet të provohen.

LPK nuk ka përcaktuar taksativisht kritere formale lidhur me mundësi që një person të dëgjohej si dëshmitar, dhe mbi këtë bazë si dëshmitar mund të dëgjohej:

- Çdo person pavarësisht nga mosha (të miturit, të rriturit dhe të moshuarit),
- pavarësisht nga gjendja shpirtërore (personave që u është marrë aftësia e veprimit, personave të cilëve u është vazhduar kujdesi prindëror dhe personat e vënë nën kujdestari).
- pavarësisht nga aftësia e kufizuar që kanë (persona të verbër, shurdhmemecët etj).
- pavarësisht nga mënyra se si kanë ardhur deri të informata për faktet kontestuese (në mënyrë direkte apo indirekte, rastësisht apo është ftuar që të marrë pjesë me rastin e lidhjes së ndonjë pune juridike) dhe
- pavarësisht nga interesimi i tij për fatin e kontestit.

Në rastet kur nga pala propozohet që si dëshmitar të dëgjohej i mituri nën moshën katërbëdhjetëvjeçare, gjykata është ajo që e vlerëson në këtë rast se a është e nevojshme dëshmia e tij dhe varësisht nga kjo do të vendosë me aktvendim për lejimin apo refuzimin e dhënies së dëshmisë nga këta persona.

Kur bëhet fjalë për personat me aftësi të kufizuar në këtë rast personat e verbër, shurdhmemecët, kur dëgjohej si dëshmitarë ata mund të dëgjohej brenda mundësive të kufizuara, p.sh i verbëri mund të dëgjohej si dëshmitar për faktet që perceptohen me anë të dëgjimit, ndërsa i shurdhëri për faktet që perceptohen me anë të shikimit etj.

4.4 Detyra për të dhënë dëshmi

Është synuar që dhënia e dëshmisë të trajtohet si detyrim i përgjithshëm qytetar. Për tu realizuar kjo detyrë, neni 339 par.1, i LPK-së ka paraparë që çdo person i cili ftohet nga gjykata si dëshmitarë ka për detyrë që t'i përgjigjet thirrjes, e në qoftë se me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe, ka për detyrë edhe të dëshmoj.

Detyrën e dhënies së dëshmisë e kanë jo vetëm shtetasit e një shteti ku zhvillohet gjykimi por edhe të huajt që ndodhen në atë shtet. Personat që gëzojnë të drejtën e eksterritorialitetit (imuniteti diplomatik) dhe ata që ndodhen jashtë shteti, mund të dëgjohej si dëshmitar sipas rregullave për dhënien e ndihmës ndërkombëtare.

Marrjen e provës me dëgjimin e dëshmitarit, gjykata e cakton me **aktvendim** për marrjen e gjitha provave ose me aktvendim të veçantë, ndaj të cilit aktvendim nuk lejohet ankimi i posaçëm. Ky aktvendim zakonisht merret në seancën përgatitore, sepse si rregull vetëm deri në këtë fazë të procedurës palët mund të propozojnë prova (neni 406 i LPK-së). Në situata të caktuara vendimi për dëgjimin e dëshmitarit mund të merret edhe në seancën për shqyrtimin kryesor, mirëpo në raste të tilla gjykata do të jetë e detyruar që të caktojë edhe një seancë për shqyrtimin kryesor në të cilën do të dëgjohej dëshmitari. Aktvendimi për caktimin e dëgjimit të dëshmitarit duhet të përmbajë edhe urdhëresën për dërgimin e thirrjes personit i cili do të dëgjohej, kurse urdhëresa duhet t'i përmbajë të dhënat personale për dëshmitarin, si dhe adresën e tij (neni 346 i LPK-së).

Ndaj dëshmitarit i cili nuk i përgjigjet thirrjes së gjykatës, ose pa ndonjë shkak të arsyeshëm refuzon të dëshmojë, gjykata do t'i ndërmerr masat ndëshkuese në pajtim me nenin 292 par.1 dhe

2 të LPK-së, pra mund të urdhërojë sjelljen e tij me urdhërim dhe pagimin e shpenzimeve të sjelljes me detyrim si dhe ta dënojë me gjobë deri në 500.00 €. Në raste të caktuara kur dëshmitari refuzon të dëshmojë apo të përgjigjet në pyetjet konkrete edhe pas vërejtjeve të gjykatës lidhur me pasojat, atëherë të njëjtin mund ta burgosë, por jo me tepër se 30 ditë.

Dëshmitar mund të jetë çdo person pavarësisht nga mosha (*të miturit, të rriturit dhe të moshuarit*), pavarësisht nga gjendja shpirtërore (*personat të cilëve u është marre aftësia e veprimit, personave të cilëve u është vazhduar kujdesi prindëror dhe personat e vënë nën kujdestari*), pavarësisht nga aftësitë e kufizuara që i kanë (*personat e verbër, shurdhmemecet etj.*), pavarësisht nga mënyra se si ka ardhur deri të informacioni për faktet kontestuese (*në mënyre direkte apo indirekte, rastësisht apo është ftuar që të marrë pjesë me rastin e lidhjes së ndonjë pune juridike*), dhe pavarësisht nga interesimi i tij për fatin e kontestit.

Nuk mund të dëgjohej si dëshmitar personi i cili për shkak të gjendjes së rëndë psikike, fizike apo shpirtërore, në të cilat ka qenë në kohën kur ka ndodhur ngjarja apo rasti për të cilën duhet të dëshmojë nuk ka pasur mundësi që ta vërejë ndodhjen e ngjarjes, apo që të mbajë mend atë dhe i cili nuk është në gjendje që gjykatës t'i japë informacione për atë ngjarje në momentin kur duhet të dëshmojë.

Dëshmitar mund të jetë edhe personi i cili më parë ka qenë i dënuar **për dëshmi të rreme**, mirëpo deklaratën e tij gjykata do ta vlerësojë në pajtim me dispozitat e nenit 8 të LPK-së. Dëshmitar mund të jetë edhe **bashkë ndërgjyqësi formal** nëse në kontest nuk e ka rolin e palës. Dëshmitar mund të jetë edhe **i autorizuari i palës**, mirëpo ai ka të drejtë që në rastet e parapara me nenet 342 dhe 343 të refuzojë dhënien e dëshmisë për përgjigje në pyetje .

Edhe **gjyqtari** mund të dëgjohej në cilësinë e dëshmitarit, mirëpo ai nuk mundet në të njëjtën çështje ta kryej detyrën e gjyqtarit (neni 67 par.1 nënpar.a) i LPK-së . **Përfaqësuesi ligjor i palës** nuk mund të dëgjohej në cilësinë e dëshmitarit. Mirëpo në raste të caktuara mund të dëgjohej në cilësinë e palës (neni 375 par.1 i LPK-së).

Në qoftë se pala propozon që të procedohet si dëshmitar personi i mitur nën moshën 14 vjeçare, gjykata do të vlerësojë nëse dëshmia e personit të tillë është e domosdoshme për vendosjen e çështjes dhe varësisht nga bindja e krijuar do të vendosë nëse do ta lejojë dhënien e dëshmisë nga personi i tillë. Në rast se ndonjëra nga palët konteston faktin për procedimin e një dëshmitari të caktuar, atëherë gjykata lidhur me këtë çështje do të vendosë me aktvendim.

Neni 340 i LPK-së në mënyre shprehimore parasheh se : “ **Pala e cila propozon që personi i caktuar të pyetet si dëshmitar duhet më parë të tregojë se për çfarë duhet të dëshmojë ai, si dhe ta tregoi emrin, mbiemrin dhe vendbanimin e tij**”. Pra, pala mundet në padi, në përgjigje në padi, në parashtrësë ose me deklaram në procesverbal, të propozoi marrjen e provave me dëgjimin e personit të caktuar në cilësinë e dëshmitarit, duke theksuar faktet për të cilat duhet të procedohet, p.sh. për mënyrën e ndodhjes së aksidentit, për kohëzgjatjen e shfrytëzimit të servitutit etj. Kjo do t'i mundësojë gjykatës që të vlerësojë nëse faktet për vërtetimin e të cilave propozohet procedimi i dëshmitarit **janë me rëndësi** për vendosjen e çështjes kontestuese, nëse ato **janë fakte kontestuese** midis palëve ose jo dhe nëse kemi të bëjmë me “ **fakte notore** ”. Gjithashtu pala në propozim duhet t'i jep edhe të dhënat personale për dëshmitarin e propozuar, emrin, mbiemrin dhe vendbanimin, në mënyrë që, nëse gjykata e pranon propozimin e palës, personit të propozuar si dëshmitar të mund t'i dërgohet thirrja për seancë dhe që të sigurohet prezenca e tij.

Pala e cila propozon marrjen e provës me dëgjimin e dëshmitarit ka për detyrë që të deponojë mjetet në shumën e caktuar për shpenzimet eventuale të dëshmitarit, siç parasheh neni 451 par.1

i LPK-së. Pra gjykata më aktvendim e detyron palën që e ka propozuar procedimin e dëshmitarit të paguaj shumën e nevojshme të monedhave për procedimin e të njëjtit.

Detyra e dhënies së dëshmisë nënkupton edhe detyrën për ta thënë të vërtetën. Kur e kërkon gjykata këtë, dëshmitari është i obliguar që të betohet lidhur me deklaratën e tij dhe se për dhënien e dëshmisë së rremë përgjigjet penalisht.

4.5 Cilët persona nuk mund të procedohen si dëshmitar?

Ka raste në praktikë ku për shkak të disa shkaqe që kanë të bëjnë me dëshmitarin dhe në disa raste kur kërkon interesi i përgjithshëm shoqërorë, përkatësisht ruajtja e sekretit ushtarak dhe atij zyrtar nuk mund të procedohet si dëshmitar një person, e që mund të jetë :

- personi i cili me thëniet e tij do ta cenonte detyrën e ruajtjes së sekretit zyrtar apo ushtarak, derisa organi kompetent të mos e lirojë nga kjo detyrë.
- Personi që për shkak të metave fizike ose psikike është absolutisht i paaftë për të qenë dëshmitar, sepse nuk është në gjendje që të perceptojë dhe të kuptoj drejtë faktet që kanë të bëjnë me çështjen dhe të bëjë dëshmi të rregullt.
- personat relativisht të paaftë siç janë: të verbrit, por vetëm për fakte që perceptohen me anë të shikimit, të shurdhëritë, por vetëm për faktet që perceptohen me anë të dëgjimit.

Gjykata sipas detyrës zyrtare kujdeset nëse faktet lidhur me të cilat dëshmitari është ftuar të dëshmojë përbejnë sekret ushtarak apo zyrtar dhe nëse konstaton se kemi të bëjmë me fakte të tilla nuk do ta procedojë dëshmitarin edhe nëse ai dëshiron të dëshmojë.

Detyrimi për ruajtjen e sekretit ushtarak dhe të sekretit zyrtar ekziston edhe pas përfundimit të shërbimit në të cilin dëshmitari ka mësuar për sekretin, pra edhe pas pensionimit. Gjykata është e detyruar që dëshmitarit t'ia tërheq vërejtjen se lidhur me disa fakte nuk mund të procedohet, mirëpo në qoftë se dëshmitari është ftuar që njëkohësisht të procedohet edhe për fakte tjera të cilat nuk përbejnë sekret zyrtar apo ushtarak, gjykata do ta procedojë dëshmitarin vetëm lidhur me ato fakte.

4.6 E drejta e dëshmitarit për të refuzuar të dëshmojë

Personat e ftuar për të dëshmuar në kontest, e të cilët gjatë kryerjes së funksionit të vetë, thirrjes ose veprimtarisë kanë marrë dijeni për disa fakte ose të dhëna, kanë të drejtë që të refuzojnë të dëshmojnë.

Arsyet për të cilat personi mund të refuzoj të dëshmojë janë të parapara në nenin 342 të LPK-së si në vijim :

- mbi atë që pala ndërgjyqëse i ka besuar si përfaqësuesit të vetë me prokurë (i autorizuari mund ta refuzoj dhënien e dëshmisë si për faktet që i ka mësuar gjatë procesit gjyqësor dhe për ato që i ka besuar pala, pa marrë parasysh në cilën kohë dhe cilin gjykim);
- mbi atë që pala ose personi tjetër ia ka treguar dëshmitarit si rrëfyesit të vetë (rrëfyesi fetar mund të refuzoj dhënien e dëshmisë për atë që pala i ka besuar me rastin e rrëfimit të bërë para tij. Për dallim nga kjo, predikuesi fetar nuk mund të refuzoj dhënien e dëshmisë për fakte të tjera për të cilat ka mësuar në përgjithësi si predikues fetar);
- mbi faktet që i ka marrë në dijeni dëshmitari si avokat, si mjek ose në ushtrimin e ndonjë profesioni apo veprimtarie tjetër, po që se ekziston detyrimi që të ruhet si sekret ajo që merr në dijeni gjatë ushtrimit të profesionit apo të veprimtarisë së vet;

Kur gjykata i ka të njohura shkaqet për refuzim ajo do t'ia tërheq vërejtjen dëshmitarit se mund të refuzoj dhënien e dëshmisë në çdo rast. Në përgjithësi kjo e drejte është e lidhur me nevojën e mbrojtjes së individit dhe të ruajtjes së sekreteve të cilat janë pjesë e raporteve të posaçme midis njerëzve, pa të cilat është e pamundur ushtrimi i disa veprimtarive. Zbulimi i fakteve dhe i të dhënave të tilla konsiderohet shkelje e detyrimit të ruajtjes së sekretit profesional, ndërkohë që ajo në disa raste përfaqëson edhe vepër penale.

Gjykata në çdo rast me çmuarje të lirë i vlerëson shkaqet e theksuara për refuzimin e dhënies së dëshmisë, lidhur me të cilin rast merr aktvendim ndaj të cilit nuk është i lejuar ankim i veçantë (neni 345 par.2 LPK-së). Gjykata do t'ia tërheqë vërejtjen dëshmitarit se mund të refuzojë dhënien e dëshmisë në çdo rast kur i ka të njohura shkaqet për refuzim. Mirëpo, në qoftë së gjykata nuk ka vepruar në këtë mënyrë, kurse dëshmitari e ka dhënë deklaratën e tij, nuk ekziston shkelje esenciale e dispozitave të procedurës, andaj si rrjedhë dëshmia e tillë mund të shërbejë për vërtetimin e fakteve vendimtare.

4.7 E drejta e dëshmitarit për mos dhënien e përgjigjes në pyetjen konkrete

Dëshmitari mund të mos jap përgjigje në pyetjen konkrete në qoftë së për një gjë të tillë ekzistojnë shkaqe të arsyeshme dhe të rëndësishme (neni 343 i LPK-së).

Rrethanat të cilat i parasheh ligji për refuzimin e dhënies së përgjigjes në pyetjen konkrete:

- në qoftë se me përgjigjen në këto pyetje, do t'ia ekspozonte vetës përgjegjësin penale apo të afërmve të tij të gjinisë së gjakut në vijë vertikale deri në cilëndo shkallë, e në vijë horizontale deri në shkallën të tretë përfundimisht, bashkëshortin e vet, ose të afërmit e gjinisë së krushqisë deri në shkallë të dytë përfundimisht, edhe po që se ka pushuar martesë, personin me të cilin jeton në bashkësi jashtëmartesore, apo kujdestarin e vet, ose personin nën kujdestarinë e tij, adoptuesin apo të adoptuarin e vet.

Nuk kërkohet nga gjykata që të kujdeset sipas detyrës zyrtare për ekzistimin e këtyre rrethanave për shkak të cilave dëshmitari mund të refuzoj përgjigjen në pyetje të caktuara, por është e obliguar që të ja tërheq vërejtjen dëshmitarit se e ka këtë të drejtë (neni 343.2, i LPK-së).

Gjykata këtë vërejtje do ta bëjë në fillim pasi t'i marrë të dhënat personale nga dëshmitari, kur edhe mëson për afrinë e tij me palët, ose drejtpërdrejtë pasi t'i parashtrahet pyetja konkrete. Nëse përkundër kësaj vërejtje dëshmitari vendos që të përgjigjet, atëherë kjo e drejtë nuk mund t'i mohohet.

Në rast se dëshmitari i refuzon që të përgjigjet në pyetjen e caktuar, gjykata do ta vlerëson se kundërshtimi i dëshmitarit a është i bazuar dhe në rast se vlerësohet që është i bazuar, nuk kërkon nga dëshmitari që të përgjigjet në pyetjet e caktuara, në qoftë se e konstaton të kundërtën, do të kërkojë nga dëshmitari që t'u përgjigjet pyetjeve të shtruar.

Se cilat do të jenë arsyet e rëndësishme për të cilat dëshmitari do të mund të refuzonte të përgjigjet në pyetjet e caktuara, në çdo rast konkret e vlerëson gjykata, duke pasur parasysh natyrën e kontestit, botëkuptimet morale të mjedisit shoqëror, normat e etikës profesionale, si dhe të gjitha rrethanat e rastit. Gjithashtu, me rastin e vlerësimit gjykata duhet të këtë parasysh edhe faktin se afërsia gjinore dhe disa obligime morale që ekzistojnë midis rrethit të caktuar të njerëzve kanë ndikim të drejtpërdrejtë në kufizimin e gatishmërisë për dhënien e përgjigjes në pyetjet e caktuara. Rast konkret mund të **jetë rreziku për ekspozim ndaj turp-it të madh** të vet dëshmitarit, të afërmve të tij, ose të personave të rrethit të caktuar si dhe me rrezikun e **pësim-it**

të demit të pakompensueshëm material të këtyre personave, me përjashtim të rasteve të parapara me nenin 344 të LPK- së.

Lidhur me **arsyeshmërinë e shkaqeve** për refuzimin e përgjigjes në pyetje, gjykata vendos me aktvendim, në qoftë së gjykata konstaton se refuzimi i dëshmitarit për t'iu përgjigjur pyetjeve është i bazuar, nuk do të kërkoj që dëshmitari t'iu përgjigjet pyetjeve të këtilla, mirëpo në qoftë se konstaton të kundërtën, do të kërkojë nga dëshmitari që t'iu përgjigjet pyetjeve të parashtruara. Në qoftë se dëshmitari refuzon përsëri t'iu përgjigjet pyetjeve të caktuara, gjykata ndaj tij do të ndërmarrë masa ndëshkuese në pajtim me nenin 292 të LPK-së.

Kundër aktvendimit të gjykatës lidhur me arsyeshmërinë e refuzimit të dëshmitarit për t'iu përgjigjur pyetjeve të caktuara, palët nuk kanë të drejtë për ankim të veçantë, kurse kundër aktvendimit me të cilin ndaj dëshmitarit është shqiptuar masa ndëshkuese për shkak të mos dhënies së dëshmisë në gjykatë, dëshmitari ka të drejtë për ankim të veçantë.

Kur nuk mund të refuzoj dëshmitari të jep dëshminë e tij?

Kategoria e caktuar e dëshmitarëve nuk mund ta refuzojnë dhënien e përgjigjeve në pyetjet konkrete me arsyetim se mund t'i shkaktohet ndonjë dëm pasuror (neni 344 i LPK-së).

Të tillë janë:

- Personat që thirren të dëshmojnë lidhur me veprimet juridike të themeluara në praninë e tyre si dëshmitar të thirrur, p.sh dëshmitarët që kanë qenë prezentë në rastin e lidhjes së kontratës së shitblerje; të përpilimit të testamentit etj.
- Personat që thirren të dëshmojnë lidhur me veprimet, të cilat në pikëpamje të raportit kontestuese i kanë kryer si paraardhës juridik apo si përfaqësues të njërës nga palët ndërgjyqëse.
- Personat që thirren të dëshmojnë për faktet, të cilat kanë të bëjnë me raportet pasurore të kushtëzuara në lidhje familjare apo martesore si dhe për faktet që kanë të bëjnë me lindjen, vdekjen apo me lidhjen e martesës, dhe
- Gjkata në çdo rast do të vlerësojë nëse ekzistojnë arsyet e justifikueshme që dëshmitari të refuzojë dhënien e dëshmisë (*psh.lidhur me gjendjen pasurore të bashkëshortit, lidhur me pasurinë e veçantë, pasurinë e përbashkët, për raportet tjera të cilat mund të jenë me rëndësi për caktimin e lartësisë në rastin e alimentacionit etj*) ose përgjigjen në pyetje të caktuara (*punëtorët e organeve të rendit, të punësuarit në inspekcione të caktuara, punonjësit në organizata shëndetësore etj*) dhe që të vërtetohet arsyeshmëria e këtyre shkaqeve mund të jetë e nevojshme dëgjimi i asaj pale.

Kundër aktvendimit me të cilin gjykata vendosë lidhur me arsyeshmërinë e shkaqeve për refuzimin e dëshmitarit për dhënien e dëshmisë apo për refuzimin e përgjigjes në pyetje të caktuara, palët nuk kanë të drejtë ankimi të veçantë. Këtë aktvendim palët mund ta sulmojnë me anë të ankesës kundër vendimit me të cilin është vendosur lidhur me çështjen kryesore.

4.8 Thirrja e dëshmitarit

Me dispozitën e nenit 346 të LPK-së, është paraparë mënyra e thirrjes së dëshmitarëve, përmbajtja e thirrjes si dhe mënyra e dëgjimit të dëshmitarëve, të cilët për shkak të moshës , shëndetit etj, nuk mund të paraqiten në gjykatë.

Si rregull thirrja e dëshmitarit bëhet në formë të shkruar.

Pala e cila e ka propozuar që në një çështje të bëhet nxjerrja e provës me dëshmitarë, në propozim ka për detyrë që t'i theksoj faktet për të cilat duhet të dëshmoj dëshmitari. P.sh., për mënyrën e ndodhjes së aksidenti, për kohëzgjatjen e shfrytëzimit të paluajtshmërisë së caktuar, për raportin e shitblerjes, etj.

Thirrja e dëshmitarit duhet të përmbajë të dhënat si në vijim:

- emri dhe mbiemri, i dëshmitarit,
- profesioni i dëshmitarit,
- vendi dhe koha e ardhjes,
- lënda lidhur me të cilën thirret, dhe
- theksimi se thirret në cilësinë e dëshmitarit.

Në letërthirrje duhet që dëshmitari të paralajmërohet për pasojat e mosardhjes në gjykatë pa arsye.

Në letërthirrje dëshmitari duhet të njoftohet edhe për të drejtën që t'i paguhen shpenzimet e parapara në nenin 355 të LPK-së.

Në propozim duhet të paraqiten edhe të dhënat personale të dëshmitarit si emri, mbiemri dhe vendbanimi i tij, në mënyrë që gjykata nëse e pranon propozimin e palës të ketë mundësi që dëshmitarit t'i dërgohet thirrja për seancë dhe të sigurohet prezenca e tij.

Thirrja e dëshmitarit me moshë nën katërbëdhjetë vjeç bëhet nëpërmjet prindërve ose kujdestarit të tij ligjor. Kjo bëhet me qëllim që prindit apo kujdestarit t'i mundësohet që të miturit të i'a shpjegojë arsyen dhe rëndësinë e thirrjes, detyrimin dhe përgjegjësinë që ka ai si dëshmitarë i ftuar, mënyrën se si duhet të sillet në gjykatë etj, por jo edhe përmbajtjen e dëshmisë.

Dëshmitarët të cilët për shkak të moshës së shtyrë ose të metave fizike nuk mund të vijnë në gjykatë, kanë për detyrë që për gjendjen e tyre ta njoftojnë gjykatën. Këta persona mund të dëgjohen në banesën e tyre, në spital, në qendra të rehabilitimit dhe në ambiente të tjera, ku eventualisht janë duke qëndruar.

4.9 Pyetja e dëshmitarit

Me dispozitën e nenit 347 të LPK-së parashihet procedura dhe mënyra e marrjes së provës me procedimin e dëshmitarëve. Dëshmitarët procedohen veç e veç, pa prezencën e dëshmitarëve të cilët do të procedohen më vonë. Kjo nënkupton se kur ka më shumë dëshmitarë të ftuar për tu proceduar në këtë cilësi, dëshmitari i parë procedohet pa prezencën e dëshmitarëve tjerë dhe secili dëshmitarë i radhës dëgjohet pa prezencën e dëshmitarëve që do të procedohen pas tij. Kjo mënyrë e procedimit është bërë me qëllim që të pamundësojë arritjen e ndonjë marrëveshje për mënyrën se si do të deklarohen për ndonjë fakt dhe pamundësisë së ndikimit të njëri tjetrit

përmes deklaratave të tyre. Kjo njëkohësisht do të sigurojë që deklaratat e dëshmitarëve të jetë sa më e besueshme.

Ky veprim procedural zakonisht kryhet në seancë gjyqësore, por kur dëshmitari për shkak të sëmundjes ose për ndonjë arsye tjetër nuk mund të paraqitet në gjykatë, gjykata mund të vendosë që pyetja e tij të bëhet në banesën e dëshmitarit apo në lokale tjera, (si për shembull në spital, qendra të rehabilitimit etj).

Dëshmitari ka për detyrë që përgjigjet t'i jap gojarisht. Përfundim nga ky rregull bëhet vetëm kur dëshmitari është memec ose nuk mund të flasë për shkaqe tjera. Kjo do të thotë se dëshmitari deklaratën, përkatësisht përgjigjen në pyetje të caktuara nuk mund ta jap në formë të shkruar, apo duke e lexuar tekstin e përgatitur më parë, sepse dhënia e deklaratës apo përgjigjes për pyetje në mënyrë të tillë, do të ndikonte drejtpërsëdrejti në besueshmërinë e deklaratës, përkatësisht të përgjigjes.

Para se të merret dëshmia nga dëshmitari, gjyqtari i çështjes ia **tërheq vërejtjen** dëshmitarit se ka për detyrë që të thotë të vërtetën dhe se asgjë nuk guxon ta lejë në heshtje, pastaj do të paralajmërohet për pasojat e dhënies së dëshmisë së rreme, duke ia bërë me dije se dhënia e dëshmisë së rreme përbën vepër penale për të cilën dëshmitari, sipas dispozitave ligjore në fuqi do të përgjigjet penalisht.

Në vazhdim dëshmitarit i bëhen të ashtuquajturat **pyetje të përgjithshme**. Dëshmitarit fillimisht gjykata do t'ia marrë të dhënat për identitetin e tij, për emrin, mbiemrin, emrin e babait, vendlindjen, moshën dhe raportin e tij me palët ndërgjyqëse. Në përgjigjet e dëshmitarit në pyetjet e përgjithshme, gjykata në të shumtën e rasteve do të mund të konstatojë nëse kemi të bëjmë me personin që është i aftë për të dëshmuar, nëse ekzistojnë pengesa ligjore për të cilat dëshmitari nuk mund të procedohet lidhur me faktet që duhet të vërtetohen, nëse dëshmitari ka të drejtë që të mos jap deklaratë apo të mos u përgjigjet pyetjeve të caktuara. Kjo njëkohësisht i mundëson gjykatës, që nëse ekzistojnë situata të tilla, ta paralajmëroj dëshmitarin me kohë se i ka këto të drejta.

2.8 Mënyra e marrjes në pyetje të dëshmitarit

Dispozita ligjore e nenit 348 të LPK-së, e ka lënë në diskrecion të palëve mënyrën e marrjes në pyetje të dëshmitarit, përkatësisht mënyrën e shtruarjes së pyetjeve konkrete. Kjo është e logjikshme duke pas parasysh faktin se palët në kontestin konkret kanë interesa të caktuara, të cilat kryesisht janë kontraverse në mes tyre. Pra, është e drejtë e secilës palë që edhe përmes dëshmitarit t'i provojnë ato fakte të cilat i konsiderojnë të nevojshme për realizimin e pretendimeve të tyre, që kanë të bëjnë me çështjen konkrete kontestimore.

Dispozita e nenit të para cituar, sjellë risi sa i përket **mënyrës së procedimit të dëshmitarit**. Pra, fillimisht dëshmitarit i bëjnë pyetje palët ndërgjyqëse dhe atë së pari pala e cila e ka propozuar thirrjen e tij, e pastaj pala kundërshtarë. Nëse është e nevojshme dëshmitarit mund t'i shtrojë pyetje sërish pala e cila e ka propozuar atë, dhe pastaj prapë pala kundërshtarë.

Duhet të kihet parasysh se nëse pala ka të autorizuar, ndërsa ai është i pranishëm në seancë për shqyrtim kryesor, atëherë ajo mund t'i bëjë pyetje dëshmitarit vetëm përmes të autorizuarit të saj (neni 85.2 LPK-së).

Është e mundur dhe në praktikë shpesh ndodhë që gjykata dhe palët dëshmitarit t'i bëjnë pyetje plotësuese për të sqaruar ose plotësuar përgjigjen që e ka dhënë ai.

Gjykata në çdo moment mund t'i bëjë pyetje dëshmitarit.

Dëshmitari duhet të pyetet çdo herë se si i ka marrë në dijeni gjërat për të cilat dëshmon (*psh. me vrotim të drejtpërdrejt, nga deklaratat e personave të cilët e kanë parë ngjarjen apo kanë qenë pjesëmarrës në to, nga informatat e marra nga shtypi, mediat etj*). Kjo është me rëndësi sepse sa më i largët të jetë burimi i marrjes në dijeni të fakteve nga dëshmitari, për të cilat dëshmon para gjykatës, edhe vërtetësia e asaj dëshmie do të jetë më pak e besueshme .

Gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit gjyqtari ka të drejtë t'i ndaloj palës që t'i bëjë pyetje të cilat s'kanë lidhje me çështjen, që mund të ndikojnë në dëshmitarin për të mos e thënë të vërteten, që mund ta ngatërrojnë etj.

4.9 Kur bëhet ballafaqimi i dëshmitarëve

Ballafaqimi i dëshmitarëve nuk është i detyrueshëm por vjen në shprehje në rastet kur në mes të deklarimeve të dëshmitarëve ka mospërputhje që krijon vështirësi për vërtetimin e fakteve që janë me rëndësi për zgjidhjen e çështjes.

Gjyqtari që e udhëheqë procesin është ai që e vlerëson se a është i nevojshëm dhe sa është i dobishëm ballafaqimi i dëshmitarëve në një rast. Ballafaqimi i dëshmitarëve bëhet kryesisht nga gjykata apo më kërkesën e palëve dhe për këtë merret **aktvendim** kundër të cilit nuk lejohet ankesë e veçantë (neni 435 par. 2 i LPK-së) dhe parimin e kërkimit të së vërtetës .

Gjyqtari i çështjes apo kryetari i trupit gjykues do t'i bëjë kryesisht ato pyetje, të cilat kanë të bëjnë me vërtetimin e fakteve që lidhen me zbatimin e nenit 3 të LPK-së si dhe me vërtetimin e fakteve të cilat kanë të bëjnë me ruajtjen, kujdesin e fëmijëve të mitur dhe të fakteve të tjera, për vërtetimin e të cilave gjykata kujdeset kryesisht.

Në ballafaqim të dëshmitarëve dëgjohen sërish dëshmitarët të cilët janë dëgjuar më parë. Ballafaqimin e dëshmitarëve e udhëheq gjyqtari i çështjes, i cili për çdo përgjigje të dhënë për ndonjë fakt, dëshmitarit do t'ia lexoj përgjigjen apo deklaratën që e ka dhënë kur është dëgjuar në këtë cilësi, dhe do ta pyes se cila nga përgjigjet është e saktë.

Me ballafaqimin e dëshmitarëve gjykata shpesh herë arrin të marr informata të rëndësishme lidhur me faktet që provohen, të cilat dëshmitarët nuk i kanë theksuar me rastin e marrjes në pyetje. Zakonisht ballafaqimi bëhet lidhur me secilën rrethanë për të cilën dëshmitarët kanë dhënë deklaratat dhe përgjigje të ndryshme dhe përgjigjet e tyre shënohen në procesverbal. Nganjëherë dëshmitari që nuk e ka thënë të vërtetën, nga frika e përgjegjësisë penale dhe nga situata e krijuar gjatë ballafaqimit (*tensionet dhe acarimet midis dëshmitarëve*), mund ta ndryshojë deklaratën e dhënë më parë, ta plotësojë atë ose ta pranojë në tërësi ose pjesërisht pavërtetësinë e deklaratës së dhënë.

Gjatë ballafaqimit gjykata ka mundësi t'i vërejë sjelljet e të dy dëshmitarëve dhe në këtë mënyrë të krijojë **bindjen** për vlefshmërinë provuese dhe besueshmërinë e deklaratave të dhëna në të dyja rastet para dhe gjatë ballafaqimit.

Dispozita ligjore e nenit 350 të LPK-së, në mënyrë shprehimore parasheh faktin se dëshmitari pas procedimit, mund të largohet nga gjykata vetëm me lejen e gjyqtarit të çështjes. Në qoftë se gjykata vlerëson se për sqarimin e ndonjë fakti apo rrethane, e cila është kontestuese mes palëve, ka nevojë që dëshmitari të merret sërish në pyetje, atëherë ajo do ta urdhërojë dëshmitarin që të qëndrojë në sallën e gjykimit dhe do t'ia tërheqë vërejtjen se gjatë qëndrimit në gjykatë, nuk

guxon të kontaktojë me dëshmitarët tjerë (të bisedojë me dëshmitarët e pranishëm, të komunikojë me telefon me dëshmitarët tjerë etj).

Dëshmitarin të cilit edhe pse i është tërheqë vërejtja largohet nga gjykata pa lejen e gjyqtarit të çështjes dhe nëse ai kontakton me dëshmitarët tjerë, para se ata të merren në pyetje gjykata mund ta **dënojë me gjobë** (sipas nenit 292 të LPK-së).

4.10 Revokimi i vendimit për procedimin e dëshmitarit

Pala e cila e ka propozuar dëgjimin e dëshmitarit mund të kërkoj nga gjykata që ai të mos pyetet fare. Kërkesa për mos dëgjimin e dëshmitarit do të merret parasysht në rast se pala tjetër është dakord dhe nëse gjykata e vlerëson se pyetja e tij nuk do të jetë e nevojshme për sqarimin e rrethanave.

Në qoftë se pala kundërshtarë e refuzon propozimin e palës, e cila ka kërkuar procedimin e dëshmitarit të caktuar që i njëjti të mos pyetet, gjykata do të vendosë që dëshmitari të pyetet. Gjukata gjithashtu do të vendosë që dëshmitari i thirrur të merret në pyetje edhe nëse pala kundërshtarë është pajtuar me kërkesën e palës tjetër për mos procedimin e tij, nëse vlerëson se me pyetjen e dëshmitarit do të mund të sqaroheshin fakte me rëndësi për vendosjen e çështjes.

Kundër aktvendimin për pranimin apo refuzimin e kërkesës lidhur me marrjen në pyetje të dëshmitarit të thirrur nuk është e lejuar ankesa e veçantë (neni 435 par.2 i LPK-së).

4.11 Heqja dorë nga procedimi i dëshmitarit

Në qoftë se gjatë gjykimit të çështjet me provat e marra dhe me dëshmitarët e dëgjuar konstatohet së janë sqaruar fakte dhe pretendimet e palëve, gjykata kryesisht apo më kërkesën e palëve mund të marrë vendim për mos pyetjen e dëshmitarëve tjerë.

Në praktikën gjyqësore duhet të bëhet dallimi në mes situatave kur pala e cila e ka propozuar dëshmitarin kërkon që ai të mos dëgjohej dhe situatave kur nga dëgjimi i disa dëshmitarëve bëhet e panevojshme dëgjimi i dëshmitarëve tjerë për shkak të sqarimit të rrethanave.

Meqenëse barra e të provuarit bie mbi palët, si rregull gjykata vendimin për mos marrjen në pyetje të dëshmitarëve tjerë do ta jap me propozimin e palëve. Mirëpo, gjykata një vendim të tillë mund ta jap edhe kryesisht, pra edhe në rastet kur palët nuk kanë dhënë një propozim të tillë, në qoftë se konstaton se faktet për sqarimin apo vërtetimin e të cilave është propozuar procedimi i dëshmitarëve, në tërësi janë sqaruar me prova të tjera dhe me deklaratat e dëshmitarëve të dëgjuar.

Me dispozitat e nenit 354 të LPK-së, është paraparë mënyra e marrjes në pyetje të dëshmitarit i cili nuk e njih gjuhën në të cilën zhvillohet procedura, të dëshmitarit i cili është i shurdhër si dhe dëshmitarit shurdhmemec. Dëshmitari që **nuk e di gjuhën** në të cilën zhvillohet procedura, lidhur me faktet apo rrethanat për të cilat është ftuar që të procedohet, do të pyetet me anë të përkthyesit. Gjukata ka për detyrë që dëshmitarit t'ia bëjë me dije se ka të drejtë që me rastin e dhënies së deklaratave apo të përgjigjeve në pyetje, **ta përdorë gjuhën e vet amtare**.

Mënyra e dëgjimit të dëshmitarit, i cili është i **shurdhër ose memec**, varet nga aftësitë e tij për të komunikuar me të tjerët. Nëse dëshmitari është i shurdhër, pyetjet i shtrohen në mënyrë të shkruar, kurse nëse dëshmitari është memec, përgjigjet në pyetje do t'i jap në formë të shkruar. Si rrjedhojë, në qoftë se dëshmitari është shurdhmemec, atëherë edhe pyetjet do t'i shtrohen në

formë të shkruar, e po ashtu edhe përgjigjet do t'i jap në formë të shkruar. Në qoftë se dëshmitari i shurdhër ose dëshmitari memec **nuk di shkrim e lexim**, atëherë gjykata dëshmitarin e tillë do ta dëgjojë dhe nga ai **do të marr përgjigjet me anë të interpretit**, i cili mund të merret vesh me dëshmitarin.

Gjykata do tua tërheqë vërejtjet përthyesit dhe interpretit se kanë për detyrë që të i transmetojnë drejtë dhe në mënyrë të besueshme pyetjet që u bëhen dëshmitarit i cili nuk e di gjuhën në të cilën zhvillohet procedura. Në qoftë se përkthyesi apo interpreti shkelin këtë detyrim, ndaj tyre mund të ndërmerren masat të cilat masa mund të ndërmerren kundër ekspertit sipas dispozitave të nenit 293 dhe 360 të LPK-së.

Përkthyesi dhe interpreti duhet të nënshkruajnë procesverbalin e shqyrtimit në të cilin kanë marrë pjesë në këtë cilësi.

4.12 Kompensimi i shpenzimeve dëshmitarit

Dëshmitari ka të drejtë në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, ushqimit, fjetjes dhe fitimit të humbur. Për këto shpenzime nuk ka udhëzime konkrete për shumat e kategoritë, por gjykata, varësisht nga rasti konkret, do ta vlerësoj se cilat do ishin shpenzimet e arsyeshme për ushqim, për udhëtim, për fjetje dhe fitimit të humbur, *(për mëditjet e humbura nga marrëdhënia e punës, për humbjet e shkaktuara nga moskryerja e punëve në dyqan, në bujqësi etj.*

Dëshmitari do të kompensohet edhe në rastet kur i është përgjigjur thirrjes së gjykatës por nuk është dëgjuar/dëshmoj pa fajin e tij, (për shembull: për shkak të shtyrjes së seancës, kërkesës që mos të dëgjohet nga pala e cila e ka propozuar, nëse gjykata e pranon një kërkesë të tillë dhe në rastet e heqjes dorë nga dëgjimi i dëshmitarit).

Dëshmitarit nuk do t'i paguhet shpenzimet nëse është vonuar për seancë dhe ka ndikuar në shtyrjen e seancës si dhe në rastet kur është paraqitur në gjykatë, por ka refuzuar të dëshmoj pa ndonjë arsye të justifikueshme.

Dëshmitari kompensimin e shpenzimeve mund ta kërkojë më së largu deri në përfundimin e procedimit në këtë cilësi, në të kundërtën ai e humb të drejtën që ta kërkojë kompensimin, përveç në rastet kur gjykata nuk e ka njoftuar për këtë të drejtë dhe për pasojat nëse nuk do të bëjë kërkesë me kohë.

Gjykata me aktvendimin me të cilin e cakton nxjerrjen e provës me procedimin e dëshmitarit, e detyron palën që ka propozuar procedimin e tij, që të **depozitohet** në gjykatë një shumë të hollash si **paradhënie** për kompensimin e shpenzimeve. Me këtë aktvendim do t'i caktohet edhe shuma që do t'i paguhet nga paradhënia e depozituar. Pala ka të drejtë ankese kundër aktvendimit për caktimin e shpenzimeve, mirëpo ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e aktvendimit. Shpenzimet e paguara për pjesëmarrjen e dëshmitarit në gjykatë, hyjnë në shpenzimet e detyrueshme të procedurës, prandaj ato përfundimisht bien në barrë të palës e cila e ka humbur kontestin, nëse pala kundërshtare i ka depozituar ato paraprakisht.

4.13 Ushtrime

Gjatë këtij moduli pjesëmarrësve do tu prezantohet nga një shembull praktik-hipotetik, që ka të bëjë me procedimin e dëshmitarit, mënyra se si dëshmitarit i parashtrihen pyetjet relevante lidhur me një rast konkret dhe renditjen e palëve se cila prej tyre ka të drejtë të i parashtrijë

pyetjet e para, si dhe në cilat raste gjyqtari mund të i parashtrojë pyetje dëshmitarit dhe sipas cilës renditje. Eventualisht grupet do të jenë të ndara varësisht nga numri i pjesëmarrësve.

4.14 Përmbledhje

Në këtë sesion pjesëmarrësit janë trajnuar lidhur me procedimin e njërës nga provat relevante për vendosjen meritore në një çështje kontestuese- procedimin e dëshmitarit, janë shpjeguar rastet të cilat lypset për tu plotësuar në mënyrë që një dëshmitar të ketë zotësi për tu proceduar, detyra për të dhënë dëshmi, sanksionet lidhur me mos dhënien e dëshmisë pa arsye dhe mos paraqitjen e dëshmitarit në seancë, përkundër thirrjes në mënyrë të rregullt. Më tutje janë trajtuar edhe faktet që kanë të bëjnë me personat të cilat nuk mund të procedohen si dëshmitarë, arsyet e dëshmitarit për të refuzuar procedimin e tij, e drejta dëshmitarit për të mos dhënë përgjigje në pyetjet konkrete, mënyra se si gjykata duhet të i bëjë ftesën dëshmitarit për procedim dhe paralajmërimi për pasojën e mos ardhjes në gjykatë pa arsye. Gjithashtu janë bërë përpjekje që pjesëmarrësve të iu afrohen njohuri më praktike për të vepruar me shkathtësi rreth marrjes në pyetje të dëshmitarit lidhur me faktet relevante të një çështje konkrete, në cilat raste duhet të bëhet ballafaqimi i dëshmitareve, në cilat raste bëhet heqja dorë nga procedimi i dëshmitarit, dhe në cilat raste bëhet kompensimi i shpenzimeve të dëshmitarit.

5. Ekspertët

5.1 Hyrje

Gjatë këtij sesi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të kuptojnë rolin e procedimit të ekspertëve nga fushat përkatëse, në të cilat fusha gjykata nuk ka njohuri të mjaftueshme profesionale. Do të kuptojnë faktin se ekspertizat në parim caktohen me propozimin e palëve ndërgjyqëse, ndërsa në raste të veçanta edhe kryesisht. Do të kuptojnë se si duhet t'iu jepet detyra secilit ekspert varësisht nga profili përkatës i tij duke u bazuar në natyrën juridike të çështjes konkrete. Do të kuptojnë detyrimet e ekspertit për të kryer ekspertizën dhe sanksionet eventuale në rast të dështimit në kryerjen e ekspertizës, do të kuptojnë rastet kur një ekspert të fushës së caktuar, do të i mundësohet lirimi për kryerjen e ekspertizës. Do të kuptojnë të vlerësojnë ekspertizën e kryer profesionale nga një ekspert i fushës së caktuar e cila provë është e barabartë me provat tjera të zbatuara në një çështje konkrete. Krejt në fund pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të kuptojnë se si bëhet procedimi i palëve si mjet provues dhe dallimi që ekziston në mos dhënien e deklaratës nga ana e palës, me mos kryerjen e ekspertizës nga ana e ekspertit.

5.2. Objektivat trajnues

Pas përfundimit të këtij moduli trajnues, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Thellojnë njohurit për marrjen e provës me procedimin e ekspertit dhe me marrjen e provës me procedimin e palëve etj.

5.3 Ekspertët - Caktimi i ekspertëve exofficio

Ekspertimi është **veprim procedural** i cili ndërmerret për **vërtetimin apo sqarimin** e fakteve për të cilat gjykata nuk ka dije të nevojshme profesionale.

Gjykata gjatë shqyrtimit dhe zgjidhjes së kontesteve civile ndeshet shpeshherë me probleme të ndryshme për zgjidhjen e të cilave kërkohen njohuri të posaçme, apo përvojë e caktuar në fushën e shkencës, teknikës, letërsisë, artit etj.

Ekspert janë personat që kanë njohuri të veçanta në fusha të ndryshme të shkencës, teknikës, prodhimit, artit e kulturës dhe që thirren nga gjykata për të dhënë mendime e vlerësime të përpikta për sende, veprimtari dhe për zgjidhjen e një çështjeje të ndërlikuar. Ekspertët japin mendimin e tyre të kualifikuar si për fakte të mëparshme, ashtu edhe për fakte që ekzistojnë aktualisht.

Sipas nenit 356 të LPK-së, gjykata ekspertimin e cakton **me propozimin e palëve ndërgjyqëse**, që është në pajtim me parimin e disponibilitetit të palëve dhe me parimin i cili ka të bëjë me barrën e të provuarit (nenit 7 i LPK-së). Kjo do të thotë që gjykata nuk është e autorizuar të caktojë ekspertimin sipas detyrës zyrtare, përveç kur zbatohet neni 3 parag.3 i LPK-së. Në qoftë se palët nuk e propozojnë ekspertizën për vërtetimin e fakteve të cilat nuk mund të vërtetohen me mjete të tjera provuese, gjykata do të konsideroj se faktet e tilla nuk ekzistojnë.

Për të vërtetuar faktet se në cilat raste kërkohet ndihma profesionale, gjykata do ta vlerësojë në varësi të rrethanave të rastit konkret. Psh. **gjeodeti** do të jetë i nevojshëm kur kemi të bëjmë me kontestet e vërtetimit të drejtës së pronësisë në paluajtshmëri (për të bërë identifikimin e paluajtshmërisë kontestuese dhe eventualisht matjet detale të saj, në çështjet jo kontestimore të rregullimit të mezhdave apo edhe të ndarjes fizike të paluajtshmërisë (kur pjesa ideale e

paluajtshmërisë të bashkëpronarëve duhet të ndahet në pjesë reale të paluajtshmërisë të secilit veç e veç; **mjeku** i profilit përkatës do të jetë i domosdoshëm për vërtetimin e fakteve që kanë të bëjnë me intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhembjeve fizike, për përjetimin e frikës, për saktësinë e shkallës së humbjes së aftësisë së përgjithshme për jetë, për konstatimin e shkallës së shëmtimit, për nevojën dhe ndihmën e personit të tretë, për nevojën për ushqim të përforcuar, për shkallën dhe kohëzgjatjen e pa aftësisë për punë, kurse **inxhinier** të ndërtimtarisë, elektroteknikës si dhe të arkitekturës do të jenë të nevojshme gjithnjë kur kemi të bëjmë me kontestin me të cilin çështjet kontestuese duhet të zgjidhen sipas rregullave të këtyre shkencave etj.

Gjykata ex officio mund të caktoj nxjerrjen e provës me ekspertizë për vërtetimin e ndonjë fakti i cili është kontestues midis palëve dhe është relevant për vendosjen e çështjes e cila është objekt i kontestit. Një mundësi e tillë i është dhënë gjykatës me Ligjin nr.04/L-118, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-006, për Procedurën Kontestimore, me të cilin është ndryshuar dispozita e nenit 356 të LPK-së. Ky ndryshim është në kundërtënie të plotë me frymën e Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe në tërësi në kundërshtim me parimin e shqyrtimit dhe hetimit, sepse bënë përjashtim vetëm për të provuarit me anë të ekspertizës.

Kjo mundësi e gjykatës vjen në shprehje sidomos **në çështjet familjare** ku janë të përfshirë të miturit, sepse gjykata është e detyruar që në çdo rast kur janë të përfshirë në procedura gjyqësore fëmijët ta zhvilloj dhe udhëheq procedurën duke u mbështetur në parimin e interesit më të mirë për të miturin.

Nga praktika gjyqësore

“Ekspertiza psikiatrike është udhërrëfyes vendimtar me rastin e vërtetimit të aftësisë mendore, përkatësisht të aftësisë vepruese të ndonjë personi, por nuk është e vetmja provë të cilën duhet të ketë parasysh gjykata”.

“Në qoftë se pala propozon marrjen e provës me ekspertim, por nuk i thekson faktet që do të tregonin se me çka ka të bëjë kërkesa kontestuese, prova e tillë nuk mund të caktohet.”

5.3.1 Caktimi i ekspertëve me propozimin e palëve

Gjykata me propozimin e palëve mund të caktoj nxjerrjen e provës me ekspertizë për vërtetimin e ndonjë fakti i cili është kontestues midis palëve dhe është i rëndësishëm për vendosjen e çështjes e cila është objekt i kontestit.

Me paragrafin 1 të nenit 357 të LPK-së është parapa si detyrë e palës që ka propozuar ekspertizën në propozim të tregoj objektin dhe vëllimin e ekspertizës dhe ta propozoj personin që do ta bëjë ekspertizën. Në propozim për caktimin e ekspertizës duhet të theksohen saktë se cilat fakte duhet të vërtetohen me ekspertizë, dhe cilat fakte ekzistuese (dokumente dhe objekte të tjera) duhet t'i analizojë eksperti për të dhënë mendimin dhe konstatimin e duhur profesional. Psh. nëse pala propozon që me ekspertizë gjeodezike të sqarohen faktet që kanë të bëjnë me fitimin e së drejtës së pronësisë mbi paluajtshmërinë përkatëse me parashkrim fitues, ajo në propozim duhet të theksojë se cilat nga faktet janë me rëndësi për provimin e fitimit të së drejtës mbi këtë bazë, që duhet të vërtetohen me ekspertizë (psh. *faktet që kanë të bëjnë me të dhënat gjeodezike të ngastrës, me numrin e ngastrës, me vendndodhjen, me kulturën, me sipërfaqen, me ndryshimet që kanë ndodhur ndërkohë në atë ngastrë, me posedimin e ngastrës etj.*)

Vendimin për caktimin e ekspertizës dhe ekspertit gjykata do ta marrë pasi që të deklarohet pala kundërshtare, përkatësisht pasi t'i është dhënë mundësia që të deklarohet dhe atë për objektin, vëllimin dhe ekspertin e propozuar.

Gjykata është e lidhur me propozimin e palëve për caktimin e ekspertit të caktuar, nëse ata janë pajtuar që mendimin, përkatësisht ekspertizën ta bëjë ai person. Nëse pala e kundërt pajtohet edhe në pikëpamje të objektit dhe vëllimit të ekspertizës, gjykata do të duhej ta miratoj propozimin dhe ta caktoj ekspertizën e propozuar.

Gjykata zakonisht e cakton një ekspert por në raste të ndërlikuara mund të caktojë me tepër ekspert.

Të rastet e ekspertimeve me të ndërlikuara, ekspertimi mund t'i besohet edhe ndonjë institucioni profesional (p.sh. spitali, laboratorët, fakultete etj.), ndërsa nëse ekzistojnë institucione të posaçme për llojin e caktuar të ekspertimit (psh. : për ekspertimin e dorëshkrimit, shenjave të gishtërinjve, të hollave të falsifikuara etj.) atëherë ekspertimi i tillë u besohet në rënd të parë këtyre institucioneve.

5.4 Detyrimet e ekspertit dhe sanksionet kundër tij

Personi i cili është caktuar ekspert në një çështje ka për detyrë t'i përgjigjet thirrjes së gjykatës dhe të jep mendimin e tij profesional (neni 359 par.1 LPK-së). Thirrjes së gjykatës duhet t'i përgjigjet edhe eksperti që mendon se nuk ka dijeni apo mjete për ta kryer ekspertizën, por edhe ai që mendon se për ndonjë shkak tjetër nuk ka për detyrë të ekspertoj.

Eksperti i cili pa ndonjë arsye të justifikueshme nuk i përgjigjet thirrjes së gjykatës apo refuzon ta kryej ekspertizën, do të dënohet me dënim me gjobë deri në 1,000.00 € (neni 293 i LPK-së), mirëpo, për dallim nga dëshmitari, eksperti nuk mund të sjellët me dhunë në gjykatë dhe atij nuk mund t'i shqiptohet dënim me burg.

Detyrimi i ekspertit nënkupton edhe detyrimin që mendimin dhe konstatimin profesional ta jap me ndërgjegje dhe në pajtim me rregullat e shkencës në fushën në të cilën është caktuar eksperti. Në të kundërtën dhënia e mendimit të rremë nga eksperti përfaqëson vepër penale, për të cilën është paraparë dënimi me gjobë ose më burg deri në 1 vit.

5.5 Lirimi i ekspertit nga detyra e ekspertimit

Gjykata do ta liroj ekspertin më kërkesën e tij, nga detyra e dhënies së mendimit të tij profesional, për të njëjtat shkaqe për të cilat dëshmitari mund të refuzoj dhënien e dëshmisë si dhe për shkaqet për të cilat dëshmitari mund të refuzoj që të përgjigjet në pyetjet konkrete.

Gjykata mund ta largoj ekspertin nga detyrimi i ekspertimit edhe atëherë kur eksperti jep shkaqe të arsyeshme për përjashtim, (mund të jenë: sëmundja, ngarkesa në vendin e tij të punës, largimi për një periudhë nga vendi apo vendbanimi i përhershëm, kur pohon se nuk posedon aftësi profesionale të profilit të ngushtë, të cilat janë të nevojshme për dhënien e mendimit dhe konstatimit profesional etj.)

Në qoftë se gjykata konstaton se ekzistojnë shkaqet **për përjashtimin e ekspertit** nga detyrimi i ekspertimit, gjykata do të **caktojë ekspert tjetër**. Duke pasur parasysh faktin se ekspertin e propozojnë palët, gjykata do të kërkojë nga palët që të propozojnë ekspert tjetër, mirëpo, në qoftë se palët nuk arrijnë të pajtohen për personin që do ta kryejë detyrën e ekspertit tjetër, gjykata do

ta caktojë vetë ekspertin nga lista e ekspertëve të përhershëm, të gjykatës ose nga radhët e ekspertëve jashtë listës. Gjithashtu, gjykata mund të caktojë ekspertin edhe pa pëlqimin e palëve, në qoftë se këtë e kërkojnë shkaqet e ekonomizmit të procedurës (*psh. kur për shkak të deklarimit të palës lidhur me ekspertin do të vijë deri të zvarritja e procedurës gjyqësore për një kohë relativisht të gjatë*).

5.6 Përjashtimi i ekspertit nga detyra e ekspertimit

Përjashtimi i një personi nga pjesëmarrja në gjykim si ekspert mund të kërkohej për të njëjtat shkaqe për të cilat kërkohej edhe përjashtimi i gjyqtarit nga gjykimi konkret. Mirëpo përderisa gjyqtari nuk mund ta ushtroj detyrën e gjyqtarit nëse është dëgjuar si dëshmitar, si ekspert mund të caktohet edhe personi i cili me parë është proceduar si dëshmitar në të njëjtin kontest. Nga kjo rezulton se, detyrimi për dhënien e dëshmisë dhe detyrimi për ekspertim nuk përjashtojnë njëri tjetrin. Kjo do të thotë se personi i cili ka qenë i pranishëm në vendin e ngjarjes kur ka ndodhur aksidenti i trafikut, mund të procedohet në cilësi të dëshmitarit për rrethana se si ka ndodhur aksidenti dhe i njëjti person, nëse posedon njohuri të nevojshme profesionale, mund të angazhohet edhe si ekspert në të njëjtën çështje, gjë që nuk vlen edhe për gjyqtarin.

Barazimi i shkaqeve për përjashtimin e gjyqtarit me shkaqet për përjashtimin e ekspertit është shprehje e synimit të ligjdhënësit që të sigurohet paanshmëri e plotë e ekspertit si një nga kushtet themelore për ekspertim të drejtë. Kjo gjithashtu do të ndikojë në eliminimin e çfarëdo dyshimi për sa i përket qëllimit për zgjidhje ligjore të raportit kontestues dhe njëkohësisht do të jetë me ndikim edhe në krijimin e besimit në paanshmërinë e gjykatave.

Kur palët kanë kundërshtime, nuk mund të marrë pjesë si ekspert në zgjidhjen e çështjes personi që është palë, bashkëshort, gjini ose krushqi e afërt me njërin nga palët, ai që ka interes në zgjidhjen e çështjes, ose është bashkëshort, gjini ose krushqi e afërt me një person që ka interes në zgjidhjen e çështjes etj.

Kërkesën për përjashtimin e ekspertit mund ta bëjë secila nga palët ndërgjyqëse. Pala e cila e bën kërkesën për përjashtimin e ekspertit duhet ta arsyetoj kërkesën, duhet ta theksoj së paku një shkak nga neni 67 i LPK-së dhe shkakun e përjashtimit duhet ta bëjë të besueshëm.

Kërkesën për përjashtimin e ekspertit pala duhet ta bëjë kur të marrë dijeni për shkakun e përjashtimit, por më së voni para fillimit të marrjes së provës me ekspertizë. Ligji ka parapa mundësin që palët të kërkojnë përjashtimin e ekspertit edhe pasi që ai ta ketë kryer ekspertimin por me kusht që shkakun e përjashtimit të ekspertit ta ketë kuptuar pasi që është punuar ekspertiza. Si rregull në këto raste kërkesa për përjashtimin e ekspertit bëhet së bashku me kundërshtimin e ekspertizës, përkatësisht të mendimit dhe konstatimit të ekspertit. Gjukata në raste të tilla, pavarësisht nga fakti se e ka dorëzuar ekspertizën, nëse vlerëson se ekzistojnë shkaqet për përjashtimin e tij, do të vendosë ta përjashtojë dhe njëkohësisht do të caktojë ekspert tjetër për kryerjen e ekspertimit.

Lidhur me kërkesën e *përjashtimit* të ekspertit vendos gjyqtari i çështjes. Në qoftë se është e nevojshme të vërtetohen pretendimet e palëve, të theksuara në kërkesën për përjashtimin e ekspertit, gjykata do t'i i verifikojë në të njëjtën mënyrë siç vepron kryetari i gjykatës lidhur me kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit (neni 70 i LPK-së) Kundër aktvendimit me të cilën aprovohet apo refuzohet kërkesa për përjashtimin e ekspertit nuk lejohet ankesë e veçantë.

5.7 Ekspertimi

Marrjen e provës me anë të ekspertizës gjykata e cakton me aktvendim në të cilin duhet të përcaktojë:

- emrin, mbiemrin dhe profesionin e ekspertit,
- objektin e kontestit,
- vëllimin dhe lëndën e ekspertimit
- afatin për paraqitjen me shkrim të konstatimit dhe mendimit.

Eksperti duhet të thirret në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes dhe një kopje të aktvendimit nga neni 361 i LPK-së, gjykata ia dërgon ekspertit bashkë me letërthirrjen për seancë kryesore, duke i kujtuar ekspertit se mendimin e tij duhet ta paraqes me nderë, në pajtim me rregullat e shkencës dhe profesionit, si dhe pasojat që i shkaktohen nga mosparaqitja e konstatimit dhe mendimit brenda afatit të caktuar, përkatësisht mosardhja pa arsye në seancë gjyqësore. Në letërthirrje eksperti njoftohet me të drejtën për shpërblimin që i takon për punën e kryer, si dhe shpenzimet e bëra lidhur me ekspertizën.

Përveç formës së paraparë të marrjes së ekspertizës që është procedimi i ekspertit apo të ekspertëve në seancë gjyqësore, sipas nenit 364 paragrafi 1 i LPK-së, i ndryshuar me nenin 23 të Ligjit (nr. 04/L-118) për ndryshimin dhe plotësimin e LPK-së, është parapa mundësia që marrja e provës me ekspertizë të bëhet edhe në formën e shkruar, të cilën ekspertizë gjykata iu dërgon palëve më së voni 7 ditë para mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me qëllim që të njëjtëve t’iu mundësohet paraqitja për deklaram në ekspertizën e kryer, me qëllim që nëse ato eventualisht kanë vërejtje, të njëjtat t’i adresojnë në mënyrë të qartë.

Nga praktika gjyqësore:

“Pala e cila e kundërshton konstatimin e ekspertit, duhet të paraqes vërejtjet konkrete dhe nuk është e mjaftueshme që të kundërshtojë vetëm në mënyrë të përgjithësuar. Theksimi i palës, se konstatimi i ekspertit është jo profesional dhe i pa mjaftueshëm, sepse me këtë nuk tregohet dhe nuk theksohet se, për çka konsiderohet se konstatimi është jo profesional. Deklarimi mbi konstatimin e ekspertit duhet të jetë shprehimisht i adresuar dhe në mënyrë të saktë duhet të theksohet se në çka përmbahet jo profesionalizmi i konstatimit”.

Mendimi i dhënë nga eksperti mund të ndodhë që nuk është i plotë (nuk përmban të gjitha të dhënat lidhur me ndonjë fakt konkret, p.sh., eksperti i gjeodezisë nuk ka paraqitur të dhëna për historiatin e ngastrës kontestuese ose është i paqartë, (nuk përmban sqarime të nevojshme për mënyrën dhe metodat në bazë të cilave eksperti e ka ndërtuar mendimin). Në këto raste gjykata sipas detyrës zyrtare ose me kërkesën e njëres palë, do ta thërras ekspertin për të dhënë sqarime plotësuese, përkatësisht që ta plotësoj apo përmirësoj konstatimin dhe mendimin e dhënë.

Për nevojën e sqarimeve plotësuese nga eksperti gjykata nxjerr aktvendim të veçantë, në të cilin duhen të paraqiten saktë udhëzimet se në cilin drejtim dhe kuptim duhet të jepen sqarime dhe plotësime në ekspertizë, si dhe duhet të ceket afati brenda të cilit eksperti duhet ta jep sqarimin plotësues.

Nëse lidhur me faktin e njëjtë kontestues ekspertët kanë dhënë mendime të ndryshme, gjykata mund t’i thërras këta ekspert që të japin sqarime lidhur me konstatimin e dhënë, si dhe të deklarohen në lidhje me konstatimin dhe mendimin e njëri tjetrit.

Nëse eksperti as pas thirrjes së gjykatës nuk e paraqet mendimin e plotë dhe të qartë, gjykata, pas deklarimit të palëve, cakton ekspertin tjetër për ekspertim.

Ka raste që janë më të ndërlikuara dhe për këtë paraqitet nevoja që të caktohen më shumë ekspert me të njëjtë detyrë. Ekspertet mund ta paraqesin mendimin dhe konstatimin e përbashkët, po që se nuk ka dallim midis tyre. Në praktikë kryesisht ndodhë që ekspertet konstatimin dhe mendimin ta paraqesin të përbashkët.

Në rastet kur ekspertët kanë dallime në konstatimet dhe mendimet e tyre, atëherë secili prej tyre e paraqet konstatimin dhe mendimin e veçantë. Në këtë rast gjykata është ajo që mendimet dhe konstatimet e ekspertëve si edhe provat e tjera do i vlerësoj sipas bindjes së lirë dhe pas kësaj përcaktohet se cilin mendim apo konstatim do ta merr më të besueshëm.

5.8 Vlerësimi i provës – ekspertizës

Mendimi i ekspertit apo ekspertiza nuk është e detyrueshme për gjykatën. Në rastet kur gjykata nuk e merr për bazë mendimin e ekspertëve, përkatësisht ka mendim të kundërt ose të ndryshëm nga ai që japin ekspertët, ajo ka për detyrë që ta arsyetoj hollësisht dhe qartë këtë kundërshtim ose ndryshim mendimi në vendimin përfundimtar. Pra, mendimi i ekspertëve nuk mbivlerësohet në krahasim me llojet e tjera të provave.

Edhe mendimi i ekspertëve, pra, si provat tjera, e ashtu siç është parapa në nenin 8 të LPK-së, do të çmohet nga gjykata sipas rregullave të përgjithshme të parapara për vlerësimin e provave, pra në bazë të bindjes së lirë, të mbështetur në ndërgjegjen juridike dhe të formuar nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tërësinë e tyre.

Kjo tregon se gjyqtarët janë të pavarur nga qëndrimi i ekspertëve, mirëpo shkalla e pavarësisë varet nga ajo se sa janë të përgatitur ata që t'ia nënshtrojnë kritikës mendimit dhe konstatimit të ekspertit.

5.9 Palët si mjet provues

Palët si mjet provues janë burim kryesor dhe i sigurt i dijenisë lidhur me faktet relevante të çështjes juridike. Dëgjimi i palëve i mundëson gjykatës që të shërbehet më dijen e palëve për vërtetimin e fakteve të rëndësishme në të njëjtën mënyrë ashtu siç shfrytëzohet dija e personave të tjerë të cilët dëgjohen si dëshmitar.

Kuptohet se palët gjatë procesit gjyqësor mund të japin shpjegime të shumta dhe të gjitha këto nuk do të thotë se kanë vlerën e provës. Këtë vlerë e kanë vetëm ato shpjegime që kanë lidhje me rrethanat e çështjes në proces dhe çmuarja e tyre bëhet nga gjykata sipas rregullave të përgjithshme për çmuarjen e provave.

Me dispozita e LPK-së, dëgjimi i palëve si mjet provues është barazuar me mjete tjera provuese, prandaj mund të përdoret në funksion të provuarit në çdo kohë dhe për vërtetimin e cilit do fakt.

5.10 Marrja e provës me procedimin e palëve

Marrja e kësaj prove caktohet me propozimin e njëres nga palët apo më propozimin e të dy palëve. *Letërthirja* për tu proceduar në seancë palës duhet t'i dorëzohet personalisht, mirëpo nëse pala është e pranishme në seancën kur është caktuar nxjerrja e kësaj prove, gjykata do t'i

tërheq vërejtjen palës që të paraqitet në seancën e radhës për tu pyetur në këtë cilësi dhe këtë vërejtje do ta shënoj në procesverbal.

Nëse pala në kontest përfaqësohet nga përfaqësuesi ligjor, thirrja për tu dëgjuar në këtë cilësi i dërgohet nëpërmjet përfaqësuesit ligjor. P.sh., personit të mitur thirrja për t'u pyetur në cilësi të palës i dërgohet përmes prindërit të tij, personit që i është marrë aftësia e veprimit, thirrja i dërgohet përmes kujdestarit të tij etj.

Me paragrafin 2 të nenit 376 të LPK-së është parapa si detyrë për gjykatën që kur cakton nxjerrjen e kësaj prove, palëve duhet t'ua bëjë me dije se në seancën e radhës do të merret prova me dëgjimin e palëve, duhet që t'ua tërheq vërejtjen se në rast të mos prezencës të ndonjërës nga palët, do të pyetet vetëm pala prezente.

Si rregull gjykata do t'i dëgjoj të dyja palët, mirëpo në raste të caktuara gjykata mund të vendos që ta dëgjoj vetëm një palë, nga këto arsye:

- në qoftë se njëra palë refuzon të procedohet në këtë cilësi, dhe
- nëse njëra palë nuk i përgjigjet thirrjes së gjykatës.

Detyrimi i gjykatës që të caktojë procedimin e të dyjave palëve nuk mund të ketë ndonjë pasojë as për palët, sepse *për dallim nga dëshmitari*, pala nuk është e detyruar që t'i përgjigjet thirrjes së gjykatës dhe as që të japë deklaratën. Gjithashtu, pala mund të refuzojë dhënien e deklaratës pa dhënë arsye për refuzim, për arsye se ndaj palës e cila nuk i përgjigjet thirrjes së gjykatës për t'u proceduar në këtë cilësi, ose nëse refuzon që të japë deklaratën apo që të përgjigjet në pyetjet e parashtruara nuk mund të ndërmerren kurrë farë sanksionesh, (neni 377 i LPK-së). I vetmi ndëshkim i cili mund t'i bëhet palës dhe që nuk i përgjigjet thirrjes së gjykatës për tu proceduar në këtë cilësi, është procedimi vetëm i palës kundërshtare.

Gjithashtu në rastin e procedimit të palëve nuk vlejné rregullat për procedimin një nga një dhe pa prezencën e palës tjetër, sepse palët mund të prezantojnë gjatë tërë rrjedhës së procedurës, duke përfshirë edhe kohën e procedimit të palës kundërshtare.

Pala nuk ka të drejtë për shpenzime të procedurës sipas rregullave të cilat zbatohen për dëshmitarët, por vetëm në kuadër të kushteve të kompensimit të shpenzimeve të procedurës.

Në rastin kur pala e cila është person fizik dhe nuk e ka zotësinë procedurale, në cilësi të palës do të procedohet përfaqësuesi i saj ligjor (prindi për fëmijët e mitur, dhe për fëmijët ndaj të cilëve është vazhduar e drejta prindërore, kujdestari për personat e ven nën kujdestari etj). Mirëpo, në qoftë se pala e tillë ka aftësi që të perceptoj dhe reproduktoj fakte, relevante, gjykata mund të vendos që ta procedoj atë në vend të përfaqësuesit ligjor apo krahas tij (neni 375.2 LPK-së).

Kur është në pyetje personi juridik si palë në procedurë, në vend të tij procedohet personi i cili me ligj apo me aktin e përgjithshëm të personit juridik është caktuar për përfaqësim.

Nga praktika gjyqësore

“Është bërë shkelja esenciale e dispozitave të LPK-së kur gjykata lidhur me faktin kontestues ka vendosur të marrë provën me procedimin e palëve, e nuk i ka proceduar të dy palët, por vetëm një palë edhe pse nuk kanë ekzistuar rrethanat të cilat do ta arsyetonin procedimin e vetëm një palë”

“Kur pala e ka të autorizuarin në shqyrtim, duhet të thirret vetëm i autorizuari, kurse pala duhet të thirret personalisht vetëm kur është caktuar procedimi i saj me qëllim të të provuarit”

“ Gjykata nuk është e autorizuar që të vendosë që të procedohet vetëm njëra palë, kur pala tjetër nuk i është përgjigjur thirrjes për shkak se ka qenë e penguar”

“ Gjykata kur vendosë që të merret prova me procedimin e palëve, mund ta procedojë njëën nga to, vetëm nëse pala tjetër e refuzon dhënien e deklaratës apo nuk i përgjigjet thirrjes së gjykatës. Megjithatë nëse gjykata edhe përkundër asaj se njëra nga palët për shkaqe të arsyeshme ka kërkuar shtyrjen e seancës në të cilën është dashur të procedohet, e procedon vetëm palën tjetër, palës që mungon me veprim të kundërligjshëm ia pamundëson shqyrtimin në gjykatë”

“ Gjykata nxjerr prova para gjyqtarit të lutur vetëm për shkaqe të rëndësishme, kurse provën me procedimin e palëve, vetëm nëse pala për shkak të pengesave të paevitueshme nuk mundet personalisht të paraqitet në gjykatë, apo nëse ardhja e saj do të shkaktonte shpenzime jo proporcionale”.

5.11 Ushtrime

Gjatë këtij sesioni pjesëmarrësit do të marrin një aktvendim me të cilin një eksperti të profilit përkatës do të i caktohet detyra për kryerjen e ekspertizës dhe dhënien e mendimit të tij në një çështje konkrete kur kërkohet sigurimi i një prove të caktuar.

5.12 Përmbledhje

Në këtë modul pjesëmarrësit janë trajnuar lidhur me procedimin e provave relevante për vendosjen meritore në një çështje konkrete-procedimin e ekspertit dhe të palëve në procedurë, janë shpjeguar rastet kur ekspertët caktohen kryesisht nga gjykata dhe kur me propozimin e palëve, rastet kur bëhet përjashtimi e ekspertit nga detyra e ekspertimit, dallimin e sanksionimit në mes të refuzimit të kryerjes së ekspertizës të ekspertit dhe refuzimit të palës për tu proceduar në këtë cilësi etj

VII. E drejta familjare

Valon Totaj
Gjyqtar në Gjykatën Themelore – Prizren

Tabela e përmbajtjes – “E drejta familjare”

Hyrje.....	330
Objektivat trajnuese	330
Metodat e të shpjeguarit	331
Pritjet nga pjesëmarrësit	331
Burimet	331
Përmbledhje.....	332
1. E drejta familjare, kuptimi i familjes, burimet e të drejtës familjare, gjinia dhe llojet e gjinisë	333
1.1 Hyrje	333
1.2 Objektivat trajnuese	333
1.3 Kuptimi i së drejtës familjare.....	333
1.4 Objekti i së drejtës familjare	334
1.5 Natyra e marrëdhënieve juridike-familjare	334
1.6 Parimet e së drejtës familjare.....	335
1.7 Burimet e së drejtës familjare	336
1.8 Ligji për familjen i Kosovës	336
1.9 Kuptimi i familjes.....	337
1.9.1 Llojet e familjes.....	337
1.9.2 Funksionet e familjes	338
1.9.3 Planifikimi i familjes	339
1.9.4 Struktura e lidhjes familjare.....	339
1.10 Gjinia	340
1.10.1 Llojet e gjinisë.....	340
1.15 Ushtrime.....	340
1.16 Përmbledhje.....	340
2. E drejta martesore, të drejtat dhe detyrat e bashkëshortëve	341
2.1 Hyrje	341
2.2 Objektivat trajnuese	341
2.3 E drejta martesore.....	341
2.3.1 Kuptimi i martesës.....	342
2.3.2 Qëllimet dhe kushtet për lidhjen e martesës	342
2.3.3 Pengesat martesore	343
2.3.4 Kushtet formale për lidhjen e martesës	344
2.4 Kuptimi, llojet e të drejtave dhe të detyrimeve të bashkëshortëve	344
2.4.1 Të drejtat dhe detyrat personale për të cilat bashkëshortët nuk mund të bëjnë marrëveshje.....	345
2.4.2 Të drejtat dhe detyrat personale për të cilat bashkëshortët mund të bëjnë marrëveshje	346
2.5 Ushtrime	346
2.6 Përmbledhje.....	346
3. Zgjidhja e martesës, procedura e shkurorëzimit, detyrimi për ushqim dhe e drejta prindërore	347
3.1 Hyrje	347
3.2 Objektivat trajnuese	347
3.3 Mënyrat e zgjidhjes së martesës	348
3.4 Parimet kryesore të procedurës së shkurorëzimit.....	349

3.4.1	Kompetenca e gjykatës	350
3.4.2	Procedura, mënyra e vendosjes dhe mjetet juridike tek shkurorëzimi	350
3.4.3	Pasojat e shkurorëzimit dhe anulimit të martesës	352
3.5	Kuptimi dhe rëndësia e detyrimit për ushqim	352
3.5.1	Karakteristikat e detyrimit për ushqim.....	353
3.5.2	Llojet e detyrimit për ushqim	353
3.6	Kuptimi i të drejtës prindërore.....	354
3.6.1	Të drejtat dhe detyrimet e prindërve ndaj fëmijëve.....	355
3.6.2	Të drejtat dhe detyrat e fëmijëve ndaj prindërve	356
3.6.3	Ushtrimi, pezullimi, kufizimi dhe heqja e të drejtës prindërore.....	356
3.7	Ushtrime	359
3.8.	Përmbledhje.....	359
4.	Kundërshtimi dhe vërtetimi i amësisë apo i atësisë	360
4.1	Hyrje	360
4.2	Objektivat trajnuese	360
4.3	Statusi i fëmijës martesor.....	360
4.4	Kundërshtimi i amësisë	362
4.5	Kundërshtimi i atësisë	362
4.6	Fëmijët jashtëmartesor	364
4.7	Vërtetimi i amësisë në procedurë gjyqësore	364
4.8	Vërtetimi i atësisë në procedurë gjyqësore.....	365
4.9	Ushtrime	365
4.10	Përmbledhje.....	366
5.	Birësimi, marrëdhëniet pasurore në mes bashkëshortëve.....	367
5.1	Hyrje	367
5.3	Kuptimi dhe rëndësia e birësimit.....	367
5.4	Llojet e birësimit.....	367
5.5	Themelimi i birësimit.....	368
5.6	Shuarja e birësimit	369
5.7	Kuptimi i marrëdhënieve pasurore në mes të bashkëshortëve	369
5.8	Regjimi pasuror i bashkëshortëve	370
5.9	Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët	370
5.10	Ushtrime.....	371
5.11	Përmbledhje.....	371
6.	Dhuna në familje.....	372
6.1	Hyrje	372
6.2	Objektivat trajnuese	372
6.3	Përkufizimi i dhunës në familje	372
6.4	Masat mbrojtëse kundër dhunës në familje	373
6.5	Mbrojtja gjyqësore kundër dhunës në familje	373
6.6	Ushtrime	374
6.7	Përmbledhje.....	374

Hyrje

E drejta familjare është pjesë përbërëse e sistemit juridik dhe njëkohësisht disiplinë e veçantë shkencore. Ajo studion tërësinë e normave juridike që rregullojnë marrëdhëniet familjare-martesorë, marrëdhënies në mes prindërve dhe fëmijëve, birësimin, kujdestarinë etj. Familja definohet në aspektin juridik dhe sociologjik. Megjithatë duhet thënë se të drejtat i shmangen përkufizimit të familjes, sepse ajo është kategori juridike dhe shoqërore që në vazhdimësi ndryshon në kohë dhe hapësirë dhe nuk është dukuri statike.

Meqenëse mbrojtja juridike e familjes ka rëndësi të veçantë, edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës përmban dispozita të cilat i referohen të drejtës familjare dhe martesore, përmes të cilave e rendit shtetin tonë në grupin e vendeve me rregullativën juridike familjare të harmonizuar me legjislacionin ndërkombëtar. Gjithashtu Kosova ka miratuar Ligjin për Familjen Nr. 2004/32, i cili konsiderohet si një përpjekje për të krijuar një bazë të re ligjore me të cilën do të respektohen parimet bazë të standardeve ndërkombëtare për rregullimin e marrëdhënieve familjare. Përmes këtij ligji shteti dhe shoqëria në përgjithësi kanë për detyrim të respektojnë të drejtat që rrjedhin nga lëmia familjare.

Moduli “E drejta Familjare” përfshinë 3 pjesë apo prezantime, të cilat do të shtjellohen para pjesëmarrësve, kandidat për gjyqtar. Kështu ndër të tjera do të trajtohen kuptimi, objekti dhe natyra e marrëdhënieve juridike-familjare, parimet dhe burimet e së drejtës familjare, familja si institucion juridik, kuptimi i familjes, llojet e familjes, funksionet e familjes, e drejta martesore dhe atë do të flitet rreth kuptimit të martesës, qëllimet dhe kushtet për lidhjen e martesës, pengesat martesore dhe kushtet formale për lidhjen e martesës. Gjithashtu do të shtjellohen të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve, do të trajtohet zgjidhja e martesës dhe mënyrat e zgjidhjes së martesës, procedura e shkurorëzimit, detyrimi për ushqim (mbajtja financiare apo alimentacioni), e drejta prindërore, vërtetimin e atësisë dhe amësisë, regjimin pasuror të bashkëshortëve, dhunën në familje etj.

Përmes këtij moduli synohet që pjesëmarrësit të mësojnë dhe t’i thellojnë njohuritë në të drejtën familjare, më saktësisht në çështjet të cilat i kemi përmendur më lartë. Gjithashtu me fitimin e këtyre njohurive profesionale nga e drejta familjare, synohet pjesëmarrësit në cilësi të ekspertëve të rinjë, të jenë në gjendje që t’i zbatojnë rregullat ligjore të ligjeve të aplikueshme të lëmisë familjare si vendore ashtu edhe atyre ndërkombëtare, në atë mënyrë që kjo ti kontribuon ngritjes së kualitetit të punës së gjykatave dhe organeve tjera shtetërore në mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave që burojnë nga marrëdhëniet familjare.

Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij moduli pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zgjerojnë njohurit lidhur me të drejtën familjare;
- Njohin objektin, parimet, burimet dhe natyrën juridike të marrëdhënieve martesore dhe familjare;
- Thellojnë njohuri rreth nocionit të familjes, llojet, funksionet dhe strukturën e saj;
- Njohin institucionin e martesës, qëllimet, karakteristikat e martesës, pengesat martesore dhe kushtet formale për lidhjen e martesës;
- Identifikojnë të drejtat dhe detyrat personale të bashkëshortëve;
- Njohin mënyrat e zgjidhjes së martesës;
- Zbatojnë drejtë procedurën e zgjidhjes së martesës me shkurorëzim;

- Zbatojnë drejtë dispozita lidhur me detyrimin për ushqim, llojet e tij dhe rrethin e personave që kanë detyrim ligjor të ofrojnë ushqim apo mbajtje;
- Njohin të drejtën prindërore, pezullimin, kufizimin dhe heqjen e të drejtës prindërore;
- Zbatojnë drejtë procedurën për vërtetimin e atësisë apo amësisë;
- Njohin birësimin, llojet dhe procedurën për lidhjen e tij;
- Analizojnë të drejtën e kujdestarisë në përgjithësi sipas LFK-së;
- Njohin regjimin pasuror në mes bashkëshortëve dhe procedurën gjyqësore që zhvillohet për ndarjen e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve;
- Zbatojnë drejtë dispozitatat ligjore lidhur me dhunën në familje, lëshimin e urdhrave për mbrojtje, si dhe procedurën gjyqësore për lëshimin e këtyre urdhërave;
- Dallimin e procedurave ligjore, të cilat zhvillohen në Gjykatat kompetente dhe atë: në çështjet e familjes, martesës, zgjidhjes së martesës dhe pasojat e saj, mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të fëmijëve, regjimet pasurore në mes bashkëshortëve, vërtetimin e atësisë apo amësisë, mbajtjen financiare etj;
- Njohin legjislacionin vendas dhe atë ndërkombëtar, i cili është i zbatueshëm në procedurën gjyqësore të lëmisë familjare, përfshirë këtu pjesën procedurale dhe materiale, gjatë shqyrtimit të kontesteve të kësaj lëmie;
- Përpilojnë vendimet gjyqësore nga lëmia e së drejtës familjare, në bazë të vendosjes meritore të çështjes, si dhe akteve dhe vendimeve procedurale;
- Marrin vendime të drejta gjyqësore, me rastin e vendosje rreth kontesteve nga lëmia familjare

Metodat e të shpjeguarit

Gjatë këtij programi do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj praktik, në mënyrë që secili nga pjesëmarrësit të jetë aktiv gjatë gjithë kohës së trajnimit, në mënyrë që të arrihen në tërësi objektivat e këtij trajnimi.

Pritjet nga pjesëmarrësit

Nga pjesëmarrësit pritjet që të jenë aktiv gjatë gjithë trajnimit, përmes parashtrimit të pyetjeve, hartimin e punive të ndryshme etj, në mënyrë që të sqarohen të gjitha çështjet kyçe të këtij programi, si dhe t'i thellojnë njohuritë e tyre për të gjitha elementet përmbajtësore të çështjeve që do të diskutohen dhe në të njëjtën kohë të jenë në gjendje që këto njohuri ti zbatojnë me sukses gjatë punës së tyre në praktikë.

Burimet

Pjesëmarrësit e programit mund të shfrytëzojnë si burime për të mësuar përveç materialit të prezantuar nga Ligjëruesit edhe nga:

- Prof.Dr. Hamdi Podvorica, “E drejta familjare”, botim i vitit 2011,
- Aleks Luarasi, “Marrëdhëniet Familjare”, botim i vitit 2001,
- Prof.Dr. Abdulla Aliu, Prof. Dr. Haxhi Gashi, “E drejta Familjare” botim i vitit 2007,
- Ivo Puhan, E drejta Romake, Prishtinë, 1972,
- Francesco Galgano, “E drejta Private”, 1999,
- Faik Brestovci, “E drejta e procedurës civile”, 1986,

- Haxhi Gashi, Abdulla Aliu, Adem Vokshi, “Komentari i Ligjit për Familjen i Kosovës, 2012,
- Justicia, Revistë shkencore e kandidatëve për gjyqtarë/prokuror, IGJK, nr.I dhe II,
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës,
- Ligji për Familjen i Kosovës, Nr. 2004/32,
- Ligji mbi martesën dhe marrëdhëniet familjare i vitit 1984 (GZ KSAK, nr. 10/1984),
- Ligji për procedurën kontestimore, nr. 03/L-006,
- Ligji për procedurën jokontestimore nr. 03/L-007,
- Ligji për Trashëgiminë e Kosovës, nr. 2004/26,
- Ligji për ndërmjetësimin, nr. 03/L-057,
- Ligji për shërbimet sociale dhe familjare, nr. 02/L-17,
- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 02/L-17, nr. 04/L-081,
- Ligji për Gjykatat, nr. 03/L-199,
- Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje, nr. 03/L-182,
- Ligji për përkrahje materiale familjeve dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme, nr. 03/L-022,
- Ligji mbi regjistrat e gjendjes civile, nr. 13/2007,
- Ligji për gjendjen civile, nr. 04/L-003,
- Ligji për procedurën përmbartimore, 04/L-007,
- Ligji për barazi gjinore, nr. 2004/2,
- Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, 04/L-154.

Përmbledhje

Në këtë modul kemi diskutuar për qëllimin e modulit, objektivat mësimore, metodat e të shpjeguarit, pritjet nga pjesëmarrësit, si dhe për burimet nga të cilat mund të mësohet për të drejtën familjare, si pjesë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.

Gjithashtu gjatë këtij moduli janë marrë sugjerime nga pjesëmarrësit, lidhur me metodat e të shpjeguarit dhe shtjellimit të moduleve në përgjithësi.

1. E drejta familjare, kuptimi i familjes, burimet e të drejtës familjare, gjinia dhe llojet e gjinisë

1.1 Hyrje

Në këtë sesion trajnimit do të flitet rreth kuptimit të drejtës familjare, objektin e të drejtës familjare, natyrën e marrëdhënieve juridike familjare, parimeve të së drejtës familjare, burimet e së drejtës familjare, si dhe për përmbajtjen dhe strukturën e Ligjit për Familjes të Kosovës. Gjithashtu do të flitet rreth kuptimit të familjes, llojet e familjes, funksionet e familjes, planifikimin e familjes, strukturën familjare si dhe për gjininë dhe llojet e gjinisë.

1.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij sesioni trajnues, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Përshkruajnë kuptimin e të drejtës familjare;
- Njohin objektin e të drejtës familjare dhe natyrën e marrëdhënieve juridike familjare;
- Interpretajnë drejtë parimet e përgjithshme të së drejtës familjare;
- Identifikojnë burimet e së drejtës familjare;
- Thellojnë njohuritë rreth dispozitave të Ligjit për Familjen
- Avancojnë njohurit lidhur me llojet, funksionet, strukturën dhe planifikimin familjar;
- Njohin gjininë dhe llojet e saj;
- Identifikojnë dispozitat përkatëse ligjore të LFK-së, që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet e përmendura më lartë.

1.3 Kuptimi i së drejtës familjare

E drejta familjare është pjesë përbërëse e sistemit juridik dhe njëkohësisht disiplinë e veçantë shkencore. Ajo studion tërësinë e normave juridike që rregullojnë marrëdhëniet familjare-martesorë, marrëdhënies në mes prindërve dhe fëmijëve, birësimin, kujdestarinë etj. Nuk kemi ndonjë përkufizim ligjor përfundimtar të familjes. Ligji për Familjen i Kosovës, në nenin 2 e përkufizon familjen si *“bashkësi vitale e prindërve dhe fëmijëve të tyre, si dhe personave të tjerë në gjini”*, si dhe *“familja është bërthamë natyrore dhe themelore e shoqërisë dhe si e tillë gëzon të drejtën në mbrojtje”*. Ndërsa sipas Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, *“Familja është njësi themelore dhe natyrore e shoqërisë” (neni 16/3) dhe “burri dhe gruaja, në një moshë të caktuar, pa dallim nga raca, kombësia, besimi, kanë të drejtë të martohen dhe të krijojnë familje”*. Familja definohet në aspektin juridik dhe sociologjik. Megjithatë duhet thënë se të drejtat i shmangen përkufizimit të familjes, sepse ajo është kategori juridike dhe shoqërore që në vazhdimësi ndryshon në kohë dhe hapësirë dhe nuk është dukuri statike.

E drejta familjare historikisht ka qenë pjesë përbërëse e së drejtës civile, ndërsa janë të njohura dy sisteme të mëdha të së drejtës civile. E para është sistemi i pandektistëve, sipas të cilit e drejta civile ndahet në: e drejta familjare, e drejta e detyrimeve, e drejta reale dhe ajo trashëgimore. E dyta është sistemi institucional, ose siç njihet në doktrinën juridike si sistemi i Gajit, ku e drejta civile ndahet në të drejtën e sendeve (res) të personave (personae) dhe në padi (actio). Në këtë sistemizim e drejta familjare përfshihej në grupin e të drejtave të personave dhe të padive. Me kalimin e kohës kuptimi se e drejta familjare është pjesë përbërëse e të drejtës civile ka

ndryshuar. Kështu në shekullin XVIII studiuesi francez Domus e ndan të drejtën familjare nga e drejta civile. Me nxjerrjen e kodeve të mëdha në shekullin e XIX, siç janë KC austriak (1811), KC gjerman (1896), KC i Napoleonit (Francë 1804) etj, është shënuar progres i madh në zhvillimin e marrëdhënieve familjare. Kjo ka qëndruar në shtrirjen e pushtetit shtetëror në sferën e rregullimit të marrëdhënieve juridike familjare, duke lënë jashtë fuqie të drejtën kanonike që deri atëherë zbatohet në këto vende.

E drejta familjare tani bazohet në format bashkohore të familjes, të cilat dallojnë thelbësisht nga tipi patriarkal i familjes që dominonte në periudhën e feudalizmit. Tani familjet karakterizohen si nga numri i vogël i anëtarëve të familjes, ashtu edhe nga numri i pakët i martesave brenda familjes. Për këto arsye sot në doktrinën juridike quhen me emra të ndryshëm si familje atomike, biologjike apo edhe familje qytetare.

1.4 Objekti i së drejtës familjare

E drejta familjare si degë e veçantë e së drejtës pozitive dhe si pjesë e shkencës juridike, përfshinë tërësinë e normave juridike që rregullojnë marrëdhëniet të cilat lindin nga familja. Andaj objekt i së drejtës familjare janë familja, martesa dhe marrëdhëniet që lindin nga to. Po ashtu objekt i së drejtës familjare janë edhe institucionet dhe marrëdhëniet e tjera që lindin nga familja dhe martesa ose që kanë lidhje të ngushta me to, siç janë marrëdhëniet në mes prindërve dhe fëmijëve, midis personave në gjini, adoptimi dhe kujdestaria.

Objekt i së drejtës familjare përbëhet në radhë të parë nga marrëdhëniet e natyrës personale. Këto marrëdhënie lindin në martesë midis bashkëshortëve, gjatë ushtrimit të së drejtës prindërore midis prindërve dhe fëmijëve, midis birësuesit dhe të birësuarit, si dhe nga kujdestaria për të miturit. Po ashtu objekti i të drejtës familjare përbëhet edhe nga marrëdhëniet pasurore, që rrjedhin nga martesa dhe gjinia. Këto marrëdhënie janë të prejardhura nga marrëdhëniet personale, prandaj edhe janë dytësore. Këto marrëdhënie lindin nga prona e përbashkët e krijuar me punë gjatë jetës martesore apo në mes anëtarëve në gjini dhe janë në funksion të realizimit më të mirë të marrëdhënieve personale. Marrëdhëniet familjare sjellin të drejta dhe detyrime, të cilat bazën e kanë në veprimet e njëjzve të parapara me ligj, e që janë martesa, birësimi, kujdestaria etj, si dhe në ngjarje siç janë lindja dhe vdekja. Ndërsa përveç veprimeve, objekt i së drejtës familjare janë edhe mosveprimet, siç është p.sh mosveprimi i bashkëshortëve ka si pasojë mospërmbylljen e të drejtave dhe të detyrimeve, të cilat mund të kenë edhe pasoja të caktuara.

Siç e cekëm edhe më lartë objekt i së drejtës familjare janë edhe marrëdhëniet juridike në mes prindërve dhe fëmijëve (martesor, jashtëmartesor dhe të birësuar). Ndërsa në kuptim të gjerë, objekti i së drejtës familjare përbëhet edhe nga marrëdhëniet juridike të anëtarëve të një gjinie. P.sh. fëmijët e mitur pa kujdes prindëror dhe personat e tjerë madhorë me pazotësi për të vepruar, vihen nën kujdestari, ku Ligji i Familjes përcakton obligimin e anëtarëve të familjes apo të tjerëve që janë në gjini që të kujdesën për kategori të personave (kujdestaria).

1.5 Natyra e marrëdhënieve juridike-familjare

Marrëdhëniet juridike-familjare janë marrëdhënie shoqërore që i përkasin të drejtës civile. Kjo shihet edhe nga vet përmbajtja e e Kodeve Civile Moderne siç janë KC austriak (1811), KC gjerman (1896), KC i Napoleonit (Francë 1804) etj, ku e drejta familjare është pjesë përbërëse e këtyre kodeve. Në vendet ku nuk ka pasur kode, marrëdhëniet familjare janë rregulluar me ligje të veçanta (legjislacioni i ish Jugosllavisë, legjislacioni modern i Shqipërisë), por që kanë qenë të

ndikuara nga kodet e lartpërmendura dhe e kanë ruajtur natyrën e tyre si marrëdhënie juridiko-civile.

Me normat ligjore që rregullohen marrëdhëniet juridiko-familjare rregullohen marrëdhëniet që lindin nga familja, martesë, marrëdhëniet e përgjegjësisë prindërore, marrëdhëniet e adoptimit etj. Në Kosovë edhe pse nuk ka ende Kod Civil, marrëdhëniet juridike-familjare janë rregulluar me ligj të veçantë, por që i përkasin fushës juridiko-civile. Megjithatë, duhet shtuar se në Kosovë ende nuk ka një ligj të veçantë i cili kishte me rregulluar aspektin e veprimit të ligjit në raport me ligjet e vendeve të huaja, respektivisht zgjidhjen e konfliktit të ligjit, kur palët janë shtetas të ndryshëm. Nëse i referohemi Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 për Ligjin e zbatueshëm në Kosovë, me ndryshimet me Rregulloren nr. 2000/59, ende në fuqi është Ligji i ish RSFJ-së për zgjidhjen e kolizionit të ligjeve me dispozitat e shteteve tjera në marrëdhëniet e caktuara i vitit 1982. Prandaj, gjatë zbatimit të LFK-së për të zgjidhur konfliktin e ligjit me element ndërkombëtar që i referohet të drejtës private/civile edhe për çështje të lidhura me LFK mund të shërbej dhe të zbatohet ligji i vitit 1982, përderisa Kosova nuk nxjerr ligj të veçantë.

1.6 Parimet e së drejtës familjare

Parimet themelore të së drejtës familjare dallojnë nga parimet e të drejtave tjera, për shkak se ato rregullojnë marrëdhënie specifike që lindin në familje dhe lidhur me to. Parimet themelore të së drejtës familjare janë: a) parimi i barazisë në marrëdhëniet familjare, b) parimi i shuarjes së ndikimit të organizatave fetare, c) parimi i mbrojtjes shtetërore dhe shoqërore të familjes, ç) parimi i laicitetit dhe d) parimi i mbrojtjes së veçantë të fëmijëve.

Parimi i barazisë në marrëdhëniet familjare shpreh përcaktimin se anëtarët e familjes në marrëdhëniet familjare janë të barabartë në pikëpamje të të drejtave dhe detyrimeve, pavarësisht nga statusi dhe seksi.

Parimi i shuarjes së ndikimit të organizatave fetare nënkupton të drejtën e anëtarëve të familjes që marrëdhëniet e tyre familjare ti ushtrojnë sipas vullnetit të lirë të tyre, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, pa u ndikuar nga organizatat e ndryshme fetare.

Parimi i mbrojtjes shtetërore dhe shoqërore të familjes përcakton detyrimin e shtetit dhe shoqërisë që të mbrojnë familjen nga çfardo cenimi i të drejtave të tyre familjare, por edhe të mbështesin në të gjitha format ligjore në plotësimin e nevojave të ndryshme për familjet në nevojë apo fëmijët pa përkujdesje. Ky është detyrim që rrjedh nga konventat ndërkombëtare, por dhe nga legjislacioni vendor siç është kushtetuta dhe ligjet tjera në fuqi.

Parimi i laicitetit nënkupton faktin që të lidhet martesë civile para organit kompetent shtetëror, duke menjanuar ndikimin e organizatave fetare në këtë çështje. Gjithësesi Ligji për Familjën i Kosovës lejon edhe lidhjen e martesës para organizatës fetare, me kusht që martesë fillimisht të lidhet para organit shtetëror (martesë civile).

Parimi i veçantë i mbrojtjes së fëmijëve nënkupton detyrimin e shtetit dhe shoqërisë që fëmijëve si kategori e veçantë ti sigurohet dhe ti garantohet mbrojtje e veçantë nga shfrytëzimi ekonomik, keqtrajtimi apo dhuna seksuale, përdorimi i paligjshëm i narkotikëve, nga kryerja e punëve që paraqet rrezik apo e dëmton shëndetin e fëmijëve, trajtimin e barabartë të fëmijëve që lindin brenda martesës dhe jashtë saj etj.

Edhe Ligji për Familjen i Kosovës në nenin 3 i përcakton parimet mbi rregullimin e marrëdhënieve familjare, si në vijim: 1) barazia ndërmjet burrit dhe gruas, 1) mbrojtja e të

drejtave të fëmijëve dhe përgjegjësia e të dy prindërve për edukimin dhe rritjen e fëmijëve të tyre, 3) prindërit dhe fëmijët detyrohen në ndihmë dhe konsideratë të ndërsjellët gjatë tërë jetës së tyre dhe 4) fëmijët e prindërve të cilët nuk kanë qenë të martuar në kohën e lindjes së tyre gëzojnë të drejtat e njëjta dhe kanë detyrime të njëjta sikur fëmijët që kanë lindur në martesë.

1.7 Burimet e së drejtës familjare

Burimet e së drejtës familjare ndahen në burime materiale dhe formale. Burimet materiale shprehin fuqinë e shoqërisë, e cila i krijon dhe u jep përmbajtjen e vet normave juridike. Me burime formale juridike nënkuptojmë formën në të cilën shprehet norma juridike. Burime formale të së drejtës familjare janë: kushtetuta, ligji, zakoni (në raste të veçanta kur përcaktohet me ligj), praktika gjyqësore në mënyrë subsidiare dhe doktrina juridike në raste të veçanta. Burimet formale zakonisht ndahen në dy lloje: 1) burime të drejtëpërdrejta dhe burime të tërthorta.

Burime themelore konsiderohen ato akte ligjore të cilat rregullojnë të gjitha marrëdhëniet juridike familjare në kuadër të së drejtës familjare të një vendi, të cilat nuk përmbajnë norma juridike për rregullimin e marrëdhënieve juridike të fushave të tjera të së drejtës. Ndërsa në burime plotësuese hyjnë ligjet me të cilat nuk rregullohen në mënyrë të veçantë marrëdhëniet familjare, por preken në mënyrë të tërthortë disa çështje që janë me rëndësi për këtë degë të së drejtës, p.sh kodi penal, e drejta trashëgimore, e drejta e procedurës penale etj.

Si burime të së drejtës familjare hyjnë edhe burimet ndërkombëtare, siç janë aktet e përgjithshme juridike, si rezolutat e OKB-së apo organeve të saj, Deklarata universale mbi liritë dhe të drejtat themelore, konventat ndërkombëtare të cilat rregullojnë, përcaktojnë dhe garantojnë liritë dhe të drejtat e njeriut edhe në fushën e të drejtës familjare.

Burimet e së drejtës familjare të cilat janë të aplikueshme në Kosovë janë: Kushtetuta e Kosovës, Ligji për Familjen i Kosovës, Ligji për barazi gjinore, Ligji për mbrojtje nga shuna në familje, konventat ndërkombëtare që aplikohen direkt në Kosovë në bazë të nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës etj.

1.8 Ligji për familjen i Kosovës

Ligji për Familjen i Kosovës nr. 2004/32, ka hyrë në fuqi në fillim të vitit 2006 dhe me këtë është shënuar një hap përpara në fushën e rregullimit juridik të marrëdhënieve familjare. Ndërsa me miratimin e këtij ligji Kosova renditet në grupin e vendeve me rregullativen juridike familjare të harmonizuara me standardet ndërkombëtare.

Ky ligj përmban gjithësejtë tetë pjesë, të cilat do të paraqiten në vijim:

Pjesa e parë, përmban dispozitat e përgjithshme të cilat janë të përbashkëta për të gjitha marrëdhëniet juridike-familjare të cilat i rregullon ky ligj. Në këtë pjesë (neni 1-24) ligjvënësi ka vënë në fillim parimet dhe institutet themelore që i përshkrojnë marrëdhëniet familjare dhe ato janë si udhërrëfyes për rregullimin e marrëdhënieve familjare.

Pjesa e dytë, rregullon fejesën (neni 9-13) dhe martesën (neni 14-58). Në këtë pjesë, fejesa është rregulluar si institut i veçantë juridik, ku edhe janë përcaktuar rregulla lidhur me detyrimet që dalin nga fejesa.

Pjesa e tretë, përmban dispozitat për shuarjen, respektivisht mbarimin e martesës (neni 59-98). Në këtë pjesë janë rregulluar të gjitha format e shuarjes së martesës.

Pjesa e katërt, rregullon marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve (neni 99-155). Në këtë pjesë ligjvënësi i kushton rëndësi marrëdhëniet në mes prindërve dhe fëmijëve, rregullon statusin juridik të fëmijëve martesor dhe jashtëmartesor, raportet prindërore, kufizimi dhe heqja e së drejtës prindërore etj.

Pjesa e pestë, rregullon format e veçanta të mbrojtjes së fëmijëve pa kujdes prindëror (neni 156-214). Në kuadër të saj janë rregulluar edhe format e veçanta të mbrojtjes së fëmijëve pa përkujdesje prindërore, siç janë vendosja e fëmijës në familjen tjetër, adoptimi etj.

Pjesa e gjashtë, rregullon kujdestarinë (neni 215-270), ndërsa kjo pjesë përmban dispozita të hollësishme me të cilat rregullohet vendosja e një personi nën kujdestari etj.

Pjesa e shtatë, rregullon marrëdhëniet pasurore të anëtarëve të bashkësisë familjare (neni 271-277), kurse me një përmbledhje të veçantë janë rregulluar marrëdhëniet pasurore midis anëtarëve të familjes.

Pjesa e tetë, rregullon mbajtjen financiare (neni 278-355), ndërsa gjerësisht rregullohet detyrimi ligjor i mbajtjes midis anëtarëve të familjes, raportet e mbajtjes në mes bashkëshortëve, prindërve dhe fëmijëve, si dhe të personave të tjerë në lidhje familjare, si dhe ka dispozita që rregullojnë procedurën në kontestet familjare, dispozita kalimtare dhe përfundimtare.

1.9 Kuptimi i familjes

Tradicionalisht familja është përkufizuar si një grup njerëzish të bashkuar nga lidhjet e gjakut, martesë ose birësimi të cilët jetojnë së bashku, kanë një ekonomi të përbashkët dhe lindin e rrisin fëmijët. Tiparet kryesore të familjes janë konsideruar lidhjet e gjakut, martesë, bashkëjetesa, ekonomia, lindja dhe rritja e fëmijëve. Por zhvillimi i shoqërisë ka sjellë përkufizime të reja për familjen. Njerëzit bashkohen në lidhje familjare të ndryshme nga lidhjet tradicionale. Në shoqëritë e sotme, madje edhe në vendin tonë njerëzit bashkohen në familje jo vetëm në bazë të lidhjeve të gjakut, por edhe në bazë lidhjesh ligjore. Mjaft çifte bashkëjetojnë jo duke lidhur martesë, por duke dashuruar, pëlqyer dhe rënë dakort me njeri-tjetrin. Mjaft bashkëshorte nuk lindin, por birësojnë ose marrin në kujdestari fëmijë. Në këto rrethana familja mund të përkufizohet si një grup njerëzish, të cilët jetojnë së bashku në bazë të marrëveshjes në formë të ndryshme, formojnë një njësi ekonomike, kujdesen dhe e konsiderojnë njëri-tjetrin përbërës të rëndësishëm të këtij grupi.

Ligjet e reja, sa i përket kuptimit të familjes, kanë pikëpamje identike. Ligji për Familjen i Kosovës e përkufizon familjen në dy mënyra: në paragrafin 1 të nenit 2 thuhet se familja është bashkësi vital e prindërve dhe fëmijëve të tyre, si dhe personave të tjerë në gjini, ndërsa në paragrafin 2 të këtij neni, i ndikuar nga neni 16 i Deklaratës së përgjithshme mbi të drejtat e njeriut, familja përkufizohet si bërthamë natyrore dhe themelore e shoqërisë dhe si e tillë gëzon të drejtën në mbrojtje.

1.9.1 Llojet e familjes

Familja gjatë zhvillimit të vet historik, prej bashkësisë së parë primitive e deri më sot, mori trajta dhe elemente të ndryshme. Andaj varësisht nga kriteret dhe elementet që do të përdoren, familja

mund të klasifikohet në lloje të ndryshme. Në literaturën juridike hasen këto klasifikime më të rëndësishme të familjës: klasifikimi historik, sociologjik dhe juridik.

Llojet e familjes sipas kriterit historik- sipas këtij kriteri familja mund të klasifikohet në tri lloje të rëndësishme: 1) familja matriarkale (e grave), 2) familja patriarkale (e burrave) dhe 3) familja egalitare bashkohore.

Llojet e familjes sipas kriterit sociologjik- ky klasifikim më së shpeshti bëhet sipas natyrës së marrëdhënieve familjare, marrëdhënieve pasurore, përkatësisë së klasave apo të shtresave, funksioneve familjare, llojeve të lidhjeve familjare, kulturave familjare, martesave të përziera, viseve dhe rajoneve të banimit etj.

Llojet e familjes sipas kriterit juridik- në literaturën juridike hasen dy lloje të familjes sipas kriterit juridik: 1) familje sipas përbërjes numerike të anëtarëve të gjinisë dhe 2) familje sipas mënyrës së themelimit. Sipas ndarjes së parë familjet ndahen poashtu në tri lloje: a) familje e vogël, b) e gjerë dhe c) e madhe. Sipas ndarjes së dytë familjet ndahen në tri lloje: a) familja martesore, b) familja jashtëmartesore dhe c) familja e birësimit.

1.9.2 Funksionet e familjes

Familja ka këto funksione më të rëndësishme: a) funksionin e riprodhimit njerëzor, b) ekonomik, c) i rritjes dhe i edukimit të fëmijëve, ç) shoqërues dhe d) funksionin e mbrojtjes.

a) Funksioni i riprodhimit njerëzor- është padyshim funksioni i përhershëm historik dhe më i rëndësishmi për familjen dhe shoqërinë njerëzore, sepse i njëjti siguron ripërtëritjen e popullësisë. Në kuadër të këtij funksioni realizohen dy nënfunksiione të tjera: 1) nënfunksioni biologjik dhe 2) nënfunksioni seksual.

b) Funksioni ekonomik- ky funksion është në shërbim të shtimit të pasurisë dhe kapitalit. Familja në të gjitha fazat e zhvillimit të saj ka qenë njësi themelore prodhuese dhe ekonomike e shoqërisë. Brenda saj realizohej riprodhimi i mjeteve të nevojshme për plotësimin e nevojave të anëtarëve të saj për jetesë. Funksioni ekonomik i familjes ka dy nënfunksiione: 1) nënfunksioni prodhues dhe 2) nënfunksioni konsumues i të mirave materiale.

c) Funksioni i rritjes dhe edukimit të fëmijëve- familja ka qenë dhe mbetet hallka kryesore e rritjes dhe edukimit të brezit të ri, në të cilën hidhen bazat e para të formimit, edukimit dhe të kalitjes së fëmijëve. Me kalimin e kohës, shteti merr nga familja përherë e më shumë tagrin e ushtrimit të këtij funksioni, posaçërisht në aspektin e arsimimit. Edukimi i tillë i fëmijëve garantohet edhe me parag. 4 të nenit 125 të LFK-së, ku thuhet se fëmijët kanë të drejtën e shkollimit fillor falas, të marrjes së informacioneve për profesione të ndryshme, si dhe për shkollat që ekzistojnë.

ç) Funksioni shoqërues i familjes- familja është një nga hallkat e para që lidh njeriun me shoqërinë. Me rritjen e tyre fëmijët kontaktojnë, komunikojnë dhe integrohen në shoqërinë e gjerë. Duke jetuar në fqinjësi njëra me tjetrën, familjet frymëzojnë anëtarët e saj me ndjenjën e solidaritetit dhe i forcojnë lidhjet e anëtarëve të saj me shoqërinë në përgjithësi.

d) Funksioni mbrojtës i familjes- familja patriarkale kryente funksionin mbrojtës, ku ajo siguronte mbrojtje për të gjithë anëtarët e familjës, si për femra ashtu edhe për meshkuj. Ata gjenin brenda familjes një siguri të plotë, si fizike ashtu edhe psikike. Në kushtet e tanishme të

zhvillimi të shoqërisë njerëzore, ku funksionon shteti ligjor dhe i së drejtës, funksionin mbrojtës të familjes dhe anëtarëve të saj, përherë e më shumë e kryen shteti dhe organet e shtetërore. Ky funksion garantohet si me legjislacionin vendor (kushtetutë dhe akte të tjera ligjore), por edhe me atë ndërkombëtarë (konventa të ndryshme etj).

1.9.3 Planifikimi i familjes

Gjatë periudhave të ndryshme të zhvillimit shoqëror ka pasur dy kahe, që dallojnë njëri me tjetrin për sa i përket planifikimit të familjës. Ato janë: 1) politika e shtimit të nataliteti dhe 2) politika e kufizimit të natalitetit.

Politika e shtimit të natalitetit- këtu shteti përmes intrumenteve ligjore dhe me mjete të tjera zhvillimore ka ndikuar në rritjen e numrit të popullësisë, ashtu që e drejta e planifikimit të familjes është tjetërsuar nga njeriu. Shteti qysh në Greqinë e lashtë (ligji i Likurgut përcaktonte së secili çift martesor duhej të kishte të paktën dy fëmijë) ndërmori masa konkrete për rritjen e shtimit natyror të popullësisë. Kjo ka vazhduar edhe në shtetin e Romës e deri në shtetin rus, pas luftës së dytë botërore.

Politika e kufizimit të natalitetit- kjo politikë kryesisht është zbatuar kryesisht në vendet me një ekspansion demografik, siç janë vendet si Kina, India, vendet afrikane etj, ku për shkak të rritjes enorme të popullësisë, qeveritë e këtyre vendeve u detyruan që të marrin masa ideologjike për kufizimin e lindjeve.

Pavarësisht nga qëndrimet e lartpërmendura, doktrina e re juridike familjare, politikën e planifikimit të familjes e konsideron si një të drejtë njerëzore. Zënia dhe lindja e fëmijëve është çështje e vet bashkëshortëve. Përfillja e kësaj të drejte nënkupton respektimin e dinjitetit të qenies njerëzore, sigurimin e vazhdimësisë së bashkësisë njerëzore me lindjen e pasardhësve, si vullnet i bashkëshortëve, e jo si rezultat i masave shtetërore.

1.9.4 Struktura e lidhjes familjare

Në të kaluarën martesë dhe gjinia ishin bazat themelore për formimin e familjes, ku për shkak të rëndësisë që kanë këto dy institucione të së drejtës familjare, ligjëvënësi i ka rregulluar me dispozita ligjore. Mirëpo, pos martesës dhe gjinisë, bazë themelore e formimit të familjes ka qenë dhe është bashkësia jashtëmartesore. Kjo është e paraparë me dispozitën e nenit 41 të LFK-së, ku përcaktohet se bashkëshortët në marrëdhënie të përhershme faktike detyrohen të kenë ndaj njëri-tjetrit respekt të njëjtë, mirëkuptim të dyanshëm dhe ndihmë sikur në bazë të martesës ligjore. Ndërsa në bazë të nenit 3 parag. 4 të LFK-së, fëmijët e prindërve që nuk kanë qenë të martuar në kohën e lindjes së tyre gëzojnë të drejtat e njëjta dhe kanë detyrime të njëjta sikur fëmijët e lindur nga prindërit të cilët kanë qenë të martuar në kohën e lindjes së tyre.

Për dallim nga familjet në bazë të martesës ligjore dhe bashkësisë jashtëmartesore, familja e formuar në bazë të gjinisë mund të jetë e plotë dhe jo e plotë. Familje e plotë quhet ajo familje e cila përbëhet nga fëmijët e lindur prej të njëjtit baba dhe të njëjtës nënë në martesë, kurse familje jo e plotë quhet ajo familje kur fëmijët nuk kanë prejardhje prej të njëjtit babë dhe prej të njëjtës nënë në martesë.

1.10 Gjinia

Kuptimi i gjinisë- gjinia është lidhje midis dy apo më shumë personave, e themeluar me lindje (mënyra natyrore) apo me anë të ligjit. Personat në gjini kanë një të paralindur të përbashkët dhe kjo lidhje duhet të ekzistojë, e që mund të jetë lidhje biologjike apo e gjakut, morale, religjioze, ekonomike apo juridike.

1.10.1 Llojet e gjinisë

Dallojmë tri lloje të gjinisë: a) gjinia e gjakut, b) gjinia e krushqisë dhe c) gjinia e birësimit.

Gjinia e gjakut- është lidhje prej gjaku, që krijohet mes dy apo më shumë personave që rrjedhin nga njëri tjetri, ose prej një të paralinduri të përbashkët. Janë të njohura dy lloje vijash të gjinisë: vija e drejtë (line recta) dhe vija e terthortë (linca colateralis). Më tutje vija e drejtë ndahet në hipëse dhe zbritëse. Në vijën e terthortë qëndrojnë vëllezërit, motrat, kushërinjët dhe nipi.

Gjinia e krushqisë (affinitas)- është lidhje që krijohet midis njërit bashkëshort me të afërmit e gjinisë së gjakut të bashkëshortit tjetër. Pra, gjinia e krushqisë nuk krijohet në mënyrë natyrore me lindjen e fëmijëve, sikurse te gjinia e gjakut, por bazë e vetme e krijimit të saj është martesë.

Gjinia e birësimit (gjinia civile)- krijohet me akt juridik midis birësuesit dhe të birësuarit. Për dallim nga gjinia e gjakut, e cila krijohet në mënyrë natyrore me lindje, gjinia e birësimit formohet në mënyrë juridike me lidhjen solemne dhe formale të kontratës, prandaj shpesh quhet si gjini e krijuar në mënyrë artificiale.

1.15 Ushtrime

Gjatë këtij sesioni trajnuet pjesëmarrësve do tu prezantohet një shembull praktik, i cili ndërlidhet me temat e shqyrtuara më lartë. Ata do të ndahen në grupe të vogla dhe nga ana e secilit grup (përfaqësuesi i grupit) do të prezantojë mendimin e tyre, në lidhje me rastin praktik.

1.16 Përmbledhje

Në këtë sesion janë dhënë shpjegime dhe keni mundur të mësoni, rreth kuptimit të drejtës familjare, objektin e të drejtës familjare, natyrën e marrëdhënieve juridike familjare, parimeve të së drejtës familjare, burimet e së drejtës familjare, si dhe për përmbajtjen dhe strukturën e Ligjit për Familjes të Kosovës. Gjithashtu është shtjelluar kuptimi i familjes, llojet e familjes, funksionet e familjes, planifikimi i familjes, struktura familjare, gjinia dhe llojet e gjinisë.

2. E drejta martesore, të drejtat dhe detyrat e bashkëshortëve

2.1 Hyrje

Në këtë sesion trajnimi do të trajtohet rreth të drejtës martesore, kuptimit të martesës, qëllimet dhe kushtet për lidhjen e martesës, pengesat martesore dhe kushtet formale për lidhjen e martesës. Më tutje do të shtjellohet kuptimi, llojet e të drejtave dhe të detyrimeve të bashkëshortëve, të drejtat dhe detyrimet personale për të cilat bashkëshortët nuk mund të bëjnë marrëveshje dhe të drejtat dhe detyrimet personale për të cilat bashkëshortët mund të bëjnë marrëveshje.

2.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij sesioni trajnues, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Thellojnë njohurit për të drejtën martesore, kushtet për lidhjen e martesës, pengesat martesore dhe llojet e të drejtave dhe detyrimeve të bashkëshortëve;
- Vlerësojnë të drejtat dhe detyrimet personale për të cilat bashkëshortët nuk mund të bëjnë marrëveshje;
- Vlerësojnë të drejtat dhe detyrimet për të cilat bashkëshortët mund të bëjnë marrëveshje;
- Identifikojnë dispozitat përkatëse ligjore të LFK-së, që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet e përmendura më lartë.

2.3 E drejta martesore

E drejta martesore është një përmbledhje normash juridike me të cilat rregullohet martesja dhe marrëdhëniet martesore, të cilat norma kryesisht janë të natyrës urdhëruese. Mirëpo, përveç me norma urdhëruese, për shkak të natyrës së marrëdhënieve midis bashkëshortëve, ekzistojnë edhe shumë marrëdhënie martesore të tjera, të cilat rregullohen me norma të karakterit dispozitiv, përkatësisht me marrëveshjen e bashkëshortëve, psh. çështja e mbiemrit, vendbanimit të përbashkët etj. E drejta martesore është në të njëjtën kohë edhe pjesë e shkencës familjare juridike. Ajo merret me studimin e martesës dhe të marrëdhënieve martesore. Detyra e shkencës juridike qëndron në sistematizimin e normave të së drejtës martesore, si dhe në përcaktimin e parimeve të saj themelore.

Objekt i së drejtës martesore- është martesja dhe marrëdhëniet martesore, të cilat janë të llojllojshme, si të natyrës personale juridike, ashtu edhe pasurore juridike. Edhe marrëdhëniet pasurore martesore të cilat lindin nga martesja përbëjnë poashtu objektin e së drejtës martesore. Kohëve të fundit objekt i së drejtës martesore është përfshirë edhe studimi dhe rregullimi i marrëdhënieve juridike të cilat lindin nga bashkësia jashtëmartesore.

Subjektet e së drejtës martesore- janë bashkëshortët, mirëpo gjithnjë e më shumë edhe bashkëshortët jashtëmartesor.

Parimet themelore të së drejtës martesore- kushtetuta si akti ligjor juridik më i larti i një vendi, përmban parimet themelore edhe të së drejtës martesore, të cilat pastaj vihen në themelet e shkencës juridike. Ato garantohen dhe përpunohen më tej, si në ligjin për familjen, ashtu edhe me dispozita të tjera ligjore.

Parimet themelore të së drejtës martesore janë: parimi i barazisë, parimi i laicitetit, parimi i institucionalitetit, parimi i monogamisë dhe parimi i jetës së vazhdueshme.

2.3.1 Kuptimi i martesës

Martesa është institucion qëndror në të drejtën familjare. Edhe martesës mund ti qasemi në kuptime të ndryshme. Nga aspekti juridik martesa zakonisht përkufizohet si bashkëjetesë e vazhdueshme (jo e përkohshme dhe jo e përhershme) e burrit dhe e gruas (hetero-seksuale) e rregulluar me ligj. Martesa në fakt paraqet një institut shoqëror dhe juridik për shkak se është formë e organizimit shoqëror dhe rregullohet me norma juridike. Normat juridike me të cilat rregullojmë martesën janë të karakterit të detyrueshëm dhe palët nuk mund t'i ndryshojnë me vullnetin e tyre, prandaj ajo bëhet një institucion juridik i mbrojtur nga shteti.

Në literaturën juridike përkufizimet për martesën ndahen në dy grupe: grupi i parë e konsideron martesën si kontratë juridike-civile me të cilën një burrë dhe një grua vendosin jetesën e tyre të përbashkët me qëllim të ndihmës reciproke në mes tyre dhe krijimin e familjes, ndërsa grupi në grupin e dytë bëjnë pjesë përkufizimet me të cilën burri dhe gruaja vendosin për një jetë të përbashkët në mes tyre të sanksionuar nga ligji dhe të cilën ata nuk mund ta zgjidhin vet. Ndërsa e drejta bashkohore i shmanget përkufizimit të martesës për shkak se ajo nuk është diçka e dhënë një herë e përgjithmonë si definim dhe ndryshon në kohë dhe hapësirë, edhe pse shumica e elementeve janë gjithmonë prezentë.

Mund të thuhet se martesa është një bashkësi e një burri dhe një gruaje me qëllim të jetës së përbashkët dhe krijimit të familjes, e krijuar, e regjistruar dhe e shkëputshme në mënyrë ligjore para organeve kompetente, e bazuar në vullnetin e lirë, jo diskriminim dhe barabarësinë e bashkëshortëve.

2.3.2 Qëllimet dhe kushtet për lidhjen e martesës

Qëllimet e martesës rrjedhin nga vetë përmbajtja e martesës, si bashkësi jetësore e një burri dhe një gruaje dhe si bazë e ligjshme e krijimit të familjes. Mund të thuhet se martesa ka tri qëllime kryesore: a) qëllimi natyror, b) qëllimi moral dhe c) qëllimi shoqëror.

a) Qëllimi natyror- është qëllimi kryesor i martesës, e që ka të bëjnë me lindjen dhe rritjen e fëmijëve, që nënkupton kryerjen e marrëdhënieve seksuale të burrit me gruan.

b) Qëllimi moral- nënkupton faktin se bashkëshortët kanë për detyrë ta ndihmojnë njëri tjetrin në nevojë, ta mirëkuptojnë e ta mbrojnë njëri tjetrin, të kujdesen dhe ta shërojnë në rast të sëmundjes.

c) Qëllimi shoqëror- nënkupton faktin se martesa si institucion shoqëror ka për detyrë të kryejë funksione të shumta shoqërore, para se gjithash në vetëdijësimin dhe ngritjen e shëndoshë të brezave të rinj.

Kushtet për lidhjen e martesës- një martesë e vlefshme mund të lidhet vetëm në kushtet e parashikuara me dispozita ligjore. Sipas LFK-së kushtet për lidhjen e martesës ndahen në: kushte thelbësore, pengesat martesore dhe ndalesat martesore. Kushtet thelbësore për lidhjen e martesës janë: vullneti i lirë i bashkëshortëve të ardhshëm, sekset e kundërta dhe lidhja e martesës para organit kompetent.

a) *Vullneti i lirë i bashkëshortëve të ardhshëm*- në dispozitën e nenit 18 të LFK-së parashikohet se një martesë nuk do të jetë e vlefshme nëse bashkëshortët kanë deklaruar pëlqimin për lidhjen e martesës jo me vullnetin e lirë, por me kërcënim, shtërngim, lajthim apo në ndonjë mënyrë tjetër, që do të thotë se ka munguar vullneti i lirë i brendshëm i bashkëshortëve të ardhshëm. Para se gjithash vullneti i shprehur për martesë duhet të jetë: real e jo simulativ, të jetë serioz e jo i shprehur sa për shaka, si dhe të dy deklaratat duhet të jepen në të njëjtën kohë në çastin e lidhjes së martesës.

b). *Sekset e kundërta*- përbëjnë komponentin biologjik, kulturor dhe civilizues të një martese. Kjo për faktin se qëllimi natyror i martesës ka qenë dhe mbetet lindja dhe rritja e fëmijëve, si dhe kryerja e marrëdhënieve seksuale.

c). *Lidhja e martesës para organit kompetent*- deklarimi i vullnetit të lirë për lidhjen e martesës së personave me sekse të kundërta përmban në vetvete dy komponente të rëndësishme: a) vullneti të jetë i shprehur para organit kompetent për lidhjen e martesës dhe b) në mënyrën e parashikuar me ligj. Martesa lidhet përpara nëpunësit të gjendjes civile, në të kundërtën martesa nuk mund të jetë e vlefshme.

2.3.3 Pengesat martesore

Pengesat martesore (impedimenta matrimonii) janë fakte dhe rrethana të përcaktuara shprehimisht në ligj, ekzistenca e të cilave pengon lidhjen e martesës së vlefshme. Ndërsa në teorinë juridike pengesat martesore klasifikohen sipas kriterëve të ndryshme, si: pengesat martesore të evitueshme dhe të paevitueshme, pengesat martesore të përhershme dhe të përkohshme, pengesat martesore absolute dhe relative. Legjislacioni ynë i parasheh këto pengesa martesore: mungesa e vullnetit, martesa egzistuese, sëmundja psikike dhe pazotësia për të vepruar, gjinia dhe kujdestaria.

a) **Mungesa e vullnetit**- martesa nuk do të jetë e plotëfuqishme, nëse pëlqimi është arritur përmes shtërngimit, kërcënimit ose lajthimit, apo të ndonjë mungese tjetër të vullnetit të lirë nga ana e bashkëshortëve të ardhshëm.

b) **Martesa ekzistuese**- nënkupton faktin se askush nuk mund të lidhë martesë të re, përderisa martesa e parë nuk pushon juridikisht. Kjo është përcaktuar në nenin 19 të LFK-së, i cili e afirmon martesën monogame, një burrë një grua.

c) **Aftësia për të vepruar**- nënkupton faktin se personi i cili ka qenë i privuar nga zotësia e tij/saj juridike me vendim të gjykatës nuk mund të lidhë martesë. Këtu kemi një përjashtim nga rregulli i përmendur më lartë, ku përjashtimisht gjykata mund të lejojë që personin e tillë që të martohet me kërkesë, ku në këtë rast gjykata mund të kërkojë mendimin e prindit, të mbikqyrësit ose të kujdestarit të personit dhe të organit të kujdestarisë (neni 20 i LFK-së).

ç) **Gjinia e gjakut**- nënkupton faktin se nuk mund të lidhin martesë personat në gjini të gjakut në vijë të drejtë ose në vijë të tërthortë siç janë vëllau dhe motra prej një ati dhe një nëne, motra dhe vëllau prej atit ose nënës, xhaxhai dhe mbesa, daja dhe mbesa, tezja dhe nipi, as fëmijët e vëllezërve dhe motrave të një ati dhe nëne dhe fëmijët e vëllezërve dhe të motrave prej atit ose nënës.

d) **Adoptimi**- nënkupton faktin se gjinia e themeluar me adoptim është pengesë martesore sikurse gjinia e gjakut.

dh) Krushqia- nuk mund të lidhin martesë personat në gjini krushqie siç janë vjehri dhe reja, dhëndrri dhe vjehrra, njerka dhe thjeshtri, njerku dhe thjeshtra, pa marr parasysh faktin se a ka pushuar martesë, lidhja e së cilës ka sjellë këtë marrëdhënie (me përjashtim në rastet e arsyeshme me lejën e gjykatës, pas marrjes së mendimit të organit të kujdestarisë).

e) Kujdestaria- martesë midis kujdestarit dhe personit nën kujdestari është e ndaluar gjatë kohës së kujdestarisë (me përjashtim në rastet e arsyeshme me lejën e gjykatës, pas marrjes së mendimit të organit të kujdestarisë).

2.3.4 Kushtet formale për lidhjen e martesës

Forma e lidhjes së martesës është civile. Dispozita e nenit 27 të LFK-së përcakton se martesë lidhet në formën solemne (forma ad solemnitatem) dhe në lokalet posaçërisht të caktuara për lidhjen e martesës. Më tutje nenit 28 i po këtij ligji parasheh se martesë lidhet përpara nëpunësit të gjendjes civile, në të kundërtën martesë nuk mund të jetë e vlefshme, duke e ndarë atë përfundimisht nga forma fetare dhe institucionet fetare. Me ritualin solemn, i cili e përshkon atmosferën e lidhjes së martesës, bëhet e mundur që akti i lidhjes së martesës të mbetet në kujtesën e të gjithë të interesuarve në mjedisin në të cilin është mbajtur lidhja e martesës dhe të cilit i përket çifti bashkëshortor. Si elemente kryesore të formës së lidhjes së martesës cilësohen:

a) Kompetenca për lidhjen e martesës- ndahet në kompetencë këndore, tokësore dhe funksionale. Si organ kompetent për lidhje të martesës LFK-ja (neni 28) përcakton organin komunal të gjendjes civile, i cili është i autorizuar për udhëheqjen e librave të amzës të të martuarve.

b) Mënyra e lidhjes së martesës- nënkupton tërësinë e rregullave të cilat duhet respektuar me rastin e lidhjes së martesës.

Procedura paraprake- fejesa është një premtim para martesës, e cila është premtim reciprok i dy personave të sekseve të kundërta për t'u martuar në të ardhmen (neni 9 i LFK-së). Më tutje lidhja e martesës është njëri prej momenteve më të rëndësishme në jetën e njeriut, pas lindjes dhe vdekjes. Lidhja e martesës bëhet në mënyrë solemne, botërisht dhe në praninë e personave zyrtar. Për këtë çështje ligji përcakton edhe procedurën që duhet ndjekur për lidhjen e martesës. Kështu që përcaktohet vendi i lidhjes së martesës, pjesëmarrja personale në aktin e martesës, aktin e lidhjes së martesës (kurorëzimin), regjistrimin e aktit të martesës në librat amzë të të martuarve etj.

2.4 Kuptimi, llojet e të drejtave dhe të detyrimeve të bashkëshortëve

Martesa në fakt krijon një tërësi të drejtash dhe detyrimesh midis bashkëshortëve, ashtu që burri dhe gruaja kanë të drejta dhe detyrime reciproke, andaj sot martesë ngrihet mbi bazën e barazisë morale dhe juridike, brenda kufijve të përcaktuar me ligj, pa ndonjë diskriminim fetar, kombëtar, racor. Nga plotësimi dhe respektimi i tërësisë së të drejtave dhe detyrimeve varet cilësia dhe stabiliteti i bashkësisë martesore. Marrëdhëniet martesore janë specifike, ku një numër prej të drejtave personale të bashkëshortëve nuk mund të rregullohen me norma juridike. Ato paraqesin një shumëllojshmëri marrëdhëniesh, që përbëjnë intimitetin e njeriut, e që janë: psikologjike, biologjike e të karakterit moral. Këto marrëdhënie realizohen spontanisht dhe kanë ngelur jashtë sferës së rregullimit juridik, mirëpo nuk kanë ngelur jashtë sferës së interesimit shoqëror, por këto marrëdhënie janë objekt rregullimi me norma etike.

Nga të lartcekurat, të drejtat dhe detyrat personale të bashkëshortëve ndahen në: a) të drejtat dhe detyrat personale për të cilat bashkëshortët nuk mund të bëjnë marrëveshje dhe b) të drejtat dhe detyrat personale për të cilat bashkëshortët mund të bëjnë marrëveshje.

2.4.1 Të drejtat dhe detyrat personale për të cilat bashkëshortët nuk mund të bëjnë marrëveshje

Në këtë grup hyjnë të drejtat personale të cilat janë të rregulluara me norma ligjore urdhëruese, si: jeta e përbashkët e bashkëshortëve, barazia e bashkëshortëve, pavarësia e bashkëshortëve në zgjedhjen e punës dhe të profesionit, besnikëria bashkëshortore dhe ndihma reciproke midis bashkëshortëve. Këto të drejta janë të rregulluara me norma të karakterit urdhërues (jus cogens), që do të thotë se bashkëshortët nuk mund t'i rregullojnë ndryshe, përpos siç janë parashikuar me dispozita ligjore.

1) *Bashkëshortët nuk mund të vendosin për jetën e përbashkët*- jetesën e përbashkët nuk duhet ngatërruar me vendbanimin e përbashkët, pasi që jeta e përbashkët është kategori shumë më e gjerë sesa vendbanimi i përbashkët. Jeta e përbashkët është e rregulluar me norma të natyrës jus cogens, d.m.th bashkëshortëve nuk ju lejohet mundësia e vendosjes ndryshe nga ajo që parashihet me dispozita ligjore.

2) *Barazia e bashkëshortëve*- është e garantuar me dispozita kushtetuese dhe ligjore. Ndërsa barazia garantohet jo vetëm në sferën e të drejtave personale, por edhe të marrëdhënieve pasurore.

3) *Pavarësia e bashkëshortëve për të zgjedhur punën dhe profesionin*- kjo nënkupton faktin se bashkëshortët kanë të drejtë për të zgjedhur lirisht punën dhe profesionin e tyre. Kjo e drejtë u garantohet edhe me dispozitën e nenit 44 parag. 5 të LFK-së, ku përcaktohet se secili bashkëshortë është i pavarur në zgjedhjen e punës dhe të profesionit.

4) *Detyrimi i ndihmës dhe i respektimit*- manifestohet në dy aspekte: në atë moral dhe material. Në aspektin moral shprehet në detyrimin që ka njëri bashkëshort për t'i ofruar mbështetje morale dhe emocionale bashkëshortit në nevojë, ndërsa në aspektin material ky është detyrim për ta mbajtur familjen ose për t'i përmbushur të gjitha nevojat e jetës së bashkëshortit tjetër që nuk është në gjendje t'i përmbush vet.

5) *Besnikëria bashkëshortore*- nënkupton faktin se bashkëshortët kanë për detyrë për t'i qëndruar besnik njëri tjetrit, sidomos në sferën e marrëdhënieve seksuale, në të kundërtën është paraparë mundësia ligjore që të ngritet padia për zgjidhje të martesës për këtë shkak (neni 69 parag. 2 i LFK-së).

LFK-ja në dispozitën e nenit 42, përcakton të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve, respektivisht të drejtat dhe detyrimet që dalin nga martesë ligjore civile, e që nënkupton martesën e lidhur para ofiqarit të gjendjes civile. Neni 42 e rregullon në veçanti barabarësinë e bashkëshortëve në marrëdhëniet personale dhe pronësore, përkufizimin e kohëzgjatjes së martesës, besnikërinë e bashkëshortëve ndaj njëri tjetrit, ndihmën reciproke të tyre, respektin reciprok, mbështjetjen financiare të njëri tjetrit, solidaritetin reciprok të tyre, si dhe solidaritetin ndaj fëmijëve të tyre të lindur në martesë apo të adoptuar.

2.4.2 Të drejtat dhe detyrat personale për të cilat bashkëshortët mund të bëjnë marrëveshje

Këto të drejta janë të rregulluara me norma të karakterit dispozitiv, që do të thotë se bashkëshortët mund t'i rregullojnë me marrëveshje dhe ndryshe ngase parashihet me ligj. Këto janë: 1) caktimi i mbiemrit, 2) caktimi i vendbanimit, 3) lindja e fëmijëve dhe ekonomia e përbashkët familjare dhe 4) caktimi i shtetësisë.

1) *Caktimi i mbiemrit*- mbiemri caktohet me marrëveshje të bashkëshortëve, ndërsa këtë LFK-ja e rregullon me dispozitën e nenit 43, ku bashkëshortët kanë shumë alternativa, p.sh secili bashkëshort ta mbajë mbiemrin e vet, që njëri ta marr mbiemrin e bashkëshortit tjetër etj.

2) *Caktimi i vendbanimit*- për këtë vendosin lirisht bashkëshortët, ndërsa këtë e parasheh edhe LFK-ja në nenin 44 parag. 3, ku thotë se bashkëshortët vendosin vet për vendin e banimit.

3) *Vendosja për numrin e fëmijëve dhe për kryerjen e punëve në bashkësi martesore*- bashkëshortët me marrëveshje vendosin bashkarisht sa fëmijë do të kenë, si do t'i rrisin, arsimojnë, edukojnë etj.

4) *Caktimi i shtetësisë*- dihet se shtetësia është lidhje juridike midis një njeriu dhe një shteti, ndërsa rregullativa ligjore i mundëson bashkëshortëve që lirisht të zgjedhin shtetësinë që duan ta mbajnë.

2.5 Ushtrime

Gjatë këtij sesioni pjesëmarrësve do tu prezantohet një shembull praktik, i cili ndërlidhet me temat e shqyrtuara më lartë. Ata do të ndahen në grupe të vogla dhe nga ana e secilit grup (përfaqësuesi i grupit) do të prezentoj mendimin e tyre, në lidhje me rastin praktik.

2.6 Përmbledhje

Në këtë sesion trajnuet janë dhënë shpjegime dhe keni mundur të mësoni, rreth kuptimit të së drejtës martesore, kuptimi i martesës, qëllimet dhe kushtet për lidhjen e martesës, pengesat martesore dhe kushtet formale për lidhjen e martesës. Më tutje janë dhënë shpjegime në lidhje me kuptimin, llojet e të drejtave dhe të detyrimeve të bashkëshortëve, të drejtat dhe detyrimet personale për të cilat bashkëshortët nuk mund të bëjnë marrëveshje dhe të drejtat dhe detyrimet personale për të cilat bashkëshortët mund të bëjnë marrëveshje.

3. Zgjidhja e martesës, procedura e shkurorëzimit, detyrimi për ushqim dhe e drejta prindërore

3.1 Hyrje

Në këtë pjesë të modulit do të flitet rreth mënyrave të zgjidhjes së martesës, anulimin i martesës dhe shkurorëzimit. Gjithashtu do të flitet rreth parimeve kryesore të procedurës së shkurorëzimit, kompetencën e gjykatës, procedurën gjyqësore, mënyrën e vendosjes dhe mjetet juridike tek shkurorëzimi, si dhe pasojat e shkurorëzimit dhe anulimit të martesës. Më tutje do të flitet rreth kuptimit dhe rëndësisë së detyrimit për ushqim (alimentacion), karakteristikat e detyrimit për ushqim, si dhe llojet e detyrimit për ushqim, kuptimit të së drejtës prindërore, të drejtat dhe detyrat e prindërve ndaj fëmijëve, të drejtat dhe detyrat e fëmijëve ndaj prindërve, ushtrimin, pezullimin, kufizimin dhe heqjen e së drejtës prindërore, si dhe vendimet e gjykatës për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave prindërore. Gjithashtu do të identifikohen dhe analizohen dispozitat ligjore të LFK-së lidhur me çështjet e cekura më lartë.

3.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të kësaj pjese të modulit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Identifikojnë mënyrat e zgjidhjes së martesës;
- Zbatojnë drejtë procedurës për zgjidhjen e martesës me anulim;
- Zbatojnë drejtë mënyrën e zgjidhjes së martesës me shkurorëzim;
- Identifikojnë kushtet formale për zgjidhjen e martesës;
- Vlerësojnë rrethin e personave që kanë të drejtë të kërkojnë zgjidhjen e martesës, sipas mënyrave të përmendura më lartë;
- Interpretojnë drejtë parimet kryesore të procedurës së shkurorëzimit;
- Njohin kompetencën e gjykatës tek zgjidhja e martesës;
- Zbatojnë drejtë procedurën gjyqësore, mënyrën e vendosjes dhe mjetet juridike të shkurorëzimit;
- Analizojnë pasojat e shkurorëzimit dhe anulimit të martesës;
- Identifikojnë dispozitat ligjore të zbatueshme në procedurën e shkurorëzimit sipas LFK-së,
- Thellojnë njohurit për detyrimin për ushqim dhe rëndësinë e tij, llojet e detyrimit për ushqim, karakteristikat kryesore të detyrimit për ushqim,
- Zbatojnë drejtë procedurën gjyqësore, mënyrën e vendosjes dhe mjetet juridike tek detyrimi për ushqim;
- Vlerësojnë rrethin e personave të cilët kanë detyrim ligjor që të japin ushqim;
- Identifikojnë dispozitat ligjore të zbatueshme në procedurën e dhënies së ushqimit sipas LFK-së;
- Njohin të drejtën prindërore dhe rëndësinë e saj, të drejtat dhe detyrat e prindërve ndaj fëmijëve dhe anasjelltas;
- Zbatojnë drejtë procedurën për ushtrimin, pezullimin, kufizimin dhe heqjen e së drejtës prindërore.

3.3 Mënyrat e zgjidhjes së martesës

Sipas nenit 60 të LFK-së, martesë mbaron kur shfaqen rrethana apo ngjarje të rëndësishme, siç janë: vdekja e njërit bashkëshort, shpallja e njërit bashkëshort të zhdukur për të vdekur, shkurorëzimi dhe anulimi i martesës.

a) Vdekja e njërit bashkëshort- nënkupton faktin se një martesë mund të shuhet me vdekjen e bashkëshortit (neni 60 paragraf. 1 i LFK-së). Ky nen nuk përmban ndonjë dispozitë e cila sqaron se si duhet të përfundojë, përkatësisht cili është akti ose momenti që konsiderohet se martesë është shuar. Megjithatë, duhet sqaruar se vdekja e bashkëshortit është ngjarje natyrore e cila shënon edhe shuarjen e martesës, kurse kjo vlen për të gjitha sistemet juridike. Me shuarjen e martesës me vdekje, bashkëshorti ka tjetër ka të drejtë të lidhë martesë të re. Vdekja regjistrohet në regjistrin e Librave të gjendjes civile, përkatësisht Librin amzë të të vdekurve. Regjistrimi i aktit të vdekjes së bashkëshortit në regjistrin amzë të të vdekurve duhet konsideruar si moment të shuarjes së martesës me vdekjen e bashkëshortit, pasi që kjo mund të dëshmohet me certifikatën e vdekjes e cila është e domosdoshme të paraqitet nëse bashkëshorti pasjetues vendos të lidhë martesë të re.

b) Shuarja e martesës me shpalljen e bashkëshortit të zhdukur për të vdekur- me nenin 60 paragraf. 1 të LFK-së, është paraparë shuarja e martesës kur njëri bashkëshort është i zhdukur e më pas shpallet i vdekur në rast se plotësohen kushtet ligjore. Personat e zhdukur për të cilët nuk ka njohuri për vendndodhjen dhe jetën e tyre dhe supozohet se janë të vdekur, mund të shpallen për të vdekur, por për të inicuar procedurën për këtë çështje duhet të plotësohen disa kushte substanciale të parapara me ligj. Shpallja e një personi të zhdukur për të vdekur realizohet në procedurë jokontestimore dhe sipas dispozitave të Ligjit të procedurës jokontestimore, ku më pas vendimi i gjykatës duhet të shënohet në regjistrin amzë të të vdekurve, ndërsa ky vendim duhet të jetë i plotëfuqishëm për të shkaktuar shuarjen e martesës.

c) Shuarja e martesës me anulim- dispozita e nenit 60 paragraf. 1 të LFK-së, gjithashtu ka paraparë shuarjen e martesës me anulim, ndërsa anulimi është një mënyrë e zgjidhjes së martesës së pavlefshme. Martesë e pavlefshme konsiderohet martesë e cila është lidhur në kundërshtim me ligjin. Me ligj parashihen kushtet ligjore për lidhjen e një martesë. Nëse nuk plotësohen kushtet ligjore, një martesë nuk mund të lidhet dhe zyrtari (ofiqari) i gjendjes civile duhet të refuzojë lidhjen e martesës, mirëpo për çfardo arsye ose rrethana të caktuara një martesë është lidhur pa u plotësuar kushtet ligjore ose pengesat ligjore për lidhjen e një martesë kanë qenë të panjohura, një martesë e tillë është e pavlefshme. Procedura e anulimit të martesës është procedurë gjyqësore, ndërsa padinë për anulim, përveç bashkëshortëve, mund ta bëjnë edhe prokurori publik dhe personat tjerë që kanë interes juridik për anulimin e martesës. Megjithatë, çdo martesë e lidhur supozohet se është e vlefshme përderisa nuk paraqiten faktet për anulimin e saj, të cilat mund t'i paraqesin personat e përcaktuar me ligj. Mungesa e këtyre kushteve sjellë pavlefshmërinë e martesës, mirëpo shkaqet që sjellin pavlefshmërinë kanë efekt të ndryshëm, që si rrjedhojë disa shkaktojnë pavlefshmëri absolute e disa shkaktojnë pavlefshmëri relative. Edhe pse LFK-ja nuk jep detaje se kur kemi të bëjmë me anulim absolut e kur me anulim relativ të martesës, por shkaqet që shkaktojnë anulimin kanë efekte të ndryshme. Andaj në vazhdim do të sqarohen këto dy lloje të anulimit- anulimin absolut dhe relativ të martesës.

1) Anulimi absolut i martesës- ekziston atëherë kur nuk plotësohen kushtet ligjore të përcaktuara me ligj për anulimin e martesës dhe anulimi i martesës mund të bëhet në çdo kohë, kurse rrethi i personave për të kërkuar anulimin është më i gjerë se sa te shkurorëzimi. Si shkaqe të cilat shkaktojnë anulimin absolut të martesës konsiderohen: martesë ekzistuese, paaftësia për të vepruar, mos-respektimi i dallimit të sekseve, gjinia (gjakut, krushqisë, adoptimit), lidhja e

martesës para moshës 16 vjeçare, shmangja nga qëllimi i martesës dhe mosrespektimi i procedurës për lidhjen e martesës.

2) *Anulimi relativ i martesës*- është po ashtu mënyrë e anulimi të një martese të pavlefshme, sepse mungojnë disa kushte ligjore për vlefshmërinë e saj. Klasifikimi në anulim relativ mund të bëhet bazuar në shkaqet që shkaktojnë pavlefshmërinë, ndërsa anulimi mund të kërkohet vetëm sipas padisë private dhe në afatin e caktuar. Sipas përmbajtjes së dispozitave ligjore të LFK-së, neneve 62-67, si shkaqe që shkaktojnë anulimin relativ të martesës, mund të konsiderohen: mungesa e vullnetit për të lidhur martesë, lidhja e martesës me personin nën moshën 18 vjet dhe paaftësia për të vepruar.

d) Shuarja e martesës me shkurorëzim- me nenin 60 parag. 1 të LFK-së, është paraparë shuarja e martesës me shkurorëzim. Shkurorëzimi është mënyrë e shuarjes së martesës së vlefshme. Shuarja e martesës me shkurorëzim dallon nga shuarja e martesës me anulim, sepse me anulim shuhet martesa e pavlefshme, ndërsa me shkurorëzim shuhet martesa e vlefshme. Shkurorëzimi mund të kërkohet vetëm nga bashkëshortët dhe për shkaqe të cilat i ka paraparë ligji. E drejta për ngritjen e padisë për shkurorëzim nuk mund të kalohet te trashëgimtarët, por të njëjtit mund të vazhdojnë procedurën e filluar për të verifikuar bazën e padisë (parag. 2 i nenit 68 të LFK-së). Shkurorëzimi ka katër komponentë: 1) shkurorëzimi presupozon ekzistimin e martesës së vlefshme, 2) shkurorëzimi mund të bëhet për të gjallë të bashkëshortëve, 3) shkurorëzimi bëhet për shkaqe të parashikuara në ligj dhe 4) shkurorëzimi mund të bëhet vetëm në procedurë gjyqësore (nenet 68 dhe 69 të LFK-së).

3.4 Parimet kryesore të procedurës së shkurorëzimit

Para se gjithash, marrëdhëniet të cilat rregullohen në kontestet martesore janë të natyrës personale, prandaj dallojnë nga kontestet pronësore-juridike, si për nga rëndësia, ashtu edhe për nga natyra. Kjo është një specifikë e rëndësishme e kontesteve martesore. Karakteristika e dytë ka të bëjë me faktin se martesa është institucion shoqëror dhe juridik dhe për këtë shkak e njëjta rregullohet me norma urdhëruese ligjore, ndërsa përmes tyre shoqëria synon realizimin e qëllimeve konkrete. Kur këto qëllime nuk realizohen atëherë martesa duhet të zgjidhet, mirëpo vetëm me vendim të gjykatës, e cila vlerëson plotësimin e kushteve të parapara me të drejtën materiale. Në kontestet martesore zbatohen rregullat e procedurës civile vetëm në rastet kur nuk janë paraparë rregulla të veçanta me dispozitat e Ligjit për Familjen.

Parimet kryesore të procedurës së shkurorëzimit janë:

a) Parimi i mbrojtjes së veçantë të disa personave në procedurë- që nënkupton faktin se gjatë të gjitha fazave të procedurës së shkurorëzimit, gjykata duhet të ketë parasysh mbrojtjen e interesave të fëmijëve të mitur, të personave të sëmurë, të cilët nuk janë në gjendje të kujdesën për të drejtat dhe interesat e tyre.

b) Parimi i përjashtimit të publikut- i cili parim nënkupton faktin se në kontestet martesore publiku përjashtohet, për shkak se përpara gjykatës trajtohen çështje të ndjeshme përfshirë ato intime (kjo sanksionohet me nenin 75 të LFK-së).

c) Parimi i dispozicionit- i cili u garanton palëve iniciativën në lidhje me grumbullimin e materialit procedural, megjithatë në këto konteste gjykata nuk ka rol pasiv sikurse në procedurat tjera civile, por ka rol aktiv dhe mund t'i hetojë faktet mbi të cilat palët i mbështesin kërkesat e tyre.

ç) Parimi i kufizimit të disponimit me objektin e kontestit- kjo nënkupton faktin se për dallim nga procedurat tjera civile në kontestet martesore palët nuk mund të kenë lirinë e plotë objektin e kontestit.

3.4.1 Kompetenca e gjykatës

Çështja e kompetencës lëndore për vendosjen e kontesteve martesore nuk rregullohet shprehimisht me dispozitat e LFK-së. Kompetenca lëndore për vendosje në kontestet martesore rregullohet me Ligjin për Gjykatat. Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Gjykatat, (i cili ka hyrë në fuqi me 1 janar 2013), ndër të tjera është përcaktuar se kompetente për vendosje në shkallë të parë të kontesteve martesore është Gjykata Themelore, përkatësisht Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni civil (dispozita e parag. 1 e nenit 11 të Ligjit për Gjykatat, thotë se: *“Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe”*), ndërsa kompetente për vendose në shkallë të dytë është Gjykata e Apelit e Kosovës. Para hyrjes në fuqi të këtij ligji kompetente për vendosje rreth kontesteve martesore ka qenë Gjykata e Qarkut (kompetencë e cila ka qenë e përcaktuar me Ligjin për Gjykatat e Rregullta që ka qenë në fuqi deri në datën e lartcekur).

Ndryshe nga kjo, çështja e kompetencës territoriale është rregulluar më qartë në nenin 72 të LFK-së, ku thuhet se në kontestet martesore kompetencën territoriale përveç gjykatës me kompetencë të përgjithshme territoriale e ka edhe gjykata në territorin e të cilës bashkëshortët e kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët. Ndërsa neni 73 e rregullon kompetencën funksionale brenda një gjykate lidhur me vendosjen e një kontesti martesor. Me rastin e vendosjes në kontestet martesore, në procedurën e shkallës të parë vendos trupi gjykues i përbërë nga një gjyqtar profesional dhe dy gjyqtarë porotë, kurse në shkallën e dytë vendos kolegji prej te gjyqtarëve. Kompetencën territoriale në kontestet martesore e përcakton neni 44 i Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), i cilin nen ka përmbajtje identike me nenin 73 të LFK-së, ndërsa kjo kompetencë emërtohet si kompetencë territoriale e zgjedhur. Gjithashtu neni 56 i LPK-së, e rregullon kompetencën territoriale e cila njihet si kompetencë territoriale ndihmëse, kurse neni 63 i po këtij ligji përcakton të drejtën e Gjykatës Supreme që në rastet kur për shkaqe të ndryshme një gjykatë nuk mund të procedojë me zgjidhjen e çështjes konkrete, të caktoj ndonjë gjykatë tjetër e cila do të vendos rreth kërkesës së palëve, përfshirë këtu edhe rastet kur njëri prej bashkëshortëve është shtetas i huaj.

3.4.2 Procedura, mënyra e vendosjes dhe mjetet juridike tek shkurorëzimi

Procedura në kontestet martesore fillon përmes parashtrimit të padisë në gjykatën kompetente nga njëri prej bashkëshortëve. Në rastet kur të dy bashkëshortët janë të pajtimit që martesën e tyre ta zgjidhin me marrëveshje, atëherë procedura fillon me parashtrimin e propozimit të përbashkët për zgjidhjen e martesës. Kjo do të thotë se vetëm bashkëshortët kanë të drejtë të parashtrinë padi në gjykatë për zgjidhjen e martesës. Mirëpo, kjo rregull i ka edhe përjashtimet e veta, pasi që me dispozita ligjore lejohet që kujdestari të parashtrijë padi për shkurorëzim në emër të bashkëshortit të sëmurë psikik apo pa zotësi për të vepruar, me pëlqimin e organit të kujdestarisë. Në këto konteste i padituri ka të drejtë të parashtrijë kundërpadi, me të cilën i mundësohet që të paraqesë para gjykatës fakte dhe prova të reja të cilat mund të kenë ndikim në vendimin e gjykatës.

LFK-ja ka paraparë edhe disa kufizime ligjore për sa i përket të drejtës për parashtrimin e padisë në gjykatë, siç është kur padia për shkurorëzim nuk mund të parashtrohet nga asnjëri bashkëshort gjatë shtatëzanisë së gruas dhe derisa fëmija i përbashkët nuk i mbush një vit (parag. 1 të nenit 70 të LFK-së). E drejta e padisë shuhet me rastin e vdekjes së njërit apo të dy bashkëshortëve. Edhe në këtë rast kemi një përjashtim kur trashëgimtarët e bashkëshortëve nuk mund të parashtrinë padinë në gjykatë për zgjidhje të martesës, por të njëjtit mund ta vazhdojnë procedurën e filluar për të verifikuar bazën e padisë (neni 68 parag. 3 i LFK-së). Kur është fjala

për zgjidhjen e martesës sipas propozimit të përbashkët të bashkëshortëve, këta të fundit kanë për obligim që propozimit t'i bashkangjisin edhe marrëveshjen në formë të shkruar (tani të noterizuar) për përkujdesjen, edukimin dhe ushqimin e fëmijëve të tyre të përbashkët dhe rregullimin e kontakteve personale me ta (neni 70 parag. 2 i LFK-së). Gjithashtu LFK-ja ka rregulluar edhe situatat kur bashkëshortët kanë të drejtë të bëjnë tërheqjen e padisë dhe propozimit të përbashkët për zgjidhje të martesës (neni 86 parag 1 dhe 2).

Mënyra e vendosjes- procedura e shkurorëzimit zhvillohet para gjykatës kompetente, ndërsa deri në marrjen e vendimit të gjykatës procedura kalon nëpër disa faza, siç janë: a) përpjekjet për pajtimin e bashkëshortëve (nenet 76-79 të LFK-së), b) caktimi i masave të përkohshme (neni 71 i LFK-së, c) prezentimi dhe administrimi i provave dhe ç) marrja e aktgjykimit.

a)) Përpjekjet për pajtimin e bashkëshortëve- LFK-ja parasheh procedurë strikte në lidhje me vendosjen e gjykatës në kontestet martesore. Kështu që neni 76 përcakton obligimin e gjykatës që aktgjykimin për shkurorëzim duhet ta merr pas një periudhe të përpjekjeve për pajtim të zhvilluara nga gjykata në seanca të veçanta, përveç kur njëri prej bashkëshortëve është i paaftë për të vepruar, kur njëri apo të dy bashkëshortët jetojnë jashtë vendit dhe kur nuk dihet vendbanimi i njërit nga bashkëshortët. Ndërsa neni 77 i po këtij ligji ndër të tjera parasheh se aktgjykimi për shkurorëzim u dërgohet palëve vetëm pas përfundimit të procedurës dhe vetëm nëse pajtimi nuk ka pasur sukses. Në rastet kur bashkëshortët kanë fëmijë të mitur, atëherë procedurën e pajtimit e zhvillon Organi i Kujdestarisë, duke zbatuar metodat e punës sociale, metodat tjera profesionale, duke shfrytëzuar shërbimet e këshillimorës për martesë dhe familje, si dhe institucionet tjera profesionale (neni 80 i LFK-së), ndërsa neni 83 i po këtij ligji përcakton afatin prej tre muajsh brenda të cilëve duhet të përfundojë procedura e pajtimit.

b) Caktimi i masave të përkohshme- LFK-ja në nenin 71 ka paraparë se gjatë procedurave të kontesteve martesore, gjykata me vendim duke u bazuar në padi, mund të caktojë masa të përkohshme për sigurimin e mbajtjes financiare për bashkëshortin dhe vendosjen e tij, ndërsa ankesa kundër këtij vendimi nuk e ndalon ekzekutimit e tij.

c) Prezentimi dhe administrimi i provave- është fazë e rëndësishme e cila i mundëson palëve në kontestet martesore që para gjykatës t'i prezentojnë të gjitha provat me të cilat do të vërtetoheshin faktet mbi të cilat e mbështesin kërkesëpadinë. Për dallim nga procedurat tjera civile LFK-ja në nenin 84 parag. 2, ka paraparë mundësinë e gjykatës që të hetojë faktet dhe të zhvillojë procedurën e provave në rastet kur bashkëshortët kanë fëmijë të mitur dhe është e rëndësishme që të vendoset drejtë për mirëqenien dhe edukimin e tyre. Ndërsa kur nuk kanë fëmijë të mitur gjykata nuk i heton faktet në të cilat është mbështetur propozimi i përbashkët për zgjidhjen e martesës (parag. 1 i nenit 84). Në rastet kur procedura zhvillohet sipas padisë atëherë gjykata i heton të gjitha faktet që janë me rëndësi për marrjen e aktgjykimit.

ç) Marrja e aktgjykimit- në kontestet martesore si në rastin kur procedura për shkurorëzim inicohet sipas padisë apo propozimit të përbashkët për zgjidhjen e martesës dhe pas përfundimit të fazave të lartcekura, gjykata vendos me aktgjykim, i cili duhet t'i përmbajë të gjitha elementet të cilat janë të parapara me dispozitat e LPK-së, ndërsa në dispozitiv të aktgjykimit duhet të vendoset për të gjithë kërkesëpadinë, përfshirë këtu zgjidhjen e martesës, besimin e fëmijëve, alimentacionin, etj. Martesa konsiderohet e zgjidhur atëherë kur aktgjykimi të merr formë të prerë. Në kontestet martesore nuk lejohet marrja e aktgjykimit për shkak mungesës apo në bazë të pohimit.

Mjetet juridike- në kontestet martesore janë të lejuara mjetet e rregullta juridike. Në rastet kur gjykata merr aktgjykim për zgjidhjen e martesës (ose kur refuzon kërkesëpadinë),

bazuar në padinë e parashtruar nga njëri prej bashkëshortëve, pala e pakënaqur ka të drejtë të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh në Gjykatën e shkallës së dytë, që në rastin tonë është Gjykata e Apelit, sipas të gjitha bazave për ankim të parapara me dispozitat e LPK-së. Këtu kemi një përjashtim apo kufizim të ankesës, në rastet kur aktgjykimi është marr sipas propozimit të përbashkët të bashkëshortëve, i cili mund të goditet vetëm për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore ose kur propozimi është dhënë në lajthim ose nën ndikimin e shtërngimit apo mashtrimit (neni 87 i LFK-së). Në kontestet martesore (si në rastet kur martesë është zgjidhur me shkurorëzim apo anulim) nuk lejohet parashtrimi i mjeteve të jashtëzakonshme juridike (neni 88 i LFK-së).

3.4.3 Pasojat e shkurorëzimit dhe anulimit të martesës

Me zgjidhjen e martesës paraqiten një varg pasojash juridike, si të natyrës personale juridike, ashtu edhe të natyrës pasurore, si pasojë e krijimit të një situatë të re juridike, për shkak të ndërprerjes së jetesës së përbashkët bashkëshortore. Këto pasoja mund të ndahen në dy grupe themelore: a) pasojat juridike për bashkëshortët dhe b) pasojat juridike për fëmijët e përbashkët, të birësuar ose për fëmijët ndaj të cilëve është vazhduar e drejta prindërore.

a) Pasojat juridike për bashkëshortët- janë mbiemri, ndarja e pronës së përbashkët, kthimi i dhuratave, detyrimi i ushqimit, e drejta e banesës, e drejta e trashëgimit dhe pasojat për fëmijë.

b) Pasojat juridike për fëmijët e përbashkët, të birësuar ose për fëmijët ndaj të cilëve është vazhduar e drejta prindërore- janë çështja se kujt duhet t'i besohen fëmijët e mitur (cilit prind), rregullimin e kontakteve personale të fëmijëve me prindërit dhe çështjen e dhënies së ushqimit për fëmijët e mitur.

3.5 Kuptimi dhe rëndësia e detyrimit për ushqim

Detyrimi për ushqim është një detyrim ligjor, pa kundërshtim dhe me karakter personal, në bazë të të cilit një apo disa anëtarë të familjes detyrohen të sigurojnë mjete të jetesës për anëtarët e tjerë të familjes që janë të paaftë për punë dhe që nuk kanë mjete të mjaftueshme për të jetuar. Detyrimin për dhënien e ushqimit e kanë personat që me dispozita ligjore detyrohen të japin ushqimin, me kusht që të mos rrezikojnë mbajtjen e tyre të domosdoshme (neni 307 paragraf. 1 i LFK-së).

Përbushja e këtij detyrimi nënkupton përbushjen në mënyrë të rregullt të nevojave për ushqim, banim, veshëmbathje, shërim, ndërsa kur është fjala për fëmijët e mitur edhe të nevojave për arsim, edukim dhe të nevojave kulturore. Sipas dispozitës së nenit 178 paragraf. 1 të LFK-së, detyrimi për ushqimin e anëtarëve të familjes dhe personave tjerë në gjini është njëherësh e drejtë dhe detyrim. Mënyrat e përbushjes së detyrimit për ushqim janë të ndryshme. P.sh marrësit të ushqimit mund t'i jepet një shumë e caktuar e parave, nevojat mund të përbushen edhe në natyrë, mund t'i jepen në shfrytëzim pasuri e patundshme, apo mund të kombinohen mënyrat e përmendura më lartë.

3.5.1 Karakteristikat e detyrimit për ushqim

Detyrimi për ushqim është i rregulluar me dispozita të Ligjit për Familjen dhe ka disa karakteristika të veçanta, të cilat dallojnë nga detyrimet e tjera pasurore-juridike. Karakteristikat e detyrimit për ushqim janë si vijon:

a) Detyrimi për ushqim buron nga ligji- nënkupton faktin se detyrimi për ushqim buron drejtëpërdrejtë nga ligji, më saktësisht është i rregulluar me dispozita ligjore urdhëruese dhe nuk është detyrim kontraktues apo deliktor.

b) Detyrimi për ushqim është i lidhur ngushtë për personalitetin- detyrimi për ushqim është detyrim dhe e drejtë personale, e cila lidhet ngushtë si me personin e detyruar për dhënien e ushqimit, ashtu edhe personin që e gëzon këtë të drejtë. E drejta e ushqimit dhe detyrimi i ushqimit nuk mund të kalohen me kontratë (inter vivos apo mortis causa) mbi personin e tretë.

c) Detyrimi për ushqim jepet vetëm për kohën e ardhshme- qëllimi kryesor i detyrimit për ushqim, është sigurimi i mjeteve të nevojshme për ekzistencë, e jo pasurim i personit në nevojë, andaj edhe ky ushqim jepet për kohën e ardhshme, e jo për kohën e kaluar.

ç) Detyrimi për ushqim nuk parashkruhet- nënkupton faktin se e drejta për të kërkuar mbajtje ligjore nuk parashkruhet dhe mund të paraqitet në çdo kohë.

d) Detyrimi për ushqim nuk është dëmshpërblim- nënkupton faktin se detyrimi për ushqim është detyrim ligjor që buron nga ligji dhe nuk mund të jetë dëmshpërblim.

dh) Detyrimi për ushqim i paguar nuk kthehet- detyrimi për ushqim nuk është dhuratë, as hua, por detyrim ligjore, prandaj edhe nuk mund të kthehet.

e) Vendimi gjyqësor mbi detyrimin e ushqimit mund të ndryshohet- gjykata me kërkesën e marrësit të ushqimit apo dhënësit të ushqimit mund ta ndryshojë vendimin, ashtu që të ndërpresë, të shtojë, të zvogëlojë lartësinë e ushqimit, varësisht nëse rrethanat mbi të cilat është bazuar vendimi kanë ndryshuar (neni 331 parag. 1 të LFK-së).

ë) kontestet lidhur me detyrimin për ushqim kanë përparësi në procedurën kontestimore dhe atë të përmbarrimit përkundër kërkesave të tjera- paditë apo propozimet për përmbarrim që kanë për objekt detyrimin për ushqim kanë përparësi në vendosje në raport me kërkesat e natyrave të tjera (lëndë urgjente).

3.5.2 Llojet e detyrimit për ushqim

Llojet e detyrimit të ushqimit janë: a) ushqimi i familjes, b) detyrimi i ushqimit mes bashkëshortëve, c) detyrimi i ushqimit mes prindërve dhe fëmijëve dhe ç) detyrimi i ushqimit mes personave të tjerë në gjini.

a) Ushqimi i familjes- nënkuptohet sigurimi i mjeteve për përmbushjen e nevojave të përbashkëta të familjes dhe për mbulimin e shpenzimeve për veshmbathje, qira, ujë, ngrohje, energji elektrike etj.

b) Detyrimi i ushqimit mes bashkëshortëve- bashkëshortët kanë për detyrë të ndihmojnë dhe t'i sigurojnë njëri tjetrit përkrahje materiale. Detyrimi ligjor i ushqimit në këtë rast lind në kohën e lidhjes së martesës, vazhdon gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj dhe mbaron me

zgjdhjen e martesës. Megjithatë, kur plotësohen kushtet ligjore, detyrimi i ushqimit të bashkëshortit vazhdon edhe pas zgjidhje ose anulimit të martesës. Gjithësesi realizimi i së drejtës për ushqim varet nga përmbushja në mënyrë kumulative e kushteve të parapara me dispozita ligjore. Në këtë drejtim neni 298 parag. 1 i LFK-së thotë se *“Bashkëshorti i cili nuk ka mjete të mjaftueshme për mbajtje financiare, i cili nuk është i aftë të punojë ose që për arsye tjera nuk mund të plotësohet, ka të drejtë në mbajtje financiare nga bashkëshorti tjetër, në përpjestim me mundësitë e tij financiare”*.

c) Detyrimi i ushqimit mes prindërve dhe fëmijëve- prindërit kanë detyrim ligjor dhe moral që të përkujdesen për fëmijët e tyre të mitur, për shëndetin, edukimin, arsimimin dhe për aftësimin e tyre për punë të pavarur derisa të mbushin moshën madhore, ndërsa në kushte të përcaktuara ligjore edhe pas moshës madhore (deri në moshën 26 vjeçare nëse vazhdojnë shkollimin e përgjithshëm). Kjo vlenë edhe për rastet kur fëmija për shkak të sëmundjes, zhvillimit me të meta psikike dhe fizike është i paaftë për punë, ndërsa nuk ka mjete të mjaftueshme për jetesë apo nuk mund të realizojë të ardhura nga pasuria e tij, atëherë prindërit janë të detyruar për ta mbajtur derisa zgjatë paaftësia. Këtë detyrim zakonisht prindërit e përmbushin vullnetarisht gjatë ushtrimit të së drejtës së rritjes dhe edukimit të fëmijëve. Po ashtu këtë detyrim prindërit e kanë si ndaj fëmijëve të lindur në martesë ashtu edhe ndaj atyre që janë lindur jashtë martesë. Detyrimi vlen edhe për partnerët e pamartuar të cilët kanë fëmijë të mitur (neni 322 i LFK-së) dhe për prindin të cilit i është hequr e drejta prindërore (neni 293 i LFK-së). Kjo vlenë edhe për fëmijët të cilët kanë për detyrim t’i mbajnë prindërit e tyre kur të njëjtit nuk kanë mjete të mjaftueshme për jetesë (neni 294 par. 1 i LFK-së).

ç) Detyrimi i ushqimit mes personave të tjerë në gjini- të afërmit në vijë të drejtë janë të detyruar t’ sigurojnë mbajtje financiare reciproke (neni 278 parag. 2 i LFK-së, ndërsa në vijë të tërthortë vëllezërit dhe motrat madhore kanë detyrimin e mbajtjes së motrave dhe të vëllezërve të mitur. Edhe personat në gjinin e krushqisë dhe të birësimit janë të detyruar të japin ushqimin në rastet kur përmbushen kushtet ligjore (neni 295 par. 1 i LFK-së).

3.6 Kuptimi i të drejtës prindërore

E drejta prindërore është tërësi rregullash juridike me të cilat rregullohen marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve, midis birësuesit dhe të birësuarit, midis kushërinjëve dhe ndaj personave tjerë në gjini. E drejta prindërore është pjesë përbërëse e të drejtës familjare, por edhe pjesë përbërëse e sistemit juridik të vendit. Marrëdhëniet prindërore përbëhen prej dy elementeve kryesore: elementit natyral dhe elementit juridik.

Elementi i parë që ndryshe quhet biologjik është i përhershëm, gjithmonë i pandryshuar dhe manifestohet me lindje. Marrëdhëniet prindërore zgjasin deri në mbushjen e moshës madhore të fëmijës, ndërsa në raste të caktuara me ligj edhe pas mbushjes së moshës madhore. Elementi i dytë imponon nevojën e vërtetimit të lidhjes biologjike të fëmijës me prindërit veç e veç. Rregullat juridike me të cilat rregullohen këto marrëdhënie janë të përfshira në Ligjin për Familjen.

Çdo fëmijë ka të drejtën e pamohueshme për të jetuar. Fëmijët kanë të drejtë të rriten në familje me prindër, ndërsa fëmijët që nuk jetojnë bashkë me të dy prindërit kanë të drejtë t’i takojnë rregullisht prindërit me të cilët nuk jetojnë. Fëmijët me të meta të diagnostifikuara mendore ose fizike kanë të drejtë për kujdesë të veçantë, për një jetë më të përshtatshme, në kushte të jetës që garantojnë dinjitetin e tyre dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e tij aktive në jetën shoqërore. Gjithashtu fëmijët kanë të drejtën e shkollimit fillor falas, të marrjen së informimit për profesione të ndryshme, si dhe për shkollat që ekzistojnë. Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes nga

shfrytëzimi ekonomik, eksploatimi i fëmijëve, trafikimi dhe eksploatimi seksual dhe nga kryerja e çdo pune që paraqet rrezik ose që cenon edukimin ose dëmton shëndetin e tyre. Fëmijët kanë të drejtë dhe duhet të mbrohen nga keqtrajtimi dhe dhunimi seksual. Gjithashtu fëmijët duhet mbrojtur nga përdorimi i paligjshëm i drogave dhe substancave psikotrope dhe nuk duhet lejuar që fëmijët të përdoren për prodhimin dhe trafikimin e paligjshëm të këtyre lëndëve (neni 125 i LFK-së).

Mbrojtja e të gjitha të drejtave të përmendura më lartë është detyrim ligjor dhe moral fillimisht i prindërve, por edhe i organeve shtetërore përfshirë këtu edhe gjykatën. Në këtë drejtim LFK-ja me dispozitat e saj përcakton detyrimet e prindërve që të ushtrojnë kujdesin prindëror ndaj fëmijëve të tyre. Kështu që dispozita e nenit 128 parag. 4 të këtij ligji përkufizon përgjegjësinë prindërore në të cilën përfshihen të drejtat dhe detyrat që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenjen emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurisë, për të cilat gjëra prindërit duhet t'i kenë në konsiderim aftësitë, prirjet dhe dëshirat e fëmijëve të tyre.

3.6.1 Të drejtat dhe detyrimet e prindërve ndaj fëmijëve

Të drejtat dhe detyrimet e prindërve ndaj fëmijëve të mitur janë të dy llojshme: a) të drejtat dhe detyrat personale të prindërve ndaj fëmijëve dhe b) të drejtat dhe detyrat pasurore të prindërve ndaj fëmijëve.

a) Të drejtat dhe detyrat personale të prindërve ndaj fëmijëve- të drejtat prindërore janë të lidhura ngushtë me personalitetin e prindit dhe askush nuk ka të drejtë të përzihet në marrëdhëniet mes fëmijëve dhe prindërve, përderisa këto të drejta dhe detyrime prindërit i ushtrojnë në interesin më të mirë të fëmijëve. Përmbajtja e këtyre të drejtave dhe detyrimeve përcaktohet me dispozita ligjore dhe ato i ushtrojnë vet prindërit. Prindërit këto të drejta i ushtrojnë me marrëveshje njëri me tjetrin, që do të thotë se në ushtrimin e tyre janë plotësisht të barabartë. Kjo rezulton edhe nga neni 18 i Konventës për të drejtat e fëmijëve, sipas të cilës *“të dy prindërit kanë përgjegjësi të përbashkëta për mirërritjen dhe zhvillimin e fëmijëve dhe interesat e fëmijëve paraqesin brengën themelore të tyre”*. Interesimi i fëmijëve është elementi qenësor në të drejtën prindërore, përkatësisht në marrëdhëniet e fëmijëve dhe prindërve, si dhe është element vendimtar apo përcaktues të cilit duhet t'i përmbahen prindërit dhe organet shtetërore që vendosin në kontestet mes prindërve dhe në mes prindërve dhe fëmijëve. Të drejtat dhe detyrat e prindërve ndaj fëmijëve janë: *1. caktimi i emrit, 2. ruajtja dhe mirërritja, 3. arsimimi dhe edukimi, 4 mbajtja dhe 5. përfaqësimi.*

b) Të drejtat dhe detyrat pasurore të prindërve ndaj fëmijëve- marrëdhëniet pasurore juridike të prindërve dhe fëmijëve lindin si rrjedhojë e jetesës së përbashkët familjare dhe kujdesit të ndërsjellë të fëmijëve dhe prindërve, mirëpo jo në bazë të një kontrate. Si rrjedhojë, edhe fëmijët mund të kenë pasurinë e tyre, të cilën mund ta fitojnë me punë, trashëgim, dhurim, lojëra fati apo në çfardo mënyre tjetër të ligjshme. Andaj, në raport me pasurinë e fëmijëve, prindërit kanë këto të drejta dhe detyrime: *1. ta administrojnë pasurinë e fëmijëve të mitur, 2. ta disponojnë këtë pasuri dhe 3.t'i shfrytëzojnë të ardhurat nga kjo pasuri.*

Prindërit kanë të drejtë dhe detyrë ligjore që t'i përfaqësojnë fëmijët e tyre të mitur, ndërsa të gjitha dërgimet apo deklaratat që duhet t'i bëhen fëmijës, mund t'i dërgohen njërit ose tjetrit prind, e nëse prindi nuk jeton së bashku, prindit me të cilin jeton fëmija. Pasurinë e fëmijës deri në moshën madhore të tij e administrojnë në dobi të fëmijës prindërit e tij. Me të ardhurat e fëmijës mund të disponojnë prindërit e tij, në radhë të parë për ushqimin, edukimin dhe arsimimin e tij, si dhe për nevojat e domosdoshme të bashkësisë familjare, nëse kjo e fundit nuk

ka mjete të mjaftueshme. Ndërsa me lejen e Organit të Kujdestarisë prindërit mund ta tjetërsojnë ose ta ngarkojnë pasurinë e fëmijës, vetëm nëse është e domosdoshme për mbajtje, kujdes dhe edukim.

Fëmija që ka mbushur moshën 14 vjeç mund të ndërmer veprime juridike, mirëpo për vlefshmërinë e këtyre veprimeve (me përjashtim të atyre që kanë rëndësi të vogël), nevojitet leja e prindërve të tij, përkatësisht leja e organit të kujdestarisë për disa veprime juridike, përveçse me ligj është paraparë ndryshe. Ndërsa fëmija që ka mbushur 15 vjet, me pëlqim të përfaqësuesit të tij statutor në mënyrë të pavarur mund të themelojë marrëdhënien e punës dhe të disponojë me të ardhurat e veta personale.

3.6.2 Të drejtat dhe detyrat e fëmijëve ndaj prindërve

Detyrimet e prindërve janë në raport korelativ me të drejtat e fëmijëve, ku secili detyrim i prindërve është në të njëjtën kohë e drejtë e fëmijëve. Nga kjo rezulton se prindërit janë të detyruar të kujdesen për ruajtjen dhe mirërritjen, emrin personal, edukimin dhe shkollimin, administrimin e pasurisë, përfaqësimin, ndërsa fëmijët kanë të drejtë të kërkojnë prej prindërve realizimin e këtyre të drejtave, të cilët janë të shtyrë edhe nga ndjenja e solidaritetit ndaj fëmijëve të tyre ti përmbushin këto obligime. Në këtë drejtim dispozita e nenit 42 parag. 4 të LFK-së parasheh se *“bashkëshortët do të zhvillojnë dhe shprehin ndenjen e solidaritetit reciprok, si dhe solidaritetin ndaj fëmijëve të tyre të lindur në martesë apo të birësuar”*, ndërsa në parag. 4 të nenit 44 të po këtij ligji është paraparë se *“të dy bashkëshortët kontribuojnë në mirëmbajtjen e familjes proporcionalisht me aftësitë e tyre individuale, ndërsa fëmijët kanë detyrë që me sjellje të mira e korrekte t’ua mundësojnë prindërve punën për realizimin e detyrimeve”*.

Përveç të drejtave të cilat i kanë fëmijët në raport me prindërit e tyre, në të njëjtën kohë ata kanë edhe disa detyrime ndaj prindërve. Këto detyrime janë dy llojesh: a) detyrimet ligjore dhe b) detyrimet morale.

a) Detyrimet ligjore- fëmijët kanë detyrë themelore që të kujdesen dhe t’i ndihmojnë prindërit e tyre, sidomos kur ata janë të paaftë për punë dhe nuk kanë mjete të mjaftueshme për jetesë, janë të sëmurë, ose për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore ose materiale nuk mund të kujdesen vet dhe të sigurojnë mirëqenie sociale. Në radhë të parë për prindërit duhet të kujdesen fëmijët madhorë. Mirëpo, edhe fëmija që ka mbushur 15 vjet, me pëlqim të përfaqësuesit të tij statutor në mënyrë të pavarur mund të themelojë marrëdhënien e punës dhe të disponojë me të ardhurat e veta personale dhe me pasurinë që e ka fituar me punën e vet, por është i detyruar që nga këto të hyra të kontribuojë për ushqimin, edukimin dhe arsimimin e vet, por nëse është nevoja duhet të kontribuojë edhe për mirëqenien e prindërve dhe familjes së tij.

b) Detyrimet morale- siç e dimë pjesa më e madhe e detyrimeve që kanë fëmijët ndaj prindërve të tyre janë të karakterit moral dhe rregullohen në bazë të rregullave morale. Respektimi i prindërve është element pozitiv i traditës tonë shekullore dhe një detyrë themelore për secilin fëmijë, të cilët duhet të kenë sjellje korrekte ndaj prindërve.

3.6.3 Ushtrimi, pezullimi, kufizimi dhe heqja e të drejtës prindërore

Siç e kemi përmendur edhe më lartë, e drejta prindërore i përket në mënyrë ekskluzive vetë prindërve të fëmijës, e cila e drejtë është e lidhur ngushtë me personalitetin e prindërve dhe fëmijëve. Prindërit zakonisht e ushtrojnë së bashku kujdesin prindëror. Pra të dy prindërit kanë të drejta të barabarta ndaj fëmijëve të tyre, më saktësisht së bashku vendosin, respektivisht marrin

vendime dhe i kryejnë veprimet e caktuara për përkujdesje ndaj fëmijëve. Prindërit duhet të merren vesh për mënyrën e kryerjes së këtyre veprimeve rreth ushtrimit të kujdesit prindëror si p.sh për vendosje lidhur me shkollimin, përkujdesjen shëndetësore, mbajtjen etj. Kjo do të thotë se asnjëri prind nuk mund të vendos në mënyrë arbitrare pa pëlqimin e prindit tjetër. Në rastet kur njëri prind ka vdekur atëherë kujdesin prindëror e ushtron prindi tjetër. Gjithashtu edhe në rastet kur njëri prind i është marrë e drejta prindërore, atëherë kujdesin prindëror e ushtron prindi tjetër. Kjo rregull vlenë edhe në rastet kur njëri prind i merret aftësia e veprimit, mirëpo ka edhe rrethana tjera kur prindi për shkak se përkohësisht ndodhet jashtë vendit ose mund të jetë i sëmurë përkohësisht, në raste të tilla kujdesin prindëror e ushtron prindi tjetër.

Organit të Kujdestarisë (OK) me ligj i është dhënë përgjegjësia që të ushtrojë kujdesin ndaj fëmijëve drejtëpërdrejtë ose përmes kujdestarit për shkaqe të caktuara me ligj. Kjo është paraparë me dispoziten e nenit 138 të LFK-së, e cila parasheh se *“Organi i Kujdestarisë vendos në emër të interesave të fëmijës, vetëm me kërkesën e njërit ose të dy prindërve, me kërkesën e personit të tretë, në rastet kur kujdesi i fëmijës është nën mbikqyrjen e tij ose me vendimin e gjykatës”*. Sipas dispozitës të përmendur më lartë prindërit mund të iniciojnë procedurë të mbikqyrjes ose vendosjes nga OK për interesa të fëmijëve. Kjo kërkesë mund të bëhet nga njëri prind ose të dy prindërit dhe mund të paraqitet në rastet kur prindi tjetër e keqpërdor të drejtën prindërore ose abuzon me të drejtën prindërore. Në këto raste kërkohet nga OK që fëmija të mbrohet nga këto keqpërdorime dhe ndaj tij të ushtrohet mbikqyrje e vazhdueshme. Gjithashtu edhe personat e tretë që për ndonjë arsye vlerësojnë se prindërit nuk e ushtrojnë të drejtën prindërore në interes të fëmijës, mund të kërkojnë nga OK që të vendos lidhur me kujdesin prindëror. Edhe ndaj fëmijëve që OK i ka nën mbikqyrje, ushtron kujdesin prindëror, p.sh tek fëmijët e braktisur, ose kur fëmija i është marrë prindërve me vendim të gjykatës. Gjithashtu edhe gjykata me vendim mund të obligojë OK që të përkujdeset për fëmijën, p.sh në rastet kur prindi është privuar nga e drejta prindërore etj. Në fund OK edhe ex officio ka përgjegjësi që të merr masa mbrojtëse, mbikqyrje të vazhdueshme për mbrojtjen e interesave të fëmijës.

LFK-ja në nenin 139 rregullon çështjen e ushtrimit të kujdesit prindëror në rastin e ndarjes së prindërve, më saktësisht përcakton faktin se kush e ushtron të drejtën prindërore në këto raste.

Pezullimi i së drejtës prindërore- nuk mund të ushtrojnë të drejtën prindërore prindi, të cilit i është hequr zotësia për të vepruar për shkak të sëmundjeve apo paaftësisë fizike për ta ushtruar të drejtën prindërore. Në këtë rast prindi që i është pezulluar e drejta prindërore nuk mund ta ushtrojnë në mënyrë aktive të drejtën prindërore, sepse paraqiten pengesa të llojeve dhe natyrave të ndryshme në mbrojtjen e interesave të fëmijëve. Pezullimi i së drejtës prindërore mund të bëhet për shkak të dy lloj pengesash: *a) pengesat faktike dhe b) pengesat juridike*. Pengesat faktike konsistojnë në faktin se prindërit, për shkak të sëmundjes së rëndë infektive, ose për shkak të vuajtjes së dënimit me burgim, mungojnë për një periudhë të gjatë kohore dhe nuk janë në pozitë që të ushtrojnë drejtëpërdrejtë e në mënyrë të vazhdueshme të drejtat e tyre prindërore. Ndërsa pengesat juridike janë pasojë e heqjes apo kufizimit të zotësisë së veprimit të prindërve.

Kufizimi i së drejtës prindërore- nënkupton faktin se e drejta prindërore mund të kufizohet në qoftë se prindërit, duke u sjellë në mënyrë të pandërgjegjshme, abuzojnë me të drejtat prindërore dhe rrezikojnë personalitetin, të drejtat dhe interesat e fëmijëve. Mund të kufizohen dy llojë të drejtash dhe detyrimesh të prindërve ndaj fëmijëve: *a) të drejtat dhe detyrat personale ndaj personalitetit të fëmijëve dhe b) të drejtat dhe detyrat pasurore ndaj pasurisë së fëmijëve*. Në bazë të dispozitave të LFK-së është në kompetencë të Organit kompetent të Kujdestarisë që të ndërmerret të gjitha masat e nevojshme ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dy llojeve të të drejtave të fëmijëve, si ato me karakter personal edhe ato me karakter pasuror,

ndërsa në disa raste të caktuara edhe gjykata mund të merr vendime për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Heqja e së drejtës prindërore- siç e cekëm edhe më lartë prindërit të cilët e keqpërdorin të drejtat prindërore, ose që në mënyrë serioze e neglizhojnë ushtrimin e të drejtave prindërore, privohen nga kujdesi prindëror (neni 149 parag. 1 i LFK-së). Nga kjo rezulton se me aktvendim gjykata kompetente e privon prindin nga ushtrimi i kujdesit prindëror. Procedura për heqjen e së drejtës prindërore mund të inicohet nga prindi tjetër, organi i kujdestarisë apo gjykata. Prindi mund të privohet nga ushtrimi i së drejtës prindërore vetëm në rastet kur përmbushen kushtet ligjore, ndërsa kujdesi prindëror mund t'i rikthehet prindit kur të pushojnë arsyet ligjore për të cilat prindit i është hequr e drejta prindërore (neni 151 parag. 1 i LFK-së). Më tutje në bazë të nenit 90 të LFK-së, prindit i cili keqpërdor ushtrimin e së drejtës prindërore apo neglizhon rëndë detyrat prindërore, pas marrjes së mendimit të Organit të Kujdestarisë, i hiqet e drejta prindërore në bazë të vendimit gjyqësor, në procedurë jokontestimore. Ligji i procedurës jokontestimore parasheh procedurën që zhvillohet për heqjen e së drejtës prindërore prindit, personat që thirren nga gjykata për të marrë pjesë në këtë procedurë, provat që duhet të administrohen dhe mënyrën e vendosjes së gjykatës (nenet 108, 111 parag. 2 dhe 3, 113 të këtij ligji). Heqja e së drejtës prindërore prodhon pasojë juridike të ndryshme.

Ligji për Familjen i Kosovës, parasheh rastet dhe procedurën që zhvillohet, atëherë kur fëmijëve duhet t'iu vazhdohet e drejta prindërore edhe pas arritjes së moshës madhore, në rastet kur plotësohen kushtet ligjore për një gjë të tillë (neni 152 i LFK-së).

3.6.4 Vendimi i gjykatës për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave prindërore

Ligji për Familjen i Kosovës në nenin 140 përcakton vendimet të cilat i merr gjykata në rastet kur është në pyetje ushtrimi i të drejtave dhe detyrave prindërore. Në këtë drejtim përcaktohet se në rastet kur gjykata kompetente në kontestin martesor e merr aktgjykimin me të cilin zgjidhet apo anulohet martesa, me të njëjtin aktgjykim gjykata do të vendosë për ruajtjen dhe edukimin e fëmijëve të mitur. Nëse prindërit nuk janë marrë vesh për rastin e përmendur më lartë, ose nëse marrëveshja e tyre nuk u përgjigjet interesave të fëmijëve, gjykata pasi të marrë mendimin dhe propozimin e Organit të Kujdestarisë dhe të hetojë të gjitha rrethanat, do të vendosë që të gjithë fëmijët të mbeten për ruajtje dhe edukim te njëri prind, që disa të mbesin te nëna, kurse disa tek babai, ose të gjithë apo disa fëmijë t'i besohen ndonjë personi tjetër. Gjithashtu nëse prindi i cili e ushtron kujdesin prindëror pengon kontaktet personale të fëmijës me prindin tjetër, gjykata me aktgjykim do të rregullojë edhe mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale të fëmijës me prind, i cili nuk e ushtron kujdesin prindëror, nëse vlerësimi i të gjitha rrethanave të rastit tregon se kjo është e domosdoshme për mbrojtjen e fëmijës. Po ashtu gjykata me kërkesën e njërit prind ose të OK, do të ndryshojë vendimin mbi kujdestarinë, nëse për këtë gjë e kërkojnë rrethanat e ndryshuara. Gjithësesi mendimi i fëmijës, i cili është i aftë të jap pikëpamjet e tij, do të merret parasysh nga gjykata në çdo procedurë që i përket atij, ndërsa mendimit të tij do t'i jepet pesha e duhur në pajtim me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.

Në të gjitha procedurat e përmendura më lartë, gjykata duhet të ketë në konsideratë parësore interesin më të mirë të të miturit, i cili gjen zbatim edhe përmes zgjidhjes së shpejtë e pa vonesa të këtyre problemeve, pa zvarritje nga ana e gjykatës. Kjo do të thotë që gjykata duhet të vendosë brenda një afati optimal në rastet e një vendimi mbi arsimimin, përgjegjësinë prindërore, përkujdesjen, kontaktet me prindin, kujdestarinë, masat urgjente që duhen marrë etj. Kjo mund të arrihet përmes një menaxhimi të rastit, jo vetëm profesionalisht, por edhe brenda një kohe sa më të shkurtër. Kohëzgjatja e procedurave gjyqësore, në rastet e konflikteve ose mosmarrëveshjeve familjare, konsiderohet edhe si një shkelje e nenit 8 të Konventës Evropiane

të të Drejtave të Njeriut, sepse respektimi efektiv i jetës familjare kërkon që marrëdhëniet e ardhshme ndërmjet prindërve dhe fëmijës të përcaktohen jo duke kapërcyer afate kohore, që do të çonte në një zgjidhje de facto të çështjes përpara asaj de jure.

3.7 Ushtrime

Gjatë këtij sesioni trajnues pjesëmarrësve do tu prezantohet një shembull praktik, i cili ndërlidhet me temat e përmendura më lartë. Ata do të ndahen në grupe të vogla dhe nga ana e secilit grup (përfaqësuesi i grupit) do të prezantoj mendimin e tyre, në lidhje me rastin praktik.

3.8. Përmbledhje

Në këtë sesion janë dhënë shpjegime dhe keni mundur të mësoni, rreth mënyrave të zgjidhjes së martesës, anulimin i martesës dhe shkurorëzimin, parimet kryesore të procedurës së shkurorëzimit, kompetencën e gjykatës, procedurën gjyqësore, mënyrën e vendosjes dhe mjetet juridike tek shkurorëzimi, si dhe pasojat e shkurorëzimit dhe anulimit të martesës. Gjithashtu janë shtjelluar kuptimi dhe rëndësia e detyrimit për ushqim (alimentacion), karakteristikat e detyrimit për ushqim, llojet e detyrimit për ushqim, kuptimi i së drejtës prindërore, të drejtat dhe detyrat e prindërve ndaj fëmijëve, të drejtat dhe detyrat e fëmijëve ndaj prindërve, ushtrimin, pezullimin, kufizimin dhe heqjen e së drejtës prindërore, si dhe vendimet e gjykatës për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave prindërore.

4. Kundërshtimi dhe vërtetimi i amësisë apo i atësisë

4.1 Hyrje

Në këtë sesion trajnimi do të flitet rreth kuptimit të statusit të fëmijës martesor, kundërshtimit të amësisë, kundërshtimit të atësisë, fëmijëve jashtëmartesor, procedurës së njohjes së amësisë të fëmijëve jashtëmartesor, procedurës së njohjes së atësisë të fëmijëve jashtëmartesor, vërtetimit të amësisë në procedurë gjyqësore, si dhe vërtetimit të atësisë në procedurë gjyqësore. Gjithashtu do të identifikohen dhe analizohen dispozitat ligjore të LFK-së dhe LMDHF-le, lidhur me çështjet e lartëcekura.

4.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të kësaj pjese të modulit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Thellojnë njohurit lidhur me statusin e fëmijës martesor;
- Thellojnë njohurit rreth kundërshtimit të amësisë dhe të atësisë;
- Dallojnë fëmijët jashtëmartesor nga ata martesor;
- Zbatojnë drejtë procedurën e njohjes së amësisë dhe të atësisë së fëmijëve jashtëmartesor;
- Zbatojnë drejtë procedurën gjyqësore të vërtetimit të amësisë dhe të atësisë;
- Identifikojnë dispozitat ligjore të zbatueshme në procedurën e kundërshtimit të amësisë apo të atësisë sipas LFK-së;
- Identifikojnë dispozitat ligjore të zbatueshme rreth dhunës në familje sipas LMDhF-së.

4.3 Statusi i fëmijës martesor

Statusin e fëmijëve e determinojnë marrëdhëniet në mes të prindërve dhe ato në mes të prindërve dhe fëmijëve. Marrëdhëniet në mes të prindërve dhe fëmijëve karakterizohen nga tri elemente themlore: a) elementi natyror, b) elementi shoqëror apo social dhe c) elementi juridik.

Elementi natyror.- Që nga gjeneza e deri më sot, marrëdhëniet në mes të prindërve dhe fëmijëve janë themeluar me lindje në mënyrë natyrore. Pra në momentin e lindjes së fëmijës, krijohet elementi natyror biologjik i marrëdhënies së fëmijëve me prindërit dhe ky element i ka përcjellur subjektet e së drejtës prindërore, përkatësisht prindërit dhe fëmijët, që nga lashtësia.

Elementi shoqëror.- Marrëdhëniet prindërore karakterizohen edhe nga elementi shoqëror, sepse çdo shoqëri rregullon në mënyrën e vet marrëdhëniet e krijuara në mes të prindërve dhe fëmijëve dhe atë që nga lindja e fëmijëve.

Elementi juridik.- Marrëdhëniet në mes të prindërve dhe fëmijëve fitojnë karakter juridik me rregullimin e tyre me norma juridike. Kjo sepse parimet themlore mbi rregullimin e marrëdhënieve të prindërve dhe të fëmijëve, i përmban Kushtetuata e çdo vendi. Me nenin 37 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është e garantuar e drejta e martesës dhe e familjes, kurse me nenin 50 të saj, janë të garantuara të drejtat e fëmijëve.

Subjektet e së drejtës prindërore janë: prindërit dhe fëmijët.

Prindërit janë persona fizik, biologjikisht të aftë për të lindur fëmijë. Nënë e fëmijës konsiderohet gruaja e cila e ka lindur fëmijun, kurse babai i tij, ai prej të cilit është nxënë fëmijë. Sidoqoftë, ky koncept klasik mi subjektet e të drejtës prindërore, me zhvillimin e shkencës dhe të teknologjisë, është duke u sfiduar dhe duke marrë një dimension të ri. Megjithatë, fakti i zënies dhe i lindjes së fëmijës, janë fakte vendimtare mbi të cilat themelohet atësia dhe amësia si lidhje faktike.

Fëmijët konsiderohen të miturit të cilët nuk kanë mbushur 18 vite. Këtë koncept të të miturit e përkrah edhe e drejta e jonë pozitive. Ajo çka i karakterizon fëmijët është pazotësia për të vepruar, e cila në fakt edhe i'a përcakton fëmijut statusin e të miturit sepse derisa të mbush moshën madhore 18 vjet, në krijimin, ndryshimin apo shuarjen e marrëdhënieve juridike, atë e përfaqësojnë prindërit e tij, si përfaqësues ligjor apo organi i kujdestarisë, nëse ai fëmijë gjendet nën kujdestari.

Vërtetimi i statusit martesor të fëmijës. – Që një fëmijë të ketë statusin e fëmijës martesor, në bazë të ligjit, duhet të plotësohen këto kushte:

- që fëmija të ketë prejardhje nga martesë apo marrëdhëniet martesore;
- që gruaja ta ketë lindur fëmijën në martesë (amësia martesore) dhe
- që i ati i fëmijës të jetë burri i nënës që e ka lindur fëmijën (atësia martesore)

- Statusi martesor i fëmijës përcaktohet me dispozita ligjore. Konsiderohet se fëmija ka lindur në martesë, nëse prindërit e tij janë të martuar në kohën e lindjes së fëmijës (neni 100 i LFK-së). Po ashtu konsiderohet fëmijë martesor edhe fëmija që ka lindur brenda 300 ditësh pas zgjidhjes së martesës. Pra në këtë rast relevant paraqitet momenti i nxënies së fëmijës, ngase fakti se a është një fëmijë martesor apo jashtëmartesor, do të varet nga ajo se a ka lindur brenda afatit prej 300 ditësh nga dita e zgjidhjes së martesës apo jo, dhe fëmija i lindur brenda këtij afati, do të konsiderohet fëmijë i lindur në martesë, qoftë edhe nëse martesë është zgjidhur apo anuluar.

- Që fëmija të ketë statusin e fëmijës martesor, është e nevojshme që atë ta ketë lindur gruaja e cila në momentin e lindjes së fëmijës ka qenë në martesë. Për shkak se shtatzëzania dhe lindja e fëmijës janë ngjarjes të dukshme, shumë rrallë ndodh në praktiken gjyqësore që të paraqiten padi për vërtetimin e amësisë. Rastet më të mundshme të këtyre llojeve të padive kanë të bëjnë me vërtetimin e amësisë tek rastet e ndryshme të ndërrimit të foshnjeve të sapolindura në maternitet, apo gabimet e ndryshme të cilat mund të ndodhin me rastin e regjistrimit të të dhënave mbi nënën e fëmijës në librat e gjendjes civile.

- Elementi i tretë i statusit të fëmijës është atësia martesore. Dy janë kushtet më të rëndësishme për vërtetimin e atësisë së fëmijës. Ekzistimi i martesës në momentin e lindjes së fëmijës dhe ekzistimi i martesës në momentin e nxënies së fëmijës. Nga kjo rezulton prezumimi se baba i fëmijës është burri i nënës së fëmijës e cila në momentin e lindjes së fëmijës, apo zënies së tij, ka qenë në lidhje martesore. Kështu sipas rregullës së parë, të gjithë fëmijët e lindur gjatë vazhdimit të martesës janë fëmijë martesor dha kanë baba burrin e nënës që i ka lindur, ndërsa sipas rregullës së dytë, fëmija i cili ka lindur brenda 300 ditësh pas zgjidhjes apo anulimit të martesës gjithashtu është fëmijë martesor dhe supozohet se edhe në këtë rast baba i fëmijës është burri i nënës e cila e ka lindur fëmijën (ish burri në rast të shkurorëzimit, apo vdekjes).

4.4 Kundërshtimi i amësisë

Në praktikën gjyqësore janë të rralla rastet me padi për kundërshtimin e amësisë, sepse janë të pakta rastet kur mbetet e panjohur prejardhja e fëmijës prej nënës, kur e lind atë gruaja martesore. Si rregull, nëna është gjithmonë e njohur, që nga momenti i nxënies, bartjes së shtatëzanisë e deri te lindja e fëmijës. Nëna e fëmijës regjistrohet në librat amë të të lindurve me rastin e regjistrimit të fëmijës së lindur. Megjithatë, jo gjithmonë është i saktë prezumimi se nëna e fëmijës e regjistruar në librat amë të të lindurve, është edhe nëna natyrore e fëmijës. Praktika ka dëshmuar edhe të kundërtën. Të tilla raste ndodhin me rastin e ndërrimit të foshnjave në maternitet, kur bëhen gabime me rastin e regjistrimit të nënës së fëmijës në librat amë të të lindurve pranë gjendjes civile, apo tek rastet e braktisjes së fëmijëve. Këto shkaqe e bëjnë të paqëndrueshëm prezumimin se nëna e regjistruar në librat amë, gjithmonë është edhe nëna e vërtetë. Prandaj qëllimi i kundërshtimit të amësisë është që të vërtetohet se nëna e regjistruar në librat amë të të lindurve, nuk është nëna e vërtetë natyrore e fëmijës. LFK-ja nuk përmban dispozita ligjore të hollësishme lidhur me kundërshtimin e amësisë, por kjo lenë të kuptohet se në mënyrë analoge aplikohen dispozitat ligjore për kundërshtimin e atësisë.

E drejta e padisë për kundërshtimin e amësisë.- Padinë për kundërshtimin e amësisë kanë të drejtë ta paraqesin: gruaja e regjistruar në librat amë të të lindurve si nënë e fëmijës; gruaja e cila veten e konsideron si nënë e fëmijës; dhe fëmija.

Kundërshtimi i amësisë nga gruaja e cila është e regjistruar si nënë e fëmijës në librat amë të të lindurve mund të bëhet brenda afatit 6 muajor nga dita e marrjes në dijeni të faktit se ajo nuk është nëna e fëmijës, e më së voni brenda afatit 7 vjetor nga lindja e fëmijës (neni 118 i LFK-së).

Kundërshtimi i amësisë nga gruaja e cila e konsideron veten nënë të fëmijës, gjithashtu mund të bëhet brenda afatit 6 muajor nga dita e marrjes në dijeni të faktit se ajo është nëna e fëmijës, e më së voni brenda afatit 7 vjetor nga lindja e fëmijës (neni 119 i LFK-së). Në këtë rast mund të thuhet se padia e gruas e cila e kundërshton amësinë e nënës së prezumuar, në të vërtetë përmban dy kërkesëpadi. Me të parën kundërshtohet amësia e nënës së prezumuar, kurse me të dytën kërkohet vërtetimi i amësisë së vetë për fëmijën.

Kundërshtimi i amësisë nga fëmija. Fëmijët kanë të drejtë të ushtrojnë padi për vërtetimin e amësisë kur marrin në dijeni se gruaja e regjistruar në librin amë të të lindurve, si nënë e tyre, në të vërtetë nuk është nëna e tyre. Deri në moshën madhore të tyre, si dhe në rastin kur fëmijës i është hequr aftësia për të vepruar, padinë në emër të fëmijës e paraqet organi i kujdestarisë apo kujdestari në emër të organit të kujdestarisë. E drejta e padisë së fëmijës për kundërshtimin e amësisë nuk parashkruhet (neni 120 i LFK-së).

4.5 Kundërshtimi i atësisë

Përmes kundërshtimit të atësisë, mëtohet të vërtetohet se burri i nënës së fëmijës, nuk është edhe i ati i fëmijës. Atësinë mund ta kundërshtojnë: nëna e fëmijës; fëmija; personi që e konsideron veten për atë të fëmijës jashtëmartesor; dhe burri i nënës së fëmijës.

Kundërshtimi i atësisë nga nëna e fëmijës. – Padia për kundërshtimin e atësisë nga nëna e fëmijës duhet të paraqitet brenda afatit prej 6 muajsh nga dita e lindjes së fëmijës (neni 114 par.2 i LFK-së).

Kundërshtimi i atësisë nga fëmija. – Fëmija mund ta kundërshtojë atësinë e personit i cili në bazë të ligjit konsiderohet si i ati i tij. Kjo sepse askuh më shumë se fëmija nuk është i interesuar që të vërtetohet se kush është i ati i tij natyror. Fëmija mund të paraqesë vetë padinë për kundërshtimin e atësisë. Nëse fëmija është i mitur ose nuk ka aftësi për të vepruar, padinë në emër të tij mund ta paraqet nëna, e nëse nëna nuk është gjallë ose e ka venqendrimin e panjohur, apo të njëjtës i është hequr aftësia për të vepruar, ose i është hequr e drejta prindërore, padinë mund ta paraqet kujdestari me lejen e organit të kujdestarisë. E drejta e fëmijës për të parashtruar padi, nuk parashkruhet (neni 115 i LFK-së).

Kundërshtimi i atësisë nga personi i cili e konsideron veten për baba të fëmijës jashtëmartesor. – Edhe personi që e konsideron veten për baba të fëmijës së lindur jashtë martesës, mund të kërkojë pavlefshmërinë e atësisë së personit tjetër i cili atë fëmijë e ka pranuar të vetin, me kusht që me po atë padi të kërkojë që të vërtetohet atësia e tij. Kjo padi mund të paraqitet brenda afatit prej një viti nga regjistrimi i atësisë së kundërshtuar në regjistrin amë të të lindurëve (neni 116 i LFK-së).

Kundërshtimi i atësisë nga burri i nënës së fëmijës. – Edhe burri i nënës së fëmijës, mund të kundërshtojë atësinë e fëmijës të cilin e ka lindur gruaja e tij gjatë martesës apo para kalimit të 300 ditëve nga dita e zgjidhjes së martesës, nëse konsideron se nuk është i ati i fëmijës. Kjo padi mund të parashtrohet brenda afatit prej 6 muajsh nga dita e marrjes në dijeni të faktit dyshues për atësinë e tije, e më së largu në aftin prej 10 vitesh nga lindja e fëmijës. Nëse burrit të nënës së fëmijës, i është hequr plotësisht aftësia për të vepruar, padinë për kundërshtimin e atësisë e bënë kujdestari i tij me lejen e organit të kujdestarisë.

Duhet cekur se në kontestet lidhur me vërtetimin dhe kundërshtimin e atësisë dhe amësisë zbatohen rregullat e procedurës civile. Në bazë të Ligjit për Gjykatat, kontestet e kësaj natyre janë në kompetencë të Gjykatave Themelore – Departamenteve të Përgjithshme – Divizionit Civil. Për shkaqe të moralit dhe ruajtjes së interesave të fëmijëve, nga shqyrtimi gjyqësor përjashtohet publiciteti. Në procedurën për kundërshtimin e atësisë nuk mund të mirret aktgjykimi në bazë të pohimit, për shkak të mungesës apo të lidhet marrëveshje gjyqësore. Gjykata duhet t'i vërtetojë faktet edhe kur ato nuk janë kontestuese midis palëve. Palë në procedurë janë: burri i nënës së fëmijës, përkatësisht personi i cili e konsideron veten baba të fëmijës jashtëmartesor, nëna e fëmijës dhe fëmija. Në procedurën për kundërshtimin e atësisë merren dhe administrohen prova juridike dhe mjeko ligjore.

Aktgjykimi me të cilin në mënyrë të suksesshme është kundërshtuar atësia, është i karakterit konstitutiv, nga arsyeja se me të ndryshohen marrëdhëniet juridike në mes të palëve. Zyrtari gjendjes civile është i obliguar që t'i bëjë ndryshimet në regjistrin amë të të lindurve, duke qenë se edhe ky aktgjykim sikurse edhe të gjitha aktgjykimet tjera statusore, krijon efekt *erga omnes*, d.m.th. vepron ndaj të gjithëve. Fëmija në këtë rast ndryshon statusin nga fëmija martesor, në atë jashtëmartesor dhe i ati i tij tani nuk dihet. Ai i humb të gjitha të drejtat të cila i kishte ndaj të atit të tij të presupozuar. Vetëm në rastin kur i ati i tij natyror me sukses e kundërshton atësinë e atit të presupozuar dhe njëkohësisht vërtetohet atësia e tij, fëmija do ta ketë të vërtetuar atësinë jashtëmartesore. Ky fëmijë tani barazohet me të afërmit në gjini të atit të vërtetuar dhe në pikëpamje të trashëgimisë, ushqimit të detyruar, mbiemrit etj. Ky aktgjykim vepron *ex tunc*, përkatësisht ka efekt prapaveprues dhe fëmijës i njihet atësia që nga dita e lindjes.

4.6 Fëmijët jashtëmartesor

Fëmijë jashtëmartesor quhet:

- çdo fëmijë jashtëmartesor që e ka lindur gruaja e pamartuar;
- çdo fëmijë që e ka lindur gruaja, dmth gruaja e martuar (apo dhe e ve) pas zgjidhjes së martesës (pas vdekjes së burrit të nënës) dhe pas kalimit të afatit prej 300 ditësh pas ditës së zgjidhjes së martesës, përkatësisht pas vdekjes së burrit të nënës, dhe
- çdo fëmijë që e ka lindur gruaja e martuar gjatë martesës apo shpalljes së saj të pavlefshme, kur atësia e fëmijës është kundërshtuar përmes gjyqit me aktgjykim të formës së prerë, ose brenda afatit prej 300 ditësh pas zgjidhjes së martesës.

Vërtetimi i marrëdhënieve prindërore jashtëmartesore bëhet në dy mënyra: a) me njohjen e amësisë dhe me njohjen e atësisë dhe b) me njohjen e amësisë dhe atësisë me vendim gjyqësor.

Njohja e amësisë. – paraqet një veprim të njëanshëm të një gruaje e cila e shpreh vullnetin e lirë ligjërisht se ajo është nëna e fëmijës së lindur jashtëmartesor. Shumë vende të botës nuk e kanë të rregulluar këtë çështje me dispozita ligjore, veqse për të zbatohen në mënyrë analoge dispozitat ligjore për njohjen e atësisë. Ngjajshëm është edhe me LFK-në, për dallim prej Kodit të Familjes së Shqipërisë, i cili e ka të rregulluar këtë çështje, e ku parashihet se njohja e amësisë mund të bëhet para nëpunësit të gjendjes civile apo me testament.

Njohja e atësisë. – Paraqet gjithashtu një akt të njëanshëm juridik me anë të të cilit mashkulli shpreh në mënyrë valide vullnetin e vet se ai është i ati i fëmijës jashtëmartesor. Për dallim nga njohja e amësisë, njohja e atësisë, është e rregulluar me dispozita të LFK-së. Sipas nenit 102 të LFK-së, atësia mund t'i njihet mashkullit i cili ka aftësi të veprimit dhe i cili ka arritur moshën 16 vjeqare, si dhe personi i cili ka qenë pjesërisht i zhveshur nga aftësia për të vepruar, nëse ai është në gjendje që të kuptojë përmbajtjen e deklaratës për njohjen e atësisë. Procedura e njohjes së atësisë është mjaft e thjeshtë dhe personi i cili e deklaron vetën për atë të fëmijës, këtë pranim mund të bëjë si në vijim:

- duke deklaruar në procesverbal para ofiqarit se e njeh atësinë e fëmijës jashtëmartesor;
- duke deklaruar se e njeh atësinë e fëmijës jashtëmartesor para organit të kujdestarisë; dhe
- me testament (neni 103 i LFK-së).

Ekzistojnë disa kushte për njohjen e atësisë siq janë: lindja gjallë e fëmijës, pëlqimi i nënës së fëmijës, pëlqimi i fëmijës dhe zotësia për të vepruar. Vlen të theksohet se duhet dalluar procedurën e njohjes së atësisë prej procedurës së vërtetimit të atësisë sepse njohja e atësisë mund të bëhet vetëm ndaj fëmijës së gjallë, për dallim prej vërtetimit të atësisë, i cili me vendim të gjykatës mund të bëhet edhe ndaj fëmijës së vdekur (neni 105 i LFK-së).

4.7 Vërtetimi i amësisë në procedurë gjyqësore

Përmes procedurës së vërtetimit të amësisë, me aktgjykim të gjykatës, vendosen marrëdhëniet prindërore në mes të nënës dhe fëmijës jashtë martesës. Ndonëse nga arsyet e cekur më lartë, kjo mund të ndodh shumë rrallë, gjithsesi se procedura e tillë paraqitet të jetë e arsyeshme. Dhe kjo për shkak të ndërrimit të mundshëm të foshnjave në maternitet, gabimeve në ofiqari, apo edhe rasteve të braktisjes së fëmijëve. Megjithatë procedura e vërtetimit të amësisë, nuk është e

rregulluar me dispozitat e LFK-së, por se në rastet e tilla eventuale, gjykata analogjikisht do të duhej t'i zbatonte dispozitat ligjore të parapara për procedurën e vërtetimit të atësisë.

Procedura e vërtetimit të atësisë është shumë më e thjeshtë dhe më e shpejtë se sa procedura e vërtetimit të atësisë. Në këtë procedurë si kriter merret fakti i shatëzanisë dhe ai i lindjes së fëmijës, e gjithashtu mund të merret si kriter edhe ai gjenetik, e kjo duke pasur parasysh zhvillimin shkencor teknologjik. Me organizimin e ri të gjykatave, kompetente për këto lloje të kontesteve paraqitet të jenë Gjykatat Themelore - departamenti i përgjithshëm – divizioni civil.

4.8 Vërtetimi i atësisë në procedurë gjyqësore

Atësia e një fëmije të lindur jashtë martese mund të vërtetohet me aktgjykim të gjykatës, në rast se gjatë gjykimit provohet se në kohën e zënies së fëmijës, i ati bashkëjetonte me të ëmën e fëmijës, ose se me të njëjtën ka kryer marrëdhënie seksuale me apo pa dhunë, ose se i ka premtuar martesë, ose nga një gjykim penal apo civil, rezulton në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi atësia e fëmijës së lindur jashtë martese, si dhe kur dihet publikisht se ai e ka njohur fëmijën si të vetin. Kjo mund të ndodh vetëm pasi të ketë lindur fëmija. Të drejtën për të paraqitur padi për vërtetimin e atësisë e kanë: nëna e fëmijës, fëmiju, personi i cili e konsideron veten si baba të fëmijës si dhe organi i kujdestarisë (neni 110 i LFK-së).

E drejta e paraqitjes së padisë për vërtetimin e atësisë nga nëna. – Nëna e fëmijës ka të drejtë që në mënyrë të pavaruar, në emrin e saj apo edhe në emër të fëmijës të paraqes padinë për vërtetimin e atësisë së një fëmije të lindur jashtë martese. Ligji nuk e ka përkufizuar afatin për paraqitjen e kësaj padie, përderisa nëna e ushtron të drejtën prindërore. Në padi në cilësi të të paditurëve ajo duhet ta përfshijë fëmijën si dhe personin i cili pretendon se është i ati i fëmijës.

Organi i kujdestarisë mund ta paraqet padinë për vërtetimin e atësisë në rastet kur nëna e fëmijës, me rastin e paraqitjes së lindjes së fëmijës, e ka shënuar emrin e personit të cilin ajo e konsideron se është i ati i fëmijës dhe në ndërkohë nuk e ka ushtruar padinë për vërtetimin e atësisë duke i neglizhuar interesat e fëmijës.

Edhe fëmija mund ta paraqet padinë për vërtetimin e atësisë. Derisa ai është i mitur, atë e përfaqëson e ëma e tij, apo organi i kujdestarisë. Këtë padi, fëmija mund ta paraqet në çdo kohë.

Përfundimisht, paraqitja e padisë për vërtetimin e të drejtës së pronësisë i njihet edhe personit i cili veten e konsideron si i ati i fëmijës së lindur jashtëmartesor. Këtij personi ligji i'a njeh të drejtën e padisë vetëm në rastet kur atij i është pamundësuar njohja e atësisë jashtë martese, e jo edhe atëherë kur ai nuk ka qenë i gatshëm për ta pranuar fëmijën për të vetin. Pra kjo vjen në shprehje kur nëna e fëmijës, fëmija apo edhe organi i kujdestarisë, në kundërshtim me dispozitat ligjore, atij nuk ia kanë dhënë përqlimin për njohjen e atësisë dhe për sa kohë që atë fëmijë e ka njohur për të vetin një mashkull tjetër. Aktgjykimi mbi vërtetimin e atësisë, ka efekt *erga omnes* sepse vepron ndaj të gjithëve dhe të gjithë janë të detyruar që ta respektojnë atë. Në këtë rast fëmija vendoset në familjen e të atit dhe ai ka të drejtë të lerë mbiemrin e nënës, apo ta marri mbiemrin e të atit.

4.9 Ushtrime

Gjatë këtij sesioni trajnues pjesëmarrësve do tu prezantohet nga një shembull praktik, i cili ndërlihet me temat e shtjelluara më lartë. Ata do të ndahen në grupe të vogla dhe nga ana e secilit grup (përfaqësuesi i grupit) do të prezantojë mendimin e tyre, në lidhje me rastin praktik.

4.10 Përmbledhje

Në këtë sesion janë dhënë shpjegime dhe keni mundur të mësoni, rreth kuptimit të statusit të fëmijës martesor, kundërshtimit të amësisë, kundërshtimit të atësisë, fëmijëve jashtëmartesor, procedurës së njohjes së amësisë të fëmijëve jashtëmartesor, procedurës së njohjes së atësisë të fëmijëve jashtëmartesor, vërtetimit të amësisë në procedurë gjyqësore, si dhe vërtetimit të atësisë në procedurë gjyqësore. Gjithashtu janë analizuar dispozitat ligjore të LFK-së dhe LMDHF-së lidhur me çështjet e lartcekura.

5. Birësimi, marrëdhëniet pasurore në mes bashkëshortëve

5.1 Hyrje

Në këtë sesion trajnimi do të flitet rreth kuptimit dhe rëndësisë së birësimit, llojet e birësimit, themelimit të birësimit dhe shuarjes së besimit, kuptimit dhe rëndësisë së marrëdhënieve pasurore në mes të bashkëshortëve, regjimit pasuror të bashkëshortëve, si dhe pjesëtimit të pasurisë së përbashkët. Gjithashtu do të identifikohen dhe analizohen dispozitat ligjore të LFK-së, lidhur me çështjet e lartcekura.

5.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij sesioni, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zgjerojnë njohurit rreth rëndësisë, mënyrën e themelimit, mënyrën e shuarjes së birësimit
- Dallojnë llojet e birësimit;
- Identifikojnë dispozitat ligjore të zbatueshme në procedurën e birësimit sipas LFK-së;
- Vlerësojnë rëndësinë e marrëdhënieve pasurore në mes të bashkëshortëve;
- Dallojnë regjimet pasurore të bashkëshortëve;
- Thellojnë njohurit lidhur me mënyrën e pjesëtimit të pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve;
- Identifikojnë dispozitat ligjore të zbatueshme rreth marrëdhënieve pasurore në mes të bashkëshortëve sipas LFK-së;

5.3 Kuptimi dhe rëndësia e birësimit

Birësimi është institucion i vjetër juridik dhe shoqëror. Mund të thuhet se kanë qenë dy qëllime kryesore të birësimit. Njëri ka qenë mbrojtja e pasurisë së qytetarëve të pasur, kurse qëllimi tjetër ka qenë ruajtja e vazhdimësisë së familjes, traditës dhe kultit të familjeve të qytetarëve pa fëmijë.

Vlen të theksohet se përkundër qëllimeve të lartcekura, disa vende të botës asnjëherë nuk e kanë njohur institutin e birësimit, madje të njëjtin edhe e kanë ndaluar me norma ligjore.

5.4 Llojet e birësimit

Duke pasur parasysh efektet juridike të cilat i shkakton birësimi, si dhe shkallën e integritetit të të birësuarit në familjen e birësuesit, teoria shkencore juridike njeh dy lloje të birësimit: a) birësimi i plotë dhe b) birësimi jo i plotë.

Birësimi i plotë (adoptoi plena). – Themelohet kur në mes të birësuesit dhe të birësuarit vendosen marrëdhënie të njëjta sikurse mes prindërve natyrore dhe fëmijëve, por edhe me persona të tjerë siç janë ata të gjinisë së gjakut. Birësimi në mes të palës birësuese dhe të birësuarit themelon të njëjtat të drejta dhe detyrime sikurse ato që ekzistojnë në mes të prindërve dhe fëmijëve. Birësuesi regjistrohet si prind i të birësuarit (neni 190 i LFK-së) në regjistrin amë të të lindurëve. Kjo nënkupton se i birësuarit i shkëput lidhjet me familjen e tij të origjinës. Ai futet në familjen e birësuarit me të drejta dhe detyrime sikurse të kishte lindur prej birësuesit. Me birësim të plotë fëmija i humb të gjitha të drejtat dhe detyrimet ndaj të afërmeve të tij biologjik. Mirëpo në të njëjtën kohë këto të drejta dhe detyrime i fiton në raport me birësuesin dhe të afërmit e tij biologjik. Ky lloj i birësimit është i pashkëputshëm.

Birësimi jo i plotë (adoptoi semi plena). – Kuptohet vendosja e marrëdhënieve prindërore vetëm në mes të birësuesit dhe fëmijës që birësohet si dhe pasardhësve eventual të fëmijës që birësohet, ndërkohë që janë të mundshme kufizimet në pikëpamje të të drejtave përkitatzi me mbiemrin dhe të drejtën trashëgimore. Tek ky lloj i birësimit, fëmija i birësuar edhe më tej mbetet anëtar i familjes së tij biologjike. Në fakt ai gëzon edhe më tej të drejtën trashëgimore dhe të mbajtjes ndaj prindërve të vet biologjik. Ky lloj i birësimit është i shkëputshim dhe pas shkëputjes eventuale të tij, i birësuarit u kthehet prindërve të tij biologjikë.

Kush mund të jetë i birësuar . - Që një person të jetë i birësuar, duhet t'i plotësoj disa kushte: a) të jetë i lindur gjallë; b) të jetë fëmijë i mitur; c) të mos jetë në gjini gjaku me të birësuarin dhe ç) fëmija që ka mbushur moshën 14 vjeq duhet ta jep pëlqimin se a dëshron të birësohet apo jo.

Kush mund të jetë birësues. – Birësuesi duhet t'i plotësoj këo kushte: a) të ketë zotësinë për të vepruar, b) të ketë cilësit e nevojshme personale për ushtrimin e suksesshëm të të drejtave dhe detyrimeve prindërore; c) të mos vuaj nga ndonjë sëmundje ngjithëse që do ta rrezikonte shëndetin e fëmijës; ç) të ketë së paku 21 vite, d) të jetë qytatar i Kosovës.

Fëmijën e mitur mund ta birësojnë edhe bashkëshortët. Kur ata e birësojnë fëmijën e mitur, njëri prej bashkëshortëve duhet ta ketë moshën 25 vjeqare, kurse tjetri moshën 21 vjeqare (neni 178 i LFK-së). Nëse fëmijën e birëson vetë njëri bashkëshort, kërkohet edhe pëlqimi i bashkëshortit tjetër.

5.5 Themelimi i birësimit

Themelimi i birësimit është akt juridik. Procedura e birësimit është në kompetencë të gjykatës dhe atë Gjykatave Themelore në procedurë jashtëkontestimore, për dallim nga ligji i mëparshëm për Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare, në bazë të të cilit birësimi themelohej përpara Organit të Kujdestarisë. Gjykata mund të kërkoj këshilla nga Organi i Kujdestarisë gjatë marrjes së vendimit mbi adoptim.

Birësimi si rregull nuk do të themelohet derisa birësuesi të kujdeset për të birësuarin për një kohë të arsyeshme të përcaktuar nga gjykata, por që nuk kalon periudhën tre muajshe. Kjo periudhë do të iniciohet, mbikëqyret dhe vlerësohet nga organi i kujdestarisë. Në procedurën e birësimit përjashtohet publiku. Procesverbali dhe dokumentet e themelimit të birësimit paraqesin sekret zyrtar. Procedura e birësimit fillon me kërkesën për birësim të birësuesit. Kompetenca territoriale caktohet sipas vendbanimit të fundit të parashtruesve të kërkesës për adoptim, si dhe në bazë të vendbanimit të të adoptuarit. Nëse gjykata në bazë të provave të siguruar dhe të bashkëngjitura si dhe çmuarjes së të gjitha rrethanave të tjera, konstaton se adoptimi nuk është i dobishëm për të adoptuarin, ajo do të marrë aktvendimin për refuzimin e kërkesës për birësim. Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së aktvendimit. Nëse gjykata konstaton se janë plotësuar kushtet për birësim të parapara me LFK, ajo do të hemelojë birësimin.

Për themelimin e birësimit nevojitet prania e birësuesit, e bashkëshortit të tij, e prindërve, përkatësisht e kujdestarit të të birësuarit, si dhe prania e të birësuarit nëse është mbi moshën 10 vjeqare. Deklarata e pëlqimit të pjesëmarrësve duhet të shënohet në procesverbalin e procedurës, i cili pastaj do tu lexohet pjesëmarrësve. Gjykata kompetente, i'a dërgon menjëherë procesverbalin e themelimit të birësimit organit kompetent për regjistrim në librat amë të të lindurëve, palës dhe organit të kujdestarisë. Në këtë rast pala birësuese regjistrohet si prindi i të birësuarit dhe fëmija e merr mbiemrin e personit birësues sikur të ishte mbiemri i tij. Është me

rëndësi të ceket se nuk mund të zhvillohet procedurë e vërtetimit të amësisë apo të atësisë së fëmijës së birësuar.

Nuk mund të ketë themelim të birësimit pas vdekjes së fëmijës.

5.6 Shuarja e birësimit

Me nenin 195 të LFK-së, është e paraparë se birësimi mund të shuhet vetëm në bazë të rregullave të parapara me këtë ligj, përkatësisht me dispozitat nga neni 196-200 të këtij ligji. Nga kjo del se kemi disa lloje të shuarjeve të birësimit, siç janë: a) shuarja me anulim; b) shurja e birësimit për shkak të keqësimit të mirëqenies së fëmijës; dhe c) shuarja e birësimit ex officio nga gjykata.

Shuarja me anulim (neni 196 i LFK-së). – Gjykata mund të anulojë marrëdhënien e birësimit në bazë të kërkesës, nëse kjo marrëdhënie ka qenë e themeluar pa kërkesë të birësuesit, pa pëlqimin e fëmijës ose të prindit. Padia për anulim mund të paraqitet brenda afatit prej 6 muajsh nga dita që është marrë në dijeni shkaku i anulimit, e më së voni brenda një viti nga dita e themelimit të birësimit.

Shuarja e birësimit për shkak të keqësimit të mirëqenies së fëmijës. – Përjashtimisht birësimi mund të shuhet edhe kur keqësohet mirëqenia e fëmijës, por vetëm nëse këtë e kërkojnë interesat themelore të fëmijës, ngase në të kundërtën nuk do të lejohet shuarja e marrëdhënies së birësimit. (neni 197 i LFK).

Shuarja e birësimit ex officio nga gjykata. – Kjo situatë mund të ndodh në rastet kur pavarësisht faktit se në procedurën e themelimit të birësimit kanë qenë të respektuara të gjitha procedurat dhe kushtet e kërkuara me ligj, gjykata vlerëson se vazhdimi i marrëdhënies së birësimit do të ishte i dëmshëm për fëmijën dhe mirëqenien e tij. Me nenin 198 të LFK-së, janë të parapara edhe shkaqet e shuarjes ex officio.

Përndryshe shuarja e birësimit ka efekt vetëm për të ardhmen. Me rastin e shuarjes së birësimit, fëmija e humb të drejtën që të bartë edhe ma tutje mbiemrin e birësuesit, përpos nëse gjykata vendos se është në interesin e fëmijës që të vazhdojë ta mbajë këtë mbiemër. Po ashtu marrëdhënia e të birësuarit dhe pasardhësve të tij eventual, me të afërmit e birësuesit ndërpritet së bashku me të drejtat dhe detyrat e krijuara.

5.7 Kuptimi i marrëdhënieve pasurore në mes të bashkëshortëve

Marrëdhëniet pasurore në mes të bashkëshortëve rregullohen me dispozita ligjore të LFK-së. Për marrëdhëniet pasurore të cilat drejpërdrejtë janë të lidhura me martesën, bashkësinë jashtëmartesore dhe marrëdhëniet reciproke midis personave në gjini, nuk zbatohen në tërësi rregullat e përgjithshme të së drejtës pasurore civile. Përjashtimi i zbatimit të disa rregullave të institucioneve të njohura të së drejtës civile, si të pronësisë, kontratës, kompensimit të dëmit etj, para se gjithash është pasojë e disa specifikave të veçanta që i karakterizojnë marrëdhëniet pasurore martesore dhe jashtëmartesore. Kjo ngase lidhja që krijohet dhe që ekziston në mes të bashkëshortëve në krijimin e pasurisë, marrëdhënieve pasurore u jep specifika të veçanta të cilat sa u përket krijimit të së drejtës së pronësisë, nuk mund të hasen në raportet në mes të personave të tretë.

5.8 Regjimi pasuror i bashkëshortëve

Tërësia e normave juridike me të cilat rregullohen marrëdhëniet pasurore të çiftit bashkëshortor quhet regjim pasuror martesor. Në të drejtën krahasimore ekzistojnë disa regjime pasurore: a) regjimi i pasurisë së veçantë; b) regjimi i pasurisë së përbashkët dhe c) regjimi i përzier.

- Me regjimin e pasurisë së veçantë duhet të kuptojmë ato norma juridike të cilat çështjen e pasurisë e rregullojnë të veqar nga martesë. Në këtë rast titullari i së drejtës së pasurisë së veçantë, posedon dhe qeverisë pronësinë e tij në mënyrë krejtësisht të pavarur nga bashkëshorti. Pasurinë e veçantë titullari i saj nuk e ka fituar me punë gjatë jetës bashkëshortore.

- Ndryshe është situata me kur është fjala me pronësi të përbashkët. Në këtë rast bashkëshortët janë titullarë të përbashkët të së drejtës së pronësisë së përbashkët. Kjo pasuri fitohet me punë të përbashkët gjatë martesës.

- Regjimi i përzier përfshin elemente të regjimit të pasurisë së veçantë, por edhe të pasurisë së përbashkët. Por jo vetëm kaq. Me rregullativën ligjore të disa vendeve, bashkëshortët me kontratë mund të zgjidhin njërin prej regjimeve pasurore martesore, e nëse këtë çështje nuk e rregullojnë me kontratë, atëherë aplikohet regjimi ligjor. Sipas profesor Hamdi Podvorica, LFK-ja, legjitimon dy regjime pasurore: regjimin ligjor dhe atë kontraktues. Në LFK, marrëdhëniet pasurore në mes të bashkëshortëve rregullohen me nenet 45-57 të tij.

Pasuria e veçantë. – Pasuria e cila i ka takuar bashkëshortit në çastin e lidhjes së martesës do të mbetet pasuri e veçantë e tij. E këtij lloji është edhe pasuria e fituar gjatë kohëzgjatjes së martesës, përmes trashëgimit, dhurimit, apo ndonjë forme tjetër ligjore të fitimit të pasurisë. Secili bashkëshort në mënyrë të pavarur e administron dhe e posedon pasurinë e vetë të veçantë gjatë gjithë kohës së martesës (neni 46 i LFK-së).

Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve. – Pasuri e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e fituar me punë gjatë vazhdimit të martesës, si dhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë (neni 47 i LFK-së). Për ekzistimin e këtij lloji të pasurisë duhet që në mënyrë kumulative të plotësohen dy kushte: 1) ekzistimi i martesës dhe 2) puna e bashkëshortëve martesor.

Pasurinë e përbashkët bashkëshortore gjatë martesës bashkëshortët e administrojnë dhe e disponojnë bashkërisht me marrëveshje.

Të drejtat e bashkëshortëve për sendet e paluajtëshme, të cilat janë pasuri e tyre e përbashkët, regjistrohen në regjistrin publik të pasurive të paluajtëshme në emër të të dy bashkëshortëve, si pasuri e përbashkët në pjesë të papërcaktuara. Kur vetëm njëri prej bashkëshortëve regjistrohet si bartës i së drejtës pronësore për pasurinë e përbashkët në regjistrin e të drejtave në pasuri të patundshme, do të konsiderohet se regjistrimi është bërë në emër të dy bashkëshortëve. Pasuria nuk mund të tjetërsohet pa pëlqimin e të dy bashkëshortëve. Në rastet kur që të dy bashkëshortët janë të regjistruar në Regjistrin publik të paluajtshmërive si pronarë të përbashkët në pjesë të caktuara, konsiderohet se ata në këtë mënyrë e kanë bërë pjesëtimin e pasurisë së përbashkët.

5.9 Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët

Pjesëtimi i pasurisë së përbashkët mund të bëhet si gjatë jetës së përbashkët martesore, ashtu edhe pas mbarimit të saj (neni 56 i LFK-së). Të drejtën që ta kërkojnë pjesëtimin e pasurisë së përbashkët e kanë: bashkëshortët, trashëgimtarët e bashkëshortit të vdekur ose atij të shpallur të vdekur, si dhe kreditori i njërit prej bashkëshortëve, nëse kërkesa e kreditorit nuk mund të

realizohet nga pasuria e pjesëtuar e atij bashkëshorti. Ky pjesëtim mund të bëhet me marrëveshjen e palëve, e në rast të pamundësisë së marrëveshjes, atëherë pjesëtimi mund të bëhet edhe përmes gjykatës dhe në këtë rast do të mirret parasysh kontributi i secilit bashkëshortë, ndihma e ofruar ndaj bashkëshortit tjetër, kujdesi ndaj fëmijëve, udhëheqja e punëve të shtëpisë, si dhe çfarëdo formë tjetër e punës dhe e bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët.

Vlen të ceket se pasuria e fituar përmes punës së përnashkët të burrit dhe të gruas në marrëdhëniet jashtëmartesore, konsiderohet pasuri e tyre e përbashkët dhe dispozitat e LFK-së që kanë të bëjnë me ndarjen e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve të një martese ligjrisht të regjistruar, në mënyrë analoge zbatohen edhe për marrëdhëniet pasurore të personave në bashkësi faktike (bashkësi jashtëmartesore)

5.10 Ushtrime

Gjatë këtij sesioni trajnues pjesëmarrësve do tu prezantohet nga një shembull praktik, i cili ndërlidhet me temat e shtjelluara më lartë. Ata do të ndahen në grupe të vogla dhe nga ana e secilit grup (përfaqësuesi i grupit) do të prezantojë mendimin e tyre, në lidhje me rastin praktik.

5.11 Përmbledhje

Në këtë sesion janë dhënë shpjegime dhe keni mundur të mësoni, rreth kuptimit dhe rëndësisë së birësimit, llojet e birësimit, themelimi i birësimit dhe shuarja e besimit. Ndërsa në pjesën e fundit të këtij prezantimit është shtjelluar, kuptimi dhe rëndësia e marrëdhënieve pasurore në mes të bashkëshortëve, regjimi pasuror i bashkëshortëve, si dhe pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të tyre. Gjithashtu janë analizuar dispozitat ligjore të LFK-së lidhur me çështjet e lartcekura.

6. Dhuna në familje

6.1 Hyrje

Në këtë sesion trajnimi do të flitet rreth kuptimit dhe përkufizimit të dhunës në familje, masave mbrojtëse kundër dhunës në familje, si dhe mbrojtjes gjyqësore në kontestet që kanë të bëjnë me dhunën në familje. Gjithashtu do të identifikohen dhe analizohen dispozitat ligjore të LFK-së dhe LMDHF-le, lidhur me çështjet e lartcekura.

6.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij sesioni, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Dallojnë masat mbrojtëse kundër dhunës në familje;
- Njohin mbrojtjen gjyqësore në kontestet që kanë të bëjnë me dhunën në familje;
- Identifikojnë dispozitat ligjore të zbatueshme rreth dhunës në familje sipas LMDHF-së.

6.3 Përkufizimi i dhunës në familje

Çështja e parandalimit të dhunës në familje në të gjitha format e saj, është e rregulluar me Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje nr.03/L-182, i cili ka hyrë në fuqi në muajin Gusht të vitit 2010, duke e shfuqizuar Rregulloren e UNMIK-ut nr.2003/12, për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje. Ky ligj po ashtu ka për qëllim edhe trajtimin e kryerësve të dhunës në familje dhe lehtësimin e pasojave. Në bazë të këtij ligji dhunë në familje, paraqet një apo më shumë vepra apo lëshime të qëllimshme që i bën një person personit tjetër me të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare si këto, por nuk kufizohet në:

- përdorimin e forcës fizike ose presionin psikik të ushtruar ndaj anëtarit tjetër të familjes
- çdo veprim tjetër i një anëtari të familjes që mund të shkaktojë apo kanos se do të shkaktojë dhembje fizike dhe vuajtje psikike;
- shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale apo cenimin e dinjitetit;
- sulmi fizik pa marrë parasysh pasojat;
- ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë;
- përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përlules së personit tjetër;
- marrëdhënia seksuale pa pëlqim dhe keqtrajtimi seksual;
- kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes ndaj personit tjetër;
- dëmtimi apo shkatërrimi i pasurisë dhe kanosja që ta bëjë këtë;
- vënia e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike;
- hyrja apo largimi me dhunë nga banesa e përbashkët apo banesën e personit tjetër;
- rrëmbimi.

Pala e mbrojtur nënkupton personin ndaj të cilit është ushtruar dhuna në familje dhe vartësit në dobi të të cilit është kërkuar urdhëri për mbrojtje, urdhëri për mbrojtje emergjente ose urdhëri për mbrojtjen e përkohshme emergjente.

Kryerësi i dhunës në familje nënkupton personin i cili ka kryer një apo më tepër vepra të dhunës në familje, kundër të cilit kërkohet urdhëri për mbrojtje, urdhëri për mbrojtje emergjente, ose urdhëri për mbrojtjen e përkohshme emergjente.

Viktima, nënkupton personin i cili i është nënshtruar dhunës në familje.

Urdhëri për mbrojtje paraqet urdhërin të lëshuar me vendim gjykatë (aktvendim), kur parshihen masat mbrojtëse për viktimën.

Urdhëri për mbrojtje emergjente nënkupton urdhërin e lëshuar përkohësisht me vendim gjykatë, dhe

Urdhëri për mbrojtje të përkohshme emergjente nënkupton urdhërin e lëshuar jashtë orarit të punës së gjykatave.

6.4 Masat mbrojtëse kundër dhunës në familje

Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje ka paraparë një mori masash mbrojtëse kundër dhunës në familje, siç janë: masat mbrojtëse të trajtimit psikosocial, masat mbrojtëse të ndalimit të afrimit të viktimës së dhunës në familje, masa mbrojtëse e ndalimit të shqetësimit të personave të ekspozuar dhunës, masa mbrojtëse e largimit nga banesa, shtëpia apo hapësira tjetër e banimit, masa mbrojtëse e shoqërimit të viktimës së dhunës, masa mbrojtëse e trajtimit mjekësor nga varësia prej alkoolit dhe substancave psikotropike, masa mbrojtëse e marrjes së sendit dhe masat mbrojtëse pasurore.

6.5 Mbrojtja gjyqësore kundër dhunës në familje

Me ligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje është e paraparë se kompetente për të vendosur në rastet e tilla, përkatësisht për të shqiptuar masat mbrojtëse, është Gjykata Komunale, respektivisht me organizimin e ri të gjykatave, Gjykata Themelore, në territorin e të cilës parashtruesi i kërkesës e ka vendbanimin apo vendqëndrimin. Me ligj është e paraparë se Gjykata me urdhërmbrojtje apo me urdhërmbrojtje emergjente mund të shqiptojë një apo me tepër masa mbrojtëse.

Organ kompetent për ekzekutimin e masave mbrojtëse është Policia e Kosovës.

Kërkesa për urdhërmbrojtje ose urdhërmbrojtje emergjente paraqitet me shkrim ose gojarisht para gjykatës dhe e njëjta duhet të përfshijë: emërtimin e gjykatës; emrin, adresën dhe profesionin e kërkuarit dhe të kryesit të dhunës në familje; emrin dhe adresën e palës së mbrojtur dhe të personit i cili ka kërkuar mbrojtjen për palën ndaj të cilës është ushtruar dhuna, si dhe lidhja familjare e palës me personin i cili ka shkatuar dhunë në familje; përshkrimi në hollësi i gjendjes faktike dhe kur është e mundur bashkangjitja edhe e provave, si dhe arsyeja për shqiptimin e urdhërit mbrojtës ose të urdhërit për mbrojtje emergjente; dhe propozimin e masës mbrojtëse.

Gjykata kompetente vendosë përkitazi me kërkesën për urdhërmbrojtje brenda 15 ditëve pas pranimit të saj, ndërsa për kërkesën për urdhërmbrojtje emergjente brenda afatit prej 24 orëve pas parashtrimit të kërkesës.

Në procedurën e lëshimit të urdhërmbrojtjes apo të urdhërmbrojtjes emergjente, përshtatshëmrisht zbatohen rregullat e procedurës civile kontestimore. Kështu dëgjimi dhe

shqiptimi bëhet në mungesë të kryerësit të dhunës në familje nëse kryerësi i dhunës në familje është thirrur në mënyrë të rregullt dhe nëse kërkesa është mbështetur në dëshmi të mjaftueshme. Kërkesa mund të konsiderohet si e tërhequr nëse në seancën e dëgjimit nuk paraqiten as pala e mbrojtur e as përfaqësuesi i autorizuar i palës së mbrojtur dhe nëse këta individë janë thirr në mënyrë të rregullt, ndërsa që mungesën e tyre nuk e kanë arsyetuar. Tërheqja e kërkesës nuk e parandalon paraqitjen e kërkesës tjetër.

Kundër vendimit të urdhërit për mbrojtje, mund të ushtrohet ankesë, brenda afatit 8 ditor nga dita e dorëzimit të vendimit. Kundër vendimit të urdhërit për mbrojtje emergjente, pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në afatin prej 3 ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit. Parashtrimi i ankesës nuk e ndalon ekzekutimin e urdhërit mbrojtës apo urdhërit për mbrojtje emergjente.

Kush e shkel në tërësi ose pjesërisht urdhërin për mbrojtje, urdhërin për mbrojtje emergjente ose urdhërin për mbrojtje të përkohshme emergjente, kryen veprë penale që dënohet me gjobë prej 200 euro e deri më 2000 euro, ose me burgim deri në gjashtë muaj. Përsëritja e vazhdueshme e shkeljes konsiderohet rrethanë rënduese për kryerësin. Shkelja e urdhërit për mbrojtje, e urdhërit për mbrojtje emergjente ose e urdhërit për mbrojtje të përkohshme emergjente do të ndiqet ex officio. Shqiptimi i urdhërit për mbrojtje dhe urdhërit për mbrojtje emergjente me vendim gjyqësor, nuk i ndalon palët e interesuara të nisin procedurë penale, për sa i përket veprimeve ose mosveprimeve që përbëjnë veprat penale.

6.6 Ushtrime

Gjatë këtij sesioni trajnues pjesëmarrësve do tu prezantohet nga një shembull praktik, i cili ndërlidhet me temat e shtjelluara më lartë. Ata do të ndahen në grupe të vogla dhe nga ana e secilit grup (përfaqësuesi i grupit) do të prezantoj mendimin e tyre, në lidhje me rastin praktik.

6.7 Përmbledhje

Në këtë sesion janë dhënë shpjegime dhe keni mundur të mësoni, rreth kuptimit dhe përkufizimit të dhunës në familje, masat mbrojtëse kundër dhunës në familje, si dhe procedura e mbrojtjes gjyqësore në kontestet që kanë të bëjnë me dhunën në familje. Gjithashtu janë analizuar dispozitat ligjore të LFK-së dhe LMDhF-së lidhur me çështjet e lartcekura.

VIII. E drejta trashëgimisë

Zenel Leku
Gjyqtar në Gjykatën e Apelit

Tabela e përmbajtjes – “E drejta e trashëgimisë”

Hyrja.....	378
Objektivat trajnuese	379
Metodat e të shpjeguarit.....	379
Mjetet e nevojshme.....	380
Pritjet nga pjesëmarrësit	380
Burimet.....	380
Përmbledhje	381
1. Trashëgimia në bazë të ligjit, pjesa e domosdoshme dhe trashëgimtarët e domosdoshme dhe transaksionet ndërmjet të gjallëve	382
1.1 Hyrje	382
1.2 Objektivat trajnuese	382
1.3 Objekti i trashëgimisë	382
1.4 Veçimi i sendeve nga pasuria trashëgimore.....	382
1.5 Caktimi i vlerës së pasurisë trashëgimore	383
1.6 Parimet themelore të se drejtës trashëgimore	383
1.7 Trashëgimia në bazë të ligjit	384
1.7.1 Radhët e trashëgimisë.....	384
1.7.2 Radha e parë e trashëgimisë	384
1.7.3 Zëvendësimi (përfaqësimi) në trashëgimin ligjore	385
1.7.4 E drejta e shtimit.....	385
1.7.5 Radha e dytë e trashëgimisë	386
1.7.6 Radha e tretë e trashëgimisë	386
1.7.7 Komuna si trashëgimtar ligjor	386
1.7.8 E drejta e trashëgimit të adoptuarit dhe adoptuesit.....	386
1.7.9 Të drejta e bashkëshortit.....	386
1.7.10 E drejta e trashëgimit të bashkëshortit jashtëmartesorë	387
1.8 Pjesa e domosdoshme dhe trashëgimtarët e domosdoshëm.	387
1.8.1 Pjesa e domosdoshme.....	387
1.8.2 Trashëgimtarët e domosdoshëm	388
1.8.3 Llogaritja e pjesës së domosdoshme	388
1.8.4 Inventarizimi i pasurisë trashëgimore.....	388
1.8.5 Regjistrimi i kërkesave të trashëgimlënësit ndaj personave të tretë apo trashëgimtarëve ...	389
1.8.6 Regjistrimi i disponimeve të trashëgimlënësit me kontratë apo me testament	389
1.8.7 Regjistrimi i borxheve që trashëgimlënësi ua ka personave të tretë.	389
1.8.8 Pasuria që veçohet nga pasuria trashëgimore.....	389
1.8.9 Veçimi i sendeve të shtëpisë	389
1.9 Zvogëlimi i disponimit me testament dhe kthimi i dhurimit për shkak të cenimit të pjesës së domosdoshme.	390
1.9.1 Cenimi i pjesës së domosdoshme.....	390
1.9.2 Radha e zvogëlimit dhe e kthimit.....	390
1.9.3 Zvogëlimi proporcional i disponimeve me testament	390
1.9.4 Zvogëlimi i legut të privilegjuar	391
1.9.5 Zvogëlimi proporcional i legeve	391
1.9.6 Radha e kthimit të dhurimeve	391
1.9.8 E drejta e kërkesë për zvogëlimin e disponimeve me testament dhe kthimin e dhurimeve.	391
1.9.9 Afati ligjor për ushtrimin e kërkesës.....	391
1.10 Llogaritja e dhurimeve dhe legëve në pjesën trashëgimore	392

1.10.1 Llogaritja e dhurimeve.....	392
1.10.2 Si bëhet llogaritja e dhuratave dhe legeve në pjesën trashëgimore	392
1.10.3 E drejta e trashëgimitarit të cilit nuk i llogaritet dhurimi ose legu.....	392
1.10.4 Llogaritja e borxhit të trashëgimitarit ndaj trashëgimlënësit	392
1.11 Transaksionet ndërmjet të gjallëve (intervivos)	392
1.11.1 Cedimi dhe ndarja e pasurisë në përgjithësi	392
1.11.2 Kushtet për vlefshmërinë e cedimit dhe pjesëtimit	393
1.11.3 Objekti cedimit dhe pjesëtimit dhe përjashtimi i pasurisë së ceduar nga pasuria trashëgimore.....	393
1.11.4 Kur konsiderohet pjesa e ceduar si dhurim.....	393
1.11.5 Shuarja kontratës mbi cedimin dhe pjesëtimin e pasurisë	393
1.11.6 Të drejtat e trashëgimtarëve pas shuarjes së kontratës	394
1.12 Ushtrime.....	394
1.13 Përmbledhje.....	394

2. Trashëgimia në bazë të testamentit, Padenjësia dhe përjashtimi i trashëgimtarëve të domosdoshëm, procedura për shqyrtimin e trashëgimisë, hapja e trashëgimisë, si dhe ndarja e trashëgimisë 395

2.1 Hyrje	395
2.2 Objektivat trajnuese	395
2.3 Trashëgimia në bazë të testamentit	395
2.3.1 Kuptimi i testamentit	395
2.3.1 Zotësia për të përpiluar testamentin	395
2.3.2 Llojet e testamentit.....	395
2.3.3 Karakteristikat e testamentit.....	396
2.3.4 Revokimi i testamentit	397
2.3.5 Shkaqet kryesore mbi pa vlefshmërinë e testamentit	397
2.3.6 Vëllimi i pavlefshmërisë së testamentit.....	398
2.3.7 Testamenti absolut nul	398
2.3.8 Testamenti relativ nul	398
2.3.9 Përmbajtja e testamentit	399
2.3.10 Barrët, afatet dhe kushtet.....	399
2.3.11 Ruajtja e testamentit.....	399
2.3.12 Interpretimi i testamentit.....	400
2.3.13 Legu.....	400
2.4 Padenjësia dhe përjashtimi i trashëgimtarëve të domosdoshëm.....	400
2.4.1 Padenjësia	400
2.4.2 Vlerësimi i padenjësisë.....	400
2.4.3 Përjashtimi nga trashëgimia e trashëgimitarit të domosdoshëm	401
2.5 Procedura për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore.....	401
2.6 Parimet e procedurës së shqyrtimit të trashëgimisë	401
2.7 Kompetenca vendore	401
2.8 Kompetenca lëndore	402
2.9 Kompetenca funksionale.....	402
2.10 Kompetenca ndërkombëtare.....	402
2.11 Përgatitja e seancës trashëgimore.....	402
2.11.1 Përpilimi i aktvdekjes	402
2.11.2 Masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë trashëgimore	403
2.11.3 Regjistrimi dhe vlerësimi i pasurisë	403
2.11.4 Koha e hapjes së trashëgimisë	403
2.11.5 Vendi i hapjes së trashëgimisë.....	403
2.11.6 Seanca trashëgimore.....	404
2.11.7 Udhëzim i palëve në kontest civil	404

2.11.8 Udhëzim në kontest për shkak të konfliktit rreth të drejtës apo aplikimi të së drejtës	404
2.11.9 Aktvendimi mbi trashëgiminë	405
2.11.10 Pasuria e gjetur pas marrjes së aktvendimit të plotfuqishëm	405
2.11.11 Gjetja e testamentit pas plotfuqishmërisë së aktvendim për trashëgim	405
2.12 Ndarja e pasurisë trashëgimore	405
2.12.1 Bashkësia e trashëgimisë	405
2.12.2 Cedimi i pjesës trashëgimore para ndarjes	406
2.12.3 E drejta e trashëgimtarëve që kanë bashkëjetuar ose kanë punuar në një bashkësi me trashëgimlënësin 406	
2.12.4 Ndarja e sendeve të shtëpisë.....	406
2.12.5 Detyrimi i mbajtjes midis trashëgimtarëve pas vdekjes.....	406
2.13 Ushtrime.....	406
2.14 Përmbledhje.....	407

Trashëgimia është kategori e lashtë shoqërore. Trashëgimi ka lindur në atë fazë të zhvillimit të shoqërisë njerëzore, kur disa të mira materiale përveç bashkësisë shoqërore u përkasin edhe personave të caktuar.

Gjatë zhvillimit të saj historik fenomeni i trashëgimisë vënë në dukje dy situata mjaftë të rëndësishme, e para, kur disa të mira materiale u takon personave vetëm si posedim dhe kur kjo rregullohej vetëm me disa norma zakonore dhe e dyta, kur personi në ato të mira materiale ka gëzuar të drejtat e caktuara subjektive dhe kur ajo ishte e rregulluar me norma ligjore juridike, pas të cilave ka qëndruar shteti. Pra, kur marrëdhëniet shoqërore duke u rregulluar me normat e së drejtës u shndërruan në norma juridike. Këto marrëdhënie lindin me rastin dhe për shkak të vdekjes së trashëgimlënësit si nevojë e kalimit të pasurisë së tij tek trashëgimtarët.

Çështjet e rregullimit të drejtës së trashëgimisë në Kosovë gjenden në një fazë të rëndësishme të zhvillimit. Problematike këtë fushë të së drejtës e bënë ekzistimi i relikteve të së drejtës zakonore në jetën e përditshme juridike në disa rajone me pak të zhvilluara të Kosovës, ekzistimi edhe më tutje i pasurisë së përbashkët të familjeve të mëdha në fshat, çështjet e avansimit të së drejtës së femrës për të trashëguar. Prania e dukurisë së heqjes dorë nga trashëgimia e femrës (sado pak ka rënë kohëve të fundit), dhe atë për shkak të traditave, normave kulturore të cilat favorizojnë trashëgiminë sipas vijës mashkullore, dhe pritjeve të familjes se gruaja nuk do ta trashëgojë pasurinë e paluajtshme nga gjinia, ajo shpesh vendos të heq dorë nga e drejta e saj e trashëgimit në dobi të vëllëzërve. Ende është i pranishëm fenomeni i përjashtimit të trashëgimtarëve. Këto janë disa sfida me të cilat përballën në punën e tyre gjatë shqyrtimit të trashëgimisë gjyqtarët dhe noterët. Për të gjitha këto shkenca jonë juridike, praktika jonë gjyqësore dhe institucionet e bërjes së ligjit duhet të ofrojnë zgjidhje adekuate.

Sipas dispozitës së nenit 1 të Ligjit të Kosovës për trashëgiminë *“Trashëgimi është kalim me ligj ose në bazë të testamentit i pasurisë (trashëgimit) së personit të vdekur (trashëgimlënësit) tek një ose më shumë persona (trashëgimtarët ose legatarët), sipas rregullave të caktuara me ligj”*.

Modul i hartuar nga lëmi “E drejta Trashëgimisë” është bërë në atë formë që të iu shërbejë gjyqtarëve të sapo-emëruar që të avancojnë njohuritë mbi bazat e thirrjes në trashëgimi, cedimin e pasurisë për së gjalli, përjashtimin nga trashëgimia, borxhet e trashëgim-lënësit, pjesën e domosdoshme të trashëgimisë, dhe trashëgimin me testament.

Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij moduli trajnues, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Avancojnë njohurit mbi bazat e trashëgimisë;
- Krijojnë ide të qarta për trashëgiminë e domosdoshme, përjashtimin nga trashëgimia dhe çështjen e borxheve të trashëgimlënësit;
- Zbatojnë drejtë procedurën për shqyrtimin e trashëgimisë, veprimet që ndërmerr gjykata dhe kompetencën;
- Thellojnë njohurit lidhur me hapjen e trashëgimisë dhe ndarjen e pasurisë trashëgimore.

Metodat e të shpjeguarit

Gjatë trajtimit të këtij moduli trajnues do të përdoren këto metoda:

- trajtimi teorik dhe prezantimi në Power Point i bazave të trashëgimisë, procedurës që aplikohet në shqyrtimin e pasurisë trashëgimore,
- trajtimi i rasteve hipotetike që përmbajnë elemente të trashëgimisë nëpërmjet aplikimit të punës në grupe, siç janë :
 - a) përcaktimi i detyrave dhe zgjedhja e tyre,
 - b) identifikimi i qëndrimeve të përbashkëta i grupeve dhe dallimet në mes tyre,
 - c) përcaktimi i hapave që duhet ndërmarr në zgjidhjen konkrete të çështjes,
 - d) identifikimi i metodave të aplikuara me rastin e mënyrës së zgjidhjes së rastit
- diskutime në grupe dhe arsyet për qëndrime të kundërta dhe
- harmonizimi i qëndrimeve mbi rastet hipotetike, duke përfshirë edhe një përmbledhje të shkurtër mbi çështjet e rëndësishme të modulit të prezantuar.

Mjetet e nevojshme

Për realizimin e këtij moduli nevojitet te paktën një lapë top, projektor me pajisjet për prezantim përmes slideve me poëer point, letër për hartimin e shkresave(detyrave), mikrofon, etj.

Pritjet nga pjesëmarrësit

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të arrijnë këto rezultate :

- të njohin dhe zbatojnë parimet dhe rregullat e përgjithshme mbi rregullimin e pasurisë trashëgimore;
- të njohin dhe zbatojnë format e trashëgimisë me ligj dhe me testament;
- të krijojnë ide të qartë për pjesën e domosdoshme;
- të njohin dhe zbatojnë trajtimin e pacenueshmërisë së pjesës së domosdoshme të trashëgimisë, padenjësinë për të trashëguar dhe çështjen e borxheve të trashëgimlënësit;
- të njohin dhe zbatojnë procedurën për shqyrtimin e trashëgimisë, veprimet që ndërmerren dhe kompetencën e gjykatave;
- të njohin dhe zbatojnë mënyrën e hapjes së trashëgimisë dhe ndarjen e saj,

Burimet

Për përgatitjen e prezantimeve të këtij moduli, janë shfrytëzuar këto materiale kryesore:

- Ligji për trashëgiminë i Kosovës nr. 2004/26 i dt.28 korrik 2004;
- Ligji mbi trashëgimin i KSA të Kosovës nr.43 i dt. 31 dhjetor 1974;
- Ligji mbi procedurën jokontestimore i Kosovës, nr.03/L007, 20 nëntor 2008;
- Nazmi Biçoku, *E drejta trashëgimore*, Tiranë 1988;
- Dr.sc Hamdi Podvorica, *E drejta familjare*, Prishtinë, 2011;
- Dr.Juliana Latifi, Enver Buqcaj, *E drejta e trashëgimisë në Kosovë*;
- Dr.sc. Hamdi Podvorica, *E drejta trashëgimore*, Universiteti i Prishtinës 2010;
- Materiale nga trajnimet në IGJK;
- Ligji për noterinë i Kosovës, Nr. 03/L-010, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës

Përmbledhje

Ky modul përfshin rendësin e lëndës “E drejta e trashëgimisë” në programin e trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar, objektivat mësimore, metodologjinë e të mësuarit dhe rezultatet e pritshme nga kandidatë. Si përfundim përmes këtij moduli do mundësohet që gjyqtarët e sapoemëruar të avancojnë njohuri mbi bazat e thirrjes në trashëgimi, cedimin e pasurisë për së gjalli, përjashtimin nga trashëgimia, borxhet e trashëgim-lënësit, pjesën e domosdoshme të trashëgimisë, trashëgimin me testament si dhe për procedurën e shqyrtimit të trashëgimisë

1. Trashëgimia në bazë të ligjit, pjesa e domosdoshme dhe trashëgimtarët e domosdoshme dhe transaksionet ndërmjet të gjallëve

1.1 Hyrje

Në kuadër të këtij sesi do të trajtohen çështje me rëndësi nga E drejta Trashëgimisë dhe atë në lidhje me objektin e trashëgimisë, bazën ligjore të thirrjes në trashëgimi, pjesën e domosdoshme dhe cenimin e saj si dhe për transaksionet ndërmjet të gjallëve (inter vivo).

1.2 Objektivat trajnuese

Si rezultat i këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Avancojnë njohurit e tyre lidhur me objektin e trashëgimisë;
- Interpretojnë drejtë parimet e të drejtës trashëgimore;
- Avancojnë njohurit lidhur me trashëgiminë me ligj, radhët e trashëgimisë, të drejtën e përfaqësimit dhe shtimit;
- Krijojnë ide të qarta për institutin e pjesës së domosdoshme, llogaritjen dhe cenimin e saj.

1.3 Objekti i trashëgimisë

Me pasuri trashëgimore kuptojmë një pasuri të caktuar, e cila përbehet nga sendet e paluajtshme, sendet e luajtshme, si dhe të drejta reale të lidhura me këtë pasuri.

Me nenin 2 të Ligjit për Trashëgimin të Kosovës (LTK), është ka përcaktuar se: “*Mund të trashëgohen sendet dhe të drejtat të cilat u përkasin individëve*”, nga e cila dispozitë ligjore, rezulton se objektin e trashëgimisë e përbëjnë të drejtat pasurore të përshtatshme për trashëgim në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit.

Në objektin e trashëgimit hyjnë si sendet e luajtshme, ashtu edhe ato të paluajtshme që i kanë takuar trashëgimlënësit në kohën e vdekjes së tij, pa marrë parasysh vlerën apo sasinë e sendeve.

Nga kjo rezulton se objekti i trashëgimisë mund të përkufizohet si:

- tërësi e të drejtave reale (e drejta e pronësisë, pengut, servituteve, posedimit etj.);
- tërësi e të drejtave të detyrimeve (kontrata e shitblerjes, shpërblimi i dëmit, pasurimi i pabazë, depozita, premitë e sigurimeve etj);
- tërësi e të drejtave të autorit, dhe
- tërësi e të drejtave të pronësisë industriale.

1.4 Veçimi i sendeve nga pasuria trashëgimore

Sendet që nuk e përbëjnë objektin e trashëgimisë veçohen para se të bëhet pjesëtimi i pasurisë (neni 158 i LTK). Këtu veçohet prona e përbashkët e bashkëshortëve dhe pasuria e pasardhësve. Sipas dispozitës së nenit 36.3 të LTK-së “veçimi i pasurisë dhe sendeve bëhet vetëm me kërkesën e autorizuesit” brenda pesë viteve nga dita e hapjes së trashëgimisë.

Në pasuri trashëgimore nuk hyjnë:

- pasuria e përcaktuar si shpërblim për mbajtjen e trashëgimlënësit në bazë të kontratës për mbajtje të përjetshme;
- punët e tjera juridike për së gjalli tek të cilat është përcaktuar se dorëzimi i sendit mund të bëhet deri në mbarimin e jetës së trashëgimlënësit;
- sendet që trashëgimlënësi i ka pasur në ruajtje, dhe
- sendet e tjera (orenditë e shtëpisë, veshmbathje, shtrojë-mbulojë etj.)

1.5 Caktimi i vlerës së pasurisë trashëgimore

Caktimi i vlerës së pasurisë trashëgimore bëhet para se të caktohet madhësia e pjesës që u takojnë trashëgimtarëve të domosdoshëm. Vlera caktohet ashtu që hiqet pasiva nga aktiva dhe ajo që mbetet është pasuri trashëgimore. Caktimi i vlerës së pasurisë bëhet vetëm në rastet e cenimit të pjesës së domosdoshme.

1.6 Parimet themelore të se drejtës trashëgimore

- Parimi i barazisë së trashëgimtarëve

Në dispozitën e nenit 3 të LTK është paraparë qartë se në kushte të njëjta, të gjithë personat fizik janë të barabartë në trashëgimi, duke përfshirë këtu edhe fëmijët jashtë martesorë (nëse atësia e tyre është e njohur rregullisht ose është vërtetuar me vendim të gjykatës) dhe fëmijët e birësuar.

- Parimi i trashëgimisë testamentare

Pasuria trashëgimore u kalon trashëgimtarëve testamentar ose ligjor, të cilët në varësi të llojit të trashëgimisë gëzojnë pjesën e caktuar. Sipas dispozitës së nenit 9 të LTK “trashëgimi me ligj zbatohet kur trashëgimlënësi nuk ka lënë testament ose ka lënë testament vetëm për një pjesë të pasurisë së tij, ose kur testamenti është tërësisht apo pjesërisht i pavlefshëm.

- Parimi i kufizimit të bazave juridike në trashëgim

Askush nuk mund të trashëgoi pa bazë juridike të trashëgimisë. Ligji për Trashëgimin i Kosovës njih dy baza të trashëgimisë, edhe atë:

- a) trashëgimin me ligj, dhe
- b) trashëgimin me testament (neni 8 i LTK).

Në disa shtete ekziston edhe trashëgimia me kontratë, mirëpo legjislacioni jonë nuk e njih këtë lloj të trashëgimisë.

- Parimi i suksesorit universal dhe singular (veçantë)

Personat që trashëgojnë tërë pasurinë e trashëgimlënësit ose një pjesë të sajë quhen suksesor universal ndërsa suksesor singular quhet ai person që përfiton vetëm dobi nga trashëgimia, pra fiton vetëm të drejta të caktuara nga aktiva.

- parimi ipso jure i trashëgimit

Ky parim mbështetet në faktin që trashëgimtarët në momentin e vdekjes së personit fizik fitojnë të drejtën në trashëgim. Sipas këtij parimi është me rëndësi se pasuria për asnjë çast nuk mbetet pa titullarin e vetë.

- Parimi i zbatimit paralel të bazave për thirrje në trashëgim

Në të njëjtën kohë një person mund të trashëgoi edhe sipas bazës së trashëgimisë me ligj edhe sipas asaj me testament.

1.7 Trashëgimia në bazë të ligjit

Trashëgimia me ligj është kalim me ligj i pasurisë së personit të vdekur tek një a më shumë persona sipas rregullave të caktuara ligjore.

Trashëgimia me ligj zbatohet kur trashëgimlënësi nuk ka lënë testament, ose ka lënë testament vetëm për një pjesë të pasurisë së tij ose kur testamenti është tërësisht ose pjesërisht i pavlefshëm (neni 9 i LTK).

Nga kjo dispozitë rezulton se trashëgimi me ligj zbatohet vetëm kur:

- mungon testamenti;
- kur me testament është disponuar vetëm një pjesë e trashëgimisë;
- kur testamenti është pjesërisht ose tërësisht i pavlefshëm.

Si fakte më të rëndësishme për formimin e radhëve të trashëgimisë ligjore janë marrë kryesisht:

- gjinia si lidhje për caktimin e radhës ligjore të trashëgimisë, dhe
- martesë si lidhje për caktimin e radhës ligjore të trashëgimisë.

1.7.1 Radhët e trashëgimisë

Trashëgimtarët ligjorë janë persona të afërm, gjini të trashëgimlënësit ose persona të caktuar në bazë të dispozitave ligjore si trashëgimtarë në bazë të martesës ose fakteve të tjera. Sipas të drejtës tonë, trashëgimtarët ligjor radhiten në tri radhë të trashëgimisë. Radhët e personave të thirrur në trashëgim është përcaktuar me norma ligjore (neni 11 i LTK-së), për të cilat radhë më afër u përmend te gjinia.

1.7.2 Radha e parë e trashëgimisë

Rrethin e trashëgimtarëve të radhës së parë të trashëgimisë përbëjnë fëmijët dhe bashkëshorti i trashëgimlënësit. Fëmijët jashtëmartesorë barazohen me fëmijët martesorë, sikur që barazohen edhe fëmijët e adoptuar.

a) Gjinia si fakt për caktimin e radhës ligjore të trashëgimisë

Trajta më e rëndësishme e lidhjes mes personave që vijnë në konsiderim të trashëgojnë dhe trashëgimlënësit – është gjinia. Sipas nenit 3.2 të LTK-ës, fëmijët e adoptuar barazohen me fëmijët legjitim. Ndërkaq sipas nenit 11 të LTK-ës trashëgimtarë ligjor janë fëmijët e

trashëgimlënësit, të birësuarit (adoptuarit) e tij dhe pasardhësit e tyre, bashkëshortit, prindërit, vëllezërit dhe motrat dhe pasardhësit e tyre, gjyshi dhe gjyshja dhe paraardhësit e tyre. Sipas nenit 11.2 në radhën e trashëgimtarëve ligjor hynë edhe bashkëshorti jashtëmartesor.

Trashëgimtarët e radhës më të afërt të trashëgimisë, përjashtojnë nga trashëgimia personat e radhës më të largët.

b) Martesa si fakt për caktimin e radhës ligjore të trashëgimisë

Sipas dispozitës së nenit 12.1 të LTK-së bashkëshorti hynë në radhën e parë dhe të dytë të trashëgimisë dhe trashëgon me pjesë të barabarta. Me Ligjin për Trashëgiminë i Kosovës janë paraparë shprehimisht rastet kur bashkëshortët nuk mund të trashëgojnë njëri-tjetrin (neni 27 i LTK-së), ndërkaq sipas nenit 12.2 të LTK-së, edhe bashkëshortët jashtëmartesorë barazohen me bashkëshortët martesorë.

1.7.3 Zëvendësimi (përfaqësimi) në trashëgimin ligjore

Në mungesë të një trashëgimtari i cili ka vdekur para trashëgimlënësit, deklarohet i padenjë për të trashëguar, heqë dorë nga trashëgimia apo përjashtohet nga e drejta për të trashëguar, në vend të tij, në shkallë të njëjtë me të drejta të njëjta futet një trashëgimtar tjetër. Këta persona që zëvendësojnë trashëgimtarin që duhet të trashëgonte, trashëgojnë në pjesë të barabarta me trashëgimtarët e tjerë.

Të drejtën e përfaqësimit e rregullon edhe LTK-ja, neni 13. Heqja dorë nga trashëgimi sipas nenit 130.2 të LTK-së, ka pasoja edhe për pasardhësit e tij.

Shembull i një rasti të tillë: *Trashëgimlënësi A ka vdekur duke lënë pas vete bashkëshorten B dhe dy fëmijët C dhe D, ndërsa fëmija i tretë E ka vdekur para trashëgimlënësit dhe ka lënë djalin E1. Në këtë rast bashkëshortja trashëgon 1/4, dy fëmijët C dhe D nga 1/4 ndërsa E1 sipas të drejtës së përfaqësimit trashëgon 1/4 e pasurisë trashëgimore që do ti takonte të atit të tij të para vdekur përkatësisht E1.*

1.7.4 E drejta e shtimit

Nëse e drejta e përfaqësimit nuk mund të zbatohet, pjesa trashëgimore që do tu takonte personave në gjini të vijës në kuadër të radhës trashëgimore, u shtohet pjesëve trashëgimore të trashëgimtarëve të tjerë në kuadër të po asaj radhe trashëgimore që është në shkallë më të afërt gjinie me trashëgimlënësin. E drejta e shtimit parashihet me nenin 23 të LTK-së. Kjo vjen në shprehje në rastet kur pjesa e një apo më shumë trashëgimtarëve mbetet e lirë, si dhe në raste kur e drejta e përfaqësimit nuk mund të zbatohet.

Shembull i një rastit kur vjen në shprehje e drejta e shtimit: *Trashëgimlënësi A ka vdekur duke lënë pas vete tre fëmijët B, C dhe D. Secili prej fëmijëve ka të drejtë e trashëgimisë me nga 1/3 e pjesës trashëgimore. Nëse për çdo arsye fëmija B eliminohet nga trashëgimia, atëherë fëmijët C dhe D do trashëgojnë nga 1/2 e pasurisë trashëgimore.*

1.7.5 Radha e dytë e trashëgimisë

Rrethi i trashëgimtarëve të rrethit të dytë të trashëgimisë përbëhet nga prindërit dhe bashkëshorti i trashëgimlënësit. Sipas nenit 14.1 të LTK-së, pasurinë e trashëgimlënësit që nuk ka lënë pasardhës e trashëgojnë prindërit e tij dhe bashkëshorti i tij. Sipas dispozitës së nenit 15 të LTK-së edhe vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit si dhe pasardhësit e tyre mund të trashëgojnë nëse njëri nga prindërit ka vdekur ose kanë vdekur të dy prindërit.

1.7.6 Radha e tretë e trashëgimisë

Trashëgimtarët e radhës së tretë ftohen për trashëgim vetëm kur nuk ka trashëgimtarë të radhës së parë dhe të dytë, kur ata nuk duan të trashëgojnë, janë përjashtuar apo janë të pa denjë për të trashëguar. Në nenin 18 të LTK-së është përcaktuar më afër se kur mund të paraqiten për trashëgimtarë gjyshërit dhe gjyshet e trashëgimlënësit.

1.7.7 Komuna si trashëgimtar ligjor

Nëse trashëgimlënësi nuk ka lënë as trashëgimtarë e as testament, konsiderohet se trashëgimi i takon Komunës, ku trashëgimtari ka pasur vendbanimin ose vendqëndrimin tij të fundit (neni 21 i LTK-së). Ndërkaq, nëse nuk dihet se ka trashëgimtarë, gjykata në kuptim të dispozitës së nenit 127.1 të LTK-së, në shpallje do ti ftojë trashëgimtarët. Afati i paraqitjes është një vit, mirëpo edhe pas kalimit të këtij afati nuk do të humbin këtë të drejtë nëse nuk kalojnë 20 vjet. Përndryshe, komuna si trashëgimtar i merr të gjitha obligimet e trashëgimlënësit sikur edhe në radhët e tjera të trashëgimisë.

1.7.8 E drejta e trashëgimit të adoptuarit dhe adoptuesit

Fëmijët të cilët janë adoptuar si dhe pasardhësit e tyre kanë të drejta të barabarta me fëmijët e adoptuesit (trashëgimlënësit), ata trashëgojnë njëjtë si fëmijët e adoptuesit, pra konkurojnë në trashëgimi në pjesë të barabarta me fëmijët e adoptuesit (neni 24 KTK). Mirëpo i adoptuari dhe pasardhësit e tij nuk do e trashëgojnë adoptuesin, në rast se adoptuesi ka paraqitur kërkesë për pushimin e adoptimit, ndërsa pas vdekjes së tij vërtetohet se kërkesa e tij ka pasur mbështetje ligjore (neni 25 LTK).

1.7.9 Të drejta e bashkëshortit

Bashkëshorti pasjetues ka të drejtë të trashëgoj në pjesë të barabarta me fëmijët e trashëgimlënësit apo 1/2 e pasurisë së trashëgimlënësit kur trashëgon në rrethin e dytë. Mirëpo bashkëshorti pasjetues ka të drejtë pjesën e pasurisë, që quhet pasuri e përbashkët, të fituar me punë gjatë martesës (neni 26.1 LTK). Me rastin e shqyrtimit të trashëgimisë, vetëm pjesa që i takon trashëgimlënësit pas ndarjes së pasurisë së përbashkët do jetë objekt i trashëgimisë (neni 26.2 i LTK).

Në cilat raste bashkëshorti nuk ka të drejtë për të trashëguar;

LTK parasheh mundësinë që bashkëshorti pasjetues të përjashtohet nga trashëgimia, dhe atë në nenin 27.2 janë paraqitur në mënyrë taksative arsye që bashkëshorti nuk ka të drejtë të trashëgojë:

- Në qoftë se trashëgimlënësi ka paraqitur padi shkurorëzimi, kurse pas vdekjes së trashëgimlënësit është bërë shkurorëzimi me aktgjykim të formës së prerë;
- Në qoftë se martesë e tij me trashëgimlënësin anulohet me aktgjykim të formës së prerë pas vdekjes së trashëgimlënësit për shkaqet që bashkëshorti pasjetues i ka ditur në kohën e lidhjes së martesës;
- Në qoftë se bashkëjetesa e tij me trashëgimlënësin ka pushuar me fajin e bashkëshortit pasjetues, ose në bazë të marrëveshjes me shkrim me trashëgimlënësin.

1.7.10 E drejta e trashëgimit të bashkëshortit jashtëmartesorë

E drejta trashëgimore në Kosovë ia njeh të drejtën në trashëgimi të bashkëshortit jashtëmartesorë nëse plotësohen këto kushte, sipas nenit 28 të LTK, dhe atë:

- Bashkësia jashtëmartesore deri në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit ka zgjatur të paktën 10 vjet, e nëse nga kjo marrëdhënie kanë lindur fëmijë-të paktën 5 vjet dhe,
- Në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit as njëri nga personat që kanë bashkëjetuar të mos ketë qenë ligjërishit i martuar me ndonjë person të tretë, ose nëse trashëgimlënësi ka qenë ligjërishit i martuar me personin e tretë, ka paraqitur padi për shkurorëzimin ose anulimin e martesës dhe pas vdekjes së tij konstatohet se padia ka pasur mbështetje.

Ndërse sipas nenit 28.2 të LTK, trashëgimtarë të domosdoshëm nuk konsiderohen bashkëshortët jashtëmartesor.

1.8 Pjesa e domosdoshme dhe trashëgimtarët e domosdoshëm.

1.8.1 Pjesa e domosdoshme

Instituti i pjesës së domosdoshme, është institut materialo juridik i të drejtës trashëgimore. Pjesa e domosdoshme pra është ajo pjesë e masës së pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësit, e për të cilën pjesë trashëgimtari i domosdoshëm ka nevojë për plotësimin e nevojave të veta jetike, por që e kufizon vullnetin e trashëgimlënësit, në lidhje me disponimin e pasurisë së tij me rastin e vdekjes.

Trashëgimlënësi me rastin e disponimit të pasurisë së tij, mund të disponoi me pasurin e tij deri $\frac{1}{2}$ pjesë, të masës së pasurisë trashëgimore, kur ka pasardhës të tij fëmijë dhe bashkëshort, ndërsa kur ai nuk ka si trashëgimtarë fëmijë dhe bashkëshort, ndërsa pas vetes ka vëllezër e motra, ai mund të disponoj deri në $\frac{2}{3}$ e pjesë së pasurisë trashëgimore. Kjo është përcaktuar me dispozitën e nenit 31.2 të LT.

1.8.2 Trashëgimtarët e domosdoshëm

Si trashëgimtar të domosdoshëm mundë të jenë vetëm rrethi i ngushtë i trashëgimtarëve të cilët për shkak të afërsisë së gjakut me trashëgimlënësin e gëzojnë mbrojtjen e veçantë ligjore. Që një trashëgimtarë të mundë të realizoi të drejtën e tij në pjesën e domosdoshme është e nevojshme të ketë cilësinë e trashëgimtarit ligjor sipas dispozitave të Ligjit për trashëgimi.

Trashëgimtarët e domosdoshëm janë të ndarë në dy grupe dhe atë :

1. Pasardhësit e trashëgimlënësit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, prindërit dhe bashkëshorti i tij (nenit 30.1 LTK).

Njësoi sikurse te radha e trashëgimisë edhe të trashëgimtarët e domosdoshëm të radhës së parë i përjashtojnë trashëgimtarët e domosdoshëm të radhës së dytë apo të tretë.

2. Grupin e dytë e përbëjnë gjyshërit e trashëgimlënësit, motrat dhe vëllezërit (nenit 30.2 të LTK), por vetëm në qoftë se përmbushen dy kushte komulative dhe atë :
 - a) që trashëgimtari i domosdoshëm të jetë i pa aftë për punë, dhe
 - b) të mos ketë mjetet për jetesë.

1.8.3 Llogaritja e pjesës së domosdoshme

Për llogaritjen e pjesës së domosdoshme është e nevojshme të bëhet vlerësimi i pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësit. Kjo bëhet në disa faza sepse është e nevojshme të dihet dhe vlerësohet pjesa aktive, ashtu edhe pjesa pasive e pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësit e të cilën pasuri e ka pasur në çastin e vdekjes.

Mënyrat e llogaritjes :

- Inventarizimi i pasurisë trashëgimore ,
- Rexhistrimi i kërkesave të trashëgimlënësit ndaj personave të tretë,
- Regjistrimi i disponimeve të trashëgimlënësit me kontratë apo me testamente dhe
- Regjistrimi i borxheve që trashëgimlënësi i ka ndaj personave të tretë.

1.8.4 Inventarizimi i pasurisë trashëgimore

Inventarizimi i pjesës trashëgimore, bëhet me qëllim të regjistrimit të pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësit të cilën pasuri e ka pasur në çastin e vdekjes. Pra bëhet regjistrimi i sendeve të luajtshme, regjistrimi i sendeve të paluajtshme, regjistrimi i të hyrave nga të drejtat (të qirasë, kamatave, nga mjetet deponuara në banka, aksione, etj.). Gjatë regjistrimit do të kihet parasysh edhe çështja e veçimit të sendeve që kanë shërbyere në plotësimin e nevojave të përditshme siç janë orënditë, mobilet, apo sendet tjera personale e të cilat ju kanë shërbyer trashëgimtarëve me të cilët ka bashkëjetuar në një familje me trashëgimlënësin. Pas inventarizimit të sendeve dhe të hyrave nga të drejtat atëherë bëhet edhe vlerësimi i këtyre sendeve në mënyrë që të dihet se cila është vlera e këtyre sendeve të pa luajtshme dhe të luajtshme.

1.8.5 Regjistrimi i kërkesave të trashëgimlënësit ndaj personave të tretë apo trashëgimtarëve

Në regjistrimin e kërkesave të trashëgimlënësit merret parasysh, regjistrimi i kërkesave që trashëgimlënësi i ka ndaj personave të tretë, çoftë në sende, në të drejta, të holla apo në letra me vlerë. Këtu merren parasysh kërkesat të cilat dihen, natyrisht këtu nuk merren parasysh kërkesat të cilat nuk mund të dihen dhe ato që nuk mund të realizohen. Pastaj është e nevojshme të regjistrohen edhe borxhet e trashëgimtarëve ndaj trashëgimlënësit.

1.8.6 Regjistrimi i disponimeve të trashëgimlënësit me kontratë apo me testament

Është e rëndësishme që të bëhet regjistrimi i disponimeve që trashëgimlënësi i ka bërë me kontrata të ndryshme në lidhje me pasurin e tij, si kontratat e dhurimit, kontratat e dy anshme apo të legeve, nëse është hartuar testamenti. Te kontratat e dhurimit është e rëndësishme të identifikohen se dhurimet a janë bërë për trashëgimtarët, apo personat e tjerë, mandej të bëhet edhe regjistrimi i dhurimeve që u ka bërë trashëgimtarëve, trashëgimlënësi e të cilët kanë hequr dorë nga trashëgimia, si dhe atyre dhurimeve për të cilat trashëgimlënësi ka urdhëruar që të mos i llogariten trashëgimtarit në pjesën e tij trashëgimore.

1.8.7 Regjistrimi i borxheve që trashëgimlënësi ua ka personave të tretë.

Gjithashtu te vlerësimi i pasurës trashëgimore është i rëndësishëm edhe regjistrimi i borxheve të trashëgimlënësit ndaj personave të tretë, apo ndaj trashëgimtarëve dhe kjo përmes identifikimit të personave që kanë kërkesa ndaj trashëgimlënësit. Është e rëndësishme që të theksohet se ka rëndësi edhe identifikimi i shpenzimeve të ceremonisë së varrimit, nëse vetëm njëri prej trashëgimtarëve i ka hequr këto shpenzime .

Pas vërtetimit të aktives dhe të pasives, bëhet përcaktimi i vlerës së pasurës trashëgimore, dhe pas vlerësimit të pjesës së pasurisë trashëgimore atëherë vijnë deri te identifikimi i pjesës së domosdoshme , çoftë për trashëgimtarët e domosdoshëm të grupit të parë , apo të grupit të dytë.

1.8.8 Pasuria që veçohet nga pasuria trashëgimore

Pjesa e veçuar e pasurisë trashëgimore është ajo pjesë, e cila ka ndikuar në rritjen e pasurisë trashëgimore në saje, të kontributit të trashëgimtarëve me të cilët ka jetuar trashëgimlënësi. Pra pasardhësit e trashëgimlënësit të cilët kanë bashkëjetuar me të është e natyrshme që ata kanë dhënë kontributin e veçantë ose në ndonjë mënyrë tjetër duke e ndihmuar me punë trashëgimlënësin të kenë dhënë kontribut që vlera e pasurisë trashëgimore të jetë më e madhe . Vlera e pasurës trashëgimore e cila është shtuar me kontributin e pasardhësve nuk do të hyjë në pasurinë trashëgimore dhe kjo vlerë e pasurisë trashëgimore do të veçohet . Pra në rastin konkret kjo pjesë e pasurisë nuk do të llogaritet gjegjësisht nëse është llogaritur ajo do të zvogëlohet dhe nuk do të merret si pasuri trashëgimore e trashëgimlënësit që ka kontribuar në rritjen e vlerës. Afati për kërkimin e veçimit të pjesës së pasurisë trashëgimore është 5 vite, nga momenti gjegjësisht dita e hapjes së trashëgimisë (neni 36 LT).

1.8.9 Veçimi i sendeve të shtëpisë

Veçimi i sendeve të shtëpisë, të cilat kanë shërbyer në plotësimin e nevojave të përditshme të bashkëshortit pasjetues dhe pasardhësve të trashëgimlënësit të cilët kanë bashkëjetuar me trashëgimlënësin nuk do të hyjnë në pasurin trashëgimore. Këto sende mund të jenë si : orenditë shtëpiake, mobilet, shporetet, frigoriferët, lavatriqa etj. Mirëpo në rast se këto sende kanë një vlerë të lartë, e të cilat janë blerë në kohën kur të gjithë trashëgimtarët kanë bashkëjetuar me

trashëgimlënësin, atëherë edhe këto sende do të llogariten në pasurinë trashëgimore dhe në pjesën e domosdoshme.

1.9 Zvogëlimi i disponimit me testament dhe kthimi i dhurimit për shkak të cenimit të pjesës së domosdoshme.

1.9.1 Cenimi i pjesës së domosdoshme

Themi se ekziston cenimi i pjesës së domosdoshme atëherë kur trashëgimlënësi me rastin e shprehjes së vullnetit të tij të fundit, disponon me tërë pasurin trashëgimore me rastin e caktimit të trashëgimtarit të tij të afërm apo jo të afërm, apo me punë juridike të dhurimit apo të lënies legë të sendeve nga pasuria trashëgimore. Pra cenimi në pjesën e domosdoshme themi se ekziston atëherë kur vlera e disponimit me testament apo me punë juridike, kontratë të dhurimit, e tejkalon vlerën e paraparë me ligj që do t'i takonte trashëgimtarit të domosdoshëm.

Në rastet kur cenohet pjesa e domosdoshme, disponimi me testament do të zvogëlohet, kurse dhurimet do të kthehen në masën që nevojitet për plotësimin e pjesës së domosdoshme.

1.9.2 Radha e zvogëlimit dhe e kthimit

Kur shkaktohet cenimi i disponimit, atëherë disponimi me testament do të zvogëlohet dhe nëse me zvogëlim të disponimit plotësohet pjesa e domosdoshme atëherë nuk ka nevojë që të kërkohet kthimi i dhurimeve të bëra nga trashëgimlënësi. Në këtë rast kthimi i dhurimeve do të kërkohet vetëm nëse me zvogëlimin e disponimeve me testament nuk do të mund të plotësohej pjesa e domosdoshme. Por nëse dhurimet e trashëgimlënësit të bëra kanë qenë sende, ndërsa si sende nuk mund të kthehen sepse ato në ndërkohë janë tjetërsuar apo ato janë konsumuar, atëherë do të veprohet, sipas dispozitave mbi kthimin sipas normave të pasurimit pa bazë siç e rregullojnë dispozitat e LMD-së.

1.9.3 Zvogëlimi proporcional i disponimeve me testament

Kur shkaktohet cenimi i pjesës së domosdoshme, përmes disponimit me testament në të njëjtën masë pa marrë parasysh natyrën e tyre dhe vëllimin e tyre dhe pa marrë parasysh a` gjenden në një ose më shumë testamente nga trashëgimlënësi atëherë këto deponime do të zvogëlohen. Zvogëlimet do të bëhen në mënyrë proporcionale deri në atë masë sa është cenuar pjesa e domosdoshme.

Shembull i një rasti të tillë: Nëse pasuria trashëgimore e trashëgimlënësit është në shumën 120.000,00€, dhe se trashëgimtari ka caktuar me testament tre persona nga 30.000,00€, ndërsa si trashëgimtarë të domosdoshëm nga radha e parë ka tre trashëgimtarë atëherë rrjedh se deponimi me testament është në shumën prej 90.000,00€, ndërsa shuma e cenuar e pjesës së domosdoshme është në shumën 30.000€. Në rastin konkret zvogëlimi i disponimit me testament do të bëhet në mënyrë proporcionale, për secilin trashëgimtar testamentar nga 10.000€, dhe për tre trashëgimtarët e domosdoshëm pjesa e tyre do të plotësohet për shumën prej 30.000€, ashtu deri sa të arrihet shuma 60.000€ dhe trashëgimtarëve të domosdoshëm secilit do ju takoj nga pjesa e domosdoshme shuma 20.000€.

1.9.4 Zvogëlimi i legut të privilegjuar

Kur trashëgimlënësi ka lenë me testament disa legë dhe ka urdhëruar që ndonjë legë të paguhet para legave të tjerë, ky legë do të zvogëlohet vetëm nëse vlera e legeve të tjera nuk mjafton për tu plotësuar pjesa e domosdoshme . Pra pjesa e domosdoshme plotësohet edhe me sendet apo të drejtat e lëna në legë me testament në atë vlerë sa plotësohet pjesa e domosdoshme e trashëgimtarit të domosdoshëm. Parimisht për plotësimin e pjesës së domosdoshme legu i privilegjuar nuk do të zvogëlohej, nëse me zvogëlimin e legeve të tjera do të plotësohej pjesa e domosdoshme e trashëgimtarëve të domosdoshëm . Pra vetëm përjashtimisht legu i privilegjuar do të zvogëlohej nëse nuk plotësohet pjesa e domosdoshme me lege tjera.

1.9.5 Zvogëlimi proporcional i legeve

Trashëgimtari i caktuar me testament, pjesa trashëgimore e të cilit duhet zvogëlohet, për tu plotësuar pjesa e domosdoshme, mundë të kërkojë zvogëlimin proporcional të legeve që ai duhet ti paguajë po që se nga përmbajtja e testamentit nuk kuptohet diçka tjetër. Pra në rastin konkret kur trashëgimtarit të caktuar me testament të trashëgimlënësit , pjesa e të cilit është e nevojshme të zvogëlohet për ta plotësuar pjesa e domosdoshme të trashëgimtarit të domosdoshëm, ka të drejtë të kërkojë në mënyrë proporcionale të zvogëlohen leget që ai duhet ti paguaj personit tjetër . Kjo situatë do të vlen dhe zbatohet edhe për legatarin të cilin trashëgimtari e ka urdhëruar të paguaj diçka nga legu i vet. Atë që mundë të kërkojë të zvogëlohet nga pagesa e legut kjo është për aq sa legu zvogëlohet, vlera e cila do të plotësojë pjesën e domosdoshme.

1.9.6 Radha e kthimit të dhurimeve

Dhurimet e bëra nga trashëgimlënësi gjatë kohës sa ka qenë në jetë e me të cilat është bërë cenimi i pjesës së domosdoshme do të kthehen në mënyrë të veçantë për secilin dhurim dhe kthimi i dhurimit fillohet nga dhurimi i fundit dhe vazhdon me radhë tek dhurimet më të hareshme . Kjo është kështu sepse me dhurimet e fundit konsiderohet se trashëgimlënësi ka bërë cenimin e pjesës trashëgimore. Në rast se njëkohësisht janë bërë disa dhurime, atëherë këto dhurime kthehen proporcionalisht deri sa plotësohet pjesa e domosdoshme.

1.9.7 Pozita e dhuratëmarrësit që e kthen dhurimin

Kjo është rregulluar me dispozitën e nenit 44 të LT, sipas të cilës dhuratëmarrësi është posedues me mirëbesim sa i përket sendit të dhuruar që është dashur ta kthej, por vetëm deri në ditën kur është vënë në dijeni për kërkesën që të kthej dhurimin.

1.9.8 E drejta e kërkesë për zvogëlimin e disponimeve me testament dhe kthimin e dhurimeve.

Të drejtën për të paraqitur kërkesë (padi) për zvogëlimin e disponimit me testament dhe kthimin e dhurimeve, me të cilat është cenuar pjesa e domosdoshme, mund ta bëjnë vetëm trashëgimtarët e domosdoshmë. Kjo e drejtë nuk mundë të cenohet nga kreditorët e trashëgimtarit të domosdoshëm (neni 45 LT).

1.9.9 Afati ligjor për ushtrimin e kërkesës

Kërkesa për zvogëlimin e disponimeve me testament mund të ushtrohet brenda afatit prej tri viteve nga dita e shpalljes së testamentit dhe kthimi i dhurimeve , brenda afatit prej tri vitesh nga vdekja e trashëgimlënësit, përkatësisht nga dita që ka marr formën e prerë vendimin për shpalljen e tij si të vdekur ose vendimi me të cilin konfirmohet vdekja.

1.10 Llogaritja e dhurimeve dhe legëve në pjesën trashëgimore

1.10.1 Llogaritja e dhurimeve

Dispozitat e nenit 47.1 të LTK, janë decidive, çdo trashëgimtari ligjor i llogaritet në pjesën trashëgimore çdo gjë që ka marrë dhurim nga trashëgimlënësi nga çfarëdo mënyre. Përfshirjet janë të përcaktuara në nenin 47.2, sipas të cilës dhurimet nuk llogariten nëse trashëgimlënësi shprehimisht është deklaruar në kohën e dhurimit, më vonë apo edhe me testament se dhurimet nuk do të llogariten në pjesën trashëgimore ose nga rrethanat mund të konkludohet se ky ka qenë vullneti i trashëgimlënësit.

Dhurimet rëndom nuk llogariten në pjesën trashëgimore, mirëpo duhet precizuar se cilat janë ato përkatësisht dhurimet e rëndomta janë ato që tradicionalisht dhurohen në raste të caktuara dhe vlera e tyre është e ulët, si p.sh. dhuratat e dhëna për festa dhe për përgëzime të tjera.

1.10.2 Si bëhet llogaritja e dhuratave dhe legeve në pjesën trashëgimore

Llogaritja e dhuratave dhe legeve bëhet në atë mënyrë që trashëgimtarët e tjerë marrin nga pasuria trashëgimore vlerën përkatëse dhe pastaj ajo që mbetet nga pasuria trashëgimore ndahet në mes trashëgimtarëve. Përndryshe, legu që është lënë trashëgimtarit ligjor llogaritet në pjesën trashëgimore të tij, përveç nëse nga testamenti del se trashëgimlënësi ka dashur që trashëgimtari të merr legun për pos pjesës së tij trashëgimore.

1.10.3 E drejta e trashëgimtarit të cilit nuk i llogaritet dhurimi ose legu

Dhurimi ose legu nuk duhet të llogaritet trashëgimtarit në pjesën trashëgimore të tij, kur sipas vullnetit të trashëgimlënësit, trashëgimtari i këtillë e mbanë këtë dhe merr pjesë me trashëgimtarët e tjerë në ndarjen e pasurisë trashëgimore edhe atë sikur mos të kishte ekzistuar fare legu ose dhurimi.

1.10.4 Llogaritja e borxhit të trashëgimtarit ndaj trashëgimlënësit

Çdo borxh i trashëgimtarit ndaj trashëgimlënësit do të llogaritet në pjesën e atij trashëgimtari sipas rregullave të përgjithshme për kompensim. Secili trashëgimtar ka të drejtë të kërkojë që dhurimet dhe leget të llogariten në pjesën trashëgimore të një trashëgimtari tjetër.

1.11 Transaksionet ndërmjet të gjallëve (intervivos)

1.11.1 Cedimi dhe ndarja e pasurisë në përgjithësi

Përveç mënyrës ligjore dhe asaj me testament, me LTK janë parapa edhe mundësi tjera të kalimit të pasurisë nga paraardhësi në pasardhës. Neni 58 të LTK parasheh se paraardhësi me anë të veprimit juridik, për së gjalli mund t'ua cedojë dhe pjesëtojë pasurinë e vet pasardhësve të tij. Një veprim i tillë mund ta kryen me anë të kontratës për ndarje të pasurisë gjatë jetës.

Me këtë kontratë paraardhësi për së gjalli ua pjesëton dhe ua cedon pasardhësve të vet gjithë pasurinë apo një pjesë të saj pasardhësve të vet të cilët sipas ligjit në qoftë se me këtë pajtohen të gjithë pasardhësit të cilët konkurrojnë në trashëgimi.

1.11.2 Kushtet për vlefshmërinë e cedimit dhe pjesëtimit

Që cedimi apo pjesëtimi i pasurisë të jetë i vlefshmen LTK me nenin 59 ka parapa disa kushte të cilat duhet plotësuar, dhe atë:

- a) pajtimi i të gjithë pasardhësve të ceduesit që do të ishin trashëgimtarë ligjor të ceduesit në kohën e cedimit;
- b) kontrata mbi cedimin dhe pjesëtimin e pasurisë duhet të përpilohet me shkrim dhe të vërtetohet nga gjyqtari, pasi që i njëjti t'ua lexon dhe tregon kontraktuesve për pasojat e kësaj kontrate.

Nëse ndonjëri nga pasardhësit nuk e ka dhënë pëlqimin, këtë mund ta bëjë më vonë në të njëjtën formë. Cedimi dhe pjesëtimi mund të mbeten të vlefshme nëse pasardhësi që nuk e ka dhënë pëlqimin ka vdekur para ceduesit pa lënë pasardhës, ose ky pasardhës ka hequr dorë nga trashëgimi, ose ky pasardhës është bërë i pa denjë.

1.11.3 Objekti cedimit dhe pjesëtimit dhe përjashtimi i pasurisë së ceduar nga pasuria trashëgimore

Objekt i cedimit apo pjesëtimit është vetë pasuria e trashëgimlënësit, qoftë si tërësi apo vetëm si një pjesë e saj. Nëse trashëgimlënësi ka bërë cedimi apo pjesëtimin e të gjithë apo një pjesë të pasurisë së tij midis të gjallëve, atëherë pasuria e tij trashëgimore do të përbëhet vetëm nga pasuria që nuk është ceduar apo pjesëtuar, si dhe çdo pasuri që e ka fituar pas cedimit apo pjesëtimit. Ndërsa pasurinë që e kanë marrë paraardhësit me anë të cedimit dhe pjesëtimit nuk hynë në pasurinë trashëgimore të ceduesit dhe as nuk merret për bazë në përcaktimin e vlerës së pasurisë trashëgimore (neni 61 par 1 dhe 2 LTK).

1.11.4 Kur konsiderohet pjesa e ceduar si dhurim

Pjesët e pasurisë që u janar ceduar pasardhësve, por, me të cilin cedim nuk është pajtuar ndonjë trashëgimtarë, konsiderohet si dhurim dhe pas vdekjes së ceduesit – paraardhësit me to do veprohet si me dhurimet e bëra trashëgimtarëve. Në të njëjtën mënyrë do veprohet edhe në rastin kur ceduesit, pas cedimit apo pjesëtimit të bërë me marrëveshje me gjithë trashëgimtarët, i lind fëmijë apo paraqitet trashëgimtari që ka qenë shpallur i vdekur (neni 62 LTK).

1.11.5 Shuarja kontratës mbi cedimin dhe pjesëtimin e pasurisë

Cedusi ka të drejtë të kërkoj shkëputjen e kontratës në mënyrë të njëanshme dhe kthimin e pasurisë, nëse përfituesit e cedimit dhe pjesëtimit kanë treguar mosmirënjohje të vrazhdë ndaj tij. Nëse kthimi i sendit është i pamundur atëherë duhet të kthehet vlera e sendit të ceduar në pajtim me dispozitat e pasurimit të pabazë. Një veprim të tillë cedusi mund ta ndërmerret edhe në rastet kur përfituesi i cedimit nuk i jep atij apo ndonjë personi tjetër ushqimin e caktuar, nuk paguan borxhet e ceduesit apo ndonjë personi tjetër, të cilat detyrime i kanë parapa në kontratën për

cedimin apo pjesëtimin e pasurisë. Gjykata, duke i kushtuar kujdes rëndësisë së detyrimit për cedimin dhe rrethanave të tjera të rastit, do të vendosë se a ka të drejtë ceduesi të kërkojë kthimin e të mirave që i ka dhënë apo vetëm të drejtën të për mbushjen e detyrimeve (neni 66 LTK).

1.11.6 Të drejtat e trashëgimtarëve pas shuarjes së kontratës

Pasardhësi që ka qenë i detyruar t'i kthejë ceduesit atë që ka marrë me rastin e cedimit dhe pjesëtimin do të mund të kërkojë pjesën e vet të detyrueshme pas vdekjes së ceduesit, me kusht që to mos jetë përjashtuar nga trashëgimi, të mos jetë i padenjë të trashëgojë ceduesin dhe të mos ketë hequr dorë nga trashëgimi. Kur llogaritet madhësia e pjesës së domosdoshme të tij, pjesët e pasurisë që trashëgimlënësi gjatë jetës së vet ua ka ceduar dhe pjesëtuar pasardhësve të tjerë të tij do të konsiderohen si dhurim.

1.12 Ushtrime

Pjesëmarrësve gjatë këtij moduli do t'iu prezantohet një shembull praktik dhe pas punës në grupe ata do të japin mendimet e tyre lidhur me shembullin dhe zgjidhjet që mendojnë lidhur me rastin e paraqitur.

1.13 Përmbledhje

Në fund të prezantimit do të nxirren përfundimet për njohuritë e fituara nga pjesëmarrësit lidhur më temat e prezantuara.

Në këtë fazë sipas nevojës do të jepen shpjegime shtesë lidhur më çështjet të cilat eventualisht do të konsiderohen si të pasqaruara në masën e duhur dhe do të bëhen përpjekjet që secila çështje e cila është përfshirë në temën e prezantimit të sqarohen.

2. Trashëgimia në bazë të testamentit, Padenjësia dhe përjashtimi i trashëgimtarëve të domosdoshëm, procedura për shqyrtimin e trashëgimisë, hapja e trashëgimisë, si dhe ndarja e trashëgimisë

2.1 Hyrje

Në kuadër të këtij sesioni do të trajtohen çështje me rëndësi nga e drejta trashëgimisë dhe atë në lidhje me trashëgimin në bazë të testamentit, përmbajtjen e testamentit, padenjësinë dhe përjashtimin e trashëgimtarëve të domosdoshëm, hapjen e trashëgimisë, procedurën për shqyrtimin e trashëgimisë, etj.

2.2 Objektivat trajnuese

Si rezultat i këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Avancojnë njohurit lidhur me trashëgiminë në bazë të testamenti, llojet e testamentit dhe përmbajtja e tij;
- Avancojnë njohurit e tyre lidhur me procedurën e shqyrtimit të trashëgimisë, hapjen e trashëgimisë dhe ndarjen e pasurisë trashëgimore;
- Krijojnë ide të qarta për padenjësinë dhe përjashtimin e trashëgimtarëve të domosdoshëm.

2.3 Trashëgimia në bazë të testamentit

2.3.1 Kuptimi i testamentit

Testamenti është një veprim juridik i njëanshëm i kryer nga vet trashëgimlënësi, me anë të cilit ky disponon pasurinë për kohën pas vdekjes. Testamenti është deklaratë e fundit e vullnetit, e njëanshme, rigorozisht personale, e personit me zotësi testamentare, e rregulluar me ligj, me të cilën disponon pasurinë pas vdekjes së tij dhe eventualisht jep urdhëresa të tjera dhe deklarata lidhur me pasurinë e tij. Testatori mund të lë shumë teste, por ato duhet të përmbajnë vetëm një vullnet të fundit të trashëgimlënësit.

2.3.1 Zotësia për të përpiluar testamentin

Kushti thelbësor që një testament të jetë i vlefshëm është që testatori të ketë pasur zotësinë e bërjes së testamentit. Është rregull që një person për të lënë një testament duhet që në mënyrë komulative t'i plotësoj këto kushte, të cilat janë parapa në nenin 70 të LTK, dhe atë:

1. Të ketë mbushur 18 vjet, apo 16 vjet, por me kusht që të jetë i martuar.
2. Të ketë zotësinë për të vepruar.

2.3.2 Llojet e testamentit

Legjislacioni ynë për trashëgimin njeh këto lloje të testamentit, të cilët do trajtohen ne vijim

1. Testamenti i shkruar me dorë të vetë testatorit (neni 74 të LTK). Këtë testament testatori duhet ta ketë shkruar që nga fillimi e deri në mbarim me dorën e vet, si dhe ta ketë datuar dhe nënshkruar ose ta ketë venë gishtin e vet.
2. Testamenti me shkrim në prani të dy dëshmitarëve (neni 75 të LTK). Ky testament shkruhet nga dikush tjetër sipas tregimit të testatorit e jo nga testatori, por pasi që ta ketë lexuar testatori tekstin e shkruar të testamentit dhe të ketë deklaruar se ky është testamenti imë, e nënshkruan, dhe e daton në prani të dy dëshmitarëve që e kuptojnë gjuhën e testatorit dhe që kanë zotësi për të vepruar.
3. Testamenti gjyqësor (*testamentum giudiciale neni 76 LTK*) quhet testamenti të cilin e përpilon gjyqtari sipas tregimit të vullnetit të fundit të trashëgimlënësit, në mënyrën dhe kushtet e parapara me ligj. Gjyqtari i gjykatës kompetente është i obliguar që pasi të vërtetojë identitetin e tij ta njofton me pasojat juridike të testamentit.

Në rastet e caktuara kur testatori nuk është në gjendje të lexojë, testamentin e përpilon vetë gjyqtari dhe e lexon në praninë e dy dëshmitarëve, të cilin pas leximit e nënshkruan vet testatori, përkatësisht e vënë shenjën e gishtit të vet, me të cilin rast testamentin duhet të nënshkruajnë edhe vetë dëshmitarët.

Testatori mund ti besoj për ruajtje gjykatës sikur testamentin e bërë në gjykatë, ashtu që edhe testamentin që e ka përpiluar vetë. Me rastin e pranimin të këtij testamenti gjykata harton në procesverbal, e vendos në një pliko, e vulos dhe e ruan në gjykatë.

4. Testamenti në rrethana të jashtëzakonshme -Në raste të tilla testatori shprehë vullnetin e tij të fundit me gojë para dy dëshmitarëve që nuk është e domosdoshme të dinë shkrim-leximin, kur për shkak të rrethanave të caktuara nuk mundë ta bënë atë me shkrim apo në ndonjë formë tjetër.

Këta dëshmitar qëndrojnë në obligim, duhet ta përpilojnë një deklaratë me shkrim të testatorit dhe si të tillë ta dorëzojnë në gjykatë, apo edhe fjalët e fundit të testatorit drejtë për drejtë në gjykatë ti përsërisin duke treguar se kur, ku dhe në çfarë rrethana testatori ka deklaruar vullnetin e tij të fundit.

Këta dëshmitar janë të obliguar që pas përfundimit të rrethanave të jashtë zakonshme në afat prej 30 ditësh të deklarohen në gjykatë mbi shprehjen e vullnetit të fundit të testatorit

5. Testamenti noterial- këtë lloj të testamentit nuk e ka rregulluar ligji për trashëgimin, por me hyrjen në fuqi të ligjit për noterinë dhe funksionalizimin e sistemit noterial, tanimë ka filluar të aplikohet edhe në Kosovë. Kushtet për vlefshmërinë e testamentit noterial dhe mënyra e përpilimit të tij janë të njëjta si të testamenti gjyqësor, por si person zyrtarë merr pjesë noteri e jo gjyqtari.

2.3.3 Karakteristikat e testamentit

Testamentin e veçojnë nga punët tjera juridike shumë karakteristika të rëndësishme e të cilat do trajtohen në vijim.

- Testamenti është akt rigoroz personal

Testatori është i obliguar personalisht ta shfaqë vullnetin e fundit duke përcaktuar qartë përmbajtjen e testamentit. Këtu nuk mundë të ia lë gjykatës apo ndokujt tjetër që ta bëjë në emër të këtij personi. Me rastin e përpilimit të testamentit përjashtohet çdo mundësi e përfaqësimit.

- Testamenti është punë juridike mortis causa

Testamenti prodhon efekte juridike vetëm në çastin e vdekjes së trashëgimlënësit, kur pasuria trashëgimore me forcën e ligjit kalon në trashëgimtarë. Pra, duhet thuhet se vdekja e personit të caktuar është element thelbësor për fillimin e prodhimit të efekteve juridike të punës juridike *mortis causa*.

- Testamenti është punë juridike bamirëse

Testamenti është gjithmonë punë bamirëse pa kundër shpërblim. Edhe atëherë kur trashëgimtarët ngarkohen me borxhe, me barrë, testamenti ka karakter bamirës, sepse vlera e borxheve dhe e barrave duhet të jetë të paktën në proporcion me përpjesën e tyre dhe deri në vlerën e pjesës së tyre të pasurisë trashëgimore.

- Testamenti është punë juridike e një anshme

Testamenti është akt juridik i një anshëm nga se lind dhe prodhon efekte juridike vetëm me deklarimin e një vullneti të fundit. Vullneti i fundit i formuluar në testament duhet të jetë vullnet i vërtetë, real, i shfaqur lirshëm nga trashëgimlënësi.

- Testamenti është akt formal juridik

Një ndër kushtet që duhet me qenë një testament i vlefshëm është plotësimi i kërkesës ligjore lidhur me formën e paraparë me ligj. Në bazë të këtij fakti mundë të konkludohet se testamenti bënë pjesë në punët juridike formale, për vlefshmërinë e të cilave kërkohet forma e paraparë me ligj.

2.3.4 Revokimi i testamentit

Testamenti si akt juridik universal mundë të revokohet tërësisht apo pjesërisht në çdo kohë nga trashëgimlënësi. Në kuptim të dispozitës së nenit 107.1 të LTK-së trashëgimlënësi mund ta revokojë kurdoherë testamentin në tërësi ose pjesërisht. Ketë mundë ta bëjë me shkrim, sipas procedurës së përcaktuar me ligj apo me asgjësim të dokumentit. Pasi ta revokoj testamentin trashëgimlënësi, revokimi shënohet në testament i cili ruhet në gjykatë (neni 190 i Ligjit të Procedurës Jokontestimore).

2.3.5 Shkaqet kryesore mbi pa vlefshmërinë e testamentit

Janë tri shkaqe kryesore që si pasojë kanë pavlefshmërinë e testamentit edhe atë:

- kanosja, shtrëngimi, mashtrimi, lajthitja mbi shkaqet që kanë shtyrë trashëgimlënësin për të bërë testamentin;
- mungesa e formës së kërkuar me ligj, dhe
- mungesa e lirisë së vullnetit të testatorit.

Testamenti është i pa vlefshëm nëse është bërë me kanosje, me shtrëngim dhe me mashtrim. Vullneti i trashëgimlënësit përmban të meta kur nuk është shprehur në mënyrë serioze, reale dhe të lirë. Kanosja dhe shtrëngimi shkaktojnë frikë të trashëgimlënësi e kur ndjekja e frikës është shkak vendimtar për vendosjen e trashëgimlënësit për të bërë testament, atëherë ky testament është i pa vlefshëm. Në kuptim të dispozitës së nenit 71 të LTK-së edhe disponimet në testament janë të pa vlefshëm edhe kur ekziston lajthitja mbi shkaqet që kanë shtyrë trashëgimlënësin për të bërë këto disponime.

Testamenti është i pa vlefshëm atëherë kur mungon forma e kërkuar me ligj. Për të qenë i plotfuqishëm kërkohen të plotësojë tri kushte kryesore edhe atë:

- testatori ta ketë shkruar tërësisht me dorën e vet;
- ta ketë nënshkruar me dorën e vet ose ta ketë vënë gishtin e vet, dhe
- ta ketë ditur duke treguar ditën, muajin dhe vitin e bërjes së testamentit.

Mungesa e zotësisë aktive të testamentit po ashtu është shkak i nulimit të testamentit. Raste të tilla paraqiten kur testamenti është bërë nga personi i cili nuk ka mbushur 18 vite, përkatësisht 16 vite. Humbja e më vonshme e kësaj zotësie, u tha edhe më lartë, nuk prekë vlefshmërinë e testamentit.

2.3.6 Vëllimi i pavlefshmërisë së testamentit

Një testament mund të jetë tërësisht i pa vlefshëm ose vetëm një pjesë e tij dhe kjo do të varet në radhë të parë nga shkaku i pa vlefshmërisë dhe nga ajo se personi i interesuar a kërkon pavlefshmërinë e tërë testamentit apo një pjesë të tij.

Në praktikë paraqiten raste të shpeshta kur testamenti është pjesërisht apo tërësisht i pa vlefshëm.

2.3.7 Testamenti absolut nul

Testamenti është absolut nulë nëse dispozitat e tija janë në kundërshtim me dispozitat imperative ligjore, me rendin juridik dhe me rregullat e moralit. E drejta për të vërtetuar pavlefshmërinë nuk shuhet dhe në këtë nuk preket në rregullat e mbajtjes, fitimin nga jo pronari dhe në parashtrimin e kërkesave.

2.3.8 Testamenti relativ nul

Një testament është relativ nul vetëm atëherë nëse shkaqet e nulitetit cenojnë interesat individuale të caktuara në kuptim të dispozitës së nenit 85 të LTK-së, nulimin e testamentit për shkak të formës së kërkuar me ligj mundë ta kërkojë pas hapjes së trashëgimisë vetëm personi që ka interes juridik edhe atë brenda një viti nga dita që merr njohuri për testamentin e më së largu brenda 10 viteve pas shpalljes së testamentit.

2.3.9 Përmbajtja e testamentit

Përmbajtjen e testamentit e përbëjnë urdhrat që dalin nga dispozitat e testamentit, pra, ajo përbëhet nga:

- caktimi i trashëgimtarëve,
- përcaktimi i pasurisë që do tu kalojë trashëgimtarëve (këtu mund të përfshihet gjithë pasuria trashëgimore apo vetëm një pjesë e saj),
- detyrimet që u ngarkohen trashëgimtarëve testamentar ose ligjor për dorëzimin e një pjese të pasurisë trashëgimore personave të tjerë (legu) dhe
- caktimi i zbatuesit të testamentit.

Në kuptim të dispozitës së nenit 87 të LTK-ës parashihet mundësia që trashëgimlënësi të caktojë me testament një ose më shumë trashëgimtar, që të trashëgojë tërë pasurinë e tij, ose një pjesë të pasurisë, pastaj që një apo më shumë personave u është lënë një apo më shumë sende etj. Për caktimin e trashëgimtarëve ose pasurisë trashëgimore ose të pjesës së sajë, me vullnetin e fundit të lirë të trashëgimlënësit, nuk mund të ketë as testament të plotfuqishëm dhe në bazë të normave ligjore.

Përmbajtja formale e testamentit ka të bëjë me rastin e caktimit të ndonjë ekzekutori të testamenti, apo caktimin e të ashtuquajturit konkretizor të vullnetit të testatorit vetëm në lidhje të veçantë në testament, p.sh., që të kujdeset vetëm për përmbushjen e urdhrit. Sa i përket caktimit të trashëgimtarëve me testament është i njohur edhe instituti i substitutit, me të cilin kuptojmë caktimin e përfaqësuesit të trashëgimtarit në rastet kur ai nuk mund ose nuk do të trashëgojë trashëgimlënësin.

2.3.10 Barrët, afatet dhe kushtet

Testamentari mund ta ngarkojë me ndonjë detyrim personin të cilit i lë ndonjë përfitim nga pasuria trashëgimore.

Njëherit me testament mund të lihen edhe kushte dhe afate për përmbushjen e detyrimeve të caktuara.

Në situata të caktuara e posaçërisht kur kemi të bëjmë me kushte jo morale, si të tilla kushte janë inekzistente.

2.3.11 Ruajtja e testamentit

Mënyra e ruajtjes nuk ka ndonjë rëndësi të natyrës së atillë sa i përket vlefshmërisë së testamentit. Me norma ligjore është rregulluar vetëm mënyra e dorëzimit dhe ruajtjes së testamentit gjyqësor. Testamentin mund ta ruajë vetë testatori, tek çdo person fizik apo juridik, por mund ta ruajë edhe në gjykatë. Shkenca juridike njehë tri mënyra të ruajtjes së testamentit, edhe atë:

- ruajtja e testamentit nga vetë testatori,
- ruajtja e testamentit nga personi i besuar dhe
- ruajtja e testamentit në institucione me depozitë (bankë , postë etj)

2.3.12 Interpretimi i testamentit

Gjetja e qëllimit të vërtetë të testatorit të manifestuar në deklaratën e vullnetin e fundit konsiderohet interpretim i testamentit. Në raste të caktuara kur paraqiten dyshime përkitazi me përmbajtjen e testamentit, aplikohen normat të cilat janë në favor të trashëgimtarëve ligjor. Interpretimi bëhet në forma të ndryshme. Shkenca i njeh dy forma të interpretimit atë: objektive dhe subjektive, e që një rëndësie më të madhe i kushtohet metodës subjektive.

2.3.13 Legu

Testatori mund të lërë në testament një ose më shumë lege. Kjo nënkupton se testatori në testament mund të urdhërojë trashëgimtarin ose ndonjë person tjetër të cilit i ka lënë një pjesë të pasurisë së tij, t'ia jep personit të caktuar një shumë të hollash, ta liroj nga ndonjë borxhë, të përmbahet nga ndonjë veprim ose të fitoj diçka, apo të bëjë diçka për të (neni 93 LTK).

2.4 Padenjësia dhe përjashtimi i trashëgimtarëve të domosdoshëm

2.4.1 Padenjësia

Padenjësia për të trashëguar është institucion juridik trashëgimor me paraqitjen e të cilit një person (ex lege) humb autorizimit juridike të trashëgimtarit. Mirëpo, në kuptim të dispozitës së nenit 110.2 të LTK, padenjësia nuk i pengon pasardhësit të personit të padenjë të trashëgojnë sikurse personi i padenjë të kishte vdekur para trashëgimtarit.

Sipas nenit 111 të LTK i padenjë për të trashëguar është ai person që:

- a) Me dashje ka vvarë ose ka tentuar të vrasë trashëgimtarin, bashkëshortin, fëmijët dhe prindërit e tij;
- b) Ka bërë ndaj trashëgimtarit kallëzim ose dëshmi të rreme, për kryerjen e një vepre penale për të cilën parashikohet dënim me heqje lirie;
- c) Me mashtrim, kanosje e dhunë ka shtyrë trashëgimtarin të bëjë, të ndryshojë ose të shfuqizojë testamentin ose ka përpiluar vetë një testament të rremë ose e ka përdorur atë për interesa të tij apo të të tjerëve;
- d) Është sjellë ndaj trashëgimtarit në mënyrë poshtëruese dhe e ka keqtrajtuar atë;
- e) Nuk e ka përmbushur detyrimin për të mbajtur apo ndihmuar trashëgimtarin.

2.4.2 Vlerësimi i padenjësisë

Për disa shkaqe që shkaktojnë padenjësinë e një personi për trashëgim, gjykata është e detyruar të kujdeset zyrtarisht e për disa arsye të tjera vetëm atëherë kur pala ngre një kundërshtim. Në kuptim të dispozitës së nenit 112 të LTK-së, për padenjësinë gjykata kujdeset kryesisht, përveç në rastet e padenjësisë për shkeljen e detyrimit të mbajtjes dhe për shkak të mos dhënies së ndihmës së domosdoshme.

2.4.3 Përjashtimi nga trashëgimia e trashëgimtarit të domosdoshëm

Me përjashtim nga trashëgimi duhet të kuptojmë heqjen e cilësisë së trashëgimtarit ligjor nga ana e trashëgimlënësit me deklarin e vullnetit të fundit, ashtu që ai nuk fiton asgjë nga pasuria trashëgimore.

Kështu Ligji mbi Trashëgimin i Kosovës në dispozitën e nenit 114 ka paraparë se kur mund të bëhet përjashtimin i trashëgimtarit nga trashëgimia e domosdoshëm, edhe atë:

- nëse ai me shkeljen e ndonjë detyrimi ligjor ose moral ka bërë cenimin e rëndë ndaj trashëgimlënësit;
- nëse ka bërë me dashje vepër të rëndë penale ndaj trashëgimlënësit, bashkëshortit, fëmijëve ose ndaj prindërve të tij, dhe
- nëse është plëngprishës, nuk do të punojë ose është dhënë pas jetës së pandershme.

2.5 Procedura për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore

Procedura trashëgimore paraqet një tërësi veprimesh të ndërmarra nga gjykata për vërtetimin e pasojave juridike të trashëgimisë, pas vdekjes së trashëgimlënësit dhe përcaktimin e masave dhe veprimeve për mbrojtjen e pasurisë trashëgimore si dhe të drejtat që prej sajë burojnë. Ligji për trashëgiminë i Kosovës nuk ka rregulluar me norma ligjore institutin e procedurës trashëgimore veç se me dispozitën e nenit 145, ka autorizuar gjykatat, organet të tjera dhe personat e autorizuar të zbatojnë në çështjet e trashëgimisë, dispozitat e procedurës jokontestimore.

Në bazë të nenit 125 të Ligjit të Procedurës Jokontestimore, gjykata konstaton se kush janë trashëgimtarë të vdekurit, cila pasuri përbën pasurinë e tij trashëgimore dhe cilat të drejtat nga pasuria trashëgimore u takojnë trashëgimtarëve, legatarëve dhe personave të tjerë.

2.6 Parimet e procedurës së shqyrtimit të trashëgimisë

Parimet themelore të procedurës për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore janë:

- parimi i urgjentitetit;
- parimi i socialitetit;
- parimi i zyrtaritetit dhe
- përjashtimi i parimit të drejtë përdrejtëshmërisë.

2.7 Kompetenca vendore

Gjykata e cila ka kompetencë vendore për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore, quhet ndryshe gjykatë trashëgimore. Në kuptim të dispozitës së nenit 128. 1 të Ligjit mbi Procedurën Jokontestimore, për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore territorialisht është kompetente gjykata komunale - tani gjykata themelore, në jurisdikcionin e të cilës trashëgimlënësi në kohën e vdekjes ka pasur vendbanimin e përhershëm ose të përkohshëm. Ndërkaq në pikën 2 të nenit 128 të po këtij ligji është parapa që në qoftë se trashëgimlënësi në kohën e vdekjes nuk ka pasur as vendbanim të përhershëm e as të përkohshëm në territorin e Republikës së Kosovës, kompetente është gjykata, në jurisdikcionin e së cilës gjendet pjesa më e madhe e pasurisë trashëgimore të tij.

2.8 Kompetenca lëndore

Për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore kompetencën lëndore e ka Gjykata Themelore, e cila është e autorizuar për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore dhe nxjerrjes së vendimit gjegjës. Kompetenca lëndore është e caktuar me ligj ndërsa palët nuk mund ta ndryshojnë këtë me marrëveshje.

2.9 Kompetenca funksionale

Kompetenca funksionale është lloj i kompetencës lëndore. Me rregullat për kompetencën funksionale bëhet ndarja e veprimeve procedurale a e punëve ose e fazave të ndryshme nëpër të cilat kalon procedura e shqyrtimit të pasurisë trashëgimore.

2.10 Kompetenca ndërkombëtare

Pasi ta ketë marrë aktvdekjen dhe certifikatën nga libri amëz i të vdekurve gjykata me vendim do të shpallet inkompetent dhe do të ndërpresë procedurën nëse gjen se për shqyrtimin e trashëgimisë është kompetent gjykata e huaj. Në bazë të dispozitës së nenit 147. 2 të LTK-së është përcaktuar se në qoftë se në shtetin e shtetasit të huaj shqyrtohet pasuria trashëgimore e shtetasit të Kosovës, sipas ligjit atij shteti, atëherë edhe pasuria trashëgimore e shtetaseve të atij shteti të huaj që ndodhet në territorin e Republikës së Kosovës, do të shqyrtohet sipas dispozitave të ligjit të Kosovës. Nga kjo rezulton se ligji mbi trashëgiminë i Kosovës ka gjetur zgjedhjen më të drejtë, zbatimin e parimit të reciprocitetit. Përkitazi me kompetencën ndërkombëtare edhe ligji mbi procedurën jokontestimore neni 129.2 në mënyrë decisive e rregullon çështjen e kompetencës ndërkombëtare .

2.11 Përgatitja e seancës trashëgimore

Gjykata sipas ligjit është e autorizuar të kryej një sërë veprimesh procedurale përpara mbajtjes së seancës trashëgimore. Si veprime paraprake konsiderohen:

- përpilimi i aktvdekjes;
- masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë trashëgimore;
- regjistrimi dhe vlerësimi i pasurisë dhe
- emërtimi i kujdestarit të përkohshëm të pasurisë trashëgimore.

2.11.1 Përpilimi i aktvdekjes

Në afat prej 15 ditësh kur një person vdes ose shpallet si i vdekur, nëpunësi i gjendjes civile që e bën regjistrimin e vdekjes, ka për detyrë që pas këtij regjistrimi t'ia dërgojë aktvdekjen gjykatës trashëgimore. Nëse nuk ka shënime të mjaftueshme gjykatës do t'ia dërgojë aktvdekjen vetëm me ato shënime që disponon.

Në bazë të nenit 102 të LPJK-ës aktvdekja i përmban shënimet e nevojshme që në bazë të kësaj aktvdekje mund të shqyrtohet pasuria trashëgimore. Pas pranimit të aktvdekjes, gjykata ndër të tjera është e obliguar ti kryej disa veprime tjera procedurale. **E para**, të hetoj nëse është kompetente, dhe **e dyta** të verifikoj se trashëgimlënësi a ka lënë testament. Në rrethana të caktuara përpilimin e aktvdekjes mund ta bëjë edhe vet gjykata.

2.11.2 Masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë trashëgimore

Gjatë gjitha fazave të zhvillimit të procedurës për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore, gjykata mund ta caktojë masën e përkohshme për sigurimin e pasurisë trashëgimore. Masat për sigurimin e pasurisë trashëgimore mund të urdhërohen:

- nga gjykata në rajonin e së cilës gjendet pasuria trashëgimore, dhe
- nga gjykata në juridikcionin e së cilës ka vdekur trashëgimlënësi.

2.11.3 Regjistrimi dhe vlerësimi i pasurisë

Regjistrimi dhe vlerësimi i pasurisë trashëgimore bëhet me qëllim të sigurimit të pasurisë që ajo të jetë e mbrojtur nga vjedhja, fshehja, ose asgjësimi. Ky regjistrim bëhet me vendim të gjykatës, mirëpo në situata të caktuara mund të bëhet edhe pa vendim.

Në mbështetje të dispozitave të neneve 138 -147 të LPJK-së bëhet inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë trashëgimore, e që përfshihet :

- tërë pasuria e luajtshme dhe e pa luajtshme ;
- pasuria që i ka takuar trashëgimlënësit e që gjendet te personi tjetër apo edhe pasuria që gjendet te trashëgimlënësi dhe është pronë e dikujt tjetër, dhe
- në regjistrin e pasurisë do të shënohet edhe kërkesat dhe borxhet e trashëgimlënësit sikur edhe obligimet e tij (p.sh. borxhet, tatimi etj.)

2.11.4 Koha e hapjes së trashëgimisë

Trashëgimia hapet në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit, sipas dispozitës së nenit 5 të LTK-së, personi i vdekur fizik (trashëgimlënësi) e trashëgon ai i cili në momentin e vdekjes së tij ka fituar të drejtën trashëgimore (trashëgimtar), pra edhe nga kjo dispozitë ligjore rezulton në mënyrë të padyshimtë se momenti i vdekjes së trashëgimlënësit, është edhe momenti i hapjes së trashëgimisë.

Hapja e trashëgimisë sjell kalimin e të drejtave pasurore të trashëgimlënësit tek trashëgimtarët e tij. Në kuptim të dispozitës së nenit 7.1 të LTK-ës, personi që në kohën e hapjes së trashëgimisë është gjallë ose është zënë para vdekjes së trashëgimlënësit dhe ka lind i gjallë ka zotësi për të trashëguar. Po sipas kësaj dispozite ligjore konsiderohet se ka qenë i zënë nëse në kohën e hapjes së trashëgimisë ai person që ka qenë i lindur gjallë brenda 300 ditëve nga dita e vdekjes së trashëgimlënësit.

2.11.5 Vendi i hapjes së trashëgimisë

Vendi i hapjes së trashëgimisë është vendqëndrimi ose vendbanimi i trashëgimlënësit. Nëse trashëgimlënësi ka qenë jashtë Kosovës, vendi i hapjes së trashëgimisë konsiderohet vendi ku trashëgimlënësi ka pasur vendqëndrimin ose vendbanimin e fundit dhe në raste të caktuara edhe ku ndodhet pasuria e tij trashëgimore.

2.11.6 Seanca trashëgimore

Seanca trashëgimore është stadi qendror dhe themelor i procedurës trashëgimore. Në atë rast gjykata do të shqyrtojë gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pasurinë trashëgimore, sidomos me të drejtën e trashëgimit, me madhësinë e pjesës trashëgimore dhe me të drejtën e legut.

Gjithashtu në seancë gjykata do të shqyrtojë gjitha çështjet e rëndësishme për marrjen e vendimit meritor, deri në mbarim të seancës trashëgimore. Trashëgimtari mund të heq dorë nga pjesa trashëgimore që do ti takonte, apo të deklarohet se e pranon trashëgiminë.

Deklarimi nuk mund të bëhet me kushte ose pjesërisht. Deklaratën për heqjen dorë nga trashëgimi trashëgimtari mund ta jep edhe para gjykatës trashëgimore ose edhe para çdo gjykate tjetër komunale – tani themelore (neni 122 pika 4 e LPJK-së).

Me rastin e shqyrtimit të pasurisë trashëgimore personat e interesuar mund të japin deklarata pa praninë e personave të tjerë të interesuar dhe nuk ka nevojë që këtyre personave në çdo rast tu jepet mundësia që të deklarohen lidhur me deklaratat e personave tjerë të interesuar (neni 121 pika 3 e LTK-së).

Gjykata në seancën e shqyrtimit mbledhë fakte, duke vërtetuar ekzistimin e Testamentit, të legut apo edhe të ndonjë fakti tjetër sipas detyrës zyrtare apo edhe në ndonjë mënyrë tjetër. Në rast se kur palët kundërshtojnë vlerësimin ose regjistrimin e pasurisë mund të urdhërohet një vlerësim i ri, apo në situata të caktuara edhe vetë gjykata mund të bëjë përcaktimin e pasurisë trashëgimore.

2.11.7 Udhëzim i palëve në kontest civil

Gjykata trashëgimore nuk është e autorizuar për ti vërtetuar vetë faktet kontestuese prej të cilave do të varet konkludimi për ekzistimin e së drejtës trashëgimore, të legut ose për ekzistimi e ndonjë të drejte tjetër nga pasuria trashëgimore, nga përbërja e pasurisë trashëgimore apo nga objekti i testamentit. Po qe se ndërmjet palëve janë kontestuese faktet nga të cilat varët ndonjë e drejtë e tyre, në bazë të dispozitës së nenit 166 të LPJK-së, do të ndërpres shqyrtimin e pasurisë trashëgimore dhe do ti udhëzojë palët që ta fillojnë kontestin ose procedurën para organit kompetent.

2.11.8 Udhëzim në kontest për shkak të konfliktit rreth të drejtës apo aplikimi të së drejtës

Në situata të caktuara trashëgimtarët mund të bien në konflikt si për faktet ashtu edhe për aplikimin e së drejtës. Në bazë të nenit 169 të LPJK-së, gjykata është e autorizuar të ndërpres shqyrtimin e pasurisë trashëgimore dhe ti udhëzojë palët që të fillojnë kontestin ose procedurën para organit kompetent në këto raste:

- Në qoftë se në mes trashëgimtarëve ka konflikt rreth faktit se a hyn ndonjë pasuri në pasurinë trashëgimore dhe
- në qoftë se ndërmjet trashëgimtarëve ka konflikt lidhur me kërkesën e të paslindurve të trashëgimlënësit, me të cilit kanë bashkëjetuar në një familje apo që nga pasuria trashëgimore duhet të veçohet pjesa që i përgjigjet kontributit të tyre në vlerën e pasurisë trashëgimore.

Nuk do të ndërpritet shqyrtimi i trashëgimisë në qoftë se mes palëve gjykata e vërteton se ekziston konflikti rreth së drejtës së legatorit ose ndonjë të drejte tjetër nga pasuria trashëgimore. Këtë gjykata do ta bënë duke marrë parasysh natyrën juridike të së drejtës së legut si një e drejtë individuale, me bindje se nuk do të dëmtohet e drejta e legut.

2.11.9 Aktvendimi mbi trashëgiminë

Në bazë të rezultateve të procedurës për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore, gjykata trashëgimore vendosë me aktvendim për trashëgiminë. Kur konstaton se cilëve personave u takon trashëgimia ata i shpall trashëgimtarë të pasurisë trashëgimore me aktvendim në kuptim të dispozitës së nenit 171 të LPJK-së.

2.11.10 Pasuria e gjetur pas marrjes së aktvendimit të plotfuqishëm

Me aktvendimin për trashëgimi duhet të vendoset për gjithçka që hynë në pasurinë trashëgimore dhe për të gjitha të drejtat lidhur me pasuri. Gjetja e mëvonshme e pasurisë trashëgimore obligon gjykatën qoftë sipas detyrës zyrtare qoftë në bazë të kërkesës së palëve të filloj procedurën dhe të marrë aktvendim plotësues për trashëgimi .

2.11.11 Gjetja e testamentit pas plotfuqishmërisë së aktvendim për trashëgim

Testamenti i gjetur pasi të jetë bërë i plotfuqishëm aktvendimi për trashëgimi apo aktvendimi për legatarin, do të ketë kuptimin e faktit të ri. Ekzistimi i këtij fakti të ri krijon bazën juridike që palët në procedurën kontestimore ti realizojnë kërkesat e tyre.

Në kuptim të dispozitës së nenit 183.1 të LPJK nëse pasi të jetë bërë i plotfuqishëm aktvendimi për trashëgimi ose aktvendimi për legatin gjendet testamenti, gjykata do ta shpallë atë dhe procesverbalin për shpalljen dhe kopjen e testamentit do t'ia dërgojë gjykatës trashëgimore, ndërsa origjinalin e mbanë për vete.

Në këtë rast nuk do të shqyrtohet pasuria trashëgimore por në kuptim të dispozitës së nenit 183.2 të LPJK-së, palët mund të realizojnë të drejtat e tyre në procedurën kontestimore. Edhe në rastet kur më vonë është paraqitur ndonjë trashëgimtarë edhe në këtë rast ky trashëgimtarë udhëzohet që të drejtën e tij ta realizojë në kontest civil.

2.12 Ndarja e pasurisë trashëgimore

Çdo trashëgimtarë në çdo kohë mund të kërkojë ndarjen e trashëgimisë, e drejtë kjo e cila nuk parashkruhet, ndërkaq nuk janë të pranueshme kontratat mbi të cilën trashëgimtari heq dorë nga e drejta që të kërkojë ndarjen e trashëgimit apo edhe dispozitat të testamentit në të cilën kufizohet ndarja.

2.12.1 Bashkësia e trashëgimisë

Trashëgimtarët e administrojnë dhe disponojnë bashkërisht pasurinë trashëgimore deri në momentin e ndarjes. Në rast të kontestit mes tyre përkitazi me administrimin e pasurisë trashëgimore apo edhe në mungesë të ekzekutuesit të testamentit, gjykata do ta caktojë

administratorin. Administrator mund të jetë edhe ndonjëri nga trashëgimtarët. Administratori me leje të gjykatës mund të ndërmer veprime të caktuara.

2.12.2 Cedimi i pjesës trashëgimore para ndarjes

Në situata të caktuara para ndarjes trashëgimtari mund ta cedojë pjesën e vet vetëm te bashkëtrashëgimtarët. Forma e cedimit është rregulluar me ligjin mbi detyrimet. Bashkëtrashëgimtarët kanë të drejtën e parablerjes. Kjo e drejtë parashkruhet ndaj secilit bashkëtrashëgimtarë brenda afatit prej 2 muajsh, nga dita e njoftimit.

2.12.3 E drejta e trashëgimtarëve që kanë bashkëjetuar ose kanë punuar në një bashkësi me trashëgimlënësin

Në rastet kur gjykata gjen se ka baza të arsyeshme mund të vendos që disa sende të luajtshme ose të paluajtshme ose grupe sendesh që do ti takonin pjesës së trashëgimtarëve të tjerë me kërkesë të trashëgimtarëve tu lejoj atyre që brenda afatit të caktuar të paguajnë shumën e vlerës së këtyre sendeve, mirëpo nëse brenda këtij afatit të caktuar nuk do të bëjnë pagesën e kësaj shume, trashëgimtarët e tjerë e kanë të drejtën që këto sende tua dorëzojnë apo eventualisht të obligojnë në përmbushjen e obligimeve.

2.12.4 Ndarja e sendeve të shtëpisë

Në situata të caktuara, sendet e shtëpisë që shërbejnë për plotësimin e nevojave të përditshme të trashëgimtarëve që ka bashkëjetuar me trashëgimlënësin në të njëjtën familje dhe nuk është pasardhës apo bashkëshort i tij, do të lihen në kërkesën e tij, ndërsa vlera e tyre do të llogaritet në pjesën e këtij trashëgimtari.

Nëse vlera e sendeve e tejkalon vlerën e pasurisë trashëgimore, trashëgimtari duhet të paguaj diferencën trashëgimtarëve të tjerë.

2.12.5 Detyrimi i mbajtjes midis trashëgimtarëve pas vdekjes

Në raste të caktuara kur një person i tretë merr një send që trashëgimtari ka fituar ose në mënyrë të ligjshme kufizon ushtrimin e një të drejte kur trashëgimtari ka fituar në ndarje apo në rastet kur një send i fituar nga trashëgimtari me ndarje ka një defekt të fshehur, në raste të tilla kur nuk mund të nxirret vlera e plotë që i ka kaluar atij, trashëgimtarët të tjerë janë përgjegjës ndaj këtij trashëgimtari për kompensimin e diferencës mes vlerës aktuale të këtij sendi, të drejtës ose objekti dhe vlerës së prezumuar të tyre gjatë ndarjes.

Kjo e drejtë e trashëgimtarit mund të ushtrohet brenda 3 viteve.

2.13 Ushtrime

Pjesëmarrësve gjatë këtij moduli do t'iu prezantohet një shembull praktik dhe pas punës në grupe ata do të japin mendimet e tyre lidhur me shembullin dhe zgjidhjet që mendojnë lidhur me rastin e paraqitur.

2.14 Përmbledhje

Në fund të sesion do të nxirren përfundimet për njohuritë e fituara nga pjesëmarrësit lidhur me temat e prezantuara.

Në këtë fazë sipas nevojës do të jepen shpjegime shtesë lidhur me çështjet të cilat eventualisht do të konsiderohen si të pasqaruara në masën e duhur dhe do të bëhen përpjekjet që secila çështje e cila është përfshirë në temën e prezantimit të sqarohet.

IX. Mbrojtja gjyqësore në konteste nga marrëdhënia e punës

Lumni Sallauka
Gjyqtarë në Gjykatën Themelore – Prizren

Tabela e përmbajtjes – “ Mbrojtja gjyqësore në konteste nga marrëdhënia e punës”

Hyrje.....	412
Objektivat mësimore.....	413
Metodat e të shpjeguarit.....	413
Pritjet nga pjesëmarrësit.....	413
Përmbledhje.....	414
1. Kontestet nga marrëdhënia e punës sipas Ligjit të Punës	415
1.1 Hyrje	415
1.2 Objektivat trajnuese	415
1.3 Kontestet nga marrëdhënia e punës sipas ligjit të punës	415
1.4 Fusha e zbatimit të Ligjit të Punës	416
1.5 Llojet e kontratave të punës sipas Ligjit të Punës.....	416
1.6 Shkaqet e shkëputjes së marrëdhënies së punës sipas Ligjit të Punës	417
1.7 Procedura para ndërprerjes së kontratës së punës nga ana e punëdhënësit	419
1.8 Procedura gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave të punës	419
1.8.1 Mbrojtja e të drejtave për të punësuarit brenda organeve të punëdhënësit	419
1.8.2 Mbrojtja e të punësuarit në Gjykatë	420
1.8.3 Vendimet e gjykatës në rastet kur konstatohet paligjshmëria e ndërprerjes së kontratës së punës 422	
1.9 Respektimi i afateve ligjore për të kërkuar mbrojtje gjyqësore	424
1.9.1 Shterimi i mjeteve të brendshme juridike për të kërkuar mbrojtje gjyqësore.....	424
1.9.2 Pasojat juridike të mos respektimit të afatit ligjor për të kërkuar mbrojtje gjyqësore sipas Ligjit të Punës 424	
1.10 Ushtrime.....	425
1.11 Përmbledhje.....	425
2. Kontestet nga marrëdhënia e punës sipas Ligjit për Shërbyesit Civil	426
2.1 Hyrje	426
2.2 Objektivat trajnuese	426
2.3 Shërbimi Civil në Republikën e Kosovës	426
2.4 Administrata Shtetërore dhe Administrata Publike.....	427
2.5 Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës	428
2.6 Ligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës	432
2.7 Konflikti Administrativ	433
2.8 Ushtrime	434
2.9 Përmbledhje.....	434
3. Mbrojtja në punë dhe kompensimi i dëmit i shkaktuar në punë	435
3.1 Hyrje	435
3.2 Objektivat trajnues	435
3.3 Përgjegjësitë e punëdhënësit në rastet e aksidenteve në punë apo sëmundjeve profesionale	435
3.3.1 Sigurimi i kushteve të nevojshme për mbrojtje në punë	435
3.3.2 Informimi i punëtorëve me shkrim, për rreziqet në punë dhe për masat mbrojtëse të cilat obligohen t'i marrin.....	437
3.4 Të drejtat e të punësuarit në rastet e aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale	438
3.4.1 Kompensimi i shpenzimeve të mjekimit dhe rehabilitimit	438
3.4.2 Kompensimi i dëmit në rastet e aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale	439
3.5 Përgjegjësia ligjore e punëdhënësit në rastet e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, sipas legjislacionit tonë.....	440

3.6 Legjislacioni i zbatueshëm në rastet e aksidenteve në punë apo sëmundjeve profesionale	441
3.6.1 Ligji i Punës	441
3.6.2 Ligji Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.....	442
3.6.2 Ligjit për Inspektoriatin e Punës	443
3.6.3 Ligji për Detyrimet.....	444
3.7 Ushtrime	445
3.8 Përmbledhje.....	445

Hyrje

E drejta e punës është pjesë përbërëse e sistemit juridik dhe njëkohësisht disiplinë e veçantë shkencore. Ajo studion tërësinë e normave juridike që rregullojnë marrëdhëniet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, përfshirë këtu edhe mbrojtjen gjyqësore të të drejtave, nëse këto të drejta shkelen nga ana e punëdhënësit.

Meqenëse mbrojtja juridike e të drejtave të punëmarrësve ka rëndësi të veçantë, edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës përmban dispozita të cilat i referohen të drejtës së punës, përmes të cilave e rendit shtetin tonë në grupin e vendeve me rregullativën juridike nga lëmia e të drejtës së punës të harmonizuar me legjislacionin ndërkombëtar. Gjithashtu Kosova ka miratuar Ligjin e Punës Nr. 03/L-2012 dhe Ligjin për Shërbyesit Civil Nr. 03/L-149 (dhe jo vetëm), të cilët konsiderohen si një përpjekje për të krijuar një bazë të re ligjore me të cilën do të respektohen parimet bazë të standardeve ndërkombëtare për rregullimin e marrëdhënieve të punës. Përmes këtij ligji shteti dhe punëdhënësi në përgjithësi kanë për detyrim të respektojnë të drejtat që rrjedhin nga lëmia e punës.

Moduli “Mbrojtja gjyqësore në kontestet nga marrëdhënia e punës” përfshinë 3 sesione, të cilat do të shtjellohen para pjesëmarrësve, përkatësisht gjyqtarëve të sapo emëruar. Kështu në sesionin e parë ndër të tjera do të trajtohen natyra juridike e kontesteve të punës, legjislacioni në fuqi tek këto konteste, fusha e zbatimit dhe llojet e kontratave të punës sipas Ligjit të Punës, shkaqet e shkëputjes së kontratës së punës, procedurën gjyqësore që zhvillohet tek kontestet e punës sipas Ligjit të Punës, llojet e vendimeve gjyqësore që merren tek kontestet e punës, dallimet në mes të kontesteve për shërbyesit civil dhe kontesteve tjera nga marrëdhënia e punës, procedurat brendshme të cilat duhet ti shfrytëzojnë shërbyesit civil, para se të kërkojnë mbrojtje gjyqësore, përfshirë këtu edhe mbrojtjen gjyqësore e të drejtave të punës për shërbyesit civil, kompetencën, afatet, mjetet juridike etj. Në sesionin e dytë do të shtjellohen Shërbimi Civil në Republikën e Kosovës, administrata shtetërore dhe administrata publike, Ligji për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, Ligji për Këshillin e Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Konflikti Administrativ. Ndërsa në sesionin e tretë ndër të tjera do të trajtohen përgjegjësitë e punëdhënësit në rastet e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, sigurimin e kushteve për mbrojtje në punë, informimin e punëmarrësve për të drejtat e tyre, të drejtat e punëmarrësve në rastet e aksidenteve apo sëmundjeve profesionale në punë, të drejtat e tyre për kompensimin e shpenzimeve të mjekimit dhe kompensimin e dëmit, për përgjegjësinë ligjore të punëdhënësve në rastet e aksidenteve apo sëmundjeve profesionale lidhur me punën, si dhe për legjislacionin e zbatueshëm në Kosovë për mbrojtjen në punë, sigurinë dhe shëndetin në punë etj.

Përmes këtij moduli synohet që pjesëmarrësit, përkatësisht gjyqtarët e sapo emëruar të mësojnë dhe t'i thellojnë njohuritë e tyre në mbrojtjen gjyqësore në kontestet nga marrëdhënia e punës, më saktësisht në çështjet të cilat i kemi përmendur më lartë. Gjithashtu me fitimin e këtyre njohurive profesionale nga e drejta e punës, përkatësisht mbrojtjen gjyqësore të këtyre të drejtave, synohet që pjesëmarrësit në cilësi të ekspertëve të rinjë, të jenë në gjendje që t'i zbatojnë rregullat ligjore të ligjeve të aplikueshme të lëmisë së punës si vendore ashtu edhe atyre ndërkombëtare, në atë mënyrë që kjo ti kontribuon ngritjes së kualitetit të punës së gjykatave dhe organeve tjera shtetërore në mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave që burojnë nga marrëdhëniet e punës.

Objektivat mësimore

Pas përfundimit të këtij moduli pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Thellojnë njohurit lidhur me kontestet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës;
- Identifikojnë legjislacionin e zbatueshëm vendor dhe ndërkombëtar në kontestet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës;
- Dallojnë kontestet për shërbyesit civil dhe kontestet e tjera nga marrëdhënia e punës sipas ligjit të punës;
- Zbatojnë drejtë dispozitat e ligjit përkatës duke vlerësuar afatet për të kërkuar mbrojtje gjyqësore;
- Dallojnë të drejtat e punëmarrësve dhe përgjegjësitë e punëdhënësit në rastet e aksidenteve në punë apo sëmundjeve profesionale;
- Zbatojnë drejtë ligjet materiale, përfshirë këtu kontratën kolektive dhe aktet e brendshme të personit juridik, të cilat janë të zbatueshme në rastet e aksidenteve në punë apo sëmundjeve profesionale.

Metodat e të shpjeguarit

Gjatë këtij programi do të përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj praktik, në mënyrë që secili nga pjesëmarrësit të jetë aktiv gjatë gjithë kohës së trajnimit, në mënyrë që të arrihen në tërësi objektivat e këtij trajnimi.

Pritjet nga pjesëmarrësit

Nga pjesëmarrësit pritet që të jenë aktiv gjatë gjithë trajnimit, përmes parashtrimit të pyetjeve, hartimin e punimeve të ndryshme etj, në mënyrë që të sqarohen të gjitha çështjet kyçe të këtij programi, si dhe t'i thellojnë njohuritë e tyre për të gjitha elementet përmbajtësore të çështjeve që do të diskutohen dhe në të njëjtën kohë të jenë në gjendje që këto njohuri ti zbatojnë me sukses gjatë punës së tyre në praktikë.

Burimet

1. Kudret Çela: “E drejtë e punës I”, Tirane 2003,
2. Francesko Galgano, “E drejta Private”, 1999,
3. Faik Brestovci, “E drejta e procedurës civile”, 1986
4. Kushtetuta e Republikës së Kosovës,
5. Ligji mbi Gjykatat i Kosovës, 03/L-199,
6. Ligji i Punës, Nr. 03/L-2012,
7. Ligji për Marrëdhënien e Punës i KSA të Kosovës, i vitit 1989,
8. Ligji i Punës i ish Jugosllavisë, i vitit 1977,
9. Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, 2001,
10. Ligji për Sigurinë dhe shëndetin në punë, Nr.04/L-161,
11. Ligji për Inspektoriatin e Punës, Nr. 2002/9,
12. Ligji për Procedurën Kontestimore, Nr. 03/L-006,
13. Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil;
14. Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale;

15. Ligji Nr. 02/L-28 për Procedurat Administrative;
16. Ligjin Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore;
17. Ligji nr. 03/l-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
18. Ligji Nr. 03/L-202, për Konfliktet Administrative,
19. Ligji i Procedurës Kontestimore, Gazeta Zyrtare e RSFJ nr. 4, e vitit 1976,
20. Iset Morina, Selim Nikçi, Komentar i Ligjit të Procedurës Kontestimore, 2012,
21. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Nr. 04/L-077,
22. Prof. Dr. Nerxhivane Dauti, av. Ruzhdi Berisha, av. Adem Vokshi, Prof. Dr. Abdulla Aliu, Komentar i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, shtator 2013,
23. Udhëzimi Administrativ nr.05/12, i nxjerr nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale,
24. Manual për trajnim, Mbrojtja gjyqësore në kontestet e punës për shërbyesit civil, Lulzim Aliaj, Prishtinë 2014,
25. Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut

Përmbledhje

Në këtë modul kemi diskutuar për qëllimin e modulit, objektivat mësimore, metodat e të shpjeguarit, pritjet nga pjesëmarrësit, si dhe për burimet nga të cilat mund të mësohet për të drejtën e punës në përgjithësi dhe mbrojtjen gjyqësore të këtyre të drejtave në veçanti, si pjesë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.

Gjithashtu gjatë këtij moduli janë marrë sugjerime nga pjesëmarrësit, lidhur me metodat e të shpjeguarit dhe shtjellimit të moduleve në përgjithësi.

1. Kontestet nga marrëdhënia e punës sipas Ligjit të Punës

1.1 Hyrje

Në modulim me temë “*Mbrojtja gjyqësore në kontestet nga marrëdhënia e punës*”, përkatësisht në sesionin e parë, ndër të tjera do të shtjellohet natyra juridike e kontesteve të punës, legjislacioni në fuqi tek këto konteste, fusha e zbatimit dhe llojet e kontratave të punës sipas Ligjit të Punës, shkaqet e shkëputjes së kontratës së punës, procedurën gjyqësore që zhvillohet tek kontestet e punës sipas Ligjit të Punës, llojet e vendimeve gjyqësore që merren tek kontestet e punës, dallimet në mes të kontesteve për shërbyesit civil dhe kontesteve tjera nga marrëdhënia e punës, procedurat brendshme të cilat duhet të shfrytëzohen shërbyesit civil, para se të kërkojnë mbrojtje gjyqësore, përfshirë këtu edhe mbrojtjen gjyqësore e të drejtave të punës për shërbyesit civil, kompetencën, afatet, mjetet juridike etj.

Gjithashtu do të shtjellohen edhe respektimi i afateve për të kërkuar mbrojtje gjyqësore, më saktësisht çështjen e shterimit të mjeteve të brendshme juridike për të fituar të drejtën e kërimit të mbrojtjes gjyqësore, si dhe pasojat juridike të mos respektimit të afateve për të kërkuar mbrojtje gjyqësore sipas legjislacionit në fuqi tek kontestet e punës.

1.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij sesioni trajnues, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Zgjerojnë njohurit lidhur me kontestet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës;
- Identifikojnë legjislacionin e zbatueshëm vendor dhe ndërkombëtar në kontestet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës;
- Dallojnë kontestet për shërbyesit civil dhe kontestet e tjera nga marrëdhënia e punës sipas ligjit të punës;
- Zbatojnë drejtë dispozitat e ligjit përkatës duke vlerësuar afatet për të kërkuar mbrojtje gjyqësore.

1.3 Kontestet nga marrëdhënia e punës sipas ligjit të punës

Siç dihet deri në miratimin e Ligjit të Punës (Ligji Nr.03/L-212), i cili ka hyrë në fuqi me datë 16 dhjetor 2010, Kosova nuk ka pasur ligj unik me të cilin do të rregulloheshin marrëdhëniet e punës. Si rrjedhojë dispozitat të cilat e kanë rregulluar këtë fushë kanë qenë të shpërndara në shumë ligje dhe rregullore, të cilat janë nxjerr dhe miratuar në rrethana të ndryshme ekonomike, shoqërore dhe politike.

Në këtë drejtim Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/24 dhe 2000/59, kanë përcaktuar legjislacionin në fuqi, ku ligje në fuqi në Kosovë janë ligjet që kanë qenë në fuqi deri më datë 22.03.1989 dhe Rregulloret e UNMIK-ut, andaj sipas këtyre rregulloreve legjislacion në fuqi në lëminë e punës kanë qenë Ligji për Marrëdhënien e Punës i KSA të Kosovës i vitit 1989, Ligji i Punës i ish Jugosllavisë i vitit 1977, si dhe Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, e datës 08 tetor 2001. Kjo gjendje e infrastrukturës ligjore në sferën e punës dhe të marrëdhënieve të punës e ka imponuar nevojën e një angazhimi të shtuar profesional të gjyqtarëve, për të identifikuar normën juridike të cilën duhet zbatuar në secilin rast konkret, në mënyrë që të aplikohet drejtë të drejtën materiale.

Duke marr parasysh faktin se Ligji i ri i Punës (edhe ligjet tjera) nuk kanë efekt prapaveprues, atëher rezulton se ende në gjykatat e Kosovës ka konteste të punës në të cilat duhet të aplikohet legjislacioni i lartcekur, ndërsa për kontestet e inicuar pas datës 16 dhjetor 2010, aplikohen dispozitat e ligjit të ri të Punës që është në fuqi.

1.4 Fusha e zbatimit të Ligjit të Punës

Ligji i Punës rregullon të drejtat dhe detyrimet në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik në Republikën e Kosovës, si dhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara të punës.

Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit me shtetësi të huaj dhe personat pa shtetësi, të cilët janë të punësuar tek punëdhënësit në territorin e Republikës së Kosovës, nëse me ligj nuk është rregulluar ndryshe. Ndërsa dispozitat e këtij ligji nuk janë të aplikueshme për marrëdhëniet e punësimit brenda misioneve ndërkombëtare, misioneve diplomatike dhe konsullore të shteteve të huaja, Pranisë Ushtarake Ndërkombëtare të vendosur në Republikën e Kosovës në bazë të Propozimit Gjithëpërfshirës për Statusin dhe organizatat ndërkombëtare qeveritare¹.

Megjithatë, rëndësia e Ligjit të Punës qëndron në faktin se i njëjti bënë rregullimin e disa të drejtave të punëtorëve (sidomos atyre në sektorin privat) që janë shkelur në masë të madhe në Kosovë që nga paslufta, sikurse pushimi i lehonisë, pushimi mjekësor, orari i punës etj. Ligj, i cili ka gjithsej 100 nene, ka marrë parasysh një varg kërkesash të sindikalistëve duke bërë që: kontrata e punës të jetë vetëm në formë të shkruar, puna provuese të zgjatë më së shumti 6 muaj, orari i punës të jetë 40 orë në javë, punëtori të ketë të drejtën për pauzë prej 30 minutash, të ketë pushim vjetor prej 4 javësh, kurse femrave iu garantohet pushim i lehonisë prej 12 muajsh, 9 nga të cilët me pagesë. Gjithsesi Ligji i Punës parasheh edhe dispozita të veçanta të cilat punëtorëve ju garantojnë mbrojtjen e të drejtave nga marrëdhënia e punës si brenda punëdhënësit (mjetet juridike të brendshme), ashtu edhe të drejtën që në rast se është i pakënaqur me vendimin e organeve të punëdhënësit me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, të kërkoj mbrojtje gjyqësore, më saktësisht të inicioj kontest pune në gjykatën kompetente, brenda afatit të paraparë ligjor.

1.5 Llojet e kontratave të punës sipas Ligjit të Punës

Ligji i Punës, kontratën e punës e përkufizon si akt individual e cila lidhet ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit, me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga marrëdhënia e punës në pajtim me këtë ligj, me Kontratën Kolektive dhe me Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit (neni 3 pika 1.11 e Ligjit të Punës). Ligji i Punës parasheh se me rastin e themelimit të marrëdhënies së punës punëdhënësi ka për obligim që me punëmarrësin të lidhë kontratën e punës, e cila lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuarit. Se cilat elemente duhet t'i përfshijë kontrata e punës e rregullon neni 11 i këtij ligji.

Me dispozitën e nenit 10 parag. 2 të Ligjit të Punës, përcaktohet se kontrata e punës mund të lidhet për një: *1. periudhë të pacaktuar, 2. periudhë të caktuar dhe 3. për punë dhe detyra specifike*. Më tutje përcaktohet se kontrata e punës që nuk përmban kurrfarë hollësish për

¹ Në nenin 2 të Ligjit të Punës është e paraparë fusha e zbatimit të këtij ligji.

kohëzgjatjen e vet, duhet të konsiderohet si kontratë në periudhë të pacaktuar (parag. 3 i nenit 10 të LP).

Ndërsa ky ligj ka përcaktuar edhe kufizimin kohor për të cilën mund të lidhet kontrata për periudhë të caktuar, e cila sipas parag. 4 nuk mund të lidhet për një periudhë më të gjatë se dhjetë (10) vite. Ligji i Punës ka paraparë një garanci shtesë për punëtorët të cilët punojnë tek punëdhënësit me kontratë në kohë të caktuar, mirëpo kanë punuar në vazhdimësi tek i njëjti punëdhënës për më shumë se 10 vite, ku në këto raste konsiderohet se i njëjti është duke punuar me kontratë në kohë të pacaktuar. Kështu që Ligji i Punës në parag. 5 të nenit 10 shprehimisht thotë: *"Kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore"*.

Kontrata për një detyrë specifike, nuk mund të jetë më e gjatë se njëqindnjëzet (120) ditë brenda një (1) viti, ndërsa personi që ka lidhur kontratë të punës për një afat të caktuar ose për një detyrë specifike, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parapara me këtë ligj, përveç nëse është paraparë ndryshe me ligj. Të punësuarit për një punë specifike, nuk i takon e drejta në pushim vjetor dhe të drejtat e tjera të përcaktuara me Kontratë Kolektive dhe Kontratën e Punës. Me Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit, përcaktohet koha në rastet kur me të punësuarin mund të themelohet marrëdhënia e punës në kohë të caktuar dhe punë specifike, në pajtim me LP².

1.6 Shkaqet e shkëputjes së marrëdhënies së punës sipas Ligjit të Punës

Konsideroj se para se të flitet në lidhje me procedurën për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të punës, duhet të shtjellohen edhe shkaqet të cilat qojnë në ndërprerjen e marrëdhënies së punës sipas Ligjit të Punës, pasi që njohja e këtyre shkaqeve e lehtëson në masë të madhe punën e gjyqtarëve në zbatimin e të drejtës materiale për sa i përket dhënjës së mbrojtjes gjyqësore tek kontestet e punës.

Në këtë drejtim Ligji i Punës në kreun e VIII fletë për rastet dhe shkaqet, si pasojë e të cilave vie deri tek ndërprerja e marrëdhënies së punës. Kështu që neni 67 i këtij ligji përcakton rastet se kur ndërprehet kontrata e punës sipas fuqisë ligjore dhe atë: 1). *me vdekjen e të punësuarit*, 2). *me vdekjen e punëdhënësit, kur puna e kryer apo shërbimet e ofruara nga puntori janë të natyrës personale, atëherë kur kontrata nuk mund të vazhdohet me pasardhësit e punëdhënësit*, 3). *me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës*, 4). *kur i punësuarit e mbush moshën e pensionimit, prej 65 vitësh*, 5). *në ditën e dorëzimit të aktvendimit të plotëfuqishëm për vërtetimin e humbjes së aftësisë për punë*, 6). *nëse i punësuarit shkon në vuajtje të dënimit i cili do të zgjasë më tepër se gjashtë (6) muaj*, 7). *me vendimin e gjykatës kompetente, vendim që pason ndërprerjen e marrëdhënies së punës*, 8). *me falimentimin dhe likuidimin e ndërmarrjes dhe* 9). *rastet tjera të përcaktuara sipas ligjeve në fuqi*. Nga shkaqet e përmendura më lartë çështja e skadimit të kontratës së punës apo edhe mos vazhdimi i kontratës së punës nga ana e punëdhënësit kanë qenë dhe janë rastet më të shpeshta të kontesteve të inicuar në gjykatë nga ana e punëmarrësve dhe për të cilat raste ka pasur praktika të ndryshme të gjykatave me rastin e vendosjes.³ Më tutje nenet 68 dhe 69, parashohin rastet e ndërprerjes së kontratës së punës me marrëveshje dhe ndërprerjen e kontratës së punës nga i punësuarit, mirëpo sigurisht që kjo mënyrë e ndërprerjes së kontratës së punës nuk ka pasojë të mëdha në shkeljen e të drejtave të punës së punëmarrësit,

² Shih Ligjin e Punës, nenin 10, parag. 6,7,8 dhe 9.

³ Në praktikën gjyqësore ka pasur vendime të ndryshme për sa i përket mënyrës së vendosjes tek rastet e ndërprerjes së marrëdhënies së punës për shkak të skadimit të kohëzgjatjes së kontratës dhe mos vazhdimi të kontratës së punës, edhe pse në kohën e fundit ka tendencë të unifikimit të kësaj praktike gjyqësore.

edhe pse ky i fundit ka për obligim që me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës të respektojë procedurën ligjore në drejtim të respektimit të afateve ligjore për këtë çështje.

Në anën tjetër në nenin 70 të Ligjit të Punës janë paraparë rastet tjera se kur punëdhënësi mund t'ia ndërprejë kontratën e punës të punësuarit, ndërsa janë të ndara rastet e ndërprerjes së kontratës së punës me paralajmërim dhe pa paralajmërim. Në këtë drejtim paragrafi 1 pika 1.1 dhe 1.2 i këtij neni përcaktojnë se punëdhënësi mund t'ia ndërprejë kontratën e punës të punësuarit me një periudhë paralajmërimi, atëherë kur ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike dhe organizative, si dhe në rastin kur i punësuarit nuk është i aftë t'i kryejë detyrat e punës. Mirëpo në pikën 1.3 të paragrafit të lartcekur janë paraparë edhe kushtet shtesë të cilat duhet ti respektojë punëdhënësi para se t'i ndërprejë kontratën e punës të punësuarit sipas pikës 1.1 dhe 1.2, dhe atë nëse nuk është e përshatshme për punëdhënësin që ta tranferojë të punësuarin në një vend tjetër të punës, apo ta trajtojë, ta kualifikojë atë për kryerjen e ndonjë pune tjetër. Nga kjo rezulton se para se ti ndërpresë kontratën e punës të punësuarit sipas paragrafëve të lartcekur, duhet të plotësohen në mënyrë kumulative kushtet e parapara në pikën 1.3 të cekur më lartë. Më tutje në pikën 1.4 të parag. 1 të nenit 70 të këtij ligji është paraparë se punëdhënësi mund t'ia ndërprejë kontratën e punës të punësuarit në periudhën e kërkuar të paralajmërimit dhe atë në rastet e rënda të sjelljes së keqe të puntorit (pika 1.4.1), si dhe për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës (pika 1.4.2), kurse pika 1.5 e obligon punëdhënësin që menjëherë ta njoftojë të punësuarin për largimin nga puna. Më tutje pika 1.6 i përcakton rastet kur punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit pa periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes dhe atë: kur i punësuarit është fajtor për përsëritjen e një sjellje të keqe më pak serioze ose të shkelje të detyrimeve (pika 1.6.1), si dhe kur performanca e të punësuarit mbetet e pakënaqshme përkundër paralajmërimit me shkrim (pika 1.6.2). Mirëpo në paragrafin 2 të nenit 70, janë paraparë edhe kushtet shtesë të cilat duhet ti respektojë punëdhënësi para se t'i ndërprejë kontratën e punës të punësuarit sipas pikës 1.6, dhe atë vetëm kur i punësuarit ka marr përshkrimin në formë të shkruar të performancës së pakënaqshme, një afat kohor brenda të cilit i punësuarit duhet ta përmirësojë performancën e vet, si dhe një deklaratë dështimi për përmirësimin e performancës do të rezultojë me largim nga puna pa asnjë paralajmërim të mëtejme me shkrim. Më tutje paragrafi 3 i nenit 70 përcakton obligimin e punëdhënësit që të mbajë takim me të punësuarin për t'ia shpjeguar arsyet e ndërprerjes së kontratës së punës, si dhe të drejtën e puntorit që në këtë rast të shoqërohet me një përfaqësues sipas dëshirës së vet⁴.

Ligji i punës nuk përmban dispozita me të cilat do të specifikoheshin llojet e sjelljeve të këqija ose shkeljeve të detyrimeve të cilat bëjnë që i punësuarit t'i nënshtrohet ndërprerjes së kontratës së punës pa periudhë paralajmërimi, qoftë për një rast të vetëm apo për shkelje të përsëritura, pasi që do të ishte e pamundur që të përmendëshin në mënyrë taksative këto lloje shkeljesh. Mirëpo paragrafi 4 i nenit 70 të Ligjit të Punës këtë çështje e lë në kompetencë të punëdhënësve që përmes akteve të brendshme të tij (rregullore, urdhëresave etj) t'i specifikojë këto lloje të sjelljeve të këqija ose llojet e shkeljeve të detyrimeve, të cilat do të kishin për pasojë ndërprerjen e kontratës së punës së puntorit. Gjithashtu ky paragraf parasheh që edhe me marrëveshje kolektive të specifikohen llojet e këtyre shkeljeve. Gjithësesi që këto lloje të shkeljeve duhet të jenë në formë të shkruar dhe të miratuara nga ana e organit përgjegjës të çdo punëdhënësi dhe duhet të jenë në pajtim me Ligjin e Punës dhe dokumentet ndërkombëtare të lëmisë së punës, pasi që në të kundërtën do të ishin të pavlefshme dhe do të kishin për pasojë anulimin e vendimit të punëdhënësit.

⁴ Më gjerësisht referoju nenit 70 të Ligjit të Punës.

1.7 Procedura para ndërprerjes së kontratës së punës nga ana e punëdhënësit

Ligji i Punës ka paraparë procedurë strikte e cila duhet të respektohet nga ana e punëdhënësit me rastin e ndërprerjes së kontratës së punës. Kjo është garanci që ligjvënasi ka parashikuar në favor të punëmarrësit, si pala më e “dobët” në kontratën e punës, që në kushtet e ekonomisë së tregut, duhet të jetë me e mbrojtur përballë punëdhënësit. Në këtë drejtim në nenin 71 të Ligjit të Punës është paraparë koha e njoftimit që duhet të respektoj punëdhënësi me rastin e ndërprerjes së kontratës së punës në kohë të pacaktuar punëmarrësit, në atë mënyrë që nëse punëmarrësi është i punësuar tek punëdhënësi prej 6 muajsh deri në dy vite, tridhjetë ditë kalendarike, prej dy deri në dhjetë vite punësim, dyzetepesë ditë kalendarike, mbi dhjetë vite punësim, 60 ditë kalendarike. Gjithashtu me paragrafin 2 të nenit të lartcekur është paraparë edhe koha e njoftimit të punëmarrësit që duhet të respektoj punëdhënësi me rastin e ndërprerjes së kontratës së punës në kohë të caktuar, apo qëllimit që mos të ripërtërijë kontratën e punës, e që është periudha prej 30 ditësh para skadimit të kontratës së punës, ndërsa është paraparë edhe sanksioni për punëdhënësin nëse nuk e respekton këtë detyrim, e që është zgjatja e tridhjetë ditëve kalendarike shtesë me pagë të plotë.

Më tutje neni 72 përcakton procedurën që duhet të ndjek punëdhënësi para se të ndërprejë kontratën e punës. Ky nen ndër të tjera përcakton se vendimi për të ndërprerë kontratën e punës duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të përfshijë arsyetimin për ndërprerje, kurse ky vendim është përfundimtar ditën kur i dorëzohet të punësuarit, si dhe faktin se punëdhënësi ka për obligim që të bëjë pagesën e pagës dhe të ardhurave të tjera deri në ditën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Gjithashtu neni 76 i Ligjit të Punës e përcakton procedurën e ndërprerjes së kontratës së punës, tek rastet që konsiderohen largime kolektive nga puna.

1.8 Procedura gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave të punës

Procedurat për realizimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës, parashihen në kreun e IX të Ligjit të Punës, e të cilat ndahen në procedurat e brendshme të cilat zhvillohen brenda punëdhënësit dhe procedurat që inicohen dhe zhvillohen në gjykatën kompetente, apo siç njihet si mbrojtja gjyqësore e marrëdhënies së punës. Konsiderojmë se secila nga procedurat e përmendura më lartë janë me rëndësi të posaçme, pasi që të dyja kanë për qëllim ofrimin e mbrojtjes qoftë brenda punëdhënësit ashtu edhe jashtë tij, në mënyrë që punëtorit ti garantohen të drejtat e tij nga lëmia e punës. Gjithsesi shtjellimi i këtyre dy procedurave është me rëndësi, pasi që kanë lidhmëri njëra me tjetrën, pasi që nga respektimi dhe zbatimi i procedurës së ndërprerjes së kontratës së punës nga ana e punëdhënësit, varet edhe lloji i vendimit të gjykatës me rastin inicimit të kontestit të punës.

1.8.1 Mbrojtja e të drejtave për të punësuarit brenda organeve të punëdhënësit

Kjo çështje është e paraparë me nenin 78 të Ligjit të Punës, ku në paragrafin 1 thuhet se i punësuarit i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. Më tutje parag. 2 përcakton obligimin e punëdhënësit për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afat prej pesëmbëdhjetë ditëve nga pranimi i kërkesës, kurse parag. 3 përcakton që vendimi i marr sipas paragrafit 2 të këtij neni i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej 8 ditësh. Gjithsesi Ligji i Punës përcakton edhe procedurën që duhet të zhvilloj punëdhënësi me rastin e shqiptimit të masave disiplinore për shkeljet e detyrave të punës. Në këtë drejtim neni 85 i këtij ligji si masa disiplinore për të punësuarit për shkelje të detyrave të punës, parasheh vërejtjen me gojë, vërejtjen me shkrim, ulje në pozitë, suspendim të

përkohshëm dhe ndërprerje të marrëdhënies së punës. Ndërsa tri masa e para disiplinore sipas parag. 3 të nenit të lartcekur mund të shqiptohen vetëm kur konstatohen shkelje të lehta të detyrave të punës, ndërsa dy masat e fundit mund të shqiptohen vetëm për shkelje të rënda të detyrave të punës. Se çka konsiderohet shkelje e lehtë dhe e rëndë e detyrave të punës, përcaktohet me aktet e brendshme të punëdhënësit apo me akte të tjera. Se kush mund të shqiptojë masat disiplinore dhe procedurën që zhvillohet lidhur me to, e rregullon neni 86 i Ligjit të Punës, i cili përcakton se vendimin mbi shqiptimin e masave disiplinore për shkeljet e detyrave të punës e nxjerr organi kompetent i punëdhënësit apo punëdhënësi, si dhe punëdhënësi i cili nuk e ka statusin e personit juridik, ose personit të cilin ai e autorizon, kurse ky autorizim duhet të jepet në formë të shkruar. Më tutje përcaktohet se vendimi i punëdhënësit duhet të bëhet me shkrim, duke theksuar arsyetimin dhe këshillën për mjetet juridike ndaj masave të shqiptuara. Është për diskutim çështja se për masat disiplinore të përmendura më lartë, përveç ndërprerjes së marrëdhënies së punës, të shqiptuara ndaj të punësuarit, a mund të kërkohet mbrojtje gjyqësore në gjykatë, meqenëse nuk kemi përfundim të marrëdhënies së punës.

1.8.2 Mbrojtja e të punësuarit në Gjykatë

Çështjen e mbrojtjes gjyqësore të drejtave nga marrëdhënia e punës, e parasheh neni 79 i Ligjit të Punës, i cili përcakton se çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit të paraparë me nenin 78 parag. 2 të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të iniciojë kontest pune në Gjykatën kompetente. Se cila gjykatë ka kompetencë lëndore për të gjykuar në kontestet e punës (sipas Ligjit të Punës) e përcakton dispozita e parag. 1 të nenit 11 të Ligjit për Gjykatat, e cila thotë se: *“Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe”*. Më tutje kompetencën territoriale tek këto konteste e përcakton neni 49 i Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK). Është interesant fakti se Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë që ka qenë në fuqi deri më 16 dhjetor 2010, nuk përmban asnjë dispozitë e cila e rregullon çështjen e mbrojtjes gjyqësore të të drejtave nga marrëdhënia e punës. Ndërsa nëse i referohemi nenit 27 të këtij ligji, i cili thotë se kjo rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të, atëherë mund të vijmë në përfundim se për mbrojtjen e të drejtave nga marrëdhënia e punës në gjykatë, kanë vlejtur dispozitat e Ligji për Marrëdhënien e Punës i KSA të Kosovës i vitit 1989, Ligji i Punës i ish Jugosllavisë i vitit 1977, të cilat siç e kemi cekur më lartë kanë qenë në fuqi krahas kësaj rregullore, bazuar në Rregulloret e UNMIK-ut nr. 1999/24 dhe 2000/59, të cilat kanë përcaktuar legjisllacionin në fuqi, ku ndër të tjera ligje në fuqi në Kosovë janë ligjet që kanë qenë në fuqi deri më datë 22.03.1989.

Në praktikë ka pasur mjaftë paqartësi në zbatimin e ligjeve të lartcekura dhe shpeshherë puntorëve nuk i është garantuar mbrojtje adekuate gjyqësore nga ana e gjykatave. Në këtë drejtim mund të përmendim rastet kur punëdhënësit i kanë ndërprerë marrëdhënien e punës puntorit pa zhvilluar kurrfarë procedure disiplinore ashtu siç është paraparë p.sh me nenet 111, 112, 113 etj të Ligjit për Marrëdhënien e Punës i vitit 1989, por duke u mjaftuar vetëm me njoftimin e puntorit për shkëputjen e kontratës së punës, bazuar në nenin 11 parag.5 të Rregullorës së UNMIK-ut 2001/27. Siç e cekëm edhe më lartë në gjykatat e Kosovës ka pasur praktika të ndryshme për sa i përket kësaj çështje, përfshirë këtu edhe vet Gjykatën Supreme të Kosovës si pushtet më i lartë gjyqësor në Kosovë. Mirëpo kohëve të fundit kemi një unifikim të këtyre praktikave nga ana e Gjykatës së Apelit dhe të asaj Supreme, pasi që tani është ardhur në përfundim se punëdhënësit me rastin e shkëputjes së marrëdhënies së punës puntorit, duhet të zbatojnë patjetër procedurën disiplinore të paraparë me ligjet e lartpërmendura dhe në rastet kur dyshohet se puntori ka bërë shkelje të detyrave të punës, këto shkelje duhet të vërtetohen përmes inicimit dhe mbajtjes së procedurës disiplinore nga organi kompetent i punëdhënësit, e

pastaj varësisht nga konstatimi i këtyre shkeljeve punëtorit t'i shqiptohen masat adekuate disiplinore, përfshirë këtu edhe masën më të rëndë siç është ndërprerja e marrëdhënies së punës. Konsiderojmë se në të gjitha kontestet e punës në të cilat gjykata konstaton se punëdhënësi ka dështuar të respektojë procedurën ligjore me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, vendimet e punëdhënësit në raport me punëtorët duhet të anulohen si të paligjshme.

Mirëpo, për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave nga marrëdhënia e punës, duhet që paraprakisht në mënyrë kumulative të përmbushen dy parakushte apo prezumime procedurale, të cilat janë: që puntori paraprakisht t'i ketë shteruar procedurat interne për mbrojtjen e të drejtave dhe që padia në gjykatë të jetë dorëzuar brenda afatit të caktuar. Procedura gjyqësore në kontestet e punës hynë në radhën e të ashtuquajturave procedura të veçanta. Tek kontestet e punës përveç rregullave të përgjithshme të procedurës kontestimore, zbatohen edhe disa rregulla të veçanta të cilat edhe e bëjnë të veçantë këtë procedurë. Kështu që Ligji i Procedurës Kontestimore (LPK) në kreun e XXVI, parasheh procedurën e kontesteve nga marrëdhënia e punës, ndërsa në nenin 474, thuhet se nëse nuk ekzistojnë dispozita të posaçme, në kontestet e punës zbatohen dispozitat e këtij ligji, e nga kjo rezulton se në këto konteste zbatohen të gjitha rregullat e përgjithshme të LPK-së, përveç atyre që janë të posaçme për këtë procedurë. Më tutje në nenin 475, është përcaktuar natyra urgjente e kontesteve të punës, sidomos me rastin e konvokimit të seancave gjyqësore, gjykata duhet të ketë parasysh nevojën e zgjidhjes së shpejtë të këtyre kontesteve. Kjo është e kuptueshme nëse marrim parasysh se janë në pyetje të drejtat personale të punëtorëve që rrjedhin nga marrëdhënia e punës dhe nga realizimi i këtyre të drejtave varet edhe mirëqenia e punëtorit dhe familjes së tij, pasi që janë pyetje realizimi i të ardhurave personale, nga të cilat varet ekzistenca e tyre. Si rrjedhojë, tek këto konteste edhe afatet për ndërmarrjen e veprimeve procedurale duhet dhe janë më të shkurta se sa në kontestet e tjera. Kështu që neni 476 i LPK-së përcakton se në aktgjykimin me të cilin urdhërohet përmbushja e ndonjë detyrimi gjykata cakton afat 7 ditor (afati paritiv), ndërsa afati për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit apo aktvendimit është poashtu 7 ditor (neni 477). Siç e cekëm edhe më lartë tek kontestet e punës zbatohen të njëjtat parime dhe rregulla të parapara me LPK-n, ashtu si në kontestet e tjera, duke përfshirë këtu pjesën e shqyrtimit paraprak të padisë, dërgimit të përmirësim dhe plotësim, mbajtjen e seancës përgatitore e kryesore, mjetet provuese etj.

Gjatë procedimit të kontesteve të punës shpeshherë ka pasur paqartësi lidhur me atë se çka vlerëson gjykata me rastin e shqyrtimit dhe vendosjes në këto konteste, a e vlerëson gjykata vetëm ligjshmërinë e vendimit kundër të cilit është ngritur padia, apo edhe mund të lëshohet edhe në vlerësimin e asaj se a është vërtetuar gjendja faktike nga ana e punëdhënësit me rastin e shkëputjes së marrëdhënies së punës punëtorit. Konsiderojmë se gjykata në procedurën kontestimore sipas padisë së ushtruar nga punëtori e vlerëson ligjshmërinë e vendimit, kundër të cilit është ngritur padia dhe varësisht nga shkeljet e konstatuara, si dhe nga lloji i kërkesës së paditësit merr vendimin përkatës në formë të aktgjykimit. Kësisoj në rastet kur kërkesëpadia ka të bëjë me vërtetimin e një fakti gjykata merr aktgjykim vërtetues, kur kërkohet anulimi i ndonjë vendimi, gjykata merr aktgjykim konstitutiv, ndërsa kur kërkesa ka të bëjë me detyrimin e punëdhënësit, atëherë gjykata merr aktgjykim detyrues. Në praktikë shpeshherë me një padi parashtrihen disa kërkesa me karakteristika të ndryshme, çka imponon edhe marrjen e vendimit gjyqësor miks. Gjithsesi është me rëndësi të theksohet se nuk është e mjaftueshme që punëdhënësi vetëm të respektoj procedurën e parapara ligjore për shkëputjen e marrëdhënies së punës punëtorit dhe ky vendim automatikisht nga gjykata të konsiderohet i ligjshëm, pasi që nuk mjafton vetëm të respektohet një procedurë ligjore dhe të ndërmerren veprime në zbatim të kësaj procedure, por gjithsesi kësaj duhet ti paraprijë vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike, ndërsa vetëm kur të arrihet kjo nga punëdhënësi atëherë vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës mund të jetë i dhe i ligjshëm.

1.8.3 Vendimet e gjykatës në rastet kur konstatohet paligjshmëria e ndërprerjes së kontratës së punës

Se çfarë vendime mund të merr gjykata nëse konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore, në bazë të Ligjit të Punës, kontratës Kolektive ose Kontratës së Punës, e rregullon neni 80 i Ligjit të Punës. Kështu në paragrafin 1 pika 1.1 të këtij ligji parashihet se nëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore në bazë të rregullativës ligjore të përmendur më lartë, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të përmbush njërën prej këtyre dëmshpërblimeve:

“t’i paguajë të punësuarve kompensimin, përveç shtesave dhe shumave të tjera të cilat i takojnë punonjësit në bazë të këtij ligji, Kontratës së Punës, Kontratës Kolektive ose Aktit të Brendshëm, në shumën të tillë që gjykata i konsideron të drejta dhe adekuate, por të cilat nuk duhet të jenë më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshpërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit”,

ndërsa në pikën 1.2 të parag. 1 të nenit të lartcekur parashihet se:

“nëse largimi nga puna vlerësohet si i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, Gjykata mund ta rikthejë të punësuarin në vendin e tij të punës dhe urdhëron kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna”.

Kurse paragrafi 2 i nenit 80 parashihet detyrimi i punëdhënësit që në afatin e caktuar të zbatoj vendimin e gjykatës kompetente.

Formulimi i tillë ligjor i nenit 80 të Ligjit të Punës, ka shkaktuar jo pak dilema dhe paqartësi në zbatimin e tij në praktikë nga ana e gjykatës, por ndoshta edhe vet punëtorët apo përfaqësuesit e tyre ka pasur dilema se cilat do të ishin kërkesat e tyre, për të cilat do të kishin mundësi ligjore që të kërkojnë mbrojtje gjyqësore në gjykatë. Kjo edhe për faktin se që nga hyrja në fuqi e Ligjit të Punës e deri më tani, nuk ka pasur ndonjë interpretim apo komentim nga organet kompetente, apo udhëzim se si duhet të zbatohet më së miri në praktikë ky nen, edhe pse kjo është mëse e domosdoshme në mënyrë që të eliminohen të gjitha paqartësitë nga zbatuesit e këtij ligji, siç janë në rastin konkret gjykatat kompetente, të cilat edhe e kanë interpretuar këtë nen në mënyrën e vet dhe kështu edhe janë krijuar praktika jo të unifikuara gjyqësore. Gjithsesi sipas mendimit tonë, në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 80, ligjdhënësi ka autorizuar gjykatat që në rastet kur konstatojnë faktin se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore apo në kundërshtim me rregullativën ligjore, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të punësuarit t’i paguajë kompensimin në shumën të cilat gjykata i konsideron adekuate dhe të drejta, që do të thotë se shumën e kompensimit i është lënë në vlerësimin e lirë të gjykatës, gjithmonë duke u bazuar në analizimin dhe vlerësimin e të gjitha rrethanave të rastit konkret. Mirëpo ligjdhënësi vetëm e ka përcaktuar kufirin minimal të kompensimit, nën të cilin gjykata nuk mund të gjykojë, e që është se kompensimi nuk mund të jetë më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshpërblimi që i takon punëtorit në kohën e shkarkimit, ndërsa kjo sigurisht është bërë me qëllim që punëtorëve si kategori më e dobët karshi punëdhënësit t’i garantohet kompensim adekuat dhe i drejtë, me rastin e ndërprerjes së kontratës së punës. Gjithsesi edhe tek këto konteste gjykata nuk mund ta tejkalojë kërkesëpadinë e parashtruar nga paditësi, mirëpo brenda asaj që është kërkuar dhe duke marr për bazë të gjitha rrethanat e rastit konkret, të gjykojë shumën adekuate të kompensimit. Konsideroj se me rastin e gjykimit të shumave që i takojnë të punësuarit për shkak të ndërprerjes së paligjshme të kontratës së punës, gjykata duhet që këtë ta bëjë sipas bindjes së lirë, sigurisht duke zbatuar nenin 323 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, i cili nen shprehimisht thotë: *“Po që se vërtetohet se palës i takon e drejta që t’i shpërblehet dëmi me të holla apo me sende të zëvendësueshme, por pa mundësi që të caktohet shumën e të hollave, apo sasia e sendeve të tilla,*

apo se një gjë e tillë do të mund të bëhej me vështirësi shumë të mëdha, gjykata për këtë do të vendosë sipas çmuarjes së lirë”.

Çështja që ka ngritur më shumë dilema brenda komunitetit të gjyqtarëve është fakti se a mundet në çdo rast kur vërtetohet nga gjykata se ndërprerja e kontratës së punës të punësuarit nga ana e punëdhënësit është joligjore, të detyrojë këtë të fundit që ta kthejë në vendin e tij të punës punëtorin. Nëse i referohemi pikës 1.2 të parag. 1 të nenit 80, atëherë mund të vijmë në përfundim se ligjdhënësi i ka kufizuar rastet se kur gjykata mund të urdhëroj punëdhënësin që ta kthejë punëtorin në vendin e tij të punës, dhe atë vetëm nëse vlerësohet se largimi nga puna është i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, duke urdhëruar në të njëjtën kohë edhe kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve të tjera.

Në këtë drejtim neni 5 i Ligjit të Punës flet për ndalimin e të gjitha llojeve të diskriminimit, ndërsa në pikën 5 të tij përcakton se dispozitat e Ligjit nr.2004/3 kundër diskriminimit, do të zbatohen drejtpërsëdrejti tek marrëdhënia e punës. Andaj, mund të vijmë në përfundim se gjykata mund të urdhëroj punëdhënësin që ta kthejë të punësuarin në vendin e tij të punës, nëse gjatë procedurës gjyqësore vërtetohet se ky i fundit është diskriminuar në vendin e tij të punës, për cilëndo nga llojet e diskriminimit që janë paraparë me neni 5 të këtij ligji, apo me dispozitat e Ligjit kundër Diskriminimit të përmendur më lartë.

Në të gjitha rastet e tjera gjykata është e autorizuar vetëm të gjykojë kompensim në shumë adekuate të të hollave (kur vërtetohet se vendimi mbi ndërprerjen e kontratës së punës është i paligjshëm, por asesi të urdhëroj punëdhënësin ta kthej të punësuarin në vendin e tij të punës.⁵Konsiderojmë se kjo mund të jetë e drejtë, nëse marrim parasysh faktin se për krijimin e marrëdhënies së punës, lidhjen dhe përtëritjen e kontratës së punës duhet të ekzistoj vullneti i të dy palëve si punëdhënësit ashtu edhe punëmarrësit, ndërsa me vet faktin se punëdhënësi ka shprehur vullnetin e tij me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës punëdhënësit, atëherë edhe mund të konkludohet se i njëjti nuk ka m0ë vullnet të tillë për vazhdimin e marrëdhënies së punës punëtorit.

Është me rëndësi të veçantë që gjykata me rastin e vendosjes rreth kontesteve të punës, të respektoj nevojën që këto konteste të zgjidhen në procedurë urgjente dhe pa vonesa, si dhe vendimet gjyqësore të jenë të qarta dhe të plota. Sidomos duhet ti kushtohet rëndësi pjesës së dispozitivit të aktgjykimit, në mënyrë që i njëjti të jetë plotësisht i qartë dhe i përmbarueshëm, pasi që paqartësia e tyre shpeshëherë shkakton vështirësi me rastin e përmbarimit të dhunshëm të tyre. Ndërsa vlen të përmendet fakti se në rastet kur gjykata në procedurë kontestimore nuk i përcakton shumën e kompensimit që i takon të punësuarit për shkak të ndërprerjes së kundërligjshme të kontratës së punës (për shkak të urgjencës së procedurës etj), por vetëm e anulon vendimin me të cilin është ndërprerë kontrata e punës dhe e obligon punëdhënësin që psh, punëtorit ti paguaj të gjitha pagat nga data e largimit nga puna deri në ekzekutimin definitiv të aktgjykimit, por siç e tham pa u cekur shuma e këtij kompensimi, atëherë zgjidhjen për këtë e japin dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore. Në këtë drejtim neni 294 i LPP-së (i vitit 2008) ka paraparë që punëtori i cili në bazë të aktgjykimit të formës së prerë kërkon kthimin në punë përmes procedurës përmbarimore, ka të drejtë që të kërkojë në këtë procedurë edhe caktimin e lartësisë së pagave të cilat i takojnë.

⁵ Në praktikën gjyqësore jo gjithmonë është respektuar dhe zbatuar drejtë neni 80 i Ligjit të Punës, sidomos për pjesën që ka të bëjë me kthimin e punëtorit në vendin e tij të punës, ku në shumicën e rasteve është obliguar punëdhënësi që ta kthej të punësuarin në vendin e tij të punës, edhe pse nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga pika 1.2 që ka të bëjë me vërtetimin e ndonjërit prej llojeve të diskriminimit. Mirëpo vështirësitë kanë ndodhur sidomos me rastin e përmbarimit me dhunë të këtyre vendimeve, ku pas rikthimit në vendin e punës, pas një kohe të shkurtër sërish të njëjtëve i ndërpritet marrëdhënia e punës.

1.9 Respektimi i afateve ligjore për të kërkuar mbrojtje gjyqësore

Siç e kemi cekur edhe më lartë për të realizuar mbrojtjen gjyqësore të të drejtave nga marrëdhënia e punës, duhet që paraprakisht në mënyrë kumulative të përmbushen dy parakushte apo prezumime procedurale, të cilat janë: që punëtori paraprakisht t'i ketë shteruar procedurat interne për mbrojtjen e të drejtave dhe që padia në gjykatë të jetë dorëzuar brenda afatit të caktuar ligjor. Duke marr parasysh faktin se të dy prezumimet procedurale kanë një rëndësi të veçantë në mbrojtjen gjyqësore të të drejtave që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, nga përmbushja apo mospërmbushja e të cilave rrjedhin edhe pasoja juridike pozitive apo negative në raport me punëmarrësit, atëherë është e nevojshme që secili prej këtyre prezumimeve të trajtohet në mënyrë të veçantë.

1.9.1 Shterimi i mjeteve te brendshme juridike për të kërkuar mbrojtje gjyqësore

Shterimi mjeteve të brendshme juridike është parakushti i parë të cilin punëtori duhet të plotësojë, para se të fitoj të drejtën që të kërkoj realizimin e të drejtave të tij që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, përmes mbrojtjes gjyqësore në Gjykatë. Se punëtori duhet të kërkoj mbrojtjen e të drejtave të tij nga marrëdhënia e punës fillimisht brenda organeve të punëdhënësit, e parasheh neni 78 i Ligjit të Punës, të cilin e kemi elaboruar më lartë (ky nen përcakton edhe afatet brenda të cilit punëdhënësi duhet të vendos lidhur me kërkesën e punëtorit). Edhe pse Ligji i Punës nuk ka ndonjë dispozitë e cila shprehimisht e përcakton shtjerimin e mjeteve juridike të brendshme nga ana e punëtorit para se ti drejtohet gjykatës, kjo indirekt parashihet me nenit 79 të këtij ligji, i cili përcakton se çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjegje brenda afatit 78 parag. 2 të këtij ligji, brenda afatit të caktuar mund të inicoj kontest pune në Gjykatën Kompetente. Nga kjo nënkuptohet se punëtori patjetër duhet ti shfrytëzojë mjetet juridike të brendshme (interne) brenda punëdhënësit, nëse dëshiron që të ketë mbrojtje gjyqësore në fazën e mëvonshme.

Gjykata me rastin e pranimit të lëndëve që kanë për objekt marrëdhëniet e punës, gjatë shqyrtimit paraprak të padisë, duhet të vërtetoj faktin se a i ka shtjeruar të gjitha mjetet juridike të brendshme punëtori brenda punëdhënësit, në mënyrë që të njëjtit ti jepet mbrojtja gjyqësore e kërkuar. Në të gjitha rastet kur gjykata konstaton se punëtori ka dështuar t'i shfrytëzoj këto mjete të brendshme juridike, atëherë me aktvendim padinë duhet ta hedhë poshtë si të parakohshme. Gjithësesi punëtori nuk e humb të drejtën që përsëri t'i drejtohet gjykatës me padi, pasi që t'i shfrytëzoj mjetet e brendshme juridike brenda organeve të punëdhënësit, sigurisht duke respektuar edhe afatin ligjor për parashtrimin e kësaj padie në Gjykatë.

1.9.2 Pasojat juridike të mos respektimit të afatit ligjor për te kërkuar mbrojtje gjyqësore sipas Ligjit të Punës

Respektimi i afatit ligjor për parashtrimin e padisë në gjykatë tek kontestet e punës është parakushti apo prezumimi i dytë që punëtori duhet të plotësojë, për të kërkuar mbrojtje gjyqësore për realizimin e të drejtave të tij që rrjedhin nga marrëdhënia e punës. Kjo është paraparë me nenin 79 të Ligjit të Punës të cilin e kemi shtjelluar më lartë, ndërsa referuar këtij neni i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës, atëherë në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh mund të inicoj kontest pune në Gjykatën Kompetente. Nëse i referohemi Ligjit për Marrëdhënien e Punës i KSA të Kosovës i vitit 1989 dhe Ligjit të Punës së ish Jugosllavisë, të cilët kanë qenë në fuqi deri në miratimin e Ligjit të Punës (në bazë të Rregulloreve të UNMIK-ut të cilat i kemi përmendur më

lartë), atëherë vijmë në përfundim se me Ligjin e Punës është paraparë afat më i gjatë për parashtrimin e padisë në Gjykatë. Kështu me nenin 83 të Ligjit për marrëdhënien e punës të KSA të Kosovës dhe nenin 181 të Ligjit të Punës së ish Jugosllavisë, afati për parashtrimin e padisë në gjykatë në kontestet e punës ka qenë 15 ditor. Sigurisht përcaktimi i afatit 30 ditor për parashtrimin e padisë në Gjykatë sipas Ligjit të Punës, është bërë me qëllim që punëtorët të kenë me shumë kohë për dorëzuar padinë në gjykatë, duke marrë parasysh faktin se ky afat është prekluziv, me humbjen e të cilit edhe humb e drejta për të kërkuar mbrojtje gjyqësore.

Gjykata me rastin e pranimit të padisë që ka për objekt mbrojtjen e të drejtave që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës, gjatë shqyrtimit paraprak të padisë, duhet të vërtetojë faktin se padia e paditësit (punëtorit) a është parashtruar brenda afatit të paraparë ligjor. Në të gjitha rastet kur gjykata konstaton se punëtori ka dështuar ta dorëzojë padinë brenda afatit të caktuar, atëherë me aktvendim padinë duhet ta hedhë poshtë si të palejueshme (pas afatshme), ashtu siç është paraparë me nenin 391 pika f) të Ligjit të Procedurës Kontestimore, i cili shprehimisht thotë se *“pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata e hedhë poshtë padinë si të palejueshme, po që se konstaton se padia është paraqitur pas skadimit të afatit, po që se me dispozita të posaçme është parashtruar afati për paraqitjen e saj”*. Në këtë rast punëtori e humb të drejtën që të ketë mbrojtje gjyqësore, për shkak se siç e cekëm edhe më lartë afati për parashtrimin e padisë në Gjykatë është prekluziv (nuk mund të shtyhet), me humbjen e të cilit humb edhe e drejta për të kërkuar mbrojtje gjyqësore në Gjykatë.

1.10 Ushtrime

Gjatë këtij sesioni pjesëmarrësve do tu prezantohet një shembull praktik, i cili ndërlidhet me temat e shqyrtuara më lartë. Ata do të ndahen në grupe të vogla dhe nga ana e secilit grup (përfaqësuesi i grupit) do të prezantojë mendimin e tyre, në lidhje me rastin praktik.

1.11 Përmbledhje

Përgjatë punimit është vlerësuar në tërësi aspekti teorik dhe ai praktik që ka të bëjë me çështjen e mbrojtjes gjyqësore të të drejtave që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës bazuar në dispozitat ligjore përkatëse të Ligjit të Punës që është në fuqi. Gjithashtu janë shtjelluar shkaqet për të cilat punëdhënësi mund t'i shëpusë kontratën e punës punëtorit në bazë të ligjit të lartpërmendur, procedurën dhe mjetet juridike të brendshme të cilat duhet t'i shfrytëzojë punëtori para se të kërkojë mbrojtje gjyqësore në Gjykatës, pasojat juridike në rastet e mos shfrytëzimit të këtyre mjeteve, afatet ligjore për parashtrimin e padisë në gjykatë dhe pasojat e mos respektimit të këtij afati. Më tutje janë shtjelluar edhe kompetenca e gjykatës dhe llojet e vendimeve që i merr gjykata në kontestet e punës, më saktësisht bazuar në nenin 80 të Ligjit të Punës, si dhe janë diskutuar edhe problematikat që janë hasur me rastin e zbatimit në praktikë të këtij neni nga ana e gjykatave, ku si rezultat i kësaj del nevoja që rreth zbatimit të drejtë të këtij neni të merret edhe ndonjë mendim juridik nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës. Gjithashtu kemi ardhur në përfundim se procedura për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës është e veçantë për të cilën përveç zbatimit të rregullave të përgjithshme të procedurës kontestimore zbatohen edhe disa rregulla të veçanta që janë paraparë me nenet 474 deri në 477 të LPK-së. Konsideroj se ky punim modest në lidhje me mbrojtjen gjyqësore të të drejtave që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës, sadopak do të ju ndihmojë gjyqtarëve të rinjë gjatë punës së tyre në praktikë, për vendosjen e lëndëve që kanë për objekt kontestet e punës.

2. Kontestet nga marrëdhënia e punës sipas Ligjit për Shërbyesit Civil

2.1 Hyrje

Në modulën me temë “Mbrotjtja gjyqësore në kontestet nga marrëdhënia e punës”, përkatësisht në sesionin e dytë, ndër të tjera do të shtjellohet natyra juridike e kontesteve të punës, të cilat rrjedhin nga Ligji për Shërbyesit Civil, legjislacioni në fuqi tek këto konteste, fusha e zbatimit dhe llojet e kontratave të punës (akt emërimeve) sipas Ligjit për Shërbyesit Civil, shkaqet e shkëputjes së marrëdhënies së punës, procedurën gjyqësore që zhvillohet tek kontestet e punës sipas Ligjit të cekur më lartë, llojet e vendimeve gjyqësore që merren tek kontestet e punës ku paditës janë shërbyesit civil, dallimet në mes të kontesteve për shërbyesit civil dhe kontesteve tjera nga marrëdhënia e punës, procedurat brendshme të cilat duhet të shfrytëzohen shërbyesit civil, para se të kërkojnë mbrojtje gjyqësore, përfshirë këtu edhe mbrojtjen gjyqësore e të drejtave të punës për shërbyesit civil, kompetencën, afatet, mjetet juridike etj.

Gjithashtu do të shtjellohen edhe respektimi i afateve për të kërkuar mbrojtje gjyqësore, më saktësisht çështjen e shterimit të mjeteve të brendshme juridike për të fituar të drejtën e kërimit të mbrojtjes gjyqësore, kompetencat e Këshillit të Pavarur Mbikqyrës, si dhe pasojat juridike të mos respektimit të afateve për të kërkuar mbrojtje gjyqësore sipas legjislacionit në fuqi tek këto konteste.

2.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij sesioni trajnues, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Marrin njohuri lidhur me kontestet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës për shërbyesit civil, përfshirë këtu procedurën që zhvillohet në Këshillin e Pavarur Mbikqyrës;
- Identifikojnë legjislacionin e zbatueshëm vendor dhe ndërkombëtar në kontestet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës tek shërbyesit civil;
- Dallojnë kontestet për shërbyesit civil dhe kontestet e tjera nga marrëdhënia e punës sipas ligjit të punës;
- Zbatojnë drejtë dispozitat e ligjit përkatës duke vlerësuar afatet për të kërkuar mbrojtje gjyqësore.

2.3 Shërbimi Civil në Republikën e Kosovës

Shërbimi Civil në Republikën e Kosovës si kategori kushtetuese është përcaktuar me aktin më të lartë juridik të vendit-Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ku me nenin 101, paragrafin 1 është përcaktuar që: *„Përbërja e shërbimit civil do të pasqyrojë shumëllojshmërinë e popullit të Kosovës, duke marrë në konsideratë parimet e barazisë gjinore, të njohura ndërkombëtarisht”*.

Në fillim, shërbimi civil në Kosovë është themeluar me krijimin e institucioneve të përkoshme dhe nxjerrjen e rregulloreve të para nga UNMIK-u, gjegjësisht me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkoshme të Vetëqeverisjes në Kosovë janë vënë parimet e përgjithshme të Shërbimit Civil, ku me nenin 4 paragrafin 1 të kësaj rregulloreje është përcaktuar që: *„Do të ekzistojë një Shërbim i Përkohshëm Civil i Kosovës, që do të drejtohet sipas legjislacionit për rregullimin e Shërbimit civil.*

Me ngritjen e kapaciteteve të institucioneve në Kosovë, reformimin e administratës publike si dhe ndryshimin e rrethanave politike e juridike, shërbimi civil ka vazhduar me sukses, rrugën e profilizimit dhe ngritjes së kapaciteteve profesionale, duke zënë vendin meritore në administratën publike në Republikën e Kosovës. Në këtë periudhë kohore kemi një ndryshim të tërësishëm të infrastrukturës ligjore për shërbimin civil nga legjislacioni që derivonte nga rregulloret e UNMIK-ut dhe aktet nënligjore të nxjerra nga Ministria e Shërbimeve Publike për zbatimin e rregulloreve të UNMIK-ut.

Në vijimësi do të përfshihen legjislacioni primar dhe sekondar në Republikën e Kosovës për shërbimin civil me fokus të veçantë në dispozitat ligjore që rregullojnë qëshkrimin e mbrojtjes së të drejtave të nëpunësve civilë në kontestet e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, ku aktet kryesore janë:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil;
- Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale;
- Ligji Nr. 02/L-28 për Procedurat Administrative;
- Ligjin Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore;
- Ligji nr. 03/l-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
- Ligji Nr. 03/L-202, për Konfliktet Administrative;
- Rregullore Nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil;
- Rregullore nr. 4/2011 për procedurat disiplinore në shërbimin civil;
- Rregullore nr. 5/2011 për procedurat e zgjidhjes së kontesteve dhe ankesave;
- Rregullore Nr. 06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës;
- Rregullore Nr.02/2011 për Rregullat dhe Procedurat e ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

2.4 Administrata Shtetërore dhe Administrata Publike

Koncepti i „administratës publike” siç përdoret në të drejtën administrative në Kosovë është më i gjerë se koncepti i „administratës shtetërore” siç përkufizohet në Ligjin për Administratën Shtetërore. Për qëllim të këtij trajnimi, do të sqarojmë vetëm përdorimin e termave për të përcaktuar statusin e nëpunësit civil dhe për të kuptuar marrëdhënien midis udhëheqjes qendrore dhe lokale siç shpjegohet më poshtë.

Në legjislacionin e tanishëm në Kosovë përdoren termat „nëpunës civilë”, “shërbyes civilë” si edhe „nëpunës shtetëror” (LASH, Neni 14). Të gjithë këta terma nënkuptojnë vetëm “nëpunës civil”, statusi dhe përkufizimi i të cilit rregullohet me Ligjin për Shërbimin Civil dhe legjislacionin përkatës që rregullon aspekte të caktuara.

Ligji për procedurën Administrative, Neni 2 i përkufizon organet e administratës publike si:

1. Organet e administratës publike janë:

a. organet e administratës publike qendrore dhe organet tjera në vartësi të tyre;

b. organet e administratës publike lokale dhe organet e tjera në varësi të tyre.

2. *Organet individuale të administratës publike janë autoritete publike me kompetenca ligjore që i ushtron një person.*
3. *Organet kolektive të administratës publike janë autoritete publike me kompetenca ligjore që i ushtrojnë dy ose më shumë persona.*

Ligji për Administratën Shtetërore përkufizon dhe klasifikon organet e administratës shtetërore në: organet e larta, organe qendrore, organe lokale, organe të pavarura. Ligji për Administratën Shtetërore bën edhe një klasifikim të “institucioneve” të administratës shtetërore si dhe dallimin e lidhjen me “organet”. Pavarësisht nga terminologjia që përdor Ligji për Administratën Shtetërore, “organet e larta”, “organet qendrore” dhe kryesisht “organet e pavarura” mund të nënkuptohen që bëjnë pjesë në “organet e administratës publike qendrore dhe organet e tjera në vartësi të tyre” sikurse përkufizohet nga Ligji për procedurën Administrative, ndërsa “organet lokale” janë ato që përkufizohen nga Ligji për procedurën Administrative, (cituat më lart, 1.b.)

Ligji për Administratën Shtetërore, parashikon komunat si institucione të drejtpërdrejta të administratës shtetërore kur veprojnë brenda kompetencave të deleguara dhe si institucione të tërthorta të administratës shtetërore kur veprojnë brenda kompetencave të tyre vetanake (decentralizimi). Sipas përkufizimit të dhënë në Ligjin për vetëqeverisje lokale, Nëpunës civilë në administratën lokale konsiderohen të gjithë personat e punësuar nga autoriteti komunal rroga e të cilëve paguhet nga buxheti i Kosovës, përveç kryetarit, nënkryetarëve dhe drejtorëve, kryesuesit dhe anëtarëve të kuvendit.

2.5 Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Ky ligj rregullon statusin e nëpunësve civilë, si dhe marrëdhënien e tyre të punës në institucionet e administratës qendrore dhe komunale.

Është me rëndësi të theksohet që me miratimin e ligjit të ri, kemi një ndarje të nëpunësve civilë nga nëpunësit tjerë që rregullohen me ligjin e punës, dhe LSHC përcakton institucionet në të cilat zbatohet, ku përfshihen institucionet e administratës qendrore dhe komunale: administrata e Kuvendit, administrata e Presidencës, Zyra e Kryeministrit dhe ministritë, agjencitë ekzekutive, agjencitë e pavarura dhe ato rregullatore dhe administrata komunale.

Sipas LSHC-së „Shërbimi civil” nënkupton: *„i tërë trupi i personelit administrativ të punësuar, në institucionet e administratës qendrore dhe komunale të parapara me këtë ligj, të cilët zbatojnë politikat dhe sigurojnë respektimin e rregullave dhe procedurave përkatëse”.*

Nëpunës civil sipas këtij ligji nënkupton:

„personi i punësuar për ushtrimin e autoritetit administrativ publik në bazë të aftësisë dhe kapacitetit, i cili merr pjesë në formulimin dhe zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative, sigurimin e ekzekutimit të tyre dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme administrative për zbatimin e tyre”.

Me nenin 3 të LSHC-së janë përcaktuar kategoritë e nëpunësve që janë pjesë e shërbimit civilë, ku përfshihen: Nëpunësit e Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës; Personeli diplomatik dhe konsullor, si dhe personeli administrativ i dërguar jashtë vendit ose i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës, Personeli civil i punësuar në Policinë e Kosovës, në Forcën e Sigurisë së Kosovës, në Doganat e Kosovës, në Shërbimin Korrektues të Kosovës si dhe Personeli administrativ i punësuar në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës.

Ligji për shërbimin civil në mënyrë të shprehur ka bërë përcaktimin e kategorive të punonjësve publikë të cilët nuk janë pjesë e Shërbimit Civil, ku përfshihen:

- *stafi mësimor i sistemit arsimor,*
- *stafi mjekësor i sistemit shëndetësor,*
- *krijuesit dhe përformuesit e artit,*
- *zyrtarët policorë të Policisë së Kosovës,*
- *zyrtarët doganorë të Doganave të Kosovës,*
- *zyrtarët korrektues të Shërbimit Korrektues të Kosovës,*
- *pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës,*
- *të emëruarit politik dhe të gjithë ata që emërohen në pozita nga të emëruarit politik dhe anëtarët e kabineteve të tyre, që nga kabineti i Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe kabinetet e ministrave,*
- *të gjithë nëpunësit e punësuar në kabinetet e funksionarëve publikë si dhe*
- *personeli i punësuar nga institucionet e administratës në nivel qendror dhe komunal, përgjegjës për kryerjen e funksioneve mbështetëse dhe të mirëmbajtjes.*

Ligji për shërbimin civil me objektivën e formimit të një shërbimi civil të karrierës ka përcaktuar edhe procedurat për mbrojtjen e të drejtave të nëpunësve civilë përmes procedurave të brendshme të ankimit si dhe obligimin e organeve të punësimit për krijimin e komisioneve përkatëse për zgjidhjen e kontesteve dhe shqyrtimin e ankesave.

Mënyra dhe procedura e ankimit ndryshon në varësi të statusit të nëpunësit civil.

Ligji për shërbimin civil me nenin 50 ka njohur të drejtën e ankesës, duke përcaktuar që:

„ Nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje ose lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe që kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës ”.

Me këtë dispozitë nëpunësve civilë u njihet e drejta për ankesë kundër vendimit të organit të punësimit, kundër veprimit por edhe kundër heshtjes së organit të punësimit.

Me paragrafin 2 të nenit 50 të LSHC, përcaktohet e drejta e nëpunësit civilë për mbrojtje përmes procedurave të brendshme administrative ose gjyqësore në rast të shkeljes së të drejtave të tyre, që rezulton nga një veprim i administratës publike.

Për nëpunësit civilë në punë provuese, të cilët nuk janë konfirmuar në pozicionin e punës, LSHC ka përcaktuar që mund të paraqesin ankesë drejtëpëdrejtë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, në afat prej tridhjetë (30) ditësh prej komunikimit të vendimit nga njësia e personelit.

Ligji i ri për shërbimin civil ka përcaktuar edhe masat disiplinore për nëpunësit ku vlen të theksohet që është përjashtuar masa e degradimit për nëpunësit civil, dhe në varësi të shkeljes mund të shqiptohen edhe masat përkatëse disiplinore, ku përfshihen:

- *Paralajmërimi nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë;*
- *Vërejtja me shkrim nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.*
- *Vërejtja me shkrim dhe mbishkrimi në dosjen personale të nëpunësit civil nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit në institucion;*
- *pezullimi parandalues me pagesë deri në tre (3) muaj në pritje të një hetimi i cili duhet të propozohet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe miratohet nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit në institucion;*
- *pezullimi i detyrave dhe ndalimi i 1/3 të rrogës për një periudhë deri në dy (2) muaj nga komisioni disiplinor pas kërkesës nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë;*

- *largimi nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit deri në pesë (5) vjet nga komisioni disiplinor;*
- *ndërprerja e marrëdhënies së punës në shërbimin civil nga komisioni disiplinor, pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension;*
- *Pensionimi i parakohshëm për nëpunësit civilë të cilëve u kanë mbetur edhe dy (2) vjet deri në datën e pensionimit.*

Për shqyrtimin e shkeljeve dhe shqiptimin e masave disiplinore, Ligji për shërbimin civil ka përcaktuar që çdo institucion i administratës publike, i cili punëson nëpunës civilë, themelon një komision disiplinor, duke precizuar që Kryesuesi dhe anëtarët e komisionit disiplinor janë nga radhët e nëpunësve civilë me përgatitje superiore shkollore dhe emërohen në periudhë dy (2) vjeçare, me mundësi vazhdimi, dhe duhet të pasqyrojnë diversitetin e shoqërisë kosovare, duke përfshirë sidomos diversitetin gjinor.

Me Rregulloren nr. 4/2011, për procedurat disiplinore në shërbimin civil është rregulluar në detaje procedura disiplinore ndaj nëpunësve civil si dhe afatet e ankesës, ku me saktësisht me nenin 16 të kësaj rregullore përcaktohet që:

„ Palet e pakënaqura kunder vendimeve të marra gjate procedures diciplinore, kane te drejte ankese në Komisionin për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, brenda afatit prej 30 ditësh’.

Për zyrtarët në pozitë të nivelit të lartë drejtues, është përcaktuar që të themelohet komision i veçantë disiplinor „Komisioni disiplinor për pozita të nivelit të lartë drejtues” i cili do të emërohet rast pas rasti nga Qeveria dhe përbëhet nga pesë (5) anëtarë dhe në përbërjen e tyre ka së paku një (1) nga zëvendëskryeministrat, ministrin përgjegjës për administratë publike, një (1) ministër nga radhët e komuniteteve dhe dy (2) anëtarë të tjerë nga radhët e sekretarëve të përgjithshëm apo pozicioneve të barasvlershme.

Për dallim nga procedura e ankesës për nëpunësit civil, LSHC me nenin 78 ka përcaktuar „Nëpunësi civil i nivelit të lartë drejtues i pakënaqur me vendimin e komisionit disiplinor, ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e njoftimit për vendimin’

Poashtu me dispozitat e Rregullores Nr. 06/2012 Për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përcaktohet procedura e ankesës dhe afatet e ankesës nga zyrtarët e nivelit të lartë drejtues që dallon nga procedura për nëpunësit tjerë civilë.

Me nenin 20 të kësaj rregullore përcaktohet që „Zyrtari i lartë drejtues i pakënaqur me vendimin e komisionit disiplinor, ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të vendimit’.

Për procedurën e rekrutimit në pozitat e nivelit të lartë drejtues, është përcaktuar themelimi i Komisionit të veçantë sipas nenit 21 të kësaj rregullore ku përcaktohet që:

„ Për të gjithë kandidatët që kanë konkurruar për pozitat e zyrtarëve të lartë drejtues në afat prej tetë ditësh pas përfundimit të procesit të selektimit të kandidatëve kanë të drejtë të ankohen në Komisionin e ankesave i cili formohet nga MAP sipas propozimit të Këshillit’.

Ligji i ri i Shërbimit Civil i ka dhënë rëndësi të madhe zgjidhjes së kontesteve në rrugë jashtë gjyqësore, duke përcaktuar edhe procedurat dhe organet për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave, ku përfshihen:

- *Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave dhe*

- *Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës.*

Në këtë frymë është edhe sanksionimi që është bërë me dhënien e efektit pezullues të ankesës, duke përcaktuar që të gjitha efektet e veprimeve administrative kundër të cilave është paraqitur ankesë ose të cilat janë në shqyrtim nga organet kompetente për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave pezullohen deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

Me nenin 82 të Ligjit për shërbimin Civil është obliguar çdo institucion i administratës qendrore dhe komunale që të themeloj Komisionet për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave, ku përcaktohet që kryesuesi dhe anëtarët e komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave janë nga radhët e nëpunësve civilë, me përgatitje superiore shkollore, emërohen nga Sekretari i Përgjithshëm apo nga pozitave ekuivalente të institucioneve përkatëse në periudhë dy (2) vjeçare, me mundësi vazhdimi, dhe pasqyrojnë diversitetin e shoqërisë kosovare, duke përfshirë sidomos diversitetin gjinor.

Kundër vendimeve të Komisioneve për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave, mund të paraqitet ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, në pajtim me procedurën e përcaktuar në Rregulloren nr. 5/2011 për procedurat e zgjidhjes së kontesteve dhe ankesave.

Sipas Rregullores nr. 5/2011 për procedurat e zgjidhjes së kontesteve dhe ankesave, është përcaktuar e drejta e ankesës e nëpunësve civil e poashtu edhe e kandidatëve që konkurrojnë për rekrutim në shërbimin civil, ku me saktësisht me nenin 4 paragrafin 1 të kësaj rregullore përcaktohet që:

„Nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo cdo shkelje ose lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe që kanë të bëjnë me mardhënien e tyre të punës”.

Me paragrafin 2 të nenit 4 të kësaj rregullore, u njihet e drejta e ankesës edhe personave të cilët kanë konkurruar në procedurë të rregullt për rekrutim në Shërbimin Civil.

Në frymën e ligjit për zgjidhjen e kontesteve jashtë procedurës gjyqësore, edhe rregullorja Rregullorja nr. 5/2011 për procedurat e zgjidhjes së kontesteve dhe ankesave, me nenin 6 përcakton obligimin e Komisionit për zgjidhjen e kontestit me arritjen e kompromisit të përbashkët në mes të palëve në procedurë.

Procedura e paraqitjes së ankesës për Komisionin për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave, është përcaktuar me nenin 8 të kësaj rregullore ku përcaktohet që ankesa duhet të bëhet me shkrim dhe të dorëzohet në njësinë e personelit të institucionit përkatës.

Afati për paraqitjen e ankesës është brenda tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga mardhënia e punës.

Poashtu afati i njëjtë tridhjetë (30) ditësh është për procedurën e paraqitjes së ankesës për procedurën e rekrutimit, ku në ndërlidhje me Rregulloren Nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil përcaktohet më saktësisht afati dhe procedura.

Me nenin 42 të kësaj rregullore është përcaktuar e drejta e nëpunësit civil ose e kandidatit të jashtëm për ankesë në Komisionin për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave, kundër refuzimit të pjesëmarrjes në procedurën e rekrutimit, dhe afati për paraqitjen e ankesës është brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e pranimit të njoftimit të refuzimit nga Komisioni Përzgjedhës për Shërbimin Civil përkatës.

Me nenin 43 të kësaj rregullore është përcaktuar e drejta e nëpunësit civil ose e kandidatit të jashtëm për ankesë në Komisionin për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave, kundër vendimit të përzgjedhjes dhe emërimit, dhe afati për paraqitjen e ankesës është brenda tridhjetë (30) ditësh nga data në të cilën vendimi për përzgjedhje dhe emërim shpallet nga institucioni përkatës.

Pas përfundimit të procedurës së ankimimit brenda institucionit të punësimit, procedura e mëtejme e ankimimit administrativ mund të vazhdohet në pajtim me dispozitat e Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

2.6 Ligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Ky ligj përcakton organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, duke përcaktuar funksionet e Këshillit, dhe një ndër funksionet kryesore është edhe: *„shqyrtimi dhe marrja e vendimeve për ankesat e nëpunësve civilë kundër vendimeve të organit të punësimit në të gjitha institucionet e Shërbimit Civil në përputhje me rregullat dhe parimet e parashtruara në Ligjin për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës”*.

Me dispozitat e këtij ligji është përcaktuar e drejta e nëpunësit civil për ankesë në Këshill pasi të ketë shteruar procedurat e brendshme të ankimimit, përveç nëse Këshilli e përjashton këtë kërkesë për shkak të frikës së arsyeshme të hakmarrjes, dështimit të organit të punësimit për të zgjidhur ankesën brenda tridhjetë (30) ditësh ose për ndonjë shkak tjetër të arsyeshëm. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është i obliguar për nxjerrjen e vendimit në lidhje me ankesën brenda afatit prej (60) ditësh pas datës së paraqitjes së ankesës, me përjashtim të rasteve specifike, kur me vendim të Këshillit, afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh mund të shtohen edhe tridhjetë (30) ditë tjera për nxjerrjen e vendimit.

Procedura e ankesës në Këshill është e rregulluar më detajisht me Rregulloren Nr.02/2011 për Rregullat dhe Procedurat e ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Me këtë rregullore i njihet e drejta për ankesë në Këshill cdo nëpunësi civil ose aplikuesi për punësim në shërbimin civil i cili është i paknaqur me vendimin e organit të punësimit. Rregullorja përcakton që ankesa duhet të paraqitet me shkrim, brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e marrjes së vendimit të komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, nga pala. Rëndësia dhe fuqia ekzekutive e vendimeve të Këshillit është e përcaktuar me nenin 13 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet që: *„Vendimi i Këshillit paraqet vendimin administrativ të formës së prerë dhe ekzekutohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palë”*.

Në fillim ka pasur mendime dhe opinione të ndryshme sa i përket fuqisë ekzekutive të vendimit të Këshillit.

Në shkurt të vitit 2012, Gjykata Supreme ka lëshuar mendimin, (Mendimi i gjykatës Supreme nr.136/12, i nxjerrë më 20 shkurt 2012) duke e ripohuar qëndrimin e fundit, duke cekur që vetëm vendimet e Këshillit lidhur me kompensimin financiar përmbrohën, ndërsa nuk përmbrohën vendimet që përfshijnë rikthimin në pozitën e mëparshme të shërbyesve civilë. Parashtruesit e ankesave që menduan se ankesat e tyre nuk janë zgjidhur në mënyrë adekuate nën këto rrethana, i kanë paraqitur ankesat e tyre para gjykatës kushtetuese, në mënyrë që të kërkojnë qartësimin përfundimtar.

Në një vendim të rëndësishëm, Gjykata kushtetuese ka marrë vendim në favor të ankuesve, ku thuhet që vendimet e Këshillit janë “të prera dhe të ekzekutueshme në procedurë

administrative”. (Aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese në rastet nr. KI 129/11 (të datës 17 korrik, 2012), KI55/11 (të datës 20 korrik, 2012), KI 04/12 (të datës 20 korrik, 2012), KI 47/12 (të datës 16 korrik, 2012), KI 50/12 (të datës 16 korrik, 2012).

Institucionet e punësimit janë të obliguara për ekzekutimin e vendimit brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Pala e pakënaqur me vendimin e Këshillit, mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Ligjit për Konfliktin Administrativ është përcaktuar që inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit.

2.7 Konflikti Administrativ

Ligji për Konfliktin Administrativ (LKA) rregullon mbrojtjen gjyqësore të interesave dhe të të drejtave të palëve të cilët pretendojnë se administrata ua ka cënuar këto interesa dhe të drejta në kundërshtim me ligjin. LKA parashikon se në cilat raste palët e interesuara mund t’i drejtohen gjykatës në rast të pretendimeve ndaj akteve administrative.

Me këtë ligj rregullohen kompetenca, përbërja e gjykatës dhe rregullat e procedurës, në bazë të të cilave gjykatat kompetente, vendosin për ligjshmërinë e akteve administrative me të cilat organet kompetente të administratës publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë dhe palëve të tjera, si dhe për ligjshmërinë e veprimeve të organeve administrative.

LKA rregullon mundësinë e palëve për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet administrative kur palët nuk janë kënaqur me zgjidhjen në procedurën administrative dhe kur ende pretendojnë se u janë cënuar të drejtat e tyre.

Për gjykatën që shqyrton konfliktin administrativ LKA është ligji bazë, por natyrisht gjatë punës bazohet edhe në legjislacionin tjetër me rëndësi si në Kushtetutën e Kosovës, Ligjin për Procedurën Kontestimore, Ligjin për Gjykatat dhe Ligjin për Procedurën Administrative.

Sipas LKA gjykata kompetente ku mund të ngrihet padi për konfliktin administrativ është Gjykata Supreme e Kosovës. Që nga 1 Janari 2013 me riorganizmin e gjykatave në Kosovë janë krijuar gjykatat themelore si gjykata të shkallës së parë me seli në shtatë qendra rajonale gjeografike. Në Gjykatën Themelore në Prishtinë ndodhet edhe Departamenti për Çështje Administrative që vepron si gjykatë e shkallës së parë për konfliktet administrative për të gjithë Kosovën. Departamenti për Çështje Administrative në Gjykatën e Apelit do të jetë gjykatë e shkallës së dytë për konfliktet administrative. Gjykata Supreme do të mbetet instanca më e lartë gjyqësore në Kosovë.

Objekti i konfliktit administrativ është akti administrativ i kontestuar. Akti administrativ që të jetë objekt i konfliktit administrativ duhet të jetë i formës së prerë, dmth. palët duhet që të kenë shterrur ankimin administrativ – vetëm pas këtij procesi akti administrativ është i formës së prerë.

LKA parashikon që pala e interesuar mund të paraqes padi për konflikt administrativ edhe në rastet kur organet e administratës nuk kanë marrë asnjë vendim, dmth. kur administrata ka “heshtur” në lidhje me kërkesën e palës. Pala duhet të provojë që përpjekjeve të saj për

komunikim me administratën, për të shqyrtuar kërkesën e saj nuk i është dhënë përgjigje sipas afateve të kërkuara nga ligji.

Padia nuk e pezullon zbatimin e aktit administrativ, përveç nëse parashikohet ndryshe me ligj. Pala mund t'i kërkojë shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, organit që është përgjegjës për ekzekutimin e vendimit ose gjykatës (edhe pa ia kërkuar më parë organit administrativ që është kompetent për zbatimin e aktit). Vendimi për shtyrjen e ekzekutimit duhet të merret brenda 3 ditëve nga data e marrjes së kërkesës. Ekzekutimi mund të shtyhet për shkaqet e përmendura në ligj ose për shkaqe të tjera të arsyeshme nëse nuk është në dëm të interesit publik.

Në përfundim të procedurës gjyqësore për konfliktin administrativ, gjykata vendos me aktgjykim nëse padia aprovohet apo nëse refuzohet si e pabazuar.

2.8 Ushtrime

Gjatë këtij moduli pjesëmarrësve do tu prezantohet një shembull praktik, i cili ndërlidhet me temat e shqyrtuara më lartë. Ata do të ndahen në grupe të vogla dhe nga ana e secilit grup (përfaqësuesi i grupit) do të prezantoj mendimin e tyre, në lidhje me rastin praktik.

2.9 Përmbledhje

Përgjatë kësaj pjese të punimit është vlerësuar në tërësi aspekti teorik dhe ai praktik që ka të bëjë me çështjen e mbrojtjes gjyqësore të të drejtave që rrjedhin nga marrëdhënia e punës bazuar në dispozitat ligjore përkatëse të Ligjit për Shërbyesit Civil që është në fuqi. Gjithashtu janë shtjelluar shkaqet për të cilat punëdhënësi mund t'i shëpusë kontratën e punës punëtorit në bazë të ligjit të lartpërmendur, procedurën dhe mjetet juridike të brendshme të cilat duhet t'i shfrytëzojë puntori para se të kërkojë mbrojtje gjyqësore në Gjykatës, pasojat juridike në rastet e mos shfrytëzimit të këtyre mjeteve, afatet ligjore për parashtrimin e padisë në gjykatë dhe pasojat e mos respektimit të këtij afati. Më tutje janë shtjelluar edhe kompetenca e gjykatës dhe llojet e vendimeve që i merr gjykata në kontestet e punës, si dhe janë diskutuar edhe problematikat që janë hasur me rastin e zbatimit në praktikë të ligjeve përkatëse nga ana e gjykatave. Konsideroj se ky punim modest në lidhje me mbrojtjen gjyqësore të të drejtave që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, sadopak do të ju ndihmojë gjyqtarëve të rinjë gjatë punës së tyre në praktikë, për vendosjen e lëndëve që kanë për objekt kontestet e punës.

3. Mbrojtja në punë dhe kompensimi i dëmit i shkaktuar në punë

3.1 Hyrje

Në vitet e fundit është rritur numri punëmarrësve të lënduar në vendet e tyre të punës apo si pasojë e sëmundjeve profesionale (një numër jo i vogël i tyre fatkeqësisht edhe e kanë humbur jetën), si pasojë e mungesës së kushteve të punës, sigurisë dhe shëndetit në punë, ndërsa me këtë edhe është rritur numri i kontesteve që për objekt të padisë kanë kompensimin e dëmit për shkak të lëndimit në punë apo sëmundjes profesionale.

Shkak për këtë është se legjislacioni në fuqi ka pasur disa mangësi me ç'rast i janë cenuar të drejtat e punëmarrësve, për shkak se në masë të madhe punëdhënësit nuk i kanë respektuar dhe zbatuar dispozitat ligjore që rrjedhin nga Ligji i Punës, Ligji për Sigurinë dhe Shëndetinë në Punë etj. Mirëpo kjo ka ndodhur si pasojë e mosnjohjes së detyrave dhe përgjegjësive që ka organi kompetent i punëdhënësit në lëminë e marrëdhënies së punës. Ky sesion do të shërben për diskutimin e problemeve të lartëcekura de ideve për tejkalimin e tyre.

Në sesionin e tretë me temë “*Mbrojtja në punë dhe kompensimi i dëmit i shkaktuar në punë*”, ndër të tjera do të shtjellohen përgjegjësitë e punëdhënësit në rastet e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, sigurimin e kushteve për mbrojtje në punë, informimin e punëmarrësve për të drejtat e tyre, të drejtat e punëmarrësve në rastet e aksidenteve apo sëmundjeve profesionale në punë, të drejtat e tyre për kompensimin e shpenzimeve të mjekimit dhe kompensimin e dëmit, për përgjegjësinë ligjore të punëdhënësve në rastet e aksidenteve apo sëmundjeve profesionale lidhur me punën, si dhe për legjislacionin e zbatueshëm në Kosovë për mbrojtjen në punë, sigurinë dhe shëndetin në punë etj.

3.2 Objektivat trajnues

Pas përfundimit të këtij prezantimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Dallojnë të drejtat e punëmarrësve dhe përgjegjësitë e punëdhënësit në rastet e aksidenteve në punë apo sëmundjeve profesionale;
- Zbatojnë drejtë ligjet materiale, përfshirë këtu kontratën kolektive dhe aktet e brendshme të personit juridik, të cilat janë të zbatueshme në rastet e aksidenteve në punë apo sëmundjeve profesionale.

3.3 Përgjegjësitë e punëdhënësit në rastet e aksidenteve në punë apo sëmundjeve profesionale

3.3.1 Sigurimi i kushteve të nevojshme për mbrojtje në punë

Liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore parashikohen në Kushtetutën e Republikës së Kosovës duke filluar nga “*E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit*”. Kjo e drejtë, veçanërisht, rregullohet nga dispozitat e Ligjit të Punës, i cili ngrihet mbi bazën e Kushtetutës. Sipas nenit 49 të Kushtetutës: “*E drejta e punës garantohet, ndërsa secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës*”.

Siguria ekonomike dhe sociale është një aspekt i rëndësishëm i sigurisë njerëzore. Në këtë pikëpamje, e drejta për punë dhe të drejtat gjatë punës luajnë një rol të rëndësishëm për arritjen e

sigurisë njerëzore. Të drejtat e punëtorëve janë të sanksionuara me ligj dhe konventa ndërkombëtare dhe garantojnë që të sigurohen kushte të përshtatshme për punë, mbrojtje kundër diskriminimit dhe shfrytëzimit në vendin e punës. Puna nuk duhet të sigurojë vetëm mirëqenien, por edhe pjesëmarrjen në shoqëri. Për këto arsye, promovimi apo shtytja e standarteve për kushte të përshtatshme të punës, pa shfrytëzim, është kusht për përmirësimin e sigurisë njerëzore.

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut përmban një varg të të drejtave të njeriut të ndërlidhura me punën. Të gjitha këto të drejta janë zhvilluar më tutje në marrëveshjet të cilat e bëjnë të detyruar mbi palët shtetërore.

“Gjithkush ka të drejtë për punë, të zgjedhë lirisht profesionin, të ketë kushte të favorshme pune dhe të jetë i mbrojtur nga papunësia”.

“Gjithkush, pa kurrfarë diskriminimi, ka të drejtë që për punë të njëjtë të marrë rrogë të njëjtë. Gjithkush që punon ka të drejtën për shpërblim të drejtë dhe të favorshëm, në mënyrë që t’i sigurojë atij dhe familjes së tij një jetë që i përgjigjet dinjitetit njerëzor dhe në qoftë se do të jetë e nevojshme, ky shpërblim të plotësohet edhe me mjete të tjera të sigurimit shoqëror.

Duke vijuar, më tej me Kartën Sociale Europiane, të nënshkruar me synimin e arritjeve të kushteve, në të cilat të drejtat mund të realizohen në mënyrë sa më efektive. Puna megjithëse është e ndërlidhur ngushtë me dinjitetin njerëzor, po ashtu mund të jetë mjet edhe për vetë realizimin dhe kontribuon në zhvillimin e personalitetit.

Përcaktimi i detyrimeve të përgjithshme të punëdhënësit, ndër të tjera ka për qëllim edhe mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së punëmarrësve. Punëdhënësi detyrohet të kujdeset për kushtet dhe higjienën e vendeve të punës, ndërsa posaçërisht duhet të marrë masat e nevojshme mbrojtëse kundër rreziqeve të veçanta që paraqesin: 1. substancat dhe agjentët helmues, 2. makineritë dhe aparaturat që përdoren në vendin e punës; 3. transporti i peshave të rënda; 4. ndotja e ajrit; 5. zhurmat dhe dridhjet; 6. si dhe rreziqe të tjera në disa degë të ekonomisë, si ndërtim, miniera, industri kimike, etj.

Ligji Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë Nr. 04/L-161, në nenin 5 normon se punëdhënësi është përgjegjës për të krijuar kushtet e punës të sigurta dhe të shëndetshme në të gjitha aspektet e jetës. Ky ligj, ndër të tjera përcakton të gjitha veprimet që duhet t’i ndërmarrin punëdhënësit, me qëllim të krijimit të kushteve optimale të punës për punëmarrësit, si dhe parandalimin e rreziqeve të ndryshme që mund të shkaktojnë lëndime të punëmarrësve dhe sëmundje profesionale për ta. Gjithashtu ky ligj në mënyrë taksative ka paraparë edhe përgjegjësitë të cilat i kanë punëdhënësit nëse dështojnë të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme të përmendura më lartë dhe si pasojë e tyre vije deri te lëndimi i punëtorëve dhe sëmundjet profesionale⁶.

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i masave për përmirësimin e shkallës së sigurisë dhe shëndetit të të punësuarve në punë. Gjithashtu dispozitat e këtij ligji përmbajnë parimet e përgjithshme për parandalimin e rreziqeve profesionale, eliminimin e faktorëve të rrezikut dhe aksidentëve, informimit, konsultimit, pjesëmarrjes së balancuar në nivelin e sigurisë dhe shëndetit në punë, trajnimin e të punësuarve, përfaqësuesve të tyre dhe udhëzimeve të përgjithshme për zbatimin e këtyre parimeve⁷.

Dispozitat e këtij ligji zbatohen në sektorin publik, privat, publiko-privat dhe sektorin e administratës shtetërore të nivelit qendror dhe lokal. Gjithashtu këto dispozitat zbatohen edhe për: praktikantët, nxënësit dhe studentët në punë praktike gjatë shkollimit, personat në vuajtje të

⁶ Shih nenin 5, 6, 7 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Ligji Nr. 04/L-161

⁷ Shih nenin 1 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë,

dënimit të angazhuar në punë, vizitorët, bashkëpunëtorët afaristë, shfrytëzuesit e shërbimeve dhe personat në aftësim ose riaftësim profesional të punëdhënësi. Ndërsa dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen në sektorët, veprimtaria e të cilëve rregullohet me ligje të veçanta, si: Forcat e Sigurisë së Kosovës, policia, shërbimi i zjarrfikësve dhe shërbimet për mbrojtje dhe shpëtim⁸.

Përveç ligjit të cekur më lartë, edhe Ligji i Punës Nr.03/L-212, përmban dispozita të veçanta të cilat rregullojnë çështjen e mbrojtjes dhe sigurisë në punë (neni 42 i këtij ligji). Ndërsa me nenet 43 deri 48 të këtij ligji përcaktohen detyrimet e punëdhënësit në raport me ofrimin e sigurisë dhe shëndetit në punë, për disa kategori të veçanta të të punësuarve, siç janë: për të punësuarit në punët që janë me rrezik të shtuar, mbrojtjen e të rinjëve, femrave dhe personave me aftësi të kufizuara.

3.3.2 Informimi i punëtorëve me shkrim, për rreziqet në punë dhe për masat mbrojtëse të cilat obligohen t'i marrin

Sipas nenit 42 parag. 2 të Ligjit të Punës, punëdhënësi është i detyruar të sigurojë kushtet e nevojshme për mbrojtje në punë, me të cilat sigurohet mbrojtja e jetës dhe e shëndetit të të punësuarve në pajtim me ligjin. Gjithashtu punëdhënësi ka për obligim që ta informojë punëtorin me shkrim para angazhimit të tij, për rreziqet në punë dhe për masat mbrojtëse të cilat obligohet t'i marrë. Poashtu punëdhënësi obligohet që të jep udhëzime që tregojnë për rreziqet në punë dhe masat mbrojtëse të cilat duhet të merren në përputhje me udhëzimet e lëshuara nga Ministria përkatëse. Ndërsa parag.5 i nenit 42 i Ligjit të Punës, parasheh se punëdhënësi është i obliguar t'i zbatojë rregullat dhe procedurat e përgjithshme për mbrojtjen dhe sigurinë në punë, që janë të përcaktuara me Ligjin për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Në këtë drejtim Ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë përcakton detyrime strikte për punëdhënësin në sigurimin e kushteve dhe sigurisë në punë për të gjithë të punësuarit, si dhe ndërmarrjen e të gjitha masave të nevojshme për siguri dhe shëndet në punë, përfshirë këtu edhe ndërmarrjen e masave për parandalimin e rreziqeve profesionale, sigurimin e informatave, organizimin e trajnimeve për të punësuarit, dhënjen e udhëzimeve të duhura për përdorimin dhe mirëmbajtjen e makinerive, instrumenteve, paisjeve dhe veglave të punës etj (neni 6 i ligjit të cekur më lartë). Gjithashtu punëdhënësi obligohet që në vazhdimësi të përmirësoj kushtet e punës, të cilat kanë për qëllim që të ngrisin nivelin e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Më tutje në nenin 18 të Ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë, janë normuar detyrimet e punëdhënësit që të ndërmarrin masa adekuate që të punësuarit apo përfaqësuesit e tyre të marrin të gjitha informatat e nevojshme lidhur me çdo rrezik që mund të paraqitet në vendet e punës, masat mbrojtëse dhe parandaluese, si dhe aktivitetet e tij që i ndërmerr nga ana e tij për eliminimin e këtyre rreziqeve etj. Ndërsa parag. 3 i këtij neni përcakton detyrimin e punëdhënësit që të vë në dispozicion të të punësuarve udhëzimet e hollësishme, në zbatimin e dokumentit të vlerësimit dhe parandalimit të rrezikut për çdo vend pune, të cilin duhet ta dokumentojë nëpërmjet një procesverbali.

Me dispozitat e Ligjit të Punës dhe Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, nuk do të thotë se vetëm punëdhënësit kanë detyrime dhe përgjegjësi, për sa i përket sigurimit të masave mbrojtëse ndaj lëndimeve në punë dhe sëmundjeve profesionale. Edhe i punësuarit përveç të drejtave ligjore të cilat ia njohin ligjet e përmendura më lartë në sigurinë në punë, mbrojtje të shëndetit dhe ambientit të punës, të njëjtit janë të detyruar që t'i përmbahen rregullave për sigurinë dhe

⁸ Shih nenin 2 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

mbrojtjen e shëndetit në punë, në mënyrë që mos të rrezikojë shëndetin dhe sigurinë e vet, si dhe sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve të tjerë⁹.

Çështja e mbikqyrjes së zbatimit të dispozitave ligjore të Ligjit të Punës dhe Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë është në kompetencë të Inspektoriatit të Punës, i cili në rastet kur vërtetohet se punëdhënësit nuk i kanë zbatuar dispozitat e ligjeve të cekura më lartë, atëherë ndaj të njëjtëve do të ndërrohet masa adekuate ligjore, përfshirë këtu edhe shqiptimin e gjobave, e deri në mbylljen e aktiviteteve të tyre¹⁰.

3.4 Të drejtat e të punësuarit në rastet e aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale

Shpesh punëdhënësit janë të prirur për rritjen maksimale të fitimeve të tyre duke mos investuar për të krijuar kushte optimale të punës për punëmarrësit. Vlen të theksohet se grave dhe fëmijëve që punojnë u ofrohet një mbrojtje e veçantë nga Kushtetuta, Ligji i Punës dhe nga ligje të tjera në fushën e punësimit. Lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit, në Ligjin e Punës parashikohet se punëdhënësi është përgjegjës në rastet e aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale pasi ai duhet të përcaktojë qartë rregullat e sigurimit teknik.

Aksident në punë është dëmtimi i menjëhershëm i punëmarrësit gjatë kryerjes për në/nga/ ose gjatë një procesi që ka lidhje me punën i cili çon në humbjen e përkohshme ose të përhershme të aftësisë për punë ose edhe në vdekje.

Sëmundje profesionale quhen ato sëmundje të shkaktuara si rezultat i ekspozimit ndaj rreziqeve që rrjedhin nga veprimtaria e punës. Në sëmundjet profesionale duhet të përfshihen jo vetëm ato të treguara në listën e sëmundjeve, por edhe komplikacionet edhe pasojat e tyre¹¹.

3.4.1 Kompensimi i shpenzimeve të mjekimit dhe rehabilitimit

Në rast të aksidentit në punë apo sëmundjes profesionale në lidhje me punën, i punësuarit ka të drejtë që të kërkojë nga punëdhënësi që ti kompensojë fillimisht të gjitha shpenzimet e nevojshme dhe të domosdoshme për trajtimin dhe shërimin e tij në institucionet shëndetësore të vendit apo edhe të huaja në raste të veçanta. Kjo e drejtë i garantohet punëmarrësit me dispoziten e nenit 60 të Ligjit të Punës, ku në paragraf. 1 të këtij nenin decidivisht thuhet:

‘Punëdhënësi është i obliguar që në rast të lëndimeve dhe sëmundjeve profesionale të të punësuarit, të marra gjatë kryerjes së punës, t’ju ofrojë sigurimin për kompensimin e shpenzimeve sipas këtij ligji dhe ligjeve tjera të aplikueshme’. Ndësa në paragraf. 2 të nenit të lartëcekur thuhet se: ‘Ministria nxjerrë akt nënligjor për të përcaktuar shtrirjen e sigurimit dhe për të klasifikuar lëndimet dhe shkallën e kompensimit për lëndimet e shkaktuara në punë’.

Në zbatim të paragraf. 2 të nenit 60 të Ligjit të Punës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka nxjerr Udhëzimin Administrativ nr. 05/12, qëllimi i të cilit është është që në rast të lëndimeve dhe sëmundjeve profesionale të të punësuarit të marra në vendin e punës gjatë kryerjes së punës, t’ju ofrohet kompensimi i shpenzimeve të obligueshme të parapara sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Përmes këtij udhëzimi administrativ përcaktohet obligimi i punëdhënësit që në rastet e lëndimeve në punë dhe sëmundjeve profesionale, të punësuarve ti kompensojë të

⁹ Shih nenin 42 paragraf. 6 të Ligjit të Punës.

¹⁰ Shih Ligjin për Inspektoriatin e punës

¹¹ Kudret Çela: “E drejtë e punës I”, Tirane 2003, fq. 209.

gjitha shpenzimet e për kurimin e të lënduarve në punë dhe sëmundjeve si pasojë e punës (neni 5 parag. 4). Në bazë të parag.5 të nenit 5 këtij udhëzimi, punëdhënësi është i obliguar të sigurojë mbështetje financiare për ofrimin e ndihmës mjekësore, kirurgjikale dhe farmaceutike dhe ndihmë tjetër në rast të aksidenteve (lëndimeve të marra gjatë kryerjes së punës) të ndodhura gjatë orarit të punës. Gjithashtu punëdhënësi është i obliguar të sigurojë mbështetje financiare për proteza ortopedike, të nevojshme në rast të aksidenteve (lëndimeve të marra gjatë kryerjes së punës) të ndodhura gjatë orarit të punës.

Me këtë udhëzim administrativ janë paraparë edhe procedurat për vërtetimin e lëndimeve dhe sëmundjeve profesionale, të cilat duhen ti nënshtrohen: procedurës së përcaktimit dhe njohjes së lëndimeve në vendin e punës, përkatësisht sëmundjeve profesionale, kushteve të cilat duhen të plotësohen për njohjen e lëndimeve në vendin e punës gjatë kryerjes së punës, përkatësisht sëmundjeve profesionale, afatit për lajmërimin e lëndimeve në vendin e punës gjatë kryerjes së punës, përkatësisht sëmundjeve profesionale.

Lëndimet në vendin e punës gjatë kryerjes së punës sipas këtij Udhëzimi Administrativ klasifikohen në: lëndimet e shkaktuara nga veprimet e drejtpërdrejtë mekanike, fizike dhe kimike, lëndimet e shkaktuara nga lëvizjet e pa pritura të trupit apo ngarkesës, lëndimet e shkaktuara nga ndikimi fiziologjike. Më tutje në këtë udhëzim përcaktohet se lista e sëmundjeve profesionale do të përcaktohet me akte ligjore dhe nënligjore të veçanta. Në parag. 3 të nenit 8 të këtij udhëzimi janë listuar të gjitha rastet të cilat nuk konsiderohen si lëndime në vendin e punës.

Ndërsa në nenin 9 të këtij udhëzimi përcaktohet organi i cili ka të drejtë dhe obligim që të bëjë vlerësimin e lëndimeve në punë dhe sëmundjeve profesionale, e që është institucioni i Mjekësisë së Punës dhe atë në formë të ekspertizës. Në nenin 10 të këtij udhëzimi përcaktohen të gjitha rastet kur të punësuarit që është lënduar në punë apo për shkak të sëmundjeve profesionale, i takon e drejta që ti kompensohen shpenzimet e pushimit mjekësor. Punëdhënësi përgjigjet ndaj të punësuarit për dëmet e shkaktuara nga lëndimi në punë, sëmundjes profesionale ose sëmundjeve të lidhura me punën, sipas parimit të përgjegjësisë objektive të së drejtës së detyrimeve (neni 11 i këtij udhëzimi).

Në zbatim të Ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë, Ministria për punë dhe mirëqenie sociale ka nxjerr edhe disa akte nënligjore, siç janë: Rregulloren nr.04/14 për kërkesat minimale për sigurinë dhe shëndetin në punë, Rregulloren nr. 03/14, për vlerësimin e rrezikut për siguri në punë, Rregulloren nr.02/14 për përcaktimin e kushteve dhe kritereve për certifikimin dhe licensimin e personave dhe institucioneve të cilët kryejnë punë nga siguria dhe shëndeti në punë, mënyrën, kushtet dhe programin për dhënien e provimit profesional etj.

3.4.2 Kompensimi i dëmit në rastet e aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale

Përveç kompensimit të shpenzimeve të mjekimit si pasojë e lëndimit në punë apo sëmundjeve profesionale, të punësuarit e lënduar kanë të drejtë të kërkojnë edhe kompensimin e dëmit, në rastet kur përmbushen kushtet ligjore për një gjë të tillë, sidomos në rastet kur dëmi shkaktohet nga sendet e rrezikshme dhe veprimtaritë e rrezikshme. Mirëpo, në këto raste duhet të përmbushen edhe kushtet tjera ligjore të parapara me dispozitat e LMD-së, sidomos pjesa që ka të bëjë me dëmin i cili është shkaktuar pa fajin e punëtorit dhe për shkak se punëdhënësi nuk i marr masat e nevojshme që kanë të bëjnë me sigurinë dhe shëndetin në punë.

Në shumicën e rasteve tek lëndimet në punë nga sendet dhe veprimtaritë e rrezikshme vie në shprehje zbatimi i përgjegjësisë objektive (pa faj) sipas rregullave dhe dispozitave të LMD-së. Gjithësesi LMD-ja, por edhe Ligji i Punës parasheh rregulla të veçanta, të cilat e përcaktojnë

përgjegjësini e punëmarrësit në rast se i shkakton dëm punëdhënësit apo personit të tretë. Në këtë drejtim neni 60 parag. 1 i Ligjit të Punës normon se: *"Punëdhënësi është i obliguar që në rast të lëndimeve dhe sëmundjeve profesionale të të punësuarit, të marra gjatë kryerjes së punës, t'ju ofrojë sigurimin për kompensimin e shpenzimeve sipas këtij ligji dhe ligjeve tjera të aplikueshme"*, ndërsa parag. 2 i këtij neni e obligon Ministrinë përkatëse që të nxjerr akt nënligjor për të përcaktuar shtrirjen e sigurimit dhe për të klasifikuar lëndimet dhe shkallën e kompensimit për lëndimet e shkaktuara në punë. Nëse punëdhënësi nuk e përmbush detyrimin e vet ligjor vullnetarisht, atëherë punëmarrësi ka të drejtë që për këtë t'i drejtohet gjykatës kompetente me padi, ku edhe të kërkon që të obligohet punëdhënësi që t'ia kompensojë dëmin e pësuar nga lëndimet në punë apo sëmundja profesionale.

Këtë çështje e rregullojnë dispozitat e nenit 136 të LMD-së që ka të bëjë me bazat e përgjegjësive ku parag.1 i këtij neni thotë *'Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij'*, ndërsa parag 2 thotë *'Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga faji'*, kurse në fund parag. 3 thotë *'Për dëmin, pavarësisht nga faji mbahet përgjegjësia edhe në rastet tjera të parashikuara me ligj'*. Më tutje këtë çështje e rregullojnë edhe nenet 152, 153 të LMD-së, të cilat i referohen përgjegjësive së punëdhënësit dhe punëmarrësit në rastet kur punëmarrësi ose organi i përsosur juridik i shkaktojnë dëm personave të tretë, si dhe neneve 154 deri 158 të LMD-së, të cilat i referohen përgjegjësive për dëmin nga sendi i rrezikshëm dhe veprimtaria e rrezikshme¹². Ndërsa këtë çështje Ligji i vjetër i marrëdhënieve të detyrimeve e ka rregulluar me nenet 170 deri 177.

Në të gjitha këto raste, punëmarrësi i lënduar paraprakisht duhet të respektojë në tërësi të gjitha procedurat e parapara me legjislacionin në fuqi (Ligjin e Punës, Ligjin për Siguri dhe shëndetin në punë, Udhëzimin Administrativ nr.05/12 etj), të cilat e rregullojnë çështjen e shfrytëzimit të procedurave brenda punëdhënësit për të realizuar të drejtën e tij për kompensimin e shpenzimeve të mjekimit dhe kompensimin e dëmit të pësuar. E pastaj eventualisht brenda afatit ligjor (pasi edhe kjo lloj kërkesë e punëmarrësit i nënshtrohet rregullave të parashkrimit), ti drejtohet gjykatës kompetente me padi për të kërkuar realizimin e të drejtave të tij në rrugë gjyqësore për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial.

Gjithësesi i mbetet gjykatës që të analizojë dhe vlerësojë secilin rast veç e veç, e konform rrethanave të merr vendim të drejtë (varësisht nga mendimi i ekspertëve mjekësor dhe ekspertit për siguri në punë dhe provave materiale të ofruara nga palët ndërgjyqëse). Edhe në rastin e parashkrimit të padisë në gjykatë nga ana e punëtorit të lënduar, i njëjti ka të drejtë që të kërkojë kompensimin e të gjitha formave të dëmit (material dhe jomaterial), fitimin e fumbur etj, ndërsa gjykata në rastin konkret do të zbatojë rregullat e përgjithshme të parapara me Ligjin për Detyrimet, përfshirë këtu edhe dispozitat që kanë të bëjnë me përgjegjësini subjektive (me faj) dhe përgjegjësini objektive (pa faj).

3.5 Përgjegjësia ligjore e punëdhënësit në rastet e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, sipas legjislacionit tonë

Përgjegjësia e punëdhënësit mund të jetë: 1. administrative, 2. juridiko-civile, ose, 3. penale, në varësi të shkeljeve të caktuara disa prej të cilave përmbajnë elementë të veprës penale.

Përgjegjësia administrative- gjatë procesit të inspektimit që kryejnë në subjekt për zbatimin e legjislacionit të punës, inspektori i punës, harton aktin e ekspertimit. Në rast të

¹² Ligji Nr. 04/L-077, për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

konstatimit të shkeljeve të legjislacionit të punës, inspektori i punës vendos njërin nga këto sanksione për punëdhënësin: 1. Paralajmërim-nëse punëdhënësi nuk ka zbatuar dispozitat ligjore për kushtet e sigurisë dhe shëndetit në punë, ai paralajmërohet që të marrë masa brenda afatit të caktuar në aktin e ekspertimit, 2. Gjobë (neni 92 i Ligjit të Punës). Inspektorati i Punës e ushtron aktivitetin e tij në të gjitha subjektet fizike dhe juridike, në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, duke përjashtuar aktivitetet ku hyrja e inspektorit të punës vë në rrezik interesin e sigurisë kombëtare dhe në të gjitha vendet e punës, ku inspektimi për marrëdhëniet e punës, sigurinë dhe shëndetin në punë janë të rregulluara me ligje të veçanta¹³.

Përgjegjësia juridiko-civile- në Ligjin e Punës dhe Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në punë përcaktohen rastet e përgjegjësisë së punëdhënësit. Punëdhënësi ngarkohet me detyrimin për të përcaktuar qartë rregullat e sigurimit teknik në punë dhe kjo do të thotë se ai është përgjegjës në të gjitha rastet e aksidenteve në punë, ndërsa në rastet kur aksidenti ose sëmundja profesionale ka ardhur si pasojë e fajësisë së rëndë të punëdhënësit ligjvënësi shprehet se punëdhënësi detyrohet të paguajë dëmin e shkaktuar punëmarrësit dhe atë sipas rregullave të Ligjit për detyrimet (kryesisht sipas përgjegjësisë objektive). Në të gjitha këto raste, punëmarrësi i lënduar duhet të respektojë në tërësi të gjitha procedurat e parapara me legjislacionin në fuqi, të cilat e rregullojnë çështjen e shfrytëzimit të procedurave brenda punëdhënësit për të realizuar të drejtën e tij për kompensimin e shpenzimeve të mjekimit dhe kompensimin e dëmit të pësuar, e pastaj eventualisht ti drejtohet gjykatës kompetente me padi për të kërkuar realizimin e të drejtave të tij në rrugë gjyqësore.

Përgjegjësia penale- Në këtë drejtim neni 221 i Kodit Penal i cili flet për cenimin e të drejtave nga marrëdhëniet e punës thotë: *“Kushdo që me vetëdije nuk e zbaton ligjin apo kontratën kolektive për punësimin apo ndërprerjen e marrëdhënies së punës; pagat apo të ardhurat e tjera; kohëzgjatjen e orarit të punës; punën jashtë orarit apo punën me ndërrime; pushimin apo mungesën nga puna; ose mbrojtjen e grave, fëmijëve apo personave me aftësi të kufizuara dhe kësajosej punëtorit ia mohon apo ia kufizon të drejtat që i takojnë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit”*.

Nga kjo rezulton se në të gjitha rastet kur përmbushen elementët e veprës penale të cekur më lartë, atëherë punëdhënësi mund të ndiqet edhe penalisht për shkeljet e qëllimshme të të drejtave që rrjedhin nga marrëdhënia e punës dhe të dënohet sipas ligjit.

3.6 Legjislacioni i zbatueshëm në rastet e aksidenteve në punë apo sëmundjeve profesionale

Siç e kemi elaboruar edhe më lartë, Kosova ka miratuar një varg ligjesh të cilat e rregullojnë sferën e marrëdhënies së punës (të cilat bazën e kanë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës), ndërsa specifikisht edhe çështjen e mbrojtjes në punë dhe shëndetit në punë, të cilat në masë të madhe janë në përputhje të plotë edhe me të gjitha konventat ndërkombëtare që i referohen kësaj fushe, e që kryesisht janë të miratuara nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP). Në vijim shkurtimisht do ti shtjellojmë disa prej tyre, pasi që pjesës më të madhe të tyre ju kemi referuar në pjesët e para të këtij punimi.

3.6.1 Ligji i Punës

Ligji i Punës Nr.03/L-212, rregullon të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës në sektorin publik dhe privat (duke përjashtuar shërbyesit civil dhe misionet diplomatike), ndërsa në përmbajtjen e tij përmban edhe dispozita e veçanta të cilat i referohen mbrojtjes dhe sigurisë në

¹³ Shih Ligjin nr.2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë.

punë. Në këtë drejtim ky ligj në kreun VI të tij, normon detyrimet e punëdhënësit që të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme dhe të sigurojë kushtet e nevojshme, për ti garantuar të punësuarve mbrojtje dhe siguri në punë (neni 42). Në parag. 3 të këtij neni është përcaktuar detyrimi i punëdhënësit që të informojë punëtorin me shkrim para angazhimit të tij, për rreziqet në punë dhe masat mbrojtëse të cilat obligohet ti marrë, si dhe detyrimin që të zbatojë rregullat dhe procedurat e përgjithshme për mbrojtje dhe siguri në punë. Gjithashtu në këtë nen normohen të drejtat e të punësuarve në siguri në punë, mbrojtje të shëndetit dhe të ambientit të përshtatshëm të punës (parag.1 i nenit 42), por edhe për detyrimin e të punësuarit që ti përmbahet rregullave për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, në mënyrë që mos të rrezikojë shëndetin dhe sigurinë e vet, apo punëtorëve të tjerë (parag.6 i këtij neni). Ndërsa me nenet 43 deri 48 të këtij ligji përcaktohen detyrimet e punëdhënësit në raport me ofrimin e sigurisë dhe shëndetit në punë, për disa kategori të veçanta të të punësuarve, siç janë: për të punësuarit në punët që janë me rrezik të shtuar, mbrojtjen e të rinjëve, femrave dhe personave me aftësi të kufizuara.

Gjithashtu Ligji i Punës përmban dispozita të veçanta që i referohen çështjes së kompensimit të lëndimit në punë. Në këtë drejtim neni 60 parag. 1 i Ligjit të Punës normon se:

”Punëdhënësi është i obliguar që në rast të lëndimeve dhe sëmundjeve profesionale të të punësuarit, të marra gjatë kryerjes së punës, t’ju ofrojë sigurimin për kompensimin e shpenzimeve sipas këtij ligji dhe ligjeve tjera të aplikueshme”.

Ndërsa neni 61 i këtij ligji i jep të drejtë të punësuarit që të mungojë në punë për shkak të pasigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit, ndërsa gjatë mungesës së përkohshme në punë për arsyt e cekura më lartë, të punësuarit i takon e drejta e kompensimit të pagës të cilën do ta kishte realizuar sikur të kishte punuar, por jo më gjatë se 45 ditë kalendarike (parag.2 i këtij neni). Konsiderojmë se kjo është një garanci shtesë e cila i është dhënë punëmarrësit për të mbrojtur shëndetin e tij, si pasojë e lëshimeve të punëdhënësit. Ky ligj përmban edhe dispozita të veçanta të cilat e obligojnë të punësuarin që t’ia kompensojë dëmin punëdhënësit nëse me dashje apo nga pakujdesia e plotë i shkakton dëm këtij të fundit apo personit të tretë (nenet 63-66).

3.6.2 Ligji Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë

Ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë Nr.04/L-161, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 13.05.2013, është ligj bazë i cili rregullon çështjen e sigurisë dhe shëndetit në punë. Ky ligj e ka zëvendësuar ligjin e mëparshëm Nr.2013/19 për sigurinë në punë, mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës. Me këtë ligj përcaktohen masat për përmirësimin e shkallës së sigurisë dhe shëndetit të të punësuarve në punë, si dhe parimet e përgjithshme për parandalimin e rreziqeve profesionale, eliminimin e faktorëve të rrezikut dhe aksidenteve, informimin, konsultimin, trajnimin e të punësuarve, përfaqësuesve të tyre. Dispozitat e këtij ligji zbatohen në sektorin publik, privat, publiko-privat dhe sektorin e administratës shtetërore të nivelit qendror dhe lokal, përfshirë këtu praktikantët, nxënësit dhe studentët në punë praktike gjatë shkollimit etj. Ndërsa dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen në sektorët, veprimtaria e të cilëve rregullohet me ligje të veçanta, si: Forca e Sigurisë së Kosovës, Policia, Shërbimi i Zjarrëfikësve dhe Shërbimet për mbrojtje dhe shpëtim¹⁴.

Në nenin 4 të këtij ligji është paraparë themelimi i Këshillit Nacional për Siguri dhe Shëndetë në punë, në përbërje prej 11 antarësh dhe atë: 3 antarë të Qeverisë, 2 të punëdhënësve, 2 të punëmarrësve, 2 ekspert nga lëmia e sigurisë dhe shëndetit në punë, një ekspert i lëmisë së punës

¹⁴ Neni 2 i Ligjit për Sigurinë dhe Mbrojtjen në Punë.

dhe 1 ekspertë ad hoc (neni 4 i këtij ligji). Ky këshill propozon, rekomandon dhe harton politika për përmirësimin e nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Detyrimet e punëdhënësit në raport me krijimin e kushteve adekuate të cilat garantojnë mbrojtje, siguri dhe shëndet në punë, janë të përcaktuara në mënyrë strikte me këtë ligj. Këto detyrime janë normuar me nenet 5 deri 20 të këtij ligji, në të cilat flitet për përgjegjësinë e punëdhënësit, masat parandaluese që duhet ti ndërmerret, shërbimet që duhet ti kryej për mbrojtjen dhe parandalimin, dhënien e ndihmës së parë, fikjen e zjarreve, caktimin e një të punësuarit ekspert i cili do të merrej me kryerjen e detyrave nga siguria dhe shëndeti në punë (mbi 50 të punësuar), detyrimet për caktimin dhe zbatimin e masave për parandalimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, vlerësimin e rrezikshmërisë në vendin e punës, informimin e të punësuarve për çdo rrezik që mund të paraqitet në vendet e punës, trajnimin e të punësuarve etj.

Në anën tjetër detyrimet e të punësuarve për përkujdesjen ndaj sigurisë dhe shëndetit në punë dhe respektimin e udhëzimeve të dhëna nga punëdhënësit, janë të normuara me nenin 21 të këtij ligji, ndërsa konrollet mjekësore të punëmarrësve janë të rregulluar me nenin 22.

Ky ligj ka paraparë edhe procedurën që duhet ta ndjekë punëdhënësi në rastet e aksidenteve në punë. Kështu që në bazë të nenit 23 të këtij ligji, në rastet e aksidenteve me pasojë lëndimin apo vdekjen e të punësuarit, punëdhënësi është i detyruar që ta lajmërojë menjëherë inspektorin e punës. Më pas inspektori i punës detyrohet të hartojë procesverbal me shkrim në të cilin do të konstatojë gjendjen faktike në kohën kur ka ndodhur aksidenti dhe të ndërmarr masat adekuate në pajtim me ligjin për shkeljet e konstatuara. Në parag.7 të nenit 23 është qartësuar se në cilat raste vlerësohet se ka ndodhur aksidenti në punë ose lidhur me punën. Ndërsa parag.8 i këtij neni bazuar në pasojat, aksidentet në punë i ka klasifikuar në tri grupe dhe atë: 1. Aksidente të cilat shkaktojnë paaftësi të përkohshme për punë, 2. Aksidente të cilat shkaktojnë paaftësi të përhershme në punë dhe 3. Aksidente me pasojë vdekje në punë. Ndërsa bazuar në numrin e personave të lënduar në punë, aksidentet klasifikohen si aksidente individuale (një punëtor) dhe aksidente masive (të paktën dy punëtor).

Ky ligj përcakton se mbikqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji e bën Inspektoriati i Punës (neni 24), ndërsa janë paraparë edhe gjambat të cilat do ti shqiptohen punëdhënësve në rastet kur nuk i zbatojnë dispozitat e këtij ligji.

3.6.2 Ligjit për Inspektoriatin e Punës

Në bazë të Ligjit Nr. 2002/9 për Inspektoriatin e Punës në Kosovë, ky i fundit:

- Do të mbikqyrë zbatimin e ligjit të punës, kushtet e punës dhe mbrojtjen në punë (funksion i paraparë edhe me nenin 94 të Ligjit të Punës dhe nenin 24 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë).
- Do t'iu siguroj informacion teknik dhe këshilla punëdhënësëve dhe punëtorëve për çështjet më të efektshme të zbatimit të dispozitave ligjore.
- Do të njoftoj Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale apo ndonjë organ tjetër kompetent për ndonjë mungesë apo ndonjë shpërdorim në ligjin e aplikueshëm.
- Do t'iu siguroj informatat dhe këshillat punëdhënësve dhe punëmarrësve të cilat do të jenë në pajtim me ligjin dhe t'i paralajmërojnë autoritetet kompetente për çfarëdo defektesh apo shpërdorimesh që nuk janë përfshirë me dispozita ligjore ekzistuese.

- e) Do t'iu jep këshilla për çështje lidhur me ligjin e punës dhe mbrojtjen e punëtorëve me rastin e riorganizimit apo ristrukturimit të një ndërmarrjeje.

Inspektoratit të punës përbëhet nga Kryeinspektori i punës dhe inspektorët e punës të cilët ushtrojnë funksionet e tyre në tërë Kosovën. Kryeinspektorin e punës e emëron Qeveria me propozim të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale. Inspektorët komunal i zgjedhë Kuvendi i komunës (neni 3 i këtij ligji). Kryeinspektori i punës mbikqyrë ekzekutimin e vendimeve që kanë të bëjnë me cenimin e ligjit të punës, rregullave të mbrojtjes në punë si dhe sanksionet e ndërmarrja, duke u mbështetur në nenin 92 të Ligjit të Punës dhe nenit 25 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

Inspektorët e punës të cilët kanë dokumentin identifikues përkatës kanë autorizime sipas ligjit:

- a) Të hyjë lirisht në çdo vend pune dhe në seli të punëdhënësit në kuadër të kompetencave të inspektimit të tyre pa paralajmërim;
- b) Të bëjë ekzaminimet, inspektimet dhe hulumtimet të cilat konsiderohen të domosdoshme për t'u siguruar se dispozitat e ligjit do të zbatohen dhe pyet vetëm ose në praninë e dëshmitarëve, punëdhënësin apo stafin, rreth ndonjë çështjeje në lidhje me zbatimin e ligjit.
- c) Të bëjë kontrollimin e të gjitha librave dhe dokumenteve të cilat duhet t'i mbajë punëdhënësi siç është përcaktuar me ligjin e punës;
- d) T'i marrë ekstraktet nga regjistrat dhe dokumentet;
- e) Të kërkojë nga punëdhënësi dërgimin e shënimeve apo dokumenteve të cilat janë kërkuar;
- f) Të marrë mostrën e materialeve apo substancave të përdorura me qëllim të analizave dhe për këtë e bënë me dije punëdhënësin apo përfaqësuesin e tij (neni 5 i këtij ligji).

Kundër vendimit të inspektorit të punës mund të bëhet ankesë në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së vendimit, autoritetit të Inspektoratit të Punës. Inspektorati i punës është i obliguar që në afat prej 60 ditësh të vendos sipas ankesës të ushtruar në vendimin e inspektorit të punës. Kundër vendimit të Inspektoratit të punës mund të ngritet kontesti administrativ në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh. Ankesa e ushtruar në vendimin e Inspektorit të punës nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit¹⁵.

3.6.3 Ligji për Detyrimet

Përveç ligjeve të përmendura më lartë, të cilat rregullojnë çështjen e mbrojtjes, sigurisë dhe shëndetit në punë, edhe Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) Nr.04/L-077, përmban dispozita të cilat zbatohen në rastet kur punëmarrësit për shkak të lëndimit në punë apo sëmundjeve profesionale, i drejtohen gjykatës me padi për të kompensuar dëmin e shkaktuar si rezultat i këtyre lëndimeve.

Se cilat dispozita të LMD-së zbatohen në rastet e cekura më lartë, i kemi elaboruar në pjesën e këtij punimi që ka të bëjë me kompensimin e dëmit si pasojë e lëndimit në punë apo sëmundjeve profesionale, për çka edhe nuk do të zgjerohemi më shumë në këtë pjesë.

¹⁵ Shih nenin 6 të këtij ligji.

3.7 Ushtrime

Gjatë këtij moduli pjesëmarrësve do tu prezantohet një shembull praktik, i cili ndërlidhet me temat e shqyrtuara më lartë. Ata do të ndahen në grupe të vogla dhe nga ana e secilit grup (përfaqësuesi i grupit) do të prezantoj mendimin e tyre, në lidhje me rastin praktik.

3.8 Përmbledhje

Përgjatë punimit është vlerësuar në tërësi aspekti teorik dhe ai praktik që ka të bëjë me çështjen e mbrojtjes në punë dhe kompensimit të dëmit të shkaktuar në punë si pasojë e lëndimeve apo sëmundjeve profesionale. Gjithashtu janë shtjelluar përgjegjësitë e punëdhënësit në rastet e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, sigurimin e kushteve për mbrojtje në punë, informimin e punëmarrësve për të drejtat e tyre, të drejtat e punëmarrësve në rastet e aksidenteve apo sëmundjeve profesionale në punë, të drejtat e tyre për kompensimin e shpenzimeve të mjekimit dhe kompensimin e dëmit, për përgjegjësinë ligjore të punëdhënësve në rastet e aksidenteve apo sëmundjeve profesionale lidhur me punën, si dhe për legjislacionin e zbatueshëm në Kosovë për mbrojtjen në punë, sigurinë dhe shëndetin në punë. Po ashtu kemi folur edhe për procedurën gjyqësore e cila zhvillohet në bazë të padisë së parashtruar nga punëmarrësit në rastet kur kërkojnë kompensimin e dëmit për shkak të lëndimit në punë apo sëmundjeve profesionale, dispozitat ligjore të zbatueshme, çështjen e provave materiale që administrohen, rolin e ekspertëve mjekësor dhe atyre për siguri dhe mbrojtje në punë etj. Konsideroj se ky punim modest në lidhje me mbrojtjen në punë dhe kompensimin e dëmit të shkaktuar në punë, sadopak do të ju ndihmojë gjyqtarëve të sapo emëruar gjatë punës së tyre në praktikë, për vendosjen e lëndëve që kanë për objekt kompensimin e dëmit si rezultat i lëndimeve në punë apo sëmundjes profesionale.

X. E drejta e detyrimeve

Rafet Haxhaj
Gjyqtarë në Gjykatën e Apelit

Tabela e përmbajtjes – “E drejta e detyrimeve”

Hyrje.....	451
Objektivat e modulit	451
Metodat e të shpjeguarit.....	451
Pritjet nga pjesëmarrësit	452
Mjetet e nevojshme.....	452
Burimet dhe literatura	452
Përmbledhje	452
1. Nocioni, karakteristikat dhe klasifikimi i detyrimeve	453
1.1 Hyrje	453
1.2 Objektivat trajnuese	453
1.4.1 Burimet formale	454
1.4.2 Burimet materiale.....	454
1.5 Nocioni karakteristikat dhe klasifikimi i detyrimeve	455
1.5.1 Nocioni i detyrimeve	455
1.5.2 Karakteristikat e detyrimeve	455
1.6 Vetitë e detyrimeve.....	455
1.7 Klasifikimi i detyrimeve	456
1.8 Përmbledhje.....	456
2. Kontratat e detyrimeve	457
2.1. Hyrje	457
2.2 Objektivat trajnuese	457
2.5 Fusha e zbatimit të kontratës	458
2.6. Parimet e të drejtës kontraktore	458
2.6.1 Parimi i lirisë së kontraktimit.....	458
2.6.2 Parimi i konsensualizmit	459
2.7 Kushtet për lidhjen e kontratave.....	459
2.7.1 Aftësia punuese e palëve kontraktuese.....	459
2.7.2 Pëlqimi i vullnetit.....	460
2.7.3 Lënda e kontratës.....	460
2.7.4 Baza e kontratës	460
2.8. Kushtet e veçanta për lidhjen e kontratës	461
2.8.1 Lidhja e kontratës me dorëzimin e sendit.....	461
2.8.2 Dhënia e pëlqimit për lidhjen e kontratës.....	461
2.8.3 Forma e kontratës	461
2.9 Përmbledhje.....	461
3. Shuarja e kontratave	462
3.1 Hyrje	462
3.2 Objektivat trajnuese	462
3.3 Shuarja e kontratave me marrëveshjen e palëve	462
3.4 Shuarja e kontratës kur zhduket lënda e saj	463
3.5 Shuarja e kontratës me vdekjen e palës kontraktuese	463
3.6 Shuarja e kontratës me anulim.....	464
3.6.1 Kontratat absolutisht të pa vlefshme	464
3.6.2 Kontratat relativisht të pavlefshme	464
3.7 Zgjdhja e kontratës për shkak të mosekzekutimit	464

3.7.1 Kushtet për zgjidhjen e kontratës për shkak të mosekzekutimit.....	465
3.8 Përmbledhje.....	466
4. Mbajtja e përjetshme	467
4.1. Hyrje	467
4.2. Objektivat trajnuese	467
4.3. Kontrata për Mbajtjen e Përjetshme: Nocioni	467
4.4. Forma	468
4.5 Përgjegjësia e dhënësit të mbajtjes për borxhet e marrësit të mbajtjes	469
4.6 Anulimi i kontratës.....	469
4.7 Ndryshimi i rrethanave	470
4.8 Shkëputja e kontratës për mbajtjen e përjetshme	470
4.9 Shuarja e kontratës mbi mbajtjen e përjetshme	470
4.10 Përmbledhje.....	470
5. Kontrata mbi dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë.....	471
5.1 Hyrje	471
5.2 Objektivat e trajnimit	471
5.3 Nocioni i kontratës mbi dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë	471
5.4 Kushtet për vlefshmërinë e kontratës mbi dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë	471
5.5 Subjekti i dorëzimit dhe ndarjes së pasurisë.....	471
5.6 Pajtimi i pasardhësve	472
5.7 Ruajtja e të drejtave gjatë dorëzimit	472
5.8 E drejta e bashkëshortit të dorëzuesit	472
5.9 Borxhet e dorëzuesit	472
5.10 Garancia	472
5.11 Revokimi i dorëzimit.....	473
5.12 Të drejtat e pasardhësve, fëmijëve të adoptuar dhe pasardhësve të fëmijëve të adoptuar pas revokimit	473
5.13 Përmbledhje.....	473
6. Shkaktimi i dëmit si burim i detyrime	474
6.1 Hyrje	474
6.2 Objektivat trajnues	474
6.7.1 Dëmi.....	477
6.7.2 Aftësia deliktore	477
6.7.3 Lidhja kauzale	478
6.7.4 Veprimi i kundërligjshëm	478
6.7.5 Faji	478
6.8 Përjashtimi i përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar	479
6.9 Baza e përgjegjësisë deliktore civile	479
6.9.1 Përgjegjësia subjektive.....	479
6.9.2 Përgjegjësia objektive:	480
6.9.3 Përgjegjësia për veprimet e tjetrit	481
6.10 Përmbledhje.....	482
7. Shpërblimi i dëmit.....	483
7.1 Hyrje	483
7.2 Objektivat trajnues	483
7.3 Padia për shpërblimin e dëmit të pësuar në aksidentet në komunikacion.....	483
7.4 Aktgjykimi lidhur me paditë për shpërblimin e dëmit të pësuar në aksidentet	483
në komunikacion	483

7.5 Përmbledhje.....	484
8. Shpërblimi i dëmit të pësuar në aksidentet në punë	485
8.1 Hyrje	485
8.2 Objektivat e trajnimit	485
8.3 Padia për shpërblimin e dëmit të pësuar në aksidentet në punë	485
8.4 Aktgjykimi lidhur me paditë për shpërblimin e dëmit të pësuar në aksidentet në punë.....	485
8.5 Përmbledhje.....	485
9. Kundërshtimi i veprimeve juridike të debitorit- padia pauliana.....	486
9.1. Hyrje	486
9.2 Objektivat e trajnimit	486
9.3 Padia Pauliana	486
9.4 Aktgjykimi lidhur me padinë Pauliana	486
9.5 Përmbledhje.....	487
10. Padia tek pasurimi i pa bazë	488
10.1 Hyrje.....	488
10.2 Objektivat trajnues	488
10.3 Pasurimi i pa bazë.....	488
10.4 Padia e pasurimit të pa bazë	488
10.5 Aktgjykimi lidhur me padinë e pasurimit të pabazë.....	489
10.6 Përmbledhje.....	489

Hyrje

Ky modul është përgatitur shprehimisht për gjyqtarët e posa emëruar të cilët do të bëhen pjesë e Sistemit Gjyqësor të Kosovës. Moduli synon që gjyqtarëve të posa emëruar tu ofrojë një ndihmesë në avancimin e njohurive të tyre lidhur me aspekte teorike nga E drejta e detyrimeve e posaçërisht do të ndihmojë në zbatimin praktik të këtyre njohurive. Përveç gjyqtarëve të sapo emëruar, moduli do të jetë një ndihmesë e madhe edhe për komunitetin e gjerë ligjor, gjyqtarët, avokatët por edhe atë akademik.

Moduli është i ndarë në 10 (dhjetë) sesioni, ku secili prej tyre në vetë ngërthen nga një pjesë të rëndësishme nga E drejta e detyrimeve. Në sesionin e parë do të bëhet fjalë për nocionin, karakteristikat dhe klasifikimin e detyrimeve si dhe do të flitet edhe për raportet te të drejtës së detyrimeve dhe të drejtës sendore si dhe llojet e burimeve të detyrimeve. Sesioni i dytë i këtij moduli i është kushtuar kontratave të detyrimeve dhe në këtë pjesë do të shtjellohen njohuri lidhur me nocioni, terminologjinë dhe fushën e zbatimit të kontratave. Do të shtjellohen gjithashtu edhe parimet e të drejtës kontraktore, kushtet për lidhjen e kontratave si dhe kushtet e veçanta për lidhjen e kontratave. Në sesionin e tretë është përfshirë shuarja e kontratave ku do të shtjellohen mënyrat e shuarjes si dhe zgjidhja e kontratës për shkak të mos ekzekutimit. Sesioni i katërt dhe i pestë u është kushtuar dy kontratave shumë të rëndësishme siç janë kontrata për mbajtjen e përjetshme dhe kontrata për dhuratën. Në sesionin e gjashtë bëhet fjalë për shkaktimin e dëmit si burim i detyrimeve, do të analizohen shkaqet e shkaktimit të dëmit, kushtet e përgjegjësisë për dëmin si dhe bazat e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar. Në sesionet shtatë, tetë, nëntë dhe dhjetë do të shtjellohen njohuritë lidhur me paditë në të drejtën e detyrimeve si padia për kompensimin e dëmit, padia pauliane dhe padia për pasurimin e pa bazë. Do të shtjellohen gjithashtu edhe aktgjykimet lidhur me këto padi.

I ndërtuar në këtë mënyrë, ky modul gjyqtarëve të rinj, por edhe atyre që tashmë janë në sistemin gjyqësor t'iu ofrojë një kurs i mirëfilltë nga pjesa praktike e të drejtës së detyrimeve.

Objektivat e modulit

Pas përfundimit të këtij moduli trajnues, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Avancojnë njohuritë e tyre lidhur me problematikat nga e drejta e detyrimeve;
- Hartojnë kontratat e detyrimeve;
- Hartojnë paditë nga e drejta e detyrimeve;
- Hartojnë aktgjykimet nga e drejta e detyrimeve.

Metodat e të shpjeguarit

Gjatë këtij kursi do të përdoren metoda të shpjegimit duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike të përcjella me shembuj praktik, në mënyrë që secili nga pjesëmarrësit të ndihet aktiv gjatë gjithë kohës duke marrë pjesë në diskutime me pjesëmarrësit tjerë dhe prezantuesin, si gjatë gjithë prezantimit e po ashtu edhe me rastin e diskutimeve lidhur me ushtrimin praktik.

Pritjet nga pjesëmarrësit

Nga ju pritjet që të kontribuoni në diskutimet grupore. Angazhimi i juaj do të ndihmoj në arritjen e objektivave të trajnimit. Ju inkurajojmë që të bëni parashtrimin e pyetjeve, të ofroni mendimin dhe vlerësimin tuaj kritik lidhur me çështjet në diskutim dhe që të jepni rekomandimet tuaja gjatë tërë zhvillimit të trajnimit.

Mjetet e nevojshme

Për realizimin e modulit nevojitet një lap-top, projektori dhe pajisjet tjera për prezantim në power-piont, letër hameri së bashku me tabelën për shënime të nevojshme gjatë trajnimit, letër A-4 për hartimin e shkresave –detyrave gjatë ushtrimeve praktike, mikrofonët dhe pajisjet e tjera për zërim etj.

Burimet dhe literatura

- Alajdin Alishani, *E drejta e detyrimeve- pjesa e përgjithshme*, Prishtinë, 1985;
- Alajdin Alishani , *Përgjegjësia për mungesat materiale të sendeve*, Prishtinë, 1984;
- Nerxhivane Dauti, *E drejta e detyrimeve- pjesa e përgjithshme*, Prishtinë, 2016;
- Nerxhivane Dauti, *Kontratat*, Prishtinë, 2012;
- Ligji për maredheniet e detyrimeve;
- Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore;
- Ligji për procedurën kontestimore;
- Ligji për trashëgiminë,

Përmbledhje

Në këtë modul janë dhënë shpjegimet themelore lidhur me të drejtën teorike por në veçanti atë që do ta quaja *E drejta praktike e detyrimeve*. Moduli paraqet një harmonizim teoriko-praktik të aspekteve të së drejtës së detyrimeve dhe përfshinë qëndrimet më të avancuara teorike dhe praktike të arritura deri më tani në Kosovë por edhe më gjerë.

Moduli ka lindur si kërkesë e Akademisë së Drejtësisë dhe mendojmë se plotëson boshllëkun e kamotshëm për të pasur një modul të këtij lloji në këtë fushë të së drejtës.

1. Nocioni, karakteristikat dhe klasifikimi i detyrimeve

1.1 Hyrje

E drejta e detyrimeve parqet një degë mjaft të rëndësishme të së drejtës dhe të sistemit juridik. Sesioni i parë i modulit do të përmbajë njohuri lidhur me të drejtën e detyrimeve dhe një degë mjaft të rëndësishme të së drejtës siç është e drejtat sendore, pikëtakimet dhe dallimet në mes këtyre dy degëve të së drejtës.

Në këtë pjesë të modulit do të shtjellohen njohuri edhe lidhur më burimet e së drejtës së detyrimeve, nocionin e detyrimeve, karakteristikat e detyrimeve, vetitë e detyrimeve dhe klasifikimin e detyrimeve.

1.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Avancojnë njohuritë e tyre lidhur me të drejtën detyrimeve dhe të drejtën sendore;
- Kuptojnë nocioni detyrim në kuptim të gjerë dhe të ngushtë;
- Dallojnë karakteristikat e detyrimeve;
- Mësojnë për vetitë e detyrimeve dhe bëjnë klasifikimin e detyrimeve.

1.3 E drejta e detyrimeve dhe e drejta sendore

E drejta e detyrimeve dhe e drejta reale, sipas përmbajtjes janë të drejta të pasurisë të cilat i përkasin një individ dhe mund të vlerësohen me para. Cenimi i të drejtave reale dhe i të drejtave të detyrimeve hapin mundësi që të kërkohet shpërblimi i dëmit. Këto dy lloje të drejtash kanë lidhshmëri të ngushtë, sepse e drejta e detyrimeve me anë të institucioneve të veta bën të mundshëm kalimin e pasurisë prej një subjekti te subjekti tjetër, e në anën tjetër, marrëdhëniet e detyrimeve sigurohen që të ekzekutohen me peng, me hipotekë.

E drejta reale ka për lëndë studimi një send të caktuar, pra është një e drejtë në send- *ius in rem*, kurse të drejta e detyrimeve janë *ius ad rem* (e drejta rreth sendit).

Të drejtat reale i japin titullarit të vet autorizim që ta përdorë sendin, t'i mbledhë frytet, ta tjetërsojë atë. Të drejtat e detyrimeve e autorizojnë titullarin e vet, d.m.th. kreditorin, vetëm ndaj subjektit të caktuar – debitorit. Sa i përket efektit të tyre, të drejtat reale janë me karakter absolut, sepse kanë efekt ndaj të gjithë personave – *erga omnes*. Rregullat e së drejtës së detyrimeve kanë efekt relativ – *inter partes* (ndërmjet palëve), pra kanë efekt vetëm ndërmjet pjesëmarrësve, subjekteve në marrëdhëniet e detyrimeve. Të drejtat reale fitohen në bazën juridike (*iustus titullus*) dhe në mënyrën e fitimit (*modus aquirendi*). Bazë juridik është kontrata, kurse mënyra e fitimit është dorëzimi i sendit (*traditio*) kur sendi është i luajtshëm, kurse kur sendi është i paluajtshëm, me regjistrim në librat e tokës. Për fitimin e së drejtës relative (të detyrimeve) duhet të lidhet kontrata. Numri i të drejtave reale është i caktuar taksativisht me të drejtën objektive *numerus clausus* dhe përmbajtja e tyre është e caktuar me norma imperative (*ius cogens*). Marrëdhëniet e detyrimeve nuk janë numerikisht të caktuar.

Për mbrojtjen e të drejtave reale përdoren paditë tipike, siç janë: rei vindicatio, actio negatoria, actio publiciana. Në të drejtën e detyrimeve, për mbrojtjen e të drejtave të pjesëmarrësve

përdoren këto padi: padia për shpërblimin e dëmit, padia kundër pasurimit të pabazë, padia Pauliana, për kthimin në gjendjen e mëparshme, kundërshtimin për mos përmbushjen e kontratës (exceptio non adimpleti contractus).

Të drejtat reale krijohen dhe ekzistojnë për një kohë të gjatë ose janë të përhershme, kurse marrëdhëniet e detyrimeve lidhen me qëllim që të krijojnë efekte të caktuara, madje edhe shuhen. Pra, kohëzgjatja e tyre është relativisht e shkurtër.

1.4 Burimet e së drejtës së detyrimeve

Burimet e së drejtës së detyrimeve ndehen në dy grupe: në burime formale dhe në burime materiale.

1.4.1 Burimet formale

Burime formale të së drejtës së detyrimeve janë ato forma të ndryshme, me të cilat shprehet vullneti. Në burimet formale të kësaj dege të së drejtës hyjnë: Kushtua dhe Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve i Kosovës. *Lgji mbi marrëdhëniet e detyrimeve i Kosovës* është burimi më i rëndësishëm formal për të drejtën e detyrimeve. Me anë të këtij ligji në mënyre unike rregullohet materia e së drejtës së detyrimeve. Ligji përmban 1059 nene dhe në tërësi përfshinë materien e detyrimeve. Pjesa e parë (Pjesa e përgjithshme) e tij përfshinë parimet themelore, dispozitat mbi burimet e detyrimeve (kontratën, shkaktimin e dëmit, pasurimin e pabazë, gjerimin e punëve të huaja pa porosi, shprehjen e njëanshme të vullnetit), efektet e detyrimeve, ndërrimin e subjekteve në marrëdhëniet e detyrimeve dhe shuarjen e detyrimeve. Pjesa e dytë e ligjit rregullon kontratat e veçanta me emër.

Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve i Kosovës (më tutje LMD) përmban parimet themelore dhe rregullat e përgjithshme për të gjitha marrëdhëniet e detyrimeve (neni 1 i LMD). Parimet kryesore në të cilat mbështetet LMD janë:

1. Parimi i ndalimit të keqpërdorimit të të drejtave (neni 6),
2. Autonomia e vullnetit (neni 2),
3. Doket afariste, uzancat dhe praktika (neni 11),
4. Parimi i ndershmërisë dhe ndërgjegjshmërisë (neni 4),
5. Parimi i ndalimit të shkaktimit të dëmit (neni 9),
6. Detyra e përmbushjes së detyrimit (neni 8),
7. Kujdesi (neni 5),
8. Barazia e pjesëmarrësve në marrëdhëniet e detyrimeve (neni 3),
9. Parimi i ekuivalencës së prestimeve (neni 7),
10. Zgjidhja e konflikteve në mënyrë paqësore (neni 10).

1.4.2 Burimet materiale

Burimet materiale janë ato fakte juridike relevante, me të cilat mund të krijohen marrëdhëniet e detyrimeve, të ndryshohen dhe të shuhen ato. Faktet relevante në marrëdhëniet e detyrimeve duhet të jenë në mbështetje të ligjit (ex lege) dhe të mos jenë kundër ligjit (contra lege). Këto

fakte juridike janë të shumta dhe të lloj-llojshme të cilave e drejta objektive u ofron mbrojtje. Këto fakte janë:

1. Kontrata,
2. Shkaktimi i demit,
3. Pasurimi i pabazë,
4. Gjerimi i punëve të huaja pa porosi dhe
5. Shprehja e njëanshme e vullnetit.

1.5 Nocioni karakteristikat dhe klasifikimi i detyrimeve

1.5.1 Nocioni i detyrimeve

Fjala “*detyrim*” shpreh kuptimin e fjalës latine “*obligatio*”. Folja (ob) ligare ka kuptimin lidhje me hallkë ndërmjet kreditorit dhe debitorit. Me shprehjet obligatio dhe obligare është përcaktuar në të drejtën romake klasike (të vjetër) lidhja e debitorit me personalitetin e vet fizik.

Në kuptimin e gjerë, detyrimi paraqet marrëdhëniet juridike ndërmjet dy ose më shumë subjekteve, në mbështetje të të cilave një subjekt (kreditori) ka të drejtën të kërkojë prej subjektit tjetër (debitorit) ë ai të kryejë diçka ose të heqë dorë nga kryerja e ndonjë veprimi, të cilin ka të drejtë ta bëjë.

Në kuptimin e ngushtë, fjala detyrim do të thotë borxh – detyrë e debitorit, por shikuar nga aspekti i kreditorit, detyrimin do të thotë e drejtë për të kërkuar – kërkesë.

1.5.2 Karakteristikat e detyrimeve

Karakteristikat e detyrimeve janë:

Detyrimet janë marrëdhënie me karakter juridik,
Detyrimet janë marrëdhënie ndërmjet subjekteve të caktuar,
Detyrimet janë marrëdhënie me përmbajtje të caktuar,
Detyrimet janë marrëdhënie me karakter relativ,
Detyrimet janë marrëdhënie me karakter pasuror.

1.6 Vetitë e detyrimeve

Subjektet e marrëdhënieve të detyrimeve lirisht e përcaktojnë përmbajtjen e marrëdhënieve të tyre. Për të qenë e plotfuqishme, çdo marrëdhënie e detyrimeve duhet të ketë veti (cilësi) të caktuara. Këto veti janë: Detyrimi është i mundshëm, Detyrimi është i caktuar, Detyrimi është i lejuar.

1.7 Klasifikimi i detyrimeve

Detyrimet janë të shumta dhe të lloj-llojshme. Për t'i studiuar më lehtë dhe më mirë detyrimet klasifikohen në lloje të ndryshme duke pasur parasysh kritere të caktuara. Kështu detyrimet mund të klasifikohen:

Sipas karakterit juridik,
Sipas lëndës së ekzekutimit,
Sipas asaj se a dorëzohet sasi parash ose sendesh të caktuara,
Sipas saktësisimit të detyrimit,
Detyrimet e përbëra prej shumë subjektesh,
Detyrimet në shumë subjekte-solidare.

1.8 Përmbledhje

Në këtë sesion janë dhënë shpjegimet teorike dhe praktike lidhur me të drejtën e detyrimeve dhe të drejtën sendore. Gjithashtu janë dhënë shpjegime lidhur me burimet e së drejtës së detyrimeve (burimet formale dhe materiale), karakteristikat, vetitë dhe klasifikimin e detyrimeve. Në fund pjesëmarrësve do tu ofrohet një rast praktik mbi të cilin ata do të japin mendimin kritik dhe zgjidhjet praktike për çështjen e paraqitur për diskutim.

2. Kontratat e detyrimeve

2.1. Hyrje

Në këtë sesion trajnimi do të shtjellohen çështje me rëndësi nga kontratat e detyrimeve. Kështu do të bëhet fjalë për nocionin, terminologjinë dhe fushën e zbatimit të kontratës. Më tutje në modul është bërë fjalë edhe për parimet e të drejtës kontraktore, kushtet e përgjithshme për lidhjen e kontratave dhe kushtet e veçanta për lidhjen e kontratave.

2.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do t jenë në gjendje që të:

- Avancojnë njohuritë e tyre nga fusha e kontratave;
- Kuptojnë parimet e të drejtës kontraktore;
- Dallojnë dhe kuptojnë kushtet e veçanta dhe kushtet e përgjithshme për lidhjen e kontratave.

2.3 Nocioni i kontratës

Kontrata është burimi kryesor dhe më i rëndësishëm i marrëdhënieve të detyrimeve. Kontrata është marrëveshje e dy apo më shumë personave, që ka për qëllim të krijojë, ndryshojë ose të shuaj një marrëdhënie juridike të detyrimit. Ligji mbi detyrimet konstaton se “kontrata është e lidhur kur palët kontraktuese janë pajtuar për elementet thelbësore.

Kontrata hyn në grupin e punëve juridike të dyanshme. Me anë të saj bëhet, si qarkullimi i brendshëm, ashtu edhe ai ndërkombëtar i mallrave. Kontrata është mjet i qarkullimit juridik, me të cilën shprehet dinamika e këmbimit të mallrave.

Në disa të drejta, me anë të kontratës bartet pronësia, kurse në disa të drejta të tjera ajo është bazë për kalimin e pronësisë.

2.4 Terminologjia e kontratës

Terminologjia lidhur me përcaktimin e kontratës nuk është unike, sepse përveç termit kontratë, përdorën edhe termat si : konventë, traktat, pakt, dakordim, marrëveshje.

Termi *conventio* (konventë) përdorët si sinonim i termit kontratë. Mirëpo, shprehja “conventio” më tepër përdoret për përcaktimin e kontratave ndërkombëtare.

Me *traktat ndërkombëtar* konsiderohet çdo pajtim i vullnetit ndërmjet shteteve me qëllim të krijimit, ndryshimit ose ndërprerjes së ndonjë raporti juridik reciprok ose marrëveshja e karakterit kontraktual ndërmjet shteteve ose organizatave të shteteve.

Marrëveshja është term i cili përdorët në kuptimin e ngushtë që të shënojë edhe bisedimet që i paraprijnë lidhjes së kontratës.

Goditja dhe hollësimi në kuptimin e ngushtë, shërbejnë për të shprehur pjesët e një kontrate. *Paktet* janë marrëveshje shumë solemne që i referohen çështjeve të ndryshme politike.

Dakordimi është shprehje që përdoret për të përcaktuar se palët janë dakorduar (janë pajtuar) për ndonjë pjesë të kontratës ose pëe ndonjë dispozitë të saj që ka qenë e paqartë.

2.5 Fusha e zbatimit të kontratës

Fusha e zbatimit të kontratës është e gjerë. Kontrata zbatohet gati në të gjitha degët e së drejtës, përveç në të drejtën penale. Në *të drejtën e punës*, kontrata gjen shprehje në marrëdhëniet rreth punës, në kontratën kolektive të punës, në kontratën ndërmjet punëdhënësit dhe punëtorit. Në *të drejtën ekonomike* më së shumti zbatohet kontrata për qarkullimin e mallrave dhe për kryerjen e shërbimeve.

Në *të drejtën ndërkombëtare publike* me anë të kontratave rregullohen marrëdhëniet midis shteteve. Në *të drejtën financiare* kontrata zbatohet në rregullimin e transaksioneve të ndryshme financiare. Por kontrata më së shumti zbatohet në të drejtën e detyrimeve.

2.6. Parimet e të drejtës kontraktore

Parimet themelore të së drejtës kontraktore janë : liria e kontraktimit dhe parimi i konsensualizmit.

2.6.1 Parimi i lirisë së kontraktimit

Liria e kontraktimit është njëri ndër parimet themelore të së drejtës kontraktore. Më hollësisht parimi i lirisë së kontraktimit do të thotë:

- Që çdo subjekt i së drejtës të vendosë lirisht, të lidhë ose të mos lidhë kontratën e caktuar;
- Që çdo subjekt i së drejtës të zgjedhë lirisht personin (partnerin) më të cilin do të lidhë kontratën;
- Që subjektet e së drejtës të caktojnë lirisht përmbajtjen e kontratës, formën dhe mënyrën e lidhjes së saj;
- Që subjektet e së drejtës të vendosin lirisht mbi ndërrimin dhe mënyrat e shuarjes së kontratës;
- Në rast që kontrata lidhet ndërmjet subjekteve me shtetësi të ndryshme, subjektet e së drejtës mund të zgjedhin lirisht legjislacionin i cili do të zbatohet në kontratën e tyre, si dhe të caktojnë gjykatën në rast se kontesti zbatohet ndërmjet palëve.

Autonomia e vullnetit

Sipas përfaqësuesve të parimit të autonomisë së vullnetit, detyrimet krijohen me vullnetin e palëve. Vullneti i palëve ka fuqi detyrimi dhe ai është mbi ligji. Kur caktohet, ajo ka vlerën e ligjit për palët. Në rast se nuk ekziston vullneti për caktimin e e përmbajtjes së kontratës, kontrata anulohet. Ajo duhet të ekzekutohet duke respektuar parimin “*pacta sunt servanda – kontrata është ligj për palët*”.

Kufizimi i lirisë së kontraktimit

Liria e kontraktimit për subjektet e së drejtës nuk është e pakufizuar. Eksiston *kufizimi sa i përket lirisë së zgjedhjes së palës kontraktuese*. Prodhuesit e bimëve industriale duhet këto prodhime t'ua dorëzojnë përpunuesve të tyre ose atyre të cilët i ka caktuar ligji. Liria e kontraktimit *kufizohet në pikëpamje të përmbajtjes së kontratës*. Disa kontrata sipas ligjit kanë përmbajtjen e caktuar, kështu që palët kontraktuese nuk kanë mundësi të ndryshojnë asgjë, p.sh. kontrata mbi shfrytëzimin e banesës, kontrata mbi kredinë që lidhet ndërmjet bankës dhe kërkuesit të kredisë etj. Liria e kontraktimit është e *kufizuar pas paraqitjes së kontratave të adezionit dhe kontratave të formulara*. Kontrata e adezionit është ajo në të cilën përmbajtja është e caktuar përpara për dy palët kontraktuese, pavarësisht nga vullneti i tyre (shitja ndërkombëtare e naftës, benzinës, pambukut, mëndafshit etj.). Kontrata formularë janë ato kontrata në të cilat kushtet e përgjithshme të kontratës i cakton vetëm njëra palë, kurse pala tjetër ka mundësi t'i pranojë ose të mos i pranojë. Liria e kontraktimit është e *kufizuar me kontratat formale*, në të cilat forma përcaktohet ose sipas ligjit ose sipas kontratës (neni 51 i LMD).

2.6.2 Parimi i konsensualizmit

Parimi i konsensualizmit është parimi i dytë më i rëndësishëm i së drejtës kontraktore. Ky parim do të thotë se kontrata mund të lidhet thjeshtë në bazë të vullnetit të palëve kontraktuese "*solo consensus*", pa pasur nevojë për përmbushjen e formës së caktuar. Në bazë të këtij parimi kontrata lidhet duke u mbështetur në *bona fides* – në mirëbesimin e palëve kontraktuese.

2.7 Kushtet për lidhjen e kontratave

Kushtet për lidhjen e kontratës ndahen në dy grupe : të përgjithshme dhe të veçanta.

Në *kushtet e përgjithshme* bëjnë pjesë : aftësia punuese e palëve, pajtimi i vullnetit, lënda e kontratës, baza e kontratës. Në grupin e *kushteve të veçanta* bëjnë pjesë : forma e kontratës, lidhja e kontratës me dorëzimin e sendit dhe dhënja e pëlqimit për lidhjen e kontratës.

2.7.1 Aftësia punuese e palëve kontraktuese

Aftësia punuese e palëve kontraktuese është kusht i përgjithshëm që kërkohet për lidhjen e kontratës. Aftësia punuese e palëve do të thotë se subjekti që e lidhë kontratën me vullnetin e vet mund të krijojë të drejta dhe detyrime të caktuara. Aftësinë punuese duhet ta kenë si personi fizik, ashtu edhe personi juridik.

Personi fizik e fiton aftësinë punuese kur e arrin moshën madhore, në moshën 18 vjeçare, dhe kur individi në moshën 16 vjeçare kur ka lidhur kurorë me lejen e organit kompetent. Këta persona kanë *aftësi të plotë punuese*. Ndërsa *aftësi të kufizuar punuese*, kanë personat e moshës 14 vjeçare dhe personat madhorë, të cilëve u është marrë pjesërisht aftësia punuese me vendim të organit kompetent. I mituri, që ka mbushur 15 vjet dhe është i punësuar, mund t'i disponojë të ardhurat që i realizon nga kjo marrëdhënie.

Ekziston edhe kategoria e veçantë e personave të cilët fare nuk mund të lidhin kontratë, sepse nuk kanë aftësi punuese (*paaftësia punuese*). Persona të paaftë për të lidhur kontratë janë personat që nuk i kanë mbushur 14 vjet, si dhe ata të cilët për arsye të mungesave mendore janë të zhveshur tërësisht nga aftësia për të vepruar. Këta persona kanë *paaftësi absolute* për të lidhur

kontratë. Nëse lidhet kontrata nga personi që nuk ka aftësi për të vepruar, kontrata e tillë nuk krijon efekte juridike.

Kontratat e detyrimeve mund t'i lidhin edhe *personat juridik*. Në emër dhe në llogari të tyre kontratat i lidhin organet e autorizuar të tyre (zakonisht drejtori i ndërmarrjes ekonomike). Kushtet që duhet të plotësohen për lidhjen e kontratës nga ana e personave juridik janë : a) që personat fizik që lidhin kontratën për personin juridik të kenë *aftësinë e plotë punuese*, b) që këta persona të kenë *autorizim* për lidhjen e kontratës dhe c) që lidhja e kontratave të këtilla t'i përgjigjet *veprimtarisë* së atillë të personit juridik me të cilin ai merret vazhdimish

2.7.2 Pëlqimi i vullnetit

Pëlqimi i vullnetit është kusht i dytë i përgjithshëm për lidhjen e kontratës. Pëlqimi i vullnetit duhet të jetë i dyanshëm, sepse që të lidhet kontrata, vullneti i dy palëve kontraktuese duhet të jetë i përputhur.

Vullneti i palëve mund të shprehet me fjalë, me shenja të rëndomta, shprehimisht, me të cilat dëshmohet se ekziston pëlqimi i vullnetit. Vullneti është deklaruar *shprehimisht* kur bëhet me fjalë, gojarisht ose me shkrim. Shprehja e vullnetit me *shenja të rëndomta* bëhet me anë të veprimeve (me luajtjen e kokës si shenjë se pranon diçka, duke vënë shenjën e gishtit me ngjyrë, ose kur sendin e caktuar e vendos në shportë, me ç'rast supozohet se dëshiron ta blejë).

Pëlqimi i vullneti duhet të ketë veti të caktuara. Këto veti janë: vullneti duhet të jetë serioz, të bëhet lirisht, të jetë i vërtetë dhe të jetë i mundshëm. Nëse pëlqimi i vullnetit të palëve nuk i ka atributet, cilësitë, të cekura më lartë, kontrata bëhet e pavlefshme.

2.7.3 Lënda e kontratës

Lënda e kontratës është kusht i përgjithshëm për lidhjen e kontratës. Lënda e kontratës është ajo për të cilën palët janë marrë vesh, ose “për çka është lidhur kontrata”. Lëndë e kontratës mund të jetë ndonjë send, ndonjë veprim ose mosveprim. Detyrimi që rrjedhë nga kontrata është lëndë e saj, p.sh në kontratën mbi dhuratën, lëndë e saj është dorëzimi i sendit të premtuar dhuratëmarrësit, në kontratën mbi shitjen, lëndë është dorëzimi i sendit dhe çmimi.

Lëndë e kontratës mund të jetë sendi i luajtshëm, i paluajtshëm dhe sendi i konsumueshëm. Si lëndë e kontratës paraqitet një e drejtë reale ose e detyrimeve. Nga të drejtat reale, si lëndë e kontratës mund të jetë : e drejta e pronësisë, hipoteka, e drejta e servitutit sendor, e drejta e pengut, kurse nga të drejtat e detyrimeve lëndë e kontratës mund të jetë çdo e drejtë që mund të bartet, të cedohet, por si lëndë e kontratës mund të jetë çdo e drejtë që mund të jetë e servitutit personal, e drejta e autorit, e drejta e mbajtjes (ushqimisë).

2.7.4 Baza e kontratës

Baza e kontratës është kusht i përgjithshëm për lidhjen e kontratës. Bazë e kontratës është qëllimi juridik që e ka shtyrë ndonjë subjekt të marrë detyrimin dhe që e ka caktuar karakterin juridik të punës juridike. Bazë e kontratës është shkaku, arsyeja për të cilën debitori merr detyrimin.

Baza e kontratës duhet të ekzistoj në çdo kontratë në çastin e lidhjes së saj. Në lidhjen e kontratës baza paraqet qëllimin e detyrimit, kurse lënda detyrën që e kemi borxh. Nuk ka kontratë të vlefshme pa bazë juridike.

2.8. Kushtet e veçanta për lidhjen e kontratës

2.8.1 Lidhja e kontratës me dorëzimin e sendit

Për disa kontrata, që të konsiderohen se janë të lidhura, përveç kushteve të përgjithshme duhet të bëhet edhe dorëzimi i sendit. Kontratat e këtilla, që lidhen duke u dorëzuar sendin, quhen *kontrata reale*. Në këtë grup të kontratave hyjnë : kontrata mbi huanë, dhuratën,depozitën, pengun, kaparin. Në këto kontrata dorëzimi i sendit përfaqëson kushtin e veçantë për lidhjen e tyre.

2.8.2 Dhënia e pëlqimit për lidhjen e kontratës

Për disa kontrata është e domosdoshme që të merret pëlqimi për lidhjen e tyre. Pa marrë pëlqimin e nevojshëm kontrata nuk do të krijojë efekte juridike. Kështu, “kur për lidhjen e kontratës është i nevojshëm pëlqimi i personit të tretë, ky pëlqim mund të jetë dhënë para lidhjes së kontratës si leje ose pas lidhjes së kontratës si pëlqim.

Ky pëlqim kërkohet në dy raste : për mbrojtjen e interesit individual dhe për mbrojtjen e interesit të përgjithshëm.

2.8.3 Forma e kontratës

Forma e kontratës është manifestim i jashtëm i përmbajtjes së kontratës. Për disa kontrata, përveç kushteve të përgjithshme, nevojitet që kontrata të lidhet në formë të caktuar. Forma për këto kontrata është kusht i veçantë për lidhjen e saj, e ajo parashihet shprehimisht me ligj. Zakonisht kërkohet forma me shkrim për lidhjen e këtyre kontratave : kontrata mbi shitjen e sendeve të paluajtshme, kontrata mbi shfrytëzimin e banesës, kontrata mbi qiranë e lokaleve afariste, kontrata mbi ndërtimin, kontrata mbi ndërtimin e objektit investiv, kontrata mbi licencën, kontrata mbi sigurimin, kontrata për garanci bankare, te kontrata mbi autorizimin, kontrata për llogarinë rrjedhëse bankare.

Sipas efektit të saj forma mund të ketë rëndësi të dyfishtë : ajo do të paraqesë kushtin qenësor për lidhjen e kontratës dhe do të kërkohet për sigurimin e provave.

Forma e kontratës mund të jetë : *solemne, reale, provuese, me shkrim, ligjore dhe kontraktore*.

2.9 Përmbledhje

Kontratat e detyrimeve paraqesin një ndër burimet më të rëndësishme për krijimin e detyrimeve. Për lidhjen e tyre nevojitet që tu nënshtrohen parimeve të caktuara të të drejtës kontraktore. Gjithashtu këto kontrata duhet që tu nënshtrohen kushteve të përcaktuara për lidhjen e tyre siç janë kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta për lidhjen e kontratave.

Pjesëmarrësve do tu ofrohet për diskutim një rast praktik, mbi të cilin ata do të japin vlerësimin e tyre kritik dhe për rastin në fjalë do të gjejnë zgjidhjet ligjore.

3. Shuarja e kontratave

3.1 Hyrje

Kontratat e detyrimeve lidhen që të krijojnë efekte juridike, e pastaj shuhen. Shuarja e kontratës bëhet nën kushtet e caktuara me ligj. Kjo pjesë e trajnimit do të përmbajë mënyrën e shuarjes së kontratës si shuarjen e kontratës me marrëveshjen e palëve, shuarjen kur zhduket lënda e kontratës, shuarja me vdekjen e palës kontraktuese, shuarjen e kontratës me anulim, zgjidhjen e kontratës për shkak të mos ekzekutimit etj.

3.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të :

- Njohin shuarjen e kontratave;
- Zgjerojnë njohurit lidhur me anulimin e kontratës dhe zgjidhjen e kontratës;
- Zbatojnë në praktikë çështjet që kanë të bëjnë me anulimin dhe zgjidhjen e kontratave

3.3 Shuarja e kontratave me marrëveshjen e palëve

Kontrata e lidhur nga palët kontraktuese krijojnë efekte juridike, e pastaj shuhen. Shuarje e kontratës konsiderohet shuarja e kontratës së plotfuqishme me vullnetin e palëve kontraktuese për shkaqe të parapara me ligj. Shkaqet e mënyrës së shuarjes së kontratës janë të ndryshme. Kontrata shuhet: 1) me marrëveshjen e palëve, 2) kur zhduket lënda e saj, 3) kur vdes pala kontraktuese, 4) me anulimin e kontratës, 5) dhe mosekzekutimi i kontratës.

Kontrata krijohet me vullnetin e palëve kontraktuese (*mutus dissere sus apo contrarius consensus*) dhe me vullnetin e tyre edhe mund të zgjidhet (*mutum dissensus*). Shuarja me marrëveshje e palëve ose zgjidhja vullnetare e kontratës, si rregull, është një rast i shuarjes së kontratës në të gjitha kontratat, pa marrë parasysh se a janë pjesëmarrësit persona fizikë ose persona juridikë. Shuarja e kontratës me marrëveshje e palëve kontraktuese gjen shprehje në rastet kur ato nuk dëshirojnë që kontrata të krijojë efekte juridike të cilat i kane pasur në çastin e krijimit të saj. Palët pajtohen me vullnetin e tyre që kontrata të zgjidhet.

Efektet juridike të shuarjes së kontratës: Shuarja e kontratës me marrëveshje e palëve kontraktuese krijon efekte juridike, të cilat shprehen në faktin se kontrata e krijuar më nuk krijon efekte juridike. Kontrata mund të ketë efekte retroaktive prej fillimit dhe në të ardhmen prej *çastit të zgjidhjes*. Në qofte se njëra palë nuk e ka përmbushur fare detyrimin e vet të arritur, atëherë atë pjese deri në çastin e shuarjes së kontratës duhet t'ia dorëzojë palës tjetër. Në qoftë se kontrata është përmbushur pjesërisht, këtu shuarja ka efekt në të ardhmen (*ex munc*). Por në disa raste kontrata nuk mund të ketë efekt tjetër përveç efektit në të ardhmen. Këtë rast e kemi në kontratat me pretime të përhershme kur nuk është e mundshme që zgjidhja të ketë efekt retroaktiv (*ex tunc*), kur ajo ka zgjatur një kohë të caktuar, p.sh të ketë efekt kontrata e qirasë që ka zgjatur një vit sepse do të shkaktonte pasurim të pabaze në anën e qiramarrësit për shfrytëzimin e sendit për një vit.

Kur kemi të bëjmë me kontrata formale, “kontrata formale mund të zgjidhet me marrëveshje joformale përveç në rast se për rastin konkret me ligj është parapare diçka tjetër, ose

në qoftë se qëllimi për të cilin është paraparë forma për lidhjen e kontratës kërkon zgjidhjen e kontratës që ajo të bëhet në formë të njëjtë” (neni 53 i LMD).

3.4 Shuarja e kontratës kur zhduket lënda e saj

Shuarja e kontratës kur zhduket lënda e saj është një rast i shuarjes së kontratës që mund të shkaktohet nën ndikimin e fuqisë madhore ose të rastit, që shkaktohet pas lidhjes së kontratës meqenëse zhdukja e lëndës së kontratës shkakton pamundësinë e përmbushjes dhe shuarjen e kontratës. Rrezikun për zhdukjen e sendit e ka debitori – *periculum est debitoris*. Kur në një kontratë të dyanshme detyruese ekzekutimi i detyrës së njërës pale kontraktuese behet i pamundshëm për shkak të shkatërrimit të sendit nga fuqia madhore, atëherë as pala tjetër kontraktuese nuk do të jetë e detyruar që ta ekzekutojë detyrën e vet dhe kontrata nuk do të ekzistojë më.

Kushtet e shuarjes së kontratës në këtë rast: që një kontratë e dyanshme detyruese të shuhet për shkak të zhdukjes së lëndës së saj, duhet të plotësohen këto kushte: a) që kontrata të jetë e dyanshme me shpërblim, sepse në kontratat e njëanshme nuk zbatohen këto rregulla, b) që lënda kontratës së dyanshme detyruese të jetë send individualisht i caktuar – *res in specie*. Për sende të caktuara sipas llojit mund të shuhet kontrata nëse sendi i caktuar sipas llojit është zhdukur te debitori. Në këtë rast debitori do të jetë i detyruar ta dorëzojë sendin tjetër të llojit të njëjtë. Kurse kur kemi të bëjmë me send individualisht të caktuar – *res in specie* dhe ai humb, për debitorin shuhet detyra, e me të edhe kontrata, c) kushti i trete për zgjidhjen e kontratës është *që sendi të jetë zhdukur nën ndikimin e fuqisë madhore – vis maior*, d.m.th. nga ngjarja e cila ka ndodhur pavarësisht prej vullnetit të debitorit që nuk ka qenë e mundshme të parashikohet, e as të evitohet. Në qoftë se shkatërrimi i lëndës është bërë me fajin e debitorit, kontrata nuk shuhet. Ajo nuk shuhet nëse debitori me fajin e vet vonohet për dorëzimin e lëndës së kontratës, ndërsa ndërkohë sendi zhduket për shkak të fuqisë madhore. Kur “përmbushja e detyrimit të njërës pale kontraktuese në kontratën e dyanshme është bërë e pamundshme për shkak të ngjarjes për të cilën nuk janë përgjegjës asnjëra palë, pala që diçka ka përmbushur nga detyrimi i vet mund të kërkojë kthimin në mbështetje të rregullave të pasurimit të pabaze” (neni 335).

Shuarja e kontratës për shkak të zhdukjes së lëndës ka efekt retroaktiv, pra krijon efekte prej fillimit të lidhjes së kontratës. Palët kontraktuese janë të detyruara të kthehen në gjendjen e mëparshme. Zhdukja e lëndës së kontratës shkakton pamundësinë e përmbushjes së saj dhe shuarjen e marrëdhënies së detyrimit në tërësi. Me shuarjen e kontratës kryesore shuhet edhe ajo aksesore (dorëzania, pengu etj.).

3.5 Shuarja e kontratës me vdekjen e palës kontraktuese

Është rregull e përgjithshme që kur vdes pala kontraktuese, kontrata nuk shuhet por kalon mbi trashëgimtarët e tij universalë. Në të drejtën kontraktore bëhet përjashtim në dy raste: a) kontrata do të shuhet kur vdes pala kontraktuese në qoftë se është lidhur duke pasur parasysht cilësitë e veçanta personale të palës kontraktuese, pra kur është lidhur kontrata *intuitu personae* (neni 340 i LMD) dhe b) në qoftë se palët kontraktuese janë marrë vesh që vdekja e njërës palë do të shkaktojë shuarjen e saj.

Kontratat tipike që shuhen kur vdes pala kontraktuese janë: kontrata mbi veprën, autorizimin dhe kontrata mbi ortakërinë.

Kur kontrata shuhet për arsye të vdekjes së palës kontraktuese, kontrata ka efekt në të ardhmen *ex nunc*. Atë që palët kontraktues ia kanë ekzekutuar njëra – tjetrës deri në çastin e vdekjes, do të jetë e vlefshme dhe nuk mund të kërkojë kthimi. Mirëpo, në rastin se gjatë jetës së njërës palë kontraktuese (p.sh., kryesit të punës) është kryer një punë, kurse pala nuk ka marrë për këtë

shpërblim, trashëgimtarët e tij do të kenë të drejtë të kërkojnë pagimin e saj në shumën që do t'u takonte paraardhësve të tyre.

3.6 Shuarja e kontratës me anulim

Kontrata e detyrimeve shuhet edhe me anulim. Anulimi i kontratës shkakton pamundësinë që kontrata të krijojë efekte juridike. Arsyet e anulimit të kontratës janë kur cenohet interesi i përgjithshëm shoqëror, ose kur cenohet ndonjë interes individual. Varësisht nga arsyet se çka cenohet, ekzistojnë dy lloje të pavlefshmërisë: pavlefshmëria absolute e kontratave dhe pavlefshmëria relative.

3.6.1 Kontratat absolutisht të pavlefshme

Kontrata absolutisht të pavlefshme janë ato të cilat janë në kundërshtim me dispozitat ligjore, imperative, me normat e moralit dhe me normat e dokeve të mira. Kontrata është absolutisht e pavlefshme nëse e ka lëndën të ndaluar, kur është caktuar afati më i gjatë ose me i shkurtër i parashkrimit, kur lidhet kontrata me fajde dhe kur ndërmarrja ekonomike krijon dhe shfrytëzon pozitën monopoliste në treg.

Anulimin e këtyre kontratave mund ta bëjnë subjektet e interesuar, ose organi përkatës sipas detyrës zyrtare. Anulimin e kontratës, në radhë të parë, mund ta kërkojë pala kontraktuese e ndërgjegjshme, si dhe trashëgimtarët univerzalë dhe singularë të tij. Këto kontrata anulohen edhe sipas detyrës zyrtare (*ex officio*). Gjykata kujdes sipas detyrës zyrtare, dhe për këto kontrata ka rol aktiv (nenin 109 i LMD).

3.6.2 Kontratat relativisht të pavlefshme

Kontrata relativisht të pavlefshme janë ato me anën e të cilave cenohen interesat individual të palës kontraktuese. Kontrata është relativisht e pavlefshme kur lidhet nga personi i mitur me aftësi të kufizuar punuese; pa lejen e prindit ose të kujdestarit, kur kontrata lidhur me kërcënimin, me lajthim, me mashtrim; kur lidhet kontratë fiktive.

Vendimi gjyqësor për këto kontrata ka karakter konsitutiv. Anulimin e këtyre kontratave mund ta kërkojnë pala e dëmtuar, trashëgimtarët e saj si dhe personi i tretë që ka interes që kjo kontratë të shpallet e pavlefshme.

3.7 Zgjidhja e kontratës për shkak të mosekzekutimit

Zgjidhja e kontratës për shkak të mosekzekutimit është mënyrë e shuarjes së kontratës së plotfuqishme për shkak të mosekzekutimit me faj të njërës pale kontraktuese.

Kjo mënyrë e shuarjes së kontratës nuk ka qenë e njohur në të drejtat e vjetra, sepse në të është proklamuar se kontrata është lig për palët. Megjithatë, në të drejtën romake nuk i janë përmbajtur këtij qëndrimi, prandaj është lejuara që në kontratën mbi shitjen ka mundur të hyjë edhe klauzola mbi shkëputjen (*lex commissoria*), sipas së cilës shitësi ka pasur të drejtë ta zgjidhe kontratën nëse blerësi nuk do ta paguajë çmimin e shitjes. Ligji për Detyrimet i Kosovës i ka paraparë dispozitat juridike për këtë rast të shuarjes prej neneve 106-115.

3.7.1 Kushtet për zgjidhjen e kontratës për shkak të mosekzekutimit

Kushtet për zgjidhjen e kontratës për shkak të mosekzekutim janë: që të ekzistojë kontrata me shpërblim, që kontrata të mos jetë ekzekutuar pjesërisht, as tërësisht, që debitori të jetë fajtor për mosekzekutimin e kontratës, dhe që kreditorit të caktojë afatin plotësues.

Që kontrata e dyanshme dhe me shpërblim të jetë detyruese është kushte themelor për këtë mënyrë të shuarjes së kontratave. Në kontratat e dyanshme, kur njëra palë nuk e përmbush detyrimin e vet, pala tjetër ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës (neni 106 i LMD).

Duhet të ketë mosekzekutim nga njëra palë kontraktuese. Mosekzekutimi ekziston kur detyrimi nuk përmbushet tërësisht nga ana e debitorit. Mosekzekutimi mund të jetë i plotë dhe i pjesërisht. Mosekzekutimi është i plotë kur debitori nuk ndërmer asgjë që të përmbushë detyrimin e vet kontraktor. Rasti i tillë ekziston kur shitësi nuk e ka përmbushur detyrimin në tërësi. Në këtë rast të mosekzekutimi, kontrata zgjidhet, sepse këtu kemi cenimin më të rëndë të saj. Mosekzekutimi i pjesshëm është kur pala kontraktuese pjesërisht e ka përmbushur detyrimin e vet, p.sh blerësi pjesërisht e ka paguar çmimin ose shitësi pjesërisht e ka dërguar mallin, ose kur zgjidhet kontrata mbi mbajtjen e përjetshme, në rast se dhënës i ushqimit i ka dhënë vetëm paratë, por ka munguar kujdesi ndaj marrësit të ushqimit.

Kushti i tretë i zgjidhjes së kontratës për mosekzekutimin është faji i palës kontraktuese. Faji ekziston kur pala kontraktuese në heshtje ose shprehimisht e refuzon përmbushjen e kontratës, ose kur pala tjetër, pa ndonjë shkak e pengon palën tjetër që ta përmbushë detyrimin e vet.

Kushti i katërt në këtë rast të zgjedhjes është caktimi i afatit plotësues. Me afatin plotësues, palës kontraktuese i ofrohet mundësia e fundit që kontrata të ngelë në fuqi duke bërë përmbushjen e saj. Caktimi i afatit plotësues është paraparë në nenin 108 par.2 të LMD. Afati plotësues është afat i kuptueshëm që jepet për kontratat që nuk kanë afat të prerë të përmbushjes. Ekzistojnë disa raste kur afati plotësues nuk caktohet. Këto raste janë:

- *Kur është kontrate fikse – në të cilën palët janë marrë vesh që kontratën do ta zgjidhin në rast se debitori nuk do ta përmbushë kontratën në afat saktësisht të caktuar;*
- *Kur debitori deklaron se nuk do ta përmbushë kontratën as në afatin plotësues. Afati i kuptueshëm nuk do të caktohet kur është e qartë se debitori nuk do të mund ta përmbushë kontratën (neni 109 i LMD). Pala e pafajshme në këtë rast të shuarjes së kontratës ka të drejta të caktuara. Kur njëra palë nuk i përmbush detyrimet e veta, pala tjetër ka të drejtë, sipas opsionit, të kërkojë përmbushjen e kontratës, ose zgjidhjen e saj, dhe në çdo rast ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e demit (neni 106 i LMD).*

Kontrata për mosekzekutim zgjidhet nga gjykata, prandaj vendimi i saj është me karakter konstitutiv.

Me zgjidhjen e kontratës për shkak të mosekzekutim kontrata shuhet dhe konsiderohet se fare nuk ka qenë e lidhur. Zgjidhja e kontratës ka efekt retroaktiv (ex tunc) (neni 114 par.2 të LMD), gjë që do të thotë se çdo palë kontraktuese ka për t'ia kthyer tjetrës atë që ka marrë prej saj. Në disa kontrata, zgjidhja e kontratës për mosekzekutim ka efekt në të ardhmen (ex nunc). Këtu është fjala për kontratat me prestime të përhershme, sepse në këto kontrata nuk ekziston mundësia që të kthehet në gjendjen e mëparshme për shkak të

vetë karakterit të marrëdhënieve. Efekti në të ardhmen (ex nunc) me rastin e zgjidhjes së kontratës për mosekzekutim është: në kontratën e qirasë, në kontratën mbi sigurimin, në kontratën mbi ortakërinë.

Zgjidhja e kontratës për mosekzekutim nuk ka efekt ndaj personit të trete (neni 81 par.1 i LMD). Revokimi i autorizimit dhe kufizimi i tij nuk ka efekt ndaj personit të trete, i cili ka lidhur kontratë të autorizimit dhe nuk ka ditur, e as që ka pasur mundësi të dijë se autorizimi është refuzuar ose është kufizuar.

3.8 Përmbledhje

Krijimi i kontratave bëhet që të krijohet efekt juridik ndërsa shuarja e tyre ndalon vazhdimin e mëtejshëm të këtij efekti. Ndër çështjet shumë me rëndësi paraqitet anulimi i kontratës i cili efekt paraqitet pasi që ai të cenon qoftë interesin shoqëror, qoftë interesin individual. Edhe zgjidhja e kontratës për shkak të mos ekzekutimit duhet që t'i plotësoj kushtet e caktuara. Pjesëmarrësve do tu parashtrohet një rast praktik mbi të cilin ata do të diskutojnë dhe japin vlerësimin kritik dhe zgjidhjet ligjore, mbi çështjen e parashtruar.

4. Mbajtja e përjetshme

4.1. Hyrje

Mbajtja e përjetshme paraqet kujdesin e plotë për marrësin e mbajtjes prej çastit kur lidhet kontrata e deri ne çastin e vdekjes së marrësit të mbajtjes. Me lidhjen e kontratës mbi mbajtjen e përjetshme krijohen efekte juridike të caktuara që shprehen në të drejtat dhe detyrat e palëve kontraktuese – marrësit të mbajtjes dhe dhënësit të mbajtjes.

Kjo pjesë e trajnimit përmban në vete një varg çështjesh të përgjithshme lishur me kontratën për mbajtje të përjetshme, formën e kontratës, anulimin, ndryshimin e rrethanave, shkëputjen e kontratës për mbajtjen e përjetshme si dhe shuarjen e kësaj kontrate.

4.2. Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Njohin efektet juridike dhe rëndësinë e kontratës mbi mbajtjen e përjetshme;
- Aplikojnë në praktikë dhe njohuritë e fituara lidhur me kontratën mbi mbajtjen e përjetshme.

4.3. Kontrata për Mbajtjen e Përjetshme: Nocioni

Me lidhjen e kontratës mbi mbajtjen e përjetshme krijohen efekte juridike të caktuara që shprehen në të drejtat dhe detyrat e palëve kontraktuese – marrësit të mbajtjes dhe dhënësit të mbajtjes. Dhënës i mbajtjes mund të jetë çdo person fizik që ka aftësi të plotë për të vepruar. Si dhënës i mbajtjes mund të paraqitet edhe personi juridik i cili si veprimtari të përhershme e ushtron dhënien e mbajtjes së përhershme, psh. shtëpia e pleqve apo ndonjë institucion tjetër i themeluar me destinim të dhënies së mbajtjes së përjetshme. Marrës i mbajtjes së përjetshme mund të jetë vetëm personi fizik i cili ka nevojë për mbajtje, e këta zakonisht janë të moshuar dhe nuk janë në gjendje të kujdesen për vete. Personi juridik nuk mund të paraqitet si marrës i mbajtjes.

Për këtë kontratë është e domosdoshme të arrihet pëlqimi i vullnetit të dhënësit dhe marrësit të mbajtjes lidhur me elementet thelbësore të kësaj kontrate. Si elemente thelbësore të kësaj kontrate paraqiten:

- mbajtja e përjetshme dhe
- caktimi i pasurisë që do t'i bartet dhënësit të mbajtjes nga ana e marrësit të mbajtjes.

Mbajtja e përjetshme paraqet kujdesin e plotë për marrësin e mbajtjes prej çastit kur lidhet kontrata e deri ne çastin e vdekjes së marrësit të mbajtjes. Kujdesi i plotë përfshin : kujdesin rreth ushqimit, veshmbathjen, shërimit, kujdesin rreth varrimit pas vdekjes sipas dokeve dhe zakoneve të vendit të marrësit të mbajtjes.

Caktimi i pasurisë që do t'i baret dhënësit të mbajtjes nga ana e marrësit të mbajtjes është elementi i dytë thelbësori kësaj kontrate. Palët kontraktuese janë të detyruara që në mënyrë të domosdoshme të caktojnë dhe të saktësojnë se cilat të drejta ose pasuri i lihen dhënësit të mbajtjes pas vdekjes së marrësit të mbajtjes. Marrësi i mbajtjes ka mundësi t'ia lërë në trashëgim dhënësit të mbajtjes një pjesë të pasurisë së tij ose pasurinë në tërësi. Në këtë rast mund të jepen

sendet e luajtshme, individualisht të caktuara, dhe sendet sipas llojit, por janë të veçuara nga sendet e llojit të njëjtë dhe të caktuara në mënyrë të saktë.

Si lëndë e detyrës së marrësit të mbajtjes mund të jenë ndonjë send ose ndonjë e drejtë pasurore e cila mund të bartet. Sendet si lëndë e kësaj kontrate mund të jenë Si lëndë e detyrës së marrësit të mbajtjes mund të jenë ndonjë send ose ndonjë e drejtë pasurore e cila mund të bartet. Sendet si lëndë e kësaj kontrate mund të jenë Si lëndë e detyrës së marrësit të mbajtjes mund të jenë ndonjë send ose ndonjë e drejtë pasurore e cila mund të bartet. Sendet si lëndë e kësaj kontrate mund të jenë çdo send në qarkullim. Lëndë e detyrës së marrësit të mbajtjes mund të jetë pasuria e përgjithshme e marrësit të mbajtjes ose ndonjë pjesë e saj. Më së shpeshti si lëndë e kësaj kontrate paraqiten paluajtshmeritë, paratë dhe letrat me vlerë.

Me lidhjen e kontratës mbi mbajtjen e përjetshme krijohen efekte juridike të caktuara si për marrësin e mbajtjes, ashtu edhe për dhënësin e mbajtjes.

Të drejtat themelore të marrësit të mbajtjes janë:

- të kërkoj dorëzimin e sendeve të caktuara si lëndë e kontratës mbi mbajtjen e përjetshme,
- të kërkoj që të bëhet kujdesi dhe mbajtja ashtu siç janë marrë vesh me rastin e lidhjes së kontratës.

Detyrat e marrësit të mbajtjes janë:

- të bartë sendin në pronësi të dhënësit të mbajtjes, përkatësisht të bartë të drejtën e caktuar në mënyrën dhe kohën e përcaktuar me kontratën e lidhur.
- detyra e pranimit të çdo dhënieje që i ofrohet nga dhënësi i mbajtjes në bazë të kontratës të lidhur mbi mbajtjen e përjetshme.

Të drejtat themelore të dhënësit të mbajtjes janë:

- të kërkoj bartjen e sendeve të caktuara nga marrësi i mbajtjes,
- të kërkoj nga marrësi i mbajtjes që ai të ndër marrë veprime që dhënësi i mbajtjes të përmbushë detyrën e tij.

Si detyra themelore të dhënësit të mbajtjes konsiderohen:

- dhënësi i mbajtjes ka për detyrë të mbaje marrësin e mbajtjes derisa të jetë ai gjalle,
- t'ia japë banesën për banim marrësit të mbajtjes,
- t'ia siguroj ushqimin marrësit të mbajtjes,
- të kujdeset përkitazi me shërimin e sëmundjeve eventuale të marrësit të mbajtjes,
- t'i mbuloj shpenzimet e nevojshme përkitazi me nevojat shoqërore dhe kulturore të marrësit të mbajtjes (p.sh. dhënia e të hollave për duhan, kinema etj.)
- detyra e varrimit të marrësit të mbajtjes.

4.4. Forma

Kontrata mbi mbajtjen e përjetshme është kontratë e cila lidhet ndërmjet dhënësit të mbajtjes dhe marrësit të mbajtjes, me të cilën dhënësi i mbajtjes merr detyrimin ta mbajë në kujdes të përjetshëm palën tjetër ose personin e tretë, kurse marrësi i mbajtjes detyrohet që për këtë të mbajë ndonjë send ose ndonjë të drejtë pasurore të palës tjetër.

Kjo kontratë, në thelb është kontratë e detyrimeve me disa elemente të trashëgimit. Si e tillë krijon të drejta dhe detyrime vetëm ndërmjet këtyre dy kontraktuesve. Kjo kontratë nuk është kontratë mbi trashëgiminë, por kontratë mbi tjetërsimin me shpërblim të të gjitha sendeve të paluajtshme që i përkasin marrësit të mbajtjes në çastin kur lidhet kontrata. Marrësi i mbajtjes deri kur vdes e mban të drejtën e pronësisë në lëndën e kësaj kontrate, për çka edhe konsiderohet si kontratë mbi mbajtjen e përvetshme **sui generis**.

Kontrata mbi mbajtjen e përvetshme zakonisht lidhet kur ndonjë individ nuk ka mundësi për shkak të moshës, sëmundjes ose paaftësisë për punë, ta punojë ose ta shfrytëzojë pasurinë e vet të cilën e ka në pronësi, kurse për vete dëshiron të sigurojë mbajtjen. Më se shpeshi kjo kontratë në praktikë lidhet nga individët e shtyrë në moshë, të sëmurë dhe të cilët nuk kanë fëmijë ose anëtarët tjerë të familjes të cilët do të kujdeseshin dhe do t'i mbanin. Kjo kontratë, pra, lidhet me qëllim të sigurimit të mbajtjes së përvetshme për marrësin e mbajtjes.

Kontrata mbi mbajtjen e përvetshme karakterizohet me disa veçori të caktuara juridike, siç janë:

- Kontrata mbi mbajtjen e përvetshme është kontratë detyruese e dyanshme, e cila krijon detyra reciproke për dhënësin dhe marrësin e mbajtjes. Me këtë kontratë dhënësi i mbajtjes është i detyruar i pari ta përmbushë detyrën që buron nga kontrata e lidhur (ta mbajë, ta ruajë, të kujdeset, t'ia punojë tokën e marrësit të mbajtjes), kurse shpërblimin për këto e fiton pas vdekjes së marrësit të mbajtjes.
- Kontrata mbi mbajtjen e përvetshme është kontratë më shpërblim, me të cilën për atë që i jep dhënësi i mbajtjes merr kundërshtëpërblim të caktuar nga marrësi i mbajtjes në formë të mbajtjes së përvetshme të mbajtësit të marrësit.
- Kontrata mbi mbajtjen e përvetshme është kontratë rreptësisht formale. Forma me shkrim e kësaj kontrate është një nga elementet për plotfuqishmërinë e saj. Pas përpilimit me shkrim të kontratës mbi mbajtjen e përvetshme nga palët kontraktuese dhe nënshkrimit të tyre, kontrata duhet që të vërtetohet tek noteri.

4.5 Përgjegjësia e dhënësit të mbajtjes për borxhet e marrësit të mbajtjes

Dhënësi i mbajtjes si palë kontraktuese në kontratën për mbajtjen e përvetshme, nuk ka për detyrë dhe nuk përgjigjet për borxhet e marrësit të mbajtjes, por në kontratë mund të përcaktohet që dhënësi i mbajtjes do të jetë përgjegjës për borxhet ekzistuese të marrësit të mbajtjes ndaj kreditorëve të caktuar.

4.6 Anulimi i kontratës

Palët kontraktuese kanë mundësi që kontratën për mbajtjen e përvetshme ta shkëpusin me marrëveshje, madje edhe pasi të kenë filluar me përmbushjen e saj.

Nëse sipas kontratës për mbajtjen e përvetshme, palët kontraktuese jetojnë së bashku dhe marëdhënia e tyre përkeqësohet deri në atë masë sa që jeta e përbashkët bëhet e pa durueshme, secila palë mund të kërkojë që gjykata ta anulojë kontratën. Secila palë mund të kërkojë shkëputjen e kontratës nëse pala tjetër nuk përmbushë detyrimet e saj.

4.7 Ndryshimi i rrethanave

Nëse pas lidhjes së kontratës, rrethanat ndryshojnë deri në atë masë sa përmbushja e kontratës bëhet shumë më e vështirë, atëherë gjykata, me kërkesën e ndonjëres nga palët, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, mund të ndryshojë marrëdhëniet e tyre në kontratë ose ta anulojë atë.

Gjykata mund të ndryshojë të drejtat e marrësit të mbajtjes në rentë jetësore, nëse kjo gjë është në interes të dyja palëve.

4.8 Shkëputja e kontratës për mbajtjen e përvetshme

Nëse dhënësi i mbajtjes vdes, detyrimet nga kjo marrëdhënie transferohen tek bashkëshortja e tij apo bashkëshorti dhe tek pasardhësit, fëmijët e adoptuar dhe pasardhësit e fëmijëve, nëse ata e japin pëlqimin për një gjë të tillë. Nëse të njëjtit nuk e japin pëlqimin për vazhdimin e kontratës për mbajtjen e përvetshme, kontrata zgjidhet dhe ata nuk kanë të drejtë të kërkojnë kompensimin për mbajtjen e mëparshme. Nëse të tillët nuk kanë mundësi të përmbushin detyrimet kontraktore ata kanë të drejtë të kërkojnë shpërblim nga marrësi i mbajtjes. Gjykata përcakton shpërblimin e tillë në bazë të diskrecionit të saj, duke marrë para sysh gjendjen financiare të palës së mbajtur dhe atyre që janë të thirrur që ta vazhdojnë kontratën për mbajtjen e përvetshme.

4.9 Shuarja e kontratës mbi mbajtjen e përvetshme

Me vdekjen e marrësit të mbajtjes qëllimi dhe misioni i kontratës së lidhur nuk mund të realizohet më tutje, ashtu që kontrata pushon së krijuari efekte juridike të mëtutjeshme. Të drejtat nga kjo kontratë nuk kalojnë tek trashëgimtarët.

Siç u tha më lartë, vdekja e dhënësit të mbajtjes nuk shkakton automatikisht shuarjen e kësaj kontrate, siç ishte rasti me vdekjen e marrësit të mbajtjes.

4.10 Përmbledhje

Në kushtet e zhvillimeve bashkëkohore, roli i kontratës për mbajtje të përvetshme sa vjen e shtohet dhe po merr rëndësinë të përdorurit në mes palëve kontraktuese.

Pjesëmarrësve do tu parashtrahet edhe një rast praktik për diskutim mbi të cilin ata do të japin vlerësimin kritik dhe do të gjejnë zgjidhjet ligjore.

5. Kontrata mbi dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë

5.1 Hyrje

Ndarja dhe dorëzimi i pasurisë tek pasardhësit është një proces që kërkon vëmendje të shtuar, pasi që efektet që krijon ky proces lidhen me atë që ata do të përfitojnë si pasuri të tyre nga pasuria e paraardhësit. Ky sesion do të përfshijë nocionin e kontratës mbi dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë, kushtet për vlefshmërinë e kontratës, subjektet e kësaj kontrate, të drejtat e bashkëshoriti, të drejtat e pasardhësve etj.

5.2 Objektivat e trajnimit

Pas përfundimit të trajnimit pjesmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zgjerojnë njohuri lidhur me rëndësinë e kontratës mbi ndarjen dhe dorëzimin e pasurisë;
- Aplikojnë në praktikë njohuritë e fituara lidhur me këtë proces juridik.

5.3 Nocioni i kontratës mbi dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë

Me kontratën e dorëzimit, dorëzuesi merr përsipër të dorëzojë dhe ndajë pronën tek pasardhësit e tij/saj, tek fëmijët e adoptuar dhe pasardhësve të fëmijëve të adoptuar .

5.4 Kushtet për vlefshmërinë e kontratës mbi dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë

Kontrata është e vlefshme vetëm nëse për të jepet pëlqimi nga pasardhësit, fëmijët e adoptuar dhe pasardhësit e tyre, të cilët sipas ligjit do të thirreshin në trashëgimi mbi bazën e kontratës. Kontrata duhet të lidhet në formë të aktit noterial. Secili nga pasardhësit që nuk e jep pëlqimin, mund ta bëjë atë më vonë në të njëjtën formë. Dorëzimi dhe ndarja mbetet e vlefshme edhe nëse një pasardhës i cili nuk e ka dhënë pëlqimin vdes para dorëzimit duke mos lënë ndonjë pasardhës, nëse heq dorë nga trashëgimia, nëse është përjashtuar nga trashëgimia, apo nëse nuk është i denjë të trashëgojë.

5.5 Subjekti i dorëzimit dhe ndarjes së pasurisë

Vetëm pasuria ekzistuese e dorëzuesit, pjesërisht ose në tërësi, mund të përfshihet në dorëzim dhe ndarje. Nëse vdes paraardhësi i cili ka dorëzuar dhe ndarë pasurinë e tij gjatë kohës sa ka qenë gjallë, pasuria e përgjithshme e tij përbëhet vetëm nga pasuria e cila nuk është përfshirë në dorëzim dhe ndarje si dhe nga prona e fituar më pas.

Pasuria e fituar nga pasardhësit e tij me anë të dorëzimit dhe ndarjes nuk klasifikohet si pjesë e pasurisë së përgjithshme të tij dhe nuk llogaritet gjatëpërcaktimit të vlerës së kësaj pasurie të përgjithshme.

5.6 Pajtimi i pasardhësve

Nëse ndonjëri nga pasardhësit nuk ak dhënë pëlqimin në dorëzimin dhe ndarjen, ato pjesë të pasurisë të dorëzuara tek pasardhësit tjerë do të konsiderohen dhurata dhe pas vdekjes së së paraardhësit trajtohen si shurata që u janë bërë trashëgimtarëve nga paraardhësi.

E njëjta gjë vlenë edhe nëse pas dorëzimit dhe ndarjes, për të cilën është dhënë pëlqimi nga të gjithë pasardhësit, është lindur një fëmijë të dorëzuesi ose një pasardhës i cili është gjetur pas shpalljes si të vdekur.

5.7 Ruajtja e të drejtave gjatë dorëzimit

Gjatë dorëzimit dhe ndarjes së pasurisë dorëzuesi mund të ruaj për veten e tij , bashkëshortin apo për çdo person tjetër të drejtën e uzufuktit mbi të gjithë pasurinë apo një pjesë të pasurisë së dorëzuar ose të kërkojë rente jetësore me para në dorë apo ën vepër, mbajtje të përjetshme ose ndonjë kompensim tjetër.

Nëse është arritur marrëveshja mbi uzufuktin ose rentën jetësore për dorëzuesin dhe bashkëshortin së bashku, atëherë në rast të vdekjes së nejrës prej tyre uzufukti apo renta jetësore i takon tjetrit në tërësinë e plotë të saj deri në vdekjen e këtij tjetrit, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me marrëveshje ose përveç nëse rrjedhe ndryshe nga rrethanat e rastit.

5.8 E drejta e bashkëshortit të dorëzuesit

Gjatë dorëzimit dhe ndarjes, dorëzuesi gjithashtu mund të marrë parasysh edhe bashkëshorten apo bashkëshortin. Për ta bërë këtë është e nevojshme dhënia e pëlqimit të bashkëshortes apo bashkëshortit.

Nëse bashkëshortja apo bashkëshorti nuk janë marrë parasysh, të drejtat e saj apo tij për pjesën e detyrueshme mbeten të pacenuara. Në rastin e tillë, dorëzimi dhe ndarja mbeten të vlefshme, por në respektin e vlerës së pasurisë së përgjithshme në bazë të së cilës është përcaktuar pjesa e detyrueshme e bashkëshortes apo bashkëshortit të pas jetuar, ato pjesë të pasurisë së trashëgimtarëve të dorëzuara tek pasardhësit e tij apo saj do të konsiderohen si dhurata.

5.9 Borxhet e dorëzuesit

Pasardhësi të cilit dorëzuesi i ka dorëzuar pasurinë e tij apo saj, nuk është përgjegjës për borxhet e dorëzuesit, përveç nëse përcaktohet ndryshe me marrëveshjen e dorëzimit dhe ndarjes. Kërkuesit e dorëzuesit mund ta ndalojnë dorëzimin dhe ndarjen sipas kushteve që zbatohen tek ndalimi i disponimit me mirëbesim.

5.10 Garancia

Detyrimi për garancinë që rrjedhë pas ndarjes ndërmjet bashkë trashëgimtarëve duhet të rrjedhë gjithashtu ndërmjet pasardhësve pas dorëzimit dhe ndarjes së pasurisë të dorëzuar dhe ndarë nga paraardhësi apo prindi adaptues.

5.11 Revokimi i dorëzimit

Dorëzuesi mund të revokojë kontratën për arsye të mosmirënjohjes së thellë nëse pas lidhjes së sajë një pasardhës sillet ndaj dorëzuesit apo ndaj personit të afërt me të në atë mënyre që sipas parimeve themelore të moralit do të ishte e padrejtë që të mbante atë që është marrë.

Dorëzuesi ka të drejtën e njëjtë nëse pasardhësi nuk arrin ti ofrojë ati apo asaj apo personit tjetër, mbajtjen për te cilën janë pajtuar me kontratën e dorëzimit dhe ndarjes ose nuk arrin të paguaj borxhet e dorëzuesit kur kontrata e ka ngarkuar pasardhësin me pagimin e borxheve të tilla.

Në rastet tjera të mos përmbushjes, së detyrimeve të marra përsipër me anë të kontratës së dorëzimit dhe ndarjes, gjykata vendosë nëse dorëzuesi ka të drejtë të kërkojë kthimin e pasurisë së dhënë apo vetëm të drejtën që të kërkojë përmbushjen e detyrimeve, duke marrë parasysh lartësinë e borxheve të dorëzuesit si dhe rrethanat tjera të rastit.

5.12 Të drejtat e pasardhësve, fëmijëve të adoptuar dhe pasardhësve të fëmijëve të adoptuar pas revokimit

Pasardhësi i cili është dashur të kthej tek dorëzuesi atë që është marrë gjatë dorëzimit dhe ndarjes mund të kërkojë pjesën e tij apo të saj të detyrueshme pas vdekjes së dorëzuesit, përveç nëse është përjashtuar nga trashëgimia apo nuk është i denjë të trashëgojë nga dorëzuesi, ose përveç nëse ka hequr dorë nga trashëgimia. Gjatë llogaritës së pjesës së detyrueshme, ato pjese të pasurisë të dorëzuara dhe shpërndara nga trashëgimlënësi gjatë jetës tek pasardhësit tjerë, konsiderohen si dhurata.

5.13 Përmbledhje

Kontrata mbi ndarjen dhe dorëzimin e pasurisë paraqet një ndër kontratat shumë me rëndësi në të drejtën detyrimeve. Kjo kontratë krijon efekt juridik ndërmjet paraardhësit në njërin anë dhe bashkëshortit pasjetues dhe pasardhësve në anën tjetër.

Pjesëmarrësve do të jepet një shembull praktik mbi të cilin ata do të japin mendimin e tyre kritik, do të hartojnë një kontratë të tillë dhe do të gjejnë zgjidhjet ligjore lidhur me problemin e parashtruar.

6. Shkaktimi i dëmit si burim i detyrime

6.1 Hyrje

Përveç kontratave, si burim i rëndësishëm i krijimit të detyrimeve paraqitet edhe shkaktimi i dëmit. Kur dëmi i shkaktohet të dëmtuarit, krijohet përgjegjësia – detyra e dëmtuesit për shpërblimin e dëmit. Ky sesion trajnimi do të shtjellojë çështje me rëndësi nga aspekti i shkaktimit të dëmit e që janë: përgjegjësia deliktore civile, shkaqet e shkaktimit të dëmit, kushtet e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, përgjegjësinë subjektive, objektive, përgjegjësia për veprimet e tjetrit etj.

6.2 Objektivat trajnues

Pas përfundimit të trajnimit pjesmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Aplikojnë në praktikë njohuritë e fituara lidhur me dëmin dhe llojet e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar.

6.3 Përgjegjësia deliktore civile

Përveç kontratave, si burim i rëndësishëm i krijimit të detyrimeve paraqitet edhe shkaktimi i dëmit. Në shkaktimin e dëmit marrëdhënia e detyrimeve krijohet nga vetë fakti se dëmi i është shkaktuar të dëmtuarit. Kur dëmi i shkaktohet të dëmtuarit, krijohet përgjegjësia – detyra e dëmtuesit për shpërblimin e dëmit.

Në *kuptimin e gjerë*, përgjegjësia për dëmin do të thotë detyrim i shpërblimit të dëmit që i është shkaktuar tjetrit. Përgjegjësia për dëmshpërblim quhet dhe përgjegjësia deliktore – civile.

Në *kuptimin e ngushtë*, përgjegjësia deliktore – civile është kur i shkaktohet dëm tjetrit me veprimin kundërligjor dhe me fajin e dëmtuesit. Përgjegjësia për dëmin paraqitet si pasojë e dëmit të shkaktuar. Përgjegjës mund të jetë subjekti si shkaktues i dëmit, ose ndonjë subjekt tjetër, që është në marrëdhënie të veçantë me shkaktuesin e dëmit, në rend të parë, poseduesi i sendit të rrezikshëm ose organizuesi i aktivitetit të rrezikshëm. Përgjegjësia e këtyre subjekteve është përgjegjësi juridike, sepse përgjegjësia e tyre është rregulluar me norma juridike të së drejtës objektive. Në përgjegjësinë juridike civile ekziston rregulla juridike e përgjithshme, që çdo subjekt duhet të përmbahet nga veprimet që mund t'i shkaktojnë dëm tjetrit.

Janë të njohura dy lloje të përgjegjësisë juridike civile: *përgjegjësia deliktore civile*, në të cilën dëmi është pasojë e veprimit deliktor dhe *përgjegjësia juridike kontraktore*, në të cilën dëmi shkaktohet nga cenimi i kontratës.

Në detyrimet e krijuara nga shkaktimi i dëmit ekzistojnë dy subjekte: ai që ia ka shkaktuar dëmin tjetrit quhet *dëmtues* dhe është *debitor*, në këtë marrëdhënie të detyrimit, dhe subjekti të cilit i është shkaktuar dëmi quhet *dëmtuar* dhe është *kreditor* në këtë marrëdhënie (në përgjegjësinë për të tjerë, subjekti përgjegjës përgjigjet për veprimet e dëmshme të tjetërkujt).

6.4 Shkaqet e shkaktimit të dëmit

Shkaqet e shkaktimit të dëmit janë të shumta dhe të lloj-llojshme. Si shkaqe të shkaktimit të dëmit mund të paraqiten: sjelljet e njerëzve, sendet, veprimet dhe ngjarjet.

- *Shkaktimi i dëmit me sjelljen (veprimin e njerëzve)* – Me sjelljen e njerëzve të caktuar mund të shkaktohet dëmi. Këta njerëz mund të jenë persona fizik dhe juridikë. Këta subjektë mund të shkaktojnë dëm duke vepruar ose duke mos vepruar. Me *veprim aktiv* dëmi shkaktohet kur subjekti ndërmer veprime të caktuara (*commisio*) p.sh. kur dëmtuesi thënë xhamin e veturës. Me *veprim pasiv (ommissio)* dëmi shkaktohet kur subjekti i caktuar nuk ndërmer veprim të caktuar.
- *Shkaktimi i dëmit nga sendet*, përfshinë të gjitha rastet e dëmit të shkaktuar nga sendet e caktuara, të cilat paraqesin rrezik të shtuar për rrethin e caktuar shoqëror. Kështu, ekziston rasti i shkaktimit të dëmit: nga helmet, eksplozimi i gazrave, rryma elektrike etj.
- *Shkaktimi i dëmit raga veprimtaritë e rrezikshme*, përfshinë të gjitha rastet e shkaktimit të dëmit që kualifikohen si veprimtari e rrezikshme p.sh. dëmi i shkaktuar në xeherore, në ndërtimtari, në trafik.
- *Shkaktimi i dëmit nga ngjarjet*, prej të cilave rëndom paraqiten ngjarjet natyrore, siç janë: rrufeja, stuhia, vërshimet e lumenjve, orteqet borës, tërmetet etj.
- *Shkaktimi i dëmit nga veprimet e njerëzve*, ndodhë i pasojë e demonstratave, grevave dhe çrregullimeve të tjera në shoqëri.

6.5 Përgjegjësia deliktore dhe përgjegjësia kontraktore

Përgjegjësia deliktore civile paraqitet si rrjedhojë e detyrës së përgjithshme ligjore (*neminem laedere*) që askujt të mos i shkaktohet dëmi. Në përgjegjësinë kontraktore, debitori e ka cenuar detyrën e vet që buron nga kontrata e lidhur, sepse ai fare nuk e ekzekuton detyrën e vet, ose vonohet ose nuk e ekzekuton ashtu siç është detyruar, prandaj, për debitorin krijohen detyra e dëmshpërblime të kreditorit. E përbashkët për këto përgjegjësi është se, si njëra ashtu edhe tjetra, bartin detyrën e dëmshpërblimit. Por në këto përgjegjësi ekzistojnë edhe dallime të dukshme që pasqyrohen:

- Përgjegjësinë deliktore e krijon fakti i shkaktimit të deliktit, kurse përgjegjësia kontraktore ekziston me vetë faktin e cenimit të kontratës për shkak të mosekzekutimit fare, ose të ekzekutimit të parregullt të saj;
- Në përgjegjësinë kontraktore, cenuesi i kontratës përgjigjet sipas fajit të supozuar, kurse në përgjegjësinë deliktore dëmtuesi përgjigjet sipas fajit, përveç në rastet kur dëmi shkaktohet nga sendet e rrezikshme ose nga veprimtaria e rrezikshme;
- Rregullat e përgjegjësisë kontraktore janë dispozitive (*ius dspozitivum*), për arsye se palët kontraktuese këto rregulla me anë të kontratës mund t'i përjashtojnë, t'i kufizojnë ose t'i zgjerojnë. Rregullat e përgjegjësia deliktore janë imperative (*ius imperativum*) dhe nuk mund të përjashtohen, por duhet të zbatohen ashtu siç janë parapare me ligj;
- Në përgjegjësinë kontraktore, debitori, në rast të cenimit të detyrimit të vet, duhet ta përmbushë kontratën dhe të shpërblejë dëmin, kurse në përgjegjësinë deliktore detyrimi kryesor është shpërblimi i dëmit;

- Në përgjegjësinë deliktore mund të përgjigjet shkaktuesi i dëmit, ndihmësi, shtytësi, pronari, poseduesi dhe organizuesi i veprimtarisë së rrezikshme. Në përgjegjësinë kontraktore përgjigjet vetëm pala kontraktuese dhe trashëgimtarët e saj, në qoftë se kontrata nuk është intuitu personae.
- Afati i parashkrimit të përgjegjësi deliktore është tri vjet dhe fillon të rrjedhë prej çastit kur i dëmtuari ka marrë vesh për dëmin e shkaktuar të dëmtuesit, e ky afat nuk mund të jetë më i gjatë se pesë vjet. Afatet e parashkrimit të kontratave ndryshojnë prej një kontrate në tjetrën.

6.6 Përgjegjësia deliktore dhe penale

Me një veprim të njejte të paluajtshtëm mund të shkaktohet delikti civil dhe vepra penale (p.sh. vjedhja e veturës). Por ka raste kur ekziston vepra penale e nuk ekziston delikti civil (p.sh. tentimi i vjedhjes). Delikt civil është cdo veprim i kundërligjshëm më ane të të cilit është shkaktuar dëmi që krijon detyrën që dëmi i shkaktuar të shpërblehet. Vepra penale është vepër e rrezikshme shoqërore, e cila është paraparë sipas ligjit si vepër penale dhe për të cilën është paraparë sanksioni penal.

Ndërmjet këtyre përgjegjësive ekzistojnë dallime të konsiderueshme:

- Vepra është vepër e rrezikshme shoqërore, kurse rrezikshmëria e përgjegjësive deliktore civile është më e vogël se ajo e përgjegjësive penale, prandaj edhe dënimet për këtë përgjegjësi janë më të vogla sesa për vepra penale.
- Në përgjegjësinë penale vlen parimi “nullum crimen sine lege, nulla poena sine lege – vepra penale duhet të parashihet me ligjin penale dhe për të duhet të parashihet dënimi i caktuar”. Në përgjegjësinë deliktore civile nuk është i numëruar në mënyre taksative, por kryesore në këtë përgjegjësi është që dëmi të jetë shkaktuar nga veprimi i palejuar i kundërligjshëm.
- Sanksioni i përgjegjësive penale është personal, kurse sanksioni i përgjegjësive deliktore është sanksion pasurore, sepse cenohet pasuria e shkaktuesit të deliktit.
- Në përgjegjësinë penale, përgjegjësia mund të ekzistojë edhe për tentim, kurse në përgjegjësinë deliktore nuk mund të krijohet kjo përgjegjësi.
- Lartësia e dënimit më para me përgjegjësinë penale parashihet sipas ligjit, kurse në përgjegjësinë deliktore gjykata e cakton shpërblimin me para duke pasur parasysh rrethanat e caktuara.
- Gjykata civile është e lidhur me vendimin e gjykatës penale.
- Rregullat e parashkrimit në përgjegjësinë penale janë me afat me të gjate se rregullat e përgjegjësive deliktore civile. Por ekzistojnë rregulla siç është rasti i gjenocidit dhe krimeve të luftës të cilat nuk parashkruhen.

6.7 Kushtet e përgjegjësive për dëmin e shkaktuar

Që të ekzistojë përgjegjësia deliktore civile për dëmin e shkaktuar duhet të plotësohen këto kushte: 1) që të shkaktohet dëmi, 2) që dëmi të jetë shkaktuar me veprimin e kundërligjshëm, 3) që të ekzistojë faji i dëmtuesit, 4) që të ekzistojë aftësia deliktore, 5) që të ekzistojë lidhja kauzale ndërmjet veprimit të kundërligjshëm dhe dëmit. Të gjitha këto kushte vlejnë për

përgjegjësini subjektive. Në përgjegjësini objektive (përgjegjësia për sendet dhe veprimtaritë e rrezikshme) faji nuk merret parasysh, kurse në përgjegjësini për të tjerët, ka raste kur faji supozohet dhe ka karakter absolut, ose kur faji nuk merret fare parasysh.

6.7.1 Dëmi

Dëmi paraqet një ndër kushtet e përgjithshme dhe të rëndësishme të përgjegjësive deliktore civile. Në *kuptimin e ngushtë*, ai ka të bëjë me çdo cenim të pasurisë, me çdo humbje të pasurisë, kurse *ne kuptimin e gjerë* dëmi paraqet cenimin e pasurisë së ndonjë subjekti, cenimin e te drejtave ose personalitetin e tij. Sipas LMD dëmi është “zvogëlim i pasurisë së dikujt (dëm i vërtetë) dhe pengim i rritjes së pasurisë (fitimi i humbur), si dhe kur tjetrit i shkaktohet dhembje fizike, psikike ose frikë (dëmi jomaterial).

Dëmi mund të shkaktojë pasoja si ën pasuri ashtu edhe në personalitetin e të dëmtuarit.

Në *kuptimin ekonomik*, dëmi është humbje e pasurisë, pa marrë parasysh mënyrën e humbjes, pash. Dëmi i shkaktohet nga vërshimet, zjarri, tërmeti. Në *kuptimin ekonomik* konsiderohet se dëmi është humbje e të mirave të cilat janë juridikisht të mbrojtura.

Dëmi material është cenimi i vlerave të ndonjë subjekti. Aty së pari hyjnë dëmi i shkaktohet sendeve të ndonjë subjekti, kur merret, dëmtohet, ose asgjësohet sendi. Dëmi material ekziston edhe ën rastin e cenimit të integritetit fizik të ndonjë njeriu, lëndimi trupor, dëmtimi i shëndetit që ka shkaktohet shpenzime për shërim, humbjen e të ardhurave personale të të dëmtuarit, ose edhe kur shkaktohet vdekja e një njeriu e ajo ndodhë me fajin e dikujt. Llojet e dëmit material janë: a) dëmi i vërtetë (damnum emergens), b) fitimi i munguar (lucrum cessans), c) dëmi abstarkt, d) dëmi konkret, e) dëmi i drejtpërdrejtë dhe f) dëmi i tërthortë.

Dëmi i vërtetë është zvogëlimi i pasurisë së dikujt, psh. dëmtuesi then xhamin e veturës. Fitimi i munguar është kur i dëmtuari pengohet që të rritë pasurinë. Ky është ai fitim që subjekti i dëmtuar do ta realizonte në të ardhmen, sikur të mos ishte shkaktohet ngjarja. Pash. Vozitësit taksist i është djegur vetura. Djegia e veturës paraqet dëmin e vërtetë, ndërsa fitimi që do ta realizonte taksisti duke kryer shërbimin e vet, paraqet fitimin e munguar, ose shembull tjetër stomatologut i dëmtohet mjeti i punës etj.

Dëmi moral (jomaterial) ekziston kur të dëmtuari ti shkaktohet dhembje fizike, vuajtje psikike dhe frikë. Dëmi moral cenon të mirat personale të të dëmtuarit siç janë: dinjiteti, autoriteti, prishja e qetësisë personale dhe familjare, cenimi i lirisë, shkaktimi i dhembjes fizike, psikike, frikës, cenimi i nderit, i lirisë personale, lirisë së mendimit etj. Ky dëm shkaktohet pavarësisht dëmit material, po më së shpeshti paraqitet bashkë me dëmin material, p.sh. Lëndimi trupor, dhembja fizike, shëmtimi.

6.7.2 Aftësia deliktore

Aftësia deliktore është kusht i përgjithshëm i përgjegjësive deliktore civile. Aftësia deliktore ose e përgjegjës aftësi e një subjekti që t'i kuptojë veprimet e veta. Per personat fizikë aftësia e përgjegjësive për dëmin e shkaktohet varet prej moshës dh zhvillimit mendor të tij. Ekziston kategorizimi i personave sipas moshës: gjer në moshën 7 vjeçare janë fëmijët; prej moshës 7 vjeçare deri në 14 vjeçare është kategoria e të miturve të rinjë, prej moshës 14 vjeçare deri 18 vjeçare janë të miturit e vjetër, kurse prej moshës 18 vjeçare janë madhore.

Sipas Ligjit të Detyrimeve, “i mituri deri në moshën 7 vjeçare nuk përgjigjet për demin e shkaktuar, deri në moshën 14 vjeçare nuk përgjigjet për demin përveç në qoftë se vërtetohet se gjatë shkakimit të dëmit ka qenë i aftë për gjykim, dhe i mituri mbi moshën 14 vjeçare përgjigjet sipas rregullave të përgjithshme të përgjegjësisë për demin e shkaktuar”.

Paaftësinë deliktore e kanë subjektet që kanë mungesa mentale. Personi i cili “për shkak të sëmundjes psikike ose ngecjes në zhvillimin mendor nuk është i aftë për gjykim, nuk përgjigjet për demin të cilin ia shkakton tjetrit”. Edhe personat juridik kanë aftësi deliktore dhe përgjigjen për demin që ua shkaktojnë subjekteve të vet, sepse ata në qarkullimin juridik veprojnë në emër dhe në llogari të personave juridik. Personi juridik përgjigjet për organet e veta në qoftë se ata, në veprimet e palejueshme, u shkaktojnë dëm personave të tretë.

6.7.3 Lidhja kauzale

Lidhja kauzale ekziston midis veprimit të kundërligjshëm dhe dëmit të shkaktuar. Lidhja kauzale është një kategori objektive, sepse këtu nuk kërkohet ekzistimi dhe vërtetimi i fajit. Lidhja kauzale ekziston p.sh. kur pronari i lokalit afarist para lokalit të vet nuk e largon borën, akullin dhe kalimtarët e rastit duke kaluar lëndohen. Vërtetimi i lidhjes kauzale në disa raste nuk paraqet problem, p.sh. kur dëmtuesi e then xhamin e veturës së dikujt, kjo fare nuk paraqet problem sepse në këtë rast ekziston lidhja kauzale ndërmjet veprimit të palejuar dhe pasojës së shkaktuar. Lidhja kauzale është vështirë të vërtetohet për lëndimet trupore, për dëmet e shkaktuara në trafik, për lëndimet trupore që shkaktohen në punë dhe lidhur me punën.

6.7.4 Veprimi i kundërligjshëm

Veprimi i kundërligjshëm është ai veprim njerëzor me anë të të cilit cenohet ndonjë normë juridike, ose ndonjë normë e moralit njerëzor. Këtu veprimi i kundërligjshëm nënkupton shkeljen, cenimin e së drejtës së huaj subjektive, p.sh. kur vozitësi vozit me shpejtësi të palejuar e shkel ndonjë kalimtar duke i shkaktuar lëndime trupore, veprimi i tij është i kundërligjshëm dhe krijon detyrën e dëmshpërblimit. Paraqitet situata tjetër kur vozitësi me shpejtësi të palejuar por nuk shkakton lëndim trupor të kalimtareve të rastit, me veprimin e tij edhe pse i ka cilësitë e veprimit të kundërligjshëm nuk cenohet asnjë e drejtë e huaj subjektive, nuk krijohet përgjegjësia juridike deliktore civile, po për kundërvajtje në trafik.

6.7.5 Faji

Faji është kusht i përgjegjësisë deliktore civile, e në veçanti i përgjegjësisë subjektive. Në disa raste të përgjegjësisë për të tjerët, faji mund të paraqitet si kusht i përgjegjësisë. Faji është kategori subjektive. Me anë të fajit vërtetohet marrëdhënia e shkaktuesit të dëmit ndaj veprimit të kundërligjshëm dhe ndaj dëmit si pasojë e tij. Në rast se ekziston dëmi dhe veprimi i kundërligjshëm por nuk ekziston faji i ndonjë subjekti, ky nuk do të përgjigjet për demin e shkaktuar. Faji është marrëdhënie e vullnetit të dëmtuesit dhe pasojave që kane rrjedhur. Veprimi ose mosveprimi i dëmtuesit nga ka rrjedhur dëmi mund t'i mvisht fajit të tij. Faji nuk është i përcaktuar në legjislaturën. Disa ligje vetëm konstatojnë se faji ekziston. Sa i përket Ligjit për Detyrimet të Kosovës, ai e përcakton në këtë mënyrë, se faji ekziston “kur dëmtuesi e ka shkaktuar demin me qëllim ose nga pakujdesia” (neni 140 i LMD).

Kur shkaktohet dëmi me veprim ose mosveprim të ndonjë subjekti, sjellja e tij krahasohet me sjelljen e njeriut të arsyeshem dhe nëse sjellja e tij nuk është në pajtim me sjelljen e njeriut të arsyeshem dhe të kujdesshem, ai do të jetë fajtor për dëmin e shkaktuar.

Që një subjekt të jetë fajtor për dëmin e shkaktuar, dëmtuesi duhet në çastin e shkaktimit të dëmit të ketë aftësi për gjykim. Dëmtuesi që nuk është i vetëdijshëm për sjellët e veta, nuk do të ketë aftësi për gjykim, nuk do të konsiderohet fajtor, prandaj nuk përgjigjet për dëmin e shkaktuar. Aftësinë për gjykim nuk e kanë të miturit dhe personat me të meta mendore.

Shkalla e fajit: Sipas peshës së fajit, “dëmi mund të jetë i shkaktuar me dashje (*dolus*) dhe nga pakujdesia (*culpa*)” (neni 140 i LMD).

6.8 Përrjashtimi i përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar

Edhe pse përgjegjësia për dëmin nga sendet e rrezikshme është më e ashpër se për fajin, ka raste kur nuk jepet përgjegjësi për të. Në rastet e përrjashtimit të përgjegjësisë për dëmin hyjnë: 1) fuqia madhore, 2) faji i të dëmtuarit dhe 3) faji i personit të tretë. Këto janë tri rrethana që duhet të ekzistojnë që të lirohet subjekti i caktuar nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar. Në këto rrethana mjafton që njeri prej tyre të shkaktohet, e subjekti të lirohet pjesërisht ose tërësisht nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar.

Fuqia madhore: Fuqia madhore është një prej rasteve të lirimit nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar. Fuqia madhore është ngjarje e jashtme që nuk është paraparë, ose që nuk mund të parashihet saktësisht se kur do të ndodh dhe që nuk mund të përballohet ose të shmanget.

Rasti: Rasti në të drejtën e detyrimeve paraqet mungesën e sjelljes së fajshme gjatë kryerjes së veprimit deliktor. Rasti paraqitet kur mungon lidhja midis ngjarjes së caktuar dhe pasojave të shkaktuara.

Dëmi i shkaktuar nga personi i tretë: Nëse dëmi i shkaktuar rrjedhë nga personi i tretë, ai do të jetë përgjegjës për dëmin. Personi i tretë është personi i cili është në marrëdhënie juridike me personin përgjegjës.

6.9 Baza e përgjegjësisë deliktore civile

Baza e përgjegjësisë paraqet arsyen për të cilën përgjigjet dikush për dëmin e shkaktuar. Arsyet e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar mund të jenë: faji dhe rreziku i krijuar.

Është tradicionale të thuhet se kush e shkakton dëmin me fajin e vet, përgjigjet për dëmin e shkaktuar (përgjegjësia subjektive). Por kur dëmi shkaktohet nga sendet e rrezikshme dhe veprimtaritë e rrezikshme, ekziston përgjegjësi për sendet ose veprimtaritë e rrezikshme (përgjegjësia objektive), ndërsa kur dikush përgjigjet për veprimet e tjetrit. Nga kjo mund të përfundojmë se llojet e përgjegjësisë deliktore civile janë: 1) *përgjegjësia subjektive*, 2) *përgjegjësia objektive* dhe 3) *përgjegjësia për tjetër*.

6.9.1 Përgjegjësia subjektive

Përgjegjësia subjektive për dëmin e shkaktuar është lloji i përgjegjësisë juridike civile, në të cilën personi përgjegjës përgjigjet për dëmin, që e ka shkaktuar me veprimin e tij deliktor dhe ai është fajtor për dëmin e shkaktuar. Kjo përgjegjësi ndryshe quhet *përgjegjësi sipas fajit*, sepse mbështetet në fajin e subjektit që e ka shkaktuar dëmin. Faji në përgjegjësinë objektive ka rol të dyfishtë: ai nga njëra anë, është kusht thelbësor i kësaj përgjegjësie, e nga ana tjetër bazë e kësaj përgjegjësisë. Subjekti i cili “tjetrit i shkakton dëm është i detyruar ta shpërblejë atë, në qoftë se

nuk vërteton se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”. Këtu supozohet se faji ekziston në sajë të vetë faktit se dëmi nga person i tretë shkakton pasoja të kundërligjshme. Faji i dëmtuesit duhet të vërtetohet nga ana e të dëmtuarit, pra, barra e vërtetimit qëndron në të dëmtuarin si kreditori. Sepse paraqet kërkesën për dëmshpërblim. Mosekzistimin e fajësisë së dëmtuesit ka si pasje pamundësinë e zbatimit të dispozitave të përgjegjësisë subjektive për demin e shkaktuar.

6.9.2 Përgjegjësia objektive:

Përgjegjësia objektive për demin e shkaktuar është ai lloj i përgjegjësisë deliktore civile që mbështetet në faktin e shkakimit të dëmit nga sendet e rrezikshme, a veprimtaritë e rrezikshme. Kjo përgjegjësi ndryshe quhet edhe “përgjegjësi pa faj”, “përgjegjësi për sendet e rrezikshme dhe veprimtaritë e rrezikshme”, si “përgjegjës kauzale ose përgjegjësi që mbështetet në parimin e kauzalitetit”.

Burim rreziku të shtuar paraqet sendi i rrezikshëm dhe veprimtaria e rrezikshme. *Sendi i rrezikshëm* konsiderohet çdo send i luajtshëm ose i paluajtshëm i cili sipas pozitës ose përdorimit, ose sipas vetive paraqet rrezik për rrethin, prandaj duhet të mbikëqyret me kujdesin më të madh.

Disa sende janë të rrezikshme sipas vetë *pozitës* që kanë, p.sh. saksia me lule në ballkon është send i rrezikshëm, sepse nëse bie mund të shkaktojë dëm ose të lëndojë dikë. Sendi i rrezikshëm për rrethinë është kanali i hapur në rrugë.

Disa sende janë të rrezikshme *për nga përbërja*, p.sh. helmet energjia atomike, rryma elektrike etj.

Disa sende janë të rrezikshme *kur vihet në përdorim*, p.sh. mjeti motorik kur vihet në lëvizje paraqet rrezik për rrethin, rryma elektrik kur vihet në veprim në përçues është send i rrezikshëm.

Disa sende *sipas vetive që kanë konsiderohet* se janë të rrezikshëm p.sh. mjetet narkotike paraqesin rrezik të shtuar për rrethin e caktuar.

Veprimtaria e rrezikshme është ajo veprimtari nga e cila krijohet rreziku për demin dhe është burim i rrezikut të shtuar. Veprimtari të rrezikshme janë: ndërtimtaria, trafiku hekurudhor, automobilistik, ajror, ujor, veprimtaria në hidrocentrale etj. Rrezik të shtuar për rrethinë paraqet organizmi i tubimeve të njerëzve në vend të mbyllur ose të hapur, rrëzimi i objektit të caktuar, sendi me mungesa në prodhim etj.

Për demin e shkaktuar nga sendet e rrezikshme dhe veprimtaritë e rrezikshme krijohet përgjegjësia për shpërblimin e dëmit. Baza e përgjegjësisë është objektive pa faj, sepse i dëmtuari këtu duhet të vërtetohet se ekziston: dëmi, lidhja kauzale dhe veprimi i kundërligjshëm për përgjegjësinë e dëmit të shkaktuar nga këto sende.

Subjekti përgjegjës: Për demin e shkaktuar nga sendet e rrezikshme ose nga veprimtaria e rrezikshme, përgjigjen subjektët e caktuar. Në rast se dëmi shkaktohet nga sendi i rrezikshëm, përgjigjet pronari i sendit të rrezikshëm, kurse për demin e shkaktuar nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet subjekti që merret me veprimtari të rrezikshme. Në qoftë se sendi i rrezikshëm është në bashkëpronësi të dy ose më shumë subjekteve atëherë solidarisht përgjigjen të gjithë bashkëpronarët. Në vend të pronarit të sendit përgjigjet subjekti të cilit i është besua që me atë send të shërbehet, ose subjekti i cili është i detyruar të mbikëqyrë atë send, ndërsa te ai nuk është në punë.

Baza e përgjegjësisë për demin e shkaktuar nga sendet e rrezikshme: Në përgjegjësinë për demin nga sendet e rrezikshme bazë e përgjegjësisë nuk është faji, por përgjegjësia pa faj.

Prandaj edhe quhet përgjegjësi objektive. Bazën e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar nga sendet e rrezikshme duhet mbështetur në rrezikun e krijuar, sepse pronari i sendeve të rrezikshme i ka dobite nga përdorimi i atyre sendeve, prandaj edhe duhet t'i bartë pasojat e dëmshme të veprimtarisë së tij. Pronari duhet të tregojë kujdes dhe të pësojë çdo dem i cili është në lidhje kauzale në atë veprimtari edhe kur nuk është fajtor për dëmin që është shkaktuar.

Rastet e veçanta të përgjegjësisë për sendet e rrezikshme dhe veprimtaritë e rrezikshme:
Ligji për Detyrimet në nenin 161-168 parasheh 12 raste të veçanta të kësaj përgjegjësie:

- Përgjegjësia për dëmin të shkaktuar në organizatat industriale dhe në vendndërtime,
- Përgjegjësia për dëmin të shkaktuar në trafik,
- Përgjegjësia për dëmin të shkaktuar nga rrëzimi, hedhja, derdhja nga ndërtesat,
- Përgjegjësia për dëmin të shkaktuar nga godina,
- Dëmi nga kafshët,
- Përgjegjësia për dëmin të shkaktuar me mjete motorike në lëvizje,
- Përgjegjësia e prodhuesit të sendit me mungesa,
- Përgjegjësia për dëmin të shkaktuar me akte terroriste, me demonstrata ose manifestime publike,
- Përgjegjësia e organizuesit të manifestimit,
- Përgjegjësia për dëmin për shkak të mos ofrimit të ndihmës së nevojshme,
- Përgjegjësia përkitazi me detyrën për lidhen e kontratës dhe
- Përgjegjësia për dëmin përkitazi me kryerjen e punëve me interes të përgjithshëm.

6.9.3 Përgjegjësia për veprimet e tjetrit

Përgjegjësia për veprimet e tjetrit është lloji i tretë i përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar. Kjo është krijuar në interes të subjektit të dëmtuar që t'i ofrohet mbrojtje më e mirë ndaj shkaktuesit të dëmit, i cili zakonisht nuk ka mjete që të bëjë shpërblimin e dëmit. Në përgjegjësinë për të tjerët nuk përgjigjet ai që e ka shkaktuar dëmin, por subjekti tjetër në vend të tij. Në këtë përgjegjësi dallohet: shkaktuesi i dëmit- dëmtuesi dhe subjekti përgjegjës.

Kushtet e përgjegjësisë për të tjerët janë:

- duhet që të shkaktohet dëmi,
- që dëmin ta shkaktojë subjekti që është në lidhje të veçantë juridike me subjektin përgjegjës,
- të ekzistojë lidhja kauzale midis veprimit të kundërligjshëm dhe dëmit të shkaktuar,
- dëmi të shkaktohet nga lëshimet e subjektit përgjegjës.

Bazë e përgjegjësisë është *faji i supozuar*.

Rastet e përgjegjësisë për veprimet e tjetrit janë:

- përgjegjësia e prindërve për fëmijë,
- përgjegjësia e kujdestarit për të miturin ose e organit të kujdestarisë,
- përgjegjësia e subjektit të zhveshur tërësisht nga aftësia për të vepruar,
- përgjegjësia e punëdhënësit për punëtorët e vet,
- përgjegjësia e ndërmarrjes për punëtorët e vet

- përgjegjësia e shtetit për dëmin e shkaktuar nga punëtorët e shtetit.

6.10 Përmbledhje

Me vet faktin se me shkaktimin e dëmit bëhet krijimi i detyrimeve, atëherë lind edhe përgjegjësia e shkaktuesit të dëmit për shpërblimin e dëmit. Që dëmi të kompensohet duhet që të dihet shkaktuesi i tij dhe përgjegjësia e tij. Pjesëmarrësve do tu ofrohet një rast praktik lidhur me të cilin ata do të japin mendimin kritik, do të hartojnë detyrën me shkrim dhe do të gjejnë zgjidhjet ligjore lidhur me problemin e parashtruar.

7. Shpërblimi i dëmit

7.1 Hyrje

Ky sesion do të jetë tërësish praktik. Pjesëmarrësve do tu parashtrohet një rast praktik lidhur me të cilin ata do të diskutojnë mbi çështjet praktike të zgjidhjes së rastit. Do të njoftohen lidhur me mënyrën e hartimit të padisë dhe nxjerrjes së aktgjykimit.

7.2 Objektivat trajnues

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Marrin njohuri mbi ndërtimin strukturor të padisë;
- Hartojnë paditë për shpërblimin e dëmit të pësuar në aksidentet në komunikacion;
- Marrin njohuri mbi ndërtimin strukturor të aktgjykimit;
- Hartojnë aktgjykimin lidhur me shpërblimin e dëmit në aksidentet në komunikacion.

7.3 Padia për shpërblimin e dëmit të pësuar në aksidentet në komunikacion

Padia për shpërblimin e dëmit të pësuar në aksidentet në komunikacion është padi detyruese.

Pjesëmarrësve do tu parashtrohet një rast praktik lidhur me të cilin ata do të japin mendimin kritik dhe do të nxjerrin përfundimet lidhur me të drejtën e subjektit të dëmtuar për shpërblimin e dëmit të pësuar, paditshmërinë, bazën e përgjegjësisë, subjektet pjesmarrës në procedurën kontestimore, të drejtën e “personit të tretë” që të dëmshpërblehet, legjislacionin që përdoret në këto raste, etj.

Pas marrjes së njohurive, pjesëmarrësve do tu shpjegohet lidhur me kategoritë shpërblyese dhe mënyrën e ndërtimit të padisë dhe kërkesëpadisë në raste e shpërblimit të dëmit në komunikacion.

7.4 Aktgjykimi lidhur me paditë për shpërblimin e dëmit të pësuar në aksidentet në komunikacion

Aktgjykimi lidhur me paditë për shpërblimin e dëmit të pësuar në aksidentet në komunikacion është aktgjykim detyrues. Pjesëmarrësve do tu shpjegohet në këtë pjesë lidhur me ndërtimin e aktgjykimit dhe mënyrën e vendosjes gjyqësore në këto raste.

Pjesëmarrësit do të hartojnë aktgjykimin lidhur me padinë për shpërblimin e dëmit që ata tashmë e kanë të hartuar. Në këtë mënyrë do të kenë një rast të kompletuar që do tu shërbejë në praktikën e tyre në punën e gjyqtarit.

7.5 Përmbledhje

I ndërtuar në këtë mënyrë moduli lidhur me shpërblimin e dëmit do të jetë shumë praktik. Pjesëmarrësit tashmë do të kenë një rast të kompletuar që nga rasti i parashtruar, padia dhe më në fund edhe aktgjykimi lidhur me shpërblimin e dëmit

8. Shpërblimi i dëmit të pësuar në aksidentet në punë

8.1 Hyrje

Ky sesion do të jetë tërësisht praktik. Pjesëmarrësit do të njihen lidhur me padinë për aksidentet në punë, palët në kontest, bazën e përgjegjësisë etj. Pjesëmarrësve do tu parashtrohet një rast praktik lidhur me të cilin ata do të diskutojnë mbi çështjet praktike të zgjidhjes së rastit. Do të njoftohen lidhur me mënyrën e hartimit të padisë dhe nxjerrjes së aktgjykimit.

8.2 Objektivat e trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Marrin njohuri mbi ndërtimin strukturor të padisë;
- Hartojnë paditë për shpërblimin e dëmit të pësuar në aksidentet në punë;
- Marrin njohuri mbi ndërtimin strukturor të aktgjykimit;
- Hartojnë aktgjykimin lidhur me shpërblimin e dëmit në aksidentet në punë.

8.3 Padia për shpërblimin e dëmit të pësuar në aksidentet në punë

Padia për shpërblimin e dëmit të pësuar në aksidentet në punë është padi detyruese. Pjesëmarrësve do tu parashtrohet një rast praktik lidhur me të cilin ata do të japin mendimin kritik dhe do të nxjerrin përfundimet lidhur me të drejtën e subjektit të dëmtuar për shpërblimin e dëmit të pësuar, paditshmërinë, bazën e përgjegjësisë, subjektet pjesëmarrës në procedurën kontestimore, të drejtën e “personit të tretë” që të dëmshpërblehet, legjislacionin që përdoret në këto raste, etj. Pas marrjes së njohurive, pjesëmarrësve do tu shpjegohet lidhur me kategoritë shpërblyese dhe mënyrën e ndërtimit të padisë dhe kërkesëpadisë në rastet e shpërblimit të dëmit në punë.

8.4 Aktgjykimi lidhur me paditë për shpërblimin e dëmit të pësuar në aksidentet në punë

Aktgjykimi lidhur me paditë për shpërblimin e dëmit të pësuar në aksidentet në punë është aktgjykim detyrues. Pjesëmarrësve do tu shpjegohet në këtë pjesë lidhur me ndërtimin e aktgjykimit dhe mënyrën e vendosjes gjyqësore në këto raste.

Pjesëmarrësit do të hartojnë aktgjykimin lidhur me padinë për shpërblimin e dëmit që ata tashmë e kanë të hartuar. Në këtë mënyrë do të kenë një rast të kompletuar që do tu shërbejë në praktikën e tyre në punën e gjyqtarit.

8.5 Përmbledhje

I ndërtuar në këtë mënyrë moduli lidhur me shpërblimin e dëmit do të jetë shumë praktik. Pjesëmarrësit tashmë do të kenë një rast të kompletuar që nga rasti i parashtruar, padia dhe më në fund edhe aktgjykimi lidhur me shpërblimin e dëmit

9. Kundërshtimi i veprimeve juridike të debitorit- padia pauliana

9.1. Hyrje

Ky sesion do të jetë tërësish praktik. Pjesëmarrësit do të njihen me padinë Pauliana, qëllimin e kësaj padie si dhe kushtet për suksesin e padisë. Pjesëmarrësve do tu parashtrohet një rast praktik lidhur me të cilin ata do të diskutojnë mbi çështjet praktike të zgjidhjes së rastit. Do të njoftohen lidhur me mënyrën e hartimit të padisë dhe nxjerrjes së aktgjykimit.

9.2 Objektivat e trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Marrin njohuri mbi ndërtimin strukturor të padisë;
- Hartojnë padinë Pauliana;
- Marrin njohuri mbi ndërtimin strukturor të aktgjykimit;
- Hartojnë aktgjykimin lidhur me padinë Pauliana.

9.3 Padia Pauliana

E drejta e kreditorit për kundërshtim është e drejtë e atillë me anë të së cilës kreditori për ta mbrojtur kërkesën e vet, mund t'i kundërshtojë ato veprime juridike të debitorit, me të cilat ka zvogëluar pasurinë e vet në llogari të pasurisë së ndonjë personi të tretë.

Qëllimi kryesor i padisë Pauliana është ta mbrojë interesin e kreditorit duke kundërshtuar veprimet e debitorit të pa ndërgjegjshëm. Me ngritjen e padisë Pauliana kërkohet që veprimi juridik i goditur i debitorit, të bëhet pa efekt vetëm ndaj kreditorit, d.m.th. që sendi që ka dalë nga pasuria e debitorit të kthehet në pasurinë e kreditorit. Më këtë padi pra, nuk anulohet veprimi juridik i debitorit me personin e tretë, por lihet jashtë fuqisë pa efekt dhe kjo vetëm ndaj kreditorit. Kështu, psh. nëse debitori ia jep personit të tretë, me padi Pauliana ky send i kthehet debitorit përsëri.

Kushtet për suksesin e padisë Pauliana: Kreditori do të ketë sukses t'i kundërshtojë veprimet e caktuara juridike të debitorit në qoftë se ka sukses të vërtetë ekzistimin e tri kushteve:

- **së pari**, se me veprimet juridike të debitorit është dëmtuar,
- **së dyti**, se debitori ka ndërmarrë veprime juridike me qëllim që ta dëmtojë kreditorin,
- **së treti**, se personi i tretë, i kundërshtuar i sulmit ka qenë i pandërgjegjshëm, pra ka qenë i njohur me qëllimin e tillë të debitorit.

9.4 Aktgjykimi lidhur me padinë Pauliana

Aktgjykimi lidhur me padinë Pauliana është aktgjykim deklarativ. Pjesëmarrësve do tu shpjegohet në këtë pjesë lidhur me ndërtimin e aktgjykimit dhe mënyrën e vendosjes gjyqësore në këto raste. Pjesëmarrësit do të hartojnë aktgjykimin lidhur me padinë që ata tashmë e kanë të hartuar. Në këtë mënyrë do të kenë një rast të kompletuar që do tu shërbejë në praktikën e tyre në punën e gjyqtarit.

9.5 Përmbledhje

I ndërtuar në këtë mënyrë moduli lidhur me padinë Pauliana do të jetë shumë praktik. Pjesëmarrësit tashmë do të kenë një rast të kompletuar që nga rasti i parashtruar, padia dhe më në fund edhe aktgjykimi lidhur me padinë Pauliana.

10. Padia tek pasurimi i pa bazë

10.1 Hyrje

Ky sesion do të jetë tërësisht praktik. Pjesëmarrësit do të njihen me padinë tek pasurimi i pa bazë, qëllimin e kësaj padie si dhe kushtet për suksesin e padisë. Pjesëmarrësve do tu parashtrohet një rast praktik lidhur me të cilin ata do të diskutojnë mbi çështjet praktike të zgjidhjes së rastit. Do të njoftohen lidhur me mënyrën e hartimit të padisë dhe nxjerrjes së aktgjyqimit.

10.2 Objektivat trajnues

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Marrin njohuri mbi pasurimin e pa bazë;
- Hartojnë padinë lidhur me pasurimin e pa bazë;
- Marrin njohuri mbi ndërtimin strukturor të aktgjyqimit;
- Hartojnë aktgjykimin lidhur me padinë për pasurimin e pa bazë.

10.3 Pasurimi i pa bazë

Përveç kontratës dhe shkaktimit të dëmit, si burim i veçantë i krijimit të marrëdhënieve të detyrimeve paraqitet pasurimi pa bazë juridike. Pasurimi i pa bazë është një marrëdhënie juridike kur nga një subjekt pasuria kalon te subjekti tjetër, pa bazë juridike dhe pa shkak të justifikuar.

Kushtet që duhet të plotësohen për të ekzistuar pasurimi i pa bazë janë:

- të ekzistojë pasurimi,
- të ekzistojë varfërimi i subjektit tjetër,
- të ekzistojë lidhja kauzale ndërmjet pasurimit dhe varfërimit, dhe
- pasurimi duhet të jetë pa bazë juridike

Rastet e pasurimit të pabazë janë:

- pagimi pa pasur borxh,
- pagimi duke pasur parasysh bazën që nuk është realizuar,
- pagimi sipa bazës që më vonë ka dështuar,
- pasurimi pa bazë me veprimin e subjektit të pasuruar,
- pasurimi pa bazë me veprimin e personit të tretë ose nga efekti i fuqisë madhore.

10.4 Padia e pasurimit të pa bazë

Padia e pasurimit të pa bazë (*conditio sine causa*) është padi e detyrimeve, me të cilën kërkohet kthimi i asaj që është marrë pa bazë juridike. Kjo padi është personale sepse i varfëruari mund ta paraqesë këtë padi kundër të pasuruarit në rast se plotësohen kushtet e pasurimit të pa bazë. Ndryshe quhet edhe padi me karakter relativ, sepse mund të ngritet vetëm kundër personit të

pasuruar. Qëllimi i kësaj padie është që të bëhet restitimi në natyrë , e në rast se nuk ekziston mundësia e kthimit në natyrë, kthehet kundërvlera në para. Është padi e natyrës detyruese.

10.5 Aktgjykimi lidhur me padinë e pasurimit të pabazë

Aktgjykimi lidhur me padinë e pasurimit të pabazë është aktgjykim detyrues. Pjesëmarrësve do tu shpjegohet ne këtë pjesë lidhur me ndërtimin e aktgjykimit dhe mënyrën e vendosjes gjyqësore në këto raste. Pjesëmarrësit do të hartojnë aktgjykimin lidhur me padinë që ata tashmë e kanë të hartuar. Në këtë mënyrë do të kenë një rast të kompletuar që do tu shërbejë në praktikën e tyre në punën e gjyqtarit.

10.6 Përmbledhje

I ndërtuar në këtë mënyrë moduli lidhur me padinë e pasurimit të pa bazë do të jetë shumë praktik. Pjesëmarrësit tashmë do të kenë një rast të kompletuar që nga rasti i parashtruar, padia dhe më në fund edhe aktgjykimi lidhur me padinë e pasurimit të pa bazë.

XI. E drejta e administrative

Enver Peci
Kyretar në Gjykatën Supreme të Kosovës

Tabela e përmbajtjes – “E drejta administrative”

Hyrje	493
Objektivat e trajnimit.....	493
Metodat e të shpjeguarit.....	494
Pritjet nga pjesëmarrësit	494
Mjetet e nevojshme.....	494
Burimet.....	494
Përmbledhje	495
1. Parimet kompetenca procedura nxjerrja e aktit administrativ	496
1.1 Hyrje	496
1.2 Objektivat trajnuese	496
1.3 Nocioni i të drejtës së procedurës administrative	496
1.4 Parimet themelore të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative	497
1.5 Kompetenca e organit për zhvillimin e procedurës administrative.....	499
1.6 Procedura para nxjerrjes së aktit administrativ	501
1.5 Përmbledhje.....	505
2. Akti administrativ, mjetet juridike dhe ekzekutimi i vendimit.....	506
2.1 Hyrje	506
2.2 Objektivat trajnuese	506
2.3. Akti administrativ	506
2.4 Mjetet juridike.....	509
2.4 Ekzekutimi i vendimit përfundimtar administrativ	512
2.5 Përmbledhje.....	514
3. Nocioni akti palët dhe kompetenca në konfliktin administrativ	515
3.1 Hyrje	515
3.2 Objektivat trajnuese	515
3.3 Konflikti administrativ - nocioni	515
3.4 Akti administrativ ndaj të cilit zhvillohet konflikti administrativ	517
3.5 Palët dhe kompetenca në konflikt administrativ	518
3.6 Përmbledhje.....	519
4. Padia dhe seanca e shqyrtimit kryesor në konfliktin administrativ	520
4.1 Hyrje	520
4.2 Objektivat trajnuese	520
4.3 Padia në konfliktin administrativ	520
4.4 Procedura paraprake në konfliktin administrativ	522
4.5 Seanca e shqyrtimit kryesor në konfliktin administrativ	523
5. Aktgjykimi dhe mjetet juridike.....	525
5.1 Hyrje	525
5.2 Objektivat trajnues	525
5.3 Aktgjykimi në konfliktin administrativ.....	525
5.4 Mjetet juridike në konfliktet administrative	527
5.4 Mjetet e jashtëzakonshme juridike	528
5.5 Karakteri i detyrueshëm i aktgjykimit në konfliktin administrativ	530
5.6 Përmbledhje.....	531

Hyrje

E drejta administrative munde të shikohet si degë e sistemit juridik por edhe si degë e shkencës juridike administrative. E drejta administrative si degë e një sistemi juridik përfshin tersin e normave specifike juridiko –administrative të cilat në përgjithësi i përkasin organizimit dhe veprimtarisë së administratës publike të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësi të bartësve të këtyre veprimtarive (organeve dhe personave zyrtar), me të cilat rregullohet veprimtaria e administratës e posaçërisht të drejtat dhe detyrimet e personave fizik dhe juridik ndaj të cilëve vepron administrata, në kontrollin e ligjshmërisë së punës të administratës publike, kontestet të cilat rrjedhin nga veprimi i administratës, si dhe në mjetet juridike të cilat me rastin veprimit të administratës munde t'i shfrytëzojnë.

Kontrolli i administratës publike është faza përfundimtare në procesin e veprimit administrativ dhe ajo paraqitet si një mbikëqyrje specifike juridike në punën e organeve administrative si dhe të organeve të pushtetit shtetëror. Këtë kontroll e bëjnë trupa të ndryshme të përfaqësuara si dhe organet politike ekzekutive në kuadër të vet administratës, avokati i popullit dhe organe tjera kompetente, ndërsa e rëndësishme së veçantë është kontrolli gjyqësor i administratës. Kontrolli gjyqësor përfshin kontrollin ligjor të akteve administrative në konfliktin administrativ dhe konsiderohet forma më e larte e kontrollit administrativo- juridik.

Duke pas parasysh të cekurat më lartë, me pa mëdyshje mundë të konstatohet se ky modul përfshin jashtëzakonisht lëmi të gjerë të së drejtës administrative, fjala është pra, jo vetëm organizimi por edhe veprimtaria e gjerë e organeve administrative. Me këtë rast gjithsesi duhet pasur parasysh edhe tërësinë organizative dhe kompleksitetin e organizimit të organeve administrative.

Duke pas parasysh se ky modul përfshin një gamë të gjerë të normave juridike, në pjesën e par do të shtjellohen temat që i përkasin procedurës administrative dhe nxjerrjes së aktit administrativ e që i përket organeve të administratës por shume e rëndësishme edhe për gjyqtaret që do të punojnë në lëmin administrative, ndërsa pjesa tjetër do të përfshij konfliktin administrativ në përgjithësi e që zhvillohet pranë gjykatës kompetente administrative e që përfshin seancën e shqyrtimit kryesor dhe marrjen e aktgjykimit ne shkallën e parë si dhe mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike gjithnjë sipas Ligjit për Konfliktet Administrative.

Objektivat e trajnimit

Pas përfundimit të këtij moduli trajnues, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Njohin nocionin e së drejtës së procedurës administrative;
- Identifikojnë dallimet në mes të procedurës administrative dhe procedurave tjera;
- Interpretojnë drejtë parimet themelore në të cilat bazohet Ligji për Procedurën Administrative;
- Zgjerojnë njohurit lidhur me kompetencën, delegimin e kompetencës, zëvendësimin dhe zgjidhjen e konfliktit për kompetencë të organeve të administratës publike gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative;
- Njohin procedurën administrative që duhet ta zhvillojnë organet kompetente në kuptimin e përgjithshëm dhe nxjerrjen e aktit administrativ;

- Avancojnë njohurit lidhur me mjetet juridike në procedurën administrative, llojin e vendimeve të organeve administrative të shkallës së dytë dhe mënyrën e vendosjes;
- Zbatojnë drejtë procedurën e ekzekutimit të vendimit përfundimtar administrativ;
- Njohin procedurën paraprake para konfliktit administrativ dhe konfliktin administrativ sipas padis;
- Përvetësojnë dhe administrojnë procedurën e seancës së shqyrtimit kryesor para gjykatës së shkallës së parë, si dhe marrjen e vendimeve procedurale dhe përfundimtarë;
- Thellojnë njohurit për mjetet juridike, bazat për ankimim kundër vendimeve të gjykatës së shkallës së parë si dhe për mjetet e jashtëzakonshme juridike.

Metodat e të shpjeguarit

Gjatë këtij trajnimi do të përdoren metodat e shpjegimit, duke u bazuar në raste, duke përdorur shembuj konkret. Kjo metodologji përdor ushtrime, diskutime. Materiali i këtij trajnimi do t'iu shpërndahet pjesëmarrësve, i cili material përmban komente, shënime, shembuj praktik mbi parimet dhe rregullat kryesore të Ligjit për Procedurën Administrative si dhe Ligjit për Konfliktet Administrative.

Pritjet nga pjesëmarrësit

Roli i trajnuesit është të lehtësoi mësimin e pjesëmarrësve. Nga ata pritet të kontribuojnë në diskutime në grupe. Materialet e trajnimit të cilat u dorëzohen përmbajnë prezantimet për principet kryesore dhe rregullat e dy ligjeve bazike të procedurës administrative dhe at, Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Ligjit për Konfliktin Administrativ si dhe zbatimin praktik të këtyre ligjeve.

Mjetet e nevojshme

Mjetet e nevojshme për këtë trajnim janë kompjuteri, flipchart, letër dhe ligjet.

Burimet

Për përgatitjen e këtij moduli janë shfrytëzuar këto materiale:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- Ligji për Procedurën Administrative;
- E Drejta e Procedurës Administrative – Mr,Sc. Agur Sokoli;
- E Drejta administrative – Esat Stavileci, Agur Sokoli, Mirlinda Batalli;
- Ligji për Konfliktet Administrative;
- Komentari i Ligjit për Procedurën Kontestimore – Prof. Dr. Iset Morina, Selim Nikçi.

Përmbledhje

Në këtë modul janë përshkruar aspektet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtën e procedurës administrative, nocioni i të drejtës së procedurës administrative, parimet themelore të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kompetenca, inicimit të procedimit administrativ dhe nxjerrjen e aktit administrativ. Gjithashtu janë shpjeguar mjetet juridike dhe ekzekutimi i vendimit administrativ të organit publik, në mënyrë që mëtutje janë shtjelluar çështjet e konfliktit administrativ duke përfshi procedurën rreth padis si dhe procedurën e gjykatës kompetente lidhur me padinë dhe seanca e shqyrtimit kryesor. Mëtutje, pjesëmarrësit do të përfitojnë njohuri lidhur me aktgjykimin dhe mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike në konfliktin administrativ.

1. Parimet kompetenca procedura nxjerrja e aktit administrativ

1.1 Hyrje

Në këtë sesion trajnues do të trajtohen parimet, kompetenca e organit për zhvillimin e procedurës administrative si dhe procedura para nxjerrjes së aktit administrativ.

1.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij moduli trajnues, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Zbatojnë drejtë dispozitat e procedurës administrative;
- Identifikojnë dallimet në mes të procedurës administrative dhe procedurave tjera;
- Interpretojnë drejtë parimet themelore në të cilat bazohet Ligji për Procedurën Administrative.
- Identifikojnë çështjet që kanë të bëjnë me kompetencën, delegimin e kompetencës, zëvendësimin dhe zgjidhjen e konfliktit për kompetencë të organeve të administratës publike gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative.
- Njohin dhe demonstrojnë praktikisht procedurën që duhet ta zhvillon organi publik para nxjerrjes së aktit administrativ.

1.3 Nocioni i të drejtës së procedurës administrative

Me të drejtën e procedurës administrative kuptojmë sistemin e dispozitave juridike të cilat caktojnë të drejtat dhe detyrimet e organit shtetëror në zbatimin e normave juridike materiale, në raste konkrete si dhe të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve të tjerë në procedurë. E drejta e procedurës administrative paraqet tërësi dispozitash me të cilat rregullohet veprimtaria e organeve administrative, organeve tjera shtetërore dhe organizatave që ushtrojnë autorizime publike, kur në çështje administrative drejtpërdrejtë duke i zbatuar dispozitat, vendosin mbi të drejtat dhe detyrimet e individëve apo të personave juridik dhe palëve tjera. Nga kjo rezulton se këto dispozita rregullojnë formën e veprimtarisë së organeve administrative lidhur me nxjerrjen e akteve administrative.

Roli i administratës në kushte të reja të zhvillimit të shoqërisë kosovare është ndër temat aktuale. Sa do që ushtrimi i pushtetit nëpërmes administratës është në kundërshtim me çfarëdo forme të demokracisë, organet administrative pa pushtet nuk mund të funksionojnë. Roli i administratës publike sot shprehet në dy drejtime: në njërin anë ajo ka rëndësi të veçantë për qytetarët të cilët paraqiten si palë në raport të drejtpërdrejte me organet administrative, në anën tjetër ajo ka rëndësi të posaçme për organet administrative të pushtetit të cilat iu nënshtrohen proceseve të reja të zhvillimit të shoqërisë.

Kërkesa për njohjen dhe zgjerimin e njohurive për administratën është e domosdoshme sidomos pas reformave në gjykata, ku nga 1 janari i vitit 2013 themelohet departamenti i veçantë për çështje administrative në Gjykatën Themelore të Prishtinës, si dhe themelimi i departamentit për çështje administrative në Gjykatën e Apelit.

Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i miratuar nga Parlamenti i Republikës së Kosovës Nr. 05/L-031 më datë 25 maj 2016 i cili është parapa të hyn në fuqi 1 vit pas publikimit në Gazetën Zyrtare e që tani është në fuqi, me të cilin është shfuqizuar Ligji Nr.

02/L-28, ka parapa disa risi sa i përket sigurimit të realizimit efektiv të autoritet publik e në shërbim të interesit publik dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave juridike të personave, me qëllim që të garantoj në raport me palët nxjerrjen e vendimeve të ligjshme dhe të drejta, gjegjësisht që të vërtetohet gjendja faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë. Ligji për Procedurën Administrative përmban dispozita me të cilat rregullohet mënyra e ushtrimit të administratës në situatat individuale, e veçmas mënyra e nxjerrjes së akteve konkrete administrative. Ky ligj përmban jo vetëm parimet themelore por edhe institutet juridike dhe rregulla juridike procedurale të cilat sigurojnë ligjshmërinë dhe objektivitetin e punës dhe të vendosjes, mbrojtjen e të drejtave subjektive të palëve si dhe inspiron racionalizimin dhe ekonomizimin e procedurës dhe njëherit pengojnë arbitraritetin e organit administrativ që zhvillon këtë procedurë.

Ligji për Procedurën Administrative përcakton dispozita të cilat rregullojnë çështjet e procedurës siç janë:

- Parimet e përgjithshme;
- Subjektet e procedurës administrative duke përfshi palët dhe përfaqësimin;
- Organet publike duke përfshi kompetencën, zyrtarin përgjegjës, përjashtimin, bashkëpunimin, ndihmën administrative si dhe organet kolegjiale;
- Veprimet administrative duke përfshi aktin administrativ, pasojat juridike të aktit, anulimin dhe shfuqizimin, kontratën administrative si dhe veprimet tjera administrative;
- Rregullat e përgjithshme të procedurës administrative duke përfshi gjuhën dhe përkthimin, kërkesën dhe parashtrimin e saj si dhe rregullat për afatet;
- Zhvillimin e procedurës administrative duke përfshi fillimin, shqyrtimin, provat, pjesëmarrjen e palës, përfundimin si dhe vërtetimi i fakteve dhe njëjtësimi i dokumenteve;
- Rregullat e përgjithshme të të njoftuarit, duke përfshi njoftimin me post, mjetet elektronike si dhe njoftimin formal;
- Mjetet juridike administrative duke përfshi ankesën dhe efektet e saja, procedurën e shqyrtimit, kundërshtimin administrativ si dhe rihapjen e procedurës; si dhe
- Ekzekutimin e aktit administrativ format dhe procedurën.

Ligjin për Procedurën Administrative e zbatojnë të gjitha organet e administratës publike, si dhe organizatat të cilat ushtrojnë autorizime publike, Organet e administratës publike janë:

- Organet e administratës publike qendrore dhe organet tjera në varësi të tyre;
- Organet e administratës publike lokale dhe organet e tjera në varësi të tyre;

1.4 Parimet themelore të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative

Sipas Ligjit për Procedurën Administrative përcaktohen parimet themelore mbi të cilat bazohet dhe zhvillohet procedura administrative. Këto parime përcaktohen në bazë të këtij ligji me qëllim që të sigurohen të drejtat dhe interesat e palëve me rastin kur vihen në marrëdhënie me organet e administratës publike. Nga kjo rezulton se këto parime themelore janë parashikuar me qëllim që të sigurohet mbrojtja e të drejtave dhe interesave juridike të qytetarëve nga veprimtaria e parregullt e administratës publike.

Prandaj mund të themi se parimet themelore të procedurës administrative janë udhërrëfyese për vendosjen e drejtë të çështjes administrative, sepse organi duke respektuar këto parime gjen orientimin për nxjerrjen e vendimit të ligjshëm dhe të drejtë.

Parimet themelore të procedurës administrative janë:

- Parimi i ligjshmërisë;
- Parimi i proporcionalitetit;
- Parimi i barazisë dhe mos diskriminimit;
- Parimi i objektivitetit dhe paanësisë;
- Parimi i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme;
- Parimi i administratës së hapur;
- Parimi i jo formalitetit dhe efikasitetit të procedurës administrative;
- Parimi i informimit dhe ndihmës aktive;
- Parimi i mospagimit të procedurës; si dhe
- Parimi i të drejtës në mjete juridike.

Parimi i ligjshmërisë në procedurën administrative përcakton jo vetëm parimin themelor të procedurës administrative por edhe njërin nga parimet themelore kushtetuese, i cili është proklamuar në të gjitha sistemet juridike. Ky parim përcakton idenë mbi sundimin e ligjit në shoqëri, që do të thotë se të gjithë qytetarët, organet dhe organizatat normative juridike nënshtrohen para ligjit. Organet e administratës publike ushtrojnë veprimtarinë administrative në përputhje me legjisllacionin në fuqi në Kosovë, brenda kufijve të kompetencave që u janë dhënë atyre dhe konform qëllimit për të cilat janë dhënë këto kompetenca. Pra sipas këtij parimi organet e administratës publike të cilat zhvillojnë procedurën administrative, kur vendosin në çështje administrative, mbi të drejtat, detyrimet ose interesat juridike të individëve, të personave juridik dhe palëve tjera duhet t'i përmbahen Ligjit për Procedurën Administrative, dhe të zbatojnë drejt dispozitat materiale juridike, në bazë të të cilave vendoset mbi të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të qytetarëve, të personave juridik ose të palëve tjera. Ligjdhënësi me qëllim të respektimit të parimit të ligjshmërisë, ka parashikuar që me rastin e moszbatimit të parimit të ligjshmërisë palët kanë të drejtë të ushtrimit të mjeteve juridike siç është përdorimi i ankesës si mjet i rregullt juridik dhe mjetet e jashtëzakonshme në procedurën administrative dhe padisë në konfliktin administrativ.

Parimi i proporcionalitetit, në bazë të këtij parimi organet e administratës publike gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre ligjore në zbatim të interesit publik do të përdorin mjetet që janë në proporcion me qëllimet që synohen të arrihen. Të drejtat e njohura ligjërish, liritë ose interesat e personave fizik apo juridik mund të kufizohen në pajtim me ligjin dhe në masën që është e domosdoshme për të realizuar një interes publik të rëndësishëm. Në çdo rast organet e administratës publike do të vlerësojnë nëse qëllimi i kërkuar mund të realizohet me masa sa me pak represive pa komprometuar efektivitetin e tyre.

Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit, përcakton detyrimin e çdo organi të administratës publike, trajtim në mënyrë të barabartë të të gjitha çështjeve në shqyrtim para tyre për aq sa këto çështje janë të njëjta. Dallimet në trajtimin e çështjeve lejohen vetëm në masën që ato përputhen me ndryshimet objektive mes çështjeve. Organet e administratës publike janë të obliguar që t'i trajtojnë në mënyrë të barabartë dhe pa dallime në mes të personave fizik dhe juridik siç është : gjinia, raca, ngjyra, gjuha, opinioni politik, origjina kombëtare ose sociale, pasuria, lindja ose ndonjë status tjetër.

Parimi i objektivitetit dhe i paanësisë, në bazë të këtij parimi organet e administratës publike gjatë veprimtarisë se tyre marrin në konsideratë dhe u japin peshën që u takon të gjithë faktorëve që lidhen me një akt të caktuar administrativ. Gjithashtu organet e administratës publike nuk duhet influencuar nga interesa private ose personale ose paragjykime të nëpunësve që ushtrojnë këtë veprimtari.

Parimi i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme, ky parim përcakton faktin se veprimet e organeve të administratës publike duhet të jenë të parashikueshme dhe të respektojnë pritshmeritë legjitime dhe të arsyeshme të personave fizik dhe juridik.

Parimi i administratës së hapur, në procedurën administrative është parim kushtetues dhe parim që zbatohet në çdo procedurë ligjore. Ky parim në të kaluarën është emërtuar parimi i publicitetit i cili në fakt përcakton hapjen e kësaj procedure parimisht ndaj të gjithëve, që do të thotë se gjatë zhvillimit të procedurës administrative mund të asistojnë edhe personat e tjerë që nuk marrin pjesë në procedurën administrative. Ky parim pikësynim e ka që organet publike duhet të veprojnë me transparencë e që nënkupton informimin e palës mbi ecurinë e procedurës administrative, qasjen në shkresat e lëndës si dhe të drejtën e njoftimit për mjetet juridike. Po ashtu me këtë parim parashihet edhe kufizimi i këtyre të drejtave kur është e domosdoshme mbrojtja e informacionit të klasifikuar, të dhënave personale apo të dhënave afariste e profesionale, të mbrojtura sipas ligjit.

Parimi i jo formalitetit dhe efikasitetit të procedurës administrative, ky parim në fakt parasheh që procedura administrative të mos i nënshtrohet ndonjë forme të caktuar dhe që organet publike të zhvillojnë procedurën administrative sa më të shpejt dhe me sa më pak shpenzime e që në fakt qëllimi është që procedura të përfundoj sa më shpejt, pikërisht për shkak të natyrës së vet çështjeve administrative nga se vonesat në shume raste shkaktojnë pasoja të pa riparueshme.

Parimi i informimit dhe ndihmës aktive. Ky parim nënkupton obligimin e organit publik i cili zhvillon procedurën administrative, që të siguron që mosdija e palës të mos përkeqësoj mbrojtjen e të drejtave dhe interesave juridike. Informimi i palëve ka të bëjë me të drejtat dhe detyrimet e tyre në procedurën administrative, si dhe për pasojat juridike të veprimeve a mosveprimeve gjatë kësaj procedure. Informimi ka të bëjë me rrjedhën dhe zhvillimin e procedurës administrative brenda fushës përkatëse të kompetencës, procedurat formale për nxjerrjen e aktit administrativ me theks të dokumenteve dhe deklaratave që duhet parashtruar, pastaj afati kohor për njoftimin e vendimit përfundimtar si dhe mjeteve juridike në dispozicion të palës dhe mënyrën e ushtrimit të tyre. Informatat konsistojnë në dhënien e informatave të përgjithshme e që nënkupton për të gjithë pjesëmarrësit në procedurën administrative duke përjashtuar rastet individuale nga se atëherë organi publik do të bie ndesh me parimet etike të informimit të vetëm njëres palë.

Parimi i mospagimit të procedurës, në parim si rregull e përgjithshëm është që për palën procedura administrative është pa pagesë vetëm në rastet kur parashikohet me ligj. Gjithashtu në këtë parim është parapa që kur pagesa është parapa me ligj e njëjta nuk mund të jetë më e madhe se kostoja mesatare e nevojshme për zhvillimin e llojit përkatës të procedurës administrative. Po ashtu janë parapa edhe situatat e lirimit të pjesës ose tërësisht nga pagesa me kërkesën e palës. Sipas mendimit tim në këtë parim me siguri ligdhënësi e ka pas fjalën për taksen administrative por koj shprehimisht nuk është cek.

Parimi i të drejtës në mjete juridike, është parim gjeneral dhe obligim i organit publik që zhvillon procedurë administrative për njoftimin e palëve për mjetet juridike e që zakonisht në fund të çdo vendimi administrativ është udhëzimi për mjetin juridik.

1.5 Kompetenca e organit për zhvillimin e procedurës administrative

Kompetenca në procedurën administrative përcakton të drejtën dhe detyrimin e organit publik ose organizatës së autorizuar për ushtrimin e autorizimeve publike, për të nxjerr vendimin në

ndonjë çështje administrative, që do të thotë se kompetenca është e drejtë dhe detyrim i organit të caktuar administrativ që të vendos në çështje të caktuar dhe në territorin e caktuar. Rëndësia e caktimit të kompetencës në procedurën administrative është e shumëfishtë. Caktimi i kompetencës është veçmas me rëndësi për individët dhe organizatat, mbi të drejtat dhe interesat juridike të cilëve vendoset në procedurë administrative, sepse ato e përcaktojnë se cilit organ duhet t'i drejtohen palët në rastin konkret. Sepse mos respektimi i kompetencës do të krijoj pasiguri përveç për organet shtetërore por edhe pakënaqësi për palët të cilët kërkojnë të drejta pranë këtyre organeve.

Llojet e kompetencës

Në procedurën administrative kemi dy lloje kompetencash:

- Kompetenca lëndore;
- Kompetenca territoriale (tokësore).

Kuptimi i kompetencës lëndore – kompetenca lëndore e organit publik përcaktohet me ligj. Kompetenca lëndore është e drejtë dhe detyrë e një organi shtetëror që të vendos në çështjet e veçanta administrative nga lëmia ose materia e caktuar administrative. Me kompetencë lëndore përcaktohet natyra e materies, grupi apo grupi i punëve apo grupi i veprimeve të cilat i përkasin një organi në procedurën administrative, p.sh. për dhënien e lejes se ndërtimit është organi kompetent për ndërtimtari dhe urbanizëm. Gjithashtu në kompetencë lëndore nëse nuk është parapa ndryshe me ligj, për të vendosur në çështje administrative në shkallë të parë janë përcaktuar organet komunale të administratës.

Sipas paragrafit 2 të nenit 21 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative është parapa se: “nëse kompetenca lëndore për një çështje të caktuar nuk përcaktohet shprehimisht nga ligji apo është e pamundur të përcaktohet sipas natyrës të çështjes, organi i ngarkuar me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit përkatës material, do të ketë kompetencë lëndore mbi at çështje”. Sipas kësaj dispozite ligjore parashihet situata ku ligji nuk ka mundur shprehimisht të përcaktoj kompetencën por që nga natyra e çështjes dhe organi i cili është i obliguar ta zbatoj ligjin material të jetë kompetent që të vendos edhe për çështjen procedurale.

Kuptimi i kompetencës territoriale (tokësore) – Ligji për Procedurën Administrative, e përcakton dhe e autorizon organin shtetëror për kompetencë territoriale që t'i kryej kompetencat e veta lëndore në territor të caktuar. Kompetenca territoriale përcakton territorin e juridiksionit të organit, që do të thotë se me kompetencë territoriale thelbësore është territori i caktuar e jo lloji i punës siç është rasti me kompetencën lëndore. kompetenca territoriale caktohet sipas dispozitave mbi ndarjen politiko territoriale dhe sipas dispozitave mbi organizimin e organeve të veçanta të administratës.

Kompetenca territoriale caktohet:

- Në çështjet që kanë të bëjnë me pasurinë e paluajtshme në vendin ku ndodhet ajo;
- Për çështjet që kanë të bëjnë me veprimtarinë e një organizate afariste ose afarizmi individual, vendi i selisë së tyre;
- Për çështjet tjera vendbanimi i palës ose selia e personit juridik.

Në qoftë se kompetenca territoriale nuk mund të përcaktohet atëherë kompetenca territoriale caktohet sipas vendit ku ka ndodhur ngjarja. Në qoftë se sipas dispozitave do të ishin dy ose me

tepër organe për vendosje sipas kompetencës territoriale kompetent është organi që ka filluar i pari lidhur me çështjen. Kompetenca lëndore dhe territoriale nuk mund të ndryshohen.

Konflikti për kompetencë në procedurën administrative

Me konflikt kompetence në procedurën administrative nënkuptojmë atëherë kur dy ose me shumë organe shpallen kompetente ose jo kompetente për vendosjen për një çështje konkrete administrative. Me rastin e paraqitjes së konfliktit të kompetencave këtë konflikt e zgjidh:

- Me marrëveshjen unanime ndërmjet dy a më shumë organeve publike;
- Nëse nuk ka marrëveshje unanime si më lart konfliktin i kompetencës zgjidhet nga organi i përbashkët epror me hierarki më të lart që ka kompetenca kontrolli apo mbikëqyrje të organeve në konflikt. Sipas ligjit organ i përbashkët në rast se janë dy ministri të ndryshme apo ndërmjet një ministrie dhe një organi qendror në vartësi të kryeministrit është Qeveria e Republikës së Kosovës;
- Në rast se organet në konflikt nuk kanë organ të përbashkët epror, atëherë konflikti i kompetencës zgjidhet nga gjykata kompetente për çështje administrative;

1.6 Procedura para nxjerrjes së aktit administrativ

Parimet themelore të Ligjit për Procedurën Administrative garantojnë detyrimin e organeve të administratës publike që të vendosin në çështjet administrative me kujdes ndaj parimeve të objektivitetit dhe paanshmërisë meqë rëndësia juridike e këtyre parimeve shprehet në të gjitha dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative. Parimet themelore të procedurës administrative kanë për qëllim që palës t'i mundësohet që në procedurë të jetë pjesëmarrës aktiv për të realizuar mbrojtjen e plotë të drejtave dhe interesave të veta juridike. Organi gjegjësisht personi zyrtar i cili zhvillon procedurën administrative, duke pasur kujdes ndaj këtyre dy parimeve, do të jetë i sigurtë se në mënyrë të ligjshme dhe të drejtë do ta vendos çështjen konkrete administrative. Pengesat ligjore që e bëjnë nëpunësin administrativ që mos ta ushtroj detyrën e nëpunësit publik apo përjashtimin e tij nga ndërmarrja e veprimeve në procedurë janë më se vijon:

Nëpunësi nuk duhet përfshihet në një procedurë administrative nëse ka një interes personal direkt apo indirekt në çështjen e caktuar e që ligji i parasheh situata si në vijim; kur me palën, me përfaqësuesin ligjor apo me të autorizuarin e palës, është në gjini të gjakut në vijë të drejtë deri në cilëndo shkallë, kurse në vijë të tërthortë deri në shkallë të katërt, apo në qoftë se është bashkëshort apo në gjini të krushqisë deri në shkallë të dytë, pavarësisht nëse martesë ka pushuar ose jo; kur bashkëshorti apo partneri bashkëjetues, apo të afërmit e tij deri në shkallë të dytë, kanë një interes personal direkt apo indirekt në çështjen në fjalë; kur është vetë palë, përfaqësues ligjor apo i autorizuar i palës, apo me palën është kreditor apo bashkëkreditor, debitor apo bashkëdebor, apo në qoftë se në të njëjtën çështje është dëgjuar si dëshmitar apo si ekspert, apo ka marrë pjesë në procedurë si këshilltar apo avokat i palës; nëpunësi apo personat e parashikuar më lartë kanë një interes direkt apo indirekt në një çështje të ngjashme me çështjen në fjalë; personat e përmendur, kanë marrë pjesë si ekspertë, dëshmitarë, këshilltarë apo avokatë në çështjen në fjalë; ndërmjet nëpunësit apo personave të përmendur ka një proces gjyqësor me palët; nëse është pjesë apo shqyrton si organ epror ankesën e një akti të marrë prej vetë atij, ose nga personat e përmendur; nëpunësi ose personat e përmendur, kanë përfituar dhurata apo shërbime me një çmim dukshëm me të ulët se vlera e tregut, nga palët në procedurën administrative, përpara ose pas fillimit të procedurës; me palën, përfaqësuesin apo të

autorizuarin e palës, është në marrëdhënie të kujdestarit, birësuesit apo të ushqyesit; në çdo situatë tjetër, parashikuar shprehimisht me ligj apo që mund të vë në dyshim paanshmërinë e tij.

Me qëllim që të sigurohet objektiviteti në vendosjen e çështjes administrative me Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative nuk lejohet ta zhvilloj personi zyrtar që objektiviteti i të cilit dyshohet qoftë për shkak të ekzistimit të rrethanave të caktuara me lartë. Andaj nëse përmbushen këto rrethana të cekura me lartë, personi zyrtar duhet të përjashtohet nga ajo çështje administrative ngase edhe vet qëllimi i përjashtimit të personit zyrtar është që të sigurohet objektiviteti në vendosje në procedurën administrative.

Përjashtimin e personit zyrtar nga procedura administrative palët mund ta kërkojnë me kërkesë për shkak të rrethanave dhe arsyeve të cilat e vejnë në dyshim objektivitetin e personit zyrtar, personi zyrtar nuk mund të ushtroj asnjë veprim në procedurë deri në nxjerrjen e vendimit mbi këtë kërkesë, përveç atyre veprimeve që sipas natyrës së çështjes nuk e lejojnë shtyrjen.

Vendosja lidhur me kërkesën për përjashtim të personit zyrtar

Vendimi për përjashtim të personit zyrtar merret brenda një afati prej pesë ditëve të punës nga dita në të cilën palët e interesuara kanë paraqitur kërkesën për përjashtim ose nëpunësi ka deklaruar pengesën. Vendimin e merr eprori apo organi kolegjial që ka marrë dijeni për një rast të përjashtimit.

Sipas Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative procedura administrative fillon sipas kërkesës së palës apo sipas detyrës zyrtare nga organi publik. Aftësia për të iniciuar një procedurë administrative do të thotë zotësinë dhe përfaqësimi ligjor ose për të marr pjesë në të, si dhe rregullat që bëjnë të mundur përfaqësimin përcaktohen në përputhje me dispozitat e civile mbi aftësinë juridike të personave fizik dhe juridik. Në rastin kur mbrohen interesat publik të cilat mund të preken nga një procedim administrativ, e drejta për të filluar një procedim administrativ ose për të marr pjesë në të, u njihet personave të cilëve procedimi administrativ iu shkakton një dëm në të drejtat e tyre të përbashkëta siç janë: shëndeti publik, arsimimi, trashëgimia kulturore, ambienti dhe cilësia e jetës si dhe personave të cilët jetojnë në brendësi apo afërsi të një prone publike, e cila mund të dëmtohet nga procedimi administrativ.

Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare, të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative. Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, dokumentet që vërtetojnë akte, fakte, cilësi apo gjendje subjektive, të nevojshme për shqyrtimin administrativ, administrohen, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që zhvillon procedurën administrative, nëse janë në administrim të tij apo të organeve të tjera publike. Organi publik mund t'i kërkojë palës vetëm informatat e nevojshme për identifikimin e tyre.

Pala bashkëpunon në mirëbesim me organin publik në përcaktimin e fakteve dhe rrethanave të nevojshme për zgjidhjen e çështjes përkatëse (në vijim: "detyrim i bashkëpunimit të përgjithshëm"). Pala detyrohet që të sjellë prova, informata, të japë një deklaratë me shkrim apo të paraqitet personalisht për të dhënë një deklaratë para një organi publik, vetëm në ato raste kur parashihet shprehimisht me ligj (në vijim: "detyrimi i bashkëpunimit të posaçëm"). Si rregull, pala mund të jep deklarata qoftë në formë verbale apo të shkruar. Në çështje të ndërlikuara, organi publik mund të kërkojë nga pala që të parashtrijë një deklaratë me shkrim. Pala nuk do të thirret që të paraqitet personalisht para organit publik, nëse deklarata mund të parashtrijet në mënyra tjera më të përshtatshme. Mosrespektimi i detyrimit të bashkëpunimit të përgjithshëm apo të posaçëm vlerësohet nga organi publik, së bashku me të gjitha rrethanat

përkatëse të çështjes dhe nuk përjashton organin publik nga detyrimi për shqyrtimin e fakteve dhe marrjen e një vendimi përfundimtar.

Organi publik, për të përcaktuar gjendjen e fakteve dhe rrethanat e ndërlidhura me çështjen, mund të përdorë çdo mjet prove të paraparë nga ligji për procedurën kontestimore. Faktet tashmë të njohura për organin publik, faktet e njohura botërisht apo faktet e prezumuara me ligj, nuk kanë nevojë të provohen.

Organi publik vlerëson, sipas bindjes së tij, se cilat fakte do të konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ.

Nëse marrja e një prove të nevojshme, mund të bëhet e pamundur ose e vështirë, organi publik, sipas detyrës zyrtare apo sipas kërkesës së arsyetuar të palës, mund të vendosë për sigurimin e provës. Kjo mund të bëhet në cilëndo fazë të procedurës, qoftë edhe para fillimit të saj. Përgjegjësia për të siguruar provat bie në kompetencën e organit publik që udhëheq procedurën administrative. Nëse paraqitja apo marrja e provave të nevojshme nga vetë organi publik është i vështirë, kërkon kohë apo ka kosto më të lartë, ai mund të vendosë, sipas detyrës zyrtare apo sipas kërkesës së palës, që paraqitja apo marrja e provave apo e pjesëve të tyre të bëhet nëpërmjet një organ tjetër publik.

Pala, në çdo fazë të procedurës, ka të drejtë të njihet me dokumentet e dosjes së procedurës administrative dhe të marrë kopje të dokumenteve që gjenden në të. Organi publik, brenda 5 (pesë) ditëve nga paraqitja e kërkesës, duhet të sigurojë në mjediset e tij të punës kushte për njohjen dhe marrjen e kopjeve të dokumenteve. Në raste të veçanta, kur është më e përshtatshme për palën, njohja me dosjen mund të bëhet edhe në mjediset e një organi tjetër publik, apo në përfaqësitë konsullore e diplomatike të Republikës së Kosovës. Kur dokumentacioni administrohet në mënyrë elektronike, organi publik i siguron palës mjetet e nevojshme teknike për njohjen me të. Organi publik mund t'i bëjë dokumentet elektronike të qasshme nëpërmjet internetit, nëse kjo nuk cenon sigurinë e të dhënave të mbrojtura sipas ligjit. Pala ka gjithashtu të drejtën të kërkojë dhe marrë informacion mbi statusin, progresin e procedurës administrative, si dhe për çdo veprim procedural të ndërmarrë nga organi publik gjatë procedurës. Organi publik, për zhvillimin e procedurës, duhet të sigurojë informacion për palën pa vonesë dhe me çdo mjet të përshtatshëm. E drejta e njohjes së dosjes, e marrjes së kopjeve të dokumenteve dhe informacionit, kufizohet vetëm nëse dhe për aq sa dokumenti apo informacioni është mbrojtur sipas legjislacionit për klasifikimin e informatave, përmban të dhëna personale, të dhëna afariste apo të dhëna profesionale të mbrojtura sipas legjislacionit në fuqi.

Pala mund të ndryshojë kërkesën e paraqitur, nëse qëllimi i kërkesës së ndryshuar bazohet në të njëjtën situatë faktike me kërkesën fillestare, apo edhe ta tërheqë plotësisht atë, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga organi publik. Nëse ka palë të tjera në procedurë, ato njoftohen. Pala, në çdo fazë të procedurës, ka të drejtë të paraqesë mendime, shpjegime për faktet, rrethanat apo edhe çështjet ligjore, që kanë të bëjnë me procedurën përkatëse, së bashku me provat e dokumentet përkatëse, në të cilat i mbështet ato si dhe të paraqesë propozime për zgjidhjen e çështjes.

Organi publik para marrjes së vendimit duhet të njoftoj palën për të drejtat e saja, e që përfshijnë, rezultatet e shqyrtimit administrativ, rezultatin e mundshëm të procedurës si dhe informacionin mbi mënyrën e ushtrimit të së drejtës së dëgjimit.

Procedura administrative e filluar sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative, ndërsa procedura administrative e filluar sipas detyrës

zyrtare përfundon sipas diskrecionit të organit publik, përveç nëse është parapa ndryshe me ligj. Ligjdhënësi megjithatë ka parapa edhe afate ligjore për përfundimin e procedurës administrative, kjo gjithsesi do të ndikoj në efikasitetin e kësaj procedure dhe eliminimin e disa procedurave burokratike që kanë ndodh në të kaluarën.

Përveç që ligjdhënësi me nenin 98 par. 1 të LPPA-së, parashih se procedura administrative duhet të përfundoj sa më shpejt që të jetë e mundur, në paragraf 2 të këtij ligji është përcaktuar afati i përgjithshëm i zbatueshëm 45(dyzetepesë) ditë nga fillimi i procedurës. Mirëpo, ligjvënësi në raste të kompleksitetit të çështjes administrative organi publik për shkaqe të arsyetuara mirë, mund të shtyj afatin e paraparë vetëm një herë dhe kjo shtyrje do të bëhet për aq sa është e nevojshme për të përfunduar procedurën administrative por jo ma gjatë se afati fillestar prej 45 ditësh.

Në procedurën administrative akti administrativ mund të miratohet edhe në heshtje në rastet e parapara me ligj e që sipas nenit 100 të LPPA-së, janë specifikuar si në vijim:

Nëse pala ka kërkuar nxjerrjen e një akti administrativ të shkruar dhe organi publik nuk e njofton palën për aktin administrativ brenda afatit fillestar dhe nuk njofton shtyrjen apo nuk njofton për aktin brenda afatit të shtyrë, sipas nenit 98 gjegjësisht 99 të këtij Ligji, kërkesa e bërë nga pala do të vlerësohet e pranuar në tërësi dhe akti administrativ i kërkuar nga pala do të vlerësohet të jetë miratuar. Në rast të një akti administrativ të miratuar në heshtje, pala ka të drejtë të marrë nga organi kompetent një vërtetim me shkrim për përmbajtjen e tij, siç është paraparë në paragrafin 3 të nenit 46 të këtij Ligji. Dispozitat e këtij Ligji për pasojat juridike, ligjshmërinë, shfuqizimin dhe anulimin e akteve administrative, si dhe për mjetet juridike, zbatohen gjithashtu, përshtatshëmrisht edhe për aktin administrativ të miratuar në heshtje.

Procedura administrative përfundon edhe në raste të posaçme nëse; organi publik zbulon se: gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike; ose një procedurë administrative tjetër, nisur sipas një kërkesë tjetër të paraqitur nga e njëjta palë me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike, është ende në proces shqyrtimi dhe e papërfunduar; pastaj vdekja e personit fizik i cili ka çështje kryekëput personale; nëse pjesëmarrja e personit fizik që ka vdekur organi publik e konsideron pjesëmarrjen si palë të domosdoshme, si dhe me tërheqjen e kërkesës së palës.

Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka parapa edhe norma ligjore me të cilat personave të interesuara me kërkesë të tyre që organi publik t'iu lejoj marrjen e vërtetimeve mbi faktet për të cilat organi është ngarkuar nga ligji e që janë kopjet, shkurtimet apo ekstraktet të njësuara me origjinalin, të dokumenteve në administrimin e tij. Gjithashtu në procedurën administrative janë parapa edhe rregullat e përgjithshme të njoftimit respektivisht komunikimit të organit publik me palët. Mes tjerash është parapa se njoftimi, kur personi është i pranishëm, mund të bëhet gojarisht apo në çdo mënyrë tjetër të përshtatshme të komunikimit, njoftimi i një shkrese, kryhet nëpërmjet dërgimit me postë, në mënyrë elektronike apo nëpërmjet njoftimit formal sipas ligji ndërsa përjashtimisht njoftimet e shkurtra dhe urgjente mund të kryhen edhe me telefon.

Në raste e posaçme njoftimi për shtete të huaja, organizatat ndërkombëtare apo personat që gëzojnë imunitet diplomatik, bëhet nëpërmjet ministrisë së punëve të jashtme të Kosovës, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj ndërsa njoftimi për shtetasit e Republikës së Kosovës jashtë vendit, mund të bëhet nëpërmjet dorëzimit personal apo të tërthortë nëpërmjet përfaqësive diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës jashtë shtetit. Përveç kësaj në ligje është rregulluar edhe mënyra e njoftimit përmes postes dhe mjeteve elektronike si dhe njoftimi formal

e që ndryshe quhet edhe dorëzimi personal me karakteristika dhe format detajisht të specifikuar me nenin 118, 119, 120 121,122 dhe 123 të LPPA-së.

1.5 Përmbledhje

Në këtë sesion janë përshkruar aspektet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtën e procedurës administrative. Janë shpjeguar nocioni i të drejtës së procedurës administrative, parimet themelore të Ligjit për Procedurën Administrative, gjithashtu është shpjeguar kompetenca, delegimi i kompetencës, zëvendësimi dhe zgjidhja e konfliktit për kompetencë të organeve të administratës publike gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, si dhe procedura administrative që duhet të zhvilloj organi publik para nxjerrjes së aktit administrativ.

2. Akti administrativ, mjetet juridike dhe ekzekutimi i vendimit

2.1 Hyrje

Gjatë këtij sesioni trajnues do të trajtohet akti administrativ dhe kontrata kolektive, mjete juridike dhe ekzekutimi i vendimit përfundimtar administrativ.

2.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij sesioni trajnues, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Zgjerojnë njohurit lidhur me aktin administrativ e duke përfshi formën dhe strukturën, pastaj paligjshmërinë e tij, anulimin dhe shfuqizimin si dhe kuptimin e kontratës kolektive.
- Thellojnë njohurit për mjetet juridike në procedurën administrative, ankesa efektet e saja dhe procedura e shqyrtimit, pastaj kundërshtimi si dhe rihapjen e procedurës administrative.
- Zbatojnë drejtë procedurën e ekzekutimit të vendimit përfundimtar administrativ.

2.3. Akti administrativ

Akti administrative është çdo manifestim vullneti i një organi publik, që rregullon në mënyrë të njëanshme një marrëdhënie juridike konkrete të së drejtës administrative, me qëllim prodhimin e pasojave juridike. Kësisoj, akti si i tillë iu drejtohet një ose disa personave individualisht të përcaktuar si quhet ndryshe edhe akti administrativ individual ose nëse i përket numrit më të madhe personave gjegjësisht ndryshe me emërtim akt administrativ kolektiv apo nëse i drejtohet një grupi personash, të përcaktuar apo të përcaktueshëm, në bazë të karakteristikave të përgjithshme kemi të bëjmë me akt administrativ i përgjithshëm, apo nëse përcakton statusin sipas të së drejtës administrative të një objekti (sendi) apo të përdorimit të tij nga publiku kemi të bëjmë sipas ligjit me akti administrativ in rem.

- **Forma**

Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, akti administrativ nxirret në formë të shkruar, verbale apo edhe çdo formë tjetër të përshtatshme, përfshirë shenja apo mjete të tjera teknike. Forma e shkruar përmbushet edhe nga një dokument elektronik në pajtim me ligjin e posaçëm që rregullon dokumentin elektronik. Me kërkesë, organi publik konfirmon pa vonesë, në formë të shkruar, përmbajtjen e aktit verbal apo aktit të miratuar në heshtje, pa i paragjykuar rregullat mbi pasojat juridike të akteve administrative.

- **Struktura**

Akti administrativ i shkruar përmban: pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes; pastaj pjesën urdhëruese apo dispozitivin, që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit; arsyetimin si dhe pjesën përmblylëse, që tregon kohën e hyrjes në

fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjete juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe këshillën juridike e në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmblylëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë.

Nëse nuk parashikohet ndryshe me ligj, akti administrativ i shkruar përmban emrin e mbiemrin e shkruar dhe nënshkrimin e nëpunësit përgjegjës gjegjësisht të kryetarit dhe të procesmbajtësit të organit kolegjal. Nëse procesmbajtësi ndodhet në pamundësi për të nënshkruar, në vend të tij nënshkruan një nga anëtarët e organit kolegjal. Kërkesa e nënshkrimit në rastin e një dokumenti elektronik, do të vlerësohet e përmbushur nga një nënshkrim elektronik i kryer në pajtim me ligjin e posaçëm.

Siç u potencua më lart ligjdhënësi ka parapa në parim që çdo akt i shkruar duhet përmbajë arsyetimin kjo për shkake se i njëjti i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. Kështu që ligjdhënësi shprehimisht ka parapa se një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërtshëm apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij, e që ka mjaft rëndësi kur t'i nënshtrohet kontrollit sipas ankesës së rregullt dhe asaj gjyqësore të aktit administrativ. Mirëpo ligji ka parapa edhe përjashtim nga kjo rregull kështu, arsyetimi i aktit të shkruar nuk është i nevojshëm kur: përjashtohet shprehimisht me ligj; akti administrativ i nxjerrë, sipas kërkesës, miraton në tërësi kërkesën e palës kërkuese dhe nuk i cenon të drejtat apo interesat juridike të ndonjë pale të tjetër, ose akti administrativ i nxjerrë, sipas detyrës zyrtare, nuk cenon të drejtat apo interesat juridike të ndonjë pale. Si zakonisht është parapa edhe mundësia e korrigjimit të aktit administrativ për shkak të gabimeve të dukshme e që janë gabimet drejtshkrimore, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të ngjashme.

- ***Paligjshmëria e aktit administrativ***

Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të LPPA-se e që nënkupton se veprimi administrative që cenon apo mundë të cenojë një të drejt apo interes juridik të një personi, duhet të jete i autorizuar me ligj; pastaj organi publik që e nxjerr aktin administrativ ka vepruar pa pasur kompetencë; janë shkelur dispozitat e procedurën administrative gjate nxjerrjes së aktit; është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; ka shkelje të ligjit material; është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme, apo nuk është në pajtim me parimin e proporcionalitetit për të cilin kemi dhënë sqarime më herët.

- ***Anulimi dhe shfuqizimi i aktit administrativ***

Akti administrativ sipas LPPA-së, mundë të anulohet ose të shfuqizohet dhe at nga vet organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin dhe at sipas detyrës zyrtare, pastaj nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj. Sipas interpretimit të ligjit në fjalë anulimi i një akti administrativ ka pasoja në të kaluarën do të thotë vepron retroaktivisht, ndërsa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetëm në të ardhmen. Gjithashtu anulimi dhe

shfuqizimi mundë të jenë të pjesshëm apo të tërësishëm. Gjithashtu ligjdhënësi ka parapa edhe situata kur një akt administrativ detyrimisht duhet anuluar. Kësisoj, një akt administrativ konsiderohet si i paligjshëm dhe duhet anulohet, nëse: është nxjerrë nën shtrëngim, zhvatje, shantazh, mashtrim, kanosje, ryshfet apo nën ndikimin e një veprë tjetër penale; objekti i tij është ligjërish apo materialisht i pamundur, apo nëse zbatimi i aktit do të përbënte vepër penale. Arsyet e anulimit të një akti të tillë është që të vendoset ligjshmëria e çështjes administrative dhe vënja e drejtësisë në vend.

Po ashtu një akt administrativ i ligjshëm mund të anulohet, nën kushtet e parapara me nenin 56 të LPPA-së, kështu me këtë dispozitë ligjore është parapa se një akt i tillë mundë të anulohet vetëm nëse: anulimi është dobiprurës për të gjitha palët apo anulimin është i pjesshëm dhe prek vetëm atë pjesë të aktit që nuk është dobiprurës për palën, apo pala në një akt administrativ që i nënshtrohet një detyrimi, siç është paraparë në paragrafin 4 të nenit 45 të këtij Ligji, nuk e ka plotësuar tërësisht detyrimin plotësues apo nuk e ka bërë këtë brenda afatit të caktuar kohor.

Gjithashtu një akt administrativ i ligjshëm mund të shfuqizohet për shkak të ndryshimit të situatës apo rrethanave faktike ose ligjore apo për shkak të arsyeve tjera të parapara me ligj. Përpos nëse parashihet ndryshe me ligj, një akt administrativ dobiprurës i ligjshëm, mund të shfuqizohet vetëm nëse shfuqizimi është i domosdoshëm për të parandaluar apo eliminuar një dëmtim serioz të jetës dhe shëndetit të njerëzve apo sigurisë publike, dhe kjo nuk do të mund të bëhet në mënyra tjera që do të cenonin më pak të drejtat apo interesat juridike të fituara të palës. Pala përfituese, në rast të shfuqizimit të paraparë më lart, do të ketë të drejtën e kompensimit monetar nëse ka hyrë në marrëdhënie juridiko-civile nga të cilat nuk mund tërhiqet më, apo nga të cilat mund të tërhiqet vetëm duke pësuar dëme, që nuk do të ishte e arsyeshme të kërkohen nga ajo. Masa e kompensimit nuk duhet të tejkalojë interesin e arsyeshëm që ka pala sikur akti i shfuqizuar të vazhdonte të prodhojë pasojat juridike. Pala nuk përfiton kompensim për fitimin e munguar.

- ***Afati për anulimin dhe shfuqizimi***

Anulimi në rastet e parapara e përshkruara më lartë të një akti të paligjshëm nga neni 55 i LPPA-se, si dhe shfuqizimi në rastin e paraparë nga paragrafi 1 i nenit 57 të këtij Ligji, e që konsiston në ndryshimin e situatës apo rrethanave faktike ose ligjore mund të bëhet në çdo kohë. Anulimi apo shfuqizimi, në çdo rast tjetër mund të bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur organi publik kompetent që ka pas autorizime në nxjerrjen e aktit administrativ, njihet me faktet që justifikojnë anulimin apo shfuqizimin, por jo me vonë se pesë (5) vjet nga njoftimi i aktit administrativ. Në rast të anulimit të aktit administrativ të gjitha pagesat apo kontributet, të cilat tashmë janë paguar nga pala apo nga organi publik në bazë të një akti të anuluar, do të kthehen, sipas dispozitave për pasurimin e pabazë sipas legjislacionit civil.

- ***Kontrata administrative***

Kontrata administrative është marrëveshje në të cilën të paktën njëra prej palëve është organ publik i cili e themelon, ndryshon apo shuan një marrëdhënie konkrete juridiko administrative. Lidhja e kësaj kontrate nga organi publik mundet vetëm në rastet e parashikuara shprehimisht me ligj por me këtë nuk cenohen të drejtat apo interesat juridike të palëve të treta. Kontrata lidhet në formën e shkruar e cila nënshkruhet nga palët. Ligji ka parapa që në situata të caktuara kontrata administrative ta zëvendësojë aktin administrativ, me këtë rast organi publik ka të drejtë të lidhë këtë lloj kontrate nëse konsideron se interesi publik mundë të përmbushet më mirë me kontratë se sa me akt administrativ. Po ashtunjë organ publik, mund të lidhë një kontratë kompromisi me personin të cilit do t'i drejtonte një akt administrativ, me qëllim të eliminimit të pasigurive në përmbajtjen e një akti administrativ,

duke u dakorduar të dyja palët, nëse pas vlerësimit të duhur rezulton se situata faktike apo ligjore nuk është e sigurtë dhe qartësimi nuk është objektivisht i mundur. Kontrata e kompromisit përcakton përmbajtjen e aktit administrativ përfundimtar dhe me lidhjen e saj, organi publik nxjerr një akt administrativ, përmbajtja e të cilit përputhet me atë të kontratës të lidhur. Organet publike gjithashtu mund të lidhin ndërmje tyre kontrata administrative për të rregulluar marrëdhëniet e tyre, për kryerjen e veprimtarive në interes të përbashkët.

2.4 Mjetet juridike

Mjetet juridike janë të lejuara në procedurën administrative sikur edhe në procedurat tjera. E drejta administrative ka specifikat e veta në krahasim me procedurat tjera por legjitimimi dhe shkaqet për mjete juridike pothuajse janë të ngjashme me procedurat tjera. Kështu, sipas nenit 124 të LPPA-së, pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim. Anëtari i një organi kolegjal, ka gjithashtu të drejtën të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi procedural të organit kolegjal, nëse pretendon se një nga dispozitat e neneve 37-43 të këtij Ligji janë shkelur nga një veprim apo mosveprim i tillë. Përveç nëse caktohet ndryshe me ligj, mjetet juridike administrative mund të ushtrohen për shkak të paligjshmërisë.

Mjetet juridike administrative, të rregullta, janë: ankesa; kundërshtimi administrativ; ndërsa përjashtimisht mjet juridik administrativ është rihapja e procedurës administrative. Sipas rregullit pala mund t'i ushtrojë vetëm një herë mjetet juridike administrative të rregullta për të njëjtën çështje. Rëndësi të veçantë në procedurën administrative ka shterimi i mjetit juridik përkatës i rregullt administrativ, pasi që është kusht paraprak për ngritjen e padisë në gjykatën kompetente për çështjet administrative.

Përjashtimisht, mund të ngrihet drejtpërdrejt padi në gjykatë, pa qenë i nevojshëm shterimi i mjeteve juridike administrative, në rastet e parashikuara me ligj e që në detaje do të flitet në temën e konfliktit administrativ por tani vetëm po përmendi rastet që LPPA-ja i ka parapa në nenin 124 e që janë nëse; nuk ekziston organi epror; palës së tretë i janë cenuar të drejtat apo interesat juridike nga akti administrativ që zgjidh ankesën, apo parashikohet shprehimisht me ligj.

- **Ankesa**

Është mjet i rregullt juridik e cila përpos nëse është parapa ndryshe me ligj, mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik apo siç quhet ndryshe heshtja administrative në afatin e përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative . Sipas LPPA-së, një veprim procedural i një organi publik gjatë procedurës administrative, mund të ankimohet ndaras, vetëm kur kjo parashihet shprehimisht me ligj.

Po ashtu një veprim procedural, i cekur më lartë do të jetë cilido akt, veprim apo mosveprim i organit publik gjatë procedurës administrative, që nuk është një akt administrativ përfundimtar apo akti administrativ i përfundimit të procedurës administrative, siç është paraparë me nenin 97 të këtij Ligji.

Ankesa në përgjithësi duhet të ketë përmbajtjen dhe formën e caktuar, kështu që njëjtë duhet të përcaktojnë aktin apo heshtjen administrative që ankimohet, shkaqet dhe arsyen pse ankimohet dhe organin publik kompetent për aktin. Çdo kërkesë, edhe në qoftë se nuk shënohet shprehimisht si ankesë, do të konsiderohet e tillë, në qoftë se qëllimi i palës për të kundërshtuar një akt apo heshtjen administrative është mjaftueshëm e qartë.

Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Pala e tretë që nuk ka marrë pjesë në procedurën administrative dhe nuk i është njoftuar akti, mund të parashtrojë ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur ka marrë apo duhej të kishte marrë dijeni për aktin, por jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga xjerrja e aktit. Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashkuar është tre (3) muaj. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ. Ankesa si rregull i parashtrohet organit publik që ka nxjerr apo ka kompetencë të nxjerrë aktin administrativ apo organit publik mbikëqyrës të organit kompetent. Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte nuk është përjashtuar shprehimisht nga ligji; ankuesi ka legjitimitet; ajo është parashtruar brenda afatit të parashkuar me ligj, dhe çfarëdo kushte të tjera të parashkuara shprehimisht në ligj.

- *Efektet e ankesës*

Përveçse kur parashkohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankese pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën. Nëse në aktin administrativ përfshihen dy ose më shumë palë me interesa të njëjta, ankesa e paraqitur nga njëra nga palët, pezullon prodhimin e pasojave juridike të aktit ndaj të gjitha palëve të përfshira. Organi publik, i cili shqyrton ankesën, mund të vendosë me akt administrativ, ndalimin e efektit pezullues të tij, nëse vonesa në ekzekutimin e tij mund t'i shkaktojë një dëm të menjëhershëm dhe të riparueshëm interesit publik apo një pale të tretë. Pala mund të paraqesë ankesë kundër vendimit për ndalimin e efektit pezullues në gjykatën kompetente për konfliktet administrative, brenda pesë (5) ditëve nga njoftimi i tij.

Gjykata merr vendim brenda pesë (5) ditëve dhe vendosë prishjen e vendimit për shkak të mosekzistencës së kushteve të parapara në ligj, apo për shkak të disproporcionalitetit të ndalimit të efektit pezullues.

- *Procedura e shqyrtimit*

Ankesa kundër një akti administrativ do të shqyrtohet, në radhë të parë nga organi kompetent publik. Organi kompetent publik fillimisht do të shqyrtojë nëse ankesa është e pranueshme dhe, vetëm nëse ankesa është e pranueshme, do të shqyrtojë ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e aktit administrativ. Nëse është e nevojshme, organi kompetent publik mund të kryejë shqyrtime administrative shtesë. Nëse anulimi apo ndryshimi i aktit administrativ të ankimuar apo nxjerrja e aktit të refuzuar do t'i shkaktojnë dëm një pale tjetër, organi kompetent duhet t'i japë asaj mundësinë për t'u dëgjuar, në pajtim me nenin 95 të këtij Ligji, përpara marrjes së vendimit për ankesën e paraqitur. Kur organi publik kompetent vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar plotësisht, me një akt të ri administrativ do të anulohet apo ndryshohet aktin e ankimuar, gjegjësisht do të lëshohet aktin e refuzuar, siç është kërkuar nga pala. Kur organi kompetent vlerëson se ankesa nuk është plotësisht e pranueshme dhe e bazuar, pa vonesë dhe pa u shprehur mbi të, do të përcjellë ankesën te organi epror, së bashku me të gjitha dokumentet përkatëse dhe një raport me shkrim të qëndrimit të saj.

Organi epror do të shqyrtojë ankesën dhe, nëse është e nevojshme, do të zhvillojë shqyrtime shtesë, apo do të urdhërojë organin kompetent që të zhvillojë shqyrtime të tilla dhe të njoftojë për to. Po ashtu organi epror, me akt administrativ, do të refuzojë ankesën nëse ankesa është e papranueshme, apo është e pabazuar, në pikëpamjen e ligjshmërisë apo përshtatshmërisë. Nëse organi epror vlerëson se pjesa urdhëruese (dispozitivi) i aktit të ankimuar është i ligjshëm, por

arsyet e dhëna janë të tjera nga ato që i ka dhënë organi kompetent publik në aktin e ankimuar, apo vlerëson se arsyetimi i tij nuk është i plotë, ai do të refuzojë ankesën dhe do të paraqes arsyetimin e ri, gjegjësisht do ta plotësojë arsyetimin aktit të ankimuar. Nëse organi epror vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar, ai duhet të vendosë përfundimisht me një akt të ri që të anulojë apo ndryshojë, plotësisht apo pjesërisht, aktin e ankimuar, gjegjësisht do të nxjerrë aktin e kërkuar nga pala. Nëse është e nevojshme, organi epror mund të urdhërojë organin kompetent që të formulojë aktin që do të nxirret nga organi epror, bazuar në udhëzimet e këtij të fundit. Ankesa nuk do të përkeqësoj situatën juridike në dëm të palës që ka paraqitur ankesë, përpos nëse shprehimisht është paraparë ndryshe me ligj.

Ankesa kundër heshtjes administrative shqyrtohet drejtpërdrejt nga organi epror. Organi epror i kërkon menjëherë organit kompetent, që pa vonesë të paraqesë të gjithë lëndën e rastit dhe një raport me shkrim mbi arsyet e heshtjes administrative. Organi epror fillimisht do të shqyrtojë nëse ankesa është e pranueshme dhe, vetëm nëse ankesa është e pranueshme, do të shqyrtojë kërkesën e palës, siç i është parashtruar organit kompetent. Organi epror do të vendosë mbi kërkesën në bazë të lëndës së rastit, apo nëse është e nevojshme do të zhvillojë shqyrtime administrative shtesë, apo do të urdhërojë organin kompetent që të zhvillojë shqyrtime administrative të tilla dhe ta njoftojë për rezultatet e shqyrtimit. Përpos kur është e paraparë ndryshe me ligj, organi epror do të zgjidhë çështjen me një akt të vetin përfundimtar. Përpos kur ligji parasheh një afat të ndryshëm, akti administrativ që zgjidh ankesën do të nxirret dhe njoftohet palës brenda tridhjetë (30) ditëve nga parashtrimi i ankesës.

- Kundërshtimi administrativ

Kundërshtimi parashtrohet kundër një akti real apo kundër moskryerjes të një akti real të kërkuar nga pala. Pala, në kundërshtimin administrativ, mund të kërkojë: ndërprerjen e zbatimit të një akti real; tërheqjen dhe korrigjimin e një deklarate publike; deklarimin e paligjshmërisë së një akti real dhe eliminimin e pasojave të tij; kryerjen e një akti real, të cilin pala ka të drejtë dhe për të cilin ka aplikuar pa

sukses. Përveç kur parashikohet ndryshe me ligj, kundërshtimi administrativ i një anëtari të organit kolegjal, sipas paragrafit 1 të nenit 124 të këtij Ligji, ka për qëllim deklarimin e paligjshmërisë së veprimit apo mosveprimit procedural dhe mund të shtrihet edhe në kërkimin e një ndalimi për të përsëritur në të ardhmen të njëjtin veprim apo mosveprim, nëse ekziston një rrezik i tillë. Parashtrimi i kundërshtimit, sipas këtij paragrafi, nuk pezullon procedurën administrative gjatë të cilës ka ndodhur veprimi apo mosveprimi i kundërshtuar, si dhe nuk ndikon në ligjshmërinë e aktit administrativ të nxjerrë nga organi kolegjal, si rezultat i kësaj procedure administrative. Një palë në kundërshtimin administrativ në lidhje me një shërbim publik të interesit të përgjithshëm, mund të kërkojë që organi publik rregullator të ushtrojë autoritetin e vet mbikëqyrës mbi ofruesin e shërbimit publik, në mënyrë që të sigurohet që pala ankuese do të përfitojë shërbimin në të cilin ka të drejtë dhe se ofruesi i shërbimit do të plotësojë detyrimet në pajtim me ligjin.

Kundërshtimi administrativ në rastin e një shërbimi publik të interesit të përgjithshëm lejohet vetëm kur, sipas të drejtës administrative, për çështjen e kontestuar nuk ekzistojnë mjetet të tjera juridike kundër ofruesit të shërbimit publik. Forma dhe përmbajtja e kundërshtimit administrativ është e njëjt sikur te ankesa. Kundërshtimi mund të parashtrohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita kur pala është njohur me aktin real të kundërshtuar, por jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga kryerja e tij, gjegjësisht brenda dy (2) muajve nga parashtrimi i kërkesës për kryerjen e një akti real, në rast të mosveprimit nga organi publik.

- *Rihapja e procedurës*

Rihapja ose rishikimi i procedurës administrative siç njihet me termin e përgjithshëm është institut i paraparë me dispozitën e nenit 140 të LPPA-së, me këtë rast pala mund të kërkojë rihapjen e procedurës administrative, nëse pas kalimit të afatit për ankesën është njohur me ekzistencën e njërit prej këtyre shkaqeve: situata faktike apo ligjore mbi të cilin bazohet lëshimi i aktit administrativ të kundërshtuar, ka ndryshuar në të mirë të palës; janë zbuluar prova të reja, të cilat, po të kishin qenë të ditura në kohën e vendimmarrjes, mund të kishin ndikuar në lëshimin e aktit të administrativ të kundërshtuar; pas lëshimit të aktit, ka ndryshuar praktika administrative për çështje të njëjta apo të ngjashme administrative. Pala nuk ka të drejtë të kërkojë rihapjen e procedurës administrative, nëse mosnjohja e shkaqeve të cekura i detyrohet neglizhencës të saj.

Kërkesa për rihapjen e procedurës administrative mund të paraqitet brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga data kur pala ka marrë dënimin për shkakun e rihapjes, por jo më vonë se tre (3) vite nga njoftimi i aktit. Kërkesa për rihapjen e procedurës administrative i adresohet dhe shqyrtohet nga organi publik kompetent për aktin. Dispozitat e këtij Ligji mbi formën dhe përmbajtjen e ankesës, do të zbatohen, përshtatshmërisht edhe për kërkesën për rihapjen e procedurës administrative.

Organi publik kompetent për aktin, nëse pas shqyrtimit të kërkesës për rihapjen e procedurës administrative, vlerëson që, po të merrej në konsideratë shkakun e rihapjes, akti administrativ do të kishte qenë i paligjshëm apo i papërshtatshëm, ai anulon apo ndryshon aktin, gjegjësisht nxjerr aktin e refuzuar. Në rast të kundërt, refuzon kërkesën për rihapje. Vendimi i marrë sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të kundërshtohet drejtpërdrejt në gjykatën kompetente për shqyrtimin e konflikteve administrative.

2.4 Ekzekutimi i vendimit përfundimtar administrativ

Pjesa e rëndësishme e procedurës administrative është ekzekutimi i akteve administrative. Nga praktika e ekzekutimit të akteve administrative është njohur se shume akte janë të vet ekzekutueshme dhe nuk kërkojnë imponim apo detyrim. Aktet që nuk sjellin dobi ose favore për personat fizik dhe juridik, por të kundërtën, që përmbajnë urdhra për ta, duke prekur në të drejtat, lirit dhe interesat e tyre, nuk mund të jetë e pritshme që të zbatohen me vullnetin e tyre. Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative 05/L-031 ka parapa pjesë të veçanta për ekzekutimin e aktit administrativ. Kësisoj, ka parapa procedura lidhur me: ekzekutuesmerin e aktit; subjektet, kohën dhe organin kompetent; procedurën, urdhrin e ekzekutimit, ekzekutimin e detyrimeve jo financiarë nëpërmjet personit të tret dhe gjobave shtrënguese, me force, të menjëhershëm; ndaljen dhe pezullimin e ekzekutimit pasojat si dhe mjetet juridike administrative ndaj veprimeve të ekzekutimit.

Në kuptimin e përgjithshëm neni 143 të LPPA-së, përcakton se akti administrativ, që detyron një palë të paguajë një shumë të caktuar të parave -detyrim financiar, të kryej apo të ndalojë kryerjen e një veprimi të caktuar – detyrim jofinanciar që nuk ekzekutohet vullnetarisht nga pala e detyruar, do të ekzekutohet sipas dispozitave të këtij ligji.

Organi publik nuk do të ndërmarrë asnjë veprim ekzekutimi që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, pa lëshuar paraprakisht një akt administrativ, që është i bërë i ekzekutueshëm, përveç rastit të siç parashihet në nenin 153 të këtij Ligji.

Ekzekutimi i aktit administrativ, nëse është e mundur, realizohet me procedurën dhe me mjetet e ekzekutimit, të cilat sigurojnë ekzekutimin e detyrimit, ndërsa shkaktojnë cenimin më të vogël të mundshëm ndaj të drejtave dhe interesave juridike të subjektit, ndaj të cilit kryhet ekzekutimi.

Akti administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: skadimin e afatit për ankesën kundër tij, nëse një ankesë e tillë nuk është parashtruar; njoftimin e palës, me aktin, kur sipas ligjit, nuk lejohet ankesa; njoftimin e palës me aktin, kur, sipas ligjit, ankesa nuk ka efekt pezullues njoftimin e palës me aktin e ndalimit të efektit pezullues të ankesës, në pajtim me paragrafin 3 të nenit 130 të këtij Ligji, apo njoftimin e palës për refuzimin e ankesës. Akti i zgjidhjes së ankesës që ndryshon një akt administrativ të ankimuar, bëhet i ekzekutueshëm me njoftimin e palës.

Akti administrativ nuk mund të ekzekutohet nëse kanë kaluar pesë (5) vite nga koha kur akti administrativ është bërë i ekzekutueshëm dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim ekzekutimi, apo kanë kaluar 3 (tre) vite nga veprimi i fundit për ekzekutimin. Ekzekutimi kryhet ndaj personit që duhet të përmbushë detyrimin sipas aktit administrativ, apo ndaj pasuesve të tij ligjorë kur detyrimi nuk është kryekëput personal. Ekzekutimi i një akti administrativ kryhet ditëve të punës, prej orës 8.00 deri në 20:00, ndërsa në ditët e festave publike dhe zyrtare, si dhe zbatimi prej orës 20:00 – 08:00, mund të kryhet vetëm në rast urgjence, me një urdhër të shkruar dhe mirëfilli të arsyetuar nga organi që kryen ekzekutimin.

Ekzekutimi i aktit administrativ kryhet nga organi publik kompetent që ka nxjerrë aktin administrativ, qoftë edhe nëse akti mund të jetë ndryshuar apo zëvendësuar nga vendimi për zgjidhjen e ankesës apo nga gjykata kompetente për konfliktet administrative. Ekzekutimi i detyrimeve financiare që burojnë nga aktet administrative të organeve të administratës shtetërore, është në kompetencën e Administratës Tatimore. Ndërsa institucionet dhe Agjencitë e Pavarura, të themeluara sipas Kushtetutës, me marrëveshje, mund t'i delegojnë Administratës Tatimore kompetencën për ekzekutimin e detyrimeve financiare që burojnë nga aktet e tyre administrative.

Para ekzekutimit sipas LPPA-së, organi kompetent për ekzekutimin nxjerr paraprakisht një urdhër ekzekutimi, i cili duhet të përshkruajë procedurën, mjetet, kohën dhe vendin e ekzekutimit. Urdhri gjithashtu mund të përcaktojë një afat për zbatimin vullnetar të detyrimit, apo të përcaktojë ekzekutimin e menjëhershëm të tij. Nëse një detyrim jofinanciar që ekzekutohet konsiston në një veprim të një natyre të tillë, që mund të kryhet edhe nga një person i tretë, organi publik kompetent për ekzekutimin mund ta ekzekutojë vetë veprimin e detyruar, apo të ngarkojë një person të tretë për kryerjen e veprimit të detyruar, po ashtu ligji ka parapa se, nëse ekzekutimi i një detyrimi jofinanciar përmes një personi të tretë, siç është paraparë më lartë, nuk është i mundur apo i përshtatshëm, organi kompetent për ekzekutimin, do të vendosë ndaj subjektit të ekzekutimit një gjobë detyruese për çdo ditë të vonesës në ekzekutim. Po ashtu ligji ka parapa edhe përdorimin e forcës të drejtpërdrejtë për ekzekutimin e një akti administrativ, i cili është i lejuar vetëm për ekzekutimin e detyrimeve jofinanciare që nuk mund të ekzekutohen nëpërmjet një personi të tretë, dhe vetëm nëse qëllimi i ekzekutimit nuk mund të arrihet ekskluzivisht nëpërmjet mjeteve respektivisht metodës së përshkruar me herët.

Ekzekutimi i menjëhershëm është parapa ne situata të caktuara të paraparë me nenin 154 të LPPA-së, dhe at për shkak të, urgjencës së jashtëzakonshme akti administrativ që përmban një detyrim jo-financiar nuk mund të nxirret në kohën e nevojshme, dhe është e nevojshme marrja e një mase urgjente për të siguruar rendin dhe sigurinë publike, apo për të shmangur kërcënime a rreziqe të menjëhershme për jetën, shëndetin apo pronën e personave.

Ekzekutimi i një akti administrativ ndalet, sipas detyrës zyrtare apo sipas kërkesës, nëse konstatohet se: detyrimi tashmë është përmbushur tërësisht; akti administrativ që ekzekutohet, është anuluar apo shfuqizuar; ekzekutimi është kryer ndaj një subjekti, që nuk ngarkohej nga detyrimet, apo sipas ligjit, ekzekutimi nuk lejohej të kryhej.

- *Mjetet juridike administrative në procedurën e ekzekutimit*

Në procedurën e ekzekutimit të vendimit administrativ janë parapa mjetet juridike. Kësisoj, neni 156 i LPPA-së, i ka parapa edhe mjetet juridike të cilat palët mundë t'i parashtrojnë gjatë kësaj procedure. Pa cenuar të drejtën e palës për t'u ankuar ndaj aktit administrativ që ekzekutohet, pala mund të parashtrojë një ankesë kundër urdhrit të ekzekutimit. Ankesa mund të parashtrohet vetëm lidhur me pretendimet ndaj vendit, kohës dhe mjeteve të ekzekutimit dhe parashtrimi i saj nuk pezullon vazhdimin e ekzekutimit. Ankesa shqyrtohet drejtpërdrejt nga organi epror i organit që është kompetent për ekzekutimin, brenda pesë (5) ditëve nga parashtrimi i saj. Pala, gjithashtu mund të parashtrojë një kundërshtim administrativ kundër veprimeve të ekzekutimit, nëse ato tejkalojnë pjesën e detyrueshme të aktit që ekzekutohet, apo kur pretendohet të jenë të paligjshme. Kundërshtimi administrativ gjithashtu shqyrtohet brenda pesë (5) ditëve nga parashtrimi, drejtpërdrejt nga organi epror i organit kompetent për ekzekutimin dhe parashtrimi i tij nuk pezullon vazhdimin e ekzekutimi.

2.5 Përmbledhje

Në këtë sesion është bërë një përmbledhje e aspekteve të përgjithshme të aktit administrativ siç është forma dhe përmbajtja posaçërisht arsyet të cilat duhet t'i përmbaj një akt administrativ. Pastaj, mjetet juridike në procedurën administrative, ankesa dhe efektet e saja procedura e shqyrtimit, kundërshtimi dhe rihapja e procedurës si dhe procedura e ekzekutimit të vendimit përfundimtar administrativ dhe mjetet juridike të lejueshme sipas LPPA-së, në këtë procedurë.

3. Nocioni akti palët dhe kompetenca në konfliktin administrativ

3.1 Hyrje

Në këtë sesion trajnim do të trajtohet konflikti administrativ, akti administrativ ndaj të cilit zhvillohet konflikt administrativ dhe palët dhe kompetenca e gjykatës.

3.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij sesioni pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Njohin nocionet dhe institucionet themelore të procedurës së konfliktit administrativ;
- Dallojnë nocionet dhe institucionet themelore të konfliktit administrativ në mes veti por edhe të bëjnë krahasimin dhe ti dallojnë në procedurat tjera gjyqësore;
- Zgjerojnë njohurit lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me kompetencën e gjykatave për zgjidhjen e konfliktit administrativ.

3.3 Konflikti administrativ - nocioni

Konflikti administrativ lind si rrjedhojë e marrëdhënieve juridike administrative në rastin kur me aktin administrativ përfundimtar të organit shtetëror, është shkelur ligji në dëm të personit fizik apo personit juridik.

Me aktin administrativ përfundimtar pala e pakënaqur kundër vendimit përfundimtar, nuk mund të përdor mjete të rregullta juridike atëherë lind konflikti midis palës dhe organit të cilin e ka nxjerr aktin administrativ përfundimtar. Ky konflikt lind si rrjedhojë e ligjshmërisë së aktit përfundimtar me të cilin organi shtetëror vendos mbi të drejtën, detyrimin ose interesin juridik të personit fizik apo juridik. Procedura e konfliktit administrativ është e rregulluar me ligjin nr. 03/L-202 i miratuar nga Parlamenti i Kosovës me dt. 17. shtator 2010. Me këtë ligj rregullohen kompetenca, përbërja e gjykatës dhe rregullat e procedurës, në bazë të të cilave gjykatat kompetente vendosin për ligjshmërinë e akteve administrative me të cilat organet kompetente të administratës publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizik dhe juridik dhe të palëve tjera, si dhe për ligjshmërinë e veprimeve të organeve administrative.

Qëllimi i këtij ligji për konfliktet administrative është sigurimi i mbrojtjes gjyqësore të të drejtave dhe interesave juridike të personave fizik, juridik dhe palëve të tjera të cilat të drejta dhe interesa janë cenuar me vendime individuale ose me veprime të organeve të administratës publike.

Parimet themelore të Ligjit për Konflikte Administrative janë: Parimi i ligjshmërisë për çka gjykata është kompetente të vendos në bazë të kushtetutës dhe ligjeve.

Parimi i deklarimit të palës: Para nxjerrjes së aktgjykimit gjykata është e obliguar që ti jap mundësinë e deklarimit secilës palë, mbi të gjitha kërkesat dhe pretendimet e palëve të tjera dhe mbi të gjitha faktet dhe çështjet juridike që janë objekt i shqyrtimit në konfliktin administrativ. Gjykata mund të vendos lidhur me çështjen e konfliktit administrativ pa dhënien e mundësisë palës për tu deklaruar, vetëm në ato raste kur ligji e ka paraparë një gjë të tillë.

Parimi i shqyrtimit verbal në procedurën gjatë shqyrtimit të kërkesës lidhur me konfliktin administrativ gjykata vendos në bazë të shqyrtimit verbal të drejtpërdrejt dhe publik. Që do të thotë se gjykata duhet të vendos në formë transparente gjatë gjithë procedurës përveç në ato raste kur ligji e ka paraparë që të vendos me seancë të mbyllur.

Parimi i efikasitetit gjykata me rastin e inicimit të konfliktit administrativ nga ana e palës është e obliguar që sa më shpejtë dhe pa zvarritje ta zhvillojë procedurën e konfliktit administrativ duke iu shmangur veprimeve dhe shpenzimeve të panevojshme, me çka e pamundëson keqpërdorimin dhe zvarritjen e realizimit të drejtave të palëve, të pjesëmarrësve të tjerë në konflikt administrativ duke i nxjerr në afat të parashikuar vendimin.

Parimi i ndihmës së palës së painformuar gjykata gjatë procedurës lidhur me konfliktin administrativ kujdeset që mos informimi i palës dhe pjesëmarrësve të tjerë në konflikt administrativ, të mos jetë në dëm të drejtave të cilat i kanë në bazë të ligjit.

- *Konflikti administrativ në kuptimin formal dhe material*

Në teorinë juridike nuk ekzistojnë pikëpamje unike lidhur me përkufizimin e nocionit të konfliktit administrativ, andaj edhe dallohen:

1. Nocioni formal
2. Nocioni material

Konflikti administrativ në kuptim formal përkufizohet me ndihmën e karakteristikave të jashtme formale, organizative. Edhe për përkufizimin e konfliktit administrativ ekzistojnë pikëpamje të ndryshme. Sipas një pikëpamje nocionin e konfliktit administrativ e lidh me natyrën e organeve të cilat i zgjidhin konfliktet administrative, konflikt administrativ do të ishte ai konflikt të cilin e zgjidhin gjykata e veçanta administrative. Sipas një pikëpamje tjetër, përkufizimin e konfliktit administrativ e lidh me veçorinë e procedurës në bazë të së cilës zgjidhen konfliktet administrative, konflikt administrativ është ai konflikt i cili zgjidhet sipas procedurës së veçantë që quhet procedurë administrative gjyqësore.

Konflikti administrativ në kuptim material përcaktohet me ndihmën e karakteristikave esenciale, përmbajtjesore. Konflikti administrativ është ai konflikt në të cilin njëra palë, qoftë në cilësinë e paditësit, qoftë të paditurit, është administrata, apo konflikt administrativ është atëherë kur objekt të konfliktit paraqitet çështja nga e drejta administrative. Objekt i konfliktit administrativ është çështja e ligjshmërisë së aktit administrativ, përkatësisht çështja e arsyeshmërisë së heshtjes administrative. Konflikti administrativ përkufizohet si lloj kontrolli gjyqësor mbi ligjshmërinë e aktit administrativ të përfunduar, apo të nxjerrë nga organi administrativ i cili ushtron autorizime publike, gjersa personi apo pala të cilit i përket ai akt administrativ, e konsideron si të paligjshëm ngase i njëjti konsideron se me këtë akt administrativ i është shkelë ndonjë e drejtë ose interes juridik. Ky konflikt zhvillohet rreth ligjshmërisë së aktit administrativ, tek gjykata kompetente në procedurën e veçantë, e ashtuquajtur procedurë administrative gjyqësore e cila është rregulluar me Ligjin për Konfliktet Administrative.

- *Objekti i konfliktit administrativ-akti administrativ*

Në bazë të ligjit për konfliktin administrativ, konflikti administrativ mund të iniciohet vetëm kundër aktit administrativ të nxjerr në procedurën administrative në shkallë të dytë. Konflikti

administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative, nuk është lejuar ankesa. Gjithashtu konflikti administrativ mund të filloj edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës ose ankesës së palës nën kushtet e parapara me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Konflikti administrativ mund të zhvillohet vetëm kundër aktit administrativ, prandaj objekt i konfliktit administrativ është çështja e ligjshmërisë së aktit administrativ i cili atakohet me padi. Andaj, objekt i konfliktit administrativ sipas ligjit për konfliktin administrativ është akti individual administrativ përfundimtar në procedurën administrative (kundër të cilit nuk mund të ushtrohet mjet i rregullt juridik-ankesa), që do të thotë se konflikti administrativ mund të fillohet kundër aktit administrativ të nxjerrë në shkallë të dytë. Mirëpo konflikti siç u cek edhe më lartë mund të filloj edhe kundër aktit administrativ të organit të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurë administrative nuk është e lejuar ankesa. Objekt i kontrollit apo shqyrtimit gjyqësor nuk mund të jenë ato pjesë të aktit administrativ në të cilat organi i administratës shtetërore mund të ushtroj çmuarjen e lirë por vetëm ato pjesë të lidhura të aktit diskrecional.

3.4 Akti administrativ ndaj të cilit zhvillohet konflikti administrativ

Akti administrativ që të mund të jetë objekt i konfliktit administrativ, duhet ti përmbajë disa karakteristika të caktuara dhe ti plotësoj disa kushte të caktuara:

1. Akti administrativ duhet të jetë akt i nxjerrësit të autorizuar, do me thënë të jetë nxjerr nga organi shtetëror ose nga një organ që ushtron autorizime publike në bazë të ligjit.
2. Akti administrativ duhet të vendoset për ndonjë të drejtë apo caktim të ndonjë detyrimi personit të caktuar fizik apo juridik.
3. Akti administrativ duhet të jetë nxjerrë për një çështje administrative, të jetë vendosë mbi ndonjë të drejtë, detyrim ose interes juridik të palës së caktuar.
4. Akti administrativ duhet të jetë konkret dhe individual-akt me të cilin vendoset në rastin e caktuar mbi të drejtat dhe detyrimet ose interesat juridik të subjektit të caktuar juridik dhe
5. Akti administrativ duhet të jetë përfundimtar në procedurën administrative, ndaj të cilit nuk mund të ushtrohet mjeti i rregullt juridik-ankesa.

Të gjitha këto kushte të cituara më lartë duhen të plotësohen kumulativisht me rastin e nxjerrjes së aktit administrativ. Për shkak të mungesës së ndonjëres nga këto kushte, akti administrativ është i mangët.

- *Shkaqet e kundërshtimit të aktit administrativ*

Akti administrativ mund të kundërshtohet për dy shkaqe dhe atë: Për shkaqet formale juridike dhe shkaqet materiale juridike:

Shkaqet formale juridike për të cilat mund të atakohet akti administrativ janë:

1. Nëse akti administrativ është nxjerr nga organi jo kompetent
- 2 Për shkak se në procedurën që i ka paraprirë nxjerrjes së aktit nuk është vepruar sipas dispozitave të procedurës.

3. Për shkak se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.
4. Për shkak se nga faktet e vërtetuara është nxjerrë përfundimi i gabuar, jo i drejtë përkitazi me gjendjen faktike.

Shkaqet juridiko-materiale për të cilat mund të kundërshtohet akti administrativ janë:

1. Me rastin e nxjerrjes së aktit administrativ nuk është aplikuar fare ose nuk është aplikuar drejt ligji, dispozita e bazuar në ligj.
2. Me rastin e nxjerrjes së aktit administrativ, organi për realizimin e qëllimit tjetër e jo për qëllimin i cili buron nga ligji.

- *Aktet administrative ndaj të cilave nuk mundë te zhvillohet konflikt administrative*

Sipas Ligjit për Konfliktin Administrativ nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ kundër akteve të nxjerra në çështjet, në të cilat është siguruar mbrojtja gjyqësore jashtë konfliktit administrativ. Do me thënë nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ kundër atyre akteve administrative të cilave iu është siguruar mbrojtja gjyqësore. Konflikti administrativ nuk mund të zhvillohet kundër akteve të nxjerra në çështjet rreth të cilave, sipas dispozitës së ligjit nuk mund të zhvillohet konflikt administrativ. Gjithashtu konflikti administrativ nuk mund të zhvillohet kundër akteve administrative që përbëjnë një detyrim të përgjithshëm të nxjerra nga organet e administratës, përveç kur ato cenojnë të drejtat e ligjshme të palëve.

- *Heshtja e administratës*

Konflikti administrativ mund të iniciohet edhe me rastin e heshtjes së organit administrativ, ngase shpesh ndodh që organet administrative nuk vendosin lidhur me kërkesën apo ankesën e palës në afatin e paraparë ligjor, andaj për këtë mos veprim të organit administrativ ligji e ka përcaktuar si heshtje administrative. Ligji i procedurës administrative e ka paraparë se me rastin e mosveprimit të organit administrativ lidhur me kërkesën apo ankesën e palës në afat ligjor, konsideron se organi ligjor ka marrë aktvendim negativ lidhur me kërkesën apo ankesën e palës. Pasi që të jetë përfunduar afatet ligjore lidhur me kërkesën përkatësisht ankesën e palës, pala e pakënaqur mund të ushtroj padi në gjykatën kompetente gjegjësisht në Gjykatën Themelore-në Departamentin për çështje Administrative. Ky institut i heshtjes administrative është përcaktuar me ligj me qëllim të mbrojtjes së palëve nga mosveprimi i organeve administrative dhe si pasojë e mosveprimit të organeve administrative, pala të ketë mundësi të inicioj konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente.

3.5 Palët dhe kompetenca në konflikt administrativ

Ligji për Konflikt Administrativ ka përcaktuar saktë se kush mund të jetë palë në konflikt administrativ, ashtu që palë në konflikt administrativ janë:

1. Padiçesi
2. I padituri
3. Personi i interesuar

Padiçesi në konflikt administrativ është personi fizik, juridik, avokati i popullit, shoqatat dhe organizatat tjera që janë të legjitimuara për ngritjen e padisë me të cilën goditet ligjshmëria e aktit administrativ i nxjerrë nga organi administrativ. Padiçes në konfliktin administrativ mund të

jetë subjekti që ka legjitimitet për iniciimin e konfliktit administrativ. Pra konfliktin administrativ mund ta iniciojnë vetëm personat e autorizuar me ligj për iniciimin e konfliktit administrativ. Padi të në konfliktin administrativ mund të jetë personi të cilit i është shkëllur ndonjë e drejtë ose interes juridik me aktin administrativ të organit shtetëror.

- *Pala e paditur në konflikt administrativ*

Pala e paditur në konflikt administrativ është organi shtetëror, përkatësisht organizata që ushtron autorizime publike. Meqenëse konflikti administrativ iniciohet kundër aktit administrativ përfundimtar, përkatësisht heshtjes përfundimtare të administratës ana e paditur është organi i cili ka nxjerr aktin administrativ i cili akt është akt përfundimtar në procedurën administrative, gjegjësisht organi i cili brenda afatit nuk e ka nxjerr aktin administrativ (heshtja e administratës). Akt administrativ përfundimtar sipas Ligjit të Procedurës Administrative është ai akt që është nxjerrë në shkallë të dytë dhe se kundër këtij akti administrativ nuk lejohet mjet i rregullt juridik-ankesa. Konflikti administrativ mund të iniciohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë. Mirëpo kundër këtij akti administrativ nuk është i lejuar mjeti juridik-ankesa. Konflikti administrativ mund të iniciohet edhe me rastin e heshtjes administrative. Që do të thotë se pas përfundimit të afateve ligjore të heshtjes administrative, pala mund të inicioj konflikt administrativ për shkak të heshtjes së administratës.

Personi i interesuar është personi i tretë të cilit me rastin e anulimit të aktit administrativ do të cenonte ndonjë të drejtë apo do të shkaktonte ndonjë dëm të drejtpërdrejt personal. Andaj për këtë arsye ky person mund të paraqitet në gjykatë si palë e interesuar lidhur me fatin e aktit administrativ.

- *Kompetenca e gjykatës*

Konflikti administrativ si procedurë e veçantë gjyqësore mund të iniciohet pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje Administrative, këtë kompetencë e ka përcaktuar ligji për gjykatat nr. 03/L-199, i miratuar nga Parlamenti i Kosovës. Neni 14 i këtij ligji ka përcaktuar se Departamenti për çështje Administrative i Gjykatës Themelore gjykon dhe vendos në konfliktet administrative sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe për çështje tjera të përcaktuara me ligj. Të gjitha çështjet në Departamentin për çështjen Administrative të Gjykatës Themelore gjykohen nga një gjyqtar profesionist, përpos nëse me ligj nuk parashihet ndryshe. Kundër aktgjykimeve të Gjykatës Themelore-Departamenti për çështje Administrative, mund të ushtrohet ankesë dhe se lidhur me ankesën kompetent për me vendosë është Gjykata e Apelit, gjersa me mjete të jashtëzakonshme vendosë Gjykata Supreme e Kosovës si gjykatë e instancës më të lartë gjyqësore në Kosovë.

3.6 Përmbledhje

Në këtë sesion është bërë një përmbledhje rreth institucioneve themelore institucioneve themelore të konfliktit administrativ në mes veti por edhe të bëjnë krahasimin me procedurat tjera gjyqësore si dhe kompetencën e gjykatave për zgjidhje e konfliktit administrativ.

4. Padia dhe seanca e shqyrtimit kryesor në konfliktin administrativ

4.1 Hyrje

Në këtë sesion pjesëmarrësve iu ofrohet njohuri për nocionin e padisë, objektin e padisë, afatin për paraqitjen e padisë, dorëzimin e padisë, përmbajtjen e padisë, heqja dorë nga padia, inicimin e konfliktit administrativ me rastin e heshtjes së administratës si dhe rrjedhën e procedurës sipas padisë, nxjerrjen e aktit tjetër administrativ pas fillimit të konfliktit administrativ si dhe dorëzimin e padisë në përgjigje në padi nga ana e palës së paditur.

4.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij sesiioni pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Zgjerojnë njohuritë rreth padisë, objektin e padisë, mënyrën e paraqitjes së padisë si dhe formën e padisë;
- Zbatojnë drejtë ligjin me rastin e heqjes dorë nga padia si dhe veprimin e padisë në ekzekutimin e aktit administrativ;
- Njohin nxjerrjen e aktit tjetër administrativ pas inicimit të konfliktit administrativ si dhe dorëzimin e padisë në përgjigje në padi nga ana e të paditurit.

4.3 Padia në konfliktin administrativ

Në bazë të Ligjit për Konfliktin Administrativ, procedura inicohet me padi duke atakuar ligjshmërinë e aktit administrativ. Kjo procedurë inicohet sipas parimit të dispozicionit të palës e jo sipas parimit oficiale që do të thotë se padinë e paraqet paditësi për shkak se i njëjti konsideron se me aktin administrativ i është mohuar ndonjë e drejtë apo detyrim. Pa padi nuk ka konflikt administrativ. Në kuptimin formal padia është parashtrësë e hartuar në mënyrë të rregullt, e drejtuar me kohë gjykatës nga ana e personit të legjitimuar për inicimin e konfliktit administrativ duke e atakuar aktin administrativ. Konflikti administrativ mund të inicohet dhe të zhvillohet vetëm kundër aktit administrativ të përfunduar, do të thotë se konflikti administrativ mund të fillohet, kundër akteve administrative të nxjerra në shkallë të dytë sepse këto akte administrative janë përfundimtare në procedurën administrative. Mirëpo konflikti administrativ mund të inicohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër këtij akti administrativ në procedurë administrative ankesa nuk është e lejuar. Konflikti administrativ mund të inicohet edhe me rastin e heshtjes administrative, që do të thotë se palës të cilit organi administrativ nuk i është përgjigjur lidhur me kërkesën apo ankesën e tij në afatin e paraparë me ligj ai mund të iniciojë konflikt administrativ duke atakuar për heshtje administrative të organit administrativ.

Me padi pala mund të kërkojë:

1. Anulimin ose shpalljen e pavlefshme të aktit administrativ;
2. Nxjerrjen e aktit administrativ, i cili akt nuk është nxjerrë në afatin e parashikuar;
3. Kthimi i sendeve të marra dhe kompensimi i dëmit i shkaktuar me ekzekutimin e aktit administrativ të atakuar.

Sipas Ligjit për Konfliktin Administrativ, padia paraqitet brenda afatit prej 30 ditësh, nga data e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtarë palës. Ky afat prej 30 ditësh, aplikohet edhe për organin e autorizuar për paraqitjen e padisë, nëse i është dorëzuar akti administrativ. Nëse akti administrativ nuk i është dorëzuar organit, mund të paraqesë padinë brenda 60 ditësh, nga data e dorëzimit të aktit administrativ palës, në favor të së cilës është nxjerr akti administrativ.

Në bazë të nenit 28 të Ligjit për Konfliktin Administrativ, padia i dorëzohet gjykatës kompetente drejtpërsëdrejti ose i dërgohet me postë rekomande. Padia mund të bëhet edhe në procesverbal në gjykatë. Dita e paraqitjes së padisë në postë rekomande, respektivisht dita e deklarimit të padisë në procesverbal, konsiderohet si ditë kur i është dorëzuar gjykatës.

Nëse padia nuk i është dorëzuar gjykatës por organi tjetër jo kompetent, ndërsa i arrin gjykatës pas skadimit të afatit për paraqitjen e padisë, do të konsiderohet se është paraqitur me kohë, nëse ushtrimi i padisë pranë këtij organi ka qenë si pasojë e mosdijes apo e gabimit të hapur të ushtruesit të padisë. Padiësi duhet t'ia bashkangjes padisë edhe aktin administrativ. Bashkë me padinë i bashkëngjitet edhe nga një kopje e padisë dhe anekset për organin e paditur dhe për çdo person të interesuar.

Sipas dispozitës së nenit 30 të Ligjit për Konfliktin Administrativ, padia është parashtrësë formale e cila duhet të përmbajë:

1. Emërtimi i gjykatës të cilës i paraqitet padia.
2. Emri, mbiemri dhe vendbanimi i padiësit dhe të paditurit.
3. Akti administrativ kundër të cilit është iniciuar padia,
4. Arsyet pse ngrihet padia.
5. Vëllimi i anulimit të aktit administrativ.

Në padi nuk është e domosdoshme që të theksohen dispozitat juridike të cilat janë shkelur, por arsyetimi në padi duhet të jetë i kurtë e jo kontradiktor. Kërkesa e padisë është objekt mbi të cilin gjykata shqyrton dhe vendos. Me një padi mund të atakohet vetëm një akt administrativ dhe me padi kontestohet ligjshmëria e aktit administrativ. Kjo është esenca e konfliktit administrativ. Me rastin e ushtrimit të padisë kolektive ekziston atëherë kur shumë persona me një padi e atakojnë të njëjtin akt administrativ.

Nëse padia nuk e përmban formën e paraparë me Ligjin për Konfliktin Administrativ sipas nenit 30 të po këtij ligji, atëherë gjykata duhet ta zbatojë dispozitën e nenit 33 të Ligjit për Konflikt Administrativ. Kur padia nuk është e plotë e pa kuptueshme ose ka të meta, gjyqtari duhet ta ftoj padiësin që brenda afatit prej 8 ditëve, ti mënjanojë të metat e padisë nga padia jo e plotë dhe e pakuptueshme nuk i ka të gjitha elementet qenësore.

Andaj me ftesë palës padiëse gjykata duhet t'ia cek udhëzimet për të mënjeluar të metat e padisë dhe paralajmërimin për pasojat që do të lindin nëse nuk vepron sipas kërkesës së gjykatës. Nëse padiësi, brenda afatit të përcaktuar me njoftim nuk i eliminon të metat e padisë, gjersa ato të meta janë të atilla që e pamundësojnë zhvillimin e drejtë të procedurës. Gjykata kompetente do ta hedhë poshtë me vendim padinë nëse nuk konstaton se akti administrativ i kontestuar është i pavlefshëm. Gjithashtu gjykata në kuptim të dispozitave të ligjit për konfliktet administrative e hedhë poshtë padinë me vendim nëse konstaton se:

1. Padia është paraqitur pas kalimit të afatit ose është e parakohshme.
2. Akti që kontestohet me padi nuk është akt administrativ.

3. Nga përmbajta e padisë shihet qartë se me aktin administrativ, që kontestohet me padi, nuk preken të drejtat e paditësit ose interesi i tij i drejtpërdrejtë i bazuar në ligj.
4. Kundër aktit administrativ, i cili kontestohet me anë të padisë, mund të bëhet ankimi, kurse ankimi nuk është bërë fare apo nuk është bërë në kohën e duhur.
5. Është fjala për çështjen sipas dispozitës shprehimore të ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ.
6. Ekziston vendimi i formës së prerë, i nxjerr në konfliktin administrativ për të njëjtën çështje.

Paditësi në procedurën e konfliktit administrativ mund të heq dorë nga padia gjithnjë gjersa gjykata të nxjerr vendimin gjyqësor sipas padisë së ushtruar. Po që se paditësi heq dorë nga padia, gjykata me vendim do ta pezulloj procedurën administrative gjyqësore.

Nëse organi administrativ gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore nxjerr aktin tjetër me të cilin revokohet ose shfuqizohet akti administrativ kundër të cilit është iniciuar konflikti administrativ, organi është i detyruar që ta njoftoj gjykatën lidhur me nxjerrjen e aktit administrativ. E në rastin konkret gjykata do ta ftoj paditësin që brenda 15 ditësh, të deklarohej se me aktin administrativ të nxjerr në afatin e mëvonshëm:

- Është i kënaqur
- Nuk heq dorë nga padia
- Pjesërisht heq dorë nga padia
- Padinë e zgjeron edhe në aktin tjetër.

Nëse paditësi deklaron se me aktin e nxjerrë në afatin e mëvonshëm është i kënaqur apo nëse nuk jep deklaratë brenda afatit prej 15 ditësh, gjykata do të nxjerr vendimin mbi pezullimin e procedurës. Nëse paditësi deklaron se me aktin e ri nuk është i kënaqur, gjykata do ta vazhdon procedurën.

4.4 Procedura paraprake në konfliktin administrativ

Nëse gjykata nuk e hedh poshtë padinë në kuptim të nenit 33 par.2 apo nenit 34 të Ligjit për Konfliktet Administrative, atëherë gjykata do t'ia dërgojë nga një kopje të padisë dhe dokumenteve të bashkangjitura në përgjigje, palës së paditur dhe personave të interesuar. Në procedurën e konfliktit administrativ sipas padisë janë të përcaktuara dy faza themelore të procedurës edhe atë:

1. Procedura paraprake sipas padisë
2. Procedura e rregullt sipas padisë.

Procedurën paraprake e karakterizon fakti se në të gjykata nuk shqyrton kërkesëpadinë në mënyrë meritore, por i ndërmerr disa veprime procedurale duke i përmbushur kushtet për fillimin dhe zhvillimin e procedurës në konfliktin administrativ. Në procedurën paraprake gjykata i ndërmerr këto veprime dhe atë:

1. Bënë vlerësimin e përmbajtjes së padisë, nëse padia është e plotë dhe e rregullt. Në këtë drejtim gjykata ka autorizim me padinë të veprojë sikurse me parashtrësat tjera të paraqitura nga palët. Nëse kemi të bëjmë me padi të pakuptueshme dhe jo të plotë. Është kompetencë e gjyqtarit që të kërkoj nga paditësi ta rregulloj padinë duke e udhëzuar si ta përmirësojë padinë dhe njëherit t'ia tërheq vërejtjen për pasojat e mosveprimit.

2. Gjykata bënë vlerësimin e padisë në kuptimin e vlerësimit të afatshmërisë, lejueshmërisë dhe paraqitjes së padisë nga personi i autorizuar. Gjyqtari në këtë fazë të procedurës mund të nxjerr aktvendim për hedhjen e padisë si të parakohshme apo si të pas afatshme. Me aktvendim hedhet padia si e pa lejueshme nëse gjyqtari konstaton se me padi kontestohet akti i cili nuk e ka karakterin e aktit administrativ. Padia hedhet kur kontestohet akti jo përfundimtar. Padia hedhet si e pa lejueshme kur konstatohet se kemi të bëjmë me “Res judicata”.

Pasi që ti ndërmer të gjitha këto veprime gjykata padinë me të gjitha shkresat ia dorëzon në përgjigje në padi të paditurit i cili është i obliguar që në afatin prej 30 ditësh, nga dorëzimi i padisë të përgjigjet lidhur me padinë. Në afatin e caktuar pala e paditur ka për detyrë ti dërgojë gjykatës të gjitha shkresat që kanë të bëjnë me lëndën. Nëse pala e paditur edhe pas kërkesës së dytë nuk i dërgon shkresat e lëndës, apo nëse deklaron se nuk mund ti dërgoj, gjykata do të vendosë për çështjen edhe pa shkresat e lëndës.

4.5 Seanca e shqyrtimit kryesor në konfliktin administrativ

Karakteristikë themelore e seancës së shqyrtimit kryesor në konfliktin administrativ me rastin e vendosjes sipas padisë është se gjykata në këtë fazë të procedurës vendosë lidhur me kërkesëpadinë duke e zgjidh çështjen kontestuese në konfliktin administrativ (ligjshmërinë e aktit administrativ). Pasi që gjykata nuk e ka hedhë poshtë padinë për shkaqe formale ajo cakton seancën e shqyrtimit kryesor fton palët në mënyrë të rregullt për pjesëmarrjen e tyre në seancë. Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor vendos për gjendjen faktike përmes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve jo relevante. Në procedurën e konflikteve administrative gjykata mund të vendos në seancë të mbyllur në rast se mund të zbulohen faktet që kanë të bëjnë me jetën private të palëve, mbi sekretin shtetëror, profesional, tregtar dhe me adoptimin. Nëse ka nevojë ftohen edhe ekspertët lidhur me ndonjë fakt për të cilën gjykata nuk ka dijeni. Në seancë mund të marr pjesë në rast nevojë edhe përkthyesi kur palët nuk kuptojnë gjuhën zyrtare e cila zhvillohet në seancën e shqyrtimit kryesor. Gjykata mund të vendos në çështjen pa shqyrtim verbal, nëse ka fakte të mjaftueshme dhe kur palët kanë dhënë pëlqimin e tyre në formë të shkruar. Gjykata mban seancën e shqyrtimit kryesor publike mirëpo në rast se vendos që të përjashtohet publiku atëherë gjykata është e obliguar që të marr vendim procedural të cilën do t’ia komunikonte palëve. Seancën e shqyrtimit kryesor e udhëheq gjyqtari që e udhëheq çështjen. Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor mbahet procesverbali, në të cilin përfshihen vetëm faktet dhe rrethanat esenciale. Procesverbali përfundon me nënshkrimin e gjyqtarit që ka udhëheqë seancën e shqyrtimit kryesor dhe me nënshkrimin e procesmbajtësit. Mungesa e palës në shqyrtimin verbal nuk e pezullon punën e gjykatës. Për shkak të mungesës së palëve nuk mund të konstatohet se ato nuk kanë hequr dorë nga kërkesat e tyre por do të lexohen parashtresat e tyre. Nëse në shqyrtim nuk vjen as paditësi e as pala e paditur gjersa shqyrtimi nuk shtyhet, gjykata do të shqyrtojë kërkesën për konflikt administrativ edhe pa praninë e palëve.

Gjykata vendosë në seancën e shqyrtimit kryesor në çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative. Nëse gjykata konstaton se konflikti administrativ nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative për shkak se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara ekzistojnë kontradikta në akte, gjë që në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht, e që nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, ose konstaton se në procedurës administrative nuk janë respektuar rregullat e procedurës, që do të kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes, gjykata do ta anulon me aktgjykim aktin e kontestuar administrativ. Në një rast të tillë në rishqyrtim organi kompetent ka për detyrë të veprojë ashtu si është caktuar në aktgjykim dhe të nxjerr akt të ri administrativ.

Sipas dispozitave të Ligjit për Konflikte Administrative, ligjshmëria e aktit administrativ të kontestuar shqyrtohet nga gjykata brenda kufijve të kërkesës nga padia, por nuk obligohet nga shkaqet e padisë. Gjersa për nulitetin e aktit administrativ gjykata përkujdeset sipas detyrës zyrtare. Për shkak të rëndësisë së pasojave të këtyre akteve administrative Ligji për Konfliktet Administrative e detyron gjykatën që sipas detyrës zyrtare të vlerëson nulitetin e aktit administrativ, pavarësisht se këtë fakt e ka theksuar apo jo paditësi.

Shpallja publike e vendimit të gjykatës, parimisht pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor e cila seancë ka qenë publike, gjykata e shpall aktgjykimin respektivisht vendimin. Në raste të ndërlikuara gjykata mund të heq dorë nga shpallja verbale e aktgjykimit respektivisht vendimit, por jo më vonë se brenda 8 ditësh, të nxjerrë aktgjykimin respektivisht vendimin.

Nëse pas përfundimit të shqyrtimit verbal të seancës së shqyrtimit kryesor, gjykata nuk e nxjerrë aktgjykimin, respektivisht vendimin për arsye se duhet më parë të vërtetojë faktin e atillë për shqyrtimin e të cilit nuk nevojitet një shqyrtim i ri verbal, gjykata do të nxjerr aktgjykimin, respektivisht vendimin brenda 8 ditësh, nga data kur do ta ketë vërtetuar këtë fakt.

5. Aktgjykimi dhe mjetet juridike

5.1 Hyrje

Në këtë sesion trajnim pjesëmarrësve ju ofron njohuri për nocionin e aktgjykimit në konfliktin administrativ, formën e aktgjykimit, mënyrën e dorëzimit, llojet e aktgjykimeve në konfliktin administrativ pastaj mjeti i rregullt (ankesën) mjetet e jashtëzakonshme siç janë: Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë si dhe kërkesa për rishikim, si dhe veprimet dhe vendimi i gjykatës lidhur me vendosjen për këto mjete juridike.

5.2 Objektivat trajnues

Pas përfundimit të këtij prezantimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Thellojnë njohurit lidhur me formën e aktgjykimit si dhe llojet e aktgjykimeve;
- Dallimin në mes të aktgjykimeve në konfliktin administrativ;
- Identifikojnë kërkesën për kthimin e sendit dhe kërkesën për shpërblimin e dëmit.
- Zgjerojnë njohurit për mjetet juridike të rregullta (ankesën)
- Bëjnë dallimin në mes të mjeteve të jashtëzakonshme juridike dhe mjeteve të rregullta,
- Bëjnë dallimin në mes të procedurave me rastin e vendosjes me mjete të rregullta juridike nga mjetet e jashtëzakonshme juridike,
- Bëjnë dallimin në mes të mjeteve të jashtëzakonshme siç janë: Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë si dhe kërkesën për rishikim.
- Analizojnë veprimet procedurale dhe vendimet lidhur me mjetet juridike në konfliktet administrative.

5.3 Aktgjykimi në konfliktin administrativ

Sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ gjykata vendos për konfliktin administrativ me aktgjykim. Me aktgjykim në konfliktin administrativ padia mundet:

1. Padia të refuzohet si e pabazuar
2. Padia të miratohet.

Në qoftë se padia aprovohet gjykata e anulon aktin administrativ të kontestuar. Pas nxjerrjes së aktgjykimit mbi anulimin e aktit administrativ, lënda i kthehet organit kompetent akti i të cilit është anuluar. Ky organ duhet që të nxjerr akt të ri administrativ në përputhje me pikëpamjen juridike të gjykatës të dhënë me aktgjykim.

Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet mundet nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendos për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar.

Sipas dispozitës së nenit 48 të Ligjit për Konfliktet Administrative, aktgjykimi duhet të përmbaj formën me shkrim dhe se ky aktgjykim duhet të përmbaj këto elemente:

1. Hyrja e aktgjykimit
2. Dispozitivi i aktgjykimit
3. Arsyetimi i aktgjykimit
4. Si dhe këshillat juridike.

Elementet të cilat kanë të bëjnë me hyrjen e aktgjykimit janë: emërtimin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin e gjyqtarit që e gjykon çështjen e të procesmbajtësit, emërtimin e palëve dhe të përfaqësuesve të tyre, objektin e konfliktit administrativ si dhe ditën kur aktgjykimi respektivisht vendimi është shpallur.

Dispozitivi i aktgjykimit duhet të jetë i ndarë nga arsyetimi. Në dispozitiv të aktgjykimit shënohet nëse miratohet padia (anullohet akti administrativ) apo refuzohet padia.

Arsyetimi i aktgjykimit përmban arsytet të cilat pse është miratuar padia apo pse padia refuzohet. Arsyetimi duhet të jetë i plotë duhet të përmbaj arsye nga të cilat gjykata shihet se pse ka vendosur në mënyrën e cekur në dispozitiv. Arsyetimi duhet me qenë bindës dhe duhet ta arsyeton konkluzën juridike të dispozitivit të aktgjykimit.

Këshilla juridike: vendoset në fund të aktgjykimit. Sa i përket mjetit të rregullt juridik-ankesës i epet vetëm për çështjet të përcaktuara shprehimisht me ligj. Gjersa sa i përket mjeteve të jashtëzakonshme juridike nuk epet këshilla juridike. Aktgjykimi nënshkruhet nga gjyqtari dhe të njëjtit i dërgohen palëve në procedurë.

Dorëzimi i aktgjykimit: aktgjykimet e gjykatës në konfliktin administrativ, palëve u ekspedohet nga një kopje përkatësisht të autorizuarit të palëve. Aktgjykimet u ekspedohen të gjitha palëve pavarësisht numrin e tyre, personave të interesuar, mirëpo kur palët kanë përfaqësues të tyre të autorizuar nga një kopje e aktgjykimit iu ekspedohet përfaqësuesve të tyre. Ekspedimi i aktgjykimit është veprim i rëndësishëm ngase nga dita e dorëzimit fillon të rrjedh afati i mjetit juridik apo të vërtetohet plotfuqishmëria e aktgjykimit. Aktgjykimi ekspedohet nëpërmjet postës, por mund të ekspedohet edhe nëpërmjet punëtorit të autorizuar të gjykatës. Gjithashtu ekspertimi mund të bëhet nëpërmjet postës elektronike. Në rast të këtyllë konsiderohet se është kryer dorëzimi i shkresës në momentin kur është dorëzuar nëpërmjet postës elektronike. Aktgjykimi kundër të cilit lejohet ankimi i veçantë, mjeti i goditjes së aktgjykimit, i dorëzohet personalisht palës, përkatësisht përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit me prokurë. Kur personi të cilit i është dërguar aktgjykimi pa ndonjë arsye të ligjshme refuzon ta marr në dorëzim aktgjykimin, dorëzuesi do t'ia lë në banesë ose në lokalet në të cilat punon personi. Në fletë dërgesë duhet të shënohet dita ora dhe shkaku i refuzimit të marrjes si dhe vendi ku është lënë shkresa. Ky dorëzim konsiderohet se i është dorëzuar në mënyrë të rregullt dhe të ligjshëm palës e cila ka refuzuar marrjen pa arsye ligjore.

Aktgjykimi aprovues: nënkupton atëherë kur gjykata në bazë të provave të nxjerra gjatë seancës së shqyrtimit kryesor ka vlerësuar se padia është e bazuar dhe se akti administrativ i atakuar me padi është nxjerr në kundërshtim me ligjin. Për këtë arsye në arsyetim të aktgjykimit, organit të paditur i sugjerohet se në rishqyrtim është i obliguar që me rastin e nxjerrjes së vendimit të ri administrativ duhet të zbatoj vërejtjet dhe sugjerimet e gjykatës.

Aktgjykim refuzues: Aktgjykimi refuzues i referohet situatës kur gjykata gjatë seancës së shqyrtimit kryesor me prova relevante ka konstatuar se organi administrativ me rastin e nxjerrjes së aktit administrativ nuk ka bërë shkelje të ligjit si procedural si dhe ligjit material. Nga kjo rezulton se me aktgjykim refuzues vërtetohet ligjshmëria e aktit administrativ të kontestuar nga ana e palës paditëse.

Aktgjykimi nga baza e heshtjes së administratës ka të bëjë me situatën kur paditësi paraqet padi për shkak të heshtjes administrative lidhur me kërkesën apo ankesën e palës, meqë organi administrativ në afatin e përcaktuar me ligj siç është në shkallë të parë 60 ditë, nëse heshtë atëherë pala ka për obligim që në afat prej 7 ditësh, t'ia tërheq vërejtjen organit administrativ që të vendos lidhur me kërkesën e palës, edhe nëse në këtë afat nuk vendos organi administrativ atëherë plotësohet kushti ligjor që të konstatohet heshtja administrative. Gjithashtu heshtje administrative kemi kur organi i shkallës së dytë nuk ka vendos me ankesën e palës paditëse në afat prej 30 ditësh dhe se pala e ankimuar pas 30 dite, ia tërheq vërejtjen organit të shkallës së dytë që të vendos lidhur me ankesën e palës së ankimuar në afat prej 7 ditësh, e nëse edhe në këtë afat nuk ka vendosë organi atëherë pala përmbush kushtin ligjor që të iniciojë konflikt administrativ në bazë të heshtjes administrative. Në rast se gjykata gjen se padia është e bazuar atëherë në dispozitiv të aktgjykimit do të konstatohet se padia është e bazuar dhe do ti epet urdhri organit administrativ të paditur, që në afatin e paraparë ligjor të nxjerr vendim lidhur me kërkesën apo ankesën e paditësit.

Shpenzimet e procedurës: Në konfliktin administrativ secila palë i bartë shpenzimet e veta, meqë në konfliktin administrativ konsiderohet se shpenzimet janë të vogla në krahasim me procedurat tjera. Shpenzimet e procedurës në konfliktin administrativ janë të përcaktuara si: Taksa për padi, taksa për vendim të gjykatës, për ankesë, për mjetet tjera juridike, kompensimi i shpenzimeve të dëshmitarit, ekspertit si dhe kompensimi i shpenzimeve nëse eventualisht ka marrë pjesë avokati.

5.4 Mjetet juridike në konfliktet administrative

Në bazë të ligjit për konfliktet administrative janë përcaktuar mjetet e rregullta juridike – ankesa dhe mjetet e jashtëzakonshme, kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë dhe kërkesa për rishikim.

- **Ankesa**

Në procedurën e konflikteve administrative, kundër vendimit të gjykatës mund të ushtrohet mjete i rregullt juridik siç është ankesa, vetëm atëherë kur shprehimisht e ka përcaktuar Ligjit për Konfliktet Administrative. Kur ankesa lejohet ajo mund të paraqitet në afat prej 15 ditësh, që nga dita e pranimit të vendimit të gjykatës. Të drejtën e paraqitjes së ankesës kundër aktgjykimit në konflikt administrativ kanë: Pala e paditur, pala paditëse si dhe personi i interesuar.

I padituri organi i cili ka nxjerrë vendimin administrativ mund të ushtrojë ankesë kur vendimi i tij është anuluar në konfliktin administrativ. Ankesë mund të paraqes edhe pala paditëse, i cili është i pakënaqur me vendimin gjyqësor të gjykatës për refuzimin e padisë, në rastet kur gjykata refuzon padinë. Ankesë mund të paraqet edhe personi i interesuar, po që se është i pakënaqur me vendimin gjyqësor të nxjerrë në konfliktin administrativ.

- **Forma dhe përmbajtja**

Ankesa duhet të përmbajë elementet themelore të saj. Në ankesë duhet të theksohet vendimi gjyqësor që goditet me ankesë dhe shkaqet e goditjes të vendimit gjyqësor. Gjykata pasi që pranon ankesën duhet ta shqyrtoj anën formale të saj, nëse konstatohet se ankesa është e palejueshme, e paraqitur pas afatit ose e paraqitur nga personi i pa autorizuar, me vendim e hedh poshtë ankesën. Nga kjo rezulton se gjykata fillimisht duhet të shqyrtojë këto elemente të ankesës. Nëse konstatohet se nuk ka mangësi lidhur me këto elemente atëherë gjykata duhet që ta

shqyrtoj ankesë, dhe atë duke u bazuar në dispozitat e nenit 63 të Ligjit për Konfliktin Administrativ ku thuhet se nëse ky ligj nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktet administrative, përshtatshmërisht duhet të zbatohet Ligji i Procedurës Kontestimore. Në rastin konkret duhet të zbatohen dispozitat e nenit 194 gjer në nenin 210 të LPK-së. Gjykata e shkallës së dytë me rastin e shqyrtimit të ankesës mund ta hedh poshtë ankesën si të vonuar, jo të plotë apo të palejueshme, ta prish aktgjykimin e goditur dhe ta hedhë poshtë padinë, ta prish aktgjykimin e goditur dhe ta kthej çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, ta refuzoj ankesën si të pathemeltë dhe të vërtetë aktgjykimin e goditur, ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë.

Në qoftë se gjykata e aprovon ankesën si të bazuar dhe e prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë, në këtë rast lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë, vërejtjet dhe sugjerimet e gjykatës së shkallës së dytë janë obligative për gjykatën e shkallës së parë kur të vendos në rigjykim dhe rivendosje, që do të thotë se gjykata e shkallës së parë duhet të zhvillojë të gjitha veprimet procedurale dhe ta shqyrtojë çështjen sipas asaj si e ka përcaktuar gjykata e instancës së shkallës së dytë duke vendosur lidhur me ankesën.

5.4 Mjetet e jashtëzakonshme juridike

Mjetet e jashtëzakonshme juridike palët mund ti shfrytëzojnë pasi që gjykata ka vendosë në mënyrë meritore dhe se aktgjykimi do ta merrte formën e prerë. Ligji për Konfliktet Administrative i ka përcaktuar tri mjete të jashtëzakonshme juridike dhe ato janë:

1. Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor
2. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë
3. Rishikimi.

Kërkesa për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, si mjet juridik i jashtëzakonshëm, mund të paraqitet kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe atë i dërgohet gjykatës brenda 30 dite, nga data e pranimit të vendimit të formës së prerë kundër të cilit pala paraqet kërkesën. Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm sipas dispozitave të ligjit për konfliktet administrative duhet të përmbajë emërtimin e aktgjykimin të gjyqësorit, si dhe shkaqet dhe vëllimin në të cilin propozohet rishqyrtimi. Ky mjet i jashtëzakonshëm juridik mund të ushtrohet për shkak të shkeljes së dispozitave materialo-juridike si dhe për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës.

Kompetente për vendosje lidhur me kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimin të formës së prerë është Gjykata Supreme konform dispozitave të Ligjit nr.03/L-199. Nëse kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm nuk është e plotë, e pa kuptueshme ose ka të meta, gjyqtari vepron në kuptim të nenit 33 të Ligjit për Konfliktin Administrativ, duke ia kthyer ushtruesit të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm që në afat prej 8 ditësh ti mënjanoj të metat.

Nëse ushtruesi i kërkesës brenda afatit të cekur nuk i mënjanon të metat, gjykata do ta hedh poshtë kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimin të formës së prerë. Nëse gjykata nuk e hedh kërkesën, atëherë ajo do t'ia dërgoj palës së kundërt, e cila brenda afatit prej 15 dite, mund të jap përgjigjen në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm.

Gjykata kundër vendimit të së cilës është paraqitur kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm kanë për detyrë që me kërkesën e gjykatës t'ia dërgojnë të gjitha shkresat e lëndës. Gjykata vendos mbi kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm në seancë të mbyllur, gjersa vendimin e kundërshtuar e shqyrton vetëm brenda kufijve të kërkesës.

Gjykata me aktgjykim refuzon ose e aprovon kërkesën. Me aktgjykim me të cilin aprovohet kërkesa gjykata mund ta anuloj ose ta ndryshoj vendimin gjyqësor kundër të cilit është paraqitur kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm. Nëse gjykata anulon vendimin gjyqësor lënda i kthehet gjykatës, vendimi i së cilës është anuluar. Kjo gjykatë e ka për detyrë ti ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale dhe ti shqyrtoj çështjet për të cilat e ka sugjeruar gjykata që ka vendosur lidhur me kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm.

- **Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë**

Prokuroi i shtetit të Kosovës nëse konstaton se është shkelur ligji, dispozitat tjera apo akti i përgjithshëm ka mundësi të paraqes kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe atë në afat brenda 90 dite, nga data kur iu është dërguar palëve vendimi, kundër të cilit paraqitet kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë. Bazë për paraqitjen e kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë është ekzistimi i shkeljes së ligjit pavarësisht se me aktin administrativ në favor të kujt është vendosur, të personit fizik apo personit juridik, mirëpo nëse është vendos edhe në dëm të interesit publik.

Për këtë arsye të gjitha organet administrative dhe institucionet të cilat ushtrojnë autorizime publike kanë detyrim që ta njoftojnë prokurorin e shtetit të Kosovës me akte të cilat janë shkelur ligji në dëm të interesit publik. Vendimi i gjykatës i cili mund të goditet me këtë mjet juridik është aktgjykimi, përkatësisht aktvendimi i kolegjit të Gjykatës Supreme. Për të gjitha çështjet procedurale lidhur me mjetin juridik të jashtëzakonshëm siç është kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë zbatohen procedurat lidhur me kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të formës së prerë.

- **Rishikimi**

Në bazë të dispozitave të ligjit për konfliktet administrative pala e interesuar mund të kërkojë risimin e vendimit që ka marrë formën e prerë dhe atë kur plotësohen kushtet:

1. Kur pala mëson për fakte të reja, apo nëse konstaton ose krijon mundësi të përdorë prova të reja, në bazë të së cilave konflikti do të mund të zgjidhej në mënyrë më të favorshme për të, po të ishin shkruar ose përdorur këto fakte, apo prova, në procedurën e mëparshme gjyqësore.
2. Vendimi i gjykatës ka ardhur si pasojë e veprës penale të gjyqtarit apo punëtorit në gjykatë ose vendimi është nxjerrë me veprim mashtrues të përfaqësuesit ose të autorizuesit të palës, të kundërshtarit të tij ose të përfaqësuesit apo të autorizuarit të kundërshtarit, kurse ky veprim përbënë vepër penale.
3. Vendimi është bazuar në aktgjykimin e nxjerrë në çështje penale apo civile kurse ky aktgjykim është anuluar më vonë me vendim gjyqësor të formës së prerë.
4. Dokumenti në të cilin bazohet vendimi është i falsifikuar, apo nëse dëshmitari, eksperti, ose pala gjatë dëgjimit para gjykatës ka dhënë deklaratë të rremë, kurse vendimi i gjykatës është bazuar në këtë deklaratë.
5. Pala konstaton apo krijon mundësi ta përdor vendimin e mëparshëm ta nxjerrë në të njëjtin konflikt administrativ.
6. Personit të interesuar nuk i është dhënë mundësia për të marr pjesë në konflikt administrativ.

Nga pika 1 deri në pikan 5 rishikimi do të lejohet vetëm nëse pala, pa faj të vetë, nuk ka pasur mundësi që këto rrethana ti shtrojë në procedurën e mëparshme.

Rishikimi i vendimeve në kushtet e cekura më lart lejohet kur ato rrethana janë vërtetuar me vendim të formës së prerë nga gjykata kompetente për pikën 2 dhe 4.

Rishikimi i vendimeve mund të kërkohet jo më vonë se brenda 30 ditësh nga data kur pala të ketë mësuar për shkakun e rishikimit. Nëse pala ka mësuar për shkakun e rishikimit para se të ketë marrë fund procedura para gjykatës, gjersa për këtë shkak nuk ka mundur ta përdorë gjatë procedurës, rishikimi mund të kërkohet brenda 30 ditësh, nga data e dërgimit të vendimit. Afati subjektiv për ushtrimin e kërkesës për rishikim është 30 ditë, nga data kur pala të ketë mësuar për shkakun e rishikimit. Gjersa afati objektiv është pasi të kenë kaluar 3 vjet nga data kur vendimi të ketë marrë formën e prerë, rishikimi nuk mund të kërkohet. Kompetente për të vendosur lidhur me kërkesën për rishikim vendos gjykata që ka nxjerr vendimin.

Kërkesa për rishikim duhet të përmbajë aktgjykimin ose vendimin i cili është nxjerr në procedurën e konfliktit administrativ, rishikimi i të cilit kërkohet.

Baza ligjore e rishikimit, provat dhe rrethanat që e bëjnë të besueshëm ekzistimin e kësaj baze për rishikim.

Rrethanat nga të cilat rezulton se kërkesa është paraqitur në afatin ligjor, dhe me cilat prova vërtetohet.

Në cilin drejtim dhe në cilin vëllim propozohet ndryshimi i aktgjykimit respektivisht i vendimit të nxjerr në procedurë, rishikimi i të cilit kërkohet.

Gjykata me rastin e shqyrtimit të kërkesës për rishikim, vendosë në seancë të mbyllur. Gjykata fillimisht duhet të vërtetoj se kërkesën e ka paraqitur personi i autorizuar ose kërkesa për rishikim është ushtruar në kohën e duhur, apo pala e ka bërë të paktën të besueshëm ekzistimin e bazës ligjore për rishikim. Nëse këto tri elemente nuk janë plotësuar atëherë gjykata duhet ta hedh poshtë kërkesën me vendim. Pas vërtetimit të këtyre elementeve gjykata kërkesën për rishikim ia dërgon palës kundërshtare i cili brenda 15 ditësh duhet ti përgjigjet kërkesës për rishikim. Pas skadimit të këtij afati për përgjigje në kërkesë për rishikim, gjykata vendosë me aktgjykim mbi kërkesën për rishikim. Nëse lejohet kërkesa për rishikim do të shfuqizohet (anulohet) vendimi i atakuar me kërkesë për rishikim.

5.5 Karakteri i detyrueshëm i aktgjykimin në konfliktin administrativ

Ligji për konfliktet administrative ka përcaktuar se kur gjykata e anulon aktin administrativ, kundër të cilit ka filluar konflikti administrativ, lënda i kthehet të njëjtit organ i cili ka nxjerrë aktin e mëparshëm, të cilin gjykata tani e ka anuluar. Nëse sipas karakterit të çështjes, që ka qenë objekt i konfliktit, duhet që në vend të aktit të anuluar administrativ, të nxirret një tjetër akt sipas vërejtjeve dhe sugjerimeve të cilat i kishte dhënë gjykata me rastin e anulimit të aktit administrativ. Organi kompetent ka për detyrë ta nxjerrë aktin e ri për shtyrje, jo më vonë se brenda 30 ditësh, nga data e dërgimit të aktgjykimin.

Pas nxjerrjes së aktgjykimin, nga ana e gjykatës kompetente në konfliktin administrativ, lindin tri situata të ndryshme dhe atë:

1. Organi vepron në përputhje me vërejtje dhe sugjerime të gjykatës dhe se me atë veprim nxjerr aktin e ri administrativ.
2. Organi kompetent nxjerr akt të ri administrativ në kundërshtim me pikëpamjen juridike të gjykatës të dhënë në aktgjykim.

3. Organi në afatin e caktuar fare nuk nxjerr akt të ri administrativ edhe pse ka qenë i detyruar për këtë.

Në qoftë se organi kompetent pas anulimit të aktit administrativ e nxjerr aktin administrativ në kundërshtim me pikëpamjen juridike të gjykatës, paditësi mund të parashtroj padi të re, gjykata mund të anuloj aktin e kontestuar, me aktgjykim i cili krejtësisht e zëvendëson aktin administrativ të anuluar.

Nëse organi kompetent pas anulimit të aktit administrativ nuk nxjerr aktin administrativ brenda 30 ditësh, nga data e dërgimit të aktgjykimit, pala me parashtrësë të veçantë mund të kërkoj nxjerrjen e aktit duke kërkuar nga organi administrativ që të veprojë konform dispozitës së nenit 65 të Ligjit për konfliktet administrative. Nëse organi kompetent pas anulimit të aktit administrativ nuk nxjerrë menjëherë e jo më vonë se 30 ditë, aktin e ri administrativ ose aktin në zbatimin e aktgjykimit të nxjerrë pala mund të kërkojë me parashtrësë të veçantë, nxjerrjen e aktit të tillë.

Nëse organi kompetent nuk e nxjerr aktin brenda 7 ditësh nga kjo kërkesë, pala mund të kërkojë nxjerrjen e aktit të tillë nga gjykata që ka nxjerrë aktgjykimin. Gjukata duke u bazuar në kërkesën e palës do të kërkojë nga organi kompetent njoftimin mbi shkaqet për të cilat organi administrativ nuk e ka nxjerrë aktin e ri. Organi kompetent ka për detyrë ta jap këtë njoftim menjëherë, jo më vonë se brenda 7 ditësh. Nëse organi administrativ nuk e bënë këtë, apo nëse njoftimi i dhënë sipas mendimit të gjykatës nuk e arsyeton moszbatimin e arsyetimit të gjykatës, gjykata do të nxjerrë vendimin i cili e zëvendëson aktin e organit kompetent.

Vendimin e nxjerrë nga gjykata, do t'ia dërgojë organit kompetent që ushtron mbikëqyrjen. Organi administrativ kompetent për ekzekutim ka për detyrë që ta përmbarojë vendimin e gjykatës. Kur në konfliktin administrativ është nxjerrë aktgjykimi nga ana e gjykatës kompetente, gjersa organi ka nxjerrë aktin administrativ për ekzekutimin e këtij aktgjykimi, por pranë organit kërkohet rishikimi i aktgjykimit për këtë akt administrativ, rishikimi mund të lejohet nëse shkak i rishikimit ka lindur pranë organit që e ka nxjerrë aktin administrativ.

5.6 Përmbledhje

Pas përfundimit të këtij sesi, pjesëmarrësit kanë përvetësuar dhe do të jenë në gjendje të përpilojnë aktgjykimin në bazë të formës ligjore të përcaktuar nga Ligji për Konfliktet Administrative, ta bëjnë dallimin në mes të hyrjes së dispozitivit, arsyetimit dhe këshilla ve juridike. Ti përcaktojnë shpenzimet procedurale lidhur me padi, taksa tjera gjyqësore pastaj me mjetet e rregullta juridike (ankesën) si dhe me mjetet juridike të jashtëzakonshme (kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe kërkesën për rishikim) si dhe lidhur me vendimin e gjykatës duke u bazuar në kërkesat të mjeteve juridike në konflikt administrativ. Po ashtu pjesëmarrësit do të janë në gjendje të kuptojnë efektin e aktgjykimit dhe karakterin e detyrueshëm të tij.

XII. E drejta Ekonomike

Mahir Tutuli
Gjyqtarë në Gjykatën e Apelit

Tabela e përmbajtjes – “E drejta Ekonomike”

Hyrje	537
Objektivat trajnuese	537
Metodat e të shpjeguarit	537
Pritjet nga pjesëmarrësit	538
Burimet	538
1. E drejta ekonomike -tregtare	541
1.1 Hyrje	541
1.2 Objektivat trajnuese	541
1.3. Hyrje në të drejtën ekonomike	541
1.3.1. Kompetenca gjyqësore në lëndët e natyrës ekonomike	542
1.3.2. Specifikat e procedurës kontestimore në kontestet Ekonomike	542
1.4 Shoqëritë tregtare.....	543
1.4.1 Qëllimi dhe Fushëveprimi i Ligjit për Shoqëritë Tregtare	543
1.4.2 Veprimtaria e cila ushtrohet përmes shoqërive tregtare të regjistruara	544
1.5 Llojet e Shoqërive Tregtare në Kosovë	544
1.5.1 Veprimtaritë dhe Qëllimet e Lejuara për Themelimin e Shoqërisë Tregtare	551
1.5.2 Keqpërdorimet në Ekonomi	551
1.6 Përmbledhje.....	553
2. Falimentimi, likuidimi dhe riorganizimi i personave juridikë	555
2.1 Hyrje	555
2.2 Objektivat trajnues	555
2.3 Falimentimi	555
2.3.1 Fillimi i procedurës së falimentimit	556
2.3.2 Pasojat juridike të hapjes së rastit	558
2.3.3 Moratoriumi	559
2.4 Administratori	560
2.5 Pasuria e falimentimit.....	560
2.5.1. Administrimi i Pasurisë së Falimentuar: Nga Paraqitja e Kërkesës deri te Lirimi	560
2.6 Riorganizimi.....	562
2.6.1 Karakteristikat e Riorganizimit:	563
2.6.2 Klasifikimi i kërkesës:	563
2.6.3 Dëmtimi i kërkesës	564
2.6.4 Karakteristikat e Planit të Riorganizimit	564
2.6.5 Shpalosja dhe Votimi	564
2.6.6 Konfirmimi Konsensual	564
2.6.7 Konfirmimi Jo-konsensual	564
2.6.8 Efektet e Konfirmimit	565
2.6.9 Shndërrimi i Likuidimit apo Pushimit	565
2.7 Koncepti i ri: Lehtësitë e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM).....	565
2.7.1 Procedura NVM – Monitoruesit.....	565
2.7.2 Konfirmimi i efektshëm i planit për NVM	566
2.7.3 Planet e para-dakorduara	566
2.8 Koncepti i ri: Lirimi Individual	566
2.8.1 Aspektet tjera të lirimit individual	567
2.9 Likuidimi.....	567
2.10 Përmbledhje.....	567

3. Kontratat në Ekonomi, Punët Bankare dhe Siguruese	569
3.1 Hyrje	569
3.2. Objektivat trajnues	569
3.3 Kontratat në Ekonomi	569
3.3.1 Disa lloje te kontratave:	570
3.4.1 Punët bankare kredituese:	572
3.4.2 Punët e veçanta kredituese	572
3.4.3 Punët shërbyese bankare.....	574
3.5 Përmbledhje.....	577
4. Të drejtat nga pronësia intelektuale	579
4.1. Hyrje	579
4.2 Objektivat trajnuese	579
4.3. Pronësia intelektuale	579
4.3.1 Burimet ligjore të DPI.....	580
4.4 Të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.....	581
4.4.1 Kuptimi dhe rëndësia e të drejtës së autorit.....	581
4.4.2 Klasifikimi i të drejtave të autorit.....	582
4.4.3 Kontratat e veçanta të së drejtës autoriale.....	583
4.4.4 Kohëzgjatja e të drejtave të autorit.....	584
4.4.5 Të drejtat e përafërta.....	584
4.4.6 Mbrojtja ligjore dhe institucionale e të drejtave të autorit në Kosovë.....	584
4.5 Markat Tregtare.....	585
4.5.1 Rëndësia e Markave Tregtare	586
4.5.2 Karakteristikat Themelore te Markave Tregtare	587
4.5.3 Funkzioni i Markës tregtare	587
4.5.4 Llojet e Markave Tregtare	589
4.5.5 Llojet e Markave Tregtare sipas spektrit të dallueshmërisë.....	590
4.5.6 Markat tregtare sipas Ligjit për Markat Tregtare të Kosovës	592
4.5.7 Instrumentet Kryesore Ndërkombëtare dhe Instrumentet e Acquis Communautaire të BE-së për Markat Tregtare	592
4.5.8 Kushtet dhe procedurat e regjistrimit të Markave Tregtare.....	594
4.5.9 Krijimi i të drejtës nga Marka Tregtare dhe natyra pronësore e MT.....	595
4.5.10 Të Drejtat që Rrjedhin nga Regjistrimi i Markës Tregtare	595
4.5.11 Shkelja e Markave Tregtare dhe Kriteret e Vlerësimit	596
4.5.12 Mbrojtja juridike e markave tregtare	598
4.5.13 Mjetet Juridike për Mbrojtjen e Markave Tregtare.....	599
4.5.14 Mbrojtja civilo-juridike , palët, mjetet juridike dhe procedurat.....	599
4.5.15 Procedura penale	602
4.5.16 Mbrojtja gjyqësore në konflikt administrativ	602
4.5.17 Mbrojtja në procedurë administrative	603
4.6 Përmbledhje.....	604
5. Zgjidhja Alternative e Kontesteve	606
5.1 Hyrje	606
5.2 Objektivat trajnues	606
5.3 Shqyrtime të përgjithshme lidhur me Metodat për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve.....	606
5.4 Ndërmjetësimi si formë alternative për zgjidhjen e kontesteve	607
5.4.1 Kompetencat e gjykatave për shqyrtimin e Vendimeve të Arbitrazhit.....	607
5.4.2 Kompetencat e gjykatës për shqyrtimin e vlefshmërisë së marrëveshjes së arbitrazhit	609
5.5 Ndërmjetësimi si formë alternative për zgjidhjen e kontesteve	610

5.5.1 Shqyrtime të përgjithshme lidhur me Ndërmjetësimin	610
5.5.2 Marrëveshja për ndërmjetësim	610
5.5.3 Arritja e Marrëveshjes në ndërmjetësim dhe përmbushja e saj	612
5.6 Përmbledhje.....	615

Hyrje

Moduli arsyetimi dhe shkrimi ligjor ka për qëllim të ndihmoj gjyqtarët në ngritjen e kapaciteteve të tyre profesionale në lëmin e të drejtës ekonomike. Ky modul do zhvillohet përmes metodave interaktive me qëllim të përfshirjes sa më të madhe të pjesëmarrësve në mënyrë që drejtpërdrejtë të ndihmohet në zbatimin praktik të njohurive ligjore dhe në zhvillimin e aftësive analitike tek gjyqtarët. Përveç udhëzimeve teorike që do të ofrohen në përgjithësi, në sesione të veçanta do diskutohen edhe rastet praktike për të kuptuar specifikat e rasteve të ndërlikuara dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre.

Përmes rasteve konkrete nga fusha e organizimit të entiteteve ekonomike, procedura e falimentimit, transaksioneve bankare dhe tregtare dhe pronësia intelektuale, pjesëmarrësit do të kenë mundësi që duke analizuar dispozitat ligjore të japin konkluzionet e tyre për mënyrat e vendosjes së çështjeve specifike

Ky modul është dizajnuar në përputhje me Programin e Trajnimit Fillestar të miratuar nga Akademia e Drejtësisë, për ngritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve në trajnim, për fushën e të drejtës Ekonomike.

Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij moduli pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Avancojnë njohurit se çka përfshinë e drejta ekonomike;
- t'i njohin format e organizimit të shoqërive tregtare dhe specifikat e tyre;
- t'i njohin specifikat e ndërmarrjeve publike;
- zgjerojnë njohurit lidhur me procesin e privatizimit dhe specifikat e tij;
- të fitojnë njohuri për procedurën e falimentimit dhe kushtet ligjore për riorganizim dhe likuidim të shoqërive tregtare;
- t'i njohin punët bankare dhe siguruese dhe specifikat e tyre,
- të avancojnë njohurit për konkurrencën në treg dhe investimet e huaja;
- të zgjerojnë njohurit për pronësinë intelektuale dhe mbrojtjen gjyqësore të drejtave që rrjedhin nga pronësia intelektuale;
- t'i njohin mënyrat e zgjidhjes alternative të kontesteve dhe ndërlidhja e procedurës së arbitrazhit dhe ndërmjetësimit me procedurat gjyqësore;
- zhvillojnë mendimin kritik dhe aftësitë interpretuese;
- demonstrojnë aftësitë hulumtuese për çështjet ligjore.

Metodat e të shpjeguarit

Trajtimi teorik i organizimit të shoqërive tregtare, procedura e likuidimit dhe riorganizimit të personave juridik në procedurën e falimentimit, transaksioneve bankare dhe tregtare dhe të drejtave të pronësisë intelektuale. Diskutim teorik lidhur me dispozitat ligjore procedurale dhe materiale që zbatohen në rastet e kontesteve që rrjedhin qoftë nga e drejta tregtare-statusore qoftë nga ajo kontraktuale. Prezantim i rasteve konkrete nga praktika gjyqësore dhe diskutime për mënyrën e vendosjes meritore për rastet konkrete. Një rëndësi të veçantë në organizimin dhe ndërtimin e këtij trajnimi do të kenë ushtrimet praktike për të nxitur pjesëmarrjen aktive të pjesëmarrësve. Për sqarimin e çështjeve do të përdoret forma e diskutimit-bashkëbisedimit, dhënies së ideve, me qëllim që të arrihet që të gjithë pjesëmarrësit të jenë aktiv gjatë gjithë kohës duke e dhënë kontributin e tyre më parashtrimin e pyetjeve, ofrimin e zgjidhjeve dhe

opinioneve. Pjesëmarrësit inkurajohen të sfidojnë idetë e trajnuesit dhe praktikat e mëparshme lidhur me shtruarjen dhe zgjidhjen e shumë çështjeve alternative apo edhe problematike.

Pritjet nga pjesëmarrësit

Në fund të këtij moduli synohet të arrihen këto rezultate: gjyqtarët e sapoemëruar të fitojnë njohuri të mjaftueshme për legjislacionin vendor dhe instrumentet ndërkombëtare, të aplikueshme në Republikën e Kosovës, në fushën e të drejtës ekonomike dhe të jenë në gjendja t'i aplikojnë këto instrumente ligjore në rastet konkrete që parashtrihen para tyre në praktikë.

Burimet

Për përgatitjen e leksioneve janë shfrytëzuar këto materiale kryesore:

- Francisko Galgano „E drejta tregtare“ / Sipërmarrësi – Shoqëritë, Tiranë 2009 (titulli në origjinal „Francisko Galgano Dritto commerciale Edizione compatta L'impreditore – Le societa, Quatra edizione, Zanichelli, Bologna 2005
- Dr. Mehdi Hetemi “ E drejta me njohuritë themelore të së drejtës afariste” Prishtinë 2004
- Graeme Dinööodie and Mark D. Janis: Trademark Law and Theory” (A Handbook of Contemporary Research), Edëard Elgar - Cheltenham, UK • Northampton, MA, USA 2008
- Richard A. Spinello (Boston College, USA) and Maria Bottis (Ionian University, Greece) “A Defense of Intellectual Property Rights” - Edëard Elgar - Cheltenham, UK • Northampton, MA, USA 2009
- David A. Burge: Patent and Trade Mark Tactics and Practice (Third Edition) – John Eëiley & Sons, Inc. 1999
- Stephen Elias and Richard Stim: “Patent, Copyright & Trade Mark” (7th edition) 2004 by Nolo and Richard Stim.
- Lionel Bently, Jennifer Davis And Jane C. Ginsburg: “Trade Marks and Brands” (An Interdisciplinary Critique) - Cambridge University Press 2008
- Eëndy Buskop: “Patents, Trademarks, Copyrights and Trade Secrets” –by ISA-Instrumentation, Systems, and Automation Society, 2008.
- Timothy Lee Eëherry: “The Librarians Guide to inetellectual Property” – American Library Association 2002, - BookZZ.org.
- The Enforcement of Intellectual Property Rights (A case book) LTC Harms – EëIPO;
- Slobodan M. Markoviç: Pravo Inetelectualne Svojine – Sužbeni Glasnik, Beograd 2000;

- Vesna Besarović: Intelektualna Svojina – Čiguja Štampa Beograd 2000,
- Manigodić, Milenko: „Robni i uslužni žigovi“, „Pronalazaštvo“, Beograd, 1989.
- Remović, Biljana. „Nepodobnost deskriptivnih znakova za zaštitu žigom“, Republika Srbija,Pravni informator, decembar 2010. godina,
- Vladimir Marič “Sličnost žigova” Botues ZMP IP L.L.C Prishtinë
- Luljeta Plakolli: Mbrojtja dhe Zbatimi i Markave Tregtare, Për EMSG – Menaxhimi Ekonomik dhe Zhvillim USAID
- Doracaku për përgatitjen e Provimit të Jurisprudencës 27 maj 2016, <http://jus.igjk.rks-gov.net/id/eprint/695>

LEGJISLACIONI:

- KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
- LIGJI NR.02./L-123 PËR SHOQËRITË TREGTARE
- LIGJI NR.02/L-33 PËR INVESTIMET E HUAJA
- LIGJI NR.02/L-44 PËR PROCEDURËN E DHËNIES SË KONCESIONEVE
- LIGJI NR.2003/4 PËR LIKUIDIM DHE RIORGANIZIMIN E PERSONAVE
- JURIDIKË NË FALIMENTIM
- LIGJI NR.03/L-087 PËR NDËRMARRJET PUBLIKE
- LIGJI NR.02/L-75 PËR ARBITRAZHIN
- LIGJI NR.03/L-057 PËR NDËRMJETËSIM
- KONVENTA E NJU JORKUT – 1958 – PËR NJOHJEN DHE EKZEKUTIMIN E
- VENDIMEVE TË HUAJA TË ARBITRAZHIT
- LIGJI NR.03/L-209 PËR BANKËN QENDRORE TË R. SË KOSOVËS
- LIGJI NR.03/L-229 PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
- LIGJI NR.04/L-028 PËR DIZAJNIN INDUSTRIAL
- LIGJI NR.04/L-026 PËR MARKAT TREGTARE
- LIGJI NR.04/L-029 PËR PATENTAT
- LIGJI NR.04/L-033 PËR DHOMËN E POSÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS, PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AKP
- LIGJI NR. 2011/04-L-082 KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
- LIGJI NR. 2011/04-L-077 LIGJI PËR MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE
- LIGJI NR. 03/L-199 PËR GJYKATAT .
- LIGJI NR. 2009/03-L-006 -LIGJI PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE
- LIGJI 2010/03-L-202 -LIGJI PËR KONFLIKTET ADMINISTRATIVE
- LIGJI NR. 03/L – 170 LIGJI PËR MASAT DOGANORE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË PRONËSISË INTELEKTUALE
- UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 1/2012 PËR EKZAMINIMIN E PARAKOHSHËM TË APLIKACIONEVE PËR MBROJTJEN E MARKAVE TREGTARE
- UA NR. 13/2012 PËR PROCEDURËN E REGJISTRIMIT TË MARKAVE TREGTARE
- LIGJIN PËR KONKURRENCËN, 2004/36.

INSTRUMENTET NDËRKOMBËTARE:

- KONVENTA E PARISIT PËR MBROJTJEN E PRONËSISË INDUSTRIALE (20 MARS 1883) – ORGANIZATA BOTËRORE E PRONËSISË INDUSTRIALE
- MARRËVESHJA E MADRIDIT PËR REGJISTRIMIN NDËRKOMBËTAR TË MARKAVE TREGTARE (1891), SI DHE PROTOKOLLI QË I PËRKET MARRËVESHJES SË MADRIDIT (1989) - ORGANIZATA BOTËRORE E PRONËSISË INDUSTRIALE
- MARRËVESHJA TRIPS (ORGANIZATA BOTËRORE E TREGTISË)
- DIREKTIVA E PARË E KËSHILLIT 89/104/EEC (1988)
- RREGULLORJA E KËSHILLIT (EC) NR. 40/94 PËR MARKËN TREGTARE TË KOMUNITETIT
- KONVENTA E NJU JORKUT – 1958 – PËR NJOHJEN DHE EKZEKUTIMIN EVENDIMEVE TË HUAJA TË ARBITRAZHIT
- KONVENTA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR KONTRATAT PËR SHITJEN NDËRKOMBËTARE TË MALLRAVE (CISG)

Ueb dhe Enciklopedi:

- Banka Botërore, <http://ëëë.ëorlbank.org/kosovo>.
- Komisioni Evropian, http://ec.europa.eu/index_en.htm
- ëëë.ëipo.int/clasiffications/fulltext/nice8/enmain.htm
- ëëë.ëipo.int/madrid/en/members

Përmbledhje

Ky modul shtjellon përmbajtjen e lëndës “E drejta ekonomike” e cila përfshinë kryesisht atë që njihet si e drejtë tregtare, përfshirë edhe pozitën juridike të subjekteve ekonomike. Kjo është një degë komplekse juridike, që merret me pozitën juridike të subjekteve ekonomike dhe me afarizmin e tyre juridik në treg.

Me transformimin në ekonomi të tregut, Republika e Kosovës ka ndërmarrë masa të përshpejtuara për zhvillimin e legjislacionit që përkrah dhe rregullon afarizmin në Kosovë. Duke pasur parasysh nevojën për një zhvillim sa më të shpejtë ekonomik, institucionet e Republikës së Kosovës dhe palët e tjera të interesit kanë investuar burime të mëdha në implementimin e legjislacionit ekonomik, që ende është një sfidë e përditshme në afarizmin kosovar.

Meqenëse në Kosovë aplikohen një mori ligjesh ekonomike që rregullojnë marrëdhëniet afariste të subjekteve ekonomike gjatë analizimit të çështjeve nga e lëmia e së drejtës ekonomike, duhet pasur kujdes sepse në shumë raste përveq legjislacionit vendor zbatohen edhe instrumentet juridike ndërkombëtare dhe aktet nënligjore që rregullojnë sfera të caktuara, andaj përmes këtij moduli do mundësohet që kandidatet për gjyqtar të ngrisin kapacitetet e tyre profesionale dhe të fitojnë njohuri të mjaftueshme, për zbatimin e legjislacionit në rastet që parashtrihen para tyre për tu zgjidhur.

1. E drejta ekonomike -tregtare

1.1 Hyrje

E drejta ekonomike është një degë juridike komplekse e cila merret me pozitën juridike të subjekteve ekonomike dhe komerciale, statusin e tyre juridik si dhe me afarizmin e tyre juridik në treg. Nevoja e Kosovës për zhvillim të shpejtë dhe të qëndrueshëm ekonomik ka paraqitur nevojën për angazhim të shtuar për rregullimin ligjor të kësaj fushe, andaj Institucione e Republikës së Kosovës në koordinim me palë të interesuara dhe Institucionet relevante ndërkombëtare kanë ndërmarrë një sërë masash drejt zhvillimit dhe implementimit të një legjislacioni ekonomik që mundëson një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Përkundër miratimit të legjislacionit adekuat, implementimi i këtij legjislacioni paraqet sfidë, si për ndërmarrjet dhe afaristët, ashtu edhe për praktikuesit e e profesioneve juridike dhe sistemin gjyqësor. Në vazhden e këtyre përpjekjeve të vazhdueshme, në Kosovë tanimë aplikohen një sërë ligjesh tregtare dhe ekonomike. Por, përveç këtyre ligjeve që janë në fuqi e që janë të publikuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në të drejtën ekonomike zbatohen edhe instrumente ndërkombëtare siç janë: Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Kontratat për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave (CISG), Konventa e New York e vitit 1958 për Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit, Konventa e Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale (20 mars 1883) – organizata botërore e pronësisë industriale, Marrëveshja trips (organizata botërore e tregtisë) si dhe instrumente tjera ndërkombëtare për të cilat, juristet që merren me këtë fushë duhet të kenë njohuri të mjaftueshme.

1.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Zgjerojnë njohurit për të drejtën Ekonomike dhe fushë që ajo mbulon;
- Identifikojnë çështjet juridike që bien në kompetencë të Departamentit Ekonomik dhe përjashtimet;
- Dallojnë specifikat e procedurës në kontestet ekonomike.
- Kuptojnë qëllimet kryesore të ligjit për shoqëritë tregtare dhe fushëveprimin e tij;
- Avancojnë njohurit me mënyrat e themelimit dhe shuarjes së shoqërive tregtare dhe pasojat juridike që krijojnë;
- Avancojnë njohurit idhur me mënyrat e organizimit, struktura e kapitalit, dhe të drejtat dhe detyrimet e pronarëve, zyrtarëve të shoqërive tregtare, përfaqësuesve të tyre dhe personave të tretë;
- Zbatojnë drejtë procedurat ligjore dhe aplikimin e tyre në mbrojtjen e të drejtave që rrjedhin nga shoqëritë tregtare.
- Njohin mënyrat dhe punët juridike për bartjen e të drejtave dhe detyrimeve nga shoqëritë tregtare.

1.3. Hyrje në të drejtën ekonomike

E drejta ekonomike paraqet një tërësi normash juridike me të cilat rregullohet pozita juridike e subjekteve të së drejtës ekonomike dhe raportet juridike në mes tyre. Përmes këtyre rregullave juridike rregullohet pozita juridike e subjekteve ekonomike si dhe raportet juridike që krijohen në mes tyre apo në mes tyre dhe subjekteve të tjera.

Në praktikë hasim termat juridik e drejta tregtare dhe e drejta ekonomike, të cilët në fakt janë të ngjashëm dhe si të tillë përfshijnë të njëjtat rregulla juridike.

E drejta ekonomike përfshin:

- të drejtën statusore; dhe
- të drejtën kontraktore.

E drejta ekonomike statusore rregullon format, pozitën juridike, mënyrën e themelimit dhe të veprimit të shoqërive tregtare.

Ndërsa e drejta ekonomike kontraktore rregullon punët juridike reciproke në mes të subjekteve të së drejtës ekonomike gjatë afarizmit të tyre.

1.3.1. Kompetenca gjyqësore në lëndët e natyrës ekonomike

Ligji për Gjykatat, neni 13.1, përcakton se Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës Themelore në Prishtinë është kompetent për çështjet në vijim:

- Kontestet ndërmjet personave juridik vendor dhe të huaj lidhur me çështjet e tyre afariste;
- Riorganizim, falimentim dhe shuarjen e personave juridik, nëse me ligj nuk përcaktohet ndryshe;
- Kontestet lidhur me pengimin e posedimit, me përjashtim të pronës së paluajtshme, ndërmjet palëve të cekura në nën-paragrafi 1.1 të këtij paragrafi;
- Kontestet lidhur me cenimin e konkurrencës, keqpërdorim apo monopolizim dhe pozitën dominuese në treg si dhe marrëveshjet monopoliste;
- Mbrojtjen e të drejtave pronësore dhe të pronës intelektuale;
- Kontestet midis kompanive të aviacionit, për të cilat zbatohet Ligji mbi Kompanitë e Aviacionit, duke përjashtuar kontestet lidhur me të drejtat e udhëtarëve; dhe
- Çështje të tjera të parapara me ligj.

Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës Themelore në Prishtinë nuk është kompetent për gjykim në kontestet lidhur me: pronësinë dhe të drejtat sendore të tjera mbi sendet e paluajtshme, në kontestet për shkak të pengim posedimit mbi sendin e paluajtshëm, si dhe në kontestet nga raportet e qiradhënies së paluajtshmërisë ose nga kontratat për shfrytëzimin e banesave apo të lokaleve të punës, kompetencë ekskluzive ka gjykata në territorin e të cilës ndodhet paluajtshmëria”.

Përveç subjekteve vendore, si palë në procedurë, shpeshherë paraqiten subjektet ekonomike nga shtetet e huaja andaj në këto raste duhet pasur kujdes lidhur me kompetencën, ligjin e aplikueshëm dhe instrumentet juridike ndërkombëtare.

1.3.2. Specifikat e procedurës kontestimore në kontestet Ekonomike

Ligji për Procedurën Kontestimore (LPK), në Kreun XXX – Procedura në Kontestet Tregtare, përcakton se, në procedurën për zgjidhjen e kontesteve tregtare zbatohen dispozitat e këtij ligji për procedurën e përgjithshme kontestimore, nëse në dispozitat e këtij kreu nuk është përcaktuar diç tjetër.

Ndërsa në vijim përcakton rregulla specifike per kontestet tregtare, si në vijim:

- Faktet lidhur me qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve të cilin e shoqërojnë dokumentet standarde afariste, si rregull, provohen me këto dokumente.
- Gjyqtari është i autorizuar që në rastet e ngutshme të konvokojë seanca me anë të telefonit apo telegramit.
- Revizioni në kontestet tregtare nuk lejohet nëse vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit të formës së prerë nuk i kalon 10.000 €.
- Neni 509: Në procedurën e zgjidhjes së kontesteve tregtare vlejné këto afate:
- Afati prej shtatë (7) ditësh për përgjigje në padi;
- Afati prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh për paraqitjen e propozimit për kthimin në gjendjen e mëparshme nga neni 130 paragrafi 3 i këtij ligji;
- Afati prej shtatë (7) ditësh për ankesën kundër aktgjykimit apo aktvendimit;
- Në kontestet nga raportet në të cilat është dhënë aktgjykimi në bazë të kambialit apo çekut, afati për ankim është shtatë (7) ditë.
- Afati prej tri (3) ditësh për paraqitjen e përgjigjes në ankesë;
- Afati prej shtatë (7) ditësh (afati paritiv) për përmbushjen e detyrimit në të holla, e për përmbushjen e premtimit jo në të holla gjykata mund të caktojë afat më të gjatë.
- Në procedurën për zgjidhjen e kontesteve tregtare të vlerës së vogël konsiderohen vetëm ato konteste në të cilat padia ka të bëjë me kërkesë në të holla e cila nuk e kalon shumën prej 3.000 €.

1.4 Shoqëritë tregtare

Ligji për Shoqëritë Tregtare është ligji elementar mbi të cilin ndërtohet e drejta ekonomike. Ky ligj përbën shtyllën e zhvillimit të kornizës ligjore ekonomike.

Ky ligj përbën shtyllën e zhvillimit të kornizës ligjore ekonomike.

1.4.1 Qëllimi dhe Fushëveprimi i Ligjit për Shoqëritë Tregtare

Ligji për Shoqëritë Tregtare i ka këto qëllime:

- t'i përcaktojë llojet e shoqërive tregtare përmes së cilave mund të zhvillohen veprimtaritë afariste
- t'i caktojë kushtet e regjistrimit
- t'i përcaktojë dispozitat ligjore për kapacitetin dhe strukturën juridike të shoqërive tregtare si dhe të drejtat dhe detyrimet e pronarëve, menaxherëve, drejtorëve, përfaqësuesve juridik dhe palëve të treta
- t'i përcaktojë dispozitat ligjore të cilat nxisin dhe lehtësojnë themelimin, funksionimin dhe shpërbërjen e rregullt të shoqërive tregtare
- ta inkurajojë ndërmarrësit në përmes kufizimit të detyrimeve të investitorëve
- ta tërheqë kapitalin e huaj dhe atë vendorë

Është me rëndësi të theksohet se Ligji për Shoqëritë Tregtare ka një fushëveprim të kufizuar.

Prandaj, ligji në fjalë nuk i:

- themelon rregullat dhe nuk i rregullon çështjet që janë në fushëveprimin e ligjeve tjera
- përfshinë rregullat të cilat trajtojnë licencimin dhe rregullimin e veprimtarive të një shoqërie
- rregullon praktikën e kontabilitetit, të raportimit financiar, të punës dhe të punësimit në kuadër organizatës.

1.4.2 Veprimtaria e cila ushtrohet përmes shoqërive tregtare të regjistruara

1. Kushti për t'u Regjistruar

Çdo person ose organizatë mund të ushtrojë çdo lloj veprimtarie afariste e cila ka qëllime të ligjshme. Megjithatë, në bazë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, veprimtaria e tillë afariste mund të ushtrohet vetëm përmes një shoqërie tregtare të regjistruar ose përmes një shoqërie tregtare të huaj e cila është regjistruar në Regjistër. Një përjashtim ndaj këtij rregulli ekziston në rastet kur një ligj tjetër ose akt i veçantë normativ shprehimisht i lejon palët ose shoqëritë tjera të ushtojnë veprimtari afariste pa u regjistruar.

2. Gjobat

Personat të cilët ushtrojnë veprimtari afariste pa regjistrimin e një shoqëritë tregtare, bëjnë shkeljen e këtij ligji dhe duhet të paguajnë gjoba administrative monetare. Ministri është përgjegjës për hartimin dhe shpalljen e akteve nën-ligjore që përcaktojnë gjobat administrative monetare për shkeljet e lartcekura. Ministri, gjithashtu është i autorizuar dhe është përgjegjës që të caktojë një ose më shumë autoritete përkatëse publike për zbatimin e akteve nën-ligjore dhe gjobave të lartpërmendura.

Personi ose shoqëria ndaj të cilit është shqiptuar gjoba administrative, ka të drejtë të parashtrojë ankesë para organit administrativ ose gjyqësor sipas Ligjit për Procedurën Administrative.

1.5 Llojet e Shoqërive Tregtare në Kosovë

Ligji për Shoqëritë Tregtare në Kosovë parasheh themelimin e shoqërive tregtare të cilat janë të njohura mirë nga investitorët e huaj. Ligji shprehimisht përcakton se veprimtaria afariste duhet të ushtrohet përmes njëres nga shoqëritë në vijim:

- Ndërmarrje Individuale
- Shoqëri Kolektive
- Shoqëri Komandite
- Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
- Shoqëri Aksionare

i) Ndërmarrja Individuale

Ndërmarrja Individuale (NI) është lloj i shoqërisë tregtare e cila juridikisht nuk ekziston ndaras nga pronari i saj. Ndërmarrje Individuale thjeshtë do të thotë që një person që ushtron veprimtari afariste në emrin e vet dhe për të ekziston vetëm një pronar.

NI-a nuk është person juridik! Pavarësisht nga kjo, Ligji për Shoqëritë Tregtare parasheh që ajo mund të lidhë kontratë, të posedojë pronë, të ngre padi dhe të paditet, në emrin e saj apo të pronarit (ose të dyve). Meqenëse NI juridikisht nuk mund të ekzistojë ndaras nga pronari i saj, pala e vërtetë në këto procedura dhe gjykime mbetet pronari.

Personi i cili ushtron një veprimtari afariste, de jure ose de facto, përmes një Ndërmarrje Individuale ka përgjegjësi të pakufizuara personale për të gjitha borxhet dhe detyrimet tjera që të NI- së, ose të cilat i imponohen me Ligj ose me kontratë. Përgjegjësia është e pakufizuar dhe përfshinë edhe pronën dhe pasuritë të çfarëdo lloji të cilat në mënyrë të drejtpërdrejt ose tërthorazi janë në pronësi të pronarit të ndërmarrjes, pa marrë parasysh se a shfrytëzohet prona ose pasuritë në fjalë për qëllime afariste, personale, apo familjare. Përveç ne disa raste specifike, kjo përgjegjësi e plotë nuk mund të kufizohet në asnjë mënyrë. Si rrjedhojë, përgjegjësia e kufizuar të cilën e gëzojnë korporatat nuk vlen për NI.

ii. Shoqëria Kolektive (“SHKL”)

Ortakëria e përgjithshme është shoqëri e bashkëpunimit në ushtrimin e veprimtarive tregtare e dy apo më shumë personash, pavarësisht nga ajo se a vendoset ky bashkëpunim në bazë të një kontrate të shkruar, marrëveshjeje gojore apo mirëkuptimi.

Sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, një SHKL mund të formohet në dy mënyra. E para, personi mund të formoj SHKL me anë të regjistrimit. Së dyti, SHKL mund të themelohet përmes veprimit të Ligjit, që nënkupton se nga pikëpamja ligjore, nëse dy apo më shumë persona dhe/ose shoqëri bashkëpunojnë në ushtrimin e veprimtarisë afariste, pa marrë parasysh nëse ky lloj bashkëpunimi bazohet në një kontratë me shkrim ose marrëveshje gojore ose mirëkuptim, atëherë ky bashkëpunim vlerësohet të jetë SHKL.

SHKL nuk është person juridik! Megjithatë, ajo ka të drejtë të kontraktoj, të ketë pronë, të padis apo të paditet në emër të saj. Dy pasojat kryesore të lejitimit të personalitetit të ndare janë se ortakëritë do të jenë në gjendje të bëhet ortak në një ortakëri tjetër.

Secili ortak i SHKL është përgjegjës bashkërisht dhe personalisht për të gjitha borxhet dhe detyrimet e tjera të SHKL; dhe kjo përgjegjësi është e pakufizuar. Përgjegjësia shtrihen në tërë pronën personale dhe asetet të cilat janë në pronësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të ortakëve të përgjithshëm.

Përveç nëse është rënë në pajtim ndryshe nga ortakët, ortaku i përgjithshëm i cili jep dorëheqjen ose përndryshe largohet nga SHKL, mbetet përgjegjës ndaj palëve të treta për të gjitha borxhet dhe detyrimet e shoqërisë, të bëra para datës në të cilën ai jep dorëheqje ose përndryshe largohet nga SHKL. Përgjegjësia ndërmjet ortakëve të përgjithshëm rregullohet nga marrëveshja për SHKL, nëse ekziston.

Të gjitha veprimet e ortakëve të përgjithshëm ne emër të SHKL-se, të cilat duket se bëhen me qëllim të zhvillimit të veprimtarisë normale dhe të zakonshme afariste të SHKL janë të detyrueshme për SHKL dhe ortakët tjerë të përgjithshëm. Kjo nënkupton se veprimi i një ortaku konsiderohet veprim të të gjithë ortakëve të tjerë! Ka një përjashtim për këtë rregull, në rastet kur (i) ortaku i përgjithshëm nuk është i autorizuar të veprojë në emër të SHKL; dhe (ii) pala e tretë më të cilën punonte ortaku ishte në njohuri se ortakut i mungon autorizimi i tillë.

Të drejtat dhe detyrimet reciproke të ortakëve:

- Të shkëmbejë të dhënat financiare dhe të gjitha të dhënat e tjera lidhur me veprimtarinë e SHKL
- Te ruaje mirëbesimin dhe informatat konfidenciale për veprimtarinë afariste të SHKL
- Të veprojë gjithmonë në mirëbesim, për interesin më të mirë të SHKL në çështjet që kanë të bëjnë me veprimtaritë afariste
- T'i shërbejë vetëm interesit të SHKL gjatë përfshirjes në një veprimtari ose transaksion në të cilin ortaku i përgjithshëm ka një interes personal

iii. Shoqëria Komandite

Shoqëria Komandite (“SHKM”) është formë e ortakërisë që përveç një ose më shumë ortakëve të përgjithshëm ka edhe një ose më shumë ortakë të kufizuar që bashkëpunojnë me qëllim të ushtrimit të veprimtarisë afariste fitimprurëse si bashkëpronarë. Ortakët e përgjithshëm, në të gjitha aspektet kryesore, janë juridikisht në të njëjtën pozitë sikurse ortakët e një Sh.K.L. Sidoqoftë, ortakët e kufizuar, njëjloj sikurse aksionarët e një korporate, kanë përgjegjësi të kufizuar dhe nuk kanë kompetenca menaxhuese.

Shoqëria komandite nuk është person juridik. Pavarësisht nga kjo, ajo mund të lidhë kontratë, të posedojë pronë, të ushtrojë padi dhe të paditet në emrin e saj. Në SHKM, ortaku i përgjithshëm është pa kurrfarë kufizimi, bashkërisht dhe personalisht përgjegjës për borxhet dhe detyrimet e shoqërisë komandite. Në anën tjetër, ortaku i kufizuar nuk është përgjegjës për borxhet ose detyrimet e tjera të shoqërisë komandite.

SHKM themelohet pas regjistrimit të Memorandumit në Zyrën e Regjistrimit (dokumenti themeltar), i cili duhet të përmbajë një mori informatash. Gjithashtu, çdo Shoqëri Komandite është e detyruar ta ketë një Marrëveshje të SHKM-së. Kjo marrëveshje është dokument ligjor i cili rregullon çështjet e brendshme ndërmjet ortakëve të kufizuar dhe atyre të përgjithshëm.

Marrëveshja e SHKM-së duhet të përmbajë së paku:

- Dispozita që rregullojnë menaxhimin e shoqërisë komandite dhe veprimtarinë e saj;
- Dispozita që rregullojnë të gjitha çështjet e tjera të cilat ortakët dëshirojnë ti përfshijnë në marrëveshje
- Kontributet e Ortakëve të Kufizuar: Secili duhet të paguaj në tërësi kontributin e tij në kohën e regjistrimit të memorandumit të SHKM-së në Zyrën e Regjistrimit.

SHKM nuk është person juridik, por ajo mund të hyjë në marrëveshje dhe të detyrohet nga ato. Megjithatë, vetëm ortaku i përgjithshëm (person ose shoqëri) ka autorizim të veprojë në emër të SHKM, ose t'i krijojë asaj detyrime. Ortaku i kufizuar nuk ka kurrfarë autorizimi të veprojë në emër të SHKM, ose t'i krijojë detyrime asaj. Nëse një ortak i kufizuar përfshihet në një transaksion në emër të SHKM, transaksioni i tillë është i detyrueshëm vetëm nëse një ortak i përgjithshëm formalisht dhe me shkrim e miraton transaksionin e tillë.

Kufizimet mbi Kontrollimin dhe Menaxhimin: Ortaku i kufizuar nuk mund të merr pjesë në kontrollimin ose menaxhimin e veprimtarisë afariste ose aktiviteteve të shoqërisë komandite. Nëse ortakët e kufizuar marrin pjesë në kontrollimin dhe menaxhimin e veprimtarisë tregtare ose aktiviteteve të SHKM, ata do të jenë përgjegjës për të gjitha borxhet dhe detyrimet tjera të shoqërisë komandite në shkallë të njëjtë sikurse ortakët e përgjithshëm.

Nëse nuk është përcaktuar me Marrëveshje, ortaku i kufizuar mund ta bëjë bartjen (transferin) e interesit të tij në shoqërinë komandite vetëm pas dhënies së pëlqimit nga të gjithë ortakët e

përgjithshëm. Bartja e interesit në shoqërinë komandite përfshin edhe bartjen e të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të ortakut të kufizuar.

Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në marrëveshjen e SHKM-së, fitimet dhe humbjet do të ndahen njëllë ndërmjet ortakëve të përgjithshëm dhe të kufizuar, sipas vlerës së kontributeve.

iv. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar (“SH.P.K.”) është formë e organizimit e cila u ofron përgjegjësi të kufizuar të gjithë pronarëve të saj. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është person juridik e cila është e ndarë edhe e dallueshme nga pronarët.

SH.P.K. është person juridik dhe ka personalitet juridik të ndarë nga pronarët e saj. Kjo nënkupton se se SH.P.K. ndër të tjera ka kompetenca për të ushtruar padi ose për të qenë e paditur; të lidh kontrata; të huazojë të holla dhe t’u nënshtrohet borxheve dhe detyrimeve tjera; të votojë, shesë ose në mënyrë tjetër të disponojë me aksionin ose interesin tjetër në një shoqëri tjetër tregtare, përveç ndërmarrjes individuale; dhe të zgjedhë ose emërojë menaxherët, punonjësit dhe agjentët e shoqërisë dhe të përcaktojë detyrat dhe kompensimin e tyre.

Kur organizohet në këtë mënyrë, pasuria e SH.P.K. nuk është në bashkëpronësi nga pronarët e SH.P.K. Pronësia e asetëve të SH.P.K. ndahet në njësi, të cilat shpesh quhen aksione (ngjashëm sikur me aksionet e një korporate). Pronësia mbi asetet e SH.P.K. është interes personal dhe mund të bartet, varësisht prej kufizimeve në fuqi në bazë të Ligjit ose marrëveshjes për shoqërinë. SH.P.K. mund të ketë një apo më shumë persona fizik ose juridik si pronarë.

SH.P.K. është përgjegjëse për të gjitha borxhet e saj dhe detyrimet tjera me tërë asetet duke përfshirë edhe kapitalin themeltar. Megjithatë, përgjegjësia nuk shtrihet në asetet personale të pronarëve të saj, d.m.th., pronarët nuk janë përgjegjës personalisht për borxhet dhe detyrimet e SH.P.K..

Statuti i SHPK-së është dokumenti themelues dhe konstituiv i SH.P.K.. SH.P.K. krijohet pas regjistrimit të statudit të saj në Zyrën e Regjistrimit. Çdo ndryshim i statudit bëhet përmes ndryshimit dhe plotësimit të statudit, i cili ekziston në dosjen në Zyrën e Regjistrimit.

SH.P.K. duhet të ketë edhe një marrëveshje të nënshkruar nga pronarët, e cila rregullon qeverisjen, menaxhimin dhe funksionimin e shoqërisë. Marrëveshje mund të jetë dokumenti më i rëndësishëm për tërë shoqërinë, sepse krijon kornizën në bazë të të cilës formohet SH.P.K. Marrëveshja për SH.P.K. rregullon pjesën më të madhe të marrëdhënieve të brendshme ndërmjet pronarëve të SH.P.K. Megjithatë, duhet të kihet parasysh se marrëveshja nuk mund të kufizojë të drejtat e palëve të treta.

Marrëveshja për “SH.P.K”, së paku, duhet të ketë dispozitat:

- se shoqëria do të menaxhohet nga një ose më shumë drejtorë menaxhues;
- rregullat specifike në lidhje me kohën, bendin, qëllimin ose procedurën e votimi në mbledhjen e pronarëve;
- specifikimet lidhur me kategoritë e pronarëve dhe të drejtat e tyre të votimit, preferencat tjera;
- përcaktimin e votave dhe aksioneve të pronarëve (nëse do të bëhet në bazë të kapitalit, ose në ndonjë mënyrë tjetër);

- listën e veprimeve të cilat kërkojnë shumicën absolute, ose ato të cilat mund të merren nga drejtori menaxhues, pa votim të pronarëve;
- mënyrën e zgjedhjes së çështjeve kur pronarët nuk mund të arrijnë marrëveshje për zgjidhjen e çështjeve, kur pronarët nuk mund të arrijnë marrëveshje/të marrin vendim;
- të drejtat e pronarëve për t'ua shitur interesat e tyre një ose më shumë pronarëve tjerë në bazë të kushteve të akorduara paraprakisht;
- se disa menaxherë të caktuar do të kenë detyra dhe autorizime specifike, dhe/ose rregullat për rregullimin e bartjes së interesit pronësor në pajtim me këtë Ligj.

Në rast të konfliktit ndërmjet statutit dhe marrëveshjes së SH.P.K., statuti mbizotëron dhe Marrëveshja për SH.P.K. duhet të ndryshohet që të përmirësohet mospërputhja.

Kontributi i një pronari në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar në këmbim të interesit pronësor, mund të bëhet në (i) të holla, (ii) pronë tjetër të vlefshme, materiale ose jo-materiale ose (iii) me punë ose shërbime tashmë të kryera për shoqërinë. Premtimi për kryerjen e punëve ose shërbimeve në të ardhmen nuk konsiderohet si kontribut i vlefshëm dhe nuk këmbëhet me interesa pronësore.

SH.P.K. mund të bëjë një shpërndarje për pronarët e saj në çdo kohë me miratimin unanim të pronarëve ose siç parashihet me Marrëveshjen e SHPK-së. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në Marrëveshjen për SH.P.K., çdo shpërndarje për pronarët, duhet të jetë e barabartë për të gjithë. SH.P.K. nuk mund të bëjë shpërndarje, nëse kjo shpërndarje bënë që asetet e kompanisë të jenë më të vogla se detyrimet e saj, ose nëse SH.P.K. nuk është në gjendje të mbulojë borxhet dhe detyrimet gjersa ato matarohen.

Pronësia në SH.P.K. mund të bartet në mënyrë të lirë, përveç nëse është e kufizuar me Marrëveshjen për SHPK.

v. Shoqëria Aksionare

Shoqëria Aksionare ("SHA") është forma e fundit e organizimit afarist e lejuar sipas Ligjit të Kosovës. Shoqëria lëshon certifikata të pronësisë ose aksione në shkëmbim të secilit kontribut, dhe aksionarët janë të lirë të bartin interesin e tyre pronësor ose t'ua shesin aksionet e tyre personave të tjerë në çdo kohë.

Sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, SHA është person juridik, që është në pronësi të një ose më shumë pronarëve (aksionarëve) dhe e cila është juridikisht e ndarë dhe e veçantë nga aksionarët e saj. SHA ka kompetenca të ushtrojë padi ose të paditet; të lidh kontrata, të huazojë të holla dhe t'i nënshtrohet borxheve dhe detyrimeve tjera; të zgjedhë ose emërojë menaxherët, punonjësit dhe agjentët e shoqërisë dhe të përcaktojë detyrat dhe kompensimet e tyre, etj.

Pronësia mbi njësitë e SHA është interes personal dhe mund të bartet, varësisht prej kufizimeve të përcaktuara në këtë Ligj ose në Marrëveshjen e Shoqërisë. SHA lëshon certifikata si dëshmi për pronësinë, megjithatë këto certifikata nuk janë të domosdoshme.

SHA është përgjegjëse për borxhet dhe detyrimet e saj me të gjitha asetet e saj, përfshirë edhe kapitalin themeltar. Megjithatë, kjo përgjegjësi nuk shtrihet edhe në asetet personale të pronarëve, d.m.th. pronarët nuk janë përgjegjës personalisht për borxhet dhe detyrimet e SHA.

Themeluesit e SHA janë përgjegjës bashkërisht dhe personalisht për veprimet e tyre në emër të SHA para regjistrimit të SHA. Autorizimi i themeluesve përfundon me regjistrimin e SHA dhe

pas kësaj, SHA mund të marr përgjegjësinë për veprimet e themeluesve para regjistrimit.

Statuti i SH.A është dokumenti themelues dhe konstituiv i SHA i cili duhet të miratohet nga aksionarët para se të dorëzohet në Zyrën e Regjistrimit. Çdo ndryshim i statutit bëhet përmes ndryshimit dhe plotësimit të statutit, i cili ekziston në dosjen në Zyrën e Regjistrimit

Rregulloret janë dokumente, të cilat miratohen, ndryshohen ose revokohen nga aksionarët ose bordi i drejtorëve. Rregulloret përmbajnë dispozitat për menaxhimin dhe funksionimin e shoqërisë. Rregulloret rregullojnë çështjet e brendshme, por nuk mund të rregullojnë të drejtat e palëve të treta. Nëse shfaqet konflikt ndërmjet statutit dhe rregulloreve të shoqërisë, statuti mbizotëron.

Menjëherë pas regjistrimit të shoqërisë aksionare, drejtorët fillestarë të emëruar me statut, duhet të mbajnë mbledhje organizative për të kompletuar organizimin e shoqërisë përmes zgjedhjes së zyrtarëve fillestarë, si dhe të ushtrojnë veprimtaritë përkatëse nën autorizimin e tyre.

Shoqëria aksionare mund të emetojë dy lloj aksionesh, aksione të thjeshta dhe aksione të privileguara. Shoqëria duhet të emërojë se paku një aksion të thjeshtë. Aksionet duhet të kenë vlerën e theksuar nominale. Nëse aksioni ka vlerën e theksuar nominale, atëherë kjo vlerë duhet të jetë më së paku 1 (një) Euro.

Aksionet e certifikuara.- Janë aksione të cilat përfaqësohen nga certifikata e aksioneve, kurse aksionet e pa certifikuara janë aksione të cilat nuk e përfaqësojnë asnjë lloj dokumenti.

Shoqëria aksionare mund të krijojë dhe të emitojë letra të tjera me vlerë, përveç aksioneve - bonde, - letra me vlerë të konvertueshme në aksione, dhe - mundësi për blerjen e aksioneve. Aksionet paguhen proporcionalisht dhe mund të paguhen në të holla dhe përmes letrave me vlerë. Bondet janë njëra prej mënyrave që shoqëria aksionare të rrisë kapitalin e saj për investime.

Kapitali themeltar për një shoqëri aksionare është 10.000 €, ose shuma e gjithmbarshme e vlerës nominale e të gjitha aksioneve të emetuara nga shoqëria në kohën e regjistrimit fillestar. Kapitali themeltar paraqet shumën nominale që është në dispozicion në përmbushjen e pretendimeve të kreditorëve.

Shpërndarjet - Bordi i drejtorëve të shoqërisë aksionare, nëse është i autorizuar në bazë të statutit ose me vendim të aksionarëve, mund të deklarojë dhe të paguajë dividend (shpërndarje) në të gjitha, por jo më pak se të gjitha aksionet e emetuara të çfarëdo lloji ose kategorie. Bordi i drejtorëve ka të drejtë të ndërmerr këtë veprim në çdo kohë.

Bordi i drejtorëve.- Çdo shoqëri aksionare duhet të ketë një bord të drejtorëve. Veprimtaria tregtare e shoqërisë menaxhohet nga ose sipas udhëzimeve të bordit të drejtorëve. Çdo drejtor duhet të jetë person fizik. Statuti i shoqërisë mund të përcaktojë kushte të tjera për kualifikimin e drejtorit.

Bordi duhet të mbajë së paku një mbledhje vjetore, por mund të mbajë edhe më shumë. Drejtorëve duhet t'iu dërgohet njoftimi për mbledhje dhe vendimet kryesore merren gjatë këtyre mbledhjeve, në mënyrë që një veprim i huaj të hyjë në fuqi. Shumica e drejtorëve që janë të pranishëm duhet të votojnë për atë veprim.

Kompetencat e aksionarëve.- Siç u tha më lart, shoqëria aksionare duhet të mbajë mbledhjen vjetore të aksionarëve brenda 60 ditësh pasi bordi të merr pasqyra të audituara financiare të

shoqërisë për secilin vit kalendarik. Shoqëria aksionare mund të mbajë edhe mbledhje të jashtëzakonshme të aksionarëve. Edhe aksionarët kanë disa kompetenca ekskluzive që rezervohen për ata me ligj.

Shpërbërja dhe likuidimi.- Shoqëria aksionare mund të shpërbëhet dhe veprimtaria e saj të likuidohet, në çdo kohë, me një vendim të bordit të drejtorëve dhe aksionarëve, si vijon:

- bordi i drejtorëve i shoqërisë apo aksionarët duhet të miratojnë një vendim për shpërbërjen ose likuidimin e propozuar dhe duhet ta dorëzojnë për miratim në mbledhjen e aksionarëve, që mund të jetë mbledhje vjetore ose e jashtëzakonshme.
- njoftimi me shkrim për propozimin dhe planin duhet t'iu dërgohet të gjithë aksionarëve që kanë të drejtë pjesëmarrjeje në mbledhje dhe në mbledhje, propozimi miratohet me votën pohuese të së paku 2/3 të aksionarëve që kanë të drejtë vote në propozim në këtë mbledhje.

Përveç formave të sipër cekura të shoqërive tregtare, ekzistojnë edhe forma tjera të subjekteve ekonomike:

vi. Ndërmarrjet publike.

Këto ndërmarrje kryejnë veprimtari me interes të përgjithshëm dhe themelohen nga shteti. Qëllimi i themelimit dhe funksionimit është plotësimi i nevojave publike. Ky interes shfaqet në disa veprimtari: energjetikë, postë-telekom, informim etj. Ato kanë cilësinë e personit juridik, pasurinë e vet dhe përgjigjen vetëm me pasuri të vet e jo edhe me pasuri të themeluesve të saj. Pozita e tyre juridike pjesërisht rregullohet me Ligjin për Ndërmarrjet, kurse rregullimi detaj i tyre bëhet me dispozita të posaçme.

vii. Ndërmarrjet shoqërore

N.SH ushtrojnë veprimtarinë e tyre me kapital shoqëror, përkatësisht me mjete shoqërore. Për dallim nga shoqëritë tregtare, ndërmarrja shoqërore nuk është e përcaktuar me formën e vetë, por me bazën e veçantë pronësore të afarizmit të vet. Për shkak se nuk ekziston titullari i pronësisë shoqërore, atëherë si bartës të ushtrimit të të drejtave, të cilat dalin nga kjo e drejtë, paraqiten të punësuarit në një ndërmarrje të tillë. Ata janë bartës të punës me mjete të afarizmit të ndërmarrjes shoqërore dhe, nga kjo bazë, janë bartës të së drejtës së qeverisjes së ndërmarrjes, e cila shprehet si vetëqeverisje, përkatësisht si vetëqeverisje e punëtorëve. Në një sistem të këtillë punëtorët nuk janë pronarë të mjeteve me të cilët punon ndërmarrja shoqërore, as veç e veç e as kolektivisht, por ata nuk janë as pronarë të kësaj ndërmarrjeje.

viii. Kooperativat

Kooperativat janë formë e organizimit të personave fizikë (kooperativistët), të cilët i realizojnë interesat e tyre ekonomike, sociale dhe kulturore në bazë të parimeve të vullnetit, reciprocitetit dhe solidaritetit, si dhe të drejtave të barabarta të qeverisjes. Kemi këto lloje të kooperativave: bujqësore, zejtare, rinore, studentore, kursimore, të konsumatorëve, banesore etj.

ix. Odat ekonomike

Odat Ekonomike janë asociacione të organizatave ekonomike, detyrë e të cilave është që të punojnë në përparimin e ekonomisë, si tërësi, në territorin e veprimit të tyre. Odat janë urë lidhëse ndërmjet ndërmarrjeve dhe shtetit. Oda është person juridik. Anëtarësimi është i obligueshëm. Odën e administrojnë anëtarët e saj, përmes përfaqësuesve të vet në organet e Odës. Organet e Odës janë: Kuvendi i Odës, Bordi Drejtues, Këshilli Mbikëqyrës dhe Kryetari i Odës. Oda e ka edhe sekretarin.

1.5.1 Veprimtaritë dhe Qëllimet e Lejuara për Themelimin e Shoqërisë Tregtare

Në Kosovë, çdo person, organizatë, ose grup mund të themelojë dhe të regjistrojë një shoqëri tregtare për çfarëdo qëllimi të ligjshëm si dhe të angazhohen në çfarëdo veprimtarie të ligjshme. Megjithatë, shoqëritë të cilat organizohen në bazë të këtij ligji duhet:

- t'i përmbahen të gjitha kushteve të imponuara me një akt tjetër primar ligjor; dhe
- t'i sigurojnë të gjitha lejet e domosdoshme (pasi që regjistrimi nuk i përjashton detyrimet për marrjen e lejeve të nevojshme për veprimtari të caktuara)

Sa i përket lejes, ajo mund të lëshohet vetëm nëse shoqëria:

- i ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore për t'u pajisur me lejen është regjistruar në Regjistër

1.5.2 Keqpërdorimet në Ekonomi

i. Marrëveshjet monopolistike -janë ajo që lidhet mes dy ose më shumë subjekteve mbi kushtet e afarizmit, të cilat synojnë të pengojnë konkurrencën e lirë. Me këtë marrëveshje zakonisht bëhet ndarja e tregut, kufizohet vëllimi i prodhimit të mallit të caktuar, bëhet shpërndarja e disa burimeve të furnizimit, caktohen çmimet e shitjes, caktohet që qarkullimi i mallit të bëhet vetëm përmes subjekteve të caktuara ekonomike etj. Kjo marrëveshje është e ndaluar me ligj dhe është e sanksionuar si vepër penale me Kodin Penal të Kosovës.

Monopoli në afarizmin ekonomik është një gjendja, në të cilën një subjekt ekonomik ose disa sish, me marrëveshje, zënë në treg vend sundues në dërgimin (livrimin) e mallit ose shërbimit të caktuar, duke përjashtuar konkurrencën nga ajo fushë. Fjala është për monopolin tregtar. Ky lloj monopoli paraqet kufizim të tregut. Për këtë arsye, ky akt ose veprim, me të cilin krijohet ose nxitet pozita monopoliste në treg, është kundërligjor.

ii. Dampingu- do të thotë shitje e mallit në tregun e jashtëm nën çmimin e mallit të njëjtë në tregun e vendit. Pra, damping është eksportimi i mallit me çmime më të ulëta se ato në tregun e vendit. Kështu bëhet diskriminimi i blerësve në tregjet e ndryshme përmes çmimeve. Kemi edhe dampingun valutor, i cili ka të bëjë me devalvimin e valutës në përqindje më të madhe sesa ajo që do të ishte e nevojshme për përmirësimin e valutës me masa devalvuese.

iii. Luftimi i akteve spekulative në ekonominë e tregut-Spekulimi është fitim i dobisë materiale të pamerituar, duke krijuar çrregullime në aspektin e furnizimit të tregut ose rritjes së paarsyeshme të çmimit. Është kjo një sjellje dhe vepër e palejueshme sipas ligjit.

spekulimet:

- fshehja e mallit;
- kufizimi ose ndalja e shitjes së mallit;
- vështirësimi a pamundësimi i blerjes së mallit;
- lidhja fiktive e kontratave;
- mosrespektimi i afatit të dërgimit të mallit.

iv. Marrëveshjet e ndaluara

Marrëveshja ndërmjet ndërmarrjeve, vendimi i një shoqate të ndërmarrjeve ose një praktikë e ndërmarrjeve është e ndaluar nëse mund të ndikojë në tregtinë brenda Kosovës, dhe mund të ndikojë në mënyrë të dukshme në parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konkurrencës në Kosovë. Ndalesat e vendosura në mënyrë specifike zbatohen për një marrëveshje, vendim ose praktikë që:

- Në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë përcakton çmimin shitës ose blerës ose çfarëdo afati apo kushti tjetër në tregti ose biznes;
- Kufizon ose kontrollon prodhimin, tregun, zhvillimin teknologjik ose investimet;
- Kufizon, ndan ose merr pjese në tregun ose në një apo me shumë burime zbaton kushte të ndryshme për transaksione të ngjashme me ndërmarrje të tjera, duke i vendosur ato në një pozitë të papëlqyeshme konkurruese;
- Kushtëzon që lidhja e kontratës të varet nga palët tjera kontraktuese, përmes kushteve të tjera plotësuese që për nga natyra e tij/saj e që sipas natyrës dhe praktikës së zakonshme tregtare, nuk kanë lidhshmëri me objektin e kontratës së tillë.

Marrëveshja ose vendimi që është i ndaluar me këto rregulla është e pavlefshme dhe e pazbatueshme. Personi, ndërmarrja ose shoqata e ndërmarrjeve që tenton të ekzekutojë, detyrojë, zbatojë dhe/ose ushtrojë marrëveshjen, vendimin ose praktikën në fjalë, do të dënohet me gjobë administrative dhe penale që përcaktohen me këtë ligj.

v. Marrëveshjet vertikale

Ndalimi themelor në marrëveshjet që kufizojnë lirinë e palëve për caktimin e çmimeve dhe kushteve në transaksionet me palët e treta: Marrëveshja ndërmjet ndërmarrjeve lidhur me mallra ose shërbime dhe që ndikon në një treg brenda Kosovës është e ndaluar për aq sa ajo e kufizon lirinë e palës për vendosjen e çmimeve në ngarkim të palëve të treta ose çfarëdo kushti thelbësor në marrëveshjet e lidhura me palët e treta. - Kontrollimi i shpërdorimit të transaksioneve ekskluzive tregtare:

Marrëveshja ndërmjet ndërmarrjeve që përfshin mallrat ose shërbimet dhe që vendos mbi një palë

- një kufizim të lirisë së shfrytëzimit të mallrave të furnizuara ose të mallrave ose shërbimeve të tjera;
- një kufizim të lirisë së blerjes ose shitjes së mallrave dhe shërbimeve të tjera për palët e treta; një kufizim mbi lirinë e shitjes së mallrave të furnizuara palëve të treta; ose
- një obligim për blerjen e mallrave ose shërbimeve që, nga karakteri i tyre ose praktika e zakonshme komerciale, nuk kanë të bëjnë me lëndën themelore të marrëveshjes në fjalë,

ndalohen nëse kufizimet ose obligimet e tilla dukshëm e dëmtojnë tregun e mallrave ose shërbimeve përkatëse.

vi. Keqpërdorimi i pozitës dominuese

Sipas ligjit aktual në Kosovë, ndalohet shpërdorimi i pozitës dominuese nga një ose më shumë ndërmarrje. Për t'u konstatuar shpërdorimi i pozitës dominuese, së pari duhet të përcaktohet ekzistimi i kësaj pozite. Konstatimi i ekzistimit të pozitës dominante: Ndërmarrja ka pozitë dominuese nëse, si furnizuese ose blerëse e disa llojeve të caktuara të mallrave ose shërbimeve, ajo:

- Nuk i nënshtrohet konkurrencës së vërtetë; ose
- Ka fuqi superiore në treg në krahasim me konkurrentët e saj ekzistues ose potencial;

Për ta konstatuar këtë, merret parasysh veçanërisht pjesëmarrja dhe pozita e saj në tregun përkatës, fuqia e saj financiare, qasja e saj ndaj furnizimeve ose tregjeve, lidhjet e saj me ndërmarrjet e tjera, pengesat juridike ose faktike për hyrjen e ndërmarrjeve të tjera në treg, konkurrenca aktuale ose potenciale me ndërmarrjet e themeluara brenda ose jashtë Kosovës, lehtësia ose vështirësia me të cilën ajo mund të ndryshojë furnizimin e mallrave ose shërbimeve të tjera si dhe aftësitë e furnizuesve ose klientëve të saj që të zhvillojnë afarizëm me ndërmarrje të tjera. Një ndërmarrje konsiderohet të ketë pozitë dominuese nëse ka pjesëmarrje më të madhe se 40% në treg. Ky konsiderim nuk është i aplikueshëm në rast se ndërmarrja në fjalë bindshëm demonstroi se është e ekspozuar para një konkurrence të konsiderueshme ose që nuk ka pozitë superiore në treg në krahasim me konkurrentët e vet, duke i marr parasysh faktorët e specifikuar më lart.

Konstatimi i shpërdorimit të pozitës dominuese: Shpërdorimi i ndaluar i pozitës dominuese ekziston nëse, si furnizues ose blerës i disa llojesh të caktuara të mallrave ose shërbimeve, një ose më shumë ndërmarrje me pozitë dominuese:

- Ndikon negativisht në konkurrencën e tregut duke dëmtuar aftësinë e ndërmarrjeve tjera për konkurrim në treg;
- Kërkon pagesa ose kushte të tjera afariste që dallojnë nga ato do të mbizotëronin po të kishte konkurrencë efektive;
- Shfrytëzon pozitën në treg për të krijuar ndërmarrje tjera që i Dhurojnë atij qëllime privilegjuese, përveç nëse qëllimi është i arsyeshëm për një trajtim të tillë favorizues.

1.6 Përmbledhje

Në këtë modul janë paraparë për trajnim, tema hyrëse për të drejtën ekonomike dhe për veprimtarinë gjyqësore të Departamentit për Çështje Ekonomike, si departament i specializuar për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndëve nga fusha e së drejtës ekonomike.

Qëllimi i Ligjit për Shoqëritë Tregtare është krijimi i një sistemi për ushtrimin e afarizmit në Kosovë. Ligji, gjithashtu, parasheh edhe kushtet e regjistrimit për llojet dhe mekanizma të ndryshëm për të siguruar që kushtet e regjistrimit të plotësohen.

Në këtë modul janë dhënë shpjegime lidhur me:

- Procesin legjislativ dhe legjislacionin në fuqi që rregullojnë ushtrimin e afarizmit në Republikën e Kosovës.
- Qëllimet kryesore të LSHT dhe fushëveprimin e tij
- Llojet e shoqërive tregtare të lejuara me ligjin e Kosovës për Shoqëritë Tregtare
- Veprimtaritë të cilat mund të ushtrohen përmes shoqërive tregtare të regjistruara si dhe qëllimet tjera të lejuara për themelimin e tyre
- Keqpërdorimet në ekonomi

2. Falimentimi, likuidimi dhe riorganizimi i personave juridikë

2.1 Hyrje

Ligji i Kosovës për falimentimin Ligji Nr. 05/L-083 (në vijim LF) I miratuar nga Kuvendi i Kosovës më me 09.06.2016, zëvendësoi ligjin e mëparshëm,(LIGJI Nr. 2003 / 4 për Likuidimin dhe Riorganizimin e personave juridik në Falimentim “ligji i mëparshëm për falimentimin”). Gjatë 13 viteve të ekzistencës së ligjit të mëparshëm për falimentimin ka pasur vetëm një rast të parashtruar në gjykatë.

Ligji i ri për falimentimin u shfaq si nevojë e domosdoshme për rregullimin e procedurës së likuidimit dhe riorganizimit të shoqërive tregtare, pasi ligji i mëparshëm ishte i pakompletuar, mbështetej në rregullore të cilat asnjëherë nuk ishin shpallur dhe si pasojë ky ligji u bë i pazbatueshëm.

Ligji i ri për falimentimin përbën ligj gjithëpërfshirës mbi falimentimin dhe josolvencën, i cili i pasqyron praktikën më të mira ndërkombëtare, por përmban shumë institute dhe specifika tjera të cilat pothuajse ishin të panjohura në sistemin tonë juridik.

Ky ligj rregullon procedurat e likuidimit dhe riorganizimit të të gjitha shoqërive tregtare, duke përfshirë edhe bizneset individuale, ortakëritë dhe shoqëritë komandite, që përbën ndryshim thelbësor nga ligji i vjetër.

Ligji përmban 9 kapituj në të cilët rregullon procedurën e riorganizimit dhe likuidimit duke përfshirë edhe konceptet e reja si: Lehtësimi i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, Lirimi Individual dhe Procedurat ndërkombëtare.

Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji pritet një rritje e dukshme e rasteve, prandaj duke pasur parasysh risitë që sjell ky ligj dhe rritja e rasteve që pritet të paraqiten para gjykatave, trajtimi i kësaj teme, është e një rëndësie të veçantë për rritur njohuritë e gjyqtarëve.

2.2 Objektivat trajnues

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Kuptojnë qëllimet kryesore të ligjit dhe fushëveprimin e tij;
- Dallojnë procedurat e përsheptuara dhe specifikat e tyre;
- Analizojnë specifikat e hapjes së rastit të falimentimit, procedurat ligjore, afatet dhe vendimet e gjykatës;
- Vlerësojnë pasojat e hapjes së rastit;
- Njohin kërkesat e kreditorëve, mënyra e paraqitjes, afatet dhe prioriteti i kërkesave;
- Zgjerojnë njohuritë lidhur me Riorganizimi, likuidimin dhe specifikat e tyre.
- Njohin lirin individual dhe Mbyllja e rastit – kushtet ligjore.

2.3 Falimentimi

Falimentimi është procedurë ligjore përmes së cilës shoqëritë tregtare, të cilat nuk mund t'i paguajnë borxhet e tyre dhe të përmbushin detyrimet e tyre mund të kenë një fillim të freskët financiar dhe të fitojnë mbrojtje nga kreditorët.

Disa prej përfitimeve nga parashtrimi i kërkesës për falimentim janë:

- Mënjanimi i detyrimit ligjor për të paguar shumicën e borxheve ose tërë borxhet, së paku për një kohë.
- Parandalimi i rimarrjes në posedim të aseteve;
- Ndalimi i veprimeve të kreditorëve për marrjen e parave (p.sh. ngacmimi për mbledhjen e borxhit);
- Dhënia e mundësisë për negocimin e borxhit;
- Ofrimi i mundësisë për të riorganizuar ndërmarrjen dhe ta çuar në këmbë atë; etj.

Procedura e falimentimit në Kosovë rregullohet me Ligjin e Kosovës për falimentimin Ligji Nr. 05/L-083, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më me 09.06.2016.

Ligji i ri është i strukturuar në 9 kapituj:

- Procedurat e përshpejtuara (NVM dhe para-pakot)
- Fillimi dhe hapja e rasteve
- Pasojat e hapjes së rastit
- Kërkesat e kreditorëve
- Riorganizimi
- Likuidimi
- Lirimi individual dhe Mbyllja e rastit
- Dispozitat ndërkufitare.

Falimentimi është një gjendje e shpallur ligjore e pamundësisë apo mundësisë së zvogëluar të një personi fizik apo juridik që t'i paguajë detyrimet ndaj kreditorëve. Sipas ligjit, vetëm shoqëritë tregtare (përfshirë bizneset individuale) mund ta përdorin ligjin. Nuk ka procedura ndaj konsumatorëve. Të përjashtuara nga fushëveprimi i ligjit janë agjencitë qeveritare, zotërimi i ndërmarrjeve shoqërore, kompanitë e sigurimeve, pensionale dhe institucionet financiare. Falimentimi mund të jetë vullnetar apo i detyrueshëm.

Falimentimi vullnetar.- Është proces i iniciuar nga vetë personi që ka vështirësi me pagesën e detyrimeve ndaj kreditorëve, pra, kërkimi i tij për mbrojtje nga gjykata.

Falimentimi i detyruar.- Ndodh kur kreditorët e një personi paraqesin kërkesën e falimentimit që t'i shpëtojë një pjesë e kredisë që debitori ia ka borxh apo që të fillojë riorganizimin e një shoqërie.

Kompetente për paraqitjen e kërkesës për falimentim është Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Ekonomike (për tërë territorin e Republikës së Kosovës).

2.3.1 Fillimi i procedurës së falimentimit

Rasti i falimentimit fillon me paraqitjen e kërkesës me shkrim në gjykatë nga ana e debitorit, kreditorit apo grupit të kreditorëve. Forma dhe përmbajtja e kërkesës përcaktohet me ligj.

Debitori mund të paraqet kërkesë vetëm plotësohen kushtet në vijim:

- Debitori nuk duhet të jetë në situatë të paaftësisë paguese për tu kualifikuar për të qenë debitor sipas këtij ligji.
- Nëse debitori paraqet një kërkesë për qëllime të papërshtatshme ose me qëllim të mashtrimit ose shkakimit të dëmit ndaj kreditorëve, gjykata mund ti shqiptojë gjobë debitorit ose anëtarëve individual të trupave menaxhues ose qeverisës së debitorit.
- Konsiderohet se debitori ka paraqitur një kërkesë për qëllime të papërshtatshme ose me qëllim të mashtrimit ose shkakimit të dëmit ndaj kreditorëve sipas paragrafit (3) të këtij neni, nëse debitori:
 - Paraqet kërkesë pa e dhënë emrin e tij të saktë, ose
 - Nuk i liston të gjithë emrat e mëparshëm përmes të cilave ka qenë i përfshirë në afarizëm; ose
 - Nuk e liston një kreditor dhe si rezultat ai kreditor nuk pranon njoftim për inicim të procedurës; ose
 - Ofron informata të rrejshme në cilëndo fazë të procedurës ose tenton të manipulojë me procedurën në çfarëdo forme

Gjykata do të shqiptojë gjoba debitorit në rastet mësipërme, nga 500 euro deri në 10,000 euro dhe paguhet në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Kreditorët apo grupi i kreditorëve mund të paraqesin kërkesë për fillimin e rastit sipas këtij ligji kundër një debitori të zgjedhur kur:

Rastet jo vullnetare të falimentimit mund të iniciohen nga kreditorët nën kushtet në vijim:

- Dy (2) ose më shumë kreditorë mund të paraqesin kërkesë për inicim të rastit ndaj një debitori kur:
 - debitori ka dështuar të paguajë të paktën nga një detyrim ndaj secilit kreditor, dhe
 - secilit detyrim i ka kaluar afati i pagesës prej të paktën nëntëdhjetë (90)ditë; dhe
 - totali i një detyrimi është të paktën në vlerë prej tremijë (3,000) Euro; dhe
 - secili detyrim është detyrim pa kushte dhe nuk është në procedurë kontestimore pranë një gjykatë ose në procedurë të arbitrazhit.
 - debitori përgjithësisht nuk është duke i paguar borxhet pas arritjes së afatit të pagesës, dhe borxhi total i detyrimeve të papaguara ka tejkaluar pesëmijë (5,000) euro.

Gjykata duhet që në afatin tre (3) ditor të njoftojë debitorin për paraqitjen e kërkesës për inicim të procedurës së falimentimit.

Gjykata gjithashtu duhet të caktojë afatin brenda të cilit debitori duhet të paraqesë përgjigjen me shkrim ndaj kërkesës dhe seancën dëgjimore për pranueshmërinë e kërkesës. Të gjitha këto informata gjykata duhet t'i paraqesë në njoftimin e dërguar palëve. Gjatë periudhës së ndërmjetme, gjykata lëshon urdhër drejtuar palëve me qëllim të sigurimit të kërkesave të debitorit dhe kreditorëve. Urdhret e tillë duhet të kërkohen dhe provohen si të domosdoshme nga palët.

2.3.2 Pasoja juridike të hapjes së rastit

Hapja e rastit ka për pasoja juridike:

- e krijon pasurinë e falimentimit;
- i jep gjykatës juridiksion ekskluziv për pasurinë e falimentimit dhe mbi debitorin;
- vendos moratoriumin,
- në procedurë të likuidimit, shkarkon tërësisht debitorin nga kontrolli i pronave të tij;
- në procedurë të riorganizimit në të cilën nuk është i emëruar dhe nuk kërkohet administratori, i jep debitorit të gjitha të drejtat dhe detyrimet e debitorit në posedim; dhe
- në procedurë të riorganizimit në të cilën është i emëruar administratori, e shkarkon tërësisht debitorin nga kontrolli i pronave të tij dhe e ngarkon administratorin me kontroll të plotë të atyre pronave.

Me hapjen e rastit, gjykata njofton brenda dy (2) ditëve, me shkrim: regjistrin e bizneseve, regjistrin e pengut, bankat komerciale, regjistrin e kredive të Bankës Qendrore dhe administratën tatimore për hapjen e rastit, të cilët janë të obliguar që të shënojnë në regjistrat e tyre fillimin e procedurës së falimentimit; Gjykata shpall njoftimin në tabelën e shpalljes të Gjykatës dhe në më se paku dy (2) gazeta ditore, cakton Administratorin në rast të fillimit të procedurës së likuidimit, vendos kohën, datën dhe vendin e takimit të parë të kreditorëve, më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë pas hapjes së rastit, njofton palët për caktim të administratorit dhe do të caktoj datën, kohën dhe vendin e takimit të parë të administratorit me kreditorët.

Gjykata cakton një seancë dëgjimore preliminare dhjetë (10) ditë pas caktimit të takimit të parë të kreditorëve për të përcaktuar gjendjen dhe rezultatet e takimit të kreditorëve. Gjykata urdhëron prezencën e debitorit ose përfaqësuesit të tij në këtë seancë dëgjimore.

Kur hapet rasti:

- Krijohet pasuria e falimentimit
- Gjykata ka juridiksion ekskluziv mbi pasurinë e falimentimit dhe debitorin
- Vendoset moratorium mbi të gjitha veprimet ndaj debitorit
- Shkarkon tërësisht debitorin nga kontrolli i pronave të tij, nëse caktohet administratori
- I jep debitorit të gjitha të drejtat dhe detyrimet e administratorit në posedim të debitorit nëse nuk kërkohet ndonjë administrator

Gjykata do të caktojë Përfaqësuesin e pasurisë falimentuese, i cili:

- Do të administrojë me të gjithë pasurinë falimentuese;
- Mund të padisë dhe të jetë i paditur në emër të pasurisë falimentuese;
- Kryen të gjitha detyrat e specifikuar në këtë ligj për përfaqësuesin e pasurisë falimentuese.
- Në procedurë të likuidimit, Administratori i falimentimit do të jetë përfaqësuesi i pasurisë falimentuese.
- Në procedurë të riorganizimit, debitori është përfaqësuesi i pasurisë falimentuese kur vepron si debitori në posedim. Në rastet kur gjykata e emëron një Administrator të falimentimit, Administratori duhet të jetë përfaqësuesi i pasurisë falimentuese në riorganizim.

Me hapjen e procedurës së falimentimit debitori ka obligim për bashkëpunim dhe shpalosje. Debitori ka për detyrë thelbësore veprimin me mirëbesim dhe shpalosjen e plotë gjatë veprimeve

të tij në përputhje me këtë ligj. Debitorit nuk i lejohet t'i ofroj gjykatës ose kreditorëve informata që janë të rreme ose mashtruese, ose të refuzojë të jap një informatë e cila nëse nuk jepet nga debitorit mund të sjell gjykatën dhe kreditorët në lajthim, mashtrim ose pasaktësi të informacionit. Debitorit është i detyruar të bashkëpunoj me Administratorin në të gjitha çështjet dhe do ti ofroj administratorit qasje pa vonesë në të gjitha dokumentet dhe informatat që kanë të bëjnë me aktivitetin dhe resurset e debitorit, duke përfshirë të gjithë informacionin për kërkesat, pronat dhe transaksionet e shpalosura.

Debitorit është i obliguar të shpalosë: Listën e të gjithë kreditorëve për të cilët ai ka njohuri se ekzistojnë, së bashku me informatat kontaktuese për secilin prej tyre; Listën e të gjitha kërkesave ndaj debitorit për të cilat ai ka njohuri se ekzistojnë, së bashku me vlerën e secilës kërkesë, datën e përafërt kur janë shfaqur kërkesat dhe informacionin nëse kërkesa është e kontestuar, e mundshme ose e pamaturuar; Listën e të gjitha aseteve të debitorit, së bashku me një vlerësim të përgatitur me mirëbesim në lidhje me vlerën e atyre aseteve.

Nëse një aset është i prekshëm, debitorit duhet të jap lokacionin se ku gjendet ai aset; nëse asetit është i paprekshëm atëherë debitorit duhet të jap informacion se kush është personi i detyruar ndaj asetit të paprekshëm dhe informatat kontaktuese të tij;

2.3.3 Moratoriumi

Një kërkesë për inicim të procedurës së falimentimit vendos ndaj të gjitha entiteteve, moratoriumin dhe urdhër ndalesë pa paralajmërim në lidhje me:

- fillimin ose vazhdimin e çfarëdo veprimi gjyqësor, administrativ ose çfarëdo veprimi ose procedure të drejtuar kundër aktiviteteve afariste të debitorit ose pronave të tij duke përfshirë çfarëdo bllokimi të llogarive bankare dhe veprimeve të cilat janë iniciuar ose do të mund të inicioheshin para inicimit të procedurës së falimentimit;
- përmbarimin ndaj debitorit dhe pronave të tij të çfarëdo aktgjykimi të nxjerr para inicimit të procedurës së falimentimit ose hapjes së rastit, përderisa përmbarimi i tillë është i ndërlidhur me aktivitetet afariste të debitorit;
- çfarëdo veprimi me qëllim të marrjes në posedim ose me qëllim të ushtrimit të kontrollit ndaj pronave pjesë të pasurisë së falimentimit;
- çfarëdo veprimi me qëllim të krijimit, regjistrimit ose përmbarimit të një barre ndaj pronave pjesë të pasurisë së falimentimit;
- çfarëdo veprimi me qëllim të krijimit, regjistrimit ose përmbarimit të një barre, deri në masën që ajo barrë ndërlidhet me aktivitetet afariste të debitorit dhe deri në masën që ajo barrë siguron një kërkesë që ka lindur para inicimit të procedurës së falimentimit;
- çfarëdo veprimi me qëllim të mbledhjes, vlerësimit ose rimarrjes së një kërkesë ndaj debitorit, deri në masën që veprimi ndërlidhet me aktivitetin afarist të debitorit dhe deri në masën që ajo kërkesë ka lidhur para inicimit të procedurës së falimentimit; dhe
- çfarëdo kërkesë për shlyerje të detyrimit drejtuar debitorit, të ndërlidhur me aktivitetin afarist të debitorit, kërkesë e paraqitur para inicimit të procedurës.

Inicimi i procedurës së falimentimit sipas këtij ligji nuk vendos moratorium dhe urdhër ndalesën pa paralajmërim. inicimit ose vazhdimin të çfarëdo procedure penale ndaj debitorit, në çështje familjare ose statusore, kujdestarisë, alimentacionit, vërtetimit të atësisë ose amësisë dhe procedurave të ndërlidhura me shkeljet e ligjeve për mbrojtjet mjedisore, shëndetin ose sigurinë.

Moratoriumi zgjat vetëm 120 ditë. Mund të vazhdohet por jo më shumë se një vit. Kreditorët e siguruar mund të përfitojnë lirim të hershëm nga moratoriumi nëse pasuria nuk siguron mbrojtje të vlerës, rasti është në procedurë të likuidimit dhe borxhi ndaj pronës e tejkalon vlerën e vet të bares dhe në qoftë se rasti është në riorganizim, borxhi e tejkalon vlerën, dhe prona nuk është e domosdoshme për riorganizimin efektiv

2.4 Administratori

Administratori emërohet nga gjykata brenda një afati (3) tre ditorë pas pranimit të rastit. Për administrator falimentues mund të emërohet vetëm personi fizik, i cili ka kualifikim shkollor superior, të drejtimit ekonomik, apo juridik, të cilitdo nën drejtim, që ka provim profesional për administrator falimentues, që është i pajisur me licencë, që është i përfshirë në listën e administratorëve, që ka aftësi profesionale dhe përvojë për të menaxhuar dhe për të udhëhequr procedurën e falimentimit.

Përveç të drejtave të përcaktuara me ligj administratori kanë drejtë të:

- merr menjëherë në posedim pasurinë e debitorit;
- thërret seancën e kreditorëve dhe të kryesojë seancat e tilla
- fillojë procedurat gjyqësore dhe administrative për realizimin e të drejtave të debitorit
- të shërbejë si përfaqësues i autorizuar për pasurinë e debitorit me pëlqimin e gjykatës
- të punësojë dhe të mbikëqyrë punën e të punësuarve të vartësve dhe ekspertëve për administrimin e drejtë të rastit,
- të mbyllë llogarinë bankare të debitorit dhe të hapë llogarinë e veçantë të falimentimit në bankën e lejuar nga gjykata,
- të bëjë pagesën e kreditorëve në llogari të kërkesave të miratuara dhe

Administratori është i detyruar ta rrisë vlerën e pasurisë, të mirëmbajë dhe të mbrojë pasurinë, të kryejë shpejt dhe në mënyrë të bindshme zgjedhjen e rastit, dhe, kur është e duhur, të udhëheqë me biznesin e pasurisë.

2.5 Pasuria e falimentimit

Me regjistrimin e kërkesës themelohet pasuria e falimentimit që përbëhet nga e gjithë pasuria e debitorit në kohën e paraqitjes së kërkesës, si dhe nga e tërë pasuria e mbledhur nga administratori në emër të debitorit gjatë kohës së procedurës ose rrjedhjes normale të biznesit.

Kjo pasuri nuk përfshin mjetet e pensioneve ose të drejtat e fituara. Çfarëdo shitje, disponim, bartje apo dhënie me qira e pasurisë është e ndaluar totalisht para emërimit të administratorit, ndërsa pas emërimit të tij/saj, kjo mund të bëhet vetëm me vendim të gjykatës.

2.5.1. Administrimi i Pasurisë së Falimentuar: Nga Paraqitja e Kërkesës deri te Lirimi

Për të kaluar nga paraqitja e kërkesës e deri te mbyllja ose riorganizimi, nevojitet ndërmarrja e disa veprimeve:

- Shitja dhe shfrytëzimi i aseteve të pasurisë
- Sigurimi i financimit
- Menaxhimi me kontrata të cilat nuk janë përmbushur plotësisht
- Largimi i aseteve të pavlera

i. Shitja dhe përdorimi i Aseteve

Gjykata mund ta autorizojë shitjen e aseteve pa asnjë ngarkesë ose interes nga ndonjë kërkesë ose barrë nëse

- Ligji jashtë falimentimit do ta lejonte atë
- Entiteti tjetër pranon
- Barra transferohet në procedurë

ii. Kontratat e papërmbushura plotësisht – Mundësitë e Pasurisë

Pasuria ka mundësi sa i përket kontratave në të cilat asnjëra palë nuk e ka përmbushur performancën e vet.

Pasuria mundet ta:

- Pranojë kontratën
- Refuzojë kontratën
- Transferojë kontratën

Pranimi nënkupton se pasuria do të përmbushë (dhe do të kërkojë nga pala tjetër për ta përmbushur). Standardi i përmbushjes nënkupton se vendimi për pranim është marrë duke ushtruar funksionet e tij me mirëbesim dhe gjykim të drejtë afarist nga përfaqësuesi i pasurisë. Shkelja pas pranimit lejon ngritjen e dëmeve që janë shpenzime administrative

Pasuria në falimentim mund të pranojë kontratë edhe nëse kërkesa për falimentim ose falimentimi është shkelje kontraktuale

Nëse është në shkelje, pasuria në falimentim mund të pranojë nëse:

- Përfaqësuesi e mënjanon shkeljen duke zbatuar detyrimin;
- E kompenson jo-debitorin; dhe
- Ofrojnë siguri të mjaftueshme për përmbushje të çdo detyrimi të papërmbushur në të ardhmen

Pasuria falimentuese mund të zgjedhë të refuzojë – shkelë – kontratën e papërmbushur nëse dëmet që dalin nga refuzimi janë dëme para deponimit të kërkesës.

Pasuria në falimentim mund ta përmbushë kontratën:

- Të njëjtat kushte si në pranim:mënjanon shkeljen duke zbatuar detyrimin, kompenson jo-debitorin dhe ofron siguri të mjaftueshme
- Pas përmbushjes, pasuria në falimentim nuk është më përgjegjëse për dëmet në kuadër të kontratës së përmbushur

iii. Braktisja e Aseteve

Pasuria në falimentim mund të “braktisë” ose transferojë një pronë me “ngarkesë të madhe për pasurinë falimentuese”, ndonjë pale të interesuar. Pronë rënduese nënkupton pronën e cila mund të jetë pa vlerë ose pa ndonjë vlerë të rëndësishme për pasurinë e falimentimit ose e cila e rëndon pasurinë e falimentimit aq shumë sa ruajtja e saj do të shkaktonte shpenzime me të mëdha se sa shitja e saj.

iv. Fuqia për t’i Anuluar ose Lënë Anash Transaksionet

Pasuria falimentuese ka fuqi t’i lënë anash preferencat e bëra:

- gjatë 120 ditëve para inicimit të rastit respektivisht
- 1 (një) vit nëse i brendshëm
- I brendshëm
 - Entitet i ndërlidhur [rregulla e pronësisë 20%];
 - Një person që është anëtar i cilësdo trupë qeverisëse apo menaxhmentit të debitorit apo është një pozitë të kontrollit substancial mbi debitorin;
 - Një person me qasje në informacione që në përgjithësi nuk janë të hapura për publikun, që kanë të bëjnë me vendimet apo kushtet financiare të debitorit; ose
 - Anëtar i familjes së ngushtë apo kushërinj të afërt të personave të përmendurve në nën-paragrafët 1, 2 dhe (3) të këtij paragrafi;
- Pagesat kreditorëve plotësisht të siguruar nuk janë preferenca
- Pagesat e bëra gjatë rrjedhës së rregullt të biznesit kanë mbrojtje të plotë

Bartjet jo-komerciale dhe për qëllime mashtrimi:

- Bartjet që janë bërë deri dy vite para inicimit të rastit
- Bartjet mund të bëhen me qëllim të fshehjes, pengimit ose mashtrimit të kreditorëve
- Bartjet mund të bëhen përderisa debitori ka qenë në situatë, ose pothuaj se në situatë të paaftësisë paguese, dhe janë bërë me vlerë më të vogël se vlera e arsyeshme

2.6 Riorganizimi

Karakteristikë e i rëndësishme e i Ligjit për Falimentimin është mundësia e riorganizimit si një nga zgjedhjet e mundshme në një procedurë të rregullt falimentimi. Riorganizimi nuk vihet në lëvizje me anë të një procedure të veçantë, por, është karakteristikë e të gjitha procedurave të falimentimit. Një procedurë falimentimi mund të çojë në likuidim ose riorganizim në varësi të rrethanave të rastit dhe të vendimeve të gjykatës ose kreditorëve. Për rrjedhojë, një procedurë falimentimi që është hapur në bazë të kërkesës së debitorit apo të kreditorit, mund të rezultojë në riorganizimin e debitorit në vend të likuidimit dhe shpërndarjes së pasurisë së tij. Një debitor, i cili ka kërkuar hapjen e procedurës së falimentimit duke përfshirë planin e riorganizimit që të përfitojë një kohë shtesë për realizimin e pretendimeve të kreditorëve, rrezikon të humbasë aktivet (si dhe ekzistencën, nëse është person juridik) nëpërmjet likuidimit, në qoftë se plani i riorganizimit nuk miratohet.

Qëllimet e Riorganizimit - Gjatë procedurës së likuidimit, gjykata i ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që:

- Ruan vendet e punës ose krijon vende të reja të punës; dhe
- Ruan vlerën e asetëve deri në masën në përputhje me riorganizimin.

Propozimi për riorganizim quhet “Plan i Riorganizimit”. Çdo propozim për debitorin, që nuk kërkon likuidimin e menjëhershëm nga administratori do të nënshtrohet dispozitave të riorganizimit. Propozimi do të formulohet me dokument me shkrim, i njohur si plani i riorganizimit. Planin për riorganizim mund ta paraqes debitori, administratori, kreditorët që posedojnë së paku 30% të kërkesave të siguruara, kreditori me 30% të kërkesave të pa siguruara ose personat që posedojnë së paku 30% të kapitalit në pronësi e debitorit, qoftë në formë të aksioneve, ose të ngjashme.

Plani i riorganizimit përmban një paraqitje të shkruar të përgjithshme në veprimtarinë biznesore të debitorit dhe rrethanat që shpjen në vështirësinë financiare, të gjitha jo më shumë se dy faqe, metodat dhe mjetet për realizimin e planit, periodhat kohore për realizimin e planit, deklarinimin se kush do ta menaxhojë organizatën, pjesët tjera të parapara me ligj.

Kreditorët e siguruar dhe të pa siguruar kanë të drejtë të votojnë për apo kundër planit të riorganizimit. Nëse plani konfirmohet nga vota e kreditorëve, atëherë kjo konsiderohet një kontratë e re për përmbushjen e kërkesave të paraqitura në të. Në atë rast, prona e falimentimit shuhet dhe pronat i kthehen debitorit. Prej atij momenti dhe tutje, debitori dhe menaxheri i tij vazhdojnë me zbatimin e planit të riorganizimit.

Në rastin kur debitori shkel planin e riorganizimit, çdo kreditor ka të drejtë që ta njoftojë gjykatën për këtë shkelje. Nëse gjykata konstaton se ka ndodhur shkelje e planit, atëherë ajo nxjerr vendim për evitimin e shkeljes, për shndërrimin e rastit në likuidim, i lejon debitorit të paraqes amendamente të planit.

2.6.1 Karakteristikat e Riorganizimit:

- Debitori mund të mbetet në kontroll të asetëve
- I ka 120 ditë për ta propozuar një plan
- Planin mund t’i ristrukturojë financat e debitorit, duke e modifikuar borxhin (duke i ndryshuar normat dhe maturitetet e interesit), anuluar pjesë apo të gjithë borxhin, ose duke e shkëmbyer borxhin për ekuitet
- Kreditorët klasifikohen në bazë të statusit të kërkesës dhe arsyesimit të biznesit
- Pas zbulimit të planit, kreditorët votojnë në bazë të klasës; klasa e pranon nëse së paku 50% të votimit së kërkesës e pranojnë planin
- Planin duhet ta kthejë së paku vlerën e likuidimit të secilit kreditor (testi i interesit më të mirë)
- Konfirmimi i planit nuk do të përcillet nga nevoja për ristrukturim të mëtutjeshëm financiar (fizibiliteti)

2.6.2 Klasifikimi i kërkesës:

- Klasat zhvillohen në bazë të të drejtave ligjore
- Të siguruarit ndahen nga të pasiguarit, ku secili ndahet nga interesat e ekuitetit
- Klasat e pasiguarit zhvillohen në bazë të nevojave ekonomike dhe të biznesit

- Kërkesa deficite e kreditorit të siguruar mund të klasifikohet ndaras nga kreditorët e rregullt të tregtisë së pasiguruar

2.6.3 Dëmtimi i kërkesës

- Klasat e dëmtuara kanë të drejtë vote
- Klasat e padëmtuara nuk kanë të drejtë
- Klasat e padëmtuara dalin nga njëra prej dy mënyrave:
- Plani nuk e ndryshon kërkesën
- Pani e mënjanon, kompenson dhe i len të pandryshuara dispozitat e borxhit i cili është në shkelje gjatë kohës së deponimit

2.6.4 Karakteristikat e Planit të Riorganizimit

- Planet janë jashtëzakonisht fleksibile në atë që mund të propozojnë – cilat do qofshin nevojat e debitorit
- Planet mund t'i ndryshojnë dispozitat e borxhit – trajtimin ligjor, zvogëlimin e normave të interesit, rritjen e maturitetit
- Planet mund ta zvogëlojnë apo eliminojnë borxhin
- Planet mund ta shkëmbejnë borxhin me stoqe apo sigurime të tjera
- Planet gjithashtu mund të përfshijnë marrëveshje të arritura me kreditorët

2.6.5 Shpalosja dhe Votimi

- Planet votohen nga kreditorët
- Klasa e pranon planin nëse kreditorët të cilët kanë së paku 50% të të gjitha kërkesave dhe të cilët votojnë për ta pranuar planin
- Numërohen vetëm ato vota
- Para votimit, gjykata duhet ta miratojë informatën e dhënë kreditorëve për ta informuar votën e tyre duke e miratuar “deklaratën e shpalosjes”
- Deklarata e shpalosjes duhet ta vlerësojë pagesën ndaj kreditorëve dhe të ofrojë projektim 5- vjeçar të qarkullimit të parasë

2.6.6 Konfirmimi Konsensual

Gjykata e konfirmon planin gjatë seancës dëgjimore nëse:

- Plani është propozuar në mirëbesim
- Gjykata gjen se secili kreditor do të pranojë nga plani aq sa do të pranonte nëse debitori do të likuidonte
- Gjykata gjen se plani mund të zbatohet në mënyrë efektive dhe nuk ka gjasa të përcillet nga nevoja për ndonjë riorganizim tjetër

2.6.7 Konfirmimi Jo-konsensual

Edhe nëse të gjitha klasat nuk e pranojnë, plani megjithatë mund të konfirmohet:

Për ta bërë këtë, gjykata duhet të gjejë se:

- Plani i plotëson të gjitha kërkesat tjera për konfirmim përveç votimit
- Plani nuk e paguan askënd më shumë se që i detyrohen
- Nuk është paguar asnjë klasë juniore e kërkesave ose interesit përveç nëse të gjitha klasat seniore të kërkesave apo interesave janë paguar plotësisht (rregulla e prioritetit absolut)

2.6.8 Efektet e Konfirmimit

- Konfirmimi i planit i detyron të gjitha palët e interesuara për dispozitat e saj, duke përfshirë ata të cilët nuk kanë deponuar prova të kërkesës dhe ata të cilët nuk kanë votuar në favor të planit
- Konfirmimi e shkarkon pronën e pasurisë në entitetin e përcaktuar në plan (zakonisht debitori)
- Konfirmimi e shkarkon debitorin nga të gjitha borxhet përveç atyre të specifikuara në plan

2.6.9 Shndërrimi i Likuidimit apo Pushimit

- Në rast se një debitor nuk mund ta konfirmojë planin brenda një viti nga deponimi (i cili mund të zgjatet deri në 18 muaj), atëherë rasti konvertohet në rast të likuidimit
- Nëse debitori nuk i përmbush dispozitat e planit të konfirmuar, atëherë pala e dëmtuar mund ta padisë në bazë të planit në gjykatë, sikur plani të jetë kontratë në mes të debitorit dhe palës së dëmtuar.

2.7 Koncepti i ri: Lehtësitë e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM)

Dispozitat kryesore të riorganizimit mund të jenë komplekse dhe të shtrenjta për entitete më të vogla andaj ligji ka paraparë lehtësira për NVM-të, të përcaktuara si “biznes, qoftë nga personat ligjor apo individët, të cilët kanë më shumë se 25 punëtorë dhe jo më shumë se [€1,000,000] qarkullim vjetor.

- Rastet e NVM trajtohen si raste të riorganizimit përveç nëse parandalohen nga dispozitat e ligjit
- NVM duket të deponojë një plan brenda 30 ditësh nga hapja e rastit
- Nëse debitori është individ, vetëm debitori mund të deponojë një plan. Nëse është person ligjor, debitori është personi i vetëm i cili mund të deponojë plan gjatë 30 ditëve të para
- NVM duhet ta konfirmojë planin brenda 60 ditësh, ose rasti pushohet

2.7.1 Procedura NVM – Monitoruesit

- Nëse një NVM deponon një kërkesë, gjykata e emëron një ”Monitorues”
- Monitoruesi tërhiqet nga paneli i Administratorëve. Konsultohet me debitorin në lidhje me biznesin
- Monitoruesi e vlerëson realizueshmërinë e planit të debitorit

- Nëse është i realizueshëm, Monitori nuk ka nevojë të bëjë asgjë. Deponon vetëm raport mbi realizueshmërinë nëse nuk ka brenga.

2.7.2 Konfirmimi i efektshëm i planit për NVM

- Gjykata do të konfirmojë një plan të NVM nëse
 - Plani është i realizueshëm
 - Së paku 75% të klasave të miratimit të siguruar
 - Së paku 33-1/3% të të gjithë kreditorëve të pasiguruar miratojnë.
 - Debitorët tregojnë se të gjithë kreditorët e padëmtuar do të pranojnë së paku aq sa do të pranon gjatë likuidimit
- Realizueshmëria shfaqet nëse
 - Monitoruesi nuk ka dorëzuar raport; ose
 - 100% e të gjithë kreditorëve të siguruar miratojnë; ose
 - 50% e të gjithë kreditorëve të pasiguruar e miratojnë planin; ose
 - Debitori përndryshe paraqet realizueshmëri

2.7.3 Planet e para-dakorduara

- Debitori mund ta propozojë një plan dhe të mbledhë vota për të para deponimit
- Debitori mund t'i përdorë këto vota kur të konfirmohet plani nëse dëshmon se ato janë mbledhur në mënyrë që është në përputhje me shpalsjen e kërkesave
- Kjo e largon shpalsjen e deklaratës së seancës dëgjimore, dhe lejon konfirmim të shpejtë
- Kur përdoret në mënyrë tipike në ristrukturim financiar kur borxhi operativ mbetet i padëmtuar, dhe ndikohet vetëm borxhi i bankës ose publik

2.8 Koncepti i ri: Lirimi Individual

Individi i cili ka biznes si pronar i vetëm tash është i përshtatshëm për të pranuar lirim nga borxhet e biznesit të tyre.

- Përrjashtimet nga lirimi:
 - Kërkesat që nuk kanë të bëjnë me aktivitetin e biznesit
 - Kompensim të urdhëruar nga gjykata
 - Tatimet
 - Kërkesat e pa-listuara në oraret e kërkuara
 - Kërkesat që bëhen përmes mashtrimit, shkeljes së detyrës, ose dëmtimit të qëllimshëm dhe keqdashës
- Debitori mund të përjashtohet nga prona e pasurisë së falimentuar:
 - Vendbanimi i tij ose saj
 - Të drejtat e pensionit ose pagesave që kanë të bëjnë me asistencën e jetesës

2.8.1 Aspektet tjera të lirit individual

- Bashkë-obliguesit nuk pranojnë përfitimin e lirit të debitorit. Ata vazhdojnë të mbeten përgjegjës
- Debitori mundet, pas konfirmimit, ta paguajë vullnetarisht çdo borxh të liruar

2.9 Likuidimi

Likuidimi është shitja e tërë pasurisë së falimentimit nga ana e administratorit. Të gjitha të ardhurat nga shitja e pasurisë bëhen pronë e pasurisë së falimentimit . Kjo pasuri financiare pastaj përdoret për tu paguar detyrimet e debitorit ndaj kreditorëve, sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj, që janë:

- kërkesat e siguruara, pa shpenzimet e arsyeshme të shitjes, konform ligjit
- kërkesat prioritare, duke përfshirë:
 - shpenzimet gjyqësore,
 - shpenzimet e administratorit,
 - shpërblimin i administratorit,
 - shpenzimet e administratorit për mirëmbajtjen e pasurisë,
 - shpenzimet e riorganizimit,
 - financimet e riorganizimit,
 - pagesat dhe shpenzimet e personelit gjatë kohës së administrimit të rastit,
 - shpenzimet e bordit të kreditorëve,
- kërkesat e preferuara për nënpunësit e pa paguar,
- kërkesat e pasiguruara,
- kërkesat e pronarëve të debitorit, aksionarëve, anëtarëve themelues, pjesëmarrësve.

Në çdo kategori, kërkesat e siguruara do të përmbushen në pajtim me prioritet e tyre në bazë të ligjit.

Në likuidim, pas mbylljes së rastit, debitori në pikëpamje ligjore do të konsiderohet i shpërbërë. Gjykata do të nxjerrë njoftim për mbylljen e rastit dhe përfundimin, jo më vonë se (5) pesë ditë pas mbylljes së rastit. Gjykata po ashtu mund të nxjerrë vendim për heqjen e emrit të kompanisë së shpërbërë nga regjistri aktiv i bizneseve.

Në rastin e riorganizimit, pas mbylljes së rastit, debitori do të konsiderohet financiarisht i rimëkëmbur dhe mund të vazhdojë veprimtarinë bizneseve pa kufizim të mëtejshëm apo mbikëqyrje.

2.10 Përmbledhje

Ky sesion trajnimi ka ofruar një pasqyrë të procesit të falimentimit përfshirë hapjen e procedurës, riorganizimin dhe likuidimin. Ky modul është marrë me kërkesat e paraqitura nga kreditorët dhe debitorët dhe ka numëruar procedurat për mënyrën e dorëzimit të kërkesave të tilla, llogaritjes së tyre, dallimet ndërmjet llojeve të ndryshme të kërkesave, vlerësimit dhe përfundimit të kërkesave dhe në fund mënyrën e anulimit të bartjeve të caktuara që do të preknin kërkesat e tilla. Ndër të

tjera, moduli ka trajtuar edhe krijimin dhe dorëzimin e planit të riorganizimeve, konfirmimin e riorganizimit dhe shndërrimin e tij në likuidim.

Në këtë modul janë dhënë shpjegime lidhur me mënyrën si ta:

- Paraqitni kërkesën.
- Llogaritni kërkesën.
- Të bëni dallimin ndërmjet kërkesave të kushtëzuara, siguruara dhe pasiguruara.
- Vlerësoni dhe përfundoni kërkesat.
- Kërkoni anulimin e bartjeve
- Hartoni planin e riorganizimit dhe dorëzoni atë në mënyrën e duhur;
- Përshkruani procesin e votimit për riorganizimit dhe konfirmimin e të njëjtit;
- Shkruani pasojat e konfirmimit të riorganizimit;
- Shndërrimin riorganizimit në likuidim
- Konceptet e reja për NVM dhe Lirimin Individual
- Likuidimi

3. Kontratat në Ekonomi, Punët Bankare dhe Siguruese

3.1 Hyrje

Në ekonominë e tregut bizneset e zhvilluara të cilat merren me veprimtari specifike, përdorin kontrata që janë specifike për afarizmin e tyre, e të cilat dallojnë si për nga struktura ashtu edhe nga të drejtat dhe detyrimet që krijojnë për palët.

Kontratat specifike që përdoren në afarizëm, punët bankare dhe sigurues kanë gjetur përdorim shumë të madh në fushën e afarizmit duke pasur parasysh hapjen e tregut. Ndërsa shoqëritë tregtare gjatë zhvillimit të biznesit në sferën ndërkombëtare shpesh aplikojnë kontratat për të cilat zbatohet Konventa për shitje ndërkombëtare të mallrave,

Këto kontrata kanë specifika të veçanta dhe kërkojnë njohuri të veçantë me rastin e zbatimit dhe interpretimit të dispozitave kontraktuese andaj kërkohen njohuri të posaçme, jo vetëm juridike por edhe nga fushat që mbulojnë këto kontrata, për zgjidhjen e kontesteve që lindin nga raporti afarist i krijuar përmes këtyre kontratave.

Në praktikën gjyqësore numri i kontesteve që rrjedhin nga këto kontrata është i konsiderueshëm, me tendencë të rritjes, prandaj trajtimi i kësaj teme është e një rëndësie të veçantë për rritur njohuritë e gjyqtarëve në trajtimin e rasteve.

3.2. Objektivat trajnues

Pas përfundimit të këtij prezantimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Identifikojnë llojet e kontratave në ekonomi, punët bankare dhe siguruese dhe specifikat e tyre;
- Njohin specifikat e kontratës për shitje ndërkombëtare të mallrave;
- Kuptojnë konventën ndërkombëtare për shitjen e mallrave, karakteristikat dhe zbatimin e saj në Kosovë;
- Bëjnë interpretimin e drejtë të kontratave dhe zbatimin e legjislacionit të zbatueshëm për rastin konkret.

3.3 Kontratat në Ekonomi

Në sistemin juridik-tregtar të vendit tonë raportet kontraktuese janë të rregulluara me LMD-në si ligj bazik. Dispozitat e LMD-së, që kanë të bëjnë me kontratat, zbatohen si tek raportet juridike-kontraktuese në mes të personave fizik ashtu edhe tek raportet juridike kontraktuese në mes të shoqërive tregtare dhe personave të tjerë juridik.

Me qënëse në qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve shpesh njëra nga palët nuk është kompani vendore dhe transaksionet marrin karakter ndërkombëtar, sipas nenit 1058, par.2, të LMD-së, zbatohet Konventa për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave (CISG. Pra, kjo Konventë zbatohet drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës.

3.3.1 Disa lloje te kontratave:

Kontrata e *ad-hezionit* (kontratë sipas pëlqimit, qasjes) është një kontratë formulare, përmbajtjen e së cilës ofertuesi i kontraktimit e ka përcaktuar paraprakisht dhe pavarësisht dhe një kontratë të tillë e oferton për ta lidhur me pranimin e të gjitha kushteve të propozuara, pa pranuar kurrfarë ndryshimesh të tyre.

Kontrata tipike është një kontratë formulare, përmbajtjen e së cilës e ka përcaktuar paraprakisht ofertuesi i saj, e cila ofrohet dhe lidhet në kushtet ashtu të tipizuar. Kjo kontratë është e ngjashme me kontratën e *ad-hezionit*, nga e cila dallon për atë që ofertuesi i saj lejon disa përjashtime të kushteve të ofruara në kontratë.

Kontrata për koncesionin-Është një instrument i qarkullimit juridik dhe ekonomik, me të cilën realizohet interesi publik. Këtu nuk vlen parimi i konsensualizmit dhe barazisë së palëve. Koncedenti vepron nga pozita e pushtetit publik. Për këtë kontratë karakteristike është prania e elementeve juridiko-publike, sepse objekti i kontratës është me interes publik. Zgjidhja e kontesteve të shkaktuara nga realizimi i të drejtave dhe detyrimeve lidhur me paluajtshmëritë është në kompetencë ekskluzive të gjykatave, kurse për të drejtat dhe detyrimet e tjera mund të përcaktohet kompetenca e arbitrazhit. Fjala koncesion rrjedh nga latinishtja *concesio* dhe do të thotë -leje.

Kontrata e shitjes është kontratë e shitjes sipas së cilës shitësi detyrohet që sendin që e shet t'ia dorëzojë blerësit, ashtu që blerësi të fitojë të drejtën e disponimit, përkatësisht të drejtën e pronësisë, kurse blerësi detyrohet që shitësit t'ia paguajë çmimin.

Kontrata për ndërmjetësimin është kontratë e tillë, në bazë të së cilës ndërmjetësuesi detyrohet që palën tjetër - komitentin ta sjellë në kontakt me ndonjë person tjetër të tretë, me qëllim që komitenti të lidhë me të ndonjë kontratë të qarkullimit të mallrave.

Kontrata për përfaqësimin tregtar- është kontratë e tillë sipas së cilës përfaqësuesi tregtar detyrohet që të kujdeset gjithmonë që personat e tretë të lidhin kontrata me urdhërdhënësin e tij dhe në atë kuptim të ndërmjetësojë midis tyre, si dhe, me të marrë të autorizimit, të lidhë kontrata me persona të tretë, në emër dhe për llogari të urdhërdhënësit, kurse ky i fundit detyrohet që përfaqësuesit t'ia paguajë kompensimin e caktuar (provizionin e përfaqësimit).

Kontrata komisionare- është kontratë joformale (por rekomandohet të jetë e formës së shkruar), me anë të së cilës një person i cili quhet *komisionar* lidhë kontratë në emër të vet dhe për llogari të tjetrit – i cili quhet *komitentit*, kurse komitenti detyrohet që komisionarit për këtë t'ia paguajë provizionin e kontraktuar. Në qarkullimin e mallrave komisionet paraqiten si komisione të shitjes, të blerjes dhe të transportit, të cilat njihen si komisione të rregullta, ku komisionari përgjigjet vetëm për zgjedhjen e ndërgjegjshme të personit të tretë, me të cilin lidh kontratën, por nuk përgjigjet për kompensimin e insolvititetit të atij personi, pra për mosrealizimin e detyrimit nga personi i tretë, për dallim prej komisionit me klauzolën *star del credere*, sipas së cilës komisionari, në bazë të kontratës, do ta marrë “garanci” të llojit të vet për përmbushjen e detyrimit të personit të tretë: komisionari - shitës se personi i tretë do ta paguajë çmimin, ndërsa komisionari - blerës se personi i tretë do ta dërgojë mallin. Në këtë mënyrë komitenti e fiton debitorin solidar, përveç personit të tretë dhe ky është komisionari qoftë shitës, qoftë blerës.

Kontrata për kontrollin e mallrave-me këtë kontratë njëra palë - ushtruesi i kontrollit, detyrohet që profesionalisht dhe me paanësi ta bëjë kontrollin e kontraktuar të mallit dhe për këtë të lëshojë certifikatën (atestin) përkatës, kurse pala tjetër - porositësi i kontrollit, detyrohet që për

kontrollin e kryer të paguajë kompensimin e kontraktuar. Objekt i kontrollit është vërtetimi i identitetit të mallit (sasia, cilësia, mënyra e paketimit etj.). Është kontratë joformale.

Kontrata për shpeditonin është një kontratë e tillë me të cilën shpeditori detyrohet që të ekspedojë mallin e palës tjetër - komitentit, kurse ky detyrohet që për këtë shpedituesit t'ia paguajë një provizion të caktuar Shpeditori, për transportin e një malli të caktuar, lidh në emër të vet dhe për llogari të komitentit, kontratë për transportin dhe kontrata të tjera të nevojshme për kryerjen e transportit të atij malli, si dhe kryen punë dhe veprime të tjera të zakonshme, si, psh., zhdoganimin, magazinimin, sigurimin e mallit etj.

Kontrata për transportin e mallit-Është kontratë me të cilën transportuesi detyrohet që të kryejë me shpërblim transportin e mallit ose të pasagjerëve nga një vend në vendin tjetër.

Kontrata për knoë-hoë-. Me kontratën e knoë - hoë-it njëra palë detyrohet ta kalojë dijen apo përvojën afariste në pikëpamje të teknikës a teknologjisë si dhe dijen afariste dhe financiare te pala tjetër, kurse kjo detyrohet që asaj, për këtë, t'ia paguajë shpërblimin e kontraktuar, në bazë të shfrytëzimit të fshehtësisë afariste. Knoë - hoë-i nuk është rregulluar drejtpërdrejt dhe shprehimisht me ligj, prandaj përmbajtja e tij nuk është përcaktuar saktësisht. Se çka do të thotë knoë - hoë është një çështje faktike, sepse përmbajtja e tij mund të jetë e ndryshme rast pas rasti, varësisht në cilën lëmë paraqitet. Në këtë kuptim, knoë-hoë-in rregullisht e përbejnë fshehtësitë e prodhimit, dokumentacionet teknike, recepturat, udhëzimet për punë, skicat, shemat, rregullat nga përvoja etj. Këto janë dije dhe përvoja të cilat atyre që i zotërojnë ato u sjellin përparësi përkatëse para konkurrentëve, që nuk i kanë këto dijeni dhe përvoja

Kontrata për lizingun-Është një kontratë, sipas së cilës dhënësi i lizingut detyrohet që shfrytëzuesit të lizingut t'ia dorëzojë për shfrytëzim të përkohshëm ndonjë send (ose grup sendesh), kurse ky detyrohet dhënësit t'ia paguajë kompensimin e caktuar, me të drejtën që shfrytëzuesi i lizingut, pas skadimit të afatit të lizingut ta blejë atë send ose ta vazhdojë lizingun. Objekt të lizingut janë rëndom sendet (pajisjet, pajimet, automjetet etj.).

Dhënësi i lizingut, përveç dorëzimit të sendit, ka për obligim edhe mirëmbajtjen, remontin, aftësimin e kuadrit të shfrytëzuesit të lizingut. Rëndësi të madhe ka lizingu financiar, i cili mundëson kreditimin për furnizimin e sendit të caktuar.

Iloje të lizingut:

- lizingun e sendeve të konsumueshme - automjetet, aparatet të amvisnisë,
- lizingun investues, që jepet në formë të pajimeve (makinave investive),
- lizingun e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme dhe
- lizingun e sendeve të përdorura.
- Lizingu sipas kohëzgjatjes: afatshkurtër dhe afatgjatë.
- Lizingu sipas pozitës së dhënësit të lizingut:
- lizingu që e realizojnë shoqëritë e lizingut,
- lizingu i koncerneve dhe
- lizingu i prodhuesit financiar.

Kontrata për franshizingun-është kontratë me të cilën midis dy subjekteve ekonomik vendoset marrëdhënia afariste për një kohë më të gjatë, gjatë së cilës dhënësi i franshizës i jep pranuesit të saj një grup të caktuar të shërbimeve afariste dhe të drejtave të mbrojtura, të cilat pranuesi i franshizës ka të drejtë t'i shfrytëzojë në afarizmin e vetë, në kushtet saktësisht të përcaktuara e me kompensim të kontraktuar. Objekt të franshizës mund të jenë: emri tregtar, vurrata mallore ose shërbyese ose ndonjë shenjë e jashtme, dija dhe përvoja teknike ose afariste, shkollimi i

kuadrove të pranuesit të franshizës, konsultimet përkatëse gjatë afarizmit në bazë të franshizës etj.

Franshizën, rëndom, ua japin subjekteve të tjera ekonomike firmat e suksesshme, të cilat janë të njohura në treg për mallra ose shërbime të caktuara (franshiza prodhuese, tregtare ose afariste). Në këtë mënyrë, krijohet një zinxhir i tërë subjektsh ekonomike të lidhur me të njëjtin dhënës të franshizingut, të cilat punojnë në mënyrë të pavarur, por që njihen në mënyrë unike në treg.

Franshizingu afarist më së shpeshti paraqitet në hotelieri, p.sh. : zinxhri e hoteleve të cilët punojnë nën një markë të njohur të hotelit - Sheraton, Hilton, Holiday-Inn, Intercontinental etj.); në shërbimet hoteliere, p.sh., Mc Donald's, Maxim, Moule de Gateau etj.; në industri, p.sh. Coca Cola etj.; në rrjetin e stacioneve të benzinës, pastrimit kimik, tregtisë së automobilave etj.

Kontrata për faktoringun paraqet një punë të tillë kredituese - bankare me të cilën klienti i bankës detyrohet të kalojë në bankë (faktorin) kërkesat ekzistuese ose kërkesat e ardhshme që përmban kontrata për shitjen e mallit, respektivisht të kryejë shërbime që lidhen me blerësin, respektivisht shfrytëzuesin e shërbimeve, kurse banka detyrohet që me provizion dhe kompensim të shpenzimeve, t'i inkasojë kërkesat dhe, eventualisht, të garantojë inkasimin, si dhe të kreditojë klientin.

3.4 Punët bankare dhe siguruese

Afarizmi bankar është veprimtari e veçantë ekonomike, objekt themelor i së cilit është qarkullimi i parasë, por ai përmban edhe disa transaksione dhe produkte tjera financiare. Në përgjithësi, bankat dhe institucionet financiare lehtësojnë veprimet afariste dhe shpeshherë ndodh që bankat specializohen në çështje specifike financiare që kërkohen nga tregu.

3.4.1 Punët bankare kredituese:

Kontrata e kredisë- Me këtë kontratë banka detyrohet që shfrytëzuesit të kredisë t'ia lërë në dispozicion një shumë të caktuar të të hollave, në kohë të caktuar ose të pacaktuar, me destinim ose pa destinim të caktuar, kurse shfrytëzuesi detyrohet t'ia paguajë bankës kamatën e kontraktuar, kurs shumë e marrë t'ia kthejë asaj në kohën dhe mënyrën e përcaktuar në kontratë.

Për kontratën e kredisë me ligj përcaktohet shuma dhe kushtet e dhënies, shfrytëzimit dhe të kthimit të kredisë. Kjo kontratë është formale, sipas qasjes, e dyanshme me ngarkesë, *intuitu personae*, pa marrë parasysh mjetet e sigurimit, të cilat e shoqërojnë si mjete shtesë, sepse si mbulesë themelore shërben besimi {latinisht "*credo*" - të besohet, besimi) ndaj personit të cilit i jepet kredia dhe aftësisë së tij kredituese. Kemi disa lloje të kredisë: sipas destinimit - investive, konsumuese, financiare etj.; sipas afatit të pagesës - kredi afatshkurtra (deri në një vit), kredi afatmesme (deri në pesë vjet) dhe kredi afatgjata (më tepër se pesë vjet).

3.4.2 Punët e veçanta kredituese

Kreditë e akceptuara.- Me këtë kontratë banka detyrohet që ta bëjë akceptimin (pranimin) e kambialit që i ofron klienti i saj dhe kalon tek ajo, ashtu që, si akceptuese, banka pranon ta paguajë kambialin në momentin e arritjes së tij për pagesë. Kambialin e akceptuar klienti i bankës mund ta përdorë në mënyra të ndryshme, pra ta eskontojë tek e njëjta bankë ose te një bankë tjetër, për të marrë para në dorë apo për ta paguar mallin e blerë ose për të kryer shërbime

të tjera, nëse atë e indoson mbi kreditorin e vet. Ajo obligohet me kontratë që për klientin e vet të sigurojë mbulesën më së largu në momentin e arritjes së kambialit.

Kreditë ramburse. - Këto kredi janë një lloj kredish akceptuese që i lejojnë importuesit për pagesën e vlerës së mallit, në bazë të dokumenteve të mallrave. Te kjo kredi, e cila shpesh shfrytëzohet në tregtinë ndërkombëtare, importuesi i jep urdhrë bankës së vet që ajo vetë (rambursi direkt) t'i lejojë kredinë ramburse, duke i akceptuar importuesit kambialin që tërhiqet në të. Kambialin e akceptuar banka ramburse ia dërgon bankës së eksportuesit, me urdhrin që t'ia dorëzojë importuesit atë vetëm pasi t'i pranojë nga ai të gjitha dokumentet e mallrave dhe dokumentet e tjera (rëndom, fletëngarkesën ose ndonjë dokument tjetër mallor ose me vlerë), me të cilat vërteton se është ekspeduar malli i kontraktuar. Eksportuesi kambialin mund ta eskontojë dhe të realizojë me të pagesën e tij ose të paguajë pasi kambiali të ketë arritur. Kjo është kredi afatshkurtër.

Kreditë e avalit. - Këto kontrata janë të ngjashme me kreditë akceptuese, me dallimin se te këto kontrata banka nuk e akcepton, por e avalon kambialin, të cilin e ka lëshuar klienti i saj, pra, banka është vetëm garant kambialor dhe quhet avalist. Është, po ashtu, kredi afatshkurtër.

Kreditë e skotnos - Sipas këtyre kontratave, poseduesi i letrës së caktuar me vlerë ia shet atë bankës kreditore, para se ajo të ketë arritur për pagesë, duke ulur një pjesë të vlerës së tyre, pra duke zbritur diskontin. Si objekt të skontos. sipas rregullit, paraqiten letrat me vlerë të paarritura, siç janë: kambiali, çeku, varanti, fletobligacionet etj., por, përjashtimisht, ato mund të jenë qenë edhe të gjitha kërkesat e paarritura. Banka mundet që kërkesat e marra për lejimin e kredisë së skontos t'ia shesë një banke tjetër (rëndom bankës qendrore) dhe ky veprim quhet reskontim, por edhe mund t'i paguajë ato në momentin e arritjes. Po ashtu, edhe këto kredi janë kredi afatshkurtra.

Kredia e lombardit. - Sipas kësaj kontrate, e cila ka klauzolën për kalim (indosimin e pengut), në bankë depozitohen sende të çmueshme, si: flori, stoli të ndryshme dhe letra me vlerë; kjo kontratë duhet të lidhet me shkrim, kurse në përmbajtjen e saj duhet të futen të dhënat lidhur me sendet e çmueshme dhe letrat me vlerë. Banka ka të drejtë t'ia japë këto sende një banke tjetër, veprim ky që quhet relombardim. Në bazë të kësaj kontrate banka detyrohet që të lejojë kthimin e sendeve dhe letrave me vlerë pas pagesës së kredisë.

Kreditë revaluase (nga lat.: qarkullim, lëvizje, përsëritje).- Ndryshe quhen kredi rotacioni. Janë kredi financiare dhe mund të shfrytëzohen shumfish brenda një afati të caktuar kohor dhe deri në limitin e caktuar. Kreditë revaluase janë të tilla që mundësojnë përsëritjen automatike pas shfrytëzimit të kredisë deri në limitin e caktuar. Pra, specifika më e rëndësishme e këtyre kredive është se këto përsëriten, d.m.th. pas kthimit të kredisë shfrytëzuesi fiton të drejtën që nën kushtet e njëjta përsëri ta shfrytëzojë kredinë deri në limitin e caktuar, përkatësisht derisa të skadojë afati i kontraktuar. Numri i përsëritjes së kredisë, sipas rregullit, kontraktohet paraprakisht. Automatizmi i përsëritjes me arritjen e limitit bën që, p.sh., ndërmarrjes importuese të mos i lejohet kredia në tërë shumën, por deri në një limit (kuota e importimit njëmujoj), mirëpo sipas sistemit revolving, transha e re aktivizohet automatikisht kur paraprakja është shfrytëzuar për pagesë.

Kreditë vinkulare (Lat. për të lidhur).- Janë një lloj kredish të cilat banka ua lejon eksportuesve në bazë të mallit që shërben si mjet sigurimi. Për dallim nga kreditë ramburse, kreditë vinkulare shfrytëzohen për eksportimin e mallrave, të cilat transportohen me komunikacion rrugor. Në bazë të kontratës së lidhur për kredinë vinkulare, banka i ofron menjëherë në dispozicion shitësit të mallit, si shfrytëzues i kredisë, një sasi të caktuar të hollash, si rregull, më pak se çmimi i shitjes i mallit, me kusht që shitësi t'ia dorëzojë kopjen e fletëngarkesës dhe dokumentet e tjera

të parashikuara në kontratë. Në fletëgarkesë banka vinkulare cilësohet si dërguese e mallit, kurse pranuese cilësohet banka korresponduese ose shpeditori në vend të importuesit. Banka korresponduese, përkatësisht shpeditori nuk mund t'i kalojë te blerësi dokumentet mallore, të cilat i ka pranuar nga banka vinkulare, përderisa ky nuk e paguan çmimin e shitjes- "pagesa sipas dokumenteve".

3.4.3 Punët shërbyese bankare

Transaksionet e pagesave- Funkcionet kryesore të bankave kanë të bëjnë pikërisht me transaksionet e pagesave. Ka disa lloje të transaksioneve që janë të ofruara për nevojat e ndryshme të klientëve dhe rrethanave ku bëhet afarizmi.

Urdhërpagesa - është një instrument financiar me të cilin një person paguan një shumë të caktuar në bankë në të mirë të një përfituesi tjetër. Kjo procedurë zëvendëson pagesën e drejtpërdrejtë personit përfitues dhe banka shfrytëzohet si ndërmjetësues. Me rastin e pagesës, banka i lëshon paguesit urdhërpagesën.

Transferi i kredisë dhe i debitit - me kontratën e kredisë, banka detyrohet që shfrytëzuesit të kredisë t'ia lërë në dispozicion një shumë të caktuar të të hollave, në kohë të caktuar ose ë pacaktuar, me destinim ose pa destinim të caktuar. Në këtë rast, shfrytëzuesi detyrohet t'ia paguaj bankës kamatën e kontraktuar, plus shumën e marrë t'ia kthejë asaj në kohën dhe mënyrën e përcaktuar në kontratë. Pra, kur nënshkruhet kontrata, banka ia transferon një shumë të hollash shfrytëzuesit me pritjen se shfrytëzuesi do ti kthehen ato në kohën dhe metodën e përcaktuar në kontratë. Në anën tjetër, kontrata për debit është një kontratë ku klienti deponon një shumë të hollash në xhirollogari rrjedhëse ne bankë dhe tërhiqet të hollat nga bankomatat (makinat për tërheqjen e të hollave) apo ngarkon atë xhirollogari në vende të ndryshme afariste, nëpërmes të një kartele të lëshuar nga banka. Ngarkesa lejohet deri në shumën e deponuar në xhirollogarinë bankare. Kjo zëvendëson bartjen e të hollave nga klienti dhe zëvendësimin e tyre me një kartelë plastike të lëshuar dhe autorizuar nga banka.

Kontrata për depozitat financiare është një kontratë me të cilën banka detyrohet që të pranojë, kurse depozituesi të depozitojë në bankë një shumë të caktuar të hollash. Në këtë punë banka është depozitar. Me këtë kontratë banka e fiton të drejtën t'i disponojë të hollat e depozituara. Banka i hap llogarinë përkatëse klientit të vet, në dobi, respektivisht në barrë të të cilit regjistrohen kërkesat, respektivisht borxhet lidhur me atë punë. Kemi depozitat e të hollave pa afatizim, kur, me kërkesë të klientit, banka është e detyruar t'ia kthejë depozituesit të hollat e depozituara. Krahas kësaj, kemi depozitim e të hollave me afatizim, ku klienti mund t'i disponojë mjetet e depozituara pas afatit të kontraktuar. Detyrimet e bankës janë: ta hapë llogarinë, të bëjë regjistrimin në dobi dhe në ngarkim të klientin, të bëjë pagesa nga llogaria, të lajmërojë për gjendjen në llogari dhe të paguajë kamatën.

Depozita e kursimit është shuma e të hollave të cilën kursimtari- depozituesi ia dorëzon bankës për kursim në kushtet e kontraktuara. Kemi depozitat pa afatizim dhe të afatizuara. Banka paguan mbi depozitat kamatën e kontraktuar ose të përcaktuar me ligj. Për depozitën banka ia lëshon depozituesit kartelën e kursimit, ndërsa me pranimin e të hollave nga ana e bankës lidhet kjo kontratë.

Kontrata për llogarinë rrjedhëse është ajo kontratë në bazë së cilës banka detyrohet që një personi t'ia hapë llogari të veçantë dhe përmes saj t'ia pranojë pagesat dhe të bëjë arkëtimin në kuadër të mjeteve të tij dhe kredisë së lejuar. Banka ka të drejtë të llogarisë provizionin për shërbimet e kryera, që i përfshin kjo kontratë, si dhe shpenzimet e posaçme të krijuara lidhur me

ato shërbime. Për çdo ndryshim banka është e detyruar të lëshojë certifikatën për gjendjen ekzistuese dhe atë t'ia dorëzojë klientit, i cili ka të drejtë të shfaqë kundërshtimet e veta brenda afatit të parashikuar ose brenda 15 ditësh, kur ky afat nuk është përcaktuar.

Kontrata për sefin është një kontratë sipas së cilës banka detyrohet t'ia lërë sefin në dispozicion shfrytëzuesit për një periudhë të caktuar, kurse shfrytëzuesi detyrohet që për këtë t'ia paguajë bankës kompensimin e caktuar. Fjala “sef ” rrjedhë nga fjala angleze “safe”, që do të thotë “i sigurt, i mbrojtur, i ruajtur mirë”. Në sef vendosen sende të çmueshme, letra me vlerë, por kurrsesi sende që paraqesin rrezik. Sendet ruhen në trezor ose në kaseta. Sefi ka vetëm një çelës, të cilin e mbanë shfrytëzuesi i tij.

Akreditivi - është një instrument pagese, me të cilin banka akredituese (banka e lëshimit) detyrohet që, sipas urdhrimit të komitentit, në bazë të dokumenteve të prezantuara në përputhje me kushtet e kontraktuara (apo pa dokumente), të kryejë pagesën ose të autorizojë bankën tjetër (banka korresponduese) që t'ia bëjë pagesën personit të tretë (shfrytëzuesit të akreditivit) ose me urdhrin e saj (kalimi i urdhrimit) ose sipas urdhrimit të komitentit, vetë ajo ose me ndihmën e bankës tjetër, të paguajë, të akceptojë ose ta blejë kambialin e tërhequr prej shfrytëzuesit të akreditivit, me kusht që të jetë vepruar në përputhje me akreditivin e hapur të bankës së lëshimit (bankës akreditive).

Akreditivi është një punë komplekse bankare, në të cilën marrin pjesë së paku tre persona (shpesh edhe katër): urdhërdhënësi për hapjen e akreditivit (blerësi i mallit - importuesi në shitblerjen ndërkombëtare, investitori i punëve etj.); banka akredituese (sipas rregullit, në vend të urdhërdhënësit e hap akreditivin në emër të vet dhe për llogari të urdhërdhënësit); shfrytëzuesi i akreditivit shitësi i mallit, eksportuesi-shitësi në shitblerjen ndërkombëtare, kryerësi i punëve etj.)

Në këtë punë shpesh merr pjesë edhe banka tjetër (ndërmjetësuese-korresponduese) me seli në vendin e shfrytëzuesit, e cila mund të ketë rol të ndryshëm, por më së shpeshti paraqitet në rolin e bankës avizuese (banka e cila lajmëron shfrytëzuesin që në llogari të tij është hapur akreditivi te banka akreditive), te banka e konfirmimit, e cila, përveç bankës akreditive, e merr përsipër detyrimin e pavarur dhe të drejtpërdrejt të pagesës së akreditivit të shfrytëzuesit të akreditivit (debitor solidar).

Kemi disa lloje të akreditivit dokumentar:

- Akreditivi i revokuar dhe ai i parevokuar.- I pari është akreditivi që nuk e lidhë bankën ndaj shfrytëzuesit, pra të cilin banka në çdo kohë mund ta ndryshojë a ta revokojë me kërkesë të urdhërdhënësit, kurse i dyti është ai të cilin banka nuk mundet as ta ndryshojë, as ta revokojë gjatë kohës sa vlen ai;
- Akreditivi i konfirmuar dhe ai i pakonfirmuar.- Kjo ndarje bëhet në raste të tilla kur pagesa bëhet përmes bankës korresponduese dhe jo përmes bankës së lëshimit të akreditivit.
- Akreditivi i kalueshëm dhe ai i pakalueshëm.- I kalueshëm është ai akreditiv tek i cili shfrytëzuesi i tij mund t'ia japë urdher bankës (akreditive a të konfirmimit) që t'ia bëjë pagesën shfrytëzuesit tjetër ose shfrytëzuesve të tjerë. Kalimi i akreditivit bëhet në tërësi apo pjesërisht, natyrisht, vetëm nëse ky kalim është parashikuar shprehimisht; në të kundërtën, sipas rregullit, akreditivi është i pakalueshëm.
- Akreditivi i ndashëm dhe ai i pandashëm.- Akreditivi i ndashëm është një lloj i tillë i akreditivit, një pjesë të të cilit shfrytëzuesi mund ta shfrytëzojë derisa t'ia paguhet në tërësi shuma e shënuar në akreditiv, kurse tek akreditivi i pandashëm shfrytëzuesi duhet ta shfrytëzojë përnjëherë pagesën e shumës së shënuar në akreditiv.

Kontrata për garancitë bankare-Garancitë bankare shërbejnë për sigurimin e përmbartimit të detyrimeve të kontraktuara dhe sigurimin nga rreziqet e tjera komerciale në vend , por më tepër në tregtinë e jashtme dhe ato paraqesin deklaratën e bankës, me të cilën ajo merr përsipër detyrimin ndaj pranuesit të garancisë se brenda afatit të arritjes do ta përmbushë ndonjë detyrim të debitorit, nëse klienti i saj nuk do të mund ta përmbushte detyrimin e vet, por duke bërë këtë kur përmbushen kushtet e parashikuara në garanci.

Me garanci bankare realizohet një shkallë më e lartë e sigurisë së kreditorëve, që ndikon dukshëm në stabilizimin e marrëdhënieve në tregun ndërkombëtar, sepse konsiderohet se bankat, nuk do të marrin përsipër detyrime për të cilat nuk ekzistojnë kushtet maksimale të mbulesës kundruall të gjitha rreziqeve.

Funksioni i garancisë bankare nuk është përmbushja e detyrimit në vend të debitorit nga ana e bankës, por pranimi i rreziqeve të ndryshme, kur ndonjë punë nuk zhvillohet në rrethana dhe mirëbesim normal.

Prandaj, nga sigurimet reale, ky është ndër mjetet më të përshtatshme, sepse nuk angazhon mjete të caktuara materiale dhe nuk kufizon qarkullimin e tyre, kurse, në anën tjetër, ky është edhe në aspektin juridik dhe ekonomik mjeti më i sigurt ndër mjetet e tjera personale të sigurimit.

Elementet qenësore të garancive bankare janë:

- caktimi i bankës së urdhërdhënësit dhe kreditorit (shfrytëzuesit të garancisë),
- caktimi i punës që sigurohet me garanci,
- shumat e të hollave që duhet të shënohet në garanci, afati i kohëzgjatjes së garancisë,
- vendi dhe data e lëshimit të garancisë,
- nënshkrimi i personit të autorizuar të dhënësit të garancisë.

Me kontratën për garancinë bankare krijohen tri marrëdhënie: marrëdhënia e urdhërdhënësit dhe bankës, marrëdhënia e kreditorit dhe e debitorit dhe marrëdhënia mes bankës dhe shfrytëzuesit të garancisë. Kemi disa lloje të garancive bankare që paraqiten në praktikë, si: garancitë bankare për kthimin e avansit, që paraqiten në të gjitha kontratat në të cilat jepet avansi, por më së shpeshti të kontrata për dërgimin e pajimeve me kredi; garancitë bankare për licitime, sipas të cilave banka detyrohet që investuesit (shfrytëzuesit të garancisë bankare) t'i paguajë një shumë të caktuar të hollash, në rast se pjesëmarrësi në licitim e ndryshon ose e revokon ofertën e tij gjatë kohës së licitimit ose nuk pranon të lidhë kontratë në pajtim me ofertën, të cilën e kishte bërë gjatë licitimit dhe të cilin investitori e kishte pranuar; garancitë bankare për kryerje të mirë të punëve, sipas të cilave banka detyrohet t'ia paguajë garancinë personit të tretë, nëse dhënësi i shërbimeve nuk i plotëson në mënyrë cilësore dhe të rregullt detyrimet e veta të përcaktuara në kontratën themelore.

Kontrata për sigurimin. Me këtë kontratë kontraktuesi i sigurimit detyrohet që në bazë të parimit të reciprocitetit dhe të solidaritetit, të bashkojë një sasi të mjeteve në bashkësinë e sigurimit, kurse bashkësia e sigurimit detyrohet që, nëse ndodh ngjarja që përbën rasti të sigurimit, t'ia paguajë të siguarit ose ndonjë personi tjetër kompensimin ose shumën e kontraktuar ose të bëjë diç tjetër. Dëshmia e kësaj kontrate është Polica e Sigurimit. Detyrimet e të siguarit janë: ta bëjë pagesën e premisë brenda afatit të parashikuar në kontratë, t'ia paraqesë rrethanat për vlerësimin e rrezikut, të lajmërojë siguruesin për ndryshimet e rrezikut, të marrë masa, sa është e mundur, për të penguar shkaktimin e dëmit, ta lajmërojë siguruesin brenda një

afati sa më të shkurtër për ndodhjen e rastit të siguar. Detyrimet e siguresit janë: ta njoftojë të siguarin për kushtet e sigurimit, t'ia dorëzojë atij policën e sigurimit, t'ia kompensojë dëmin kur ndodh rasti i siguar, të bëjë pagimin e shpenzimeve të detyrueshme dhe të domosdoshme.

Fletobligacionet janë letra të shtypura, të cilat lëshuesi detyrohet që personit i cili është i shënuar në fletobligacion ose sipas urdhrin të tij, përkatësisht sipas prurësit të fletobligacionit, duhet t'ia paguajë në ditën e caktuar shumë e caktuar të fletobligacionit, përkatësisht shumë e kuponit në radhën e punëve bankare afatgjata, për shkak se afati i kërkesave të fletobligacionet është më i gjatë se një vit. Me lëshimin e fletobligacioneve zakonisht bëhet mbledhja e mjeteve të lira financiare, ashtu që lëshuesi do t'iu dorëzojë fletobligacionet vetëm atyre personave të cilët kanë paguar shumë e caktuar të të hollave, kurse banka detyrohet që shfrytëzuesit të këtij dokumenti t'ia paguajë në afatin e caktuar shumë nominale, që është përcaktuar në letër, së bashku me kamatën e caktuar në lidhje me kontratën ose me kontratë.

Bursat janë organizata të specializuara të tregut, të cilat themelohen si shoqëri aksionare për dhënien e shërbimeve lidhur me qarkullimin e mallrave, letrave me vlerë dhe metaleve të çmueshme si dhe të hollave.

Bursa është një vend a hapësirë e posaçme e tregtimit ku takohen afaristët dhe persona të tjerë në kohë të caktuar, në mënyrë që në kushte të caktuara të lidhin ndonjë kontratë për shitje në lëmin e afarizmit a objektit të punës së bursës. Në bursa tregtohet me të holla zhirale - kambiale, çeka, fletaksione dhe me letra të tjera me vlerë, me deviza, kapital, flori dhe metale të tjera të çmueshme, me mallra dhe derivate financiare (material tregu).

Bursat janë institucione të vjetra të së drejtës tregtare, të cilat janë paraqitur qysh në shekullin XV. Konsiderohet se bursa e parë është themeluar në Anvers, në vitin 1460, e pastaj në Londër, në vitin 1570 etj.

Bursat dallohen nga format e tjera të tregut, për shkak se në to, nuk ekspozohet malli, por shitja bëhet në bazë të mostrave ose modeleve dhe në bazë të standardeve të caktuara.

Kemi bursa të produkteve (mallrave), në të cilat shiten lloje të ndryshme të produkteve industriale dhe bujqësore, siç janë: drithërat, tekstili, vaji, metalet (bakri, plumbi, alumini etj.); bursa efektive (financiare), në të cilat shiten dhe blihen efekte të ndryshme tregtare, siç janë: kambiali, çeku, fletë-aksionet etj., por tregtohen edhe të holla dhe metale fisnike dhe bursa të përziera, në të cilat tregtohen të gjitha llojet e materialeve të tregut (mallra, letra me vlerë etj.).

3.5 Përmbledhje

Ky modul përmbledh njohuri të avancuara për kontratat specifike që përdoren në afarizmin e subjekteve ekonomike. Po ashtu ky modul përfshin njohuri për punët bankare dhe siguresë dhe jep informacione për mënyrat e zbatimit të kontratave që përdoren në afarizëm, në sektorin bankar dhe atë të sigurimeve. Rëndësi e veçantë i është kushtuar transaksioneve ndërkombëtare, specifike të tyre dhe mënyrës së realizimit. Ndër të tjera, moduli ka trajtuar edhe të drejtat dhe detyrimet palëve të përfshira në transaksionet afariste, bankare dhe siguresë,

Prezantimi është hartuar në atë formë që të adresoj dilemat dhe vështirësitë që hasen në praktiken afariste aktuale dhe në praktikën gjyqësore, përmes diskutimeve të pjesshme teorike, diskutimeve interaktive mes pjesëmarrësve dhe prezantimit të rasteve praktike.

Ky prezantim është modeluar duke pasur parasysh njohuritë e pjesëmarrësve dhe kërkesat specifike të tyre, me synim që të kontribuojë që:

- të rritet ekspertiza profesionale e gjyqtarëve në këtë fushë
- të krijohet praktikë gjyqësore në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe Evropiane
- të fitohen njohuri për përvojat dhe praktikat me te mira të shteteve në rajon
- të aplikohen instrumentet ndërkombëtare që rregullojnë këtë sferë?

4. Të drejtat nga pronësia intelektuale

4.1. Hyrje

Në këtë sesion do të trajtohen të drejtat nga pronësia intelektuale (PI), përfshirë të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta dhe markat tregtare. Në praktikën gjyqësore rastet më të shpeshta të kontesteve nga pronësia intelektuale përfshijnë kontestet lidhur me markat tregtare dhe të drejtën autoriale.

Të drejtat nga PI gjithnjë e më tepër po tregohen si një faktor i rëndësishëm zhvillimor në ekonominë e tregut dhe zhvillimin ekonomik të vendit, prandaj respektimi dhe zbatimi i këtyre të drejtave është i një rëndësie të veçantë. Përveç zhvillimit ekonomik zbatimi i të drejtave nga PI ndikon po ashtu në stimulimin e krijimtarisë kulturore dhe kreative. Sistemi ekonomik dhe sistemi i mbrojtjes së PI janë tregues i zhvillimit ekonomik të një vendi.

Edhe pse në Kosovë ekziston infrastruktura ligjore për mbrojtjen e të PI, si në aspektin civil ashtu edhe penal, megjithatë ende nuk është arritur që të krijohen mekanizma funksional për parandalimin e shkeljes së këtyre të drejtave, andaj rrjedhimisht titullarëve të këtyre të drejtave të vetmen mundësi të mbrojtjes efektive të se drejtave e kanë mbrojtjen gjyqësore. Si rezultat i të cekurave, ne gjykatë janë paraqitur një numër i caktuar i rasteve por ky numër pritet të rritet shumë në të ardhmen e afërt. Prandaj trajtimi i kësaj teme, është e një rëndësie të veçantë për të rritur njohuritë e pjesëmarrësve dhe krijimin e praktikave uniforme në trajtimin e rasteve.

4.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij moduli pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zgjerojnë njohuri lidhur me sistemin kompleks të të drejtave të pronësisë intelektuale si dhe rregullimin juridik të tyre;
- Njohin të drejtat e PI dhe autorizimet e titullarit të së drejtës;
- Identifikojnë llojet e ndryshme të të drejtave nga pronësia intelektuale dhe mënyrën e krijimit, realizimit dhe mbrojtjes së tyre;
- Avancojnë njohurit lidhur me mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe të fitojnë shkathësi praktike në vendosjen në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme lidhur me kërkesëpaditë nga kjo fushë e së drejtës ekonomike;
- Kuptojnë mbrojtjen juridike në aspektin civile dhe penal;
- Kuptojnë mbrojtja alternative e të drejtave të autorit – shoqatat profesionale;
- Zbatojnë drejtë procedurën gjyqësore për mbrojtjen e të drejtës së autorit.

4.3. Pronësia intelektuale

Të drejtat nga pronësia intelektuale (DPI) janë duke zënë gjithnjë e më shumë një vend të rëndësishëm në sferën juridike. Këto të drejta dhe mbrojtja e tyre mund të konsiderohen si tregues të zhvillimit ekonomik, krahas faktorëve të tjerë. Mbrojtja e të drejtave nga pronësia intelektuale ka efekt në rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike dhe krijimin e parakushteve për zhvillim ekonomik si dhe tërheqjen e investimeve të huaja.

Mbrojtja e të drejtave të pronës intelektuale tashmë është bërë një ndër fushat më të rëndësishme për bizneset, meqë shumica e tyre identifikohen me një emër, shenjë, formë, dizajn dhe produkt të caktuar.

Prandaj, me qëllim që dikush tjetër mos të krijojë avantazhe nga përdorimi i këtyre shenjave, logove, etj, në pothuajse secilin vend të botës këto të drejta mbrohen me ligj. Tashmë është miratuar një numër i madh i Konventave ndërkombëtare të cilat merren me këtë çështje. Ndërkaq në Kosovë, janë miratuar katër ligje të cilat mbulojnë katër llojet e pronës intelektuale të cekura më lartë. Më poshtë, do të paraqesim disa elemente të rëndësishme për markat tregtare, të drejtat e autorit, patentat, dhe dizajnet industriale, gjithnjë në kontekst të mbrojtjes juridike të përcaktuar me legjislacionin kosovar.

4.3.1 Burimet ligjore të DPI

Burimet themelore ligjore të të drejtave nga pronësia intelektuale në Kosovë janë:

- Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta,
- Ligji për Markat Tregtare,
- Ligji për Patentat,
- Ligji për Dizajnin Industrial.

4.3.2 Klasifikimi i DPI

Të drejtat nga pronësia intelektuale ndahen në dy grupe të të drejtave:

- Të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, dhe
- Të drejtat nga pronësia industriale.

Pronësia intelektuale në esencë përfshinë katër lloje të ndryshme të produkteve mendore që mund të dalin si rezultat i punës intelektuale të njerëzve. Ato janë:

- Të drejtat e autorit
- Markat tregtare
- Patentat
- Dizajnet industriale

Përveç këtyre katër llojeve, shumë autorë theksojnë se si pronë intelektuale mbrohet edhe të drejta të tjera të përafërta, siç janë p.sh, fshehtësitë tregtare.

Të drejtat nga pronësia intelektuale janë duke zënë gjithnjë e më shumë një vend të rëndësishëm në sferën juridike. Këto të drejta dhe mbrojtja e tyre mund të konsiderohen si tregues të zhvillimit ekonomik, krahas faktorëve të tjerë. Mbrojtja e të drejtave nga pronësia intelektuale ka efekt në rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike dhe krijimin e parakushteve për zhvillim ekonomik si dhe tërheqjen e investimeve të huaja.

Mbrojtja e të drejtave të pronës intelektuale tashmë është bërë një ndër fushat më të rëndësishme për bizneset, meqë shumica e tyre identifikohen me një emër, shenjë, formë, dizajn dhe produkt të caktuar.

Prandaj, me qëllim që dikush tjetër mos të krijojë përfitime të padrejta nga përdorimi i këtyre shenjave, logove, etj, në pothuajse secilin vend të botës këto të drejta mbrohen me ligj. Tashmë është miratuar një numër i madh i Konventave ndërkombëtare të cilat merren me këtë çështje. Ndërkaq në Kosovë, janë miratuar katër ligje të cilat mbulojnë katër llojet e pronës intelektuale të cekura më lartë. Më poshtë, do të paraqesim disa elemente të rëndësishme për markat tregtare, të drejtat e autorit, patentat, dhe dizajnet industriale, gjithnjë në kontekst të mbrojtjes juridike të përcaktuar me legjislacionin kosovar.

4.4 Të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta

4.4.1 Kuptimi dhe rëndësia e të drejtës së autorit

E drejta e autorit është degë e së drejtës ekonomike me të cilën rregullohen të drejtat e krijuesve nga krijimtaria e tyre letrare, shkencore apo artistike dhe përgjegjësitë e të tjerëve për respektimin e të drejtave të tyre.

Vepra autoriale është produkt i mendjes së njeriut (punë mendore) që shprehet përmes të shkruarit apo përmes veprave tjera artistike.

E drejta e autorit i takon autorit me vetë faktin e krijimit të veprës. Pra, për të gëzuar mbrojtjen e të drejtës së autorit nuk kërkohet plotësim paraprak i çfarëdo formaliteti administrative. Vepra e krijuar dhe autori i saj nuk kanë nevojë të regjistrohet në ndonjë regjistër publik.

Autor është personi fizik i cili e ka krijuar veprën. Nëse vepra përbën tërësi të pandashme dhe është krijuar në bashkëpunim të dy apo më shumë personave ata konsiderohen bashkautorë të veprës.

i. Veprat që mbrohen me të drejtën autoriale, përfshijnë:

- Veprat gojore;
- Veprat e shkruara;
- Veprat muzikore;
- Veprat filmike;
- Veprat teatrore;
- Veprat koreografike dhe të pantomimës;
- Veprat e artit figurativ dhe ato të artit aplikativ;
- Veprat e arkitekturës;
- Veprat fotografike;
- Programet dhe data bazat kompjuterike;
- Veprat e shprehura në harta, toponime, vizatime teknike etj.
- Veprat të autorit, mund të jenë:
- Krijimet intelektuale origjinale, si romanet, filmat, dramat, pikturat, etj.
- Veprat e prejardhura.

Vepra të prejardhura janë përkthimet, përshtatjet, aranzhmanet, orkestrimet muzikore dhe përpunimet tjera të një vepre ekzistuese apo materiali tjetër.

Veprë e autorit konsiderohet koleksioni i veprave ekzistuese të autorit ose materialeve të tjera që për nga për zgjedhja, përshtatja dhe bashkërenditja e përmbajtjeve të tyre paraqet krijim origjinal intelektual, përkatësisht veprë të mëvetësishme siç janë: enciklopeditë, antologjitë, koleksionet e poezive apo veprave në prozë, përmbledhja e shprehjeve folklorike, e dokumenteve dhe vendimeve gjyqësore.

Sipas Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta (nenin 8.1) vepra të autorit janë krijimet intelektuale origjinale. Originaliteti në krijimtari kërkohet si të krijimet origjinale ashtu edhe të veprat e prejardhura.

Në praktikën gjyqësore njihet rasti i krijimit të regjistrit të telefonave nga një person në SHBA, i cili ka pretenduar së ky regjistër përbën krijimtari të re dhe të drejtë autoriale të tij, mirëpo gjykata e ka refuzuar me vlerësimin se regjistri i telefonave nuk përbën veprë origjinale nga se autori nuk ka treguar ndonjë kreativitet por vetëm i ka aranzhuar të dhënat apo faktet të cilat kanë ekzistuar më herët. Fakti se është humbur kohë në përpilimin e regjistrit nuk është vlerësuar nga gjykata si relevant për krijimin e të drejtës autoriale.

ii. Veprat që nuk gëzojnë mbrojtjen si vepra autoriale janë:

- Idetë, parimet, udhëzimet, procedurat, zbulimet ose konceptet matematikore;
- Parashtrësas dhe aktet tjera në procedurat administrative ose gjyqësore;
- Materialet zyrtare të botuara për informim të publikut;
- Lajmet e ditës dhe informacionet e ndryshme që kanë karakter të raportimeve të rëndomta të mediave.
- Ligjet, aktet nënligjore dhe aktet e tjera;
- Materialet zyrtare dhe botimet e organeve parlamentare, qeveritare dhe të organizatave tjera që kryejnë funksione publike;
- Përkthimet zyrtare të akteve juridike dhe materialeve tjera zyrtare, si dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe instrumenteve tjera; etj.

4.4.2 Klasifikimi i të drejtave të autorit

Të drejtat e autorit ndahen në të drejta morale dhe të drejta pasurore.

i. Të drejtat morale: Përmbajnë autorizimet ekskluzive personale për të mbrojtur pacenueshmërinë e veprës së autorit dhe personalitetin e autorit. Të drejtat morale janë të drejtat ekskluzive të cilat mbrojnë integritetin e veprës së mbrojtur të autorit dhe personalitetin e autorit të saj.

Të drejtat morale përfshijnë:

- E drejtat për të vendosur nëse, kur dhe si do të publikohet për herë të parë vepra e tij,
- E drejta e atribuimit, që nënkupton të drejtën e autorit të njihet dhe të shënohet si autor i veprës,
- E drejta e autorit që të vendosë nëse autorësia e tij duhet të tregohet me emër, pseudonim apo shenjë,

- E drejta e integritetit mbi veprën, që nënkupton të drejtën që të kundërshtojë çfarëdo deformimi, apo intervenimi tjetër në veprën e tij, dhe çfarëdo shfrytëzimi të veprës, nëse një ndërhyrje e tillë do të mund ta paragjykonte reputacionin e tij kreativ dhe respektin.

Të drejtat morale janë të patjetërsueshme, ashtu që autori nuk mund t'ia kalojë të drejtat morale të tij personit tjetër. Konsiderohen të pavlefshme bartjet kontraktuese me të cilat autori bën kalimin e të drejtave morale.

ii. Të drejtat pasurore: Autorizimet ekskluzive pasurore për të mbrojtur interesat pasurore të autorit – quhen të drejtat pasurore të autorit. Autori ka të drejtë ekskluzive për shfrytëzimin pasuror të veprës së tij në çfarëdo forme, si dhe t'ia lejojë apo ndalojë personave të tjerë shfrytëzimin e veprës së tij. P.sh. autori i një veprë letrare ka të drejtën të shumëztoj veprën e tij në disa ekzemplar dhe ta shes në treg.

Personat tjerë mund të shfrytëzojnë veprën e autorit vetëm në bazë të autorizimit të autorit. Për çdo shfrytëzimi të veprës, autorit i takon kompensimi. Të drejtat pasurore dhe të drejtat e tjera të autorit mund të jenë objekt i kalimit juridik. Autori mund t'ia kalojë personit tjetër të drejtat pasurore për shfrytëzim të veprës së tij, përmes lidhjes së kontratës apo veprimit tjetër juridik. Po ashtu, të drejtat pasurore mund të jenë objekt trashëgimi në procedurë trashëgimore.

Të gjitha kontratat me anë të të cilave bëhet kalimi i të drejtave pasurore dhe të drejtave tjera të autorit, ose jepen autorizime për shfrytëzim të veprës, bëhen në formë të shkruar. Kalimi i të drejtave pasurore mund të jetë ekskluziv ose jo ekskluziv. Kalimi ekskluziv e autorizon vetëm marrësin e të drejtës që, në mënyrën e përcaktuar me kontratë, të shfrytëzojë veprën e autorit, duke përjashtuar të gjithë personat tjerë, përfshirë edhe autorin.

Ndërsa, kalimi jo ekskluziv e autorizon marrësin e të drejtës që në mënyrën e përcaktuar me kontratë, të shfrytëzojë veprën e autorit, krahas autorit dhe cilit do person tjetër që është titullar i të drejtës së autorit.

4.4.3 Kontratat e veçanta të së drejtës autoriale

i. Kontrata e botimit

Me kontratë botimi autori ia kalon të drejtën botuesit për të riprodhuar veprën e tij me anë të shtypshkrimit dhe të drejtën për shpërndarje të ekzemplarëve të veprës, ndërkaq botuesi merr për detyrim të bëjë riprodhimin dhe shpërndarjen e veprës si dhe për këtë t'i paguajë autorit kompensimin. Me kontratën për përpunimin e veprës së autorit, autori e kalon të drejtën për t'u përpunuar vepra e tij në formën e përshtatjes skenike, përshtatjes audio vizuale ose për mënyra të tjera të shfrytëzimit të veprës në formë të ndryshuar.

ii. Kontrata për shfaqjen

Me kontratë për shfaqjen, përkatësisht kontratën për interpretimin e veprës, autori ia kalon shfrytëzuesit të drejtën për të shfaqur, përkatësisht për të interpretuar publikisht veprën e tij, ndërsa shfrytëzuesi merr detyrimin që atë vepër ta shfaqë, përkatësisht ta interpretojë publikisht në afatin e caktuar, në mënyrën dhe nën kushtet e përcaktuara me kontratë, dhe për këtë t'i paguajë autorit kompensimin.

iii. Kontrata për porosinë e veprës

Me kontratën për porosi të veprës së autorit, autori merr detyrimin që për porositësin të krijojë veprën e autorit dhe t'ia dorëzojë origjinalin ose ekzemplarën e veprës, ndërsa porositësi merr detyrimin që autorit t'ia paguajë kompensimin.

4.4.4 Kohëzgjatja e të drejtave të autorit

Të drejtat pasurore të autorit zgjasin gjatë gjithë jetës së autorit dhe shtatëdhjetë (70) vjet pas vdekjes së tij. Me mbarimin e afateve të kohëzgjatjes së mbrojtjes, vepra e mbrojtur me të drejtën e autorit kalon në domenin publik dhe është e lirë për t'u shfrytëzuar.

Sa iu përket të drejtave morale, ligji ynë bënë disa dallime në kohëzgjatjen e tyre. E drejta e publikimit të parë zgjat derisa autori të jetë gjallë. Ndërsa, e drejta e atribuimit, që nënkupton të drejtën e autorit të njihet dhe të shënohet si autor i veprës dhe e drejta për integritet, gjegjësisht e drejta në mbrojtjen e veprës nga çdo lloj deformimi, gjymtimi apo shfrytëzimi të veprës, nëse me këtë mund të fyhet nderi dhe fama krijuese e tij, zgjasin pa kufizim kohor.

4.4.5 Të drejtat e përafërta

Të drejtat që gëzojnë mbrojtje juridike si të drejta të përafërta me të drejtat e autorit, u takojnë:

- Interpretuesve përkitazi me interpretimet e tyre;
- Prodhuesve të fonogrameve përkitazi me fonogramet e tyre;
- Producentëve të filmit përkitazi me videogramet e tyre;
- Shërbyesve medial audiovizuel përkitazi me transmetimet e tyre;
- Prodhuesve të bazave të të dhënave përkitazi me bazat e tyre të të dhënave;
- Botuesve përkitazi me botimet e tyre; etj.

4.4.6 Mbrojtja ligjore dhe institucionale e të drejtave të autorit në Kosovë

E drejta e autorit përveç mbrojtjes me Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e përafërta, mbrohen edhe me Kodin Penal, ashtu që shkelja e të drejtave të kësaj fushe, nën kushte të caktuara përbën edhe vepër penale nga neni 296 i KPK-së dhe mund të dënohet deri në tri vite burgim, e në raste më të rënda të shkeljeve deri në 8 vite burgim.

Përveç rregullimit ligjor, janë krijuar edhe mekanizma me qëllim që të arrihet një mbrojtje efikase të drejtave autoriale, si:

- Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta (ZPI), në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
- Inspektoratit i Tregut, si organ ekzekutiv në kuadër të MTI, kompetent për mbikëqyrjen e Tregut në territorin e Republikës së Kosovës, përveç tjerash, i janë dhënë kompetenca dhe përgjegjësi të rëndësishme edhe për mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, në zhvillimin e veprimtarisë tregtare në vend;
- Task Forca kundër piraterisë dhe falsifikimit;

- Policia e Kosovës, ka kompetenca ligjore në luftimin e krimit ekonomik duke përfshirë edhe
- shkeljet në fushën e të drejtës së autorit; dhe
- Prokuroritë dhe gjykatat e vendit në kuadër të kompetencave të tyre ligjore, janë në shërbim të mbrojtjes së të drejtave autoriale.

Format më të shpeshta të shkeljes së të drejtave autoriale bëhen përmes fotokopjimit, shumëzimit, shfrytëzimit të paautorizuar të veprave autoriale, e formave të tjera të realizimit të përfitimit ilegal.

Interneti dhe teknologjia që po përdoret në ditët e sotme ofrojnë mundësi të lehta për fotokopjimin e CD-ve, filmave, librave, etj. Kur këto materiale origjinale kopjohen në tërësi, dukuria e tillë quhet pirateri, e cila dukuri fatkeqësisht është prezentë kudo nëpër botë, por edhe në Kosovë.

Çdo person i cili konsideron se i janë shkelur të drejtat e autorit, mund të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të tij dhe zhdëmtim përkatës në varësi me shkeljen dhe dëmet e shkaktuara.

Në rast të shkeljes së të drejtave të autorit, bartësi i të drejtës mund të kërkojë me padi nga gjykata, që:

- Të konstatohet ekzistimi i shkeljes së të drejtave autoriale;
- Të lëshohet vendimi që ndalon vazhdimin e shkeljes dhe të shkeljeve të përsëritura në të ardhmen, si edhe disa akte përgatitore për shkeljet e tilla periodike;
- Mallrat që krijohen si rezultat i shkeljes së të drejtave, materialet dhe mjetet kryesisht të përdorura në krijimin apo fabrikimin e mallrave që shkelin të drejtat mund të kërkohej që definitivisht të largohen nga tregu dhe të shkatërrohen me shpenzime të shkelësit;
- Të kompensohet dëmi material që nënkupton dëmin aktual dhe fitimin e humbur,
- Të kompensohet dëmi jo material i shkaktuar si rezultat i shkeljes së të drejtave morale;
- Të bëhet shpallja e plotë apo pjesërisht e aktgjykimit nga gjykata, në masmedia, me shpenzime të shkelësit.

4.5 Markat Tregtare

Markat Tregtare janë kategori e rëndësishme nga të Drejtat e Pronësisë Intelektuale (DPI) që luajnë rol të rëndësishëm në ekonominë e tregut, pasi që ndërmarrjet gjatë zhvillimit të afarizmit të tyre përdorin Markat Tregtare me qëllim të dallimit të produkteve dhe shërbimeve të tyre nga produktet dhe shërbimet e të tjerëve, si dhe për mbrojtjen e produkteve të tyre

Kosova në përpjekjet e saj për krijimin e një sistemi juridik bashkëkohor, ka krijuar bazën juridike e cila mundëson regjistrimin dhe mbrojtjen e markave tregtare. Në këtë drejtim, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për Markat Tregtare - Ligji Nr. 04/L-026.

Mbrojtja e Markave Tregtare u paraqit si nevojë e kohës respektivisht e nevojave për zhvillim ekonomik pasi që Kosova synon një ekonomi të tregut dhe një dinamikë të përshpejtuar të zhvillimit përmes investimeve të huaja, ndërsa mbrojtja e Markave Tregtare përbën një prej parakushteve themelore për tërheqjen e kompanive multinacionale dhe krijimin e sigurisë juridike në qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve.

Edhe pse mbrojtja e markave tregtare garantohej si me Ligjin për Markat Tregtare ashtu edhe me Kodin Penal, si dhe me masa tjera administrative duke përfshirë edhe ato doganore, megjithatë në praktikën juridike hasen vështirësi të shumta në zbatimin e dispozitave ligjore.

Këto vështirësi paraqiten si pasojë e paqartësive të ligjit, mos-kordinimit të organeve shtetërore që e mbulojnë këtë sferë, si dhe mungesës së përvojës së akterëve të kyçur në këtë aktivitet.

Po ashtu, në praktikën juridike paraqiten konteste me element ndërkombëtar, që shfaqin nevojën e analizimit të përputhshmërisë së legjislacionit të brendshëm me rregullat ndërkombëtare, për tu siguruar se gjatë zbatimit të dispozitave, interpretimi i tyre të jetë në përputhje me praktikat ndërkombëtare.

4.5.1 Rëndësia e Markave Tregtare

Ne kohët moderne markat tregtare përbëjnë një komponentë shumë të rëndësishme për ndërmarrjet gjatë zhvillimit të afarizmit të tyre, sepse përmes tyre identifikojnë produktet dhe shërbimet e tyre nga produktet dhe shërbimet e të tjerëve. Sot, markat tregtare luajnë rol të rëndësishëm për mbrojtjen e interesave të ndërmarrjeve, si dhe në mbrojtjen e konsumatorëve.

Marka tregtare funksionon si garantues i cilësisë, indikatorë për konsumatorët që kërkojnë produkte të sigurta, siguroes që shpërblimet u shkojnë investitorëve të cilët posedojnë emër tregtar i cili përfaqëson emër dhe reputacion të mirë.

Marka Tregtare sipas Shoqatës Amerikane për Marketing – AMA (American Marketing Association) definohej si, emër, shprehje, disajn, simbol apo çfarë do shenjë tjetër e cila identifikon mallin apo shërbimin e një shitësi, si të ndryshëm nga malli apo shërbimi i shitësit tjetër.¹⁶ Të njëjtin përkufizim e jep edhe Agjencia për Pronësi Industriale e Republikës së Kosovës¹⁷

Markat tregtare u mundësojnë konsumatorëve që me kosto sa më të ulët të zgjedhin në mes të mallrave dhe shërbimeve që sot ofrohen në treg.

Markat tregtare luajnë një rol të rëndësishëm në ekonominë e tregut për disa arsye, të cilat janë cekur në vijim, por që nuk kufizohen vetëm në këto¹⁸ :

- Ulin koston e kërkimit
- Nxisin konkurrencën
- Sigurojnë informata të sakta lidhur me atë produkt.
- Rrisin shitjen dhe krijojnë mirëbesim.
- Nxisin eksportin.
- Mund të shndërrohen në pasuri të vlefshme për kompaninë/biznesin.

¹⁶<http://www.uspto.gov/learning-and-resources/trademark-faqs#1223>

¹⁷<http://www.kipa-ks.org/sq/markat-tregtare>

¹⁸Mbrojtja dhe Zbatimi i Markave Tregtare faq.4, - Për EMSG – Menaxhimi Ekonomik dhe Zhvillim USAID; Luljeta Plakolli; <https://juristat.files.ëordpress.com/2012/08/menaxhimi-ekonomik.pdf>

4.5.2 Karakteristikat Themelore te Markave Tregtare

Marka tregtare është e drejtë pronësore ekskluzive përmes së cilës mbrohet shenja me të cilën pronari i markës tregtare identifikon mallrat apo shërbimet e tij në qarkullimin tregtar, me qëllim të dallueshmërisë nga mallrat apo shërbimet e subjekteve tjera.

Në qarkullimin tregtar Marka tregtare barazohet me shenjë dalluese por në thelb marka tregtare është e drejtë pronësore e cila titullarit të së drejtës i jep të gjitha të drejtat që i gëzon edhe pronari i pronës së paluajtshme.

Prandaj Marka tregtare në thelb nuk përbën shenjë dalluese, emër tregtar apo markë të produktit por në fakt Marka Tregtare përbën të drejtë subjektive të titullarit të saj.

Bartësi i të drejtës së Markës Tregtare ka të drejtën që t'i ndalojë të tjerët për përdorimin jo vetëm të markës së tij por edhe markës së ngjashme e cila mund të shkaktojë konfuzion në lidhje me origjinën e mallit, mund ta licencojë, ta jap për shfrytëzim dhe të përfitojë nga kjo, ta bartë të drejtën e tij në persona tjerë, ta lë peng, të jetë objekt i ekzekutimit apo të përfshihet në procedurën e falimentimit. Pra Marka tregtare përbën pasuri të vlefshme për titullarin e saj dhe gëzon të gjitha të drejtat që i gëzon çdo pasuri tjetër.

4.5.3 Funkzioni i Markës tregtare

Lidhur me funksionet e Markës tregtare në teorinë dhe praktikën ndërkombëtare ekzistojnë mendime të ndryshme. Sipas pikëpamjeve tradicionale funksioni themelor i Markës Tregtare është funksioni i identifikimit të origjinës së produktit apo shërbimit¹⁹. Këtë qëndrim e ka mbështetur edhe Gjykata Evropiane e Drejtësisë (GJED) në vitet 70, para Direktivës për Markat Tregtare²⁰.

Këtë qëndrim GJED e ka theksuar në rastin Hoffman-La Roche v. Centafarm, ku thekson: "Funksioni thelbësor i markës tregtare është është për të garantuar identitetin e origjinës së produktit të markës tregtare ndaj konsumatorit apo përdoruesit të fundit, duke ia bërë të mundur atij që pa asnjë mundësi konfuzioni ta dallojë atë produkt nga produktet të cilat kanë një origjinë tjetër.

Kjo garanci e origjinës do të thotë që konsumatori ose përdoruesi i fundit mund të jenë të sigurt se një produkt me markë tregtare, i cili i është shitur atij, nuk i është nënshtruar në një fazë të mëparshme të marketingut apo të ndërhyrjes nga një person i tretë, pa autorizimin e pronarit të markës tregtare te tilla që ndikojnë në kushtin e origjinalitetit të produktit. E drejta i atribuohet

¹⁹Në një artikull të vitit 1970, K. Breier vuri në dukje se «një marke tregtare shërben për të dalluar mallrat e një prodhuesi nga mallrat e prodhuesit tjetër. Marka duhet të identifikojë origjinën e mallrave të kompanisë së caktuar. E drejta ekskluzive e përdorimit për pronarin e markës tregtare shërben për të mbrojtur vetëm këtë funksion dhe është i kufizuar nga qëllimi themelor i mbrojtjes së markës tregtare; Pronari është i mbrojtur me të drejtën e tij ligjore vetëm kundër përdorimit të padrejtë të markës së e tij në mallrat etë tjerëve. Kjo e drejtë do të parandalojë të tjerët që të shkaktojnë konfuzion lidhur me origjinën e mallrave dhe duke siguruar avantazh të padrejtë të emrit të mirë të mishëruar në markën markën tregtare. Një mbrojtje e tillë është edhe interes të publikut të gjerë që duhet të mbrohet kundër paraqitjes ndryshe ». Shih F. K. Beier, «Territoriality of Trademark and International Trade», 1 IIC (1970), pp. 48 ff. (61-62).

²⁰ Direktiva e Parë e Këshillit 89/104/EEC (1988), 21 dhjetor 1988 Për harmonizimin e legjislacionit të shteteve anëtare lidhur me Markat Tregtare

Pronarit për të parandaluar përdorimin e paautorizuar të markës tregtare, e cila mund të dëmtojë garantimin e origjinës, prandaj është e kuptueshme që kjo përbën objekt të veçantë të së drejtës së markës tregtare²¹.

Gjykimet e tjera para Direktivës së Markave Tregtare përsëritin të njëjtin përcaktim²². Kur u miratua Direktiva për Markat Tregtare ajo miratoi gjithashtu nocionin e funksionit thelbësor²³. Përderisa dispozitat e Direktivës nuk e përmendin në mënyrë specifike këtë koncept, në pikën 10 të Preambulës së Direktivës theksohet se "funksioni i markës së regjistruar tregtare, në veçanti është për të garantuar markën tregtare si një tregues të origjinës"²⁴.

Përveç kësaj në nenin 2 të Direktivës, kur përcaktohet "shenjat nga e cila mund të përbëhet Marka tregtare ", kërkon që ato të jenë "shenja që mundësojnë për të dalluar mallrat ose shërbimet e një ndërmarrjeje nga ato të ndërmarrjeve tjera.

GJED dhe shumë komentatorë e kanë parë në këtë nen përfshirjen e funksionit thelbësor nga ana e Direktivës²⁵. Gjykata e ka mbajtur të afirmuar funksionin thelbësor të markës tregtare në shumë vendime të dhëna pas miratimit të Direktivës, shpesh duke përdorur formulimin klasik nga rasti Hoffman-La Roche v. Centafarm²⁶.

Praktika e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GJED), me kalimin e kohës përveç funksionit themelor të markës tregtare, atë të identifikimit të origjinës së produktit, në rastin L’Oreal v. Bellure (2009) ka njohur edhe katër funksione tjera të markës tregtare, atë të kualitetit, investimit, komunikimit dhe reklamimit.

i. Funksioni identifikues/dallueshmërisë: Funksioni thelbësor i markës tregtare është funksioni i identifikimit të origjinës të produktit apo shërbimit, respektivisht ta bëjë të dallueshëm produktin apo shërbimin e një ndërmarrjeje nga produkti apo shërbimi i ndërmarrjes tjetër. Marka tregtare duhet t’i mundësojë konsumatorëve të dallojnë mallrat dhe shërbimet e ndërmarrjeve të ndryshme pa krijuar paqartësi për të njëjtat, qoftë duke i ngatërruar markat midis tyre apo duke besuar se një shenjë e caktuar ka të njëjtën origjinë me markën e caktuar.

ii. Funksioni i kontrollit të kualitetit/garancionit: markat tregtare gëzojnë mbrojtje pasi ato shfaqin kualitete të caktuara të produktit apo shërbimit dhe shërbejnë si garantues të kualitetit të mallit. Njerëzit përcaktohen për blerjen e një produkti apo shërbimi nëse mallrat apo shërbimet e

²¹ECJ 23 May 1978, Case 102/77, Hoffmann-La Roche/Centrafarm), § 7.

²² Shih për shembull. ECJ 10 tetor 1978, Rasti/Case 3/78, Centrafarm/American Home Products, § 12; ECJ 17 October 1990, Case C-10/89, HAG II, § 14.

²³ Direktiva e Parë e Këshillit 89/104/EEC (1988), 21 dhjetor 1988 Për harmonizimin e legjislationit të shteteve anëtare lidhur me Markat Tregtare

²⁴ E njëjta gjë thuhet në pikën 11 të versionit të kodifikuar të Direktivës.

²⁵ Shih GJED 4 tetor 2001, Çështja C-517/99, Merz & Krell. Pas theksimit se "funksioni thelbësor i markës tregtare është që të garantojë identitetin e origjinës së mallit ose shërbimit të markës tregtare ndaj konsumatorit apo përdoruesit të fundit, Gjykata konsideron se" Ky funksion thelbësor i markave tregtare ka qenë i inkorporuar nga legjislatura e Komunitetit në nenin 2 të Direktivës. "Shih id. §§ 22-23. Shiko poashtu ECJ 12 nëntor 2002 Case C-206/01, Arsenal / Reed, § 49 (njëjtë). Në mesin e komentareve ligjor, shih p.sh. J. Antill & A. James, «R egistrability and the scope of the monopoly: current trends, EIPR, 26(4) 2004, pp. 157 ff.; I. Simon Fhima, «How Does "Essential Function" Doctrine Drive European Trade Mark Law?», IIC 36 (2005), pp. 401 ff. (408).

²⁶ Shih p.sh. GJED 29 Shtator 1998 (C-39/97, Canon/Metro-Goldwyn-Mayer), § 28; GJED 4 Tetor 2001 (C-517/99, Merz & Krell), § 22; GJED 23 April 2002 (C-143/00, Boehringer Ingelheim), § 12; ECJ 12 Nëntor 2002 (C-206/01, Arsenal/Reed), § 51; GJED 6 Maj 2003 (C-104/01, Libertel), § 62; GJED 16 Nëntor 2004 (C-245/02, Anheuser-Busch), § 59; GJED 25 Janar 2007 (C-48/05, Adam Opel/Autec), § 21; GJED 11 Shtator 2007 (C-17/06, Céline), §§ 16, 26; GJED 10 prill 2008 (C-102/07, Adidas/Marca Mode), § 36; GJED 19 shkurt 2009 (C-62/08, UDV/Brandtraders), § 42; ECJ 18 June 2009 (C-487/07, L’Oréal/Bellure), § 58; CJED 23 Mars 2010 (C-236/08 to C-238/08, Google France), §§ 77, 82.

shitura nën një markë të caktuar tregtare tregojnë cilësi. Marka tregtare nxit besnikërinë e konsumatorit dhe krijon emrin e mirë të prodhuesve apo ndërmarrjeve. Funkzioni i kontrollit të kualitetit të markës tregtare gjithashtu nxit prodhimin e mallrave të kualitetit të qëndrueshëm.

iii. Funkzioni i investimit, komunikimit dhe reklamimit: Këto funksione vijnë në shprehje të markat tregtare me reputacion. Një markë tregtare me reputacion gëzon të drejtën e mbrojtjes edhe në rastet kur nuk ekziston mundësia e shkakimit të konfuzionit tek konsumatori përkatës, por përdorimi i markës së ngjashme do të shkaktoje përfitime të padrejta për përdoruesin dhe njëkohësisht do të ishte e dëmshme për reputacionin e markës tregtare. Ky funksion i markës tregtare u adresua për herë të parë nga GJED në rastin “Google France case”²⁷.

iv. Funkzioni i të drejtës së pronës private dhe funksioni ekonomik: Një prej funksioneve të rëndësishme të markës tregtare është fakti që marka tregtare përbën të drejtë pronësore. Titullari i të drejtës së markës tregtare gëzon të gjitha të drejtat që i gëzon edhe titullari i pronës së paluajtshme apo asaj të luajtshme. Në shtetet e zhvilluara markat tregtare janë pasuri të paluajtshme të cilat janë bërë pasuri e vlefshme dhe e domosdoshme në zhvillimet afariste.

4.5.4 Llojet e Markave Tregtare

Në qarkullimin juridik dallimi kryesor i markave tregtare bëhet ndërmjet markave tregtare të mallrave dhe shërbimeve.

i. Markë Tregtare (shkurtesa në anglisht TM) zakonisht i referohet shenjës e cila përshkruan një produkt dhe bartë informacione tek konsumatori lidhur me prejardhjen e atij produkti. Shenjat, të cilat përdoren si tregues burimi të një shërbimi quhen **Marka Shërbimi** (shkurtesa në anglisht SM).

Në qarkullimin tregtar, llojet e markave të cilat shërbejnë si identifikues të burimit janë:

ii. Markat tregtare individuale – përbën markë tregtare të personit fizik apo juridik që shërben për identifikimin respektivisht dallimin e një apo disa produkteve, apo shërbimeve të atij subjekti, nga produktet apo shërbimet e subjekteve tjera.

iii. Markat Kolektive- markë e cila përdoret nga anëtarët e një shoqate ose ndonjë grupi tjetër kolektiv për të dalluar produktet dhe shërbimet e tyre nga produktet dhe shërbimet e të tjerëve.

iv. Marka e kualitetit/garancionit është markë e cila përdoret nga shumë subjekte nën mbikqyrjen e bartësit të markës tregtare dhe e cila shërben si garantues i kualitetit, prejardhjes gjeografike, mënyrës së prodhimit apo elementeve tjera të përbashkëta të mallit apo shërbimit të atyre subjekteve.

v. Në qarkullim njihen poashtu:

- **Marka e rezervuar** - si markë e cila planifikohet të përdoret në të ardhmen.
- **Marka defanzive** të cilën titullari i markës nuk planifikon ta përdor si shenje mbrojtëse në produktet e tij por markën e përdor si mjet juridik për t'ia pamundësuar të tjerëve që ta përdorin atë shenjë apo shenjë të ngjashme në produktet e tyre.

²⁷CJEU 23 mars 2010, “Joined Case c-236/08 to c-233/08, Google France §§ 91 ff.”

4.5.5 Llojet e Markave Tregtare sipas spektrit të dallueshmërisë

Meqenëse funksioni kryesor i një marke tregtare është që të shërbejë si identifikues i burimit, marka duhet të ketë veçori dalluese. Dallueshmëria është kushti themelor për mbrojtjen e markës tregtare. Sa më e dallueshme të jetë një markë, aq më shumë mbrojtje do të gëzojë, dhe anasjelltas.

Duke marrë për bazë nivelin e dallueshmërisë përmes të ashtuquajturit “spektrit të dallueshmërisë” markat kategorizohen në pesë nivele:

- i. Markat e sajuara apo imagjinare** - janë markat më të fuqishme. Shembuj të këtyre janë markat KODAK, MERCEDES, NIKE. Këto dy shembuj janë marka të shpikura dhe qëllimi i tyre i vetëm është ta identifikojnë një mall ose shërbim të caktuar. Ato nuk ndërlidhen me produktin dhe nuk tregojnë ndonjë karakteristikë të tyre por shërbejnë për identifikimin e burimit të produkteve për të cilat ato edhe janë bërë markë tregtare.
- ii. Markat arbitrare** - janë marka të cilat përbëhen nga një fjalë që ka kuptim të zakonshëm, si për shembull CAMEL (për cigare), RINGS, (për restorant) dhe Domino`s (për pica), por që nuk kanë lidhje me mallrat dhe shërbimet të cilat shiten nën atë emër të markës tregtare. Për shembull, nëse marka RINGS përdoret për unaza, atëherë do të konsiderohej si markë përshkruese që nuk meriton mbrojtjen. Mirëpo, nëse e njëjta përdoret në lidhje me një restorant, atëherë konsiderohet si markë e fuqishme e cila mbrohet me ligj.
- iii. Markat sugjeruese** - janë marka që sugjerojnë një cilësi ose veçori të mallit apo shërbimit. Ky lloj i markave qëndron në mes të markave arbitrare dhe atyre përshkruese sepse ato përbëhen prej fjalëve me kuptim të zakonshëm, sikur markat arbitrare ndërsa iu referohen mallrave dhe shërbimeve sikurse markat përshkruese. Shembuj të markave sugjeruese janë: MICROSOFT, NETSCAPE, SILICON GRAPHICS.
- iv. Markat përshkruese** - janë marka të cilat përshkruajnë shërbimet dhe mallrat për të cilat përdoren. Markat përshkruese nuk gëzojnë mbrojtje, përveç nëse ato kanë fituar kuptim dytësor në mendjen e konsumatorit. Megjithatë, është e mundur që markat përshkruese të arrijnë "dallueshmërinë", duke fituar kuptim dytësor. Kuptimi dytësor tregon se edhe pse shenja në paraqitjen e saj është përshkruese e mallrave ose shërbimeve, konsumatorët e njohin si shenjë që tregon burimin e origjinës. Një term përshkrues apo frazë kur arrihet "kuptimin dytësor" (kuptimi i parë është kuptimi i zakonshëm i fjalës apo frazës), shndërrohet në markë të mbrojtur. Kuptimi dytësor mund të arrihet me anë të përdorimit afatgjatë, apo përmes reklamave dhe publicitetit të madh. Përvetësimi i kuptimit dytësor është dëshmuar shpesh nëpërmjet përdorimit të sondazheve të konsumit, të cilat tregojnë se konsumatorët njohin shenjën si një markë, si p.sh "DIGITAL"

Shembuj të shenjave të cilat mund të konsiderohen përshkruese, por kanë zhvilluar në mënyrë të qartë kuptimin e dytësor përfshijnë:

- SHARP për televizionet;
- EINDOËS për softuerë ;
- INTERNATIONAL BUSINESS MACHINES për kompjuterë dhe makina tjera të biznesit; dhe
- POËER COMPUTING për kompjuterë bazuar në “chip PC” te fuqishëm.

- v. **Markat e përgjithshme (Gjenerike)** - bien në kategorinë më të ulët të spektrit të dallueshmërisë pasi që përbëhen prej fjalëve që janë të rëndomta në gjuhën e përditshme. Edhe një markë e regjistruar mund të bëhet fjalë e rëndomtë dhe kështu ta humb mbrojtjen nëse nuk përdoret në mënyrë të mirëfilltë. Për shembull, marka ËALKMAN, e cila ka qenë markë tregtare e regjistruar, e humbi mbrojtjen sepse njerëzit filluan ta përdorin këtë fjalë për mini-kasetofon.

Shembujt tipik të ish markave tregtare që u bënë fjalë të rëndomta për një produkt janë ASPIRIN dhe CELLOPHANE. Markat tregtare që janë konsideruar të shndërrohen në fjalë të rëndomta janë XEROX dhe KLINEKS. XEROX ka shpenzuar shuma të mëdha të parave në reklama për të parandaluar keqpërdorimin e shenjës së saj.

Në këtë mënyrë XEROX ka shmangur humbjen e markës së saj.

Fjalët dhe shprehjet e mëposhtme mund të konsiderohen si të përgjithshme respektivisht fjalë të rëndomta dhe për këtë arsye nuk mund të funksionojnë si një markë tregtare:

- SMARTPHONE;
- SOCIAL NETËORK; dhe
- E-MAIL.

Në përgjithësi ligjet e vendeve të ndryshme përjashtojnë mbrojtjen në tërësi të këtyre shenjave të përgjithshme apo gjenerike. Mirëpo sipas LMT, Neni 6 paragrafi 2 e mundëson mbrojtjen edhe në rastin e markave të përgjithshme me kusht që të njëjtat të kenë fituar dallueshmëri përmes përdorimit, para se të kenë aplikuar për regjistrim.

Në parim shenjat që nuk shërbejnë si identifikues burimi nuk mund të gëzojnë mbrojtje mirëpo në rast se provohet dallueshmëria e fituar përmes përdorimit ato shenja do të mund të gëzonin mbrojtje. Këto shenja nuk posedojnë veçori dalluese mirëpo me kalimin e kohës për shkak të përdorimit apo reklamimit të gjerë të shenjës në treg, kanë fituar veçori dalluese të mjaftueshme për të gëzuar mbrojtje. Si rrjedhojë, në praktikë dhe në teori dallojmë “dallueshmërinë në thelb” (inherent distinctiveness) dhe “dallueshmërinë dytësore apo të fituar” (acquired distinctiveness).

Në rastin kur shenja posedon veçori dalluese në thelb e njëjta nuk ka nevojë që të jetë në përdorim apo shfrytëzim përpara se të kërkoj regjistrimin e saj pranë ZPI-së. Pra, përdorimi paraprak i shenjës nuk është i domosdoshëm.

Ndërsa, në rastin e dytë, kur një shenjë e caktuar nuk posedon veçori dalluese, te rasti me shenjat sugjeruese apo përshkruese, atëherë bartësi duhet që paraprakisht të filloj të shfrytëzoj shenjën e caktuar respektivisht ta përdor këtë shenjë në lidhje me produkte apo shërbime të caktuara, në mënyrë që të mund ta provojë dallueshmërinë e fituar dhe të regjistrohet si markë tregtare. Shembull tipik i dallueshmërisë së fituar mund të konsiderohet “Ujë Rugove” “Kos Sharri” etj, të cilat sipas spektrit të dallueshmërisë mund të renditen tek markat përshkruese, sepse shpjegojnë produktin (uji, kosi) dhe prejardhjen e produktit (rajoni i Rugovës, Sharrit). Mirëpo, për shkak të përdorimit të gjerë, këto shenja do të asocionin tek konsumatorët me origjinën e produktit dhe jo me produktin si të tillë²⁸.

²⁸ Mbrojtja dhe Zbatimi i Markave Tregtare faq.30, - Manual Trajnimi “Markat Tregtare, Programi për përmbarim dhe legjislacion komercial USAID; http://kontrata.net/repository/docs/USAID-CLE_Training_Manual_on_Trademarks_ALB_545088.pdf

4.5.6 Markat tregtare sipas Ligjit për Markat Tregtare të Kosovës

Neni 5 i LMT-së nuk jep përkufizimin e saktë se çka nënkupton marka tregtare por përcakton saktë se çka mbrohet si markë tregtare. Sipas kësaj dispozite: Markë tregtare mund të jetë çdo shenjë e cila mund të paraqitet grafikisht, në veçanti fjalët, përfshirë edhe emrat personal, skicimet, shkronjat, numrat, formën e mallrave apo paketimin e tyre, ngjyrat si dhe kombinimi i gjitha këtyre me kusht që shenjat e tilla të mund të dallojnë mallrat ose shërbimet e një ndërmarrjeje nga mallrat ose shërbimet e ndërmarrjeve tjera.²⁹

Nga kjo dispozitë rezulton se shenja e cila mund të paraqitet grafikisht mund të regjistrohet si markë tregtare me kusht që ta përmbush funksionin e identifikimit të origjinës së produktit apo shërbimit, respektivisht të shërbejë si shenjë e cila konsumatorëve ja mundëson të dallojnë mallrat ose shërbimet e një ndërmarrjeje nga mallrat ose shërbimet e ndërmarrjeve tjera.

LMT me nenet 6 dhe 7, përcakton të ashtuquajturat kushte negative të markave tregtare, mungesa e të cilave pamundëson regjistrimin e një shenje si markë tregtare. Kushtet e tilla ndahen në shkaqe absolute dhe relative për refuzimin e regjistrimit të Markës Tregtare (shih Kapitullin III).

LMT njeh dhe rregullon markat e njohura tregtare, markat komunitare dhe markat tregtare kombëtare. Markat tregtare komunitare janë marka të regjistruara në përputhje me Rregulloren e Këshillit (EC) nr. 40/94 për Markat Tregtare Komunitare, pranë Zyrës për Harmonizimin e Tregut të Brendshëm në Alikante.

Markat tregtare ndërkombëtare janë marka të regjistruara sipas Sistemit ndërkombëtar të Madridit pranë Organizatës Botërore për Pronë Intelektuale në Gjenevë.

LMT rregullon kushtet dhe procedurat për regjistrimin e markave tregtare, të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi dhe zbatimi i këtyre të drejtave.

Sipas LMT (Neni 4.1) e drejta në markë tregtare fitohet përmes regjistrimit të markës në Zyrën për Pronësi Industriale (ZPI). Me këtë përcaktim ligjor Republika e Kosovës ka përvetësuar sistemin “i pari që e paraqet” (first to file) fiton të drejtën në markën tregtare. Ky sistem është karakteristikë e vendeve që praktikojnë të drejtën civile, ndërsa shumica e vendeve që praktikojnë të drejtën zakonore aplikojnë sistemin sipas të cilit pronar i markës tregtare bëhet ai i cili i pari e shfrytëzon markën në tregti. Sipas LMT të drejtat nga marka tregtare mund të gëzohen vetëm nga bartësit e markave tregtare të regjistruara, përveç përjashtimeve të parapara me ligj.

4.5.7 Instrumentet Kryesore Ndërkombëtare dhe Instrumentet e Acquis Communautaire të BE-së për Markat Tregtare

Të drejtat nga prona industriale në përgjithësi, dhe të drejtat nga markat tregtare janë të natyrës territoriale. Parimi territorial nënkupton që të drejtat nga marka tregtare fitohen dhe gëzojnë mbrojtje juridike vetëm brenda territorit në të cilin ato të drejta janë fituar/krijuar përmes procedurës ligjore. Kjo për arsye se kushtet për fitimin e të drejtës së markës tregtare dhe niveli i mbrojtjes ligjore mund të ndryshojnë nga shteti në shtet.

²⁹Ligji Nr. 04/L-026 PËR MARKAT TREGTARE http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji_për_markat_tregtare.pdf

Ky parim si në aspektin bashkëkohor ashtu edhe historik është një parim i përgjithshëm i te drejtës ndërkombëtare dhe i të drejtave të brendshme të shteteve, se markat tregtare dhe ligjet për markat janë territoriale. Megjithatë, kohët e fundit disa studiues kanë sugjeruar se "Modeli territorial i të drejtës së markës tregtare. . . është një anakronizëm "në tregun global"³⁰.

Ky parim ka tendencë të modifikohet në një epokë të tregtisë globale. Zhvillimet e fundit si në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare sugjerojnë se ky parim mund të ketë një intensitet të ndryshëm sot. Disa gjykata të shteteve të ndryshme kanë treguar gatishmëri për të ndryshuar parimet dhe doktrinën tradicionale të reflektojnë gjithnjë natyrën ndërkufitare të emrit të mirë "goodëill". Parimi i territorialitetit duhet të rishikohet edhe në dritën e globalizimit të tregjeve dhe ndryshimet në praktikën e marketingut në shoqëritë moderne.

Poashtu ligjet për markat tregtare të vendeve të ndryshme mund të jenë të ndryshme si në aspektin material ashtu edhe në atë procedural dhe kjo e vështirëson mbrojtjen ndërkufitare të markave tregtare. Për të mënjeluar këto problem dhe për të harmonizuar ligjet kombëtare për markat tregtare, në të drejtën ndërkombëtare janë krijuar instrumente rajonale dhe ndërkombëtare. Instrumentet kryesore ndërkombëtare dhe të BE-së të cilat rregullojnë Markat Tregtare apo thënë ndryshe kanë për qëllim të përafrojnë ligjet e kësaj lëmie janë:

i. Konventa e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale (20 Mars 1883) - traktati i parë ndërkombëtar, në fushën e të drejtave për Pronësinë Intelektuale, i cili vendosë rregulla dhe parime të përbashkëta për të gjitha Shtetet Kontraktuese. Parimet kryesore të kësaj Konvente lidhur me markat tregtare janë parimet e: trajtimit kombëtar, e drejta e përparësisë, mbrojtja e markave të mirënjohura. Neni 6bis i Konventës së Parisit obligon shtetet kontraktuese t'i ofrojnë mbrojtje një marke të mirë njohur tregtare edhe nëse ajo markë nuk është e regjistruar në atë shtet.

ii. Marrëveshja e Madridit për Regjistrimin Ndërkombëtar të Markave Tregtare (1891), si dhe Protokollit që i përket Marrëveshjes së Madridit 2 (1989)- i ashtuquajturit Sistemi i Madridit 1, i administruar nga OBPI, me 172 Shtete Kontraktuese, iu mundëson pronarëve të markave tregtare që të aplikojnë në të njëjtën kohë për regjistrimin e një marke tregtare në shumë shtete anëtare, pa pasur detyrim për të aplikuar në secilin shtet veç e veç. I vetmi kusht për ta shfrytëzuar këtë mundësi të sistemit ndërkombëtar të Madridit është që ndërmarrja të ketë një aplikim të vlefshëm për markë tregtare në vendin e origjinës, i cili duhet të jetë shtet nënshkruar i Marrëveshjes apo Protokollit të Madridit.

Procedura e regjistrimit të aplikimit për markë tregtare zhvillohet veçmas në secilin shtet por në përfundim të procedurës, pronarit i jepet një Regjistrim Ndërkombëtar për markën tregtare i cili është njëjtë i vlefshëm si regjistrimet kombëtare në shtetet e përfshira. Republika e Kosovës nuk është shtet nënshkruar i Marrëveshjes ose Protokollit të Madridit prandaj personat apo ndërmarrjet kosovare nuk e kanë këtë mundësi.

iii. Marrëveshja TRIPS - është marrëveshje ndërkombëtare, e cila administrohet nga Organizata Botërore e Tregtisë (OBT). Marrëveshja TRIPS përveç parimeve të cilat kanë qenë paraparë edhe me marrëveshjet tjera të mëhershme sikurse Konventa e Parisit apo Konventa e Bernës, marrëveshja TRIPS parashihet edhe herë të parë edhe parimin e "trajtimit më të favorshëm kombëtar" (most favoured nation treatment).

³⁰Marshall A. Leaffer, The New World of International Trademark Law , 2 M ARQ. INTELL. P ROP. L. REV. 1, 28 (1998).

iv. Direktiva e Parë e Këshillit 89/104/EEC (1988) –ka për qëllim përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian që ndërlidhen me markat tregtare. Direktiva është projektuar për harmonizimin e trajtimit të pabarabartë në ligjet përkatëse të markave tregtare, që kishte potencial për të penguar lëvizjen e lirë të mallrave dhe ofrimit të shërbimeve dhe pengimin e konkurrencës së lire në Bashkimin Evropian. Direktiva përcakton kornizën e dispozitave minimale të zbatueshme në të gjithë Bashkimin Evropian, por nuk imponon detyrime të vështira për regjistrim kombëtar të markës tregtare. Direktiva nuk i përcakton rregullat për regjistrimin, revokimin dhe pavlefshmërisë së markave tregtare të shteteve anëtare, por këto çështje u janë lënë në diskrecionin e organeve të shteteve anëtare.

v. Rregullorja e Këshillit (EC) Nr. 40/94 për Markën Tregtare të Komunitetit - i mundëson secilit pronar të markës tregtare që me një aplikacion të vetëm të regjistrojë atë në shumë shtete anëtare të kësaj Rregullore me efekt në të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Përmes këtij regjistrimi sigurohet mbrojtja në shtetet anëtare të BE-së, drejtpërdrejtë përmes zyrave nacionale për regjistrimin dhe administrimin e markave tregtare në shtetin e caktuar. Kjo mund të bëhet edhe përmes Zyrës Për Harmonizimin e Tregut të Brendshëm (OHIM) e cila operon përmes kësaj Rregullore. Sipas Rregullores për Marka Komunitare, aplikuesi e fiton regjistrimin në 28 shtetet anëtare. Poashtu kjo rregullore mundëson që nëse dikush posedon një Markë Tregtare të Komunitetit (CTM), i njëjti mund të aplikojë për Regjistrim Ndërkombëtarë në bazë të Protokollit të Madridit, dhe të regjistrohet jo vetëm në 28 Shtetet Anëtare të Rregullores në fjalë, por edhe në të gjitha Shtetet Kontraktuese të Protokollit të Madridit.

4.5.8 Kushtet dhe procedurat e regjistrimit të Markave Tregtare

LMT përcakton kushtet për ekzistimin apo regjistrimin e një marke tregtare. Regjistrimi i Markës Tregtare bëhet në Zyrën për Pronësi Industriale (ZPI)³¹. Për Regjistrimin e markës tregtare duhet të plotësohen në mënyrë kumulative të gjitha kushtet ligjore të parapara me Nenin 5,6 dhe 7 të LMT-së.

Kushtet ligjore për regjistrimin e markës tregtare ndahen në kushte “pozitive” dhe kushte “negative”.

i. Kushte pozitive janë elementet të cilat shenja e caktuar duhet të i përmbaj në mënyrë që të mund të regjistrohet si markë tregtare, respektivisht kushtet mungesa e të cilave është pengesë që një shenjë të mund të regjistrohet si markë tregtare dhe të gëzojë mbrojtje juridike.

Kushtet pozitive janë të parapara me nenin 5 të LMT i cili përcakton se: Markë tregtare mund të jetë çdo shenjë e cila mund të paraqitet grafikisht, në veçanti fjalët, përfshirë edhe emrat personal, skicimet, shkronjat, numrat, formën e mallrave apo paketimin e tyre, ngjyrat si dhe kombinimi i gjitha këtyre me kusht që shenjat e tilla të mund të dallojnë mallrat ose shërbimet e një ndërmarrjeje nga mallrat ose shërbimet e ndërmarrjeve tjera.

Nga dispozita e Nenit 5 të LMT-së rrjedh se, për tu regjistruar si markë tregtare një shenjë duhet ti përmbush dy kushte themelore:

Dallueshmëria - Funksioni kryesor i një marke tregtare është të shërbejë si identifikues i burimit. Në mënyrë që ta kryen këtë qëllim, marka duhet të ketë veçori dalluese. Për këtë arsye, dallueshmëria është kushti themelor për mbrojtjen e markës tregtare³².

³¹Neni 3 i Ligjit Nr. 05/L-40 - për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-026 Për Markat Tregtare; <http://www.kuvendikosoves.org/cid=1,191,1129>

³²Më gjërësisht shih pikën 2.1.2 të këtij punimi.

Paraqitja Grafike - Paraqitja grafike nënkupton që shenja të mund të paraqitet vizualisht, përmes fotografive, linjave apo shkronjave ashtu që ato do të mund të identifikoheshin në mënyrë të qartë.

LMT i Kosovës nuk ka definuar se çka nënkuptojmë më paraqitjen grafike por kjo mbetet në diskrecion të gjykatës për vlerësim. Gjykata Evropiane e Drejtësisë (GJED) në rastin e “Ralf Sieckman kundër Zyrës së Patentimit dhe Markave në Gjermani” (C-237/00, 2002), ka përcaktuar kriteret që një paraqitje grafike e një shenje duhet të i plotësojë. Sipas GJED një paraqitje grafike duhet të jetë e qartë, e saktë, vetë-funksionuese, lehtësisht e arritshme, e kuptueshme, e qëndrueshme dhe objektive.

Paraqitja grafike nuk është problematike kur është fjala për të ashtuquajturat marka tradicionale si janë markat fjalë, markat figurative apo markat e përziera. Problemi i paraqitjes grafike shfaqet në rastin e markave jo-tradicionale, niveli i mbrojtjes së të cilave akoma dallon jashtëzakonisht shumë në vende të ndryshme. Si marka jo-tradicionale konsiderohen ngjyrat, markat me zë, markat erë, markat lëvizëse (motion marks) dhe hologramet³³.

ii. Kushtet negative janë ato të cilat nuk duhet të ekzistojnë respektivisht kushtet që përbëjnë pengesa për regjistrimin e markës tregtare.

Këto kushte respektivisht pengesa për regjistrimin e markave tregtare janë të përcaktuara në nenet 6 dhe 7 të LMT-së, të cilat përcaktojnë dy kategori të pengesave për regjistrimin e markës tregtare.

4.5.9 Krijimi i të drejtës nga Marka Tregtare dhe natyra pronësore e MT

Të drejtat nga markat tregtare konsiderohen të drejta pronësore dhe të njëjtat janë të drejta absolute. Kjo nënkupton se të gjitha palët e treta obligohen që të përmbahen nga përdorimi i paautorizuar i markës tregtare të regjistruar. Me regjistrimin e një marke të caktuar me ZPI, bartësi i markës tregtare fiton të drejtën ekskluzive mbi markën tregtare.

Pra e drejta nga marka tregtare krijohet në momentin e regjistrimit respektivisht në momentin e lëshimit të vendimit nga ZPI dhe regjistrimit të saj në Buletinin Zyrtar. Efektet e markës tregtare llogariten nga data e paraqitjes së aplikimit për regjistrim, por ndaj palëve të treta krijon efekt vetëm nga data kur regjistrimi i asaj marke është publikuar në Buletinin Zyrtar të ZPI-së (Neni 8, paragrafi 3 i LMT).

4.5.10 Të Drejtat që Rrjedhin nga Regjistrimi i Markës Tregtare

Bartësi i markës së regjistruar tregtare gëzon një numër të drejtash me rastin e marrjes së vendimit për regjistrim të markës tregtare me ZPI. Kështu, sipas LMT, bartësi i markës së regjistruar tregtare ka drejta të:

- Ndaloj përdorimin e paautorizuar të markës tregtare të tij përmes mjeteve juridike në dispozicion (Nenet 8 – 13 i LMT)³⁴;

³³http://kontrata.net/repository/docs/USAIDCLE_Training_Manual_on_Trademarks_ALB_545088.pdf, faq.27

³⁴ Kjo e drejtë e përcaktuar me LMT rrjedh edhe nga Neni 16 pika I e Marrëveshjes TRIPS I cili përcakton se: Pronari i një marke tregtare do të ketë të drejtën ekskluzive për të parandaluar të gjitha palët e treta të cilat nuk kanë pëlqimin e pronarit, që të përdorin në treg, shenja identike ose të ngjashme për mallrat ose shërbimet të cilat janë identike ose të ngjashme me ato për të cilat marka tregtare është regjistruar, ku përdorimi i tillë do të mund të shkaktojë konfuzion. Në rast të përdorimit të një shenje identike për mallra ose shërbime identike, mundësia për konfuzion prezumohet. Të drejtat e përshkruara më sipër nuk do të paragjykojnë (ndikojnë) në të drejtat ekzistuese të mëparshme, as që do të ndikojnë në mundësinë e anëtarëve për të bërë të drejtat e disponueshme në bazë të përdorimit.

- Të përdorë markën e regjistruar në tregun e Kosovës (Neni 14 i LMT), si dhe
- Të disponojë me markën tregtare të tij (Nenet 15 – 22 i LMT).

i. Të drejtat ekskluzive të mbajtësit të markës tregtare:

Titullar i markës tregtare mund t'i ndalojë palët e treta që pa pëlqimin e tij të përdorin shenjë identike ose të ngjashme për mallrat apo shërbimet të llojit të njëjtë ose të ngjashme. Thelbi qëndron në funksionin themelor të markës - identifikimit të origjinës së produktit apo shërbimit.

Mundësia e krijimit të konfuzionit për origjinën luan rol kyç në përcaktimin e fushës së mbrojtjes që marka tregtare i ofron titullarit të saj.

Titullari i një marke tregtare ka të drejtë t'ia ndalojë personave të tjerë të përdorin pa autorizim:

a) Shenjën e cila është identike me markën e tij në lidhje në mallrat ose shërbimet të cilat janë të ngjashme me mallrat ose shërbimet për të cilat është regjistruar marka tregtare,

b) Shenjën e cila është identike ose e ngjashme me markën e tij në lidhje me mallrat ose shërbimet të cilat janë identike apo të ngjashme me mallrat apo shërbimet për të cilat është regjistruar marka tregtare, nëse ekziston mundësia që publiku mund të mashtrohet duke përfshirë edhe mundësinë e lidhjes së produktit me shenjën dhe markën tregtare.

c) Shenjën e cila është identike ose e ngjashme me markën e tij në lidhje me mallrat ose shërbimet, të cilat nuk janë të ngjashme me mallrat dhe shërbimet për të cilat është regjistruar marka tregtare, por kjo shenjë ka një reputacion në Kosovë, dhe kjo shenjë pa kurrfarë arsye përdoret për të krijuar përfitim të padrejtë duke përdorur karakterin dallues apo pamjen e veçantë të markës tregtare se mirënjohur ndërkombëtarisht (markat e mirënjohura).

Pra, mbajtësi i një marke tregtare ka të drejtë të ndalojë si në vijim³⁵:

- a) vendosjen e një markës së mbrojtur, na mallra, në paketim ose etiketat e mallit
- b) ofrimin e mallrave, vendosjen e tij në treg apo ruajtjen e saj për këto qëllime, apo ofrimin e shërbimeve nën markën tregtare të tij.
- c) importimin, eksportimin ose transitin e mallrave nën markën tregtare,
- d) përdorimin e markës së mbrojtur në dokumentet zyrtare ose për reklama.

4.5.11 Shkelja e Markave Tregtare dhe Kriteret e Vlerësimit

LMT parashikon që parimet dhe kriteret e përgjithshme mbi të cilat bazohemi gjatë vlerësimit të ngjashmërisë së shenjave, janë:

- Parimi i parë i unitetit (specialitetit) të markës tregtare – Funkcioni identifikues/dallueshmërisë (shih Kapitulli I pikën 2.1.1 pika a) LMT
- Mundësia e dytë - e konfuzionit në treg,
- Njohuritë e publikut përkatës.

³⁵Shih Nenin 8 të Ligjit Nr. 04/L-026 PËR MARKAT TREGTARE
http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji_per_markat_tregtare.pdf

i. Mundësia e shkaktimit të konfuzionit.

Elementet bazë për vlerësimin e ngjashmërisë së shenjave është mundësia e krijimit të konfuzionit tek konsumatorët. Konfuzioni mund të shkaktohet duke përdorur shenjën që është identike ose e ngjashme me markën e regjistruar e një personi tjetër, por vetëm me kusht që kjo shenjë të përdoret për llojet e njëjta ose të ngjashme të mallrave ose shërbimeve.

Konfuzion mund të shkaktojë shenja e cila në kushte të rëndomta të tregut, te konsumatorët krijojnë bindjen se është fjala për mallra apo shërbime të njëjta. Sipas Nenit 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2, i LMT-së, pronari i një marke të regjistruar nuk ka nevojë të vërtetojë konfuzionin që faktikisht është krijuar nga përdorimi i markës identike ose të ngjashme, por vetëm mundësinë e krijimit të një konfuzioni tek konsumatorët.

Një qëndrim të njëjtë e përmban dhe Rregullorja e Këshillit të Bashkimit Evropian nr. 40/94, e vitit 1993 - për Markat Tregtare Komunitare, sipas të cilës "Për ekzistimin e ngjashmërisë nuk është e nevojshme që konfuzioni të krijohet por është e mjaftueshme ekzistimi i mundësisë së shkaktimit të konfuzionit te konsumatorët".

Llojet e konfuzionit: Varësisht prej ndikimit në krijimin e bindjes tek konsumatorët, ekzistojnë dy mundësi të shkaktimit të konfuzionit;

Mundësia direkte për konfuzion shkaktohet kur konsumatorët ngatërrojnë markat tregtare respektivisht ku gabimisht besojnë se malli apo shërbimi është produkt i një subjekti i cili është titullar i një marke tregtare, e jo i subjektit i cili atë mall e ka vënë në qarkullim.

Mundësia e tërthortë për konfuzion ndodh kur konsumatori gabimisht beson se ndërmjet subjektit që është titullar i asaj marke tregtare dhe subjektit që e ka vënë në qarkullim produktin përkatës ekziston lidhja ekonomike apo organizative, p.sh. frashizing apo kontratë mbi licensën.

ii. Vlerësimi i mundësisë për konfuzion

Gjatë vlerësimit të ngjashmërisë së markave ashtu edhe ngjashmërisë së produkteve apo shërbimeve aplikohet i ashtuquajti "test i mundësisë së krijimit të konfuzionit".

Nga praktika e GJED-it, rrjedh se gjatë vlerësimit të ngjashmërisë së mallrave dhe shërbimeve gjykatat duhet të marrin parasysh këta faktorë:

- Natyrën e mallrave dhe të shërbimeve;
- Perceptimin e konsumatorit mesatar;
- Faktin nëse këto dy ndërmarrje janë në konkurrencë me njëra tjetrën apo janë ekonomikisht të ndërlidhura.

Ndërsa, gjatë vlerësimit të shkallës së ngjashmërisë në mes të markave, gjykatat duhet marrin parasysh këta faktorë:

a) Shkallën e ngjashmërisë vizuale/pamore:

- në rast të dy markave fjalë, duhet vlerësuar numri dhe radhitja e shkronjave, numri i fjalëve, struktura e shenjave;
- në rast të markës fjalë kundrejt një marke figurative, atëherë analizohet numri i shkronjave apo fjalëve të përbashkëta.

- Në rast të dy markave figurative, atëherë shqyrtohet nëse në to kanë edhe elemente fjalë – elemente të tjera identike ose të ngjashme, konturet etj. Një element identik është i mjaftueshëm për të konstatuar një ngjashmëri.
- në rast të dy markave ngjyrë, atëherë markat në diskutim janë të ngjashme nëse ndajnë hijezimet/nuancat e të njëjtës ngjyrë.

b) Shkallën e ngjashmërisë aurale (në dëgjim):

- Markat thjeshtë figurative nuk kanë ndonjë ngjashmëri fonetike,
- Markat fjalë mundë ta analizohen varësisht prej rrokjeve, sekuenca e rrokjeve dhe theksi.
- Shkallën e ngjashmërisë konceptuale apo përmbajtjesore;
- Përmbajtja e njëjte ose e ngjashme;
- Koncepti i secilit element, përveç nëse shenja nuk ka ndonjë kuptim;
- Nëse një shenjë nuk ka ndonjë kuptim përmbajtjesore, atëherë nuk ka ngjashmëri konceptuale.

E rëndësishme është të theksohet se gjatë vlerësimit të ngjashmërisë midis markave duhet të bëhet një vlerësim objektiv i përgjithshëm. Shqyrtimi i ngjashmërisë nuk mund të reduktohet në konstatimit e pjesëshëm të ngjashmërisë së njërit nga tri elementet e mësipërme, por duhet përqendruar në atë se çfarë është rezultati i përgjithshëm i të gjitha ngjashmërive dhe dallimeve në aspektin auditiv, vizual dhe konceptuar. Përveç ngjashmërisë midis mallrave dhe markave në diskutim, faktorë të tjerë me rëndësi mund të paraqiten edhe dallueshmëria e markave në diskutim, vëmendja e konsumatorit relevant, imazhi jo-perfekt, familja e markave tregtare, incidente të konfuzionit etj.

4.5.12 Mbrojtja juridike e markave tregtare

Përdorimi i paautorizuar i një marke tregtare, si e drejtë ekskluzive e pronarit të saj sipas Nenit 8 të LMT-së, përbën shkelje të markës tregtare. Shkelja mund të kryhet ndaj markës së regjistruar por edhe gjatë procedurës së regjistrimit nëse regjistrimi rezulton i suksesshëm.

Shkelja mund të bëhet me çdo veprim të ndërmarrë pa autorizimin e pronarit, me të cilin atakohet të paktën njëri prej të drejtave të pronarit të markës tregtare. Kjo shkelje mund të bëhet gjatë kohës së vlefshmërisë së markës tregtare, brenda territorit për të cilën ajo është e autorizuar.

Për shkelje nuk është e domosdoshme të shkaktohet konfuzioni në tregun përkatës por mjafton mundësia e shkakimit të konfuzionit. Shkelja mund të ndodhë edhe me një vënie të përkohshme të mallit në qarkullim.

Pronari i markës tregtare gëzon mbrojtje juridike pavarësisht nga kualiteti dhe niveli i njohjes së mallit apo shërbimit të tij në treg, në raport me kualitetin dhe nivelin e mallit apo shërbimit me të cilin kryhet shkelja e markës së tij.

Shkelje e markës tregtare konsiderohet imitimi i saj, transkriptimi, transliterimi, si dhe kur shenjës i shtohen fjalët "lloji", "mënyrë", "sipas" dhe të ngjashme.

i. Imitimi - ekziston në qoftë se konsumatori mesatar i mallrave, pavarësisht nga lloji i mallit apo shërbimit mund të vërejë dallimin vetëm duke i kushtuar vëmendje të veçantë. Imitimi paraqitet në rastet kur shenja e përdorur është përkthim i shenjës së mëhershme, nga një gjuhë e huaj në gjuhën e tregut përkatës, kur shenja e përdorur paraqitet me shkronja dhe kuptim të njëjtë por

paraqitet në mënyrë tjetër (p.sh. në vend të shkronjave të vogla paraqitet me shkronja të mëdha, shkronjat stilizohen ndryshe, etj.).

ii. Transcriptimi (kopjimi) është përshtatje e fjalëve të huaja në gjuhën e tregut përkatës dhe bartja e një shenjë nga një etiketë e mallit në tjetrën, duke marrë parasysh shqiptimin. Transkriptohen emrat me të njëjtat shkronja, përkatësisht nga një alfabet në tjetrin, apo fjalët e huaja përpunohen dhe përshtaten në kuptimin fonologjik, morfologjik dhe semantic (kuptim) në gjuhën dhe shkrimin në të cilin kryhet transkriptimi.

iii. Transliterimi përbën transferimin e shenjave/personazheve nga një etiketë pavarësisht nga kuptimi.

4.5.13 Mjetet Juridike për Mbrojtjen e Markave Tregtare

Instrumentet ndërkombëtare (Marrëveshja TRIPS dhe Direktivat e BE-së), parashohin obligimin e shteteve që të sigurojnë mjete juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave që rrjedhin nga markat tregtare.

Me mjete juridike efektive nënkuptohet jo vetëm dhënia e mundësisë ligjore për të kërkuar mbrojtjen gjyqësore por shtetet janë të obliguara që të krijojnë sistem të tillë që mjeti juridik duhet të jetë efektiv dhe i zbatueshëm shpejt.

LMT parashih se në rast të një shkelje të markës tregtare, mbajtësit të markës tregtare dhe mbajtësi i licencës ekskluzive kanë të drejtë të iniciojnë procedurë civile kundër personave përgjegjës për shkeljen. Poashtu edhe me ligjet tjera sikurse Ligji mbi Inspektoratin e Tregut,

Ligji mbi Masat Doganore si dhe Kodi Penal i Republikës së Kosovës përmbajnë dispozita të cilat autorizojnë bartësit e markës tregtare që mbrojtjen e tyre të kërkojnë edhe në procedura tjera.

Titullari i një marke tregtare, mund të kërkojë mbrojtje si në procedurë administrative pranë ZPI, Inspektoratit të Tregut dhe Doganës së Kosovës, në procedurë penale pranë Gjykatës Themelore të juridiksionit të përgjithshëm, dhe në procedurë civile pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike.

4.5.14 Mbrojtja civilo-juridike , palët, mjetet juridike dhe procedurat

Në rast të shkeljes së markës tregtare, titullari i saj mund të parashtrijë padi në gjykatë me të cilin inicion kontestin civil për mbrojtjen e të drejtave të tij që rrjedhin nga marka tregtare. Në bazë të Nenit 13 të Ligjit për Gjykatat e Kosovës (Ligji Nr. 03/L-199), Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike është e kompetencës lëndorë për shqyrtimin e çështjeve lidhur me markat tregtare.

Para ngritjes së çështjes në gjykatë, titullari i markës tregtare i dërgon palës tjetër një të ashtuquajtur “Shkresë për Ndërprerje dhe Pushim” përmes së cilës pronari i kërkon palës tjetër ta ndërpresë shkeljen. Kjo shkresë shërben si dëshmi që paditësi i`a ka tërhequr vërejtjen para ngritjes së padisë dhe është përpjekur ta arrijë një marrëveshje jashtë-gjyqësore.

Kjo procedurë paraprake e arritjes së marrëveshjes jashtë gjyqësore nuk është obligative, por megjithatë praktikohet në praktikën juridike, si mjet për t'i ikur shpenzimeve të panevojshme gjyqësore.

Si rregull, gjykata pas marrjes së përgjigjes në padi nga pala e paditur cakton seancën përgatitore, në të cilën konform dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (Ligji Nr. 03/L-006) konfirmon rregullsinë e përfaqësimit të palëve, vlerëson nëse ekziston ndonjë pengesë procedurale dhe vendos se çka do të jetë objekt shqyrtimi dhe cilat prova do të merren në seancën e shqyrtimit kryesor. Në këtë fazë, nëse e lejojnë rrethanat e rastit, gjykata u propozon palëve që çështjen e tyre ta zgjidhin në procedurën e ndërmjetësimit apo përmes pajtimit gjyqësor.

Nëse nuk arrihet pajtim gjyqësor gjykata cakton seancën e shqyrtimit kryesor në të cilin administrohen provat dhe në bazë të fakteve të vërtetuara dhe ligjit material, gjykata bie vendimin meritore lidhur me çështjen.

Sa i përket barrës së provës, LMT nuk përmban dispozita që përcaktojnë se kujt i bie barra e të provuarit në kontestet për marka tregtare andaj aplikohen dispozitat e LPK-së, respektivisht Neni 319 i cili parasheh se palët ndërgjyqëse kanë për detyrë t'i provojnë faktet mbi të cilat i bazojnë kërkesat e tyre. Pra, nëse pala paditëse pretendon se veprimet e palës tjetër paraqesin shkelje të markës tregtare, atëherë për një gjë të tillë paditësi duhet të dorëzojë dëshmi. Në anën tjetër, nëse pala e paditur pretendon se veprimet e saj janë të lejuara për ndonjë arsye ose tjetër, atëherë edhe kjo duhet të i provojë këto pretendime.

Megjithatë bazuar në dispozitat procedurale gjykata mundet edhe pa propozimin e palëve të nxjerrë prova për vërtetimin e gjendjes faktike apo ndonjë çështje paraprake, të rëndësishme për vendosjen e çështjes. P.sh. gjykata mund të kërkojë informata nga ZPI lidhur me procedurën e regjistrimit dhe validitetin të markës tregtare, apo vlerësimin e tyre për shkeljen e pretenduar të markës tregtare. Por vlerësimi i ZPI nuk e obligon gjykatën.

i. Kërkesëpatria e palës dhe mbrojtje gjyqësore

Mbajtësi i markës tregtare mund të kërkojë nga gjykata kompetente ndërmarrjen e veprimeve të ndryshme. Paditësi mund të kërkojë nga gjykata vërtetimin e shkeljes dhe të urdhërojë ndalimin e veprimeve të ardhshme me të cilën shkelet e drejta e tij.

Poashtu me padi mund të kërkojë nga gjykata që ta urdhërojë tërheqjen e mallrave nga tregu, konfiskimin dhe shkatërrimin e produkteve që përbëjnë shkelje, me shpenzime të shkelësit.

Paditësi mund të kërkojë edhe kompensimin e dëmit për përfitim pa bazë dhe fitim të humbur, publikimin e aktgjykimit ose kërkesën e gjykatës që të urdhërojë shkelësin e së drejtës për të informuar bartësin e markës me identitetin e personave të tretë të përfshirë në prodhimin dhe shpërndarjen e mallrave ose shërbimeve kundërvajtëse, si dhe të kanaleve të tyre të shpërndarjes.

ii. Afati për paraqitjen e padisë

Padia mund të paraqitet brenda fatit subjektiv 3 vjeçar nga data kur paditësi ka marrë njohuri për shkeljen e markës tregtare apo brenda 5 viteve nga data kur për herë të parë është kryer

shkelja. Me kalimin e afateve të mësipërme pronari i markës tregtare e humb të drejtën për të kërkuar mbrojtje gjyqësore.

Në këtë rast shfrytëzuesi jo-pronar i markës tregtare mund ta përdor atë krahas pronarit të markës tregtare. Kjo përbën rast specifik, i krijuar në bazë të gjendjes faktike nga përdorimi i dy palëve, i ashtuquajtur i “drejta e ndarë” apo e “e drejta përbashkët” në markën tregtare.

Duhet theksuar se pronari i markës nuk e humb të drejtën në markën në raport me personat e tretë mirëpo nuk mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore ndaj personit shfrytëzues të markës, ndaj të cilit nuk ka paraqitur padi brenda afateve ligjore.

iii. Masat e përkohshme në rast të shkeljes së markës tregtare

LMT parasheh mundësinë që bartësi i markës tregtare mund të kërkojë nga gjykata caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, jo vetëm kur dëshmon se marka e tij është shkelur, por edhe në rast se dëshmon se marka e tij kërcënohet të shkelet respektivisht personi tjetër është duke u tentuar ta shkelë markën e tij.

Sipas Nenit 101 të LMT, gjykata mund të caktojë ndonjërin prej masave:

- të urdhërojë shkelësin e supozuar që t'i ndalojë veprimet që shkelin markën tregtare;
- të lëshojë një urdhër ndalimi kundër ndërmjetësuesit shërbimet e të cilit i përdorin personat e tretë që shkelin markën tregtare.
- të urdhërojë konfiskimin apo largimin nga tregu të produkteve që pa të drejtë emërtohen si marka tregtare.

LMT me Nenin 101, i jep të drejtë bartësit të së drejtës nga marka tregtare që në rastin e shkeljeve të kryera në veprimtari afariste, në qoftë se dëshmon se shkelja është kryer me qëllim të përfitimit material dhe shkelja ka tentuar t'i shkaktojë atij dëm të riparueshëm apo vështirë të riparueshëm, të kërkojë nga gjykata që përveç masave të mësipërme të urdhërojë bllokimin e përkohshëm të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të shkelësit të supozuar, përfshirë edhe bllokimin e llogarive të tij bankare dhe pasuritë e tjera. Në këtë rast bartësi duhet të provojë shkeljen apo tentativën e shkeljes, që shkelja të jetë kryer në afarizëm dhe për përfitime materiale, dhe që të dëshmojë se shkelja do të i shkaktojë dëm të riparueshëm apo vështirë të riparueshëm.

Kërkesa për caktimin e masës së përkohshme në rast të shkeljes mund të paraqitet si para fillimit të procedurës së shkeljes, me kusht që brenda një afati të caktuar të iniciojë procedurën gjyqësore për shkak të shkeljes, ashtu edhe gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore për shkak të shkeljes. Kushtet dhe procedura për përcaktimin e masës së sigurimit përveç Nenit 101 të LMT-së, përcaktohen me Nenin 297 të LPK-së.

Masa e sigurimit në procedurë kontestimore dallon nga masa e sigurimit në procedurën për shkeljen e markës tregtare, për shkak të natyrës specifike të markave tregtare. Përderisa në procedurën kontestimore masa e sigurimit gjithmonë caktohet për sigurimin e kërkesëpadisë në procedurën për shkelje të markës tregtare masa e sigurimit shërben si preventivë për ndalimin e shkeljes së markës tregtare, e në raste të caktuara si masë ndëshkuese me të cilën mund të urdhërohet konfiskimi i mallrave dhe ndalimi i veprimeve të cilat e cenojnë markën tregtare. Masa e sigurimit në kontestet për markat tregtare mund të caktohet edhe për kërkesa të cilat janë identike me kërkesëpadinë nga padia, gjë që nuk lejohet në kontestet tjera.

iv. Masat e përkohshme për ruajtjen dhe sigurimin e dëshmimeve.

Ruajtja dhe sigurimi i dëshmimeve është procedurë përmes së cilës sigurohen dëshmitë për të cilat ekziston rreziku që më vonë nuk mund të sigurohen.

Këtë mundësi e parasheh Neni 102 i LMT i cili përcakton se, edhe para fillimit të procedurës kontestimore, me kërkesë të palës paditëse e cila ka paraqitur prova të mjaftueshme për të mbështetur pretendimet e tij se marka tregtare është shkelur apo rrezikohet të shkelet, gjykata mund të urdhërojë masa të përkohshme për të ruajtur dëshmitë që ndërlidhen me shkeljen e pretenduar të markës tregtare.

4.5.15 Procedura penale

Shkelja e markës tregtare përbën veprë penale pothuajse në të gjitha legjislacionet penale si dhe me instrumentet ndërkombëtare. Prandaj të gjitha shtetet nënshkruese të konventave ndërkombëtare nga fusha e pronësisë intelektuale kanë obligime të krijojnë mekanizma ligjor dhe institucional në luftimin e veprimeve më të cilat shkelen të drejtat nga pronësia intelektuale.

Në këtë drejtim Marrëveshja e tregtisë ACTA , e nënshkruar në maj të vitit 2011 nga Shtetet e Bashkuara, Japonia, Zvicra, dhe BE, kërkon që palët e saj të caktojnë dënime penale, përfshirë burgosje dhe gjoba, për shkelje të së drejtës së autorit dhe shkeljen e markës tregtare, dhe i detyron palët që të ndërmarrin masa policore për shkelje të këtyre të drejtave.

Edhe Kodi Penal i Republikës së Kosovë ka penalizuar disa veprime të cilat ndërlidhen me shkeljen e markave. Me nenin 298 të Kodit Penal, përcaktohet se: “Kushdo që gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike dhe me qëllim të mashtrimit të blerësve apo konsumatorëve, përdor ose posedon me qëllim të përdorimit si emër apo shenjë të tij ose shenjë të veçantë të mallrave të tij, emrin apo shenjën e tjetrit, shenjën e mallrave apo shenjën e shërbimeve të tjetrit, ose shenjën e tjetrit që lidhet me prejardhjen gjeografike, ose ndonjë shenjë tjetër të veçantë të mallrave apo përbërësve të tyre, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.”

Nga ky formulim rezulton, se jo të gjitha shkeljet e markave tregtare apo përdorimet e paautorizuara të saj konsiderohen edhe veprë penale. Për të u konstatuar një shkelje si veprë penale, përdorimi ose posedimi i paautorizuar i markës tregtare të tjetrit duhet të ekzistojë qëllimi apo dashja, respektivisht përdorimi ose posedimi i paautorizuar duhet të jetë kryer me vetëdije dhe me dëshirë e jo nga pakujdesia. Poashtu përdorimi duhet të jetë kryer gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike respektivisht nga ndërmarrja e aktiviteteve biznesore apo nga gjenerimi i fitimit. Elementi i tretë që duhet përmbushur, që një shkelje e markës tregtare të konsiderohet si veprë penale është qëllimi që të mashtrujë konsumatorët, element i cili zakonisht është prezent tek produktet e falsifikuara.

Procedura penale fillon me ngritjen e aktakuzës kundër shkelësit të supozuar nga ana e Prokurorit të Shtetit, bazuar në kallëzimin penal të paraqitur nga ana e policisë apo palës së dëmtuar. Për ngritjen e aktakuzës penale për shkelje të markës tregtare qoftë nga ana e policisë qoftë nga pala e dëmtuar duhet siguruar provat me të cilat, dëshmohet kryerja e veprës penale nga personi i caktuar, ndaj një marke tregtare të regjistruar.

4.5.16 Mbrojtja gjyqësore në konflikt administrativ

Sipas Nenit 90 të LMT-së, kundër vendimeve të ZPI lidhur me regjistrimin apo refuzimin e regjistrimit të markës tregtare, lejohet ankesa në Komisionin për shqyrtimin e ankesave pranë

Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Sipas paragrafit 4 të nenit 90, në rast të pakënaqësisë me vendimin e Komisionit, në afat prej 30 ditësh mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën kompetente. Kjo dispozitë nuk e përcakton se cila është gjykata kompetente por duke u nisur nga fakti se, procedura lidhur me këtë ankesë nuk është përfshirë në kapitullin XIII të LMT-se, e cila rregullon mbrojtjen civilo-juridike, ndërsa vendimi i Komisionit përbën akt administrativ përfundimtar, duke iu referuar Ligjit për Konflikt Administrativ mund të konstatohet se, pala e pakënaqur me vendimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave, mund të fillojë konfliktin administrativ pranë Departamentit për Çështje Administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë, për mbrojtjen e të drejtave të tij.

4.5.17 Mbrojtja në procedurë administrative

Përveç procedurave të mësipërme mbrojtja e të drejtave që rrjedhin nga markat tregtare është obligim ligjor edhe i organeve administrative. Në këtë drejtim Inspektorati i Tregut dhe Dogana e Kosovës janë institucionet përgjegjëse për parandalimin e shkeljeve të markave tregtare dhe ofrimin e mbrojtjes së këtyre të drejtave.

i. Inspektorati i Tregut - është kompetent dhe ka për detyrë inspektimin e veprimtarive prodhuese, shërbyese dhe tregtare për të siguruar mbrojtjen e konsumatorit, mbrojtjen e të drejtave nga pronësia industriale dhe mbrojtjen e të drejtave të autorit. Në rast të shkeljes së markës tregtare Inspektorati i Tregut duhet të veprojë sipas detyrës zyrtare apo sipas paraqitjes së ankesës nga pala e cila pretendon se është duke iu shkelur ndonjë e drejtë. Inspektorati i tregut në rast të konstatimit të shkeljes së markës tregtare është i autorizuar që menjëherë të ndërmarrë të gjitha masat për bllokimin e atij malli dhe ne koordinim me organet tjera (policia, gjykata, etj.) të ndërmarrë sekuestrimin, konfiskimin dhe asgjësimin e mallit.

i. Masat Doganore- Mbrojtja nga shkelja e markave tregtare sigurohet edhe përmes masave doganore, të cilat i aplikojnë Doganat e Kosovës, dhe atë:

- Sipas paraqitjes së kërkesës për veprim nga pala;
- Sipas detyrës zyrtare.

Me Ligjin për Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale³⁶ janë të parapara masat kufitare për parandalimin e mallrave që shkelin të drejtat nga markat tregtare. Dogana e Kosovës mbikëqyre dhe vepron në rastet e dyshimit për shkelje të markave tregtare, sidomos në rastet e dyshimit për produkte të falsifikuara gjatë importit, eksportit, transitit, deponimeve doganore, përpunimit të brendshëm të produkteve, mbikëqyrjes doganore dhe importit të përkohshëm të vendosur në zonën e lirë doganore.

Bartësi i të drejtës mund të paraqes pranë Doganës një kërkesë për veprim doganor, përmes plotësimit të formularit të gatshëm, i cili mund të sigurohet në doganë, me të cilën mund të kërkohet ndalimi i përkohshëm i mallrave apo shkatërrimi i tyre, nëse paraqitësi i kërkesës me të drejtë dyshon se:

- është duke u kryer importi, transiti apo eksporti i mallrave me të cilët është duke u shkelur e drejta e tij;

³⁶Shih Ligjin për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, Ligji Nr. 03/L – 170 Ligji - Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Prishtinë.

- jep informacione të mjaftueshme për identifikimin e mallrave, bartësin e të drejtës së markës tregtare, informacioni mbi mundësinë dhe mënyrën e shkeljes, si dhe të dhëna tjera të nevojshme duke përfshirë datën e ardhjes së mallit, itinerarin, mjetet e transportit, transportuesin, etj.
- të dhëna për kohën për të cilën kërkohet veprimi i Doganës.

Kërkesa për veprim duhet të dorëzohet së bashku me deklaratën e përgjegjësive, me të cilën paraqitësi merr përsipër t'i bartë të gjitha shpenzimet për shkatërrimin e mallrave, si dhe përgjegjësitë në rast të dëmit eventual ndaj palës së tretë. Kërkesa për veprim duhet të përmbajë edhe vendimet për regjistrimin e markës tregtare nga ZPI, si kusht themelor për paraqitjen e kërkesës për veprim pranë Doganës së Kosovës. Kërkesa pranohet për një vit, me mundësi të shtyrjes së afatit për secilin vit tjetër vijues.

Dogana në rast të gjetjes së mallrave të dyshimta, bën ndalimin e përkohshëm të mallrave, informon bartësin e të drejtës në lidhje me ndaljen dhe kërkon nga ai që të konfirmoj nëse mallrat e ndaluara janë të falsifikuara apo origjinale. Nëse këto mallra janë të falsifikuara, bartësi është i obliguar që brenda afatit të caktuar, të paraqesë pranë Doganës “pëlqimin për shkatërrim” të marrë nga importuesi i mallrave. Në rast se importuesi pajtohet të vazhdohet me shkatërrim bëhet shkatërrimi i mallrave pa shkuar në procedurë gjyqësore. Kjo procedurë ndiqet edhe nëse importuesi nuk ka kundërshtuar në mënyrë shprehimore brenda afatit të caktuar me ç`rast konsiderohet se importuesi ka dhënë “pëlqim të heshtur”.

Afati për paraqitjen e “pëlqimit të importuesit” është tetë ditë pune që nga dita e marrjes së njoftimit nga Dogana.

Në rast se importuesi nuk pajtohet se mallrat e ndaluara janë të falsifikuara dhe nuk jep pëlqimin për shkatërrim, atëherë bartësi i markës tregtare ka edhe një afat shtesë për të paraqitur padinë pranë gjykatës kompetente për shkelje të markës tregtare. Në këtë rast sipas Nenit 12 të Ligjit për Masat Doganore, Dogana do të ndalojë mallrat derisa të vendoset çështja me vendim të gjykatës.

4.6 Përmbledhje

Në këtë modul janë përfshirë çështje të rëndësishme nga të drejtat nga pronësia intelektuale, me fokus të veçantë në të drejtat e autorit dhe në markat tregtare. Prezantimet e trajnuesit, puna në rast studimor, diskutimet e pjesëmarrësve, pyetje, përgjigjet dhe komentet, do të mundësojnë që pjesëmarrësit të përfitojnë, në drejtim të ngritjes së kapaciteteve teorike dhe praktike të kandidatëve nga kjo fushë.

Në praktikën gjyqësore numri i kontesteve që rrjedhin nga markat tregtare dhe shkelja e të drejtave autoriale është i konsiderueshëm, me tendencë të rritjes, prandaj trajtimi i kësaj teme është e një rëndësie të veçantë për rritur njohuritë e gjyqtarëve në trajtimin e rasteve.

Nga ky prezantim pjesëmarrësit do marrin njohuri të reja lidhur me:

- Kuptimin e të drejtave nga pronësia intelektuale dhe nevojën për mbrojtje juridike;
- Të drejtat e autorit dhe mbrojtja juridike që ato gëzojnë
- Llojet e markave tregtare dhe mbrojtja juridike që ato gëzojnë;
- Të drejtat e titullarëve të markave tregtare;
- Mënyrat e regjistrimit dhe humbja e të drejtës nga marka tregtare;
- Procedurat ligjore dhe aplikimin e tyre në mbrojtjen e të drejtave që rrjedhin nga pronësia intelektuale;

- Mënyrat dhe kriteret e vlerësimit në rastet kur titullari pretendon për shkelje të së drejtës autoriale apo markës së tij tregtare.

5. Zgjidhja Alternative e Kontesteve

5.1 Hyrje

Aplikimi i formave alternative për zgjidhje të kontesteve (Arbitrazhi dhe Ndërmjetësimi) është e një rëndësie të veçantë pasi që rrisin sigurinë juridike dhe mundësojnë tërheqjen e investimeve të huaja aq të nevojshme për zhvillimin e ekonomik, sepse në botën bashkëkohore të afarizmit bizneset janë të pritura për t'i zgjidhur kontestet e tyre jashtë procedurave gjyqësore.

Kosova në përpjekjet e saj për krijimin e një sistemi juridik bashkëkohor, ka krijuar bazën juridike e cila mundëson zgjidhjen alternative të kontesteve. Në këtë drejtim, Kuvendi i Kosovës në vitin 2007, ka miratuar Ligjin për Arbitrazhin Nr. 02/75 ndërsa në vitin 2008 ka miratuar Ligjin për Ndërmjetësim Nr. 03/L-057.

Përkundër përparësive të ekzistimit të sistemeve alternative, krahas atyre gjyqësore, në praktikën juridike këto dy sisteme e interferojnë apo komplementojnë njëra tjetrën andaj paraqiten situata të cilat kërkojnë përgjigje nga doktrina juridike dhe praktika gjyqësore.

Po ashtu, në praktikën juridike paraqiten konteste me element ndërkombëtar, që shfaqin nevojën e analizimit të përputhshmërisë së legjislacionit të brendshëm me rregullat ndërkombëtare, për tu siguruar se gjatë zbatimit të dispozitave, interpretimi tyre të jetë në përputhje me praktikat ndërkombëtare.

Prandaj trajtimi i kësaj teme, është e një rëndësie të veçantë për rritur njohuritë e gjyqtarëve në trajtimin e rasteve.

5.2 Objektivat trajnues

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Kuptojnë se çka përfshin Zgjidhja Alternative e Kontesteve (ZAK);
- Zgjerojnë njohuritë lidhur me Arbitrazhin – llojet dhe karakteristikat si dhe kompetencat e gjykatës lidhur me arbitrazhin;
- Zbatojnë drejtë procedurën e njohjes, ekzekutimit të vendimeve të arbitrazhit dhe procedurës sipas kërkesës për anulimin e vendimit të arbitrazhit;
- Zbatojnë drejtë procedurën dhe kompetencat e gjykatës për shqyrtimin e vlefshmërisë së marrëveshjes së arbitrazhit;
- Kuptojnë se çka përfshin Ndërmjetësimi – llojet dhe karakteristikat;
- Njohin marrëveshjen për ndërmjetësim dhe ekzekutimin e saj.

5.3 Shqyrtime të përgjithshme lidhur me Metodën për Zgjidhjen Alternative të Kontesteve

Kosova në përpjekjet e saj për krijimin e një sistemi juridik bashkëkohor, ka krijuar bazën juridike e cila mundëson zgjidhjen alternative të kontesteve. Në këtë drejtim, Kuvendi i Kosovës në vitin 2007, ka miratuar Ligjin për Arbitrazhin Nr. 2007 - 02/L-75 ndërsa në vitin 2008 ka miratuar Ligjin për Ndërmjetësim Nr. 03/L-057.

Zgjidhja alternative e kontesteve u paraqit si nevojë e kohës respektivisht e nevojave për zhvillimi ekonomik pasi që Kosova synonte një ekonomi të tregut dhe një dinamikë të përshtetshme të zhvillimit saj.

Ngarkesa e gjykatave me lëndë dhe stërzgjatja e procedurave gjyqësore imponuan zbatimin e formave alternative për zgjidhje të kontesteve. Kjo mënyrë e re dhe efektive e zgjidhjes së kontesteve ka përparësitë e veta pasi që do t'i shkarkojë gjykatat nga numri tejet i madh i lëndëve dhe krijon sistem alternativ në të cilin rastet zgjidhen brenda një kohe të duhur.

Aplikimi i formave alternative për zgjidhje të kontesteve është e një rëndësie të veçantë pasi që rrisin sigurinë juridike dhe mundësojë tërheqjen e investimeve të huaja, aq të nevojshme për zhvillimin e ekonomik sepse në botën bashkëkohore të afarizmit bizneset janë të prirura për t'i zgjidhur kontestet e tyre jashtë procedurave gjyqësore.

Përkundër përparësive të ekzistimit të sistemeve alternative, krahas atyre gjyqësore, në praktikën juridike këto dy sisteme e interferojnë apo komplementojnë njëra tjetrën andaj paraqiten situata të cilat kërkojnë përgjigje nga doktrina juridike dhe praktika gjyqësore.

Poashtu, në praktikën juridike paraqiten konteste me element ndërkombëtar, që shfaqin nevojën e analizimit të përputhshmërisë së legjislacionit të brendshëm me rregullat ndërkombëtare, për tu siguruar se gjatë zbatimit të dispozitave, interpretimi tyre të jetë në përputhje me praktikën ndërkombëtare.

Në vijim do t'i shtjellojmë çështjet ngritura më sipër, duke u fokusuar në analizimin e mundësive të kontestimit të vendimeve të arbitrazhit nga ana e gjykatave të rregullta, si dhe analizimin e harmonizimit të legjislacionit të brendshëm me rregullat ndërkombëtare.

5.4 Ndërmjetësimi si formë alternative për zgjidhjen e kontesteve

5.4.1 Kompetencat e gjykatave për shqyrtimin e Vendimeve të Arbitrazhit

Pavarësisht se procedura e arbitrazhit dhe procedura gjyqësore përbëjnë procedura ta pavarura nga njëra tjetra, megjithatë në faza të caktuara ato ndërlidhen ndërmjet vete dhe e plotësojnë njëra tjetrën.

Ndërlidhja më e theksuar ndërmjet arbitrazhit dhe gjykatave të rregullta paraqitet në rastin e ekzekutimit të vendimeve të arbitrazhit.

i. Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të Tribunalit të Arbitrazhit

Ligjin për Arbitrazhin Nr. 02/L-75, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës me 26 janar 2007, në Kreu VIII (Neni 38 dhe 39), rregullon ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit.

Sipas Neneve 38 dhe 39 të këtij Ligji, nuk bëhet dallim ndërmjet vendimeve të arbitrazhit të nxjerra nga Tribunali i Arbitrazhit të Kosovës dhe Tribunalit të huaj dhe se vendimet e Tribunalit ekzekutohen nga gjykata, nëse vendimet e tilla shpallen të ekzekutueshëm nga gjykata. Në këtë drejtim Neni 38.1 i Ligjit përcakton se “*Vendimi i arbitrazhit i cili është nxjerrë nga një tribunal i arbitrazhit brenda Kosovës ekzekutohet pasi që të shpallet i ekzekutueshëm nga Gjykata*” ndërsa Neni 39.1 i Ligjit parasheh se: “*Gjykatat e Kosovës i njohin vendimet e arbitrazhit të nxjerra jashtë Kosovës si të plotfuqishme dhe i ekzekutojnë ato nëse vendimet në fjalë janë njohur dhe janë shpallur të ekzekutueshëm*”. Këto Nene njohin parimet e Konventës së Neë Yorkut të vitit 1958, mbi Njohjen dhe Përmbartimin e Vendimeve të Arbitrazhit të huaj.

Neni 39.3 i ligjit parasheh se për njohjen dhe ekzekutimin vendimit arbitrazhit , pala e interesuar duhet t`i paraqitet gjykatës me kërkesë, të cilës duhet t`ia bashkëngjisë:

- origjinalin e vendimit ose një kopje të vërtetuar të vendimit;
- origjinalin e marrëveshjes së arbitrazhit ose një kopje të vërtetuar të saj; dhe
- një përkthim të certifikuar të marrëveshjes së arbitrazhit dhe të vendimit të arbitrazhit në njërën prej gjuhëve zyrtare të Kosovës, nëse marrëveshja ose vendimi nuk është përpiluar në njërën prej gjuhëve zyrtare të Kosovës.

Pas plotësimit të kushteve të përcaktuara me këtë Nen (39.3), gjykata në parim merr aktvendim me të cilin e njeh vendimin e Tribunalit të Arbitrazhit dhe e ekzekuton atë.

ii. Kontestimi i vendimeve të Tribunalit të Arbitrazhit në procedurën e njohjes dhe ekzekutimit

Edhe pse në parim Ligji parasheh njohjen dhe ekzekutimin vendimeve të arbitrazhit, në Nenin 39.4 Ligji përcakton se “Kërkesa për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit refuzohet në bazë të kërkesës së palës tjetër, nëse ajo dëshmon se:

- njëra palë në marrëveshjen e arbitrazhit, sipas së drejtës kompetente për atë marrëveshje, nuk ka pasur zotësi për të vepruar; ose nëse marrëveshja e arbitrazhit nuk ka qenë e vlefshme sipas së drejtës së caktuar nga palët ose, në mungesë të një caktimi të tillë, sipas së drejtës në territorin ku është marrë vendimi;
- pala, ndaj së cilës kërkohet ekzekutimi i vendimit, nuk është njoftuar me rregull në lidhje me caktimin e një arbitri ose për procedurën e arbitrazhit, ose për arsye tjera nuk ka qenë në gjendje të paraqesë rastin e saj;
- vendimi nuk ka të bëjë me çështjen e shqyrtuar nga tribunali i arbitrazhit ose ka të bëjë me një çështje e për të cilën nuk është kompetent tribunali i arbitrazhit, ose vendimi përfshin çështje për të cilat nuk është kompetent tribunali i arbitrazhit. Në këto raste, nëse vendimi mbi çështjet për të cilat është kompetent tribunali i arbitrazhit mund të ndahet nga çështjet tjera, atëherë kjo pjesë e vendimit mund të njihet dhe të ekzekutohet;
- përbërja e tribunalit të arbitrazhit ose procedura e arbitrazhit nuk ka qenë në pajtim me dispozitat e ligjit të zbatueshëm në atë rast;
- vendimi ende nuk është bërë i plotfuqishëm për palët, ose është shfuqizuar ose pezulluar nga një organ kompetent në territorin ku është nxjerrë vendimi, respektivisht sipas drejtës në bazë të së cilës është nxjerrë vendimi;

si dhe nëse

- sipas ligjit në fuqi në Kosovë, kontesti përkatës nuk mund të zgjidhet përmes arbitrazhit, ose
- njohja ose ekzekutimi i vendimit do të cenonte ose do të ishte në kundërshtim me rendin publik (ordre public) të Kosovës.

Kushtet për shkak të të cilave mund të refuzohet njohja e ekzekutimit të aktvendimit të tribunalit të huaj, të përcaktuara me Nenin e sipërcituar të Ligjit, janë në përputhje me Nenet IV dhe V të Konventës së Nju Yorkut të vitit 1958, mbi Njohjen dhe Përmbartimin e Vendimeve të Arbitrazhit të huaj si dhe me Nenin 36 të Ligjit model UNCITRAL mbi Arbitrazhin komercial ndërkombëtar.

iii. Kontestimi i vendimeve të Tribunalit të Arbitrazhit dhe kërkesa për anulimin e tyre në procedurë gjyqësore

Pavarësisht dispozitave ligjore të cilat parashohim mundësinë e kontestimit të vendimeve të arbitrazhit në procedurën e njohjes dhe ekzekutimit pranë gjykatës, Ligji në Kreu-n VII, Neni 36, parasheh mundësinë e kontestimit të vendimit të arbitrazhit, nën kushte të caktuara, edhe para fillimit të procedurës së njohjes dhe ekzekutimit, respektivisht brenda 90 ditëve nga data e marrjes së vendimit nga Tribunali.

Në këtë drejtim, Neni 36 i Ligjit parasheh se, secila palë mund të kërkojë anulimin e vendimit pranë gjykatës dhe gjykata do ta anulojë atë, nëse plotësohen kushtet e caktuara të cilat i radhit në dy kategori:

- a) Rrethanat të cilat duhet t'i dëshmojë pala paditëse e cila ka kërkuar anulimin e vendimit:
 - njëra palë në marrëveshjen e arbitrazhit nuk ka patur zotësinë për të vepruar;
 - marrëveshja e arbitrazhit nuk është e vlefshme sipas së drejtës së caktuar nga palët ose nga tribunalin i arbitrazhit ose, në mungesë të një caktimi të tillë, sipas ligjit të zbatueshëm në Kosovë;
 - paditësi nuk është njoftuar me rregull në lidhje me emërimin e një arbitri ose mbi procedurën e arbitrazhit, ose për arsye tjera nuk ka qenë në gjendje të paraqesë rastin e tij;
 - vendimi nuk ka të bëjë me çështjen e shqyrtuar nga tribunalin i arbitrazhit ose ka të bëjë me një çështje për të cilën nuk është kompetent tribunalin i arbitrazhit, ose vendimi përfshinë çështje për të cilat nuk është kompetent tribunalin i arbitrazhit.
 - përbërja e tribunalit të arbitrazhit ose procedura e arbitrazhit nuk ka qenë në pajtim me dispozitat e këtij ligji ose me marrëveshjen e arbitrazhit, me kusht që mangësia e tillë të ketë patur ndikim në vendimin e tribunalit; dhe
- b) Rrethanat të cilat gjykata i vlerëson sipas detyrës zyrtare:
 - arbitrazhi në fjalë është i ndaluar me ligj; ose
 - ekzekutimi i vendimit do të cenonte ose do ishte në kundërshtim me rendin publik (ordre public).

5.4.2 Kompetencat e gjykatës për shqyrtimin e vlefshmërisë së marrëveshjes së arbitrazhit

Kompetenca e gjykatës lidhur me shqyrtimin e vlefshmërisë së marrëveshjes së arbitrazhit është e rregulluar me Nenet 7 dhe 14 të Ligjit të Kosovës për Arbitrazhin. Bazuar në Nenin 7 të Ligjit, gjykata është kompetente për të vlerësuar nëse marrëveshja mbi arbitrazhin është e pavlefshme ose që çështja kontestuese nuk mbulohet nga marrëveshja e arbitrazhit.

Kjo i referohet rasteve kur marrëveshja e arbitrazhit mund të jetë e ndaluar me ligj apo kontesti ka të bëjë me çështje që sipas ligjeve në fuqi nuk mund të zgjidhen në procedurë të arbitrazhit

(p.sh. çështjet familjare, statusore,etj) si dhe rastet kur marrëveshja mund ta cenon rendin publik (ordre public).

Përderisa dipozita e Nenit 7 parasheh kompetencën e gjykatës për rastet e sipërcekura, Neni 14.1 i ligjit parasheh kompetencën ekskluzive të Tribunalit të Arbitrazhit për të vendosur lidhur me ***vlefshmërinë e klauzolës së arbitrazhit.***

Shqyrtimi i vlefshmërisë së klauzolës së arbitrazhit nënkupton vlerësimin nëse marrëveshja respektivisht klauzola e arbitrazhit i përmbush kriteret e parapara ligjore apo elementet themelore (forma me shkrim, gjuha e arbitrazhit, vendi i arbitrazhit, miratimi i palëve për arbitrim, Institucioni dhe rregullat e arbitrazhit, etj.)

Nga shqyrtimi i i vlefshmërisë së arbitrazhit duhet dalluar rastin kur ndonjëra nga palët kontraktuese pretendon se ***klauzola për arbitrazh nuk ekziston.*** Në këto ato raste gjykata ka juridiksion të vlerësojë ekzistimin apo mos-ekzistimin e klauzolës së arbitrazhit dhe mund të marr vendim me të cilin e shpall jo-ekzistente klauzolën e tillë, nëse pala e cila ka kërkuar shqyrtimin e mos-ekzistencës së klauzolës së arbitrazhit argumenton se, klauzola është rezultat i mashtrimit, presionit, gabimit apo mosdijes dhe se nuk ka ekzistuar qëllimi i tij për të arbitruar.

5.5 Ndërmjetësimi si formë alternative për zgjidhjen e kontesteve

5.5.1 Shqyrtime të përgjithshme lidhur me Ndërmjetësimin

“Ndërmjetësimi” është mënyrë alternative e zgjidhjes së kontesteve, në të cilën përmes negociimit, me ndërmjetësimin e një palë të tretë, palët tentojnë të arrijnë marrëveshje për zgjidhjen e kontestit ndërmjet tyre.

Procedura e ndërmjetësimit, në parim është e ndarë nga procedura gjyqësore, por megjithatë ajo është mjaft e ndërlidhur me procedurat që zhvillohen në gjykata. Kjo ndërlidhje paraqitet në mënyra të ndryshme pasi që në raste të caktuar gjykata e udhëzon apo i urdhëron palët në procedurë të ndërmjetësimit. Për më tepër përmbushja e detyrueshme e marrëveshjeve të arritura në ndërmjetësim mund të arrihet përmes procedurës gjyqësore.

5.5.2 Marrëveshja për ndërmjetësim

Marrëveshja për ndërmjetësim dallohet nga marrëveshja e arritur nga palët në kontest përmes ndërmjetësimit. Përderisa e para krijon detyrimin për ndërmjetësim, e dyta është marrëveshje për zgjidhjen e kontestit ndërmjet tyre.

Ligji i Kosovës për ndërmjetësim Nr. 03/ L-057, në Nenin 9.1 parasheh se: “*Procedura e ndërmjetësimit fillon në momentin kur palët pajtohen për fillimin e saj*” Kjo nënkupton se palët ndërmjet, janë të lirë që në bazë të vullnetit të tyre të vendosin nëse dëshirojnë që kontestin ta zgjidhin në procedurë të ndërmjetësimit, kohën kur do të fillojnë procedurën e ndërmjetësimit dhe lirisht ta zgjedhin ndërmjetësuesin.

Përveç ndërmjetësimit vullnetar në praktikën juridike njihen edhe format e detyrueshme të ndërmjetësimit.

Në parim ekzistojnë tri mënyra përmes së cilave krijohet obligimi i palëve të një kontesti, që të angazhohet në ndërmjetësim:

- përmes kontratës,
- përmes urdhrit gjyqësor,
- me ligj.

Ky obligim nuk krijon detyrim të domosdoshëm që të arrijë marrëveshje dhe ta zgjidh kontestin në procedurë të ndërmjetësimit, por pala e cila merr përsipër këtë detyrim obligohet që të marr pjesë në procedurën e ndërmjetësimit.

Ligjet e aplikueshme në Kosovë, nuk parashohin ndërmjetësimin e obliguar sipas ligjit, andaj në Kosovë njihen dy forma të ndërmjetësimit të obliguar, ndërmjetësimi kontraktual dhe ai i urdhëruar nga gjykata dhe prokuroria.

i. Detyrimi kontraktual për ndërmjetësim në rast të kontestit krijohet më marrëveshjen e palëve, e cila mund të jetë e kontraktuar para kontestit apo pas kontestit.

Kontrata për ndërmjetësim para kontestit mund të jetë kontratë e veçantë ndërmjet palëve përmes së cilës palët pajtohen që kontestin ta zgjidhin në procedurë të ndërmjetësimit, apo mund të jetë klauzolë e veçantë në kuadër të kontratës kryesore ndërmjet tyre, përmes së cilës klauzolë e përcaktojnë ndërmjetësimin si mënyrë e zgjidhjes së kontestit, në rast të lindjes së kontestit ndërmjet tyre.

Kontrata për ndërmjetësimin pas kontestit nënkupton kontratën të cilët palët e lidhin pas paraqitjes së kontestit ndërmjet tyre, e më të cilën kontratë ata pajtohen që ti nënshtrohen procedurës së ndërmjetësimit.

Detyrimi kontraktual për ndërmjetësim mund të jetë kusht për angazhim në forma tjera të zgjidhjes së kontestit, qoftë përmes formës alternative - arbitrazhit, qoftë përmes procedurës gjyqësore para gjykatës, i cili kusht pengon fillimin e procedurave tjera pa i'u nënshtruar ndërmjetësimit.

Marrëveshjet për ndërmjetësim i nënshtrohen rregullave të përgjithshme të cilat rregullojnë kontratat siç janë përcaktuar në Ligjin për detyrimet. Nëse marrëveshja për ndërmjetësim është valide formalisht apo materialisht, ajo përmbahet nga gjykata dhe krijon detyrim mbi të gjitha palët e marrëveshjes së ndërmjetësimit, për t'u angazhuar në ndërmjetësim si procedurë jashtëgjyqësore për zgjidhje të kontestit.

Detyrimi kontraktual për ndërmjetësim nuk përfshinë detyrimin për të zgjidhur kontestin përmes ndërmjetësimit por vetëm detyrimin për përfshirje në procedurë të ndërmjetësimit dhe nëse ata nuk arrijnë marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit, kjo nuk konsiderohet mos-përmbushje e marrëveshjes së ndërmjetësimit.

Shkelja e detyrimit kontraktues për pjesëmarrje në ndërmjetësim paraqitet në dy forma:

- Refuzimi i palës për pjesëmarrje në ndërmjetësim; dhe
- Neglizhimi i detyrimit kontraktues për ndërmjetësim nga ana e palës dhe inicimi i drejtpërdrejtë i procedurës së arbitrazhit apo procedurës gjyqësore.

Në rastin e parë, pala tjetër mund të kërkojë përmbarimin e marrëveshjes për ndërmjetësim, në procedurë gjyqësore ndërsa në rastin e dytë pala tjetër mund ta kundërshtojë iniciimin e

procedurës para gjykatës si të parakohshëm dhe marrëveshjen për ndërmjetësim të paraqes si pengesë procedurale për zhvillimin e procedurës gjyqësore.

ii. Detyrimi i urdhëruar nga gjykata për ndërmjetësim, krijohet sipas urdhrorit të gjykatës përmes së cilës gjykata i urdhëron palët që t'i nënshtrohen procedurës së ndërmjetësimit lidhur me kontestin e tyre.

Ligjet e aplikueshme në Kosovë parashohin dy situata lidhur me delegimin e kontestit në procedurë të ndërmjetësimit;

Në rastin e parë, përfshihen rastet kur ligji parasheh se gjykata vetëm mund t'i udhëzojë palët për ndërmjetësim po jo edhe t'i detyrojë ato. Rasti i tillë parashihet Neni 9.6 të Ligjit të Kosovës për Ndërmjetësimin, i cili parasheh se: “ *Gjykata mundet në secilën fazë të procedurës gjyqësore, deri në përfundimin e saj, t'i sugjeroj palët në procedurën e ndërmjetësimit*”. Në këtë rast palët mund ta injorojnë sugjerimin e gjykatës dhe të vazhdojnë me procedurë gjyqësore.

Në rastin e dytë, kemi të bëjmë me rastet kur ligji parasheh mundësinë e dhënies së urdhrorit për dërgimin e çështjes në procedurë të ndërmjetësimit dhe në atë rast krijohet detyrimi i palëve që të përfshihen në procedurë të ndërmjetësimit. Rasti i tillë parashihet me Nenin 232 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (Kodi Nr. 04/L-123), sipas të cilit prokurori mund ta dërgojë çështjen në procedurë të ndërmjetësimit dhe në atë rast krijohet detyrimi për ndërmjetësim që ta zhvillojë procedurën e ndërmjetësimit ndërsa i akuzuari përfshihet në këtë procedurë pavarësisht vullnetit të tij.

5.5.3 Arritja e Marrëveshjes në ndërmjetësim dhe përmbushja e saj

Marrëveshje e arritur në ndërmjetësim, nënkupton marrëveshjen e arritur ndërmjet palëve në procedurën e ndërmjetësimit në të cilën ato zgjidhin kontestin e tyre.

Ligji i Kosovës për Ndërmjetësim Nr. 03/L-057, në Nenin 12, përcakton se arritja e marrëveshjes në procedurën e ndërmjetësimit varet ekskluzivisht nga vullneti i palëve, duke ia njohur kështu autonominë e plotë të palëve për arritjen e marrëveshjeve në procedurë të ndërmjetësimit.

Ligji parasheh dy situata lidhur me përmbushjen e marrëveshjes së arritur në ndërmjetësim dhe bën dallimin ndërmjet:

- marrëveshjes së arritur në bazë të vullnetit të palëve jashtë procedurës gjyqësore dhe
- rastit kur procedura është iniciuar në gjykatë dhe marrëveshja arrihet në ndërmjetësimin e zhvilluar sipas udhëzimit/urdhrit të gjykatës, e cila marrëveshje pastaj miratohet në gjykatë.

Në rastin e parë, kur marrëveshja arrihet jashtë procedurës gjyqësore, Neni 12 i ligjit në paragrafin 4 parasheh se: Marrëveshja “...ka fuqinë e dokumentit përfundimtar dhe është i detyrueshëm” nëse marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit është e përpiluar në përputhje me paragrafin 3 të të njëjtit Nen, respektivisht nëse është përpiluar me shkrim dhe nëse është nënshkruar nga palët dhe ndërmjetësuesi.

Në rastin e dytë, kur procedura është duke u zhvilluar në gjykatë, Neni 12.5 i ligjit parasheh se: *“Në rast se dosja e lëndës gjendet në gjykatë, marrëveshja e arritur me shkrim duhet ti dërgohet gjykatës, e cila pas aprovimit, e ka fuqinë e titullit ekzekutiv”*

Nga të lartcekurat, mund të konstatojmë se në bazë të ligjit, varësisht se si është arritur marrëveshja në ndërmjetësim, përmbushja e marrëveshjes trajtohet në forma të ndryshme.

Marrëveshja e arritur jashtë procedurës gjyqësore, në parim përbën marrëveshje e cila krijon detyrime kontraktuese ndërmjet palëve sipas rregullave të së drejtës së detyrimeve respektivisht Ligjit mbi Detyrimet dhe marrëveshja e tillë përbën kontratë ndërmjet palëve andaj secila nga palët mund të kërkojë përmbushjen e detyrimeve në procedurë gjyqësore.

Dilemat lindin lidhur me procedurën që duhet ndjekur gjykata për përmbushjen e marrëveshjes së ndërmjetësimit. A duhet të trajtohet marrëveshja e tillë si kontratë detyrimore apo dokument përmbarues?

Në bazë të ligjeve në fuqi, askund nuk parashihet se marrëveshja e arritur me ndërmjetësim përbën “dokument përmbarues” ashtu siç përcaktohte me Nenin 22 të Ligjit të procedurës përmbarimore të Kosovës (Ligji nr. 04/L-139). Edhe Neni 12.4 i Ligji i Kosovës për ndërmjetësim përcakton se Marrëveshja e ndërmjetësimit është e detyrueshme, por nuk e kualifikon atë si dokument përmbarues.

Ligji i mëparshëm i procedurës përmbarimore nuk e parashihte marrëveshjen e arritur në ndërmjetësim si “titull ekzekutiv” dhe se marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit nuk mund të përmbarohej drejtpërdrejtë në procedurë përmbarimore, përveç rastit kur ndërmjetësimi është kryer sipas udhëzimit/urdhrit të gjykatës.

Me Ligjin e ri të procedurës përmbarimore të Kosovës (Ligji nr. 04/L-139), edhe pse kjo çështje është avancuar megjithatë ligji nuk e përcakton qartë nëse marrëveshja e arritur në ndërmjetësim përbën dokument përmbarues i cili mund të përmbarohet drejtpërdrejtë në procedurë përmbaruese. Neni 22 i Ligjit në pikën 1.4 cilësinë e dokumentit përmbarues ja njeh marrëveshjes së lidhur ne procedurë të ndërmjetësimit vetëm pas aprovimit të së njëjtës nga gjykata. Ndërsa sipas Nenit 23 par. 1 të Ligjit, marrëveshjes së arritur në procedurën e ndërmjetësimit i njihet cilësia e “Ujdisë” por edhe në këtë rast nuk qartësohet nëse bëhet fjalë vetëm për marrëveshjen e arritur në procedurën e ndërmjetësimit kur çështja referohet në ndërmjetësim nga gjykata apo edhe marrëveshja e arritur me ndërmjetësim sipas vullnetit të palëve, jashtë procedurës gjyqësore.

E njëjta paqartësi haset edhe në Nenin 25 të Ligjit të procedurës përmbarimore, i cili paragrafin 1 thekson se: *“Ujdia gjyqësore, aktpajtimi i lidhur në procedurën administrative, marrëveshja përmbaruese e arbitrazhit, **marrëveshja e lidhur ne procedurën e ndërmjetësimit apo marrëveshja e lidhur ne procedurë tjetër** është e përmbarueshme në qoftë se kredia të cilën duhet përmbushur sipas saj është bërë e arritshme”*.

Bazuar në dispozitat e lartëcituar, nuk është e qartë nëse marrëveshja e ndërmjetësimit e arritur jashtë procedurave gjyqësore përbën dokument përmbarues apo duhet t'i nënshtrohet një procedure tjetër gjyqësore për ta fituar cilësinë e dokumentit përmbarues. Neni 22 i Ligjit në pikën 1.4 kërkon aprovimin e gjykatës që marrëveshja e arritur në ndërmjetësim ta fitojë cilësinë e dokumentit përmbarues, por ligji nuk parashikon procedurën përmes së cilës do të duhej të aprovohej nga gjykata marrëveshja e arritur në ndërmjetësim, jashtë procedurës gjyqësore. Në këtë drejtim ekziston vakum ligjor i cili duhet të trajtohet në të ardhmen, qoftë përmes

amandamentimit të ligjit apo eventualisht përmes ndonjë qëndrimi juridik të organeve kompetente, i cili do ta sqaronte interpretimin e dispozitave të lartcekura.

Në situatën aktuale juridike, duke u nisur nga fakti se dispozitat e Nenit 23.1 dhe 25.1 të Ligjit të procedurës përmbartimore, nuk bëjnë dallimin ndërmjet marrëveshjes së arritur në procedurën e ndërmjetësimit të referuar nga gjykata dhe asaj pa referim nga gjykata, do të duhej të lejohej përmbartimi i marrëveshjes së arritur në ndërmjetësim, ashtu siç parashihet me Nenin 25.2 të Ligjit të procedurës përmbartimore, nëse kredia të cilën duhet përmbushur është bërë e arritshme.

Ligji dhe praktika juridike do të duhej t'i trajtoje njëjtte si marrëveshjen e arritur në procedurën e ndërmjetësimit kur çështja referohet në ndërmjetësim nga gjykata ashtu edhe marrëveshja e arritur me ndërmjetësim jashtë procedurës gjyqësore, apo duhet të përcaktohet qartë procedura se si mund ta fitojë cilësinë e dokumentit përmbartues marrëveshja e arritur në ndërmjetësim jashtë procedurës gjyqësore.

Në favor të kësaj flet edhe Direktiva Evropiane për ndërmjetësimin (Direktiva 2008/52/EC), e cila parasheh se “shtetet anëtare duhet të sigurojnë mundësinë e përmbartimit të marrëveshjeve të arritura në procedurën e ndërmjetësimit, në rastet kur marrëveshja e tillë nuk është në kundërshtim me ligjin e atij shteti dhe nëse përmbartimi i tillë nuk ndalohet me ligjin e brendshëm”.

Këtë praktikë e kanë ndjekur edhe vendet tjera të rajonit, të cilat në ligjet e tyre e kanë njohur përmbartueshmërinë e marrëveshjes së arritur në procedurën e ndërmjetësimit – jashtë gjykatës.

Me Ligjin Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Republikës së Shqipërisë³⁷ në Nenin 22.1, përcaktohet se: “*Kur palët bien dakord për zgjidhjen e pranueshme të mosmarrëveshjes ndërmjet tyre, së bashku me ndërmjetësit, nënshkruajnë marrëveshjen përkatëse, në kuptim dhe në zbatim të kushteve, rasteve dhe të procedurave të parashikuara në këtë ligj. Kjo marrëveshje është e detyrueshme dhe e ekzekutueshme në të njëjtën shkallë me vendimet e arbitrazhit*”. Ndërsa në Nenin 23 i cili rregullon zbatimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit, në pikën 3 theksohet se: “*Nëse aktmarrëveshja respekton kushtet e përcaktuara në nenin 22 të këtij ligji, përbën titull ekzekutiv dhe, në këtë rast, ngarkohet shërbimi përmbartimor për ekzekutimin e tij*”.

Të njëjtën zgjidhje e ka bërë edhe Ligji mbi Procedurën e Ndërmjetësimit i Bosnje dhe Hercegovinës³⁸ i cili në Nenin 25 përcakton se marrëveshja e arritur në ndërmjetësim përben **dokument përmbartues**.

Marrëveshja e arritur në procedurë gjyqësore. - Marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit sipas referimit të gjykatës, pas aprovimit nga ana e gjykatës, prokurorisë apo nëse vërtetohet nga organi tjetër kompetent, ka fuqinë e marrëveshjes gjyqësore dhe konsiderohet titull ekzekutiv i cili mund të përmbartohet drejtpërdrejtë në procedurë të përmbartimit.

Këtë e përcakton Neni 12.5 i Ligjit për Ndërmjetësim i cili përcakton se: “*në rast se dosja e lëndës gjendet në gjykatë, marrëveshja e arritur me shkrim duhet të dërgohet gjykatës, e cila pas aprovimit, e ka fuqinë e titullit ekzekutiv*”.

³⁷ Ligji Nr.10 385, datë 24.2.2011 Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë. Shpallur me dekretin nr.6922, datë 8.3.2011, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë

³⁸ZAKON O POSTUPKU MEDIJACIJE - Službeni glasnik BiH, br. 37/04

Kjo marrëveshje mund të kontestohet nga palët vetëm nën kushtet e përcaktuara me nenin 14.5 të Ligjit për ndërmjetësimin, i cili parasheh se: *“Gjykata ose prokuroria mund ta anuloj marrëveshjen e arritur me ndërmjetësim, kur konstaton se është lidhur në kundërshtim me ligjin në fuqi, kur nuk pasqyrohet vullneti i palëve në konflikt, kur janë cenuar rëndë të drejtat dhe interesat e tyre ose kur zhdëmtimi është haptazi në disproporcion me dëmin e shkaktuar.*

5.6 Përmbledhje

Ky punim shtjellon bazat ligjore të rregullimit procedurës së zgjidhjes së kontesteve përmes Arbitrazhit dhe Ndërmjetësimin dhe mbrojtjes juridike juridike që gëzojnë palët pjesëmarrëse sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës. Poashtu shtjellon çështjen e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të arbitrazhit dhe ndërmjetësimin qoftë vendore ashtu dhe vendimeve të huaja. Rëndësi e veçante i është kushtuar mjeteve juridike në procedurën e njohjes dhe përmbartimit të vendimeve të arbitrazhit respektivisht mundësisë së kontestimit (anulimin/mospranimin) të vendimit të arbitrazhit, nga gjykatat në Kosovë si dhe ekzekutimit të marrëveshjeve të arritura në procedurën e ndërmjetësimin.

Moduli ofron për pjesëmarrësit njohuri lidhur me:

- Kuptimin dhe specifikat e vendimeve të Arbitrazhit dhe Ndërmjetësimin.
- Njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të Tribunalit të Arbitrazhit
- Kontestimi i vendimeve të Tribunalit të Arbitrazhit në procedurën e njohjes dhe ekzekutimit
- Kontestimi i vendimeve të Tribunalit të Arbitrazhit dhe kërkesa për anulimin e tyre në procedurë gjyqësore
- Kompetencat e gjykatës për shqyrtimin e vlefshmërisë së marrëveshjes së arbitrazhit.
- Kompetencat e gjykatave lidhur me ndërmjetësimin
- Marrëveshja për ndërmjetësim.
- Arritja e Marrëveshjes në ndërmjetësim dhe përmbushja-ekzekutimi i saj.

XIII. E drejta e pronësisë dhe të drejta e tjera të përafërta

Erdogan Haxhibeqiri
Gjyqtarë në Gjykatën Supreme të Kosovës

Tabela e përmbajtjes – “E drejta e pronësisë dhe të drejta e tjera të përfaqëruara”

Hyrje	621
Objektivat trajnuese	621
Metodat e të shpjeguarit	621
Pritjet nga pjesëmarrësit	622
Mjetet e nevojshme.....	622
Burimet.....	622
Përmbledhje	622
1. E drejta e pronësisë	623
1.1 Hyrje.....	623
1.2 Objektivat trajnuese.....	623
1.3 Nocioni i pronësisë	623
1.4 Pronësia dhe pasuria	624
1.5 Karakteristikat e pronësisë.....	624
1.6 Kufizimet e pronësisë	624
1.7 Përmbledhje.....	624
2. Bashkëpronësia dhe pronësia e përbashkët	625
2.1 Hyrje.....	625
2.2 Objektivat trajnues	625
2.3 Nocioni i bashkëpronësisë dhe pronës së përbashkët.....	625
2.4 Të drejtat dhe detyrimet e bashkëpronarëve	627
2.5 E drejta e pjesëtimit.....	628
2.6 Shuarja e bashkëpronësisë	629
2.7 Pronësia e përbashkët	629
2.8 Pronësia e përbashkët e familjeve të mëdha	630
2.9 Pronësia e përbashkët e bashkëshortëve	631
2.10 Pronësia e përbashkët bashkëtrashëgimtarëve mbi sendet e masës trashëgimore	631
2.11 E drejta e pronës në kate.....	632
2.12 Përmbledhje.....	634
3.1 Hyrje.....	635
3.2 Objektivat trajnues	635
3.3 Kufizimet e drejtës së pronësisë	635
3.4 Kufizimet e së drejtës së pronësisë nga e drejta fqinjësore.....	636
3.5 Imisionet	637
3.6 Përmbledhje.....	637
4. Mënyrat e fitimit të drejtës së pronësisë -Fitimi derivativ të drejtës së pronësisë	638
4.1 Hyrje.....	638
4.1 Objektivat trajnues	638
4.2 Bazat e fitimit të drejtës së pronësisë	638
4.4 Mënyra e fitimit të pronësisë	638
4.5 Kushtet për fitimin e drejtës së pronësisë	639
4.6 Bartësit të drejtës së pronësisë	639
4.7 Fitimi i pronësisë në mënyrë derivativ	639
4.8 Modus Aquirendi për fitimin e pronësisë mbi paluajtshmëri	640
4.9 Përmbledhje.....	640

5.	Mënyra origjinere e fitimit të drejtës së pronësisë	641
5.1	Hyrje.....	641
5.2	Objektivat trajnues	641
5.3	Fitimi i pronësisë në mënyrë origjinere	641
5.4	Parashkrimi fitues (Usucapio).....	641
5.5	Ndërtimi në tokën e huaj	642
5.6	Përmbledhje.....	643
6.	Mbrojtja gjyqësore e të drejtës së pronësisë	644
6.1	Hyrje.....	644
6.2	Objektivat trajnues	644
6.3	Rëndësia e mbrojtjes drejtës së pronësisë	644
6.4	Protokoli 1 Konventës Evropiane për mbrojtjen e lirive themelore dhe drejtave njeriut.	644
6.5	Llojet e padive.....	644
6.6	Padia rei vindikimit (action reivindicatio).....	645
6.7	Padia publiciane (actio publiciana)	645
6.8	Përmbledhje.....	646
7.	Padia negatore edhe mbrojtja e posedimit	647
7.1	Hyrje.....	647
7.2.	Objektivat trajnues	647
7.6	Përmbledhje.....	649
8.	Të drejtat sendore në sendet e huaja,vërtetimi, konstituimi dhe ndërprerja e servituteve sendore, dhe mbrojtja e servituteve sendore	650
8.1	Hyrje	650
8.2	Objektivat trajnuese	650
8.3	Të drejtat sendore në sendet e huaja	650
8.4	Servitutet sendore	650
8.5	Servitutet personale.....	651
8.6	Parimet e servituteve	651
8.7	Llojet e servituteve	651
8.8	Servitutet tokësore	652
8.9	Servitutet shtëpiake.....	652
8.10	Shuarje e servituteve	653
8.11	Mbrojtja servituteve	653
8.12	Përmbledhje.....	654
9.	Humbja drejtës së pronësisë.....	655
9.2	Hyrje	655
9.3	Objektivat trajnues	655
9.3	Humbja e pronësisë (shuarja)	655
9.4	Përmbledhje.....	656
10.	E drejta e ndërtimit (Superficies).....	657
10.1	Hyrje.....	657
10.2	Objektivat trajnuese.....	657
10.3	Nocioni	657
10.4	Fitimi i të drejtës së ndërtimit.....	658
10.5	Përmbajtja e të drejtës së ndërtimit	658

10.6 Mbrojtja e të drejtës së ndërtimit.....	658
10.7 Shuarja e të drejtës së ndërtimit	659
10.8 Pasojat e shuarjes të së drejtës së ndërtimit	659
10.9 Përmbledhje.....	659

Hyrje

Në çdo shoqëri lindin dhe zhvillohen marrëdhënie të caktuara në kuadër të cilave lindin dhe zhvillohen edhe raporte të ndryshme dhe specifike të cilat varësisht nga karakteristikat dhe përmbajtja diferencohen dhe grupohen degë të caktuara të marrëdhënieve të cilat pastaj ndërliken dhe bëhen pjesë e sistemit të përgjithshëm të marrëdhënieve shoqërore.

Duke qenë cilin marrëdhënie shoqërore normohet me norma juridike me normimin e grupeve të veçanta të marrëdhënieve lindin dhe zhvillohen degë të veçanta të së drejtës të cilat pastaj ndërliken me degët tjera në një tërësi dialektike dhe formojnë sistemin unik juridik.

Në kuadrin e marrëdhënieve të përgjithshme shoqërore kanë lindë dhe janë edhe zhvilluar marrëdhëniet shoqërore- pronësore me karakteristika dhe përmbajtje të veçanta, të cilat janë normuar me normat të veçanta juridike, me çka lindë e drejta e pronësisë. Për rrjedhojë e drejta e pronësisë mund të përkufizohet si degë e veçantë e së drejtës e cila përmban tërësinë e normave juridike më të cilat rregullohen marrëdhëniet e pronësisë.

Gjithashtu e drejta e pronësisë merret me studimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë dhe me elementet të cilat e përbejnë këtë raport juridik.

Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij moduli trajnues, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Thellojnë njohurit lidhur me të drejtën e pronësisë në shumë subjekte;
- Dallojnë bashkëpronësinë dhe pronësisë së përbashkët;
- Njohin mënyrat e fitimit të pronësisë;
- Zgjerojnë njohurit lidhur me llojet e padive për mbrojtje të pronësisë dhe dallimet në mes të këtyre padive;
- Njohin mënyrat e humbjes së pronësisë;
- Zbatojnë drejtë infrastrukturën ligjore lidhur me drejtën e pronësisë në përgjithësi;
- Bëjnë dallime në mes mënyrave të fitimit të pronësisë, formave të pronësisë, padive pronësore dhe qëllimit të këtyre padive;
- Analizojnë institutin e drejtës së ndërtimit;
- Fitojnë njohurit nga praktika gjyqësore lidhur me të drejtën e pronësisë.

Metodat e të shpjeguarit

Gjatë sesioneve do të përdoren metodat bashkëkohore të shpjegimit siç janë: metodat interaktive duke motivuar në fillim që vijuesit e trajnimit për pjesëmarrje aktive në temat që do të shtjellohen, me kombinim shpjegimit teorik, me dhënien e shembujve nga praktika gjyqësore, me angazhimin e pjesëmarrësve për zgjedhjen e rasteve dhe situatave të caktuara juridike të cilat rëndom ndodhin në procedurat gjyqësore në situata të caktuara juridike të cilat ndodhin në procedurat pran gjykatave dhe nxjerrjen e përfundimeve dhe konkluzioneve në rastet konkrete.

Gjithashtu gjatë prezantimeve do të përdoret teknika PowerPoint si dhe mjetet tjera të përshtatshme për prezantim audio vizual.

Pritjet nga pjesëmarrësit

Nga pjesëmarrësit pritet të jenë aktiv gjatë gjithë fazave të sesioneve që të angazhohen ,që të sqarohen të gjitha çështjet kyçe të temave të cilat do të shtjellohen që të fitojnë njohuritë e nevojshme për të gjitha elementet përmbajtore të institutëve që do të shtjellohen dhe që të jenë në gjendje që në mënyrë të pavarur të shpjegojnë dhe të zbatojnë në praktikë.

Mjetet e nevojshme

Pajisjet e nevojshme për zbatim e sesioneve

- Projektor, kompjuter, mikrofon
- Qasje internet
- Tabela e bardh dhe marker
- Pajisje për përkthim
- Fotokopjimi i rasteve nga praktika
- Fli charter,

Burimet

1. E drejta e sendor Prof. Dr. Abdula Aliu
2. Marrëdhëniet pronësore juridike në sendet e paluajtshme në KSA Kosovës Pr.Dr.EjupStatovci
3. Stvarno pravo Prof Dr. Dragoljub Stojanoviq botimi I VII ndryshuar dhe plotësuar Beograd 1987
4. Komenti i ligjit themelor mbi marrëdhëniet pronësore juridike-Autor Dr. Dragoljub Stojanoviq dhe Dr Dimitar Po Georgiev botimin e dytë i zgjeruar Beograd 1983
5. Ligji Themelore mbi marrëdhëniet pronësore juridike
6. Ligji mbi pronësinë dhe drejtat tjera sendore
7. Protokollu 1 Konventës Evropiane mbi Liritë dhe të Drejtat e Njeriut

Përmbledhje

Në këtë modul është bërë shqyrtimi i çështjeve në pajtim me qëllimin dhe objektivat mësimore për aftësimin profesional të gjyqtarëve në Republikën e Kosovës. Metoda e kombinuar me ligjërime të shkurt, me bashkëbisedim do të jenë në shfrytëzim, duke shfrytëzuar burimet tjera juridike pjesëmarrësit do të përfitojnë njohuri dhe shkathtësi profesionale për zbatimin praktik lidhur me Drejtën e Pronësisë dhe të drejtat tjera të përafërta.

1. E drejta e pronësisë

1.1 Hyrje

Në këtë sesion do të jepen shpjegime për të drejtën pronësisë si një ndër institutet ma të rëndësishme të drejtës civile ne përgjithësi dhe drejtës sendore në veçanti.

Garantimi i drejtës së pronësisë si drejtë themelore e njeriut çka përmbajnë autorizimet e drejtës së pronësisë. Përkufizimet e drejtës së pronësisë duke u mbështetur në autorizimet që ka titullari i drejtës së pronësisë. Gjithashtu në këtë sesion do të jepen shpjegime lidhur me dallimet në mes të pronësisë dhe të pasurisë si dhe karakteristikat e pronësisë, njoftimet lidhur me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane mbi mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore njeriut (KEDNJ).

Do të shpjegohet lidhur me nocionin e bashkëpronësisë, pronësisë së përbashkët dhe format e pronësisë së përbashkët. Pjesëmarrësit do të kenë mundësi të kuptojnë mënyrat e fitimit të këtyre dy formave të pronësisë, dallimet në mes të këtyre dy formave të pronësisë.

1.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij sesioni, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Njohin me gjerësisht për përkufizimet e në mes të pronësisë dhe drejtës së pronësisë;
- Bëjnë dallimet në mes të pronësisë dhe pasurisë;
- Njohin karakteristikat e drejtës së pronësisë;
- Fitojnë njohuri lidhur me ligjet aplikueshme;
- Zgjerojnë njohurit lidhur me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ.

1.3 Nocioni i pronësisë

E drejta e pronësisë është një ndër institutet ma të rëndësishme të së drejtës sendore. Me të gjitha aktet ma të larta juridike garantohet e drejta e pronësisë për shkak rëndësisë që ka e drejta e pronësisë e që nga autorët emërtohet edhe si pronësi.

Ligji i Pronësisë dhe të drejtat tjera sendore (Gazeta zyrtare Republikës së Kosovës) nr. 03/L-154), në nenin 1 paragrafi përcakton :krijimin , përmbajtjen, bartjen, mbrojtjen si dhe shuarjen e drejtave sendore. E drejta e pronësisë titullarit i garanton pushtetin ma të lartë mbi një send.

E drejta e pronësisë është drejtë sendore bartësit të saj mundëson posedimin, përdorimin, shfrytëzimit dhe disponimit e sendit të caktuar brenda kufijve të paraparë me ligj. LPDTS përcakton definicioni e pronësisë.

E drejta e pronësisë është e drejtë sendore që përmban në vete autorizime ma të gjëra me rastin e shfrytëzimit dhe të disponimit me një sendit. E drejta e pronësisë titullarit garanton pushtetin ma të lartë mbi një send.

Përkufizimi i pronësisë është në shumicën e ligjeve dhe kodeve civile, e drejta e pronësisë është drejtë sendore e çka bartësit të saj i mundëson posedimin, përdorimin, shfrytëzimin dhe

disponimin e sendit të caktuar brenda kufijve të paraparë me ligj. Pra ushtrimin në kufijtë e ligjit është kuptim më të gjerë sesa keqpërdorimi i drejtës që ndalohet me ligj.

Pra e drejta e pronësisë është pakufizuar, përveç nëse me ligj është kufizuar si dhe për të mirë të interesit publik, për këtë shprehimisht parasheh ligji. Në kufizime përgjithshme bëhet ndalimi i keqpërdorimit të pronësisë.

1.4 Pronësia dhe pasuria

Në jetën e përditshme ndodh që të ngarrohen termet pronësia dhe pasuria ,sepse disa nuk bëjnë dallim. Pasuria është tërësi drejtave subjektive civile me karakter pasuror që takojnë një personi lëndë e pasurisë janë sendet vlerat ekonomike .Konventa Evropiane përdor termin “Property”.

E drejta e pronësisë është drejtë sendore që përmban autorizime ma të gjëra lidhur me përdorimin ,shfrytëzimin e një sendi.

1.5 Karakteristikat e pronësisë

E drejta e pronësisë ka disa karakteristika, siç janë uniteti i së drejtës së pronësisë, e drejta lidhur me subjektin e caktuar, veprim plotësisht i lirë për të disponuar, karakteri pasuror i pronësisë, karakteri absolut.

1.6 Kufizimet e pronësisë

Si u tha e drejta e pronësisë ka autorizime e gjëra dhe kjo mundë të kufizohet me ligj. Në të gjitha ligjet dhe kodet civile kemi kufizime të së drejtës së pronësisë. Këtë e parasheh edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 46. Neni 6 të LPDTS ndalon keqpërdorimet e të drejtave sendore.

Në nenin 1 par.1 të ligjit në fjalë, pronësia dhe e drejta sendore mund të kufizohen ose merren kundër vullnetit të titullarit sipas kushteve të përcaktuara me ligj.

1.7 Përmbledhje

Në këtë sesion janë dhënë shpjegime lidhur me të drejtën e pronësisë së një ndër të drejtat elementare të njeriut, të cilën e garanton ligji, kushtetuta dhe konventat ndërkombëtare si dhe janë dhënë karakteristikat e pronësisë dhe kufizimet e drejtës së pronësisë me ligjet aplikueshme.

2. Bashkëpronësia dhe pronësia e përbashkët

2.1 Hyrje

Bashkëpronësia dhe pronësia e përbashkët paraqesin një prej formave të pronësisë kur shumë subjekte kanë autorizime pronësore mbi një send.

Ekzistojnë dallimet në mes të këtyre dy formave të pronësisë sa i përket përcaktimit të pjesëve ideale. Në praktikë paraqiten dilema në dallimin e këtyre dy formave të pronësisë, prandaj objektivat dhe qëllimi i këtij trajnimi do të fokusohet në zgjidhjen e dilemave, paqartësive që paraqiten në interpretimin dhe implementimin në procesin e vendimmarrjes nga gjyqësori i Republikës së Kosovës. Synimi kryesor i këtij trajnimi konsiston në faktin që duke shqyrtuar praktikën relevante gjyqësore të qëndrueshme të ndërtohen standardet e njëjta juridike, me intencë që të arrihet siguria juridike e palëve dhe rrjedhimisht stabiliteti social. Duke u mbështetur në këto postulate juridike objektivi strategjik është që të arrihet performanca dhe kredibiliteti në gjyqësorin e Republikës së Kosovës.

2.2 Objektivat trajnues

Pas përfundimit të këtij sesioni pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Dallojnë këto forma të drejtave të pronësisë dhe të vendosin në raste kontesti në mesë të subjekteve për këto forma të pronësisë;
- Përkufizojnë të drejtat e pronarëve të përbashkët e veçmas të drejtën e pjesëtimit të pronësisë së përbashkët dhe mënyra e pjesëtimit;
- Zbatojnë dispozitat ligjore në mënyrë të drejtë në rastet e vërtetimit të kontributit të bashkëshortëve të pronësia e përbashkët e bashkëshortore.

2.3 Nocioni i bashkëpronësisë dhe pronës së përbashkët

Në të drejtën tonë është e mundur që një send individualisht i caktuar të jetë objekt edhe dy e më tepër personave ashtu që të ketë më shumë subjekte me të drejtë pronësie mbi një send. Kjo mund të paraqitet në formë të bashkëpronësisë dhe pronës së përbashkët.

Pronësia mbi një send mund t'i përkas një personi ose disa personave. Kur pronësia mbi një send u përket dy ose më shumë personave kemi bashkëpronësinë. Prona që u përket disa bashkëpronarëve gjuhët bashkëpronësi. Personat që marrin pjesë në këtë pronësi gjuhen bashkëpronar. Karakteristikë e bashkëpronësisë është se pjesët e bashkëpronarëve janë të caktuara më parë në mënyrë numerike - alikuote apo në pjesë ideale (1/2) ose 50 % . Në të vërtetë në këtë rast konkret bëhet fjalë për pjesëtimin juridik të sendit në mes të bashkëpronarëve. Bashkëpronësia paraqitet sikundër në sendet e luajtshme ashtu edhe në sendet e paluajtshmen.

Në këto raste sendi në mënyrë reale është i pandashëm. Pjesa juridike e bashkëpronarëve paraqet të drejtën sendore të pavarur dhe ka natyrën juridike të pronësisë. Prandaj edhe të bashkëpronësia zbatohen rregullat e pronësisë. Te pronësia e përbashkët pjesët e pjesëmarrësve nuk dihen në mënyrë numerike dhe alikuote.

Nga kjo del se bashkëpronësia dhe pronësia e përbashkët janë dy format e pronësisë ku shumë subjekte kanë të drejtën e pronësisë mbi një send. Sendet e bashkëpronësisë dhe pronësisë së përbashkët mund të jenë të luajtshme ose të paluajtshme. Bazat e fitimit të bashkëpronësisë është e ngjashme me bazat e fitimit të pronësisë me ndonjë specifik të veçantë.

Ligji mbi Bazat Marrëdhënive Themelore Juridiko Pronësore e rregullon bashkëpronësinë me dispozitat e nenit nenet 13 – 17. Definicionin e bashkëpronësisë parashikohet me nenin 13 të këtij ligji . Me këtë dispozitë ligjore theksohet citat” *më shumë persona kanë të drejtën e bashkëpronësisë në sendin e pandarë kur pjesa e secilit prej tyre është përcaktuar në përpjesëtim me tërësinë (pjesa ideale). Në qoftë se pjesët nuk janë të caktuara supozohet se janë të barabarta. Bashkëpronari ka autorizime të pronarit në pjesën e tij ideale e cila është caktuar sipjesë ideale, pasi sendi realisht nuk është e ndarë”.*

Ligji i pronësisë dhe i të drejtave tjera sendore rregullon bashkëpronësinë në kapitullin e pestë përkatësisht me nenet 51 – 56.Me këto dispozita ligjore emërtohet gabimisht definicioni i pronësisë i disa personave që është përcaktim i gabuar, sepse pronësia e disa personave në sendet e luajtshme apo paluajtshme gjithsesi është bashkëpronësi apo pronësi e përbashkët.

Ndërkaq ,me dispozitat e nenit 77 të këtij Ligji normohet natyra juridike me specifikat e saja të pronës së përbashkët. Me këtë dispozitë ligjore parashikohet pronësia e përbashkët edhe at: “nëse disa persona kanë të drejtë pronësie mbi një send në atë mënyrë që pjesët e tyre nuk janë të caktuara ,por janë të caktueshme, atëherë janë pronarë të përbashkët. Pra prona e përbashkët është atëherë kur pjesët e pronësisë mund të caktohen por paraprakisht nuk janë caktuar. Pronësia e përbashkët mund të krijohet me ligjit apo me kontratë, me vendimin e organit shtetëror, ne bazë të parashkrimit fitues, pa pëlqimin e bashkëpronarëve dhe me specificatio.

Me kontratë krijohet pronësia e përbashkët vetëm nëse shprehimisht është e parashikuar me ligj. Pronarët e përbashkët disponojnë së bashku me pronësinë dhe përgjigjen së bashku për detyrimet në lidhje me këtë pronësi.

Po kështu është një kriter juridik substancial me të cilën parashikohet se pronarët e pronës së përbashkët kanë autorizime dhe përgjegjësi të kërkojnë shitjen e pjeseshme të pronësisë së përbashkët, por janë kohë të papërshtatshme dhe në dëm të bashkëpronarëve tjerë. Dispozitat e parashikuara për bashkëpronësinë të këtij ligji mutatismutandis zbatohet edhe për pronësinë e përbashkët, përpos rasteve nëse me ligj parashikohet ndryshe.

Kodi civil i Republikës së Shqipërisë emërton institutin e bashkëpronësi si bashkëpronësi në pjesë sipas neneve (199 – 208) dhe bashkëpronësia në tërësi me nenet (208-231) që i referohet pronës së përbashkët. Në këtë lloj të bashkëpronësisë pjesët e bashkëpronarëve nuk janë të përcaktuara por mund të përcaktohen. Pra, pronësinë e përbashkët e emërton si bashkëpronësi në tërësi.

Si shkaqet që qojnë në lindjen e kësaj bashkëpronësie në tërësi, sipas Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë, janë të ndryshme si trashëgimia, objektet e përbashkëta të ndërtesave si bashkëpronësi e detyrueshme, bashkëpronësia e anëtarëve të familjes dhe bashkëpronësia ndërmjet bashkëshorteve.

Bashkëpronësinë e detyrueshme të objekteve të përbashkëta të ndërtesave ky Kod e rregullon tërësisht dhe saktësisht me dispozita përkatëse. Në kuadër të institutit bashkëpronësisë në pjesë ky Kod i rregullon të drejtat e bashkëpronarëve, detyrimet bashkëpronarit, administrimit të bashkëpronësisë, e drejta e parablerjes, e drejta e kreditorit mbi pjesën bashkëpronarit, pjesëtimi i sendit të përbashkët.

2.4 Të drejtat dhe detyrimet e bashkëpronarëve

Bashkëpronarët duke hyrë në marrëdhënie me njëri tjetrin për shkak të bashkëpronësisë, linden të drejtat dhe detyrimet në mes të tyre. Të drejtat dhe detyrimet e tyre caktohen në përpjesëtim me pjesët e secilit. Për të siguruar vazhdimësinë normale të bashkëpronësisë është e domosdoshme njohja e drejtave dhe detyrimeve nga secili bashkëpronar.

Të drejtat e bashkëpronarit janë :

a) e drejta mbi të ardhurat e sendit

Secili bashkëpronar, në përpjesëtim me pjesën e tij përfiton nga të ardhurat e sendit. Në të ardhurat e sendit përfshihet frytet natyrale dhe civile të sendit (neni 52) LPDTS).

b) E drejta e përdorimit dhe disponimit

Bashkëpronari ka të drejtë që sendin të përdor dhe kjo e drejtë i takon të gjithë bashkëpronarëve. Ata paraqiten në raport me sendin në tërësi si bashkë posedues. Asnjëri nga bashkë poseduesit nuk mund të ketë posedimin e tërësishëm të sendit. Frutat të cilat i jep sendi ndahen sipas madhësisë së pjesës. Në qoftë se ndarja e frutave nuk është e mundshme, atëherë bashkëpronarët e fitojnë bashkëpronësinë mbi fruta në natyrë apo ato civile.

Bashkëpronari mund të disponojë me pjesën e tij në send edhe pa pëlqimin bashkëpronarëve të tjerë. Pra ,sikundër mbulimi i shpenzimeve të domosdoshme atyre luksoze dhe vjelja e frutave realizohet sipas rregullit pro rata. Si bashkë posedues të sendit ata mund të posedojnë sendin bashkërisht (tre student në një dhomë shfrytëzojnë bashkërisht kompjuterin me të cilën kanë bashkëpronësinë).

Bashkëpronarët mund të caktojnë njërin të posedoj sendin për të gjithë apo munden me marrëveshje që në periodë të caktuar kohore të kaloj në posedim secilit prej tyre (Shtëpia për pushime në bregdet ku dy bashkëpronar me marrëveshje caktojnë që njëri të shfrytëzoj në gjysmën e parë të vitit e tjetri në gjysmën e dytë të vitit).

Në qoftë se tjetërsohet pjesa alikuote objekt i bashkëpronësisë atëherë secilit bashkëpronar i takon e drejtë e parablerjes. Kur disa bashkëpronarë parashtrojnë kërkesën për të drejtën e parablerjes, atëherë secilit i takon e drejta e parablerjes sipas pjesës së tij.

E drejta e parablerjes është e vlefshme edhe atëherë, kur një gjykatë ka urdhëruar shitjen e pjesës në ankand publik. E drejta e parablerjes nuk konstituohet, nëse një bashkëpronar pjesën e tij ua kalon trashëgimtarëve të tije. Me nenin 53 të LPDTS tërësisht dhe saktësisht rregullohet bazat dhe kriteret administrimit të bashkëpronësisë. Si rregull bashkëpronarët e administrojnë së bashku një send, në të cilin ekziston bashkëpronësia.

Çdo veprim juridik i ndërmarrë për administrimit të rregullt të bashkëpronësisë janë të pavlefshme pa pëlqimin e 50% bashkëpronarëve. Ndërkaq, për punët e administrimit të jashtëzakonshëm, veçanërisht për dispononim me sendin dhe ngarkimin e sendit ose emërimi i administratorit, është i nevojshëm pëlqimi i të gjithë bashkëpronarëve. Këto vendime janë të vlefshme edhe kundrejt pasardhësve juridikë të një bashkëpronari.

Bashkëpronarët si bashke poseduesit gëzojnë mbrojtje të posedimit në raport me personat e tretë si dhe në raportet në mes të tyre. Neni 54 LPDTS rregullon që secili bashkëpronar mund të parashtroj kërkesat kundrejt personave të tretë lidhur me tërë sendin. Kërkesat për kthim dhe

prestime që sipas natyrës së tyre janë të pandashme mund të parashtrohen nga bashkëpronari, vetëm në atë mënyrë që, prestimi të bëhet ndaj të gjithë pronarëve.

Secili bashkëpronar mund të disponoj me pjesën e tij pa pëlqimin e bashkëpronarëve të tjerë. Me disponimin e sendit nënkupton jo vetëm tjetërsimin e pjesës së bashkëpronësisë por edhe ngarkimin (hipotekë, e drejta e përparësisë së blerjes). Nuk mund të ngarkohet pjesa e bashkëpronësisë me servitut real pasi që servituti real përfshin sendin në tërësi. Tjetërsimi i pjesës së bashkëpronësisë me shitjen është kufizuar me përparsi të blerjes. Ndërsa, tjetërsimi i gjithë sendit të bashkëpronësisë bëhet vetëm me pëlqimin e bashkëpronarëve.

2.5 E drejta e pjesëtimit

Mbi të drejtën e ndarjes dhe mënyrën ndarjes të sendit në bashkëpronësi Ligji mbi bazat marrëdhënies themelore juridiko pronësore përcakton me nenin 16” Bashkëpronari ka të drejtë që në çdo kohë të kërkojë ndarjen e sendit, përveç në kohën me të cilën ndarja do të ishte në dëm të bashkëpronarëve dhe në qoftë se me ligj nuk është paraparë ndryshe”. Kjo e drejtë nuk parashkruhet. Nuk është kontrata me të cilën bashkëpronari heqë dorë nga e drejta e ndarjes. Bashkëpronarët me marrëveshje caktojnë mënyrën e ndarjes, në qoftë se nuk ka marrëveshje, vendos gjykata. Gjykata mund të vendos që ndarja të bëhet me shitjen e sendit, në qoftë se ndarja fizike është e pamundur apo vjen deri zvogëlimin konsiderueshëm vlerës së sendit.

Neni 56 paragrafi 3 rregullon:” në qoftë se shuarja e bashkëpronësisë bëhet përmes ndarjes në natyrë apo kur një apo ma shumë bashkëpronarë fitojnë pronësinë në tërë sendin . Atëherë vlera qarkullimit të sendit duhet të përcaktohet përmes ekspertizës të një eksperti zyrtar , nëse nuk heqin dorë të gjithë bashkëpronarët nga ekspertiza e tillë.” Në paragrafi 4 është rregulluar theksuar se nëse nuk mund të arrihet pajtimi rreth ndarjes së sendit në bashkëpronësi, atëherë tjetërsimi i sendit në bashkëpronësi bëhet sipas rregullave shitjes së pasurisë që është në peng, ndërsa të ardhurat e krijuara duhet të ndahen bashkëpronarëve në pajtim me pjesët e tyre . Bashkëpronarët përgjigje për të metat fizike dhe juridike të sendit në kufi të vlerës së pjesëve të bashkëpronësisë. Kjo drejtë shuhet në afat prej tre vitesh nga ndarja e sendit. E drejtë e bashkëpronarëve për të kërkuar e sendit nuk parashkruhet.

E drejta jonë më pare nuk ka pasur rregulla ku ndarja e bashkëpronarëve në kohë të caktuar është përjashtuar. Në drejtën kooperative ky afat ka qenë 5 vjet më të drejtë që ky afat të shtyhet edhe për 5 vjet. Në nenin 55 LPDTS rregullohet “Në qoftë se bashkëpronarët e një paluajtshmërie kanë rregulluar administrimin dhe përdorimin apo kanë përcaktuar që zgjidhja e bashkësisë përjashtohet përgjithmonë ose përkohësisht ose kanë caktuar një afat denoncimit, atëherë ky rregull nuk vlen kundër pasardhësve të veçantë të një bashkëpronari, vetëm nëse ky rregull është regjistruar në regjistrat e të drejtave në paluajtshmëri”.

Ndarja gjyqësore bëhet sipas Rregullave të procedurës jokontestimore, në qoftë se ndërmjet bashkëpronarëve nuk ka kontest. Në qoftë se ndërmjet bashkëpronarëve ekziston kontesti mbi lëndën e ndarjes, mbi të drejtën e pronësisë mbi atë se sa janë pjesët e bashkëpronësisë vendoset në procedure kontestimore.

Ligji mbi bazat marrëdhënies themelore juridiko pronësore ka paraparë me nenin 17, që në kushtet dhe rastet e caktuara me ligje, bashkëpronësia mund të ekzistoj në sendin e pandarë e cila në një pjesë është në pronësi shoqërore ndërsa në pjesën tjetër ekziston e drejta e pronësisë. Këtë formë të bashkëpronësisë Republika e Sllovenisë ka rregulluar me Ligje mbi të Drejtat e banesave ndërsa Republika e Serbisë ka pasur Ligjit mbi bashkëpronësinë në banesa.

2.6 Shuarja e bashkëpronësisë

Bashkëpronësia sipas nenit 56 par.1 të LPDTS shuhet nëpërmjet ndarjes, marrjes për sipër të sendit nga një bashkëpronar, braktisje të sendit të paluajtmshëm, apo kur shitet në ankand të shitjes së paluajtmshëmive.

Me paragrafin 2 është përcaktuar se në qoftë se bashkëpronarët vlerësojnë se tjetërsimi te personi i tretë është i papranueshëm për të gjithë bashkëpronarët, atëherë sendi mund të shitet në ankand publik dhe të ardhurat do të ndahen bashkëpronarëve sipas pjesëve që i takon bashkëpronarëve. Ndërkaq, nëse bashkëpronarët nuk ia arrijnë që t'i zgjidhin kontestet e ndërsjella lidhur me bashkëpronësinë, pason shitja e atij objekti e pastaj bëhet ndarja e vlerës së objektit të shitur varësisht nga kontributi i pjesës alikuote.

2.7 Pronësia e përbashkët

Instituti i Pronësisë së përbashkët është institut qendror i të drejtës së pronësisë dhe rrjedhimisht i të drejtës reale që nënkupton të drejtën e pronësisë të disa personave në një send të pandarë, pjesët e të cilëve paraprakisht nuk janë të caktuara, por mund të përcaktohen. Kështu e definon neni 18 i Ligjit themelor i marrëdhënieve pronësore-juridike. *Ndërkaq në literaturën juridike pronësia e përbashkët përkufizohet si vijon "Pronësia e përbashkët është e drejtë pronësore e më shumë persona mbi një send, sipas pjesëve që nuk janë të caktuara as realisht, as idealisht, por janë të caktueshme"*

Normat të cilat e rregullojnë këtë në detale parashikohen në ligje tjera të së drejtës materiale. Kjo formë e pronësisë ekzistoni vetëm në rastet shprehimisht përcaktuara me ligj dhe e rregullohen me atoligje, varësisht nga materialet cilën e rregullojnë. Te prona e përbashkët, në rastet e përcaktuara me ligj, më shumë persona e kanë të drejtën e pronësisë në një send, ashtu që e drejta e pronësisë u takon të gjithëve atyre së bashku.

Pronarët e përbashkët administrojnë dhe disponojnë me sendin bashkërisht, me vendim unanim, nëse me ligj nuk është parashikuar ndryshe për rastet konkrete.

Pronari i përbashkët nuk e ka pjesën e vetë të veçantë. Ai është pronarë i tërë sendit i pakufizuar me të drejtën e pronësisë të pronarëve tjerë të përbashkët, nga kjo arsye edhe nuk mundet të disponoj me asnjë pjesë të pronës së përbashkët pa pëlqimin e pronarëve tjerë të përbashkët.

Për detyrimet eventuale të sendit të përbashkët pronarët e përbashkët përgjigjen solidarisht. Sikur te bashkëpronësia, pronari i përbashkët ka të drejtë të kërkoj ndarjen e pronës së përbashkët, e cila edhe bëhet në të njëjtën mënyrë.

Sipas të drejtës tonë, pronësia e përbashkët në bazë të ligjit ekziston në këto forma:

- a. Prona e përbashkët e anëtarëve të familjes;
- b. Pronësia e përbashkët bashkëshortëve dhe
- c. Pronësia e përbashkëte bashkëtrashëgimtarëve para ndarjes së trashëgimisë.

Titullarët e me pronën e përbashkët mund të disponojnë bashkërisht me to, derisa zgjasë gjendja e pronësisë së përbashkët. Pjesët nuk janë të caktuara as në pjesë ideale apo pjesë reale dhe kjo dallon nga bashkëpronësia në të cilën dihen pjesë ideale të bashkëpronarëve.

Pra LMBMPJ nuk rregullon në mënyrë detale pronësinë e përbashkët por ai parashikon paraqitjen e saj në raste të caktuara me ligj.

Ligji për pronësinë dhe drejtat tjera sendore në nenin 77 paragrafi 1 definon pronësinë e përbashkët "*Nëse disa persona kanë të drejtën e pronësisë mbi një send në atë mënyrë që pjesët e tyre nuk janë të caktuara por mund të caktohen ,atëherë ata janë pronarë të përbashkët”..*

Sipas paragrafi 2 "*Pronësia e përbashkët mund të krijohet me ligji ose përmes kontratës. Marrëveshja me të cilën krijohet pronësia e përbashkët mund të lidhet vetëm nëse shprehimisht është lejuar me ligj"*

Pronarët mundë të kërkojnë shitjen e pjeseshme të pronësisë së përbashkët ,por jo në kohë të papërshtatshme dhe në dëm të të tjerëve.

Pronarët e përbashkët disponojnë së bashku me pronësinë dhe përgjigjen së bashku për detyrimet në lidhje me këtë pronësi. Çdo gjë që nuk është parashikuar me këtë dispozitë ligjore atëherë vlejnë muitatismutandis dispozitat ligjore lidhur me bashkëpronësinë apo të drejtën e pronës në përgjithësi- neni 77 paragrafi 5. i ligjit

Pronësinë e përbashkët është çdo herë i lidhur me bashkësinë jetësore apo të punës në mes të shumë personave (bashkëshortët, ekonomitë familjare) Një përjashtim i pronësisë së përbashkët ku nuk nevojitet elementi i bashkësisë është pronësia e përbashkët e trashëgimtareve pas vdekjes së dekujusit në sendet e trashëgimisë.

Kolektivi qeveris dhe disponon me sendet bashkërisht me vendim të përbashkët. Mirëpo, ligji mund të rregullojë mënyrën tjetër të qeverisjes dhe të disponimit me sendet e përbashkëta. Këta mund të autorizojnë njërin prej tyre të qeveris me sendet e përbashkëta, për të gjitha këto duhet të ketë marrëveshje.

Anëtarët e kolektivit nuk kanë pjesë të veçanta në sendet e përbashkëta, por janë pronarë në tërë sendet të kufizuara me të drejtën e pronësisë anëtarëve tjerë. Pronari i përbashkët asnjë veprim nuk mund të ndërmar pa pëlqimin e anëtarëve të tjerë të bashkësisë. Për obligimet ne të njërit anëtar bashkësisë, në mënyrë solidare përgjigjet bashkësia.

Lidhur me shkëputjen e bashkësisë zbatohen në mënyrë analoge dispozitat mbi bashkëpronësinë. Anëtarët e bashkësisë mund të kërkojnë ndarjen e pronësisë në qoftë se me ligj nuk është rregulluar ndryshe.

Për mbrojtjen e pronësisë së përbashkët anëtarët e bashkësisë mund të paraqiten ndaj personave të tretë, ndërsa personat e tretë mund ta paraqesin padinë kundër të gjithë anëtarëve të kolektivit.

2.8 Pronësia e përbashkët e familjeve të mëdha

Paraqet një ndër format me interesante të pronësisë së përbashkët dhe kjo ka mbetur nga rregullimi fisnor dhe turko- feudal e cila përveç ekonomive familjare përfshinë edhe pronësinë e përbashkët në kullosat e fshatarëve, pyjeve, utrinave në favor të fshatarëve. Karakteristikë e përbashkët e tyre është rregullimi fisnor.

Në kohën kur marrëdhëniet ekonomike kanë qenë të pazhvilluara, individi ka mund të ekzistoj vetëm në bashkësi jetësore dhe të punës me të tjerët. Në këtë periudhë ekzistojnë vetëm në bashkësi jetësore dhe të punës me të tjerët. Në këtë periudhë bashkësia shtëpiake , gjegjësisht ekonomia familjare ka qenë celulë bazë dhe e mbrojtur e shoqërisë. Mirëpo më vonë kur është

kërkuar liria e individit këto ekonomi familjare humbin kuptimin e saj. Pas luftës së dytë botërore me ligje pozitive përmenden ekonomitë familjare. Ligji mbi reformën agrare dhe kolonizimin 1945, 1946 dhe 1948 parasheh që ekonomive ma të mëdha familjare mund të njihet e drejta e e pronësisë në maksimum prej 35 hektar tokës bujqësore e më vonë me Ligjin mbi tokën bujqësore kjo është zvogëluar në 15 hektar.

Në ekonominë familjare të gjithë anëtarët janë të lidhur me gjini gjaku dhe tërë pasuria i takon në tërësi bashkësisë. Këta nuk kanë subjektivitet juridik dhe nuk kanë cilësi personit juridik pasi subjektiviteti anëtarëve bashkësisë nuk ekziston. Individit jashtë bashkësisë nuk ka pronësi as subjektivitet. Madhësia e pjesës së anëtarëve të bashkësisë nuk dihet deri në ndarje. Nuk mundën anëtarët e disponojnë me asnjë pjesë që kanë në pronësi të bashkësisë. Me zhvillimin e shoqërisë është parë se nuk ka arsye që individit të kufizohet në qarkullimin juridik dhe të privohet nga subjektiviteti i tij dhe se me kalimin e kohës kjo formë e organizimit dhe pronësi është shuar.

E drejta zakonore si dhe Kanuni Lek Dukagjinit njih këtë formë të pronësisë. Kanuni përmendë tokën nga Kujrija dhe se askush këtë tokë nuk mund të shndërronte në arë, vresht, kopsht.

2.9 Pronësia e përbashkët e bashkëshortëve

Një prej formave më tipike të pronës përbashkët në drejtën tonë është pronësia e përbashkët bashkëshortëve. Pasurinë të cilën kanë krijuar bashkëshortët gjatë martesës është pronësia e tyre e përbashkët. Se sa është pjesa e secilit bashkëshort cakton gjykata në rast kontesti, varësisht prej kontributit secili bashkëshort duke vlerësuar të gjitha rrethanat e rastit.

Në rastin e caktimit pjesës secilit bashkëshort nuk merret vetëm fitimi bashkëshortëve, por ndihma njërit bashkëshortë bashkëshortit tjetër, udhëheqja në punët shtëpiake, mirëmbajtja e familjes ose çdo formë tjetër punës dhe bashkëpunimit në ruajtjen dhe rritjen e kësaj pasurie. Këtë në mënyrë ma detale rregullon Ligji mbi martesën dhe marrëdhëniet familjare të Kosovës nenet 327-331 dhe Ligji i ri mbi familjet e Kosovës që është në fuqi prej 16.01.2006 dhe atë nenet 45-58.

Me sendet në pronësi të përbashkët së bashku qeverisin bashkëshortët. Në qoftë se kemi të bëjmë me sendet e paluajtshme në librat katastrale regjistruhen në emër të dy bashkëshortëve në pjesë papërcaktuar.

Bashkëshortët mund të kërkojnë ndarjen e kësaj pasurie në çdo kohë dhe atë me marrëveshje apo nëpërmjet gjykatës dhe se pas ndarjes ata bëhen bashkëpronar. Në rast shitjes me së detyrueshme pjesës njërit bashkëshort, bashkëshortit tjetër ka përparësi të blerjes.

Një kohë statusi i pronësisë të bashkëshortëve është pranuar bashkëshortëve jashtëmartesor për pasurin e fituar gjatë bashkësisë jashtëmartesore. Praktika gjyqësore ka pranuar që bashkëshortit jashtëmartesor të kërkoj kompensim sipas rregullave pasurimit pa bazë për pasurinë e përbashkët të krijuar gjatë bashkësisë jashtëmartesore. Këtë njih edhe Ligji i Ri mbi martesën neni 58.

2.10 Pronësia e përbashkët bashkëtrashëgimtarëve mbi sendet e masës trashëgimore

Karakteristikë e kësaj forme pronësisë është ngase këtu nuk kërkohet bashkësia e jetës apo e punës, pra nga fillimi kjo bashkësi është orientuar në ndarje. Secili prej tyre e dinë sa është pjesa e tij në sendin e përbashkët dhe kjo formë ka karakteristikat bashkëpronësisë, meqenëse pjesa e

secilit dihet, anëtari i bashkësisë mund të tjetërsoj pjesën e tij, mund të tjetërsoj edhe personave tretë para ndarjes, personat e tretë kanë të drejtë që pas ndarjes fizike të kërkojnë pjesën e tyre.

Gjatë shitjes së sendit njërit trashëgimtar të tjerët kanë përparësi të blerjes. Këtë formë të pronësisë rregullon Ligji mbi trashëgimin (Kosovës 43/74) dhe Ligji i ri mbi trashëgiminë në fuqi.

2.11 E drejta e pronës në kate

Kjo formë e pronësisë ka qenë e rregulluar me Ligjin Federativ mbi pronësinë në pjesën e ndërtesave. E drejta e pronës në kate nënkupton të drejtën e pronës në banesë dhe në lokale afariste si pjesë të veçantë të ndërtesës (neni 19 i LBMJP). Pronësia në kate nënkupton të drejtën e pronësisë në pjesën fizike të ndërtesës, qoftë asaj banesore apo afariste.

Objekt i kësaj forme të pronës është banesa apo lokali afarist si pjesë e veçantë e ndërtesës, pjesët e përbashkëta të ndërtesës (korridoret, shkallët, etj) dhe toka në të cilën ndodhet ndërtesa. Nga kjo arsye edhe e drejta e pronës në kate është komplekse dhe në vete përmban:

1. Të drejtat dhe detyrimet nga pronësia në banesë, apo lokal afarist;
2. Të drejtat dhe detyrimet përkitazi me shfrytëzimin e pjesëve të përbashkëta të ndërtesës dhe
3. Të drejtat dhe detyrimet përkitazi me sipërfaqen e tokës ku ndodhet ndërtesa.

Titullarët e të drejtës së pronësisë në kate kanë të drejtën e pronës së përbashkët në pjesët e përbashkëta të ndërtesës, që shërbejnë për plotësimin e nevojave të përbashkëta të tyre, siç janë: muret, pullazi, korridoret, shkallët, kthinat për terjen e teshave, etj. Kryesorja këtu është e drejta e pronës në banesë apo lokal afarist, si pjesë e veçantë e ndërtesës. Të drejtat tjera sekondare përcjellin fatin e të drejtës kryesore. Nga kjo rrjedh se e drejta e pronës në banesë apo lokal afarist dhe të drejtat në pjesët e pandashme të ndërtesës nuk mund të ndahen.

Instituti i pronës etazhe apo pronësia në njësi të ndërtesës është rregulluar me një sërë dispozitash ligjore të LPDS(nenet 57-76 të ligjit).Për shkak aktualitetit si dhe çështjeve komplekse lidhur me këtë institut juridik kemi dhënë shpjegime dhe sqarime të thukëta të plota dhe të drejta. Praktika gjyqësore do të përballët dëndur me këto çështje juridike në të ardhmen. Kjo aq më tepër kur çështja e pronës në njësinë e ndërtesës për shkak të ndërtimeve pa plan gjeneral dhe detal urbanistik si dhe në të shumtën e rasteve pa leje ndërtimi do të ketë pasoja të paparashikueshme të dëmshme për titullarë e njësisë së ndërtesës dhe rrjedhimisht involivimit të gjyqësorit të Republikës së Kosovës në marrjen e vendimeve të drejta dhe të ligjshme.

Me këto dispozita ligjore parashikohet që pronësia e përbashkët ekziston në paluajtshmëri (toka) mbi të cilën është ndërtuar ndërtesa ,në pjesët që janë pjesë organike dhe instalimet si dhe pajisjet ,të cilat qëndrojnë në pronësi të veçantë ose në pronësi të një personin të tretë . Ndërkaq, pronësia e veçantë-etazhe është ajo pronësi në një pjesë të një ndërtese (njësi ndërtese) hapësirë (lokal) afariste ose një vend parkim garazhi së bashku me pjesën e bashkëpronësisë në paluajtshmëri në të cilën ndodhet pjesa e ndërtesës.

Pronësia e veçantë në njësi të ndërtesës krijohet vetëm kur banesat, hapësirat afariste vend parkimet në garazhe janë të kufizuara. Pjesa e bashkëpronësisë në paluajtshmëri nuk mund të ndahet nga pronësia e veçantë në njësitë ndërtesës.

Pronësia etazhe fitohet sipas rregullave të përgjithshme që vlejné për fitimin e së drejtës së pronësisë (me ndërtim, me blerje, me ndërtim me trashëgim etj.)

Titullari i njësisë së ndërtesës është i autorizuar t'i disponojë me pjesët e veçanta të ndërtesës si pronar i vetëm, dhe të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme lidhur me sendin e vet. Titullari i kësaj prone etazhe gëzon të drejtat mbi pjesët e përbashkëta të ndërtesës. Ndërkaq, mbi tokën në të cilën është ndërtuar ndërtesa, pronarët kanë të drejtën e përdorimit të përhershëm. Prona në njësinë e ndërtesës mund të jetë objekt i hipotekimit. Po kështu prona në njësinë e ndërtesës mund të regjistrohet në regjistrin e të drejtave të pronave të paluajtshme duke siguruar paraprakisht një skicë nga autoriteti i ndërtimit me të gjitha karakteristikat e asaj pjese të veçantë dhe se në atë pjesë ekzistojë kushtet për kufizim.

Marrëdhënia e ndërsjella juridike pronarëve të njësisë të ndërtesës përcaktohen me dispozitat dhe marrëveshjen e tyre dhe se marrëveshja nuk mund të jetë në kundërshtim me ligjin. Këto marrëveshje kanë efekt universal, por edhe ndaj pronarëve të njësisë së ndërtesës cilët nuk e kanë miratuar vendimin apo nuk ishin prezentë gjatë marrjes së vendimit.

Një pronar i një njësie të ndërtesës mund të kërkojë zgjidhjen e bashkëpronësisë vetëm atëherë, nëse ndërtesa është e shkatërruar krejtësisht apo pjesërisht, dhe nuk ekziston ndonjë detyrim për rindërtim.

Të drejtat e pronarit të një njësie të ndërtesës- Secili pronar i një njësie të ndërtesës mund të disponojë në kuadër të ligjeve sipas dëshirës me pjesët e ndërtesës të cilat janë në pronësi të veçantë dhe të tjerët t'i përjashtojë nga cenimi apo nga largimi i posedimit.

Detyrimet e pronarit të një njësie të ndërtesës - Secili pronar i një njësie të ndërtesës është i detyruar veçanërisht:

- që pjesën e ndërtesës që gjenden në pronësi të veçantë të mirëmbajë ashtu që pronësia e veçantë dhe pronësia e përbashkët të përdorët vetëm në atë mënyrë që asnjë pronar tjetër i një njësie të ndërtesës të mos pëson një dëm,
- të lejojë hyrjen dhe përdorimin e pjesëve të ndërtesës që gjenden në pronësi të veçantë, kur kjo është e nevojshme për mirëmbajtjen dhe riparimin e pronësisë së përbashkët,
- që të mban barrën e mirëmbajtjes së pronësisë së përbashkët si dhe shpenzimet e mirëmbajtjes së pronësisë së përbashkët sipas proporcionalitetit të pjesës së tij.

E drejta e përjashtimit-Ky institut i së drejtës së pronësisë është marr nga e drejta gjermane dhe ka efekt real-juridik dhe detyrimor juridik në vendosjen e rregullave dhe kritereve për shfrytëzimin e qet dhe të denjë të banesës përkatëse. Po ashtu, me këtë institut parandalohet prishja e rendit dhe qetësisë ndaj personave të papërgjegjshëm si dhe njëherit ndikohet madje në mënyrë preventive ndaj dukurive të tilla negative dhe asociale.

Pra, me nenin 68 të ligjit parashikohet kur pronari i një njësie të ndërtesës në mënyrë të përsëritur është fajtor për shkelje të rëndë të detyrimeve ndaj pronarëve të tjerë të njësisë të ndërtesës, në atë mënyrë që nuk mund të pritët edhe më tej vazhdimi i bashkësisë me atë, atëherë pronarët e tjerë të njësisë të ndërtesës kanë të drejtë të kërkojnë prej tij tjetërsimin e njësisë së tij të ndërtesës.

Për marrjen e këtij vendimi është i nevojshëm pëlqimi i mbi 50% të pronarëve. Nëse pronari i njësisë së ndërtesës nuk ka marrë pjesë në masat e domosdoshme për mirëmbajtjen e objektit, atëherë ato shpenzime proporcionale i minusohen shitësit, kur ai objekt shitet nga çmimi i shitjes. Në rast të bartjes së pronës në një njësi të ndërtesës, pronarëve të tjerë të një njësie në të njëjtën ndërtesë u takon e drejta e parablerjes.

Administrimi i rregullt-Administrimin e rregullt e rregullojnë me marrëveshje pronarët të ndërtesës me shumicë votash po qese nuk është rregulluar ndryshe me ligj. Ky administrim në interes të gjithë pronarëve të një njësie të ndërtesës përfshin:

1. mirëmbajtjen dhe riparimin e rregullt të pronësisë së përbashkët, lidhjen e kontratave,
2. sigurimet të nevojshme kundër zjarrit dhe të sigurimeve në zonën (territorin)e pronarëve të shtëpive dhe të paluajtshmërive, sigurimin e një sasi të parave të arsyeshme për mirëmbajtje,
3. kryerjen e të gjitha masave të nevojshme në veçanti për furnizim me ujë, për ujëra të zeza dhe energji, telefon dhe instalime të telekomunikacionit, përpilimin e një plani ekonomik, dhe
4. shpalljen e një rendi shtëpiak.

Administrimi i jashtëzakonshëm-mund të merret vetëm unanimisht nga pronarët e njërive të ndërtesës dhe vetëm atëherë kur duhet të bëhet rindërtimi i ndërtesës.

Caktimi, shkarkimi, të drejtat dhe detyrat e administratori-administratori caktohet për 5 vjet me mundësi vazhdimi nga pronarët e njërive të ndërtesës me shumicë votash.

Administratori ka të detyrë që të zbatojë vendimet e pronarëve të një njërive të ndërtesës, të përkujdeset për mirëmbajtjen pronësisë së përbashkët dhe të administrojë fondet financiare lidhur me administrimin e rregullt dhe të jashtëzakonshëm. Ai ka autorizim që t'i kryejë të veprimet juridike për çështjet gjyqësore.

Këshilli administrues -pronarët e njërive të ndërtesës me shumicë votash e formojnë një këshill administrues, duke caktuar kryetarin dhe zëvendësin. Këshilli administrues përkrah administratorin gjatë administrimit të njërive të ndërtesës duke kontrolluar implementimin e këtij plani

Kuvendi i pronarëve të njërive të ndërtesës- kuvendin e pronarëve të njërive të ndërtesës e konstituojn pronarët me marrëveshjes.

Kuvendin e thirr administratori së paku një herë në vit. Po kështu , ai konvokohet me kërkesën e një anëtar të këshillit administrues si dhe së paku nga një e katërta e pronarëve të njërive të ndërtesës. Për vendimmarrje të vlefshme është e domosdoshëm votimi unanim kur vendoset për investimet e jashtëzakonshme.

Zgjidhja e kontesteve nga gjykata-Gjykata vendos në bazë të kërkesës të një parashtruesi lidhur me të drejtat dhe detyrimet tëpronarëve të njërive të ndërtesës si dhe të drejtave dhe detyrimeve të administratorit gjatëadministrimit të pronësisë së përbashkët, apo caktimit të një administratori ose vlefshmërisë së vendimeve të kuvendit të pronarëve të ndërtesave.

2.12 Përmbledhje

Në këtë sesion janë dhënë shpjegime lidhur me bashkëpronësinë dhe për pronësinë e përbashkët dhe format e saja, dallimet në mesë të këtyre formave të pronësisë si dhe ndarja fizike e bashkëpronësinë dhe vërtetimin e kontributit të pronësia e përbashkët dhe pjesëtimi i saj .

3. Autorizime dhe kufizimet e drejtës së pronësisë

3.1 Hyrje

E drejta e pronësisë është e drejtë sendore që përmban në vehte autorizime ma të gjëra me rastin e shfrytëzimit dhe të disponimit me një send. E drejta e pronësisë për nga përmbajtja e saj titullarit garanton pushtetin ma të lartë mbi sendin. E drejta e pronësisë është e pakufizuar, përveç me ligj është e kufizuar si edhe për të mire të interesit publik, kur këtë shprehimisht parasheh ligji. Të drejta e pronësisë garantojnë ligjet, kushtetuta si dhe dokumentet ndërkombëtare. Me këto akte juridike parashihet mundësia e marrjes apo kufizimit të drejtës së pronësisë në interes të shtetit në kompensim me çmim të tregut.

3.2 Objektivat trajnuës

Pas përfundimit të këtij sesioni, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Njohin të drejtën e pronësisë me autorizimet që e ka e drejta e pronësisë;
- Identifikojnë kufizimet e përgjithshme dhe të veçanta të së drejtës së pronësisë;
- Njohin të drejtën fqinjësore dhe imisionet si rregullator për kufizimin e drejtës së pronësisë;
- Dallojnë të drejtën fqinjësore dhe servitutet sendore;
- Aplikojnë në praktikë rastet që kanë të bëjnë me autorizimet e drejtës së pronësisë dhe kufizimet e saja.

3.3 Kufizimet e drejtës së pronësisë

Janë:

Kufizimet e përgjithshme

Kufizimet e veçanta

Kufizimet e veçanta të drejtës së pronësisë

Në kufizimet e përgjithshme bëjnë pjesë : ndalimi mi keqpërdorimit të së drejtës së pronësisë, sepse nuk lejohet që të përdoret drejta e pronësisë në dëm të tjerëve e për këtë parashihet pronari si askush tjetër nuk mund të shërbehet me të drejtën e vetë, me të vetmin qëllim që tjetrit të shkaktoj dëm ose të pengojë. Kjo do të ishte si p.sh. kur dikush në oborrin e vet ndërton një mur mbi lartësinë normale dhe se pengon fqinunë në depërtimin e dritës natyrore. Pronësia duhet të jetë në funksion interesit të përgjithshëm.

Ushtrimin e autorizimeve nga e drejta e pronësisë duhet të bëhet në pajtim me ligjin. Vetë fakti se autorizimet pronësore duhet të ushtrohen në kuadër ligjit, del se pronari është kufizuar në realizimin e autorizimeve ligjore, pra e drejta e pronësisë nuk është absolutisht e pakufizuar.

Kufizimet e veçanta

Në kufizimet e veçanta bëjnë pjesë: Shpronësimi të pronës për interesat e përgjithshëm. Kjo bëhet me kompensim sipas çmimit të tregut (Të theksohen dispozitat e ligjit mbi shpronësimin)

Sipas nenit 46 par. 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton e drejta e pronësisë është garantuar në par 2 përcaktohet se e drejta e pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik në par.3 garantohet se askush nuk mund të privohet nga e drejta e pronësisë në mënyrë arbitrare. Shpronësimi mund të bëhet nëse është përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, por me sigurimin ekonomike apo për pronarin kompensimin adekuat. Të gjitha kontestet që lindin nga akti Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës do të zgjidhen nga gjykatat kompetente.

Neni 1 të protokolit 1 të Konventës Evropiane të të drejtave të njeriut garantohet se çdo person fizik ose juridik ka të drejtën që t'i respektohet pasuria e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveç nëse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara me ligj dhe parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë dispozitat e mëparshme nuk cenon të drejtat e shteteve për të nxjerr ligje që rregullojnë përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose kontributeve të tjera ose të gjobave (rasti GJEDNJ te Suedisë dhe Gjerman Zonja Strong).

Një ndër karakteristikat e të drejtës së pronësisë me rregullativën e mëhershme ligjore ka qenë kufizimi i drejtës së pronësisë në tokën bujqësore, në pyje, në objekte e banimit dhe afariste, kufizime për nevoja urbanistike etj.

3.4 Kufizimet e së drejtës së pronësisë nga e drejta fqinjësore

Me të drejtën fqinjësore nënkuptojmë normat e veçanta të cilat vlejné për raportet në mes të dy pronarëve të paluajtshmërive fqinje.

E drejta fqinjësore është rregullator për kufizimin e së drejtës së pronësisë, e drejta e pronësisë edhe pse është e drejtë absolute ajo prapë me disa raste i nënshtrohet kufizimeve të caktuara: kufizimet ligjore për pronësinë janë zvogëluar, prandaj lirisht mund të thuhet se në sistemin juridik me ekonomi të tregut, e drejta fqinjësore konsiderohet si kufizues kryesor ë të drejtës së pronësisë.

Gjendja e fqinjësisë bën të pamundur ushtrimin e autorizimeve të pushtetit prej njërit pronar, pa ndërhyre në autorizimet e pronarit tjetër. Ky lloj i kufizimit të pronësisë ekzistonte në të drejtën Romake, në Kodin Civil Austriak, Kodi i Përgjithshëm Pasurori Malit të Zi, Kodi Juridiko-sendor i Sllovenisë, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë nuk afron dispozitë për nocionin e të drejtës fqinjësore. Në këtë kod ekzistojné dispozitat për të drejtat fqinjësore lidhur me degët dhe rrënjët e drunjtëve që kalojnë mbi sipërfaqen respektivisht nëntokën e fqinjit, si dhe të drejtën mbi frutat e këtyre degëve (155), caktimi i shenjave në kufijtë e tokave dhe përcaktimin e kufijve në mes të tokave (157) largësinë mbjelljes shkurreve dhe drunjtëve që mbillen në mes të dy tokave fqinje (158) rrjedhën natyrore të ujit.

Për shkak të shmangies së përkufizimit të së drejtës fqinjësore në shumicën e kodeve civile, në teorinë juridike shumë vështirë të përcaktohet natyra juridike e të drejtës fqinjësore. Një dispozitë të përgjithshme hasim me Ligjin mbi marrëdhëniet themelore juridiko-pronësore në neni 5 alinea 1 thuhet:

“Pronari i pasurisë së paluajtshme ka për detyrë që, me rastin e shfrytëzimit të pasurisë së paluajtshme, të përmbahet nga veprimet dhe t'i mënjanojë shkaqet që rrjedhin nga pasuria e tij e paluajtshme, më të cilat vështirësohet shfrytëzimi i pasurive tjera të paluajtshme (përhapja e tymit, erërave të pakëndshme, ngrohtësisë dhe blözës, zhurmës, rrjedhës se ujërave reziduale, përtej masës që është e zakonshme duke marrë parasysh natyrën e destinimit të pasurisë së paluajtshme dhe rrethanat e vendit, ose me të cilat shkaktohet dëm i madh”

Të drejtat fqinjësore edhe pse e kanë bazën edhe në vet ligjin, ato nuk janë të njëjtat me servitutet sendore ligjore: e drejta fqinjësore ekziston në princip reciprociteti, kjo e drejtë nuk regjistrohet, pastaj kjo e drejtë nuk lidhet me afat, ndërsa servitute sendore ligjore janë të drejta sendore, regjistrohen në libra, ekzistojnë në favor të pasurisë që është dominuese, mund të jenë të përkohshme, parashkruhen me mos ushtrim dhe mungon reciprociteti me rastin e ushtrimit të servitutit sendor.

Në të shumtën e rasteve e drejta fqinjësore mbështetet në vendimin e gjykatës, vendim i cili ka karakter konstituiiv. E drejta fqinjësore nuk regjistrohet e librat publik.

3.5 Imisionet

Imisionet paraqiten po ashtu si një kufizues i të drejtës së pronësisë në rast kur ato duhet të durohen si një keqe pashmangshme. Në këtë rast bëhet fjalë për imisionet e lejuara (neni 5 LMTHMPJ). Imisionet mund të jenë të palejuara: p.sh. Lëshimi i gazit, tymit, ujërave të ndota etj.

Në praktik kemi tri lloje të imisioneve:

- a) Pozitiv
- b) Negativ
- c) Ideale

a) Rastet ma të shpeshta në praktik janë imisionet pozitive p.sh tymi, bloza, pluhuri depërtimi i lagështisë nga uji i tokës së fqijut, për shkak punës së ndërmarrjeve industriale, depërtimi i bletëve ose minjve nga toka e fqijut.

b) Imisionet negative kemi psh. të bëjnë marrjen e ajrit, dritës dhe me këto imisione zhvlerësohet paluetjshmëria e fqijut.

c) Imisionet ideale këto jo vetëm që ndikojnë paluejthmëria por edhe por edhe njerëz ekziston WC fqijut, zërimi tepërt nga fqiu .

Qëllimi i nenit 5 të LMTHMPJ është të mbroj pronarin e tokës nga ndikimet e ndryshme negative (imisionet) të cilët mund të dëmtojnë përdorimin e tokës të cilat në kohë të fundit janë paraqitë për shkak zhvillimit të shpejt të teknikës. Kjo që rregullon e drejta civile duhet të plotësohen me dispozitat të së drejtës publike për mbrojtjen ambientit.

3.6 Përmbledhje

Në këtë sesion është shpjeguar kuptimi i drejtës fqinjësore dhe imisionet në të drejtën krahasuese dhe në të drejtën tonë, karakteristikat dhe kufizimet nga e drejta fqinjësore dhe imisionet, dallimet në mes të drejtës fqinjësore dhe servituteve sendore, dhe llojet e imisioneve.

4. Mënyrat e fitimit të drejtës së pronësisë -Fitimi derivativ të drejtës së pronësisë

4.1 Hyrje

Pronësia është një e drejtë transferuese, për kalimin e saj nga një pronar në person tjetër është e domosdoshme që të vërtetohet një fakt juridik (një shkak juridik). Transferimi apo kalimi i pronësisë tek personat tjerë bëhet kryesisht me vullnetin e pronarit, si me kontratë shitjes, dhurimit. Por mund të bëhet edhe pa vullnetin e pronarit me pushtim, me shpronësim, me parashkrim fitues etj.

4.1 Objektivat trajnues

Pas përfundimit të këtij sesioni pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zgjerojnë njohurit lidhur me mënyrat e fitimit të drejtës së pronësisë;
- kuptojnë mënyrat e fitimit të drejtës së pronësisë..
- aplikojnë në praktikë rastet që kanë të bëjnë me mënyrat e fitimit të drejtës së pronësisë

4.2 Bazat e fitimit të drejtës së pronësisë

Bazat e fitimit të pronësisë rregullohen në disa raste me kushtetutë por rregull është se bazat e fitimit të pronësisë të rregullohen me ligj. E drejta e pronësisë fitohet ,në bazë të ligjit , në bazë të punës juridike dhe me trashëgimi si dhe në bazë të vendimit organit kompetent.

Ligji mbi pronësinë dhe drejtat tjera sendore nga neni 21 deri me nenin 25 rregullon mënyrat e fitimit të pronësisë në mënyrë derivative dhe origjinere në sendet të luajtshme në nenin 21 përcakton mënyrën derivative të fitimit të pronësisë në sendet e luajtshme ku kërkohet puna e vlefshme juridike (baza juridike) dhe dorëzimi i sendit.

Në nenin 28 deri me nenin 35 përcaktohen mënyrat e fitimit të pronësisë në sendet e luajtshme si është: parashkrimi fitues, bashkimi, përziëra, përpunimi, fitimit të pronësisë në sendet e paluajtshme papronar, gjetja e sendit, gjetja e thesarit, heqja dore nga pronësia.

Neni 36 LPDTS përcakton mënyrat e fitimit të pronësisë në mënyrë derivative në sendet e paluajtshme, kur kërkohet puna e vlefshme juridike (baza juridike) dhe regjistrimi i ndryshimit të pronësisë në paluajtshmeri. Kontrata në formën e me shkrim dhe legalizimi i nënshkrimeve të palëve kontraktuese. Prej nenit 40 deri me nenin 43 përcaktohen mënyra origjinere të fitimit të pronësisë në paluajtshmeri si është parashkrimi, parashkrimi, heqja dore nga paluajtshmeria.

Pronësia është pushtet faktik dhe juridik mbi sendin. Të fitosh pronësinë do të thotë të kesh faktet juridike të cilat e njeh drejta objektive si bazë pushtetit juridik të pronësisë.

4.4 Mënyra e fitimit të pronësisë

Faktet juridike që qojnë në lindjen e të drejtës së pronësisë quhen mënyrat e fitimit të pronësisë. Pronësia mund të fitohet në dy mënyra :

- Mënyra origjinere e fitimit të pronësisë
- Mënyra derivative e fitimit të pronësisë

- Fitimin origjiner kemi atëherë kur pronari të drejtën e vet pronësore nuk nxjerrë nga e drejta e paraardhësit por nga faktet tjera juridike
- Fitimi derivative i pronësisë kemi atëherë kur personi drejtën e vet pronësisë nxjerr nga e drejta e paraardhësit të tij juridik.

4.5 Kushtet për fitimin e drejtës së pronësisë

Për fitimin e pronësisë kërkohet të plotësohen disa kushte ku bëjnë pjesë: aftësia e secilit që të jetë objekti i pronësisë, zotësia fituesit për të qenë pronar mbi atë send dhe titulli juridik për fitimin e pronësisë.

4.6 Bartësit të drejtës së pronësisë

Bartësit të drejtës së pronësisë mund të jenë personat fizik dhe juridik. Bartësit të drejtës së pronësisë mund të jenë edhe personat juridik publik, këta janë personat e drejtës publike si që është shteti. Pozita juridike titullarëve të pronësisë është e njëjtë qofshin ato privat apo publik.

Në Kosovë parashihen kufizime për fitimin e pronësisë për personat fizik dhe juridik. Me ligjet e aplikueshme në Kosovë personat fizik dhe juridik mund të fitojnë drejtën e pronësisë në ndërtesë dhe tokë na bazë të trashëgimisë po që se ekziston reciprociteti. Disa shtete bëjnë kufizime për shtetasit të huaj.

4.7 Fitimi i pronësisë në mënyrë derivativ

Me fitim pronësie kuptojmë faktin juridik, me vërtetimin e të cilit një person fizik, juridik ose shteti i lind e drejta e pronësisë mbi një send të caktuar.

Faktet juridike që çojnë në lindjen e drejtës së pronësisë quhen mënyra të fitimit të pronësisë. LMTHPJ përcakton bazat e fitimit të pronësisë ku thotë se “ E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë veprimi juridik dhe me trashëgimi”.

E drejta e pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror me kushtet dhe mënyrën e caktuar me ligj. Tek fitimi derivateve titulli juridik është puna juridike, ndërsa mënyra e fitimit është regjistrimi në librat publike.

Në kuptimin e bartjes pronësisë themeli (baza) juridike është punë juridike me të cilin dëshirohet të bartet pronësia mbi një person tjetër. Baza juridike mund të jetë puna e njëanshme juridike p.sh. dispozitat e testamentit me të cilën bartet pronësia. Puna juridike mund të jetë dyanshme që ndryshe quhet kontrata. Puna juridike duhet të jetë e vlefshme juridikisht.

Përveç titullit juridik për fitimin e pronësisë kërkohet edhe mënyra e fitimit ose modus aquirendi. Te sendet e luajtshme dorëzimi i sendit është mënyra e fitimit të pronësisë. Për sendet e paluajtshme mënyra e fitimit është regjistrim në librat e tokës. Për të bartur pronësinë e një sendi duhet të jesh pronari i atij sendi.

Dorëzim fiktiv -Kur sendi fizikisht nuk dorëzohet por bartet pushteti fizik kemi edhe constitutum possessorium. Është rast kundër nga i mëparshëm. Në veçanti do të bëhet fjalë për bartjen e sendeve pa bartjen e pronësisë dhe themeli më i fortë me rastin e bartjes shumëfish të pronësisë

4.8 Modus Aquirendi për fitimin e pronësisë mbi paluajtshmëri

E drejta e pronësisë mbi paluajtshmërinë që bartet në punë të vlefshme juridike fitohet vetëm atëherë kur e drejta të regjistrohet në librat publik. Dorëzimi fizik nuk është i mjaftueshëm për bartje të pronësisë. Ligjet e aplikueshme shprehimisht kërkojnë që të bëhet regjistrimi në librat publikë.

Këtë parasheh LMTHPJ ,ne Kosovë për këtë çështje është aprovuar ligji i veçantë. Ligji nr. 2003/13 ndryshimet dhe plotësimet 2002/5 mbi themelimit të regjistrit të drejtave në pronën të palujtshme.

Në rastet kur fitimin e pronësisë kërkohet që regjistrim të bëhet në librat publik, kërkohet deklaratë e bartësit të së drejtës të pajtohet që fituesi të regjistroj të drejtën në librat publik. Kjo quhet clausolaintabulandi. Nëse nuk ekziston kjo deklaratë blerësi mund të kërkojë që gjykata të ta nxjerrë aktgjykimin, i cili e zëvendëson këtë deklaratë dhe në bazë të vendimit gjyqësor bëhet regjistrimi.

4.9 Përmbledhje

Në këtë sesion është shpjeguar kuptimi i drejtës fqinjësore dhe imisionet në të drejtën krahasuese dhe në të drejtën tonë, karakteristikat dhe kufizimet nga e drejta fqinjësore dhe imisionet, dallimet në mes të drejtës fqinjësore dhe servituteve sendore mbi llojet e imisioneve është trajtuar pronësia si e drejtë e transferueshme, ekzistimi i fakteve juridike për kalimin e drejtës së pronësisë tek personat tjerë - bazat e fitimit të pronësisë, pronësia si pushtet faktik dhe juridik, mënyrat e fitimit të pronësisë, bartësit e drejtës së pronësisë si dhe kufizimet për fitimin e drejtës së pronësisë.

5. Mënyra origjinere e fitimit të drejtës së pronësisë

5.1 Hyrje

Në këtë sesion do të jepen shpjegime lidhur me fitimin e pronësisë në mënyrë origjinere. Si fitohet e drejta e pronësisë në mënyrë origjinere dhe titulli juridik për fitimin e saj dhe mënyrat e fitimit të pronësisë në mënyrë origjinere. Në këtë mënyrë të pronësisë ekziston ndërprerja, kontinuiteti juridik në mes të drejtës së paraardhësit dhe pronarit të ri. Mënyrat e fitimit të pronësisë në mënyrë origjinere sipas LMTHPJ dhe PLDTS. Gjatë këtij sesi do të ndalemi te fitimi i pronësisë në bazë parashkrimit fitues dhe ndërtimit në tokën e huaj.

5.2 Objektivat trajnues

Pas këtij sesi do të jenë në gjendje që të:

- Zgjerojnë njohurit lidhur me mënyrat e fitimit të pronësisë në mënyrë origjinere dhe titulli juridik fitimit të pronësisë në mënyrë origjinere;
- Zbatojnë drejtë dispozitat ligjore që lidhen me mënyrat e fitimit të pronësisë në mënyrë origjinere sipas LTHMPJ dhe LPDTS;
- Identifikojnë kushtet e fitimit të pronësisë në bazë parashkrimi fitues;
- Njohin se si fitohet pronësia në ndërtimin në tokën e huaj.

5.3 Fitimi i pronësisë në mënyrë origjinere

Në dallim nga fitimi i pronësisë në mënyrë derivative ku bartja bëhet nga një titullar në titullarin tjetër te fitimi i pronësisë në mënyrë origjinere e drejta nuk nxirët nga paraardhësi juridik por në bazë ndonjë fakti tjetër juridik e kjo është ligji.

Titujt për fitimin e pronësisë në mënyrë origjinere në bazë LMTHPJ i parasheh neni 21, ku thuhet “ Sipas ligjit e drejta e pronësisë fitohet me krijimin e sendit të ri, me bashkim, me përzjerje, me ndërtimin në tokën e huaj, me ndarjen e fryteve, me parashkrim fitues, me fitimin e pronësisë nga jo pronari, me okupim dhe rastet tjera te caktuara nga ligji.”

Te kjo mënyrë e fitimit të pronësisë ekziston ndërprerja e kontinuitetit juridik në mes të drejtës paraardhësit dhe pronarit të ri. E drejta e pronësisë së fituar në mënyrë origjinere, nuk varet nga vëllimi i pronësisë të ish-pronarit. Pronari i ri fiton pronësinë pa kurrfarë ngarkese të cilat i ka pasur pronari i mëparshëm.

5.4 Parashkrimi fitues (Usucapio)

Fitimi i pronësisë në bazë parashkrimit fitues ndryshe quhet Usucapio. E drejta e pronësisë në bazë parashkrimit fitues, fitohet duke mbajtur sendin në posedim në kohë të caktuar.

Pushteti faktik (posedimi) e shëndron në pushtet juridik.

Për parashkrim fitues nevojiten tri kushte: posedimi, mirëbesimi dhe kalimi i kohës.

- Me LMTHPJ parasheh për sendet e luajtshme dhe të paluajtshme kërkohet kohë.

Me ndryshimet e LMTHPJ e drejta e pronësisë në parashkrim fitues mund të fitohet edhe në sende në pronësi shoqërore.

5.5 Ndërtimi në tokën e huaj

Duke rregulluar ndërtimin me tokën e huaj Ligji themelor mbi marrëdhëniet pronësore juridike, në rastet të cilat janë më të shpeshta në praktikë, dallon tri situata se për çdo njëren cakton rregullat dhe ato janë:

- a) situata e parë e cila është më e shpeshtë në jetën e përditshme, kur ndërtuesi ngrit objektin ndërtimor në tokën e huaj, si person i ndërgjegjshëm, i cili nuk ka ditur as që ka mundur të dinte se o ndërton në tokën e huaj dhe se pronari nuk ka kundërshtuar për ndërtimin edhe pse ka ditur (neni 24 par.1 LTHMPJ),
- b) situata e dytë përfshinë rastet e ndërtimit në tokën e huaj nga ndërtuesi i pandërgjegjshëm i cili ka ditur se ndërton në tokën e huaj, kur pronari i tokës ka kundërshtuar, ndërsa ndërtuesi ka vazhduar ndërtimin (neni 25 par. 1),
- c) situata e tretë përfshinë rastet për të cilat sipas rregullave të paraluftës nuk ka pasur dispozita, ka të bëjë me rastet kur ndërtuesi ka qenë i ndërgjegjshëm, pronari i tokës nuk ka ditur për ndërtimin, pra edhe ai ka qenë i ndërgjegjshëm dhe se objekti i ndërtuar vlen më tepër se toka (neni 26 LTHPJ).

Në nenin 24 të LTHMPJ shqyrton situatën kur ndërtuesi i objektit apo objektit tjetër ndërtimorë tokën e huaj, para kësaj nuk ka ditur as që ka mundur të dijë se ndërton në tokën e huaj, ndërsa pronari i tokës nuk ka kundërshtuar edhe pse ka ditur për ndërtimin. Këto situata pronari i tokës nuk mund të kërkojë që objekti të rrënohet pasi që kjo do të ishte në kundërshtim me parimin e ndershmërisë dhe ndërgjegjshmërisë.

Ligji në këto situata parashikon që ndërtuesi me mirëbesim fiton të drejtën e pronësisë në tokë në të cilën është ndërtuar objekti ndërtimor si dhe në tokë që është e domosdoshme për shfrytëzimin e rregullt të objektit. Në këto raste nuk ka mundur të zbatohet parimi Superficies Solo Cedit .

Pronari i tokës ka të drejtë të kërkojë vlerën e tokës me çmimet në momentin e marrjes së vendimit gjyqësor. Kjo kërkesë paraqitet në afatin subjektiv prej 3 ditësh nga data e marrjes në dijeni të përfundimit të objektit në afat objektiv prej 10 vitesh duke llogaritur nga momenti i përfundimit të objektit.

Në nenin 25 të LTHMPJ rregullon situatat të cilat lindin me ndërtimin në tokën e huaj, edhe nëse ndërtuesi vetë din nga fillimi i ndërtimit të objektit se atë e bënë në tokën e huaj, apo në fillim nuk dinë, mirëpo pronari i tokës menjëherë ka kundërshtuar ndërtimin, ndërsa ai ka vazhduar ndërtimin. Prandaj, në situata të tilla kur në njëren anë kemi ndërtuesin e pandërgjegjshëm e në anën tjetër pronarin e ndërgjegjshëm, kur ndërtuesi i pandërgjegjshëm me uzurpimin e tokës së huaj mundohet me ndërtimin e objektit dhe vlerën e saj të krijojë dilemën artificiale me të cilën nuk ka asnjë bazë juridike, se nuk ka arsye shoqërore që të rrënohet objekti i ndërtuar. Ligji në këto situata si dhe praktika gjyqësore ka marrë qëndrim që uzurpatori i tokës së huaj nuk mund të jetë pronari i tokës. Pronarit të tokës iu është dhënë mundësia që të zgjedhë tri mundësi:

Ai mund të kërkojë që t'i takojë e drejta e pronësisë në objektin ndërtimor apo ndërtuesi të rrënojë objektin e ndërtuar dhe tokën ta kthejë në gjendje të mëparshme, apo ndërtuesi të paguajë çmimin e vlerës së tokës

Të drejtën e zgjedhjes nga këto kërkesa të cilën e ka pronari i tokës ndaj ndërtuesit të pandërgjegjshëm mund ta realizojë në afat prej 3 ditësh nga dita e përfundimit të objektit ndërtimor. Pas kësaj pronari i tokës mund të kërkojë çmimin qarkullues të tokës. Në qoftë se pronari i tokës është orientuar për zgjidhjen që t'i takojë e drejta e pronësisë në objekt, është i obliguar që ndërtuesit t'ia kompensojë vlerën e objektit sipas lartësisë mesatare – vlerës së ndërtimit të objektit në vendin në momentin kur është marrë vendimi gjyqësor.

Te ndërtimi në tokën e huaj përveç solucioneve të paraqitura më lartë, janë situatat edhe në praktikë se ndërtuesi është i ndërgjegjshëm i cili nuk ka ditur se ndërton në tokën e huaj, si dhe pronari i tokës nuk ka ditur për ndërtimin për të kundërshtuar menjëherë ndërtimin. Në situatat e tilla në nenit 26 në fjalë janë paraqitur tri zgjidhje:

1. Kur objekti ndërtimor vlen më tepër se toka, atëherë objekti ndërtimor me tokën i takon ndërtuesit, ndërsa ai për tokën obligohet të kompensojë pronari çmimin qarkullues të tokës,

2. Në qoftë se toka vlen më tepër se objekti ndërtimor, gjykata objektin ndërtimor do ta caktojë pronarit të tokës dhe të obligojë që ndërtuesit t'ia kompensojë vlerën e objektit,

3. Në qoftë se vlera e objektit dhe tokës është përafërsisht e njëjtë, gjykata objektin ndërtimor, gjegjësisht objektin ndërtimor dhe tokën t'ia caktojë pronarit të tokës apo ndërtuesit duke marrë parasysh nevojat e tyre veçmas nevojave banesore.

Kur pronari i tokës për shkak të vlerës së madhe ka të drejtë të kërkojë që të takojë objektin ndërtimor dhe këtë kërkesë mund ta paraqesë në afat prej 3 ditësh ngaditë e përfundimit të objektit.

5.6 Përmbledhje

Në këtë sesion është trajtuar mënyra e fitimit të pronësisë në mënyrë derivative dhe fitimin e pronësisë në mënyrë origjinere, kushte për fitimin e pronësisë në mënyrë derivative, titulli juridik (baza) mënyra e bartjes dorëzimi i sendit, titulli juridik për fitimin e pronësisë në mënyrë origjinere, kushtet për fitimin e pronësisë në bazë të parashkrimit fitues dhe ndërtimit në tokën e huaj.

6. Mbrojtja gjyqësore e të drejtës së pronësisë

6.1 Hyrje

Në këtë sesion do të jepen shpjegime lidhur me mbrojtjen e pronësisë si drejtë subjektive karakterit absolute, mbrojtja e pronësisë në sistemet juridike dhe Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (KEDNJ) Protokolit 1.

6.2 Objektivat trajnues

Pas përfundimit të këtij sesioni pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Analizojnë rendësin e mbrojtjes së pronësisë;
- Dallojnë llojet e këtyre padive;
- Rëndësia e nenit 1 të Protokolit 1 të Konventës Evropiane mbi mbrojtjen e drejtave dhe lirive themelore të e njeriut;
- Aplikojnë drejtë infrastrukturën ligjore për këto padi;
- Zbatojnë drejtë praktikën gjyqësore për këto padi.

6.3 Rëndësia e mbrojtjes drejtës së pronësisë

E drejta pronësisë si e drejtë subjektive të karakterit absolute gëzon mbrojtje juridike. Për të afruar mbrojtje juridike drejtës së pronësisë nuk është interesuar vetëm individi por edhe vetë sistemi juridik (Ligjvënësi). Pronësia konsiderohet si drejtë e njeriut dhe gëzon mbrojtje me konventa ndërkombëtare.

6.4 Protokoli 1 Konventës Evropiane për mbrojtjen e lirive themelore dhe drejtave njeriut.

Protokoli 1 KEDNJ parasheh Çdo person fizik dhe juridik ka të drejtë shfrytëzimit të lirë ta pasurisë së vet. Askush nuk mund të zhvishet nga pasuria e vet, përveç për interes publik dhe në kushtet e parapara me ligj dhe me parimet e përgjithshme të të drejtës ndërkombëtare.

Nga kjo rezulton se e drejta e pronësisë si e drejtë absolute gëzon mbrojtje me Konventat ndërkombëtare. Karakteristik e Protokolit 1 KEDNJ se e përdor termin pasuri ku gjatë prezantimit do të diskutohet.

Pronësia gëzon mbrojtje me dispozitat e drejtës penale, drejtës civile dhe drejtës administrative .Mbrojtjen e pronësisë afron edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 14.

6.5 Llojet e padive

Sistemi i padive lind dhe formohet në një shkallë të caktuar të zhvillimit të marrëdhënieve ekonomike. Përmbajtja e këtyre padive bazën e ka në marrëdhëniet pronësore dhe shumica e tyre e njohin emërtimet që mbanin në drejtën romake.

Padi për mbrojtjen e pronësisë sipas ndarjes tradicionale janë:

Padia Reivindikimit (ActioReivindicatio)

Padia Publiciane (ActioPubliciana)

Padia negatore

Në praktik është edhe padia për vërtetimin e pronësisë, këto padi do të jenë objekti i shqyrtimit në prezantimi të veçantë.

6.6 Padia rei vindikimit (action reivindicatio)

Padia e rei vindikimit është padia e pronarit jo posedues kundër poseduesit jo pronar, duke kërkuar nga ky i fundit të dorëzojë sendin në posedim. Pronari duhet të provojë mbi sendin, kthimit e të cilit e kërkon, ka të drejtën e pronësisë dhe sendi i gjendet në posedim faktik të paditurit. Kjo më parë ka qenë e rregulluar me nenin 37 të Ligjit themelor mbi marrëdhëniet pronësore juridike, tani kjo rregullohet me nenin 93 Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore. E drejta e paraqitjes së kësaj padie nuk parashkruhet, me rastin e vendosjes në bazë të kësaj padie jo vetëm që kthehet sendi por vërtetohet edhe pronësia, aktgjykimi i tillë vepron edhe ndaj personave të tretë.

Pronari provon se pronësinë e ka fituar në mënyrë origjinare ose derivative. Nëse pronari ka fituar të drejtën e pronësisë në mënyrë origjinare ai duhet të provojë ekzistimin titullit juridik në bazë të cilës e ka fituar të drejtën e pronësisë p.sh. parashkrimi fitues.

Te fitimi derivative jo vetëm që provon pronësinë e tij por edhe paraardhësit të tij. Kjo mënyrë provimi quhet probatio diabolica (provimi djallëzor). Kjo mënyrë e të provuarit është shumë e vështirë aty ku nuk ekzistojnë librat tokësorë, si në Kosovë prandaj e drejta moderne ka heqë dorë nga kjo mënyrë e të provuarit.

Mund të rei vindikohet sendi individualisht caktuar sendet gjenerike nuk mund të jenë objekti i kësaj padie, paditur kundër padisë reivindiktive, mund të paraqesë dy lloje kundërshtimesh:

- permetore
- dilatore

Kundërshtimi permetor bëhet kur i padituri provon se ka fituar pronësinë pas paditësit me parashkrime fituese

Kundërshtimet dilatore janë:

- se i padituri e mban sendin në bazë ndonjë marrëdhënie detyrimi në mes të tij dhe paditësi ose personin e tretë (huapërdorja , qiraja etj)
- sendin e mban në cilësi uzufukti
- i padituri i cili humbë kontestin në bazë të padisë së reivindiktimit është i obliguar që të dorëzojë sendin paditësi
- paditësi njih shpenzimet e paditurit varësisht nga mirëbesimi.

6.7 Padia publiciane (actio publiciana)

Actio publiciana është padi për kthimin e sendit të cilin e paraqet poseduesi uzukapient i mëparshëm, kundër poseduesit aktual (të tanishëm).

Me këtë padi, poseduesi i kualifikuar kërkon sendin nga poseduesi i cili ndodhet sendi pa bazë juridike ose me bazë më të dobët juridike. Pra me këtë padi provohet baza më e fortë e pronësisë.

Kjo padi nuk kërkon provimin e pronësisë por të posedimit., këtë padi parasheh neni 41 i LMTHPJ dhe e drejta e paraqitjes së kësaj padie nuk parashkruhet.

Te padia actio publicana paditësi është poseduesi i kualifikuar i cili pretendon se ka pronësinë dhe se është zhveshur nga posedimi i sendit.

Dallimi në mes të padisë reivindikimit dhe actio publicana qëndron në atë se padia A.R paditësi duhet të provojë patjetër pronësinë ndërsa tek A.P paditësi thirret në posedimin e vet mjaftueshëm për parashkrim fitues. I padituri mund të bëjë prapësim duke provuar titullin më të fortë juridik. Nëse paditësi dhe i padituri kanë titujt në mënyrë njëjtë pronësia i takon atij që ka posedimin e sendit në momentin kur vendoset për këtë çështje

6.8 Përmbledhje

Në këtë sesion është prezantuar çështja e mbrojtjes së pronësisë në këto dy padi: legjitimitet për të ngritur këtë padi, provuarit e pronësisë dhe prapësimet padituri. Dallimet në mes të këtyre padive po ashtu është trajtuar çështja e mbrojtjes së pronësisë mbrojtjen e pronësisë si drejtë subjektive të karakterit absolut, sisteme juridike që afrojnë mbrojtje pronësisë, theks të veçantë është dhënë Protokolit 1 KEDNJ.

7. Padia negatore edhe mbrojtja e posedimit

7.1 Hyrje

Padia negatore është një prej padive tradicionale për mbrojtjen e së drejtës pronësisë, ku titullari i drejtës së pronësisë kërkon mbrojtje ndaj shqetësimeve që bëhen nga personat tjerë ndaj pronarit, legjitimitetin për ngritjen e kësaj padie ka pronari i sendit. Ndërsa me padi për mbrojtje nga pengim posedimi, poseduesi kërkon mbrojtje nga akti i pengimit dhe të drejtën për ngritjen e kësaj padie ka poseduesi fundit faktit i sendit.

7.2. Objektivat trajnues

Pas përfundimit të këtij sesi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Njohin specifikat e kësaj padie;
- Dallojnë padinë negatore me paditë tjera;
- Bëjnë dallimin në mes të padisë negatore dhe pengim posedimin;
- Zgjerojnë njohurit lidhure me padinë negatorë dhe kundërshtimet e palëve në padinë negatorë;
- Bëjnë dallim në mes të drejtës së posedimit dhe posedimit;
- Vlerësojnë kushtet për mbrojtjen nga akti pengim posedimi;
- Analizojnë specifikat e kontesteve nga pengim posedimi;
- Marrin njohuri nga praktika gjyqësore lidhur me këto konteste.

7.3 Padia negatore – Actio negatoria

Me padinë mohuese (negatore) pronari –poseduesi kërkon mbrojtje ndaj shqetësimeve që nuk kanë të bëjnë me marrjen e sendit. Padia negatore është padi për mbrojtjen e pronësisë. Të kjo padi pronari nuk zhvishet nga pushteti faktik i sendit, ai sendin e ka në posedim. Këtë padi mund të paraqet pronari i sendit e jo poseduesi i sendit p.sh shfrytëzuesi i banesës.

Veprimet e personave të tretë ndaj pronarit të sendit është të fitojnë ndonjë të drejtë në sendin ose pengojnë, kufizojnë pronarin e sendit në ushtrimin e drejtës së pronësisë. Shqetësimet duhet të drejtohen kundër autorizimeve (tagrave) të pronarit të sendit. Shqetësimi mund të bëhet në hapësirë ajrore, tokësore dhe nëntokësore të paluejtshmërisë, duke cenuar shfrytëzimin e lirë të hapësirës.

Padinë negatorë e përcakton dispozita e nenit 42 LMTHMPJ “nëse personi i tretë pa bazë trazon pronarin ose pronarin e supozuar në mënyrë tjetër e jo me marrjen e sendit.

Pronari gjegjësisht pronari i supozuar mund të kërkojë padi që kjo të pushoj. LPDTS i Kosovës me dispozitën e nenit 102 parasheh kërkesën për largimin e ose marrjes së sendit ,pronari mund të kërkojë ndërprerjen e mëtejme të cenimit. Nëse priten cenime të mëtejme pronari mund të ngritë padinë për cenimet e tilla LPDTS shprehimisht e njeh padinë negatorë dhe kjo padi nuk parashkruhet

Në paragrafin 2 të nenit 42 thuhet “se në qoftë se me trazim është shkaktuar dëmi, pronari ka të drejtë të kërkojë kompensimin e dëmit sipas rregullave të përgjithshme të kompensimit të dëmit”.

E drejta e paraqitjes së kësaj padie nuk parashkruhet. Padia negatore e mbron pronarin nga diçka që është në kontinuitet ose mund përsëritet.

Qëllimi i kësaj padie është ndërprerja dhe ndalesa e pengimit, kërkohet kthimi në gjendje të mëparshme, ndalimi i shqetësimit të ardhshëm. Padia negatore nuk do të ketë sukses në rastin e imisioneve.

7.4 Kuptimi i posedimit

Posedimi dhe pronësia dallohen, posedimi është pushteti faktik mbi sendin, pronësia është pushteti juridik mbi sendin. Se një person është pronar në shikim të parë mund të konstatohet, ndërsa si posedues i një sendi menjëherë mund të vërehet sepse këtu kërkohet pushteti faktik mbi sendin. Në të Drejtën Romake është bërë dallimi në mes të pronësisë dhe posedimit, sipas Drejtës Romake ka qenë e domosdoshme të plotësohen dy kushte: pushteti faktik mbi sendin apo Corpuspossessiones dhe vullneti që sendin të mbaj poseduesi si pronari i sendit. Të gjitha Kodet civile bëjnë dallimet në mes të posedimit dhe pronësisë.

Posedimi sipas Ligjit themelor mbi marrëdhëniet pronësore juridike dhe Ligjit për pronësinë dhe të drejta tjera sendore

LMTHMPJ – niset nga koncepti objekti i posedimit dhe bën dallime në mes të posedimit pa ndërmjetshëm dhe ndërmjetshëm (neni 70 al 2). Te posedimi pa ndërmjetshëm prezumimi është që poseduesi përveç raportit hapësinor me sendin në kohë të caktuar ka ndikim direkt në te dhe në te ka vullnetin faktik të kontrolloj sendin. Poseduesi ndërmjetshëm pushtetin faktik mbi sendin e ka nëpërmjet tjetrit (kontrata mbi shfrytëzimin e banesës, huapërdorja).

LMTHMPJ bënë dallime në mes të posedimit të sendit dhe të drejtës, jo të gjitha drejtave por vetëm drejtën e servitutit sendor (Al 3 neni 70 të ligjit)LMTHMPJ në nenin 70 al.3 niset nga mundësia që disa persona të kenë posedimin e sendit dhe drejtës (bashkë poseduesit).LPDTS

Ligjit për pronësinë dhe të drejta tjera sendore kur bën përkufizimin e posedimit parasheh subjekti i posedimit mund të jetë sendi dhe nuk parasheh që edhe e drejta të jetë objekti i posedimit, por sipas LPDTS objekti i posedimit mund të jetë edhe e drejta jotrupore që ka cilësinë e të drejtës sendore të kufizuar. Sendet në përdorim të përgjithshëm nuk mund të jenë objekti e posedimit p.sh rrugët publike parqet etj. Pasurit publike nuk mund të jenë në posedim derisa për nga natyra e tyre janë përjashtuara nga qarkullimi civilo- juridik, Ndërsa pasurit publike që për nga natyra mund të jenë qarkullim civilo-juridik dhe gjenden nën regjimin të veçantë administrativ –juridik është e mundshëm posedimi në p.sh librat në bibliotekën publike, sendet në muzeume.

7.5 Mbrojtja e posedimit

Poseduesi i sendit nën kushtet e caktuara gëzon mbrojtje juridike nga akti i pengim posedimit. Qëllimi i mbrojtjes së posedimit është që poseduesit ti ofroj mbrojtje juridike kundër personave të cilët marrin posedimin e tij apo pengojnë në ushtrimin e posedimit.

Kushtet për mbrojtje nga pengim posedimi janë:

- Ekzistimi i posedimit (ku nuk ka posedim nuk ka as pengim posedimi)

- Marrja ose shqetësimi i posedimit.

Padinë për pengim posedimin e rregullon neni 79 LMTHMPJ ku përcakton: “Me vendimin mbi kërkesën për pengim posedimin caktohet ndalesa i pengimit të mëtejme posedimit me kërcënim dënimit me të holla, gjegjësisht kthimi i posedimit të marrë dhe masat tjera nga akti pengimit të mëtejme. ”LPDTS parasheh padinë kundër pengimi posedimit lejon parashtrimin e kërkesës nëse poseduesi pengohet në posedimin në mënyrë të kundër ligjshme, atëherë poseduesi mund të kërkoj nga penguesi mënjanimin e pengesave dhe nëse priten pengime në të ardhmen poseduesi mund të kërkoj mbrojtje gjyqësore për pengim posedim që dallohet nga padia për kthimin e sendit në posedim e cila mund të kërkohet me padi për kthimin e sendit në posedim.

Procedura për pengim posedimin ka për qëllim të vendos gjendjen e fundit faktike të posedimit. Kufiri në mes të pengim posedimit dhe marrjes së posedimit është shumë elastik dhe duhet të kemi kujdes. Në këto konteste gjykata afron mbrojtje sipas gjendjes së fundit faktike të posedimit pa u lëshuar në të drejtën e posedimit dhe drejtën e shpërblimit të demit.

Në çoftë se pengimi është evituar para përfundimit të shqyrtimit është lejuar kërkesëpapia pa kthim në gjendje të mëparshme nëse paditësi ka interes për vërtetimin e pengimit nga frika që kjo mos të përsëritet.

Padia për pengim posedimin duhet të ngritet në afat prej 30 ditësh nga dita e kuptimit të pengimit dhe kryesin më së voni në afat pre 1 viti nga dita e shkaktimit të pengimit posedimit (neni 77 LMTHMPJ). Afati është prekluziv dhe pas afatit padia hudhet poshtë si pas afatshme. LPDTS afatin për paraqitjen e padisë për pengim posedim prashen në nenin 114 që është 30 ditë, pasi që poseduesi merr për djeni lidhur me privimin nga posedimi.

Vendimi i gjykatës në këto konteste merret në formë aktvendimi.

Elementi qenësor i pjesës së kërkesëpadiisë është urdhëresa për kthim në gjendje mëparshme.

Pjesë e tjetër e kërkesëpadiisë është ndalimi i pengimit të mëtejme

Gjatë procedurës në konteste nga pengim posedimi gjykata mund mere masa përkohshme sipas rregullave të procedurës së përmbartimit.

7.6 Përmbledhje

Në këtë sesion është prezantuar padia negatore (mohuese) e cila është një prej padive pronësore, dallimet në mesë të padisë negatore dhe padive tjera pronësore dhe me padinë e pengim posedimit. Është prezantuar edhe çështja e posedimit, kuptimit të posedimit dhe dallimin në mes të posedimit dhe pronësisë, mbrojtja nga akti i pengimi posedimit sipas LMTHMPJ dhe LPDTS si dhe karakteristikat e këtyre kontesteve.

8. Të drejtat sendore në sendet e huaja, vërtetimi, konstituimi dhe ndërprerja e servituteve sendore, dhe mbrojtja e servituteve sendore

8.1 Hyrje

Në të gjitha sistemet juridike domosdo paraqitet nevoja e ekzistimit të të drejtave subjektive sendore mbi sendin e vetë dhe mbi sendin e huaj. E drejta mbi sendin e vetë është e drejta e pronësisë. Përkundër faktit se ekziston e drejta mbi sendin e vetë, kemi dhe të drejtat subjektive sendore mbi sendin e huaj. Kjo ekziston atëherë kur titullari shfrytëzon për nevojat e sendit të tij sendin e huaj. Në të drejtën tonë pozitive si të drejtat sendore mbi sendin e huaj janë e drejta e servitutit, e drejta e pengut, dhe barat reale.

Të drejtat sendore, përfshirë edhe të drejtën e servitutit mund të shuhen njësoj si edhe fitohen. Servitutet, si të drejta sendore, gëzojnë mbrojtje juridike dhe legjislacioni pozitiv parasheh mënyrën e mbrojtjes së servituteve. Përmes këtyre moduleve qëllimi është që pjesëmarrësve në këtë trajnim të mundësohen njohuri teorike dhe nga praktika gjyqësore për mënyrat e humbjes së servituteve sendore dhe mbrojtjen e tyre. Këtu veçmas duke marrë parasysh problemet që hasen në punën e gjyqtarëve në praktikë. Do të bëhet fjalë mbi mënyrat e humbjes së pronësisë sipas ligjit themelor mbi marrëdhëniet pronësore juridike. Si humbet pronësia sipas ligjit në fjalë? Cilat janë mënyrat e humbjes së pronësisë?

8.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij sesioni, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Përfitojnë njohuri të reja lidhur me rregullativën ligjore dhe praktikën gjyqësore lidhur me humbjen e servituteve dhe mbrojtjen e tyre;
- Njohin mënyrat e humbjes së servituteve sendore;
- Përfitojnë njohuri teorike dhe praktike lidhur me humbjen e servituteve sendore dhe mbrojtjen e tyre;
- Bëjnë dallime në mes të padive posesore dhe petitore të mbrojtja e servituteve sendore;
- Dallojnë çështjet që kanë të bëjnë me vërtetimin e ekzistimit të servitutit sendor dhe konstituimin e saj.

8.3 Të drejtat sendore në sendet e huaja

E drejta e servitutit është e drejtë mbi sendin e huaj e cila titullarit të vetë i mundëson që ta shfrytëzoj sendin e tjetrit ose të kërkoj që pronari i sendit të kufizohet në shfrytëzimin e të drejtës së vetë, në interes të titullarit të drejtës së servitutit. Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore i Kosovës, shprehimisht institutin e servituteve e rregullon në nenet 252 -254, ku bën fjalë për servitutet sendore dhe personale, ndërsa uzufruktin e trajton në mënyrë të veçantë në nenet 218-249. Servitutet sendore krijohen në favor të sendit të paluajtshëm, ndërsa servitutet personale në favor të personit.

8.4 Servitutet sendore

Është e drejtë e një pronarit të një paluajtshmërie (prona sunduese) që për nevojat e kësaj paluajtshmërie të kryej veprime të caktuara në paluajtshmërinë e një pronarit tjetër (prona

shërbyese), ose të kërkoj nga pronari i pasurisë shërbyese që të përmbahet nga veprimet e caktuara, përndryshe do të kishte të drejtë të kryente në pasurinë e vetë të paluajtshme.

8.5 Servitutet personale

Është e drejtë e një personi në favor të cilit është ngarkuar një paluajtshmëri që të përdor në mënyrë të caktuar ose të ndalojë ushtrimin e veprimeve të caktuara apo të përjashton ushtrimin e një të drejte e cila rrjedh nga pronësia e paluajtshme. Servitutet personale nuk mund të barten dhe nuk mund të trashëgohen. Servitutet personale paraqesin rregullator për kufizimin e drejtës së pronësisë dhe veprojnë ndaj personave të tretë.

8.6 Parimet e servituteve

Parimet e servituteve duhet të jenë të përbashkëta për servitutet sendore dhe personale. Parime të e servituteve janë:

- servitutit është e drejtë sendore,
- është e drejtë në sendin e huaj,
- servituti nuk mund të jetë në bërje,
- servituti duhet të jetë i dobishëm ,
- parimi i restriksionit të drejtës së servitutit,
- ushtrimi i servitutit duhet të bëhet me kujdes ,
- servituti në vetë servitut nuk mund të ekzistoj,
- servitutet janë të patjetërsueshme ,
- servitutet janë të papjesëtueshme ,
- servituti nuk mund të ekzistoj në pjesët alikuote të bashkëpronësisë.

8.7 Llojet e servituteve

Servitutet kryesisht ndahen :

- a) Servitutet sendore dhe
- b) Servitutet personale.

Kjo ndarje bëhet në bazë të kriterit nëse servituti është krijuar në dobi të një paluajtshmërie apo në dobi të personit të caktuar.

Servitutet sendore nuk nënshtrohen parimit të numërimit taksativ, pasi vazhdimisht krijohen servitutet të reja.

Servitutet sendore ndahen në:

- Servitutet tokësore dhe
- Servitutet shtëpiake .

Servitutet personale tradicionalisht ndahen në:

:

- Uzufactus(frytgëzimi),
- Usus (përdorimi) dhe
- Habitatio (banimi).

8.8 Servitutet tokësore

Servituti tokësore është një e drejtë sendore në sendin e huaj e cila krijohet në dobi të pronarit aktual të tokës dominante, duke ngarkuar pronarin aktual të tokës shërbyese me qëllim të shfrytëzimit sa ma të mirë ekonomik si dhe shtimit të tokës dominante. Numri i këtyre servituteve nuk është caktuar në mënyrë taksative. Ndërsa servitutet ma të shpeshta tokësore numërohen :

- servituti i rrugës,
- servituti i nxjerrjes së ujit,
- servituti i kullotjes së kafshëve ,
- servituti i nxjerrjes së rërës
- servituti i prerjes së druve.

Servituti i rrugës mund të jetë, kalimit në këmbë, me mjete, servituti i ndjekjes së kafshëve, kullotja e bagëtisë. LPDTS nuk rregullon të drejtën e kalimit të domosdoshëm te servitutet, por kjo rregullohet te e drejta fqinjësore,te kalimi i domosdoshëm duhet të plotësohen këto kushte:

- të mos ketë dalje në rrugën publike,
- fitimi të jetë më e madh se dëmi që shkaktohet të pasuria shërbyese,
- gjithmonë duhet të paguhet kompensimi.

8.9 Servitutet shtëpiake

LPDTS nuk përmban dispozita për servitutet shtëpiake dhe së këto për nga numri janë të pakufizuara. Kodi civil i Republikës së Shqipërisë trajton në mënyrë të veçantë servitutet shtëpiake, por parasheh servitutet që rrjedhin nga ndërtimi i ndërtesave në distancë, marrja e dritës së pamjes, nxjerrja e ballkoneve.

Servitutet shtëpiake janë:

- servituti i mbështetjes së shtëpisë në murrin e huaj,
- hapja e dritareve në murin e huaj,
- e drejta e kalimit të tymit apo gazrave në oxhakun e huaj,
- detyrimin që shtëpinë të mos ndërtoj në lartësi.

Servitutet sipas përmbajtjes së tyre ndahen:

- Servitutet pozitive dhe
- Servitutet negative

Ndarja tjetër e servituteve është :

- servitutet e dukshme

- servitutet e padukshme ,
- servitutet kontiunele –vijuese ,
- servitutet jokontiunele –jovijuese

E drejta e servituteve shuhet në disa mënyra. LMTHMPJ shprehimisht parasheh rastet kur shuhet e drejta servituteve sendore (neni58).Neni 260 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore.

8.10 Shuarje e servituteve

Disa prej mënyrave më të rëndësishme të shuarjes së servituteve sendore janë:

1. Shuarja e servituteve sendore kur pronari i pronës shërbyese kundërshton ushtrimin e tij, kurse pronari i pronës shërbyese 3 vjet me resht nuk ka ushtruar të drejtën e tij (neni 58 al.1).
2. Servitutet sendore shuhet po që se nuk ushtrohen një kohë gjatë kohës së nevojshme për fitimin e tij me anë të parashkrimit fitues. Mos ushtrimi i drejtës servitutit sendor në afat prej 20 vitesh ka efekt lirues për titullarin e të mirës shërbyese e cila për shkak mos ushtrimit lirohet nga ngarkesa e pronës së tij (neni 58 al 3)
3. Shuarje servituteve sendore mund të kërkoj pronari i pronës shërbyese kur ai bëhet për shfrytëzimin e pronës sunduese të cilit është vendosur(neni 58 al 2)
4. Me shkatërrimin e pronës shërbyese dhe dominuese Neni 58Al 3)
5. Nëse është kontraktuar në kohë të caktuar me kalimin e kohës .
6. Me heqjen dorë titullarit ndaj pronës dominues.
7. Nëse i njëjti person fiton të drejtën e pronësisë ne pronën shërbyese dhe dominuese (neni 58 al 3)

Shuarja e servituteve sendore i nënshtrohet rregullave të shuarjes së drejtës së pronësisë.

8.11 Mbrojtja servituteve

Servitutet si të drejta sendore gëzojnë mbrojtje juridike, edhe legjislacioni pozitiv parashikon mënyrën e mbrojtjes së servituteve. Për mbrojtjen e të drejtës së servituteve sendore ekzistojnë paditë me emrin padia konfessore (Actio confesoria) dhe padia petitore.

Mbrojtja posesore e drejtës së servituteve është e mundur pasi që në të drejtën tonë është e mundur posedimi i drejtës së servitutit si formë e posedimit(neni 70 al3 LMTHMPJ). LPDTSbi Kosovës , shprehimisht rregullon mbrojtjen e servitutit sendor me një dispozitë të përgjithshme në neni 102.

Për paditë posesore nuk do të përqendrohemi, por do të përqendrohemi me paditë petitore. Për mbrojtjen petitore të servituteve sendore parashihet mundësia e ngritjes e këtyre padive:

1. Pronari pronës dominues mund të kërkoj që ndaj pronarit të pronës shërbyese të vërtetohet ekzistimi servitutit real (neni56 al.1), kjo në situata kur pronari i pronës konteston ekzistimin e servitutit real.

2. Forma e dytë e padisë petititore është kur pronari i pronës dominuese pengohet në ushtrimin e drejtës së servitutit. Me këtë padi pronari i pronës dominuese kërkon që pengimi të ndërprehet. Pronari i pronës dominues duhet me këtë padi të provojë drejtën e servitutit të tij (si te padia reivindikimit).

I padituri mund të jetë pronari i pronës shërbyese si çdo person tjetër që pengon ushtrimin e servitutit sendor. Nëse e drejta e servitutit nuk pengohet por vetëm kontestohet me padi mund të kërkohet vërtetimi i ekzistimit servitutit. Nëse pengohet, kërkon ndërprerjen e pengimit.

8.12 Përmbledhje

Me këtë sesion kemi diskutuar për servitute llojet e tyre dhe mbrojtja e drejtës së servituteve si dhe dilemat që paraqiten në praktikën gjyqësore lidhur me mbrojtjen e servituteve.

9. Humbja drejtës së pronësisë

9.2 Hyrje

Në këtë sesioni do të bëhet fjalë mbi mënyrat e humbjes së pronësisë sipas ligjit themelor mbi marrëdhëniet pronësorë juridike, si humbet pronësia sipas ligjit në fjalë dhe cilat janë mënyrat e humbjes së pronësisë.

9.3 Objektivat trajnues

Pas përfundimit të këtij sesioni, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zgjerojnë njohurit lidhur me mënyrat e humbjes së pronësisë;
- Zbatojnë drejtë infrastrukturën ligjore lidhur me humbjen e pronësisë.

9.3 Humbja e pronësisë (shuarja)

Fitimin e drejtës së pronësisë, si dhe humbjen ka rregulluar dispozita e nenit 7 LMTHMPJ, ky ligj ka paraparë katër mënyra themelore për humbjen e pronësisë e këto janë:

1. Humbja e drejtës së pronësisë me kalimin e sendit në pronësi shoqërore (neni 44).
 2. E drejta e pronësisë personit të caktuar humb kur personi tjetër fiton drejtën e pronësisë mbi atë send (neni 45)
 3. E drejta e pronësisë humbet me braktisjen e sendit (Neni 46)
 4. E drejta e pronësisë humbet me shkatërrimin e sendit (neni 47)
-
1. Humbja e drejtës së pronësisë me kalimin e sendit në pronësi shoqërore si mënyrë e humbjes së pronësisë, mund të lind (krijohet) me ligj (nacionalizimi, braktisjen e sendit, lënda e trashëgimisë pa trashëgimtar, gjetja e sendit të humbur pronari i të cilit nuk është paraqitur 1 (një) vit, në bazë të vendimit të organit shtetëror, konfiskimi, eksproprijimi, marrjen e paluejtshmërisë mbi maksimumin e lejuar si edhe mënyrat e tjera të përcaktuara me ligj dhe në bazë të punës së dyanshme juridike (Kontrata e shitblerjes, ndërrimit, dhuratës) punës njëanshme juridike (testamentit).
 2. E drejta e pronësisë, kur personi i caktuar ka sendin, humb kur personi tjetër fiton të drejtën e pronësisë në atë send.

Personi tjetër mund të fitoj të drejtën e pronësisë në bazë të ligjit (parashkrimin, bashkimi i sendeve) vendimit të organit shtetëror (kur caktohet kompensimi për tokën e eksproprijuar ose për tokën e aronduar jepet toka tjetër) në bazë të punës juridike (Kontrata e shitblerjes, dhurata, nderimi) dhe trashëgimi.

Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, nuk përmban dispozita konkrete për shuarjen e pronësisë por përmban dispozita kur bën fjalë për shuarjen e bashkëpronësisë, pronësisë së përbashkët .

3. E drejta e pronësisë humbet me braktisjen e sendit, për këtë mënyrë të humbjes së pronësisë ligji parasheh dy kushte :
- a) se pronari në mënyrë të padyshimtë ka shprehur vullnetin se sendin nuk dëshiron të mbaj,
 - b) pushimi i posedimit në send.

Në paluejtshmëria nuk mund të fitohet pronësia me okupim.

4. E drejta e pronësisë humbet me shkatërrimin e sendit (shkatërrohet objekti në të cilën ekziston pronësia).Sendi mund të shkatërrohet në shumë mënyra (harxhim, shkatërrim nga ana e pronarit, me fuqi madhore, djegieje të sendit.

Në nenin 48 të LMTHMFJ parasheh se e drejta e pronësisë humbet edhe në mënyrat tjera të përcaktuara me ligj

Ndarja e humbjes së pronësisë është :

- a) relative
- b) absolute.

- a) Humbje relative kemi atëherë kur vjen deri te ndërrimi i pronarëve ajo mund të jetë me vullnet apo pavarësisht nga vullneti.
- b) Humbje absolute e pronësisë ekziston kur e drejta e pronësisë shuhet dhe zhduket nga jeta juridike p.sh. kur sendi shkatërrohet, ai humb individualitetin e vetë – krijohet sendi i ri .

Nga gjithë kjo del se mënyrat e fitimit të pronësisë si rregull janë edhe njëkohësisht mënyrat e humbjes së pronësisë për pronarin e mëparshëm.

9.4 Përmbledhje

Në këtë sesion është trajtuar mënyrat e humbjes së pronësisë sipas ligjit të aplikueshëm dhe se pjesëmarrësve janë prezantuar mënyrat e humbjes së pronësisë sipas ligjit të aplikueshëm.

10. E drejta e ndërtimit (Superficies)

10.1 Hyrje

Në këtë sesion do të shpjegohet e drejta e ndërtimit sipas LPDTS. Ky ligj të drejtën e ndërtimit e përkufizon si në vijim: ”e drejta e ndërtimit është e drejtë për të pasur pronësi në ndërtesë, mbi ose nën sipërfaqen e paluajtshmërisë që ekziston ose do të ndërtohet. Objekti i drejtës së ndërtimit nuk mund të jetë një kat, e drejta e ndërtimit është një e drejtë e tjetërsueshme dhe trashëguese dhe mund të ngarkohet me hipotekë.”

E drejta e ndërtimit paraqet një përjashtim nga parimi unitetit të paluajtshmërisë, sepse pronari i paluajtshmërisë është dikush tjetër, ndërsa i ndërtesës dikush tjetër: kohëzgjatja e se drejtës së ndërtimit mund të jetë ma tepër se 99 vite.

10.2 Objektivat trajnuese

Pas përfundimit të këtij sesioni, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Thellojnë njohurit rreth të drejtës së ndërtimit si institutit të ri të së drejtës sendore, se si duhet të krijohet një e drejtë ndërtimi;
- Fitojnë njohuri për përmbajtjen dhe shuarjen e një të drejte ndërtimi;
- Fitojnë njohuri se si të zbatohet ligji aktual në praktikë;
- Marrin njohuri nga praktika gjyqësore lidhur me këto konteste.

10.3 Nocioni

E drejta e ndërtimit është e drejtë sendore në sendin e huaj, por mundet të jetë edhe e drejtë në sendin vet. E drejta e ndërtimit fitohet në bazë të kontratës që lidhet në mes të pronarit të paluajtshmërisë dhe përfituesit, për të cilën merren vesh për krijimin e së drejtës së ndërtimit si dhe regjistrimin në regjistrat të drejtave në paluajtshmëri. Titullari i të drejtës së ndërtimit e fiton të drejtën në tokën e huaj që ta përdorë tokën mbi ose nën sipërfaqe për ndërtim të objektit ndërtimor. Titullari i të drejtës së ndërtimit e fiton pronësinë në ndërtesë, kështu sipas kësaj të drejte kemi dy pronarë: 1 Pronarin e tokës dhe 2 Pronarin e ndërtesës.

LPDTS e njeh unitetin e pronësisë ashtu që me konceptin e paluajtshmërisë si paluajtshmëri konsiderohet toka dhe çdo gjë e lidhur me tokën. Andaj, pronari i tokës konsiderohet edhe pronarë i ndërtesës ose pjesëve tjera të ngulitura me tokën, përveç nëse toka është e ngarkuar me një të drejtë tjetër.

E drejta e ndërtimit bën përjashtimin nga uniteti i pronësisë, respektivisht parimi *superficios solo cedit*. Kështu me themelimin e të drejtës së ndërtimit shfaqen dy të drejta: e drejta e pronësisë së pronarit të tokës dhe e drejta e pronësisë së pronarit të ndërtesës. LPDTS i Kosovës, të drejtën e ndërtimit e përkufizon shprehimisht ku thuhet se e drejta e ndërtimit është e drejtë për të pasur pronësinë e një ndërtesë, mbi ose nën sipërfaqen e paluajtshmërisë dhe objekt. Objekti i së drejtës së ndërtimit është paluajtshmëria që ekziston ose që do të ndërtohet dhe ndërtesa e ndërtuar në bazë të se drejtës së ndërtimit konsiderohet si pjesë përbërëse e se drejtës së ndërtimit .Objekti i së drejtës së ndërtimit nuk mund të jetë në një pjesë të ndërtimit e veçanërisht në një kat, nuk është e lejuar dhe se e drejta e ndërtimit është trashëgueshme dhe tjetërsueshme dhe mund të jetë objekt i hipotekës. Kohëzgjatja e së drejtës së ndërtimit është

caktuar me ligj dhe nuk mund të jetë më tepër se 99 vite, kjo e drejta ndërtimit është një e drejtë e re që është rregulluar me LPDTS. Kohëzgjatja e drejtës së ndërtimit mund të rregullohet me marrëveshje të palëve, por nuk mund të jetë më e gjatë se 99 vjet. Pronari i tokës edhe pas krijimit të drejtës së ndërtimit ruan të drejtën e pronësisë në paluajtshmëri.

E drejta ndërtimit titullarit të saj ia jep dy autorizime: shfrytëzimin e tokës ndërtimore për një periudhë deri 99 vjeçare dhe të drejtën e pronësisë në ndërtesën e ndërtuar. Titullari i drejtës së ndërtimit është edhe pronar i ndërtesave të ndërtuara apo të atyre që ndërtohen, ndërsa paluajtshmëria e ngarkuar është pronësi e pronarit. Titullari i drejtës së ndërtimit ia paguan pronarit të paluajtshmërisë qiranë, titullari i drejtës së ndërtimit është pronar i ndërtesës për kohën sa zgjat e drejta e ndërtimit.

10.4 Fitimi i të drejtës së ndërtimit

Fitimi i të drejtës së ndërtimit behet me kontratë në mes titullarit të tokës dhe titullarit të drejtës së ndërtimit. Mirëpo, e drejta e ndërtimit është e drejtë sendore dhe fitimi i të drejtës bëhet përmes regjistrimit. Kështu, për fitimin e të drejtës së ndërtimit kërkohet të plotësohen dy kushte:

1. Titulli juridik – kontrata dhe
2. Mënyra e themelimit – regjistrimi i të drejtës në regjistrin për të drejtat në paluajtshmëri.

Kontrata për krijimin e drejtës së ndërtimit duhet të jetë në formën me shkrimi dhe të vërtetuar te noteri. Këtë e udhëzon neni 272 të LPDTS. Titulli i krijimit e të drejtës së ndërtimit mund të jetë edhe vendimi i gjykatës edhe pse LPDTS i Kosovës nuk e njeh, por ligjet e rajonit si Kroacia dhe Sllovenia e njohin.

10.5 Përmbajtja e të drejtës së ndërtimit

E drejta ndërtimit është e drejte e kufizuar dhe dallon nga të drejtat tjera të kufizuara për shkak natyrës juridike të saj. Ajo paraqet si fikcion për paluajtshmëri, pasi që është barazuar me paluajtshmërinë. Përmbajtja e të drejtës së ndërtimit caktohet me marrëveshje të palëve siç është pagimi i shpërblimit për paluajtshmëri të ngarkuar, lidhur me ngritjen, mirëmbajtjen dhe përdorimin e ndërtesës, për shkak shkeljes së detyrimeve rreth mirëmbajtjes dhe përdorimit të ndërtesës etj. Ndryshimet në përmbajtjen e të drejtës së ndërtimit mund të bëhen me pëlqimin e pronarit të paluajtshmërisë në të cilën është themeluar e drejta e ndërtimit. Në rastet kur e drejta ndërtimit prek të drejtat e të tjerëve, duhet të kërkohet edhe pëlqimi i tyre sepse sipas rregullës e drejta e ndërtimit është e pa ndryshueshme.

10.6 Mbrojtja e të drejtës së ndërtimit

Titullari i të drejtës së ndërtimit ka të drejtë të përdor të gjitha paditë që vlejné edhe për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë. E drejta e ndërtimit e fituar në paluajtshmërinë në të cilën ende nuk janë ndërtuar ndërtesat për ose lokalet afariste, mbrohet në mënyrë të njëjtë sikurse edhe drejta e servitutit dhe atë me pajtim me nenin 102 LPDTS. Ndërsa për objektet mbi të cilat titullari i të drejtës së ndërtimit e ka të drejtën e pronësisë, mbrojtja do të bëhet sipas rregullave për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë që mund të përdoren edhe për mbrojtjen e pronësisë në objekte dhe lokale afariste.

10.7 Shuarja e të drejtës së ndërtimit

E drejta e ndërtimit shuhet sikurse edhe të drejtat tjera sendore. Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore parasheh mënyrat e shuarjes së drejtës së ndërtimit me dispozitat e neneve 278 - 280 dhe ato janë:

- Me kalimin e kohës së caktuar;
- Mund të shuhet para kohe, me marrëveshje në mes të pronarit të paluajtshmërisë dhe titullarit të drejtës së ndërtimit;
- Me shkatërrimin e sendit;
- Me heqjen dorë të titullarit të drejtës së ndërtimit;
- Për shkak të mos pagesës së shpërblimit për shfrytëzimin e paluajtshmërisë në të cilën është themeluar e drejta e ndërtimit, me të cilën titullari i drejtës së ndërtimit është vonuar në pagesën e kompensimit për shfrytëzim në shumën prej dy pagesave vjetore, pronari i paluajtshmëriës mund të kërkojë nga titullari kthimin e drejtës së ndërtimit.

Në qoftë se e drejta e ndërtimit është ngarkuar me të drejtën e një pale të tretë, nevojitet pëlqimi me shkrim i personit të tretë.

Shuarja e drejtës së ndërtimit juridikisht ndodh me çregjistrimin nga regjistri për regjistrimin e të drejtave në paluajtshmërisë. Paraqitet si dilemë se çka ndodhë me paluajtshnëri të privatizuar ku janë ndërtuar ndërtesa. Në këto raste pronësia mbi ndërtesa është e afatizuar për 99 vite, dhe me kalimin e këtij afati pronari i tokës bëhet edhe pronar i ndërtesës.

10.8 Pasojat e shuarjes të së drejtës së ndërtimit

Me shuarjen e të drejtës së ndërtimit, ndërtesa bëhet pjesës e paluajtshmërisë. Këtu respektohet parimi Superficies solo cedit, çka nënkupton se pronari i paluajtshmërisës behet edhe pronari i ndërtesës dhe atë pas shuarjes të drejtës së ndërtimit. Në këtë mënyrë ruhet uniteti i paluajtshmëriës në Kosovë. Kalimi i drejtës së pronësisë në pronarin e paluajtshmëriës ndodh automatikisht, nëse pronari i paluajtshmëriës dhe titullari i drejtës së ndërtimit nuk janë marrë vesh ndryshe, atëherë pronarit i duhet t'ia paguaj titullarit të së drejtës së ndërtimit vlerën $\frac{1}{4}$ (një të katërtat), të ndërtesës dhe atë sipas vlerës në ditën e mbarimit të ndërtimit. Në qoftë se nuk ka marrëveshje, atëherë vlejnë dispozitat e LPDTS. Nëse e drejta e ndërtimit është ngarkuar me hipotekë shpërblimin e merr nga vlera $\frac{1}{4}$ të ndërtesës, d.m.th asaj pjesë që i takon titullarit të drejtës së ndërtimit, ndërsa pronari i tokës lirohet nga detyrimi i pagimit të shpërblimit. Rregullat e veçanta vlejnë me rastin e përmbarimit të detyrueshëm në një paluajtshmeri që është me të drejtën e ndërtimit

10.9 Përmbledhje

Në përfundim, të këtij sesiioni janë dhënë shpjegime lidhur me të drejtën ndërtimit si një nga institutet e reja të drejtës sendore, mënyrat e fitimit të drejtës së ndërtimit, shuarjes, dhe pasojat e shuarjes të drejtës së ndërtimit.